

TI MUND TA KUPTOSH BIBLËN!

*Letra e Palit ndaj një Kisha të  
Trazuar:  
Letra I dhe II drejtuar  
Korintasve*

BOB UTLEY  
PROFESORI I HERMENEUTIKËS  
(INTERPRETIMI BIBLIK)

*SERI KOMENTARI UDHËZIMESH STUDIMI  
DHJATA E RE, VOL. 6*

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEXAS

## PËRMBAJTJE

SHKURTIME TË PËRDORURA NË KËTË KOMENTAR.....	4
NJË FJALË NGA AUTORI: SI MUND T’JU NDËHMOJË KY KOMENTAR?.....	10
NJË UDHËZUES PËR LEXIM TË MIRË TË BIBLËS:.....	12
NJË KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME .....	12
HYRJA TEK LETRA E PARË DREJTUAR KORINTASVE .....	19
1 KORINTASVE 1 .....	25
1 KORINTASVE 2 .....	68
1 KORINTASVE 3 .....	88
1 KORINTASVE 4 .....	102
1 KORINTASVE 5 .....	113
1 KORINTASVE 6 .....	124
1 KORINTASVE 7 .....	141
1 KORINTASVE 8 .....	165
1 KORINTASVE 9 .....	175
1 KORINTASVE 10 .....	192
1 KORINTASVE 11 .....	208
1 KORINTASVE 12 .....	227
1 KORINTASVE 13 .....	245
1 KORINTASVE 14 .....	254
1 KORINTASVE 15 .....	273
1 KORINTASVE 16 .....	302
HYRJA TEK LETRA E DYTË DREJTUAR KORINTASVE.....	314
2 KORINTASVE 1 .....	319
2 KORINTASVE 2 .....	336
2 KORINTASVE 3 .....	346
2 KORINTASVE 4 .....	356
2 KORINTASVE 5 .....	366
2 KORINTASVE 6:1-7:1 .....	380
2 KORINTASVE 7:2-16 .....	390
2 KORINTASVE 8 .....	397
2 KORINTASVE 9 .....	407
2 KORINTASVE 10 .....	416
2 KORINTASVE 11 .....	423
2 KORINTASVE 12 .....	433
2 KORINTASVE 13 .....	446
PËRCAKTIME TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT .....	453

<b>KRITIKA E TEKSTIT</b> .....	461
<b>FJALORTH</b> .....	465
<b>SHPALLJE DOKTRINORE</b> .....	474

## TEMAT E VEÇANTA: PËRMBAJTJE

<b>I THIRRUR.....</b>	<b>26</b>
<b>KISHA (EKKLESIA).....</b>	<b>27</b>
<b>SHENJTËRIA/SHENJTËRIMI NË DHIATËN E RE .....</b>	<b>28</b>
<b>SHENJTORË.....</b>	<b>29</b>
<b>PAQE (SHALOM) .....</b>	<b>31</b>
<b>ATËSIA E PERËNDISË.....</b>	<b>31</b>
<b>FALENDERIMI .....</b>	<b>33</b>
<b>I PA MËKATË, I PAFAJSHËM, PA FAJ, PA QORTIM.....</b>	<b>38</b>
<b>BESO, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHJATËN E VJETËR.....</b>	<b>40</b>
<b>KOINŌNIA .....</b>	<b>43</b>
<b>BIRI I PERËNDISË .....</b>	<b>44</b>
<b>NGUSHËLLIM.....</b>	<b>45</b>
<b>EMRI I ZOTIT (DHJATA E RE).....</b>	<b>46</b>
<b>PAGËZIMI .....</b>	<b>49</b>
<b>KJO EPOKË DHE EPOKA QË DO TË VIJË.....</b>	<b>52</b>
<b>PLANI I PËRJETSHËM SHPENGUES I YHWH .....</b>	<b>53</b>
<b>NEVOJA PËR TË QËNDRUAR .....</b>	<b>55</b>
<b>MESIA .....</b>	<b>56</b>
<b>ZGJEDHJA/PARAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK.....</b>	<b>58</b>
<b>MISH (SARX).....</b>	<b>60</b>
<b>ANULOJ DHE SHFUQIZOJ (KATARGEŌ).....</b>	<b>61</b>
<b>DREJTËSI .....</b>	<b>62</b>
<b>SHPENGOJ/ÇLIROJ .....</b>	<b>65</b>
<b>PËRNDRITJA/NDRIÇIMI .....</b>	<b>69</b>
<b>FRYMËZIMI.....</b>	<b>69</b>
<b>PËRDORIMI NGA PALI I FJALËVE TË PËRBËRA ME “HUPER” .....</b>	<b>70</b>
<b>MISTER .....</b>	<b>72</b>
<b>FUND OSE PLOTË (TELOS) .....</b>	<b>74</b>
<b>PËRJETË (‘OLAM) .....</b>	<b>76</b>
<b>LAVDIA (DOXA).....</b>	<b>78</b>
<b>EMRAT E PERËNDISË.....</b>	<b>79</b>
<b>TRINIA.....</b>	<b>82</b>
<b>PERSONALITETI I FRYMËS.....</b>	<b>83</b>
<b>ZJARR.....</b>	<b>94</b>
<b>FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE.....</b>	<b>95</b>
<b>KOHËT E FOLJEVE GREQISHT QË PËRDOREN PËR SHPËTIMIN .....</b>	<b>96</b>

<b>I SHENJTË</b> .....	<b>98</b>
<b>PËRDORIMI I PALIT I FJALËS <i>KOSMOS</i> (BOTË)</b> .....	<b>100</b>
<b>DREJTIM SHËRBYES</b> .....	<b>103</b>
<b>DËRGOJ (<i>APOSTELLŌ</i>)</b> .....	<b>108</b>
<b>MBRETËRIA E PERËNDISË</b> .....	<b>111</b>
<b>FRYMË (<i>PNEUMA</i>) NË DHJATËN E RE</b> .....	<b>116</b>
<b>MBURRJA</b> .....	<b>118</b>
<b>MAJA</b> .....	<b>119</b>
<b>VESET DHE VIRTYTET NË DHJATËN E RE</b> .....	<b>121</b>
<b>FEMOHIMI (<i>AFISTĒMI</i>)</b> .....	<b>129</b>
<b>TRASHËGIMIA E BESIMTARËVE</b> .....	<b>131</b>
<b>RIKTHIMI NË ÇDO MOMENT I JEZUSIT PËRKUNDREJT “AKOMA JO”</b> .....	<b>137</b>
<b>GRATË NË BIBËL</b> .....	<b>144</b>
<b>AGJËRIMI</b> .....	<b>147</b>
<b>LIGËSIA SI PERSON</b> .....	<b>147</b>
<b>POROSITË E PALIT PËR SKLLEVËRIT</b> .....	<b>156</b>
<b>PASURIA</b> .....	<b>158</b>
<b>TRUP E FRYMË</b> .....	<b>161</b>
<b>NDËRTOJ</b> .....	<b>167</b>
<b>MONOTEIZMI</b> .....	<b>168</b>
<b>SHKATËRRIMI (<i>APOLLUMI</i>)</b> .....	<b>172</b>
<b>VULA</b> .....	<b>177</b>
<b>BARNABA</b> .....	<b>178</b>
<b>PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT</b> .....	<b>180</b>
<b>KRITICIZËM TEKSTUAL</b> .....	<b>181</b>
<b>SHKALLËT E SHPËRBLIMEVE DHE NDËSHKIMEVE</b> .....	<b>188</b>
<b>DETI I KUQ</b> .....	<b>194</b>
<b>RENDI I SHËRBESES SË PASHKËS NË JUDAIZMIN E SHEKULLIT TË PARË</b> .....	<b>199</b>
<b>ENGJËJ DHE DEMONË</b> .....	<b>201</b>
<b>LIRIA E KRISHTERË PËRKUNDREJT PËRGJEGJËSISË SË KRISHTERË</b> .....	<b>203</b>
<b>A DUHET TA GJYKOJNË TË KRISHTERËT NJËRI-TJETRIN?</b> .....	<b>205</b>
<b>KOKA (<i>KEPHALĒ</i>)</b> .....	<b>211</b>
<b>QËNDRIMET BIBLIKE NDAJ ALKOOLIT DHE ALKOOLIZMIT</b> .....	<b>219</b>
<b>BESËLIDHJA</b> .....	<b>223</b>
<b>FRYMË NË BIBËL</b> .....	<b>229</b>
<b>MALLKIMI (<i>ANATHEMA</i>)</b> .....	<b>232</b>
<b>KRISHTERIMI ËSHTË KOLEKTIV</b> .....	<b>234</b>

<b>PROFECIA NË DHJATËN E VJETËR .....</b>	<b>235</b>
<b>DASHAMIRËSI (HESED) .....</b>	<b>247</b>
<b>SHPRESA (ELPIS, TEK PALI).....</b>	<b>252</b>
<b>PROFECIA NË DHJATËN E RE .....</b>	<b>256</b>
<b>AMEN.....</b>	<b>262</b>
<b>ZEMRA (DHJATA E RE).....</b>	<b>265</b>
<b>PËRDORIMI NGA PALI I GRAVE NË SHËRBESË .....</b>	<b>268</b>
<b>TEORI TË LIDHURA ME “GRATË TË HESHTIN” .....</b>	<b>268</b>
<b>NËNSHTRIMI (HUPOTASSŌ).....</b>	<b>269</b>
<b>KERIGMA E KISHËS SË HERSHME.....</b>	<b>275</b>
<b>QËNDROJ (HISTĒMI).....</b>	<b>277</b>
<b>RINGJALLJA.....</b>	<b>279</b>
<b>SHFAQJET E JEZUSIT PAS RINGJALLJES.....</b>	<b>280</b>
<b>NUMRI DYMBËDHJETË .....</b>	<b>281</b>
<b>JAKOBI, GJYSMË-VËLLAI I JEZUSIT .....</b>	<b>282</b>
<b>I PARËLINDURI .....</b>	<b>286</b>
<b>TERMA TË DHJATËS SË RE PËR KTHIMIN E KRISHTIT .....</b>	<b>286</b>
<b>ARCHĒ .....</b>	<b>288</b>
<b>AUTORITETI (EXOUSIA) .....</b>	<b>289</b>
<b>NIVELE ENJËLLORE NË SHKRIMET E PALIT .....</b>	<b>291</b>
<b>I PAMEND .....</b>	<b>295</b>
<b>SHKATËRROJ, SHKRETOJ, KORRUPTOJ (PHTHEIRŌ) .....</b>	<b>297</b>
<b>BRIRË TË PËRDORUR NGA IZRAELI.....</b>	<b>300</b>
<b>TË JAPËSH TË DHJETËN .....</b>	<b>304</b>
<b>“DERA” NË DHJATËN E RE.....</b>	<b>307</b>
<b>JINI TË FORTË.....</b>	<b>309</b>
<b>MARANATHA.....</b>	<b>312</b>
<b>SOFISTËT.....</b>	<b>314</b>
<b>TIMOTEU.....</b>	<b>321</b>
<b>MUNDIMI (THLIPSIS) .....</b>	<b>324</b>
<b>GARANCI.....</b>	<b>326</b>
<b>ATË DITË.....</b>	<b>330</b>
<b>SIGURIA E SHPËTIMIT .....</b>	<b>333</b>
<b>TEPROJ (PERISEUŌ).....</b>	<b>339</b>
<b>PLANE (TEK PALI).....</b>	<b>340</b>
<b>TITI.....</b>	<b>341</b>
<b>LAVDËRIMI, LUTJA DHE FALENDERIMI I PALIT NDAJ PERËNDISË.....</b>	<b>342</b>

<b>GUXIM (<i>PARRHĒSIA</i>).....</b>	<b>352</b>
<b>JEZUSI DHE FRYMA.....</b>	<b>354</b>
<b>PËRTËRIJ (<i>ANAKAINŌSIS</i>).....</b>	<b>364</b>
<b>TË VDEKURIT, KU JANË ATA? (<i>SHEOL/HADES, GEHENNA, TARTARUS</i>).....</b>	<b>370</b>
<b>KTISIS.....</b>	<b>376</b>
<b>PENDIMI NË DHJATËN E VJETËR .....</b>	<b>393</b>
<b>LËMOSHA.....</b>	<b>411</b>
<b>RRËFIMI .....</b>	<b>414</b>
<b>QIEJT DHE QIELLI I TRETË .....</b>	<b>435</b>
<b>SATANI.....</b>	<b>437</b>
<b>DOBËSIA (<i>ASTHENEŌ</i>).....</b>	<b>439</b>
<b>‘E VËRTETA’ NË SHKRIMET E PALIT.....</b>	<b>449</b>

# SHKURTIME TË PËRDORURA NË KËTË KOMENTAR

- AB Anchor Bible Commentaries [Komentarë të Biblës Ankor], botim i William Foxwell Albright [Uilliam Foksuell Ollbraijt] dhe David Noel Freedman [Dejvid Noel Fridman]
- ABD Anchor Bible Dictionary [Fjalori i Biblës Ankor] (6 volume.), botim i David Noel Freedman [Dejvid Noel Fridman]
- AKOT Analytical Key to the Old Testament [Çelësi Analitik për tek Dhjata e Vjetër] nga John Joseph Owens [Xhon Xhozef Ouens]
- ANET Ancient Near Eastern Texts [Tekste të Lindjes së Afërme Antike], James B. Pritchard [Xhejms Bi Pritçard]
- BDB Një Leksikon i Hebraishtes dhe Anglishtes i Dhjatës së Vjetër nga F. Brown [Ef Braun] , S. R. Driver [Es Ar Drajvër] dhe C. A. Briggs [Si Ej Brigs]
- IDB The Interpreter's Dictionary of the Bible [Fjalori i Interpretuesit të Biblës] (4 volume), botuar nga George A. Buttrick [Xhorxh Ej Batrik]
- ISBE International Standard Bible Encyclopedia [Enciklopedia Ndërkombëtare Standarte Biblike] (5 volume), botuar nga James Orr [Xhejms Orr]
- JB Jerusalem Bible [Bibla Jeruzalem]
- JPSOA Shkrimet e Shenjta sipas Tekstit Mazoretik: Një Përkthim i Ri (The Jewish Publication Society of America [Shoqëria Hebraike e Publikimit e Amerikës])
- KB Leksikoni Hebraik dhe Aramaik i Dhjatës së Vjetër nga Ludwig Koehler [Ludvig Koehler] dhe Walter Baumgartner [Uollter Baumgartner]
- LAM Bibla e Shenjtë nga Dorëshkrimet Antike Lindore (the Peshitta [Peshita]) nga George M. Lamsa [Xhorxh Em Lamsa]
- LXX Septuaginti (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
- MOF Një Përkthim i Ri i Biblës nga James Moffatt [Xhejms Mofat]
- MT Masoretic Hebrew Text [Tekst Hebraik Mazoretik]
- NAB New American Bible Text [Teksti i Biblës së Re Amerikane]
- NASB New American Standard Bible [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan]
- NEB New English Bible [Bibla e Re Angleze]
- NET NET Bible: New English Translation, Second Beta Edition [Bibla NET: Përkthimi i Ri Anglez, Botimi i Dytë Beta]
- NIDOTTE New International Dictionary of Old Testament Theology and Exegesis [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Vjetër dhe Eksegjezës] (5 volume), botuar nga Willem VanGemeren [Uillëm Van Gemeren]



NIV	New International Version [Versioni i Ri Ndërkombëtar]
NJB	New Jerusalem Bible [Bibla e Re e Jeruzalemit]
NRSV	New Revised Standard Bible [Bibla e Re sipas Versionit të Rishikuar]
OTPG	Old Testament Passing Guide [Udhëzuesi i Kalimit të Dhjatës së Vjetër] nga Todd S. Beall [Todd Es Biëll], William A. Banks [William Ej Benks] dhe Colin Smith [Kolin Smith]
REB	Revised English Bible [Bibla Angleze e Rishikuar]
RSV	Revised Standard Version [Versioni Standart i Rishikuar]
SEPT	Septuaginti (Greqisht-Anglisht) nga Zondervan, 1970
TEV	Today's English Version [Versioni Anglez i Sotshëm] nga United Bible Societies [Shoqëritë Biblike të Bashkuara]
YLT	Young's Literal Translation of the Holy Bible [Përkthimi fjalë-për-fjalë i Young i Biblës së Shenjtë] nga Robert Young [Robert Jang]
ZPEB	Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible [Enciklopedia Piktoriale Zondervan e Biblës] (5 volume), botimi i Merrill C. Tenney [Merril Si Tenej]

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# NJË FJALË NGA AUTORI: SI MUND T'JU NDIHMOJË KY KOMENTAR?

Interpretimi biblik është një proces racional dhe shpirtëror i cili përpiqet të kuptojë një shkrimtar antik të frymëzuar në mënyrë të tillë që mesazhi nga Perëndia të mund të kuptohet dhe të zbatohet në kohën tonë.

Proçesi shpirtëror është thelbësor por i vështirë për t'u përkufizuar. Ai përfshin dorëzim tek Perëndia dhe hapje ndaj Perëndisë. Duhet të ketë një uri (1) për Të, (2) për ta njohur Atë dhe (3) për t'i shërbyer Atij. Ky proces përfshin lutjen, rrëfimin dhe gatishmërinë për të ndryshuar stilin e jetesës. Fryma është thelbësore në procesin interpretues, por arsyeja se pse të krishterët e sinqertë dhe të perëndishëm e kuptojnë Biblën në mënyra të ndryshme është një mister.

Proçesi racional është më i lehtë për t'u përshkruar. Ne duhet të jemi të qëndrueshëm dhe të drejtë ndaj tekstit dhe të mos ndikohemi nga paragjykimet tona personale apo denominacionale. Ne të gjithë kushtëzohemi historikisht. Asnjë nga ne nuk është interpretues objektiv dhe neutral. Ky komentari ofron një proces racional të kujdesshëm i cili përmban tre parime interpretimi të strukturuar për të na ndihmuar të tejkalojmë paragjykimet tona.

## Parimi i Parë

Parimi i parë është të vëresh rrethanat historike në të cilat është shkruar libri biblik dhe situatën e veçantë historike për autorësinë e tij. Autori origjinal kishte një qëllim, një mesazh për të komunikuar. Teksti nuk mund të nënkuptojë për ne diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim që të nënkuptonte për autorin origjinal, antik dhe të frymëzuar. Qëllimi i tij, dhe jo nevoja jonë historike, emocionale, kulturore, personale apo denominacionale, është çelësi. Zbatimi është një partner integral për interpretimin, por interpretimi i saktë gjithmonë duhet të paraprijë zbatimin. Duhet të përsëritet e ripërsëritet që çdo tekst biblik ka një dhe vetëm një kuptim. Ky kuptim është ai që autori origjinal biblik kishte për qëllim përmes drejtimit të Frymës për të komunikuar në kohën e tij. Ky kuptim i vetëm mund të ketë shumë zbatime të ndryshme në kultura dhe situata të ndryshme. Këto zbatime duhet të lidhen me të vërtetën qëndrore të autorit origjinal. Për këtë arsye, ky komentari udhëzues studimi është projektuar që të japë një hyrje tek secili libër i Biblës.

## Parimi i Dytë

Parimi i dytë është të identifikosh njësitë letrare. Çdo libër biblik është një dokument i unifikuar. Interpretuesit nuk kanë asnjë të drejtë të izolojnë një aspekt të së vërtetës duke përjashtuar aspektet e tjera. Prandaj ne duhet të synojmë të kuptojmë qëllimin e të gjithë librit biblik përpara se të interpretojmë njësitë individuale letrare. Pjesët individuale – kapitujt, paragrafët apo vargjet – nuk mund të nënkuptojnë diçka që e gjithë njësia nuk e nënkupton. Interpretimi duhet të lëvizë nga një përjasje deduktive e së gjithës në një përjasje induktive të pjesëve. Prandaj, ky komentari udhëzues studimi është dizenuar për të ndihmuar studentin të analizojë strukturën e secilës njësi letrare sipas paragrafëve. Ndarjet në paragrafë dhe kapituj nuk janë të frymëzuara, por ato na ndihmojnë për të identifikuar njësitë e mendimeve.

Të interpretosh në nivel paragrafi – jo nivel fjali, pjesë fjali, fraze apo fjale – është çelësi për të ndjekur kuptimin që ka pasur për qëllim autori biblik. Paragrafët janë të bazuar mbi tema të unifikuara, të quajtura shpesh tematika apo fjali tematike. Çdo fjalë, frazë, pjesë fjali apo fjali në paragraf lidhet në një mënyrë me këtë tematikë të unifikuar. Ato e limitojnë, zgjerojnë, shpjegojnë dhe / ose vënë në pyetje atë. Një çelës i vërtetë për interpretim të saktë është të ndjekësh mendimin e autorit origjinal paragraf-pas-paragrafi përmes njësive individuale letrare të cilat përbëjnë librin biblik. Ky komentari udhëzues studimi është dizenuar për të ndihmuar studentin që ta bëjë këtë duke krahasuar përkthime moderne në anglisht. Këto përkthime janë zgjedhur sepse ato zbatojnë teori të ndryshme përkthimi:

1. Teksti greqisht i United Bible Society [Shoqëria Biblike e Bashkuar] është botimi i katërt i rishikuar (UBS4). Ky tekst është ndarë në paragrafe nga studiues modernë të tekstit.
2. New King James Version (NKJV) [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms] është një përkthim i drejtëpërdrejtë fjalë-për-fjalë i bazuar në traditën greke të dorëshkrimeve të njohur si Textus Receptus. Ndarjet e tij në paragrafe janë më të gjata se sa në përkthime të tjera. Këto njësi më të gjata ndihmojnë studentin të shohë temat e unifikuara.

3. New Revised Standard Version (NRSV) [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar] është një përkthim i modifikuar fjalë-për-fjalë. Ai formon një pikë të mesme midis dy versioneve të mëposhtme moderne. Ndarjet e tij në paragrafe janë mjaft ndihmëse në identifikimin e subjekteve.
4. Today's English Version (TEV) [Versioni Anglisht i Sotshëm] është një përkthim dinamik ekuivalent i publikuar nga Shoqëria Biblike e Bashkuar. Ai përpiket ta përkthejë Biblën në një mënyrë të tillë që lexuesi apo folësi modern i anglishtes të mund ta kuptojë tekstin grek. Shpesh, sidomos tek Ungjijtë, ai ndan paragrafët sipas folësit dhe jo sipas temës, në të njëjtën mënyrë sikurse NIV. Për qëllime të interpretuesit, kjo nuk është ndihmëse. Është interesante të vësh re se të dy versionet UBS4 dhe TEV janë publikuar nga i njëjti entitet, e megjithatë ndarja e tyre në paragrafë ndryshon.
5. Jerusalem Bible (JB) [Bibla Jeruzalem] është një përkthim ekuivalent dinamik i bazuar mbi një përkthim francez katolik. Është shumë ndihmës në krahasimin e paragrafëve nga një perspektivë europiane.
6. Teksti i printuar është botimi i vitit 1995 Updated New American Standard Bible (NASB) [Versioni i Përditësuar i Ri i Biblës Amerikane], i cili është një përkthim fjalë-për-fjalë. Komentet varg pas vargu ndjekin këtë ndarje në paragrafë.

### **Parimi i Tretë**

Parimi i tretë është ta lexosh Biblën në përkthime të ndryshme në mënyrë që të rrokësh gamën më të gjerë të mundshme të kuptimit (fusha semantike) që fjalët apo shprehjet biblike mund të kenë. Shpesh një frazë apo fjalë në greqisht mund të kuptohet në mënyra të ndryshme. Këto përkthime të ndryshme japin këto mundësi dhe të ndihmojnë të identifikosh dhe të shpjegosh variacionet e dorëshkrimeve greke. Ato nuk ndikojnë mbi doktrinën, por na ndihmojnë që të përpiqemi t'i rikthehemi tekstit origjinal të shkruar nga autori antik i frymëzuar.

Ky komentat ofron një mënyrë të shpejtë që studenti të kontrollojë interpretimet e tij. Ai nuk ka për qëllim të jetë përcaktues, por më shumë informues dhe provokues mendimesh. Shpesh, interpretime të tjera të mundshme na ndihmojnë që të mos jemi shumë mendjengushtë, dogmatikë dhe denominacionalë. Interpretuesit kanë nevojë të kenë një gamë më të gjërë mundësish interpretimi që të mund të dallojnë se sa i paqartë mund të jetë teksti antik. Është befasuese se sa pak dakordësim ka midis të krishterëve të cilët pretendojnë se Bibla është burimi i tyre i së vërtetës.

Këto parime më kanë ndihmuar mua të tejkaloj shumë nga kushtëzimet e mia historike duke më detyruar që të përballem me tekstin antik. Shpresa ime është që ky të mund të jetë një bekim edhe për ju.

Bob Utley  
27 qershor 1996

# NJË UDHËZUES PËR LEXIM TË MIRË TË BIBLËS: NJË KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

Materiali në vazhdim është një shpjegim i shkurtër i filozofisë hermeneutike të Dr. Bob Utley si dhe i procedurave të përdorura në komantarët e tij.

[Guide to Good Bible Reading Video -- 40 min.](#) [Udhëzues për Lexim të Mirë të Biblës Video – 40 minuta]

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet ajo? A mund ta verifikojmë atë nga ana logjike? A ka një autoritet përfundimtar? A ka të vërteta absolute të cilat mund të udhëzojnë jetët tona, botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi ne këtu? Ku po shkojmë ne? Këto pyetje, pyetje që të gjithë njerëzit racionalë bëjnë, e kanë munduar intelektin njerëzor që nga fillimi i kohërave (Predi. 1:13-18; 3:9-11). Mbaj mend kërkimin tim personal për një qendër integrale në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në një moshe të re, bazuar kryesisht në dëshminë e njerëzve të mi të dashur në familjen time. Ndërsa u rrita, pyetjet për veten time dhe për botën time gjithashtu rriteshin. Klishetë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk sillnin kuptim në eksperiencat për të cilat lexoja apo përjetoja. Ishte një kohë konfuzioni, kërkimi, dëshirimi dhe shpesh ndjesie për mungesë shprese në përballje me botën e pandjeshme dhe të vështirë në të cilën unë jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje ndaj këtyre pyetjeve thelbësore, por pas kërkimeve dhe reflektimeve, unë arrita në përfundimin se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite antike, (3) përjetesa personale ose (4) projeksione psikologjike. Unë kisha nevojë për një shkallë verifikimi, disa prova, pak racionalitet mbi të cilin të bazoja pikëpamjen time për botën, qendrën time integrale, arsyen time për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin tim të Biblës. Unë fillova të kërkoj për prova të vlefshmërisë së saj, të cilën e gjeta në (1) vlefshmërinë historike të Biblës të konfirmuar me arkeologjinë, (2) saktësinë e profecive të Dhjatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës përgjatë 1600 viteve nga prodhimi i saj dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve, jetët e të cilëve u ndryshuan në mënyrë të përhershme nga kontakti me Biblën. Krishtërimi, si një sistem i unifikuar besimi, ka aftësinë të merret me pyetje komplekse për jetën njerëzore. Jo vetëm jepte kjo një strukturë rationale, por aspekti i përvojës së besimit biblik më solli gëzim dhe stabilitet emocional.

Unë mendoja se e kisha gjetur qendrën integrale për jetën time – Krishti, sikurse e kisha kuptuar përmes Shkrimeve. Ishte një eksperiencë e nxituar, një çlirim emocional. Megjithatë, unë ende e mbaj mend tronditjen dhe dhimbjen që ndjeva kur fillova të kuptoj se sa interpretime të ndryshme të këtij libri mbroheshin, ndonjëherë edhe brenda së njëjtave kisha apo shkollash mendimi. Të pranuarit e frymëzimit apo vlefshmërisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i verifikoj apo refuzoj interpretimet e ndryshme dhe konfliktuese të shumë pasazheve të vështira në Shkrime me ato që pretendonin autoritetin dhe vlefshmërinë e tyre?

Kjo detyrë u bë qëllimi i jetës sime dhe pelegrimi i besimit tim. E dija se besimi im në Krishtin më kishte sjellë shumë paqe dhe gëzim. Mendja ime kishte etje për disa të vërteta absolute në mes të relativitetit të kulturës sime dhe të dogmatizmit të sistemeve fetare konfliktuese dhe arrogancës denominacionale. Në kërkimin tim për përjasje të vlefshme ndaj interpretimit të letërsisë antike, u befasova teksa zbulova paragjykimet e mia historike, kulturore, denominacionale dhe të përvojës. E kisha lexuar shpesh Biblën vetëm për të përforcuar pikëpamjet e mia. Unë e përdorja si një burim për dogmë për të sulmuar të tjerët ndërsa përforcoja pasigurinë dhe papërshtatshmëritë e mia. Sa e dhimbshme ka qënë të kuptoja të arrija në këtë konkluzion!

Megjithëse nuk mund të jem kurrë tërësisht objektiv, unë mund të bëhem një lexues më i mirë i Biblës. Unë mund të kufizoj paragjykimet e mia duke i identifikuar ato dhe duke pranuar që ato ekzistojnë. Unë nuk jam ende i lirë prej tyre, por unë jam përballur me dobësitë e mia. Interpretuesi shpesh është armiku më i keq i leximit të mirë të Biblës! Më lejoni të listoj disa nga presupozimet që unë sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ju, lexuesi, të mund t'i analizoni ato së bashku me mua:

## I. Presupozimet

1. Unë besoj se Bibla është e vetmja vetë-zbulesë e Perëndisë së vetëm të vërtetë. Prandaj, duhet të interpretohet në dritën e qëllimit të autorit origjinal hyjnor përmes një shkrimtari njerëzor në një rethanë specifike historike.


2. Unë besoj se Bibla është shkruar për njerëzit e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia e vendosi Vetveten për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk fsheh të vërtetën – Ai dëshiron që ne ta kuptojmë! Prandaj, duhet të interpretohet në dritën e ditës kur është shkruar, dhe jo kohës sonë. Bibla nuk duhet të nënkuptojë për ne diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim të nënkuptojë për personat e parë që e lexuan apo dëgjuan atë. Ajo është e kuptueshme për mendjen njerëzore normale dhe përdor forma dhe teknika komunikimi normale njerëzore.
3. Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe qëllim të unifikuar. Ajo nuk e kundërshton vetveten, edhe pse përmban pasazhe të vështira dhe paradoksikale. Prandaj, interpreteshi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.
4. Unë besoj se çdo pasazh (duke përjashtuar profecitë) ka një dhe vetëm një kuptim të bazuar në qëllimin e autorit origjinal dhe të frymëzuar. Edhe pse nuk mund të jemi kurrë të sigurtë plotësisht për qëllimin e autorit origjinal, shumë tregues të shpien në këtë drejtim:
  - a. Zhanri (lloji letrar) i zgjedhur për të shprehur mesazhin
  - b. Rrethana historike dhe / ose ndodhia specifike që nxjerr shkrimin
  - c. Konteksti letrar i të gjithë librit ashtu sikurse dhe çdo njësie letrare
  - d. Forma (skica) tekstuale e njësisë letrare ndërsa ato lidhen me të gjithë mesazhin
  - e. Karakteristikat specifike gramatikore të zbatuara për të komunikuar mesazhin
  - f. Fjalët e zgjedhura për të prezantuar mesazhin

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të një pasazhi. Përpara se unë të shpjegoj metodologjinë time për një lexim të mirë të Biblës, me lejoni të përshkruaj disa nga metodat e papërshtatshme të përdorura sot të cilat kanë shkaktuar shumë diversitet në interpretim, dhe për pasojë duhet të shmangen:


## II. Metoda të papërshtatshme

- a. Shpërfillja e kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo fjalie, pjese fjalie apo edhe fjalëve individuale si pohime të së vërtetës të palidhura me qëllimin e autorit apo kontekstin më të madh. Kjo shpesh quhet “proof-texting”.
- b. Shpërfillja e rrethanave historike të librave duke zëvendësuar një rrethanë historike të supozuar e cila ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
- c. Shpërfillja e rrethanave historike të librave dhe leximi i saj si një gazetë e mëngjesit e qytetit e shkruar kryesisht për të krishterët individualë modernë.
- d. Shpërfillja e rrethanave historike të librave duke e alegorizuar tekstin në një mesazh filozofik / teologjik tërësisht të palidhur me lexuesit e parë dhe qëllimin e autorit origjinal.
- e. Shpërfillja e mesazhit origjinal duke zëvendësuar sistemin e vet teologjik, doktrinën vetiake apo çështje kontemporane të palidhura me qëllimin e autorit origjinal dhe mesazhin e pohuar. Ky fenomen shpesh ndjek leximin fillestar të Biblës si një mënyrë për të themeluar autoritetin e folësit. Kjo shpesh i referohet si “reagimi i lexuesit” (interpretimi “çfarë-teksti-më-thotë-mua”).

Të paktën tre përbërës mund të gjenden në të gjitha komunikimet njerëzore të shkruara:



Në të shkruarën, teknika të ndryshme të leximit janë fokusuar në një nga tre përbërësit. Por për të pranuar vërtetë frymëzimin unik të Biblës, një diagram më e modifikuar është më e përshtatshme:



Në të vërtetë të tre përbërësit duhet të përfshihen në procesin e interpretimit. Për qëllime verifikimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori dhe teksti origjinal. Unë me shumë mundësi po reagoj ndaj abuzimeve që kam vënë re (1) duke alegorizuar ose spiritualizuar tekstet dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (çfarë-teksti-më-thotë-mua). Abuzimi mund të ndodhë në secilën nga etapat. Ne duhet gjithmonë të kontrollojmë motivet, paragjykimet, teknikat dhe aplikimet tona. Por si t’i kontrollojmë ato nëse nuk ka kufij për interpretimet, nuk ka limite, nuk ka kriteret? Këtu struktura e qëllimit të autorit dhe të tekstit më japin mua disa kriteret për të kufizuar gamën e interpretimeve të mundshme të vlefshme.

Mbi bazë të këtyre teknikave të papërshtatshme të leximit, cilat janë disa përjasje të mundshme për lexim dhe interpretim të mirë të Biblës të cilat ofrojnë një shkallë verifikimi dhe qëndrueshmërie?

### III. Përjasje të mundshme për lexim të mirë të Biblës

Në këtë pikë nuk po diskutoj teknikat unike të interpretimit të zhanreve specifike por parime të përgjithshme hermeneutike të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për përjasje specifike për zhanërin është *How To Read The Bible For All Its Worth [Si Ta Lexosh Biblën Për Gjithë Vlerën E Saj]* nga Gordon Fee [Gordën Fi] dhe Douglas Stuart [Dagllas Stjuart], të publikuar nga Zondervan.

Metodologjia ime përqendrohet fillimisht tek lexuesi duke lejuar Frymën e Shenjtë që të ndriçojë Biblën përmes katër ciklesh personale të leximit. Kjo e bën Frymën, tekstin dhe lexuesin parësorë dhe jo dytësorë. Kjo gjithashtu e mbron lexuesin nga të qëniti i ndikuar padrejtësisht nga komentatorët. Unë kam dëgjuar të thuhet: “Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret.” Kjo që them nuk ka për qëllim të jetë një koment zhvlerësues për ndihmësit e studimit, por më shumë një lutje për një përdorim në kohën e duhur të tyre. Ne duhet të jemi të aftë të mbështesim interpretimet tona nga vetë teksti. Pesë zona na sigurojnë të paktën verifikime të kufizuara:

1. Rrethanat historike
2. Konteksti letrar
3. Strukturat gramatikore (sintaksa)
4. Përdorimi bashkëkohor i fjalëve
5. Pasazhe paralele të lidhura
6. Zhanri

Ne kemi nevojë të mund të japim arsyet dhe logjikën që qëndron pas interpretimeve tona. Bible është burimi ynë i vetëm për besimin dhe zbatimin. Është e trishtë se të krishterët shpesh nuk bien dakord për atë që ajo mëson apo pohon. Katër ciklet e leximit janë projektuar për të siguruar njohuritë e mëposhtme interpretuese:

1. Cikli i parë i leximit
  - a. Lexojeni librin të tërën njëherëshi. Lexojeni atë sërish në një përkthim tjetër, mundësisht nga një teori tjetër përkthimi
    - (1) Fjalë-për-fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
    - (2) Ekuivalent dinamik (TEV, JB)
    - (3) Perifrazim (Living Bible, Amplified Bible)
  - b. Kërkoni qëllimin qëndror të të gjithë shkrimit. Identifikoni tematikën e tij.
  - c. Izoloni (nëse është e mundur) një njësi letrare, një kapitull, një paragraf ose një fjali e cila qartazi shpreh këtë qëllim apo temë qëndrore.
  - d. Identifikoni zhanrin letrar dominues
    - (1) Dhjata e Vjetër
      - a) Narrative hebraike
      - b) Poezia hebraike (literatura e urtësisë, psalmet)

- c) Profecia hebraike (proza, poezia)
  - d) Kodikët e ligjit
- (2) Dhjata e Re
- a) Narrativat (Ungjijtë, Veprat e Apostujve)
  - b) Shëmbëlltyrat (Ungjijtë)
  - c) Letrat
  - d) Literatura apokaliptike
2. Cikli i dytë i leximit
- a. Lexoni të gjithë librin sërish, përpquni të identifikoni temat apo subjektet kryesore.
  - b. Skiconi temat kryesore dhe shkurtimisht përmbledhni përmbajtjen e tyre në një fjali të thjeshtë.
  - c. Kontrolloni pohimin tuaj të qëllimit dhe skicën e përgjithshme me materiale ndihmuese studimi.
3. Cikli i tretë i leximit
- a. Lexoni të gjithë librin sërish, përpquni të identifikoni rrethanat historike dhe rastet specifike për shkrimin nga vetë libri i Biblës.
  - b. Listoni pjesët historike që përmenden në librin e Biblës
    - (1) autori
    - (2) data
    - (3) marrësi
    - (4) arsyeja specifike pse është shkruar
    - (5) aspektet e rrethanave kulturore që lidhen me qëllimin e shkrimit
    - (6) referencat ndaj njerëzve apo ndodhive historike
  - c. Zgjeroni skicën tuaj në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpretoni. Gjithmonë identifikoni dhe skiconi njësinë letrare. Kjo mund të jetë disa kapituj ose paragrafë. Kjo ju mundëson të ndiqni logjikën e autorit origjinal dhe projektimin e tekstit.
  - d. Kontrolloni rrethanat historike të identifikuar nga ju me materiale ndihmuese studimi.
4. Cikli i katërt i leximit
- a. Lexojeni njësinë specifike letrare sërish në disa përkthime
    - (1) Fjalë-për-fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
    - (2) Ekuivalent dinamik (TEV, JB)
    - (3) Perifrazim (Living Bible, Amplified Bible)
  - b. Kërkoni për strukturat letrare apo gramatikore
    - (1) Fraza të përsëritura, Efes. 1:6,12,14
    - (2) Struktura gramatikore të përsëritura, Rom. 8:31
    - (3) Koncepte kontrastuese
  - c. Listoni pjesët e mëposhtme
    - (1) Terma të rëndësishëm
    - (2) Terma të pazakontë
    - (3) Struktura të rëndësishme gramatikore
    - (4) Veçanërisht fjalë, pjesë fjalie dhe fjali të vështira
  - d. Kërkoni për pasazhe paralele të lidhura
    - (1) Kërkoni pasazhin më të qartë të mësimin mbi temën tuaj duke përdorur a) libra të “teologjisë sistematike”, b) Bibla referencash, c) konkordanca (lista alfabetike).
    - (2) Kërkoni për një çift të mundshëm paradoksikal në brendësi të subjektit tuaj. Shumë të vërteta biblike janë të pranishme në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale kanë ardhur nga *proof-texting*<sup>1</sup> i zbatuar mbi gjysmën e një pasazhi biblik. E gjithë Bibla është e frymëzuar dhe ne duhet të përpqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që të japë një ekuilibër shpirtëror për interpretimin tonë.
    - (3) Kërkoni për paralelizma brenda të njëjtit libër, i njëjti autor ose i njëjti zhanër; Bibla është interpretuesi më i mirë i saj sepse ka vetëm një autor, Frymën.

<sup>1</sup> Shkëputja e një pasazhi nga Bibla dhe nxjerrja nga konteksti. (Shënim i përkthyesit)

- e. Përdorni materiale ndihmëse studimi për të kontrolluar vëzhgimet tuaja të rrethanave dhe ndodhive historike
  - (1) Bibla studimi
  - (2) Enciklopedi, manuale dhe fjalorë biblikë
  - (3) Hyrje në Bibël
  - (4) Komentarë biblikë (në këtë pikë në studimin tuaj, lejoni komunitetin e besimit, të shkuar dhe të tashëm, që t'ju ndihmojnë dhe t'ju korrigjojnë studimin tuaj personal.)

#### IV. Zbatimi i Interpretimit Biblik

Në këtë pikë kalojmë tek zbatimi. Ju keni investuar kohë për të kuptuar tekstin dhe rrethanat e tij origjinale; tani duhet ta zbatoni atë në jetën tuaj, në kulturën tuaj. Unë e përkufizoj autoritetin biblik si “të kuptosh atë që autori origjinal biblik ka qënë duke iu thënë bashkëkohësve të tyre dhe ta zbatosh atë në ditët tona.”

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e qëllimit të autorit origjinal si në kohë dhe në logjikë. Ne nuk mund të zbatojmë një pasazh biblik në ditët tona deri në momentin që nuk e dimë se çfarë po i komunikonte dëgjuesve të ditës kur është shkruar! Një pasazh biblik nuk duhet të nënkuptojë kurrë diçka që nuk ka pasur kurrë për qëllim që ta nënkuptojë!

Skica juaj e detajuar, në nivel paragrafi (lexoni ciklin tre të leximit), do të jetë udhëzuesi juaj. Zbatimi duhet të bëhet në nivel paragrafi, dhe jo në nivel fjale. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; pjesët e fjalive kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar i përfshirë në procesin interpretues është autori origjinal. Ne vetëm mund të ndjekim udheheqjen e tij nga ndriçimi i Frymës së Shenjtë. Por ndriçimi nuk është frymëzim. Që të themi: “kështu thotë Zoti,” ne duhet të qëndrojmë në qëllimin e autorit origjinal. Zbatimi duhet të lidhet specifikisht me qëllimin e përgjithshëm të të gjithë shkrimit, njësinë specifike letrare dhe nivelin e paragrafit për të zhvilluar mendime.

Mos lejoni çështjet e ditëve tona të interpretojnë Biblën; lejoni Biblën të flasë! Kjo mund të na kërkojë që të vendosim disa parime nga teksti. Kjo vlen nëse teksti mbështetet mbi një parim. Fatkeqësisht, shumë herë parimet tona janë thjesht ato, parimet “tona”, jo parimet e tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të mbajmë mend se (përveçse në profeci) një dhe vetëm një kuptim vlen për një tekst specifik biblik. Ai kuptim lidhet me qëllimin origjinal të autorit ndërsa ai i drejtohet një krize apo nevojë në ditën e tij. Shumë zbatime të mundshme mund të nxirren nga ky kuptim. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve por duhet të lidhet me kuptimin e autorit origjinal.

#### V. Aspekti Shpirtëror i Interpretimit

Derimë tani kam diskutuar procesin logjik të përfshirë në interpretim dhe zbatim. Tani më lejoni të diskutoj shkurtimisht aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme e kontrolleve ka qënë ndihmëse për mua:

1. Lutuni për ndihmën e Frymës së Shenjtë (shih I Kor. 1:26-2:16).
2. Lutuni për falje personale dhe pastrim nga mëkati që dini (shih I Gjoni 1:9).
3. Lutuni për një dëshirë më të madhe për ta njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e në vazhdim.; 119:1 e në vazhdim).
4. Zbatoni menjëherë në jetën tuaj çdo zbulesë të re.
5. Qëndroni i përgjatur dhe me dëshirë për të mësuar.

Është kaq e vështirë të mbash një ekuilibër midis procesit logjik dhe drejtimit shpirtëror të Frymës së Shenjtë. Citimet e më poshtme më kanë ndihmuar mua që të ekuilibroj këto të dyja:

1. Nga James W. Sire [Xhejms Dabëllju Sajër], Kthimi i Shkrimeve, fq. 17-18:  
 “Iluminimi vjen në mendjet e popullit të Perëndisë – jo thjesht tek një elitë frymore. Nuk ka një klasë gurush në krishtërimin biblik, nuk ka “iluminati”, nuk ka njerëz përmes të cilëve të vijnë të gjitha interpretimet e sakta. Dhe gjithashtu, ndërsa Fryma e Shenjtë na jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe dallimi frymor, Ai nuk na i cakton këta të krishterë me dhunti që të jenë të vetmit interpretues me autoritet të Fjalës së Tij. Varet nga secili person i popullit të Tij për të mësuar, për të gjykuar dhe për të dalluar me referencë ndaj Biblës se cila qëndron si autoritet edhe ndaj atyre që Perëndia iu ka dhënë aftësi të veçanta. Për ta përmbledhur, supozimi që unë po bëj përgjatë gjithë librit është se Bibla është zbulesa e vërtetë e Perëndisë ndaj gjithë



njerëzimit, është autoriteti ynë vendimtar mbi të gjitha çështjet për të cilat ajo flet, nuk është një mister total por mund të kuptohet në mënyrë të përkorë nga njerëz të zakonshëm në çdo kulturë.”

2. Mbi Kierkegaard [Kirkegardin], gjendur tek Bernard Ramm [Bernard Ram], Interpretime Biblike Protestante, fq. 75:  
Sipas Kierkegaard [Kirkegardit], studimi gramatik, leksikor dhe historik i Biblës ishte i nevojshëm së pari për një lexim të vërtetë të Biblës. “Për të lexuar Biblën si Fjala e Perëndisë, ne duhet ta lexojmë atë me zemrën e etur, në majë të gishtave, me pritshmëri të etur, në bisedë me Perëndinë. Të lexosh Biblën pa e menduar ose në mënyrë të shkujdesur ose në mënyrë akademike apo profesionale nuk është të lexosh Biblën si Fjala e Perëndisë. Nëse e lexon atë si një letër dashurie, atëherë vërtetë e lexon atë si Fjala e Perëndisë.”
3. H. H. Rowley [Ejç Ejç Roullej] në Lidhja e Biblës, fq. 19:  
“Asnjë i kuptuar thjesht intelektual i Biblës, sado i plotë, nuk mund të marrë të gjithë thesaret e saj. Ai nuk përçmon këtë të kuptuar, sepse është thelbësor për një të kuptuar të plotë. Por duhet që të drejtojë për tek një i kuptuar frymor i thesareve shpirtërore të këtij libri nëse duhet të jetë i plotë. Dhe për këtë të kuptuar frymor nevojitet diçka më shumë se sa vigjilencë intelektuale. Gjërat frymore dallohen frymërisht dhe studenti i Biblës ka nevojë për një qëndrim shpirtëror marrës, një etje për të gjetur Perëndinë që ai të mund t’i nënshtrohet Atij, nëse dëshiron që të shkojë përtej studimit të tij shkencor për tek trashëgimia më e pasur e librit më të madh nga të gjithë librat.”

## VI. Metoda e Këtij Komentari

Komentari Udhëzues i Studimit është dizenuar për të ndihmuar procedurat tuaja interpretuese në mënyrat e mëposhtme:

1. Një skicë e shkurtër historike bën hyrjen në çdo libër. Pasi keni bërë “ciklin tre të leximit”, kontrolloni këtë informacion.
2. Gjenden njohuri kontekstuale në fillim të çdo kapitulli. Kjo do t’ju ndihmojë të shihni se si është e strukturuar njësia letrare.
3. Në fillim të çdo kapitulli apo njësie të rëndësishme letrare, jepen ndarjet në paragrafë apo titujt e tyre përshkrues nga disa përkthime moderne:
  - a. Teksti grek i United Bible Society (UBS4) [Shoqërisë Biblike të Bashkuar], botimi i katërt i rishikuar
  - b. New American Standard Bible (NASB) [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan], përditësim i vitit 1995
  - c. New King James Version (NKJV), [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms]
  - d. New Revised Standard Version (NRSV), [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar]
  - e. Today’s English Version (TEV), [Versioni Anglisht i Sotshëm]
  - f. New Jerusalem Bible (NJB), [Bibla e Re e Jeruzalemit]

Ndarjet në paragrafë nuk janë të frymëzuara. Ato duhet të konstatohen nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime modern nga teori të ndryshme përkthimi dhe perspektiva të ndryshme teologjike, ne jemi të aftë të analizojmë strukturën e supozuar të mendimit të autorit origjinal. Çdo paragraf ka një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalja e temës” ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretim të saktë historik dhe gramatikor. Askush nuk duhet të interpretojë, predikojë ose japë mësim në më pak se një paragraf! Gjithashtu mbani mend se çdo paragraf lidhet me paragrafët e tij pararendës ose vijues. Kjo është arsyeja pse skicimi në nivel paragrafi i të gjithë librit është kaq i rëndësishëm. Ne duhet të jemi të aftë të ndjekim logjikën e subjektit që është adresuar nga autori origjinal i frymëzuar.

4. Shënimet e Bob-it ndjekin një përjasje varg-pas-vargu ndaj interpretimit. Kjo na përcakton që të ndjekim mendimin e autorit origjinal. Shënimet japin informacion nga disa zona:
  - a. Konteksti letrar
  - b. Njohuri historike, kulturore
  - c. Informacion gramatikor

- d. Studime fjalësh
  - e. Pasazhe paralele të lidhura
5. Në pika të caktuara në komantar, teksti i printuar i New American Standard Version [Bibla sipas Standartit të Ri Amerikan] (përditësim i vitit 1995) do të plotësohet nga përkthimet e disa versioneve të tjera moderne:
- a. New King James Version (NKJV), [Versioni i Ri i Mbretit Xhejms] i cili ndjek një dorëshkrim tekstual të “Textus Receptus.”
  - b. New Revised Standard Version (NRSV), [Bibla sipas Versionit të Ri të Rishikuar], e cila është një rishikim fjalë-për-fjalë nga Këshilli Kombëtar i Kishave të Versionit Standard të Rishikuar.
  - c. Today’s English Version (TEV), [Versioni Anglisht i Sotshëm], i cili është një përkthim dinamik ekuivalent nga Shoqëria Amerikane Biblike.
  - d. Jerusalem Bible (JB), [Bibla e Jeruzalemit], i cili është një përkthim në anglisht i bazuar mbi një përkthim ekuivalent dinamik katolik francez.
6. Pë rata që nuk e lexojnë greqishten, të krahasosh përkthimet në anglisht mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
- a. Variacionet e dorëshkrimeve
  - b. Kuptimet alteranative të fjalëve
  - c. Struktura dhe tekstet e vështira gramatikore
  - d. Tekstet e paqarta

Edhe pse përkthimet në anglisht nuk mund t’i zgjidhin këto probleme, ato synojnë të jenë vende për studim më të thellë dhe më të hollësishëm.

Në fund të çdo kapitulli ka pyetje diskutimi të lidhura të cilat përpiqen që të adresojnë çështjet më të mëdha interpretuese të atij kapitulli.

# HYRJA TEK LETRA E PARË DREJTUAR KORINTASVE

(KËSHILLA PRAKTIKE NDAJ NJË KISHE TË TRAZUAR)

## I. VEÇANTIA E LETRËS SË PARË DREJTUAR KORINTASVE

- A. Citohet më shpesh dhe më herët nga etërit e kishës së hershme se sa çdo shkrim tjetër i Palit, e cila dëshmon për rëndësinë dhe dobinë e kësaj letre.
- B. Në Fragmentin Muratorian, i cili ishte një listë e librave kanonikë nga Roma (viti 200 pas Krishtit), listohet si letra e parë e shkrimeve të Palit, që gjithashtu dëshmon për rëndësinë e saj.
- C. Pali bën një dallim në këtë letër praktike midis mendimit të tij personal dhe urdhërimeve të Zotit. Megjithatë, kjo bazohet në njohuritë e tij për mësimet e Jezusit mbi subjektet që trajtohen. Nëse ai do të mundte, ai do të transmetonte fjalët e Jezusit. Ai besonte se edhe mendimet e tij ishin të frymëzuara dhe me autoritet (shih 1 Kor. 7:25, 40).
- D. Parimi udhëzues i Palit për marrëdhënie në kishë është që liria e besimtarëve individualë, por gjithashtu edhe përgjegjësia e tyre e përbashkët sipas proporcionit përkatës, nuk bazohet mbi ligjin por mbi dashurinë. Shëndeti dhe rritja e të gjithë kishës shfuqizon çdo preferencë apo privilegj personal (shih 1 Kor. 12:7).
- E. Kjo letër (së bashku me letrën II drejtuar Korintasve) na jep një pamje të hershme tek kisha e Dhjatës së Re, struktura, metodat dhe mesazhi i saj. Megjithatë, gjithashtu duhet mbajtur mend se kjo kishë ishte një grigjë problematike, jo-tipike.

## II. QYTETI I KORINTIT

- A. Korsitë transportuese të dimrit përreth pikës më jugore të Greqisë (dmth., Kepi Malea) ishin shumë të rrezikshme. Prandaj, një rrugë tokësore e gjatësisë më të shkurtër të mundshme ishte thelbësore. Vendndodhja gjeografike e Korintit në isthmusin prej 4 milje midis Gjirit të Korintit (dmth., Deti Jon) dhe Gjirit Saronik (dmth., Deti Egje) e bënin qytetin një qendër të rëndësishme biznesi transportues, tregtues (i specializuar në llojet e poçeve dhe një lloj të veçantë tunxhi) dhe ushtarake. Në kohën e Palit ky ishte vërtet vendi ku kulturat Perëndimore dhe Lindore takoheshin.
- B. Korinti ishte gjithashtu një qendër e rëndësishme kulturore e botës Greko-Romake sepse në të mbaheshin dy herë në vit lojërat Isthmiane të cilat nisën në vitin 581 para lindjes së Krishtit (në tempullin e Poseidonit). Vetëm Lojërat Olimpikë që mbaheshin në Athinë, çdo katër vjet, mund t'i konkurronin ato në përmasa dhe rëndësi (Thucydides, *Hist.* 1.13.5).
- C. Në vitin 146 para lindjes së Krishtit, Korinti u përfshi në një revoltë (dmth., Liga Akeane) kundër Romës dhe u shkatërrua nga Gjenerali Romak Lucius Mummius dhe popullata greke u shpërbë në skllavëri. Për shkak të rëndësisë së saj ekonomike dhe ushtarake, ai u rindërtua ose në vitin 46 ose në vitin 48 përpara Krishtit nga Julius Caesar. Ai u bë një koloni romake ku ushtarët romakë qëndronin në periudhën e pensionit. Ishte një imitim i Romës në arkitekturë dhe kulturë dhe ishte qendra administrative e provincës romake (dmth., Senatoriali) të Akaias në vitin 27 para lindjes së Krishtit. Ajo u bë provinca perandorake në vitin 15 pas lindjes së Krishtit.
- D. Akropoli i Korintit të Vjetër, i ngritur në mbi 570 metra mbi sipërfaqje, ishte vendndodhja e tempullit të Afroditës. Tek ky tempull rrinin 1,000 prosituta (Strabo, *Geography*, 8.6.20-22). Që të quheshe “një korintas”, (dmth., *Korinthiazesthai*, i cituar nga Aristophanes [450-385 para Krishtit]) ishte sinonim me një stil jetese të lirshëm, të tërbuar. Ky tempull, sikurse pjesa më e madhe e qytetit, u shkatërrua nga një tërmet rreth 150 vjet përpara se të vinte Pali aty, sikurse ndodhi sërish në vitin 77 pas Krishtit. Është e pasigurtë nëse kulti i pjellorisë vazhdonte në kohën e Palit. Duke qënë se romakët, në vitin 146 pas

Krishtit, shkatërruan qytetin dhe vranë ose skllavëruan të gjithë qytetarët e tij, shija greke e qytetit u zëvendësua me statusin e saj të kolonisë romake (Pausanias, II.3.7). Ky kontekst kulturor romak në vend të kulturës greke, bën dallimin në interpretimin e letrës së parë drejtuar Korintasve.

### III. AUTORI

- A. Në këtë qytet erdhi apostulli Pal në udhëtimin e tij të dytë misionar; për të shkruhet tek Veprat e Apostujve 18:1-21. Përmes një vegimi që Zoti i zbuloi Palit, shumë besuan dhe asnjë kundërshti e suksesshme nuk i qëndroi shërbesës së tij (shih Veprat e Apo. 18:9-10).
- B. Strategjia misionare e Palit ishte të mbillte një kishë në qytetet e mëdha të kohës së tij, duke e ditur se vizitorët, biznesmenët që udhëtonin dhe marinarët e konvertuar do ta shpërndanin ungjillin ndërsa vazhdonin rrugëtimin e tyre. Pastaj varej nga kisha e tyre lokale që të merrnin përgjegjësinë për ungjillizimin dhe dishepullizimin e zonës së tyre.
- C. Pali gjeti Akuilën dhe Prishilën, të cilët gjithashtu ishin tenda-bërës ose punues lëkure besimtarë hebrej, në Korint. Ata i përzunë nga Roma në vitin 49 pas Krishtit mbi bazë të dekretit të Klaudius-it (Orosius, *Hist.* 7:6:15-16) kundër çdo riti apo rituali hebre (shih Veprat e Apo. 18:2). Pali kishte ardhur në Korint vetëm. Të dy, Silasi dhe Timoteu, ishin me detyrë në Maqedoni (shih Veprat e Apo. 18:5). Ai ishte shumë i dekurajuar (shih Veprat e Apo. 18:9-19; 1 Kor. 2:3). Megjithatë, ai ngulmoi dhe qëndroi në Korint për tetëmbëdhjetë muaj (shih Veprat e Apo. 18:11).
- D. Autorësia e Palit për këtë libër u vërtetua nga Klementi i Romës, i cili i shkroi një letër Korintit në vitin 95/96 pas Krishtit (*I Clement* 37:5; 47:1-3; 49:5). Autorësia e Palit për këtë letër nuk është dyshuar kurrë, madje as nga studiuesit kritikë modernë.

### IV. DATA

- A. Data e vizitës së Palit në Korint është konstatuar nga një mbishkrim i Perandorit Klaudius të gjetur tek Delphi, i cili daton në kohën e guvernatorit Gallio, i cili ishte në detyrë që në korrik të vitit 51 pas Krishtit deri në korrik të vitit 52 (shih Veprat e Apo. 18:12-17), fakte që e bëjnë mbërritjen e Palit të datojë rreth viteve 49-50 pas Krishtit.
- B. Data e letrës së Palit është diku tek mesi i viteve 50-të. Ai e shkroi atë nga Efesi ku ai shërbeu nga dy vjet (shih Veprat e Apo. 19:10) dhe tre vjet (shih Veprat e Apo. 20:31).
- C. Një kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit e ndjekur nga F. F. Bruce dhe Murry Harris me përshtatje të vogla:

	<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat e Apostujve</u>
1	Galatasve	48	Antiokia Siriane	Veprat 14:28; 15:2
2	1 Thesalonikasve	50	Korinti	Veprat 18:5
3	2 Thesalonikasve	50	Korinti	
4	1 Korintasve	55	Efesi	Veprat 19:20
5	2 Korintasve	56	Maqedonia	Veprat 20:2
6	Romakëve	57	Korint	Veprat 20:3
7-10	Letra ndaj të burgosurve			
	Kolosianëve	Në fillim të viteve 60-të	Romë	
	Filemoni	Në fillim të viteve 60-të	Romë	
	Efesianëve	Në fillim të viteve 60-të	Romë	
	Filipianëve	Në fund të viteve 62-63	Romë	Veprat 28:30-31
11-13	Udhëtimi i katërt misionar		Efesi (?)	

1 Timoteu Titi	63 (ose më vonë, 63 përpara viti 64 pas lindjes së Krishtit, 68)	Maqedoni
2 Timoteu		Romë

## V. DËGJUESIT E LETRËS

- A. Marrësit / dëgjuesit e letrës ishte kisha e re e përbërë më së shumti nga johebrenj. Popullsia e Korintit ishte e përzierë nga ana raciale dhe kulturore. Ne e dimë nga arkeologjia dhe Shkrimet (shih Veprat e Apo. 18:4-8) që gjendej një sinagogë në Korint.
- B. Ushtarët romakë kalonin atje kohën e pensionit pasi kishin përfunduar njëzet vite shërbimi ushtarak. Korinti ishte një qytet i lirë, një koloni romake dhe kryeqyteti i provincës romake të Akaias.
- C. Letra duket se reflekton disa grupe në kishë:
1. Grekët intelektualë të cilët ishin ende shumë krenarë për traditat e tyre filozofike dhe po përpiqeshin të lidhnin zbuluesën e krishterë me këto zakone të vjetra dhe tradita intelektuale
  2. Padronët romakë dhe elita sociale
  3. Një kontigjent hebrenjsh besimtarë së bashku me një grup johebrenjsh “që kishin frikë Perëndinë”, të cilët merrnin pjesë në sinagogë
  4. Një numër i lartë skllëvërish të konvertuar

## VI. QËLLIMI I LETRËS

- A. Pali dëgjoji problemet që ishin zhvilluar në Korint nga këto burime
1. Njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11
  2. Një letër nga kisha që i bënte pyetje, 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12
  3. Një vizitë personale nga Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17
- Është e mundur që letra (pika numër 2) të jetë dërguar nga këta burra (pika numër 3)
- Është interesante që Murry Harris ka skicuar librin e letrës së parë drejtuar Korintasve të bazuar mbi informacionin që Pali kishte marrë rreth kishës.
1. Raportim gojor nga anëtarë të shtëpisë së Kloes, që rezultoi në shkrimin e kapitujve 1 Kor. 1-4 nga Pali
  2. Raportim gojor nga përfaqësues të kishës (dmth., Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku), që rezultoi në kapitujt 1 Kor. 5-6
  3. Pyetje të shkruara nga kisha, që rezultuan në kapitujt 1 Kor. 7-16
- B. Kisha ishte përçarë, duke mbrojtur drejtues të ndryshëm: Palin, Apollin, Pjetrin dhe ndoshta një parti të Krishterë (shih 1 Kor. 1:12). Jo vetëm ishte kisha e ndarë mbi llojet e drejtimit, por gjithashtu edhe mbi disa çështje morale dhe përdorimi i dhuntive frymore. Një pikë kryesore e grindjeve ishte autoriteti apostolik i Palit (sidomos në letrën e dytë drejtuar Korintasve)!

## VII. KONTAKTET E PALIT ME KISHËN KORINTASE – NJË PROPOZIM I MUNDSHËM

- A. Sa letra i shkroi Pali kishës në Korint?
1. Vetëm dy, letrën e I dhe II drejtuar Korintasve
  2. Tre, dhe një letër është humbur
  3. Katër, dhe dy letra kanë humbur
  4. Disa studiues modernë gjejnë pjesë të dy letrave të humbura në 2 Korintasve
    - a. Një letër e mëparshme (1 Kor. 5:9, tek 2 Kor. 6:14-17:1)
    - b. Një letër e ashpër (2 Kor. 2:3-4,9; 7:8-12, tek 2 Kor. 10-13)

5. Pesë, ku 2 Kor. 10-13 janë letra e pestë, e dërguar pas raportimit të Titit të lidhur me lajme të tjera të këqija

B. Teoria numër 3 duket se i përshtatet më mirë

1. Letra e mëparshme, e humbur (1 Kor. 5:9)
2. 1 Korintasve
3. Letër e ashpër, e humbur (ku mundësisht pjesë prej së cilës janë regjistruar tek 2 Kor. 2:1-11; 7:8-12)
4. 2 Korintasve

C. Një rikonstruktim i propozuar

<b>DATA</b>	<b>VIZITA</b>	<b>LETRA</b>
Viti 50-52 pas Krishtit, Udhëtimi i Dytë Misionar i Palit	a. Gjatë Udhëtimit të tij të Dytë Misionar, Pali qëndroi në Korint për 18 muaj (shih Veprat e Apo. 18:1-11)	a. 1 Kor. 5:9-11 duket se i referohet një letre mbi situatën imorale në kishë. Kjo letër është e panjohur, vetëm nëse: (1) sikurse disa supozojnë, se 2 Kor. 6:14-7:1 është pjesë e saj ose (2) se 2 Kor. 2:3,4,9 janë forma aoriste të letrës dhe i referohet 2 Korintasve.
Viti 52 pas Krishtit, Gallio ishte prokonsull nga viti 51 pas Krishtit (shih Veprat e Apo. 18:12-17)		
Viti 56 pas Krishtit (pranverë)	b. Pali dëgjon për problemet në kishë ndërkohë që ai është në Efes nga dy burime: (1) njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11 dhe (2) Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17. Ata me sa duket sollën një letër nga kishat e shtëpive korintase që përmbante pyetje	
Viti 56 pas Krishtit (dimër) ose viti 57 pas Krishtit (dimër)		b. Pali i përgjigjet këtyre pyetjeve (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,2) duke shkruar letrën e parë drejtuar Korintasve. Timoteu (shih 1 Kor. 4:17) merr përgjigjen nga Efesi (shih 1 Kor. 16:8) tek Korinti. Timoteu nuk mund t'i zgjidhte problemet në kishë.
	c. Pali bëri një vizitë urgjente dhe të dhimbshme në Korint (të paregjistruar tek Veprat e Apostujve, shih 2 Kor. 2:1). Ajo nuk rezultoi e suksesshme, por ai u betua se do të rikthehej.	
		c. Pali shkroi një letër të ashpër (shih 2 Kor. 2:3-4:9; 7:8-12) ndaj kishave të shtëpive korintase, letër e cila u dorëzua nga Titi (shih 2 Kor. 2:13; 7:13-15). Kjo letër është e panjohur, vetëm nëse, sikurse disa supozojnë, pjesë e saj është tek 2

Kor. 10-13.

d. Pali planifikonte të takonte Titin në Troas, por Titi nuk kishte ardhur, kështuqë Pali shkoi në Maqedoni (shih 2 Kor. 13; 7:5,13), ndoshta Filipi (shih MSS B<sup>c</sup>, K, L, P).

d. Ai gjeti Titin dhe dëgjoi që kisha i ishte përgjigjur drejtimit të tij dhe ai më pas shkroi 2 Korintasve me shumë falenderim (shih 7:11-16). Kjo letër u dorëzua nga Titi.

Viti 57-58 pas Krishtit (dimër)

e. Vizita e fundit e Palit për në Korint e regjistruar duket se ka referencë tek Veprat e Apo. 20:2-3. Edhe pse ajo nuk e përmend Korintin me emër, ajo e nënkupton atë. Ai qëndroi atje gjatë muajve të dimrit.

e. Ndryshimi në qëndrim nga kapitujt 1-9 dhe 10-13 shpjegohet nga disa studiues si më shumë si një lajm i keq (ndoshta rivitalizimi i kundërshtarëve të vjetër dhe shtimi i kundërshtarëve të rinj) nga kishat e shtëpive korintase pasi kapitujt 1-9 ishin shkruar (F. F. Bruce).

## VIII. PËRFUNDIMI

- A. Tek 1 Korintasve ne shohim Palin, një pastor, që merret me një problem të kishës. Në këtë letër dhe tek letra drejtuar Galatasve ne e shohim atë të verë në zbatim të vërtetën universale të ungjillit në mënyra të ndryshme, të bazuar në nevojat e kishës: liria për kishat galatase / kufizimi për kishën korintase.
- B. Ky libër është ose një seri “dinosaurësh kulturorë” ose një pasuri të vërtetash primore të zbatuara tek një rrethanë e caktuar historike / kulturore. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ngatërrojmë të vërtetën me zbatimet kulturore të asaj të vërtete. Për një diskutim të mirë të kësaj çështjeje mjaft të rëndësishme hermeneutike shihni librin e Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart *How To Read the Bible for All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj] fq. 65-76 dhe Gordon Fee, *Gospel and Spirit* [Ungjilli dhe Fryma].
- C. Ky libër do t’ju shtyjë në limitin e aftësisë tuaj frymore për të interpretuar Biblën. Ai do t’ju detyrojë të rimondoni aspektet e teologjisë tuaj. Ai do të hapë një derë për vullnetin e Perëndisë në ditët tona, duke folur në mënyrë praktike, sikurse pak shkrime të tjera biblike.

## IX. SKICIM I SHKURTËR I LETRËS SË PARË DREJTUAR KORINTASVE

- A. Hyrja tek 1 Kor. 1:1-9
  - 1. Përshëndetje, 1 Kor. 1:1-3
  - 2. Falenderime, 1 Kor. 1:4-9
- B. Probleme të raportuara në Korint, 1 Kor. 1:10-6:20
  - 1. Ndarje brenda kishës për shkak të keqkuptimit të motiveve dhe mesazhit të drejtuesve të krishterë (dmth., Pali, Apolli, Pjetri), 1 Kor. 1:10-4:12
  - 2. Imoralitet shokues, 1 Kor. 5:1-13
  - 3. Proçedim i krishterë, 1 Kor. 6:1-11
  - 4. Liria e krishterë e kufizuar me përgjegjësi, 1 Kor. 6:12-20
- C. Një letër nga Korinti që bën pyetje të bezdisshme, 1 Kor. 7:1-1-16:4
  - 1. Seksualiteti njerëzor, 1 Kor. 7:1-40

2. Marrëdhënia me një kulturë idhujtarie dhe liria e Krishterë, 1 Kor. 8:1-11:1
3. Adhurimi dhe spiritualiteti i krishterë, 1 Kor. 11:2-14:40
4. Dritë mbi eskatologjinë, sidomos ringjalljen, 1 Kor. 15:1-58
5. Kontributi për kishën mëmë në Jeruzalem, 1 Kor. 16:1-4

D. Shënime përmbyllëse

1. Planet për udhëtim të Palit (dhe personave të tjerë që shërbenin me të), 1 Kor. 16:5-12
2. Porositë e fundit dhe përshëndetjet, 1 Kor. 16:13-24

## X. LEXIME TË SUGJERUARA MBI MENDIMET E PALIT

- A. *The Mind of St. Paul* [Mendja e Shën Palit], William Barclay, publikuar nga Harper & Row
- B. *Paul, Apostle of the Heart Set Free* [Pali, Apostulli me Zemrën e Liruar], F. F. Bruce, publikuar nga Eerdmans
- C. *The Origins of Paul's Religion* [Origjinat e Fesë së Palit], J. Gresham Machen, publikuar nga Eerdmans
- D. *Paul, An Outline of His Theology* [Pali, Një Skicim i Teologjisë së Tij], Herman Ridderbos (përkthyer nga John De Witt), publikuar nga Eerdmans
- E. *Epochs in the Life of Paul* [Epoka në Jetën e Palit], A. T. Robertson, publikuar nga Baker
- F. *A Man In Christ* [Një Njeri në Krishtin], James S. Stewart, publikuar nga Harper & Row
- G. *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalor i Palit dhe Letrave të Tij], publikuar nga IVP
- H. *Paul in the Roman World, The Conflict at Corinth* [Pali në Botën Romake, Konflikti në Korint], Robert M. Grant, publikuar nga Westminster, John Knox Press
- I. *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali mes Sofistëve], Bruce W. Winter, publikuar nga Eerdmans
- J. *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali u largua nga Korinti], Bruce W. Winter

### CIKLI NJË I LEXIMIT (nga "[A Guide to Good Bible Reading](#)") [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik]

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh. Shprehni me fjalët tuaja tematikën qendrore të të gjithë librit.

1. Tematika e gjithë librit
2. Lloji i letërsisë (zhanri)

### CIKLI DY I LEXIMIT (nga "[A Guide to Good Bible Reading](#)") [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik]

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh për një herë të dytë. Skiconi subjektet kryesore dhe shprehni secilin subjekt në një fjali të vetme.

1. Subjekti i njësisë së parë letrare
2. Subjekti i njësisë së dytë letrare
3. Subjekti i njësisë së tretë letrare
4. Subjekti i njësisë së katërt letrare
5. Etj.



# 1 KORINTASVE 1

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË<sup>2</sup>

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje dhe Falenderime	Përshëndetje	Përshëndetje	Përshëndetje	Adresa dhe përshëndetje
1:1-3	1:1-3	1:1-3	1:1 1:2 1:3	1:1-3
	Dhunti Frymore në Korint	Falenderime	Bekime në Krishtin	Falenderime
1:4-9	1:4-9	1:4-9	1:4-9	1:4-9
Ndarjet në Kishë	Sektarianizmi është Mëkat	Ndarjet në Korint	Ndarjet në Kishë	Përçarjet në mes të Jobesnikëve
1:10-17	1:10-17	1:10-17	1:10-13 1:14-17	1:10-16 Urtësia e Vërtetë dhe e Rremë
Krishti Fuqia dhe Urtësia e Perëndisë	Krishti Fuqia dhe Urtësia e Perëndisë	Krishti i Kryqëzuar (1:18-25)	Krishti Fuqia dhe Urtësia e Perëndisë	(1:17-3:4)
1:18-25	1:18-25	1:18-25	1:18-20 1:21-25	1:17-25
1:26-31	1:26-31	1:26-31	1:26-31	1:26-31

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

<sup>2</sup> Edhe pse ato nuk janë të frymëzuara, ndarjet e paragrafëve janë kyç për të kuptuar dhe ndjekur qëllimin fillestar të autorit. Çdo përkthyes modern ka ndarë dhe përmbledhur paragrafë. Çdo paragraf ka një temë, të vërtetë apo mendim qëndror. Çdo version e mbërthen atë temë në mënyrën e vet të veçantë. Ndërsa lexoni tekstin, pyeteni veten tuaj se cili përkthim i përshtatet më së miri të kuptuarit tuaj të ndarjes së subjektit dhe të vargjeve. Në çdo kapitull duhet të lexojmë Biblën së pari dhe të përpiqemi të identifikojmë subjektet e ndryshme të saj (paragrafët), dhe më pas të krahasojmë të kuptuarin tonë me versionet moderne. Vetëm pasi ne e kuptojmë qëllimin origjinal të autorit duke ndjekur logjikën dhe prezantimin e tij ne mund të kuptojmë vërtet Biblën. Vetëm autori origjinal është i frymëzuar – lexuesit nuk kanë asnjë të drejtë për të ndryshuar apo tjetërsuar mesazhin. Lexuesit e Biblës kanë përgjegjësi në aplikimin e të vërtetës të frymëzuar në ditën dhe jetët e tyre.

Vini re se të gjitha termat dhe shkurtime teknike shpjegohen plotësisht në dokumentet e mëposhtme: [Brief Definitions of Greek Grammatical Structure](#) [Shpjegime të Shkurtra të Strukturës Gramatikore të Gjuhës Greke], [Textual Criticism](#) [Kriticizëm Tekstual], and [Glossary](#) [Fjalor].

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:1**

**<sup>1</sup>Pali, i thirrur apostull i Jezu Krishtit, me anë të vullnetit të Perëndisë, dhe vëllai Sosten,**

**1:1 “Pali”** Pjesa më e madhe e hebrenjve në kohën e Palit që jetonin jashtë Palestinës kishin dy emra, një hebraik dhe një romak (shih Veprat e Apostujve 13:9). Emri hebraik i Palit ishte Saul. Ai, sikurse mbreti antik i Izraelit, ishte nga fisi i Beniaminit (shih Rom. 11:1; Fil. 3:5). Emri i tij romak ose grek, Pal, do të thoshte “i vogël”. Kjo i referohet ose:

1. Paraqitjes së tij fizike, ndaj së cilës aludohet në një libër jo-kanonik të shekullit të dytë, *The Acts of Paul* [Veprat e Palit], në një kapitull të lidhur me Thesalonikën të quajtur “Pali dhe Thekla”.
2. Qëndrimin të tij personal të të qenit më i vogli ndër shenjtorët për shkak se ai fillimisht persekutonte kishën (shih 1 Kor. 15:9; Efe. 3:8; 1 Tim. 1:15)
3. Thjesht emri i dhënë nga prindërit e tij në lindje

▣ **“i thirrur”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: I THIRRUR (SPECIAL TOPIC: CALLED)**

Perëndia gjithmonë e merr iniciativën në thirrjen, zgjedhjen dhe tërheqjen e besimtarëve tek Vetja (shih Gjoni 6:44, 65; 15:16; 1 Kor. 1:1-2; Efe. 1:4-5,11). Termi “thirrje” përdoret në disa kuptime teologjike.

- A. Në Dhjatën e Vjetër “të thërrisje emrin” ishte gjithmonë në një kontekst adhurimi (shih Zan. 4:26; 12:8; 21:33; 26:25; Eksod. 34:5).
- B. Mëkatarët thirren në shpëtim me anë të hirit të Perëndisë (dmth., Eksod. 34:6-7), përmes punës së përfunduar të Krishtit dhe bindjes së Frymës (p.sh., *klētos*, shih Rom. 1:6-7; 9:24, që është i ngjashëm nga ana teologjike me 1 Kor. 1:1-2 dhe 2 Tim. 1:9; 2 Pjet. 1:10).
- C. Mëkatarët thërrasin emrin e Zotit për t’u shpëtuar (p.sh., *epikaleō*, shih Veprat e Apo. 2:21; 22:16; Rom. 10:9-13). Kjo deklaratë është një idiomë adhurimi hebreje.
- D. Besimtarët thërrasin Emrin e Tij në kohë krize dhe stresi (dmth., Veprat e Apo. 7:59).
- E. Besimtarët janë thirrur për të jetuar jetë si të Krishtit (p.sh., *klēsis*, shih 1 Kor. 1:26; 7:20; Efe. 4:1; Fil. 3:14; 2 Thes. 1:11; 2 Tim. 1:9).

Besimtarët janë thirrur në detyra të shërbesës (shih Veprat e Apo. 13:2; 1 Kor. 12:4-7; Efe. 4:1).

▣ **“apostull”** Kjo është një fjalë e përbashkët greke për “dërgoj” (dmth., *apostellō*). Shih Temë e Veçantë tek 1 Kor. 4:9. Ky term ka disa përdorime teologjike.

1. Rabinët e përdornin atë si një term për të thirrur dhe dërguar si përfaqësues zyrtarë të dikujt tjetër, sikurse themi në ditët e sotme “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20).
2. Ungjijt shpesh e përdorin këtë term për Jezusin të dërguar nga Ati (shih Mat. 10:40; 15:24; Mark 9:37; Luka 9:48). Tek Gjoni, termi merr theks mesianik (shih Gjoni 4:34; 5:24,30,36,37,38; 6:29,38,39,40,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,8,18,21,23,25; 20:21). Ai përdoret për Jezusin që dërgoi besimtarët (shih Gjoni 17:18; 20:21).
3. Dhjata e Re e përdor për dishepujt.
  - a. Fillimisht 12 të cilët ishin një rreth i brendshëm i dishepujve (shih Luka 6:13; Veprat e Apo. 1:21-22)
  - b. Një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkë-punëtorësh apostolikë
    - (1) Barnaba (shih Veprat e Apo. 14:4,14)
    - (2) Andronicus dhe Junias (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)
    - (3) Apolli (shih 1 Kor. 4:6-9)
    - (4) Jakobi, vëllai i Zotit (shih Gal. 1:19)
    - (5) Silvani dhe Timoteu (shih 1 Thes. 2:6)
    - (6) Ndoshta Titi (shih 2 Kor. 8:23)

(7) Ndoshta Epafroditi (shih Fil. 2:25)

c. Një dhuratë e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)

4. Pali përdor këtë titull për veten e vet në pjesën më të madhe të letrave të tij si një mënyrë për të shpallur thirrjen e tij nga Perëndia dhe autoritetin e tij si një përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titit 1:1).

■ **“Jezu Krishtit”** Këto terma janë pjesë e titullit më të plotë “Zoti Jezus Krisht” (shih 1 Kor. 1:2,3,7,8,9,10).

Këta tre tituj kanë të gjithë rëndësi individuale.

1. “Jezus” është emri i dhënë foshnjës në Betlehem nga engjëlli (shih Mat. 1:21). Ai përbëhet nga dy emra hebraikë: “YHWH”, emri i besëlidhjes për hyjësinë, dhe “shpëtim” (dmth., Hosea). Ai është i njëjti emër në hebraisht si Joshua. Kur përdoret vetëm, shpesh ai identifikon njeriun, Jezusi i Nazaretit, biri i Marisë (p.sh., Mat. 1:16, 25; 2:1; 3:13,15,16).
2. “Krisht” është përkthimi grek i emrit *Mesia* në hebraisht (dmth., i Vajosuri). Ai shpall titullin e Dhjatës së Vjetër për Jezusin si i premtuari i YHWH i dërguar për të vendosur epokën e re të drejtësisë.
3. “Zot” (përdorur tek 1 Kor. 1:1 tek KJV) është përkthimi i termit hebraik *adon*, që do të thotë “pronar, bashkëshort, zotëri ose zot”. Hebrenjtë kishin frikë që të thonin emrin e shenjtë YHWH, që të mos e shpërdoronin dhe të thyenin një nga Dhjetë Urdhërimet. Kurdo që ata lexonin Shkrimet, ata zëvendësonin YHWH me *Adon*. Kjo është arsyeja pse përkthimet në anglisht përdorin të gjitha shkronja kapitale për fjalën YHWH në Dhjatën e Vjetër. Duke e transferuar këtë titull (*kurios* në greqisht) tek Jezusi, autorët e Dhjatës së Re shpallin hyjësinë e Tij dhe barazinë e Tij me Atin.

■ **“me anë të vullnetit të Perëndisë”** Ky është i pari nga shumë pohimet theksuese në këtë hyrje të lidhur me autoritetin e Palit (dmth., “i thirrur apostull”, 1 Kor. 1:1, “me anë të vullnetit të Perëndisë”, 1 Kor. 1:1 dhe “në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit”, 1 Kor. 1:10). Autoriteti apostolik i Palit është çështja kryesore teologjike në letrat korintase, sidomos në letrën e dytë drejtuar Korintasve.

Po e njëjta frazë hyrëse përdoret tek Kol. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; dhe 2 Tim. 1:1. Pali ishte i bindur se Perëndia e kishte zgjedhur atë që të ishte një apostull. Ky qëndrim i veçantë thirrjeje filloi në konvertimin e tij në rugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:22,26).

■ **“Sosten”** Ky ishte ndoshta drejtuesi hebre i përmendur tek Veprat e Apo. 18:17, i cili ishte rrahur nga turma dhe ndoshta më vonë u bë një besimtar dhe drejtues i një kisha lokale. Ka mundësi që ai të ketë qënë (1) ndihmuesi i Palit; (2) skrib; (3) burimi i informacionit për Palin mbi kishën; ose (4) dikush që e njihte kishën mirë.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:2**

**<sup>2</sup>kishës së Perëndisë që është në Korint, të shenjtëruarve në Krishtin Jezus, të thirrur shenjtorë, bashkë me të gjithë ata që në çdo vend e thërrasin emrin e Jezu Krishtit, Zotit të tyre dhe tonit:**

1:2 “kishës” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: KISHA (EKKLESIA) [SPECIAL TOPIC: CHURCH (EKKLESIA)]**

Kjo fjalë greke, *ekklesia*, vjen nga dy fjalë: “jashtë prej” dhe “i thirrur”. Kjo fjalë kishte një përdorim laik (dmth., qytetarët e thirrur në një mbledhje, shih Veprat e Apo. 19:32, 39, 41), si dhe për shkak se Septuaginta e kishte përdorur në kuptimin e “asamblesë” së Izraelit (*Qahal*, BDB 874, KB 1078, shih Num. 16:3; 20:4; Ligji i Përt. 31:30), një përdorim fetar. Kisha e hershme e shihte veten si vazhdimësia e popullit të Perëndisë në Dhjatën e Vjetër. Ata ishin Izraeli i ri (shih Rom. 2:28-29; Gal. 3:29; 6:16; 1 Pjet. 2:5,9; Zbu. 1:6), përmbushja e misionit mbarëbotëror të Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Eksod. 19:5-6; Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8; shih TEMË E VEÇANTË: PLANI I PËRJETSHËM SHPENGUES I YHWH / SPECIAL TOPIC: YHWH'S ETERNAL REDEMPTIVE PLAN).

Kjo fjalë përdoret në një sërë kuptimesh në Ungjijtë dhe në Veprat e Apostujve:

1. takim laik i qytetit, Veprat e Apo. 19:32, 39, 41

2. populli mbarëbotëror i Perëndisë në Krishtin, Mat. 16:18 dhe Efesianëve
3. bashkësi lokale besimtarësh të krishterë, Mat. 18:17; Veprat e Apo. 5:11 (në këto vargje, kisha në Jeruzalem); Veprat e Apo. 13:1; Rom. 16:5; 1 Kor. 16:19; Kol. 4:15; Filemon v. 2
4. populli i Izraelit në mënyrë kolektive, Veprat e Apo. 7:38; në predikimin e Stefanit
5. populli i Perëndisë në një rajon të caktuar, Veprat e Apo. 8:3; Gal. 1:2 (Judea ose Palestina)

Kisha është një grup i mbledhur njerëzish, jo një ndërtesë. Nuk kishte asnjë ndërtesë kishë për qindra vite. Tek Jakobi (një nga librat më të hershëm të krishterë) kishës i referohet me termin “*synagōgē*” (asambleja). Ky term për kishën ndeshet vetëm tek Jakobi (shih Jakobi 2:2; 5:14).

■ **“së Perëndisë që është në Korint”** Kjo frazë shpreh dy kuptime të ndryshme mbi “kishën”.

1. Është një trup lokal i përbërë nga besimtarë të rilindur, të pagëzuar. Pjesa më e madhe e vendeve në Dhjatën e Re ku fjala *ekklesia* përdoret reflekton këtë kuptim lokal.
2. Ajo është gjithashtu shprehja universale e trupit të Krishtit. Kjo shihet tek Mat. 16:18 (dmth., përdorimi i parë, nga përdorimet e rralla, të këtij termi nga Jezusi, shih Mat. 18:17 [dy herë]); Veprat e Apo. 9:31 përdor njëjtesin “kishë” për të gjitha grigjat lokale në Jude, Galile dhe Samari; dhe së fundmi, përdorimi i termit tek letra drejtuar Efesianëve, e cila është një letër ciklike për kishat e Azisë së vogël (shih Efe. 1:22; 3:10,21; 5:23-32).

Gjendet një trup i madh i Krishtit i përbërë nga të gjithë besimtarët (disa tanimë të vdekur, disa të gjallë) dhe ka shprehje lokale të këtij trupi universal.

■ **“të shenjtëruarve”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer, e cila do të thotë se ata kanë qënë dhe vazhdojnë të deklarohen të shenjtë me anë të veprës së Jezusit përmes Frymës (shih 1 Kor. 6:11). Ky term (*hagiazō*) lidhet me fjalën “i shenjtë” (*hagios*) dhe “shenjtorë” (dmth., “të shenjtë” *hagioi*). Ai flet për ndarjen tonë për Perëndinë për shërbim. Këtu i referohet pozicionit në Të sikurse bën 1 Kor. 1:3, por në vende të tjera të Dhjatës së Re, besimtarët duhet të luftojnë drejt “shenjtërisë” (dmth., Mate 5:48). Ky është një pozicion që duhet patur. Pali inkurajon këtë kishë të përçarë dhe krenare duke i quajtur ata “shenjtorë” edhe në mes të dështimeve dhe mëkateve të tyre!

**TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIA/SHENJTËRIMI NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NT HOLINESS/SANCTIFICATION)**

Dhjata e Re pohon se, kur mëkatarët kthehen te Jezusi me pendim dhe besim (cf. Mark 1:15; Veprat e Apo. 3:16,19; 20:21), shfajësohen dhe shenjtërohen menjëherë. Ky është pozicioni i tyre i ri në Krishtin. Drejtësia e tij u është llogaritur atyre (shih Zan. 15:6; Romakëve 4). Ata shpallen të drejtë dhe të shenjtë (akt ligjor i Perëndisë).

Por, gjithashtu, Dhjata e Re u bën thirrje besimtarëve për shenjtëri, ose shenjtërim. Ky është edhe pozicion teologjik në bazë të veprës së përfunduar të Jezu Krishtit, edhe thirrje për të qënë si Krishti në qëndrim dhe në veprime në jetën e përditshme. Ashtu si shpëtimi është dhuratë falas dhe stil jetese që të kushton gjithçka, kështu ndodh dhe me shenjtërimin.

**Përgjigjia fillestare**

Veprat e Apo. 26:18  
 Romakëve 15:16  
 1 Korintasve 1:2-3; 6:11  
 2 Thesalonikasve 2:13  
 Hebrenjve 2:11; 10:10, 14; 13:12  
 2 Pjetrit 1:2

**Ngjashmëria gjithnjë e më madhe me Krishtin**

Romakëve 6:19  
 2 Korintasve 7:1  
 Efesianëve 1:4; 2:10  
 1 Thesalonikasve 3:13; 4:3-4, 7; 5:2  
 1 Timoteut 2:15  
 2 Timoteut 2:21

■ **“në Krishtin Jezus”** Kjo formë gramatike është përcaktuar si një sferë lokative. Besimtarët shenjtërohen nga Ati (dmth., burimi, shih Gjoni 17:7; 1 Thes. 5:23) përmes Jezusit (dmth., themelet, shih 1 Kor. 1:2; Efe. 5:26). Të dy aspektet bashkohen tek Heb. 2:11. Normalisht është Fryma e Shenjtë ndaj së cilës kjo atribohet (dmth., mjeti, shih Rom. 15:16; 2 Thes. 2:13).

Kjo është mënyra e preferuar e Palit për të përcaktuar besimtarët. Një shembull i mirë i kësaj është tek Efe. 1:3,4,7,9,10,12,13. Shih William Barclay, *The Mind of St. Paul* [Mendja e Shën Palit], fq. 121-132. Kjo do të thotë bashkim jetësor dhe personal me Jezusin (shih Veprat e Apo. 17:28).

Është interesante të vëresh se si skribët ndonjëherë kanë shkruar:

1. “në Krishtin Jezus” - MSS P46, B, D, F, G
2. “në Jezus Krishtin” - MSS α, A

Këto lloj variacionesh ndodhin shpesh në procesin e leximit dhe të kopjimit. Ato nuk ndikojnë tek kuptimi, por na tregojnë se skribët e hershëm ishin më të shqetësuar për kuptimin bazë të një teksti dhe jo për leximin e ngurtë të tij.

■ **“të thirrur”** Kjo është një formë pjesore e tashme e mesme. Ndërsa Pali u thirr apostull, po kështu edhe të krishterët korintas u thirrën shenjtorë (shih Rom. 1:7). Vini re theksin e rënduar mbi doktrinën e zgjedhjes në këtë kapitull tek 1 Kor. 1:9,24,26,27,28. Ky ndërtim i referohet veprës në fillim të Perëndisë duke i thirrur ata dhe thirrja prej tyre më pas ndaj Jezusit në lutje për shpëtim, që rezulton në lutje, adhurim dhe bindje të vazhdueshme. Shpëtimi është edhe një përgjigje fillestare besimi / pendese dhe një përgjigje e vazhdueshme besimi / pendese. Shih Temën e Veçantë: Thirrje tek 1 Kor. 1:1.

■ **“shenjtorë”** “Shenjtorë” (*hagioi*) është teologjikisht e lidhur me termin e Dhjatës së Vjetër “i shenjtë”, (*kadosh*) që do të thotë “i ndarë veçmas për shërbesën e Perëndisë” (shih 1 Kor. 1:2; 2 Kor. 1:1; Rom. 1:1; Fil. 1:1; Kol. 1:2). Kjo fjalë është në shumës në Dhjatën e Re, përveçse një herë tek Filipianët (4:21), por edhe atje, ajo përdoret duke nënkuptuar shumës. Të shpëtohesh do të thotë të jesh pjesë e komunitetit të besimit të besëlidhjes, familjes së besimtarëve, trupit të Krishtit.

Populli i Perëndisë është i shenjtë për shkak të drejtësisë së vendosur nga Jezusi (shih Romakëve 4; 2 Kor. 5:21; Galatasve 3). Është vullneti i Perëndisë që ata të jetojnë jetë të shenjta (shih 1 Kor. 1:4; 4:1; 5:27; Kol. 1:22; 3:12). Besimtarët tani shpallen të shenjtë (shenjtërim pozicional) dhe thirren për një stil jetese shenjtërie (shenjtërim progresiv). Drejtësimi dhe shenjtërimi duhet të pohoen së bashku!

#### **TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË [SPECIAL TOPIC: SAINTS (*hagios*)]**

Ky është barazvlerësi grek i fjalës hebraike *kadosh* (EMËR, BDB 871; FOLJE, BDB 872, KB 1066-1067; shih TEMË E VEÇANTË: I SHENJTË / Special Topic: Holy), e cila ka kuptimin themelor të ndarjes së dikujt, diçkaje ose ndonjë vendi mënjane për përdorimin ekskluziv të YHWH. Shpreh konceptin e “të shenjtës”. Izraeli ishte “kombi i shenjtë” i YHWH (shih 1 Pjet. 2:9, i cili citon Eksod. 19:6). YHWH është i ndarë mënjane nga njerëzimi nga natyra e Tij (Shenjtëri e përjetshme, e pakrijuar) dhe nga karakteri i Tij (përsosmëria morale). Ai është standardi me anë të të Cilit matet dhe gjykohet gjithçka tjetër. Ai është i Shenjti i Ndryshëm, i Shenjti i Përtejkesibotshëm.

Perëndia i krijoi njerëzit për bashkësi me Të, por Rënia (Zan. 3) shkaktoi një barrierë marrëdhënore dhe morale midis një Perëndie të Shenjtë dhe njerëzimit mëkatar. Perëndia zgjodhi ta rimëkëmbte / restauronte krijimin e Tij të ndërgjegjshëm; prandaj, Ai e thërret popullin e Tij të jetë “i shenjtë” (shih Lev. 11:44; 19:2; 20:7,26; 21:8). Me anë të një marrëdhënieje besimi me YHWH populli i Tij u bë i shenjtë me anë të pozicionit të tij besëlidhor në Të, por gjithashtu është thirrur të jetojë jetë të shenjta (shih Temë e Veçantë: Shenjtërim / Special Topic: Sanctification, shih Mat. 5:48; Efe. 4:1,17; 5:2-3,15; 1 Pjet. 1:15).

Kjo jetesë e shenjtë është e mundur sepse besimtarët janë plotësisht të pranuar dhe të falur përmes (1) jetës së Jezusit dhe (2) veprës dhe pranisë së Frymës së Shenjtë në mendjet dhe zemrat e tyre. Kjo vendos situatën paradoksale të besimtarëve:

1. të qenit të shenjtë për shkak të veshjes së drejtësisë së Krishtit (dmth., Romakëve 4)
2. thirrjes për të jetuar si të shenjtë për shkak të pranisë së Frymës (shih Temë e Veçantë: Shenjtërim / Special Topic: Sanctification)

Besimtarët janë “shenjtorë” (*hagioi*) për shkak të

1. vullnetit të të Shenjtit (Atit, shih Gjoni 6:29,40; 1 Pjet. 1:15-16);
2. veprës së Birit të Shenjtë (Jezusit, shih 2 Kor. 5:21; 1 Pjet. 1:18-21);
3. pranisë së Frymës së Shenjtë (shih Rom. 8:9-11,27).

Dhjata e Re gjithmonë u referohet shenjtorëve si SHUMËS (përveç një herë te Fil 4:21, por edhe atje konteksti e bën atë SHUMËS). Të jesh i shpëtuar është të jesh pjesë e një familjeje, një trupi, një ndërtese! Besimi biblik fillon me një pranim personal, por rezulton në një bashkësi trupore. Ne të gjithëve na janë dhënë dhunti (shih 1 Kor. 12:11) për shëndetin, rritjen dhe mirëqenien e trupit të Krishtit – kishës (shih 1 Kor. 12:7). Ne jemi shpëtuar për të shërbyer! Shenjtëria është një karakteristikë familjare!

Ai u bë një term për besimtarët (shih Veprat e Apo. 9:13,32,41; 26:10; Rom. 1:7; 1 Kor. 1:2; 2 Kor. 1:1; Efe. 1:1; Fil. 1:1; Kol. 1:2) dhe një mënyrë për të përshkruar shërbesën ndaj të tjerëve (shih Rom. 12:13; 16:2; Efe. 1:15; Kol. 1:4; 1 Tim. 5:10; Heb. 6:10). Pali mori një ofrim të veçantë, të njehershëm nga kishat johebraike për të varfërit në Kishën Mëmë në Jeruzalem (shih Rom. 15:25-26; 1 Kor. 16:1; 2 Kor. 8:4; 9:1).

■ **“bashkë me të gjithë ata që në çdo vend”** Pali e përdor këtë frazë për t’iu rikujtuar besimtarëve korintas se ata janë pjesë e një familje më të madhe kishë. Ata nuk kanë të drejtë për një trajtim të veçantë apo unik. Ata duhet t’i konformohen trupit tërësor të Krishtit në doktrinë dhe zbatim (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:16; 14:33).

■ **“e thërrasin emrin e Zotit tonë”<sup>3</sup>** Kjo i referohet të bërit të krishter (shih Veprat e Apo. 2:21; 22:16; Rom. 10:9-13), por gjithashtu një adhurimi të vazhdueshëm (dmth., përdorimi i emrit në Dhjatën e Vjetër, shih Zan. 4:26; 12:8; 26:25). Këtu ajo është një formë pjesore e tashme e mesme, e cila përshkruan një marrëdhënie besimi moment-pas-momenti me Krishtin (dmth., teologjikisht e ngjashme me “në Krishtin” të Palit) dhe një theks mbi zgjedhjen e një individi. Shih Tema të Veçanta tek 1 Kor. 1:10.

■ **“Zotit të tyre dhe tonit”** Kjo është një frazë tjetër që nënkupton unitetin e të gjithë besimtarëve dhe kishave. Jezusi është Zot i të gjitha grigjave të krishtera, të cilat përfshijnë edhe Korintin. Pali e identifikon veten e tij dhe Sostenin me besimtarët në Korint me anë të kësaj fraze. Ata kanë nevojë të rikujtohen se (1) ata janë një nga shumë grigja dhe (2) Pali është një prej tyre dhe është në anën e tyre!

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:3

<sup>3</sup> hiri dhe paqe për ju nga Perëndia, Ati ynë, dhe nga Zoti Jezu Krisht.

**1:3 “Hiri”** Pali ka ndryshuar termin e formës normale të hapjes së një letre greke “përshëndetje”, *charein*, në një formë unike të krishterë, që tingëllon në mënyrë të ngjashme, *charis* (shih Rom. 1:7; 2 Kor. 1:2; Gal. 1:3 Efe. 1:2; Fil. 1:2; 2 Thes.1:2; Filemon 1:3).

■ **“paqe”** Ka mundësi që sikurse hiri reflektonte një përshëndetje tipike greke, po kështu edhe “paqe” të reflektonte një përshëndetje tipike hebraike, shalom. Termi shalom është përshëndetje hebraike edhe në takim, edhe në largim. Ajo nënkupton jo vetëm mungesën e problemeve, por praninë e mirësisë dhe mirëqenies. Ka mundësi që përshëndetja standarte e Palit vjen nga Numrat 6:25-26, ku shfaqen si hiri dhe paqja. Teologjikisht hiri gjithmonë e paraprin paqen, por të dyja gjenden vetëm në një marrëdhënie besimi me Krishtin (dmth., edhe në mënyrë të përbashkët edhe në mënyrë individuale).

<sup>3</sup> Versioni në shqip është: “e thërrasin emrin e Jezu Krishtit” (shënim i përkthyesit).

## TEMË E VEÇANTË: PAQE (*SHALOM*) [SPECIAL TOPIC: PEACE (*SHALOM*)]

Termi në hebraisht *shalom* (BDB 1022, KB 1532) është i zakonitë në termat Semitikë.

- A. Akkadik
  - 1. të jesh i padëmtuar
  - 2. të qëndrosh mirë
  - 3. të jesh në kushte të mira
- B. Ugratik (Kananian)
  - 1. të jesh i padëmtuar
  - 2. të jesh i shëndetshëm
- C. Arabisht
  - 1. të jesh i shëndetshëm
  - 2. të jesh në një situatë të lumtur
- D. Aramaisht
  - 1. të jesh i plotë
  - 2. të arrish në një përfundim / përmbushje
  - 3. të përmbushësh një paqe
  - 4. të qëndrosh i padëmtuar
- E. Nënkuptime hebraike
  - 1. plotësi
  - 2. shëndet
  - 3. mirëqënie
  - 4. paqe

Sot termi *shalom* është një përshëndetje hebraike dhe një pohim përshëndetës në largim. Ai vazhdon të përcaktojë mungesën e së ligës dhe praninë e së mirës (dmth., kënaqësi me jetën). Ai përshkruan një gjendje mendore të sigurisë dhe kënaqësisë. Vini re se Dhjata e Vjetër flet për një “besëlidhje paqeje” (shih Num. 25:12; Ezek. 34:25; 37:26; gjithashtu vini re Zan. 26:29,31; Joz. 9:15). Ajo duhet ndjekur (shih Ps. 34:14; Rom. 14:19). AB, vol. 5, fq. 206, thotë “Paqja”, “e vërteta” dhe “drejtësia” janë koncepte paralele hebraike (shih Zak. 8:16-19). YHWH thirret “Zoti i Paqes” (shih Gjyq. 6:24; Rom. 16:20; 2 Kor. 13:11; Fil. 4:9; 1 Thes. 5:23). Mesia do të quhet “Princi i Paqes” (shih Isa. 9:5). Një ditë e re kur paqja, e vërteta dhe drejtësia do të jenë realitet në eksperiencën njerëzore (shih Isa. 60:17; 66:12,22). Ajo që Perëndia ka thënë “shumë e mirë” tek Zan. 1:31 është ende një mundësi, po, një premtim (dmth., “një qiell i ri dhe një tokë e re”).

■ **“nga Perëndia, Ati ynë, dhe nga Zoti Jezu Krisht”** Të dyja termat “hir” dhe paqe” vijnë nga Ati dhe Biri. Ati dhe Jezusi lidhen gramatikisht si një njësi (dmth., një parafjalë por dy objekte). Kjo është një mënyrë e Zakonshme se si autorët e Dhjatës së Re pranonin hyjësinë e Jezusit (shih 1 Thes. 1:1; 3:11; 2 Thes. 1:2,12; 2:16). Përdorimi i titujve të Dhjatës së Vjetër për Perëndinë të zbatuara tek Jezusi është një mënyrë tjetër për të pranuar të njëjtën të vërtetë (dmth., Zot); gjithashtu një ndodhi në Dhjatën e Vjetër “Dita e Zotit tonë”, tani i atribuohet Jezusit (“dita e Zotit tonë Jezus Krisht”, shih 1 Kor. 1:8).

Për titullin “Zoti Jezus Krisht” shih shënimin tek 1 Kor. 1:1.

## TEMË E VEÇANTË: ATËSIA E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: FATHERHOOD OF GOD)

- I. Dhjata e Vjetër
  - A. Në një kuptim Perëndia është atë nëpërmjet krijimit.
    - 1.Zan. 1:26-27

- 2.Mal. 2:10  
 3.Veprat e Apo. 17:28
- B. Átë është një analogji e përdorur në disa kuptime.
- 1.átë i Izraelit (me anë të zgjedhjes)
    - a. “Bir” – Eks. 4:22; Ligji i Përt. 14:1; 39:5; Isa. 1:2; 63:16; 64:8; Jer. 3:19; 31:20; Osea 1:10; 11:1; Mal. 1:6
    - b. “i parëlinduri” – Jer. 31:9
  2. átë i mbretit të Izraelit (Mesianik)
    - a. 2 Sam. 7:11-16
    - b. Ps. 2:7; Veprat e Apo. 13:33; Heb. 1:5; 5:5
    - c. Osea 11:1; Mat. 2:15
  - 3.analogjia e një prindi të dashur
    - a. átë (metaforë)
      - (1)mbart birin e tij – Ligji i Përt. 1:31
      - (2)e disiplinon - Ligji i Përt. 8:5; Fjalët e Urta 3:12
      - (3)siguron (p.sh. Eksodi) – Ligji i Përt. 32:6
      - (4)nuk do ta braktisë kurrë – Ps. 27:10
      - (5)e do – Ps. 103:13
      - (6)mik/udhërrëfyes – Jer. 3:4
      - (7)shërues/falës – Jer. 3:22
      - (8)dhënës i mëshirës – Jer. 31:20
      - (9)stërvitës – Osea 11:1-4
      - (10) bir i veçantë – Mal. 3:17
    - b. nënë (metaforë)
      - (1)nuk do ta braktisë kurrë – Ps. 27:10
      - (2)dashuria e një mëndeshe – Isa. 49:15; 66:9-13 dhe Osea 11:4 (duke propozuar ndreqjen e tekstit nga “zgjedhë” në “foshnjë”)

## II. Dhjata e Re

### A. Trinia (tekstet ku përmenden të tre)

- 1.Ungjijtë
  - a. Mat. 3:16-17; 28:19
  - b. Gjoni 14:26
- 2.Pali
  - a. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10
  - b. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
  - c. 2 Kor. 1:21-22; 13:14
  - d. Gal. 4:4-6
  - e. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4
  - f. 1 Thes. 1:2-5
  - g. 2 Thes. 2:13
  - h. Titit 3:4-6
- 3.Pjetri – 1 Pjet. 1:2
- 4.Juda – vv. 20-21

### B. Jezusi

1. Jezusi si “i vetëmlinduri” - Gjoni 1:18; 3:16,18; 1 Gjonit 4:9
- 2.Jezusi si “Biri i Perëndisë” - Mat. 4:3; 14:33;16:16; Luka 1:32,35; Gjoni 1:34,49; 6:69; 11:27
- 3.Jezusi si Biri i Dashur - Mat. 3:17; 17:5
- 4.Përdorimi nga ana e Jezusit e *abba* për Perëndinë – Marku 14:36
- 5.Përdorimi nga ana e Jezusit e PËREMRAVE për të treguar marrëdhënien e Tij dhe tonën me Perëndinë
  - a. “Ati im,” p.sh., Gjoni 5:18; 10:30,33; 19:7; 20:17



- b. “ati juaj,” p.sh., Mat. 5:16,45,48; 6:1,4,6,8,9,14,15,18,26,32; 7:11; 10:20,29; 18:14
  - c. “ati ynë,” p.sh., Mat. 6:9,14,26
- C. Një nga metaforat e shumta familjare për të përshkruar marrëdhënien intime midis Perëndisë dhe njerëzimit:
1. Perëndia si Atë
  2. Besimtarët si
    - a. Bij të Perëndisë
    - b. Fëmijë
    - c. Të lindur nga Perëndia
    - d. Të lindur sërish
    - e. Të adoptuar
    - f. Të nxjerrë
    - g. Familje e Perëndisë

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:4-9

<sup>4</sup>Përherë i falem nderit Perëndisë tim për ju, për hirin e Perëndisë, i cili ju është dhënë me anë të Jezu Krishtit, <sup>5</sup>sepse në atë ju u bëtë të pasur në të gjitha, në çdo fjalë dhe në çdo njohuri, <sup>6</sup>sikurse dëshmimi i Krishtit që u vërtetua ndër ju, <sup>7</sup>kaq sa nuk ju mungon asnjë dhunti, ndërsa prisni zbulesën e Zotit tonë Jezu Krishtit, <sup>8</sup>i cili edhe do t’ju vërtetojë deri në fund, që të jeni të paqortueshëm në ditën e Zotit tonë Jezu Krishtit. <sup>9</sup>Besnik është Perëndia, nga i cili jeni thirrur në bashkësinë e Birit të tij Jezu Krishtit, Zotit tonë.

**1:4 “Përherë i falem nderit Perëndisë tim për ju”** Kjo është një formë treguese aktive e tashme, e cila shpreh veprim të vazhdueshëm. Vargjet 4-9 janë një zgjerim i gjërave për të cilat Pali falenderon Perëndinë në jetën e kësaj kisha të trazuar. Një falenderim hyrës ishte një element i pritshëm nga ana kulturore në letrat e shekullit të parë. Nuk ka asnjë falenderim në hyrjen tek letra e 2-të drejtuar Korintasve (as Galatasve). Gjenden dy dorëshkrime greke antike uncial (dmth.,  $\aleph^*$  and B), të cilat e heqin përemrin “tim”. Megjithatë, dorëshkrimet greke P<sup>61</sup>,  $\aleph^2$ , A, C, D, F, G, gjithashtu përkthimet Vulgate, Siriake, Koptike dhe Amerikane e përfshijnë atë. Teksti grek UBS<sup>4</sup> i jep përfshirjes së saj një vlerësim A (dmth., i sigurtë).

#### TEMË E VEÇANTË: FALENDERIMI (SPECIAL TOPIC: THANKSGIVING)

##### I. Hyrje

- A. Ky është qëndrimi i duhur i besimtarëve ndaj Perëndisë
  1. Ky është burimi i lavdërimit tonë ndaj Perëndisë përmes Krishtit
    - a. 2 Korintasve 2:14
    - b. 2 Korintasve 9:15
    - c. Kolosianëve 3:17
  2. Ky është qëllimi i duhur për shërbesë, 1 Kor. 1:4
  3. Kjo është tema e përsëritur për qiellin:
    - a. Zbulesa 4:9
    - b. Zbulesa 7:12
    - c. Zbulesa 11:17
  4. Kjo është tema e përsëritur e besimtarëve
    - a. Kolosianëve 2:7
    - b. Kolosianëve 3:17
    - c. Kolosianëve 4:2

##### II. Materiali Biblik

- A. Dhjata e Vjetër

1. Dy fjalë bazë
  - a. *yadah* (BDB 392, KB 398), që do të thotë lavdërim
  - b. *todah* (BDB 392, KB 1695), që do të thotë falenderim. Ajo zakonisht përdoret për flijimet e ofruara (shih 2 Kro. 29:31; 33:16)
2. Davidi caktoi levitë të veçantë për të lavdëruar dhe falenderuar Perëndinë. Kjo mënyrë u vazhdua nga Solomoni, Hezekia dhe Nehemia
  - a. 1 Kronikave 16:4,7,41
  - b. 1 Kronikave 23:30
  - c. 1 Kronikave 25:3
  - d. 2 Kronikave 5:13
  - e. 2 Kronikave 7:6
  - f. 2 Kronikave 31:2
  - g. Nehemia 11:12
  - h. Nehemia 12:24,27,31,38,46
3. Libri i Psalmeve është përmbledhja e lavdërimeve dhe falenderimeve të Izraelit.
  - a. Falenderime ndaj YHWH për besnikërinë e Tij ndaj Besëlidhjes
    - 1) Psalmi 107:8
    - 2) Psalmi 103:1e në vazhdim
    - 3) Psalmi 138:2
  - b. Falenderimi ishte pjesë e proceseve në tempull
    - 1) Psalmi 95:2
    - 2) Psalmi 100:4
  - c. Falenderimi shoqëronte flijimin
    - 1) Psalmi 26:7
    - 2) Psalmi 122:4
  - d. Falenderim i dhënë për veprat e YHWH
    - 1) Çlirim nga armiku
      - (a) Psalmi 7:17
      - (b) Psalmi 18:49
      - (c) Psalmi 28:7
      - (d) Psalmi 35:18
      - (e) Psalmi 44:8
      - (f) Psalmi 54:6
      - (g) Psalmi 79:13
      - (h) Psalmi 118:1,21,29
      - (i) Psalmi 138:1
    - 2) Çlirim nga burgu (metaforë), Psalmi 142:7
    - 3) Çlirim nga vdekja
      - (a) Psalmi 30:4,12
      - (b) Psalmi 86:12-13
      - (c) Isaia 38:18-19
    - 4) Ai vë poshtë të pabesët dhe lartëson të drejtët
      - (a) Psalmi 52:9
      - (b) Psalmi 75:1
      - (c) Psalmi 92:1
      - (d) Psalmi 140:13
    - 5) Ai fal
      - (a) Psalmi 30:4
      - (b) Isaia 12:1
    - 6) Ai siguron për popullin e Tij
      - (a) Psalmi 106:1e në vazhdim
      - (b) Psalmi 111:1

- (c) Psalmi 136:1,26
- (d) Psalmi 145:10
- (e) Jeremia 33:11

## B. Dhjata e Re

1. Fjala kryesore e përdorur për falenderim dhe falenderime (disa referenca)
  - a. *eucharisteō* (shih 1 Kor. 1:4,14; 10:30; 11:24; 14:17,18; Kol. 1:3,12; 3:17)
  - b. *eucharistos* (shih Kol. 3:15)
  - c. *eucharistia* (shih 1 Kor. 14:16; 2 Kor. 4:15; 9:11,12; Kol. 2:7; 4:2)
  - d. *charis* (shih 1 Kor. 15:57; 2 Kor. 2:14; 8:16; 9:15; 1 Pjet. 2:19)
2. Shembulli i Jezusit
  - a. Ai falenderonte për ushqimin:
    - 1) Luka 22:17,19 (1 Kor. 11:24)
    - 2) Gjoni 6:11,23
  - b. Ai ishte falenderues për përgjigjet ndaj lutjeve, Gjoni 11:41
3. Shembuj të tjerë falenderimi
  - a. Për dhuratën e Perëndisë në Krishtin, 2 Kor. 9:15
  - b. Për ushqimin
    - 1) Veprat e Apo. 27:35
    - 2) Romakëve 14:6
    - 3) 1 Korintasve 10:30; 11:24
    - 4) 1 Timoteu 4:3-4
  - c. Për shërimin, Luka 17:16
  - d. Për paqen, Veprat e Apo. 24:2-3
  - e. Për çlirimin nga rreziku
    - 1) Veprat e Apo. 27:35
    - 2) Veprat e Apo. 28:15
  - f. Për të gjitha rrethanat, Filipianëve 4:6
  - g. Për të gjithë njerëzit, sidomos drejtuesit, 1 Timoteu 2:1-2
4. Aspekte të tjera të falenderimit
  - a. Është vullneti i Perëndisë për të gjithë besimtarët, 1 Thesalonikasve 5:18
  - b. Është provë e një jete të mbushur me Frymën, Efesianëve 5:20
  - c. Të lësh pasdore falenderimin është mëkat
    - 1) Luka 17:16-17
    - 2) Romakëve 1:21
  - d. Është një kundërhelm për mëkatin, Efesianëve 5:4
5. Mirënjohja e Palit
  - a. Bekimet e tij ndaj kishës
    - 1) Për shpalljen e ungjillit
      - (a) Romakëve 1:8
      - (b) Kolosianëve 1:3-4
      - (c) Efesianëve 1:15-16
      - (d) 1 Thesalonikasve 1:2
    - 2) Për hirin e dhuruar
      - (a) 1 Korintasve 1:4
      - (b) 2 Korintasve 1:11; 4:15
    - 3) Për pranimin e ungjillit, 1 Thesalonikasve 2:13
    - 4) Për marrëdhënien në shpërndarjen e ungjillit, Filipianëve 1:3-5
    - 5) Për rritjen në hir, 2 Thesalonikasve 1:3
    - 6) Për njohurinë e zgjedhjes, 2 Thesalonikasve 2:13
    - 7) Për bekimet frymore, Kolosianëve 1:12; 3:15
    - 8) Për lirinë në dhënie, 2 Korintasve 9:11-12
    - 9) Për gëzimin mbi besimtarët e rinj, 1 Thesalonikasve 3:9

b. Falenderimi i tij personal

- 1) Që është një besimtar, Kolosianëve 1:12
- 2) Për çlirimin nga prangat e mëkatit, Romakëve 7:25; 2 Kor. 2:14
- 3) Për punën sakrifiku të besimtarëve të tjerë, Romakëve 16:4; 2 Kor. 8:16
- 4) Që disa vepra nuk kanë ndodhur, 1 Korintasve 1:14
- 5) Për dhuntinë personale frymore, 1 Korintasve 14:18
- 6) Për rritjen frymore të miqve, Filemoni 4-5
- 7) Për fuqinë fizike për shërbesë, 1 Timoteu 1:12

III. Konkluzione

- A. Falenderimi është përgjigja jonë kryesore ndaj Perëndisë pasi shpëtohem. Ajo shprehet jo vetëm me fjalë, por me një stil jetese mirënjohës.
- B. Falenderimi në gjithçka është qëllimi i një jete të pjekur në kujdesin e Perëndisë (shih 1 Thes. 5:13-18).
- C. Falenderimi është tema e përsëritur e të dy dhjatave, Dhjatës së Vjetër dhe Dhjatës së Re. A është falenderimi temë e jetës tënde?

■ **“për hirin e Perëndisë, i cili ju është dhënë me anë të Jezu Krishtit”** Pali thekson se qëndrimi dhe dhuntitë e tyre ishin me anë të hirit përmes punës së përfunduar të Jezus Krishtit dhe jo me anë të meritës së tyre personale (dmth., formë pjesore pasive aoriste, shih Efe. 2:8-9). Ky ishte fokusi i nevojshëm për të vendosur mënjandë krenarinë e tyre frymore në

1. Drejtuesit e tyre me dhunti
2. Dhuntitë e tyre individuale frymore
3. Sfondi i tyre intelektual (dmth., kultura greke)
4. Qëndrimi i tyre shoqëror (dmth., kultura romake)

**1:5 “në atë ju u bëtë të pasur në të gjitha”** Kjo formë treguese aoriste pasive përputhet teologjikisht me theksin e 1 Kor. 1:4 (dmth., hiri i Perëndisë i dhënë në Krishtin). Në të gjitha foljet pasive tek 1 Kor. 1:4-9, agjenti i nënkuptuar është Perëndia. Perëndia tre-në-një iu ka siguruar besimtarëve gjithçka që ata kanë nevojë (dmth., të gjitha dhuntitë frymore, shih 1 Kor. 1:7). Shih Temën e Veçantë: Triniteti (Special Topic: The Trinity) tek 1 Kor. 2:10.

Vini re përdorimin e Palit në këtë varg të tre *pas* (dmth., “të gjitha” ose “gjithçka”). Perëndia është një sigures i plotë. Ai nuk ka nevojë për zgjuarsinë, intelektin apo qëndrimin social të qënieve njerëzore.

NASB	“në çdo të folur dhe çdo njohuri”
NKJV	“në çdo thënie dhe çdo njohuri”
NRSV	“në të folur dhe njohuri të çdo lloji”
TEV	“në të gjitha gjërat, përfshirë çdo të folur dhe çdo njohuri”
NJB	“në çdo lloj thënie dhe njohuri”

Përkthimi i Phillips ka “nga fjalët mbi buzët e tua deri në të kuptuarit në zemrat tuaja”. Këto ishin dy aspekte të krenarisë frymore të orientuar nga kultura greke (më vonë Gnostike) të cilat po zhvilloheshin në kishën korintase (shih 1 Kor. 13:1-3). Ata po lavdëronin dhuntitë dhe performancën e tyre në vend që të lavdëronin Krishtin. Ishte Perëndia ai që iua dha ato dhunti atyre. Nuk kishte / nuk ka vend për krenari njerëzore (shih Efe. 2:9). Shih Temën e Veçantë: Mburra (SPECIAL TOPIC: BOASTING) tek 1 Kor. 5:6.

Njohuria ndaj së cilës Pali po aludon nuk është njohuri teorike, as njohuri akademike, por e vërteta e krishterë dhe tani ajo i aplikohet jetës (shih 1 Kor. 1:8-10; Rom. 14:1-15:13). Njohuria njerëzore ndërton, por njohuria e Perëndisë udhëzon dhe shpie në paqe dhe harmoni në marrëdhënien e krishterë. Oh sa nevojë që kemi për dhuntinë e njohurisë së Perëndisë në kishën e sotme!

**1:6 “sikurse dëshmimi i Krishtit”** Predikimi apostolik i ungjillit, i fuqizuar nga Fryma, i pasuroi këta besimtar në dhunti frymore. Sikurse të gjitha bekimet dhe dhuntitë e Perëndisë, kjo rrjedh përmes Krishtit tek zemrat njerëzore që janë në nevojë dhe përgjigjen.

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“u konfirmua në ju”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“është forcuar në mes jush”</b>
<b>TEV</b>	<b>“është fiksuar fort në mes jush”</b>
<b>NJB</b>	<b>“ka zënë rrënjë në ju”</b>

Ky është termi grek *bebaios*, i cili ka tre domethënie.

1. Ajo që është e sigurtë ose së cilës mund t’i besohet (shih Rom. 4:16; 2 Kor. 1:7; Heb. 2:20; 3:6,14; 6:19; 2 Pjet. 1:10,19).
2. Proçesi me anë të së cilës tregohet apo themelohet besueshmëria e diçkaje (shih Rom. 15:8; Heb. 2:2, shih Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament* [Leksikoni Greko-Anglez i Dhjatës së Re], Vol. 1, fq. 340,377,670).
3. Në shekullin e parë papirusët Koine të gjetur në Egjipt u bënë terma teknikë për një garanci ligjore (shih Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament* [Fjalori i Dhjatës së Re Greke], fq. 107-8).

Këtu ajo i referohet fuqisë së Perëndisë të dëshmuar mes tyre (dmth., dhuntitë frymore). Ai mund t’i referohej manifestimeve të tjera të Frymës, për shkak se është një tjetër formë treguese pasive aoriste e paralelizuar me 1 Kor. 1:5 (dhe gjithashtu një formë pjesore pasive aoriste tek 1 Kor. 1:4), ajo gjithashtu mund t’i referohej veprimeve të Perëndisë përmes Frymës së Shenjtë në konvertimin e tyre.

### 1:7

<b>NASB, NJB</b>	<b>“kaq sa nuk ju mungon asnjë dhunti”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“kaq sa ju nuk keni mungesë në asnjë dhunti”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“kaq sa nuk ju mungon asnjë dhunti frymore”</b>
<b>TEV</b>	<b>“që ju nuk keni dështuar në marrjen e qoftë edhe një bekimi të vetëm”</b>

Termi “dhunti” është *charisma*. Kjo fjalë lidhet me termin “hir”, *charis*, i cili thekson se dhuntitë frymore u dhanë nga Perëndia për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7,11). Ato kanë për qëllim të përlëvdojnë Krishtin, jo Frymën ose të krishterët individual (shih kapitujt 12-14). Të gjitha dhuntitë e nevojshme ishin të pranishme në kishën korintase sikurse janë në çdo kishë (shih 1 Kor. 1:5). Perëndia ka siguruar me bollëk (dmth., gjendet një formë mohuese e fortë e dyfishtë e lidhur me “mungesën”) për popullin e Tij gjatë periudhës tranzitore midis dy ardhjeve të Jezusit përmes shërbesës së Frymës së Shenjtë.

▣ **“ndërsa prisni me padurim”<sup>4</sup>** Ky term grek mund të nënkutojë:

1. Pritjen me durim për një ndodhi të pritur të ardhme (shih Heb. 10:13; 1 Pjet. 3:20)
2. Pritjen me padurim për një ndodhi të ardhme (shih Rom. 8:19,23,25; Fil. 3:20; Heb. 9:28)

Përkthimet NJKV, NASB dhe NIV ndjekin pikën 2, ndërsa NRSV, TEV dhe NJB ndjekin pikën 1.

▣ **“zbulesën e Zotit tonë Jezu Krishtit”** Ky është termi grek *apocalupsis*. Ai shpesh përkthehet “zbulesë”. Termi në thelb nënkupton të heqësh një perde në mënyrë që të zbulosh diçka. Është titulli i librit të fundit të Dhjatës së Re. Këtu ai i referohet rikthimit të Krishtit (shih 1 Kor. 1:8). Shih Temën e Veçantë: Terma të Dhjatës së Re për Rikthimin e Krishtit (Special Topic: NT Terms for Christ's Return) tek 1 Kor. 15:23.

### 1:8

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“i cili edhe do t’ju vërtetojë deri në fund”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“Ai gjithashtu do t’ju forcojë deri në fund”</b>
<b>TEV</b>	<b>“Ai do t’ju mbajë ju fort deri në fund”</b>
<b>NJB</b>	<b>“Ai do të vazhdojë t’ju japë juve forcë deri në fund”</b>

Përgjatë 1 Kor. 1:4-9, agjenti aktiv i foljeve pasive ka qënë Perëndia. Megjithatë, 1 Kor. 1:8 është e paqartë. Disa komentatorë mendojnë se për herë të parë në këtë seksion Krishtit i referohet “kush”. Duket kontekstualisht më

<sup>4</sup> Versioni në shqip është: “ndërsa prisni” (shënim i përkthyesit).

mirë të supozosh se Perëndia At është ende agjenti aktiv i cili mban besimtarët dhe themelon pranueshmërinë e tyre.

Termi “vërtetohet” u përdor tek 1 Kor. 1:6. Kjo kishë kishte nevojë të stabilizohej, të ishte e qëndrueshme dhe e palëkundshme. Ky është një nga qëllimet kryesore të letrave të Palit drejtuar atyre. Ungjilli i Krishtit u vërtetua (dmth., 1 Kor. 1:6) dhe ata do të konfirmohen me ndihmën e Perëndisë (dmth., 1 Kor. 1:8). Tek 2 Kor. 2:8, Pali dëshiron që dashuria e tyre të konfirmohet.

Bibla ka dy të vërteta dukshëm paradoksale mbi marrëdhënien e besimtarëve me Perëndinë.

1. Është me natyrë besëlidhjeje; prandaj, ai përfshin një përgjigje besimi dhe pendese fillestare dhe të vazhdueshme. Ne duhet të jemi të zellshëm për të mbajtur marrëdhënien tonë.
2. Është e sigurtë në besnikërinë e Perëndisë (shih Juda 24). Askush nuk mund të na vjedhë marrëdhënien (shih Gjoni 6:37,39; 10:28; Rom. 8:38-39). Siguria dhe qëndrueshmëria janë të dyja biblike (shih Efe. 2:8-9,10 dhe Fil. 2:12-13). Ato janë dy aspekte të nevojshme të “besëlidhjes”.

■ “të paqortueshëm” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

### **TEMË E VEÇANTË: I PA MËKATË, I PAFAJSHËM, PA FAJ, PA QORTIM (SPECIAL TOPIC: BLAMELESS, INNOCENT, GUILTLESS, WITHOUT REPROACH)**

#### **A. Pohime Hyrëse**

1. Ky koncept përshkruan teologjikisht gjendjen origjinale të njerëzimit (dmth., Zanafilla 1, kopështi i Edenit)
2. Mëkati dhe rebelimi e kanë shkatërruar këtë gjendje marrëdhënieje të përkryer (dmth., Zanafilla 3)
3. Njerëzit (meshkuj dhe femra) dëshirojnë shumë restaurimin e marrëdhënies me Perëndinë për shkak se ata janë krijuar në shëmbëlltërinë dhe ngjashmërinë e Tij (dmth., Zan. 1:26-27).
4. Perëndia është marrë me njerëzimin mëkatar në disa mënyra
  - a. Drejtuesit e perëndishëm (dmth., Abrahami, Moisiu, Isaia)
  - b. Sistemi flijues (dmth., Levitiku 1-7)
  - c. Shembujt e perëndishëm (dmth., Noeu, Jobi)
5. Përfundimisht Perëndia siguroi Mesian
  - a. Si një zbulues të plotë të Vetvetes (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:13-17; Heb. 1:2-3)
  - b. Si një flijim i përkryer për mëkatin (shih Mark 10:45; 2 Kor. 5:21)
6. Të krishterët janë bërë të pamëkatë
  - a. Ligjrisht përmes drejtësisë së vendosur nga Krishti (shih Rom. 4:3,6,8,11,22,23,24; Jakobi 2:23)
  - b. Në mënyrë progresive përmes veprës së Frymës (Gjoni 16:8-11)
  - c. Qëllimi i krishtërimin është ngjashmëria me Krishtin (shih Rom. 8:28-30; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3; 5:23; 2 Thes. 2:13; Titit 2:14; 1 Pjet. 1:15), e cila në realitet, është restaurimi i imazhit të Perëndisë të humbur në rënien e Adamit dhe Evës
7. Qielli është një restaurim i marrëdhënies së përsosur të Kopështit të Edenit. Qielli është Jeruzalemi i Ri që do të zbresë poshtë nga prania e Perëndisë (shih Zbu. 21:2) në një tokë të pastruar (shih 2 Pjet. 3:10). Bibla fillon dhe përfundon me të njëjtat tema.
  - a. Një marrëdhënie intime, personale me Perëndinë
  - b. Në një rrethanë kopështi (Zanafilla 1-2 dhe Zbuluesi 21-22)
  - c. Me anë të një pohimi profetik, prania dhe shoqëria e kafshëve (shih Isa. 11:6-9)

#### **B. Dhjata e Vjetër**

1. Ka qat shumë fjalë të ndryshme hebraike që mbajnë konceptin e përsosmërisë, mungesës së mëkatis, pafajësisë sa është e vështirë t'i emërtosh dhe të tregosh të gjitha marrëdhëniet e përfshira.
2. Termat kryesorë që mbajnë konceptin e përsosmërisë, mungesës së fajit apo pafajësisë (sipas Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], fq. 94-

99) janë:

- a. *shalom* (BDB1022, KB 1532)
- b. *thamam* (BDB1070, KB 1743)
- c. *calah* (BDB478, KB 476)

3. Septuaginti (dmth., Bibla e kishës së hershme) i përkthen këto koncepte hebraike në terma të gjuhës koine greke të përdorur në Dhjatën e Re (shih pikën C. më poshtë).

4. Koncepti kyç lidhet me sistemin flijues.

- a. *amōmos* (BDB 1071, shih Eksod. 29:1; Lev. 1:3,10; 3:1,6; Num. 6:14)
- b. *amiantos* dhe *aspilus* gjithashtu kanë nënkuptime kultike

#### C. Dhjata e Re

1. Koncepti ligjor

- a. Nënkuptimi kultik ligjor hebraik përkthehet nga *amōmos* (BDB 1071, shih Efe. 5:27; Fil. 2:15; 1 Pjet. 1:19)
- b. Nënkuptimet ligjore greke (shih 1 Kor. 1:8; Kol. 1:22)

2. Krishti është i Pamëkati, i Pafaji, i Pafajshmi (*amōmos*, shih Heb. 9:14; 1 Pjet. 1:19)

3. Ndjekësit e Krishtit duhet të imitojnë Atë (*amōmos*, shih Efe. 1:4; 5:27; Fil. 2:15; Kol. 1:22; 2 Pjet. 3:14; Juda 1:24; Zbu. 14:5)

4. Ky koncept gjithashtu përdoret për drejtuesit e kishës

- a. *aneglētos*, "pa akuzë" (shih 1 Tim. 3:10; Titit 1:6-7)
- b. *anepileptos*, "mbi kritikën" ose "asnjë çështje për qortim" (shih 1 Tim. 3:2; 5:7; 6:14; Titit 2:8)

5. Koncepti i "të panjollësuar" (*amiantos*) përdoret për:

- a. Vetë Krishtin (shih Heb. 7:26)
- b. Trashëgiminë e krishterë (shih 1 Pjet. 1:4)

6. Konceptin e "plotësisë" apo "shëndetit" (*holoklēria*) (shih Veprat e Apo. 3:16; 1 Thes. 5:23; Jakobi 1:4)

7. Koncepti i "pa mëkat", "pafajësi e pa fajë" nxirret nga *amemptos* (shih Luka 1:6; Fil. 2:15; 3:6; 1 Thes. 2:10; 3:13; 5:23)

8. Koncepti i "jo subjekt ndaj fajit" nxirret nga *amōmētos* (shih 2 Pjet. 3:14)

9. Koncepti i "panjollë", "i patëmetë" shpesh përdoret në pasazhet që kanë një nga termat e mësipërm gjithashtu (shih 1 Tim. 6:14; Jakobi 1:27; 1 Pjet. 1:19; 2 Pjet. 3:14)

D. Numri i fjalëve në hebraisht dhe greqisht që nxjerrin këtë koncept tregon rëndësinë e saj. Perëndia ka siguruar për nevojën tonë përmes Krishtit dhe tani na thërret që të jemi si Ai.

Besimtarët shpallen në mënyrë pozicionale dhe publike "të drejtë", "të drejtësuar", "të pamëkatë" me anë të veprës së Krishtit. Tani besimtarët do të marrin pozicionin e tyre. "Të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë" (shih 1 Gjoni 1:7). "Ecni të tillë që të jeni të denjë për thirrjen" (shih Efe. 4:1,17; 5:2,15). Jezusi ka restauruar imazhin e Perëndisë. Marrëdhënia intime tani është e mundur, por mbani mend, Perëndia dëshiron një popull që reflekton karakterin e Tij, sikurse bëri Biri i Tij, ndaj një bote të humbur (dmth., ndaj kombeve). Ne jemi thirrur për asgjë më pak se sa shenjtëri (shih Mate. 5:20,48; Efe. 1:4; 1 Pjet. 1:13-16). Shenjtëria e Perëndisë, jo vetëm ligjërisht, por ekzistencialisht!

■ **"në ditën e Zotit tonë Jezu Krishtit"** Autorët e Dhjatës së Re kanë marrë "Ditën e YHWH" nga Dhjata e Vjetër dhe e kanë aplikuar atë tek Ardha e Dytë e Jezusit. Jezu Krishti është zëvendësuesi i YHWH tek krijimi, shpëngimi dhe gjykimi.

**1:9 "Besnik është Perëndia"** Termi "besim" në Dhjatën e Vjetër është një zgjerim metaforik i një pozite të qëndrueshme. Ai tregon metaforikisht atë që është e sigurtë, e besueshme, besnike dhe tek e cila mund të mbahesh. Asnjë nga këto nuk përshkruan madje njerëzimin e rënë dhe të shpenguar. Nuk është besnikëria apo besueshmëria e njerëzimit apo besimi për t'u mbajtur tek njerëzimi, por tek Perëndia (shih Ligji i Përt. 7:9; Psa. 36:5; 40:10; 89:1,2,5,8; 92:2; 119:90; Isa. 49:7; Rom. 3:3; 1 Kor. 10:13; 2 Kor. 1:18; 1 Thes. 5:24; 2 Tim. 2:13). Ne besojmë në premtimet e Tij të besueshme, jo në besueshmërinë tonë! Bindja e besëlidhjes vjen nga

mirenjohja! Fokusi biblik ka qënë gjithmonë mbi besnikërinë e Tij, dhe jo mbi besimin e besimtarëve! Besimi nuk mund ta shpëtojë ndokënd. Vetëm hiri shpëton, por ai merret me anë të besimit (shih Efe. 2:8-9). Fokusi nuk është kurrë mbi sasinë e besimit (shih Mat. 17:20), por mbi objektin e tij (Jezusi). Shpresa jonë është në karakterin e pandryshueshëm të Perëndisë i cili thërret dhe premtion (shih Mal. 3:6; 2 Kor. 1:20).

Besimi pranon dhuratën falas të Perëndisë në Krishtin (shih Rom. 3:22,25; 4:5; 6:23; 9:30; Gal. 2:16; 1 Pjet. 1:5). Njerëzimi duhet të përgjigjet (dmth., fillimisht dhe në vazhdimësi) ndaj ofertës së Perëndisë për hir dhe falje në Krishtin (shih Gjoni 1:12; 3:16-17,36; 6:40; 11:25-26; Rom. 10:9-13).

Perëndia merret me njerëzimin e rënë me anë të besëlidhjes. Ai gjithmonë merr iniciativën (shih Gjoni 6:44, 65) dhe vendos planin dhe kufijtë (shih Mark 1:51; Veprat e Apo. 20:21). Ai e lejon njerëzimin e rënë që të marrë pjesë në shpëtimin e tyre duke iu përgjigjur ofertës së tyre të besëlidhjes. Përgjigja e mandatuar është si në fillim dhe në vazhdimësi me besim, pendesë, bindje, shërbesë, adhurim dhe qëndrueshmëri.

Michael Magill, *New Testament TransLine* [Translinja e Dhjatës së Re], fq. 577, numër 24, ka një koment të fuqishëm:

“Vini re kohën e shkuar tek 1 Kor. 1:5-6, kohë e tashme tek 1 Kor. 1:7, kohë e ardhme tek 1 Kor. 1:8. Perëndia është besnik në të tre kuptimet.”

## **TEMË E VEÇANTË: BESO, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHJATËN E VJETËR (SPECIAL TOPIC: BELIEVE, TRUST, FAITH, AND FAITHFULNESS IN THE OLD TESTAMENT)**

### **I. Shënim hyrës**

Duhet pohuar se përdorimi i këtij koncepti teologjik, kaq jetik për Dhjatën e Re, nuk është përcaktuar dhe aq qartë në Dhjatën e Vjetër. Pa dyshim që ekziston aty, por demonstron në pasazhe dhe persona kyç e të përzgjedhur.

Dhjata e Vjetër shkrin

1. individin me komunitetin

2. takimin personal dhe bindjen e besëlidhjes

Besimi është edhe takim personal, edhe stil i përditshëm jetese! Është më e lehtë ta përshkruash në jetën e një ndjekësi besnik, sesa në formë leksikore (pra, me studime fjale). Ky aspekt personal ilustron më së miri në

1. Abrahamin dhe farën e tij

2. Davidin dhe Izraelin

Këta burra u takuan/u poqën me Perëndinë dhe jetët e tyre ndryshuan një herë e përgjithmonë (jo jetë të përsosura, por besim i vazhdueshëm). Sprovimi zbuloi dobësitë dhe pikat e forta të takimit të besimit të tyre me Perëndinë, por marrëdhënia e ngushtë dhe plot besim vazhdoi gjatë gjithë kohës! Ajo u sprovua dhe u përpunua, por vazhdoi të dëshmohej në përkushtimin dhe stilin e tyre të jetesës.

### **II. Rrënja kryesore që përdoret**

#### **A. אמן (BDB 52, KB 63)**

##### **1. FOLJA**

a. Rrënja *Qal* – mbështes, ushqej (p.sh., 2 Mbret. 10:1, 5; Ester 2:7, përdorimi joteologjik)

b. Rrënja *Niphal* – bëj të sigurt ose të patundur, themeloj, pohoj, jam besnik ose i besueshëm

1) për njerëzit, Isa. 8:2; 53:1; Jer. 40:14

2) për gjërat, Isa. 22:23

3) për Perëndinë, Ligji i Përt. 7:9; Isa. 49:7; Jer. 42:5

c. Rrënja *Hiphil* – qëndroj i patundur, besoj, kam besim

1) Abrahami besoi në Perëndinë, Zan. 15:6

2) Izraelitët në Egjipt besuan, Eks. 4:31; 14:31 (mohuar në Ligji i Përt. 1:32)

3) Izraelitët besonin se YHWH fliste përmes Moisiut (Eks. 19:9; Ps. 106:12, 24)



- 4) Ahazi nuk i besoi Perëndisë, Isa. 7:9
  - 5) Kushdo që beso në të, Isa. 28:16
  - 6) Besoni të vërtetat për Perëndinë Isa. 43:10-12
2. EMRI (GJINIA MASHKULLORE) – besnikëri (shih Ligji i Përt. 32:20; Isa. 25:1; 26:2)
  3. NDAJFOLJA – me të vërtetë, ashtu është, jam dakord, ashtu qoftë (shih Ligji i Përt. 27:15-26; 1 Mbret. 1:36; 1 Kro. 16:36; Isa. 65:16; Jer. 11:5; 28:6). Ky është përdorimi liturgjik i “amen” në Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re.
- B. אָמֵן (BDB 54, KB 68) EMRI FËMEROR, patundshmëri, besnikëri, e vërtetë
    1. për njerëzit, Isa. 10:20; 42:3; 48:1
    2. për Perëndinë, Eks. 34:6; Psa. 117:2; Isa. 38:18-19; 61:8
    3. për të vërtetën, Ligji i Përt. 32:4; 1 Mbret. 22:16; Psa. 33:4; 98:3; 100:5; 119:30; Jer. 9:5; Zak. 8:16
  - C. אֱמוּנָה (BDB 53, KB 62), patundshmëri, qëndresë, besnikëri
    1. për duart, Eks. 17:12
    2. për kohët, Isa. 33:6
    3. për njerëzit, Jer. 5:3; 7:28; 9:2
    4. për Perëndinë, Psa. 40:11; 88:11; 89:1, 2, 5, 8; 119:138
- III. Përdorimi i këtij koncepti të Dhjatës së Vjetër nga Pali
- A. Pali e bazon kuptimin e tij të ri të YHWH-së dhe Dhjatën e Vjetër në takimin e vet personal me Jezusin në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:1-19; 22:3-16; 26:9-18).
  - B. Ai gjeti mbështetje në Dhjatën e Vjetër për botëkuptimin e tij të ri në dy pasazhe kyçe të Dhjatës së Vjetër, të cilat përdorin rrënjën אָמֵן
    1. Zan. 15:6 – takimi personal i Abrahamit, i nisur nga Perëndia (Zanafilla 12) rezultoi në një jetë bindjeje dhe besimi (Zan. 12-22). Pali aludon për këtë në Romakëve 4 dhe Galatasve 3.
    2. Isa. 28:16 – ata që besojnë në të (pra, në gurin e sprovuar të qoshes të Perëndisë, i cili është vendosur në mënyrë të patundur), kurrë
      - a. Rom. 9:33, “nuk do të turpërohen” apo “zhgënjehen”
      - b. Rom. 10:11, njësoj si më lart
    3. Hab. 2:4 – ata që njohin Perëndinë besnik do të bëjnë jetë besnike (shih Jer. 7:28). Pali e përdor këtë pasazh në Rom. 1:17 dhe Gal. 3:11 (vini re dhe Heb. 10:38).
- IV. Përdorimi i këtij koncepti të Dhjatës së Vjetër nga Pjetri
- A. Pjetri kombinon
    1. Isa. 8:14 – 1 Pjet. 2:8 (guri i pengesës)
    2. Isa. 28:16 – 1 Pjet. 2:6 (guri i qoshes)
    3. Psa. 118:22 – 1 Pjet. 2:7 (guri i refuzuar)
  - B. Ai i kthehet gjuhës unike që përshkruan Izraelin, “racë e zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë, popull për zotërimin e Perëndisë” nga
    1. Ligji i Përt. 10:15; Isa. 43:21
    2. Isa. 61:6; 66:21
    3. Eks. 19:6; Ligji i Përt. 7:6
 dhe tani e përdor për besimin e kishës në Krishtin (shih 1 Pjet. 2:5,9)
- V. Përdorimi i këtij koncepti nga Gjoni
- A. Përdorimi në Dhjatën e Re
 

Termi “besoi” vjen nga termi greqisht *pisteuō*, që mund të përkthehet edhe “besoj”, “besim”, ose “bindje”. Për shembull, EMRI nuk shfaqet në ungjillin e Gjonit, por si FOLJE përdoret shpesh. Tek Gjoni 2:23-25, ka pasiguri për vërtetësinë e përkushtimit të turmës ndaj Jezusit të Nazaretit si Mesi. Shembuj të tjerë të këtij përdorimi sipërfaqësor të termit “besoj” gjenden tek Gjoni 8:31-59 dhe Veprat e Apo. 8:13, 18-24. Besimi i vërtetë biblik është më tepër sesa një reagim fillestar. Ai duhet vijuar nga një proces dishepullizimi (shih Mat. 13:20-22, 31-32).

## B. Përdorimi i tij me PARAFJALË

1. *eis* do të thotë “në”. Ky konstrukt unik thekson faktin se besimtarët e vendosin besimin në Jezusin
  - a. në emrin e Tij (Gjoni 1:12; 2:23; 3:18; 1 Gjonit 5:13)
  - b. në Të (Gjoni 2:11; 3:15,18; 4:39; 6:40; 7:5,31,39,48; 8:30; 9:36; 10:42; 11:45 48; 12:37,42; Mat. 18:6; Veprat e Apo. 10:43; Fil. 1:29; 1 Pjet. 1:8)
  - c. në Mua (Gjoni 6:35; 7:38; 11:25,26; 12:44,46; 14:1,12; 16:9; 17:20)
  - d. në Birin (Gjoni 3:36; 9:35; 1 Gjonit 5:10)
  - e. në Jezusin (Gjoni 12:11; Veprat e Apo. 19:4; Gal. 2:16)
  - f. në Dritën (Gjoni 12:36)
  - g. në Perëndinë (Gjoni 14:1)
2. *ev* do të thotë “në”, si te Gjoni 3:15; Marku 1:15; Veprat e Apo. 5:14
3. *epi* do të thotë “në” ose “mbi”, si te Mat. 27:42; Veprat e Apo. 9:42; 11:17; 16:31; 22:19; Rom. 4:5, 24; 9:33; 10:11; 1 Tim. 1:16; 1 Pje. 2:6
4. RASA DHANORE pa PARAFJALË, si te Gal. 3:6; Veprat e Apo. 18:8; 27:25; 1 Gjonit 3:23; 5:10
5. *hoti*, që do të thotë “besoj se”, i jep përmbajtje asaj që besohet
  - a. Jezusi është i Shenjti i Perëndisë (Gjoni 6:69)
  - b. Jezusi është Unë Jam-i (Gjoni 8:24)
  - c. Jezusi është në Atin dhe Ati është në Të (Gjoni 10:38)
  - d. Jezusi është Mesia (Gjoni 11:27; 20:31)
  - e. Jezusi është Biri i Perëndisë (Gjoni 11:27; 20:31)
  - f. Jezusi u dërgua nga Ati (Gjoni 11:42; 17:8, 21)
  - g. Jezusi është një me Atin (Gjoni 14:10-11)
  - h. Jezusi erdhi nga Ati (Gjoni 16:27, 30)
  - i. Jezusi e identifikoi Vetën me emrin e besëlidhjes së Atit, “Unë Jam” (Gjoni 8:24; 13:19)
  - j. Ne do të jetojmë me Të (Rom. 6:8)
  - k. Jezusi vdiq dhe u ringjall (1 Thes. 4:14)

## VI. Përmbyllje

Besimi biblik është reagimi njerëzor ndaj një fjale/premtimi Hyjnor. Perëndia është gjithmonë nismëtari (p.sh., Gjoni 6:44-45), por pjesë e këtij komunikimi hyjnor është nevoja që njerëzit t’i përgjigjen (dmth., shih TEMË E VEÇANTË: BESËLIDHJA / Special Topic: Covenant).

- A. Pendimi (shih TEMË E VEÇANTË: PENDIMI NË DHIATËN E VJETËR / SPECIAL TOPIC: REPENTANCE IN THE OLD TESTAMENT)
- B. Besimi (shih TEMË E VEÇANTË: BESIMI, BESOJ OSE KAM BESIM / SPECIAL TOPIC: FAITH, BELIEVE, OR TRUST)
- C. Bindja
- D. Qëndrueshmëria (shih TEMË E VEÇANTË: QËNDRUESHMËRIA / SPECIAL TOPIC: PERSERVERANCE)

Besimi biblik është

1. marrëdhënie personale (besimi fillestar)
2. pohim i së vërtetës biblike (besim në zbulesën e Perëndisë, dmth., Shkrimet)
3. reagim i duhur dhe plot bindje ndaj tij (besimi i përditshëm)

Besimi biblik nuk është biletë për në qiell, apo policë sigurimi. Ai është marrëdhënie personale. Ky është synimi i krijimit dhe bërjes së njerëzve në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë me Perëndinë (shih Zan. 1:26-27). Çështja qëndron te “ngushtësia e marrëdhënies”. Perëndia dëshiron bashkësi, jo një qëndrim të caktuar teologjik! Por bashkësia me Perëndinë e shenjtë kërkon që fëmijët e tij të shfaqin karakteristikat e “familjes” (pra, shenjtërinë, shih Lev. 19:2; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:15-16). Rënia (Zanafilla 3) na preku aftësinë për t’u përgjigjur në mënyrën e duhur. Si rrjedhojë, Perëndia veproi në emrin tonë (shih Ezek. 36:27-38), duke na dhënë një “zemër të re” dhe një “frymë të re”, që na mundëson, përmes besimit dhe pendimit, që të kemi bashkësi me Të dhe t’i bindemi!

Të tria këto janë kyçe. Të tria duhen ruajtur. Synimi është të njohim Perëndinë (si në kuptimin hebraisht, ashtu dhe atë greqisht) dhe të reflektojmë karakterin e Tij në jetët tona. Synimi i besimit nuk është qielli një ditë, por ngjashmëria me Krishtin përditë!

Besnikëria njerëzore është rezultati (Dhjata e Re), jo baza (Dhjata e Vjetër), për një marrëdhënie me Perëndinë: besimi i njeriut në besnikërinë e Tij; besimi i njeriut në besueshmërinë e Tij. Thelbi i pikëpamjes së Dhjatës së Re për shpëtimin është se njerëzit duhet t'i përgjigjen fillimisht dhe vazhdimisht hirit dhe mëshirës së Perëndisë, të demonstruar në Krishtin. Ai ka dashur, ai ka dërguar, ai ka siguruar; ne duhet t'i përgjigjemi me besim dhe besnikëri (shih Efe. 2:8-9 dhe 10)!

Perëndia besnik do njerëz besnikë për t'iu zbuluar kësaj bote pa besim dhe për t'iu sjellë ata në një besim personal në Të.

■ **“nga i cili jeni thirrur”** Ky është theksi i vazhdueshëm mbi të zgjedhurit e Perëndisë të besimtarëve korintas (shih 1 Kor. 1:2,9,24,26; Veprat e Apo. 18:9).

■ **“në bashkësinë e Birit të tij”** Ky është termi grek *koinonia* i cili do të thotë pjesëmarrje e bashkuar në diçka. Perëndia na ka thirrur për të qënë në bashkësi me Birin e Tij si në mënyrë pozicionale (shih Tema e Veçantë: Shenjtërimi [Special Topic: Sanctification] tek 1 Kor. 1:2) dhe në marrëdhënie. Qëllimi i Krishtëritimit është ngjashmëria me Krishtin (shih Rom. 8:29; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 2:10).

Stili i jetesës së besimtarëve pasi ata janë takuar me Krishtin janë dhësmi e shpëtimit të tyre (shih librat e Dhjatës së Re të Jakobit dhe 1 Gjonit). Ata janë shpëtuar me anë të hirit përmes besimit për tek veprat (shih Efe. 2:8-9,10)! Ata janë shpëtuar për të shërbyer (shih Rom. 6:11)! Besimi pa vepra është i vdekur, sikurse janë veprat pa besimin (shih Mat. 7:21-23 dhe Jakobi 2:14-26). Qëllimi i zgjedhjes së Perëndisë është që besimtarët të jenë “të shenjtë dhe të paqortueshëm” (shih Efe. 1:4; Mat. 5:48).

Pali shpesh sulmohej për ungjillin e tij të lirë radikal për shkak se dukej se inkurajonte jetë të paperëndishme. Një ungjill që dukej kaq i shkëputur nga sjellja morale mund të shpinte në abuzim. Ungjilli i Palit ishte falas në hirin e Perëndisë dhe në veprën e përfunduar të Krishtit dhe në bindjen e Frymës së Shenjtë, por ai gjithashtu kërkonte një përgjigje të përshtatshme, jo vetëm një përgjigje fillestare pendese, por një pendesë të vazhdueshme. Jetesa e perëndishme është rezultati, nuk është ligjshmëria. Veprat e mira nuk janë mekanizmi i shpëtimit, por janë rezultati i tij. Ky paradoks i shpëtimit plotësisht falas dhe një përgjigje që kushton gjithçka është i vështirë për t'u komunikuar, por të dyja duhet të mbahen në një ekuilibër të mbushur me tension, paradoksisht dhe dialektik. Nuk duhet të guxojmë të ndajmë drejtësimin dhe shenjtërimin.

### TEMË E VEÇANTË: *KOINŌNIA* (SPECIAL TOPIC: *KOINŌNIA*)

Termi “bashkësi” (*koinōnia*) do të thotë

1. shoqërim i ngushtë me një person
  - a. me Birin (shih 1 Kor. 1:9; 1 Gjonit 1:6)
  - b. me Frymën (shih 2 Kor. 13:14; Fil. 2:1)
  - c. me Atin dhe me Birin (shih 1 Gjonit 1:3)
  - d. me vëllezërit/motrat e tjerë të besëlidhjes (shih Veprat e Apo. 2:42; 2 Kor. 8:23; Gal. 2:9; Filemoni v. 17; 1 Gjonit 1:3,7)
  - e. jo me ligësinë (shih 2 Kor. 6:14)
2. shoqërim i ngushtë me gjëra ose grupe
  - a. me ungjillin (shih Fil. 1:5; Filemoni 6)
  - b. me gjakun e Krishtit (shih 1 Kor. 10:16)
  - c. jo me errësirën (shih 2 Kor. 6:14)
  - d. me vuajtjet (shih 2 Kor. 1:7; Fil. 3:10; 4:14; 1 Pje. 4:13)
3. dhuratë ose kontribut, që jepet në mënyrë bujare (shih Rom. 12:13; 15:26; 2 Kor. 8:4; 9:13; Fil. 4:15; Heb. 13:16)

4. dhurata e hirit të Perëndisë përmes Krishtit, e cila rimëkëmb bashkësinë e njerëzimit me Të dhe me vëllezërit e motrat e tij

Kjo thekson marrëdhënien horizontale (njeri me njeri) që shkaktohet nga marrëdhënia vertikale (njeriu me Krijuesin). Ajo thekson dhe nevojën për komunitetin e krishterë, si dhe gëzimin e këtij komuniteti (dmth., Heb. 10:25).

■ **“Birit të tij”** Jezusi si Biri i Perëndisë është një temë e përsëritur në shkrimet e Palit (shih Rom. 1:3,4,9; 5:10; 8:3,29,32; 1 Kor. 1:9; 2 Kor. 1:19; Gal. 1:16; 2:20; 4:4,6; Efe. 4:13; Kol. 1:13; 1 Thes. 1:10). Ai nuk është “biri” vetëm në kohë, por është “Biri” në përjetësi (shih Heb. 1:2; 3:6; 5:8; 7:28). Nuk ka pasur asnjë kohë kur Jezusi nuk ka qënë Biri. Lartësimi i Jezusit nga ringjallja dhe në ngjitjen e tij në qiell ishin vetëm restaurime dhe lartësime të lavdisë së Tij para-ekzistuese, para-mishërimi.

### TEMË E VEÇANTË: BIRI I PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE SON OF GOD)

Ky është një nga titujt kryesorë në Dhjatën e Re për Jezusin. Pa dyshim që ka ngjyrim hyjnor. Ajo e përfshinte Jezusin si “Biri”, ose si “Biri im”, dhe Perëndisë i drejtohet me termin “Atë”. Në Dhjatën e Re shfaqet mbi 124 herë. Edhe vetëpërcaktimi si “Bir i Njeriut” ka ngjyrim hyjnor nga Dan. 7:13-14.

Në Dhjatën e Vjetër, termi “bir” mund t’u referohet katër grupeve të veçanta (shih Temën e Veçantë: “Bij të...” / Special Topic: “Sons of. . .”).

- A. engjëjve (zakonisht, në SHUMËS, shih Zan. 6:2; Jobi 1:6; 2:1)
- B. Mbreti i Izraelit (shih 2 Sam. 7:14; Psa. 2:7; 89:26-27)
- C. kombi i Izraelit në tërësi (shih Eks. 4:22-23; Ligji i Përt. 14:1; Os. 11:1; Mal. 2:10)
- D. gjykatësit e Izraelit (shih Psa. 82:6)

Ajo që lidhet me Jezusin është faza e dytë. Në këtë mënyrë, “biri i Davidit” dhe “biri i Perëndisë” lidhen me 2 Samuelin 7; Psalmi 2 dhe 89. Në Dhjatën e Vjetër, “biri i Perëndisë” nuk përdoret kurrë në mënyrë të veçantë për Mesinë, përveç si mbreti eskatologjik, si një nga “ofiqtet e vajosura” të Izraelit. Sidoqoftë, në Pergamenat e Detit të Vdekur, ky titull me ngjyrim mesianik është i zakonshëm (shih referencat e veçanta në *Dictionary of Jesus and the Gospels* [Fjalori i Jezusit dhe i ungjijve], f. 770). Po kështu, “Biri i Perëndisë” është titull mesianik në dy vepra judaike apokaliptike në periudhën ndërthjatore (shih 2 Esdra 7:28; 13:32, 37, 52; 14:9 dhe 1 Enokut 105:2).

Sfondi i saj në Dhjatën e Re, kur përdoret për Jezusin, përmbledhet më së miri nga një sërë kategorish.

1. paraekzistenca e tij (shih Gjoni 1:15-30; 8:56-59; 16:28; 17:5; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3; 10:5-8)
2. lindja e tij unike (e virgjër) (shih Isa. 7:14; Mat. 1:23; Luka 1:31-35)
3. pagëzimi i Tij (shih Mat. 3:17; Marku 1:11; Luka 3:22. Zëri i Perëndisë nga qielli bashkon mbretin mbretëror të Psalmi 2 me shërbëtorin e përvuajtur të Isaisë 53).
4. tundimi i tij mesianik (shih Mat. 4:1-11; Marku 1:12, 13; Luka 4:1-13). Ai tundohet për të vënë në dyshim natyrën e Tij birnore, ose të paktën, që ta arrinte synimin e saj me mjete të ndryshme nga kryqi).
5. pranimi i Tij nga rrëfyet të papranueshëm
  - a. demonët (shih Marku 1:23-25; Luka 4:31-37, 41; Marku 3:11-12, 5:7; shih Temën e Veçantë: Demonët [frymërat e papastra] / Special Topic: The Demon [unclean spirits])
  - b. jobesimtarët (shih Mat. 27:43; Marku 14:61; Gjoni 19:7)
6. pranimi i Tij nga dishepujt e Tij
  - a. Mat. 14:33; 16:16
  - b. Gjoni 1:34, 49; 6:69; 11:27

7. rrëfimi që Ai dha për veten

a. Mateu 11:25-27

b. Gjoni 10:36

8. përdorimi nga ana e tij e metaforës familjare të Perëndisë si Atë

a. përdorimi i fjalës “*abba*” për Perëndinë

1) Marku 14:36

2) Romakëve 8:15

3) Galatasve 4:6

b. përdorimi i përsëritur i fjalës Atë (*patēr*) për të përshkruar marrëdhënien e Tij me Perëndinë

Si përmbledhje, titulli “Bir i Perëndisë” kishte kuptim të madh teologjik për ata që e njihnin Dhjatën e Vjetër dhe premtimet e kategoritë e saj, por shkruesit e Dhjatës së Re ishin nervozë për ta përdorur këtë term me johebrejtë, për shkak të sfondit të tyre pagan ku “perënditë” merrnin gra dhe fëmijët që lindnin prej tyre quheshin “titanë” ose “gjigantë”.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:10-17

<sup>10</sup> Tani vëllezër, ju bëj thirrje në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit të flisni që të gjithë të njëjtën gjë dhe të mos keni ndasi midis jush, por të jeni plotësisht të bashkuar, duke pasur një mendje dhe një vullnet. <sup>11</sup> Sepse më është treguar për ju, o vëllezër, nga ata të shtëpisë së Kloes, se në mes jush ka grindje. <sup>12</sup> Dhe dua të them këtë, që secili nga ju thotë: “Unë jam i Palit,” “unë i Apolit,” “unë i Kefës” dhe “unë i Krishtit.” <sup>13</sup> Vallë i ndarë qenka Krishti? Mos Pali u kryqëzua për ju? Apo ju u pagëzuat në emër të Palit? <sup>14</sup> E falënderoj Perëndinë që nuk kam pagëzuar asnjë nga ju, me përjashtim të Krispit dhe të Gait, <sup>15</sup> që askush të mos thotë se e pagëzova në emrin tim. <sup>16</sup> Unë pagëzova edhe familjen e Stefanës; përveç tyre nuk di të kem pagëzuar ndonjë tjetër. <sup>17</sup> Sepse Krishti nuk më dërgoi të pagëzoj, por të predikoj ungjillin, jo me dituri fjale, që kryqi i Krishtit të mos dalë i kotë.

**1:10 “Tani”** Kjo është një formë adversative. Pali nis trupin kryesor të letrës.

■ **“ju bëj thirrje”** Kjo frazë është edhe e butë edhe e fortë. Ajo ishte një thirrje për një jetesë të përshtatshme sikurse dhe një sfidë autoritare. Pali e përdorte shpesh këtë term (shih 1 Kor. 1:10; 4:16; 16:15; 2 Kor. 2:8; 5:20; 6:1; 10:1; 12:1,8; 15:30; Efe. 4:1; Fil. 4:2; 1 Thes. 4:10; 1 Tim. 1:3; Filemon 1:9-10). Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

#### TEMË E VEÇANTË: NGUSHËLLIM (SPECIAL TOPIC: COMFORT)

I. Ngushëllim në Dhjatën e Vjetër (shënime nga Isa. 40:1)

Ky term (BDB 636, KB 688, *Piel* urdhërore, në shumës) përdoret tek Isaia 1-39 vetëm tre herë, por tek Isaia 40-66 përdoret katërmbëdhjetë herë (sidomos në *Piel*). “Ngushëllim” mund të ishte titulli i këtij pasazhi nga Isaia. Ai përcakton përkujdesin dhe interesimin e dhembshur të YHWH (shih Isa. 12:1). Fjala duket se është zhvilluar nga ngjethja e rëndë e kuajve. YHWH është i ligështuar që Atij i duhej t’i dënonte njerëzit e Tij. Dënimi ka mbaruar. Kjo nuk është e sigurtë nëse është për shkak se

A. Ata u penduan (dmth., Ezekieli 18)

B. YHWH zgjodhi të vepronte në vend të tyre edhe pse ata ishin të paaftë për një pendesë të vërtetë (shih Ezek. 36:22-38)

Një ditë e re (dmth., një besëlidhje e re, shih Jer. 31:31-34) ka aguar! Ajo bazohet tek karakteri i YHWH, jo performanca e popullit të tij (shih Rom. 3:21-31; Galatasve 3; Efe. 2:8-9); aftësia e Tij, jo e tyre; plani i Tij i përjetshëm shpengues ku ata janë një pjesë përfshirëse.

## II. Ngushëllim në Dhjatën e Re (shënime nga 2 Kor. 1:4-11)

Termi “ngushëllim”, *paraklēsis*, në format e tij të ndryshme, përdoret dhjetë herë tek 2 Kor. 1:3-11. Është termi kyç përgjatë të gjithë pasazhit dhe gjithashtu tek 2 Korintasve 1-9, ku ai përdoret njëzetë e pesë herë. Fjala do të thotë “të thërrasësh përgjatë rrugës”. Ajo shpesh përdoret në një kuptim ligjor për një avokat i cili paraqet ndihmë ligjore, ngushëllim dhe udhëheqje ligjore.

Në këtë kontekst ajo përdoret në kuptimin e inkurajimit dhe konsolidimit. Një term i lidhur me të, *paraklētos*, përdoret për Frymën e Shenjtë tek Gjoni 14:16,26; 15:26; 16:7; dhe për Jezusin tek 1 Gjonit 2:1. Në këtë kontekst ajo përdoret për Atin (shih TEMËN E VEÇANTË PARACLETE [PARAKLŌTOS] / SPECIAL TOPIC: PARACLETE [PARAKLŌTOS]).

Folja përdoret në disa kuptime.

### A. Septuaginti

1. Këshilloj, Ligji i Përt. 3:28
2. Ngushëlloj, Zan. 24:67; 37:35; Ps. 119:50 (në një kuptim mesianik tek Isa. 40:1; 49:13; 51:3; 61:2)
3. Të kesh dhembshuri, Ligji i Përt. 32:36; Gjyq. 2:18; Ps. 135:14
4. Jap ngushëllim, Isa. 35:4
5. Thërras, Eksod. 15:13

### B. Shkrimet e Palit ndaj Korintit

1. Këshilloj, 1 Kor. 1:10; 4:16; 14:30-31; 16:15-16; 2 Kor. 2:8; 5:20; 6:1; 8:4,6; 10:1
2. Ngushëlloj, jap zemër, 2 Kor. 1:4,6; 2:7; 7:6,7,13; 13:11
3. Kam dhembshuri, ngushëlloj, 1 Kor. 4:13
4. Përgjërohemi, lutem, kërkoj, 1 Kor. 16:12; 2 Kor. 9:5; 12:18

■ **“vëllezër”** Pali përdor termin “vëllezër” ose “vëlla” shpesh. Edhe pse Pali duhej t’i bënte thirrje kësaj grigje me fjalë të forta, ata ende ishin vëllezërit dhe motrat e tij në Krishtin.

Pali shpesh e përdor këtë term për të dhënë një sinjal për një temë të re, por në këtë libër ai e përdor atë gjithashtu për të sinjalizuar unitetin e kësaj kisha si me Palin ashtu edhe me kishat e tjera.

■ **“në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit”** Në jetën hebraike emri përfaqësonte karakterin dhe autoritetin e dikujt. Këtu përkthimi i Phillips ka zënë thelbin “me gjithçka që Zoti ynë Jezu Krisht do të thotë për ju”.

## TEMË E VEÇANTË: EMRI I ZOTIT (DHJATA E RE) [SPECIAL TOPIC: THE NAME OF THE LORD (NT)]

Kjo ishte një frazë e zakonshme e Dhjatës së Re për praninë personale dhe fuqinë aktive të Perëndisë Triun në kishë. Nuk ishte formulë magjike, por një apel ndaj karakterit të Perëndisë siç shihej në Jezusin.

Shpesh kjo frazë i referohet Jezusit si Zot (shih Fil. 2:11)

1. Në rrëfimin e besimit të dikujt në Jezusin (shih Rom. 10:9-13; Veprat e Apo. 2:21,38; 8:12,16; 10:48; 19:5; 22:16; 1 Kor. 1:13,15; Jakobi 2:7)
2. Në dëbimin e demonëve (shih Mat. 7:22; Mark 9:38; Luka 9:49; 10:17; Veprat e Apo. 19:13)
3. Në shërim (shih Veprat e Apo. 3:6,16; 4:10; 9:34; Jakobi 5:14)
4. Në një akt shërbese (shih Mat. 10:42; 18:5; Luka 9:48)
5. Në kohën e disiplinës së kishës (shih Mat. 18:15-20)
6. Gjatë predikimit ndaj johebrenjve (shih Luka 24:47; Veprat e Apo. 9:15; 15:17; Rom. 1:5)
7. Në lutje (shih Gjoni 14:13-14; 15:7,16; 16:23; 1 Kor. 1:2)
8. Si një mënyrë për t’iu referuar krishtërit (shih Veprat e Apo. 26:9; 1 Kor. 1:10; 2 Tim. 2:19; Jakobi 2:7; 1 Pjet. 4:14)

Çfarëdo që ne bëjmë si shpallës, shërbëtorë, ndihmës, shërues, dëbues demonësh, etj., ne e bëjmë në karakterin e Tij, në fuqinë e Tij, në sigurimin e Tij – në Emrin e Tij (dmth., Fil. 2:9-10)!

- ▣ **“që të gjithë të njëjtën gjë”** Gjenden dy fjali të nënrenditura aktive të tashme në qëllimin e Palit (dmth, *hina*).
1. Që të mos vazhdojë të ketë mosmarrëveshje (fjali e nënrenditur aktive e tashme)
  2. Që ata të mund të (fjali e nënrenditur aktive e tashme) jenë lidhur së bashku (dmth., pjesore e përkryer pasive, e cila e bën këtë një formë perifrastike).

Këto fjali të nënrenditura shtojnë një shënim kontigjence. Kishte ndasi dhe këto grupe nuk ishin të lidhura së bashku. Qëndrimi dhe veprimet e nevojshme për të mbajtur unitetin janë të listuara tek Efe. 4:2-3.

Dëshira e Palit për këtë kishë reflekton lutjen e Jezusit tek Gjoni 17:11,21-23, “që ata të mund të jenë një, sikurse edhe ne jemi”. Kjo është gjithashtu nxitja e Efe. 4:1-6. Uniteti (jo uniformiteti) është thelbësor për një kishë të shëndetshme, që rritet, dhe që ndjek Urdhërimin e Madh (shih Fil. 1:27). Mungesa e unitetit rezulton në mendje të verbuara (shih 2 Kor. 3:14; 4:4; 11:3).

▣ **“të mos keni ndasi midis jush”** Ky term (dmth., *schismata*) u përdor në gjuhën greke Koine të grupeve partiake politike (shih Veprat e Apo. 14:4; 23:7). Në anglisht kemi fjalën, “schism”, nga ky term grek. Ishte një nga problemet më të mëdha në këtë kishë (shih 1 Kor. 11:18-19; 12:25). Këto ndarje u bazuan në:

1. Preferencat personale të besimtarëve për disa aftësi drejtimi (p.sh., retorikë)
2. Krenaria dhe xhelozia personale e besimtarëve mbi dhuntitë frymore
3. Dallimi i besimtarëve i kategorive ekonomike (dmth., të pasur dhe të varfër)
4. Paragjykimet e besimtarëve mbi shtresat shoqërore (dmth., skllevër dhe të lirë)
5. Krenaria raciale e besimtarëve (dmth., hebrenj dhe johebrenj)
6. Xhelozia ose krenaria e besimtarëve mbi statusin martesor (dmth., të martuar dhe të pamartuar)
7. Krenaria e besimtarëve mbi nivelet intelektuale (dmth., etilizmi arsimor i shekullit të parë, sofistët)

Në shumë mënyra ky theks mbi arrogancën, krenarinë, dogmatizmin dhe preferencat personale përshkruan konfuzionin denominacional në kishën moderne. Çdo grup kërkon që të jetë i pari që ndjek liderin e tyre njerëzor (dmth., Luteri, Kalvini, Arminiusi, Wesley [Uesli], etj.). Çdo grup mendon se ata reflektojnë në mënyrë ekskluzive mendjen e Perëndisë. Oh, sa nevojë të vazhdueshme kemi për përlësi dhe aftësi për t’u mësuar. Të gjithë ata që vazhdimisht thërrasin emrin e Jezusit janë kisha e Tij!

▣ **“por të jeni plotësisht të bashkuar, duke pasur një mendje dhe një vullnet”** Përkthimi i Today's English Version (TEV) [Versioni i Sotshëm Anglez] thotë “plotësisht të bashkuar me vetëm një mendim dhe një qëllim”. Qëllimi është mbretëria e Perëndisë, ungjilli, Urdhërimi i Madh, shenjtëria personale, jo bazimet, preferencat apo planet personale!

**1:11 “të shtëpisë së Kloes”** Ne nuk dimë asgjë për këtë zonjë përveçse ndoshta që ajo ishte një anëtare e kishës në Korint ose të paktën punonjësit e saj ishin anëtarë të saj. Emri i saj është një nofkë për perëndeshën e bujqësisë, Demeter. Shërbëtorët e saj janë një burim i njohurisë së Palit mbi problemet që ishin zhvilluar brenda kishave në shtëpitë e Korintit. Shih hyrjen VI. A.

▣ **“se në mes jush ka grindje”** Po i njëjti term (dmth., *eris*) listohet tek frytet e mishit tek Gal. 5:20, i cili karakterizon njerëzit e rënë, të zemëruar dhe egoist. Ai gjithashtu listohet tek disa lista të tjera mëkatesh të letrave të Palit (shih 1 Kor. 3:3; 2 Kor. 12:20; 1 Tim. 6:4). Kjo gjë nuk duhet ta karakterizojë kurrë, kurrë kishën e Jezus Krishtit!

**1:12** Kjo duket se është një listë e ndarjeve (dmth., grupi i Palit, grupi i Apollit, grupi i Pjetrit, grupi i Jezusit). Shumë gjëra janë krijuar nga karakteristikat e liderave (dmth., Pali = partia e lirisë, e cila përfshinte johebrenjtë vetëm me anë të besimit; Apollit = partia filozofike; Kefa = partia tradicionaliste hebraike ose legalistike, shih 2 Kor. 11:18-33); Krishti = ata të një shtrese, thirrje, dhuntie, ose jete frymore të veçantë (shih ndoshta 2 Kor. 12:1). Megjithatë, nuk ka një informacion të sigurtë në Dhjatën e Re mbi teologjinë apo motivimin e secilit grup. Këta drejtues në vetvete nuk ishin të përçarë. Ishin grupet në Korint, të cilët pretendonin se ata ishin kampionët e tyre, që ishin të përçarë.

▣ **“Apollit”** Ky ishte një predikues mjaft i shkolluar dhe elokuent nga Aleksandria në Egjipt. Ai ishte në Korint (shih Veprat e Apo. 18:24-19:1), por ai refuzonte të kthehej (shih 1 Kor. 16:12). Ai ishte thjesht lloji i liderit ndaj së cilit kjo kishë tërhiqej.

▣ **“Kefës”** Ky është emri në gjuhën aramaike që i korrespondon emrit grek, Pjetër. Nuk është e sigurtë nëse Pjetri ishte ndonjëherë në Korint. Nëse jo, kjo mund të reflektojë një parti “judaistike” (shih Galatasve dhe ndoshta 2 Korintasve).

▣ **“unë i Krishtit”** Është e pasigurtë nëse ky është një reagim i Palit ndaj ndarjeve të orientuara nga liderët apo një tjetër grup ndarës i cili pretendonte se vetëm Krishti ishte lideri i tyre. Klementi i Romës, i cili i shkroi Korintit në vitin 95 pas Krishtit (dmth., I Klem. 48) nuk e përmend partinë e Krishtit, edhe pse ai përmend grupe të tjera ndarëse. Kjo mbështet pikëpamjen se kjo mund të jetë një shpallje nga Pali. Ata mund të zgjedhin të dallojnë dhe të ndjekin liderë njerëzorë, por ai ngre lart dhe i përket vetëm Krishtit! Studiues të tjerë kanë supozuar se ky mund të ketë qënë një grup që pretendonte një njohuri të veçantë të Jezusit ose një zbulues të veçantë nga Jezusi ose një marrëdhënie të veçantë me Jezusin (dmth., një grup elitë, i tipit Gnostik). Por sërish, kjo është e pasigurtë dhe thjesht spekulim. Ka qark shumë që nuk dimë për kishën e shekullit të parë dhe të dytë.

**1:13** Ky varg regjistron reagimin e tmerruar të Palit. “Vallë i ndarë qenka Krishti?” Kjo është një formë treguese pasive e përkryer, që nënkupton se Krishti është ndarë dhe qëndron i ndarë nga qëndrimet dhe reagimet e këtyre ndasive në Korint. Nëse kjo është një pyetje, atëherë përgjigja e pritur është “po”. Dorëshkrimi i papirusit i cili u shkrua në vitet 200 pas Krishtit, ka një variant tekstual: “Krishti nuk mund të ndahet” (por ky papirus është dëmtuar dhe teksti është i pasigurtë). Dorëshkrimet greke më antike dhe të besueshme uncial, Ɑ, A, B, C, D, F dhe G fshijnë fundin mohues, dhe në këtë mënyrë, e bëjnë këtë (1) një pyetje; (2) një thirrje; ose (3) një pohim. Version UBS<sup>4</sup> i jep tekstit më të shkurtër një cilësim A (i sigurtë).

▣ **“Mos Pali u kryqëzua për ju? Apo ju u pagëzua në emër të Palit?”** Këto janë pohime theksuese të Palit mbi supremacinë e Krishtit (dmth., ai ul veten e tij) ndoshta të adresuara tek këto grupe ndarëse ose të pakten tek grupi që thirrej me anë të emrit të tij. Kjo pyetje pret një “jo” si përgjigje.

**1:14 “Krispit”** Ky është personi i përmendur tek Veprat e Apo. 18:8 i cili ishte drejtuesi i sinagogës në Korint i cili pranoi Krishtin. Veprat e Apo. 18:8 gjithashtu përmend se ai u pagëzua së bashku me shtëpinë e tij (shih 1 Kor. 1:16). Me sa duket Pali bëri këtë pagëzim “shtëpie”. Në botën antike kur kreu i shtëpisë konvertohej, zakonisht konvertohej e gjithë shtëpia. Kjo normalisht përfshinte fëmijët dhe shërbëtorët, nëse kishte ndonjë. Për shënimin tim të plotë shihni tek Veprat e Apo. 16:5 online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org).

▣ **“Gait”** Ky person mund të jetë ai i përmendur tek Rom. 16:23, në shtëpinë e së cilit takohej kisha në Korint. Emri i tij i plotë romak ishte Gaius Titus Justus.

**1:16 “Stefanës”** Ky është personi i përmendur tek 1 Kor. 16:15,17. Ai ishte një nga tre anëtarët e kishës që solli një letër nga kisha tek Pali në Efes. Shih Hyrjen, VI. A.

**1:17 “Sepse Krishti nuk më dërgoi të pagëzoj, por të predikoj ungjillin”** Kjo nuk është menduar që të diskreditojë pagëzimin, por të reagojë ndaj frymës ndarëse në kishën e Korintit që ishte duke lartësuar lidera të caktuar. Megjithatë, ky pohim tregon se pagëzimi nuk shihej si një agjent “sakramental” i hirit. Është habitëse që disa i interpretojnë shkrimet e Palit në një kuptim sakramental ndërkohë që në të gjitha shkrimet e tij ai përmend në mënyrë specifike Darkën e Zotit vetëm një herë tek 1 Kor. 11 dhe pagëzimin dy herë, tek Rom. 6:1-11 dhe Kol. 2:12. Megjithatë, pagëzimi është vullneti i Perëndisë për çdo besimtar:

1. Ai është shembulli i Jezusit (Mate. 3:13-17)
2. Ai është urdhërimi i Jezusit (Mate. 28:28-10)
3. Ai është një procedurë normale dhe e pritshme për të gjithë besimtarët (Romakëve 6, Veprat e Apostujve 2:38)



Unë nuk besoj se është kanali për të marrë hirin e Perëndisë apo Frymën. Ai ishte mundësia publike që besimtarët e rinj të shprehin besimin e tyre në çdo mënyrë publike dhe vendimtare. Asnjë besimtar i Dhjatës së Re nuk do të pyeste, “A duhet të pagëzohem unë për t’u shpëtuar?” Jezusi u pagëzua! Jezusi e urdhëroi kishën që ta bënte! Bëjeni!

## TEMË E VEÇANTË: PAGËZIMI (SPECIAL TOPIC: BAPTISM)

### I. Pagëzimi në jetën hebraike

#### A. Pagëzimi ishte një rit i zakonit mes hebrenjve të shekullit të parë dhe të dytë.

1. Përgatitje për adhurim në tempull (dmth., ritet e pastrimit)
2. Vetë-pagëzimi i prozelitëve.

Nëse dikush nga sfondi johebraik bëhej një bir i plotë i Izraelit, ai duhej të përmbushte tri detyra:

- a. Të rrethpritej nëse ishte mashkull
  - b. Të vetë-pagëzohej me anë të zhytjes, në prani të tri dëshmitarëve
  - c. Flijimi në Tempull
3. Një vepër pastrimi (shih Levitiku 15)

Në grupet sektare të Palestinës së shekullit të parë, si Esenët, pagëzimi ishte dukshëm një përvojë e zakonit dhe e përsëritur. Megjithatë, për Judaizmin kryesor, pagëzimi i Gjonit për pendesë do të kishte qënë poshtërues për një bir natyral të Abrahamit që të kalonte përmes një riti pranimi për johebrejtë.

#### B. Disa precedentë të Dhjatës së Vjetër mund të citohen për larje ceremoniale.

1. Si një simbol i pastrimit frymëror (shih Isa. 1:16)
  2. Si një rit i rregullt i kryer nga priftërinjtë (shih Eksodi 19:10; Levitiku 16)
- Duhet theksuar se të gjithë pagëzimet e tjera në kulturën hebraike të shekullit të parë ishin të vetë-administruara. Vetëm Gjon Pagëzori bëri thirrje për pagëzim që e përfshinte atë si një vlerësues (shih Mat. 3:7-12) dhe administrator të kësaj vepre pendese (shih Mat. 3:6).

### II. Pagëzimi në kishë

#### A. Qëllime teologjike

1. Falja e mëkatit – Veprat e Apo. 2:38; 22:16
2. Marrja e Frymës së Shenjtë – Veprat e Apo. 2:38 (Veprat e Apo.10:44-48)
3. Bashkësia me Krishtin – Gal. 3:26-27
4. Anëtarësia në kishë – 1 Kor. 12:13
5. Simbol i një kthimi frymëror – 1 Pjet. 3:20-21
6. Simbol i një vdekjeje dhe ringjalljeje frymërore – Rom. 6:1-5

B. Pagëzimi ishte mundësia e kishës së hershme për shpalljen publikisht të besimit të një personi (ose rrëfimin). Ai nuk ishte / nuk është mekanizmi për shpëtim, por mundësia për një pranim verbal të besimit (dmth., ndoshta me fjalët: “Jezusi është Zot”). Mbani mend se kisha e hershme nuk kishte ndërtesa dhe takoheshin në shtëpi ose shpesh në vende të fshehta për shkak të persekutimit.

C. Shumë komentatorë kanë pranuar se 1 Pjetrit është një predikim pagëzimi. Megjithëse kjo është e mundur, nuk është mundësia e vetme. Është e vërtetë që Pjetri shpesh përdor pagëzimin si një vepër thelbësore e besimit (shih Veprat e Apo. 2:38,41;10:47). Megjithatë, ai nuk ishte / nuk është një ndodhi sakramentale, por një ndodhi besimi, që simbolizon vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen ndërsa besimtari identifikohet me përvojën e vetë Krishtit (shih Rom. 6:7-9; Kol. 2:12). Veprimi është simbolik, jo sakramental; veprimi është mundësia e rrëfimit, jo mekanizmi i shpëtimit.

### III. Pagëzimi dhe Pendesa tek Veprat e Apo. 2:38

Curtis Vaughan, *Veprat*, ka një shënim interesant në fund të faqes në fq. 28. lidhur me Veprat e Apo. 2:38.

“Fjala greke për ‘pagëzuar’ është një urdhërore e vetës së tretë; fjala për ‘pendohu,’ urdhërore e vetës së dytë. Ky ndryshim nga urdhri më i drejtpërdrejtë i vetës së dytë në atë më pak të drejtpërdrejtë të vetës së tretë të ‘pagëzuar’ nënkupton se thirrja kryesore e Pjetrit është për pendim.”

Kjo ndjek theksin e predikimit të Gjon Pagëzorit (shih Mat. 3:2) dhe Jezusit (shih Mat. 4:17). Pendimi duket se është një çelës shpirtëror dhe pagëzimi është një shprehje e jashtme e këtij ndryshimi shpirtëror. Në Dhjatën e Re nuk shohim besimtarë të papagëzuar! Për kishën e hershme pagëzimi ishte rrëfimi publik i besimit. Ai është rasti për rrëfim publik të besimit në Krishtin, jo mekanizmi për shpëtim! Duhet mbajtur mend se pagëzimi nuk përmendet në predikimin e dytë të Pjetrit, megjithëse pendimi përmendet (shih Veprat e Apo. 3:19; Luka 24:17). Pagëzimi ishte një shembull që na e la Jezusi (shih Mat. 3:13-18). Pagëzimi u urdhërua nga Jezusi (shih Mat. 28:19). Çështja që shtrohet sot, nëse është i nevojshëm pagëzimi për shpëtim, nuk trajtohet në Dhjatën e Re; të gjithë besimtarët duhet të pagëzohen. Megjithatë, duhet të kemi kujdes edhe ndaj kthimit të sakramenteve në diçka mekanike! Shpëtimi është çështje besimi, jo çështje e vendit të duhur, fjalëve të duhura, ritualit të duhur!

NASB	“jo me dituri fjale”
NKJV	“jo me urtësinë e fjalëve”
NRSV	“jo me urtësi elokuate”
TEV	“pa përdorur gjuhën e urtësisë së njerëzve”
NJB	“jo me anë të urtësisë së gjuhës”
Peshitta	“duke mos u mbajtur tek urtësia e fjalëve”
REB	“pa parë si zgjidhje aftësitë e retorikës”

Termi *sophia* (dmth., zgjuarsia ose urtësi) tek 1 Kor. 1:17-24 përdoret në orientimin e saj njerëzor (dmth., urtësi si e botës, urtësi njerëzore, urtësi e rënë). Elokuenca dhe / ose urtësia njerëzore nuk mund të zënë vendin e lajmit të mirë të Perëndisë në vdekjen zëvendësuese të Krishtit. Fuqia është tek mesazhi, jo tek mesazh-përcjellësi (dmth., as vetë tek Pali, shih 2 Kor. 10:10; 11:6). Një segment i kësaj kishe krenohej në retorikë (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në mes të Sofistëve]). Një grup mësuesish të rremë të orientuar tek hebrenjtë do të vijnë më vonë në Korint dhe do të sulmojnë Palin për mungesën e tij në aftësi folëse retorike tek 2 Korintasve 10-13. Asnjë mish nuk mund të marrë lavdi përpara Perëndisë (shih 1 Kor. 1:29; Efe. 2:9).

■ “që kryqi i Krishtit të mos dalë i kotë” Nëse njerëzit do të mund të shpëtonin veten e tyre përmes veprave ose intelektit, atëherë vdekja e Krishtit nuk do të kishte qenë e nevojshme! Por, ata nuk mundeshin / nuk mundën! Fuqia e kryqit është sigurimi i plotë i Perëndisë përmes Krishtit. Gjithçka që nevojitet të bëhet që të shpëtohet e gjithë bota është përfunduar, plotësuar dhe është gati në jetën, mësimet, vdekjen, ringjalljen, ngjitjen dhe rikthimin e Krishtit, ndaj së cilës njerëzit mund t’i përgjigjen dhe të cilën ata mund ta marrin vetëm me besim.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:18-25

<sup>18</sup> Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbin, por për ne që shpëtohem është fuqia e Perëndisë. <sup>19</sup> Sepse është shkruar: “Do të bëj të humbasë dituria e të diturve, dhe do ta asgjësoj zgjuarësinë e të zgjuarve.” <sup>20</sup> Ku është i dituri? Ku është skribi? Ku është debatuesi i kësaj epoke? A nuk e bëri të marrë Perëndia diturinë e kësaj bote? <sup>21</sup> Sepse, duke qenë se nëpërmjet diturisë së Perëndisë bota nuk e njohu Perëndinë me urtinë e vet, Perëndisë i pëlqeu të shpëtojë ata që besojnë nëpërmjet marrëzisë së predikimit, <sup>22</sup> sepse Judenjtë kërkojnë një shenjë dhe Grekët kërkojnë dituri, <sup>23</sup> por ne predikojmë Krishtin të kryqëzuar, skandal për Judenjtë dhe marrëzi për Grekët, <sup>24</sup> kurse për ata që janë të thirrur, qofshin Judenj ose Grekë, predikojmë Krishtin, fuqia e Perëndisë dhe diturinë e Perëndisë; <sup>25</sup> sepse marrëzia e Perëndisë është më e ditur se njerëzit dhe dobësia e Perëndisë më e fortë se njerëzit.

**1:18 “Sepse fjala e<sup>5</sup> kryqit”** Kjo “fjalë” (dmth., *logos*) lidhet me përmbajtjen e predikimit të Palit (shih 1 Kor. 1:17 and 23). Zakonisht në predikimet e tij Pali thekson si kryqëzimin edhe ringjalljen e Krishtit. Por në këtë kontekst ai fokusohet mbi kryqëzimin (shih Zan. 3:15; Psalm 22; Isaia 53; Zakaria 9-14) dhe rezultatet e tij (shih 1 Kor. 1:30).

**NASB, NKJV, NRSV “marrëzi”**  
**TEV “është e pakuptimtë”**  
**NJB “budallallëk”**

Kjo fjalë greke vjen në anglisht si “moron”. Është një element kyç në përshkrimin e Palit për urtësinë njerëzore të rënë (shih 1 Kor. 1:18,21,23,25), gjithashtu, vini re 2:14; 3:18-19; 4:10. Ungjilli është zbulues (dmth., vetë-zbulues) nga Perëndia, jo zbulim njerëzor!

▣ **“për ata që humbin, por për ne që shpëtohen është fuqia e Perëndisë”** Këto janë dy forma pjesore të tashme. E para është një formë pjesore e tashme e mesme dhe e dyta është një formë pjesore pasive e tashme. Shih Temën e Veçantë: Shpëtimi (Kohë Foljesh Greke) [SPECIAL TOPIC: SALVATION (GREEK VERB TENSES)] tek 1 Kor. 3:15. Ka vetëm dy lloje njerëzish: ata që po humbasin dhe ata që po shpëtohen (shih 2 Kor. 2:15; 4:3). Termi “humbasin” nuk do të thotë asgjësim fizik, por humbje të përhershme të marrëdhënies me Perëndinë, gjë për të cilën ata u krijuan. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:28. Interpretuesit modern kanë marrë eufemizmat hebraike dhe i kanë kthyer ato në kuptim të drejtëpërdrejtë. Dy shembuj janë:

1. “gjumë” = vdekje, jo pavetëdijshmëri deri në ringjallje
2. “humbje” = humbje frymore, jo asgjësim

Disa thonë se asgjesimi (dmth., përfundimi i jetës) është më njerëzor se sa ferri i përhershëm (shih Fudge, *The Fire That consumes* [Zjarri që konsumon]). Problemi ngrihet kur e njëjta fjalë e përdorur për të përshkruar ferrin, përdoret për qiellin (dmth., “i përjetshëm”, shih Mate. 25:46) dhe për të përmendur një ringjallje të dyfishtë si tek Dan. 12:2; Gjoni 5:28-29; dhe Veprat e Apo. 24:15. Megjithatë, nuk është Perëndia që i dërgon njerëzit në ferr, por vetë refuzimi i tyre i (1) dritës që ata kanë (dmth., Ps. 19:1-6; Romakëve 1-2) ose (2) ungjilli (dmth., mëkati i pafalshëm dhe mëkati për në vdekje janë mëkati i mosbesimit). Mosbesimi në këtë jetë ndikon në përjetësi.

Dhjata e Re e përshkruan shpëtimin si

1. Një veprim vendimtar i së shkuarës (dmth., koha aoriste, Veprat e Apo. 15:11; Rom. 8:24; 2 Tim. 1:9; Titi 3:5)
2. Një proces që vazhdon përgjatë jetës (dmth., koha e tashme 1 Kor. 1:18; 15:2; 2 Kor. 2:15)
3. Një ndodhi në të shkuarën e cila bëhet një gjendje e qenies (dmth., koha e përkryer, Efe. 2:5,8)
4. Një konsumim i ardhshëm (dmth., koha e ardhme, Rom. 5:9,10; 10:9; 13:11; 1 Kor. 3:15; Fil. 1:28; 1 Thes. 5:8-9; Heb. 1:14; 9:28)

Rreziku teologjik është të izolosh këdo nga këto si esenca e shpëtimit. Ne gjithmonë duhet të jemi të vëmendshëm përkundrejt një besimi të thjeshtë i cili thekson vetëm veprimin fillestar ose perfeksionizmin i cili thekson vetëm produktin. Shpëtimi është një përgjigje fillestare dhe e vullnetshme ndaj ofertës falas të Perëndisë në Krishtin e cila rezulton në një jetesë të përditshme si e Krishtit. Nuk është vetëm një person për t’u mirëpritur, por gjithashtu një mesazh rreth personit që do të merret, dhe një jetë në krahasim me personin që do të jetohet. Nuk është një produkt, një policë sigurimi, një biletë për në qiell, por një marrëdhënie e përditshme që rritet me Jezusin. Dhjata e Re nuk thekson marrjen e një vendimi, por të qenit një dishepull (shih Mate. 28:19-20).

Misteri i vërtetë është se kur ungjilli prezantohet, disa thonë “po” dhe shpëtohen, por disa thonë “jo” dhe rebelimi i tyre ripohet (shih Luka 2:34; Gjoni 9:39; 1 Pjet. 2:7). Nuk më surprizon që njerëzit thonë po, por mahnitem me

1. Dëshirën e Perëndisë që të gjithë të shpëtohen
2. Veprën e përfunduar të Krishtit
3. Këmbënguljen e Frymës
4. Fajin e ndjerë të njerëzimit
5. Mungesën e qëllimit në jetën pa Perëndinë që njerëzit të thonë “Jo”! Ky është misteri i të zgjedhurit (shih 2 Kor. 3:14; 4:4; 11:3).

<sup>5</sup> Versioni në shqip është: “Sepse mesazhi i kryqit” (shënim i përkthyesit).

■ **“fuqia e Perëndisë”** Ungjilli është fuqia e Perëndisë (shih 1 Kor. 1:24; Rom. 1:16). Ungjilli zbulon dhe kanalizon fuqinë e Perëndisë. Ai prodhon besim. Ai prodhon pendesë. Ai prodhon urtësi, drejtësi, shenjtëri dhe shpengim (shih 1 Kor. 1:30). Predikimi i kryqit e bën gjithë këtë. Është fuqia e Perëndisë që gjendet pas fjalës së shkruar (dmth., Bibla), fjalës së gjallë (dmth., Krishti), fjalës së predikuar (dmth., ungjilli) dhe fjalës së themeluar (dmth., ngjashmëria me Krishtin / mbretëria e Perëndisë).

**1:19** Ky është një citim i Isa. 29:14. Është një shembull i paralelizmit sinonim të Dhjatës së Vjetër. Theksi është mbi marrëzinë e urtësisë njerëzore pa Perëndinë (shih Isa. 29:13; Pred. 1:12-18; 12:12).

■ **“shkatërrojë”**<sup>6</sup> Kjo është pjesë e një citimi nga Dhjata e Vjetër (dmth., Isa. 29:14). Shih Temën e Veçantë: Apollumi (Special Topic: *Apollumi*) tek 1 Kor. 8:11.

**1:20** Kjo është një listë e racionalistëve njerëzorë (dmth., hebrenj dhe johebrenj). Ai mund të jetë një aludim ndaj Isa. 33:18 tek LXX (*Jerome Biblical Commentary* [Komentarët Biblik të Xheromë], fq. 257). Njerëzit nuk mund të zbulojnë ungjillin. Ai është misteri i Perëndisë i fshehur në epoka (shih Efe. 2:11-3:13). Plani dhe sigurimi i Perëndisë duken marrëzi për shkak se ata zhvleftësojnë meritën dhe urtësinë njerëzore.

■ **“i kësaj epoke... e kësaj bote”** Këto dy fraza reflektojnë një koncept të ngjashëm në faktin që kjo periudhë kohe është e rënë. Kjo nuk është bota që Perëndia kishte për qëllim, por ungjilli do ta transformojë këtë epokë të rënë në krijimin që kishte për qëllim Perëndia (dmth., Zanafilla 1-2 dhe Zbulesa 21-22). Termi “botë” përdoret në dy kuptime në Dhjatën e Re: (1) planeti fizik (shih Gjoni 3:16) dhe (2) shoqëria njerëzore e rënë e organizuar dhe që funksionon e ndarë nga Perëndia (shih Jakobi 1:27; 4:4; 1 Gjonit 2:15-17). Në shkrimet e Palit termi hebraik *‘olam*, përkthehet në greqisht si *aiōn*, dhe ka marrë kuptimin e sinonimit me *kosmos* (shih 1 Kor. 1:20; 2:6; 3:19; Efe. 2:2). Për termin *kosmos* shih Temën e Veçantë: Përdorimi i Palit i Kosmos (bota) [Special Topic: Paul's Use of *Kosmos* (world)] tek 1 Kor. 3:21b-22.

#### **TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA QË DO TË VIJË (SPECIAL TOPIC: THIS AGE AND THE AGE TO COME)**

Profetët e Dhjatës së Vjetër e shihnin të ardhmen si zgjatim të së tashmes. Për ta, e ardhmja do të shënojë rimëkëmbjen e Izraelit gjeografik. Sidoqoftë, edhe ata e shihnin si ditë të re (shih Isa. 65:17; 66:22). Me refuzimin e vazhdueshëm kokëfortë të YHWH-së nga pasardhësit e Abrahamit (edhe pas robërisë), në letërsinë apokaliptike në periudhën midis dy Dhjatave të judenjve u zhvillua një paradigmë e re (p.sh., 1 Enoku, 4 Esdra, 2 Baruku). Këto shkrime filluan të bënin dallimin mes dy epokave: epoka e ligë e tanishme, e dominuar nga Satani, dhe epoka e ardhshme e drejtësisë, e dominuar nga Fryma dhe e inauguruar nga Mesia (shpesh, si luftëtar dinamik).

Në këtë zonë të teologjisë (eskatologjia) ekziston një zhvillim i dukshëm. Teologët e quajnë këtë “zbulesë e shkallëzuar”. Dhjata e Re e pohon këtë realitet të ri kozmik të dy epokave (pra, një dualizëm kohor).

<sup>6</sup> Versioni në shqip është “humbasë” (shënim i përkthyesit).

**Jezusi**

Mateu 12:32; 13:22, 39  
 Marku 10:30  
 Luka 16:8; 18:30; 20:34-35

**Pali**

Romakëve 12:2  
 1 Kor. 1:20; 2:6, 8; 3:18  
 2 Kor. 4:4  
 Galatasve 1:4  
 Efe. 1:21; 2:2,7; 6:12  
 1 Timoteut 6:17  
 2 Timoteu 4:10  
 Titit 2:12

**Hebrenjve (Pali)**

Heb.1:2; 6:5; 11:3

Në teologjinë e Dhjatës së Re, këto dy epoka judaike janë mbivendosur për shkak të parashikimeve të papritura dhe të anashkaluara për dy ardhjet e Mesisë. Mishërimi i Jezusit përmbushi profecitë e Dhjatës së Vjetër për inaugurimin e epokës së re (Dan. 2:44-45). Mirëpo Dhjata e Vjetër parapa edhe ardhjen e Tij si Gjykatës dhe Fitimtar, por herën e parë Ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53; Zak. 12:10), i përulur dhe i butë (shih Zakaria 9:9). Ai do të kthehet me fuqi, pikërisht siç e paratha dhe Dhjata e Vjetër (shih Zbulesa 19). Kjo përmbushje me dy faza bëri që Mbretëria të jetë e tashme (e inauguruar), por edhe e ardhshme (e papërmbushur plotësisht). Ky është tensioni i Dhjatës së Re: tashmë, por ende jo!

■ **“A nuk e bëri të marrë Perëndia diturinë e kësaj bote”** Gramatika tregon se Pali pret një përgjigje “po”.

**1:21 “Sepse, duke qenë se nëpërmjet diturisë së Perëndisë”** Ky mund të jetë një aludim ndaj Pro. 8:22-31, sikurse është Gjoni 1:1-5,9-14. Ai gjithashtu i referohet planit të Perëndisë për të shpenguar njerëzimin e rënë. Shpengimi ishte i planifikuar në zemrën e Perëndisë përpara krijimit (shih Mat. 25:34; Veprat e Apo. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Efe. 1:4; 1 Pjet. 1:19-20; Zbu. 13:8). Ky plan përfshinte:

1. Paranjohjen e rënies së njerëzimit
2. Paaftësinë e njerëzimit për të performuar vullnetin e Perëndisë (shih Ligji i Përt. 31:27-29; Joz. 24:19; Gal. 3)
3. Sigurimin e Perëndisë në Krishtin (dmth., besëlidhja e re, shih Jer. 31:31-34)
4. Ftesa ndaj hebrenjve dhe johebrejve me anë të besimit në Krishtin (shih 1 Kor. 1:21; Efe. 2:11-3:13)

**TEMË E VEÇANTË: PLANI I PËRJETSHËM SHPENGUES I YHWH (SPECIAL TOPIC: YHWH'S ETERNAL REDEMPTIVE PLAN)**

Të dashur lexues, duhet t’ju rrëfej se jam i anshëm në këtë pikë. Teologjia ime sistematike nuk është kalvinizmi ose dispensacionalizmi, por besimi ungjillor i Urdhërimit të Madh (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat e Apo. 1:8). Unë besoj se Perëndia ka një plan të përjetshëm për shpengimin e gjithë njerëzimit (p.sh., Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5-6; Jer. 31:31-34; Ezekieli 18; 36:22-39; Veprat e Apo. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29; Rom. 3:9-18, 19-20, 21-31), për gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin dhe ngjashmërinë e Tij (shih Zan. 1:26-27). Besëlidhjet janë bashkuar në Krishtin (shih Gal. 3:28-29; Kol. 3:11). Jezusi është misteri i Perëndisë, dikur i fshehur por tani i zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13)! Çelësi për të kuptuar Biblën nuk është Izraeli, por ungjilli i Dhjatës së Re.

Këto koncepte paraprake ma përcaktojnë gjithë interpretimin që i bëj Shkrimit. I lexoj të gjitha pasazhet përmes këtyre koncepteve! Padyshim që kjo quhet anësi (të gjithë interpretuesit e kanë një të tillë!), por ama është anësi e informuar nga Bibla.

Fokusi i Zanafillës 1-2 është krijimi nga YHWH i një vendi ku Ai dhe krijesa e Tij më e lartë, njerëzimi, mund të kenë miqësi me njëri-tjetrin (shih Zan. 1:26, 27; 3:8). Krijimi fizik është skena ku zhvillohet ky plan hyjnor ndërpersonal.

1. Shën Augustini e karakterizonte si një boshllëk me formë hyjnore brenda çdo njeriu; ky boshllëk mund

të mbushet vetëm nga Perëndia.

2. C. S. Ljuis e quante këtë planet “planeti i prekur”, (pra, i përgatitur nga Perëndia për njerëzit).

Dhjata e Vjetër përmban shumë shenja të këtij plani hyjnor.

1. Zanafilla 3:15 është premtimi i parë se YHWH nuk do ta braktisë njerëzimin në lëmshin e tmerrshëm të mëkatit dhe kryengritjes. Këtu nuk bëhet fjalë për Izraelin, pasi në atë kohë s’kishte Izrael, as popull të besëlidhjes; kjo ndodhi vetëm pas thirrjes së Abrahamit në Zanafilla 12.
2. Zanafilla 12:1-3 përbën thirrjen e parë të Abrahamit nga YHWH, ku atij iu zbulua se do të bëhet populli i besëlidhjes, Izraeli. Por edhe në këtë thirrje të parë, Perëndia e kishte vështrimin te gjithë bota. Vini re Zan. 12:3!
3. Në Eksodi 20 (Ligji i Përtërirë 5), YHWH ia dha ligjin e vet Moisiut për ta udhëhequr popullin e Tij të veçantë. Vini re se, në Eks. 19:5-6, YHWH i zbulon Moisiut marrëdhënien unike që do të ketë Izraeli. Por vini re, gjithashtu, se ashtu si Abrahami, edhe Izraeli u zgjodh për të bekuar botën (shih Eks. 19:5, “sepse gjithë toka është e Ëmja”). Izraeli duhet të shërbente si mekanizëm me anë të së cilit kombet do të njihnin YHWH-në dhe do të tërhiqeshin tek Ai. Izraeli dështoi në mënyrë tragjike (shih Ezek. 36:22-38).
4. Në 1 Mbretërve 8, Solomoni e përkushton tempullin që të gjithë të vijnë te YHWH (shih 1 Mb. 8:43, 60).
5. Në Psalmet – 22:27-28; 66:4; 86:9 (Zbu. 15:4)
6. Njëpërmjet profetëve, YHWH vazhdoi të zbulonte planet e Tij shpenguese për gjithë botën.
  - a. Isaia – 2:2-4; 12:4-5; 25:6-9; 42:6,10-12; 45:22; 49:5-6; 51:4-5; 56:6-8; 60:1-3; 66:18,23
  - b. Jeremia – 3:17; 4:2; 16:19
  - c. Mikea 4:1-3
  - d. Malakia 1:11

Ky theksim i përbotshëm bëhet i mundshëm nga shfaqja e “besëlidhjes së re” (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38), që përqendrohet në mëshirën e YHWH, jo në përpjekjet e njerëzve të rënë. Ajo do të sjellë “një zemër të re”, “një mendje të re” dhe “një shpirt të ri”. Bindja është thelbësore, por është diçka e brendshme, jo thjesht një kod i jashtëm (shih Rom. 3:21-31).

Dhjata e Re e thekson qartë planin e përbotshëm shpengues në disa mënyra.

1. Urdhërimi i Madh – Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat e Apo. 1:8
2. Plani i përfundimtar (pra, i paracaktuar) i Perëndisë – Luka 22:22; Veprat e Apo. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29
3. Perëndia dëshiron që gjithë njerëzit të shpëtohen; Gjoni 3:16; 4:42; Veprat e Apo. 10:34-35; 1 Tim. 2:4-6; Titit 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14
4. Krishti bashkon Dhjatën e Vjetër me Dhjatën e Re – Gal. 3:28-29; Efe. 2:11-3:13; Kol. 3:11. Të gjitha pengesat dhe dallimet njerëzore hiqen në Krishtin. Jezusi është “misteri i Perëndisë”, i fshehur por tani i zbuluar (shih Efe. 2:11-3:13).

Dhjata e Re përqendrohet në Jezusin, jo në Izraelin. Rol qëndror luan ungjilli, jo kombësia apo zona gjeografike. Izraeli është zbulesa e parë, por Jezusi është zbulesa përfundimtare (shih Mat. 5:17-48).

Shpresoj që do të merrni pak kohë për të lexuar Temën e Veçantë: Pse duken premtimet e besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër kaq të ndryshme nga premtimet e besëlidhjes së Dhjatës së Re? / Special Topic: Why Do OT Covenant Promises Seem So Different from NT Covenant Promises. Këtë mund ta gjeni falas në internet në [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org).

■ **“nuk e njohu Perëndinë”** Grekët nuk besuan se Perëndia ishte i njohshëm. Perënditë e tyre kishin dobësi njerëzore dhe ishin të papërfshirë në këtë botë. Njerëzimi i rënë nuk mundet ta zbulojë Perëndinë, por Perëndia ka zgjedhur ta zbulojë Vetën e Tij përmes Krishtit (dmth., Fjalës së Gjallë) dhe përmes Biblës (dmth., Fjalës së shkruar), sikurse përmes njerëzimit të shpenguar (dmth., fjalës së themeluar)!

■ **“Perëndisë i pëlqeu...nëpërmjet marrëzisë së predikimit”** Nuk është prezantimi, por përmbajtja e ungjillit që është marrëzi për botën e rënë (shih 1 Kor. 2:14).

■ **“të shpëtojë ata që besojnë”** Kjo është një formë aktive aoriste paskajore e ndjekur nga një formë pjesore aktive e tashme. Ky është thelbi i proklamitës së ungjillit! Termi “shpëtojë” u përdor në Dhjatën e Vjetër për çlirim fizik, por në Dhjatën e Re ai u përdor për faljen dhe pranimin shpirtëror. Pranimi ynë nga Perëndia përmes Krishtit është një fakt i përmbushur, por në anën tonë është një marrëdhënie e vazhdueshme besëlidhjeje. Të gjitha marrëdhëniet midis Perëndisë dhe njerëzve janë mbi bazë besëlidhjeje. Perëndia gjithnjë fillon besëlidhjen dhe vendos kushtet e saj, por Ai ka zgjedhur që ne duhet të përgjigjemi personalisht dhe të vazhdojmë të përgjigjemi. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:15.

### **TEMË E VEÇANTË: QËNDRUESHMËRI (SPECIAL TOPIC: PERSEVERE)**

Doktrinat biblike që lidhen me jetën e krishterë janë të vështira të shpjegohen, pasi paraqiten në dyshe dialektike, që janë tipike për botën lindore (shih Temën e Veçantë: Letërsia Lindore [paradokse biblike] / Special Topic: Eastern Literature [biblical paradoxes]). Këto dyshe duken kontradiktore, por janë të dyja biblike. Të krishterët perëndimorë janë prirur që të zgjedhin njërën të vërtetë dhe të anashkalojnë ose zhvlerësojnë të vërtetën e kundërt. Më lejoni t’ju jap disa shembuj.

- A. A është besimi një vendim fillestar për të besuar në Krishtin, apo një përkushtim dishepullizimi gjithë jetën?
- B. A është shpëtimi një zgjedhje që bën Perëndia sovran me anë të hirit, apo është një përgjigje e njerëzimit me besim dhe me pendim ndaj ofertës hyjnore?
- C. Pasi merret shpëtimi, a është i pamundur të humbet, apo ekziston nevoja për zell të vazhdueshëm? Çështja e qëndresës ka qenë polemike gjatë gjithë historisë së kishës. Problemi fillon me

disa pasazhe në Dhjatën e Re që duket sikur janë në kundërshti me njëra-tjetrën:

- A. pasazhet për sigurinë e shpëtimit
  1. thëniet e Jezusit (Gjoni 6:37; 10:28-29)
  2. thëniet e Palit (Rom. 8:35-39; Efe. 1:13; 2:5,8-9; Fil. 1:6; 2:13; 2 Thes. 3:3; 2 Tim. 1:12; 4:18)
  3. thëniet e Pjetrit (1 Pjet. 1:4-5)
- B. pasazhet për nevojën për qëndresë
  1. thëniet e Jezusit (Mat. 10:22; 13:1-9,24-30; 24:13; Marku 13:13; Gjoni 8:31; 15:4-10; Zbu. 2:7,17,26; 3:5,12,21)
  2. thëniet e Palit (Rom. 11:22; 1 Kor. 15:2; 2 Kor. 13:5; Gal. 1:6; 3:4; 5:4; 6:9; Fil. 2:12; 3:18-20; Kol. 1:23; 2 Tim. 3:2)
  3. thëniet e autorit të Hebrenjve (2:1; 3:6, 14; 4:14; 6:11)
  4. thëniet e Gjonit (1 Gjonit 2:6; 2 Gjonit 9)
  5. thëniet e Atit (Zbu. 21:7)

Shpëtimi biblik rrjedh nga dashuria, mëshira dhe hiri i Perëndisë Triun dhe sovran. Asnjë njeri nuk mund të shpëtohet pa nismën e Frymës (shih Gjoni 6:44, 65). Perëndia vjen në fillim dhe përcakton rendin, por kërkon që njerëzit të përgjigjen me besim dhe pendim, si në fillim, ashtu dhe në vazhdim. Perëndia punon me njerëzimin në një marrëdhënie besëlidhjeje. Ka edhe privilegje, edhe përgjegjësi!

Shpëtimi iu ofrohet gjithë njerëzve. Vdekja e Jezusit i dha fund problemit të mëkatit në krijimin e rënë. Perëndia ka siguruar një rrugë dhe kërkon që gjithë ata që janë krijuar në shëmbëllimin e tij t’i përgjigjen dashurisë dhe asaj që na ka siguruar Ai në Jezusin.

Nëse dëshiron të lexosh më tepër për këtë temë nga një pikëvështrim jokalvinist, shih

1. Dale Moody, *The Word of Truth [Fjala e së vërtetës]*, Eerdmans, 1981 (f. 348-365)
2. Howard Marshall, *Kept by the Power of God [I ruajtur me anë të Fuqisë së Perëndisë]*, Bethany Fellowship, 1969
3. Robert Shank, *Life in the Son [Jeta në Birin]*, Westcott, 1961

Bibla trajton dy probleme të ndryshme në këtë pikë: (1) të mos e marrim sigurinë e shpëtimit si leje për të bërë jetë të pafrytshme dhe egoiste; dhe (2) të inkurajojë ata që kanë vështirësi në shërbesë apo me mëkatën personal. Problemi është se grupet e gabuara po marrin mesazhin e gabuar dhe po ndërtojnë sisteme teologjike mbi pasazhe të kufizuara biblike. Disa të krishterë kanë nevojë të dëshpëruar për mesazhin e sigurisë së shpëtimit, ndërsa disa të tjerë kanë nevojë për paralajmërime të rrepta! Në cilin grup bën pjesë ti?

**1:22 “Judenjtë kërkojnë një shenjë”** Kjo reflekton njohurinë e Palit mbi jetën e Krishtit (shih Mat. 12:38; 16:1,4; Mark 8:11-12; Gjoni 4:48; 6:30).

■ **“Grekët kërkojnë dituri”** “Grekët” (*Hellēnes*) i referohet të gjithë popujve johebrenj. Kjo është qartasi e parë në përdorimin e saj tek Veprat e Apo. 18:16-21,32; Rom. 1:13.

**1:23** Ky varg duhet të nisë me fjalën kundërshtuese “por”. Përgjigja e Palit ndaj dëshirës si për “shenja” dhe “urtësi” ishte ungjilli.

■ **“të kryqëzuar”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer. Kryqëzimi i Jezusit, jo llogjika apo mrekullitë, janë në zemër të ungjillit të Palit. Koha e përkryer pranon se Jezusi vazhdon të jetë “i kryqëzuar”. Kur ne të shohim Jezusin në qiell, Ai do të ketë mbajtur shenjat e kryqëzimit të Tij (shih Gjoni 20:25) sepse ata janë bërë distiktivat e Tij të nderit dhe lavdisë. Jezusi është e vetmja pjesë e Trinitetit që ka dhe një trup fizik. Është sigurisht e pamundur që kjo kohë e përkryer të jetë një e përkryer konsumative e cila fokusohet në përmbushjen e një ndodhie apo vepre, duke nënkuptuar rezultatin (shih Daner dhe Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament* [Një Manual i Gramatikës së Greqishtes së Dhjatës së Re], fq. 202-203). Jezusi i kryqëzuar vulosi shpëtimin tonë. Ai ishte përmbushja e Zan. 3:15; Psalm 22; Isaia 53; dhe Zak. 12:10. Një Mesia që vuan ishte një shok teologjik ndaj hebrenjve!

Vini re titujt mesianik të përdorur nga shpallësit dhe rrëfyesit e parë.

1. Jezusi është Krishti (Mesia) – Veprat e Apo. 5:42; 9:22; 17:3; 18:5,28; 1 Kor. 1:23
2. Jezusi është Biri i Perëndisë – Veprat e Apo. 9:20; Rom. 1:3-4
3. Jezusi është Zot (duke reflektuar Zotin, YHWH) – Veprat e Apo. 2:36; 10:36; 11:20; Rom. 10:9; 2 Kor. 4:5; Kol. 2:6

Këto janë përmbledhje teologjike të përdorura për të pranuar pranimin kristologjik (shih James D. G. Dunn, *Unity and Diversity in the NT* [Uniteti dhe Diversiteti në Dhjatën e Re], fq. 34-63).

<b>NASB, NKJV, NRSV</b>	<b>“një gur pengesë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“një ofendim”</b>
<b>NJB</b>	<b>“një pengesë”</b>

Ky term grek (dmth., *skandalon*) përdorej për mekanizmin e tërheqjes mbi një kurth kafshe (shih Gal. 5:11). Hebrenjtë refuzuan Krishtin për shkak të kryqëzimit (shih Ligji i Përt. 21:23). Ata po prisnin një Mesia që të ishte një drejtues ushtarak pushtues (dhe Ai do të jetë kur të rikthehet!). Hebrenjtë nuk e dalluan një Mesia që vuan (shih Zan. 3:15; Psalm 22; Isa. 52:13-53:12) dhe që do të vijë në dy faza (dmth., i mishëruar dhe rikthimi i lavdishëm).

**TEMË E VEÇANTË: MESIA (NGA DAN. 9:26) [SPECIAL TOPIC: MESSIAH (FROM DAN. 9:26)]**

Vështirësia në interpretimin e këtij vargu vjen për shkak të kuptimeve të mundshme që shoqërohen me termin “Mesia”, ose “i vajosuri” (BDB 603, KB 645). Termi u përdor për hedhjen e një vaji të veçantë mbi një person për të përcaktuar thirrjen e Perëndisë dhe pajisjen për një detyrë të caktuar drejtimi.

1. Përdorej për mbretërit judenj (p.sh., 1 Sam. 2:10; 12:3; 24:6,10; 2 Sam. 19:21; 23:1; Ps.



- 89:51; 132:10,17; Vajt. 4:20; Hab. 3:13; “Princi i Vajosur” tek Dan. 9:25)
2. Përdorej për priftërinjtë judenj (dmth., “priftërinjtë e vajosur”, Eksod 29:7; p.sh., Lev. 4:3,5,16; 6:15; 7:36; 8:12; ndoshta Ps. 84:9-10; dhe 133:2)
  3. Përdorej për patriarkët dhe profetët (shih Zan. 26:7; 1 Kro. 16:22; Ps. 105:15, i cili i referohet popullit të përbashkët të besëlidhjes; ndoshta Hab. 3:13)
  4. Përdorej për profetët (shih 1 Mbret. 19:16; ndoshta 1 Kro. 29:22)
  5. Përdorej për Kirin (shih Isa. 45:1)
  6. Pikat 1 dhe 2 kombinohen me njëri-tjetrin në Psalmi 110 dhe Zakaria 4
  7. Përdorej për Mbretin e ardhshëm e të veçantë Davidik të Perëndisë, i cili do të sillte epokën e re të drejtësisë
    - a. Pasardhja e Judës (shih Zan. 49:10)
    - b. Familja e Jeseut (shih 2 Samuelit 7)
    - c. Mbretërim universal (shih Psalmi 2; Isa. 9:6; 11:1-5; Mik. 5:1-4 e më tej)
    - d. Shërbesa ndaj njerëzve në nevojë (shih Isa. 61:1-3)

Personalisht, mua më tërheq identifikimi i “të vajosurit” me Jezusin e Nazaretit (shih Gjoni 1:41; 4:25) për këto arsye:

1. Prezantimi i një Mbretërie të përjetshme në kapitullin 2 të Danielit gjatë perandorisë së katërt
2. Prezantimi i “një biri njeriu” tek Dan. 7:13, të cilit i jepet një mbretëri e përjetshme
3. Fjalitë shpënguese të Dan. 9:24, të cilat dëftojnë drejt pikës kulmore të historisë së botës së rënë
4. Përdorimi që i bën Jezusi librit të Danielit në Dhjatën e Re (shih Mat. 24:15; Marku 13:14)

Duhet pranuar se ky është një titull i rrallë në Dhjatën e Vjetër, ndoshta vetëm tek Dan. 9:25. Duhet pranuar se Jezusi nuk i përputhet përshkrimet të përgjithshëm të Dhjatës së Vjetër për Mesian.

1. Jo drejtues në Izrael
2. Jo i vajosur zyrtarisht nga një prift
3. Jo thjesht shpëtimtar i Izraelit
4. Jo vetëm “bir i njeriut”, por çuditërisht “Biri i Perëndisë”

**NASB, NJB  
NKJV  
NRSV  
TEV**

**“dhe për johebrenjtë marrëzi”  
“ndaj grekëve marrëzi”  
“marrëzi ndaj johebrenjve”  
“budallalëk ndaj johebrenjve”**

Hebrenjtë refuzuan Krishtin për shkak se koncepti i ringjalljes (dmth., për shkak se për ta trupi fizik ishte origjina e së keqes) nuk i përputhej idealeve të tyre filozofike të paramenduara. Kjo fjalë e Palit gjithashtu tregon se shpengimtarit i tyre i supozuar “i cili do të vdiste dhe do të ringjallej” i kulteve të pjellorisë dhe feve të misterit nuk ishte një parim grek i menduar dhe sigurisht nuk ishte burimi i pikëpamjes së Palit për Jezusin.

Bëni kujdes që të mos gjykoni ungjillin me kulturën tuaj apo kategoritë kombëtare! NKJV, duke ndjekur Textus Receptus, ka fjalën “grekët”, e cila ndjek dorëshkrimet greke uncialle C<sup>3</sup> dhe D<sup>c</sup>. Të gjitha dorëshkrimet e tjera greke kanë fjalën “johebrenjtë” (*ethnesiu*). Termi “grekët” nuk shfaqet në 1 Kor. 1:22 dhe 24. Ndoshta skribët antikë e ndryshuan 1 Kor. 1:23 për t’i bërë të gjitha të jenë në përputhje.

Për fjalën “marrëzi” shihni shënimin tek 1 Kor. 1:25.

**1:24 “kurse për ata që janë të thirrur”** Hyrja tek 1 Korintasve thekson thirrjen e Perëndisë (dmth., të zgjedhurit) dhe hirin e Perëndisë si i vetmi themel për shpëtimin e kishës së Korintit (shih 1 Kor. 1:2,9,26,27; Efe. 1-2). Ne mësojmë nga Gjoni 6:44,65 që asnjë nuk vjen te Perëndia përveçse nëse Fryma e tërheq atë. Thirrja e Perëndisë nuk e eliminon apo minimizon nevojën për përgjigje njerëzore, si në fillim ashtu edhe në vazhdimësi.

## **TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK (SPECIAL TOPIC: ELECTION/PREDESTINATION AND THE NEED FOR A THEOLOGICAL BALANCE)**

Zgjedhja është doktrinë e mahnitshme. Megjithatë, ajo nuk përbën thirrje për parapëlqime, por thirrje për të qenë kanal, instrument ose mjet për shpengimin e të tjerëve! Në Dhjatën e Vjetër, kjo fjalë përdorej pikësisht për shërbesë; në Dhjatën e Re, përdoret kryesisht për shpëtimin, i cili rezulton në shërbesë. Bibla nuk e pajton kurrë kontradiktën në dukje midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor, por i pohon të dyja! Një shembull i mirë i tensionit biblik është Romakëve 9, që flet për zgjedhjen sovraane të Perëndisë, dhe Romakëve 10, që flet për përgjigjen e domosdoshme nga ana e njerëzimit (shih Rom. 10:11, 13).

Çelësi për të kuptuar këtë tension teologjik mund të jetë Efe. 1:4. Jezusi është njeriu i zgjedhur i Perëndisë dhe të gjithë janë mundësisht të zgjedhur në Të (Karl Barth). Jezusi është “po”-ja e Perëndisë për nevojën e njerëzimit të rënë (Karl Barth). Po kështu, Efesianëve 1:4 na ndihmon në sqarimin e kësaj çështjeje kur pohon se synimi i paracaktimit nuk është qielli, por shenjtëria (ngjashmëria me Krishtin). Shpesh, ne joshemi nga dobitë e ungjillit dhe ia anashkalojmë përgjegjësitë! Thirrja (zgjedhja) e Perëndisë është, jo vetëm për përjetësinë, por edhe për kohën!

Doktrinat vijnë në marrëdhënie me të vërteta të tjera, jo si të vërteta të vetme dhe të shkëputura. Një analogji e mirë do të ishte yjësia përkundrejt një ylli të vetëm. Perëndia e paraqet të vërtetën me gjini letrare lindore, jo perëndimore. Nuk duhet ta largojmë tensionin që shkaktohet nga dyshet dialektike (paradoksale) të së vërtetave doktrinale:

1. Paracaktimi kundrejt vullnetit të lirë njerëzor
2. Siguria e besimtarëve përkundrejt nevojës për qëndrueshmëri
3. Mëkati fillestar përkundër mëkatit të vullnetshëm
4. Mungesa e mëkatit (“përsosmëria”) kundrejt mëkatimit më pak
5. Shfajësimi dhe shenjtërimi i atypëratyshëm fillestar dhe shenjtërimi i përshkallëzuar
6. Liria e krishterë përkundrejt përgjegjësisë së krishterë
7. Transhendenca e Perëndisë kundrejt imanencës së Perëndisë
8. Perëndia si i panjohshëm në mënyrë absolute përkundrejt Perëndisë si i njohshëm në Shkrimet
9. Mbretëria e Perëndisë si e tashme përkundrejt përmbushjes së ardhshme
10. Pendimi si dhuratë e Perëndisë kundrejt pendimit si reagim i domosdoshëm njerëzor ndaj besëlidhjes
11. Jezusi si hyjnor kundrejt Jezusit si njerëzor
12. Jezusi është i barabartë me Atin kundrejt Jezusit si i nënshtruar ndaj Atit

Koncepti teologjik i “besëlidhjes” bashkon sovranitetin e Perëndisë (i cili është gjithmonë Ai që merr nismën dhe përcakton rendin e gjërave) me reagimin e detyrueshëm fillestar dhe të vazhdueshëm me besim dhe pendim nga ana e njerëzimit (shih Marku 1:15; Veprat e Apo. 3:16, 19; 20:21). Ruhu që të mos e përdorësh vargje “provë” për njërën anë të këtij paradoksi duke zhvlerësuar anën tjetër të tij! Ki kujdes që të mos pohosh vetëm doktrinën, ose sistemin tënd të parapëlqyer teologjik!

■ **“qofshin Judenj ose Grekë”** Kjo tregon se qëllimi i ungjillit është që të bashkojë të gjithë njerëzit në Krishtin. Ky është misteri i Perëndisë i fshehur nga epokat, por tani është i zbuluar qartazi (shih Efe. 2:11-3:13).

■ **“Krishtin, fuqia e Perëndisë dhe diturinë e Perëndisë”** Frazja e parë mund të lidhet me ringjalljen e Krishtit për shkak të përdorimit të “fuqisë së Perëndisë” tek Rom. 1:4. Frazja e dytë lidh në mënyrë të veçantë problemin e kishës së Korintit me theksin që ata vinin mbi njohurinë. Megjithatë, ajo sigurisht mund të jetë një referencë ndaj Pro. 8:22-31 (dmth., urtësia e personifikuar e krijimit, shih 1 Kor. 8:6; Kol. 1:15-17; Heb. 1:2).

**1:25 “marrëzia e Perëndisë është më e ditur se njerëzit”** Kjo është një temë e Dhjatës së Vjetër (shih Isa. 55:8-9). Ajo përsëritet tek 1 Kor. 1:18,21,23. Ky është termi *mōros*. Ky term dhe forma të tjera të tij përdoren shpesh nga Pali tek letrat e tij drejtuar kishës së Korintit. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:36.

1. *mōros* (i marrë), 1 Kor. 1:25,27; 3:18; 4:10
2. *mōria* (marrëzi), 1 Kor. 1:18,21,23; 2:14; 3:19
3. *mopainō* (i bërë i marrë), 1 Kor. 1:20

▣ **“dobësia e Perëndisë më e fortë se njerëzit”** Kjo në thelb pranon madhësinë e pakrahasueshme të Perëndisë. Ai madje madhësohet përmes dobësisë njerëzore (shih 1 Kor. 12:5,7-10). Ai mund t’i referohet dështimit “në dukje” të vdekjes së Jezusit nga një pikëpamje tërësisht njerëzore (shih 2 Kor. 13:4), megjithatë në të vërtetë ajo ishte një fitore me pasoja të përjetshme!

Ungjilli, fitorja, është e gjitha e Perëndisë dhe jo e njerëzimit. Shih Temë e Veçantë: Dobësi (Special Topic: Weakness) tek 2 Kor. 12:9.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 1:26-31**

<sup>26</sup> Shikoni në fakt thirrjen tuaj, vëllezër, sepse ndër ju ka jo shumë të ditur sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë fisnikë, <sup>27</sup> por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët; <sup>28</sup> dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, <sup>29</sup> që asnjë mish të mos mburret përpara tij. <sup>30</sup> Por prej tij ju jeni në Krishtin Jezus, i cili nga Perëndia u bë për ne dituri, drejtësi, shenjtërim dhe shpengim, <sup>31</sup> që, sikurse është shkruar: “Ai që mburret, le të mburret në Zotin.”

**1:26-31** Ky paragraf i fundit i kapitullit një na tregon marrëdhënien e mbushur me tension të “urtësisë” dhe “njohurisë” siç ajo lidhet me ungjillin. Në një kuptim ato janë “keq”, në një kuptim tjetër ato janë “mirë”. Më lejoni të citoj një pasazh të mrekullueshëm nga Paul, *An Outline of His Theology* [Pali, një Skicim i Teologjisë së Tij] nga Herman Ridderbos:

“Për të qënë të sigurtë, marrëdhënia midis besimit dhe njohurisë, *pistis* and *gnosis*, sikurse ajo e besimit dhe veprave është e ndarë në dysh. Nga një anë, njohuria qëndron në rrugën e besimit, që do të thotë se, sikurse veprat e mira për hebrenjtë, ajo përfaqëson vullnetin njerëzor për vetë-shpengim. Ndërsa kjo antitezë zhvillohet tek Galatasve dhe Romakëve në lidhje me veprat, ky rrezik ndaj besimit të krishter nga ana e *gnosis* shpjegohet veçanërisht tek letra e parë drejtuar Korintasve (shih p.sh., 1 Kor. 1:26-29). Dhe ky rrezik ekziston jo vetëm në anën e asaj që Pali quan “urtësi e kësaj bote” (1 Kor. 1:21), por gjithashtu nga një lloj i caktuar *gnosis* i krishter. Pali e pranon se *gnosis* në vetvete thotë: ne e dimë se të gjithë ne kemi njohuri (1 Kor. 8:1). Por ai menjëherë shton ndaj kësaj pike: njohuria krekos, kurse dashuria ndërton. Ajo që është në diskutim këtu është një *gnosis* i krishter i përdorur në mënyrë të gabuar, i cili e ngre veten e tij mbi atë të të afërmit të vet, të dobëtit; një njohuri që në të vërtetë i shërben lirisë individuale të dikujt, por nuk ngre lart kishën. Kjo *gnosis* promovon vetëm individualizëm krenar dhe qëndron kundër dashurisë. Në këtë kuptim të *gnosis*, edhe me vepra, mund të ngrihet lart dhe të qëndrojë kundër dashurisë; si e tillë, ajo është dëmtuese dhe pa përfitim (1 Kor. 13:2,3)” fq. 242.

#### **1:26**

<b>NASB, NRSV, NJB</b>	<b>“konsideroni”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“shikoni”</b>
<b>TEV</b>	<b>“mbani mend”</b>

Kjo është ose një formë urdhërore aktive e tashme ose një formë treguese aktive e tashme. Moffatt e përkthen kështu: “Shihni gradat tuaja.” Ky pasazh nuk kishte për qëllim të ishte një dekurajim për kishën e hershme dhe liderët e saj, por një pranim i dashurisë dhe fuqisë së Perëndisë. Ai kishte për qëllim të prishte krenarinë e kësaj kisha arrogante. Kisha e hershme përbëhej kryesisht nga shtresat e varfëra të shoqërisë. Megjithatë, me sa duket një nga grupet e në Korint përbëhej nga patronët romakë dhe elita kulturore. Duke përdorur ata që nuk kanë asnjë status botëror, Perëndia madhësohet fuqinë e Tij.

■ **“jo shumë të ditur sipas mishit”** Kjo i referohet urtësisë njerëzore ose standarteve botërore (shih 1 Kor. 1:20; 2:6,8; 3:18).

### **TEMË E VEÇANTË: MISH (SARX) [SPECIAL TOPIC: FLESH (SARX)]**

Ky term përdoret më shpesh nga Pali tek letra drejtuar Galatasve dhe në zhvillimin e saj teologjik tek letra drejtuar Romakëve. Studiuesit dallojnë në mënyrën se si karakterizojnë ngjyrimet e ndryshme të termit. Sigurisht ka disa mbivendosje tek kuptimet. Më poshtë është thjesht një përpjekje për të dalluar fushën e gjerë semantike të termit.

- A. trupi njerëzor, Gjoni 1:14; Rom. 2:28; 1 Kor. 5:5; 7:28; 2 Kor. 4:11; 7:5; 12:7; Gal. 1:16; 2:16,20; 4:13; Fil. 1:22; Kol. 1:22,24; 2:5; 1 Tim. 3:16
- B. prejardhja njerëzore, Gjoni 3:6; Rom. 1:3; 4:1; 9:3,5,8; 11:14; 1 Kor. 10:18; Gal. 4:23,29
- C. personi njerëzor, Rom. 3:20; 7:5; 8:7-8; 1 Kor. 1:29; 2 Kor. 10:3; Gal. 2:16; 5:24
- D. e folur njerëzor, Gjoni 8:15; 1 Kor. 1:26; 2 Kor. 1:12; 5:16; 10:2; Gal. 6:12
- E. dobësia njerëzore, Rom. 6:19; 7:18; 8:5-6,9; 2 Kor. 10:4; Gal. 3:3; 5:13,16,19-21; Kol. 2:18
- F. dobësia njerëzore ndaj Perëndisë lidhur me pasojat e rënies së njerëzimit, Rom. 7:14; 13:14; 1 Kor. 3:1,3; Efe. 2:3; Kol. 2:18; 1 Pjet. 2:11; 1 Gjoni 2:16

Duhet theksuar se “mishi” nuk shihet si i lig në Dhjatën e Re, sikurse është në mendimin grek. Për filozofët grekë, “mishi” ishte burimi i problemeve njerëzore; vdekja e lironte njeriun nga ndikimi i tij. Por në Dhjatën e Re, “mishi” është fushë beteja e konfliktit frymëror (shih Efe. 6:10-18), e megjithatë është neutrale. Një person mund të përdorë trupin fizik si për mirë ashtu edhe për keq.

■ **“jo shumë të fuqishëm”** Kjo i referohet forcës fizike ose statusit social.

■ **“jo shumë fisnikë”** Kjo i referohet sfondit familjar i cili përfshinte pasuri, edukim dhe privilegj social. Këto tre karakterizime i përshtaten Sofistëve, të cilët ishin kaq krenar për edukimin, pozitën dhe sofistifikimin e tyre.

**1:27 “Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët”** Kjo është një formë treguese aoriste e mesme. Vetë Perëndia ka zgjedhur të manifestojë fuqinë e Tij përmes të dobtëve në mënyrë që të mos ketë dyshim se kush duhet të marrë lavdinë (shih 2 Korintasve 12). Fitorja është në burimet e Perëndisë, jo në arritjet njerëzore (shih 1 Kor. 1:29; Efe. 2:9) ose në statusin social. Për “të marrë” shih shënimin tek 1 Kor. 1:25. Për “botë” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:21b-22.

**1:28**

<b>NASB</b>	<b>“gjërat e dobëta të botës dhe të përçmuarit”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“gjërat e dobëta të botës dhe gjërat që përçmohen”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“ato që janë të ulëta dhe të përçmuara në botë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“ato të cilat bota i përçmon dhe i ul”</b>
<b>NJB</b>	<b>“ato që me standartet njerëzore janë të zakonshme dhe të përbuzhme”</b>

Kjo frazë është në kundërshti me “të ditur... të fuqishëm... fisnikë” të 1 Kor. 1:26. Termi “gjërat e dobëta” është fjalë për fjalë “ato të lindura të ulëta”, që është një referencë tjetër për fisnikërinë romake.

<b>NASB, NRSV</b>	<b>“gjërat që nuk janë”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“gjërat të cilat nuk janë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“gjërat që janë asgjë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“ato të cilat nuk quhen për asgjë”</b>

Është kjo një kategori tjetër e gjërave jo fisnike / njerëzve jo fisnikë apo është një përmbledhje? Për shkak se nuk ka *kai* (dmth., dhe; MSS P<sup>46</sup>, <sup>8</sup>, A, C<sup>\*</sup>, D, F, G) përpara kësaj fraze sikurse ka me gjithë të tjerët, ajo ndoshta është një pohim përmbledhës. Perëndia thërret dhe përdor ata njerëz të cilët bota nuk i vë re! Pikat teologjike këtu janë:

1. “që asnjë mish të mos mburret përpara tij” (shih 1 Kor. 1:29)
2. Fuqia dhe aftësimi nga Perëndisë madhësohet në dobësinë e enëve njerëzore (shih 2 Kor. 12:1-10)
3. Ndërmjetësimi i Krishtit madhësohet (shih 1 Kor. 1:30)

Në Të, çdo gjë që hebrenjtë apo grekët kërkonin dhe përpiqeshin të arrinin, është një dhuratë nga YHWH, përmes Mesias, i energjizuar nga Fryma e Shenjtë!

▣ **“për të asgjësuar ato që janë”** Ky është termi grek, *katargeō*. Shih shënimin tek 1 Kor. 1:18 dhe Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: ANULOJ DHE SHFUQIZOJ (KATARGEŌ) [SPECIAL TOPIC: NULL AND VOID (KATARGEŌ)]**

Ky term (*katargeō*) ishte një nga fjalët e preferuara të Palit. Ai e përdori atë të paktën njëzet e pesë herë, por ajo ka një spektër shumë të gjerë semantik (kuptimor).

- A. Rrënja e saj etimologjike është nga *argos* që kishte kuptimin
  1. Joaktiv/e
  2. Jo në punë
  3. I/e papërdorur
  4. I/e papërdorshëm/me
  5. Joveprues/e
- B. Bashkimi me *kata* përdorej për të shprehur
  1. Mungesë aktiviteti
  2. Papërdorshmëri/pavlefshmëri
  3. Diçka që ishte anuluar
  4. Diçka që ishte flakur tej
  5. Diçka që ishte krejtësisht e paefektshme
- C. Përdoret një herë te Luka për të përshkruar një pemë pa fryte, e si të tillë, të pavlerë (shih Luka 13:7)
- D. Pali e përdor në kuptim figurativ në dy mënyra kryesore
  1. Perëndia i bën jovepruese gjërat që janë armiqësore ndaj njerëzimit
    - a. Natyrën mëkatore të njerëzimit – Rom. 6:6
    - b. Ligjin e Moisiut në lidhje me premtimin nga Perëndia të “farës” – Rom. 4:14; Gal. 3:17; 5:4, 11; Efe. 2:15
    - c. Forcat frymërore – 1 Kor. 15:24
    - d. Njeriun e “pau dhë” – 2 Thes. 2:8
    - e. Vdekjen fizike – 1 Kor. 15:26; 2 Tim. 1:10 (Heb. 2:14)
  2. Perëndia zëvendëson të vjetrën (besëlidhjen, epokën) me të renë
    - a. Gjërat e lidhura me Ligjin e Moisiut – Rom. 3:3,31; 4:14; 2 Kor. 3:7,11,13,14
    - b. Analogjia e martesës përdoret për Ligjin – Rom. 7:2,6
    - c. Gjërat e kësaj epoke – 1 Kor. 13:8,10,11
    - d. Këtë trup – 1 Kor. 6:13
    - e. Udhëheqësit e kësaj epoke – 1 Kor. 1:28; 2:6

Kjo fjalë përkthehet në shumë mënyra të ndryshme, por kuptimi i saj kryesor është ta bësh diçka të padobishme, të zhvlerësuar dhe të shfuqizuar, jovepruese, të pafuqishme, por jo patjetër joekzistente, të shkatërruar apo të asgjësuar.

**1:29 “asnjë njeri<sup>7</sup> të mos mburret përpara tij”** Folja është një formë lidhore aoriste e mesme e cila nënkupton një zgjedhje personale të vendosur. Asnjë mish i krijuar të mos e mburrë veten përpara krijuesit (shih Efe. 2:9)!

<sup>7</sup> Versioni në shqip është “asnjë mish” (shënim i përkthyesit).

Kjo ishte e vërteta qëndrore e mesazhit të Palit ndaj korintasve krenarë dhe ndaj njerëzimit të rënë në tërësi, hebrej ose johebrej (shih Rom. 3:27; Efe. 2:9). Shih Temë e Veçantë: Mburrye (Special Topic: Boasting) tek 1 Kor. 5:6.

■ **“njeri”** Kjo fjalë për fjalë është “mish”. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**1:30**

NASB	“me anë të veprës së Tij”
NKJV	“e Tij”
NRSV	“Ai është burimi”
TEV	“Perëndia”
NJB	“prej Tij”

Kjo është fjalë për fjalë “prej Tij”, e cila është një shprehje greke që shpreh Shkakun e Parë, Lëvizësin Fillestar. Ati e dërgoi atë, Jezusi e solli atë dhe Fryma e energjizoi atë. Në vazhdim është një listë e dhuntive të Perëndisë ndaj besimtarëve përmes Krishtit.

■ **“dituri nga Perëndia”** Ne hebraisht urtësia e mendimeve personifikohet tek Pro. 8:22-31 dhe Kol. 2:2-3. Urtësia është një person. E vërteta është një person. Ungjilli është një person: Jezusi! (shih Gjoni 14:6). Megjithatë, nëse Pali po i drejtohej elementit filozofik në kishë, atëherë *sophia* do të kishte një lidhje me krenarinë e tyre në traditat e tyre kulturore (dmth., Platoni, Sokrati, Aristoteli etj.). Kjo do të ishte një metaforë për edukimin. Gjithashtu është e mundur që një gnosticizmi fillestar gjendej në ambjentin fillestar eklektik të Korintit dhe ndoshta ishte infiltuar në kishë (shih 1 Kor. 1:18-2:8; 3:18-23; 8:1-2). Nëse është kështu, atëherë komentet e Palit tek letra drejtuar Kolosianëve janë me vend (dmth., Krishti, Vetë, është urtësi, shih Kol. 1:9; 2:3). Unë mendoj se gjithë këto terma i referohen asaj që Krishti ka bërë për besimtarët përmes Jezusit.

1. Ai është urtësia e Perëndisë për ne
2. Ai është drejtësia e Perëndisë për ne
3. Ai është shenjtërimi i Perëndisë për ne
4. Ai është shpengimi i Perëndisë për ne

Gjithçka është e Perëndisë At përmes Perëndisë Bir.

■ **“drejtësi”** Kjo është një metaforë nga gjykata e ligjit (shih Rom. 3:21-26; 2 Kor. 5:21). Në kohën e Palit, rabinët kishin transferuar urtësinë gjysmë-personale të Proverbave 8 tek Ligji i Moisiut. Ndaj tij atribuohet autoriteti përfundimtar. Nëse Pali po mendonte për elementin hebraik në kishën e Korintit, ky ishte një përcaktim i fuqishëm dhe përfundimtar.

#### TEMË E VEÇANTË: DREJTËSI (SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS)

“Drejtësia” është temë kaq kyçe sa studiuesi i Biblës duhet të bëjë një studim të hollësishëm personal të këtij koncepti.

Në Dhjatën e Vjetër, karakteri i Perëndisë përshkruhet si “i drejtë” (folje, BDB 842; KB 1003; emër mashkullor, BDB 841, KB 1004; emër femëror, BDB 842, KB 1006). Vetë kjo fjalë mesopotamase vjen nga një “kallam lumi”, që përdorej si vegël ndërtimi për të gjykuar drejtësinë horizontale të mureve dhe gardheve. Perëndia e zgjodhi këtë term për ta përdorur në mënyrë metaforike për natyrën e Vet. Ai është shkopi i drejtë (vizorja) me të cilin maten të gjitha gjërat. Ky koncept pohon edhe drejtësinë e Perëndisë, edhe të drejtën e Tij për të gjykuar.

Njeriu u krijua në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27; 5:1, 3; 9:6). Njerëzimi u krijua për miqësi me Perëndinë (p.sh., Zan. 3:8). Gjithë krijimi është skenë ose sfond për ndërveprimin e Perëndisë me njerëzimin. Perëndia donte që krijesa e Tij më e lartë, njeriu, ta njihje, ta donte, t’i shërbente dhe të ishte si Ai! Besnikëria e njerëzimit u vu në sprovë (shih Zanafilla 3) dhe çifti i parë dështoi. Kjo çoi në prishjen e marrëdhënies së Perëndisë me njerëzimin (shih Rom. 5;12-21).

Perëndia premtoi se do ta ndreqte dhe rimëkëmbte këtë bashkësi (shih Zan. 3:15; shih Temën e

Veçantë: Plani i Përjetshëm Shpengues i YHWH / Special Topic: YHWH's Eternal Redemptive Plan). Ai e bën këtë me vullnetin e Vet dhe me anë të Birit të Vet. Njerëzit ishin të paaftë për ta ndrequr këtë çarje (shih Rom. 1:18-3:20; Zbulesa 5).

Pas Rënies, hapi i parë i Perëndisë drejt ripërtëritjes së miqësisë është koncepti i besëlidhjes, i bazuar në ftesën e Tij dhe në përgjigjen e njerëzimit me pendim, besim dhe bindje (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). Për shkak të Rënies, njerëzit nuk ishin të aftë që të kryenin veprimin e duhur (shih Rom. 3:21-31; Galatasve 3). Vetë Perëndisë iu desh të merrte nismën për të rimëkëmbur njerëzit që thyen besëlidhjen. Ai e bëri këtë

1. duke e shpallur njerëzimin të drejtë përmes veprës së Krishtit (pra, drejtësia ligjore).
2. duke i dhënë lirisht njerëzimit një drejtësi me anë të veprës së Krishtit (pra, drejtësia e llogaritur).
3. duke siguruar Frymën brendabanues, i cili prodhon drejtësi (pra, ngjashmëria me Krishtin, rikthimi i shëmbëllimit të Perëndisë) në njerëzimin.
4. duke rikthyer bashkësinë e Kopshtit të Edenit (krahaso Zanafillën 1-2 me Zbulesën 21-22)

Gjithsesi, Perëndia kërkon një përgjigje ndaj besëlidhjes. Ai vendos (pra, jep lirisht; Rom. 5:8; 6:23) dhe siguron, por njerëzit duhet të përgjigjen dhe të vazhdojnë të përgjigjen me

1. pendim
2. besim
3. bindje në stilin e jetesës
4. qëndresë

Prandaj, drejtësia është një veprim reciprok i besëlidhjes mes Perëndisë dhe krijesës së Tij më të lartë. Ajo bazohet në karakterin e Perëndisë, veprën e Krishtit dhe aftësimin e Frymës, dhe çdo individ duhet t'i përgjigjet siç duhet, personalisht dhe vazhdimisht. Ky koncept quhet "shfajësim me anë të besimit" (shih Efe. 2:8-9). Ky koncept zbulohet në Ungjijtë, por jo me këto fjalë. Në fillim, u përcaktua nga Pali, i cili e përdor termin greqisht "drejtësi" në forma të ndryshme mbi 100 herë.

Pali, si rabin i trajnuar, termin *dikaosunē* e përdor në kuptimin e saj hebraik *tsaddiq*, të përdorur edhe nga Septuaginta, dhe jo nga literatura greke. Në shkrimet greke, kjo fjalë përdorej për dikë që përputhej me pritshmëritë e Hyjnës dhe shoqërisë (p.sh., Noeu dhe Jobi). Në kuptimin e saj hebraik, kjo fjalë strukturohej gjithmonë në kuadër të besëlidhjes (shih Temën e Veçantë: Besëlidhja / Special Topic: Covenant). YHWH është Perëndi i drejtë, etik dhe moral. Ai do që populli i Tij të reflektojë karakterin e Tij. Njerëzimi i shpenguar bëhet krijesë e re (shih 2 Kor. 5:17; Gal. 6:15). Kjo risi çon në një stil të re jetese me perëndishmëri (shih Mateu 5-7; Gal. 5:22-24; Jakobi; 1 Gjonit). Meqë Izraeli ishte teokraci, nuk kishte dallim të qartë mes laikës (rregullave shoqërore) dhe së shenjtës (vullnetit të Perëndisë). Ky dallim shprehet duke i përkthyer fjalët hebraisht dhe greqisht në anglisht si "justice" (drejtësia që lidhet me shoqërinë) dhe "righteousness" (drejtësia që lidhet me fenë).

Ungjilli (lajmi i mirë) i Jezusit është se njerëzimi i rënë është rikthyer në bashkësi me Perëndinë. Kjo është arritur përmes dashurisë, mëshirës dhe hirit të Atit; jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Birit; dhe nxitjes e afrimit që na ka bërë Fryma me ungjillin. Shfajësimi është akt falas i Perëndisë, por duhet të çojë në perëndishmëri (pozicioni i Augustinit, i cili reflekton edhe theksin e reformacionit të natyrës falas e ungjillit, por edhe theksin katolik për jetën e ndryshuar plot dashuri dhe besnikëri). Për reformatoret, termi "drejtësi e Perëndisë" është GJINORE KUNDRINORE (pra, akti që e bën njerëzimin e mëkatshëm të pranueshëm nga Perëndia [shenjtërimi pozicional]), ndërsa për katolikët është GJINORE KRYEFJALORE, që nënkupton procesin ku njeriu bëhet gjithnjë e më tepër si Perëndia [shenjtërimi përparues dhe i përjetuar]. Në të vërtetë, ajo është patjetër të dyja bashkë!).

Për mendimin tim, e gjithë Bibla, nga Zanafilla 4 deri te Zbulesa 20, tregon sesi Perëndia rimëkëmb miqësinë e Edenit. Bibla nis me miqësinë e Perëndisë me njerëzimin në një kontekst tokësor (shih Zanafilla 1-2) dhe Bibla përfundon me të njëjtin kontekst (shih Zbulesa 21-22). Shëmbëllimi dhe qëllimi i Perëndisë do të rimëkëmbet!

Për të dokumentuar diskutimet e mësipërme, vini re pasazhet e mëposhtme, të përzgjedhura nga Dhjata e Re, që ilustrojnë grupin e fjalëve greke.

1. Perëndia është i drejtë (shpesh lidhet me Perëndinë si Gjykatës)
  - a. Romakëve 3:26

- b. 2 Thesalonikasve 1:5-6
- c. 2 Timoteut 4:8
- d. Zbulesa 16:5
- 2. Jezusi është i drejtë
  - a. Veprat e Apo. 3:14; 7:52; 22:14 (titulli i Mesisë)
  - b. Mateu 27:19
  - c. 1 Gjonit 2:1, 29; 3:7
- 3. Vullneti i Perëndisë për krijimin e Vet është drejtësia
  - a. Levitiku 19:2
  - b. Mateu 5:48 (shih 5:17-20)
- 4. Mënyra e Perëndisë për të siguruar dhe prodhuar drejtësinë
  - a. Romakëve 3:21-31
  - b. Romakëve 4
  - c. Romakëve 5:6-11
  - d. Galatasve 3:6-14
- 5. Jepet nga Perëndia
  - a. Romakëve 3:24; 6:23
  - b. 1 Korintasve 1:30
  - c. Efesianëve 2:8-9
- 6. Merret me anë të besimit
  - a. Romakëve 1:17; 3:22, 26; 4:3, 5, 13; 9:30; 10:4, 6, 10
  - b. 2 Korintasve 5:7, 21
- 7. Përmes veprave të Birit
  - a. Romakëve 5:21
  - b. 2 Korintasve 5:21
  - c. Filipianëve 2:6-11
- 8. Vullneti i Perëndisë është që ndjekësit e Tij të jenë të drejtë
  - a. Mateu 5:3-48; 7:24-27
  - b. Romakëve 2:13; 5:1-5; 6:1-23
  - c. Efesianëve 1:4; 2:10
  - d. 1 Timoteut 6:11
  - e. 2 Timoteut 2:22; 3:16
  - f. 1 Gjonit 3:7
  - g. 1 Pjetrit 2:24
- 9. Perëndia do ta gjykojë botën me drejtësi
  - a. Veprat e Apo. 17:31
  - b. 2 Timoteut 4:8

Drejtësia është karakteristikë e Perëndisë, dhe i jepet lirisht njerëzimit të mëkatshëm me anë të Krishtit. Ajo është

- 1. vendim i Perëndisë
- 2. dhuratë e Perëndisë
- 3. akt i Krishtit
- 4. jetë për t'u jetuar

Por ajo është edhe proces i të bërit i drejtë; ky proces duhet ndjekur me forcë dhe këmbëngulje dhe do të përmbushet një ditë, në Ardhjen e Dytë. Bashkësia me Perëndinë rikthehet në çastin e shpëtimit, por përparon gjatë gjithë jetës dhe bëhet takim ballë përballë në çastin e vdekjes (shih 1 Gjonit 3:2), ose në *Parousia*!

Ja një citim i duhur për ta përmyllur këtë diskutim. Është marrë nga *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalori i Palit dhe letrave të tij], nga IVP:

“Kalvini, shumë më tepër se Luteri, thekson aspektin e marrëdhënies të drejtësia e Perëndisë.



Pikëpamja e Luterit për drejtësinë e Perëndisë duket se përmban aspektin e deklarimit të pafajësisë. Kalvini thekson natyrën e mrekullueshme të komunikimit ose përcimit të drejtësisë së Perëndisë te ne” (fq. 834).

Për mua, marrëdhënia e besimtarit me Perëndinë ka tre aspekte.

1. ungjilli është person (theksi i kishës lindore dhe Kalvinit)
2. ungjilli është e vërtetë (theksi i Augustinit dhe Luterit)
3. ungjilli është jetë e ndryshuar (theksi katolik)

Këto janë të tria të vërteta dhe duhen mbajtur të bashkuara për të patur një krishterim të shëndetshëm, të shëndoshë dhe biblik. Nëse ndonjëra prej tyre mbitheksohet ose nënvlerësohet, shfaqen probleme.

Duhet ta mirëpresim Jezusin!

Duhet t’i besojmë ungjillit!

Duhet të ndjekim ngjashmërinë me Krishtin!

■ **“shenjtërim”** Kjo ishte një metaforë nga sistemi sakrifikues i Izraelit (shih Rom. 6:19-23). Kjo është nga e njëjta rrënjë sikurse fjala “i shenjtë” ose “i shenjtëruar”. Në Dhjatën e Vjetër ajo i referohej një personi, vendi ose diçkaje që ishte e ndarë për shërbesë ndaj Perëndisë. Teologjikisht i referohet pozitës së besimtarëve në Krishtin. Në momentin që një njeri vendos besimin e tij tek Ai, ky njeri është i drejtësuar dhe i shenjtëruar (shih Rom. 8:30). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

■ **“shpengim”** Kjo do të thotë të “blesh mbrapsht” (shih Rom. 3:24). Kjo ishte një metaforë nga tregu i skllavërve. Është koncepti kryesor i shpëtimit në Dhjatën e Vjetër.

## TEMË E VEÇANTË: SHPENGOJ/ÇLIROJ (SPECIAL TOPIC: RANSOM/REDEEM)

### I. DHJATA E VJETËR

A. Kryesisht, ka dy terma ligjorë hebraisht që e përçojnë këtë koncept.

1. *Ga'al* (BDB 145 I, KB 169 I), që në thelb do të thotë “çliroj [dikë] me anë të pagimit të një çmimi”. Forma e fjalës *go'el* i shton këtij koncepti ndërmjetësin personal; zakonisht ky ndërmjetës është një anëtar i familjes (pra, shpenguesi i fisit). Ky aspekt kulturor i së drejtës për të shpenguar objekte, kafshë, tokë (shih Lev. 25, 27), ose të afërm (shih Ruthi 4:14; Isa. 29:22) i transferohet teologjikisht çlirimit që i bën YHWH Izraelit nga Egjipti (shih Eks. 6:6; 15:13; Psa. 74:2; 77:15; Jer. 31:11). Ai bëhet “Shpenguesi” (shih Jobi 19:25; Ps. 19:14; 78:35; Fja. 23:11; Isa. 41:14; 43:14; 44:6,24; 47:4; 48:17; 49:7,26; 54:5,8; 59:20; 60:16; 63:16; Jer. 50:34).

2. *Padah* (BDB 804, KB 911), që në thelb do të thotë “çliroj” ose “shpëtoj”.

- a. shpengimi i të parëlindurve (Eks. 13:13-15; Num. 18:15-17)
- b. shpengimi fizik krahasohet me shpengimin shpirtëror (Psa. 49:7, 8, 15)
- c. YHWH shpëton Izraelin nga mëkati dhe rebelimi (Psa. 130:7-8)

B. Ky koncept teologjik përfshin një sërë elementesh të lidhura.

1. Ekziston nevoja, skllavërimi, falimentimi, burgosja.

- a. Fizike
- b. Shoqërore
- c. Shpirtërore (shih Psa. 130:8)

2. Duhet paguar një çmim për lirinë, lirim dhe rimëkëmbjen.

- a. E kombit të Izraelit (shih Ligji i Përt. 7:8)
- b. E individit (shih Jobi 19:25-27; 33:28; Isaia 53)

3. Dikush duhet të veprojë si ndërmjetës dhe bamirës. Në rastin e *ga'al*-it, ky ishte zakonisht një anëtar i familjes, ose farefis (shih *go'el*, BDB 145).

4. Shpesh, YHWH e përshkruan Vetën me terma familjarë.

- a. At'
- b. Bashkëshort
- c. Shpengues/Shpagues Faferisnor. Shpengimi kryhet më anë të veprimit personal të YHWH; paguhet një çmim dhe arrihet shpengimi!

## II. DHJATA E RE

A. Ka disa terma që përdoren për përçimin e këtij koncepti teologjik.

1. *Agorazō* (shih 1 Kor. 6:20; 7:23; 2 Pje. 2:1; Zbu. 5:9; 14:3-4). Ky është term tregtar, që pasqyron pagimin e një çmimi për diçka. Ne jemi një popull i blerë me gjak, i cili nuk e ka jetën e vet në dorë. Ne i përkasim Krishtit.

2. *Exagorazō* (shih Gal. 3:13; 4:5; Efe. 5:16; Kol. 4:5). Edhe ky është term tregtar. Pasqyron vdekjen zëvendësuese të Jezusit për hirin tonë. Jezusi mbarti "mallkimin" e ligjit, që bazohej te veprat (pra, ligjit të Moisiut, shih Efe. 2:14-16; Kol. 2:14), të cilin njerëzit mëkatarë nuk e përmbushnin dot. Ai mbajti mbi Vete mallkimin (shih Ligji i Përt. 21:23) për të gjithë ne (shih Marku 10:45; 2 Kor. 5:21)! Në Jezusin, drejtësia dhe dashuria e Perëndisë u shkrinë në një për të mundësuar faljen, pranimin dhe komunikimin e plotë me Perëndinë!

3. *Luō* "çliroj"

- a. *Lutron*, "çmim i shlyer" (shih Mat. 20:28; Marku 10:45). Këto janë fjalë të fuqishme nga goja e vetë Jezusit në lidhje me qëllimin e ardhjes së Tij: pra, për të qenë Shpëtimtar i botës duke shlyer një borxh mëkati që nuk e kishte Ai Vetë (shih Gjoni 1:29).
- b. *Lutroō*, "çliroj"
  - (1) Çliroj/shpengoj Izraelin (Luka 24:21)
  - (2) Jezusi dha Vetën për të shpenguar dhe pastruar popullin e Vet (Titit 2:14)
  - (3) Jezusi ishte zëvendësues i pamëkatë (1 Pje. 1:18-19)
- c. *Lutrōsis*, "çlirim", "shpengim", ose "lirim"
  - (1) Profecia e Zakarisë për Jezusin, Luka 1:68
  - (2) Lavdet e Hanës ndaj Perëndisë për Jezusin, Luka 2:38
  - (3) Flijimi më i mirë, i kryer një herë e përgjithmonë, nga Jezusi, Heb. 9:12

4. *Apolytrōsis*

- a. Shpengim në Ardhjen e Dytë (shih Veprat e Apo. 3:19-21)
  - (1) Luka 21:28
  - (2) Romakëve 8:23
  - (3) Efesianëve 1:14; 4:30
  - (4) Hebrenjve 9:15
- b. Shpengimi në vdekjen e Krishtit
  - (1) Romakëve 3:24
  - (2) 1 Korintasve 1:30
  - (3) Efesianëve 1:7
  - (4) Kolosianëve 1:14

5. *Antilytron* (shih 1 Tim. 2:6). Ky është pasazh kyç (si dhe Titit 2:14), sepse e lidh çlirimin me vdekjen zëvendësuese të Jezusit në kryq. Ai është flijimi i vetëm i pranueshëm, ai që vdiq për të gjithë (shih Gjoni 1:29; 3:16-17; 4:42; 1 Tim. 2:4; 4:10; Titit 2:11; 2 Pje. 3:9; 1 Gjonit 2:2; 4:14).

B. Koncepti teologjik në Dhjatën e Re.

1. Njerëzimi është i skllavëruar ndaj mëkatit (shih Gjoni 8:34; Rom. 3:10-18, 23; 6:23).

2. Robërimi i njerëzimit ndaj mëkatit është zbuluar me anë të ligjit të Moisiut në Dhjatën e Vjetër (shih Gal. 3) dhe me anë të Predikimit në Mal të Jezusit (shih Matu 5-7). Përpjekja njerëzore është kthyer në dënim me vdekje (shih Kol. 2:14).

3. Jezusi, qengji i pamëkatë i Perëndisë, ka ardhur dhe ka vdekur në vendin tonë (shih Marku

10:45; Gjonit 1:29; 2 Kor. 5:21). Ne jemi çliruar nga mëkati që t'i shërbejmë Perëndisë (shih Rom. 6).

4. Si rrjedhojë, YHWH dhe Jezusi janë “të afërm” që veprojnë në vendin tonë. Kjo vazhdon dhe metaforat e familjes (pra, ati, burri, biri, vëllai, i afërmi).

5. Shpengimi nuk është çmim që i paguhet Satanit (pra, siç thotë teologjia e mesjetës), por është pajtimi i fjalës dhe drejtësisë së Perëndisë me dashurinë e Perëndisë dhe shlyerjen e plotë në Krishtin. Në kryq u kthye paqja, rebelimi njerëzor u fal, dhe shëmbëllimi i Perëndisë në njerëzimin tani është plotësisht funksional për të patur bashkësi të ngushtë me Të!

6. Shpengimi ka dhe një aspekt në të ardhmen (shih Rom. 8:23; Efe. 1:14; 4:30), që ka të bëjë me trupin tonë të ringjalljes dhe me marrëdhënien e ngushtë dhe personale me Perëndinë Triun (shih Temën e Veçantë: Trinia / Special Topic: The Trinity). Trupi ynë i ringjalljes do të jetë si ai i Krishtit (shih 1 Gjonit 3:2). Ai kishte trup fizik, por me një aspekt shtesë nga ana dimensionale. Është e vështirë ta përcaktosh paradoksin e 1 Kor. 15:12-19 me 1 Kor. 15:35-58. Siç shihet, ka trup fizik dhe tokësor, por ka dhe trup qiellor dhe shpirtëror. Jezusi i ka të dy!

**1:31** Ky është një citim nga Jer. 9:23-24. Pali e përsërit këtë frazë tek 2 Kor. 10:17. “Zot” tek pasazhet nga Jeremia i referohet YHWH, por këtu i referohet Jezusit! Kjo është një teknikë e zakonshme në Dhjatën e Re për të pranuar hyjësinë e Jezusit. Ne nuk mburremi në apo me veten tonë, por në Atë në të cilin banon me trup gjithë plotësia e Perëndisë! Këto dy citime të Jeremias tregojnë një lidhje midis 1 Korintasve 1-4 dhe 2 Korintasve 10-13. Kundërshtarët janë sofistët hebrej të cilët mburren me stilin retorik (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në mes të Sofistëve]).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse Pali thekson kaq shpesh thirrja nga Perëndia?
2. Si mund t'i quajë “të shenjtë” Perëndia njerëzit mëkatar?
3. Cili është qëllimi i dhuntive frymore në kishë?
4. Pse ishte kisha e Korintit kaq e përçarë?
5. Si lidhet 1 Kor. 1:12 me denominacionet moderne?
6. A po hedh poshtë Pali pagëzimin tek 1 Kor. 1:17?
7. Pse e refuzuan ungjillin hebrejtë?
8. Pse e refuzuan ungjillin grekët?
9. Pse ka zgjedhur Perëndia njerëzit e dobët me asnjë status social apo intelektual për të shpërndarë ungjillin?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](http://www.biblelessons.org)

# 1 KORINTASVE 2

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Të Shpallësh Krishtin të kryqëzuar	Krishti i Kryqëzuar	Krishti i Kryqëzuar	Mesazhi mbi Krishtin në Kryq	Urtësia e Vërtetë dhe e Rremë (1:17-3:4)
2:1-5	2:1-5	2:1-5	2:1-5	2:1-5
Zbulesa nga Fryma e Perëndisë	Urtësia Frymore	Urtësia Frymore	Urtësia e Perëndisë	
2:6-16	2:6-16	2:6-13	2:6-12  2:13-16	2:6-9  2:10-16
		2:14-16		

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 2:1-16**

- A. Kishte disa në kishën e Korintit që ishin shumë të orientuar intelektualisht (dmth., traditat retorike të shekullit të parë). Në këtë kontekst të njohurisë dhe performancës njerëzore të mbi-theksuar, Pali fillon në kapitullin 1 me një theks mbi hirin e Perëndisë (sikurse bën tek Efe. 2:1-10). Megjithatë, ai pranoi se urtësia dhe njohuria janë gjithashtu ndër dhuntitë e Perëndisë. Në kapitullin 2, Pali vazhdon në këtë temë duke theksuar zbulesën<sup>8</sup> përkundrejt zbulimit njerëzor. Duke qënë se korintasit nuk mund të kishin asnjë pretendim mbi njohurinë që kishin, ata po ashtu nuk mund të kishin asnjë pretendim ndaj mënyrës së marrjes së atyre njohurive.
- B. Në thelb, 1 Kor. 2:1-16 është një përforsim i kapitullit 1 Kor. 1:18-25.
- C. Vargjet 10-16 mund të kuptohen si referencë ndaj disa kategorive të njohurive apo zbulesës frymore. Perëndia ka vepruar kështu për të na zbuluar Vetën e Tij (dmth., zbulesë, 1 Kor. 2:10-12); Ai ka zgjedhur disa njerëz për të regjistruar dhe shpjeguar veprat e Tij (dmth., frymëzimin, v. 13) dhe së fundmi Fryma iu mundëson lexuesve të Biblës të kuptojnë të vërtetat kryesore të zbulesës së Tij (dmth., iluminimi, 1 Kor. 2:14-16).

<sup>8</sup> Zbulesën nga Perëndia (shënim i përkthyesit).

## **TEMË E VEÇANTË: PËRNDRITJA/NDRIÇIMI (SPECIAL TOPIC: ILLUMINATION)**

Perëndia ka vepruar në të kaluarën për t'i zbuluar Vetën e Vetë qartë njerëzimit (dmth., krijimi, përmbytja, thirrja e Patriarkëve, mërgimi, sundimi, etj.). Në teologji, kjo quhet “zbulesë”. Ai përzgjedhi disa njerëz për ta shkruar dhe shpjeguar këtë vetë-zbulesë (p.sh., Gjoni 14:26; 16:12-15). Në teologji, kjo quhet “frymëzim”. Ai ka dërguar Frymën e Vetë për t'i ndihmuar lexuesit që ta kuptojnë Atë dhe premtimet e sigurimet e Tij, sidomos ardhjen e Mesias. Në teologji, kjo quhet “përndritje/ndriçim”. Problemi vjen kur ne pohojmë se Fryma përfshihet në të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë— atëherë, pse ka kaq shumë interpretime të ndryshme të Tij dhe vullnetit e mënyrave të Tij?

Një pjesë e problemit ka të bëjë me botëkuptimin ose përvojat personale të lexuesit. Shpesh, trajtohet një axhendë personale duke e përdorur Biblën si tekst-provues, ose në mënyrë të shkëputur nga konteksti. Shpesh, Biblës i imponohet një kuadër teologjik i caktuar, që e lejon Biblën të flasë vetëm në zona të caktuara dhe në mënyra të përzgjedhura. Përndritja/ndriçimi nuk duhet barazuar kurrsesi me frymëzimin, ndonëse Fryma përfshihet në të dyja. Frymëzimi (shih Temën e Veçantë: Frymëzimi / Special Topic: Inspiration) ka përfunduar me Dhjatën e Re (dmth., Juda 3, 20). Pjesa më e madhe e teksteve të Dhjatës së Re të cilat lidhen me ndriçimin i referohen njohurisë mbi ungjillin dhe jetën e ngjashme me Krishtin (dmth., Rom. 8:12-17; 1 Kor. 2:10-13; Efe. 1:17-19; Fil. 1:9-11; Kol. 1:9-13; 1 Gjoni 2:20-27). Kjo, në të vërtetë, është një nga premtimet e “besëlidhjes së re” (shih Jer. 31:31-34, sidomos v. 34).

Qasja më e mirë për të lejuar Frymën të ndihmojë besimtarët të kuptojnë zbulesën mund të jetë të përpqemi të shprehim idenë qendrore të një paragrafi, dhe jo të interpretojmë çdo hollësi të pjesës. Ai që përçon të vërtetën qendrore të autorit fillestar është mendimi tematik. Përvijimi i librit, ose njësia letrare, na ndihmon që të ndjekim synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Asnjë interpretues nuk është i frymëzuar. Ne s'mund të riprodhojmë metodën interpretuese të shkrimtarit biblik (dmth., frymëzimi). Por ne mundemi dhe duhet të përpqemi të kuptojmë se çfarë po thoshte autori fillestar për kohën e vet dhe, pastaj, këtë të vërtetë ta përçojmë në kohën tonë. Ka pjesë të Biblës që janë të vagullta ose të fshehura (deri në një kohë ose periudhë të caktuar). Do të ketë gjithmonë mosmarrëveshje për disa tekste ose tema të caktuara, por duhet t'i shprehim qartë të vërtetat qendrore dhe duhet të lejojmë njëfarë lirie për interpretimet individuale brenda caqeve të synimit të autorit fillestar. Interpretuesit duhet të ecin nën dritën që kanë, gjithmonë duke qenë të hapur për të marrë më tepër dritë nga Bibla dhe nga Fryma. Perëndia do të na gjykojë në bazë të nivelit të të kuptuarit tonë dhe në bazë të mënyrës sesi e zbatojmë atë që kuptojmë.

## **TEMË E VEÇANTË: FRYMËZIMI (SPECIAL TOPIC: INSPIRATION)**

Ky është pranimi i besimit se Perëndia ishte i përfshirë aktivisht me anë të Frymës së Tij në regjistrimin e veprave, premtimeve dhe vullnetit të Tij për njerëzimin. Kjo është vetë-zbulesa hyjnore! Kjo vetëzbulesë quhet “zbulesë”. Regjistrimi i saj për të ardhmen quhet “frymëzim”.

Përdorimi i vetëm i fjalës “frymëzim” në Bibël është tek 2 Tim. 3:16 dhe fjalë për fjalë është “Perëndia nxorri frymë”. Vini re “Shkrimet” tek Dhjata e Re gjithmonë i referohen Dhjatës së Vjetër (p.sh., 2 Tim. 3:15 i referohet rritjes së Timoteut sipas traditave hebraike). Vini re se qëllimi i Shkrimeve është i dyfishtë.

1. Urtësia që na con në shpëtim, 2 Tim. 3:15
2. Trajnimi në drejtësi, 2 Tim. 3:16

Vini re se si Gjoni 5:39; 1 Kor. 15:3-4; dhe 1 Pjet. 1:10-12 e shohin Dhjatën e Vjetër teksa drejton tek Krishti. Vetë Jezusi e pranoi këtë tek Luka 24:25-27! Fryma udhëhiqte shkrimtarët e Dhjatës së Vjetër (shih 2 Pjet. 1:20-21). Kisha pranoi kanonin (shih Temën e Veçantë: Kanon / Special Topic: Canon) të Dhjatës së Vjetër. Ata e shihnin atë si plotësisht të frymëzuar (shih Mate. 5:17-19). Megjithatë, ata gjithashtu kuptuan se Dhjata e Re, e cila përmban fjalët dhe veprat e Jezusit, ishte zbulesa përfundimtare (shih Mate. 5:21-48; Heb. 1:1-2). Jezusi është zbulesa e plotë, përfundimtare dhe e plotësuar e YHWH (shih Gjoni 1:1-5,14; Kol. 1:15-16). Ai përmbush premtimin e Dhjatës së Vjetër për Mesia (dmth., Mate.

26:31,56; 14:27,49; Luka 20:17; Gjoni 12:14-16; 13:18; 15:25; 17:12; 19:24-36; Veprat e Apo. 1:16; 3:18,21-26; 4:25-28).

Fryma duhet të hapë mendjen dhe zemrën përpara se njeriu të kuptojë (shih Veprat e Apo. 8:34-35; 13:27). Shkrimtarët biblikë të udhëhequr nga fryma për të shprehur në fjalë, shprehje dhe ilustrime njerëzore të vërtetat e vetë-zbulesës së Perëndisë në Jezusin (shih Gjoni 14:26; 15:26-27; 1 Kor. 2:10-11,13-16).

Një diskutim i mirë i shkurtër gjendet tek Millard J. Erickson, *Christian Theology* [Teologjia e Krishterë], botimi i dytë, fq. 224-245.

Gjithashtu një diskutim i mirë mbi procesin letrar nga një shoqëri e bazuar mbi fjalën e folur tek dokumentat e shkruar gjendet nga John H. Walton dhe D. Brent Sandy tek *The Lost World of Scripture* [Bota e Humbur e Shkrimeve] (2013).

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 2:1-5

<sup>1</sup>Edhe unë, o vëllezër, kur erdha te ju, nuk erdha me shkëlqim fjalësh a diturie, që t'ju shpall dëshminë e Perëndisë, <sup>2</sup>sepse e vendosa që të mos di tjetër gjë ndër ju, veç Jezu Krishtit edhe atë të kryqëzuar. <sup>3</sup>Edhe unë kam qenë te ju me dobësi, me frikë dhe drithërimë të madhe. <sup>4</sup>Dhe fjala ime dhe predikimi im nuk u bënë me fjalë mbushamendëse nga dituria njerëzore, por në dëftim të Frymës dhe të fuqisë, <sup>5</sup>që besimi juaj të mos qëndrojë mbi diturinë e njerëzve, po mbi fuqinë e Perëndisë.

**2:1 “vëllezër”** Ky përcaktim për besimtarët përdoret shpesh nga Pali, në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme, për të përshkruar hapin tjetër në prezantimin e një të vërtete apo në prezantimin e një të vërtete të re (shih 1 Kor. 2:1; 3:1; 4:6; 7:24; 10:1; 11:33; 12:1; 14:6, 20, 35; 15:1, 31, 50, 58; 16:15). Termi përshkruan burrat dhe gratë e kishës së Korintit.

NASB	“nuk erdha me epërsinë e fjalëve apo të urtësisë”
NKJV	“nuk erdha me shkëlqimin e fjalëve apo të urtësisë”
NRSV	“nuk erdha duke shpallur... në fjalë të larta apo në urtësi”
TEV	“nuk përdora fjalë të gjata dhe mësim të mëdha”
NJB	“nuk erdha me ndonjë shkëlqim oratorie apo argument të mënçura”

Pali po shprehte ndryshimin mes vetes së tij (dmth., Pali në Korint, shih Veprat e Apo. 18:1-18) dhe mbi-theksimit të rremë mbi njohurinë dhe retorikën e disa prej korintasve të cilët më pas u bënë drejtues kishë. Apoli, jo Pali, ishte retoriku i aftë dhe ata dëshironin që Pali të rivalizonte stilin e tij të folurit në publik (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në mes të Sofistëve]). Për “epërsi” (*huperochē*) shih Temën e Veçantë më poshtë.

### TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI NGA PALI I FJALËVE TË PËRBËRA ME “HUPER” (SPECIAL TOPIC: PAUL'S USE OF HUPER COMPOUNDS)

Pali kishte një prirje të veçantë për të krijuar fjalë të reja duke përdorur PARAFJALËN greke *huper*, e cila pak a shumë do të thotë “mbi” ose “i sipërm.” Kur përdoret me rasën GJINORE (RRJEDHORE) ka kuptimin “në emër të.” Ajo mund të ketë kuptimin “rreth” ose “në lidhje me,” si *peri* (shih 2 Kor. 8:23; 2 Thes. 2:18). Kur përdoret me KALLËZOREN ka kuptimin “mbi,” “sipër,” ose “përtej” (shih A. T. Robertson, *A Grammar of the Greek New Testament in the Light of Historical Research* [Një Gramatikë e Dhjatës së Re Greke nën Dritën e Kërkimeve Historike], fq. 625-633). Kur Pali donte të theksonte një koncept, ai e përdorte këtë PARAFJALË në një fjalë të përbërë. Më poshtë është një listë me përdorimin e veçantë nga Pali të kësaj PARAFJALË në fjalë të përbëra.

5. *Hapax legomenon* (përdorur vetëm një herë në Dhjatën e Re)
  - a. *Huperakmos*, dikush që e ka kaluar lulen e jetës, 1 Kor. 7:36
  - b. *Huperauxanō*, të shtosh shumë, 2 Thes. 1:3
  - c. *Huperbainō*, të tejkalosh ose të shkelësh, 1 Thes. 4:6
  - d. *Huperkeina*, përtej, 2 Kor. 10:16
  - e. *Huperekteina*, shtrihet përtej, 2 Kor. 10:14
  - f. *Huperentugchanō*, të ndërmjetësosh, Rom. 8:26
  - g. *Hupernikaō*, të jesh fitimtar me bollëk, Rom. 8:37
  - h. *Huperleonazō*, të kesh bollëk me tepri, 1 Tim. 1:14
  - i. *Huperupsoō*, të lartësosh mbi gjithçka, Fil. 2:9
  - j. *Huperphroneō*, të kesh mendime të larta, Rom. 12:3
6. Fjalë të përdorura vetëm në shkrimet e Palit.
  - a. *Huperaiomai*, të lartësosh veten, 2 Kor. 12:7; 2 Thes. 2:4
  - b. *Huperballontōs*, mbi masën, me tepri, 2 Kor. 11:23; (NDAJFOLJE vetëm këtu, por FOLJE në 2 Kor. 3:10; 9:14; Efe. 1:19; 2:7; 3:19)
  - c. *Huperbolē*, shtënie me tepri, armatosje e jashtëzakonshme, Rom. 7:13; 1 Kor. 12:31; 2 Kor. 1:8; 4:7,17; 22:7; Gal. 1:13
  - d. *Huperekperissou*, përtej çdo lloj mase, Efe. 3:20; 1 Thes. 3:10; 5:13
  - e. *Huperlian*, në shkallën më të lartë ose mbizotëruese, 2 Kor. 11:5; 12:11
  - f. *Huperochē*, mbidallim, shkëlqyeshmëri, 1 Kor. 2:1; 1 Tim. 2:2
  - g. *Huperperisseuō*, të teprosh me bollëk, Rom. 5:20 (DIATEZA JOVEPRORE, të jesh i mbushur me bollëk, të derdhesh me tepri, 2 Kor. 7:4)
7. C. Fjalë të përdorura nga Pali dhe rrallë në shkrimtarë të tjerë të Dhjatën e Re
  - a. *Huperanō*, shumë lart, Efe. 1:21; 4:10; dhe Heb. 9:5)
  - b. *Huperechō*, shkëlqyeshmëri, mbidallueshmëri, Rom. 13:1; Fil. 2:3; 3:8; 4:7; 1 Pjet. 2:13
  - c. *Huperēphanos*, krenar ose fodull, Rom. 1:30; 2 Tim. 3:2 dhe Luka 1:51; Jakobi 4:6; 1 Pjet. 5:5.

Pali ishte një njeri i karakterizuar nga pasion i madh; kur gjërat ose njerëzit ishin mirë, ata ishin shumë mirë dhe kur ishin keq, ata ishin shumë keq. Kjo PARAFJALË e lejonte atë të shprehte ndjenjat e tij sipërore në lidhje me mëkatën, veten dhe Krishtin e Ungjillin.

NASB, NKJV	“dëshminë e Perëndisë”
NRSV, NJB	“misterin e Perëndisë”
TEV	“të vërtetën sekrete të Perëndisë”

Gjendet një variant dorëshkrimi grek këtu. Termi grek *musterion* (mister) shfaqet tek MSS P<sup>46</sup>, **ⲛ**<sup>\*</sup>, A dhe C. Fjala *marturion* (dëshmi) shfaqet në dorëshkrimet antike **ⲛ**<sup>2</sup>, B, C, D. Nëse është “mister”, ky koncept përshkruhet tek 1 Kor. 2:7; Efe. 2:11-3:13; dhe Kol. 1:26-27, i cili është uniteti i hebrenjve dhe grekëve përmes Krishtit në një familje (dmth., kisha). Nëse është “dëshmi”, është e lidhur me vargun e mëparshëm 1:6, i cili është sinonim me “ungjill”. Versioni UBS<sup>4</sup> i jep “mister” një shkallëzim B (dmth., pothuajse i sigurtë).

Termi “mister” përdoret shpesh në papirusët në gjuhën koine në shekullin e parë të gjetur në Egjipt në referencë ndaj njohurisë sekrete të re ndaj një grupi të veçantë (dmth., besime misterioze). Pali e merr këtë term teknik dhe e përdor atë në lidhje me ata që kanë Frymën (dmth., besimtarët) dhe ata që nuk e kanë. Nuk ka dallim në këtë pikë në prezantimin e Palit midis besimtarëve (shih 1 Kor. 3:1). Të gjithë konsiderohen “të pjekur” (shih 1 Kor. 2:6).

## TEMË E VEÇANTË: MISTERI NË UNGJIJTË (SPECIAL TOPIC: MYSTERY IN THE GOSPELS)

- A. Në ungjijtë sinoptikë, “misteri” përdoret për mësimet shpirtërore që nxirren nga shëmbëlltyrat e Jezusit.
1. Marku 4:11
  2. Mateu 13:11
  3. Luka 8:10
- B. Pali e përdori në disa mënyra të ndryshme:
1. Ngurtësimi i pjesës së Izraelit në mënyrë që të mundësohej përfshirja e johebrenjve. Ky vërshim johebrenjsh do të funksionojë si mekanizëm që judenjtë të pranojnë Jezusin si Krishtin e profecisë (shih Rom. 11:25-32).
  2. Ungjilli iu bë i njohur kombeve, duke iu thënë se të gjithë janë të përfshirë në Krishtin dhe nëpërmjet Tij (shih Rom. 16:25-27; Kol. 2:2).
  3. Trupat e rinj të besimtarëve në Ardhjen e Dytë (shih 1 Kor. 15:5-57; 1 Thes. 4:13-18).
  4. Përmbledhja e të gjitha gjërave në Krishtin (shih Efe. 1:8-11)
  5. Johebrenjtë dhe judenjtë si bashkëtrashëgimtarë (shih Efe. 2:11-3:13).
  6. Ngushtësia e marrëdhënies së Krishtit me Kishën përshkruhet me metaforën e martesës (shih Efe. 5:22-33).
  7. Johebrenjtë përfshihen si popull i besëlidhjes dhe brendabanohen nga Fryma e Krishtit në mënyrë që në ta të prodhohet pjekuria e Krishtit, pra, të ripërtërihet shëmbëllimi i përcudnuar i Perëndisë në njeriun (shih Zan. 1:26-27; 5:1; 6:5, 11-13; 8:21; 9:6; Kol. 1:26-28).
  8. Antikrishti i kohëve të fundit (shih 2 Thes. 2:1-11).
  9. Një himn i kishës së hershme për misterin e ungjillit gjendet në 1 Tim. 3:16.
- C. Në Zbulesën e Gjonit, misteri përdoret në lidhje me kuptimin e simboleve apokaliptike të Gjonit.
1. 1:20
  2. 10:7
  3. 17:5, 6
- D. Këto janë të vërteta që njerëzit nuk i zbulojnë dot; duhen zbuluar nga Perëndia. Këto mësimet janë thelbësore për ta kuptuar vërtet planin e përjetshëm të Perëndisë për shpengimin e gjithë njerëzve (shih Zan. 3:15). Shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpengues i YHWH / SPECIAL TOPIC: YHWH'S ETERNAL REDEEMPTIVE PLAN.

**2:2 “unë”** Në vargjet 1-5 Pali duket se po e krahason veten e tij me

1. Prezantimin e tij të mëparshëm të ungjillit në Athinë ku ai përdori llogjikën greke, madje edhe citoi poetët e tyre (dmth., të sugjeruar fillimisht nga Origeni, shih Veprat e Apostujve 17:16-34)
2. Prezantimi i tij i ungjillit përkundrajt atyre në Korint të cilët flisnin me urtësi njerëzore dhe retorikë njerëzore mbi çështje frymore

■ **“Jezu Krishtit edhe atë të kryqëzuar”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer (shih 1 Kor. 1:23).

Gjenden dy aspekte teologjike të zbuluara në këtë formë pjesore:

1. Koha e përkryer zbulon se Jezusi mbetet i kryqëzuar. Kur ne ta shohim Atë, Ai do të ketë ende shenjat e plagëve. Ato janë bërë shenja e Tij e lavdisë (shih shënimin tek 1 Kor. 1:23).
2. Forma pasive zbulon se vdekja e Jezusit ishte
  - a. Nga ndërveprimi i Atit dhe ishte plani i Tij i përjetshëm (shih Veprat e Apo. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29) për shpengim (shih Isa. 53:10)
  - b. Nga mëkati dhe rebelimi njerëzor të cilët kërkonin një fljirim (shih Rom. 5:14-15,18-19)



Mesazhi mbi vdekjen e Krishtit në vend të njerëzimit është mesazhi qëndror i teologjisë së Palit. Koncepti i një Mesie që vuan dhe vdes ishte i huaj për mendimin tradicional hebraik. Ky aspekt i ungjillit fillimisht duhet ta ketë trazuar Palin. Si mundet që i Vajosuri i YHWH të mallkohet nga Perëndia (shih Ligji i Përt. 21:23). Megjithatë, kjo ishte pjesë e zbulësës së Dhjatës së Vjetër (shih Zan. 3:15; Psalm 22; Isaia 53; Zak. 12:10). Jezusi, Biri i pamëkatë i Perëndisë, vdiq në vendin tonë (shih Rom. 5:18-19; 2 Kor. 5:21). Ai u bë mallkimi për ne (shih Gal. 3:13). Krishti i kryqëzuar për të gjithë është misteri i fshehur i Perëndisë (shih Kol. 1:26-28; 2:2-4).

**2:3 “unë kam qenë te ju me dobësi, me frikë dhe drithërimë të madhe”** Ky mund të jetë një aludim ndaj Eksod. 15:16 tek LXX. Pali po na tregon mangësitë e tij.

1. Ai ishte i mbushur me frikë për shkak të trajtimit të vështirë që i bën në Filipi, Thesalonikë dhe Berea (shih Veprat e Apo. 16-17)
2. Ai u zhgënjye nga rezultatet dhe ndoshta nga metodologjia e tij e përdorur në Athinë (dmth., pikëpamja e Origenit nga Veprat e Apo. 17:22-34)
3. Problemi i tij fizik, ndoshta problem me syrin, i shkaktonte atij shumë vështirësi (shih 2 Kor. 12:7-9)
4. Mungesa e besimit tek Pali dhe dekurajimi ndërkohë që ishte në Korint

Krishti duhej t'i shfaqej Palit disa herë për ta inkurajuar atë (shih Veprat e Apo. 18:9-10; 23:11; 27:23). Fjalët e tij dhe gjendja e tij fizike nuk ishin ato që i kthyen njerëzit tek besimi në Krishtin, por tërheqja e ungjillit dhe fuqia e Frymës (shih 1 Kor. 2:4; 1:17; 2 Kor. 10:10).

Mua si shërbëtor i Jezus Krishtit më ndihmon të kuptoj se

1. Jezusi kishte momentet e tij të dekurajimit (p.sh., Gjetsemanë)
2. Apostujt shpesh nuk i kuptonin plotësisht mësimet e Jezusit
3. Pali ndihej i frikësuar dhe i dobët

Ne duhet të pranojmë gjithmonë dobësinë e mishit e megjithatë edhe fuqinë e jashtëzakonshme të ungjillit dhe praninë e Frymës! Karakteri dhe sigurimet e Perëndisë madhësohen përmes dobësisë njerëzore (shih 1 Kor. 1:26-29; 2 Kor. 12).

Dobësitë e Palit janë pikërisht këto gjëra për të cilat mësuesit e rremë sulmonin Palin tek 2 Kor. 10-13. Ata madhësojnë fuqitë e tyre (dmth., edukimin, pozitën sociale, dhuntitë frymore, aftësitë folëse). Me sa duket, shkrimet e Palit ishin më të strukturuar nga ana retorike (shih 2 Kor. 10-13) dhe më të fuqishme se sa mesazhet e tij të përcjella gojarisht.

Shih Temën e Veçantë: Dobësi (Special Topic: Weakness) tek 2 Kor. 12:9.

## 2:4

<b>NASB</b>	<b>“jo në fjalë mbushamëndëse të urtësisë”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“jo me fjalë mbushamëndëse të urtësisë njerëzore”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“jo me fjalë mbushamëndëse të urtësisë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“jo të dorëzuara me fjalë plot aftësi të urtësisë njerëzore”</b>
<b>NJB</b>	<b>“jo me qëllim për t'ju bindur me argumente filozofike”</b>

Ka shumë variante të kësaj fraze në dorëshkrimet greke.

1. Problemi i parë lidhet me mbiemrin e rrallë *peithois* (shih MSS P<sup>46</sup>, x, A, B, C, D), i cili nuk gjendet në ndonjë vend tjetër të Septuagint-it, papirusët në gjuhën koine apo në Dhjatën e Re.
2. Disa mendojnë se variantet u shkaktuan nga skribët të cilët ishin të pamësuar me këtë mbiemër. Ata mund ta kenë ndryshuar pak formën e tij në *peithoi*, që do të thotë “bindje”.
3. Disa dorëshkrime greke shtojnë “bindjen nga njeriu” (shih 1 Kor. 2:13 dhe MSS x<sup>2</sup>, A, C).
4. Në disa dorëshkrime termi “fjalët” (dmth., *logois* ose *logos*) mungon (shih MSS P<sup>46</sup>, F, G dhe teksti grek i përdorur nga Chrysostom [Krisostom-i]).

Duket më e përshtatshme nga konteksti i përgjithshëm që të lidhësh këtë frazë me refuzimin e Palit për retorikën, llogjikën dhe urtësinë njerëzore (shih 1 Kor. 1:17; 2:1,13). Megjithatë, kuptimi i saktë i fjalës *peithois* mbetet i pasigurtë (shih NIDNTT, vol. 1, fq. 588-593).

■ **“në dëftim të Frymës dhe të fuqisë”** Kjo i referohet jetëve të ndryshuara të korintasve që ishin konvertuar. Ajo gjithashtu mund të lidhet me praninë e shenjave konfirmuese që ndodhnin shpesh gjatë predikimit të Palit për ungjillin (shih Veprat e Apo. 13:11; 14:10; 16:18,28; 19:11-12; 20:10). Shih shënimin mbi shkronjën e madhe apo të vogël “f” për frymën tek 1 Kor. 2:11.

2:5 Për Palin, shpresa e vetme e njerëzimit ishte në hirin e Atit, në punën e përfunduar të Birit dhe në fuqinë e Frymës. Me fjalë të tjera, vetë Perëndia është themeli i vetëm i vërtetë për shpëtim. Zbuluesi i Perëndisë dhe jo zbulimi njerëzor, urtësia e Perëndisë dhe jo elokuenca apo llogjika njerëzore, janë të vetmet burime sigurie. Për Palin, ungjilli i Perëndisë dhe përgjigjet e duhura të njerëzimit të rënë ndaj besëlidhjes (dmth., pendesa, besimi, bindja dhe qëndrueshmëria) janë çelësi për tek jeta e përjetshme.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 2:6-13

<sup>6</sup> Dhe ne flasim dituri në mes njerëzish të pjekur, por jo diturinë e kësaj kohe dhe as të pushtetarëve të kësaj kohe, që nuk arrin asgjë, <sup>7</sup> por flasim diturinë e Perëndisë të fshehur në mister, që Perëndia e kishte paracaktuar përpara kohërash për lavdinë tonë, <sup>8</sup> të cilën asnjë nga pushtetarët e kësaj kohe nuk e ka njohur; sepse, po ta kishin njohur, nuk do të kishin kryqëzuar Zotin e lavdisë. <sup>9</sup> Por, sikurse është shkruar: “Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë.” <sup>10</sup> Po Perëndia na i ka zbuluar me anë të Frymës së tij, sepse Fryma heton çdo gjë, edhe të thellat e Perëndisë. <sup>11</sup> Sepse cili nga njerëzit, pra, njeh gjërat e njeriut, përveç se fryma e njeriut që është në të? Po kështu asnjëri s’i njeh gjërat e Perëndisë, përveç Fryma e Perëndisë. <sup>12</sup> Dhe ne nuk kemi marrë frymën e botës, por Frymën që vjen nga Perëndia, që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia. <sup>13</sup> Për këto edhe flasim, por jo me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por të mësuara nga Fryma e Shenjtë, duke i krahasuar gjëra frymërore me fjalë frymërore.

2:6 “Dhe ne flasim dituri në mes njerëzish të pjekur” Pali mund të jetë

1. Duke përdorur sarkazmën këtu në lidhje me mbivlerësimin e korintasve ndaj urtësisë njerëzore dhe pikëpamjes së vetë atyre për “pjekurinë” e tyre (shih George E. Ladd, *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], fq. 383-385)
2. Kjo mund të lidhet me besimtarët e rinj të 1 Kor. 3:1-4 të cilët Pali i lidh me frymën përçarëse të botës në kishë
3. Tek Efe. 4:13 vetë ky term, *teleios*, përshkruan besimtarët e pjekur kundër fëmijëve (dmth., fjalë për fjalë “foshnje” Efe. 4:14). Vini re gjithashtu 14:20; Fil. 3:15 dhe Heb. 5:14

Vini re se si fjala përdoret tek hebrenjtë nga Tema e Veçantë më poshtë.

#### TEMË E VEÇANTË: FUND OSE PLOTË (*TELOS*) [SPECIAL TOPIC: END OR FULL (*TELOS*)]

Ky kulmim i gjerave frymore është një temë e përsëritur tek Hebrenjtë.

1. *telos* fund, përmbushje (Heb. 3:6,14; 6:8,11)
  2. *teleiōo*, “të bësh të përkryer”
    - a. (Jezusi) për të bërë të përkryer autorin e shpëtimit të tyre përmes vuajtjeve (shih Heb. 2:10)
    - b. (Jezusi) i bërë i përkryer përmes vuajtjeve (shih Heb. 5:8-9)
    - c. Ligji nuk bëri asgjë të përkryer (shih Heb. 7:19)
    - d. Një Bir, i bërë i përkryer përjetë (shih Heb. 7:28)
    - e. Të bësh adhuresin të përkryer (shih Heb. 9:9)
    - f. Të bësh të përkryer ata që afrohen (shih Heb.10:1)
    - g. Ai ka bërë të përkryer për të gjitha kohët ata që shenjtërohen (shih Heb. 10:14)
    - h. Përvec nesh, ata nuk duhet të bëhen të përkryer (shih Heb. 11:40)
    - i. Fryma e njerëzve të drejtë është bërë e përkryer (shih Heb. 12:23)
  3. *teleios*, i pjekuri (shih Heb. 5:14)
  4. *teleios*, tabernakulli më i përkryer (shih Heb. 9:11)
  5. *teleiotēs*, të ngulmsh në pjekuri (shih Heb. 6:1)
  6. *teleiōsis*, nëse përsosmëria vinte përmes priftërinjve levitikë (shih Heb. 7:11)
  7. *teleiōtēs*, autori dhe përkryesi / plotësonjësi i besimit tonë (shih Heb. 12:2)
- Jezusi sjell pjekurinë dhe plotësinë që Besëlidhja me Moisiun nuk mund ta bënte kurrë!

▣ **“jo diturinë e kësaj kohe”** Ky është Pali teksa pranon konceptin ndërbiblik hebraik të dy epokave: epoka aktuale e ligë, e dominuar nga njerëzimi i rënë, dhe epoka e drejtësisë e cila do të vijë, e dominuar nga Mesia. Urtësia njerëzore e botës është në thelb e bazuar mbi supozime dhe ndryshon nga kultura në kulturë dhe nga periudha në periudhë. Shih Temën e Veçantë mbi konceptet e dy epokave hebraike tek 1 Kor. 1:20.

▣ **“dhe as të pushtetarëve të kësaj kohe”** Është e mundur që kjo frazë t’i referohet gradave engjëllore ose amshimeve gnostike (shih Rom. 8:38-39; Efe. 1:21; 3:10; 6:12; Kol. 1:16; 2:10,15, BAGD, fq. 114, nr.3; F. F. Bruce, *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve], fq. 90). Ajo duket më shumë në linjë me këtë kontekst për t’i interpretuar ata si drejtues njerëzorë (shih 1 Kor. 2:8; Veprat e Apo. 3:17; Rom. 13:1-2; shih Grant Osborne, *The Hermeneutical Spiral* [Spiralja Hermeneutike], fq. 82-83). Është kaq e vështirë të kuptosh nëse Pali po flet për llogjikën njerëzore apo për veprimtarinë djallëzore që fshihet pas llogjikës njerëzore; të dyja janë të pranishme. Njerëzit ndikohen për shkak të gjendjes së tyre të rënë (shih Rom. 12:2; Gal. 1:14; Efe. 2:2), por ata gjithashtu ndikohen nga prania e të ligut të mbinaturshëm (dmth., engjëllor dhe djallëzor, shih 2 Kor. 4:4; Dan. 10).

**NASB** “që po kalojnë”  
**NKJV** “që nuk arrin asgjë”  
**NRSV** “që janë të dënuar të humbasin”  
**TEV** “fuqitë që humbasin fuqinë e tyre”  
**NJB** “që nuk do të zgjasin shumë tani”

Kjo është një formë pjesore pasive e tashme e termit i cili nënkupton “të bëhët i papërdorshëm” (shih 1 Kor. 1:28; Rom. 6:6). Pali përdor këtë term njëzet e shtatë herë. Nëse kjo i referohet autoriteteve njerëzore, ato do të vdesin. Nëse kjo i referohet autoriteteve engjëllore, kjo epokë do të kalojë në epokën e re të drejtësisë. Shih Temën e Veçantë: Pa forcë ligjore (*Katargeō*) tek 1 Kor. 1:28.

**2:7 “por”** Kjo është një formë kundërshtuese “*alla*”. Urtësia dhe fuqia e Palit ishin nga Perëndia.

▣ **“diturinë e Perëndisë të fshehur në mister”** Kjo urtësi është nga Perëndia (dmth., *Theos* vendoset i pari, në tekstin grek për të vendosur theksin); kjo është urtësi e fshehur (dmth., formë pjesore pasive e përkryer, shih Efe. 3:9); ky mister tani është manifestuar qartazi në Krishtin (shih Rom. 16:25; Efe. 3:3-5; Kol. 1:26). Ky sekret i pazbuluar (dmth., ungjilli) thekson zbuluesin e Perëndisë përkundëjt zbulimit njerëzor (shih Rom. 16:25-26; Efe. 1:9-10; 3:3-5; Kol. 1:26; 2:2-3). Përkufizimi më gjithëpërfshirës i këtij misteri është se hebrenjtë dhe johebrenjtë janë bashkuar në një popull të ri të Perëndisë (dmth., kisha, shih Efe. 2:11:-3:13). Shih Temën e Veçantë: Mister tek 1 Kor. 2:1.

**NASB** “që Perëndia e paracaktoi”  
**NKJV** “që Perëndia e vendosi”  
**NRSV** “që Perëndia e dekretoi”  
**TEV** “atë që ai e kishte zgjedhur tanimë”  
**NJB** “që Perëndia e paracaktoi”

Edhe përpara krijimit Perëndia tashmë kishte planin e Tij të shpengimit (shih Mat. 25:34; Gjoni 17:24; Efe. 1:4; 1 Pjet. 1:20; Zbu. 13:8 dhe gjithashtu Veprat e Apo. 2:13; 3:18; 4:28; 13:29). Termi i përkthyer këtu “paracaktoi” është një fjalë e përbërë e parafjalës “para” dhe “vendos kufij” (shih Veprat e Apo. Rom. 8:29,30; Efe. 1:5,11). Pasazhet përfundimtare mbi paracaktimin në Dhjatën e Re janë Rom. 8:28-30; Rom. 9; dhe Efe. 1:3-14. Këto tekste dukshëm theksojnë se Perëndia është Sovran. Ai ka nën kontroll të gjitha gjërat, duke përfshirë edhe historinë njerëzore. Gjendet një plan për shpengim hyjnor i paravendosur i cili po vihet në zbatim në kohën e vet. Megjithatë, ky plan nuk është arbitrar apo selektiv. Ai bazohet jo vetëm në sovranitetin dhe paranjohurinë e Perëndisë, por gjithashtu në karakterin e Tij të pandryshueshëm të dashurisë, mëshirës dhe hirit të pamerituar. Ne duhet të bëjmë kujdes me individualizmin tonë perëndimor ose me zellin tonë ungjillizues që të mos i japim ngjyra kësaj të vërtete të mrekullueshme. Ne duhet gjithashtu të bëjmë kujdes që të mos polarizohemi në konfliktet historike e teologjike midis Agustinit dhe Pelegit apo Kalvinit dhe Arminianismit.

Paracaktimi nuk është një doktrinë e nënkuptuar për të kufizuar dashurinë, hirin apo mëshirën e Perëndisë, as për të përjashtuar disa nga ungjilli. Ai ka për qëllim të forcojë besimtarët duke iu dhënë formë botëkuptimit të tyre. Dashuria e Perëndisë është për gjithë njerëzimin (shih 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9). Perëndia ka nën kontroll gjithçka. Kush ose çfarë mund të na ndajë ne nga Ai (shih Rom. 8:31-39)?

Paracaktimi formon një nga dy mënyrat për ta parë jetën. Perëndia e sheh gjithë historinë si të tashme; njerëzit janë të lidhur ndaj kohës. Perspektiva jonë dhe aftësitë tona mendore janë të kufizuara. Nuk ka asnjë kontraditë midis sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë të njerëzimit. Është një strukturë mbi bazë besëlidhjeje. Ky është një shembull tjetër i së vërtetës biblike e dhënë në dyshe paradoksikale, dialektike dhe të mbushura me tension. Doktrinat biblike prezantohen nga perspektiva të ndryshme. Ato shpesh shfaqen paradoksikale. E vërteta është një ekuilibër midis dysheve në dukje të kundërta. Ne nuk duhet të heqim tensionin duke zgjedhur njërin nga të vërtetat. Ne nuk duhet të izolojmë ndonjë të vërtetë biblike në një ndarje në vetvete.

Gjithashtu, është e rëndësishme të shtosh se qëllimi i të zgjedhurit nuk është vetëm qielli kur ne të vdesim, por një jetë në ngjashmëri me Krishtin tani (shih Efe. 1:4; 2:10)! Ne u zgjodhëm që të jemi “të shenjtë dhe të pamëkatë”. Perëndia zgjedh të na ndryshojë që të tjerët të mund të shohin ndryshimin dhe t’i përgjigjen Perëndisë me besim në Krishtin. Paracaktimi nuk është një privilegj personal, por një përgjegjësi mbi bazë besëlidhjeje! Ne shpëtohem për të shërbyer!

■ **“përpara kohërash”** Fraza “përpara kohërash” është një shprehje e Dhjatës së Vjetër që i referohet përjetësisë së kaluar. Ajo korrespondon me termin hebraik *'olam*, i cili mund të ketë kuptimin përjetësi, të shkuar ose të ardhme. Ai gjithashtu mund të përshkruajë një periudhë të kufizuar kohe. Ai duhet të përkthehet në kontekst. Përkthimi i tij lidhet me objektin e tij (dmth., Perëndia, premtimet e besëlidhjes në Dhjatën e Vjetër, jeta në tokë, të ligët etj.).

Kjo është gjithashtu e vërtetë për përkthimet greke të Dhjatës së Re *aiōn*, *aiōnios*, *eis ton aiōna*, të cilat ndjekin përkthimin e Septuagint-it të *'olam*. Perëndia është i përjetshëm, por gjërat fizike (dmth., qiejt dhe toka) do të kalojnë (shih 2 Pjet. 3:10). Sikurse me të gjitha fjalët, por veçanërisht me *'olam* dhe *aiōn*, konteksti është thelbësor dhe përcakton përkthimin.

Për diskutime interesante të “përjetësisë” shih *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër] të Robert B. Girdlestone, fq. 312-319 dhe *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve] të F. F. Bruce, fq. 202-203.

#### **TEMË E VEÇANTË: PËRJETË ('OLAM) [SPECIAL TOPIC: FOREVER ('OLAM)]**

Etimologjia e termit hebraik *'olam*, מלוע (BDB 761, KB 798) është i pasigurtë (NIDOTTE, vëll. 3, fq. 345). Ai përdoret në disa kuptime (zakonisht e përcaktuar nga konteksti). Më poshtë janë vetëm disa shembuj të zgjedhur.

1. Gjërat antike
  - a. Popujt, Zan. 6:4; 1 Sam. 27:8; Jer. 5:15; 28:8
  - b. Vendet, Isa. 58:12; 61:4
  - c. Perëndia, Ps. 93:2; Fjalët e Urta 8:23; Isa. 63:16
  - d. Gjërat, Zan. 49:26; Job 22:15; Ps. 24:7,9; Isa. 46:9
  - e. Koha, Ligji i Përt. 32:7; Isa. 51:9; 63:9,11
2. Koha e ardhme
  - a. Jeta e dikujt, Eksod. 21:6; Ligji i Përt. 15:17; 1 Sam. 1:22; 27:12
  - b. Hiperbola e respektit ndaj një mbreti, 1 Mbret. 1:31; Ps. 61:7; Neh. 2:3
  - c. Ekzistenca e vazhdueshme
    - 1) Toka, Ps. 78:69; 104:5; Pred. 1:4
    - 2) Qiejt, Ps. 148:5
  - d. Egzistenca e Perëndisë
    - 1) Zan. 21:33
    - 2) Eksod. 15:18
    - 3) Ligji i Përt. 32:40
    - 4) Ps. 93:2

- 5) Isa. 40:28
- 6) Jer. 10:10
- 7) Dan. 12:7
- e. Besëlidhja
  - 1) Zan. 9:12,16; 17:7,13,19
  - 2) Eksod. 31:16
  - 3) Lev. 24:8
  - 4) Num. 18:19
  - 5) 2 Sam. 23:5
  - 6) Ps. 105:10
  - 7) Isa. 24:5; 55:3; 61:8
  - 8) Jer. 32:40; 50:5
- f. Besëlidhje e veçantë me Davidin
  - 1) 2 Sam. 7:13,16,25,29; 22:51; 23:5
  - 2) 1 Mbret. 2:33,45; 9:5
  - 3) 2 Kro. 13:5
  - 4) Ps. 18:50; 89:4,28,36,37
  - 5) Isa. 9:7; 55:3
- g. Mesia i Perëndisë
  - 1) Ps. 45:2; 72:17; 89:35-36; 110:4
  - 2) Isa. 9:6
- h. Ligjet e Perëndisë
  - 1) Eksod. 29:28; 30:21
  - 2) Lev. 6:18,22; 7:34; 10:15; 24:9
  - 3) Num. 18:8,11,19
  - 4) Ps. 119:89,160
- i. Premtimet e Perëndisë
  - 1) 2 Sam. 7:13,16,25; 22:51
  - 2) 1 Mbret. 9:5
  - 3) Ps. 18:50
  - 4) Isa. 40:8
- j. Pasardhësit e Abrahamit dhe Toka e Premtuar
  - 1) Zan. 13:15; 17:19; 48:4
  - 2) Eksod. 32:13
  - 3) 1 Kro. 16:17
- k. Festime të besëlidhjes
  - 1) Eksod. 12:14,17,24
  - 2) Lev. 23:14,21,41
  - 3) Num. 10:8
- l. Përjetësi, kohëzgjatje
  - 1) 1 Mbret. 8:13
  - 2) Ps. 61:7-8; 77:8; 90:2; 103:17; 145:13
  - 3) Isa. 26:4; 45:17
  - 4) Dan. 9:24
- m. Çfarë thonë psalmet se do të bëjnë besimtarët përjetë
  - 1) falenderojnë, Ps. 30:12; 79:13
  - 2) qëndrojnë në praninë e Tij, Ps. 41:12; 61:4,7
  - 3) besojnë në mëshirën e Tij, Ps. 52:8
  - 4) lavdërojnë Zotin, Ps. 52:9
  - 5) këndojnë lavde, Ps. 61:8; 89:1
  - 6) shpallin drejtësinë e Tij, Ps. 75:7-9
  - 7) përlevdojnë emrin e Tij, Ps. 86:12; 145:2

- 8) bekojnë emrin e Tij, Ps. 145:1
- n. përdorur tek Isaia për të përshkruar epokën e re
  - 1) besëlidhje e përjetshme, Isa. 24:5; 55:3; 61:8
  - 2) YHWH një Shkëmb i përjetshëm, Isa. 26:4
  - 3) Gëzim i përjetshëm, Isa. 35:10; 51:11; 61:7
  - 4) Perëndia i Përjetshëm, Isa. 40:28
  - 5) Një shpëtim i përjetshëm, Isa. 45:17
  - 6) Një dashamirësi e përjetshme (Hesed), Isa. 54:8
  - 7) Një shenjë e përjetshme, Isa. 55:13
  - 8) Një emër i përjetshëm, Isa. 56:5; 63:12,16
  - 9) Një dritë e përjetshme, Isa. 60:19,20

Një përdorim i orientuar negativisht i lidhur me dënimin e përjetshëm të të këqijve gjendet tek Isa. 33:14, “një djegie e përjetshme”. Isaia shpesh përdor “zjarrin” për të përshkruar zemërimin e Perëndisë (shih Isa. 9:18,19; 10:16; 47:14), por vetëm tek Isa. 33:14 përshkruhet si “i përjetshëm”.

3. Si prapa ashtu edhe para në kohë (“nga përjetësia në përjetësi”)
  - a. Ps. 41:13 (lavdi Perëndisë)
  - b. Ps. 90:2 (Vetë Perëndia)
  - c. Ps. 103:17 (dashamirësia e Perëndisë)

Mbani mend, konteksti përcakton gjerësinë e përdorimit të termit. Besëlidhjet dhe premtimet e përjetshme janë kushtore (dmth., Jeremia 7, shih Temën e Veçantë: Besëlidhje / Special Topic: Covenant). Bëni kujdes që të mos lexoni pikëpamjen tuaj moderne të teologjisë tuaj sistematike të Dhjatës së Re në çdo përdorim të Dhjatës së Vjetër të kësaj fjale shumë fluide. Mbani mend gjithashtu premtimet e Dhjatës së Vjetër të universalizuara në Dhjatën e Re (shih Temën e Veçantë: Parashikime të Dhjatës së Vjetër të së Ardhmes përkundrejt Parashikimeve të Dhjatës së Re / Special Topic: OT Predictions of the Future vs. NT Predictions).

▣ “për lavdinë tone” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

### TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) [SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*)]

Koncepti biblik i “lavdisë” është i vështirë për t’u përkufizuar. LXX përdor *doxa* për të përkthyer mbi njëzetë fjalë në hebraisht. Ajo përdoret shumë herë për gjatë Dhjatës së Re në disa mënyra. Ajo përdoret për Perëndinë, Jezusin, njerëzit dhe Mbretërinë Mesianike.

Në Dhjatën e Vjetër fjala më e zakonshme hebraike për “lavdi” (*kabod*, BDB 458, KB 455-458) ishte fillimisht një term komercial i lidhur me peshoret (“të jesh i rëndë”, KB 455). Ajo që ishte e rëndë ishte e çmuar ose kishte vlerë të brendshme. Shpesh koncepti i shkëlqyeshmërisë i shtohet fjalës për të shprehur madhështinë e Perëndisë (shih Eksodi 19:16-18; 24:17; 33:18; Isa. 60:1-2). Vetëm Ai është i denjë dhe i nderueshëm (shih Ps. 24:7-10; 66:2; 79:9). Ai është tepër i shkëlqyeshëm për sytë e njerëzimit, ndaj Ai e vesh Vetveten në re, dorë ose tym (shih Eks. 16:7,10; 33:17-23; Isa. 6:5). YHWH mund të njihet me të vërtetë vetëm përmes Krishtit (shih Gjoni 1:18; 6:46; 12:45; 14:8-11; Kol.1:15; 1 Tim. 6:16; Heb. 1:3; 1 Gjoni 4:12).

Për një diskutim të plotë të *kabod*, shih Temën e Veçantë: Lavdi [Dhjata e Vjetër] / Special Topic: Glory [OT]). Lavdia e besimtarëve është se ata kuptojnë ungjillin dhe lavdinë në Perëndinë, jo në veten e tyre (shih 1 Kor. 1:29-31; Jer. 9:23-24). Për një diskutim të detajuar, shih NIDOTTE, vëll. 2, fq. 577-587.

**2:8 “nëse / po”** A. T. Robertson, tek *Word Pictures in the New Testament* [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re], fq. 85, e quan këtë një fjali kushtore të rendit të dytë të quajtur “kundërshtuese ndaj faktit”. Një pohim i gabuar bëhet për të theksuar një konkluzion të gabuar: “Nëse sunduesit e kësaj epoqe do ta kishin kuptuar

(dmth., formë treguese aktive e përkryer), gjë të cilën ata nuk e kanë bërë, atëherë ata nuk do ta kishin kryqëzuar (dmth., formë treguese aktive aoriste) Zotin e lavdisë, gjë të cilën ata e bënë.”

■ **“Zotin e lavdisë”** Kjo frazë përdoret për YHWH tek Veprat e Apo. 7:2; Efe. 1:17 dhe ndoshta është një aludim ndaj Eksod. 24:16. Një frazë e ngjashme përdoret për Jezusin tek Jakobi 2:1. Ky është një tjetër shembull i autorëve të Dhjatës së Re teksa përdorin një titull të YHWH për Jezusin dhe, në këtë mënyrë, pranojnë barazinë e Tij me YHWH (shih 2 Kor. 4:6).

## TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY)

### A. *El* (BDB 42, KB 48)

1. Kuptimi fillestar i këtij termi të përgjithshëm e të lashtë për Perëndinë është i pasigurtë, ndonëse shumë studiues besojnë se vjen nga rrënja akadiane “jam i fortë”, ose “jam i fuqishëm” (shih Zan. 17:1; Num. 23:19; Ligji i Përt. 7:21; Psa. 50:1).
2. Në panteonin kanaanit, perëndia i lartë është *El* (tekstet e Ras Shamras), i quajtur “ati i perëndive” dhe “zot i qiellit”
3. Në Bibël, zakonisht, *El* shoqërohet me terma të tjerë. Këto kombinime u bënë një mënyrë për të karakterizuar Perëndinë.
  - a. *El-Elyon* (“Perëndia Shumë i Lartë”, BDB 42 & 751 II), Zan. 14:18-22; Ligji i Përt. 32:8; Isa. 14:14
  - b. *El-Roi* (“Perëndia që sheh”, ose “Perëndia që zbulon veten”, BDB 42 & 909), Zan. 16:13
  - c. *El-Shaddai* (“Perëndia i Gjithëfuqishëm”, ose “Perëndia i Gjithëmëshirshëm”, ose “Perëndia i malit”, BDB 42 & 994), Zan. 17:1; 35:11; 43:14; 49:25; Eks. 6:3
  - d. *El-Olam* (“Perëndia i Përjetshëm”, BDB 42 & 761), Zan. 21:33. Ky term lidhet nga ana teologjike me premtimin e Perëndisë për Davidin, 2 Sam. 7:13, 16
  - e. *El-Berit* (“Perëndia i Besëlidhjes”, BDB 42 & 136), Gjyq. 9:46
4. *El* barazohet me
  - a. YHWH, në Num. 23:8; Ps. 16:1-2; 85:8; Isa. 42:5
  - b. *Elohim* në Zan. 46:3; Jobi 5:8, “Unë jam *El*, *Elohim* i atit tuaj”
  - c. *Shaddai*, në Zan. 49:25; Num. 24:4,16
  - d. “xhelozinë”, në Eks. 34:14; Ligji i Përt. 4:24; 5:9; 6:15
  - e. “mëshirën” në Ligji i Përt. 4:31; Neh. 9:31;
  - f. “i madh dhe i mahnitshëm” në Ligji i Përt. 7:21; 10:17; Neh. 1:5; 9:31; Dan. 9:4
  - g. “njohurinë”, në 1 Sam. 2:3
  - h. “streha ime e fuqishme”, në 2 Sam. 22:33
  - i. “hakmarrësi im”, në 2 Sam. 22:48
  - j. “i shenjti”, në Isa. 5:16
  - k. “fuqi”, në Isa. 10:21
    - l. “shpëtimi im”, në Isa. 12:2
  - m. “i madh dhe i fuqishëm”, në Jer. 32:18
  - n. “shpagim”, në Jer. 51:56
5. Një kombinim i të gjithë emrave kryesore të Perëndisë në Dhjatën e Vjetër gjendet në Jozueu 22:22 (*El*, *Elohim*, *YHWH*, të përsëritur)

### B. *Elyon* (BDB 751, KB 832)

1. Kuptimi bazë i kësaj fjale është “i lartë”, “i lartësuar”, ose “i ngritur lart” (shih Zan. 40:17; 1 Mbret. 9:8; 2 Mbret. 18:17; Neh. 3:25; Jer. 20:2; 36:10; Psa. 18:13).
2. Përdoret në kuptim paralel me disa emra/tituj të tjerë të Perëndisë.
  - a. *Elohim* – Ps. 47:1-2; 73:11; 107:11
  - b. *YHWH* – Zan. 14:22; 2 Sam. 22:14
  - c. *El-Shaddai* – Psa. 91:1, 9
  - d. *El* – Num. 24:16

e. *Elah* – përdoret shpesh te Danieli 2-6 dhe Esdra 4-7, lidhur me *illair* (aramaisht, “Perëndia i Lartë”), te Dan. 3:26; 4:2; 5:18, 21

3. Përdoret shpesh nga johebrenjtë.

a. Melkizedeku, Zan. 14:18-22

b. Balaami, Num. 24:15

c. Moisiu, që u flet kombeve te Ligji i Përt. 32:8

d. Ungjilli i Lukës në Dhjatën e Re, që u shkruhet johebrenjve, përdor ekuivalentin grek *Hupsistos* (shih 1:32, 35, 76; 6:35; 8:28; Veprat e Apo. 7:48; 16:17)

C. *Elohim* (SHUMËS), *Eloah* (NJËJËS), që përdoren kryesisht në poezi (BDB 43, KB 52)

1. Ky term nuk gjendet jashtë Dhjatës së Vjetër.

2. Kjo fjalë mund të nënkuptojë Perëndinë e Izraelit ose perënditë e kombeve (shih Eks. 3:6; 20:3). Familja e Abrahamit ishte politeiste (shih Joz. 24:2).

3. Mund t’u referohet gjyqtarëve të Izraelit (shih Eks. 21:6; Psa. 82:6).

4. Termi *elohim* përdoret edhe për qenie të tjera shpirtërore (engjëjt, demonët), si te Ligji i Përt. 32:8 (LXX) Psa. 8:5; Jobi 1:6; 38:7.

5. Në Bibël, ky është emri/titulli i parë i Hyjnisë (shih Zan. 1:1). Është i vetmi që përdoret deri te Zan. 2:4, ku kombinohet me YHWH. Në thelb, nga ana teologjike, nënkupton Perëndinë si krijues, ruajtës dhe sigures i gjithë jetës në këtë planet (shih Psalmi 104). Është sinonim me *El* (shih Ligji i Përt. 32:15-19). Mund të jetë edhe term paralel me YHWH, si Psalmi 14 (*Elohim*, v. 1, 2, 5; YHWH, v. 2, 6; madje *Adon*, v.4)

6. Ndonëse SHUMËSI mund të përdoret edhe për perënditë e tjera, shpesh, ky term nënkupton Perëndinë e Izraelit, por zakonisht ajo që tregon kuptimin monoteist është FOLJA në NJËJËS (shih Temën e Veçantë: Monoteizëm / Special Topic: Monotheism)

7. Është e çuditshme që një emër i zakonshëm i Perëndisë monoteiste të Izraelit është në SHUMËS (gjithashtu vër re “ne” tek Zan. 1:26; 3:22; 11:7)! Ndonëse nuk ka siguri, këto janë teoritë.

a. Hebraishtja ka shumë SHUMËSA, që shpesh përdoren për theksim. E lidhur ngushtë me këtë është një veçori e mëvonshme gramatikore e hebraishtes, që quhet “shumësi i madhështisë”, ku SHUMËSI përdoret për të përforcuar një koncept.

b. Kjo mund t’i referohet këshillit të engjëjve, me të cilët Perëndia takohet në qiell dhe të cilët bëjnë vullnetin e Tij (shih 1 Mbret. 22:19-23; Jobi 1:6; Psa. 82:1; 89:5, 7).

c. Madje, është e mundur që kjo të reflektojë zbuluesën në Dhjatën e Re e të një Perëndie në tre persona. Te Zan. 1:1, Perëndia krijon; Zan. 1:2, Fryma rri mbi ujërat, dhe, nga Dhjata e Re, Jezusi është vepruesi i krijimit të Atit Perëndi (shih Gjoni 1:3, 1 Rom. 11:36; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2; 2:10).

D. YHWH (BDB 217, KB 394)

1. Ky është emri që reflekton Hyjninë si Perëndia që bën besëlidhje; Perëndia si shpëtimtar, shpengues! Njerëzit i thyjnë besëlidhjet, kurse Perëndia është besnik ndaj fjalës, premtimit, besëlidhjes së vet (shih Psalmi 103). Ky emër përmendet për herë të parë në kombinim me *Elohim* në Zan. 2:4. Te Zan. 1-2 nuk gjenden dy rrëfime të krijimit, por dy theksime të tij:

a. Perëndia si krijuesi i universit (fizikja, Psalmi 104)

b. Perëndia si krijuesi i veçantë i njerëzimit (Psalmi 103)

Zanafilla 2:4-3:24 nis zbuluesën e veçantë për pozicionin dhe synimin e privilegjuar të njerëzimit, si dhe për problemin e mëkatit dhe rebelimit që shoqërojnë këtë pozitë unike.

2. Në Zan. 4:26, thuhet se “njerëzit filluan t’i bënin thirrje emrit të ZOTIT” (YHWH).

Mirëpo Eks. 6:3 nënkupton se populli i hershëm i besëlidhjes (patriarkët dhe familjet e tyre) e njihnin Perëndinë vetëm si *El-Shaddai*. Emri YHWH shpjegohet vetëm një herë në Eks. 3:13-16, sidomos në v. 14. Megjithatë, shkrimet e Moisiut shpesh i interpretojnë fjalët me lojëra të njohura fjalësh, jo me etimologji (shih Zan. 17:5; 27:36; 29:13-35). Ka patur disa teori për kuptimin e këtij emri (marrë nga IDB, vëll. 2 f. 409-11).



- a. nga një rrënjë fjale arabisht, “tregoj dashuri të zjarrtë”
  - b. nga një rrënjë fjale arabisht, “fryj” (YHWH si Perëndia i furtunës)
  - c. nga një rrënjë fjale ugarite (kanaanite), “flas”
  - d. nga një mbishkrim fenikas, një PJESORE SHKAKORE që do të thotë “Ai që mban”, ose “Ai që themelon”
  - e. nga forma *Qal* në hebraisht, “Ai që është”, ose “Ai që është i pranishëm” (në kuptimin e ardhshëm, “Ai që do të jetë”)
  - f. nga forma *Hiphil* në hebraisht, “Ai që bën të jetë”
  - g. nga rrënja e fjalës hebraisht “jetoj” (p.sh. Zan. 3:21), që do të thotë “Ai që është i vetmi që jeton dhe që jeton gjithmonë”
  - h. nga konteksti i Eks. 3:13-16, një lojë fjalësh me formën E PAKRYER të përdorur në një kuptim TË KRYER, “Unë do të vazhdoj të jem ai që isha”, ose “do të vazhdoj të jem ai që kam qenë gjithmonë” (shih J. Wash Watts, *A Survey of Syntax in the Old Testament* [Një Anketë e Sintaksës në Dhjatën e Vjetër], f. 67). Emri i plotë YHWH shpesh shprehet në formë të shkurtuar, ose, mundësisht, në një formë fillestare.
    - 1) *Yah* (p.sh. Halelu – yah, BDB 219, shih Eks. 15:2; 17:16; Psa. 89:8; 104:35)
    - 2) *Yahu* (fondi i emrave me “iah”, p.sh., Isaia)
    - 3) *Yo* (emrat që fillojnë me “Jo”, p.sh., Jozueu ose Joeli)
3. Në judaizmin e mëvonshëm, ky emër i besëlidhjes u bë kaq i shenjtë (tetragramatoni), sa që judenjtë druheshin ta përdornin se mos shkelnin urdhrin e Eks. 20:7; Ligji i Përt. 5:11; 6:13. Kështu, ata e zëvendësuan me termin hebraisht “pronar”, “zotëri”, “bashkëshort”, “zot” – *adon* ose *adonai* (zoti im). Kur vinin te fjala YHWH në leximin e pasazheve të Dhjatës së Vjetër, ata shqiptonin “zot”. Ja pse YHWH shkruhet me të mëdha ZOT në përkthimet tona.
4. Si në rastin e *El-it*, edhe YHWH shpesh kombinohet me terma të tjerë për të theksuar disa karakteristika të Perëndisë së Besëlidhjes me Izraelin. Ndonëse ka shumë terma të mundshëm për këto kombinime, ja disa prej tyre.
- a. *YHWH – Yire* (YHWH do të sigurojë, BDB 217 & 906), Zan. 22:14
  - b. *YHWH – Rophekha* (YHWH është shëruesi yt, BDB 217 & 950, PJESORJA *Qal*), Eks. 15:26
  - c. *YHWH – Nissi* (YHWH është flamuri im, BDB 217 & 651), Eks. 17:15
  - d. *YHWH – Meqaddishkem* (YHWH, Ai që të shenjtëron, BDB 217 & 872, PJESORE *Piel*), Eks. 31:13
  - e. *YHWH – Shalom* (YHWH është Paqe, BDB 217 & 1022), Gjyq. 6:24
  - f. *YHWH – Sabbaoth* (YHWH i ushtrive, BDB 217 & 878), 1 Sam. 1:3, 11; 4:4; 15:2; shpesh në Profetët
  - g. *YHWH – Ro’I* (YHWH është bariu im, BDB 217 & 944, PJESORE *Qal*), Psa. 23:1
  - h. *YHWH – Sidqenu* (YHWH është drejtësia jonë, BDB 217 & 841), Jer. 23:6
  - i. *YHWH – Shammah* (YHWH është aty, BDB 217 & 1027), Ezek. 48:35

**2:9 “është shkruar”** Kjo është një shprehje hebraike (dmth., një formë treguese pasive e përkryer) për të prezantuar një citim të Dhjatës së Vjetër. Klementi i Romës (dmth., Letra e Parë e Klementit ndaj Korintasve XXXIV), shkruar në vitin 95 pas Krishtit, thotë se është një citim nga Septuaginta i Isa. 64:4 ose ndoshta i kombinuar me 65:17 (shih Isa. 52:15 dhe Jer. 3:16). Origen dhe Jerome mendonin se Pali po citonte një nga librat jokanonikë të quajtur *Apocalypse of Elijah* [Apokalipsi i Elias], i cili pothuajse është humbur. E vërteta është se ky citim / aludim nuk i përshtatet asnjë teksti të Dhjatës së Vjetër (e njëjta gjë është e vërtetë për Mat. 2:23; Gjonin 7:38; Jakobin 4:5).

Perëndia ka vepruar në mënyra të tilla që qëniet njerëzore nuk mund t’i kishin imagjinuar kurrë (shih Isa. 55:8-9), por tani përmes unguillit dhe Frymës ata mundën me anë të besimit! Çfarë premtimi i mrekullueshëm!

▣ “zemër” Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 14:25.

**2:10 “Po Perëndia na i ka zbuluar me anë të Frymës së tij”** Ati, përmes Frymës, ka zbuluar (dmth., *apokaluptō*, formë treguese aktive aoriste) këtë mister të fshehur në Krishtin. E gjithë urtësia është në Krishtin (shih 1 Kor. 1:18-25,30).

Vini re Perëndinë tre në një tek 1 Kor. 2:8-10: Zoti i lavdisë i kryqëzuar (dmth., Jezusi), Perëndia (dmth., Ati) dhe Fryma.

### TEMË E VEÇANTË: TRINIA (SPECIAL TOPIC: THE TRINITY)

Vini re veprimtarinë e të tre Personave të Trinisë në kontekste të bashkuara. Termi “trini”, i shpikur së pari nga Tertuliani, nuk është fjalë biblike, por koncepti i saj shfaqet kudo.

- A. Ungjijtë
  - 1. Mat. 3:16-17; 28:19 (dhe paralelet e saj)
  - 2. Gjoni 14:26
- B. Veprat e Apostujve – Veprat e Apo. 2:32-33, 38-39
- C. Pali
  - 1. Rom. 1:4-5; 5:1,5; 8:1-4,8-10
  - 2. 1 Kor. 2:8-10; 12:4-6
  - 3. 2 Kor. 1:21-22; 13:14
  - 4. Gal. 4:4-6
  - 5. Efe. 1:3-14,17; 2:18; 3:14-17; 4:4-6
  - 6. 1 Thes. 1:2-5
  - 7. 2 Thes. 2:13
  - 8. Titi 3:4-6
- D. Pjetri – 1 Pjet. 1:2
- E. Juda – v. 20-21

Në Dhjatën e Vjetër, aludohet për një shumësi personash në Perëndinë.

- A. Përdorimi i SHUMËSIT për Perëndinë
  - 1. Emri *Elohim* është SHUMËS (shih Temë e Veçantë: Emra për Hyjësinë / Special Topic: Names for Deity), por kur përdoret për Perëndinë ka gjithmonë një FOLJE në NJËJËS
  - 2. “Ne” te Zanafilla 1:26-27; 3:22; 11:7
- B. Engjëlli i Zotit (shih Temën e Veçantë: Engjëlli i Zotit / Special Topic: The Angel of the Lord) ishte përfaqësues i dukshëm i Hyjnisë
  - 1. Zanafilla 16:7-13; 22:11-15; 31:11,13; 48:15-16
  - 2. Eksodi 3:2,4; 13:21; 14:19
  - 3. Gjyqtarët 2:1; 6:22-23; 13:3-22
  - 4. Zakaria 3:1-2
- C. Perëndia dhe Fryma e Tij janë të veçantë, Zan. 1:1-2; Ps. 104:30; Isa. 63:9-11; Ezek. 37:13-14
- D. Perëndia (YHWH) dhe Mesia (*Adon*) janë të veçantë, Psa. 45:6-7; 110:1; Zak. 2:8-11; 10:9-12
- E. Mesia dhe Fryma janë të veçantë, Zak. 12:10
- F. Të tre përmenden te Isa. 48:16; 61:1

Natyrë hyjnore e Jezusit dhe personaliteti i Frymës shkaktonin probleme për besimtarët e hershëm që ishin monoteistë të rreptë (shih Temën e Veçantë: Monoteizëm / Special Topic: Monotheism).

- 1. Tertuliani – ia nënshtroi Birin Atit
- 2. Origeni – nënshtroi esencën hyjnore të Birit dhe të Frymës
- 3. Ari – mohoi natyrën hyjnore të Birit dhe të Frymës
- 4. Monarkianizmi – besonte në shfaqjen e njëpasnjëshme të të njëjtit Perëndi si At’, si Bir dhe, pastaj, si Frymë

- Trinia është një formulim i zhvilluar nga ana historike, por i informuar nga materiali biblik
1. Natyra e plotë hyjnore e Jezusit, i barabartë me Atin, gjë që u pohua në vitin 325 pas Krishtit nga Këshilli i Nikesë (shih Gjoni 1:1; Fil. 2:6; Titi 2:13)
  2. Personaliteti dhe natyra e plotë hyjnore e Frymës, i barabartë me Atin dhe me Birin, u pohua nga Këshilli i Kostandinopojës (viti 381 pas Krishtit)
  3. Doktrina e Trinisë shprehet në mënyrë të plotë në veprën e Augustinit *De Trinitate*

Këtu kemi vërtet një mister. Por Dhjata e Re duket se pohon një esencë të vetme hyjnore me tre shfaqje të përbërë personale (At, Bir dhe Frymë).

- **“sepse Fryma heton çdo gjë, edhe të thellat e Perëndisë”** Theksi këtu është mbi personalitetin e plotë të Frymës (shih Isa. 63:10; Efe. 4:30). Fryma është e vetmja mënyrë që kemi për të njohur Perëndinë (shih Rom. 8:26-27; 11:33-36). Ky është theksi i vazhdueshëm i të gjithë kontekstit që mënyrat njerëzore janë të pamundura të njohin Perëndinë apo gjërat (dmth., planet) e Perëndisë. “Të thellat” është një metaforë e asaj që është (1) e thellë dhe jo e cekët ose (2) e fshehur përtej asaj që mund të arrijë apo zbulojë njerëzimi. Vepra e Frymës është thelbësore për bindje, shpëtim dhe një jetë si e Krishtit (shih Gjoni 16:7-14).
- Fraza “gjërat e thella të Perëndisë” (NKJV) mund të kenë qënë një frazë tipike e një nga grupeve në Korint. Gjërat e thella të Perëndisë janë të arritshme për të gjithë që kanë besim në Krishtin. Nuk ka më sekrete të fshehura. Ungjilli zbulohet ndaj të gjithë atyre që e marrin. Nuk ka “gjëra më të thella”, nuk ka ndarje në elitë, nuk ka përjashtim!
- Kjo siguri e mrekullueshme e kujdesit dhe sigurimit të Perëndisë u shfrytëzua nga gnostikët e mëvonshëm, të cilët e deklaruar si një tekst provë për njohuri të veçantë (dmth., libri jokanonik dhe gnostik i *Ascension of Isaiah* [Ngjitja e Isaias]).

#### **TEMË E VEÇANTË: PERSONALITETI I FRYMËS (SPECIAL TOPIC: THE PERSONHOOD OF THE SPIRIT)**

Në Dhjatën e Vjetër, “Fryma e Perëndisë” (pra, *ruach*) ishte një forcë që përmbushte synimin e YHWH-së, por nuk na aludohet se ai ishte person (pra, në monoteizmin e Dhjatës së Vjetër, shih Temën e Veçantë: Monoteizëm / Special Topic: Monotheism). Mirëpo, në Dhjatën e Re, dokumentohet personaliteti i plotë i Frymës.

1. Ai mund të shahet (shih Mat. 12:31; Marku 3:29)
2. Mëson të tjerët (shih Luka 12:12; Gjoni 14:26)
3. Dëshmon (shih Gjoni 15:26)
4. Bind, drejton (shih Gjoni 16:7-15)
5. Quhet “dikush” (pra, *hos*, shih Efe. 1:14)
6. Mund të trishtohet (shih Efe. 4:30)
7. Mund të shuhet (shih 1 Thes. 5:19)
8. Mund të kundërshtohet (shih Veprat e Apo. 7:51)
9. Mbron besimtarët si avokat (shih Gjoni 14:26; 15:26; 16:7)
10. Përlëvdon Birin (shih Gjoni 16:14)

Edhe pasazhet trinitare (këtu janë tre nga shumë, shih Temën e Veçantë: Trinia / Special Topic: The Trinity) flasin për tre persona.

1. Mat. 28:19
2. 2 Kor. 13:14
3. 1 Pjet. 1:2

Ndonëse në greqisht fjala “frymë” (*pneuma*) është në gjininë ASNJANËSE, kur bëhet fjalë për

Frymën, Dhjata e Re shpesh përdor PERËMRIN VETOR MASHKULLOR (shih Gjoni 16:8, 13-14). Fryma lidhet me veprimtarinë njerëzore.

1. Veprat e Apo. 15:28
2. Rom. 8:26
3. 1 Kor. 12:11
4. Efe. 4:30

Roli i Frymës theksohet që në fillim të Veprave të Apostujve (njësoj si në ungjillin e Gjonit). Dita e Rrëshajave nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Jezusi kishte gjithmonë Frymën. Pagëzimi i tij nuk ishte fillimi i punës së Frymës, por një kapitull i ri. Fryma është mjeti i efektshëm i synimit të Atit për rimëkëmbjen e Atit të të gjithë njerëzve të krijuar në shëmbëllimin e Tij (shih Temën e Veçantë: Plani i përjetshëm shpengues i YHWH / Special Topic: YHWH's Eternal Redemptive Plan)!

**2:11-12** Ky është një shembull i së vërtetës të shprehur më parë. Vini re se përdorimi i parë dhe i tretë i “frymës” në këtë varg kanë një “f” të vogël, ndërsa përdorimi i dytë i “Frymës” ka një “F” të madhe. Në tekstin grek nuk ka asnjë mënyrë për të dalluar shkronjat e mëdha, prandaj, ky është interpretim i përkthyesve. Një shkronjë e madhe “F” i referohet Frymës së Shenjtë dhe një shkronjë e vogël “f” i referohet frymës së njeriut (shih 1 Kor. 6:18; Rom. 8:16; 2 Kor. 2:13; 7:13; 12:18; Gal. 6:18; Fil. 4:23). Ky mund të jetë një aludim ndaj Pro. 20:27.

**2:12 “frymën e botës”** ky është një tjetër konotacion i termit *kosmos* (dmth., botë, shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:21b-22), shoqëria njerëzore organizohet dhe funksionon pa Perëndinë (një gjë mjaft e zakonshme në shkrimet e Gjonit). Sot ne do e quanim këtë “humanizëm ateist” (shih 1 Kor. 2:6). Ai gjithashtu quhet “fryma e skllavërisë” tek Rom. 8:15.

■ **“që të njohim gjërat që na janë dhuruar falas nga Perëndia”** Besimtarët mund të kuptojnë ungjillin e Krishtit dhe bekimet e tyre në Të vetëm përmes Frymës së Shenjtë.

Është sigurisht e vërtetë që në gjendjen e tyre të rënë dhe të përkohshme, as besimtarët nuk mund të njohin Perëndinë plotësisht dhe tërësisht, por mund të njohin dhe të kuptojnë çdo gjë që ju nevojitet për shpëtimin dhe jetën e perëndishme përmes zbulësës së Atit, personit dhe veprës së Birit dhe ndriçimit nga Fryma. Fakti që ne nuk njohim çdo gjë nuk është asnjë justifikim që të mos përqafojmë të vërtetat e qarta të Biblës dhe të ecim në to. Është gjithashtu thelbësore që besimtarët të pranojnë se urtësia e Perëndisë na është “dhënë falas” (shih Rom. 8:32). Ajo është një dhuratë nga Perëndia, dhuratë të cilën Ai dëshiron t’ua japë të gjithë njerëzve të krijuar në shëmbëlltërinë e Tij (shih Zan. 1:26-27), por që tani përmes rebelimit janë të ndarë prej Tij (shih Zanafilla 3). Urtësia e Perëndisë nuk është rezultat i njohurisë njerëzore, statusit shoqëror apo gjenialitetit, por është zbulësia e dashurisë dhe mëshirës së Perëndisë përmes veprës së Krishtit dhe ndërmjetësimit të Frymës. Që prej kohës së Krishtit, injoranca është diçka që mund të zgjidhet me paramendim! Fryma e Shenjtë na jep dritë, të vërtetë dhe shpëtim. Fryma e kësaj bote jep errësi, mashtrim dhe vdekje.

**2:13 “Për këto edhe flasim”** Është thelbësore që besimtarët të ndajnë këto të vërteta të dhëna nga Perëndia. Ato janë jetë dhe dritë për një botë të humbur dhe që po vdes, një botë që është në të vërtetë e dashur dhe është shpenguar vetëm sikur të pranonin Birin e Perëndisë, të vërtetën e Perëndisë! Zbulësia është fillimisht shpenguese (shih 2 Tim. 2:15) dhe më pas transformuese (shih 2 Tim. 3:16-17).

NASB	“në ato të mësuara nga Fryma, duke kombinuar mendimet frymërore me fjalët frymërore”
NKJV	“të cilat Fryma e Shenjtë i mëson, duke i krahasuar gjëra frymërore me fjalë frymërore”
NRSV	“të mësuara nga Fryma e Shenjtë, duke interpretuar gjërat frymërore ndaj atyre që janë frymërore”
TEV	“ne nuk flasim me fjalë të mësuara nga dituria njerëzore, por me fjalë të mësuara nga Fryma”
NJB	“në terma të mësuara nga Fryma, duke përshtatur gjuhën frymërore me gjërat frymërore”

Kjo është një frazë shumë e paqartë për disa arsye. Përpara se të përpiqemi që ta kuptojmë këtë, mbani mend se çelësi është konteksti i madh, dhe jo detajet e paqarta të gramatikës apo filologjisë greke. Konteksti i madh lidhet me besimtarët e pjekur (shih 1 Kor. 2:6). Ai kundërshton diturinë dhe urtësinë njerëzore me urtësinë e Perëndisë, që është Krishti, dhe diturinë e Perëndisë, që shprehet në ungjill. Kjo është e vërteta kryesore e kapitujve 1 dhe 2. Fryma e Shenjtë është kanali i domosdoshëm i komunikimit (shih Gjoni 16:8-14). Ai zbulon të vërteta frymore ndaj atyre që kanë besuar Krishtin dhe kanë marrë Frymën që të banojë në ta. Në disa mënyra, diskutimi i Palit këtu është i ngjashëm me shëmbëlltyrën e Jezusit për mbjellësin dhe tokën (shih Mateu 13). Mesazhi i ungjillit kuptohet dhe merr përgjigje nga dëgjuesit marrës, por refuzohet nga dëgjuesit që nuk i përgjigjen atij. Termi *pneumatikois* mund të jetë i gjinisë asnjëanëse (dmth., gjërat frymore) ose i gjinisë mashkullore (dmth., njerëzit frymore). Një tjetër grup dëgjuesish përmendet në vargun e radhës, *psuchikos* (dmth., njeriu natyror ose i humbur). Është e mundur që termi tek 1 Kor. 2:13 t'i referohet njerëzve frymore. I njëjti grup përmendet më parë tek 1 Kor. 2:6 (dmth., *teleiois*, besimtarët e pjekur dhe të pajisur) sikurse tek 1 Kor. 2:15 (dmth., aty ku ata thirren *pneumaikos*). Me sa duket gjenden tre grupe njerëzish ndaj të cilët ka referencë në këtë kontekst.

1. Njerëzit e humbur
2. Besimtarët e shpëtuar, por të papjekur
3. Besimtarët e pjekur

Nuk duket të ketë ndonjë ndryshim midis grupit numër 1 dhe atij numër 2.

Nëse është kështu, atëherë si i komunikon Fryma të vërtetat frymore? Forma pjesore aktive e tashme, *sunkrinontes*, përdoret në Septuagint për të interpretuar ëndrrat (shih Zan. 40:8,16,22; 41:12,15; Gjyq. 7:15; Dan. 5:12; 7:15,16). Megjithatë, kjo fjalë në greqisht përdoret vetëm këtu dhe tek 2 Kor. 10:12 në Dhjatën e Re duke patur kuptimin e saj normal të “krahasimit”. Se si konkretisht i komunikon Fryma të vërtetat frymore tek njerëzit frymore është e paqartë dhe për shkak të kësaj ne nuk duhet të bëhemi dogmatikë apo të ngurtë në mënyrën se si e interpretojmë këtë tekst. E vërteta e madhe është se Perëndia i Shenjtë kërkon dhe arrin të komunikojë me njerëzimin e rënë (shih 1 Kor. 2:12). Perëndia flet, a e dëgjojmë ne?

Gjendet një artikull interesant mbi “Zbulesën dhe Shkrimet” tek *Expositor's Bible Commentary* [Komentari Biblik i Studiuësit], vol. 1, fq. 461-462. Më poshtë është një paragraf i tij.

“Për shkrimtarët e Dhjatës së Re, zbulesa lidhet me të vërtetën. E vërteta është një funksion i gjuhës. Në këtë mënyrë zbulesa dhe Shkrimet janë të lidhura ngushtësisht në teologjinë e Dhjatës së Re. Ndodhia dhe interpretimi ecin paralelisht. Zbulesa e Dhjatës së Re siç lidhet me Jezus Krishtin përfshin jo vetëm të vërteta etike abstrakte dhe pa kufij kohorë, ose eksperiencia subjektive të dishepujve, por ajo lidhet me ndodhitë që janë konkrete, të veçanta dhe aktuale. Pohimi dhe interpretimi apostolik i ndodhive është e vërteta e çështjes. Shkrimtarët kishin për qëllim të përcillnin tek lexuesi atë që është në fakt – që do të thotë, të pohosh se çfarë po ndodh me gjërat që po ndodhnin. Çfarëdo akuze të bëhet kundër shkrimtarëve të Dhjatës së Re për sa i përket besimeve të tyre fetare, ne pranojmë se ata përpiqen të na japin zbulesë hyjnore të shprehur në gjuhë njerëzore (1 Kor. 2:13).”

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 2:14-16

<sup>14</sup> Dhe njeriu natyror nuk i rrok gjërat që janë të Frymës së Shenjtë; sepse për të janë marrëzi dhe nuk mund t'i njohë; sepse ato gjykohen frymërisht. <sup>15</sup> Por njeriu që është frymëror gjykon çdo gjë dhe vetë nuk është i gjykuar nga asnjeri. <sup>16</sup> Sepse kush e ka njohur mendjen e Zotit që mund të mësojë atë? Por ne kemi mendjen e Krishtit.

2:14

NASB	“një njeri natyror”
NKJV	“njeriu natyror”
NRSV	“ata që nuk janë frymore”
TEV	“njeriu që nuk ka Frymën”
NJB	“personi natyror”

Kjo është e kundërta e një njeriu frymor ndaj të cilët i referohej 1 Kor. 2:6,13 dhe 3:1. Termi (dmth., *psuchikos*) përdoret disa herë në Dhjatën e Re ku i referohet jetës në tokë, jetës së jetuar në lidhje vetëm me pesë shqisat (dmth., jeta *bios* përkundrajt jetës *zoë*). Pjesa fundore *ikos* do të thotë “e karakterizuar nga” (shih 1 Kor. 3:3).

Atëherë mund të kishte kuptim tokësor përkundrejt qiellor ose frymor përkundrejt jofrymor (shih 1 Kor. 15:44,46; Jakobi 3:15; dhe Juda 1:19).

**NASB** “nuk pranon”  
**NKJV, NRSV** “nuk merr”  
**TEV** “nuk mund të marrë”  
**NJB** “nuk ka hapësirë për”

Kjo formë mohore në greqisht do të thotë “refuzon”, “refuzon të pranojë”, “nuk mund të kuptojë” ose “nuk nxjerr dot kuptim nga”. Ky term pa formën mohuese shpesh përdoret për të mirëpritur një të ftuar. Ky term (dmth., *dechomai*, shih Luka 8:13; Veprat e Apo. 8:14; 11:1; 17:11; 2 Kor. 11:4; 1 Thes. 1:6; Jakobi 1:21) është sinonim me *lambanō* (shih Gjoni 1:12; 12:48; 14:17). Ai nuk lidhet me injorancën njerëzore, por me aftësinë për të kuptuar të vërtetën frymore!

Ky është misteri i si / pse disa që e kanë dëgjuar ungjillin përgjigjen dhe disa jo. A lidhet ky refuzim me paracaktimin apo me vullnetin njerëzor? Përgjigja është “po”, por se si lidhen këto të dyja është pjesë e natyrës dialektike të vetë zbulësës (shih Fil. 2:12-13, shih Temë e Veçantë tek 2 Kor. 8:16-17). Më pëlqen ajo që thotë Frank Stagg, tek *New Testament Theology* [Teologjia e Dhjatës së Re], “në Dhjatën e Re, e kundërta e të zgjedhurit nuk është të mos zgjedhurit por refuzimi i njeriut ndaj shpëtimit të Perëndisë” (fq. 87).

▣ **“marrëzi”** Shih shënimin tek 1 Kor. 1:25.

▣ **“ato gjykohen frymërisht”** Ky është një term ligjor që flet për ekzaminimin paraprak të plotë përpara një gjyqi (shih Luka 23:14; Veprat e Apo. 12:19; 24:8; 25:26; 28:18) ose të ekzaminosh diçka me kujdes (dmth., Shkrimet, shih Veprat e Apo. 17:11; ushqimi, shih 1 Kor. 10:25,27). Kjo fjalë shfaqet edhe dy herë të tjera tek 1 Kor. 2:15.

▣ Besimtarët të mbushur me Frymën janë të aftë të gjykojnë në mënyrë të duhur gjërat si në hapësirën fizike ashtu edhe në atë frymore (shih 1 Kor. 1:22-25 dhe 2:2, gjithashtu vër re 14:29 dhe 1 Thes. 5:20-21). Megjithatë, njerëzit jofrymorë të 1 Kor. 2:14 nuk mund të dallojnë saktë gjërat frymore, të vërtetat frymore apo njerëzit frymorë.

**2:15 “dhe vetë nuk është i gjykuar nga asnjeri”** Kjo, sigurisht, është një formë e përgjithshme mashkullore. Besimtarët nuk mund të gjykohen, dhe as të kuptohen plotësisht nga jobesimtarët (shih 1 Kor. 4:3-4). Kjo mund të jetë një referencë ndaj disa prej armiqve të Palit në Korint (shih 1 Kor. 9:3). Është Fryma që banon e cila sjellë dritë përmes ungjillit në realitet, jo në realitetin e kësaj epoke apo realitetin fizik, por në realitetin e Perëndisë!

**2:16** Ky është një aludim ndaj Isa. 40:13 tek Septuaginti. Tek Isa. 40:3 termi “Zot” është emri Hyjnor i YHWH, por këtu Pali përdor citimin për t’iu referuar Jezusit (gjithashtu vër re Rom. 10:13 dhe Fil. 2:10-11).

Kjo vazhdon theksin kontekstual në nevojën për Frymën që njerëzit të “dëgjojnë” ungjillin dhe të kuptojnë të vërtetën frymore. Ky kontekst dhe Gjoni 14-16 janë thelbësor për të kuptuar veprën e Frymës së Perëndisë.

Pa Frymën, njerëzimi i rënë përfshihet në spekulime, mite, madje edhe të vërteta të rreme të frymëzuara nga djalli! Oh, tragjedia e feve botërore dhe filozofisë njerëzore!

▣ **“Por ne kemi mendjen e Krishtit”** Përemri “ne” është theksues! Kjo mund t’i referohet (1) Palit dhe shoqëruesve të tij; (2) predikuesve të krishterë; ose (3) të krishterëve të pjekur. Kjo nuk do të thotë se besimtarët dinë gjithçka që di Krishti, por që Fryma ka hapur mendjet tona ndaj perspektivës së Tij, prioritetëve të Tij dhe zemrës së Tij (shih Rom. 12:2; Fil 2:5).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Përkufizoni përdorimin e Palit për fjalën “mister” në këtë konteskt.
2. Çfarë nënkuptonte Pali kur tha se ai erdhi me frikë dhe drithërimë të madhe në Korint?
3. Cila ishte prova që predikimet e Palit ishin të fuqizuara nga Perëndia?
4. Pse autorët e Dhjatës së Re hezitojnë të përshkruajnë qiellin apo ferrin në detaje?
5. Shpjegoni ndryshimin midis “zbulesës”, “frymëzimit” dhe “iluminimit”.
6. Listoni tre mënyra të ndryshme në të cilat Pali përdor termin “urtësi” në këtë kapitull.
7. Kërkojeni vargun 1 Kor. 2:13 në disa përkthime në anglisht. Çfarë mendoni se mëson ky varg?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 3

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Bashkëpunëtorë me Perëndinë	Sektarianizmi është Material	Përçarja mbi Drejtuesit	Shërbëtorët e Perëndisë	Urtësia e Vërtetë dhe e Rremë (1:17-3:4)
3:1-9	3:1-4 Vaditja, Punimi dhe Paralajmërimi 3:5-17	3:1-4  3:5-9	3:1-4  3:5-9a 3:9b-15	3:1-4 Vendi i Predikuesit të Krishter 3:5-9
3:10-17		Mësues dhe Kisha nën Perëndinë 3:10-15 3:16-17	3:16-17	3:10-15 3:16-17 Përfundime (3:18-4:13)
3:18-23	Shmang Urtësinë e Botës 3:18-23	3:18-23	3:18-23	3:18-23

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 3:1-23**

- A. Në këtë kapitull, Pali vazhdon të zhvillojë karakterizimin e të krishterëve korintas si të papjekur sikurse në kapitullin 2.
- B. Grupet e fokusuara mbi personalitete që përmenden në kapitullin 1 përmenden sërish në mënyrë specifike në kapitullin 3. Kjo tregon se kapitujt 1-3 janë një argument i mbështetur mbi njohurinë njerëzore dhe drejtimin e krishter.
- C. Vini re tre grupet.
  - a. Njeriu natyror, 1 Kor. 2:1
  - b. Njeriu frymor, 1 Kor. 3:1
  - c. Foshnje në Krishtin, 1 Kor. 3:1



D. Vargjet 10-17 janë parë për një periudhë të gjatë si të përshkruanin të krishterë individualë, fizikë. Kjo është e mundur duke krahasuar kontekstin e madh të 1 Kor. 1:12 përgjatë 3:4-5. Një provë tjetër e kësaj pikëpamjeje do të ishte që Pali i adresohet kishës (shumësi “ju”) tek 1 Kor. 3:1 dhe 16. Përdorimi i përsëritur i “çdo njeri”, “asnjë njeri”, “kushdo njeri” tek 1 Kor. 3: 10,11,12,13, 14,15, 17,18 gjithashtu jep besueshmëri për këtë interpretim.

Megjithatë, gjithashtu është e mundur që të lidhësh këtë tekst me drejtuesit e kishës (shih 1 Kor. 3:10). Grupet e përçara nuk i referohen të gjithë të krishterëve korintas (dmth., të krishterët e pjekur të 1 Kor. 2:6), vetëm disa prej tyre (dmth., “njerëzve të mishit”, “foshnje në Krishtin”, 3:1). Drejtuesit e këtyre grupeve të përçara Pali i krahason me vetveten dhe Apollin tek 1 Kor. 3:6-9. Konteksti i menjëhershëm lidhet me 1 Kor. 3:10-15 me drejtuesit, me se si ata përdorin dhuntitë e tyre frymore për t’i shërbyer kishës. Kjo është shtysa për paralajmërimin tek 1 Kor. 3:17.

Është e vështirë të zgjedhësh midis dy pikëpamjeve: (1) Dhjata e Re nuk diskuton statusin frymor dhe pasojat e të krishterëve fizikë dhe (2) “shkatërrimi” i 1 Kor. 3:17 nuk qartësohet. Vargjet 15 dhe 17 duhet të mbahen në tension. Të gjitha rastet e “po sikur” në këtë kontekst janë fjali kushtore të gradës së parë, të cilat supozohen si të vërteta për qëllimet e autorit. Vargu 14 supozon se ata janë besimtarë të vërtetë, ndërsa 1 Kor. 3:15 supozon se disa do të vuajnë humbjen e të gjithë shpërblimit. Termi për “sprovë” tek 1 Kor. 3:13 nënkupton një sprovë që rezulton në aprovim. Megjithatë, konteksti nënkupton se Pali po i akuzon ata se nuk kuptojnë ungjillin, se janë jofrymorë, xhelozë dhe të përçarë.

Mua më duket më e mira që të mos lidhet ky tekst me të gjithë të krishterët, por gjithashtu, as të kufizohet tek drejtuesit. Ky tekst specifikisht lidhet me ata që promovojnë përçarjet dhe ndarjet brenda kishës. Të gjithë besimtarët do të japin llogari tek Perëndia për shërbesën që i kanë bërë ose dëmin që i kanë shkaktuar trupit të Tij, kishës (shih 2 Kor. 5:10; Gal. 5:10).

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 3:1-4

<sup>1</sup>Dhe unë, o vëllezër, nuk munda t’ju flas si njerëz frymëror, por ju fola si njerëz të mishit, si foshnja në Krisht. <sup>2</sup>Ju dhashë qumësht për të pirë dhe nuk ju dhashë ushqim të fortë, sepse nuk ishit në gjendje ta asimilonit, madje edhe tani jo, sepse jeni akoma të mishit; <sup>3</sup>në fakt sepse midis jush ka smirë, grindje e përçarje a nuk jeni të mishit dhe a nuk ecni sipas mënyrës së njerëzve? <sup>4</sup>Sepse, kur dikush thotë: “Unë jam i Palit,” dhe një tjetër: “Unë jam i Apolit,” a nuk jeni ju të mishit?

**3:1 “vëllezër”** Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 2:6.

▣ **“nuk munda t’ju flas”** Kjo është një formë treguese aoriste dhe një formë paskajore aoriste, e cila i referohet predikimit fillestar të Palit në Korint (shih Veprat e Apo. 18:1-18).

NASB “si burrave frymorë”  
 NKJV, NRSV “si njerëzve frymorë”  
 TEV “si njerëzve që kanë Frymën”  
 NJB “si njerëz frymorë”

Kujt po ia drejton Pali këto vargje: (1) të gjithë besimtarëve apo (2) besimtarëve të papjekur frymërisht (dmth., grupeve të ndara, shih 1 Kor. 3:4)? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje përfshin mënyrën se si interpretohet vargu 2:6. A kishte disa besimtarë të udhëhequr nga Fryma dhe të pjekur në kishën korintase apo ishin ata të gjithë të papjekur?

▣ **“por”** Kjo është fjala e fortë kundërshtuese *alla*. Gjendet një kontrast midis “të pjekur” të 1 Kor. 2:6 (dmth., njerëz frymorë) dhe “njerëzve të mishit” tek 1 Kor. 3:1-4. Të dy grupet kanë Frymën (dmth, janë të krishterë) por grupi i parë karakterizohet nga Fryma, ndërkohë që grupi i dytë karakterizohet nga jeta sipas botës.

NASB “njerëz të mishit”  
 NKJV “si mishorë”  
 NRSV “si njerëz të mishit”

**TEV** “sikur t’i përkisnit kësaj bote”  
**NJB** “si njerëz që ende jetojnë me preferencat tuaja”

Kjo është “*sarkinos*” në greqisht. Prapashtesa *inos* do të thotë “e bërë nga” ose “rrjedh nga” (p.sh., “zemrat e mishit”, shih 2 Kor. 3:3) dhe kjo do të nënkuptonte “të bëra nga mish”. Pali përdor fjalën “mish” në mënyra të ndryshme (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26). Ky kontekst (dmth., “si foshnja në Krisht”) duket se e përdor këtë term për besimtarët që kanë Frymën, por ecin sipas mënyrave të botës. Nuk është mish i Palit përkundrajt Frymës (shih Rom. 8:1-11), por një kategori besimtarësh. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, ky kontekst është një nga pak vendet në Dhjatën e Re ku bëhet ky dallim. Këtu është tragjedia e shpëtimit pa shenjtërim. Të shpallësh Krishtin si Shpëtimtar, por të mos jetosh sikur Krishti është Zot. Nëse kjo gjendje frymore e tmerrshme është e karakterizuar nga xhelozia, grindja dhe një frymë ndarëse, çfarë mund të themi për kishën moderne? Oh, tragjedia e “foshnjeve në Krishtin” për Mbretërinë e Perëndisë dhe zemrën e Mbretit!

▣ **“si foshnja në Krisht”** Çdo besimtar fillon si një foshnje e krishterë. Nuk ka asnjë turp në këtë gjë. Kjo është origjina e metaforës familjare të nxjerrë nga koncepti i të qenit “i rilindur” (shih Gjoni 3:3; 2 Kor. 5:17; 1 Pjet. 1:3,23), por ne nuk duhet të qëndrojmë foshnje!

**3:2 “Ju dhashë qumësht për të pirë”** Kjo është një metaforë e vazhdueshme e të krishterëve të rinj si krijesa plotësisht të reja të karakterizuara si fëmijë (shih Heb. 5:12-14; 1 Pjet. 2:2). Tertullian [Tertuliani] dhe Hippolytus [Hipotili] tregojnë se kisha e hershme i jepte një gotë me qumësht të konvertuarve të rinj si kungim i parë si simbol i kësaj të vërtete.

▣ **“sepse nuk ishit në gjendje ta asimilonit”** Në kohën kur Pali shkroi këtë letër, shumë muaj kishin kaluar. Edhe pse është e përshtatshme të jesh një foshnje e krishterë në fillim të jetës së krishterë, është një tragjedi që të jesh ende foshnje e krishterë pas shumë vitesh. Këto vargje hapëse të kapitullit 3 duhet ta kenë lënduar krenarinë intelektuale të drejtuesve të grupeve. Ka një lojë befasuese me kohën e papërkryer (dmth., “sepse ju nuk mundeshit ende”) dhe kohës së tashme (dmth., edhe tani ju nuk mundeni”). Fjala “mund” në gjuhën greke është termi *dunamai*, që do të thotë fuqi për të vepruar, për të arritur, për të funksionuar drejt një rezultati të dëshiruar. Besimtarët shpëtohen për të shërbyer; ata thirren që të jetojnë një jetë si të Krishtit tani, jo vetëm më vonë kur të jenë në qiell. Këta “besimtarë” nuk kishin asnjë fuqi Mbretërie, vetëm fuqi mish, që do të thotë, në të vërtetë, pafuqi!

**3:3**  
**NASB** “jeni akoma prej mishit”  
**NKJV** “jeni akoma mishorë”  
**NRSV** “jeni akoma të mishit”  
**TEV** “ju jetoni ende siç jetojnë njerëzit e kësaj bote”  
**NJB** “ju jetoni ende me preferencat tuaja natyrore”

Kjo është fjala *sarkikos* në greqisht. Pjesa fundore *ikos* do të thotë “i karakterizuar nga” (shih 1 Kor. 2:14-15). Pali po luan me fjalën *sarks* (mish) tek 1 Kor. 3:1 dhe 3 për të përshkruar shumë të krishterë në Korint sit ë shpëtuar, por shumë të papjekur. Ata ishin ende egoistë, jo vetmohues! Për fjalën “mishor” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

▣ **“smirë e grindje”** Këto janë dy nga veprat e mishit të listuara tek Gal. 5:19-21. Ato ishin provë që disa të krishterë korintas ishin ende mishorë. Në disa dorëshkrime të hershme greke (dmth., P<sup>46</sup>, D, dhe përkthimet Siriake) gjendet një term shtesë përshkruar, “përçarje”, që gjithashtu gjendet tek Gal. 5:20. Ai sigurisht përshkruan problemin në Korint. Megjithatë, termi mungon në dorëshkrimet MSS P<sup>11</sup>, x, A, B, C, dhe P dhe në përkthimet Vulgate, Koptik dhe Armenian. Duket se është një shtesë nga skribët (dmth., UBS<sup>4</sup> i jep heqjes së saj një vlerësim B – pothuajse i sigurtë).

■ **“a nuk ecni sipas mënyrës së njerëzve”** Forma gramatike e kësaj pyetjeje pret një “po” si përgjigje. Ky është thelbi i jetës sipas mishit. Pjekuria shihet në fyrtet e saj, si në qëndrim edhe në veprime (shih Rom. 8:1-11; Mat. 7:1 e në vazhdim).

3:4 Kjo reflekton ndarjet e 1 Kor. 1:10-17.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 3:5-9

<sup>5</sup> Kush është, pra, Pali dhe kush është Apoli, veçse shërbëtor me anë të të cilëve ju besuat, edhe ashtu si Zoti i dha gjithsecilit? <sup>6</sup> Unë mbolla, Apoli ujiti, po Perëndia i bëri të rriten. <sup>7</sup> Kështu, pra, as ai që mbjell, as ai që ujit, nuk është gjë, por Perëndia që rrit. <sup>8</sup> Por ai që mbjell dhe ai që ujit janë një, dhe secili do të marrë shpërblimin e vet sipas mundit të tij. <sup>9</sup> Ne, pra, jemi bashkëpunëtorë të Perëndisë; ju jeni ara e Perëndisë, ndërtesa e Perëndisë.

NASB, NRSV, NJB “çfarë”  
NKJV, TEV “kush”

Version i Mbretit James (Xhejms) ka përkthimin “kush” (dmth., *tis*), duke ndjekur dorëshkrimet greke P<sup>46</sup>, C, D, dhe G. pjesa më e madhe e përkthimeve moderne të anglishtes kanë “çfarë” (dmth., *ti*), që duket se qëllimisht largon fokusin nga personalitetet (dmth., Apoli, Pali dhe Pjetri). Kjo konfirmohet nga *ti* në vargun 7. Shih Bruce Metzger, *A Textual Commentary On the Greek NT* [Një Komentar Tekstual mbi Greqishten e Dhjatës së Re], fq. 548.

■ **“shërbëtor”** Ky është termi (dmth., *diakonos*) nga i cili ne marrim fjalën “diakon” (shih Fi. 1:1; 1 Tim. 3:8,12). Kjo u bë një nga tre fjalët në greqisht (dmth., *therapeuō*, *hupēreteō* dhe *diakoneō*) që u përdor për të përcaktuar shërbim, ndihmë ose shërbesë (një term tjetër i zakonit *latreuō* përcaktonte shërbesën priftërore). Shih Temën e Veçantë: Drejtim Shërbyes (Special Topic: Servant Leadership) tek 1 Kor. 4:1.

■ **“me anë të të cilëve ju besuat”** Krishtërimi fillon me një vendim të vullnetshëm për të pranuar (dmth., formë treguese aktive aoriste) ungjillin e Perëndisë, i cili është Jezus Krishti, mësimet e Tij, veprat e Tij shpenguese, ringjallja e Tij dhe rikthimi i Tij. Nuk mund të kalosh direkt tek shpëtimi. Nuk ka të bëjë me prindërit, kombin, apo inteligjencën e dikujt. Është një çështje e dhuratës së besëlidhjes së Perëndisë dhe përgjigjes sonë ndaj kësaj besëlidhjeje (dmth., pendesë, besim, bindje, shërbesë dhe qëndrueshmëri). Njerëzit bëhen të krishterë duke marrë Krishtin, duke besuar ungjillin dhe duke ecur në Krishtin. Këta të krishterë kishin bërë dy të parat, por iu mungonte e treta. Lajmi i mirë është një Person, një e vërtetë dhe një stil jetese. Të tre janë thelbësore për pjekurinë.

Termi grek besoj (dmth., *pisteuō*) përkthehet në anglisht si besoj, i besoj ose kam besim. Ekuivalentja e kësaj fjale në Dhjatën e Vjetër kishte kuptim “të qëndrosh fort” dhe në këtë mënyrë u përdor metaforikisht për dikë që ishte i besueshëm, besnik, tek i cili mund të mbështeteshe (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9). Sikurse zbulojnë nënkuptimet e këtij konteksti, njerëzit mund t’i përgjigjen besnikërisë së Perëndisë, besueshmërisë së Perëndisë, besnikërisë së besëlidhjes së Perëndisë. Besimi njerëzor është një përgjigje ndaj besnikërisë së Perëndisë! Objekti i besimit, premtimi i besimit është Perëndia! Hiri i Tij, mëshira e Tij, thirrja e Tij, Biri i Tij, Fryma e Tij, këto janë shpresa e vetme për njerëzimin e rënë.

■ **“edhe ashtu si Zoti i dha gjithsecilit”** Theksi këtu është mbi elementin hyjnor, jo mbi përgjigjen apo performancën njerëzore. Por qëllimi i paracaktimit është shenjtëria (shih Efe. 1:4; 2:10), jo një pozitë e privilegjuar, jo ushtrimi i privilegjit personal apo preferencës personale. Çdo besimtar pajiset nga Perëndia për shërbesë në kishë dhe për kishën (shih 1 Kor. 12:7,11; Efe. 4:11-13).

Identifikimi i saktë i “Zot” është i vështirë. Zakonisht është Perëndia At i cili thërret për shpëtim. Por Pali ka përdorur “Zot” disa herë tashmë tek 1 Korintasve për t’iu referuar Jezusit (shih 1 Kor. 1:2,3,7,8,9,10; 2:8). Megjithatë, disa herë Pali citon një pasazh të Dhjatës së Vjetër kur Zot i referohet YHWH (shih 1 Kor. 1:31; 2:16; 3:20). Paqartësia shihet qartë në 1 Kor. 2:16 ku Zot në një citim të Dhjatës së Vjetër përdoret në paralelizëm me “mendjen e Krishtit.”

Fraza “gjithësecilit” gjithashtu qartazi tregon vështirësinë për të përcaktuar se kujt po i drejtohet. A iu drejtohet drejtuesve si Pali dhe Apolli, apo besimtarëve në Korint, apo të gjithë besimtarëve?

1. Të gjithë besimtarët thirren dhe kanë dhunti, por disa gjithashtu thirren dhe kanë dhunti për të drejtuar (shih Num. 16:3).
2. A është konteksti vetëm i përbashkët apo ka një theks individual (dmth., disa drejtues)?

**3:6 “mbolla... ujiti”** Pali po përdor metafora bujqësore. Ungjilli është fara (dmth., Mateu 13), por njerëzit e mbollën dhe u kujdesën për të.

Urdhërimi i Madh (dmth., Mat. 28:19-20) ka dy detyra të barabarta.

1. Ungjillizimin
2. Dishepullizimin

Pali e filloi kishën duke predikuar ungjillin dhe Apolli mësoi kishën. Të dyja janë thelbësore dhe të pandashme.

▣ **“po Perëndia i bëri të rriten”** Kjo është koha e pakryer, që do të thotë se veprimi vazhdon në të shkuarën. Veprimet e Apollit dhe të Palit ishin veprime që ndodhnin një herë, por veprimet e Perëndisë vazhdojnë (shih 1 Kor. 3:7).

**3:8**

**NASB, NKJV** “janë një”

**NRSV** “kanë një qëllim të përbashkët”

**TEV** “nuk ka ndryshim mes tyre”

**NJB** “janë të gjitha një”

Pyetja e kësaj fraze greke të shkurtër dhe të paqartë (dmth., NASB, NKJV) është (1) a janë të gjithë drejtuesit të barabartë apo (2) a ndajnë të gjithë drejtuesit në të njëjtën shërbesë të rritjes së kishës? Kontrasti i vërtetë nuk është midis dhuntive frymore (dmth., ungjillizuesi fillestar apo dishepulli, apo pastori / mësuesi, etj., shih Efe. 4:11), por midis veprës së Perëndisë dhe instrumentalitetit njerëzor. Çelësi është Perëndia!

▣ **“por<sup>9</sup> secili do të marrë shpërblimin e vet sipas mundit të tij”** Koncepti i shpërblimeve zhvillohet tek 1 Kor. 3:10-15. Në diskutimin e shpërblimeve shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 3:14.

Ideja e shpërblimeve për shërbesën lidhet me parimin frymëror të paraqitur tek 1 Kor. 3:13 dhe Gal. 6:7. Ne korrim atë që mbjellim (shih 2 Kor. 9:6).

Një çështje teologjike e lidhur është shkallët e shpërblimeve. Njohuria e ungjillit e energjizuar nga Fryma dhe thirrja për të drejtuar brenda kishës së Perëndisë sjell një përgjegjësi më të madhe (shih Luka 12:48). Dhjata e Re duket se mëson shkallë të shpërblimeve dhe ndëshkimeve (shih Mat. 10:15; 11:22,24; 18:6; 25:21,23; Mark 12:40; Luka 12:47-48; 20:47; Jakobi 3:1). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 9:24.

**3:9**

**NASB, NKJV** “ne jemi bashkëpunëtorë të Perëndisë”

**NRSV** “ne jemi shërbëtorë të Perëndisë, duke punuar së bashku”

**TEV** “ne jemi partnerë duke punuar së bashku me Perëndinë”

**NJB** “ne ndajmë në veprën e Perëndisë”

**REB** “ne jemi bashkëpunëtorë në shërbesën e Perëndisë”

Përkthimet e ndryshme përpiqen të tregojnë se Apolli dhe Pali punojnë “për” Perëndinë, jo se ata janë të tre bashkëpunëtorë. Prioriteti duhet të qëndrojë me Perëndinë, jo me drejtuesit e Tij të përkohshëm njerëzorë! Kjo i referohet Palit dhe Apollit. Kjo është një metaforë e Lindjes së Afërme e një familjeje që punon bashkë në fushë (shih 2 Kor. 6:1). Ky varg ka tre forma gjinore pronore: Pali dhe Apolli i përkasin Perëndisë Atit, sikurse kisha në Korint.

<sup>9</sup> Versioni në shqip është: “dhe” (shënim i përkthyesit).

☐ **“ju jeni ara e Perëndisë, ndërtesa e Perëndisë”** Kjo i referohet kishës korintase. Pali po përdor metafora të rritjes bujqësore (shih Isa. 61:3; Mat. 15:13) dhe ndërtimit të ndërtesave (shih Efe. 2:20-22; Kol. 2:7; 1 Pjet. 2:5) për të përshkruar kishën. Teologjikisht duhet të mbajmë mend se kisha është një popull, jo një ndërtesë.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 3:10-15**

<sup>10</sup> Sipas hirit të Perëndisë që më është dhënë, si arkitekt i ditur, unë kam hedhur themelin dhe një tjetër ndërton mbi të; por secili të ketë kujdes se si ndërton mbi të, <sup>11</sup> sepse askush nuk mund të hedhë themel tjetër përveç atij që është hedhur, i cili është Jezu Krishti. <sup>12</sup> Dhe, në qoftë se dikush ndërton mbi këtë themel ar, argjend, gurë të çmuar, dru, sanë, kashtë, <sup>13</sup> vepra e secilit do të shfaqet, sepse dita do ta tregojë; sepse do të zbulohet me anë të zjarrit, dhe zjarri do të provojë veprën e secilit e ç’lloji është. <sup>14</sup> Në qoftë se vepra që dikush ka ndërtuar mbi themelin qëndron, ai do të marrë një shpërblim, <sup>15</sup> në qoftë se vepra e tij digjet, ai do të pësojë humbje, por ai vetë do të shpëtohet, si përmes zjarrit.

**3:10 “Sipas hirit të Perëndisë që më është dhënë”** Pali po pranon shpëtimin e tij, thirrjen dhe dhuntinë e tij si apostulli ndaj johebrenjve (shih 1 Kor. 15:10).

☐ **“arkitekt i ditur”** Kjo gjithashtu mund të nënkuptonte “një mbikëqyrës ndërtimesh”. Ne marrim fjalën arkitekt nga kjo fjalë greke. Në një farë kuptimi, Pali po pranon autoritetin e tij si apostull i thirrur nga Krishti ndaj johebrenjve dhe i pari që ka ndarë ungjillin me këta korintas.

☐ **“unë kam hedhur themelin”** Kjo i referohet predikimit fillestar të Palit të ungjillit në Korint. Ai mund të jetë një aludim ndaj Isa. 28:16. Jezusi është themeli!

☐ **“dhe një tjetër ndërton mbi të”** Pali nisi kishën, por të tjerë kontribuan në rritjen e saj. Apollu është një shembull (shih 1 Kor. 3:5-9). Megjithatë, në kontekst kjo gjithashtu duhet të lidhet me ata drejtues në kishë që kanë promovuar një frymë përçarëse. Ata kanë qënë drejtues të kishave-shtëpi të ndryshme.

☐ **“por secili të ketë kujdes”** Kjo është fjalë për fjalë një formë urdhërore aktive e tashme e *blepō*, “unë shoh”. Ky është një paralajmërim që drejtuesit e kishës do të japin llogari tek Perëndia për punën e tyre në kishë, sikurse do të bëjnë të gjithë besimtarët (shih 2 Kor. 5:10).

**3:11** Gjenden dy kritere të përmendura në këtë pasazh për kishën.

1. Mesazhi i drejtuesit / besimtarit duhet të jetë i qëndëruar tek Krishti (shih 1 Kor. 3:11-12 dhe Efe. 2:20-21)
2. Jeta e drejtuesit / besimtarit duhet të jetë si e Krishtit (shih 1 Kor. 3:12-15)

**3:12 “në qoftë se”** Kjo është e para nga një seri fjalish kushtore të rendit të parë të cilat supozohen se janë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimin e tij letrar (shih 1 Kor. 3:12,14,15,17,18). Kishte (dhe ka) drejtues të frytshëm dhe të çmuar dhe gjithashtu drejtues lëndues dhe shkatërrues!

☐ **“dikush ndërton mbi këtë themel”** Pyetja kryesore interpretative këtu është: Për cilin themel po flet Pali: (1) ungjillin, 1 Kor. 3:11 apo (2) kisha në Korint, 1 Kor. 3:10? A po i drejtohet ai drejtuesve apo besimtarëve në përgjithësi? Interpretimi i 1 Kor. 3:10-15 duhet të lidhet me 1 Kor. 3:16-17, i cili përshkruan kishën në tërësi si tempulli i Perëndisë.

☐ **“ar, argjend, gurë të çmuar”** Theksi këtu është mbi atë që zgjat në kohë, që është e bukur dhe e shtrenjtë, dhe që nuk mund të shkatërrohet me zjarr. Gurët e çmuar mund të jenë xhevahirë, gurë gjysmë të çmuar, ose gurë mermeri të lëmuar.

**3:13**

NASB

“do të bëhet e dallueshme”

NKJV

“do të bëhet e manifestuar”

NRSV

“do të bëhet e dukshme”

TEV  
NJB

“do të shihet”  
“do të shfaqet”

Ky manifestim i qartë i shërbesës së besimtarëve apo drejtuesve (dmth., motivet, veprat, qëllimet) theksohet nga një përsëritje e trefishtë e foljeve tek 1 Kor. 3:13.

1. Bëhet e dallueshme (dmth., *phainō*)
2. Shfaqet (dmth., *dēloō*)
3. Zbulohet (dmth., *apokaluptō*)

Kjo shfaqje dhe ky gjykim i hapur i besimtarëve duhet të lidhet me fronin e gjykimit të Krishtit tek 2 Kor. 5:10.

▣ **“dita do ta tregojë”** Kjo i referohet “Ditës së Zotit” tek Dhjata e Vjetër, e cila do të përfshijë si përlëvdimin dhe shpërblimet për besimtarët ashtu edhe gjykimin për jobesimtarët. Megjithatë, edhe besimtarët gjithashtu do të japin llogari përpara fronit të gjykimit të Krishtit (shih 2 Kor. 5:10; Mat. 12:36-37; 25:31e në vazhdim; Rom. 2:16; 14:12; Gal. 5:10; Heb. 13:17).

▣ **“zjarri”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### TEMË E VEÇANTË: ZJARR (SPECIAL TOPIC: FIRE)

Në Shkrim, zjarri ka edhe ngjyime pozitive, edhe negative.

##### A. Pozitive

3. ngroh (shih Isa. 44:15; Gjoni 18:18)
4. ndriçon (Isa. 50:11; Mat. 25:1-13)
5. pjek (shih Eks. 12:8; Isa. 44:15-16; Gjoni 21:9)
6. pastron (shih Num. 31:22-23; Fja. 17:3; Isa. 1:25; 6:6-8; Jer. 6:29; Mal. 3:2-3)
7. shenjtëria e Perëndisë (shih Zan. 15:17; Eks. 3:2; 19:18; Ezek. 1:27; Heb. 12:29)
8. udhëheqja e Perëndisë (shih Eks. 13:21; Num. 14:14; 1 Mbret. 18:24)
9. fuqizimi i Perëndisë (shih Veprat e Apo. 2:3)
10. mbrojtja e Perëndisë (shih Zak. 2:5)

##### B. Negative

1. djeg (shih Joz. 6:24; 8:8; 11:11; Mat. 22:7)
2. shkatërron (shih Zan. 19:24; Lev. 10:1-2)
3. zemërim (shih Num. 21:28; Isa. 10:16; Zak. 12:6)
4. ndëshkim (shih Zan. 38:24; Lev. 20:14; 21:9; Joz. 7:15)
5. shenjë e rremë eskatologjike (shih Zbu. 13:13)

##### C. Zemërimi i Perëndisë kundër mëkatit shprehet me metafora zjarri

1. zemërimi i tij djeg (shih Os. 8:5; Sof. 3:8)
2. ai derdh zjarr (shih Nah. 1:6)
3. zjarri i përjetshëm (shih Jer. 15:14; 17:4; Mat. 25:41; Juda v. 7)
4. gjykim eskatologjik (shih Mat. 3:10; 13:40; Gjoni 15:6; 2 Thes. 1:7; 2 Pjet. 3:7-10; Zbu. 8:7; 16:8; 20:14-15)

##### D. Shpesh, zjarri shfaqet në teofani

1. Zan. 15:17
2. Eks. 3:2
3. Eks. 19:18
4. Psa. 18:7-15; 29:7
5. Ezek. 1:4, 27; 10:2
6. Heb. 1:7; 12:29

E. Ashtu si shumë metafora të tjera në Bibël (si majaja, luani), zjarri mund të jetë bekim ose mallkim, në varësi të kontekstit.

■ **“do të provojë”** Kjo i referohet zjarrit të rafinuesit (shih 1 Kor. 4:5), i cili provon me qëllim aprovimin (dmth., *dokimazō*).

**TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE (SPECIAL TOPIC: GREEK TERMS FOR TESTING AND THEIR CONNOTATIONS)**

Ka dy fjalë greke që përçojnë idenë e vënies dikujt në provë për një qëllim të caktuar.

1. *Dokimazō, Dokimion, Dokimasia*

Kjo fjalë është term metalurgjik për vënien në provë të autenticitetit të diçkaje (pra, metaforikisht, të dikujt) me anë të zjarrit (shih Temë e Veçantë: Zjarr / Special Topic: Fire). Zjarri zbulon metalin e vërtetë dhe djeg (pra, pastron) skoriet. Ky proces fizik u shndërrua në zhargon të fuqishëm teologjik ku Perëndia, dhe/ose Satani, dhe/ose njerëzit vënë në sprovë të tjerët. Kjo fjalë përdoret vetëm në kuptimin pozitiv të sprovimit me synim që dikush të miratohet (shih Temë e Veçantë: Perëndia Sprovon Popullin e Tij [Dhjata e Vjetër] / Special Topic: God Tests His People [OT]).

Në Dhjatën e Re përdoret për të vënë në sprovë

- a. qetë – Luka 14:19
- b. vetveten – 1 Kor. 11:28
- c. besimin tonë – Jakobi 1:3
- d. madje dhe Perëndinë – Heb. 3:9

Rezultatet e këtyre sprovave merren si pozitive (shih Rom. 2:18; 14:22; 16:10; 2 Kor. 10:18; 13:3; 7; Fil. 2:27; 1 Pje. 1:7), prandaj, ky term përçon idenë e shqyrtimit dhe miratimit të dikujt si

- a. i vlefshëm
- b. i mirë
- c. i vërtetë
- d. i vyer
- e. i nderuar

2. *Peirazō, Peirasmōs*

Shpesh, ky term ka ngjyrimin e shqyrtimit me qëllim gjetjen e të metave, ose refuzimin. Shpesh, përdoret në lidhje me tundimin e Jezusit në shkretëtirë.

- a. Përçon përpjekjen për ta shtënë Jezusin në kurth (shih Mat. . 4:1; 16:1; 19:3; 22:18, 35; Marku 1:13; Luka 4:2; Heb. 2:18).
- b. Kjo fjalë (*peirazōn*) përdoret edhe si titull i Satanit në Mat. 4:3; 1 Thes. 3:5 (dmth., “tunduesi”).
- c. Përdorimi
  - (1) Përdorej nga Jezusi për të na paralajmëruar që të mos e vëmë Perëndinë në sprovë (shih Mat. 14:7; Luka 4:12) [ose Krishtin, shih 1 Kor. 10:9].
  - (2) Po kështu, ajo nënkupton përpjekjen për të bërë diçka që ka dështuar (shih Heb. 11:29).
  - (3) Përdoret në lidhje me tundimin dhe sprovat e besimtarëve (shih 1 Kor. 7:5; 10:9, 13; Gal. 6:1; 1 Thes. 3:5; Heb. 2:18; Jakobi 1:2, 13, 14; 1 Pje. 4:12; 2 Pje. 2:9).

■ **“veprën e secilit e ç’lloji është”** Në kontekst kjo duhet t’i referohet përfshirjes në kishë. Të gjitha dhuntitë frymore janë për ndërtimin e kishës (shih 1 Kor. 12:7). Nuk ka asnjë dallim frymor midis klerit dhe popullit, drejtuesit dhe ndjekësit, por ka një dallim në detyrë (shih Num. 16:3). Drejtuesit janë më përgjegjës, do të japin më shumë llogari (shih Jakobi 3:1).

**3:14 “Në qoftë se”** Kjo është e dyta nga një seri fjalish kushtore të rendit të parë, të supozuara se janë të vërteta nga perspektiva e shkruarit ose për qëllimin e tij letrar (shih 1 Kor. 3:12,14,15,17,18).

■ **“ai do të marrë një shpërblim”** Ky pasazh i referohet shpërblimeve, jo shpëtimit. I gjithë populli të cilit i drejtohet supozohet të jetë besimtarë!

Koncepti i Dhjatës së Re për shpërblimet duhet të dallohet nga shpëtimi me anë të meritës (shih Rom. 6:23). Në Dhjatën e Vjetër shpërblimet ose bekimet lidheshin me bindjen (shih Ligji i Përt. 11:13-32,27-29; Psalm 1). Në një farë kuptimi, kjo është ende e vërtetë. Megjithatë, shpëtimi është një dhuratë, jo një shpërblim. Jeta e besimit dhe bindjes është një rezultat i shpëtimit, jo një mënyrë për të marrë shpëtimin. Shpërblimet mund të humben, por shpëtimi të merret. Shpërblimet janë një vlerësim i një shërbese në rritje të besimtarëve. Pali tani ka universalizuar vlerësimin e tij eskatologjik (shih 1 Thes. 2:19-20; Fil. 2:14-16) për të përfshirë të gjithë besimtarët. Shpërblimet janë një mënyrë për të dalluar ata që kanë shërbyer në mënyrë efektive dhe me besnikëri në përparimin e ungjillit. Shpërblimet janë dhurata të Perëndisë përmes fuqizimit të Tij për Mbretërinë e Tij. Megjithatë, si të gjitha marrëdhëniet të bazuara në besëlidhje, besimtarët duhet të përgjigjen në mënyrën e duhur dhe vazhdimisht (shih 1 Kor. 9:24-27). Shih Temën e Veçantë: Shkallë të Shpërblimeve dhe Dënimit (Special Topic: Degrees of Rewards and Punishment) tek 1 Kor. 9:24-27.

**3:15 “në qoftë se vepra e tij digjet”** Oh, tragjedia e një jete të krishterë të pafrytshme, egoiste dhe të përçarë – një tragjedi për personin, një tragjedi për kishën dhe një tragjedi për të pashpëtuarit!

▣ **“por ai vetë do të shpëtohet”** Kjo tregon prioritetin e hirit edhe me mundësinë e humbjes së shpërblimit. Ky koncept mund t’i përgjigjet dilemës teologjike të shpëtimit falas në hirin e Perëndisë, veprën e përfunduar të Krishtit dhe në paralajmërimet e Frymës të kontrastuara me mandatin e gjithë-kushtueshëm të jetës së krishterë. E vetmja frikë e imja në përdorimin e këtij teksti si një koncept kyç është se sa rrallë përdoret në Shkrime kategoria teologjike e një të krishterit të tërhequr, mishor, foshnje! Kisha moderne përdor këtë koncept për të shpjeguar një kishë joefektive, apatike dhe sipas botës, por rrallë përshkruan mandatin e Dhjatës së Vjetër për rritje frymore (shih Heb. 5:11-14).

▣ **“do të shpëtohet”** Kjo shprehje ka një orientim eskatologjik. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: KOHËT E FOLJEVE GREQISHT QË PËRDOREN PËR SHPËTIMIN  
[SPECIAL TOPIC: SALVATION (GREEK VERB TENSES)]**

Shpëtimi nuk është produkt, por një marrëdhënie e përditshme. Nuk përfundon kur njeriu beson në Krishtin; sapo ka filluar (një portë dhe më pas një shteg, shih Mat. 7:13-14)! Nuk është policë sigurimi kundër zjarrit, as biletë për në qiell, por një jetë ku njeriu sa vjen e bëhet si Krishti (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3,7; 5:23; 1 Pjet. 1:15). Në Amerikë ekziston një proverb që thotë se, sa më tepër të jetojë çifti së bashku, aq më tepër i ngjasin njëri-tjetrit. Ky është synimi i shpëtimit!

**SHPËTIMI SI VEPRIM I PLOTËSUAR (AORIST)**

- Veprat e Apostujve 15:11
- Romakëve 8:24
- 2 Timoteut 1:9
- Titit 3:5
- Romakëve 13:11 (kombinon AORISTIN me një orientim TË ARDHSHËM)

**SHPËTIMI SI GJENDJE EKZISTENCE (E KRYERA)**

- Efesianët 2:5, 8

**SHPËTIMI SI PROCES I VAZHDUAR (E TASHMJA)**

- 1 Korintasve 1:18; 15:2
- 2 Korintasve 2:15
- 1 Pjetrit 3:21

**SHPËTIMI SI PËRMBUSHJE E ARDHSHME (KOHË E ARDHME në FOLJE, ose konteksti)**

- Romakëve 5:9, 10; 10:9, 13



- 1 Korintasve 3:15; 5:5
- Filipianëve 1:28
- 1 Thesalonikasve 5:8-9
- Hebrenjve 1:14; 9:28
- 1 Pjetrit 1:5, 9

Si rrjedhojë, shpëtimi fillon me një vendim fillestar besimi (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13), por kjo duhet të rezultojë në një proces besimi në stilin e jetesës (shih Rom. 8:29; Gal. 2:19-20; Efe. 1:4; 2:10), që, një ditë, do të përmbushet me shikim (shih 1 Gjonit 3:2). Kjo gjendje përfundimtare quhet përlëvdim (shih Rom. 8:28-30). Kjo mund të ilustruhet si

1. Shpëtimi fillestar – shfajësimi (shpëtuar nga ndëshkimi i mëkatit)
2. Shpëtimi përparues – shenjtërimi (shpëtuar nga fuqia e mëkatit)
3. Shpëtimi përfundimtar – përlëvdimi (shpëtuar nga prania e mëkatit)

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 3:16-17

**16 A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju? 17 Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë, sepse tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë.**

**3:16 “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë”** Nuk ka asnjë nyje me fjalën “tempull” (dmth., *naos*, vetë vendi i shenjtë qendror). Përemri “ju” është shumës, ndërsa “tempull” është njëjës, prandaj në këtë kontekst “tempull” duhet t’i referohet të gjithë kishës në Korint (shih 2 Kor. 6:16; Efe. 2:21-22), e cila mund të ketë përfshirë disa kisha shtëpish.

Fokusi i besimit hebraik zhvillohej në ritualet dhe liturgjinë e Tempullit (shih Jeremia 7) në vend të një besimi personal në YHWH. Nuk ka të bëjë me vendin apo kohën se kur adhurojmë, por me Atë me të cilin jemi në marrëdhënie, me Perëndinë. Jezusi e pa trupin e Tij si tempulli i Perëndisë (shih Gjoni 2:21). Jezusi është më i madh se sa Tempulli i Dhjatës së Vjetër (shih Mat. 12:6). Veprimtaria e Perëndisë ka lëvizur nga një ndërtesë e shenjtë në një trup të shenjtëruar besimtarësh (dmth., të shpenguar, të shenjtë). Fokusi i veprimtarisë së Perëndisë në botë janë njerëzit! Trupi i Jezusit tani është një vend, si i përbashkët ashtu edhe individual.

■ **“se Fryma e Perëndisë banon në ju”** “Banon” është një formë treguese aktive e tashme. “Ju” është në shumës. Koncepti i tempullit si një vend banimi unik i YHWH në Dhjatën e Vjetër paralelizohet këtu me konceptin e kishës si vendi i banimit të Frymës së Shenjtë.

Koncepti i hyjesisë që banon është i përsëritur në Dhjatën e Re. Të tre personat e Trinitetit thuhet se banojnë tek besimtarët.

1. Fryma (shih Gjoni 14:16-17; Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
2. Biri (shih Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
3. Të dy Biri dhe Ati (shih Gjoni 14:23 dhe 2 Kor. 6:16)

**3:17 “Në qoftë se dikush e prish tempullin e Perëndisë, Perëndia do ta prishë atë”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozon realitetin e besimtarëve jo frymorë të cilët dëmtojnë veprën e kishës (dmth., drejtuesit ose grupet e përçarë). Këtu theksi është mbi veprimet e besimtarëve individual. Kjo nuk prek shpëtimin e tyre, 1 Kor. 3:15, por jetëgjatësinë dhe shpërblimin e tyre.

Tragedia supreme e besimtarëve që jetojnë jetë egoiste dhe të pafrytshme është potenciali i burimeve që ata kanë në dispozicion. Ata e njohin ungjillin; ata kanë Frymën, e megjithatë ata dhe kisha dëmtohen nga veprimet e tyre. Këtu Luka 12:48 flet fuqishëm! A po flet për ty?

Termi *phtheirō* (shkatërroj) ka disa përdorime në Dhjatën e Vjetër.

1. Prish ose korrtoj fizikisht (dmth., fruta që prishen ose mish që priset, edhe metaforikisht për prishjen financiare)

2. Prish ose korruptoj moralisht (dmth., duke thyer rregullat e një konkursi atletik ose duke e joshur dikë seksualisht)
3. Shkatërroj
  - a. Fizikisht
  - b. Frymërisht
  - c. Përjetësisht

Vetëm konteksti i menjëherëshëm mund të përcaktojë kuptimin e tij. Këtu ai përdoret në fjali të nënreditura paralele, por është e pasigurtë nëse ka të njëjtin kuptim në secilën fjali të nënrenditur për shkak se e para i referohet kishës dhe e dyta një personi. Ky term në kontekst i referohet besimtarëve të shpëtuar, por të papjekur, të cilët po shkaktojnë zhvillimin e një fryme përcarëse në kishën në Korint. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:42.

Është e vështirë të përkufizosh çfarë do të thotë “shkatërroj” në këtë kontekst (shih Mat. 18:6; Luka 17:1-2; Rom. 14:15; 1 Kor. 5:5; 8:11; 1 Tim. 1:20).

Ndërsa po flas për këtë temë, unë personalisht nuk besoj se ky term (dhe termat e lidhur me të) mund të përdoren legjitimisht për të vërtetuar asgjesimin e personave të humbur (Fudge, *The Fire That Consumes* [Zjarri që Konsumon]), por në vend të saj, ndarjen e ndërgjegjshme dhe të përjetshme nga Perëndia (dmth., ferri, shih Dan. 12:2; Mat. 25:46; Veprat e Apo. 24:15).

Është madje e mundur që ajo së cilës i referohet Pali këtu lidhet me 1 Kor. 5:5 dhe 1 Tim. 1:20, ku kisha disiplinon dikë duke e nxjerrë nga marrëdhënia e tyre (por gjithmonë me shpresën dhe lutjen e restaurimit që vjen pas pendesës).

▣ **“tempulli i Perëndisë, i cili jeni ju, është i shenjtë”** Ky është një koncept i përbashkët. Nënkuptimi i lidhur dhe logjik është se besimtari individual është gjithashtu një tempull i Perëndisë (shih 1 Kor. 6:19). Të krishterët thirren për në shenjtëri (shih Mat. 5:48; Efe. 1:4).

#### TEMË E VEÇANTË: I SHENJTË (SPECIAL TOPIC: HOLY)

- I. Dhjata e Vjetër (ilustruar kryesisht nga Isaia)
  - A. Etimologjia e fjalës *kadosh* (BDB 872, KB 1072) është e pasigurtë; ka gjasa të jetë kanaanite (dmth., ugaritike). Ka mundësi që një pjesë e rrënjës së saj (pra, *kd*) të ketë kuptimin “ndaj”. Ky është burimi i përcaktimit popullor “i ndarë (nga kultura kanaanite, shih Ligji i Përt. 7:6; 14:2, 21; 26:19) për përdorim nga Perëndia”.
  - B. Ajo lidhet me praninë e Perëndisë në objekte, vende, kohë dhe persona të ndryshëm. Nuk përdoret te Zanafilla, por bëhet e zakonshme te Eksodi, Levitiku dhe Numrat.
  - C. Në literaturën profetike (sidomos te Isaia dhe Osea), elementi personal, që më parë ishte i pranishëm por jo i theksuar, tani del në pamje të pare (shih Temë e Veçantë: I Shenjti / Special Topic: The Holy One). Bëhet mënyrë për të përcaktuar thelbin e Perëndisë (shih Isa. 6:3). Perëndia është i shenjtë. Emri i Tij, që përfaqëson karakterin e Tij, është i shenjtë. Populli i Tij, që duhet t’ia zbulojë kësaj bote nevojtare karakterin e Tij, është i shenjtë (nëse i bindet besëlidhjes me besim).
1. MBIEMËR, BDB 872 שׁוֹדֵק, “i shenjtë”, i përdorur për
  - a. Perëndinë, Isa. 5:16; 6:3 (tri herë); shih Temën e Veçantë: I Shenjti / Special Topic: The Holy One
  - b. Emri i Tij, Isa. 40:25; 49:7; 57:15
  - c. Vendbanimi i Tij, Isa. 57:15
  - d. Shabati i Tij, Isa. 58:13
2. FOLJE, BDB 872 שׁוֹדֵק, “veçoj”, “shenjtëroj”
  - a. Karakteri i Perëndisë, Isa. 5:16; 29:23
  - b. Perëndia, Isa. 8:13; 65:5
  - c. Engjëjt e Perëndisë, Isa. 13:3
  - d. Emri i Perëndisë, 29:23
  - e. Festival, Isa. 30:29

- f. Njerëz të shenjtëruar, Isa. 66:17
3. EMËR, BDB 871 קדש, “veçim”, “shenjtëri”
- a. Farë e shenjtë, Isa. 6:13
  - b. Mal i shenjtë, Isa. 11:9; 27:13; 56:7 57:13; 65:11, 25; 66:20
  - c. I veçuar, Isa. 23:18
  - d. Udha e shenjtërisë, Isa. 35:8
  - e. Shenjtërorja, Isa. 43:28; 62:9; 64:11
  - f. Qytet i shenjtë, Isa. 48:2; 52:1
  - g. I Shenjti, Isa. 49:7 (shih Temën e Veçantë: I Shenjti / Special Topic: The Holy One)
  - h. Krah i shenjtë, Isa. 52:10
  - i. Ditë e shenjtë, Isa. 58:13
  - j. Popull i shenjtë, Isa. 62:12
  - k. Fryma e Shenjtë, 63:10,11
  - l. Froni i Perëndisë, Isa. 63:15
  - m. Vendi i shenjtë, Isa. 63:18
  - n. Qytete të shenjta, Isa. 64:10
- D. Mëshira dhe dashuria e Perëndisë janë të pandashme nga konceptet teologjike të besëlidhjeve, drejtësisë dhe karakterit thelbësor. Këtu qëndron tensioni brenda Perëndisë kundrejt njerëzimit të pashenjtë, të rënë dhe rebel. Është një artikull shumë interesant për marrëdhënien e Perëndisë si “i mëshirshëm” me Perëndinë si “i shenjtë”, te Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament (Sinonime të Dhiatës së Vjetër)*, f. 112-113.
- II. Dhiata e Re
- A. Shkrimtarët e Dhjatës së Re (përveç Lukës) janë mendimtarë hebrej, por që shkruanin në greqishten *koine*. Kisha e Dhjatës së Re përdorte përkthimin grek të Dhjatës së Vjetër, Septuagintën. Ajo që kontrollonte fjalorin e tyre nuk ishte feja, mendimi, apo literatura klasike greke, por përkthimi grek i Dhjatës së Vjetër.
  - B. Jezusi është i shenjtë ngaqë është nga Perëndia dhe si Perëndia (shih Luka 1:35; 4:34; Veprat e Apo. 3:14; 4:27, 30; Zbu. 3:7). Ai është i Shenjti dhe i Drejti (shih Veprat e Apo. 3:14; 22:14). Jezusi është i shenjtë ngaqë është i pamëkat (shih Gjoni 8:46; 2 Kor. 5:21; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pje. 1:19; 2:22; 1 Gjoni 3:5).
  - C. Për shkak se Perëndia është i shenjtë (shih Gjoni 17:11; 1 Pjet. 1:156-16; Zbu. 4:8; 6:10), fëmijët e Tij duhet të jenë të shenjtë (shih Lev. 11:44-45; 19:2; 20:7, 26; Mat. 5:48; 1 Pje. 1:16). Për shkak se Jezusi është i shenjtë, edhe ndjekësit e Tij duhet të jenë të shenjtë (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pje. 1:15). Të krishterët shpëtohen për të shërbyer në ngjashmëri me Krishtin (shenjtëria).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 3:18-23

<sup>18</sup> Askush të mos mashtrojë vetveten; në qoftë se ndonjë nga ju mendon se është i urtë në këtë kohë, le të bëhet i marrë, që të mund të bëhet i urtë. <sup>19</sup> Sepse dituria e kësaj bote është marrëzi pranë Perëndisë, sepse është shkruar: “Ai i zë të urtët në dinakërinë e tyre”; <sup>20</sup> dhe përsëri: “Zoti i njeh mendimet e të urtëve se janë të kota.” <sup>21</sup> Prandaj asnjë të mos mburret në njerëzit, sepse të gjitha gjërat janë tuajat; <sup>22</sup> Pali, Apoli, Kefa, bota, jeta, vdekja, gjërat e tanishme dhe gjërat e ardhshme, të gjitha gjërat janë tuajat. <sup>23</sup> Dhe ju jeni të Krishtit dhe Krishti është i Perëndisë.

**3:18 “Askush të mos mashtrojë vetveten”** Kjo është një formë urdhëruese e tashme me një prapashtesë mohuese, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që tanimë ka nisur. Disa nga besimtarët në Korint po krenoheshin nga anëtarësia e tyre ose besnikëria e tyre ndaj drejtuesve të caktuar dhe / ose njohurive të veçanta. Termi “mashtrojë” është një formë e intensifikuar e *apataō* (shih Efe. 5:6; 1 Tim. 2:14; Jakobi 1:26) me parashtesën *ek* (shih Rom. 7:11; 16:8; 2 Thes. 2:3). Ky term është sinonim me *planaō* (dmth., të endesh, të

devijosh, të largohesh), e cila përdoret në Ungjijt Sinoptikë (Mateu, Marku dhe Luka), në shkrimet e Gjonit dhe të Palit (shih 1 Kor. 6:9; 15:33 dhe mbiemri tek 2 Kor. 6:8). Vetëmashtrimi është një tragjedi frymore (shih Rom. 12:16; Gal. 6:3; 2 Tim. 3:13; 1 Gjoni 1:8). Pali mund të jetë duke aluduar ndaj Pro. 3:7 ose Isa. 5:21 ose madje Jer. 9:23-24. Shumë nga drejtuesit e grupeve në Korint mendonin se ishin të pjekur dhe të mençur, por ata po mashtronin vetveten.

■ **“në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Shumë në kishën korintase krenoheshin me nivelin e tyre frymor ose me dhuntitë apo njohuritë e tyre frymore. Këto tendenca janë të ngjashme me ato që më pas u quajtën Gnosticizëm. Historikisht është e pasigurtë nëse Korinti u ndikua nga ky ekskluzivizëm intelektual grek që u zhvillua. Ky sistem mendimi (një dualizëm radikal midis frymës dhe materies) nuk është i dokumentuar plotësisht deri në shekullin e dytë, por ishte një heresi kryesore e kishës së hershme.

■ **“ndonjë nga ju mendon se është i urtë në këtë kohë”** Kjo i referohet personit që mendon se ai / ajo ka njohuri apo status të veçantë. Në kishë kishte nga ata që pretendonin superioritet të bazuar në nivelin e tyre frymor, njohurinë, statusin social apo inteligjencën. Është e mundur që kjo t’i referohet grupit të drejtuesve ose grupeve të përmendura tek 1 Kor. 1:12; 3:5,21.

■ **“le të bëhet i marrë”** Kjo është një formë urdhëruese deponente aoriste e mesme. Ungjilli i Perëndisë, Krishti Vetë, është e vetmja urtësi e vërtetë. Ky term përdoret shpesh për të përshkruar “urtësinë e kësaj epoke” (shih 1 Kor. 1:18,27; dhe këtu). Pali madje e përdor atë tek 1 Kor. 4:10 në një kuptim sarkastik në lidhje me të krishterët korintas të cilët pretendonin dhe lartësonin urtësinë njerëzore. Shih Temën e Veçantë: Terma për Njerëz të Marrë tek 1 Kor. 15:36.

**3:19 “dituria e kësaj bote është marrëzi pranë Perëndisë”** Kjo është për shkak se ajo bazohet në njohuri të kufizuara, botërore dhe të rëna (shih 1 Kor. 1:18,21,23,25). Për “marrëzi” shih shënimin tek 1 Kor. 1:25.

**3:19-20** Citimet e mëposhtme të modifikuara pak janë nga Jobi 5:13 dhe Psalmi 94:11. Për termin “dinakëri” shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 4:2.

**3:21**

<b>NASB</b>	<b>“Prandaj asnjë të mos mburret në njerëzit”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“ndaj asnjëri të mos përlëvdohet në njerëzit”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“prandaj asnjëri të mos mburret për drejtuesit njerëzorë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“asnjë, atëherë, nuk duhet të mburret për atë që mund të bëjnë qeniet njerëzore”</b>
<b>NJB</b>	<b>“prandaj nuk duhet të ketë asnjë mburrje për qeniet njerëzore”</b>

Ky madje mund të jetë një aludim ndaj Jer. 9:23-24. Mburria njerëzore përmendet disa herë tek 1 Kor. (shih 1 Kor. 1:29,31; 3:21; 4:7; dhe 2 Kor. 5:12; 10:17; 11:12,18,30; 12:1,5,6,9). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 5:6. Ishte një problem i madh në Korint (dhe me njerëzit në përgjithësi). Ky problem përfshinte më shumë nga kisha se sa thjesht disa drejtues; ndjekësit janë gjithashtu përgjegjës. Kjo tingëllon shumë si arroganca dhe krenaria moderne denominacionale (dmth., unë jam i Calvin [Kalvinit]; unë jam i Wesley [Ueslit]; unë jam i . . ., shih 1 Kor. 4:6).

**3:21b-22** Pali po pranon se të gjitha gjërat (dmth., një listë shumë e ngjashme me Rom. 8:38-39) i përkasin besimtarëve përmes Krishtit duke përfshirë të gjithë predikuesit e përmendur. Termi *kosmos* (dmth., botë) përdoret këtu në një kuptim pozitiv për rregullin e krijuar (shih LXX të Zan. 1:31). Besimtarët janë bashkë-trashëgimtarë të të gjitha gjërave dhe të gjitha kohërave përmes Krishtit (shih Rom. 8:12-17). Mos e kufizoni veten tuaj.

<p><b>TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT I FJALËS <i>KOSMOS</i> (BOTË) [SPECIAL TOPIC: PAUL'S USE OF <i>KOSMOS</i> (WORLD)]</b></p>
--

Pali përdor fjalën *kosmos* në një sërë mënyrash.

1. gjithë rendi i krijuar (shih Rom. 1:20; Efe. 1:4; 1 Kor. 3:22; 8:4,5)
2. ky planet (shih 2 Kor. 1:12; Efe. 1:10; Kol. 1:20; 1 Tim. 1:15; 3:16; 6:7)
3. njerëzit (shih 1 Kor. 1:27-28; 4:9,13; Rom. 3:6,19; 11:15; 2 Kor. 5:19; Kol. 1:6)
4. njerëzit, të organizuar dhe duke funksionuar veçmas Perëndisë (shih 1 Kor. 1:20-21; 2:12; 3:19; 11:32; Gal. 4:3; Efe. 2:2,12; Fil. 2:15; Kol. 2:8,20-23). Është shumë e ngjashme me përdorimin e Gjonit (dmth., 1 Gjoni 2:15-17)
5. strukturat e tanishme të botës (shih 1 Kor. 7:29-31; Gal. 6:14, e ngjashme me Fil. 3:4-9, ku Pali përshkruan strukturat judaike).

Në disa mënyra, këto mbivendosen dhe është e vështirë të kategorizosh secilin përdorim të tyre. Kjo fjalë, ashtu si shumë të tjera në mendimin e Palit, duhen përcaktuar nga konteksti i atypëratyshëm dhe jo nga ndonjë përcaktim paraprak. Terminologjia e Palit është elastike (shih James Stewart, *A Man in Christ* [Një Njeri në Krishtin]). Ai nuk po përpiqej të formulonte një teologji sistematike, por të shpallte Krishtin.

**3:23 “ju jeni të Krishtit”** “Ju” është e theksuar dhe në shumës. Kjo tregon pozicionin e lartësuar të Krishtit në kishë (shih 1 Kor. 1:29-31). Kjo gjithashtu tregon drejt përgjegjësisë tyre si besimtarë.

▣ **“Krishti është i Perëndisë”** Kjo i referohet dorëzimit të përkohshëm të Krishtit tek Ati (shih 1 Kor. 11:3; 15:28). Kjo nuk është një çështje thelbi (shih Gjoni 1:1-3), por një çështje funksioni. Triniteti (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10) është i orientuar drejt detyrës.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Cili është dallimi midis qumështit dhe ushqimit të fortë siç lidhet me predikimin e krishterë?
2. A do të qëndrojnë të krishterët përpara Perëndisë në gjykim? Nëse po, pse?
3. Kujt po i drejtohen vargjet 1 Kor. 3:10-15?
4. A i referohet vargu 1 Kor. 3:16 besimtarëve të veçantë apo kishës në përgjithësi?
5. Çfarë kuptimi ka termi “shkatërroj” tek 1 Kor. 3:17? Si lidhet me 1 Kor. 3:15?
6. A do të thotë nënshtrimi i Krishtit ndaj Atit, i cili shihet qartazi tek 1 Kor. 3:23 dhe 15:28, se Ai nuk është hyjësi?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 4

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërbesa e Apostujve	Kujdestarë të Mistereve të Perëndisë	Zbatime	Apostuj të Krishtit	Konkluzione (3:18-4:13)
4:1-5	4:1-5	4:1-5	4:1-5	4:1-5
	Të Marrë për Hir të Krishtit			
4:6-13	4:6-13	4:6-7 4:8-13	4:6-7 4:8-13	4:6-13
	Përkujdesi Atëror i Palit	Adhurimi i Atit dhe Paralajmërimë		Thirrje
4:14-21	4:14-21	4:14-21	4:14-17 4:18-21	4:14-17 4:18-21

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimor udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### SKICIM I SHKURTËR I KAPITULLIT 4

- A. Vargjet 1-5 trajtojnë të krishterët që gjykojnë dhe që gjykohen.
- B. Vargjet 6-13 vënë në kontrast drejtuesit krenarë korintas dhe apostujt e vërtetë.
- C. Në vargjet 14-21 Pali diskuton autoritetin e tij dhe planet për udhëtim nën dritën e akuzave të kundërshtarëve.

### STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 4:1-5

<sup>1</sup> Kështu njeriu, pra, le të na mbajë për shërbëtorë të Krishtit dhe si administratorë të mistereve të Perëndisë. <sup>2</sup> E tjetra që kërkohet nga administratorët, është që secili të gjendët besnik. <sup>3</sup> Sa për mua, më intereson fort pak që të gjykohem prej jush ose prej një gjykate njerëzore; madje as vetveten nuk e gjykoj. <sup>4</sup> Sepse nuk jam i vetëdijshëm për asnjë faj, por për këtë nuk jam justifikuar, por ai që më gjykon është Zoti. <sup>5</sup> Prandaj mos gjykoni asgjë para kohe derisa të vijë Zoti, që do të nxjerrë në dritë gjërat e fshehta të errësirës dhe do të shfaqë këshillat e zemrave; dhe atëherë secili do të ketë lavdërimin e vet nga

**4:1 “Kështu njeriu, pra, le të na mbajë për”** Kjo është një formë urdhërore e tashme e mesme (deponente). Besimtarët duhet të vlerësojnë ose të konsiderojnë statusin e drejtimit. Për Mbretërinë e Perëndisë drejtimi është shërbimi / kujdestaria (shih Marku 10:42-44). Teologjia e Palit ndjek fjalët e Jezusit.

■ **“shërbëtorë të Krishtit”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES (SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP)**

**I. Në Dhjatën e Vjetër ("Shërbëtori Im")**

Ky ishte një titull respekti dhe thirrjeje (BDB 713, KB 774).

**A. Përdorej në një kuptim kolektiv**

1. Patriarkët si grup – Ligji i Përt. 9:27
2. profetët – 2 Mbr. 9:7; 17:13; Esdra 9:11; Jer. 7:25; 26:5; 29:19; 35:15; 44:4
3. Izraeli – Ps. 105:6; 136:22; Isa. 41:8-9; 42:18-19; 44:1,2,21; 45:4; 48:20; 49:3; Jer. 30:10; 46:27,28
4. Septuaginta shton një frazë tek Isa. 42:1, e cila e bën atë t'i referohet kombit të Izraelit (“Jakobi është shërbëtori im, do ta ndihmoj atë; Izraeli është i zgjedhuri im”)

**B. Përdorej në një kuptim individual**

1. Abrahami – Zan. 26:24; Ps. 105:6
2. Jobi – Jobi 1:8; 2:3; 42:7,8
3. Isaku – Zan. 24:14
4. Jakobi – 1 Kro. 16:13; Ps. 105:6; Ezek. 28:25
5. Moisiu – Eksod. 14:31; Num. 12:7-8; Ligji i Përt. 34:5; Jos. 1:1-2,7,13,15
6. Jozueu – Joz. 24:29; Gjyq. 2:8
7. Kalebi – Num. 14:24
8. Davidi – Ezek. 37:25
9. Zerubabeli – Hag. 2:23
10. Solomoni – 1 Mbr. 3:8
11. Isaia – Isa. 20:3; 44:26
12. Jezusi – Mate. 12:15-21 citon Isa. 42:1-4

**II. Tek Dhjata e Re (sidomos Korintasve)**

Drejtuesit e Perëndisë janë dhurata për kishën (Efe. 4:11), ata janë ende shërbëtorë, jo drejtorë! Pali përdor disa terma për të adresuar idenë e shërbëtorit / shërbenjësit në letrat ndaj korintasve.

**A. Ndhimë e brëndshme (kuptimi fillestar "të ngresh pluhur")**

1. *diakonos*, 1 Kor. 3:5; 2 Kor. 3:6; 6:4; 11:15 (dy herë), 23
2. *diakonia*, 1 Kor. 16:15; 2 Kor. 3:7,8,9 (dy herë); 4:1; 5:18; 6:3; 8:4; 9:1,13; 11:8
3. *dialoneō*, 2 Kor. 3:3

**B. shërbëtor ose ndihmës, *hupēretēs* (në Dhjatën e Re përdoret për shumë lloje të ndryshme ndihmësish), 1 Kor. 4:1**

**C. skllav (dikush që posedohet dhe drejtohet nga dikush tjetër)**

1. *doulos*, 1 Kor. 7:21,22 (dy herë), 23; 2 Kor. 4:5
2. *douloō*, 1 Kor. 9:19

**D. bashkëpunor, bashkëndihmues (i përbërë nga *sun* + punëtor) *sunergos*, 2 Kor. 1:24**

**E. furnizues (kuptimi fillestar “dikush që furnizon një kor”)**

1. *chorēgeō*, 1 Kor. 9:10
2. *epichorēgeō*, 2 Kor. 9:10

**F. shërbenjës (i përdorur në Septuagint për Jozefin ndaj Potifarit, Jozueun ndaj Moisiut, Samuelin ndaj Elit, Abishagun ndaj Davidit dhe levitët ndaj Izraelit - *leitourgia*, dmth., termi i përgjithshëm për shërbesë tek Septuaginti 2 Kor. 9:12)**

Të gjithë këta terma tregojnë të kuptuarit e Palit për shërbesën. Besimtarët i përkasin Krishtit. Sikurse Krishti iu shërbeu të tjerëve (shih Mark 10:45), besimtarët iu shërbejnë njëri-tjetrit (shih 1 Gjonit 3:16). Drejtimi i kishës është drejtim shërbyes (shih Mat. 20:20-28; Mark 10:32-45; Luka 22:24-27). Këto grupe arrogante, krenare në Korint e kishin keqkuptuar plotësisht ungjillin dhe kishin dështuar të kuptonin zemrën dhe shërbesën e Jezusit!

Besimtarët janë pjesë e një familjeje. Qëllimi nuk është i drejtuar tek besimtarët individualë por tek shëndeti dhe rritja e Trupit, familjes, fushës, ndërtimit të tempullit (të gjitha metafora të përbashkëta të Dhjatës së Re). Besimtarët janë të gjithë me dhunti (shih 1 Kor. 12:11) për të mirën e përgjithshme (shih 1 Kor. 12:7). Ne shpëtohem për të shërbyer!

■ **“administratorë”** Ky është një term i përbërë grek nga fjalët “shtëpi” dhe “ligj”. Ishte shërbëtori ai që menaxhonte shtëpinë / pronën dhe që jepte llogari tek pronari (dmth., termi tek Mate. 25:14-46; Luka 16:1, koncepti i “të shpërndash”, “ajo që i caktohet dikujt”). Ky është theksi mbi përgjegjësinë për dhe besueshmërinë e ungjillit (shih 1 Kor. 4:2; 4:1; 9:17; Kol. 1:25; 1 Thes. 2:4; Titit 1:7; 1 Pjet. 4:10). Perëndia do të gjykojë administratorët e Tij (shih 1 Kor. 4:4,5; 3:13). Çfarë privilegji dhe detyrimi i mrekullueshëm!

■ **“të mistereve të Perëndisë”** Ky term përdoret në mënyra të ndryshme nga Pali. Nxitja kryesore duket se është fakti që Perëndia do të bashkojë hebrenjtë dhe johebrejtë në një familje përmes Krishtit, duke përbushur në këtë mënyrë Zan. 3:15 dhe 12:3. Shih Temën e Veçantë: Misteri (Special Topic: The Mystery) tek 1 Kor. 2:1.

■ **“që secili të gjendët besnik”** Ky është mbiemri *pistos*. Jezusi përdori konceptin e një shërbëtori besnik tek Mate. 24:45; 25:21,23!

TEMË E VEÇANTË: BESO, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHJATËN E VJETËR (SPECIAL TOPIC: BELIEVE, TRUST, FAITH, AND FAITHFULNESS IN THE OLD TESTAMENT), shih 1 Korintasve 1:9

**4:3 “Sa për mua, më intereson fort pak që të gjykohem prej jush”** Pali ishte sulmuar personalisht nga disa grupe (dmth, foshnje në Krishtin, shih 1 Kor. 3:1, ose edhe nga kundërshtarë hebrenj të ngjashëm me Judaizerët e Galatasve) në Korint. Vlerësimi i tyre i urdhërit të tij apostolik nuk ishte shqetësimi i tij kryesor (edhe pse ishte e dhimbshme). Ai ishte i shqetësuar me mënyrën se si njerëzit e shihnin ungjillin dhe kishën (shih 1 Kor. 8:13; 9:19-23; 10:23,33; 2 Kor. 4:2; 5:11; Rom. 14:1-15:13).

■ **“ose prej një gjykate njerëzore”** Kjo është fjalë për fjalë “ditë njerëzore”. Ajo i referohet procesimeve të gjykatës njerëzore sikurse vargu 3:13 i referohet procesimeve të gjykatës “hyjnore” në ditën e fundit (shih 1 Kor. 1:8; 5:5). Sikurse vargu 4:3a i referohet *sarkinois* (dmth., besimtarëve të papjekur të 1 Kor. 3:1), kjo frazë i referohet *psuchikos* (dmth., njerëzve natyrorë pa Frymën) të 1 Kor. 2:14.

■ **“madje as vetveten nuk e gjykoj”** Është shumë e vështirë të gjykojë vetveten në mënyrën e duhur nga ana frymore. Shpesh besimtarët e gjykojnë vetveten shumë ashpër dhe i gjykojnë të tjerët shumë lehtëazi. Shpesh ne krahasojmë veten tonë me njerëzit e tjerë (shih 2 Kor. 10:12-18). Ne duhet të lejojmë Perëndinë të gjykojë (shih 1 Kor. 4:5). Ai e njeh zemrën dhe i njeh rrethanat (shih 1 Sam. 16:7; 1 Mbert. 8:39; 1 Kron. 28:9; Jer. 17:10; Luka 16:15; Veprat e Apo. 1:24).

**4:4 “Sepse nuk jam i vetëdijshëm për asnjë faj”** Përpara konvertimit të Palit ai ndihej në këtë mënyrë në lidhje me marrëdhënien e tij ndaj ligjit të Moisiut (shih Veprat e Apo. 23:1; Fil. 3:5-6). Fryma zbuloi lakminë e tij (shih Rom. 7:7) dhe Pali u bind për mëkat dhe iu përgjigj hirit të Perëndisë vetëm në Krishtin (shih Rom. 3:19-26). Ai jetoi dhe shërbeu në këtë hir si një administrator. Në paradoksin e hirit falas, por administrimit përgjegjës, ai kishte një ndërgjegje të pastër, por vetëm një Gjykatës hyjnor në një rrethanë eskatologjike mund të bëjë vlerësimin dhe shpërblimin e duhur!

NASB, NRSV  
NKJV

“shfajësuar”  
“drejtësuar”



**TEV** “i pafajshëm”  
**NJB** “justifikuar”

Kjo është një formë treguese pasive e përkryer. Është një term teknik ligjor që dikush është shfajësuar nga pasojat e një krimi (shih Rom. 3:24). Është teologjikisht e ngjashme me “asnjë dënim” tek Rom. 8:1 dhe kontekstin ligjor të Rom. 8:31-35. Në këtë kontekst, kjo do të thotë se Pali nuk është i lirë nga gjykimi hyjnor (shih 2 Kor. 5:10) vetëm për shkak se ndërgjegja e tij ishte e pastër.

▣ **“por ai që më gjykon është Zoti”** Administratorët do të japin llogari për besnikërinë e tyre (shih 1 Kor. 4:2; 3:11; 2 Kor. 5:10; 10:18).

**4:5**  
**NASB NKJV, NRSV** “prandaj”  
**TEV** “kështu”  
**NJB** “për këtë arsye”

Ky është konkluzioni i diskutimit të Palit mbi këtë temë dhe është një urdhërim i lidhur me vlerësimet e papjekura të njerëzve.

▣ **“mos gjykoni asgjë para kohe”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme me një pjesëz negative, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh së kryeri një veprim që është tanimë në proces (shih Mate. 7:1-5). Këto grupe të përçara ose aderuesit ndaj mësuesve të rremë e kishin gjykuar tanimë Palin. Pali duhet të ketë pasur shumë kritikë në Korint përgjatë viteve (shih 2 Kor. 10-12).

▣ **“derisa të vijë Zoti”** Ardhja e Dytë është e sigurtë; koha dhe mënyra janë të pasigurta. Vlerësimi i vërtetë duhet të presë deri në momentin e duhur (shih Mate. 13:24-30,36-43).

▣ **“që do të nxjerrë në dritë gjërat e fshehta të errësirës”** Edhe besimtarët do të japin llogari për qëllimet, planet dhe qëndrimet e tyre (shih 1 Kor. 3:13; Gjoni 3:17-21; Rom. 2:16; 2 Kor. 5:10), por lavdi Perëndisë, jo për mëkatet e tyre! Pali përdor të njëjtën fjalë “gjërat e fshehta” (*krupta*) disa herë.

1. Romakëve 2:16 – “gjërat e fshehta të njerëzve”
2. 1 Korintasve 4:26 – “gjërat e fshehta të errësirës”
3. 1 Korintasve 14:25 – “gjërat e fshehta të zemrës”
4. 2 Korintasve 4:2 – “gjërat e fshehta të turpit”

▣ **“dhe do të shfaqë qëllimet<sup>10</sup> e zemrave”** Kjo është thelbësore. Kjo është arsyeja pse vetëm Perëndia mund të gjykojë në mënyrë të drejtë. Besimtarët janë përgjegjës vetëm për ato që ata kuptojnë, por ata janë gjithmonë përgjegjës për qëndrimet dhe qëllimet e tyre. Besnikëria do të shpërblehet (shih 1 Kor. 3:8,14,15), mungesa e besnikërisë do të gjykohet (shih 1 Kor. 3:16-17). Shih TEMËN E VEÇANTË: ZEMRA (SPECIAL TOPIC: THE HEART) tek 1 Kor. 14:25.

▣ **“dhe atëherë secili do të ketë lavdërimin e vet nga Perëndia”** Kjo është një temë e përsëritur (shih Job 34:11; Ps. 62:12; Predi. 12:14; Jer. 17:10; 32:19; Mate. 16:27; 25:31-40; Rom. 2:16; 14:12; 1 Kor. 3:8; 2 Kor. 5:10; 1 Pjet. 1:17; Zbu. 2:23; 20:12; 22:12) bazuar në parimin e Gal. 6:7.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 4:6-7

<sup>6</sup> Dhe tani, o vëllezër, për të mirën tuaj, ia kalova këto gjëra vetes sime dhe Apolit, që nëpërmjet nesh të mësoni që të mos mendoni përtej asaj që është shkruar, që të mos krekoset ndonjë prej jush, njeri kundër tjetrit. <sup>7</sup> Sepse çfarë të bën të ndryshëm? Çfarë ke ti që nuk e ke marrë? Dhe, nëse e ke marrë, pse krenohesh sikur nuk e ke marrë?

**4:6**

<sup>10</sup> Versioni në shqip është: “këshillat” (shënim i përkthyesit).

**NASB** “unë i kam zbatuar këto në mënyrë figurative tek vetja ime dhe tek Apolli”  
**NKJV** “i kam transferuar në mënyrë figurative”  
**NRSV, TEV, NJB** “zbatuar”

Fjala greke “i kam zbatuar në mënyrë figurative” (dmth., *meteschēmatisa*, e cila është në formë treguese aktive aoriste) është shumë e vështirë për t’u përkthyer në këtë kontekst. Në kontekste të tjera, Fil. 3:21, forma aktive do të thotë “të transformosh”, dhe tek 2 Kor. 11:13-15, forma e mesme do të thotë “të fshehësh”. Ideja themelore është të transferosh një sërë rrethanash nga një grup në një grup tjetër. Pali po përdor vetveten dhe Apollin si shembuj për të gjithë drejtuesit.

**NASB** “që në ne ju të mund të mësoni të mos tejkaloni atë që është shkruar”  
**NKJV** “që në ne të mësoni që të mos mendoni përtej asaj që është shkruar”  
**NRSV** “që ju të mund të mësoni nëpërmjet nesh kuptimin e thënies ‘Asgjë përtej asaj që është shkruar’”  
**TEV** “vëzhgoni rregullat e duhura”  
**NJB** “asgjë përtej asaj që është shkruar”

Fraza “është shkruar” përdoret shpesh në Dhjatën e Re për të prezantuar citime nga Dhjata e Vjetër. Këtu duket se kjo frazë prezanton një fjalë të urtë mjaft të njohur. Interpretimet e mundshme janë

1. Një prezantim ndaj një citimi nga Dhjata e Vjetër (shih 1 Kor. 1:19,31; 3:19)
2. Një slogan partie të një nga grupeve në Korint
3. “të vëzhgosh rregullat e duhura” (dmth., besimtarët duhet të jetojnë në nënshtrim ndaj Shkrimeve:
  - a. Sidomos atyre që Pali ka cituar në kapitujt 1-3
  - b. Jo të shkosh përtej Shkrimeve sikurse disa nga mësuesit e rremë hebrenj)

**NASB** “në mënyrë që asnjë prej jush të mos bëhet arrogant për llogari të njërit kundër tjetrit”  
**NKJV** “që asnjë nga ju të mos krekoset për llogari të njërit kundër tjetrit”  
**NRSV** “në mënyrë që asnjë nga ju të mos krekoset në favor të njërit kundër tjetrit”  
**TEV** “asnjë nga ju nuk duhet të jetë krenar për një person dhe të përçmojë një tjetër”  
**NJB** “asnjë individ mes jush nuk duhet të mbushet me rëndësinë e vet dhe të bëjë krahasime, në dëm të tjetrit”

Termi grek *phusioō* fillimisht do të thoshte të ndezësh diçka (dmth., Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re] fq. 105, dhe Vincent, *Word Studies*, [Studime Fjale] fq. 766, nga *phusa* - shakull). Ajo më pas u përdor në letërsinë e krishterë (ndoshta e nisur nga Pali) në mënyrë metaforike për krenarinë ose arrogancën. Ky është një problem i madh për kishën në Korint. Pali përdor këtë fjalë tek 1 Kor. 4:6,18,19; 5:2; 8:1; 13:4 dhe në një listë të mëkateve tek 2 Kor. 12:20. Ajo përdoret vetëm jashtë letrave korintase në Dhjatën e Re tek Kol 2:18, ku i referohet vegimeve gnostike të njohurive të veçanta. Besimtarët nuk duhet të zgjedhin në mënyrë arrogante disa mësues në vend të disa të tjerëve. Ata duhet të gjykojnë shpallësit nga përmbajtja e mesazhit të tyre (1 Gjoni 4:1-6) dhe stili i tyre i jetesës (Mate. 7:1 dhe në vazhdim), jo nga prezantimi i tyre apo nga personaliteti i tyre apo nga preferencat e tyre personale apo nga drejtuesit njerëzor që ata shpallin si të tyre (dmth., denominacionin).

#### 4:7

**NASB** “Kush të konsideron ty më të lartë”  
**NKJV** “Çfarë të bën ty të ndryshëm nga të tjerët”  
**NRSV** “Kush shikon ndonjë gjë ndryshe në ty”  
**TEV** “Kush të ka bërë ty më të lartë se të tjerët”  
**NJB** “Kush të ka bërë ty kaq të rëndësishëm”

Përemri “ju” dhe foljet janë në njëjës në 1 Kor. 4:7, por është ende në një kontekst “secili nga ju”. Shumësi “ju” vazhdon tek 1 Kor. 4:8.

Termi i përbërë grek *diakrinō* përdoret shpesh tek 1 Korintasve në disa kuptime.

1. Për të preferuar ose për të referuar superioritet (shih 1 Kor. 4:7)

2. Për të gjykuar (shih 1 Kor. 6:5)
3. Për të bërë një dallim (shih 1 Kor. 11:29)
4. Për të studiuar (shih 1 Kor. 11:31; 14:29)
5. Për të dalluar (forma emërore e *diakrisis*, shih 1 Kor. 12:10)

Fjala e përbërë e lidhur *anakrinō* përdoret tek 1 Kor. 2:15 (dy herë); 4:3,4 dhe 14:24. Proçesi i duhur i vlerësimit midis besimtarëve dhe drejtuesve dhe midis drejtuesve dhe drejtuesve ishte thelbësor për kishën në Korint.

Ky format pyetje / përgjigje është një metodë tipike e mësimdhënies së Palit të njohur si “diatribe / fjalim i ashpër”. Është një teknikë e zakonitë e Dhjatës së Vjetër (shih Malakian) dhe rabinike. Pali duhet se i drejtohet drejtuesve krenarë të grupeve të përçara (ndoshta kishat shtëpi).

☐ **“Çfarë ke ti që nuk e ke marrë”** Pali po i rikujton këta drejtues krenarë se ata nuk ishin iniciuesit apo zbuluesit e së vërtetës, por marrësit e shërbesës së të tjerëve.

☐ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozon se është e vërtetë nga pikëpamja e shkrimtarit ose për qëllimet e tij letrare. Kjo është pyetja e tretë retorike e 1 Kor. 4:7. Disa drejtues dhe ndjekësit e tyre po vepronin sikur të ishin burimi i të vërtetave që ata shpallnin. Një tjetër problem i Korintit ishte mburrja njerëzore (shih 1 Kor. 1:29,31; 3:21; 4:7; 13:4). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 5:6.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 4:8-13

<sup>8</sup> Tashmë jeni të ngopur, tashmë jeni të pasur, tashmë u bëtë mbretër pa ne; dhe makar të ishit bërë mbretër, që edhe ne të mbretëronim me ju. <sup>9</sup> Sepse unë mendoj se Perëndia na ka paraqitur ne apostujt si të fundit, si njerëz të dënuar për vdekje; sepse u bëmë lojë për botën, për engjëjt dhe për njerëzit. <sup>10</sup> Ne jemi të marrë për Krishtin, por ju të urtë në Krishtin; ne jemi të dobët, por ju të fortë; ju jeni të nderuar, por ne të përbuzur. <sup>11</sup> Deri tani vuajmë nga uria, etja, e jemi të zhveshur; jemi të qëlluar me shuplaka dhe endemi pa shtëpi, <sup>12</sup> dhe mundohemi, duke punuar me duart tona; duke qenë të fyer, bekojmë; duke qenë të përndjekur, durojmë; <sup>13</sup> duke qenë të sharë, lutemi; jemi bërë si pislleku i botës, porsia plehurat e të gjithëve deri më sot.

**4:8-13** Kjo është një sarkazëm shokuese!

**4:8**

**NASB**

**“tashmë jeni të mbushur”**

**NKJV**

**“tashmë jeni të ngopur”**

**NRSV**

**“tashmë ju keni gjithçka që dëshironi”**

**TEV**

**“a keni tanimë gjithçka që ju nevojitet”**

**NJB**

**“ju keni gjithçka”**

Përemri “ju” është në shumës tek 1 Kor. 4:8,10. Ky term “i mbushur” normalisht përdoret për ngrënien fizike (shih Veprat e Apo. 27:38), por këtu ajo është një metaforë (shih Mate. 5:6) e krenarisë frymore. Vargu 8 mund të jetë tre pyetje (shih TEV) ose tre pohime (shih NASB, NKJV, RSV, dhe REB). Këto janë një seri pohimesh ose pyetjesh sarkastike të cilat zbulojnë krenarinë e drejtuesve të përçarë korintas. Ata mendonin se kishin arritur (dmth., forma perifrastike pasive e përkryer). Pali do të donte shumë që vërtet të kishin arritur, por kjo nuk ishte e vërtetë; veprimet e tyre zbuluan nivelin e tyre të pjekurisë (dmth., foshnje në Krishtin).

☐ **“mbretër... mbretëronim”** Pali po përdor pamje eskatologjike për të shkundur vetë-mjaftueshmërinë arrogante të drejtuesve. Në Krishtin, të gjithë besimtarët do të bashkë-mbretërojnë me Mbretin Jezus, por vetëm pas Ardhjes së Dytë. Këta drejtues e konsideronin vetveten se tanimë mbretëronin, duke folur në aspektin frymor.

**4:9 “Perëndia na ka paraqitur ne apostujt si të fundit, si njerëz të dënuar për vdekje”** Ky varg është një ilustrim i marrë nga një Marsh Triumfator Romak (shih Kol. 2:15), ku të burgosurit e dënuar (dmth., që zakonisht vriteshin më vonë në arenat romake, shih 1 Kor. 15:32) shfaqeshin të fundit në një paradë fituese romake.

## TEMË E VEÇANTË: DËRGOJ (*APOSTELLŌ*) [SPECIAL TOPIC: SEND [*APOSTELLŌ*]]

Kjo është fjalë e zakonshme në greqisht që do të thotë “dërgoj” (pra, *apostellō*). Ky term ka një sërë përdorimesh teologjike.

1. Në greqishten klasike rabinët e përdornin në kuptimin e dikujt që thirret dhe dërgohet si përfaqësues zyrtar i një tjetri, pak a shumë si fjala jonë “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20)
2. shpesh, ungjijtë e përdorin këtë term për dërgimin e Jezusit nga Ati. Te Gjoni, ky term merr ngjyrimë mesianike (Mat. 10:40; 15:24; Marku 9:37; Luka 9:48 dhe veçanërisht Gjoni 5:36,38; 6:29,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3, 8, 18, 21, 23, 25; 20:21 [si “apostull” ashtu edhe sinonimi i saj *pempō* përdoren në v. 21]). Përdoret për dërgimin e besimtarëve nga Jezusi (shih Gjoni 17:18; 20:21 [në v. 21 përmendet, si *apostellō*, ashtu dhe sinonimi i tij *pempō* tek Gjoni 20:21]).
3. Dhjata e Re e përdori emrin “apostull” për dishepujt
  - a. rrethi i brendshëm fillestar i dymbëdhjetë dishepujve (p.sh., Marku 6:30; Luka 6:13; Veprat 1:2, 26)
  - b. një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkëpunëtorësh apostolikë
    - (1) Barnaba (shih Veprat e Apo. 14:4, 14)
    - (2) Androniku dhe Juniasi (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)
    - (3) Apollo (shih 1 Kor. 4:6-9)
    - (4) Jakobi, vëllai i Zotit (Gal. 1:19)
    - (5) Silvani dhe Timoteu (1 Thes. 2:6)
    - (6) ndoshta Titi (2 Kor. 8:23)
    - (7) ndoshta Epafroditi (Fil. 2:25)
  - c. një dhunti e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
4. Pali e përdor këtë titull për vete në shumicën e letrave të tij si mënyrë për të pohuar autoritetin hyjnor të tij si përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titi 1:1).
5. Problemi me të cilin përballemi ne sot si besimtarë është se Dhjata e Re nuk e përkufizon se për çfarë bën fjalë kjo dhunti e vazhdueshme, apo si identifikohet te besimtarët. Qartazi, duhet bërë dallimi mes të Dymbëdhjetëve të parë (#3a) dhe përdorimit të mëvonshëm të kësaj fjale (#3b). Shih Temën e Veçantë: Frymëzimi, dhe Temën e Veçantë: Përndritja. Nëse “apostujt” e sotëm nuk janë të frymëzuar që të shkruajnë Bibël shtesë (pra, kanoni është i mbyllur; Juda v. 3; shih Temën e Veçantë: Kanoni), atëherë çfarë bëjnë ata që është e ndryshme nga profetët e Dhjatës së Re ose ungjilltarët (shih Efe. 4:11)? Ja mundësitë e mia:
  - a. Mbjellës misionarë kishash të reja në vende të paungjillizuara (kështu përdoret në Didake)
  - b. Udhëheqës pastorësh në një zonë ose denominacion të caktuar
  - c. ?

Mua më pëlqen alternativa #1.

▣ **“u bëmë lojë për botën, për engjëjt dhe për njerëzit”** Pali po i referohet detyrës së vështirë për të predikuar ungjillin (shih 2 Kor. 4:7-12; 6:3-10; 11:23-30).

Fraza “për engjëjt” mund të jetë e lidhur me Efe. 2:7; 3:10. Perëndia e ka zbuluar Vetveten ndaj botës engjëllore me anë të veprave të Tij ndaj njerëzve (shih 1 Pjet. 1:12).

**4:10 “Ne jemi të marrë për Krishtin”** Urtësia e Perëndisë është marrëzi ndaj botës, edhe ndonjëherë ndaj të krishterëve arrogantë. Për “të marrë” shih shënimin tek 1 Kor. 1:25 dhe Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:36.

▣ **“por ju të urtë në Krishtin... ju të fortë; ju jeni të nderuar”** Kjo është një sarkazëm thumbuese e cila vazhdon nga 1 Kor. 4:7-9.

▣ **“dobët”** Shih TEMË E VEÇANTË: DOBËSI (SPECIAL TOPIC: WEAKNESS) tek 2 Kor. 12:9.

**4:11 “Deri tani vuajmë nga uria, etja, e jemi të zhveshur; jemi të qëlluar me shuplaka dhe endemi pa shtëpi”** Këto vargje reflektojnë eksperiencën e vet Palit (shih 1 Kor. 4:7-12; 6:3-10 dhe 11:23-30, gjithashtu vini re Hebrejtë 11:34-38). Ai shkroi letrën e parë drejtuar Korintasve nga Efesi.

**4:12 “mundohe mi, duke punuar me duart tona”** Kjo reflekton theksin hebraik mbi përshtatshmërinë e punës manuale (shih Veprat e Apo. 18:3; 20:34; 1 Thes. 2:9; 2 Thes. 3:8). Ajo zhvlerësohet nga kultura greke, duke përfshirë edhe kishën në Korint.

■ **“duke qenë të fyer, bekojmë”** Pali po reflekton mësimet e Jezusit (shih Mate. 5:10-12; 1 Pjet. 2:23). Termi “fyer” (dmth., *loidoreō*) gjithashtu përfshihet në listën e mëkateve tek 1 Kor. 5:11 dhe 6:10 (dmth., *loidoros*). Vincenti, *Word Studies*, [Studime Fjale], thotë se ky term i referohet abuzimit personal verbal, ndërkohë që termi “sharë” (dmth., *dusphēmeō*, shih 1 Kor. 4:13) do të thotë shpifje publike (shih 1 Kor. 4:13; 2 Kor. 6:8). Unë nuk kam qenë në gjëndje që ta konfirmoj këtë dallim. Ato janë të dyja pjesë e një numri të madh të termave në gjuhën greke koine të përdorura në kategori semantike të “fyej dhe shaj” (shih Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon*, [Leksikoni Greqisht – Anglisht] vol. 1, fq. 433-434).

Pali përjetoi abuzim verbal nga shumë mësues të rremë, por ishte kisha në Korint që duhet ta ketë lënduar atë më së shumti. Një grup njerëzish që ai i drejtoi personalisht tek Krishti u bënë fyesit e tij më të mëdhenj.

**4:13 “lutemi”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

NASB	“ne jemi bërë si llumi i botës, fundërrinat e të gjithëve”
NKJV	“ne jemi bërë si pislleku i botës, pors i plehrat e të gjithëve”
NRSV	“ne jemi bërë si plehra të botës, fundërrinat e të gjithëve”
TEV	“ne nuk jemi më shumë se sa mbeturinat e botës; ne jemi llumi i tokës”
NJB	“ne trajtohe mi edhe tani si fundërrinat e botës, si më i ulëti llum”

Ky paragraf (1 Kor. 4:8-13) tregon dhimbjen personale të Palit të përfshirë në predikimin e ungjillit. Ai ndihej i turpëruar dhe i refuzuar jo vetëm nga jobesimtarët, por edhe nga këta drejtues korintas arrogantë.

Fraza e parë “llumi i botës” i referohet çfarë ka ngelur pas pastrimit të enëve të kuzhinës. Fjalë për fjalë është të pastros në të gjitha vendet dhe nga të gjitha anët.” Në përkufizimin e këtyre sinonimeve të rralla, është thelbësore të ngrihet pyetja e origjinës së metaforave të Palit.

1. Nëse ai përdor sfondin e Dhjatës së Vjetër sikurse shprehur përmes përkthimeve greke, Septuagint-it, ky term përdoret për një pastrim të thellë dhe me anë të tij edhe një shpërblese (shih Fjalët e Urta. 21:18). Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker në librin e tyre *Greek/English Lexicon* [Leksikoni Greqisht / Anglisht], fq. 647, dhe A. T. Robertson në librin e tyre *Word Pictures* [Pamje Fjale], fq. 108, sugjerojnë se mund të kuptohet si “kokë turku” ndoshta nga përdorimi i tij tek Tobit 5:19.
2. Nëse ai po përdor sfondin helenistik, dy termat në 1 Kor. 4:13 janë sinonime të asaj që do të hiqet me anë të një pastrimi të thellë.
3. Nëse ai po i përdor ato metaforikisht, atëherë ato të dyja thjesht i referohen turpërimit (shih Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker në librin e tyre *Greek/English Lexicon* [Leksikoni Greqisht / Anglisht], fq. 653).

Fraza e dytë “fundërrinat e të gjitha gjërave” gjithashtu i referohet asaj që është hequr në një proces pastrimi. Këto dy terma janë sinonime. Ato janë terma të forta, por përdoren si metafora ose shprehje. Ndoshta ato janë kaq të forta dhe të shumëngjyrshme për ne për shkak se janë terma të rrallë. Ato ndihmojnë Palin për të intensifikuar sarkazmën.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 4:14-21

<sup>14</sup> Këto gjëra nuk po i shkruaj që t’ju turpëroj, por që t’ju paralajmëroj si fëmijët e mi të dashur. <sup>15</sup> Sepse, edhe sikur të kishit dhjetë mijë mësues në Krishtin, nuk do të kishit shumë etër, sepse unë ju kam dhënë jetë në Krishtin Jezus, me anë të ungjillit. <sup>16</sup> Prandaj ju bëj thirrje të bëheni imituesit e mi. <sup>17</sup> Për këtë arsye ju kam dërguar Timoteun, që është biri im i dashur dhe besnik në Zotin. Ky do t’ju kujtojë udhët e mia në Krishtin ashtu siç mësoj kudo në çdo kishë. <sup>18</sup> Dhe disa u krekosën, sikur nuk do të vija më te ju; <sup>19</sup> por shpejt kam për të ardhur te ju, në dashtë Zoti, dhe kam për të njohur jo fjalën, po fuqinë e atyre që janë krekosur, <sup>20</sup> sepse mbretëria e Perëndisë nuk qëndron në fjalë, por në fuqi. <sup>21</sup> Çfarë

**4:14 “Këto gjëra nuk po i shkruaj që t’ju turpëroj”** Vargjet 8-13 ishin shumë sarkastike. Pali ndihet se ata duhet të turpërohen (shih 1 Kor. 6:5; 15:34). Është e pasigurtë nëse ky paragraf (dmth., 1 Kor. 4:14-24) drejtohet pas (dmth., kapitujt 1-4) apo përpara. Ata kishin shumë gjëra për të cilat të turpëroheshin.

▣ **“por që t’ju paralajmëroj si fëmijët e mi të dashur”** Pali po përdor metaforën e trajnimit të fëmijës për të inkurajuar korintasit (shih Efe. 6:4). Kjo është një fjalë e përbërë greke (dmth., “mendja” plus “të vendosësh”) e përdorur për të rikujtuar (shih 1 Kor. 10:11 dhe Titit 3:10). Një term i lidhur (dmth., “me” plus “kujtim”) përdoret tek 1 Kor. 4:17; 11:24-25; 2 Kor. 7:15.

**4:15 “nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë e cila nënkupton veprim të mundshëm.

<b>NASB</b>	<b>“mësues të panumërt”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“dhjetë mijë mësues”</b>
<b>NRSV, TEV</b>	<b>“dhjetë mijë rojëtarë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“dhjetë mijë shërbëtorë që kujdeseshin për ju”</b>

Kjo fjalë për fjalë është “mësues skllëvër” (shih Gal. 3:24). Këta skllëvër ishin përgjegjës për shoqërimin e djemve për në shkollë, duke i mësuar ata në shtëpi dhe duke i ruajtur ata nga rreziku.

▣ **“etër... at<sup>11</sup>”** Kjo është metafora e Palit për të përshkruar vetveten si një ungjilltar i cili fillimisht i drejtoi ata në besimin në Krishtin. Kjo meriton disi respekt dhe prioritet!

**4:16 “ju bëj thirrje të bëheni imituesit e mi”** Kjo është një formë urdhërore e tashme e mesme (deponente). Ne marrim fjalën në anglisht “mimic” nga ky term në greqisht “imitues”. Pali jetoi besimin e tij (shih 1 Kor. 11:1; Fil. 3:17; 4:9; 1Thes. 1:6; 3:9) dhe ai iu bënte thirrje këtyre drejtuesve të kishës në Korint që të bënin të njëjtën gjë.

▣ **“bëj thirrje”** Shih TEMËN E VEÇANTË: NGUSHËLLOJ (SPECIAL TOPIC: COMFORT) tek 1 Kor. 1:10.

**4:17 “ju kam dërguar Timoteun”** Ne nuk kemi informacion tjetër biblik mbi këtë vizitë. Timoteu u konvertua gjatë udhëtimit të parë misionar të Palit dhe u rekrutua si një ndihmës gjatë udhëtimit të dytë. Ai u bë miku i besuar i Palit, shoqëruesi, bashkë-punëtori dhe përfaqësuesi apostolik i tij. Dërgimi i Timoteut tregoi dashurinë dhe shqetësimin e Palit për këtë kishë. Por Pali shqetësohet se si disa në kishë do ta trajtojnë mikun e tij të ri dhe përfaqësuesin e tij personal, Timoteun (shih 1 Kor. 16:10-11). Shih TEMËN E VEÇANTË: TIMOTEU (SPECIAL TOPIC: TIMOTHY) tek 2 Kor. 1:1.

▣ **“ashtu siç mësoj kudo në çdo kishë”** Pali dëshironte të theksonte se kisha korintase kishte marrë të njëjtat mësimet si të gjitha kishat e tjera (shih 1 Kor. 7:17; 11:16; 14:33). Ato nuk ishin të veçanta apo të avancuara. Ato nuk kishin të drejtë të ishin ndryshe, të reja apo avangarde. Shih TEMËN E VEÇANTË: KISHË (SPECIAL TOPIC: CHURCH) tek 1 Kor. 1:2.

**4:18-21** Këto janë planet e ardhshme të udhëtimit të Palit, siç lidhen me Korintin. Ai e bën këtë për shkak se disa në kishë po përdorin mungesën e Palit si një mënyrë për ta sulmuar (shih 1 Kor. 4:18). Ata po pranojnë se (1) mungesa e Palit është një shenjë që ai nuk shqetësohej vërtet për këtë kishë ose (2) ai kurrë nuk i mbante premtimet e tij.

**4:18 “disa u krekosën”** Pali e ka përdorur këtë term tre herë në këtë kapitull (dmth., 1 Kor. 4:6,18,19) dhe disa herë në letrat drejtuar korintasve (shih 1 Kor. 5:2; 8:1; 13:4 dhe 2 Kor. 12:20). Ky ishte një problem i veçantë për këtë kishë. Shih shënimin tek 1 Kor. 4:6.

<sup>11</sup> Versioni në shqip është: “sepse unë ju kam dhënë jetë” ndërsa në anglisht është: “sepse unë u bëra at për ju” (shënim i përkthyesit).

**4:19 “shpejt kam për të ardhur te ju”** Pali kthehej e rikthehej për të forcuar kishat që ai nisi (shih 1 Kor. 11:34; 16:5). Pali dëshironte që të shkonte tek ato, por jeta e tij nuk i përkiste atij. Ai duhet të kërkonte dhe të ndiqte drejtimet e Frymës (shih Veprat e Apo. 16:6).

▣ **“në dashtë Zoti”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm. Kjo nuk ishte një frazë e pakuptimtë për Palin (shih 1 Kor. 16:7; Veprat e Apo. 18:21; Rom. 1:10; 15:32).

**NASB** “dhe do të zbuloj, jo fjalët e atyre që janë arrogant, por fuqinë e tyre”  
**NKJV** “dhe kam për të njohur jo fjalën e atyre që janë krekosur, po fuqinë”  
**NRSV** “dhe do të zbuloj jo bisedën e këtyre njerëzve arrogant, por fuqinë e tyre”  
**TEV** “dhe më pas do të zbuloj për veten time fuqinë që këta njerëz krenarë kanë, dhe jo thjesht çfarë ata thonë”  
**NJB** “dhe më pas do të zbuloj jo se çfarë thonë këta njerëz të vetë-rëndësishëm, por çfarë fuqie kanë ata”

Mësuesit e rremë ishin elokuent në fjalimet e tyre por të pafuqishëm në rezultate (shih Mateu 7).

**4:20 “mbretëria e Perëndisë”** Pali nuk përdor këtë koncept aq shumë sa e përdorte Jezusi (dmth., më së shumti tek Ungjijt Sinoptikë). Ajo i referohet mbretërimit të Perëndisë në zemrat njerëzore tani (shih Rom. 14:17), të cilat një ditë do të konsumohen mbi të gjithë tokën sikurse në qiell (shih Mate. 6:10). Pali përdor këtë frazë më shumë tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 4:20; 6:9; 15:24,50) se sa tek letrat e tjera të tij. Këta besimtarë kishin nevojë të dinin se ata ishin pjesë e një plani më të madh të krishter (shih 1 Kor. 4:17).

#### **TEMË E VEÇANTË: MBRETËRIA E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: THE KINGDOM OF GOD)**

Në Dhjatën e Vjetër, YHWH mendohej si Mbreti i Izraelit (shih 1 Sam. 8:7; Psa. 10:16; 24:7-9; 29:10; 44:4; 89:18; 95:3; Isa. 43:15; 44:6), ndërsa Mesia si mbreti ideal (shih Psa. 2:6; Isa. 9:6-7; 11:1-5). Me lindjen e Jezusit në Betlehem (6-4 para K.), mbretëria e Perëndisë hyri furishëm në historinë njerëzore me fuqi të re dhe me shpengim (besëlidhja e re, shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:27-36).

1. Gjon Pagëzori shpalli afërsinë e mbretërisë (shih Mat. 3:2; Marku 1:15).
2. Jezusi mësoi qartë se mbretëria ishte e pranishme në atë Vetë dhe në mësimet e Tij (shih Mat. 4:17, 23; 9:35; 10:7; 11:11-12; 12:28; 16:19; Marku 12:34; Luka 10:9,11; 11:20; 17:21; 21:31-32). Mirëpo mbretëria është edhe e ardhshme (shih Mat. 16:28; 24:14; 26:29; Marku 9:1; Luka 21:31; 22:16, 18).

Në paralelet sinoptike të Marku dhe Luka gjejmë frazën “mbretëria e Perëndisë”. Kjo temë e zakonshme e mësimet të Jezusit kishte të bënte me mbretërimin e tanishëm të Perëndisë në zemrat e njerëzve, që, një ditë, do të përmbushej mbi gjithë tokën. Kjo pasqyrohet në lutjen e Jezusit të Mat. 6:10. I shkruar për judenjët, ungjilli i Mateut preferonte frazën që nuk përdorte emrin e Perëndisë (Mbretëria e qiejve), ndërsa Marku dhe Luka, që iu shkruan johebrenjëve, përdorën termin e zakonshëm, duke përdorur emrin e hyjnisë.

Kjo është një frazë shumë kyçe në ungjijtë sinoptikë. Predikimi i parë dhe i fundit i Jezusit, si dhe shumica e shëmbëlltyrave të Tij, trajtuan këtë temë. Ajo flet për mbretërimin e Perëndisë në zemrat e njerëzve tani! Është e habitshme që Gjoni e përdor këtë frazë vetëm dy herë (dhe asnjëherë në shëmbëlltyrat e Jezusit). Në ungjillin e Gjonit, metaforë kyçe është “jeta e përjetshme”.

Tensioni në këtë frazë shkaktohet nga dy ardhjet e Krishtit. Dhjata e Vjetër përqendrohej vetëm te një ardhje e Mesisë së Perëndisë – një ardhje ushtarake, gjyquese dhe e lavdishme – por Dhjata e Re tregon se, herën e parë, Ai erdhi si Shërbëtori i Përvuajtur i Isaisë 53 dhe si mbreti i përlulur i Zak. 9:9. Dy epokat judaike (shih Temë e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka që do të Vijnë / Special Topic: This Age and the Age to Come), epoka e ligësisë dhe epoka e re e drejtësisë, mbivendosen. Tani, Jezusi mbretëron në zemrat e besimtarëve, por, një ditë, do të mbretërojë mbi gjithë krijimin. Ai do të vijë siç paratha Dhjata e Vjetër

(shih Zbulesa 19)! Besimtarët jetojnë në periudhën “tashmë, por ende jo” të mbretërisë së Perëndisë (shih Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj], fq. 131-134).

▣ **“nuk qëndron në fjalë, por në fuqi”** Për ta vendosur këtë të vërtetë në një fjalë të urtë amerikane: “veprimet flasin më shumë se sa fjalët” ose “prova shihet tek puna”.

**4:21 “thupër”** Kjo i referohet shkopit të mësuesit (shih 1 Kor. 4:15). Kjo kishë duhej të vendoste nëse Pali do të vinte si një at disiplinues apo si një at falës. Veprimet e tyre përcaktonin përqasjen e tij.

▣ **“një frymë zemërbutësie”<sup>12</sup>** Tek *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër] Robert Girdlestone ka një diskutim interesant të përdorimeve të termit “frymë” në Dhjatën e Re (fq. 61-63).

1. Frymërat e liga
2. Fryma njerëzore
3. Fryma e Shenjtë
4. Gjërat që Fryma prodhon në dhe përmes frymërave njerëzore
  - a. ‘jo një frymë robërie përkundrejt një fryme birërie’ – Rom. 8:15
  - b. ‘një frymë zemërbutësie’ – 1 Kor. 4:21
  - c. ‘një frymë besimi’ – 2 Kor. 4:13
  - d. ‘Frymën e diturisë dhe të zbulesës, në njohurinë e tij,’ – Efe. 1:17
  - e. ‘jo një frymë frike përkundrejt force, dashurie dhe urtësie’ – 2 Tim. 1:7
  - f. ‘frymën e gabimit’ përkundrejt ‘frymën e së vërtetës’ – 1Gjoni 4:6

Shih një tjetër shënim mbi “frymë” tek 2 Kor. 4:13.

*The Jerome Bible Commentary, NT*, [Komentari Biblik Xherom] fq. 260, përmend se kjo fjali e fundit tek 1 Kor. 4:21 mund të jetë një aludim ndaj Jobit 37:13.

## PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse nuk duhet që besimtarët të gjykojnë njëri-tjetrin apo të lejojnë të tjerët që të bëjnë një gjë të tillë? Si lidhet kjo me dëshminë tonë të krishterë?
2. Çfare thotë paragrafi, vargjet 6-13, mbi motivet dhe stilin e jetesës së shërbetarëve modernë?
3. Përkufizoni termin “Mbretëria e Perëndisë”.
4. Identifikoni dhe shpjegoni përdorimin e sarkazmës ironike të Palit në këtë kapitull.

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](http://www.biblelessons.org)

<sup>12</sup> Versioni në shqip është: “me dashuri dhe me zemërbutësi” (shënim i përkthyesit).



# 1 KORINTASVE 5

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
		Trazira në Korint (5:1-6:20)		
Gjykim Kundër Imoralitetit 5:1-8	Imoraliteti e Ndot Kishën 5:1-8	Një Rast Disiplinimi i Kishës 5:1-2 5:3-5 5:6-8	Imoraliteti në Kishë 5:1-5 5:6-8	Incesti në Korint 5:1-5 5:6-8
5:9-13	Imoraliteti Duhet Gjykuar 5:9-13	5:9-13	5:9-11 5:12-13	5:9-13a 5:13b

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### SFONDI TEOLOGJIK NDAJ DISIPLINËS SË KRISHTERË

- A. Ky është një nga disa pasazhe në Dhjatën e Re mbi disiplinën e kishës (shih 1 Kor. 5:2,7,13; 2 Kor. 2:5-7; 2 Thes. 3:14-15; 1 Tim. 1:20; Titit 3:10).
- B. Disiplina e Kishës ka tre qëllime.
  - a. Të mbajë reputacionin dhe integritetin e kishës lokale
  - b. Të ndihmojë dishepujt dhe të restaurojë një vëlla apo motër besëlidhjeje që ka bërë gabim (shih 2 Kor. 2:5-11; 2 Thes. 3:14-15)
  - c. Të bëjë që të krishterët e tjerë të mos mëkatojnë (shih 1 Tim. 5:20)
- C. Gjetet një përfaqje në faza.
  - a. Së pari, konfrontimi privat dhe nëse nuk është i suksesshëm, përjashtimi personal (shih Mate. 18:15; Gal. 6:1; 2 Thes. 3:14-15; Titit 3:10)
  - b. Së dyti, konfrontimi në grup të vogël (shih Mate. 18:16)
  - c. Së treti, përjashtimi publik nga marrëdhënia e krishterë (shih Mate. 18:17; 1 Kor. 5:1; 1 Tim. 1:20)
  - d. Qëllimi duhet të jetë gjithmonë për pendesë dhe restaurim, jo thjesht izolim dhe ndëshkim (shih 2 Kor. 2:6-8; Gal. 6:1)

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 5:1-2

<sup>1</sup> Kudo po dëgjohej se ndër ju ka kurvëri, madje një kurvëri të tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë, saqë një shkon me gruan e babait të vet. <sup>2</sup> Dhe ju u krekosët e madje nuk vajtuat, që të hiqet nga mesi juaj ai që ka kryer një punë të tillë.

**5:1 “Në fakt raportohet<sup>13</sup>”** Termi në anglisht “në fakt” është termi grek *holōs*, një formë e rrallë e cila ndodh disa herë tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 5:1; 6:7; 15:29). Është një formë e termit *holos*, e cila do të thotë “plotësisht”, “krejtësisht”. Kjo formë e rrallë duket se do të thotë “e njohur gjerësisht” (shih NJB). Kjo mund të ketë qënë një nga arsytet pse Pali ishte kaq i zemëruar me këtë imoralitet të dukshëm. Kisha korintase po lavdëronte në të dhe kjo gjë po raportohet gjerësisht tek kishat e tjera. Pali duhej të merrej me këtë veprim të të kapërcyerit të kufijve dhe me qëndrimin e kësaj kishe, përndryshe ato do të ndikonin negativisht tek të gjitha kishat (dmth., parimi i majasë, shih 1 Kor. 5:6-8).

▣ **“kurvëri”** Ky është termi grek “*porneia*” i cili ishte termi i përgjithshëm për lirshmërinë seksuale. Ne marrim fjalën pornografi nga kjo fjalë greke. Korinti grek njihej për shthurjen e tij seksuale. Edhe paganët e tjerë tmerrroshin nga lejueshmëria sociale ndaj imoralitetit në Korint. Shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali u largua nga Korinti].

Në Dhjatën e Vjetër ka një dallim midis termave “tradhëti bashkëshortore” (dmth., një ose të dy janë të martuar) dhe “kurvërim” (dmth., asnjëri nuk është i martuar), por ky nuk është rasti në gjuhën greke koine (shih Veprat e Apo. 15:20,29). Ky term i referohet cilëso sjellje seksuale të papërshtatshme (dmth., tradhëti bashkëshortore, kurvërim, homoseksualitet, madje edhe kryerjen e marrëdhënieve me kafshët). Këtu ka një thyerje të Lev. 18:8; Ligji i Përt. 27:20.

▣ **“të tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë”** Kjo marrëdhënie incesti ndalohej nga ligji i Moisiut (shih Lev. 18:8 dhe Ligji i Përt. 22:30), por gjithashtu duhet të ketë qënë tmerruese edhe për paganët imoralë të Korintit. Kjo ishte “e tepërt” edhe për kulturën romake të shekullit të parë (shih Gaius, *Inst. I*, 63 dhe *Oxford Classical Dictionary* [Fjalori Klasik i Oksfordit] 8, 539-540).

NASB, NKJV	“johebrenjtë”
NRSV	“paganët”
TEV	“të pafetë”
NJB	“johebrenjtë”

Pali po përdor këtë term në një kuptim të specializuar. Në Dhjatën e Vjetër kishte një dallim të fortë midis hebrejve dhe johebrejve. Fjala “kombet” kishte kuptim negativ. Pali po përdor këtu fjalën “johebrej / paganë” duke nënkuptuar jobesimtarët. Shumë prej atyre të cilëve ai po ju shkruante ishin në fakt jo hebrej.

NASB	“sa dikush ka gruan e babait të tij”
NKJV	“saqë një burrë ka gruan e babait të vet”
NRSV	“sa një burrë jeton me gruan e babait të tij”
TEV	“saqë një burrë shkon me njerikën e tij”
NJB	“saqë një prej jush po jeton me njerikën e tij”

Kjo me sa duket i referohet jetesës së këtij njeriu me njerikën e tij. Ky burrë

1. Kishte joshur njerikën e tij duke e larguar nga babai i tij
2. Po jetonte me njerikën e tij të divorcuar
3. Po jetonte me njerikën e tij vejushe

<sup>13</sup> Versioni në shqip është: “Kudo po dëgjohej” (shënim i përkthyesit).

5:2 Është e mundur që ta shikosh këtë varg si (1) tre pyetje; (2) tre pohime (NASB, NKJV) ose (3) një kombinim (shih NRSV, TEV, NJB, NIV).

NASB	“Ju jeni bërë arrogant”
NKJV	“ju jeni krekosur”
NRSV	“ju jeni arrogant”
TEV	“Si atëherë, mund të jeni krenarë”
NJB	“Dhe ju jeni kaq të mbushur me vetë-rëndësinë tuaj”

Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer e termit “krekosem”, e përdorur aq shpesh në letrën korintase (shih 1 Kor. 4:6,18,19; 5:2; 8:1; 13:4; 2 Kor. 12:20). Ajo ka foljen “jam” të lidhur me të, që e bën një formë perifrastike të përkryer, e cila nënkupton një kusht të vendosur. Problemi i vërtetë ishte qëndrimi i kishës (dmth., përemri dhe foljet në shumës). Ata ishin krenarë për këtë situatë.

Ky incident tmerrues ka disa disa arsye të mundshme.

1. Nga konteksti i përgjithshëm është e mundur që kjo shihej nga kisha si një shembull i risisë radikale që sjell shpëtimi
2. Ajo reflekton sfondin hebraik të Rabbi Aqibah i cili ilustron se si një i konvertuar i ri ishte një person plotësisht i ri (dmth., A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re] fq. 111), prandaj, në rrethanat korintase ky nuk ishte incest, por liri e krishterë (dmth., të qëniti i ri në Krishtin).

NASB	“dhe nuk vajtuat në vend të kësaj”
NKJV	“e madje nuk vajtuat”
NRSV	“A nuk duhet që të kishit vajtuar në vend të kësaj”
TEV	“Përkundrazi, ju duhet të mbusheni me trishtim”
NJB	“Do të kishte qënë më mirë nëse do të kishit vuajtur dhimbshëm”

Kjo fjalë greke (dmth., *pentheō*, shih Mate. 5:4; 9:15; 2 Kor. 12:21; Jakobi 4:9) përdorej për vajtimin e të vdekurve (shih Zbu. 18:8,11). Në shoqërinë hebraike vajtimi bëhej për të vdekurit, për tragjedi ose për blasfemi (shih Marku 14:63).

NASB	“që të hiqej nga mesi juaj”
NKJV	“që të mund të largohet nga mesi juaj”
NRSV	“do të ishte hequr nga mesi juaj”
TEV	“duhet të përjashtohet nga miqësia juaj”
NJB	“u përzhunë nga komuniteti”

Kjo është një formë aoriste pasive lidhore. Kjo fjalë greke do të thotë “të ngresh lart dhe të largosh,” shpesh duke përfshirë gjykim (shih Mate. 24:39) dhe shkatërrim (shih Gjoni 11:48). Qëllimi i disiplinës së kishës është i trefishtë.

1. Pastrimi i kishës lokale (dmth., si pastrimi nga mëkati ashtu edhe restuarimi i imazhit të saj në komunitetin lokal)
2. Reformimi dhe shpengimi i besimtarëve që gabojnë. Është thjesht e mundur për shkak të 1 Kor. 5:5 (gjithashtu, të njëjtat terma përdoren tek Luka 23:18) që kjo i referohet vdekjes së besimtar(ëve) që gabon/gabojnë.
3. Besimtarët e tjerë shohin disiplinën e Perëndisë dhe inkurajohen që të mos mëkatojnë.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 5:3-5

<sup>3</sup>Dhe unë, megjithëse nuk jam aty me trup, me frymë aty jam, dhe, sikur të isha i pranishëm, kam gjykuar tanimë atë që bëri këtë. <sup>4</sup>Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht, mbasi të mblidheni ju bashkë me frymën time, me fuqinë e Zotit tonë Jezu Krisht, <sup>5</sup>vendosa që t'i dorëzohet ky njeri në dorë të Satanit për prishjen e mishit, që t'i shpëtohet fryma në ditën e Zotit Jezus.

**5:3-5** Ky paragraf është një metaforë juridike. Pali po supozon se kisha thërriste një “gjykatë kishe” (shih Jakobi 2:1-4). Kisha e hershme ndiqte një model administrativ dhe adhurimi si të sinagogës. Këto gjykata ishin të zakonshme dhe shumë u përzunë nga sinagoga.

**5:3 “megjithëse nuk jam aty me trup, me frymë aty jam”** Këto janë të dyja forma pjesore aktive të tashme. Kjo qartazi tregon kuptimin e Palit të autoritetit të tij apostolik (shih 1 Kor. 5:3 & 5). Por vini re se ai dëshiron që kisha të konfirmojë vendimin e tij (shih 1 Kor. 5:4).

**TEMË E VEÇANTË: FRYMË (PNEUMA) NË DHJATËN E RE [SPECIAL TOPIC: SPIRIT (PNEUMA) IN THE NT]**

Termi greqisht “frymë” përdoret në mënyra të ndryshme në Dhjatën e Re. Ja disa klasifikime dhe shembuj përfaqësues.

- A. për Perëndinë Triun (shih Temë e Veçantë: Trinia / Special Topic: The Trinity)
  - 1. për Atin (shih Gjoni 4:24)
  - 2. për Birin (shih Rom. 8:9-10; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11)
  - 3. për Frymën e Shenjtë (shih Marku 1:11; Mat. 3:16; 10:20; Gjoni 3:5,6,8; 7:39; 14:17; Veprat e Apo. 2:4; 5:9; 8:29,35; Rom. 1:4; 8:11,16; 1 Kor. 2:4,10,11,13,14; 12:7)
- B. për forcën e jetës njerëzore
  - 1. për Jezusin (shih Marku 8:12; Gjoni 11:33,38; 13:21)
  - 2. për njerëzimin (shih Mat. 22:43; Veprat e Apo. 7:59; 17:16; 20:22; Rom. 1:9; 8:16; 1 Kor. 2:11; 5:3-5; 7:34; 15:45; 16:18; 2 Kor. 2:13; 7:13; Fil. 4:23; Kol. 2:5)
  - 3. gjërat që Fryma prodhon në dhe përmes frymërave njerëzore
    - a. jo një frymë skllavërie përkundrejt një fryme birërie – Rom. 8:15
    - b. një frymë zemërbutësie – 1 Kor. 4:21
    - c. një frymë besimi – 2 Kor. 4:13
    - d. një frymë urtësie dhe zbulëse në njohurinë e Tij – Efe. 1:17
    - e. jo një frymë frike por fuqie, dashurie dhe disipline – 2 Tim. 1:7
    - f. frymë gabimi përkundrejt frymës së së vërtetës – 1 Gjoni 4:6
- C. për botën shpirtërore
  - 1. qeniet shpirtërore
    - a. të mira (pra, engjëjt, shih Veprat e Apo. 23:8-9; Heb. 1:14)
    - b. të këqija (pra, demonët, shih Mat. 8:16; 10:1; 12:43,45; Veprat 5:16; 8:7; 16:16; 19:12-21; Efe. 6:12)
    - c. fantazmat (shih Luka 24:37)
  - 2. dallueshmëria shpirtërore (shih Mat. 5:3; 26:41; Gjoni 3:6; 4:23; Veprat e Apo. 18:25; 19:21; Rom. 2:29; 7:6; 8:4,10; 12:11; 1 Kor. 14:37)
  - 3. gjërat shpirtërore (shih Gjoni 6:63; Rom. 2:29; 8:2,5,9,15; 15:27; 1 Kor. 9:11; 14:12)
  - 4. dhuntitë shpirtërore (shih 1 Kor. 12:1; 14:1)
  - 5. frymëzimi i Frymës (shih Mat. 22:43; Luka 2:27; Efe. 1:17)
  - 6. trupi shpirtëror (shih 1 Kor. 15:44-45)
- D. Karakterizon
  - 1. qëndrimin e botës (shih Rom. 8:15; 11:8; 1 Kor. 2:12)
  - 2. procesin e mendimit të njerëzve (shih Veprat 6:10; Rom. 8:6; 1 Kor. 4:2)
- E. për sferën fizike
  - 1. era (shih Mat. 7:25, 27; Gjoni 3:8; Veprat 2:2)
  - 2. hukatja (shih Veprat 17:25; 2 Thes. 2:8)

Është e qartë se ky term duhet interpretuar në bazë të kontekstit të atypëratyshëm. Ka ngjyrimë të ndryshme kuptimore që mund t’i referohen (1) botës fizike; (2) botës së padukshme; (3) si dhe personave të kësaj bote fizike, ose të sferës shpirtërore.

Fryma e Shenjtë është ai person i Perëndisë triun që është më së tepërmi veprues në këtë fazë të

historisë. Epoka e re e Frymës ka mbërritur. Gjithçka që është e mirë, e shenjtë, e drejtë dhe e vërtetë lidhet me Frymën. Prania, dhuntitë dhe shërbesa e Tij janë kyçe për përhapjen e ungjillit dhe për suksesin e mbretërisë së Perëndisë (shih Gjoni 14 dhe 16). Ai nuk e tërheq vëmendjen tek Vetvetja, por tek Krishti (shih Gjoni 16:13-14). Ai dënon, bind, josh, pagëzon dhe pjek gjithë besimtarët (shih Gjoni 16:8-11).

▣ **“kam gjykuar tanimë atë që bëri këtë”** Kjo është një formë treguese aktive e përkryer. Pali e pranon autoritetin e tij edhe në mungesën e tij fizike dhe vendimi i tij qëndron.

**5:4 “Në emër të Zotit tonë Jezu Krisht”** Kjo është një mënyrë hebraike e të pranuarit të prestigjit dhe fuqisë së Krishtit të ringjallur si burim i autoritetit apostolik të Palit. Pali përfaqëson Atë dhe imiton Atë.

Gjendet një shumëllojshmëri e formave të “në emër të \_\_\_\_\_” në dorëshkrimet greke të këtij vargu.

1. “Jezusi ynë” në dorëshkrimet uncial B, D\*
2. “Jezus Krishti” në dorëshkrimin uncial  $\alpha$
3. “Jezus Krishti ynë” në dorëshkrimet uncial D<sup>2</sup>, F, G
4. “ynë” në Leximet e dorëshkrimeve me shkronja të vogla 1021 (shekulli i dymbëdhjetë)
5. “Jezus Krishti Zoti ynë” në dorëshkrimet me shkronja të vogla 81 (shekulli i njëmbëdhjetë)

United Bible Societies' Greek NT [Dhjata e Vjetër në Greqisht e Shoqërive Biblike të Bashkuara] në botimin e katërt (UBS<sup>4</sup>) thotë se është e vështirë të vendosësh, por preferon pikën e parë.

Po i njëjti problem me dorëshkrimin ndodh sërish tek 1 Kor. 5:5 (dhe gjithashtu tek 1 Kor. 5:11).

1. “Zot” tek MSS P<sup>46</sup>, B
2. “Zot Jezus” tek MS  $\alpha$
3. “Zoti Jezus Krisht” tek MS D
4. “Zoti ynë Jezus Krisht” tek MSS A, F, G, P

UBS<sup>4</sup> vlerëson pikën 1 si pothuajse të sigurtë.

**5:5 “t’i dorëzohet ky njeri në dorë të Satanit për prishjen e mishit”** “Dorëzohet” është termi grek *paradidōmi*, i cili përdoret në ungjijt për të dorëzuar dikë tek autoritetet për dënimin e duhur (shih Mate. 4:12; 5:25; 10:4,17; 18:34; 20:19; 26:15; 27:2,18,26) dhe tek Romakëve (shih Rom. 1:24,26,28) për të dorëzuar dikë tek fuqitë frymore të liga. Ky përdorim përshtatet më së miri me këtë kontekst (dmth., Satani i identifikuar).

Kjo është e ngjashme me 1 Tim. 1:20. Ka pasur shumë diskutime mes studiuesve dhe komentatorëve se çfarë përfshin kjo. Disa e shohin atë si të rezultonte në dënim përfundimtar fizik (dmth., vdekje), sikurse tek Veprat e Apo. 5 dhe 1 Kor. 3:17; 11:30. Të tjerë e shohin atë si një dënim të plotë, duke vendosur dikë në hapësirën e veprimtarisë së Satanit, që është bota (shih Gjoni 12:31; 16:11; 1 Kor. 4:4; 1 Gjoni 5:19), ku largimi i tij nga marrëdhënia me Perëndinë dhe popullin e Tij mund ta kthejë atë sërish tek Perëndia dhe të shmangë gjykimin eskatologjik. Pali pa botën si një sferë të Satanit (shih Efe. 2:2). Ligësia që ndodh në këtë botë (dmth., vdekja, sëmundja, humbja etj.) i atribuohet të ligut, Satanit (shih 2 Kor. 12:7; 1 Thes. 2:18). Gjithashtu është e mundur që “mish” mund t’i referohet stilit rebel sensual të jetesës njerëzore (dmth., natyra e rënë Adamike). Shih Temën e Veçantë: I ligu Personal tek 1 Kor. 7:5.

Për fjalën “mish” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

▣ **“që t’i shpëtohet fryma”** Disiplina e kishës duhet që gjithmonë të jetë shpenguese dhe restauruese, jo ndëshkimore (shih 2 Kor. 2:5-11; 2 Thes. 3:14-15). Ky është kuptimi i Dhjatës së Vjetër për fjalën “shpëtuar”, e cila do të thotë çlirim fizik. Ky person, edhe pse sillet në mënyrë imorale, është një anëtar i kishës. Ai ka nevojë për çlirim frymor, jo për shpëtim.

Sikurse shumë shpesh në shkrimet e Palit, trupi fizik dhe fryma vendosen në kontrast (p.sh., Rom. 8:1-11). Ata përfaqësojnë dy struktura të ndryshme autoriteti, dy pikëpamje, dy aleanca (shih Mate. 6:19-34; 1 Gjoni 2:15-17). Një pikë tjetër teologjike mbi 1 Kor. 5:5: Satani përdoret nga Perëndia për qëllimet e Tij shpenguese. Në Dhjatën e Vjetër Satani është një armik i njerëzimit, por një shërbëtor i Perëndisë (shih A. B. Davidson, *An OT Theology* [Një Teologji e Dhjatës së Vjetër], fq. 300-306). Marrëdhënia intensifikohet në Dhjatën e Re. Satani bëhet një armik i Perëndisë, por ai është ende një shërbëtor i pabindur. Satani përdoret nga Perëndia tek 1 Kor. 5:5 për të sjellë shpëtimin përfundimtar tek një anëtar kishe që ka gabuar.

■ **“në ditën e Zotit Jezus”** Kjo dukshëm i referohet një rrethane eskatologjike të ditëve të fundit. Gjykimi i përkohshëm i Perëndisë ndaj të krishterëve mund të shihet tek 1 Kor. 11:30-32; Veprat e Apo. 5 dhe 1 Tim. 1:20. A nënkupton ky tekst (1) vdekje fizike, por shpëtim eskatologjik, 1:8 apo (2) shpëtimi varet nga pendesa e tij? Gjendet një theks eskatologjik i përsëritur tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 1:7-8; 3:13; 4:5; 5:5; 6:14; 11:26; 13:12; 15:50-54; 16:22). Ndoshta një nga problemet teologjike në kishën korintase ishte eskatologjia e mbi-kuptuar e kombinuar me një gnosticizëm fillestar. Ata mendonin se kishin arritur nga ana frymore (shih 1 Kor. 4:7-10) dhe se trupi ishte i lig (dmth., mendimi grek) dhe prandaj, nuk kishte lidhje me çështjet frymore. Pali i përgënjeshtroi këto tendenca duke

1. Pranuar një gjykim të ardhshëm sikurse një gjykim të tashëm (shih 1 Kor. 5:5)
2. Theksuar papërshtatshmërinë e imoralitetit për besimtarët (shih 1 Kor. 5:5-6)

Gjithashtu, vini re se frazat e Dhjatës së Vjetër që i referohen YHWH tani janë transferuar tek Jezusi (shih 1 Kor. 1:8; 2 Kor. 1:14; 1 Thes. 5:2; 2 Thes. 2:2; 2 Tim. 4:8). Kjo është një nga mënyrat letrare që autorët e Dhjatës së Re pranojnë hyjësinë e Jezusit të Nazaretit.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 5:6-8

<sup>6</sup>Mburrja juaj nuk është e mirë. A nuk e dini se pak maja e mbrun gjithë brumin? <sup>7</sup>Hiqni, pra, majanë e vjetër, që të jeni një brumë i ri, siç jeni pa maja; sepse pashka jonë, që është Krishti, u flijua për ne. <sup>8</sup>Prandaj le të krentojmë festën jo me maja të vjetër, as me maja ligësie dhe keqësie, por me bukë pa maja të sinqeritetit dhe të së vërtetës.

**5:6 “Mburrja juaj nuk është e mirë”** Ky koment ndihmon të interpretosh qëndrimin e kishës korintase. Ata po shpallnin një liri dhe lejim të bazuar mbi ungjillin. Ata dëshironin të kapardiseshin me lirinë e tyre të re në vend që të jepnin një dëshmi të ungjillit ndaj komunitetit të tyre.

#### TEMË E VEÇANTË: MBURRJA (SPECIAL TOPIC: BOASTING)

Këto terma greke, *kauchaomai*, *kauchēma* dhe *kauchēsis* përdoren rreth tridhjetë e pesë herë nga Pali dhe vetëm dy herë në pjesën tjetër të Dhjatës së Re (të dyja tek Jakobi). Përdorimi i tij kryesor është në 1 dhe 2 Korintasve.

Ka dy të vërteta kryesore të lidhura me mburrjen.

- Asnjë mish nuk do të lavdërohet/mburret para Perëndisë (shih 1 Kor. 1:29; Efe. 2:9)
- Besimtarët duhet të lavdërohen në Zotin (shih 1 Kor. 1:31; 2 Kor. 10:17, që është një aluzion ndaj Jer. 9:23-24)

Prandaj, ka mburrje/lavdërim (dmth., krenari) të duhur dhe jo të duhur.

##### A. E duhur

1. në shpresën e lavdisë (shih Rom. 4:2)
2. në Perëndinë përmes Zotit Jezus (shih Rom. 5:11)
3. në kryqin e Zotit Jezu Krisht (dmth., tema kryesore e Palit, shih 1 Kor. 1:17-18; Gal. 6:14)
4. Pali mburret për
  - a. Shërbesën e tij pa shpërblim (shih 1 Kor. 9:15,16; 2 Kor. 10:12)
  - b. Autoritetin e tij nga Krishti (shih 2 Kor. 10:8,12)
  - c. Faktin që nuk mburret me punën e të tjerëve (siç bënin disa në Korint, shih 2 Kor. 10:15)
  - d. Prejardhjen e tij etnike (siç bënin të tjerë në Korint, shih 2 Kor. 11:17; 12:1,5,6)
  - e. Kishat e tij
    - (1) Korinti (2 Kor. 7:4,14; 8:24; 9:2; 11:10)
    - (2) Selaniku (shih 2 Thes. 1:4)
    - (3) Sigurinë e tij në ngushëllimin dhe çlirimin e Perëndisë (shih 2 Kor. 1:12)

##### B. Jo e duhur

1. në lidhje me trashëgiminë e tij hebreje (shih Rom. 2:17,23; 3:27; Gal. 6:13)
2. disa në kishën e Korintit po mburreshin
  - a. në njerëzit (shih 1 Kor. 3:21)

- b. në urtësinë (shih 1 Kor. 4:7)
- c. në lirinë (shih 1 Kor. 5:6)
- 3. mësuesit e rremë u përpoqën të mburreshin me kishën në Korint (shih 2 Kor. 11:12)

■ **“A nuk e dini”** Kjo është një frazë karakteristike e përdorur shpesh nga Pali për t’iu referuar gjërave që besimtarët duhet të kishin dijëni, gjërave që iu ishin komunikuar më parë atyre, por që ata shpesh me sa duket (dmth., për shkak të veprimeve dhe qëndrimeve të tyre) i harronin (shih Rom. 6:16; 11:2; 1 Kor. 3:16; 5:6; 6:2,3,9,15,19; 9:13,24).

■ **“maja”** Kjo i referohet një fjale të urtë hebraike (shih Mate. 16:6,12; Gal. 5:9) mbi majanë, shpesh në një kuptim negativ, duke e krahasuar me kalbësirën, për shkak të procesit të fermentimit. Megjithatë, ndonjëherë metafora ka një aspekt pozitiv (shih Mate. 13:33; Luka 13:20-21), e cila tregon se kuptimi lidhet me kontekstin.

### TEMË E VEÇANTË: MAJA (SPECIAL TOPIC: LEAVEN)

Termi “maja” (BDB 329, KB 329; greqisht, *zumē*) përdoret në dy kuptime si në Dhjatën e Vjetër ashtu edhe në Dhjatën e Re:

1. Në kuptim korrupsioni, kështuqë, është një simbol i së ligës
  - a. Eksod. 12:15,19; 13:3,7; 23:18; 34:25; Lev. 2:11; 6:17; Ligji i Përt. 16:3
  - b. Mate. 16:6,11-12; Mark 8:15; Luka 12:1; Gal. 5:9; 1 Kor. 5:6-8
2. Në kuptim depërtimi, kështuqë, është një imazh i ndikimit, jo një simbol i së ligës
  - a. Lev. 7:13; 23:17; Amos 4:5
  - b. Mate. 13:33; Luka 13:20-21

Vetëm konteksti mund të përcaktojë kuptimin e kësaj fjale (e cila është e vërtetë!).

Mbi temën e bukës pa maja, Izraelitët nuk mund të prisnin deri në mëngjes që buka të vinte. Ky detaj i natës së eksodit nisi festën e Pashkës së Eksodit e kombinuar me festën bujqësore (shih Eksod. 12:15-20; 23:14-17; 34:18).

Majaja përdorej rregullisht në sendet sakrifikuere (shih Lev. 7:13; 23:17), por më vonë u bë simbol i mëkatit dhe rebelimit. Fermentimi shihej në këtë kuptim simbolik si mundësia e Izraelit mbi bazë individuale për të studiuar jetët e tyre nëse kishin ndonjë shenjë rebelimi apo mosbindjeje ndaj YHWH. Ndërsa dita e Pajtitimit (Levitiku 16) funksiononte në nivel kombëtar, Festa e Bukës pa Maja funksiononte në nivel individual ose familjar.

Kjo festë e detyrueshme vjetore, e kombinuar me festën e Pashkës, e mbante çlirimin e hirshëm të YHWH të freskët në mendjet dhe zemrat e popullit të Tij. Ndërsa hiri dhe premtimi siguronin çlirim nga Egjipti, po kështu Izraeli varej nga këto karakteristika hyjnore për ta shpëtuar atë ndërsa vitet kalonin (shih Eksod. 13:8,14; Ligji i Përt. 4:9; 6:2,7,20-21).

**5:7 “Hiqni, pra, majanë e vjetër”** Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste. Ajo është një aludim ndaj traditës hebraike të heqjes së majasë nga shtëpia menjëherë përpara Pashkës çdo vit (shih Eksod. 12:15). Rituali i përvitshëm ishte një simbol i pendesës.

NASB  
NKJV  
NRSV  
TEV

“që ju të mund të jeni një sasi e re, sikurse jeni në fakt pa maja”

“që ju të mund të jeni një brumë i ri, siç jeni pa maja”

“që ju të mund të jeni një grumbull i ri, sikurse jeni në të vërtetë pa maja”

“që ju të jeni tërësisht të pastër. Atëherë ju do të jeni si një pjesë e re brumi pa asnjë maja, sikurse në fakt ju njoh se jeni”

NJB

“që ju të mund të jeni një brumë i freskët, pa maja sikurse jeni”

Kjo tregon kombinimin tipik të Palit të urdhërimit MORAL të lidhur me pohimin POZICIONAL. Ajo që ne jemi në Krishtin pozicionalisht, duhet të bëhemi sipas stilit të jetesës të ngjashëm me Krishtin. Ata ishin populli i Perëndisë (dmth., pa maja), por do të ishin populli eskatologjik i Perëndisë (dmth., brumi i ri).

NASB	“sepse Krishti Pashka jonë gjithashtu është flijuar”
NKJV	“sepse në të vërtetë Krishti, Pashka jonë, u flijua për ne”
NRSV	“sepse festa jonë e Pashkës është gati, tani që Krishti, qengji ynë i Pashkës, është flijuar”
TEV	“sepse festivali ynë i Pashkës është gati, tani që Krishti, qengji ynë i Pashkës është flijuar”
NJB	“sepse Pashka jonë është flijuar, që është, Krishti”

Pali lidh vdekjen e Krishtit me konceptin e Dhjatës së Vjetër të Qengjit të Pashkës (shih Eksod. 12:15 e në vazhdim; 13:7). Ky është një nga vendet e pakëta në Dhjatën e Re ku kjo lidhje pohohet specifikisht:

1. Gjon Pagëzori e pa këtë lidhje dhe e thirri Jezusin “Qengji i Perëndisë, që heq mëkatën e botës!” tek Gjoni 1:29.
2. Gjon 19:36 përdor një citim nga Pashka e Eksodit nga Eksod. 12:46.

**5:8 “Prandaj le të kremtojmë festën”** Kjo është një formë lidhore aktive e tashme (një formë lidhore nxitëse bën thirrje për veprim). Ajo lidhet me të vetmen ditë të agjërimit në Dhjatën e Vjetër (shih Levitiku 16), të quajtur Ditën e Pajtit tek 1 Kor. 5:7, ndërkohë që 1 Kor. 5:7b dhe lidhen me Festën e Pashkës (shih Eksodi 12). Kjo i referohet stilit tonë të vazhdueshëm të jetesës për shkak të veprës së Krishtit për ne dhe në ne, por me një element kontigjence (dmth., forma lidhore).

■ **“jo me maja të vjetër”** Kjo i referohet Besëlidhjes së Re në Krishtin (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). Kjo besëlidhje e re e përjashton mburrjen dhe arrogancën njerëzore. Vdekja e Krishtit ishte çasti vendimtar i zbulësës biblike.

■ **“as me maja ligësie dhe keqësie”** Në kontekst dhe në kontrast, Pali po pranon qëllimet dhe veprimet e papërshtatshme, madje të liga, të disa nga grupeve në kishat shtëpi të Korintit.

■ **“por me bukë pa maja të sinqeritetit”** Kjo fjalë e rrallë (sinqeriteti) është ndoshta e përbërë nga termat “treze dielli” dhe “grykoj”. Ajo përçon konceptin e qëllimeve të pastra, të pafshehta (shih 1 Kor. 5:8; 2 Kor. 1:12; 2:17; Fil. 1:10; 2 Pjet. 3:1).

■ **“vërtetës”** Etimologjia e *alētheia* është “të ekspozosh, të zbulosh, të manifestosh qartazi”, që është paralelizëm me rrënjën e fjalës “sinqeritet”. Pali është i shqetësuar për qëllimet! Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 13:8.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 5:9-13

<sup>9</sup> Ju kam shkruar në letër, të mos përziheni me kurvarë, <sup>10</sup> dhe aspak me kurvarët e kësaj bote, ose me lakmuesit ose me cubat, ose me idhujtarët, sepse atëherë duhet të dilni nga bota. <sup>11</sup> Por tani ju shkrova të mos përziheni me atë, të ashtuquajturin vëlla, që është kurvar, ose lakmues ose idhujtar, o shpi-fës, o pijanec ose cub; me një të tillë bile as të mos hani bashkë. <sup>12</sup> Sepse a më takon mua të grykoj edhe ata që janë jashtë? A nuk i grykoni ju të brendshmit? <sup>13</sup> Por ata të jashtëmit Perëndia i grykon. Prandaj nxirreni të ligun nga vetja juaj.

**5:9 “Ju kam shkruar në letër”** Kjo ndoshta i referohet një letre të humbur (shih A, T, Robertson, *Word Pictures in the New Testament*, [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re] fq. 115, dhe M. R. Vincent, *Word Studies in the New Testament* [Studime Fjale në Dhjatën e Re] fq. 769). Është e mundur që të jenë humbur disa nga letrat e Palit (shih Kol. 4:16) ose mund të jetë një formë aoriste e shkrimit të letrave (shih 1 Kor. 9:15), që do t’i referohej 1 Korintasve, të cilëve ai po i shkruante në atë moment (shih 1 Kor. 5:11). Shih Hyrjen tek 1 Korintasve, VII. C.



■ **“kurvarë”** Ky është termi grek  *pornos*  (shih 1 Kor. 5:9,10,11; 6:9). Ai lidhet me “imoralitetin” (dmth., *porneia* shih 1 Kor. 5:1 [dy herë]; 6:13,18; 7:2; 2 Kor. 12:21) dhe “bërjen e imoralitetin” (dmth., *porneuō*, shih 1 Kor. 6:18; 10:8).

Këta besimtarë të rinj në Korint ishin më së shumti paganë (ndoshta romakë). Paganët adhuronin me vepra dehjeje dhe seksuale në tempujt e perëndive të tyre dhe në darka special publike dhe private. Besimi i tyre i ri në Krishtin ishte ende i përzierë me të shkuarën dhe kulturën e tyre pagane.

**TEMË E VEÇANTË: VESET DHE VIRTYTET NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: VICES AND VIRTUES IN THE NT)**

Listat e veseve dhe virtyteve përmenden shpesh në Dhjatën e Re. Shpesh, ato reflektojnë listat rabinike dhe kulturore (stoike). Listat e Dhjatës së Re, me karakteristika të kundërta, mund të shihen në:

	<b>Veset</b>	<b>Virtytet</b>
1. Pali	Rom. 1:28-32	---
	Rom. 13:13	Rom. 12:9-21
	1 Kor. 5:9-11	---
	1 Kor. 6:10	1 Kor. 6:6-9
	2 Kor. 12:20	2 Kor. 6:4-10
	Gal. 5:19-21	Gal. 5:22-23
	Efe. 4:25-32	---
	Efe. 5:3-5	---
	---	Fil. 4:8-9
	Kol. 3:5,8	Kol. 3:12-14
	1 Tim. 1:9-10	---
	1 Tim. 6:4-5	---
	2 Tim. 2:22a, 23	2 Tim. 2:22b, 24
Titit 1:7, 3:3	Titit 1:8-9; 3:1-2	
2. Jakobi	Jakobi 3:15-16	Jakobi 3:17-18
3. Pjetri	1 Pje. 4:3	1 Pje. 4:7-11
	2 Pje. 1:9	2 Pje. 1:5-8
4. Gjoni	Zbu. 21:8; 22:15	---

**5:10** Letra e Palit ishte keqkuptuar. Pali iu bënte thirrje besimtarëve të rinj që t’i largoheshin imoralitetit. Megjithatë, disa e interpretuan këtë si “të mos shoqëroheshin kurrë me”. Pali duhej ta sqaronte këtë kuptim. Besimtarët jetojnë në një botë të rënë; është e pamundur të mos jesh në kontakt me njerëzit imoralë (sidomos nëse ne marrim seriozisht vargun tek Mate. 28:19). Ajo që Pali nënkuptonte ishte që të mos lejonin paganët aktivë të ishin vëllezërit e tyre të besëlidhjes, anëtarë të kishës apo edhe miqtë e tyre më të mirë. Kjo është një formë paskajore e mesme e tashme e termit *sunanamignumi*, e cila do të thotë “të përziesh së bashku” (shih 1 Kor. 5:9,11; 2 Thes. 3:6,14). Vargjet 10-11 japin një pamje të qartë të rrethanave kulturore të kishës në Korint.

**5:11**

**NASB**  
**NKJV**  
**NRSV**  
**TEV**  
**NJB**

**“ndonjë të ashtuquajtur vëlla”**  
**“ndonjërin të quajtur vëlla”**  
**“ndonjërin që mban emrin e vëllait apo të motrës”**  
**“një person që e quan vetveten një besimtar”**  
**“ndonjërin që thirret vëlla”**

Kjo frazë është një pjesore pasive e tashme, e cila lidhet me fjalinë kushtore të rendit të tretë. Ajo i referohet dikujt që shpall emrin e Krishtit (shih Efe. 5:3) ose thërret emrin e Krishtit (shih Rom. 10:9-13; Fil 2:11). Të merrje emrin e Krishtit do të thoshte të merrje karakterin e Tij. Është mjaft e qartë që Pali (sikurse Jezusi) besonin

se stili i jetesës së një njeriu zbulonte veten e tij të vërtetë (shih Mate. 7:15-23). Shfaqja e jashtme e një njeriu duhej të përputhej me njohurinë e ungjillit, banimin e Frymës, bindjen dhe qëndrueshmërinë personale.

▣ **“shpifës”** Shih shënimin tek 1 Kor. 4:12.

▣ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila do të thotë veprim të mundshëm. Gjenden disa lista në shkrimet e Palit mbi mëkatit e mishit (shih Romakëve 1:29-37; 1 Kor. 5:10-11; 6:9-10; 2 Kor. 12:20; Gal. 5:19-21; Efe. 4:31; 5:3-4; Kol. 3:5-9).

▣ **“me një të tillë bile as të mos hani bashkë”** Kjo mund t’i referohet Darkës së Zotit, por mund t’i referohet edhe kontaktit social (shih 1 Kor. 10:27). Në kulturën romake darkat ose drekat ishin shpesh mundësi për imoralitet.

**5:12** Pali dhe kisha duhet të merren me anëtarët (1 Kor. 5:12 pret një “po” si përgjigje), por besimtarët duhet të lejojnë Perëndinë të merret me ata që nuk janë anëtarë. Besimtarët nuk duhet të gjykojnë njëri-tjetrin (shih Mate. 7:1 e në vazhdim; Rom. 14:1-15:13), por

1. Ne duhet të analizojmë frytet e njëri-tjetrit për pozicione drejtimi (shih 1 Kor. 6:1-3; Mateu 7)
2. Ne duhet të ushtrojmë disiplinë në kishë kur reputacioni i kishës rrezikohet

Ky shpesh është një kufi i hollë! Duke nënkuptuar, Pali po pranon se mëkati i njeriut të 1 Kor. 5:1 duhet të vendoset në realitetin e gjykimit të Perëndisë (dmth., jashtë kishës).

Lind pyetja se si ky kontekst lidhet me shoqëritë moderne ku besimtarët dhe jo-besimtarët kanë të drejtë të votojnë për të rregulluar normat sociale. A duhet që besimtarët të marrin pjesë fuqishëm në proceset politike? Konteksti është i limituar tek gjykimi i lidhur me disiplinën e kishës dhe jo me demokracinë perëndimore moderne. Besimtarët janë qytetarë të dy realiteteve me detyrime dhe privilegje tek të dyja ato! Fryma e Perëndisë, vullneti i Perëndisë dhe Libri i Perëndisë na ndihmon ne si besimtarë të gjejmë rrugën tonë në këtë botë të rënë, por jobesimtarët shfrytëzohen dhe manipulohen nga mëkati, vetvetja dhe Satani. Ata kanë nevojë për dëshminë dhe dhembshurinë tonë, jo për gjykimin tonë të vetë-drejtësisë. Ata nuk mund të kuptojnë motivet, qëllimet apo veprimet tona.

Problemi i kur dhe si duhet të “gjykojnë” të krishterët njëri-tjetrin bëri që disa dorëshkrime greke ta ndryshojnë këtë tekst.

1. Papirusi shumë i hershëm i dorëshkrimit P<sup>46</sup> (rreth vitit 200 pas lindjes së Krishtit) sikurse përkthimi Bahairik Koptik (shekulli i tretë) dhe përkthimi Siriak Peshitta (shekulli i pestë) thjesht e heqin formën negative dhe e përkthejnë fjalën në formën urdhërore: “gjykoni ata që janë brenda [kishës]” (Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, [Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke] fq. 551).
2. Përkthimi Sadihik Koptik (shekulli i tretë) vendos formën negative me fjalinë pararendëse: “Çfarë kam të bëj unë me gjykimin e atyre që janë jashtë dhe jo të atyre që janë brenda? Gjykoni ata që janë brenda” (Metzger, fq. 51).
3. Teksti UBS<sup>4</sup> as që e pranon mundësinë e këtyre varianteve si origjinale.

**5:13** Pali përfundoi argumentin e tij nga një pikëpamje hebraike duke aluduar ndaj shkrimeve të Moisiut (shih Ligji i Përt. 13:5; 17:7,12; 19:19; 21:21; 22:21,24; 24:7). Nëse kisha toleron (apo merr lavdi në) anëtarët imoralë, ata do të ndikojnë të gjithë kishën (shih 1 Kor. 5:11).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse nuk e praktikojnë kishat sot disiplinën e kishës?

2. Si duhet të lidhim autoritetin apostolik të Palit me autoritetin e kishës lokale?
3. Çfarë do të thotë të dorëzosh dikë tek Satani për shkatërrimin e mishit të tij?
4. Sa letra i shkroi Pali Korintit?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 6

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Të Shkosh përpara Ligjit përpara Jobesimtarëve 6:1-11	Mos padisni Vëllezërit 6:1-11	Padi në Gjykata Pagane 6:1-6 6:7-8	Padi kundër Vëllezërve të Krishterë 6:1-6 6:7-11	Adresim tek Gjykatat Pagane 6:1-8 6:9-11
Lavdëroni Perëndinë në Trupin Tuaj 6:12-20	Lavdëroni Perëndinë në Trup dhe në Frymë 6:12-20	Një Paralajmërim kundër Sthurjes 6:9-11 6:12-20	Përdorni Trupat Tuaj për Lavdi të Perëndisë 6:12-14 6:15-17 6:18-20	Imoraliteti Seksual 6:12-17 6:18-20

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### KOMENTE HAPËSE

Unë përgjatë viteve, kam ndeshur disa juristë që më kanë pyetur se si ky kontekst lidhet me shoqërinë tonë moderne.

Së pari, ndalimi përkundrejt të marrit të dikujt (qoftë dhe një i krishter tjetër) në gjykatë duhet trajtuar. Dikush mund të diskutojë që gjykatat moderne ndryshojnë nga gjykatat pagane, por si është e mundur? Shumë nga ligjet tona gjithashtu bazohen tek ligjet romake. Disa gjyqtarë sot janë besimtarë, por kjo nuk duhet t’i ndikojë vendimmarrjet e tyre ligjore.

Duket se ka disa çështje të përfshira.

1. Motivi dhe qëllimi i çështjeve gjyqësore janë thelbësore, jo thjesht baza ligjore e rastit. Ne jetojmë në një shoqëri me çështje ligjore, sikurse në Athinën antike. Shpesh krenaria, paratë apo hakmarrja janë çështje të vërteta.
2. Impakti social që rrjedh nga të krishterët lakmitarë, zemërngushtë apo të zemëruar në gjykatat e hapura duhet shmangur. Çdo besimtar ka një detyrim të përbashkët ndaj Mbretërisë së Perëndisë. Dëshmia jonë është thelbësore.
3. Sidoqoftë, kisha nuk ka mundësuar mjetet e frytshme të arbitrimit midis besimtarëve. Nuk ka një forum kishtar për besimtarët se ku të drejtohen dhe të trajtojnë çështjet që janë të rëndësishme për ta ose që janë në thelb të padrejta.

4. Ndoshta një zgjidhje është një Shoqatë e Krishterë Juristësh / Avokatësh (Christian Lawyers Association) me burime frymore (dmth., Shkrimet, urtësi e perëndishme etj.), jo thjesht precedentë ligjorë, e cila merret me çështje ligjore që përfshijnë besimtarët. Besimtarët (dmth., juristët / avokatët besimtarë) që ndihen të udhëhequr për t'u përfshirë në një çështje ligjore duhet të kërkojnë drejtimin e Perëndisë dhe të vendosin udhëzimet me anë të të cilave ata zgjedhin të zbatojnë ligjin. Kjo duhet të zhvillohet në një forum për arbitrim midis besimtarëve.

Edhe pse Dhjata e Re është historikisht dhe kulturalisht e kushtëzuar, problemet bazë dhe tendencat e njerëzimit nuk janë të tilla. Perëndia po flet përmes këtyre teksteve dhe besimtarët duhet të dëgjojnë fjalët dhe vullnetin e Tij, jo në kategoritë greko-romake të shekullit të parë. Këto tekste bëjnë thirrje që besimtarët të jenë më pak ligjorë dhe më shumë si Krishti. Ato i bëjnë thirrje kishës që të sigurojë një forum (si gjykatat e sinagogave). Ato na bëjnë thirrje që humbja personale është më e mirë se sa humbja e Mbretërisë (dmth., ungjilli)!

Në kohën kur ka pak disiplinë kisha, divorci i shfrenuar mes besimtarëve, i kombinuar me një shoqëri lakmitare dhe ligjore, kapitujt 5 dhe 6 janë tekste thelbësore për ne për t'u studiuar dhe vënë në zbatim, si në mënyrë të përbashkët (kisha dhe kishat) ashtu edhe individualisht. Liritë amerikane bazohen në barazinë nën ligj. Kjo do të thotë se si besimtarë ne jetojmë në dy sfera ose realitete, një civil dhe një frymor. Ne nuk guxojmë të shfuqizojmë sistemin tonë ligjor, por duhet të mbajmë mend qytetarinë tonë qiellore. Të dy realitetet kanë të drejta dhe përgjegjësi. Por njëri realitet ka prioritet (shih 1 Kor. 6:19-20)!

Disa besimtarë mund të shohin çështjen e rasteve ligjore dhe të arsyeve të duhura për çështje ligjore në mënyra të ndryshme. Ne të gjithë duhet të ecim në dritën që kemi. Ky kontekst mund ta rrisë atë dritë.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 6:1-6

<sup>1</sup>A guxon ndonjë nga ju, kur ka ndonjë çështje kundër një tjetri, të gjykohet përpara të padrejtëve dhe jo përpara shenjtorëve? <sup>2</sup>A nuk e dini ju se shenjtorët do të gjykojnë botën? Dhe nëse bota do të gjykohet nga ju, a thua nuk jeni të zotët të gjykoni gjërat më të vogla? <sup>3</sup>A nuk e dini ju se ne do të gjykojmë engjëj? Dhe aq më tepër mund të gjykojmë gjërat e kësaj jete! <sup>4</sup>Pra, në qoftë se kenë për të gjykuar çështje të kësaj jete, vini gjykatës ata që çmohen më pak në kishë. <sup>5</sup>Këtë e them për turpin tuaj. Kështu midis jush nuk paska asnjë të urtë, i cili të jetë i zoti të gjykojë në mes të vëllezërve të tij? <sup>6</sup>Por një vëlla hyn në gjyq me të vëllanë, dhe kjo përpara të pabesëve.

#### 6:1

NASB	“rast”
NKJV	“çështje”
NRSV	“ankesë”
TEV	“grindje”
NJB	“ankim”

Kjo përdoret në papiruset greke koine të gjendura në Egjipt për (1) “një veprim” ose “një vepër”; (2) “një padi”; (3) “problem” ose “vështirësi”; (4) “biznes” ose “tregti” (shih Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament* [Fjalori i Dhjatës së Re Greke], fq. 532). Pika dy përshtatet më mirë me këtë kontekst. Ne dimë nga dokumentet athinase që grekët kishin prirje kulturore ndaj çështjeve ligjore. E njëjta gjë, deri në një farë mase, zbatohet tek romakët. Korinti i kohës së Palit nuk ishte grek, por romak (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali u largua nga Korinti], Eerdmans, 2001).

NASB	“fqinji i tij”
NKJV, NRSV, NJB	“një tjetri”
TEB	“një tjetër të krishteri”

Kjo është fjalë për fjalë *heteros* (shih 1 Kor. 10:24; 14:17; Gal. 6:4). Në greqishten klasike kishte një dallim midis *alla* (dmth., një tjetër i të njëjtit lloj) dhe *heteros* (dmth., një tjetër i një lloji tjetër). Ky dallim në gjuhën greke koine (sikurse ishin shumë nga dallimet në gramatikën dhe përdorimin e gjuhës greke klasike) po zbehej. Ky

kontekst është një shembull i mirë. Përdorimi këtu i *heteros*, duke iu referuar një besimtarit tjetër, paralelizohet tek Rom. 13:8. Tek Rom. 2:1 termi ka një kuptim më të gjerë, ndoshta fqinj, bashkëqytetar ose hebre. Fakti kontekstual nga konotacioni në këtë varg është fraza “përpara shenjtorëve”. Një fqinj i humbur me shumë mundësi nuk do të binte dakord përpara një gjykate kishe (shih Mate. 18:17; Jakobi 2:1-4) në një diskutim me një besimtar.

Është sigurisht e mundur që Pali kishte një dallim në dy nivele. Është ndoshta një problem për një besimtar kundër një jobesimtarit që të shkojë përpara një gjyqi pagan. Është edhe më keq për një besimtar që të çojë një besimtar tjetër përpara një gjyqi pagan. Unë preferoj interpretimin që “fqinji” tek 1 Kor. 6:1 gjithashtu do të thotë “partner në besëlidhje” ose “bashkë-besimtar”.

▣ **“guxon”** Ky term grek (dmth., *tolmaō*) përdoret disa herë në letrat e korintasve në kuptimin e “të marrësh me mend” ose të “sigurosh një guxim” (shih 1 Kor. 6:1; 2 Kor. 6:2,10; 11:21; dhe Rom. 5:7; 15:15,18; Juda 9).

NASB, NKJV	“shkon të gjykohet përpara të padrejtëve”
NRSV	“e çon çështjen përpara të padrejtëve”
TEV	“shkon përpara gjykatave të pafe”
NJB	“kërkon gjykim nga mëkatarët”

Pali nuk ishte i shqetësuar për besimtarët që po trajtoheshin në mënyrë të padrejtë, por për ekspozimin e problemeve të krishtera përpara jobesimtarëve. Fryma, dhe jo ligji pagan, është çelësi për marrëdhëniet ndërpersonale në kishë. Ungjillizimi është më i rëndësishëm se sa drejtësia personale!

**6:2 “A nuk e dini ju se”** Shih shënimin tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“shenjtorët”** “Shenjtorët” (*hagioi*) është nga termi i Dhjatës së Vjetër “i shenjtë”, (*kadosh*) që do të thotë “i ndarë veçmas për shërbesë të Perëndisë” (shih Eksod. 19:6; Ligji i Përt. 7:6; 1 Kor. 1:2; 2 Kor. 1:1; Rom. 1:1; Efe. 1:1; Fil. 1:1; Kol. 1:2). Gjithmonë është shumës në Dhjatën e Re përveçse një herë tek Filipianët (4:21), por edhe atje, ai përdoret në mënyrë të përbashkët. Për t’u shpëtuar duhet që të jesh pjesë e komunitetit të besëlidhjes së besimit, familjes së besimtarëve. Shih TEMA E VEÇANTË: SHENJTORËT (SPECIAL TOPIC: SAINTS) tek 1 Kor. 1:2.

Populli i Perëndisë është i shenjtë për shkak të drejtësisë së vendosur të Jezusit (dmth., pohim tregues, shih Romakëve 4; 2 Kor. 5:21). Është vullneti i Perëndisë që ata të jetojnë jetë të shenjta (dmth., urdhërim urdhërues, shih Efe. 1:4; 4:1; 5:27; Kol. 1:22; 3:12). Besimtarët shpallen të shenjtë (shenjtërim pozicional) dhe gjithashtu thirren për një stil jetese të shenjtë (shenjtërim progresiv). Drejtësimi dhe shenjtërimi duhet të mbahen bashkë! Shih TEMËN E VEÇANTË: SHENJTËRIA / SHENJTËRIMI NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NT HOLINESS/SANCTIFICATION) tek 1 Kor. 1:2.

▣ **“do të gjykojnë botën”** Edhe pse Jezusi përmendi specifikisht se apostujt do të veprojnë si gjyqtarët, rrjedhoja llogjike e kësaj të vërtete është se shenjtorët gjithashtu do të gjykojnë (shih Dan. 7:22,27; Mate. 19:28; Luka 22:28-30; Zbu. 2:26, 3:21, 20:4). Kur dhe si janë pyetje të vështira.

▣ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozon se shenjtorët do të marrin pjesë si gjyqtarë në ndodhitë e kohëve të fundit.

NASB	“a nuk jeni ju kompetentë për të gjykuar gjyqet më të vogla ligjore”
NKJV	“a thua nuk jeni të zotët të gjykoni gjërat më të vogla”
NRSV	“a jeni ju të pazotët të provoni raste të parëndësishme”
TEV	“a nuk jeni ju të aftë të gjykoni çështje të vogla”
NJB	“a jeni ju të paaftë për raste të thjeshta”

Kjo është një sarkazëm e ashpër e drejtuar tek ata që shpallnin se kishin njohuri superiore! I njejtë term (dmth., *anaxios*) përdoret për sjelljen e papërshtatshme të kishave korintase në darkën e Zotit (shih 1 Kor. 11:27,29). Këta besimtarë të papjekur, të cilët shpallnin se kishin kaq shumë njohuri të veçanta frymore, në të vërtetë, nuk dinin se si të vlerësonin apo të silleshin në mënyrën e duhur!

Termi “më të vogla” është forma superlative e *mikros*. Pali e përdori atë më herët tek 1 Kor. 4:3. Përdorimi i saj e rrit sarkazmën.

**6:3 “A nuk e dini ju se ne do të gjykojmë engjëjt”** Forma gramatikore pret një “po” si përgjigje. Besimtarët janë në një shkallë frymore më të lartë se sa engjëjt. Është e vështirë për besimtarët, të zënë në grackë në këtë botë të rënë, të kuptojnë vendin tonë të vërtetë frymor (shih 1 Kor. 13:12). Engjëjt u krijuan si shërbëtorë të Perëndisë dhe të njerëzimit të rënë (shih Heb. 1:14). Njerëzimi, jo engjëjt, është krijuar në shëmbëlltërinë dhe ngjasimin me Perëndinë (shih Zan. 1:26-27). Jezusi e dha jetën e Tij për njerëzimin, jo për engjëjt (shih Heb. 2:14-16). Besimtarët një ditë do të gjykojnë engjëjt (dmth., engjëjt rebelë, shih Zan. 6; Mate. 25:41; 2 Pjet. 2:4-9; Juda 6 ose të gjithë engjëjt si metaforë e sundimit universal, Dan. 7:22, 27). Sipas teologjisë rabinike, engjëjt kanë qënë gjithnjë xhelozë të dashurisë, kujdesit dhe sigurimit të Perëndisë për njerëzimin e rënë. Letërsia apokaliptike hebraike madje pranon se rebelimi i Satanit lidhej me urdhërimin e Perëndisë për t’i shërbyer racës së Adamit.

▣ **“Dhe aq më tepër”** Kjo reflekton një formë pjesore enklitike të fortë (dmth., *ge*), e cila përdoret për të treguar theksin (shih *Analytical Lexicon* [Leksikoni Analitik] i Moulton, i rishikuar, fq. 75). Kontrasti sarkastik është i dukshëm.

**6:4 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila do të thotë veprim i mundshëm.

▣ **“vini”** Ka disa mënyra të ndryshme për ta përkthyer këtë frazë. Teoritë janë

1. Treguese (një pohim), “ju vini”
2. Interrogative (një pyetje), “a vini ju?”
3. Thirrje (shih NJB, NIV), “ju vini!”
4. Urdhërore (një urdhër), “vini”

Ideja është që i krishteri më i vogël duhet të jetë në gjendje të gjykojë çështjet e thjeshta dhe të zakonshme tokësore. Për t’i qartësuar mundësitë më mirë, ka dy mënyra për ta parë këtë tekst: (1) ai i referohet gjyqtarëve paganë ose (2) i referohet anëtarëve më pak të rëndësishëm të kishës. Nëse është kështu, është një sarkazëm që vazhdon.

NASB, NJB	“që nuk llogariten”
NKJV	“që çmohen më pak”
NRSV, TEV	“ata që nuk kanë asnjë status”

Vetë ky term (dmth., *exoutheneō*, në formë pjesore pasive të përkryer) u përdor nga Pali tek 1 Kor. 1:28 për të treguar se Perëndia përdor “gjërat bazë”, “të përcmuarit”, “gjërat që nuk janë” për të trazuar urtësinë e botës në mënyrë që Vetë Perëndia të marrë lavdinë. Këtu ai duket se nënkupton ata në kishë pa asnjë status apo aftësi drejtimi. Më të vegjëlit të popullit të Perëndisë janë më të përshtatshëm për shkak të urtësisë së Perëndisë dhe Frymës që merret me problemet më mirë se sa gjyqtarët shekullar jobesimtarë me edukimin dhe eksperiencën më të mirë.

▣ **“kishë”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

**6:5 “Këtë e them për turpin tuaj”** Pali e përdor shpesh këtë fjalë (shih 1 Kor. 4:14; 6:5; 15:34; 2 Thes. 3:14; Titit 2:8). Turpërimi është një nga mënyrat se si Fryma sjell bindje dhe lejon të vërtetën dhe veprimet e qëndrimet besnike që të zhvillohen. Ky varg vazhdon sarkazmën therrëse.

▣ **“Kështu midis jush nuk paska asnjë të urtë”** Kjo ishte një sarkazëm therëse për këtë kishë intelektualisht arrogante. Kjo është një pyetje e dyfishtë negative, e cila pret një “po” si përgjigje. Shih shënimin tek 1 Kor. 4:7.

**6:6 “dhe kjo përpara jobesimtarëve<sup>14</sup>”** Nuk ka asnjë nyjë, prandaj, theksi është mbi cilësinë botërore të gjyqtarëve “paganë”.

<sup>14</sup> Versioni në shqip është: “përpara të pabesëve” (shënim i përkthyesit).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 6:7-8

<sup>7</sup> Gjithsesi është një e keqe që të keni gjyqe njëri me tjetrin. Pse nuk lejoni më mirë që t’ju bëhet padrejtësi? Pse nuk lejoni më mirë që të mashtroheni? <sup>8</sup> Po, përkundrazi, ju bëni padrejtësi dhe mashtroni, dhe këto ua bëni vëllezërve.

**6:7** “Në fakt<sup>15</sup>” Shih shënimin tek 1 Kor. 5:1.

▣ “është tashmë<sup>16</sup>” Kjo frazë (dmth., *ēdē men oun*) nënkupton se kjo kishë kishte qënë tashmë duke i bërë këto gjëra. Ata ishin tanimë të mposhtur.

NASB, NRSV	“një mposhtje”
NKJV	“një dështim absolut”
TEV	“dështoi plotësisht”
NJB	“një gabim”

Kjo fjalë për fjalë është “më pak”, por u përdor në kuptimin e disfatës apo dështimit (shih 2 Kor. 12:13; Rom. 11:12; 2 Pjet. 2:19-20).

NASB, NRSV	“Pse jo më mirë t’ju bëjnë të gabuarën? Pse jo më mirë t’ju mashtrojnë?”
NKJV	“Pse nuk lejoni më mirë që t’ju bëhet padrejtësi? Pse nuk lejoni më mirë që të mashtroheni?”
TEV	“A nuk do të ishte më mirë për ju që t’ju bëhej padrejtësi? A nuk do të ishte më mirë për ju që t’ju grabisin?”
NJB	“Pse nuk preferoni të vuani padrejtësi, pse nuk preferoni të mashtroheni”

Këto janë dy forma treguese pasive të tashme. Të drejtat individuale te besimtarëve nuk janë aq të rëndësishme sa reputacioni dhe misioni i kishës. A fiton ndonjë i krishter nëse Mbretëria humbet?

**6:8** Kisha perëndimore, me theksin e saj tek individ, e ka shtrembëruar ungjillin. Ne kemi humbur theksin e saj të vazhdueshëm mbi të gjithë trupin e përbashkët! Ne e shohim krishtërimin si diçka për ne individualisht dhe jo si diçka për ungjillin. Ne shpëtohem (individualisht) për t’i shërbyer trupit (shih 1 Kor. 12:7). Besimtarët duhet të zhvillojnë një botëkuptim të Dhjatës së Re, të shohin botën përmes syve të Perëndisë dhe qëllimeve të përbashkëta e globale të Perëndisë (dmth., Mate. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 6:9-11

<sup>9</sup> A nuk e dini ju se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë? Mos u gënjeni: as kurvarët, as idhujtarët, as shkelësit e kurorës, as të zhburrëruarit, as homoseksualët, <sup>10</sup> as vjedhësit, as lakmuesit, as pijanecët, as përqeshësit, as grabitësit nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë. <sup>11</sup> Dhe të tillë ishit disa nga ju; por u latë, por u shenjtëruat, por u shfajësuar në emër të Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë tonë.

**6:9-10** Pali është dukshëm i shqetësuar për stilin e jetesës së të krishterëve individual (shih 1 Kor. 5:10,11; 6:9-10), i cili reflekton mbi kishën. Shpëtimi nuk është vetëm një veprim ligjor (dmth., i justifikuar me anë të besimit), është një jetë e ndryshuar (dmth., shenjtërim ose ngjashmëri me Krishtin, shih Gal. 6:7). Shih TEMËN E VEÇANTË: SHENJTËRIA / SHENJTËRIMI NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NT HOLINESS/SANCTIFICATION) tek 1 Kor. 1:2.

Kisha ka qënë, dhe vazhdon të jetë, duke u mashtruar. Kjo është një formë urdhërore e tashme pasive me një pjesëz negative, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh së kryeri një veprim në proces.

<sup>15</sup> Versioni në shqip është: “Gjithsesi” (shënim i përkthyesit).

<sup>16</sup> Version në anglisht është: “Në fakt, atëherë, është tashmë e mposhtur”, ndërsa në shqip është “Gjithësesi, është një gjë e keqe” (shënim i përkthyesit).



**6:9 “A nuk e dini ju”** Shih shënimin tek 1 Kor. 5:6. Nënkuptimi është që besimtarët, për shkak të shpëtimit të tyre dhe banimit të Frymës brenda tyre, duhet t’i dinë këto gjëra! Por, besimtarët foshnjë (të papjekura), mishorë nuk i dinë!!! Ata zotërohen mendërisht nga sistemi i kësaj bote të rënë dhe nga demonët (dmth., vetë mashtrim, të mashtruar nga kultura dhe të mashtruar nga Satani, shih 1 Kor. 12:2).

■ **“se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë”** Pali e pohon këtë dy herë për ta theksuar (1 Kor. 6:9, 10). Kjo sjell paradoksin e ungjillit në një kontrast të fortë. Shpëtimi është i lirë në veprën e përfunduar të Krishtit, por shpëtimi i besëlidhjes kërkon një përgjigje të përshtatshme dhe të vazhdueshme. Besimtarët që shpallen “të drejtë” në Krishtin duhet të maturohen në ngjashmëri me Krishtin. Qëllimi i Perëndisë ka qënë gjithnjë një popull i drejtë që reflekton karakterin e Tij. Dhjata e Re është si Dhjata e Vjetër në këtë drejtim. Natyra radikale e Besëlidhjes së Re (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38) është se performanca njerëzore për shpëtim është zëvendësuar me performancën e Krishtit. Por kjo nuk ndikon mbi dëshirën e Perëndisë për një popull të drejtë. Ajo thjesht ndryshon mekanizmin. Në periudhën e ungjillit, besimtarët motivohen me anë të mirënjohjes, jo shpërblimit.

Megjithatë, parimi frymor i “mbjelljes dhe korrijes” (shih Gal. 6:7) është ende në fuqi për besimtarët dhe jobesimtarët (shih kapitulli 3). Oh tragjedia e pafrytshmërisë së krishtërimin (shih Gjoni 15; Jakobi 2:14-26; 1 Pjetrit; 1 Gjoni). Ajo ndikon mbi Mbretërinë, kishën lokale, individin dhe të humburit.

A mundet një i krishter që ka bërë mëkatet e listuara tek 1 Kor. 6:9-10 të shpëtohet? Patjetër (shih 1 Kor. 6:11)! A mundet që një i krishter të vazhdojë t’i bëjë këto mëkate dhe të jetë i shpëtuar? Jo pa pasoja hyjnore – humbja e marrëdhënies me Perëndinë, humbja e udhëheqjes së Frymës, humbja e sigurisë, humbja e paqes, humbja e lutjes efektive, humbja e adhurimit, humbja e gëzimit, humbja e dëshmisë! Çfarë çmimi i lartë për t’u paguar!

Ka disa tekste tek Veprat e Apostujve dhe në shkrimet e Palit (shih Veprat e Apo. 20:32; 26:18; 1 Kor. 6:9-10; 15:50; Gal. 5:21; Efe. 5:5) të cilat reflektojnë fjalët e Jezusit mbi të trashëguarit e Mbretërisë (shih Mate. 25:34).

#### **TEMË E VEÇANTË: FEMOHIMI (AFISTĒMI) [SPECIAL TOPIC: APOSTASY (APHISTĒMI)]**

Termi në greqisht, *aphistēmi*, ka fushë të gjerë semantike. Gjithsesi, termi anglisht “apostasy” [shqip, “femohim”] rrjedh nga ky term dhe e paragjykon përdorimin e tij në mendjen e lexuesve anglishtfolës. Si gjithmonë, konteksti ka vlerë kyçe, dhe jo ndonjë përcaktim paraprak.

Kjo është një fjalë e përbërë nga parafjala *apo*, që do të thotë “prej” ose “larg nga” dhe *histēmi*, “ulem”, “qëndroj”, ose “ngulis”. Vini re përdorimet e mëposhtme (joteologjike):

1. heq fizikisht
  - a. nga tempulli, Luka 2:37
  - b. nga një shtëpi, Marku 13:34
  - c. nga një njeri, Marku 12:12; 14:50; Veprat e Apo. 5:38
  - d. nga të gjitha gjërat, Mat. 19:27, 29
2. heq politikisht, Veprat e Apo. 5:37
3. heq nga ana e marrëdhënieve, Veprat e Apo. 5:38; 15:38; 19:9; 22:29
4. heq ligjërisht (divorcoj), Ligji i Përt. 24:1, 3 (LXX) dhe Dhjata e Re, Mat. 5:31; 19:7; Marku 10:4; 1 Kor. 7:11
5. largoj një borxh, Mat. 18:27
6. tregoj moskokëçarje duke u larguar, Mat. 4:20; Gjoni 4:28; 16:32
7. tregoj preokupim duke mos u larguar, Gjoni 8:29; 14:18
8. lejoj ose jap leje, Mat. 13:30; 19:14; Marku 14:6; Luka 13:8

Në kuptimin teologjik, edhe FOLJA ka përdorim të gjerë:

1. anuloj, fal, largoj fajin e mëkatit, Eks. 32:32 (LXX); Num. 14:19; Jobi 42:10 dhe Dhjata e Re, Mat. 6:12, 14-15; Marku 11:25-26
2. i qëndroj larg mëkatit, 2 Tim. 2:19
3. neglizhoj duke u larguar prej
  - a. Ligjit, Mat. 23:23; Veprat 21:21
  - b. Besimit, Ezek. 20:8 (LXX); Luka 8:13; 2 Thes. 2:3; 1 Tim. 4:1; Heb. 3:12

Besimtarët e sotëm bëjnë shumë pyetje teologjike që shkrimtarëve të Dhjatës së Re as nuk u kanë shkuar kurrë në mendje. Një prej këtyre lidhet me prirjen moderne për ta ndarë besimin (shfajësimi) nga besnikëria (shenjtërimi).

Ka persona në Bibël që përfshihen në popullin e Perëndisë dhe ndodh diçka që i bën ata të largohen.

#### I. Dhjata e Vjetër

A. Ata që dëgjuan lajmin e dymbëdhjetë (dhjetë) spiunëve, Numrat 14 (shih Heb. 3:16-19)

B. Korahu, Numrat 16

C. Bijtë e Elit, 1 Samuelit 2, 4

D. Sauli, 1 Samueli 11-31

E. Profetët e rremë (shembuj)

1. Ligji i Përt. 13:1-5; 18:19-22 (mënyrat si të njihet profeti i rremë)

2. Jeremia 28

3. Ezekieli 13:1-7

F. Profeteshat e rreme

1. Ezekieli 13:17

2. Nehemia 6:14

G. Drejtuesit e ligj të Izraelit (shembuj)

1. Jeremia 5:30-31; 8:1-2; 23:1-4

2. Ezekieli 22:23-31

3. Mikea 3:5-12

#### II. Dhjata e Re

A. Fjalë për fjalë, ky term greqisht do të thotë “femohim”. Dhjata e Vjetër dhe ajo e Re konfirmojnë shtimin e ligësisë dhe mësimit të rremë përpara Ardhjes së Dytë (shih Mat. 24:24; Marku 13:22; Veprat e Apo. 20:29,30; 2 Thes. 2:9-12; 2 Tim. 4:4). Ky term grek mund të reflektojë fjalët e Jezusit në Shëmbëlltyrën e Mbjellësit të gjendur tek Mateu 13, Marku 4 dhe Luka 8. Qartazi, këta mësues të rremë nuk ishin të krishterë, por vinin nga brenda (shih Veprat e Apo. 20:29-30; 1 Gjonit 2:19); megjithatë, ata janë në gjendje të joshin dhe të bëjnë për vete besimtarët e papjekur (shih Heb. 3:12).

Pyetja teologjike është kjo: a kishin qenë ndonjëherë besimtarë këta mësues të rremë? Është e vështirë t'i përgjigjemi, pasi në kishat lokale kishte mësues të rremë (shih 1 Gjonit 2:18-19). Shpesh, traditat tona teologjike ose denominacionale i përgjigjen kësaj pyetjeje pa iu referuar pasazheve të veçanta biblike (përveç metodës së “pasazhit-provë”, pra, e citimit të një vargu jashtë konteksti gjoja për të provuar anshmërinë tënde).

B. Besim në dukje

1. Juda, Gjoni 17:12

2. Simon Magjistari, Veprat e Apo. 8

3. Ata që përmenden te Mat. 7:13-23

4. Ata që përmenden te Mateu 13; Marku 4; Luka 8

5. Judenjtë e Gjonit 8:31-59

6. Aleksandri dhe Himeneu, 1 Tim. 1:19-20

7. Ata të 1 Tim. 6:21

8. Himeneu dhe Fileti, 2 Tim. 2:16-18

9. Dema, 2 Tim. 4:10

10. Mësuesit e rremë, 2 Pjetri 2:19-22; Juda v. 12-19

11. Antikrishtët, 1 Gjonit 2:18-19

C. Besim pa fryt

1.1 Korintasve 3:10-15

2.2 Pjetrit 1:8-11

Ne rrallëherë mendojmë për këto pasazhe për shkak se teologjia jonë sistematike (kalvinizëm,

arminianizëm, etj.) na dikton përgjigjen e detyruar. Ju lutem, mos më paragjykoni pse po e shtroj këtë temë. Preokupimi im është procedura e saktë hermeneutike. Duhet t'i lejojmë Biblës të na flasë dhe s' duhet të përpiqemi ta fusim Biblën brenda një teologjie të paracaktuar. Shpesh, kjo është e dhimbshme dhe tronditëse për shkak se një pjesë e mirë e teologjisë sonë është denominacionale, kulturore, ose sociale (prindi, miku, pastori), jo biblike (shih Temë e Veçantë: Çfarë do të thotë të "marrësh", "besosh", "rrefesh", "thërrasësh"? / Special Topic: What Does It Mean to "receive," "believe," "confess/profess," "call upon"?). Disa që janë Popull i Perëndisë dalin se nuk janë pjesë e Popullit të Perëndisë (p.sh., Rom. 9:6).

### **TEMË E VEÇANTË: TRASHËGIMIA E BESIMTARËVE (SPECIAL TOPIC: BELIEVERS' INHERITANCE)**

Në Dhjatën e Vjetër çdo fis përveç Levit, merrte një trashëgimi toke (shih Jozueu 14-22). Levitët, si fis priftërinjsh, shërbyes në tempull dhe mësues lokalë, shiheshin si të kishin Vetë YHWH si trashëgiminë e tyre (shih Ps. 16:5; 73:23-26; 119:57; 142:5; Vajt. 3:24). Shkrimtarët e Dhjatës së Re shpesh merrnin të drejtat dhe privilegjet e levitëve dhe i zbatonin ato tek të gjithë besimtarët. Kjo ishte mënyra e tyre për të pohuar se ndjekësit e Jezusit ishin populli i vërtetë i Perëndisë dhe se tani të gjithë besimtarët ishin thirrur për të shërbyer si priftërinj ndaj Perëndisë (shih 1 Pjet. 2:5,9; Zbu. 1:6), sikurse pohon Dhjata e Vjetër për gjithë Izraelin (shih Eksod. 19:4-6). Theksi i Dhjatës së Re nuk është mbi individin si një prift me privilegje të caktuara, por mbi të vërtetën se të gjithë besimtarët janë priftërinj, që kërkon një qëndrim të përbashkët shërbimi (shih 1 Kor. 12:7). Popullit të Perëndisë në Dhjatën e Re i ishte dhënë detyra e Dhjatës së Vjetër për ungjillizimin e botës (shih Zan. 12:3; Eksod. 19:5b; Mat. 28:18-20; Luka 24:46-47; Veprat e Apo. 1:8; shih Temë e Veçantë: Plani i Përgjithshëm Shpengues i YHWH / Special Topic: YHWH's Eternal Redemptive Plan).

Ky është koncepti i Jezusit si pronar i krijimit për shkak se Ai ishte agjenti i Atit në krijim (shih John 1:3,10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2-3). Ne jemi bashkëtrashëgimtarë për shkak se Ai është trashëgimtari (shih Rom. 8:17; Gal. 4:7; Kol. 3:24). Shkrimi flet për faktin që besimtarët trashëgojnë (shih Veprat e Apo. 20:32; 26:18; Efe. 1:4; Kol. 1:12; 3:24) shumë gjëra për shkak të marrëdhënies të tyre familjare me Jezusin i Cili është trashëgimtar i të gjitha gjërave (shih Heb.1:2). Për rrjedhojë, ata janë bashkë-trashëgimtarë (shih Rom. 8:17; Gal. 4:7) të

1. mbretërisë (shih Mat. 25:34, 1 Kor. 6:9-10; 15:50; Efe. 5:5)
2. jetës së përjetshme (shih Mat. 19:29; Heb. 9:15)
3. premtimeve të Perëndisë (shih Heb. 6:12)
4. mbrojtjes nga ana e Perëndisë të premtimeve të Tij (shih 1 Pjet. 1:4-5)

■ **“Mos u gënjeni”** Kjo është një formë urdhërore pasive e tashme (*The Expositor's Bible Commentary* [Komentari Biblik i Studiuesit], Vol. 10, fq. 223, thotë se është një formë e tashme e mesme, dmth., “ndaloni së mashtruari vetveten”) me pjesëz negative, e cila zakonisht do të thotë “të ndalosh një veprim që është në proces”. Kjo është një *asyndeton* si tek 1 Kor. 6:18, e cila ishte një formë gramatikore e gjuhës koine greke e theksit që sillte në vëmendje tek lexuesi ose dëgjuesi.

**NASB, NKJV, NRSV**

**TEV**

**NJB**

**“kurvarët”**

**“njerëzit që janë imoralë”**

**“të imoralët seksualë”**

Ky është termi i përgjithshëm për imoralitet seksual (shih 1 Kor. 5:1 [dy herë], 9,10; 6:9,11,13,18; 7:2; 10:8; 2 Kor. 12:21). Vargjet 9-10 listojnë mëkatet që lidhen me praktikat pagane të adhurimit të shekullit të parë (shih 1 Kor. 5:9-11), të cilat përfshinin rregullisht aktivitete seksuale të shturura në emër të perëndisë së pjellorisë.

▣ **“idhujtarët”** Për një besimtar me perspektivën e Dhjatës së Vjetër, nuk ka asgjë më të keqe se sa kjo. Përdorimi i këtij termi në listën e mëkateve konfirmon se kjo ishte një listë praktikash pagane adhurimi. Të gjithë besimtarët johebrenj në Korint vinin nga ky sfond (shih 1 Kor. 6:11). Pali përdor këtë koncept (dmth., adhurimin dhe shërbimin ndaj perëndive të rremë) shpesh në letrat e tij drejtuar korintasve (shih 1 Kor. 5:10,11; 6:9; 8:4,7,10; 10:7,14,19,28; 12:2; 2 Kor. 6:16).

▣ **“shkelësit e kurorës”** Ky është termi grek *moichos*, i cili i referohet tradhëtisë seksuale jashtëmartesore. Ky është vendi i vetëm ku përdoret në letrat korintase.

NASB	“të zhburrëruarit”
NKJV, NJB	“homoseksualët”
NRSV	“prostitutat meshkuj”
TEV	“perversët homoseksualë”
NJB	“vetë-toleruesit”

Ky term (*malakos*) fjalë për fjalë do të thotë i butë. Ai mund të përdoret për veshjet (shih Mate. 11:8). Kur përdoret në mënyrë metaforike për persona i referohet prostitutave meshkuj, zakonisht burrave të rinj në moshë. Një artikull i mirë mbi homoseksualitetin gjendet tek *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalori i Palit dhe Letrave të Tij], fq. 413-414.

NASB	“homoseksualët”
NKJV, NRSV, NJB	“homoseksualët”
TEV	“(të dy termat bashkë përkthehen ‘perversët homoseksualë’)”

Ky term (*arsenokoitēs*, nga *arsēn*, një mashkull, dhe *keitē*, një që shtrihet me) i referohet një mashkulli homoseksual (shih 1 Tim. 1:10; Rom. 1:27). Ky ishte një problem madhor në shoqërinë romake (shih Rom. 1:26-27; 1 Tim. 1:10) sikurse ishte në Lindjen e Afërme antike (shih Lev. 18:22; 20:13; Ligji i Përt. 23:18). Këta dy terma të lidhur tek 1 Kor. 6:9 për aktivitetin seksual mund t’i referohen formës aktive (*arsenokoitai*) dhe pasive (*malakoi*) të aspekteve të këtij mëkati seksual.

Ka shumë presion modern kulturor për të pranuar homoseksualitetin si një stil jetese alternativ të përshtatshëm. Bibla e dënon atë si një stil jetese shkatërrues, jashtë vullnetit të Perëndisë për krijimin e Tij.

1. Ai thyen urdhërimin e Zanafillës 1 për të qënë të frytshëm dhe për t’u shumëfishuar
2. Ai karakterizon adhurimin dhe kulturën pagane (shih Lev. 18:22; 20:13; Rom. 1:26-27; dhe Juda 7)
3. Ai zbulon një pavarësi të vetë-qendëruar, pavarësi nga Perëndia (shih 1 Kor. 6:9-10)

Megjithatë, përpara se të lë këtë temë, më lejoni të pranoj dashurinë dhe faljen e Perëndisë ndaj të gjithë qenieve njerëzore rebele. Të krishterët nuk kanë asnjë të drejtë të sillen me urrejtje apo arrogancë ndaj këtij mëkati të veçantë, sidomos kur është e dukshme se të gjithë ne mëkatojmë. Lutje, shqetësim, dëshmi dhe dhembshuri arrijnë shumë më tepër në këtë fushë se sa dënimi i furishëm. Fjala e Perëndisë dhe Fryma e Tij do të bëjnë gjykimin nëse ne i lejojmë ato. Të gjithë mëkatet seksuale, jo vetëm ky, janë një neveri ndaj Perëndisë dhe shpien në gjykim. Seksualiteti është një dhuratë nga Perëndia për mirëqënien dhe gëzimin e njerëzimit, për një shoqëri të qëndrueshme. Por kjo dëshirë e fuqishme, e dhënë nga Perëndia, shpesh kthehet në një jetesë rebele, të vetë-qendëruar, kërkuese për kënaqësi, e stilit “më-shumë-për-mua-me-çfarëdo-kushti” (shih Rom. 8:1-8; Gal. 6:7-8).

▣ **“përqeshësit”** Shih shënimin tek 1 Kor. 4:12.

**6:11 “të tillë ishit disa nga ju”** Kjo është një formë treguese e papërkryer, e cila shpreh një veprim të vazhdueshëm në të shkuarën. Kjo tregon zyrtësinë morale të kulturës pagane në kohën e Palit (shih 1 Kor. 12:2), por ajo gjithashtu tregon hirin e mrekullueshem dhe fuqinë ndryshuese të ungjillit të Perëndisë në Krishtin. Jetët e ndryshuara të këtyre paganëve të konvertuar ishin një dëshmi e fuqishme për ungjillin. Por ndryshimi duhet të jetë i përhershëm dhe i plotë, jo i përkohshëm dhe selektiv. Ata tani ishin ndryshe, Fryma banonte në ta tani, ata ishin të informuar tani. Ata nuk duhet të ktheheshin si një qen tek të vjellat e tij apo si një derr tek balta (shih 2 Pjet. 2:22). Bota e humbur po shikon!

▣ **“por”** Vini re përkthimin e trefishtë të *alla* në tekstin grek për të përcaktuar këto tre ndodhi të ndryshme frymore:

1. Larja
2. Shenjtërimi
3. Drejtësimi i kryer përmes Birit dhe Frymës nëpërmjet besimit tonë dhe përgjigjes së penduar

▣ **“u latë”** Kjo është një formë treguese aoriste e mesme. Kjo mund t’i referohet pagëzimit si një vepër fillestare, e vullnetshme, e dukshme, simbolike e pastrimit të brendshëm (shih Veprat e Apo. 2:38; 22:16; Titit 3:5). Pjesa më e madhe e përkthimeve e përkthejnë këtë frazë në formë pasive përveç përkthimit të Williams, i cili shkruan “ju keni larë veten tuaj, e keni bërë të pastër”. Prozelitët ndaj Judaizmit pagëzonin njëri-tjetrin kur i bashkoheshin sinagogës. Nëse kjo fjalë është formë e mesme sikurse tek Veprat e Apo. 22:16, kjo mund të jetë një aludim teologjik ndaj diskutimit të përgjegjësisë së besëlidhjes tek Ezek. 18:31 e kombinuar me sovranitetin iniciues të Perëndisë (shih Ezek. 36:25-27). Kjo mund të jetë një metaforë për pastrim (shih Titit 3:15).

▣ **“u shenjtëruat”** Kjo është një formë treguese pasive aoriste me anë të vdekjes së Krishtit dhe ndërmjetësimit të Frymës (shih 1 Kor. 1:2,30). Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIA / SHENJTËRIMI NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NT HOLINESS/SANCTIFICATION) tek 1 Kor. 1:2.

▣ **“u shfajësuar”** Kjo është një formë treguese aoriste pasive. Besimtarët shenjtërohen dhe shfajësohen kur ata besojnë (shih Rom. 8:29). Ky qëndrim pozicional teologjik kërkon një jetesë si të Krishtit. Shih TEMËN E VEÇANTË: DREJTËSI (SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS) tek 1 Kor. 1:30.

▣ **“në emër të Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë tonë”** Kjo frazë ndoshta konfirmon interpretimet që “u lanë” dhe “u latë” tek 1 Kor. 6:11 i referohet pagëzimit (shih Rom. 10:9-13). Rrëfimi publik i besimit në kishën e hershme ishte pagëzimi. Kandidatët pranonin besimin e tyre duke thënë gojarisht “unë besoj se Jezusi është Zot” ose një rrëfim leturgjik të ngjashëm.

Fraza e dytë që përmend “Frymën” mund të jetë një aludim ose formulë leturgjike e bazuar tek Mate. 28:19, “duke i pagëzuar ata në emër të Atit dhe të Birit dhe të Frymës së Shenjtë.” Është interesante se sa shpesh Pali i referohet “emrit” në hapjen e kapitujve të 1 Korintasve (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:10).

1. Një mënyrë për t’iu referuar besimtarëve (“ata... që thërrasin emrin”, shih 1 Kor. 1:2)
2. Një mënyrë për të nxitur besimtarët (shih 1 Kor. 1:10)
3. Një mënyrë për të pranuar autoritetin e Palit (shih 1 Kor. 5:4)
4. Një mënyrë për t’iu referuar besimtarëve fillestar të veprimit të thirrjes së emrit (shih 1 Kor. 6:11)

Emri përfaqëson personin e Jezusit, autoritetin, karakteristikat dhe statusin e Tij.

Kjo është një referencë e dukshme për veprën shpenguese të Perëndisë Triun (shih 1 Kor. 6:10-11). Termi “Trini” nuk është një fjalë biblike, por koncepti është. Nëse Jezusi është hyjnor dhe Fryma është një person, atëherë thelbi hyjnor ka tre manifestime personale të përhershme. Shih TEMËN E VEÇANTË: TRINIA (SPECIAL TOPIC: THE TRINITY) tek 1 Kor. 2:10.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 6:12-20**

<sup>12</sup> Çdo gjë më lejohet, por jo gjithçka është e dobishme; çdo gjë më lejohet, por unë nuk do të nënshtrohem asnjërës. <sup>13</sup> Gjellët janë për barkun dhe barku për gjellët; por Perëndia do të shkatërrojë edhe këtë edhe atë; por trupi nuk është për kurvëri, po për Zotin, dhe Zoti për trupin. <sup>14</sup> Tani Perëndia siç e ringjalli Zotin kështu do të na ringjallë edhe ne me fuqinë e tij. <sup>15</sup> A nuk e dini ju se trupat tuaj janë gjymtyrë të Krishtit? Të marr, pra, unë gjymtyrët e Krishtit dhe t’i bëj gjymtyrë të një kurve? Mos qoftë ashtu! <sup>16</sup> A nuk e dini ju se ai që bashkohet me një kurvë bëhet një trup me të? Sepse thuhet: “Do të jenë të dy, thotë Zoti, një mish i vetëm.” <sup>17</sup> Por ai që bashkohet me Zotin është një frymë me të. <sup>18</sup> Largohuni nga kurvëria! Çdo mëkat që kryen njeriu është jashtë trupit, po ai që kurvëron mëkaton kundër trupit të vet. <sup>19</sup> A nuk e dini se trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë që është në ju, të cilin e keni nga Perëndia, dhe se nuk i përkthini vetvetes? <sup>20</sup> Sepse u bletë me një çmim! Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tuaj dhe në frymën tuaj, që i përkasin Perëndisë.

NASB, NKJV, NRSV  
TEV  
NJB

“Të gjitha gjërat janë të ligjshme për mua”  
“Dikush do të thotë, ‘Mua më lejohet të bëj çdo gjë’”  
“Për mua çdo gjë është e lejueshme”

Kjo mund t’i referohet diçkaje që Pali e kishte thënë në rastet e mëparshme (shih 1 Kor. 10:23; Rom. 14:2,14,20), por ishte hequr nga konteksti nga (1) legalizmi i besimtarëve hebrej ose (2) mësuesit e rremë të shthurur të cilët po përdornin lirinë e krishterë si një liçencë për të mëkatuar (shih Gal. 5:13; 1 Pjet. 2:16). Pali po përpiqet të ecë në një linjë të hollë midis dy ekstremeve dhe t’ju flasë të dyve.

Kjo mund të jetë hera e parë e Palit që citon një nga sloganet e mësuesve të rremë apo që mësuesit e rremë kanë nxjerrë nga konteksti që ai kishte predikuar dhe e kanë zgjeruar thënien e tij në zona të tjera (shih 1 Kor. 6:12,13; 7:1; 8:1,4; 10:23, shih (1) *The Cambridge History of the Bible* [Historia e Biblës nga Kembrixh], vol. 1, fq. 244, dhe (2) Klein, Blomberg, dhe Hubbard, *Introduction to Biblical Interpretation* [Hyrje në Interpretim Biblik], fq. 362-363). Jo se ajo që ata thanë nuk ishte e vërtetë, por ata e çuan të vërtetën përtej kufijve të duhur. Është e vështirë të kuptosh se kur po e përdor Pali këtë teknikë. Ndoshta kriteret e mëposhtme mund të jenë ndihmëse.

1. Është diçka që Pali vetë kishte thënë në shkrime të tjera (shih 1 Kor. 10:23; Rom. 14:2,14,20).
2. Është një pohim i përgjithshëm i shkurtër i së vërtetës (si një fjalë e urtë).
3. Të gjitha metaforat biblike janë të vërteta, por kanë kufij për sa i përket zbatimit të tyre të përshtatshëm. Asnjë shembull apo metaforë nuk mund të shtyhet në çdo nivel. Ato zakonisht kanë një zbatim madhor.

Pali përpiqet të ritheksojë të vërtetën e synuar dhe të kufizojë zgjerimet e papërshtatshme. Kjo është çështja e hermeneutikës në çdo epokë!

■ **“por jo gjithçka është e dobishme”** Ky varg flet për përdorimin e duhur të lirisë së krishterë e cila duhet ushtrohet në dashuri vetë-limituese (shih 1 Kor. 10:23; 14:26; Rom. 14:19; 15:2). Ndërtimi i trupit të Krishtit është më i rëndësishëm se sa të drejtat dhe liritë personale.

■ **“e dobishme”** Ky është një term i përbërë grek i cili nënkupton “të bashkojë për përfitimin e një personi” (shih 1 Kor. 6:12; 7:35; 10:23; 12:7; 2 Kor. 8:10, negativja tek 1 Kor. 12:1). Kjo paralelizon pohimet e Palit tek Rom. 14:19; 15:2; 1 Kor. 10:23; 14:26; 2 Kor. 12:19; Efe. 4:12,29. Thjesht për shkak se një besimtar është i lirë në Krishtin nuk do të thotë se çdo gjë ndërton besimtarët e tjerë. Ne kufizojmë lirinë tonë në dashuri për Zotin dhe kishën e Tij. Ne gjithmonë kërkojmë të promovojmë shëndetin dhe jetën e të gjithë trupit të Krishtit (shih 1 Kor. 12:7).

NASB  
NKJV  
NRSV  
TEV  
NJB

“por unë nuk do të lejoj të më zotërojë asgjë”  
“por unë nuk do të ulem poshtë pushtetit të asnjërit”  
“por unë nuk do të nënshtrohem asnjëres”  
“unë nuk jam duke lejuar asgjë që të më bëjë skllavin e vet”  
“por jam i vendosur që të mos nënshtrohem nga asgjë”

Kjo është një formë treguese pasive e termit grek *exousia*. Ky term kishte një sferë të gjerë përdorimesh

1. Autoriteti
2. Juridiksioni
3. Kontrolli
4. Fuqia
5. Fuqia natyrore

Pali mund të ketë pasur disa nga këto nënkuptime në mendje në këtë rrethanë. Gjendet dukshëm një lojë fjalësh midis “të ligjshëm” (*exestin*) dhe “të zotëruar” (*exousiasthēsomai*). Ai nuk ndihej se

1. Ndonjë qenie njerëzore kishte të drejtën ta gjykonte atë (shih 1 Kor. 2:14-15; 3:4-5)
2. Asnjë fuqi e mbinatyrshme nuk kishte autoritet mbi të (shih 1 Kor. 12:2, jobesimtarët drejtohen për në rrugën e gabuar nga demonët)
3. Asnjë liri personale apo preferencë personale apo tundim personal (dmth., *timos*, një mbiemër përemëror njëjës në kontrast ndaj përdorimit të dyfishtë të *panta* në këtë varg)

Autoriteti i Palit ishte nga Krishti. Ishte Krishti dhe Fryma e Tij që e kontrollonin dhe e fuqizonin atë. Vetë-kontrolli është sigurisht një nga frytet e Frymës (shih Gal. 5:23; Veprat e Apo. 24:25; 2 Pjet. 1:6). Pali kontrollon lirinë e tij në mënyrë që ungjilli të përparojë, dhe kështu duhet të bëjmë edhe ne!

Pali po pranon se liria e krishterë nuk duhet të jetë një mundësi për liçencë personale. Shumë gjëra që janë të mira mund të bëhen motive, qëndrime apo situata të papërshtatshme (shih Rom. 14:23). Kjo çështje e lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së krishterë është çështja thelbësore e letrave korintase. Kjo çështje trajtohet gjithashtu tek Rom. 14:1-15:13. Do të doja të citoja shënimet e mia hapëse mbi këtë temë nga komentari i romakëve.

### **NJOHURI KONTEKSTUALE NGA ROMAKËVE 14:1-15:13**

- A. Ky kapitull përpiqet të ekuilibrojë paradoksin e lirisë dhe përgjegjësisë së krishterë. Njësia letrare vazhdon deri tek vargu 15:13.
- B. Problemi që përshkallëzon ky kapitull ishte ndoshta tensioni midis besimtarëve johebrenj dhe hebrenj në kishën e Romës. Përpara konvertimit hebrenjtë prireshin të ishin legalistë dhe paganët prireshin të ishin imoralë. Mbani mend se ky kapitull i drejtohet ndjekësve të sinqertë të Jezusit. Ky kapitull nuk adreson besimtarët mishorë (shih 1 Kor. 3:1). Qëllimi më i lartë i caktohet të dy grupeve. Gjendet një rrezik në ekstremet e të dy anëve. Ky diskutim nuk është një liçencë për të zgjedhur ligalizmin apo lirinë e shfrenuar.
- C. Besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm të mos e bëjnë teologjinë e tyre apo etikën standart për të gjithë besimtarët e tjerë (shih 2 Kor. 10:12). Besimtarët duhet të ecin në dritën që ata kanë, por të kuptojnë se teologjia e tyre nuk është automatikisht teologjia e Perëndisë. Besimtarët ende ndikohen nga mëkati i tyre. Ne duhet të inkurajojmë, nxisim dhe mësojmë njëri-tjetrin nga Shkrimet, arsyet dhe eksperiencat, por gjithmonë në dashuri. Sa më shumë që dikush të njohë, aq më shumë ai person mëson se nuk di (shih 1 Kor. 13:12)!
- D. Qëndrimi dhe motivet e dikujt përpara Perëndisë janë çelësat kryesorë në vlerësimin e veprimeve të tij. Të krishterët do të qëndrojnë përpara Krishtit për t'u gjykuar mbi mënyrën se si ata kanë trajtuar njëri-tjetrin (shih 1 Kor. 6:10,12 dhe 2 Kor. 5:10).
- E. Martin Luteri tha: “Një njeri i krishter është më i liri nga të tërë, i nënshtruar ndaj askujt; një njeri i krishter është shërbëtori më i përkushtuar, i nënshtruar ndaj të gjithëve.” E vërteta Biblike shpesh prezantohet në një paradoks të mbushur me tension.
- F. Kjo temë e vështirë por thelbësore trajtohet brenda së tërës njësia letrare të Romakëve 14:1-15:13 dhe gjithashtu tek 1 Korintasve 8-10 dhe Kolosianëve 28-23.
- G. Megjithatë, është e nevojshme të pohoet se pluralizmi mes besimtarëve të sinqertë nuk është diçka e keqe. Çdo besimtar ka pika të forta dhe të dobëta. Secili duhet të ecë në dritën që ai / ajo ka, gjithmonë i hapur ndaj Frymës dhe Biblës për më shumë dritë. Në këtë periudhë të shikimit përmes një xhami të errët (1 Kor. 13:8-13) ne duhet të ecim në dashuri (1 Kor. 6:15), dhe paqe (1 Kor. 6:17,19) për ndërtim të përbashkët.
- H. Titujt, “më i fortë” dhe “më i dobët”, që Pali iu jep këtyre grupeve, i paragjykojnë ata tek ne. Ky me siguri nuk ishte qëllimi i Palit. Të dy grupet ishin besimtarë të sinqertë. Ne nuk po përpiqemi t'i bëjmë të krishterët e tjerë si vetvetja! Ne e pranojmë njëri-tjetrin në Krishtin!

### **NJOHURI KONTEKSTUALE NGA ROMAKËVE 15:13**

- A. Diskutimi mbi lirinë dhe përgjegjësinë e krishterë vazhdon nga kapitulli 14.
- B. I gjithë argumenti mund të skicohej si më poshtë
  1. Pranoni njëri-tjetren për shkak se Perëndia na ka pranuar ne në Krishtin (shih 1 Kor. 14:1,3; 15:7);
  2. Mos e gjykoni njëri-tjetrin sepse Krishti është Mjeshtri dhe Gjykatësi ynë i vetëm (shih 1 Kor. 14:3-12);

3. Dashuria është më e rëndësishme se sa liria personale (shih 1 Kor. 14:13-23);
4. Ndiqni shembullin e Krishtit dhe sakrifikoni të drejtat tuaja për ndërtimin dhe të mirën e të tjerëve (shih 1 Kor. 15:1-13).

C. Rom. 15:5-6 reflekton qëllimin e trefishtë për të gjithë kontekstin e 1 Kor. 14:1-15:13

1. Jetoni në harmoni me njëri-tjetrin;
2. Jetoni në përputhje me shembullin e Krishtit;
3. Me zemra të bashkuara dhe buzë të ofruara në unitet për lavdërim ndaj Perëndisë.

D. I njëjti tension midis lirisë personale dhe përgjegjësisë së përbashkët trajtohet tek 1 Kor. 8-10 dhe Kol. 2:8-23.

## 6:13

NASB

“Ushqimi është për stomakun”

NKJV

“Ushqimet për stomakun dhe stomaku për ushqimet”

NRSV

“Ushqimi është menduar për stomakun dhe stomaku për ushqimin”

TEV

“Dikush tjetër do të thotë: ‘Ushqimi është për stomakun, dhe stomaku është për ushqimin’”

NJB

“Ushqimet janë për stomakun dhe stomaku është për ushqimet”

Ky mund të jetë një tjetër slogan. Ai duket se i referohet një zgjerimi hermeneutik të papërshtatshëm nga mësuesit e rremë të shthurur. Pali pranon se ka një element të vërtetë në atë çfarë ata thonë (shih Mark. 7:19). Pali

1. Ose po përdor një teknikë letrare të quajtur diatribe / fjalim i ashpër, ku ai po përdor kundërshtarët e supozuar për të përçarur pikat e tij teologjike
2. Ose po citon sloganet e mësuesve të rremë, një pjesë e të cilëve mund të kenë origjinën nga mësimet e Jezusit apo mësimet e Palit

▣ **“por Perëndia do të shkatërrojë edhe këtë edhe atë”** Ky është një aludim ndaj Mbretërisë së konsumuar. Ushqimi është vetëm për një pjesë kohe, jo për përjetësi. Jezusi hëngri peshk edhe pas ringjalljes së Tij (p.sh., Gjoni 21), por kjo ishte një mundësi për të kaluar kohë me dishepujt e Tij të frikësuar, jo një nevojë fizike për Të. Jezusi gjithashtu foli për një banket mesianik (dmth., Luka 22:30), por edhe kjo, është një metaforë e marrëdhënies, jo një nevojë fizike që të përsëritet. Frazja “largojë” (shih NASB) ose “shkatërrojë” (shih NKJV) është *katargeō*. Pali përdori këtë fjalë njëzetë e shtatë herë, por në kuptime të ndryshme. Shih Temën e Veçantë: *Katargeō* (Special Topic: *Katargeō*) tek 1 Kor. 1:28.

▣ **“por trupi nuk është për kurvëri”** Kjo tregon qartazi zgjerimin e rremë. Njerëzit janë të krijuar në mënyrë të mrekullueshme për jetën dhe për zhvillimin e saj në këtë planet. Megjithatë, ka disa kufij të dhënë nga Perëndia për të siguruar një ekzistencë të gjatë, të lumtur dhe të frytshme. Që nga rënia (shih Zanafilla 3), njerëzimi priret të grabisë me çdo kusht kënaqësi të menjëherëshme, vetë-përmbushëse, personale.

▣ **“trupi... për Zotin, dhe Zoti për trupin”** Këto fraza janë në një marrëdhënie paralele. Nxitja duket se bëhet që besimtarët t’i përkasin Zotit (shih 1 Kor. 6:20; 7:23; Veprat e Apo. 20:28). Ai dëshiron të përdorë trupat e tyre për shërbesën e Tij, për qëllimet e Tij. Kjo mund të jetë një lojë fjalësh me trupin njerëzor dhe kishën si trup i Krishtit.

**6:14** Kapitulli përcaktues në Dhjatën e Re mbi ringjalljen e Krishtit dhe ringjalljen e besimtarëve është 1 Korintasve 15.

Nën dritën e mendimit grek (dmth., trupi fizik është i lig), ka nevojë të theksohet se mendimi biblik nuk e nënvlerëson trupin. Në këtë kontekst trupi është

1. I krijuar “për Zotin” (shih 1 Kor. 6:13)
2. “anëtarë të Krishtit” (shih 1 Kor. 6:15)
3. Një tempull që banohet nga Fryma (shih 1 Kor. 6:19)
4. Për të përlëvduar Krishtin (1 Kor. 6:20)



Trupi nuk është i lig. Ai do të ringjallet dhe do të jetë pjesë e mbretërisë së përjetshme. Megjithatë, është gjithashtu realiteti i tundimit dhe fushëbeteja morale e mëkatit. Jezusi dha Vetveten fizikisht për kishën. Besimtarët duhet të ndjekin shembullin e tij (shih 1 Gjoni 3:16).

■ **“Tani Perëndia siç e ringjalli Zotin”** Tek *A Textual Commentary of the Greek New Testament* [Një Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re në Greqisht] Bruce M. Metzger i përcakton variantet e dorëshkrimeve greke të lidhur me kohën e foljes:

1. “AORISTE tek MSS P<sup>46</sup>, C<sup>2</sup>, B
2. E TASHME tek MSS P<sup>11</sup>, P<sup>46</sup>, A, D\*
3. E ARDHME tek MSS P<sup>46</sup>, C<sup>1</sup>, 8, C, D<sup>3</sup>

Koha e ARDHME i përshtatet kontekstit dhe paralelizimit tek 2 Kor. 4:14” (fq. 552; UBS<sup>4</sup> e cilëson atë “B” [pothuajse të sigurt]).

Kjo frazë është një mundësi e shkëlqyer për të treguar se Dhjata e Re shpesh i atribuon veprat e shpengimit tek të tre Personat e Perëndisë.

1. Perëndia At e ngriti Jezusin (shih Veprat e Apo. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10)
2. Perëndia Biri ngriti Vetveten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë e ngriti Jezusin (shih Rom. 8:11)

■ **“kështu do të na ringjallë edhe ne”** Pali gëzohet në marrëdhënien e tij personale aktuale me Krishtin (shih 1 Kor. 6:17). Kjo është eskatologjia e kuptuar e Palit (shih C. H. Dodd). Në një kuptim të vërtetë qielli duhej të vinte tek Pali në këtë jetë dhe do të plotësohej në një jetë të ardhshme.

Pali gjithashtu besonte se Jezusi do të rikthehej shumë shpejt. Në disa tekste Pali pranon se ai do të ishte gjallë në rikthimin e Krishtit (shih 1 Thes. 4:17; 1 Kor. 15:51-52; Fil. 3:20). Megjithatë, në disa tekste ai e lidh me ata që u ngritën prej së vdekuri (shih 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14). E gjithë letra e dytë drejtuar Thesalonikasve pret një Parousia të vonuar, ashtu sikurse pjesë të Mateut 24, Markut 13 dhe Lukës 21.

Ardhja e Dytë është shpresa e çdo brezi të krishter, por realiteti i vetëm një brezi. Megjithatë, ringjallja me trupin e saj të ri dhe marrëdhënien intime është një realitet për të gjithë besimtarët!

**TEMË E VEÇANTË: RIKTHIMI NË ÇDO MOMENT I JEZUSIT PËRKUNDREJT “AKOMA JO”  
(SPECIAL TOPIC: THE ANY-MOMENT RETURN OF JESUS VS. THE NOT YET)**

- A. Pasazhet eskatologjike të Dhjatës së Re reflektojnë njohuritë profetike të Dhjatës së Vjetër që e shihnin fundin e kohërave përmes ngjarjeve bashkëkohore.
- B. Mateu 24, Marku 13 dhe Luka 21 janë kaq të vështirë për t’u interpretuar sepse ata trajtojnë disa pyetje njëkohësisht.
  1. Kur do të shkatërrohet Tempulli?
  2. Cila do të jetë shenja e rikthimit të Mesias?
  3. Kur do të përfundojë kjo epokë (shih Mate. 24:3)?
- C. Zhanri i pasazheve eskatologjike të Dhjatës së Re janë zakonisht një kombinim i gjuhës apokaliptike dhe profetike e cila është qëllimisht e paqartë dhe tejet simbolike (shih D. Brent Sandy, *Plowshares and Pruning Hooks: Rethinking the Language of Biblical Prophecy and Apocalyptic* [Parmendat dhe Drapërit: Të Rimendosh Gjuhën e Profecisë dhe Apokaliptikës Biblike]).
- D. Disa pasazhe në Dhjatën e Re (shih Mateu 24, Marku 13, Luka 17 dhe 21, 1 dhe 2 Thesalonikasve dhe Zbulesa) trajtojnë Ardhjen e Dytë. Këto pasazhe theksojnë:
  1. Koha e saktë e ngjarjes nuk është e njohur, por ngjarja është e sigurtë
  2. Ne mund të dimë kohën e përgjithshme, por jo kohën specifike të ndodhivë
  3. Ajo do të ndodhë papritur dhe befasi
  4. Ne duhet të qëndrojmë në lutje, të jemi gati dhe të jemi besnik ndaj detyrave që na janë caktuar
- E. Gjendet një tension paradoksikal teologjik midis
  1. Rikthimit të çdo momenti (shih Luka 12:40,46; 21:36; Mat.24:27,44) dhe

2. Faktit që disa ndodhin në histori duhet të ndodhin më parë (pika F. më poshtë)
- F. Dhjata e Re pohon se disa ndodhi do të ndodhin përpara Ardhjes së Dytë:
  1. Ungjilli do të predikohet në të gjithë botën (shih Mat. 24:14; Mark 13:10)
  2. Braktisja e madhe (shih Mat. 24:10-13, 21; 1 Tim. 4:1; 2 Tim. 3:1 e në vazhdim.; 2 Thes. 2:3)
  3. Zbulimi i “njeriut të mëkatit” (shih Dan. 7:23-26; 9:24-27; 2 Thes. 2:3)
  4. Heqja e asaj / atij që kufizon (shih 2 Thes. 2:6-7)
  5. Shpresojmë një rizgjim hebraik (shih Zak. 12:10; Romakëve 11)
- G. Luka 17:26-37 nuk paralelizohet tek Marku. Ky pasazh ka një paralelizim të pjesshëm sinoptik tek Mat. 24:37-44
- H. Për një diskutim të rikthimit të shpejtë të Krishtit, shih Temën e Vecantë: Rikthimi i Shpejtë (Special Topic: Soon Return)
- I. Për një diskutim të rikthimit të vonuar, shih Temën e Vecantë: Ardhja e Dytë e Vonuar (Special Topic: Delayed Second Coming)

**6:15 “A nuk e dini ju”** Shih shënimin tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“trupat tuaj janë gjymtyrë të Krishtit”** Pali përdor këtë analogji nga Zan. 2:24 si një bazë për një paralajmërim për njëjësinë e besimtarëve në imoralitetin seksual të çdo lloji. Besimtarët janë një me Krishtin (shih 1 Kor. 12:20,27; Rom. 12:5; Efe. 4:12,16,25).

▣ **“kurve”** Ky është termi grek *pornē*, i cili vjen nga folja “të shesësh” (dmth., *pernēmi*, shih Kittel, *Theological Dictionary of the New Testament* [Fjalori Teologjik i Dhjatës së Re], vol. 6, fq. 580). Në Korint (dhe në Lindjen e Afërme Antike) kishte dy lloje prostitutash, një kultike (p.sh., adhurimi pagan) dhe skllëverit (p.sh., për përfitim). Pali në mënyrë të vazhdueshme diskuton *porneia* (shih 1 Kor. 5:1 [dy herë]; 9,10,11; 6:9,13,15, 16,18; 7:2; 10:8; 2 Kor. 11:21). Adhurimi pagan i pjellorisë shprehej në akte seksuale. Dëgjuesit e Palit ishin rritur dhe kishin marrë pjesë në këto rituale dhe rite, por ata tani janë të krishterë!

NASB	“Kurrë mos qoftë”
NKJV	“Sigurisht jo”
NRSV	“Kurrë”
TEV	“E pamundur”
NJB	“As që diskutohet”

Kjo frazë me pasthirrma (një formë në mënyrën dëshirore që shpreh një dëshirë ose lutje të fuqishme) përdoret shpesh nga Pali për të shprehur tmerrin e tij se si disa i përgjigjen (dmth., diatribe / fjalim i ashpër) pohimeve të tij apo pyetjeve të tij retorike (shih Rom. 3:4; 6:31; 6:2,15; 7:7,13; 9:14; 11:1,11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14).

**6:16 “Do të jenë të dy... një mish i vetëm”** Ky është një citim nga Zan. 2:24. Në martesë dy persona me vullnetin e tyre bëhen një mish. Intimiteti fizik është një eksperiencë e fuqishme bashkimi. Ajo ka një vend të përshtatshëm, të përcaktuar nga Perëndia. Sikurse të gjitha dhuratat e Perëndisë, edhe me këtë mund të abuzohet dhe ajo mund të çohet përtej kufijve të vendosura nga Perëndia.

**6:17** Kjo është një analogji frymore e marrë nga Zan. 2:24. Sikurse një burrë dhe një grua bëhen një mish fizikisht, besimtari dhe Zoti i tij bëhen një entitet frymor (shih Gjoni 17:11,23; Gal. 2:20; Eph. 5:21-33). Një shembull i mirë i këtij koncepti teologjik është Rom. 6:1-11. Besimtarët vdesin me Krishtin, varrosen (në pagëzim) me Krishtin dhe ngrihen me Krishtin.

NASB	“ai që e bashkon veten e tij”
NKJV	“ai që bashkohet”
NRSV	“kushdo i bashkuar”
TEV	“ai që e bashkon vetveten”
NJB	“kushdo që e ngjit vetveten”

Kjo është saktësisht paralelizëm me 6:16. Ndërtimi gramatikor është

1. Një formë pjesore pasive e tashme si tek 1 Kor. 6:16 (shih Zerwick dhe Grosvenor, *A Grammatical Analysis of the Greek New Testament* [Një Analizë Gramatikore e Dhjatës së Re në Greqisht], fq. 508)
2. Një formë pjesore e tashme e mesme (Harold K. Moulton, *The analytical Greek Lexicon Revised* [Leksikoni Grek Analitik i Rishikuar], fq. 236)

Përkthimet ekuivalente dinamike (p.sh., TEV, NJB), sikurse NASB, e përkthejnë atë në formë të mesme. Është e dukshme se konteksti fokusohet në vullnetin e palëve të përfshira.

**6:18 “Largohuni nga kurvëria”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme pa një lidhje gramatikore me atë që paraprin apo vijon (p.sh., *asyndeton*), e cila për një lexues të gjuhës koine greke ishte një mënyrë për të theksuar, duke e bërë që fraza të theksohet.

Seksualiteti njerëzor është një dhuratë nga një Perëndi i hirshëm, por ka aspekte të përshtatshme dhe të papërshtatshme se si dikush i ushtron dhuratat e Perëndisë. Pali konfirmon martesën me këtë citim nga Zan. 2:24, por me vendosshmëri vendos kufijtë mbi imoralitetin paramartesor apo jashtë-martesor.

Besimtarët duhet të jenë vazhdimisht të kujdesshëm në këtë fushë, sidomos kur kultura është imorale. Mëkatet e seksit janë probleme madhore në jetën e besimit. Besimtarët duhet të jetojnë jetë të transformuara në mënyrë të përshtatshme seksuale (shih 2 Kor. 12:21; Efe. 5:3; Kol. 3:5).

▣ **“Çdo mëkat që kryen njeriu është jashtë trupit”** Ky është një moment i çuditshëm. Do të doja ta kuptoja më mirë. Ai mund të reflektojë

1. Kulturën pagane të Korintit
2. Një theks mësimdhënieje të mësuesve të rremë
3. Një theks predikimi të Palit (shih 1 Kor. 6:12, 13)

Njerëzit nuk kanë një shpirt, ata janë një shpirt (shih Zan. 2:7). Me këtë lidhet të kuptuarit e Palit se besimtarët nuk kanë një trup, ata janë një trup. Ky është ndoshta një zhvillim teologjik nga Zanafilla dhe kundër mendimit grek që e zhvlerësonte trupin fizik si të lig. Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re pranojnë një ringjallje fizike e cila është një mënyrë pranimit e mirësisë dhe përjetësisë e ekzistencës së përbashkët njerëzore. Më vonë mësuesit gnostikë të shturur apo antinomianë do të ndanin aspektet fizike nga aspektet mendore. Në këtë mënyrë, ata pranonin shpëtimin si njohuri dhe jo si perëndishmëri apo drejtësi. Pali konfirmon se ungjilli është

1. Një person për t'u pranuar
2. Një e vërtetë për atë person që duhet besuar
3. Një jetë e atij personi që duhet imituar

Këto nuk mund të ndahen! Njerëzit janë në unitet! Shpëtimi është gjithëpërfshirës. Mbretëria ka mbërritur.

Gjendet një lidhje e pakëputshme midis besimit dhe bindjes. Shenjtërimi fillestar duhet të drejtojë tek shenjtërimi progresiv. Drejtësia është si një dhuratë (treguese), ashtu edhe një urdhërim (urdhëruese).

Kolegu im tek Universiteti Baptist i Teksasit Lindor (East Texas Baptist University), Dr. Bruce Tankersley, më kujtoi se në prostituimin kultik, prostitutë është një surrogate për hyjësinë. Prandaj, marrëdhëniet seksuale nuk ishin vetëm imorale, por përbënin edhe veprime idhujtarie.

**6:19 “A nuk e dini se”** Shih shënimin tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“trupi juaj është tempulli i Frymës së Shenjtë”** Krishtërimi zëvendëson tempullin fizik të hebrenjve me tempullin frymor të trupit fizik të Krishtit (shih Gjoni 2:21) si trupi i Tij i përbashkët, kisha (shih 1 Kor. 10:16,17; 11:29; 12:12-27). Ky koncept i tempullit përdoret në dy kuptime tek 1 Korintasve.

1. Tek 1 Kor. 3:16-17 ai përdoret për të gjithë kishën lokale
2. Këtu ai përdoret për besimtarin individual

Kjo shpreh marrëdhënien e paqëndrueshme midis aspekteve të përbashkëta dhe individuale.

Pika kryesore e Palit në këtë kontekst është një thirrje për shenjtëri. Besimtarët duhet të jenë rrënjësisht të ndryshëm nga kultura që i rrethon. Kjo ka dy qëllime.

1. Ajo arrin qëllimin e ngjashmërisë me Krishtin
2. Ajo tërheq njerëzit tek besimi në Krishtin, të cilat janë dy anët e Urdhërimit të Madh (shih Mate. 28:19-20)

■ **“Frymës së Shenjtë që është në ju”** Ky është një theks mbi Frymën e Shenjtë që banon. Fuqia për një jetë të krishterë është një dhuratë nga Perëndia, ashtu sikurse shpëtimi. Ne duhet ta nënshtrojmë veten tonë tek vepra e Frymës. Të tre personat e Trinisë banojnë tek besimtari.

1. Fryma (shih Gjoni 14:16-17; Rom.8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
2. Biri (shih Mate. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
3. Ati (shih Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)

Besimtarët janë populli i pronësisë së Perëndisë. Kjo është vullnetshëm ndryshe nga posedimi i demonëve në kuptimin që bashkëpunimi i vullnetshëm i besimtarit është thelbësor në çdo fazë dhe nivel. Demonët shkatërrojnë vullnetin e individit, por Perëndia Sovran ka zgjedhur të nderojë lirinë e krijimit të Tij njerëzor. Vetëm në pjekurinë e krishterë (dmth., në ngjashmërinë me Krishtin) bëhet vullneti i Perëndisë forca udhëheqëse dominuese!

**6:20 “u bletë me një çmim”** Kjo është një formë treguese aoriste pasive. Kjo metaforë vjen nga tregu i skllëvërve (shih 1 Kor. 7:22-23; Rom. 3:24; Gal. 3:13; 4:5). Në Dhjatën e Vjetër kjo njihet si *go'el*, që ishte një i afërm i cili blinte një person nga skllavëria (shih Lev. 25:25). Kjo është një referencë ndaj pajtimit zëvendësues, të bërë për të tjerët nga Jezusi (shih Isaia 53; Mark 10:45; 2 Kor. 5:21). Kur një njeri pranon Krishtin, ai / ajo heq dorë nga të drejtat personale ndaj trupit të tij / saj dhe merr përgjegjësinë për shëndetin e përbashkët dhe jetën e të gjithë tempullit, të gjithë trupit (shih 1 Kor. 12:7).

■ **“Përlëvdoni Perëndinë, pra, në trupin tuaj”** Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste, një urdhër urgjent, jo një mundësi. Mënyra se si besimtarët jetojnë është thelbësore për sigurinë, për paqen, për dëshminë! Shih **TEMËN E VEÇANTË: LAVDI (DOXA) [SPECIAL TOPIC: GLORY (DOXA)]** tek 1 Kor. 2:7.

Ka dy ekstreme për t'u shmangur në jetën e krishterë: (1) çdo gjë është e papërshtatshme; (2) çdo gjë është e përshtatshme. Trupat tanë janë për Perëndinë, jo për veten; ata janë për shërbesë, jo për mëkat (shih Romakëve 6). Kjo pikëpamje e trupit është shumë e ndryshme nga pikëpamja greke e trupit si një burg i shpirtit. Trupi nuk është i lig, por është fushëbeteja e jetës frymore (shih Efe. 6:10-20).

Gjendet një frazë shtesë tek NKJV: “dhe në frymën tuaj, që janë të Perëndisë”, e cila është në disa unciale më të vonshme dhe në shumë dorëshkrime greke me shkronja të vogla të mëvonshme. Megjithatë, teksti më i vjetër nuk e ka këtë. Ai nuk është tek P<sup>46</sup>, A, B, C\*, D\*, F, or G. The UBS<sup>4</sup> i jep tekstit më të shkurtër një cilësim “A” (të sigurtë).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A mëson ky kapitull se të krishterët në ditën tonë nuk duhet të shkojnë në gjyq?
2. Si dhe kur do t'i gjykojnë shenjtorët engjëjt?
3. A i referohet lista e mëkateve tek vargjet 9 dhe 10 veprimeve individuale apo stilit të zakonshëm të jetesës?
4. Kur Pali konfirmon se çdo gjë është e lejuar për mua, çfarë do të thotë ai saktësisht me këtë pohim në referencë ndaj zakoneve personale dhe urdhërimeve specifike në Bibël?
5. Pse janë mëkatet seksuale një problem kaq i rëndësishëm frymor?
6. Shpjegoni dallimin midis pikëpamjes greke të trupit dhe pikëpamjes së krishterë të trupit.

# 1 KORINTASVE 7

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Probleme në Lidhje me Martesën	Parime të Martesës	Udhëzime për Martesën	Pyetje për Martesën	Martesa dhe Dëllirësia
7:1-7	7:1-9	7:1-7	7:1a 7:1b-5 7:6-7	7:1-7
7:8-16	Mbani Premtimet tuaja të Martesës 7:10-16	7:8-9 7:10-11 7:12-16	7:8-9 7:10-11 7:12-16	7:8-9 7:10-11 7:12-16
Jeta që Zoti të ka Caktuar	Jetoni Sikurse Jeni Thirrur	Eskatologjia dhe Ndryshimet në Statusin Social dhe Martesor	Jetoni Siç Perëndia Ju Ka Thirrur	
7:17-24	7:17-24	7:17-20 7:21-24	7:17-24	7:17-24
Të Pamartuarit dhe Vejushët	Ndaj të Pamartuarve dhe Vejushëve		Pyetje rreth të Pamartuarve dhe Vejushëve	
7:25-35	7:25-40	7:25-31 7:32-35	7:25 7:26-28 7:29-31 7:32-34 7:35	7:25-28 7:29-31 7:32-35
7:36-38		7:36-38	7:36-38	7:36-38
7:39-40		7:39-40	7:39-40	7:39-40

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih "[Bible Interpretation Seminar](#)" [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 7:1-40**

A. Ky është diskutimi më i zgjeruar i Palit mbi marrëdhëniet familjare. Ai trajton çështjet e

- a. Imoralitetit seksual, 6:9-20; 7:2
  - b. Martesës, 1 Kor. 7:2-5, 10-16, 28
  - c. Beqarëve, 1 Kor. 7:6-9, 25-26, 29-35
  - d. Virgjëreshave, 1 Kor. 7:36-38
  - e. Rimartesën e vejushave dhe vejushëve, 1 Kor. 7:39-40
  - f. Tema e përsëritur është: “qëndroni siç jeni,” 1 Kor. 7:1, 6-7, 8, 10, 17-24, 26-35, 37, 40; për shkak të krizës aktuale dhe *parousia*-s së pritshme, edhe pse ai lejon përjashtime
- B. Kapitulli 7 është një shembull shumë i mirë se si situatat lokale dhe të përkohshme duhen marrë në konsideratë përpara se të interpretojmë Biblën në mënyrën e duhur ose të nxjerrim parime universale për t’u zbatuar. Është shumë e veshtirë në librin e 1 Korintasve që të mësohesh rrethanat historike për shkak se
- a. Ne nuk e dimë saktësisht se cila ishte kriza e përsëritur në Korint (ndoshta uria / zia e bukës)
  - b. Ne nuk e dimë se cilave grupe përçarëse po iu drejtohet Pali dhe në cilat vargje (dmth., asketëve apo të shthururve)
  - c. Ne nuk kemi letrën që kisha i shkroi Palit duke i bërë këto pyetje (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12)
- C. Duket se ka dy qëndrime / ndarje të papërshtatshme në Korint që po shkaktonin zënkë të madhe. Të parët ishin ata njerëz që prireshin drejt asketizmit (shih 1 Kor. 7:1). Grupi tjetër ishin ata që prireshin drejt lirshmërisë morale ose mohimit (shih 1 Kor. 6:12; 10:23). E gjithë e vërteta sulmohet nga ekstremet. Tek 1 Korintasve 7, Pali po përpiqet të ecë përmes një litari të tendosur praktik dhe teologjik midis këtyre dy ekstremeve, ndërkohë që përpiqet t’ju flasë të dy grupeve.
- D. Gjetet një temë e përsëritur përgjatë kapitullit 7. Ajo karakterizohet nga vargjet 17, 20, 24, 26, 40 dhe aludohet në vargun 8. Kjo temë është “qëndroni siç jeni” sepse koha është e shkurtër. Ky nuk mund të jetë një parim universal për shkak se
- a. Kjo lidhet me një periudhë persekutimi
  - b. Martesa është vullneti i Perëndisë për njerëzimin (shih Zan. 1:28)
  - c. Kjo kishë përballej me probleme të brendshme me mësuesit e rremë
- Është për t’u konsideruar se cilën kategori (dmth., të pamartuarve kurrë, të martuar një herë, apo të martuar ndaj një jobesimtari) kishte përjetuar vetë Pali. Ndoshta ai ekzistencialisht i kishte përjetuar të gjitha. Pjesa më e madhe e hebrenjve martoheshin në bazë të interpretimit rabinik të Zan. 1:28 dhe sipas traditës. Gruaja e Palit ose vdiq (dmth., ai ishte një i ve) ose e kishte lënë atë për shkak të besimit të tij të ri (dmth., ai ishte i divorcuar). Në pikën e thirrjes së tij për shpëtim dhe shërbesë (dmth., në rrugën për në Damask) ai personalisht kishte zgjedhur beqarinë, ashtu sikurse Barnaba, por ai kurrë nuk e dënoi martesën e Pjetrit (shih 1 Kor. 9:5).
- E. Martesa në Bibël është një normë e pritshme (shih Zan. 1:28; 2:18). Pali ka mundësi që ka qënë i martuar në një periudhë kohe (dmth., implikimi nga Veprat e Apo. 26:10, nëse Pali ishte një anëtar i Sinedrit, atëherë ai duhej të ishte i martuar). Ai pranon se martesa është një status i nderuar për besimtarët (shih 1 Kor. 6:16; 7:14; 2 Kor. 11:2 dhe Efe. 5:22-31). Ne duhet të mbajmë mend se Pali po i drejtohet situatës lokale të shekullit të parë, pagane, të përçarë, kozmopolitane.
- F. Diskutimi i Palit për rrethprerjen tek vargu 19 pranon se për Palin ritualet dhe rregullat e Dhjatës së Vjetër janë kaluar në ungjillin e Jezus Krishtit për paganët besimtarë (shih Veprat e Apo. 15) dhe për këtë arsye, nuk janë kufizuese. Në aspektin teologjik, zakonisht thuhet se Pali i konfirmon aspektet etike të Dhjatës së Vjetër, por mohon aspektet ceremoniale. Deri në një farë mase kjo është e vërtetë.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:1-7

<sup>1</sup>Tani lidhur me ato që më shkruat, mirë është për njeriun të mos prekë grua. <sup>2</sup>Por, për shkak të kurvërimit, le të ketë secili gruan e vet dhe secila grua burrin e vet. <sup>3</sup>Burri le të kryejë detyrën martesore

ndaj gruas, po ashtu edhe gruaja ndaj burrit. <sup>4</sup> Gruaja nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por burri; gjithashtu burri nuk ka pushtet mbi trupin e vet, por gruaja. <sup>5</sup> Mos ia privoni njëri-tjetrit, përveç në qoftë se jeni marrë vesh, për një farë kohe, që t'i kushtoheni agjërimit dhe lutjes, dhe përsëri ejani bashkë që të mos ju tundojë Satani për shkak të mungesës së vetkontrollit tuaj. <sup>6</sup> Dhe këtë unë e them si leje, jo si urdhërim, <sup>7</sup> sepse do të doja që të gjithë njerëzit të ishin si unë; por secili ka dhunti të veçantë nga Perëndia, njeri kështu dhe tjetri ashtu.

**7:1 “Tani lidhur me ato që më shkruat”** Me shumë mundësi çështjet e adresuara në kapitujt 1-6 i ishin komunikuar Palit përmes njerëzve të Kloit. Fraza “tani lidhur me” i referohen pyetjeve specifike që kisha në Korint i kishte dërguar Palit nëpërmjet Stefanit, Fortunatit dhe Akaikut (shih 1 Kor. 7:25; 8:1; 12:1; 16:1,12). Është shumë e vështirë të interpretosh këtë kapitull pa ditur saktësisht çfarë pyetjesh kanë bërë korintasit dhe kush i ka bërë këto pyetje (dmth., besimtarët besnikë, grupi i shthurur, grupi i asketëve apo grupi i përçarë i kishave shtëpi).

**NASB, NKJV**

**“është mirë për një njeri që të mos prekë grua”**

**NRSV**

**“është mirë për një njeri të mos prekë grua”**

**TEV**

**“Një njeri bën mirë të mos martohet”**

**NJB**

**“Po, është një gjë e mirë për një njeri që të mos prekë grua”**

Termi “mirë” ka një fushë të gjerë semantike, por në këtë kontekst ai do të thotë “i përfitueshëm” ose “për të mirën e dikujt” (shih 1 Kor. 7:1,8,26). Ajo përdoret në po të njëjtin kuptim tek Septuagjinti tek Zan. 2:18. I gjithë qëllimi i Palit është çfarë është më e mira për individin në kohët e shqetësimit dhe cila është më e mira për Mbretërinë e Perëndisë.

Kjo mund t’i referohet

1. Një citimi nga letra që Korintasit i shkruajtën Palit
2. Një slogani të një nga grupeve përçarëse
3. Një fraze të marrë nga predikimet e Palit, por e keqinterpretuar dhe e zbatuar në një mënyrë asketike, legaliste apo liberale

Ky term “prekë” ka shumë nënkuptime të ndryshme, “të vësh duart mbi”, “të mbash”, “të kontrollosh”. Ai është përdorur metaforikisht për kontaktin seksual (shih LXX Zan. 20:6; Fjalët e Urta. 6:29; *Antiquities* [Antikitete] 1.163 i Josephus; gjithashtu *Leges* [Leges] 8.840a i Platos; *Alex. M.* [Alex M.] 21.4 i Plutarch. Shih *Lexicon* [Leksikonin] e Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, fq. 102, por jo i përdorur në një kuptim seksual tek papirusi në gjuhën koine nga Egjipti).

Pali nuk po e nënvlerëson martesën apo seksualitetin njerëzor, por abuzimin njerëzor me seksualitetin. Njerëzimi gjithmonë i merr dhuratat e Perëndisë dhe i kalon përtej kufijve të Perëndisë. Klima sociale në Korint ishte imorale deri në ekstrem (shih 1 Kor. 7:2a).

**NASB**

**“Por për shkak të imoraliteteve”**

**NKJV**

**“Megjithatë, për shkak të imoralitetit seksual”**

**NRSV**

**“Por për shkak të rasteve të imoralitetit seksual”**

**TEV**

**“Por për shkak se ka qaq shumë imoralitet”**

**NJB**

**“megjithatë, për të shmangur imoralitetin”**

Martesa nuk ishte një problem për Palin. Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme, në vetën e tretë njëjës. Shumë besojnë se ai ishte një rabi për shkak se kishte studiuar nën Rabi Gamalielin dhe ai ishte i zellshëm për ligjin. Ai e dinte se martesë ishte e nevojshme për të përmbushur Zanafillën: “jini të frytshëm dhe shumëzohuni” (shih Zan. 1:28; 9:1,7). Marrëdhënia seksuale është një dhuratë nga Perëndia. Shoqëria pagane ishte aq e lirshme seksualisht dhe aq imorale për shkak se seksi përdorej në praktikën pagane të adhurimit të pjellorisë për të cilat Pali mendoi se ishte e nevojshme që ta adresonte si çështje.

Pali iu drejtua temës teologjike të beqarisë dhe rrethanave të përsëritura të persekutimit. Ka një dhunti frymore të beqarisë. Ajo nuk është më frymore se sa martesë. Njeriu beqar është i aftë të përkushtojë më shumë kohë, energji dhe burime personale ndaj shërbesës. Kjo është mirë, por jo për të gjithë, dhe jo për shumicën!

Çështja e vërtetë për Palin në këtë kontekst nuk është beqaria, por “qëndroni siç jeni”. Kohët ishin të vështira. Persekutimi po rritej. Historia na tregon për tre zi buke në mbarë mbretërinë gjatë kësaj periudhe. Pali konfirmon martesën (shih 1 Kor. 6:16), por në rrethanat aktuale sociale ai mbron beqarinë. Kjo nuk është domosdoshmërisht një parim universal, por një paralajmërim i përkohshëm kulturor.

Shqetësimi tek 1 Kor. 7:2 është imoraliteti depërtues i kulturës greko-romake të shekullit të parë. Në një shoqëri të shthurur, martesë besnike, monogame është shumë më mirë nga ana frymore, emocionale dhe fizike se sa adhurimi pagan. Jo vetëm konfirmohet martesë këtu, por konfirmohet gjithashtu përgjegjësia e duhur e secilit partner.

**7:2 “Ie të ketë secili gruan e vet dhe secila grua burrin e vet”** Këto janë dy forma urdhërore të tashme, por nuk funksionojnë si urdhër, vetëm nëse kjo parashikon 1 Kor. 7:5. Kjo është një strukturë paralele, sikurse janë 1 Kor. 7:3 dhe 4. Martesa nuk është përjashtim; ajo është normë, nuk është një lëshim (shih 1 Tim. 4:3; Heb. 13:4).

**7:3** Ky varg gjithashtu ka dy forma urdhërore aktive të tashme. Pali jep katër udhëzime në dy vargje. Është e mundur që Pali po trajton dy probleme në këtë fushë të seksualitetit njerëzor (shih Gordon D. Fee, *To What End Exegesis* [Në Përfundim të Eksegjezës], fq. 88-98).

1. Të krishterët e shthurur që vazhdonin sjelljen e tyre seksuale të mëparshme pagane, sidomos në tempujt dhe festimet pagane (dmth., liberalët)
2. Të krishterët që e kishin bërë madje edhe marrëdhënien seksuale martesore një tabu frymore (dmth., asketikët, shih 1 Kor. 7:5 dhe në këtë mënyrë 1 Kor. 7:1 bëhet një slogan ose një nga grupimet)

**7:4** Ky varg tregon aftësinë e Palit për të ekuilibruar papërshtatshmërinë e kulturës së tij (shih Efe. 5:21,22-33). Në kohën e Palit, gratë kishin pak të drejta. Pali i drejtohet të dy partnerëve të martuar me një përgjegjësi të përbashkët. Nevojat seksuale nuk janë të liga. Ato janë një dëshirë e dhënë nga Perëndia.

**7:5 “Mos ia privoni njëri-tjetrit”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme me një pjesëz mohuese, e cila zakonisht nënkupton “të ndalosh një veprim që është në proces”. Kjo lidhet me problemin e asketicizmit në kishën korintase. Ajo gjithashtu pranon se seksi, ose të mohuarit të seksit, nuk duhet të jetë një instrument për të kontrolluar bashkëshortin/en!

■ **“përveç në qoftë se jeni marrë vesh”** Kjo frazë fillon me *ei mēti*, që do të thotë “vetëm nëse ndoshta” ose “vetëm në qoftë” (shih Luka 9:13). Këtu po jepet një përjashtim i mundur ndaj normës së pohuar. Ky lloj strukture (dmth., një rregull dhe më pas një përjashtim) përdoret përgjatë këtij kapitulli. Pali po ecën përmes litarit të tendosur midis legalizmit / asketicizmit dhe liberalizmit / mohimit. Çdo grup kishte planet dhe sloganet e veta!

Vini re se Pali po shpreh një model barazie. Bashkëshorti nuk është i vetmi që ka të drejtë të zgjedhë! Udhëheqja biblike mashkullore tragjikisht keqkuptohet. Bashkëshorti duhet të veprojë në mënyra vetë-dorëzuese për pjekurinë e familjes (shih Efe. 5:25-29), jo për interes personal apo për preferenca personale, por në përkujdesje frymore.

#### **TEMË E VEÇANTË: GRATË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: WOMEN IN THE BIBLE)**

- I. Dhjata e Vjetër
  - A. Nga ana kulturore, gratë konsideroheshin prona
    1. përfshiheshin në listën e pronave (Eks. 20:17)
    2. trajtimi i skllaveve (Eks. 21:7-11)
    3. betimet e grave ishin të anulueshme nga meshkuj të përgjegjshëm nga ana sociale (Numrat 30)
    4. gratë si plaçka lufte (Ligji i Përtërirë 20:10-14; 21:10-14)
  - B. Praktikisht, ekzistonte një reciprocitet
    1. meshkujt dhe femrat të krijuara në shëmbëllimin e Perëndisë (Zan. 1:26-27)
    2. nderoni babanë dhe nënën (Eks. 20:12 [Ligji i Përt. 5:16])



3. kini nderim për babanë dhe nënën (Levitiku 19:3; 20:9)
  4. burrat dhe gratë mund të ishin naziritë (Num. 6:1-2)
  5. bijat kishin të drejtë trashëgimie (Num. 27:1-11)
  6. pjesë e popullit të besëlidhjes (Ligji i Përtërirë 29:10-12)
  7. zbato mësimin e babait dhe nënës (Fja. 1:8; 6:20)
  8. bijtë dhe bijat e Hemanit (familje levite) drejtonin muzikën në tempull (1 Kron. 25:5-6)
  9. bijtë dhe bijat do të profetizojnë në epokën e re (Joeli 2:28-29)
- C. Gratë ishin në role udhëheqjeje
1. motra e Moisiut, Miriami, quhej profeteshë (Eks. 15:20-21, shih dhe Mikea 6:4)
  2. gratë që kishin dhunti nga Perëndia për të endur materiale për tabernakullin (Eks. 35:25-26)
  3. një grua e martuar, Debora, që ishte edhe profeteshë (shih Gjyq. 4:4), u priu gjithë fiseve (Gjyq. 4:45; 5:7)
  4. Hulda ishte profeteshë, të cilës mbreti Josia i bëri thirrje të lexonte dhe të interpretonte “Librin” e sapogjetur “të Ligjit” (2 Mbret. 22:14; 2 Kro. 34:22-27)
  5. mbretëresha Ester, një grua e perëndishme, shpëtoi judenjtë në Persi

## II. Dhjata e Re

- A. Nga ana kulturore, si në judaizëm ashtu dhe në botën greko-romake, gratë ishin qytetare të dorës së dytë, me pak të drejta apo privilegje (me përjashtim të Maqedonisë).
- B. Gratë në role udhëheqjeje
1. Elizabeta dhe Maria, gra të perëndishme në dispozicion të Perëndisë (Luka 1-2)
  2. Ana, gruaja e perëndishme që shërbente në tempull (Luka 2:36)
  3. Lidia, besimtare dhe drejtuese e një kishë shtëpi (Veprat e Apo. 16:14, 40)
  4. Katër bijat e virgjra të Filipit ishin profeteshë (Veprat e Apo. 21:8-9)
  5. Febja, dhjake e kishës në Kenkrea (Rom. 16:1)
  6. Priska (Prishila), bashkëpunëtorja e Palit dhe mësuesja e Apollos (Veprat e Apo. 18:26; Rom. 16:3)
  7. Maria, Trifena, Trifoza, Persisi, Julia, motra e Nereut, një sërë grash bashkëpunëtoreshë të Palit (Rom. 16:6-16)
  8. Junia (KJV), ndoshta një grua apostull (Rom. 16:7)
  9. Evodia dhe Sintika, bashkëpunëtoreshë të Palit (Fil. 4:2-3)

## III. Si t'i drejtpeshojë shembujt e ndryshëm biblikë besimtarë i kohës së sotme?

- A. Si të përcaktojmë të vërtetat historike ose kulturore, që vlejné vetëm për kontekstin fillestar, dhe të vërtetat e përjetshme që vlejné për të gjitha kishat, për të gjithë besimtarët e të gjitha kohëve?
1. Duhet të marrim shumë seriozisht synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Bibla është Fjala e Perëndisë dhe i vetmi burim për besimin dhe praktikën.
  2. Duhet të ballafaqohemi me pasazhet e frymëzuara që, dukshëm, janë të kushtëzuara nga ana historike.
    - a. Kulti (pra, rituali dhe liturgjia) e Izraelit (shih Veprat e Apo. 15; Gal. 3)
    - b. Judaizmi i shekullit të parë
    - c. Thëniet e kushtëzuara historikisht të Palit në 1 Korintasve
      - (1) sistemi ligjor i Romës pagane (1 Kor. 6)
      - (2) qëndrimi në skllavëri (1 Kor. 7:20-24)
      - (3) beqaria (1 Kor. 7:1-35)
      - (4) virgjëreshat (1 Kor. 7:36-38)
      - (5) ushqimi që u flijohet idhujve (1 Kor. 8; 10:23-33)
      - (6) veprime të padenja në Darkën e Zotit (1 Kor. 11)
  3. Perëndia e zbuloi plotësisht dhe qartazi Vetën në një kulturë të veçantë dhe në një kohë të veçantë. Ne duhet të marrim seriozisht zbuluesin, por jo çdo aspekt të

përshtatjes së saj historike. Fjala e Perëndisë u shkrua me fjalë njerëzore dhe iu drejtua një kulture të caktuar në një kohë të caktuar.

- B. Interpretimi biblik duhet të kërkojë synimin e autorit fillestar. Çfarë po i thoshte ai ditës së vet? Kjo është themelore dhe kyçe për interpretimin e saktë. Por, më tej, këtë duhet ta zbatojmë në kohën tonë. Tani, këtu qëndron problemi me gratë në udhëheqje (problemi i vërtetë interpretues mund të jetë përcaktimi i termit. A kishte shërbesa të tjera përveç pastorëve që konsideroheshin udhëheqje? A shiheshin si drejtuese dhjaket ose profeteshat? Është shumë e qartë se Pali, në 1 Kor. 14:34-35 dhe 1 Tim. 2:9-15, po pohon se gratë nuk duhet të marrin drejtimin në adhurimin publik! Por si ta zbatoj këtë në kohën time? Nuk dua që kultura e Palit, apo e imja, t'i mbyllë gojën Fjalës dhe vullnetit të Perëndisë. Ndoshta, koha e Palit ishte tepër kufizuese, por ndoshta koha ime mund të jetë tepër e hapur. S'ndihem fare rehat të them se fjalët dhe mësimet e Palit janë të vërteta të kushtëzuara, situatore, lokale të shekullit të parë. Kush jam unë që t'i lejoj mendjes ose kulturës sime të mohojnë një autor të frymëzuar?!

Nga ana tjetër, si t'ia bëj kur gjej shembuj biblikë për gratë drejtuese (edhe në shkrimet e Palit, shih Romakëve 16)? Një shembull i qartë i kësaj është diskutimi që i bën Pali adhurimit publik në 1 Korintasve 11-14. Në 11:5, ai duket se lejon predikimin dhe lutjen e grave në adhurimin publik, por me koka të mbuluara, ndërsa në 14:34-35 kërkon që ato të qëndrojnë në heshtje! Kishte dhjake (shih Rom. 16:1) dhe profetsha (shih Veprat e Apo. 21:9). Është pikërisht kjo larmi që më jep lirinë t'i identifikoj komentet e Palit (në lidhje me kufizimet për femrat) si tipare që vlenin vetëm për Korintin dhe Efesin e shekullit të parë. Në të dyja ato vende kishte probleme me femrat që ushtronin lirinë e tyre të sapogjetur (shih Bruce Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin]), gjë që mund të ketë shkaktuar vështirësi për kishën që të ungjillizonte shoqërinë për Krishtin. Liria e tyre duhej kufizuar në mënyrë që ungjilli të ishte më i efektshëm.

Koha ime është plotësisht e kundërt me atë të Palit. Në kohën time, ungjilli mund të kufizohet nëse grave të trajnuara, që dinë të flasin, nuk u lejohej të ndajnë ungjillin ose të drejtojnë! Cili është synimi absolut i adhurimit publik? A nuk është ungjillizimi dhe dishepullizimi? A mund të nderohet dhe kënaqet Perëndia nga gratë drejtuese? Bibla në tërësi duket se thotë “po”!

Unë dua t'i nënshtrohem Palit; teologjia ime është kryesisht paliane. Nuk dua që të ndikohem ose manipulohem nga feminizmi modern! Megjithatë, mendoj se kisha ka qenë e ngadaltë për të reaguar ndaj të vërtetave të qarta biblike, si papranueshmëria e skllavërisë, racizmit, fanatizmit dhe seksizmit. Po kështu, ajo ka reaguar shumë me vonesë ndaj abuzimit të femrave në botën e sotme. Perëndia, në Krishtin, e çliroi skllavin dhe femrën. Unë nuk guxoj që të lejoj një pasazh të kufizuar nga ana kulturore që t'i fusë sërish nën pranga.

Dhe një pikë e fundit: si interpretues, unë e di se Korinti ishte një kishë shumë problematike. Dhuntitë karizmatike vlerësoheshin dhe përdoreshin për t'u mburrur. Në këtë gjë mund të jenë përfshirë dhe femrat. Po kështu, besoj se Efesi po ndikohej nga mësuesit e rremë, të cilët po përfitonin nga gratë dhe po i përdornin si folëse zëvendësuese në kishat shtëpi të Efesit.

- C. Sugjerime për lexime të mëtejshëm

1. *How to Read the Bible For All Its Worth* [Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka], Gordon Fee dhe Doug Stuart (f. 61-77)
2. *Gospel and Spirit: Issues in New Testament Hermeneutics* [Ungjilli dhe Fryma: Çështje në hermeneutikën e Dhiatës së Re], Gordon Fee
3. *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të vështira në Bibël], Walter C. Kaiser, Peter H. Davids, F. F. Bruce, dhe Manfred T. Branch (f. 613-616; 665-667)

NKJV  
TEV  
NJB

“që ju të mund ta jepni veten tuaj tek lutja dhe agjërimi”  
“në mënyrë që të kaloni kohën tuaj në lutje”  
“që të lini veten tuaj të lirë për lutje”

“Agjërimi” është Tekstus Receptus që ndjek versionet MSS  $\kappa^c$ , K, dhe L dhe Peshitta. Megjithatë, pjesa më e madhe e teksteve antike greke, P<sup>11</sup>, P<sup>46</sup>,  $\kappa^*$  A, B, C, D, G, P, dhe pjesa më e madhe e përkthimeve moderne në anglisht, nuk e përfshijnë atë. Versioni UBS<sup>4</sup> i jep tekstit më të shkurtër një cilësim “A” (i sigurtë). Parimi i Dhjatës së Re mbi agjërimin vullnetar në mënyrë periodike për qëllime frymore paralelizohet këtu me mungesën e marrëdhënieve seksuale brenda martesës në mënyrë periodike për qëllime frymore. Ndërsa agjërimi e fokuson mendjen tek vullneti i Perëndisë, po të njëjtën gjë mund të bëjë edhe mungesa e marrëdhënieve seksuale.

#### TEMË E VEÇANTË: AGJËRIMI (SPECIAL TOPIC: FASTING)

Ndonëse nuk urdhërohet kurrë në Dhjatën e Re, agjërimi pritej që, në kohën e duhur, të bëhej nga dishepujt e Jezusit (shih Mat. 6:16, 17; 9:15; Marku 2:19; Luka 5:35). Agjërimi i duhur përshkruhet në Isaia 58. Jezusi e vendosi Vetë këtë precedent (shih Mat. 4:2). Kisha e hershme agjëronte (shih Veprat 13:2-3; 14:23; 2 Kor. 6:5; 11:27). Qëllimi dhe mënyra e agjërimit janë thelbësore; ndërsa koha, kohëzgjatja dhe shpeshësia janë fakultative. Agjërimi i Dhjatës së Vjetër nuk është detyrim për besimtarët e Dhjatës së Re (shih Veprat 15:19-29). Agjërimi nuk është mënyrë për t’u mburrur që je njeri shpirtëror (shih Isaia 58; Mat. 6:16-18), por është një mënyrë sesi mund të afroresh më tepër me Perëndinë dhe të kërkosh drejtimin e Tij (p.sh., Jezusi, Mat. 4:2). Agjërimi mund të jetë i dobishëm nga ana shpirtërore.

Prirja e kishës së hershme drejt asketizmit bëri që disa kopjues të fushin fjalën “agjërim” në disa pasazhe (shih Mat. 17:21; Marku 9:29; Veprat 10:30; 1 Kor. 7:5). Për të dhëna të mëtejshme për këto pjesë të dyshimta, shih librin e Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentar Tekstual i Dhjatës së Re Greke], botuar nga United Bible Societies.

■ “që të mos ju tundojë Satani” Edhe çiftet e martuara kanë nevojë të jenë shumë të kujdesshme ndaj tundimeve dredharake të Satanit brenda martesës. Seksualiteti njerëzor, edhe pse një dhuratë nga Perëndia, është një shtyrës i fuqishëm njerëzor. Satani e përdor këtë aspekt të nevojës biologjike si një instrument për të izoluar njerëzimin e rënë nga Perëndia. Kjo është e vërtetë si për të humburit edhe për të shpëtuarit, edhe pse në nivele të ndryshme (shih 1 Tim. 5:14-15).

Në këtë kontekst, gjendet qartazi një problem që adreson një teologji të seksualitetit njerëzor në kishën e Korintit. Ndoshta ajo i kishte të dy ekstremet e asketizmit ose libertinizmit.

#### TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON (SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL)

##### I. SATANI ËSHTË TEMË SHUMË E VËSHTIRË

Kjo është një temë shumë e vështirë për një sërë arsyesh.

- A. Dhjata e Vjetër nuk zbulon një kryearmik ndaj së mirës (Perëndisë), por një shërbëtor të YHWH-së, i cili i ofron njerëzimit një alternativë dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi (A. B. Davidson, *Old Testament Theology* [Teologjia e Dhjatës së Vjetër], f. 300-306).
- B. Koncepti i një kryearmiku personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërthjatore (jokanonike) nga ndikimi i fesë persiane (zoroasrianizmi). Nga ana e vet, ajo ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik (pra, gjatë mërgimit të Izraelit në Babiloni dhe Persi).
- C. Dhjata e Re i zhvillon temat e Dhjatës së Vjetër nëpërmjet kategorive çuditërisht të prera, por dhe të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, ose autor, ose gjini letrare, studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse ligësinë e studiojmë nga një qasje jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose e feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimit të Dhjatës së Re gjen pararendës në dualizmin persian dhe në spiritizmin greko-romak.

Nëse je i përkushtuar në mënyrë paraprake ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit (si unë!), atëherë zhvillimi në Dhjatën e Re duhet parë si zbulësë e përshkallëzuar. Të krishterët duhet të ruhen që të mos lejojnë idetë popullore judaike apo letërsinë evropiane (p.sh., Danten dhe Miltonin) që të qartësojnë më tej këtë koncept. Pa dyshim që ka mister dhe vagulli në këtë zonë të zbulësës. Perëndia ka zgjedhur të mos na zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, origjinën (Shih Temën e Veçantë: Luciferi) dhe synimin e saj, por na ka zbuluar mposhtjen e saj!

## II. SATANI NË DHIATËN E VJETËR

Në Dhjatën e Vjetër, termi Satan (BDB 966, KB 1317), ose “akuzues”, duket se përdoret për tre grupe të ndryshme.

- A. akuzues njerëzorë (1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbret. 11:14,23,25; Ps. 109:6,20,29)
- B. akuzues engjëj (Num. 22:22-23; Zak. 3:1)
  - 1. Engjëlli i Zotit – Num. 22:22-23
  - 2. Satani – 1 Kro. 21:1; Jobi 1-2; Zak. 3:1
- C. akuzues demonë (ndoshta, Satani) (1 Mbre. 22:21; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën ndërthjatore, identifikohet me Satanin gjarpri i Zanafillës 3 (shih Libri i Urtësisë 2:23-24; 2 Enokut 31:3); madje, kalon edhe më shumë kohë para se ky të bëhet mendim rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” në Zanafilla 6 bëhen engjëjt e ligj në 1 Enokut 54:6. Ata bëhen fillësia e ligësisë në teologjinë rabinike. Këtë po e përmend, jo për të pohuar saktësinë e saj teologjike, por për të treguar zhvillimin e saj. Në Dhjatën e Re, këto veprimtari të Dhjatës së Vjetër i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëjlore (pra, Satanit) në 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9.

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (në varësi të pikëvështrimit) të përcaktohet nga Dhjata e Vjetër. Një arsye për këtë është monoteizmi i fortë i Izraelit (shih Ligji i Përt. 6:4-6; 1 Mbret. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi i atribuohet YHWH-së për të demonstruar natyrën unike dhe epërsinë e Tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bijtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14; Ezekieli 28, ku mbretërit krenarë të lindjes së afërt (Babilonisë dhe Tirit) përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë s’jam shumë i bindur për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora të kopshtit të Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohjes së të Mirës dhe të Keqes (Ezekieli 31). Nga ana tjetër, Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një rebelim engjëjlor për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, kjo është një mënyrë dhe vend tejet i paqartë për këtë synim (shih Temën e Veçantë: Luciferi). Duhet t’i ruhem prirjes së teologjisë sistematike që të marrë pjesë të vogla dhe të vagullta nga Dhjata, autorë, libra dhe gjini të ndryshme e t’i kombinojë si copëza të një enigme hyjnore.

## III. SATANI NË DHIATËN E RE

Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah* [Jeta dhe kohët e Jezus Mesisë], vëll. 2, shtojcat XIII [f. 748-763] dhe XVI [f. 770-776]) thotë se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi dhe hamendësimi demoniak pers. Rabinët nuk janë burim i mirë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi ndryshon tërësisht nga mësimet e sinagogës. Unë mendoj se koncepti rabinik për ndërmjetësimin (shih Veprat e Apo. 7:53) dhe kundërshtimin engjëjlor në dhënien e ligjit që iu bë Moisiut në malin Sinai i hapi derën konceptit të armikut kryeengjëjlor të YHWH-së dhe njerëzimit. Në dualizmin persian (zoroastrian) ka dy perëndi të larta:

- 1. *Ahura Mazda*, më vonë i quajtur *Ohrmazd*, i cili ishte perëndia krijues, perëndia i mirë
- 2. *Angra Mainju*, më vonë i quajtur *Ahriman*, perëndia shkatërrues, perëndia i lig. Ata luftojnë për epërsi, ku toka është fushëbeteja. Ky dualizëm u zhvillua në judaizëm në një dualizëm të kufizuar mes YHWH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, në Dhjatën e Re shohim përparimin e zbulësës në lidhje me zhvillimin e konceptit të ligësisë, por jo aq me hollësi sa ç’shpallin rabinët. Një shembull i mirë i këtij dallimi është “lufta në qiell”.

Rënia e Satanit është domosdoshmëri logjike, por detajet nuk jepen (shih Temën e Veçantë: Rënia e Satanit dhe engjëjve të tij). Edhe ajo që jepet mbulohet me gjininë apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbyes i YHWH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t'i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ekziston vetëm një Perëndi dhe njerëzimi është përgjegjës për veprimet e veta. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara ashtu dhe pas shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe përmes Tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet (shih Zbu. 20:10)!

■ **“për shkak të mungesës së vetkontrollit tuaj”** Ky është termi *kratos*, i cili do të thotë “fuqi”, “forcë”, “sundim”, me një formë alfa privative, e cila mohon kuptimin. Kjo mungesë e vetëkontrollit përmendet tek

1. Mateu 23:25 në lidhje me skribët dhe farisenjtë
2. 1 Korintasve 7:5 në lidhje me çiftet e martuara
3. 2 Timoteu 3:3 në një listë vesesh

Termi i lidhur, *egkrateia*, ka një nënkuptim të vetë-kontrollit, sidomos të lidhur me aktivitetin seksual.

1. Veprat e Apo. 24:25 në një listë virtytesh të prezantuar nga Pali ndaj Feliksit
2. 1 Korintasve 7:9 në diskutimin e Palit të të drejtave martesore
3. 1 Korintasve 9:25 në lidhje me trajnimin atletik
4. Galatasve 5:23 në listën e Palit të fryteve të Frymës
5. 2 Pjetrit 1:6 në një listë karakteristikash të cilat sjellin maturi

Vetëkontrolli është (1) një fryt i Frymës dhe (2) një praktikë e zhvilluar e kontrollit të dëshirave natyrale.

Mbizotërimi i frymës njerëzore të shpenguar mbi mishin është i mundur me ndihmën e Frymës së Shenjtë që banon në ne. Dëshirat natyrale nuk janë të këqija në vetvete përveçse kur ato çohen përtej kufijve të dhëna nga Perëndia.

**7:6**

**NASB**

**“Por këtë e them si një mënyrë leje, dhe jo si urdhërim”**

**NKJV**

**“Por këtë e them si leje, jo si urdhërim”**

**NRSV**

**“Këtë unë e them si një mënyrë lejeje, jo si një urdhërim”**

**TEV**

**“Unë jua tregoj këtë jo si urdhër, por thjesht si një leje”**

**NJB**

**“Unë po jua tregoj këtë si një leje, jo si një urdhër”**

A i referohet 1 Kor. 7:6 (1) 1 Kor. 7:1-5; (2) 1 Kor. 7:3-5; (3) 1 Kor. 7:5; apo (4) 1 Kor. 7:7? Pali po jep opinionin e tij të drejtuar nga Fryma. Ai priste

1. Ardhjen e Dytë në çdo moment
2. Rritjen e persekutimit në çdo moment
3. Zinë e bukës së vazhduar

Qëllimi i tij ishte të ndihmonte besimtarët të zgjidhnin çështjet e tyre aktuale, jo t'i kufizonin ato.

**7:7 “sepse do të doja që të gjithë njerëzit të ishin si unë”** Kjo mund t'i referohet (1) Palit si një njeri beqar; (2)

Palit si një person (në brendësi) ose (3) Palit si një njeri me vetëkontroll (shih 1 Kor. 7:9). Pali nodshta ka qënë dikur i martuar për shkak të presionit kulturor nga origjina e tij hebraike dhe nënkuptimeve tek Veprat e Apo.

26:10, ku Pali duket se ka qënë pjesë e Sinedrit (dmth., “unë hedh votë”). Nëse ai ishte pjesë e Sinedrit, ai duhej të kishte qënë i martuar.

Dëshira e Palit që të gjithë besimtarët të qëndrojnë siç ishte ai, ka nevojë të sqarohet në disa mënyra.

1. Pali priste Ardhjen e Dytë gjatë jetës së tij, ashtu siç bënin të gjithë të krishterët e shekullit të parë. Rikthimi i Jezusit në çdo moment (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 6:14) ka për qëllim të jetë një motivues i fuqishëm ndaj ngjashmërisë me Krishtin dhe ungjillizimit në çdo epokë.
2. Pikëpamja e Palit duhet të shihet nën dritën e urdhërimit të Perëndisë për të “qënë të frytshëm dhe për t'u shumuar” nga Zan. 1:28.

☐ **“secili ka dhunti të veçantë nga Perëndia”** Kjo duket se i referohet beqarisë si një nga shumë dhuntitë frymore (shih Mate. 19:12). Nuk listohet tek ndonjë nga listat e dhuntive (Romakëve 12; 1 Korintasve 12; Efesianëve 4). Nuk duket të jetë një veprim apo funksion tipik sikurse dhuntitë e tjera. Pali po përdor fjalën “dhunti” në një kuptim të veçantë.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:8-9**

<sup>8</sup> Por të pamartuarve dhe grave të veja po u them se për ta është mirë nëse qëndrojnë si unë, <sup>9</sup> por në qoftë se s’kanë vetkontroll, le të martohen, sepse është më mirë të martohesh se të digjesh.

**7:8 “të pamartuarve dhe grave të veja”** Termi i parë është në gjininë mashkullore dhe mund t’iu referohet (1) të gjithë njerëzve të pamartuar ose (2) burrave të ve. Termi i dytë është në gjininë femërore dhe lidhet me (1) ato të cilëve iu kishte vdekur bashkëshorti ose (2) vejushave.

☐ **“për ta është mirë”** Shih shënimin tek 1 Kor. 7:1 mbi “mirë”.

☐ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila i referohet një veprimi të mundur.

☐ **“qëndrojnë si unë”** Pali sapo ka përmendur një dhunti frymore tek 1 Kor. 7:7, por ky varg përmend një situatë në jetë, jo një dhunti. Ndoshta “dhunti” përdoret në këtë kontekst në kuptimin e qëndrimit apo perspektivës.

**7:9 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë e cila supozohet të jetë e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Shumë do të duan të martohen jo për shkak se janë të këqij, por për shkak se nuk e kanë dhuntinë e beqarisë.

☐ **“s’kanë vetkontroll”** Kjo tingëllon shumë negative ndaj veshëve monderne. A po thotë Pali se martesë është një shenjë që besimtari nuk ka vetëkontroll? A është kjo një gjëndje më pak frymore? Nën dritën e mësimeve të të gjithë Shkrimeve kjo nuk mund të jetë e vërtetë. Pali po drejton komentet e tij tek situata lokale e përkohshme. Ky nuk është një koment universal mbi martesën dhe beqarinë. Martesa nuk është e keqja më e vogël; por marrëdhëniet seksuale të shturura është gjithmonë jashtë kufijve.

☐ **“le të martohen”** Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste. Pali e mbështeste martesën (shih 1 Tim. 5:14).

NASB **“sepse është më mirë të martohet se sa të digjet me pasion”**

NKJV, TEV **“Sepse është më mirë të martohet se sa të digjet me pasion”**

NRSV **“Sepse është më mirë të martohet se sa të marrë flakë me pasion”**

NJB **“Duke qënë se është më mirë të martohet se sa të digjet”**

Vini re kontrastin midis “të martohet” (formë infinitive aktive aoriste) dhe “të digjet” (formë infinitive pasive e tashme). Martesa e sjell pasionin e vazhdueshëm nën kontroll. Ky gjithashtu nuk është një koment zhvlerësues mbi martesën, por një vëzhgim praktik. Martesa është mënyra normale për të përmbushur një dëshirë të fortë dhe të përsëritur, të dhënë nga Perëndia. Po i njëjti term “digjet” përdoret nga Pali për veten e tij tek 2 Kor. 11:29; prandaj, nuk është automatikisht një term negativ.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:10-11**

<sup>10</sup> Kurse të martuarve u urdhëroj, jo unë, por Zoti, që gruaja të mos ndahet nga burri, <sup>11</sup> dhe në qoftë se ndahet, të mbetet e pamartuar, ose të pajtohet me burrin e saj. Dhe burri të mos e lërë gruan.

**7:10 “të martuarve”** Ky është grupi i tretë të cilëve iu drejtohet: “të pamartuarit”, “vejshët” dhe tani “të martuarit”.

☐ **“jo unë, por Zoti”** Me këtë frazë Pali po i referohet fjalëve të Jezusit, shumë, por jo të gjitha prej tyre, të regjistruara në Ungjijt sinoptikë për sa i përket divorcit (shih Mate. 5:32, 19:6; Mark 10:11-12; Luka 16:8).

Ky është një shembull i mirë i faktit që Pali nuk po merret me të gjithë aspektet e mësimëve të Zotit mbi divorcin, por vetëm me një. Letrat e Palit janë “dokumente të rastësishme”. Ai po regon ndaj teologjisë së varfër të të dy grupeve, liberalëve dhe asketëve. Kjo situatë vazhdon modelin e Palit teksa pranon disa nga pohimet e mësuesve të rremë apo grupeve të përçara, por gjithashtu përcakton kufijtë e sloganeve të tyre. Gjysmë-të vërtetat janë shumë të vështira për t’u korrigjuar, sidomos nëse abuzohet në të dy anët e çështjes!

■ **“që gruaja të mos ndahet nga burri”** Kjo nënkupton se të dy janë besimtarë (shih 1 Kor. 7:12-16). Gratë nuk kanë të drejtën të ndahen në judaizëm, por ato kishin të drejtë në shoqërinë romake. Vetëm sepse një kulturë e caktuar lejon apo nuk lejon diçka nuk do të thotë që besimtarët duhet t’iu japin vetes të drejtën apo ta kthejnë atë në një tabu! Për shkak se një person lejohet diçka nuk do të thotë se duhet ta bëjë atë gjë (shih Rom. 14:1-15:13). Me siguri ka rrethana në të cilat divorci është dukshëm gjëja më e mirë.

1. E keqja më e vogël
2. Ribashkimi është bërë i pamundur
3. Rrezik fizik ndaj bashkëshortit/es dhe fëmijëve është një mundësi reale

Në këtë pikë, dëshiroj të ritheksoj seriozitetin biblik të bërjes së betimeve në emër të Perëndisë. Martesat e krishtera janë betime fetare! Perëndia, më shumë se sa shoqëria shekullare, i mban besimtarët përgjegjës për mënyrën se si ata e trajtojnë emrin e Tij. Martesa është menduar të jetë e përhershme. Martesa është norma, jo përjashtimi. Në vitin 2002 përqindja aktuale e shtëpive tradicionale në Amerikën e Veriut (dmth., bashkëshort, bashkëshorte, fëmijë) është ulur në 23%! A e shihni problemin me divorcin e thjeshtë? Martesa është fillimisht një premtim ndaj Perëndisë dhe më pas ndaj një personi tjetër. Shtëpitë e forta të krishtera mund të jenë një nga instrumentet më të fuqishme dëshmuese në ditët tona (ashtu sikurse në Romën antike).

**7:11 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm. NASB e vendos këtë fjali në kllapa si një koment anësor. Mënyra lidhore nënkupton se divorcet po ndodhnin në komunitetin e krishterë.

■ **“të mbetet e pamartuar”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Pyetja e rimartesës së krishterë është një pyetje e vështirë. Ligji i Përtërirë 24 u shkruajti nga Moisiu për të shpjeguar për rimartesën. Përgjigjet e Jezusit, nën dritën e pyetjeve të farisenjve, nuk merren specifikisht me këtë çështje. Dikush mund të thotë, po Marku 10:11-12. Problem është se ky ungjill nuk përfshin fjalinë përjashtuese sikurse tek Mate. 5:32. Si lidhet fjalia përjashtuese me rimartesën? 1 Timoteu 5:14-15 ka nevojë të zgjerohet në ditët tona ndaj një grupi më të gjerë se sa “vejushat e reja”. Me siguri kujdesi i Perëndisë për beqarët që dëshirjnë të martohen tek 1 Kor. 7:9 duhet të lidhet gjithashtu me shoqërinë tonë të trazuar. Njerëzit u krijuan nga Perëndia si krijesa seksuale. Përveçse kur ka një dhunti beqarie, dhe / ose vetëkontroll të pjekur, duhet të ketë një opsion të përshtatshëm seksual për njerëzit e Perëndisë; imoraliteti seksual nuk është kurrë një mundësi, por një rimartese e krishterë mund të jetë një alternativë e pranueshme. Hiri dhe zbulesa duhet të zbatohen këtu.

■ **“ose të pajtohet me burrin e saj”** Kjo është një formë urdhërore aoriste pasive. Në këtë situatë kulturore, mundësitë e Palit për ata që janë të martuar tashmë ishin (1) beqaria ose (2) ribashkimi. Ky varg është përdorur si një rregull i vështirë dhe i shpejtë nga shumë besimtarë modernë. Ribashkimi është gjithmonë një shpresë përveçse kur njëri nga partnerët është rimartuar. Në këtë situatë ajo nuk është më rezultati i dëshiruar (dmth., është i ndaluar në Dhjatën e Vjetër).

Është e vështirë ta interpretohet 1 Korintasve sepse

1. Ka çështje të dukshme kulturore që kultura moderne perëndimore nuk i trajton drejtpërdrejtë (dmth., ushqimi i ofruar idhujve, partnerët e virgjër në shërbesë etj.).
2. Ka dy grupe tipesh personaliteti (dmth., asketët ose liberalët) ose grupet teologjike. Fjalët e Palit janë një përpjekje për të pranuar të vërtetat e përfshira, por kufizojnë teprinë (dmth., legalizmin dogmatik, mos u marto; dhe lirinë pa rregulla, nëse ndihesh mirë me këtë, bëje).

Është e pasigurtë nëse këto ekstreme reflektojnë (1) Hebrenjtë / Johebrenjtë; (2) legalistët / liberalët; (3) tipet e personaliteteve apo (4) dy forma të mendimit grek (i fundit i parë në grupet gnostike). Konfuzioni vjen kur interpretuesit modernë nuk e dinë

1. Cilët ishin sloganet
2. Burimin e sloganeve
  - a. Predikimet e mëparshme të Palit

- b. Judaizmi
- c. Stoikët / Gnostikët e parë

Pali iu drejtohet të dy ekstremeve! Vështirësia është të vendosësh cilat fjalë i drejtohen besimtarëve të vërtetë dhe cilat grupe të përçara. Interpretuesit modernë dëgjojnë atë që ata dëshirojnë të dëgjojnë dhe dënojnë atë që atyre nuk iu pëlqen! Interpretimet tona thonë më shumë për teologjinë tonë se sa letrat e Palit ndaj një qyteti romak në Akaia të shekullit të parë.

▣ **“Dhe burri të mos e lërë gruan”** Kujtoni se ky kontekst i drejtohet besimtarëve të martuar. Ka dy përjashtime në Dhjatën e Re ndaj këtij mandati: (1) sjellja e papërshtatshme seksuale (shih Mate. 5:32, 19:9) dhe (2) mosbesimi (shih 1 Kor. 7:12,13).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:12-16**

<sup>12</sup> Dhe të tjerëve u them unë, jo Zoti: në qoftë se një vëlla ka një grua jobesimtare dhe ajo pranon të jetojë bashkë me të, të mos e lërë atë. <sup>13</sup> Edhe gruaja, që ka një burrë jobesimtar, në qoftë se ai pranon të jetojë bashkë me të, të mos e lërë atë, <sup>14</sup> sepse burri jobesimtar është shenjtëruar me anë të gruas, dhe gruaja jobesimtare është shenjtëruar me anë të burrit, sepse përndryshe fëmijët do të ishin të papastër; kurse kështu janë të shenjtë. <sup>15</sup> Nëse jobesimtari ndahet, le të ndahet; në këto raste vëllai ose motra nuk janë më të lidhur; por Perëndia na ka thirrur në paqe. <sup>16</sup> Sepse çfarë di ti, o grua, nëse ke për ta shpëtuar burrin? Ose ç’di ti, o burrë, nëse ke për ta shpëtuar gruan?

**7:12 “të tjerëve”** Kjo iu referohet çifteve pagane të martuara ku njëri prej bashkëshortëve ishte bërë besimtar. Kjo nuk mund të përdoret si një justifikim që një besimtar të martohet me një jobesimtar. Kjo i referohet një situatë ku të dy ishin fillimisht jobesimtarë. Një prej tyre e kishte pranuar Krishtin dhe me shpresë me kalimin e kohës, edhe tjetri do ta bëjë (shih 1 Kor. 7:16).

NASB, NRSV	“u them unë, jo Zoti”
NKJV	“unë, jo Zoti”
TEV	“(vetë, unë, jo Zoti)”
NJB	“këto udhëzime janë të miat, jo të Zotit”

Ky nuk është një mohim i frymëzimit nga Pali, por thjesht një pranim që Pali nuk dinte rreth ndonjë mësimi të Jezusit mbi këtë çështje të caktuar. Pali pranon sensin e tij të frymëzimit tek 1 Kor. 7:25 dhe 40 të këtij kapitulli.

▣ **“në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Kishte çifte të përziera në Korint. Kjo tregon si efektshmërinë e predikimit të Palit ashtu edhe vështirësinë e përfshirë në të qenit i martuar ndaj një jobesimtari.

▣ **“të mos e lërë atë”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme, si në paralelizmin tek 1 Kor. 7:13.

**7:14**

NASB, NKJV, NJB	“sepse burri jobesimtar është shenjtëruar”
NRSV	“sepse burri jobesimtar është bërë i shenjtë”
TEV	“sepse burri jobesimtar është bërë i pranueshëm tek Perëndia”

Kjo është një formë treguese pasive e përkryer si në frazën paralele tek 1 Kor. 7:14. Kjo nuk nënkupton se bashkëshorti jobesimtar shpëtohet. Kjo lidhet me shqetësimin e disave në Korint se të qenit i martuar ndaj një jobesimtari mund të barazohej me pjesëmarrjen e tyre në mëkat. Ata mund të kenë dëgjuar mësimin e Palit mbi një mish (shih 1 Kor. 6:16-20). Kjo duhet të lidhet me ndikimin e perëndishëm të bashkëshortit besimtar në familje. Kjo nuk mund të lidhet me pozicionin e jobesimtarit në Krishtin. Nuk ka asnjë mënyrë të shpëtohesh frymërisht përveçse nëpërmjet besimit personal dhe pendesës në Krishtin. Ungjillizimi është qëllimi i besimtarit për bashkëshortin / bashkëshorten e saj / tij (shih 1 Kor. 7:16).

NASB, NIV	“gruaja jobesimtare është shenjtëruar përmes burrit të saj besimtar”
NKJV, NRSV	“gruaja jobesimtare është shenjtëruar me anë të burrit”



**NJB**  
**REB**

**“gruaja jobesimtare është shenjtëruar përmes vëllait”**  
**“gruaja përmes burrit të saj të krishter”**

Gjendet një variant i dorëshkrimit grek në këtë frazë. Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve të hershme greke kanë “vëllai” në vend të “bashkëshorti besimtar” (shih MSS P<sup>46</sup>,  $\kappa^*$ , A, B, C, D<sup>\*</sup>, G, dhe P). Skribët grekë e ndryshuan atë për ta balancuar me frazën paralele të mëparshme (shih MSS  $\kappa^c$ , D<sup>C</sup>, K, and L). Versioni UBS<sup>4</sup> i jep “vëlla” vlerësimin “A” (i sigurtë).

▣ **“sepse prindryshe fëmijët do të ishin të papastër; kurse kështu janë të shenjtë”** Ka pasur shumë interpretime të kësaj frazë; ajo i referohet

1. Ligjshmërisë së fëmijëve (dmth., në kuptimin ligjor)
2. Pastërtisë ceremoniale (dmth., në kuptimin hebraik)
3. Bashkëshorti jobesimtar dhe fëmijët marrin nga bekimet e atij që është i krishterë në familje (dmth., në kuptimin frymor)

Shumë janë përpjekur ta interpretojnë këtë varg në lidhje me praktikën e pagëzimit foshnjor, por ajo duket tejet e pamundur duke qënë se marrëdhënia e besimtarit ndaj fëmijëve është ekzaktësisht e njëjtë me marrëdhënien e besimtarit ndaj bashkëshortit / bashkëshortes jobesimtar/e. Shih Temën e Veçantë: I Shenjtë (SPECIAL TOPIC: HOLY) tek 1 Kor. 3:17.

**7:15 “Nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Krishtërimi ka bërë që disa nga familjet të ndahen (shih Mate. 10:34-36; Luka 12:49-53).

**NASB, NKJV**

**“nuk është më i lidhur në këto raste”**

**NRSV**

**“në një rast të tillë vëllai apo motra nuk është i lidhur!”**

**TEV**

**“Në raste të tilla, partneri i krishterë qoftë burri apo gruaja, është i lirë të veprojë”**

**NJB**

**“Në këto rrethana vëllai apo motra nuk është më i lidhur”**

Kjo është një formë treguese pasive e përkryer e termit “i skllavëruar”. Kjo nënkupton se të krishterët në këtë situatë të veçantë kulturore mund të mos nisin procedurat e divorcit, por nëse partneri jobesimtar e bën këtë gjë, atëherë kjo është e lejuar. Kjo nuk ka lidhje me besimtarët që martohen me jobesimtarët; kjo situatë i referohet dy jobesimtarëve nga të cilët njëri është konvertuar. Në kontekst kjo i referohet ndarjes, jo rimartesës (shih 1 Kor. 7:11), edhe pse terminologjia e Palit është shumë e ngjashme me “lidh dhe zgjidh” të jurisprudencës hebraike në të cilën rimartesa supozohet sipas Ligjit të Përt. 24:1-4. James S. Jeffers tek *The Greco-Roman World* [Bota Greko-Romake], thotë:

“termi i përkthyer ‘ndarje’ tek 1 Kor. 7:15 i referohet divorcit sepse antikët nuk kishin asnjë ekuivalent të konceptit modern ligjor të ndarjes” (fq. 247).

Megjithatë, çështja e divorcit duket se është vendosur për Palin tek mësimet e Jezusit (shih Mark 10:2-12). Pali mbron “beqarinë” ndaj atyre që nuk janë të “lidhur” dhe rimartesën ndaj atyre të cilëve iu ka vdekur bashkëshorti / bashkëshortja!

▣ **“Perëndia na ka thirrur në paqe”** Kjo është një formë treguese aktive e përkryer. Ajo i referohet paqes me Perëndinë i cili jep paqe brenda besimtarit dhe brenda shtëpisë së tij. Perëndia dëshiron që fëmijët e Tij të kenë shtëpi të lumtura, të dashura dhe përmbushëse. Kjo shpesh është e pamundur me një bashkëshort agresiv, jobesimtar dhe ndonjëherë e pamundur me një bashkëshort të krishterë të papjekur, egoist dhe mëkatar! Mungesa e paqes është vetë arsyeja pse disa familje “të krishtera” ndahen. Shpesh një partner mund të jetë besimtar, por jo i pjekur. Paqja nuk është prezente në të gjitha familjet “e krishtera”! Unë thjesht nuk mundem të besoj se Pali, në këtë kontekst, po mbron qëndrimin bashkë me qdo kusht! Ka situata të rrezikshme fizike dhe emocionale. Ky nuk mund të jetë një mandat i vështirë dhe i shpejtë universal. Ai duhet interpretuar në kontekst dhe me tekste të tjera. Është kaq e vështirë të balancosh respektin tonë për Shkrimet dhe aspektet kulturore dhe historike në zbulësë (dmth., Bibla).

Teksti i UBS<sup>4</sup> preferon (vlerësimi B) “ju” në shumës, e cila gjendet tek MSS,  $\kappa^*$ , A, C, K, në vend të “ne” (MSS, P<sup>46</sup>,  $\kappa^2$ , B, D, F, G). Ka shumë variante tekstuale të lidhura me përemrat.

**7:16 “Ose ç’di ti, o burrë, nëse ke për ta shpëtuar gruan”** Ka dy interpretime të mundshme këtu të cilat janë dramatikisht të kundërta.

1. Ky pasazh ndoshta ndjek 1 Pje. 3:1-12 ku ungjillizimi është një arsye e kuptimtë për të vazhduar një marrëdhënie martesore (shih NRSV, TEV, NJB, NEB, NIV)
2. Martesa nuk është së pari për ungjillizim; ajo është për bashkërrugëtim dhe marrëdhënie, prandaj, një partner besimtar nuk duhet të qëndrojë me partnerin jobesimtar në një situatë abuzimi dhe mungese dashurie, thjesht me shpresën e ungjillizimit (shih shënimin, përkthimi i Phillips dhe LB).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:17-20**

<sup>17</sup> Gjithsecili secili të vazhdojë të jetojë ashtu si ia ka dhënë Perëndia dhe ashtu sikurse e thirri Zoti; dhe kështu urdhëroj në të gjitha kishat. <sup>18</sup> A u thirr ndokush kur ishte i rrethprerë? Le të mos bëhet i parrethprerë. Dikush u thirr kur ishte i parrethprerë? Le të mos rrethpritet. <sup>19</sup> Rrethprerja nuk është asgjë dhe parrethprerja nuk është asgjë, vetëm zbatimi i urdhërimeve të Perëndisë ka rëndësi. <sup>20</sup> Gjithsecili le të mbetet në atë gjendje në të cilën ishte thirrur.

**7:17**

NASB	“Vetëm”
NKJV	“Por”
NRSV	“Megjithatë”
TEV	-hequr-
NJB	“Gjithsecili”
NIV	“Megjithatë”

Kjo nis implikimet e zgjeruara të diskutimit të Palit mbi çështjet seksuale. Termat grekë *ei mē* mund të nënkuptojnë “vetëm nëse”, “përveç” ose “por”.

NASB, NRSV	“Zoti ia ka dhënë gjithësecilit”
NKJV	“Perëndia i ka shpërndarë gjithësecilit”
TEV	“dhurata e Zotit ndaj jush”
NJB	“Zoti i ka dhënë atij”

Kjo folje *merizō* do të thotë “të ndash ose të shpërndash”. Ajo përdoret në Septuagint për ndarjen e Tokës së Premtuar ndaj fiseve hebraike nga YHWH (shih Eksod. 15:9; Num. 26:53,55,56; Ligji i Përt. 18:8), i cili e bën atë një metaforë për popullin e Perëndisë ashtu sikurse bën folja tjetër, “thirri”. YHWH “thirri” popullin e Tij dhe ata i “thirrën” emrit të Tij. Në këtë kontekst, të dy foljet i referoën dhuntisë së veçantë nga Perëndia (shih 1 Kor. 7:7), e cila lejon që njerëzit t’i shërbejnë Atij (shih 1 Kor. 12:7,11). Cilado qoftë situata e jetës së tyre, kur ata u thirrën, shpëtuan dhe iu dhanë dhunti, ata tani duhet të shërbejnë (dmth., “qëndroni siç jeni”, 1 Kor. 7:8,17,20,24,26,40). Lulëzo aty ku u mbolle me ndihmën e Perëndisë dhe disa përjashtime.

NASB	“në këtë mënyrë le të ecë ai”
NKJV	“le të ecë ai”
NRSV	“le të drejtojë jetën secili nga ju”
TEV	“të vazhdojë të jetojë”
NJB	“le të vazhdojë secili në pjesën”

Kjo është fjalë për fjalë “ecni” (dmth., në formën urdhërore aktive të tashme), e cila është një metaforë biblike për stilin e jetesës (shih Efe. 2:2,10; 4:1,17; 5:2,15; Kol. 1:10; 2:6). Pali e shpjegon atë që ai dëshiron të thotë tek 1 Kor. 7:18-20.

■ **“kështu urdhëroj në të gjitha kishat”** Kjo frazë përsëritet shpesh tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:16; 14:33; 16:1). Kisha korintase e mendonte vetveten si “të veçantë”, “të privilegjuar” dhe “me dhunti të veçanta”. Pali reagon ndaj kësaj arrogancë false duke pranuar se ai mëson të njëjtat të vërteta në të gjitha kishat. Shih Temën e Veçantë: Kisha tek 1 Kor. 1:2.

7:18  
NASB  
NKJV  
TEV  
NJB

“Ai nuk duhet të bëhet i parrethprerë”  
“Le të mos bëhet i parrethprerë”  
“ai nuk duhet të përpiqet të heqë shenjat e rrethprerjes”  
“Nëse një njeri i cili është thirrur është rrethprerë tashmë, atëherë ai duhet të qëndrojë i rrethprerë”

Kjo është një formë urdhërore pasive e tashme (paralelizmi tek 1 Kor. 7:18b gjithashtu është në formën urdhërore pasive të tashme). Kjo i referohet dikujt që heq me operacion shenjat e rrethprerjes (shih 1 Makabeut 1:15 dhe *Antiq.* i Josefus 12.5.1).

**7:19 “Rrethprerja nuk është asgjë dhe parrethprerja nuk është asgjë”** Kjo tregon pikëpamjen e Palit mbi ritualet dhe rregullat e Dhjatës së Vjetër (shih Veprat e Apo. 15; Rom. 2:28,29; Gal. 5:6; 6:15; shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 9:9). Kjo ishte pikërisht çështja e ngritur në Këshillin e Jeruzalemit të Veprave të Apostujve 15 dhe i zgjeruar nga Judaizerët në kishat e Galatisë. Teologjia e Palit në këtë pikë është mjaft e qartë. Johebrenjtë nuk kanë nevojë të performojnë rite, rituale dhe procedura kultike hebraike. Hebrenjtë besimtarë nuk duhet të jenë as krenarë dhe as të turpëruar nga praktikatat e besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër që kishin praktikuar në të shkuarën. Rrethprerja e vërtetë është ajo e zemrës (shih 1 Kor. 10:16; Ligji i Përt. 30:6; Jer. 4:4), jo trupi, dhe çështjet e saj në veshët e “rrethprerë” (shih Jer. 6:10) për të dëgjuar Perëndinë dhe buzët (shih Eksod. 6:12,30) për të folur mesazhin e Tij, mesazhin e Tij të ri në Krishtin (shih Jer. 9:25,26).

■ **“vetëm zbatimi i urdhërimeve të Perëndisë ka rëndësi”** Ky është theksi i profetëve të Dhjatës së Vjetër që bindja është më e rëndësishme se sa rituali (shih 1 Sam. 15:22; Isa. 1:11-17; Ose. 6:6; Amos 5:21-27; Mik. 6:6-8). Perëndia shikon qëndrimin dhe arsyet tona përpara se të shohë veprimet tona. Të gjitha çështjet e Perëndisë me njerëzimin e rënë, në Dhjatën e Vjetër dhe të Re, janë mbi një bazë besëlidhjeje. Bindja është thelbësore (shih Luka 6:46), por aspektet e kërkesave specifike të besëlidhjes kanë ndryshuar me kalimin e kohës.

**7:20 “Gjithsecili le të mbetet në atë gjendje në të cilën ishte thirrur”** Versioni NKJV është më i drejtëpërdrejtë dhe e ruan lojën me fjalë që bëhet “le të qëndrojë secili në të njëjtën thirrje që është thirrur” (shih Efe. 4:1,4). Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Ajo është tema e përsëritur e Palit përgjatë këtij kontekstit (1 Kor. 7:8,17,20,24,26,40). Termi “thirrur” i referohet momentit kur ata kishin pranuar Krishtin (shih 1 Kor. 1:20). Shih Temën e Veçantë: Thirrur (SPECIAL TOPIC: CALLED) tek 1 Kor. 1:1.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:21-24**

<sup>21</sup> A je thirrur kur ishe skllav? Mos u pikëllo; por nëse mund të bëhesh i lirë, më mirë ta bësh këtë. <sup>22</sup> Sepse ai që është thirrur në Zotin kur ishte skllav, është i liruari i Zotit; po ashtu ai që është thirrur kur ishte i liru, është skllav i Krishtit. <sup>23</sup> Ju jeni blerë me një çmim, mos u bëni skllav të njerëzve. <sup>24</sup> Vëllezër, secili le të mbetet te Perëndia në gjendjen në të cilën është thirrur.

**7:21 “skllav”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 4:1.

NASB  
NKJV  
NRSV

“nëse gjithashtu ke mundësi të bëhesh i lirë, bëje këtë”  
“por nëse mund të bëhesh i lirë, përdore këtë”  
“edhe nëse mund të fitosh lirinë tënde, përdore kushtin tënd të tashëm tani më shumë se kurrë”  
TEV  
NJB  
“por nëse ke një shans të bëhesh i lirë, përdore këtë”  
“edhe nëse ke një shans lirie, ti duhet të preferosh ta përdorësh plotësisht për kushtin tënd si skllav”

Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, disa skllavë do të kenë mundësinë të bëhen të lirë, të ndjekur nga një formë urdhërore aoriste e mesme, “bëje!” Ka dy mundësi interpretimi.

1. Që një skllav duhet të qëndrojë në situatën në të cilën ai është thirrur, 1 Kor. 7:20,24

2. Që nëse ai ka një mundësi të bëhet i lirë, ai / ajo duhet ta përdorë këtë mundësi (shih NASB, TEV, NJB) Kjo i përshtatet kontekstit të menjëhershëm të lirisë të (1) beqarë për t'u martuar, 1 Kor. 7:9 dhe 28 (shih NRSV, NJB) dhe (2) partnerëve besimtarë për të lënë partnerët jobesimtarë, 1 Kor. 7:15. Këtu janë këshilla personale e Palit dhe zgjedhja e besimtarit individual anë për anë. Të gjithë besimtarët kanë vështirësi me këto “zona gri”. Kur Zoti ose Shkrimet nuk kanë adresuar një çështje qartazi, besimtarëve iu jepet një “fleksibilitet i perëndishëm”! Në disa çështje “një masë” nuk i përshtatet të gjithëve!

**TEMË E VEÇANTË: POROSITË E PALIT PËR SKLLEVËRIT (SPECIAL TOPIC: PAUL'S ADMONITIONS TO SLAVES)**

1. Ji i kënaqur, por nëse të del mundësia për të fituar lirinë, shfrytëzoje (1 Kor. 7:21-24).
2. Në Krishtin nuk ka skllav apo të lirë (Gal. 3:28; Kol. 3:11; shih 1 Kor. 12:13).
3. Puno si për Zotin; Ai do të ta shpërblejë (Efe. 6:5-9; Kol. 3:22-25; shih 1 Pje. 2:18-20).
4. Në Krishtin skllavërit bëhen vëllezër (1 Tim. 6:2; Filemoni 1:16-17).
5. Skllavërit e perëndishëm e nderojnë Perëndinë (1 Tim. 6:1; Titit 2:9).

Porositë e Palit për skllavopronarët:

Skllavërit dhe skllavopronarët e krishterë kanë të njëjtin Zotëri; prandaj, duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin me respekt (Efe. 6:9; Kol. 4:1).

Skllavëria është një nga elementet kulturore (si kultura patriarkale) që ishte shtyllë e botës së shekullit të parë. Dhjata e Re nuk e sfidon këtë aspekt. Megjithatë, të vërtetat e ungjillit, me kalimin e kohës sollën ndryshime në këtë aspekt kulturor.

**7:22-23** Në Zotin të gjithë besimtarët janë të lirë; në Zotin të gjithë besimtarët janë shërbëtorë (shih 1 Kor. 8:1-10:33; Rom. 14:1-15:13). Jezusi, duke vepruar si *go'el* ynë, na bleu nga skllavëria e mëkatit dhe vetvetes. Tani ne i shërbejmë Atij (shih 1 Kor. 6:20; 7:23; Rom. 6; Kol. 2:16-23).

**7:23 “mos u bëni skllavër të njerëzve”** Gjuha greke është një gjuhë e lakueshme. Ndonjëherë forma mund të ketë dy kuptime të mundshme. Kjo formë urdhërore mund të jetë

1. E tashme e mesme, “mos e lejoni veten të bëheni skllavër të njerëzve”
2. E tashme pasive, “mos u skllavëroni nga njeriu”

Të dyja i përshtaten kontekstit. Grupet e përçara në kishën korintase po përpiqeshin të kontrollonin të gjithë besimtarët. Kjo ende ndodh sot. Duhet të ketë liri brenda kufijve; një liri, jo ndaj vetes dhe mëkatit, por tek Krishti (shih Romakëve 6 dhe 14); një liri të zgjedhjeve individuale të stilit të jetesës se si të shërbesh Krishtin më mirë të udhëhequr nga dhuntitë e Perëndisë dhe rrethanat e tashme.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:25-31**

<sup>25</sup> Por për sa u takon virgjëreshave, s'kam urdhër nga Zoti, por po jap një mendim si njeri që kam fituar mëshirën e Zotit për të qenë i besueshëm. <sup>26</sup> Mendoj se është mirë për njeriun të jetë kështu siç është, për shkak të ngushticës së tanishme. <sup>27</sup> Je i lidhur me një grua? Mos kërko të zgjidhesh. Je i zgjidhur nga gruaja? Mos kërko grua. <sup>28</sup> Por, edhe në qoftë se martohesh, ti nuk mëkaton; edhe nëse një virgjëreshë martohet, nuk mëkaton; por këta do të kenë shtrëngim në mish; dhe unë dëshiroj t'ju kursej juve. <sup>29</sup> Dhe po ju them këtë, o vëllezër, se koha tanimë është shkurtuar; kështu tash e tutje edhe ata që kanë gra të jenë si ata që nuk kanë; <sup>30</sup> dhe ata që qajnë, sikurse të mos qanin; dhe ata që gëzohen, sikurse të mos gëzoheshin; dhe ata që blejnë, sikur të mos kishin gjë në zotërim; <sup>31</sup> dhe ata që përdorin nga kjo botë, sikur të mos e përdornin, sepse forma e kësaj bote po kalon.

**7:25 “Por tani në lidhje me<sup>17</sup>”** Kjo është një shenjë tekstuale që tregon se Pali po kalon në një pyetje tjetër të shkruar që e kishte marrë nga kisha korintase (shih 1 Kor. 7:1,25; ;8:1; 12:1; 16:1,12).

NASB, NKJV, NRSV, NIV

“virgjëreshave”

<sup>17</sup> Versioni në shqip është: “Por për sa u takon”. (shënim i përkthyesit)

**TEV**  
**NJB**

**“njerëzit e pamartuar”**  
**“njerëzit që kanë qëndruar të virgjër”**

Pyetja më e madhe për këtë term është se si lidhet përdorimi i tij tek 1 Kor. 7:25 me përdorimin e tij tek 1 Kor. 7:36 (shih shënimin tek 1 Kor. 7:36). Konteksti i 1 Kor. 7:25-35 duket se lidhet me beqarinë në krahasim me martesën si gjendja e preferuar nën dritën e situatës aktuale, e cila mund t'i referohej

1. Ardhjes së Dytë të menjëhershme
2. Persekutimit qeveritar
3. Urisë të përhapur në atë zonë
4. Aftësisë së personit beqar për t'u fokusuar në shërbesën ndaj Krishtit

▣ **“s’kam urdhër nga Zoti, por po jap një mendim”** Disa janë përpjekur të përdorin pohimin e Palit tek 1 Kor. 7:6 dhe 25 për të ulur autoritetin e tij si një apostull ose për ta bërë këtë një mohim të frymëzimit. Nuk është asnjë nga këto. Kjo është një formë shprehimore për të pranuar se ai nuk e di nëse Jezusi i është drejtuar ndonjëherë kësaj çështjeje në mënyrë specifike. Vargjet 25 dhe 40 tregojnë se Pali e ndjente se apostullati dhe thirrja e tij i jepnin atij autoritetin t'i adresonte këto çështje që ishin gritur në jetën e kishës së hershme johebraike.

▣ **“si njeri që kam fituar mëshirën e Zotit për të qenë i besueshëm”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer. Kjo është një formë shprehimore e të pranuarit të autoritetit të tij apostolik dhe njohurisë së drejtuar nga Fryma.

**7:26**

**NASB, NKJV, TEV**  
**NRSV**  
**NJB**

**“ngushtica e tanishme”**  
**“kriza e vazhdueshme”**  
**“për shkak të stresit që rëndon mbi ne”**

Ky pasazh është interpretuar në disa mënyra, por është shumë e rëndësishme të shohësh se pjesa më e madhe e pohimeve në kapitullin 7 nuk janë parime universal, por janë reagime të Palit ndaj situatave lokale dhe të përkohshme. Disa e shohin këtë frazë si t'i referohej:

1. Krizës së kulturës pagane
2. Situatës specifike lokale në Korint
3. Një urie në të gjithë zonën mesdhetare
4. Afërsisë së Ardhjes së Dytë (shih 1 Kor. 7:29)

▣ **“është mirë për njeriun të jetë kështu siç është”** Bëhet një lojë me fjalën “mirë” (shih 1 Kor. 7:1,18,26), që do të thotë “me përfitim”. Tema e përsëritur e “qëndroni në të njëjtin kusht siç kur u shpëtuat” (shih 1 Kor. 7:8,12-13,18,21,24,26,27,37,40); ky është standarti teologjik i Palit në këtë letër.

**7:27 “Je i lidhur me një grua?”** Kjo është një formë treguese pasive e përkryer nga termi *dēo*, i cili do të thotë të lidhësh. Ai përdoret në një kuptim metaforik për martesën (shih 1 Kor. 7:27,39; Rom. 7:2). Gjendet një paralelizëm ndaj kësaj fraze në të njëjtin varg, i cili gjithashtu është në formën treguese pasive të përkryer, “Je i zgjidhur nga gruaja?” Pali dëshiron që dëgjuesit e tij të qëndrojnë ashtu siç ata janë.

▣ **“Mos kërko të zgjidhesh... Mos kërko grua”** Këto janë të dyja forma urdhëruese aktive të tashme me forma pjesore mohuese, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh së kryeri një veprim në proces. Këtu sërish lind pyetja nëse grupe të ndryshme po mbronin modele familjare të ndryshme (beqarinë, martesën, shturjen) apo nëse qëllimi i Palit është shërbesa maksimale ndaj Krishtit. Kjo është një çështje e përsëritur. Pali duket se pranon se

1. Të gjithë duhet të qëndrojnë siç janë
2. Nëse dikush është beqar, duhet të fokusohet në shërbesën ndaj Krishtit
3. Nëse ka një dëshirë për martesë, s'ka problem, por përdoreni martesën tuaj për t'i shërbyer Krishtit!

Besimtarët qëndrojnë beqarë për të shërbyer, martohen për të shërbyer, jetojnë në persekutim për të shërbyer, jetojnë në liri për të shërbyer, jetojnë në bindje teologjike për të shërbyer! Besimtarët shpëtohen për të shërbyer!

**7:28 “në qoftë se... nëse”** Këto janë të dyja fjali kushtore të rendit të tretë, të cilat do të thonë veprim i mundshëm.

▣ **“ti nuk mëkaton”** Pali po i drejtohet një situatë unike, nuk po bën pohime universale. Martesa është normë e dhënë nga Perëndia (shih Zan. 1:28).

▣ **“në qoftë se ti... nëse një virgjëreshë”** Pyetja është kujt i referohen këto pika? E para lidhet me 1 Kor. 7:27. Nëse po, atëherë kjo i referohet rimartesës. E dyta lidhet me 1 Kor. 7:25, iu drejtohet atyre që nuk kanë qënë kurrë të martuar. Të dy kategoritë janë adresuar sërish tek 1 Kor. 7:34.

▣ **“por këta do të kenë shtrëngim në mish; dhe unë dëshiroj t’ju kursej juve”** Kjo nuk lidhet me martesën në përgjithësi, por me krizën e tashme (shih 1 Kor. 7:26). Vargjet 32-34 i drejtohen martesës si një parim i përgjithshëm.

▣ **“shtrëngim”** Shih Temën e Veçantë: Mundim tek 2 Kor. 1:4.

▣ **“shtrëngim”** Kjo është fjalë për fjalë “mish”. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**7:29 “koha tanimë është shkurtuar”** Kjo është një formë perifrastike pasive e përkryer. Ka disa interpretime të kësaj fraze; ajo duket se kontekstualisht lidhet me 1 Kor. 7:25 (“shtrëngimi i tanishëm”). Kalvini besonte se i referohej shkurtësisë së jetës njerëzore; të tjerë kanë qënë në njëjtën linjë duke besuar se i referohet mundësisë së shkurtër për shërbesën tonë të krishterë. Unë besoj se i referohet Ardhjes së Dytë (shih 1 Kor. 7:31; Rom. 13:11-12).

A priste Pali një rikthim të menjëhershëm të Jezusit apo një rikthim të mëvonshëm? Gjenden tekste për të dy herët. Unë nuk mendoj se teologjia e Palit ndryshoi (apo u maturua). Në një nga letrat e tij të para ai mëson për një Ardhje të Dytë të mëvonshme (shih 2 Thesalonikasve 2). Pali (sikurse të gjithë autorët e Dhjatës së Re) përdorën shpresën e një ardhjeje të sigurtë të Zotit si një nxitje ndaj jetesës së perëndishme dhe shërbesës aktive. Rikthimi i Krishtit është pritshmëria e çdo brezi besimtarësh, por do të jetë realiteti i vetëm njërit brez! Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 6:14.

Për një diskutim interesant mbi eskatologjinë apokaliptike dhe komentet e Palit tek 1 Kor. 7:26,28,29, shih *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira në Bibël], fq. 593-595.

**7:29-30 “ata që”** Këto fraza paralele përshkruajnë jetën njerëzore normale të përditshme. Besimtarët duhet të qëndrojnë të fokusuar në detyrat e tyre shërbestare, sipas dhuntive të tyre frymore (shih 1 Kor. 7:32,35). Besimtarët janë qytetarë të dy hapësirave, botës frymore dhe botës fizike, ose të kishës dhe të botës. Bota fizike nuk është e ligë por tranzitore. Besimtarët duhet të jenë të orientuar ndaj shërbesës, të orientuar ndaj ungjillit. Në përdorim botën dhe burimet e saj për t’i shërbyer Mbretërisë. Përndryshe, gjëja fizike dhe gjërat e botës na përdorin ne!

Mos lejoni martesën të veprojë si një çlirim nga prioritetet frymore! Jetoni në të dy botët me urtësi të perëndishme.

**7:30 “sikur të mos kishin gjë në zotërim”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: PASURIA (SPECIAL TOPIC: WEALTH)**

- I. Këndvështrimi i Dhjatës së Vjetër në tërësi
  - A. Perëndia është zotëruesi i gjithçkaje
    1. Zanafilla 1-2
    2. 1 Kronikave 29:11
    3. Psalmi 24:1; 50:12; 89:11
    4. Isaia 66:2
  - B. Njerëzit janë administrues të pasurisë për synimet e Perëndisë

- 1.Ligji i Përtërirë 8:11-20
  - 2.Levitiku 19:9-18
  - 3.Jobi 31:16-33
  - 4.Isaia 58:6-10
- C. Pasuria është pjesë e adhurimit
- 1.Dy të dhjetat
    - a. Numrat 18:21-29; Ligji i Përt. 12:6-7; 14:22-27
    - b. Ligji i Përtërirë 14:28-29; 26:12-15
    - c. Fjalët e Urta 3:9
- D. Pasuria shihet si dhuratë nga Perëndia për besnikërinë ndaj besëlidhjes
- 1.Ligji i Përtërirë 27-28
  - 2.Fjalët e Urta 3:10; 8:20-21; 10:22; 15:6
- E. Paralajmërimi për pasurinë në kurriz të të tjerëve
- 1.Fjalët e Urta 21:6
  - 2.Jeremia 5:26-29
  - 3.Osea 12:6-8
  - 4.Mikea 6:9-12
- F. Pasuria nuk është e mëkatshme në vetvete, ndonëse përbën përparësi
- 1.Psalmi 52:7; 62:10; 73:3-9
  - 2.Fjalët e Urta 11:28; 23:4-5; 27:24; 28:20-22
  - 3.Jobi 31:24-28

## II. Këndvështrimi unik i Fjalëve të Urta

- A. Pasuria vendoset në zonën e përpjekjeve personale
- 1.përtacia dhe dembelizmi dënohen – Fjalët e Urta 6:6-11; 10:4-5,26; 12:24,27; 13:4; 15:19; 18:9; 19:15,24; 20:4, 13; 21:25; 22:13; 24:30-34; 26:13-16
  - 2.puna e palodhur mbrohet – Fjalët e Urta 12:11, 14; 13:11
- B. Varfëria kundrejt pasurisë përdoret për të ilustruar drejtësinë kundrejt ligësisë – Fjalët e Urta 10:1 e më tej; 11:27-28; 13:7; 15:16-17; 28:6,19-20
- C. Urtësia (njohja e Perëndisë dhe Fjalës së Tij, dhe jetësimi i kësaj njohurie) është më e mirë se pasuritë: Fjalët e Urta 3:13-15; 8:9-11,18-21; 13:18
- D. Paralajmërimi dhe porosi
- 1.Paralajmërimi
    - a. mos dil garant për kredinë e të afërmit: Fjalët e Urta 6:1-5; 11:15; 17:18; 20:16; 22:26-27; 27:13
    - b. ruhu nga pasurimi me mjete të padrejta: Fjalët e Urta 1:19; 10:2,15; 11:1; 13:11; 16:11; 20:10,23; 21:6; 22:16,22; 28:8
    - c. mos merr borxh: Fjalët e Urta 22:7
    - d. ruhu nga natyra e përkohshme e pasurisë: Fjalët e Urta 23:4-5
    - e. pasuria nuk do të të ndihmojë në ditën e gjykimit: Fjalët e Urta 11:4
    - f. pasuria bën shumë “miq”: Fjalët e Urta 14:20; 19:4
  - 2.Porosi
    - a. nxitet bujaria: Fjalët e Urta 11:24-26; 14:31; 17:5; 19:17; 22:9,22-23; 23:10-11; 28:27
    - b. drejtësia, më e mirë se pasuria: Fjalët e Urta 16:8; 28:6, 8, 20-22
    - c. lutje për përmbushjen e nevojave, jo për pasuri të madh: Fjalët e Urta 30:7-9
    - d. kur i jep të varfrit, i ke dhënë Perëndisë: Fjalët e Urta 14:31

## III. Këndvështrimi i Dhjatës së Re

- A. Jezusi
- 1.pasuria të shtyn në tundimin e veçantë që të besosh te vetja dhe te burimet e tua, dhe jo te Perëndia dhe burimet e Tij

- a. Mateu 6:24; 13:22; 19:23
  - b. Marku 10:23-31
  - c. Luka 12:15-21, 33-34
  - d. Zbulesa 3:17-19
2. Perëndia do të sigurojë për nevojat tona fizike
- a. Mateu 6:19-34
  - b. Luka 12:29-32
3. mbjellja lidhet me korrjen (fizike, por edhe shpirtërore)
- a. Marku 4:24
  - b. Luka 6:36-38
  - c. Mateu 6:14; 18:35
4. pendimi ndikon në pasuri
- a. Luka 19:2-10
  - b. Levitiku 5:16
5. shfrytëzimi ekonomik dënohet
- a. Mateu 23:25
  - b. Marku 12:38-40
6. gjykimi i ditëve të fundit lidhet me përdorimin që i bëjmë pasurisë: Mateu 25:31-46

#### B. Pali

1. pikëpamje praktike si Fjalët e Urta (puna)
- a. Efesianëve 4:28
  - b. 1 Thesalonikasve 4:11-12
  - c. 2 Thesalonikasve 3:8, 11-12
  - d. 1 Timoteut 5:8
2. pikëpamje shpirtërore si Jezusi (gjërat janë të përkohshme, prandaj ji i kënaqur)
- a. 1 Timoteut 6:6-10 (kënaqja)
  - b. Filipianëve 4:11-12 (kënaqja)
  - c. Hebrenjve 13:5 (kënaqja)
  - d. 1 Timoteut 6:17-19 (bujaria dhe besimi në Perëndinë; jo pasuritë)
  - e. 1 Korintasve 7:30-31 (transformimi i gjërave)

#### IV. Përfundime

- A. Nuk ka teologji sistematike në Bibël për pasurinë.
- B. Nuk ka pasazhe absolute për këtë temë; prandaj, mësimet mund të nxirren nga pasazhet e ndryshme. Kujdes që të mos i detyrosh pasazhet e izoluara që t'i përshtaten pikëpamjeve të tua.
- C. Fjalët e Urta, që u shkruan nga njerëz të mençur (të urtët), kanë këndvështrim të ndryshëm nga llojet e tjera të gjinive letrare biblike. Fjalët e Urta është libër praktik dhe i përqendruar te individi. Ai drejtpeshon dhe duhet drejtpeshuar me Shkrimet e tjera (shih Jer. 18:18).
- D. Koha jonë duhet t'i analizojë pikëpamjet dhe praktikatat e veta në lidhje me pasurinë në dritën e Biblës. Kemi përparësi të gabuara nëse udhërrëfyes të vetëm kemi kapitalizmin, ose komunizmin. Pse dhe si mund të arrihet suksesi janë pyetje më të rëndësishme sesa vlera e pasurisë që akumulon njeriu.
- E. Akumulimi i pasurisë duhet drejtpeshuar me adhurimin e vërtetë dhe me kujdestarinë e përgjegjshme (shih 2 Korintasve 8-9).

**7:31 “sepse forma e kësaj bote po kalon”** Profetët e Dhjatës së Vjetër (sidomos Isaia 56-66) zbulojnë një qiell të ri dhe një tokë të re. Epoka e re do të jetë si epoka e vjetër, por e pastruar dhe e shpenguar (shih 2 Pjet. 3:10-13). Qielli do të jetë një kopësht i Edenit i transformuar – Perëndia, njerëzimi dhe kafshët – në marrëdhënie të përkryer dhe rregull do të jetë i restauruar; Zanafilla 1-2 paralelizohet tek Zbulesa 21-22. Çdo brez besimtarësh përjeton kalimin e rregullit të kësaj bote (dmth., *schēma*) ndërsa maturohen në ngjashmëri me Krishtin. Ndërsa e shohim Krishtin në mënyra gjithnjë e më të qarta, gjërat e kësaj jete bëhen gjithnjë e më të



mërzitshme. Ne jemi në botë, por nuk jemi të botës. Ne përdorim gjërat e kësaj bote për qëllime ungjillizimi, jo për qëllime personale.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:32-35**

<sup>32</sup> Dhe unë dëshiroj që ju të jeni pa merak. I pamartuari merakoset për gjërat e Zotit, si mund t'i pëlqejë Zotit; <sup>33</sup> por i martuari merakoset për gjërat e botës, si mund t'i pëlqejë gruas së tij. <sup>34</sup> Ka dallim gruaja nga virgjëresha; e pamartuara kujdeset për gjërat e Zotit që të jetë e shenjtë në trup e në frymë, kurse e martuara kujdeset për gjërat e botës, si mund t'i pëlqejë burrit. <sup>35</sup> Edhe këtë unë e them për dobinë tuaj, jo që t'ju vë një lak, po që të jeni të hijshëm dhe t'i kushtoheni Zotit pa u shkëputur.

**7:32-34** Ky pasazh përshkruan përkushtimin e përbashkët të njerëzve të martuar ndaj njëri-tjetrit si “një mish” (shih Efe. 5:24-31). Kjo nuk është ligësi, ajo përdoret për të përshkruar marrëdhënien midis Krishtit dhe kishës së Tij. Është e qartë se njerëzit beqar kanë më shumë kohë dhe energji për shërbesë.

Shqetësimi i Palit përgjatë këtij konteksti ka qënë aftësia për të qënë një besimtar aktiv pa shqetësime. Pali përdor termin *merimnaō* katër herë në dy vargje. Ky term mund t'i referohet shqetësimeve të pavlera (shih Mate. 10:19; Luka 12:25) ose shqetësimeve të qënësishme (shih 2 Kor. 11:28; 1 Pjet. 5:7). Në këtë kontekst i referohet çështjeve normale të jetës martesore të cilat mund të konkurojnë me kohën dhe energjinë që një njeri ka për të përdorur për Zotin. Ajo gjithashtu mund të lidhet me presionin unik për të qënë një besimtar në një shoqëri pagane (shih 1 Kor. 7:26).

Pali dëshiron që besimtarët (1) të jenë aktivë për Krishtin dhe (2) të jetojnë në paqe dhe kënaqësi. Të dyja janë të vlefshme, por të vështira.

**7:34 “gruaja e pamartuar dhe virgjëresha”<sup>18</sup>** Pali po i referohet dy lloj grave të pamartuara të krishtera:

1. Njëra është më e madhe, tjetra është më e re
2. E para ka qënë më parë e martuar (dmth., vejushat) dhe e dyta nuk është martuar asnjëherë
3. E dyta ndoshta i referohet një grupi të veçantë grash beqare ose partneresg shërbese (shih 1 Kor. 7:36-38)

■ **“që të jetë e shenjtë në trup e në frymë”** Ky nuk është një koment diskretitues që seksualiteti njerëzor është i lig. Kjo është mënyra se si mësimet e Palit interpretoheshin nga ata që ndikoheshin nga kultura greke (dmth., stoikët, gnostikët etj.). Ajo që Pali dëshiron të thotë është se individët e fokusuar në Zotin mund ta shpenzojnë kohën e tyre cilësore, energjinë dhe burimet e tyre në gjëra frymore, ndërkohë që ata që janë të martuar duhet që gjithashtu të jenë të shqetësuar me çështje dhe përgjegjësi familjare. Shih Temën e Veçantë: I shenjtë (SPECIAL TOPIC: HOLY) tek 1 Kor. 3:17.

**TEMË E VEÇANTË: TRUP E FRYMË (SPECIAL TOPIC: BODY AND SPIRIT)**

Trupi dhe fryma nuk janë një dikotomi ontologjike në njerëzim, por një marrëdhënie e dyanshme si ndaj këtij planeti dhe ndaj Perëndisë. Fjala në hebraisht *nephesh* (BDB 659, dmth., shih shënimin tek Zan 35:18 online) përdoret si për njerëzimin (shih Zan. 2:7) dhe për kafshët (shih Zan. 1:20,24,30; 9:12,15,16) tek Zanafilla, ndërkohë që “frymë” (*ruah*) përdoret vetëm për njerëzimin. Kjo nuk është një pjesëz e nxjerrë nga konteksti mbi natyrën e njerëzimit si një qenie me dy pjesë (dikotomi, shih 1 Kor. 7:34; Heb. 4:12) ose me tre pjesë (trikotomi) (shih 1 Thes. 5:23). Njerëzimi kryesisht përfaqësohet në Bibël si një njësi (shih Zan. 2:7; 2 Kor. 7:1). Për një përmbledhje të mirë të teorive të njerëzimit si trikotomi, dikotomi apo një njësi, shih Millard J. Erickson *Christian Theology* [Teologjia e Krishterë, botimi i dytë], fq. 538-557 dhe Frank Stagg *Polarities of Man's Existence in Biblical Perspective* [Polaritete të Ekzistencës së Njeriut në Perspektivën Biblike].

<sup>18</sup> Version në shqip është: “virgjëresha; e pamartuara”. (shënim i përkthyesit)

7:35 “jo që t’ju vë një lak” Ky term u përdor për një lak kafshe.

NASB	“por për të promovuar atë që është e përshtatshme dhe për të siguruar përkushtim të pa shpërqëndruar ndaj Zotit”
NKJV	“por për atë që është e përshtatshme, dhe që ju të mund t’i shërbeni Zotit pa shpërqëndrim”
NRSV	“por që të promovoj rregull të mirë dhe përkushtim të papenguar ndaj Zotit”
TEV	“në vend të kësaj, unë dua që ju të bëni atë që është e drejtë dhe e duhur, dhe ta jepni veten tuaj plotësisht tek shërbesa ndaj Zotit pa ndonjë rezervë”
NJB	“por në mënyrë të tillë që çdo gjë të jetë siç duhet të jetë dhe që ju të mund të jepni vëmendjen tuaj të pandarë tek Zoti”

Fraza greke është shumë e shkurtër. Dy fjalët kyçe janë

1. *euschemā*, një fjalë e përbërë nga “mirë” dhe “formë”. Ajo përcakton atë që është e duhur, e pëlqyeshme dhe e përshtatshme (shih 1 Kor. 12:23-24; 14:40; Rom. 13:13) e ngjashme në kuptim me *kalos* tek 1 Kor. 7:1,8,26.

2. *aperispastōs*, një fjalë në formë alfa privative me një term për kthimin dhe humbjen e fokusit Pali dëshiron që të gjithë besimtarët të jenë të përqëndruar në çështje të Mbretërisë, në shërbesë! Unë sigurisht bie dakord me këtë. “Problemi” im me këtë kontekst është zhvlerësimi i tij i dukshëm i martesës si një model i njëjtë shërbese sikurse beqaria. Perëndia e krijoi martesën; është norma. Unë jam një person dhe një shërbestar më i fortë për shkak të martesës sime. Ky kapitull është përdorur dhe me të është abuzuar nga legalistët dhe asketët. Qëllimi është i përqëndruar tek shërbesa, jo tek një rregull dogmatik mbi nëse duhet të martohesh apo të qëndrosh beqar. Pali kishte po të njëjtat qëllime të menjëhershme të udhëhequra nga Fryma, por këto nuk mund të kthehen në parime universal të cilat mohojnë tekste të tjera të frymëzuara.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:36-38

<sup>36</sup> Por nëqoftëse dikush mendon të sillet në mënyrë të pahijshme ndaj virgjëreshës së tij, kur asaj i kalon lulja e kohës, edhe duhet të bëhet kështu, le të bëjë çfarë të dojë; le të martohen. <sup>37</sup> Por ai që është i qëndrueshëm në zemër të vet dhe që nuk i nënshtrohet nevojës, por është zot i vullnetit të vet dhe e ka vendosur në zemër të vet të ruajë virgjëreshën e tij, bën mirë. <sup>38</sup> Prandaj ai që marton bën mirë, ai që nuk e marton bën edhe më mirë.

7:36 “nëqoftëse” Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila nënkupton se është e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllime letrare.

NASB	“ndonjë njeri... ndaj bijës së tij të virgjër”
NKJV	“ndonjë njeri... ndaj virgjëreshës së tij”
NRSV	“ndokush... ndaj të fejuarës së tij”
TEV	“në rast se një çift i fejuar që kanë vendosur të mos martohen, nëse burri... ndaj vajsës së re”
NJB	“dikush me pasione të forta... ndaj të fejuarës së tij”

Ka tre linja kryesore interpretimi të këtij pasazhi.

1. Që i referohet një babai të krishterë dhe vajzës së tij të pamartuar (shih NASB dhe JB)
2. Që i referohet një burri të krishterë dhe të fejuarës së tij (shih NRSV, TEV, NJB)
3. Që i referohet një lloj martese frymore e cila do të përkthehej në “partnerë në pastërti fizike” (shih NEB)

Fjalë për fjalë termi është “virgjëreshë”.

Opsioni i parë po përdor frazën “ai që jep” (1 Kor. 7:38) si t’i referohej një babai që jep vajzën e tij për t’u martuar. Opsioni i dytë merr nga fraza tek 1 Kor. 7:36, “nëse ajo e ka kaluar lulen e kohës”. Ky opsion duket më i miri nën dritën e të gjitha provave, si tekstuale ashtu edhe historike. Opsioni i tretë nënkupton një situatë historike të veçantë. Disa predikues që udhëtonin në shekullin e parë mund të kenë marrë virgjëresha të krishtera si ndihmëse shërbese dhe të jetonin me to, por qëndronin të pastër fizikisht si një shenjë e vetë-kontrollit të tyre.

▣ “nëse<sup>19</sup>” Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm.

NASB	“ajo e ka kaluar rininë e saj”
NKJV	“ajo e ka kaluar lulen e rinisë së saj”
NRSV	“pasionet e tij janë të forta”
TEV	“pasionet e tij janë tepër të forta”
NJB	“që gjërat duhet të marrin rrugën e tyre”

Kjo mund t’i referohet (1) kohës normale të martesës (shih NASB, NKJV dhe NJB) ose (2) duke qënë se forma është ndoshta mashkullore dhe jo femërore, ajo mund t’i referohet një burri që bëhet pasionant (shih NRSV, TEV).

Për termin “i ka kaluar lulja e rinisë” (*hyperakmos*) shih Temën e Veçantë: Përdorimi i Palit të Fjalëve të Përbëra *Huper* (SPECIAL TOPIC: PAUL’S USE OF HUPER COMPOUNDS) tek 1 Korintasve 2:1.

▣ “le të bëjë çfarë të dojë” Kjo është fjalë për fjalë “le të bëhet siç dëshiron ai”. Kjo frazë mund t’i referohet ose burrit ose gruas. Përemrat përgjatë këtij konteksti janë tejet të paqartë dhe siguria në interpretim është e pamundur.

NASB	“le të martohet”
NKJV, NRSV	“le të martohen”
TEV	“ata duhet të martohen”
NJB	“ata duhet të martohen”

Kjo është një formë urdhërore aktive e përkryer në vetën e tretë shumës, duke nënkuptuar fjalë për fjalë “le të martohen”. Kjo i referohet (1) një burri dhe të fejuarës së tij ose (2) “partnerëve në pastërti fizike”.

**7:37 “është i qëndrueshëm”** Shih Temën e Veçantë: I Qëndrueshëm tek 1 Kor. 15:1.

**7:38 “ai që nuk e marton bën edhe më mire”** Ky nuk është një koment përçmues mbi martesën por një këshillim praktik nën dritën e

1. Krizës aktuale në Korint
2. Ardhjes së shpejtë të Dytë
3. Pasionit seksual njerëzor normal të të krishterëve të përfshirë

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 7:39-40

<sup>39</sup> Gruaja është e lidhur për sa kohë rron burri i saj; por, në qoftë se i vdes burri, ajo është e lirë të martohet me cilin të dojë, veçse kjo punë të bëhet në Zotin. <sup>40</sup> Por, sipas gjykimit tim, ajo është më e lumtur, po mbeti ashtu; dhe mendoj se edhe unë kam Frymën e Perëndisë.

**7:39 “Gruaja është e lidhur për sa kohë rron burri i saj”** Kjo është një formë treguese pasive e përkryer (shih 1 Kor. 7:27). Vargu 39 tregon se rimartesa pas vdekjes së bashkëshortit / bashkëshortes nuk është diçka e keqe (shih 1 Tim. 5:14). Ajo gjithashtu tregon se si Pali nuk po përpiqet të vendosë rregulla të vështira dhe universale të shpejta.

▣ “veçse kjo punë të bëhet në Zotin” Ka dy interpretime të mundshme: (1) një i krishterë duhet të martohet me një të krishterë (shih 2 Kor. 6:14) ose (2) ajo duhet të sillet si e krishterë kur të rimartohet. Shpesh vargu 2 Kor. 6:14 përdoret si një provë për opsionin e parë, por në kontekst nuk i adresohet specifikisht kësaj çështjeje. Megjithatë, sipas parimit, mund të jetë kështu.

**7:40 “Por, sipas gjykimit tim... dhe mendoj se edhe unë kam Frymën e Perëndisë”** Pali po ripohon temën e tij të përsëritur dhe kuptimin e tij të frymëzimit hyjnor (shih 1 Kor. 7:12,25).

<sup>19</sup> Versioni në shqip është “kur”. (shënim i përkthyesit)

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si e zbatojmë të vërtetën e kapitullit 7 sot?
2. Sa prej kapitullit 7 është e bazuar në anën kulturore dhe sa prej saj është universale?
3. A është pastërtia fizike një gjëndje frymore më e lartë për Palin se sa martesë? Nëse po, pse?
4. A e lejon Bibla divorcin? Nëse po, a e lejon Bibla rimartesën? (shih 1 Kor. 7:28,39)
5. Cila ishte “kriza e tashme” ndaj së cilës i referohet Pali tek 1 Kor. 7:26?
6. A përdoret ndryshe termi “virgjëreshë” tek 1 Kor. 7:25 dhe 36?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 8

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ushqim i ofruar tek idhujt	Jini të Ndjeshëm ndaj Ndërgjegjes	A Mund të Hajë një i Krishterë Ushqim të Ofruar një Idhulli?	Pyetja rreth Ushqimit të Ofruar Idhujve	Ushqim Ofruar Perëndive të Rremë (8:1-11:1) Parime të Përgjithshme
8:1-6	8:1-13	8:1-3	8:1 8:2-3	8:1-6
8:7-13		8:4-6 8:7-13	8:4-6 8:7-8 8:9-13	Pretendimet për Njohuri 8:7-13

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 8:1-13**

- A. Konteksti letrar vijon nga vargu 8:1 deri tek 11:1 sikurse tregon skicimi më sipër i versionit NJB.
- B. Pyetja e të ngrënit ushqim të ofruar idhujve duket shumë e çuditshme për njerëzit modernë. Por në kontekst të kohës së Palit dhe njerëzve në Korint ishte një çështje mjaft e rëndësishme. Pjesa më e madhe e të mbledhurit social kishin konotacion fetar në kohën e Palit. Gjithashtu, mishi që shitej në tregjet e Korintit ishte më së shumti, në mos i gjithi, nga një prej tempujve paganë.
- C. Teologjikisht, kapitulli 8 është paralel ndaj Romakëve 14:1-15:13. Shih Temën e Veçantë tek Njohuri Kontekstuale nga Rom. 14:1-15:13 tek 1 Kor. 6:12, në të cilin shënimet janë marrë nga komentari im mbi Rom. 14:1-15:13. Të dy këto pasazhe trajtojnë temën e vështirë dhe të komplikuar të mënyrës se si një i krishterë ekuilibron lirinë e tij / saj në Krishtin dhe përgjegjësinë e tij / saj në dashuri ndaj të tjerëve.

Gordon Fee tek *To What End Exegesis?* [Çfarë e Përmbylli Eksegjezën?], fq. 105-128, mendon se ky kontekst i referohet jo vetëm të ngrënit të ushqimit që i është flijuar një idhulli, por pjesëmarrjes në vaktin e idhullit të tempullit (i cili shpesh përfshinte edhe aktivitet seksual gjithashtu, shih 1 Kor. 10:6-22).

- D. Ky kapitull gjithashtu thekson se njohuria, edhe njohuria zbuluese, nëse nuk ekuilibrohet me dashuri për të tjerët, është vetëm pjesërisht e vërtetë (shih 1 Kor. 13:1-13)

- E. Unë mendoj se James D. G. Dunn, *Unity and Diversity in the New Testament* [Uniteti dhe Diversiteti në Dhjatën e Re], fq. 319 ka një pohim të mirë përmbledhës.  
 “Ai nuk mbronte të krishterët hebraikë të cilët e ngushtonin lirinë e krishterë në legalizëm (Gal. 5:1 e në vazhdim; Fil. 3:2 e në vazhdim); por gjithashtu nuk mbronte të krishterët johebrej që abuzonin me lirinë e krishterë duke kaluar në lejim dhe elitizëm (Rom. 16:17 e në vazhdim; 1 Kor. 5-6; 8-10; shih 2 Thes. 3:6,14 e në vazhdim).”

Për Palin “ungjilli për të gjithë”, ishte parim drejtues! Kjo shprehet në mënyrë të fuqishme në fjalët e tij tek 1 Kor. 9:19-23!

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 8:1-3

<sup>1</sup> Për sa u përket flijimeve për idhujt, ne e dime se të gjithë kemi njohuri; njohuria krekos, kurse dashuria ndërton. <sup>2</sup> Në qoftë se dikush mendon se di diçka, ai nuk di ende asgjë sikundër duhet të dijë. <sup>3</sup> Por në qoftë se dikush e do Perëndinë, ai është i njohur prej tij.

**8:1 “Për sa u përket flijimeve për idhujt”** Kjo është një pyetje tjetër (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12) që u bë nga kisha korintase në një letër që ata i shkruan Palit, të sjellë nga Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku (shih 1 Kor. 16:17).

NASB	“gjëra sakrifikuar idhujve”
NKJV	“gjëra ofruar idhujve”
NRSV	“ushqim sakrifikuar idhujve”
TEV	“ushqim ofruar idhujve”
NJB	“ushqim që i është përkushtuar perëndive të rremë”

Ky është një term i përbërë nga *eidōlon*, që do të thotë një formë, figurë, imazh ose statujë; dhe *thuō*, që do të thotë të vrasësh ose të ofrosh një flijim. Po ky term u përdor për të ndaluar ngrënien e mishit të ofruar ndaj një idhulli në letrën dërguar kishave johebraike nga Këshilli i Jeruzalemit tek Veprat e Apo. 15:29 (shih Veprat e Apo. 21:25).

☐ **“ne e dime se të gjithë kemi njohuri”** Ndoshta ky është

1. Një citim nga letra që kisha korintase i shkroi Palit
2. Një slogan i një nga grupeve të përçara
3. Një citim nga predikimet e mëparshme të Palit, të cilin kisha korintase e kishte keqkuptuar

☐ **“njohuria krekos, kurse dashuria ndërton”** Pali bie dakord me pohimet që përmban letra e kishës së Korintit, por kufizon konceptet dhe tregon kuptimin dhe zbatimin e tyre të vërtetë (kjo gjithashtu është e vërtetë për sloganet e mësuesve të rremë në kapitujt 6-7).

Njohuria ishte një nga aspektet e kulturës greke në të cilën disa në kishën e Korintit krenoheshin. Problemi me njohurinë është se ajo priret ta bëjë njeriun konkures dhe të mbushur me krenari (shih 1 Kor. 4:6,18,19; 5:2; 8:1; 13:4; 2 Kor. 12:20). Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 4:6. Ai fokusohet në individin, jo në familjen, trupin, kishën. Termi “ndërton” është një metaforë ndërtimi. Pali shpesh flet për “të ndërtuarit” e kishës ose të të krishterëve individualë (shih Rom. 14:19; 15:2; 1 Kor. 8:1; 10:23; 14:3,5,12,26; 2 Kor. 10:8; 12:19; 13:10; Efe. 4:12,29; 1 Thes. 5:11).

Dashuria është thelbësore në lirinë tonë të krishterë. Njohuria nuk do ta zgjidhë problemin e krenarisë; vetëm dashuria vetë-kufizuese mund ta bëjë këtë. Besimtarët duhet të ndjekin atë që e ndërton kishën, jo atë që lavdëron të krishterët individualë me dhunti.

## TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ (SPECIAL TOPIC: EDIFY)

Kjo fjalë, *oikodomeō*, dhe format e tjera të saj përdoren shpesh nga Pali. Fjalë për fjalë, do të thotë “ndërtoj një shtëpi” (shih Mat. 7:24), por më vonë filloi të përdorej në mënyrë metaforike për:

1. trupin e Krishtit, kishën (1 Kor. 3:9; Efe. 2:21; 4:16)
2. ndërtimin
  - a. e vëllezërve të dobët (Rom. 15:1)
  - b. e të afërmve (Rom. 15:2)
  - c. e njëri-tjetrit (Efe. 4:29; 1 Thes. 5:11)
  - d. e shenjtorëve për shërbesë (Efe. 4:11)
3. ne e ndërtojmë njëri-tjetrin me anë të
  - a. dashurisë (1 Kor. 8:1; Efe. 4:16)
  - b. kufizimit të lirisë personale (1 Kor. 10:23-24)
  - c. shmangies së hamendësimeve (1 Tim. 1:4)
  - d. kufizimit të folësve në shërbesat e adhurimit (këngëtarëve, mësuesve, profetëve, atyre që flasin në gjuhë, dhe interpretuesve); 1 Kor. 14:3-4, 12
4. të gjitha gjërat duhet të ndërtojnë
  - a. autoriteti i Palit (2 Kor. 10:8; 12:19; 13:10)
  - b. pohimet përmbledhëse në Rom 14:19 dhe 1 Kor. 14:26

**8:2 “Në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare (shih 1 Kor. 8:3,5).

▣ **“dikush mendon se di diçka”** Kjo është një formë treguese aktive e përkryer e ndjekur nga një formë infinitive e përkryer. Kjo reflekton arrogancën e vendosur të kishës së Korintit (shih 1 Kor. 3:18).

NASB	“ai ende nuk di siç duhet të dijë”
NKJV	“ai nuk di ende asgjë sikundër duhet të dijë”
NRSV	“ai ende nuk ka njohurinë e nevojshme”
TEV	“ai vërtetë nuk di siç duhet të dijë”
NJB	“dhe ende nuk di siç duhet të dijë”

Pali zbulon mungesën tek ata të njohurisë frymore. Urtësia e botës (dmth., filozofia njerëzore) shkakton ndarje dhe arrogancë, por njohuria e Perëndisë në ne (shih 1 Kor. 13:12; Gal. 4:9) dhe njohja jonë e ungjillit na bën të lirë për t’i shërbyer Atij dhe popullit të Tij.

**8:3 “Por në qoftë se dikush e do Perëndinë”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Kishte nga ata në Korint të cilët e donin Perëndinë. Vini re se theksi i Palit është mbi dashurinë (dmth., forma treguese aktive e tashme), jo mbi njohurinë (shih 1 Kor. 13:1-13).

▣ **“ai është i njohur prej tij”** Ky mund të jetë një shembull tjetër i sloganeve të atyre që pretendojnë se janë më të ndritur dhe frymorë. Është shumë e ngjashme me një frazë të mëvonshme gnostike të gjendur tek *Gospel of Truth* [Ungjilli i së Vërtetës] 19.33. Ata që janë vërtetë të ndritur e dinë se nuk ka dallime midis njerëzve, jo midis

1. Hebrenjve – Johebrenjve
2. Skllëvërve – të lirëve
3. Meshkujve – femrave
4. Të fortëve – të dobtëve

Të gjitha barrierat “bien poshtë” në Krishtin!

Njohuria jonë e Perëndisë është e rëndësishme, por njohuria rreth Perëndisë nuk është zëvendësuese për një marrëdhënie personale të nisur nga Perëndia, që del në dashurinë tonë për njëri-tjetrin, e cila shpreh dashurinë tonë për Të (shih Gal. 4:6; 2 Tim. 2:19; 1 Gjoni 4:19).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 8:4-6

<sup>4</sup> Pra, për sa i përket të ngrënit të flive që u bëhen idhujve, ne e dimë se idhulli nuk është asgjë në botë dhe se nuk ka Perëndi tjetër, veç një. <sup>5</sup> Sepse, ndonëse ka të ashtuquajtura perëndi në qiell a në tokë (sikurse ka shumë perëndi dhe shumë zotër), <sup>6</sup> për ne s'ka veçse një Perëndi, Ati nga i cili janë të gjitha gjërat dhe ne në të; dhe një Zot, Jezu Krishti, me anë të të cilit janë të gjitha gjërat, dhe ne jetojmë me anë të tij.

**8:4 “ne e dimë se idhulli nuk është asgjë në botë”** Gjendet një lojë fjalësh në konotacionet në këto vargje midis konceptit hebraik të “njohjes” si marrëdhënie personale (shih 1 Kor. 8:3; Zan. 4:1; Jer. 1:5) dhe konotacionit grek të “njohjes” si fakte mbi diçka ose dikë (shih 1 Kor. 8:1,2,4).

Në Dhjatën e Vjetër idhujt ishin “bosh” ose “të kotë”. Ata nuk ishin aspak perëndi (shih 2 Kro. 13:9; Isa. 37:19; 41:29; Jer. 2:11; Veprat e Apo. 14:15; Gal. 4:8). Pali, më vonë në letrën e 1 Korintasve, pranon se demonët përdorin supersticionet dhe idhujtarinë e njerëzve (shih 1 Kor. 10:20), por në të vërtetë nuk ka asnjë realitet tek idhujt!

■ **“se nuk ka Perëndi tjetër, veç një”** Ky është një pranim teologjik i monoteizmit (shih 1 Tim. 2:5-6). Sipas zbulesës biblike, është vetëm një Perëndi i vërtetë (shih 1 Kor. 8:6; Ligji i Përt. 4:35,39; Ps. 86:8,10). Shpesh Dhjata e Vjetër flet për të tjerë “*elohim*” (dmth., qenie frymore), por asnjë si (pra, në të njëjtën kategori, shih Eksod. 20:2-3; Ligji i Përt. 32:39) YHWH (shih Eksod. 15:11; Ps. 86:8; 89:6). Lutja hebraike e quajtur *Shema* nga Ligji i Përt. 6:4 është pranimi hebraik i cituar çdo ditë në çdo shërbesë adhurimi duke pranuar veçantinë dhe njëjësinë e YHWH (shih Mark 12:28-29).

#### TEMË E VEÇANTË: MONOTEIZMI (SPECIAL TOPIC: MONOTHEISM)

Njerëzimi gjithnjë ka ndjerë se realiteti ka më shumë se sa fizikja (dmth., i ndikuar nga gjëra që janë jashtë kontrollit të tyre, si stuhitë, eklipset, kometat, moti, ndodhitë, vdekja etj.). Antropologët na tregojnë se ata gjejnë gjëra në varre të hominoidëve primitivë të cilët dukshëm janë për jetën tjetër, të cilën ata e shihnin si zgjatim të kësaj jete.

Kultura e parë e shkruar ishte Summer (në pjesën jugore të lumenjve Tigër dhe Euftrat), filloi rreth viteve 10 000 – 8 000 para Krishtit. Ata shkruan poezi për të shprehur pikëpamjen e tyre mbi perënditë dhe ndërveprimin e tyre. Sërish, si shumë njerëz me të gjitha dobësitë e tyre. Traditat e tyre ekzistuan në formë gojore për një kohë të gjatë përpara se ato të shkruheshin.

Pati një zhvillim teologjik nga

1. Animizmi në
2. Politeizëm në
3. Një perëndi të lartë (ose dualizmi)

Koncepti i “monoteizmit” (vetëm një Perëndi personal, etik pa një partner femëror), dhe jo thjesht i “perëndisë së lartë” të politeizmit, apo perëndisë së mirë të dualizmit iranian (zoroastrianizmi), është unik për Izraelin (Abrahami dhe Jobi, 2000 para K.). Vetëm një përjashtim i rrallë ekzistoi shkurtimisht në Egjipt (Amenhotepi IV, i njohur edhe si Akhenateni, 1367-1350, ose 1386-1361 para K., që adhuronin *Aten*, perëndinë diell, si perëndia i vetëm). Shih J. Assmann, *The Mind of Egypt* [Mendja e Egjiptit], fq. 216-217.

Ky koncept shprehet me një sërë frazash në Dhjatën e Vjetër.

4. “askush s’është si YHWH, Elohimi ynë”, (Eks. 8:10; 9:14; Ligji i Përt. 33:26; 1 Mbr. 8:23)
5. “askush tjetër përveç Tij” (Ligji i Përt. 4:35,39; 32:39; 1 Sam. 2:2; 2 Sam. 22:32; Isa. 45:21; 44:6,8; 45:6,21)
6. “YHWH është një” (Ligji i Përt. 6:4; Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4,6; 1 Tim. 2:5; Jakobi 2:19)
7. “askush si Ti” (2 Sam. 7:22; Jer. 10:6)
8. “Vetëm Ti je Perëndi” (Psa. 86:10; Isa. 37:16)
9. “Para Meje nuk ishte formuar asnjë perëndi, dhe s’do të ketë tjetër pas meje” (Isa. 43:10)
10. “Nuk ka tjetër; përveç Meje... nuk ka tjetër” (Isa. 45:5, 6, 22)
11. “S’ka asnjë Perëndi tjetër” (Isa. 45:14, 18)
12. “S’ka tjetër veç Meje” (Isa. 45:21)



13. “nuk ka tjetër... nuk ka tjetër si Unë” (Isa. 46:9)

Duhet pranuar se kjo doktrinë kyçe është zbuluar në mënyrë të shkallëzuar. Pohimet e hershme mund të kuptohen si “henoteizëm”, ose si monoteizëm praktik (ekzistojnë perëndi të tjerë, dmth., Joz. 24:15; 1 Mbret. 18:21), por vetëm një perëndi për ne (shih Eks. 15:11; 20:2-5; Ligji i Përt. 5:7; 6:4,14; 10:17; 32:12; 1 Mbret. 8:23; Psa. 83:18; 86:8; 136:1-9).

Pasazhet e parë që fillojnë të vënë në dukje faktin se ka vetëm një perëndi (monoteizmi filozofik) janë të hershëm (shih Eks. 8:10; 9:14; 20:2-3; Ligji i Përt. 4:35, 39; 33:26). Pohimet e plota dhe tërësore gjenden te Isaia 43-36 (shih 43:10-11; 44:6, 8; 45:7, 14, 18, 22; 46:59, 9).

Dhjata e Vjetër zhvlerëson perënditë e kombeve si

1. Krijesa njerëzore – Ligji i Përt. 4:28; 2 Mbret. 19:18; Ps. 115:4-8; 135:15-18; Isa. 2:8; 17:8; 37:19; 40:19; 41:7,24,29; 44:10,12; 46:6-7; Jer. 10:3-5; Zbu. 9:10
2. demonët – Ligji i Përt. 32:17; Ps. 106:37; Isa. 8:19; 19:3c; 1 Kor. 10:20; Zbu. 9:20
3. boshësi – Ligji i Përt. 32:21; 2 Mbret. 17:15; Ps. 31:6; Isa. 2:18; 41:29; Jer. 2:5; 10:8; 14:22; Jer. 2:5; 8:19
4. asnjë perëndi – Ligji i Përt. 32:21; 2 Kro. 13:9; Isa. 37:19; Jer. 2:11; 5:7; 1 Kor. 8:4-5; 10:20; Zbu. 9:20

Dhjata e Re aludon për Ligji i Përt. 6:4 te Rom. 3:30; 1 Kor. 8:4, 6; Efe. 4:6; 1 Tim. 2:5; dhe Jakobi 2:19. Jezusi e citon si urdhërimin e parë te Mat. 22:36-37; Marku 12:29-30; Luka 10:27. Dhjata e Vjetër, ashtu si Dhjata e Re, pohon realitetin e qenieve të tjera shpirtërore (demonët, engjëjt), por vetëm një krijues/Perëndi shpengues (YHWH, Zan. 1:1).

Monoteizmi biblik karakterizohet nga si më poshtë:

1. Perëndia është një dhe i pashoq (ontologjia e tij merret si fakt i kryer, nuk specifikohet)
2. Perëndia është personal (shih Zan. 1:26-27; 3:8)
3. Perëndia është etik (shih Eks. 34:6; Neh. 9:17; Psa. 103:8-10)
4. Perëndia i krijoi njerëzit në shëmbëllimin e Vet (Zan. 1:26-27) për bashkësi me ta (shih #2). Ai është Perëndi xheloz (shih Eks. 20:2-3)

Nga Dhjata e Re:

1. Perëndia ka tre shfaqje të përjetshme dhe personale (shih Tema e Veçantë: Trinia)
2. Perëndia është zbuluar në mënyrë të përsosur dhe të plotë në Jezusin (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:15-19; Heb. 1:2-3)
3. Plani i përjetshëm i Perëndisë për shpengimin e njerëzimit të rënë është ofrimi flijues i Birit të Tij të vetëm (Isaia 53; Marku 10:45; 2 Kor. 5:21; Fil. 2:6-11; Hebrenjve)

**8:6 “për ne s’ka veçse një Perëndi”** Ky është pohimi teologjik i monoteizmit. Shih shënimin tek 1 Kor. 8:4. Në historinë e fesë ka pasur disa kategori besimi mbi hyjninë.

1. Animizmi, qëniet frymore janë të lidhura me procese ose objekte natyrore
2. Politeizmi, ekzistenca e shumë perëndive
3. Henoteizmi, shumë perëndi, por vetëm një perëndi për ne (dmth., fiset, kombet, zonat gjeografike)
4. Monoteizmi, ekzistenca e vetëm një Perëndie (jo perëndia i lartë i një panteoni)

Ky tekst pranon ekzistencën e shumë qënieve frymore (shih 1 Kor. 8:5), por vetëm një Perëndie të vërtetë (shih 1 Kor. 8:4, shih TEMËN E VEÇANTË: MONOTEIZËM [SPECIAL TOPIC: MONOTHEISM] tek 1 Kor. 8:4). Për ata në traditën judeo-kristiane ka vetëm një Perëndi krijues / shpengues i cili ekziston në tre persona të përjetshëm. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10.

■ **“Ati”** Ky është një titull i mrekullueshëm intim, personal dhe familjar për hyjninë. Ai thekson imanencën e Perëndisë. Ky aspekt i Perëndisë mund të bëhet i njohur vetëm përmes vetë-zbulesës së Tij, jo me anë të filozofisë apo zbulesës njerëzore.

Megjithëse ky titull familjar shfaqet pak herë në Dhjatën e Vjetër (shih Ligji i Përt. 32:5-6; Isa. 63:16; 64:8; Jer. 31:9,20; Ose. 11:3-4; Mal. 1:6; 2:10), ishte Jezusi, Biri, i cili zbuloi plotësisht këtë analogji mahnitëse, intime dhe metaforike (shih “Ati ynë”, Mat. 6:9; 23:9; Efe. 4:6; *Abba*, Mark 14:36). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:3).

■ **“nga i cili janë të gjitha gjërat”** Ky është pohim i Perëndisë si krijues (shih 1 Kor. 11:12; Rom. 11:36; 2 Kor. 5:18; Kol. 1:16; Heb. 2:10). Shih Temën e Veçantë: I Parëlindur (SPECIAL TOPIC: FIRSTBORN) tek 1 Kor. 15:20.

■ **“dhe ne ekzistojmë për Të”<sup>20</sup>** Perëndia e bëri botën si një skenë ku njerëzimi të ketë marrëdhënie me Të. Pasi rezultatet e rebelimit njerëzor (shih Zanafilla 3) janë tejkaluar në shpëtimin dhe restaurimin tonë përmes Krishtit, ne kuptojmë qëllimin që Perëndia ka pasur për ne. Pasi imazhi i Perëndisë në njerëzimin restaurohet përmes Krishtit, atëherë marrëdhënia personale dhe intime e kopështit të Edenit restaurohet.

■ **“një Zot, Jezu Krishti”** Titulli “Zot” reflekton një përkthim të Dhjatës së Vjetër të YHWH, që është folja hebraike “të jesh” (shih Eksod. 3:14, shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:8). Hebrenjtë kishin frikë ta thonin këtë emër të shenjtë se mos ata e përdornin kot, prandaj, ata e zëvendësuan me termin hebraik *Adon* ose *Zot*. Të thërrisje Jezusin *Zot* (dmth., *kurios* është ekuivalenti grek i formës hebraike *Adon*) është një mënyrë e pranimit të hyjesisë së Tij dhe njëjesisë së Tij me YHWH (shih Fil. 2:11). Koncepti i njëjesisë është gjithashtu i rëndësishëm (shih Efe. 4:5; 1 Tim. 2:5).

Edhe pse Pali nuk e përdor termin *Theos* (dmth., Perëndi) për Jezusin në këtë kontekst, ai e përdor atë për Jezusin tek Veprat e Apo. 20:28; Rom. 9:5; dhe Titit 2:13 dhe *Theotētus* tek Kol. 2:9. Nuk mund të ketë asnjë dyshim që në mendjen e Palit Jezusi është hyjnor. Pali ishte një monoteist strikt. Ai kurrë nuk e cilëson se si një Perëndi mund të ekzistojë përjetësisht në manifestimin e tre personave, por ky është konkluzioni i dukshëm. Shih TEMËN E VEÇANTË: TRINIA (SPECIAL TOPIC: TRINITY) tek 1 Kor. 2:10.

■ **“me anë të të cilit janë të gjitha gjërat, dhe ne jetojmë me anë të tij”** Jezusi ishte agjenti i Atit në krijim (shih Gjoni 1:3; Kol. 1:16; Heb. 1:2). Ky ishte roli i urtësisë së personifikuar tek Fjalët e Urta 8:22-31. Urtësia është në gjininë femërore në hebraisht (shih Fjalët e Urta 8:1-21) sepse emri “urtësi” (BDB 315) është një emër në gjininë femërore. Në këtë pasazh ne shohim tensionin midis pranimit tonë të monoteizmit dhe zbulesës së Dhjatës së Re të Trinisë. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 8:7-13

<sup>7</sup> Por njohuria nuk është në të gjithë; madje disa, të ndërgjegjshëm për idhullin, hanë gjëra posi të flijuara idhujve; dhe ndërgjegja e tyre, duke qenë e dobët, përlyhet. <sup>8</sup> Por të ngrënit nuk na çon te Perëndia; po të hamë, nuk fitojmë asgjë më tepër dhe, po të mos hamë, s’kemi gjë më pak. <sup>9</sup> Por kini mendjen se mos kjo liri që keni të bëhet pengesë për të dobëtit. <sup>10</sup> Sepse, në qoftë se dikush të sheh ty, që ke njohuri, të ulur në tryezë në një tempull idhujsh, ndërgjegja e tij, që është e dobët, a nuk do të marrë guxim që ai të hajë gjërat e flijuara për idhujt? <sup>11</sup> Edhe kështu, për shkak të njohurisë sate, do të humbasë vëllai yt i dobët, për të cilin vdiq Krishti. <sup>12</sup> Dhe, kur mëkatoni kështu kundër vëllezërve, duke plagosur ndërgjegjen e tyre të dobët, ju mëkatoni kundër Krishtit. <sup>13</sup> Prandaj, në qoftë se një ushqim skandalizon vëllanë tim, unë nuk do të ha më kurrë mish, që të mos e skandalizoj vëllanë tim.

**8:7 “Megjithatë, jo të gjithë njerëzit e kanë këtë njohuri”<sup>21</sup>** Në kontekst kjo i referohet të krishterëve “më të dobët” dhe “më të fortë” (shih Rom. 14:1,2,14,22-23; 15:1). “I dobët” në këtë kontekst i referohet supersticionit ose legalizmit të lidhur me të shkuarën e jetës së pakonvertuar të një personi. Ky është një vështrim sarkastik mbrapa tek 1 Kor. 8:1 dhe arroganca e grupeve të caktuara të përçara të kishës së Korintit dhe theksit të tyre mbi urtësinë dhe njohurinë (shih 1 Kor. 8:11).

■ **“dhe ndërgjegja e tyre, duke qenë e dobët, përlyhet”** Besimtarët duhet të veprojnë në besim në dritën që ne kemi (shih Rom. 14:23), edhe kur kjo njohuri është e gabuar apo frymërisht femërore. Besimtarët janë vetëm përgjegjës për atë që ata e kuptojnë.

<sup>20</sup> Versioni në shqip është: “dhe ne në të”. (shënim i përkthyesit)

<sup>21</sup> Versioni në shqip është: “Por njohuria nuk është në të gjithë”. (shënim i përkthyesit)

Pali përdor termin “ndërgjegje” shpesh tek letrat drejtuar korintasve (shih 1 Kor. 4:4; 8:7,10,12; 10:25,27,28,29; 2 Kor. 1:12; 4:2; 5:11). Ai i referohet sensit të brendshëm moral të asaj që është e përshtatshme apo e papërshtatshme (shih Veprat e Apo. 23:1). Ndërgjegjia mund të ndikohet nga jetët tona të shkuara, nga zgjedhjet tona të dobëta ose nga Fryma e Perëndisë. Ajo nuk është një udhëheqje e pagabueshme, por përcakton kufijtë e besimit tonë individual. Prandaj, të cënosh ndërgjegjen tonë, edhe nëse ajo është në gabim apo e dobët, është një problem i madh besimi.

Ndërgjegjia e besimtarit ka nevojë që të jetë gjithnjë e më shumë e formuar nga Fjala e Perëndisë dhe nga Fryma e Perëndisë (shih 1 Tim. 3:9). Perëndia do të gjykojë besimtarët me dritën që ata kanë (dmth., të dobët apo të fortë), por të gjithë ne duhet të jemi të hapur ndaj Biblës dhe Frymës për më shumë dritë dhe për t’u rritur në njohurinë e Zotit Jezus Krisht. Shih shënimin më të plotë mbi “ndërgjegjen” tek 1 Kor. 10:25. Shih TEMËN E VEÇANTË: DOBËSI (SPECIAL TOPIC: WEAKNESS) tek 2 Kor. 12:9.

▣ **“përlyhet”** Ky term fillimisht i referohej veshjeve të papastra (shih Zak. 3:3-4; Juda 23; Zbu. 3:4). Ai u përdor në mënyrë figurative për ndotjen morale (shih Zbu. 14:4).

Është e habitshme që ky term përdoret për të përshkruar çfarë iu ndodhi besimtarëve të dobët që shkelën kufijtë e tyre të besimit. Perëndia sheh zemrën në çdo situatë. Të thyesh të kuptuarit tonë të besimit, edhe nëse je i dobët apo bëhet në mënyrë të papërshtatshme, është një thyerje serioze besimi!

**8:8 “Por të ngrënit nuk na çon te Perëndia”** Kjo tregon teologjinë e gabuar, si të atyre që pranojnë asketicizmin, ose legalizmin hebraik, ashtu edhe të atyre që pranojnë lirinë radikale. As të ngrënit dhe as të mos ngrënit nuk do të na prezantojë si të pranueshëm tek Perëndia (shih Rom. 14:14,23; Mark 7:18-23). Dashuria për Perëndinë e shprehur në dashuri vetë-limituese për vëllezërit dhe motrat e tjerë në Krishtin është çelësi për paqe dhe pjekuri brenda marrëdhënies së krishterë.

▣ **“na çon”** Shih Temën e Veçantë: Bollëk [Special Topic: Abound] tek 2 Kor. 2:7.

▣ **“po... po”** Gjenden dy fraza kushtore të rendit të tretë tek 1 Kor. 8:8, të cilat tregojnë veprim të mundshëm.

**8:9**

<b>NASB, NRSV</b>	<b>“Por bëni kujdes se mos kjo liri e juaja nuk bëhet në një mënyrë një pengesë për të dobëtit”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“Por kini kujdes se mos në ndonjë mënyrë kjo liri e juaja bëhet një gur pengese për ata që janë të dobët”</b>
<b>TEV</b>	<b>“Jini të kujdesshëm, megjithatë, duke mos e lejuar lirinë tuaj të veprimit të bëjë që ata që janë të dobët të bien në mëkat”</b>
<b>NJB</b>	<b>“Vetëm jini të kujdesshëm që kjo liri e juaja të mos kthehet në ndonjë mënyrë në një pengesë për të penguar ata që janë të dobët”</b>

Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Liria e krishterë (dmth., *exousia*, shih 1 Kor. 9:4,5,6,12,18) duhet të kontrollohet nga dashuria ose ajo bëhet një liçencë (shih 1 Kor. 10:23-33; 13:1-13; Rom. 14:1-15:13). Ne jemi ata që duhet të kujdesen për vëllezërit!

Kjo temë e lirisë dhe përgjegjësisë së krishterë gjithashtu diskutohet tek Rom. 14:1-15:13. Shih Njohuri Kontekstuale nga komentari im mbi letrën drejtuar romakëve, kapitujt 14 dhe 15 tek 1 Kor. 6:12.

**8:10 “në qoftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të tretë, e cila do të thotë veprim i mundshëm. Gramatika e 1 Kor. 8:10 pret një “po” si përgjigje.

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“dikush të sheh ty, që ke njohuri, të ulur në tryezë në një tempull idhujsh”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“të tjerë të shohin ty, që ke njohuri, duke ngrënë në tempullin e një idhulli”</b>
<b>TEV</b>	<b>“supozoni se një njeri, ndërgjegjja e të cilit është e dobët në këtë temë, të shikon ty që ke të ashtu-quajturën ‘njohuri’ duke ngrënë në tempullin e një idhulli”</b>
<b>NJB</b>	<b>“supozoni se dikush të shikon ty që ke njohuri, të ulur në tempullin e ndonjë perëndie të rremë”</b>

Kjo frazë përkthehet në mënyrë të paqartë tek NASB dhe NKJV. Përkthimet ekuivalente shprehimore, idiomatike të TEV dhe NJB e rrokin mendimin.

Njohuria së cilës Pali po i referohet, kthehet mbrapa tek 1 Kor. 8:1-4. Besimtarët e fortë e dinë se ka vetëm një Perëndi (shih 1 Kor. 8:4). Besimtarët e dobët ende ndikohen nga e shkuara. Besimtarët e fortë përkulen prapa në mënyrë që të mos ofendojnë vëllezërit apo motrat e tyre të dobët në besim në Krishtin ose që janë kërkues të sigurtë (shih 1 Kor. 8:1).

Fuqia e vërtetë frymore nuk është vetëm në njohuri, por në veprime dashurie ndaj besimtarëve të tjerë, edhe ndaj të dobtëve, ndaj supersticiozëve, ndaj legalistëve, ndaj asketikëve, ndaj foshnjeve në besim! Njohuria e vërtetë e bën njeriun një kujdestar të përlulur të hirit të pamerituar të Perëndisë në Krishtin!

▣ **“të ulur në tryezë në një tempull idhujsh”** Shih shënimet tek 1 Kor. 10:14-22.

NASB	“forcohet”
NKJV	“do të marrë guxim që të hajë”
NRSV	“do të inkurajohet deri në pikën që të hajë”
TEV	“a nuk do ta inkurajojë atë të hajë”
NJB	“mund të inkurajohet të hajë”

Ky është termi “ndërtoj” sikurse në vargun 1. Këtu ai përdoret ose

1. Në një kuptim sarkastik për ndikimin shkatërrues të veprimeve të vëllait të fortë
2. Një mundësi për të cituar nga letra korintase e lidhur me ndihmën ndaj atyre me besim të dobët

8:11

NASB	“Sepse përmes njohurisë tënde, ai që është i dobët shkatërrohet, vëllai për hir të të cilit vdiq Krishti”
NKJV	“Edhe kështu, për shkak të njohurisë sate, do të humbasë vëllai yt i dobët, për të cilin vdiq Krishti”
NRSV	“Kështu me anë të njohurisë tënde, ata besimtarë të dobët për të cilët Krishti vdiq, shkatërrohen”
TEV	“Dhe kështu, ky person i dobët, vëllai yt për të cilin Krishti vdiq, do të shkatërrohet për shkak të ‘njohurisë’ tënde”
NJB	“Dhe më pas do të jetë përmes njohurisë tënde që ky vëlla për të cilin Krishti vdiq, i dobët siç është, do të hubmasë”

Rendi i fjalisë greke thekson “yt” (dmth., kjo e ashtu-qaajtura njohuri superiore që ti ke). Kur liria e një të krishterit shkatërron një të krishter tjetër, ajo liri është një shkatërrim (shih Rom. 14:15,20).

Ky është një koment sarkastik sikurse është 1 Kor. 8:10. Kisha korintase ishte krenare për njohurinë e tyre (8:1). Këtu Pali tregon se njohuria mund të jetë një shkatërrim. Pali gjithmonë e qorton vëllain “më të fortë” që të ketë durim dhe të kujdeset për vëllain “më të dobët”, për shkak të dashurisë së Krishtit për të dy ata.

Termi “shkatërrohet”, “humbet” ose “rrënohet” duhet të interpretohet nën dritën e Rom. 14:22-23, ku ajo do të thotë “të shkatërosh dikë tjetër të mëkatojë”, që është analoge me përdorimin e termit këtu. Ky nuk është shkatërrimi përfundimtar, por një zbrapsje e përkohshme por serioze në rritjen frymore.

#### **TEMË E VEÇANTË: SHKATËRRIMI (APOLLUMI) [SPECIAL TOPIC: DESTRUCTION (APOLLUMI)]**

Ky term ka një fushë të gjerë semantike, gjë që ka shkaktuar pëshqjellim të madh në lidhje me konceptet teologjike të gjykimit të përjetshëm përkundër asgjësimit. Kuptimi bazë i fjalëpërfjalshëm është “nga” apo plus *ollumi*, “shkatërroj, rrënoj”.

Problemi vjen nga përdorimet e figurshme të këtij termi. Kjo mund të shihet qartë në Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament, Based on Semantic Domains* [Leksik greqisht-anglisht i Dhiatës së Re, bazuar në domenet semantike], vëll. 2, fq. 30. Ata rendisin disa kuptime të këtij termi

1. shkatërroj (p.sh. Mat. 10:28; Luka 5:37; Gjoni 10:10; 17:12; Veprat e Apo. 5:37; Rom. 9:22 nga vëll. 1, fq. 232)
2. s'arrij të përftoj (p.sh., Mat. 10:42; vëll. 1, fq. 566)
3. humbas (p.sh., Luka 15:8, vëll. 1, fq. 566)
4. i pavetëdijshëm për vendndodhjen (p.sh., Luka 15:4; vëll. 1, fq. 330)
5. vdes (p.sh., Mat. 10:39, vëll. 1, fq. 266)

Gerhard Kittel, *Theological Dictionary of the New Testament* [Fjalor Teologjik i Dhjatës së Re] përpiket të përvijojë përdorimet e ndryshme duke renditur katër kuptime:

1. shkatërroj, ose vras (p.sh. Mat. 2:13; 27:20; Marku 3:6; 9:22; Luka 6:9; 1 Kor. 1:19)
2. humbas ose pësoj humbje nga (p.sh., Marku 9:41; Luka 15:4, 8)
3. humbas (p.sh. Mat. 26:52; Marku 4:38; Luka 11:51; 13:3,5,33; 15:17; Gjoni 6:12,27; 1 Kor. 10:9-10)
4. të jesh i humbur (p.sh., Mat. 5:29-30; Marku 2:22; Luka 15:4, 6, 24, 32; 21:18; Veprat 27:34)

Më tej, Kittel thotë: “në përgjithësi, mund të themi se #2 dhe #4 gjenden në thënie të lidhura me këtë botë, si të unguar sinoptikë, ndërsa #1 dhe #3 gjenden në ato thënie të lidhura me botën tjetër, si të Pali dhe Gjoni” (fq. 394).

Këtu qëndron dhe përshtjellimi. Ky term ka një përdorim kaq të gjerë semantik sa që autorë të ndryshëm të Dhjatës së Re e përdorin në një larmi mënyrash. Mua më pëlqen Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], fq. 275-277. Ai e lidh këtë term me ata njerëz që janë të shkatërruar moralisht dhe presin ndarjen e përjetshme nga Perëndia, në dallim nga ata njerëz që njohin Krishtin dhe kanë jetë të përjetshme në Të. Grupi i dytë është “i shpëtuar”, ndërsa i pari shkatërrohet.

Robert B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], fq. 276, vë re se ka disa vende ku ky term nuk mund të përkthehet asgjësim, “por një plagë e tillë e bën objektin praktikisht të papërdorshëm për qëllimin e tij fillestar.”

1. Shpërdorimi i vajit, Mat. 26:8
2. Shkatërimi i kacakëve të vjetër, Mat. 9:17
3. Shkatërimi i flokëve, Luka 21:18
4. Shkatërimi i ushqimit, Gjoni 6:27
5. Shkatërimi i arit, 1 Pjet. 1:7
6. Shkatërimi i botës, 2 Pjet. 3:6
7. Shkatërimi i trupit fizik, Mat. 2:13; 8:25; 12:14; 21:41; 22:7; 26:52; 27:20; Rom. 2:12; 14:15; dhe 1 Kor. 8:11

Ky term nuk i referohet kurrë asgjësimit të personit, por fundit të ekzistencës trupore. Ai gjithashtu përdoret zakonisht në një kuptim moral. “Të gjithë njerëzit shihen si moralisht të shkatërruar, dmth., ata kanë dështuar të përçojnë qëllimin për të cilin u krijua raca” (fq. 276). Përgjigja e Perëndisë ndaj këtij problemi mëkati ishte Jezus Krishti (shih Gjoni 3:15-16 dhe 2 Pjet. 3:9). Ata që refuzojnë unguar tani janë subjekt të një shkatërimi të mëtejshëm, i cili përfshin trupin dhe frymën (shih 1 Kor. 1:18; 2 Kor. 2:15; 4:3; 2 Thes. 2:10). Për mendimin e kundërt, shih Fudge, *The Fire That Consumes* [Zjarri që Konsumon].

Personalisht (shih R. B. Girdlestone, *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], fq. 276), nuk mendoj se ky term nënkupton asgjësim (shih E. Fudge, *The Fire That Consumes* [Zjarri që shkrumbon]). Fjala “e përjetshme” përdoret si për ndëshkimin e përjetshëm, ashtu dhe për jetën e përjetshme, në Mat. 25:46. Nëse zhvlerëson njerëz, zhvlerëson dhe tjetrën!

**8:12 “kur mëkatoni kështu kundër vëllezërve... ju mëkatoni kundër Krishtit”** Ky është një pohim i fuqishëm. Dashuria jonë për Perëndinë tregohet në dashurinë tonë për njëri-tjetrin. Disa herë në Dhjatën e Re, veprimet e njerëzve kundër besimtarëve shihen si veprime kundër Krishtit (shih Veprat e Apo. 9:4,5) dhe veprimet e njerëzve për besimtarët shihen si veprime për Krishtin (shih Mat. 25:40,45).

**8:13 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Çështjet e ushqimit po bënin që disa besimtarë të çënonin supozimet e besimit të tyre personal.

▣ **“pengon”<sup>22</sup>** Ky është termi grek që përdorej për të vënë në kurth kafshët. Fjalë për fjalë ajo i referohej një shkopi karremi të zënë”.

▣ **“unë nuk do të ha më kurrë mish”** Ky varg ka një ndërtim me formë mohuese të trefishtë shumë të fuqishme (shih Rom. 14:21). Liria në Krishtin duhet të ndërtojë, jo të shkatërrojë. Nënkuptimi i pathënë është se Pali nuk do të hajë mish të flijuar ndaj një idhulli apo në tempullin e një idhulli. Kjo nuk do të thotë që Pali u bë vegetarian.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Është e dukshme që ky problem i veçantë nuk është një problem bashkëkohor; megjithatë, parimi universal këtu është mjaft i rëndësishëm. Shpreheni këtë parim me fjalët tuaja.
2. Si lidhet aktiviteti demonik me fetë në botë në kohën tonë sot?
3. Nëse ka vetëm një Perëndi, si mund të jetë Jezusi hyjnor?
4. Shpjegoni marrëdhënien midis lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së krishterë.
5. Përkufizoni besimtarët e “dobët” dhe të “fortë”.
6. A duhet të jenë të gjithë besimtarët vegetarianë?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

---

<sup>22</sup> Versioni në shqip është: “skandalizon”. (shënim i përkthyesit)

# 1 KORINTASVE 9

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Ushqim i Ofruar Perëndive të Rremë (8:1-11:1)
Të Drejtat e një Apostulli	Një Sjellje Vetë-mohimi	Të Drejtat e Palit si një Apostull	Të Drejtat dhe Detyrat e një Apostulli	Pali Jep Shembullin e Tij
9:1-2	9:1-18	9:1-2 9:3-7 9:8-12a	9:1-2 9:3-7 9:8-12a	9:1-14
9:12b-18		9:12b-14 Pali është i Lirë të Heqë Dorë nga të Drejtat e Tij Apostolike	9:12b-14	
	Duke Shpëtuar Gjithë Njerëzit	9:15-18	9:15-18	9:15-18
9:19-23	9:19-23 Duke Synuar për një Kurorë	9:19-23	9:19-22 9:23-27	9:19-23
9:24-27	9:24-27	9:24-27		9:24-27

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 9:1-27**

- A. Ky kapitull lidhet me kapitullin 8 në kuptimin e të kërkuarit të një ekuilibri midis të drejtave të krishtera dhe përgjegjësisë në dashuri (shih Rom. 14:1-15:13 dhe 1 Kor. 8:1-11 dhe 13:1-13).
- B. Është e qartë nga konteksti që drejtimi i Palit po sulmohej nga ndonjë grup ose disa grupe në kishën e Korintit.
  - a. Mësues hebraikë shëtitës të trajnuar në retorikë
  - b. Gnostikë fillestarë
- C. Gjendet një variacion i përemrave vetorë (dhe formave të foljeve) të përdorura në këtë kapitull.

- a. Veta e parë njëjës, tek 1 Kor. 9:1-3,6,8,15-23,26-27
- b. Veta e parë shumës, tek 1 Kor. 9:4-5,10-11,25
  - i. Duke qënë se Barnaba përmendet specifikiisht tek 1 Kor. 9:6, ai ndoshta nënkuptohet tek 1 Kor. 9:4-5
  - ii. Tek 1 Kor. 9:10-11 Pali duket se përfshin Apollin dhe ndoshta edhe predikues të tjerë vizitorë, madje dhe Pjetrin
  - iii. Shpesh Pali përdor shumësin editorial “ne” për të folur për veten e tij
- c. Veta e dytë njëjës, tek 1 Kor. 9:13,24 i referohet të krishterëve që pretendojnë njohuri “të plotë” të gjërave të Perëndisë
- d. Përdorimi i Palit i përemrave është tejet i vështirë dhe burimi i shumë varianteve të dorëshkrimeve greke

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:1-2

<sup>1</sup> A s’jam unë apostull? A s’jam unë i lirë? Po a nuk e pashë Jezu Krishtin, Zotin tonë? A nuk jeni ju vepra ime në Zotin? <sup>2</sup> Në qoftë se për të tjerët nuk jam apostull, së paku për ju unë jam; sepse ju jeni vula e apostullimit tim në Zotin.

**9:1 “A s’jam unë i lirë”** Gjendet një seri pyetjesh në këtë kontekst. USB<sup>4</sup> ka katërmbëdhjetë, NASB ka gjashtëmbëdhjetë, NKJV ka pesëmbëdhjetë, NRSV ka gjashtëmbëdhjetë, TEV ka katërmbëdhjetë dhe NJB ka dymbëdhjetë. Është e pasigurtë nëse këto janë pohime apo pyetje (shih Ellingworth and Hatton, *A Handbook on Paul's First Letter to the Corinthians* [Një Udhëzues mbi Letrën e Parë të Palit ndaj Korintasve], fq. 193). Këto pyetje tek 1 Kor. 9:1-2 të gjitha presin një “po” si përgjigje. Pyetjet tek 1 Kor. 9:6,7,10, dhe 11 shprehen të tilla që të presin një “jo” si përgjigje.

Ky është përdorimi i “i lirë” në kuptimin e lirisë frymore në Krishtin (shih 1 Kor. 9:19; 10:29), jo liri romake (dmth., të drejtat politike). Në Krishtin, besimtari, i cili tani banohet nga Fryma, i formuar tashmë me anë të ungjillit ka lirinë “të mos”! Fuqia e “vetes së rënë”, e “mua së pari” në Zanafillën 3 është zhvendosur me “të tjerët së pari”! Liria në ungjill nuk është “liri për të...”, por “liri për të mos...”! Është shumë e ndryshme nga liria politike e cila është realisht fryti i pemës së njohurisë së të mirës dhe së keqes. Njerëzimi i rënë nuk mund ta përballojë “lirinë”! Po ashtu nuk mundën besimtarët e papjekur!

▣ **“Po a nuk e pashë Jezu Krishtin, Zotin tonë”** Kjo është forma treguese aktive e përkryer, e cila nënkupton se një veprim në të shkuarën ka rezultuar në një gjëndje aktuale statusi. Apostullimi i Palit po sulmohej për shkak se ai nuk ishte një nga Dymbëdhjetët e parë. Kualifikimet për një apostull ishin që duhej të kishe qënë me Jezusin gjatë jetës së tij në tokë dhe të kishe parë ringjalljen e tij (shih Veprat e Apo. 1:15-26). Pali pranon se ai e kishte parë Krishtin e ringjallur (shih Veprat e Apo. 9:3,17,27; 22:14; 1 Kor. 15:8). Thirrja e Palit ishte me anë të një veprimit të veçantë të Krishtit për një mision të veçantë tek johebrenjtë, e cila kërkonte një zbulës të veçantë (shih Veprat e Apo. 18:9; 23:11).

Pali jo vetëm që e takoi Jezusin personalisht në rrugën për në Damask, por disa herë gjatë shërbesës së tij, Jezusi ose një engjëll si përfaqësues i Jezusit, iu shfaq atij për ta inkurajuar (shih Veprat e Apo. 18:9-11; 22:17-21), tek Veprat e Apo. 27:23.

▣ **“A nuk jeni ju vepra ime në Zotin”** Prova e apostullimit të Palit ishin kishat e numërta që ai kishte formuar, ndër të cilat ishte edhe kisha e Korintit (shih 1 Kor. 4:15; 2 Kor. 3:1-3).

**9:2 “Në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila tregon se autoriteti i Palit u refuzua nga disa grupe të përçara në kishën e hershme (shih Veprat e Apostujve 15 dhe Letrën drejtuar Galatasve).

▣ **“sepse ju jeni vula e apostullimit tim në Zotin”** Një vulë në botën antike ishte një pjesë dylli e ngrohtë në të cilën shtypej një unazë me vulë personale në mënyrë që të vuloste letrën ose pakon. Ajo ishte një siguri që brendia e saj nuk ishte hapur; ajo tregonte se cilit i përkiste brendia e letrës ose pakos; dhe tregonte origjinalitetin e



përmbajtjeve, që ishte dërguar nga personi i duhur. Ky lloj vule u bë metaforë për sigurinë e krishterë (shih Gjoni 3:33; Rom. 4:11).

### TEMË E VEÇANTË: VULA (SPECIAL TOPIC: SEAL)

Vula mund të ketë qenë mënyrë e lashtë për të treguar

1. të vërtetën (shih Gjoni 3:33)
2. pronësinë (shih Gjoni 6:27; 2 Tim. 2:19; Zbu. 7:2-3; 9:4)
3. siguri ose mbrojtje (shih Zan. 4:15; Mat. 27:66; Rom. 4:11; 15:28; 2 Kor. 1:22; Efe. 1:13; 4:30; Zbu. 20:3)
4. mund të jetë edhe shenjë e realitetit të premtimit të një dhurate nga Perëndia (shih Rom. 4:11 dhe 1 Kor. 9:2)

Qëllimi i kësaj vule tek Zbulesa 7:2-4; 9:4 është të identifikojë popullin e Perëndisë në mënyrë që zemërimi i Perëndisë të mos i prekë. Vula e Satanit identifikon njerëzit e tij, të cilët janë objekt i zemërimit të Perëndisë. Në Zbulesë, “mundimi” (pra, *thlipsis*) nënkupton gjithmonë përndjekjen e besimtarëve nga jobesimtarët, ndërsa zemërimi/tërbimi (pra, *orgē* ose *thumos*) është gjithmonë gjykimi i Perëndisë mbi jobesimtarët në mënyrë që ata të pendohen dhe të kthehen në besim te Krishti. Ky synim pozitiv i gjykimit mund të shihet në mallkimet/bekimet e besëlidhjes të Ligji i Përtërirë 27-28; Psalmi 1.

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:3-7

<sup>3</sup> Kjo është mbrojtja ime ndaj atyre që më hetojnë. <sup>4</sup> A nuk kemi edhe ne të drejtë të hamë e të pimë? <sup>5</sup> A nuk kemi edhe ne të drejtë të marrim me vete një bashkëshorte, që të jetë motër në besim, sikurse edhe apostujt e tjerë, dhe vëllezërit e Zotit, edhe Kefa? <sup>6</sup> Apo vetëm unë dhe Barnaba nuk kemi të drejtë të mos punojmë? <sup>7</sup> Kush, vallë, shkon në luftë me shpenzimet e veta? Kush mbjell vresht dhe nuk ha nga fryti i tij? Kush kullot një tufë dhe nuk ha nga qumështi i tufës?

**9:3 “mbrojtja ime”** Ky term (dmth., *apologia*) u përdor për “mbrojtje ligjore” (shih Veprat e Apo. 19:33; 22:1; 25:16; Fil. 1:7,17; 1 Pjet. 3:15). Sintetifikisht vargu 1 Kor. 9:3 mund të përputhet me 1 Kor. 9:2 ose 1 Kor. 9:4. Versionet USB<sup>4</sup>, NRSV dhe TEV e tregojnë se ai vazhdon me 1 Kor. 9:4, ndërkohë që versionet NKJV dhe NJB nuk e thejnë paragrafin në asnjë nga këto pikë.

■ **“ndaj atyre që më hetojnë”** Pali po kritikohej nga disa grupe teologjike në Korint (shih 1 Kor. 2:15; 4:3). Ata po shpallnin

1. që ai nuk ishte një apostull i vërtetë
2. që ai ndryshoi mesazhin e apostujve të Jeruzalemit
3. që ai vetëm predikonte për para

**Këto akuza nuk thuhet specifikisht, por nënkuptohen nga rrethanat historike dhe nga temat që Pali zgjodhi të adresonte.**

**9:4** Kjo nis një seri pyetjesh (shih 1 Kor. 9:4-7) ku Pali pranon të drejtën e tij si një apostull për t’u suportuar nga kishat lokale. Megjithatë, ai personalisht zgjodhi të mos ushtronte të drejtat e tij (shih 1 Kor. 9:15,18; 1 Thes. 2:6), por ai pranon të drejtat e punëtorëve të tjerë të krishterë.

**9:5 “të marrim me vete... sikurse edhe apostujt e tjerë”** Konteksti nuk po pranon drejtëpërsëdrejti të drejtën e apostujve për të pasur gra, edhe pse kjo është sigurisht e nënkuptuar, por të drejtën e apostujve për të pasur mbështetjen e kishës për ta dhe për bashkëshortet e tyre.

Termi “apostull” mund t’i referohet të dymbëdhjetëve ose një përdorimi më të gjerë të termit (shih Veprat e Apo. 14:4,14; Rom. 16:67; 1 Kor. 4:9; Gal. 1:9; Efe. 4:11; Fil. 2:25; 1 Thes. 2:6). Për shkak se Pjetri emërohet veçmas, grupi i mëvontë nënkuptohet. Gjithashtu, është e mundur që një grup (dmth., një nga grupet e përcara) në këtë kishë po ngrinte lart apostullimin e Pjetrit (shih 1 Kor. 1:12; 3:22).

Në gjuhën greke, gjendet një çift i dyfishtë i emrave, “një motër, një bashkëshorte”, i cili ishte shprehje për “një bashkëshorte besimtare”. Problemi historik është se si lidhet kjo me

1. gruan që shoqëronte Jezusin dhe grupin apostolik dhe i ndihmonte ata (shih Mat. 27:55; Mark 15:40-41)
2. gruaja e diskutuar tek 1 Kor. 7:36-38 (pra, një bijë ose një shoqëruese virgjëreshë ose një e fejuar)
3. shërbesa e grave të drejtuesve të kishës e ngjashme me diakoninë e Rom. 16:1 ose “grupi i vejuarëve” të pastoralëve (shih 1 Tim. 3:11; 5:9-10)

Ndoshta të Dymbëdhjetët që Jezusi zgjodhi ishin të martuar për shkak se beqaria në mes të hebrenjve ishte shumë e rrallë. Hebrenjtë martoheshin për shkak të urdhërimit tek Zan. 1:28; 9:1,7.

▣ **“ashtu sikurse pjesa tjetër e apostujve”** Termi “apostull” kishte disa nënkuptime në Dhjatën e Re.

1. Ata që u thirrën nga Jezusi dhe e ndoqën Atë gjatë jetës së Tij në tokë
2. Pali i thirrur në një vizion të veçantë në rrugën për në Damask
3. Një dhuratë e vazhdueshme në kishë (shih Efe. 4:11), e cila përfshinte disa njerëz

Çështja tekstuale këtu është çfarë bëjmë ne me listën e Palit.

1. Pjesa tjetër e apostujve
2. Vëllezërit në Zotin
3. Kefa
4. Barnaba dhe Pali

▣ **“vëllezërit e Zotit”** Jerome (346-420 pas lindjes së Krishtit) besonte se këta ishin kushërinj të Jezusit; Epifani (310-403 pas lindjes së Krishtit) tha se ata ishin fëmijë nga martesë e mëparshme e Jozefit. Të dy këto interpretime ishin të lidhura dukshëm me zhvillimin e presupozimeve romake katolike mbi Marinë dhe jo me Dhjatën e Re. Maria pati fëmijë të tjerë pas Jezusit (shih Mat. 12:26; 13:55; Mark 6:3; Gjoni 2:12; 7:3,5,10; Veprat e Apo. 1:14; Gal. 1:19).

Në fakt kjo nënkupton që Jezusi kishte gjysmë vëllezër, të cilët ishin aktivë në kishë, dhe që konsideroheshin pjesë e drejtimit. Në fakt, një nga të afërmit e Jezusit ishte drejtuesi i kishës së Jeruzalemit për disa breza gjatë shekullit të parë, duke filluar me Jakobin.

▣ **“Kefa”** Kjo është forma aramaike e emrit në greqisht *Petros*. Ajo nënkuptonte një gur ose shkëmb (shih Mat. 8:14; Gjoni 1:42). Kefa ishte i martuar (shih Mark. 1:30).

Pali e quan Pjetrin “Kefa” tek 1 Kor. 1:12; 3:22; 9:5; 15:5 dhe Gal. 1:18; 2:9. Por tek Gal. 2:7,8,11,14 ai e quan atë Pjetër. Duket se nuk ka dallim teologjik, por ndoshta ndryshime letrare. Ai quhet Pjetër kudo në ungjijt përveçse tek Gjoni 1:42.

Është interesante që kisha ka bërë një lidhje kaq të fortë midis Pjetrit (dmth., *Petros*) dhe “këtij shkëmbi” (dmth., *petra*) tek Mat. 16:18. Jezusi foli në gjuhën aramaike dhe nuk ka aspak dallim midis dy termave në atë gjuhë.

**9:6 “Barnaba”** Barnaba gjithashtu thirret një apostull, që tregon një përdorim më të gjerë të termit (Efe. 4:11) se sa thjesht Dymbëdhjetët të parët (shih Veprat e Apo. 14:14, 18:5).

#### **TEMË E VEÇANTË: BARNABA (SPECIAL TOPIC: BARNABAS)**

- I. Njeriu
  - A. Fillimisht i quajtur Jozef (shih Veprat e Apo. 4:36)
  - B. I lindur në Qipro (shih Veprat e Apo. 4:36)
  - C. Nga fisi i Levit (shih Veprat e Apo. 4:36)
  - D. Me pseudonimin “biri i inkurajimit” (shih Veprat e Apo. 4:36, 11:23)
  - E. I quajtur “një njeri i mirë” (shih Veprat e Apo. 11:24)

- F. Një anëtar i kishës së Jeruzalemit (shih Veprat e Apo. 11:22) dhe i dërguar si përfaqësues i saj për të kontrolluar kishën e re në rritje të Antiokisë, Siri (shih Veprat e Apo. 11:19-28)
  - G. Për të thuhej se ishte i mbushur me Frymën e Shenjtë (shih Veprat e Apo. 11:24)
  - H. Për të thuhej se ishte i mbushur me besim (shih Veprat e Apo. 11:24)
  - I. Ai kishte dhuntitë frymore të një profeti dhe mësuesi (shih Veprat e Apo. 13:1)
  - J. I quajtur një apostull (shih Veprat e Apo. 14:14)
- II. Shërbesa e Tij
- A. Në Jeruzalem
    - 1. Shiti pasurinë e tij dhe ua dha gjithë paratë apostujve për të ndihmuar të varfërit (shih Veprat e Apo. 4:37)
    - 2. Drejtues në kishën e Jeruzalemit (shih Veprat e Apo. 11:22)
  - B. Me Palin
    - 1. Ai ishte një nga të parët që i besoi konvertimit të Saulit / Palit (shih Veprat e Apo. 9:27)
    - 2. Ai shkoi në Tars për të gjetur Saulin / Palin dhe për ta ndihmuar me kishën e re në Antioki (shih Veprat e Apo. 11:24-26)
    - 3. Kisha në Antioki dërgoi Barnabën dhe Saulin në kishën në Jeruzalem me një kontribut për të varfërit (shih Veprat e Apo. 11:29-30)
    - 4. Barnaba dhe Pali shkojnë në udhëtimin e tyre të parë misionar (shih Veprat e Apo. 13:1-3)
    - 5. Barnaba ishte drejtuesi i skuadrës në Qipro (vendin e tij të lindjes), por së shpejti drejtimi i Palit u pranua (shih Veprat e Apo. 13:13)
    - 6. Ata i raportonin kishës në Jeruzalem për të shpjeguar dhe dokumentuar veprën e tyre të misionit në mes të johebrenjve (shih Veprat e Apo. 15:1-21, të quajtur Këshilli i Jeruzalemit)
    - 7. Barnaba dhe Pali patën një mosdakordësim mbi ligjet hebraike të ushqimit dhe marrëdhënies me johebrenjtë të regjistruar tek Gal. 2:11-14
    - 8. Barnaba dhe Pali planifikuan një udhëtim të dytë misionar, por diskutimi u ngrit mbi kushëririn e Barnabës, Gjon Markun (shih Kol. 4:10), i cili la punën në udhëtimin e parë misionar (shih Veprat e Apo. 13:13). Pali refuzoi që ta merrte në udhëtimin e dytë misionar, kështu që skuadra u nda (shih Veprat e Apo. 15:36-41). Kjo rezultoi në dy skuadra (dmth., Barnaba dhe Gjon Marku, dhe Pali dhe Sila).
- III. Tradita kishtare (Eusebius)
- A. Barnaba ishte një nga shtatëdhjetë të dërguarit nga Jezusi (shih Luka 10:1-20).
  - B. Ai vdiq si një martir i krishterë mbi tokën e tij të vendlindjes, Qipro (nga Veprat e Barnabës)
  - C. Tertuliani thotë se ai shkroi librin e Hebrenjve
  - D. Klementi i Aleksandrisë thotë se ai shkroi librin jo-kanonik të Letrës së Barnabës

<b>NASB</b>	<b>“nuk kemi të drejtë të mos punojmë”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“të cilët nuk kanë asnjë të drejtë të mos punojnë”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“të cilët nuk kanë asnjë të drejtë të mos punojnë për të jetuar”</b>
<b>TEV</b>	<b>“të vetmit që duhet të punojnë për t’u ushqyer”</b>
<b>NJB</b>	<b>“të vetmit që nuk kanë të drejtë të ndalojnë së punuari”</b>

Rabinët pranuan dinjitetin e punës së krahut. Të gjithë rabinët duhet të kishin një punë jo të lidhur me besimin, sepse konsiderohej mëkat të merrje para për të mësuar të vërtetat e YHWH (shih Pirke Abot 1:13; 4:7). Pali zgjodhi të mos përfitojë nga e drejta e tij si predikues i ungjillit (1 Kor. 9:18), ndoshta për shkak të (1) trashëgimisë së tij hebraike ose (2) sulmeve të atyre që pretendonin se ai i manipulonte njerëzit për para (shih Veprat e Apo. 20:33; 2 Kor. 11:7-12; 12:14-18).

**9:7-14** Në këto vargje gjenden disa shembuj nga jeta e përditshme të përdorur si analogji për të treguar se sa e përshtatshme ishte për punëtorët e ungjillit që të merrnin një pagë jetese nga kishat ku ata shërbenin (shih Rom. 15:27): (1) një ushtar, v.7; (2) një vreshtar, 1 Kor. 9:7; (3) një bari, 1 Kor. 9:7; (4) kau, 1 Kor. 9:9; (5) një lëruës dhe shirës, 1 Kor. 9:10; (6) një mbjellës, 1 Kor. 9:11; dhe (7) një prift, 1 Kor. 9:13.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:8-14**

<sup>8</sup> A i them këto si njeri? A nuk i thotë këto edhe ligji? <sup>9</sup> Sepse në ligjin e Moisiut është shkruar: “Mos ia lidh gojën kaut që shin.” A u merrka Perëndia me qetë, vallë? <sup>10</sup> Apo e thotë këtë për ne? Vërtetë për ne janë shkruar, sepse kush lëron duhet të lërojë me shpresë, dhe kush shin, duhet të shijë me shpresë që të marrë atë që shpreson. <sup>11</sup> Në qoftë se ne kemi mbjellë midis jush gjërat frymërore, a është gjë e madhe nëse korrim të mirat tuaja materiale? <sup>12</sup> Në qoftë se të tjerë kanë pjesë të kësaj të drejte mbi ju, a nuk do ta kishim ne shumë më tepër? Po ne nuk e përdornim këtë të drejtë; po durojmë çdo gjë, për të mos i vënë asnjë pengesë ungjillit të Krishtit. <sup>13</sup> Nuk e dini ju se ata që kryejnë shërbesën e shenjtë hanë nga gjërat e tempullit, dhe ata që i shërbejnë altarit marrin pjesë nga të mirat e altarit? <sup>14</sup> Kështu edhe Zoti urdhëroi që ata që shpallin ungjillin, nga ungjilli të rrojnë.

**9:8**

**NASB**

“sipas gjykimit njerëzor”

**NKJV**

“si një njeri i thjeshtë”

**NRSV**

“sipas autoritetit njerëzor”

**TEV**

“për ta kufizuar veten në shembuj të tillë të jetës së përditshme”

**NJB**

“thjesht sipas urtësisë së botës”

Teksti në greqisht ka “sipas njeriut” (dmth., *anthrōpos*, që i referohet njerëzve). Pali përdor këto fraza kontrastuese disa herë (shih 1 Kor. 3:3; 9:8; 15:32; Rom. 3:5; Gal. 1:11; 3:15). Ishte mënyra e tij shprehimore për të kontrastuar gjërat njerëzore me këtë mënyrë të re sjelljeje dhe veprimi të drejtuar nga Fryma (dmth., mësimet e Jezusit ose urtësia nga Fryma).

**9:9 “në ligjin e Moisiut është shkruar”** Mënyra hebraike e përgjigjes ndaj pyetjes ishte me një citim autoritativ, nëse ishte e mundur nga shkrimet e Moisiut (dmth., Zan. – Ligji i Përt.); prandaj, Pali citon Ligjin e Përt. 25:4 (shih 1 Tim. 5:18).

**TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT (SPECIAL TOPIC: PAUL'S VIEWS OF THE MOSAIC LAW)**

Ai është i mirë dhe nga Perëndia (shih Rom. 7:12,16).

- A. Ai nuk është rruqa për në drejtësi dhe në pranim nga Perëndia (ai madje mund të jetë një mallkim, shih Galatasve. 3). Shih Temë e Veçantë: Ligji i Moisiut dhe të Krishterët / Special Topic: Mosaic Law and the Christian
- B. Ai është ende vullneti i Perëndisë për besimtarët sepse është vetë-zbulesa e Perëndisë (Pali shpesh e citon Dhjatën e Vjetër për të bindur për mëkat dhe/ose inkurajuar besimtarët).
- C. Besimtarët informohen nga Dhjata e Vjetër (shih Rom. 4:23-24; 15:4; I Kor. 10:6,11), por nuk shpëtohen nga Dhjata e Vjetër (shih Veprat e Apostujve 15; Romakëve 4; Galatasve 3; Hebrenjve). Ai funksionon për shenjtërim por jo për shfajësim.
- D. Ai funksionon në besëlidhjen e re për të:
  1. treguar mëkatshmeri (shih Gal. 3:15-29)
  2. udhëhequr njerëzimin e shpenguar në shoqëri
  3. informuar vendimet etike të krishtera

Është ky spektër teologjik nga mallkimi (shih Gal. 3:10-13) dhe aspekti kalimtar në bekim dhe përhershmeri që shkakton problemin kur përpiqemi të kuptojmë pikëpamjen e Palit për Ligjin e Moisiut. Në *A Man in Christ* [Një Njeri në Krishtin], James Stewart tregon të menduarit dhe të shkruarit paradoksal të Palit:

“Natyrshëm do të prisnim që një njeri i cili i ishte futur punës për të ndërtuar një sistem mendimi dhe doktrine do t’i fiksonte në mënyrë sa më të ngurtë kuptimet e termave që do të përdorte. Do të prisnim që ai të synonte precizion në frazeologjinë e ideve të tij kryesore. Do të kërkonim që një fjalë, pasi të ishte përdorur njëherë nga shkrimtari ynë në një kuptim të caktuar, duhej ta ruante atë kuptim gjithandej. Por nëse do ta kërkojmë këtë te Pali, do të zhgënjehemi. Pjesa më e madhe e frazeologjisë së tij është fluide, jo e ngurtë. . . ‘Ligji është i shenjtë,’ shkruan ai, ‘Unë gjej kënaqësi të madhe në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm’ (shih Rom. 7:12, 22) por është qartësisht një aspekt tjetër i *nomos* që e bën të thotë në një vend tjetër, ‘Krishti na ka shpenguar nga mallkimi i ligjit (shih Gal. 3:13)’” (fq. 26).

■ **“Mos ia lidh gojën kaut që shin”** Ky është një citim nga Septuagint i Ligjit të Përt. 25:4. Termi “lidh” është *phimōsies*, i cili shfaqet tek dorëshkrimet greke P<sup>46</sup>, א, A, B<sup>3</sup>, C, D<sup>b,c</sup>, K, L, P, dhe në pjesën më të madhe të dorëshkrimeve të vogla të mëvonshme. Ky term gjithashtu përdoret në citimet e Palit të të njëjtit tekst tek 1 Tim. 5:18.

Megjithatë, redaktorët e UBS<sup>4</sup> preferonin variantin *kēmōseis*, i cili gjithashtu do të thotë “lidh”, i gjendur tek versionet MSS B\*, D\*, F dhe G. Arsyetimi i tyre ishte fjala e përdorur më pak (ndoshta një fjalë zhargon) ishte ndoshta origjinale për shkak se fjala tjetër pritej nga Septuaginti dhe citimi tek 1 Timoteut, prandaj lind pyetja: pse do ta ndryshonte një skrib atë? Termi i zgjedhur si origjinal nuk përbën asnjë dallim në interpretim, por ilustron parimet tekstuale me anë të të cilëve kritikët modernë tekstualë i vlerësojnë dorëshkrimet në gjuhën Koine Greke në një përpjekje për të mbuluar fjalën origjinale të autografit. Shih Shtojcën Dy.

## TEMË E VEÇANTË: KRITICIZËM TEKSTUAL (SPECIAL TOPIC: TEXTUAL CRITICISM)

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojë shënimet tekstuale të gjendura në këtë komentari.

Do të përdoret skica e mëposhtme

I. Burimet tekstuale të Biblës në versionin tonë

A. Dhjata e Vjetër

B. Dhjata e Re

II. Shpjegimi i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kriticizmit të ulët” gjithashtu të quajtur “kriticizmit tekstual”.

III. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

I. Burimet tekstuale të Biblës në versionin tonë

A. Dhjata e Vjetër

1. Teksti Masoretik (MT) – Teksti hebraik me bashkëtingëllore u vendos nga Rabi Aquiba në vitin 100 pas lindjes së Krishtit. Pikat zanore, theksi, shënimet në marxhina, pikëzimi dhe pikat u shtuan duke filluar nga shekulli i gjashtë pas lindjes së Krishtit dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas lindjes së Krishtit. Kjo u bë nga një familje studiuesish hebraikë të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që ata përdorën ishte e njëjtë me atë tek Mishnah, Talmud, Targums, Peshitta, dhe Vulgate.

2. Septuaginti (LXX) – Tradita thotë se Septuaginti (përkthimet greke të Dhjatës së Vjetër) u prodhua nga 70 studiues hebrenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë nën sponsorizimin e Mbretit Ptolemi II (285-246 para lindjes së Krishtit). Përkthimi duket se u kërkua nga një drejtues hebraik që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristeas”. LXX bazohej shpesh mbi një traditë tekstuale hebraike e ndryshme nga teksti i Rabbi Aquiba (MT).

3. Dorëshkrimet e Detit të Vdekur (DSS) – Dorëshkrimet e Detit të Vdekur u shkruajtën në

periudhën romake para Krishtit (nga viti 200 para lindjes së Krishtit deri në vitin 70 pas lindjes së Krishtit) nga një sekt hebrejsh separatistë të quajtur “Essenes” (Esenët). Dorëshkrimet hebraike, të gjendura në disa pjesë përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraike disi ndryshe pas të dy: MT dhe LXX.

4. Disa shembuj specifikë të se si këto tekste kanë ndihmuar interpretuesit të kuptojnë Dhjatën e Vjetër.
- a. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit të kuptojnë MT
    - (1) LXX e Isa. 52:14, “Shumë do të çuditën me të”,
    - (2) MT e Isa. 52:14, “Kaq shumë u çuditën me ty”,
    - (3) Tek Isa. 52:15 dallimi përemëror i LXX konfirmohet
      - (a) LXX, “kështu do të mahniten shumë kombe me të”
      - (b) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”
  - b. DSS ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit të kuptojnë MT
    - (1) DSS e Isa. 21:8, “më pas profeti thirri, Unë qëndroj mbi një kullë vrojtimi.
    - (2) MT e Isa. 21:8, “dhe unë thirra, një luan! Zoti im, unë gjithmonë qëndroj mbi kullën e vëzhgimit ditën”
  - c. Të dy LXX dhe DSS kanë ndihmuar të sqarohet Isa. 53:11
    - (1) LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij ai do të shohë dritë, ai do të jetë i kënaqur”
    - (2) MT, “ai do të shohë... të mundimit të shpirtit të tij, Ai do të jetë i kënaqur”

## B. Dhajta e Re

1. Mbi 5,300 dorëshkrime të të gjitha pjesëve të Dhjatës së Re Greke janë ruajtur. Rreth 85 janë shkruar mbi papiruse dhe 268 janë dorëshkrime të shkruara të gjitha në shkroja kapitale (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas lindjes së Krishtit, një dorëshkrim qarkullues (me shkronja të vogla) u zhvillua. Dorëshkrimet greke të shkruara në formë numrash janë rreth 2,700. Ne gjithashtu kemi rreth 2,100 kopje të listës së teksteve të shkrimeve të përdorura në adhurim që ne i quajme leksionarë.
2. Rreth 85 dorëshkrime greke përmbajnë pjesë të Dhjatës së Re të shkruar në papiruse mbahen në muzeume. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas lindjes së Krishtit, por pjesa më e madhe janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas lindjes së Krishtit. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban të gjithë Dhjatën e Re. Vetëm sepse këto janë kopje të Dhjatës së Re nuk do të thotë automatikisht se ata kanë variante më të pakta. Shumë prej tyre u kopjuan shpejt për përdorim lokal. Nuk u tregua kujdes gjatë procesit. Prandaj, ato përmbajnë shumë variante.
3. Codex Sinaiticus, i njohur nga shkronja hebraike א (*aleph*) ose (01), i gjendur tek manastiri i Shën Katerinës mbi Malin Sinai nga Tischendorf. Ai daton nga shekulli i katërt pas lindjes së Krishtit dhe përmban si LXX të Dhjatës së Vjetër ashtu edhe Dhjatën e Re në greqisht. Është një tekst i llojit “Aleksandrian”.
4. Codex Alexandrinus, i njohur si “A” ose (02), një dorëshkrim grek i shekullit të pestë i cili u gjend në Aleksandri, Egjipt.
5. Codex Vaticanus, i njohur si “B” ose (03), i gjendur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas lindjes së Krishtit. Ai përmban si LXX të Dhjatës së Vjetër ashtu edhe Dhjatën e Re Greke. Ai është një tekst i llojit “Aleksandrian”.
6. Codex Ephraemi, i njohur si “C” ose (04), një dorëshkrim grek i shekullit të pestë i cili u shkatërrua pjesërisht.
7. Codex Bezae, i njohur si “D” ose (05), një dorëshkrim grek i shekullit të pestë ose të gjashtë. Ai ishte përfaqësuesi kryesor i asaj që quhej “Teksti Perëndimor”. Ai përmban shumë shtesa dhe ishte dëshmuesi kryesor grek për përkthimin e Mbretit Xhejms.
8. NT MSS mund të grupohet në tre, ndoshta katër, familje që ndajnë karakteristika të

caktuara.

- a. Teksti Aleksandrian nga Egjipti
  - (1) P<sup>75</sup>, P<sup>66</sup> (rreth vitit 200 pas lindjes së Krishtit), i cili regjistron ungjijt
  - (2) P<sup>46</sup> (rreth vitit 225 pas lindjes së Krishtit), i cili regjistron letrat e Palit
  - (3) P<sup>72</sup> (rreth viteve 225-250 pas lindjes së Krishtit), i cili regjistron Pjetrin dhe Judën
  - (4) Codex B, i quajtur Vaticanus (rreth vitit 325 pas lindjes së Krishtit), i cili përfshin të gjithë Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re
  - (5) Origeni citon nga ky lloj teksti
  - (6) Të tjerë MSS të cilët tregojnë se ky lloj teksti janë x, C, L, W 33
- b. Tekst perëndimor nga Afrika e Veriut
  - (1) Citime nga etër kishash të Afrikës së Veriut, Tertullian [Tertuliani], Cyprian [Cipriani] dhe përkthim i Vjetër Latin
  - (2) Citime nga Irenaeus [Ireneasi]
  - (3) Citime nga Tatian [Tatiani] dhe përkthimi i vjetër Siriak
  - (4) Codex D “Bezae” ndjekin këtë lloj teksti
- c. Tekstet bizantine lindore nga Konstandinopoja
  - (1) Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 MSS
  - (2) Cituar nga etërit e kishës së Antiokut të Sirisë, Cappadoceans, Chrysostom dhe Therodoret
  - (3) Codex A, vetëm në ungjijt
  - (4) Codex E (shekulli i tetë) për Dhjatën e Re të plotë
- d. Lloji i katërt i mundshëm është “Çezariani” nga Palestina
  - (1) Shihet kryesisht vetëm tek Marku
  - (2) Disa dëshmitarë të tij janë P<sup>45</sup> dhe W

II. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kriticizmit të ulët” gjithashtu të quajtur “kriticizmit tekstual”.

A. Si ndodhën variantet

1. Në mënyrë të shkujdesur ose aksidentale (pjesa më e madhe e ngjarjeve)

- a. Shkëputja e shikimit gjatë kopjimit me dorë gjatë të cilit hiqet shembulli i dytë i dy fjalëve të ngjashme dhe në këtë mënyrë hiqen të gjitha fjalët midis tyre (homoioteleuton)
  - (1) Ndarja e syrit gjatë heqjes së një fjale apo fraze me dy shkronja (haplography)
  - (2) Ndarja e mendjes në përsëritjen e një fraze apo rreshti të një teksti grek (dittography)
- b. Ndarja e veshit në kopjimin me diktim oral ku ndodh shkrimi i gabuar (itacism). Shpesh shkrimi i gabuar nënkupton gjithashtu shkrimin e një fjale në greqisht që ka një kuptim të ngjashëm.
- c. Tekstet më të hershme greke nuk kishin kapitull ose ndarje vargjesh, kishin pak ose aspak shenja pikëzimi dhe nuk kishte fjalë ndarëse midis tyre. Gjithashtu është e mundur që të ndash shkronjat në vende të ndryshme nga formimi i fjalëve të ndryshme.

2. Në mënyrë të qëllimshme

- a. Ndryshimet u bënë për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar
- b. Ndryshimet u bënë për të sjellë tekstin në konformitet me tekste të tjera biblike (harmonizimi i paraleleve)
- c. Ndryshimet u bënë duke kombinuar dy ose më shumë lexime variante në një tekst të gjatë të kombinuar (konflacion<sup>23</sup>)

<sup>23</sup> Shkrimi në një e dy ose më shumë pjesëve të informacionit, tekste, ide, etj. (shënim i përkthyesit)

- d. Ndryshimet u bënë për të korigjuar një problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
  - e. Disa informacione shtesë për sa i përket rrethanave historike apo interpretimit të duhur të tekstit u vendosën në marxhinat nga një skrib por u futën në tekst nga një skrib tjetër (shih Gjoni 5:4)
- B. Parimet bazë të kritikizmit tekstual (udhëzime llogjike për të përcaktuar leximin origjinal të një teksti kur ekzistojnë variante)
1. Teksti më i vështirë apo gramatikisht i pazakontë është ndoshta teksti origjinal
  2. Teksti më i shkurtër është ndoshta teksti origjinal
  3. Tekstit më të vjetër i jepet më shumë peshë për shkak të afërsisë historike ndaj origjinalit, nëse çdo gjë tjetër është njësoj
  4. MSS që janë gjeografikisht të ndryshme zakonisht kanë leximin origjinal
  5. Tekstet më të dobëta nga ana doktrinale, sidomos ato që lidhen me diskutime të rëndësishme teologjike të periudhës së ndryshimeve të dorëshkrimeve, si Trinia tek 1 Gjoni 5:7-8, duhet të jenë ato që preferohen.
  6. Teksti që mund ta përshkruajë më mirë origjinën e varianteve të tjera
  7. Dy citime që ndihmojnë të tregojnë ekuilibrin në këto variante shqetësuese
    - a. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism*, “Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet mbi një tekst të debatueshëm; dhe studenti i Dhjatës së Re duhet të jetë i ndërgjegjshëm për dëshirën e tij që ky tekst të jetë më i perëndishëm ose më i fortë nga ana doktrinale se sa teksti origjinal i frymëzuar” (fq. 68).
    - b. W. A. Criswell i tha Greg Garrison të *The Birmingham News* që ai (Criswell) nuk beson se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “ose të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut modern pas shekujsh përkthimesh”. Criswell tha:
 

“Unë jam vërtet një besimtar në kritikizmin tekstual. Si i tillë, mendoj se gjysma e dytë e kapitullit të 16-të të Markut është herezi: nuk është i frymëzuar, ai është thjesht i sajuar... Kur krahason dorëshkrimet që datojnë në të shkuarën, nuk gjen diçka të tillë si konkluzioni i Librit të Markut. Dikush e ka shtuar atë...”

Patriarku i SBC të pagabueshmit gjithashtu pretendon se “interpolimi” është i dukshëm tek Gjoni 5, regjistrimi i Jezusit në pellgun e Betesdas. Dhe ai diskuton dy regjistrimet e ndryshme të vetëvrasjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat e Apo. 1): “Është thjesht një pikëpamje e ndryshme e vetëvrasjes,” thotë Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një arsye për këtë. Dhe të dy regjistrimet për vetëvrasjen e Judës janë në Bibël.” Criswell shtoi: “Kritikizmi tekstual është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Ajo nuk është kalimtare, ajo nuk është pa etikë. Ajo është dinamike dhe qëndrore...”

### III. Probleme dorëshkrimi (kritikizëm tekstual). Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

- A. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual* [Kritikizëm Biblik: Historik, Letrar dhe Tekstual] nga R.H. Harrison
- B. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption and Restoration* [Teksti i Dhjatës së Re: Transmetimi, Korruptimi dhe Restaurimi i tij] nga Bruce M. Metzger
- C. *Introduction to New Testament Textual Criticism* [Hyrje në Kritikizmin Tekstual të Dhjatës së Re] nga J. H Greenlee



**NRSV** “A është i shqetësuar për qetë Perëndia”  
**TEV** “Tani, a shqetësohet Perëndia për qetë”  
**NJB** “A janë qetë për të cilët Perëndia shqetësohet këtu”

Vargu 9 dhe 10 tregojnë se si një tekst i Dhjatës së Vjetër u zgjerua (dmth., për të nxjerrë në pah rëndësinë ose zbatimin) për të përmbushur nevojat e një dite të re (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 9:10; 10:6,11). Dhjata e Vjetër shfaq kujdes të veçantë për kafshët (shih Eksod. 21:33,35; 27:10-13; 23:5,12; Ligji i përt. 5:14; 22:4). Jezusi aludon ndaj këtij kujdesi për kafshët (shih Luka 13:15; 14:5, ku Ai zbaton parimin rabinik të “lehtë dhe rëndë”). Kjo nuk nënkupton se Perëndia nuk shqetësohet për kafshët, por se Ai gjithashtu shqetësohet për njerëzit, dhe në këtë konteskt, për punëtorët e ungjillit (shih 1 Tim. 5:18). Kjo është e ngjashme me Mat. 6:26-34. Jezusi përdor sigurimin e Perëndisë në natyrë si një mënyrë për të provuar sigurimin e Perëndisë për njerëzimin e krijuar në imazhin e Tij. Kjo është një teknikë tipike rabinike e njohur si “më pak për më shumë” ose “lehtë dhe rëndë”, që ishte një nga parimet e Hillel-it (shih Aboth. de Rab. Nathan XXXVII dhe Tosefta Sanhedrin c. 7). Kujto, Gamalieli ishte mësuesi rabinik i Palit (shih Veprat e Apo. 5:34; 22:3). Shih Shtojcën Tre (Hermeneutika Rabinike) në hebraisht tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org).

### 9:10

**NASB** “Apo po flet ai në tërësi për hirin tonë? Po, për hirin tonë u shkruajt”  
**NKJV** “Apo e thotë këtë për ne? Vërtetë për ne janë shkruar”  
**NRSV** “Apo nuk flet ai tërësisht për hirin tonë? Në fakt u shkruajt për hirin tonë”  
**TEV** “A nuk e kishte për ne ai kur e tha këtë? Patjetër që u shkruajt për ne”  
**NJB** “apo nuk thuhet tërësisht për hirin tonë? Qartazi u shkruajt për ne”

Disa herë Pali pranon se Dhjata e Vjetër u shkruajt si një shembull për besimtarët e Dhjatës së Re (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 9:10; 10:6,11). Trajnimi rabinik i Palit i mësoi atij të zbatojë Ligjin në rrethanat aktuale. Këtu ai po përdor argumentin rabinik të quajtur “lehtë dhe rëndë” ose “më pak për më shumë”. Në kontekstin e Ligjit të Përt. 25:4 ky zbatim do të kishte qënë i panjohur dhe i panevojshëm. Pyetja hermeneutike është: “A po përdorte Pali qëllimin original të shkruarit të frymëzuar?” Përgjigja është qartazi, jo! Por a po përdor ai një zbatim të vlefshëm të një parimi? Pali është i frymëzuar! Ai shikon të vërtetën në një nivel që ne nuk e shohim dot! Megjithatë, ne nuk jemi të frymëzuar por të ndriçuar nga Fryma. Interpretuesit modernë nuk mund të riprodhojnë metodën hermeneutike të autorëve të Dhjatës së Re. Prandaj, është më mirë të lejojmë ata të flasim, por të kufizojmë veten tonë në përfaqsimin tonë historiko-gramatikore, e cila kërkon qëllimin e autorit original si një kuptim përcaktues, por duke lejuar shumë zbatime të cilat lidhen me qëllimin original! Shih Temën e Veçantë: Ndriçimi dhe Frymëzimi në fillim të 1 Korintasve 2.

**9:11 “Në qoftë se... nëse”** Këto të dyja janë fjali kushtore të rendit të parë, që nënkuptohen të jenë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

Pyetja e vërtetë është kush janë të tjerët që pretendojnë se kanë të drejtën për mbështetjen e kishës Korintase ndaj tyre? A ishin këta mësues të rremë që udhëtonin apo ata që ishin pjesë e drejtimit lokal? Ai ndoshta i referohet drejtuesve të tjerë lokalë të cilët nuk lejonin kishën që t’i mbështeste ata (shih përkthimin J. B. Phillips)

▣ **“mbjellë... korrin”** Rrethanat bujqësore të Dhjatës së Vjetër të korrjes bëhen një parim frymor (shih Job. 4:8; Fjalët e Urta 22:8; Ose. 8:7; Hag. 1:6; Gjoni 4:37; 1 Kor. 9:11; 2 Kor. 9:6,10; Gal. 6:7-9).

▣ **“të mirat materiale”** Kjo është fjalë për fjalë *ta sarkika*, “gjërat e mishit,” por jo në një kuptim mëkatar, por në kuptimin e gjërave fizike të cilat iu nevojiten njerëzve për të mbijetuar në këtë botë (dmth., ujë, ushqim, strehim, veshje, etj. Shih Rom. 15:27).

**9:12 “Në qoftë se”** Kjo është një fjalë tjetër kushtore e rendit të parë. Drejtuesit e tjerë po ushtronin të drejtën (dmth., *exousia*) për t’u kompesuar nga ana materiale.

▣ **“a nuk do ta kishim ne shumë më tepër”** Ky është një përdorim metaforik i fjalës greke për “rrënjë”, që do të thotë “të mbulosh”, “të fshehësh” ose “të durosh” (shih 1 Kor. 13:7).

▣ **“pengesë”** Ky ishte një term i fuqishëm ushtarak. Fjala përdorej për të thyer një rrugë për të ndaluar armikun që ta përdorte atë.

▣ **“ungjillit të Krishtit”** Termi “ungjill” është fjalë për fjalë “lajm i mirë”. Ai përfshin disa aspekte.

1. Lajmin fillestar të keq të mëkatit dhe rebelimit të njerëzimit
2. Sigurimi i hirshëm i Perëndisë për të trajtuar mëkatin njerëzor (dmth., vdekja e Krishtit)
3. Ftesa e hapur për këdo dhe për të gjithë për të pranuar sigurimin e Perëndisë me pendesë dhe besim

Ky lajm i mirë mbi Jezusin përfshin tre aspekte.

1. Ai është një person për t’u mirëpritur (dmth., Jezusi)
2. Ai është e vërteta për atë person për t’u besuar (dmth., Dhjata e Re)
3. Ai është një jetë që matet me atë person (dmth., një jetë që i përngjan Krishtit)

Nëse ndonjë nga këto tre aspekte nënvlerësohet, ungjilli dëmtohet!

**9:13 “ata që kryejnë shërbesën e shenjtë hanë nga gjërat e tempullit”** Kjo i referohet priftërinjve të Dhjatës së Vjetër dhe Levitëve (shih Lev. 7:6,8-10,14,28-36; Ligji i Përt. 18:1). Pali përdor një term që u përdor tek Septuagjinti për veprën priftërore (shih Num. 3:7; 8:15) sikurse dhe për veprën në përgjithësi (shih Zan. 2:5,15; 3:23; 4:2,12; 29:27). Pali pa shërbesën e tij ungjillore si një shërbesë priftërore (shih Rom. 15:16).

**9:14 “Kështu edhe Zoti urdhëroi”** Kjo duhet t’i referohet fjalëve të Jezusit tek Mat. 10:10 dhe Luka 10:7. Pali gjithnjë përpiket t’i referohet mësimëve të Jezusit mbi një temë nëse është e mundur.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:15-18**

<sup>15</sup> Por unë nuk përdora asnjë nga këto gjëra as nuk i shkrova, që kështu të më bëhet, sepse për mua është më mirë të vdes se sa dikush ta bëjë të kotë të mburrurit tim. <sup>16</sup> Sepse, në qoftë se unë predikoj ungjillin, s’ka asgjë që unë të mburrem, sepse kjo është një nevojë që më është ngarkuar; edhe mjerë unë, po nuk predikova ungjillin! <sup>17</sup> Sepse, po e bëra këtë vullnetarisht, do të kem një pagë; por po ta bëj kundër dëshirës, mbetet gjithnjë një detyrë që më është besuar. <sup>18</sup> Cila, pra, është paga ime? Që, duke predikuar ungjillin ta bëj ungjillin të ofruar falas, pa e përdorur për keq pushtetin tim në ungjillin.

**9:15 “Por unë nuk përdora asnjë nga këto gjëra”** Kjo është një formë treguese e mesme e përkryer. Pali kurrë nuk mori kompensim nga Korinti, ndoshta për shkak se kishte nga ata në këtë kishë që përdornin çdo gjë për ta sulmuar atë. Ai pranoi para nga Filipia (shih 1 Kor. 4:15) dhe Thesalonika (shih 2 Kor. 11:9), por vetëm më vonë, jo ndërkohë që ai ishte atje.

▣ **“sepse për mua është më mirë të vdes”** Çfarë pohimi i fuqishëm në lidhje me pranimin apo refuzimin e kompensimit. Gjendet gjithashtu një problem gramatikor në këtë pikë që shkaktoi disa variante dorëshkrimesh greke. Pali është shumë emocional mbi këtë temë. Ai mori para dhe ndihmë nga Filipia (shih Fil. 4:15) dhe Thesalonika (shih 2 Kor. 11:9), pse jo nga Korinti? Dukshëm për shkak të kësaj ai po sulmohet personalisht nga disa grupe apo mësues të rremë.

Gjendet një ndërprerje e mendimit të Palit në mes të fjalisë pas “se”. Vini re se versionet NRSV dhe NET të Biblës vendosin një vijë në mes, ndërsa NJB vendos pika, duke u përpjekur për të treguar ndërprerjen gramatikore. Se si ndikon kjo ndërprerje në frazën tjetër është e pasigurtë. Duket se ai kishte për qëllim të pranonte se ai nuk do të merrte asnjë para nga kisha korintase, por ai e lë këtë të pathënë! Ky është një pasazh tejet emocional. Pali ka dhembje, po reagon, po lutet, nuk po jep thjesht mësim mbi një pikë. Jeta e tij ilustron parimin (dmth., të gjitha, gjithçka, çdo kohë, me këdo për ungjillin, shih 2 Kor. 4:5-12; 6:3-13; 11:16-33)! Është kaq e vështirë të interpretosh letrën e Palit kur nuk kemi (1) letrën që kisha i shkroi atij ose (2) njohurinë specifike mbi situatën lokale.

**9:16 “në qoftë se... po”** Këto janë të dyja fjali kushtore të rendit të tretë, të cilat nënkuptojnë veprim të mundshëm.

☐ **“që më është ngarkuar; edhe mjerë unë, po nuk predikova ungjillin”** Pali u ndje i ngarkuar me detyrën për të predikuar për shkak të thirrjes së veçantë të Krishtit në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:15; Rom. 1:14). Ai ishte si Jeremia në moshë (shih Jer. 20:9). Ai duhej ta ndante ungjillin (shih Veprat e Apo. 4:20).

**9:17 “po... po”** Këto dy fjali janë fjali kushtore të rendit të parë, të cilat nënkuptohen se janë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllime të tij letrare.

☐ **“mbetet gjithnjë një detyrë që më është besuar”** Kjo është një formë treguese pasive e përkryer. Punëtorët e ungjillit kanë si një privilegj besëlidhjeje ashtu edhe një përgjegjësi të mrekullueshme (shih 1 Kor. 4:1; Gal. 2:7; Efe. 3:2; Kol. 1:25). Shih shënimin e plotë mbi kujdestarinë tek 1 Kor. 4:1.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:19-23

<sup>19</sup> Sepse, ndonëse jam i liruar nga të gjithë, e bëra vetën time shërbëtor të të gjithëve që të fitoj sa më shumë njerëz. <sup>20</sup> Kështu e kam bërë vetën time Jude me Judenjtë për t'i fituar Judenjtë; e kam bërë vetën time si një që është nën ligj me ata që janë nën ligj për t'i fituar ata që janë nën ligj; <sup>21</sup> me ata që janë pa ligj e kam bërë vetën time si pa ligj (ndonëse nuk isha pa ligjin e Zotit, por nën ligjin e Krishtit), për të fituar ata që janë pa ligj. <sup>22</sup> E kam bërë vetën time të dobët me të dobëtit, për të fituar të dobëtit; e kam bërë vetën time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz. <sup>23</sup> Dhe këtë e bëj për hir të ungjillit, që të bëhem edhe unë pjestar i tij.

**9:19 “Sepse, ndonëse jam i liruar nga të gjithë”** Ky është theksi mbi lirinë e përshtatshme të krishterë (shih 1 Kor. 9:1; 10:29; Gal. 5:13). Martin Luteri ka thënë: “Një i krishterë është një zot i lirë mbi çdo gjë dhe nuk është subjekt ndaj askujt. Një njeri i krishterë është një shërbëtar në të gjitha, subjekt ndaj çdokujt.” Shih shënimin nga Romakëve 14 dhe 15 tek 1 Kor. 6:12.

☐ **“e bëra vetën time shërbëtor të të gjithëve”** Ky është theksi mbi përgjegjësinë e duhur të krishterë (shih Rom. 14:1-15:13; 2 Kor. 4:5). Për shkak se Pali ishte një skllav i Krishtit, ai ishte një skllav i të gjithëve të cilët Krishti erdhi t'ju shërbejë dhe të shpëtojë, si besimtarët ashtu edhe jobesimtarët. Shih Temën e Veçantë: Drejtim Shërbyes tek 1 Kor. 4:1.

☐ **“që të fitoj sa më shumë njerëz”** Ky është termi “fitoj” (dmth., *kerdainō*). Ai përdoret në një sërë kuptimesh në Dhjatën e Re. Në këtë kontekst Pali përdor termin në një kuptim ungjillor (shih 1 Kor. 9:19,20,21,22 dhe 1 Pjet. 3:1). Ky është qëllimi i duhur ungjillor i të gjithë veprimeve tona (shih 1 Kor. 9:22-23). Qëllimshmëria ungjillore në çdo zonë të jetës sonë, dhe jo një metodologji e përcaktuar, është çelësi për një ekuilibër të duhur midis lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së krishterë.

**9:20** Ky varg shpreh qëllimshmërinë e Palit. Shqetësimi kryesor i Palit ishte ungjillizimi (shih 1 Kor. 9:20-23; 10:31-33). Prandaj, ai rrethpreu Timoteun që të punonte me hebrenjtë (shih Veprat e Apo. 16:3), por nuk e rrethpreu Titin (shih Gal. 2:3-5) që të mos kompromentonte lirinë e ungjillit në mes të johebrenjve.

☐ **“e kam bërë vetën time si një që është nën ligj”** Është interesante që Textus Receptus (dmth., i njohur si teksti perëndimor), i cili njihet për tendencat e tij ekspansionistike, nuk përfshin këtë frazë origjinale të dukshme. Ai gjendet tek dorëshkrimet greke P<sup>46</sup>, א, A, B, C, D\*, F, G, P dhe përkthimet Vulgate, Syriak, Koptik dhe Armenian. Ne duhet të lidhim fjalët e Palit këtu me fjalët e Jezusit tek Mat. 5:17-20. Pali nuk po përjashtonte Ligjin e Moisiut, por po shikon përmbushjen e tij të vërtetë në Krishtin. Ligji nuk është mënyra e shpëtimit, por është ende (1) një zbulësë e vërtetë dhe (2) një reflektim i vullnetit të Perëndisë për shoqërinë njerëzore. Ai funksionon në shenjtërim progresiv, por jo në drejtësim. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 9:9.

**9:21 “por nën ligjin e Krishtit”** Kjo është një mënyrë e Dhjatës së Re për t'iu referuar Besëlidhjes së Re të Jer. 31:31-34. Ka mënyra të ndryshme se si shprehet nga Pali dhe Jakobi (“ligji i Frymës së jetës”, Rom. 8:2; “ligji i Krishtit”, Gal. 6:2; “ligji i përkryer, ligji i lirisë”, Jakobi 1:25 dhe 2:12; “ligji mbretëror”, Jakobi 2:8).

**9:22 “të dobët me të dobëtit, për të fituar të dobëtit”** Kuptimi i “i dobët” është i pasigurtë këtu sepse ai është përdorur në këtë kontekst për të krishterët e mbi-ndërgjegjshëm ose supersticiozë (shih 1 Kor. 8:7,10). Ai ndoshta lidhet me paganët supersticiozë (shih 1 Kor. 9:21). Përkthimi Williams madje e përkthen atë si “të mbi-ndërgjegjshmit”, që është një pasqyrim i mirë. Shih Temën e Veçantë: Dobësi tek 2 Kor. 12:9.

▣ **“e kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz”** Vini re numrin e “gjithë” (dmth., forma e *pas*) në këtë frazë. Njeriu i brendshëm i Palit është transformuar nga vetë-qendërimi në ungjill-qendërim. Ai është i lirë për t’i shërbyer Krishtit, për t’i shërbyer ungjillit, për t’i shërbyer Mbretërisë (shih Rom. 6:11; 7:4). Fleksibiliteti, qëllimshmëria dhe dashuria janë aspekte thelbësore të jetës dhe shërbesës së Palit!

Mendja e Palit ishte gjithmonë në ungjillizim (shih Rom. 11:14; 1 Kor. 1:21; 7:16; 10:31-33; 1 Tim. 1:15).

Megjithatë, është e trishtë të thuash se fraza e fundit na jep një ide që pjesa më e madhe e atyre që e dëgjuan atë nuk u përgjigjën në besim ndaj këtij mesazhi. Pse disa dëgjojnë (me veshë frymorë) dhe disa jo, është misteri i zgjedhjes dhe vullnetit të lirë!

**9:23** Ky është një varg përmbledhës, një varg tranziti. Ai mund të përshtatet me 1 Kor. 9:19-22 ose 24-27 ose mund të qëndrojë më vete. Ky varg nuk mbron një shpëtim me anë të veprave. Pali nuk është shpëtuar për shkak se ai ungjillizon. Ai e bën këtë për shkak se ai ka pranuar ungjillin dhe njuh paqen dhe urgjencën e tij.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 9:24-27**

<sup>24</sup> A nuk e dini se ata që vrapojnë në pistë, vërtetë vrapojnë të gjithë, por vetëm një e fiton çmimin? Vraponi në mënyrë që ta merrni. <sup>25</sup> Dhe kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha; dhe ata e bëjnë këtë për të marrë një kurorë që priset, kurse ne për një kurorë që nuk priset. <sup>26</sup> Unë, pra, vrapoj, por jo sikur jam i pasigurt; kështu luftoj, por jo sikur rrah erën; <sup>27</sup> madje e mendoj trupin tim dhe e nënshtroj, se mos, pasi t’u kem predikuar të tjerëve, të bëhem për t’u përjashtuar.

**9:25 “kushdo që merr pjesë në garë kontrollon veten në të gjitha”** Pali po përdor metafora atletike nga lojërat Isthmiane të mbajtura në Korint çdo dy vjet. Theksi këtu është mbi përpjekjet supreme të përdorura nga atletët që garojnë, jo nga përpjekjet me gjysmë zemër (shih Heb. 12:1-3). I krishteri nuk garon për të fituar shpëtimin, por për shkak se ai e ka përjetuar shpëtimin.

Ne kemi fituar garën në Krishtin, tani ne vrapojmë garën për Krishtin!

▣ **“një kurorë që priset”** Fituesit e konkursit atletik korintas merrnin një kurorë pishe (në Athinë një kurorë ulliri; në Delphi një kurorë dafine), e cila shpejt me kalimin e kohës prishej. Besimtarët marrin kurorën e (1) gëzimit (shih 1 Thes. 2:19); (2) drejtësisë (shih 2 Tim. 4:8); (3) jetës (shih Jakobi 1:12; Zbu. 2:10); dhe (4) lavdisë (shih 1 Pjet. 5:4). Këto janë kurora që nuk zbehen kurrë. A duhet që përkushtimi dhe entuziazmi i besimtarëve të jetë ndopak më i ulët se ai i atletëve? Ata synojnë fort për atë që nuk mund të zgjasë. Ne luftojmë për atë që nuk mund të zbehet!

**9:26-27 “unë vrapoj... unë luftoj... rrah erën”** Këto janë metafora atletike për të ilustruar nevojën për një vetë-kontroll dhe disiplinë të fuqishme. Jeta e krishterë nuk ka disa rregulla dhe kërkesa. Këto lidhen me shpërblimet, jo me shpëtimin. Palit duhet t’i kenë pëlqyer eventet sportive të kohës së tij, ai i përdor ato shpesh si metafora për jetën e krishterë.

#### **TEMË E VEÇANTË: SHKALLËT E SHPËRBLIMEVE DHE NDËSHKIMEVE (SPECIAL TOPIC: DEGREES OF REWARDS AND PUNISHMENT)**

- A. Përgjigja e duhur ose e gabuar ndaj Perëndisë bazohet në nivelin e njohurisë që ka individ. Sa më pak njohuri të ketë, aq më pak i përgjegjshëm është. Por edhe e kundërta është e vërtetë (shih Luka 12:45).
- B. Njohuria e Perëndisë vjen thelbësisht në dy mënyra:

1. krijimi (shih Psalmi 19; Romakëve 1-2)
  2. Shkrimi (shih Psalmi 19; 119; Jezusi, siç na zbulohet në Dhjatën e Re)
- C. Të dhënat nga Dhjata e Vjetër
1. shpërblimet
    - a. Zan. 15:1 (zakonisht, shoqërohet me shpërblimet tokësore: toka dhe fëmijë djem)
    - b. Lev. 26:1-13; Ligji i Përt. 28:1-14, 58-68 (bindja ndaj besëlidhjes sjell bekim)
    - c. Dan. 12:3
  2. Ndëshkimet: Lev. 26:14-39; Ligji i Përt. 27:15-26; 28:15-37 (mosbindja ndaj besëlidhjes sjell mallkim)
  3. Modeli i Dhjatës së Vjetër për shpërblimin për drejtësinë personale ndaj besëlidhjes modifikohet për shkak të mëkatit njerëzor. Ky modifikim shihet te Jobi dhe Psalmi 73 (pra, “dy udhët”, shih Ligji i Përt. 30:15, 19; Psami 1). Dhjata e Re e përforcon fokusin nga vepra te mendimi (shih Predikimin në Mal, Mateu 5-7).
- D. Të dhënat nga Dhjata e Re
1. shpërblimet (përtej shpëtimit)
    - a. Marku 9:41
    - b. Mat. 5:12,46; 6:1-4,5-6,6-18; 10:41-42; 16:27; 25:14-23
    - c. Luka 6:23, 35; 19:11-19, 25-26
  2. ndëshkimet
    - a. Marku 12:38-40
    - b. Luka 10:12; 12:47-48; 19:20-24; 20:47
    - c. Mateu 5:22, 29, 30; 7:19; 10:15, 28; 11:22-24; 13:49-50; 18:6; 25:14-30
    - d. Jakobi 3:1
- E. Për mua, e vetmja analogji e kuptueshme vjen nga opera. Unë nuk shkoj nëpër shfaqje operistike, kështu që nuk i kuptoj. Sa më shumë ta kuptoja vështirësinë dhe kompleksitetin e kompozimit, muzikës dhe kërcimit, aq më shumë do ta vlerësoja një shfaqje të tillë. Unë mendoj se Perëndia do të na e mbushë kupën plot në qiell, por mendoj se shërbesa jonë tokësore është ajo që na përcakton madhësinë e kupës.
- Prandaj, njohuria dhe reagimi ndaj kësaj njohurie çon në shpërblime dhe ndëshkime (shih Mat. 16:7; Luka 12:48; 1 Kor. 3:8, 14; 9:17, 18; Gal. 6:7; 2 Tim. 4:14). Ekziston një parim shpirtëror: korrin atë që mbjellim! Disa mbjellin më tepër, kështu që korrin më tepër (shih Mat. 13:8, 23).
- F. “Kurora e drejtësisë” është e jona në veprën e përfunduar të Jezu Krishtit (shih 2 Tim. 4:8), por vini re se “kurora e jetës” lidhet me qëndresën nën sprova (shih Jak. 1:12; Zbu. 2:10; 3:10-11). “Kurora e lavdisë” për drejtuesit e krishterë lidhet me stilin e tyre të jetesës (shih 1 Pje. 5:1-4). Pali e di se ka një kurorë të paprishshme, por ushtron vetëkontroll të rreptë ndaj vetes (shih 1 Kor. 9:24-27).
- Misteri i jetës së krishterë është se unguilli është plotësisht falas për shkak të veprës së përfunduar të Krishtit, por, ashtu siç duhet t’i përgjigjemi ofertës së Perëndisë në Krishtin, duhet t’i përgjigjemi edhe fuqizimit të Perëndisë për të bërë një jetë të krishterë. Jeta e krishterë është e mbinatyrshme, njësoj si shpëtimi, por duhet ta pranojmë dhe ta mbajmë fort. Paradoksi “falas, por të kushton gjithçka” është misteri i shpërblimeve dhe mbjellje/korrjes.
- Ne nuk shpëtohem nga veprat e mira, por për të kryer vepra të mira (shih Efe. 2:8-10). Veprat e mira janë provë se jemi takuar me Jezusin (shih Mateu 7). Merita njerëzore në fushën e shpëtimit çon në shkatërrim, ndërsa jetesa e perëndishme shpërblehet.

■ **“e disiplinohet<sup>24</sup> trupin tim”** Ky term, disiplinë, fjalë për fjalë i referohet të goditurit në fytyrë poshtë syve. Ai përdoret në mënyrë figurative tek Luka 18:5.

Pali e kishte seriozisht për vetëkontrollin në jetën e krishterë. Trupi nuk është i lig, por është fushëbeteja e tundimit. Nëse besimtarët nuk kontrollojnë mishin / trupin, ai do t’i kontrollojë ata (shih Rom. 8:1-11). Kjo nuk është një fitore e lehtë e një-hershme, por një maratonë afat-gjatë e vetë-disiplinimit për kauzën e Krishtit. Vetëkontrolli është virtyti përfundimtar i fryteve të Frymës tek Gal. 5:23.

<sup>24</sup> Versioni në shqip është “mundoj”. (shënim i përkthyesit)

Termi “trupi” (*sōma*) i referohet personit të plotë të Palit. Ai nuk është një nga tre aspektet e njerëzimit. Ai shpesh nënkupton të gjithë personin (shih 1 Kor. 7:4; 13:3; Rom. 12:2; Fil. 1:20). Bibla prezanton njerëzimin si një njësi (shih Zan. 2:7), jo një dikotomi apo trikotomi (shih George E. Ladd, *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], fq. 464-466. Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 7:34).

**NASB, NKJV “në mënyrë që... unë vetë të mos përjashtohem”**

**NRSV “unë vetë nuk duhet të përjashtohem”**

**TEV “që unë vetë të mos përjashtohem”**

**NJB “unë, vetë mund të përjashtohem”**

Ky term “përjashtuar” është një metaforë e lidhur me thyerjen e rregullave të lojërave atletike dhe në këtë mënyrë të mos mund të fitosh garën (shih 1 Tim. 6:12; 2 Tim. 4:7). Është nga rrënja e “të testosh” me një pamje drejt aprovimit (dmth., *dokimazōi*), por me një alfa privative, e cila e mohon atë (shih 2 Kor. 13:5).

Kjo nuk i referohet shpëtimit të Palit (edhe pse përdoret në këtë kuptim tek 2 Tim. 3:8); edhe pse paragrafi i mëparshëm duket i tillë (shih 1 Kor. 9:19-23). Kjo do të ishte në kundërshti me shumë pasazhe të tjera doktrinale nga Pali, sidomos Romakëve dhe Galatasve. Ai po diskuton në këtë paragraf frikën e tij për të qënë i padisiplinuar dhe për t’u refuzuar si një shpallës i ungjillit. Dhjata e Re regjistron disa të cilët përjashtohen (shih 1 Kor. 15:12; 1 Tim. 1:20; 2 Tim. 4:10). Pali dëshironte frytet e ungjillizimit nga njerëzit e konvertuar dhe nga kishat.

Trajnimi i burrave të rinj për lojërat greke përmendet tek (1) *Ars Poetica*, 412 dhe (2) *Ad Martyres*, 3. Ai përfshinte dhjetë muaj kufizimesh dhe regjimesh të rrepta fizike, dietike dhe sociale. Megjithatë, ka dhe një mënyrë tjetër të vlefshme për ta parë këtë tekst (shih *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës], nga Kaiser, Davids, Bruce dhe Branch):

“Në këtë mënyrë autori godet ekuilibrin e gjendur përgjatë Dhjatës së Re. Autorët e Dhjatës së Re shkruajnë nga experienca e hirit të Krishtit dhe për një bindje të plotë se ata janë në rrugën e tyre për një trashëgimi më të madhe në qiell. Në të njëjtën kohë, ata shkruajnë me një shqetësim se ata ose lexuesit e tyre mund të ndryshojnë dhe në këtë mënyrë të humbasin atë që ata kanë tashmë. Për sa kohë njerëzit ndjekin Krishtin, autorët e Dhjatës së Re kurrë nuk shprehin ndonjë shpresë se pa pendesë njerëz të tillë do të hyjnë në qiell. Ky është një lloj tensioni i dhimbshëm, por jo që të prodhojë frikë, i parë tek Pali (1 Kor. 9:27; Gal 5:2, 7-10; Fil 3:12; 2 Tim 4:7, ndonjëherë duke folur për tensionin në vetë jetën e tij dhe ndonjëherë duke folur për shqetësimin e tij për të tjerët), Jakobi (Jakobi 5:20, qëllimi i letrës është ‘të shpëtojë [një mëkatar, që do të thotë një besimtar që i është kthyer botës] nga vdekja’), Juda (Juda 23) dhe Gjoni (1 Gjonit 5:16-17 KJV, theksi duke qënë mbi lutjen për njerëzit përpara se ata t’i përkushtohen ‘mëkatit deri në vdekje’). Thirrja ndaj lexuesit modern është që të bëjë kujdes ndaj paralajmërimeve dhe ‘të imitojë ata që përmes besimit dhe durimit trashëgojnë atë që është premtuar’ (Heb 6:12) në mënyrë që autori të thotë për ne gjithashtu, ‘Ne jemi të bindur për gjëra më të mira në rastin tuaj – gjëra që shoqërojnë shpëtimin’” (fq. 683).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si lidhet kapitulli 9 me kapitullin 8?
2. A është e përshtatshme për një predikues të marrë mbështetje nga kisha? Nëse po, pse Pali nuk e lejoi këtë kishë që ta mbështeste atë?

3. Si mund të sillet ndryshe Pali ndaj grupeve të ndryshme dhe të mos konsiderohet një hipokrit?
4. Në vargjet 24-27 theksohet metafora atletike. Si zbatohet kjo metaforë në jetët tona të krishtera?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 10

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Ushqim i Ofruar Perëndive të Rremë (8:1-11:1)
Paralajmërim Ndaj Idhujtarisë	Shembuj të Dhjatës së Vjetër	Një Paralajmërim Ndaj Sigurisë së Tepruar	Paralajmërim Ndaj Idhujve	Një Paralajmërim dhe Mësime të Historisë së Izraelit
10:1-13	10:1-13	10:1-5 10:6-13	10:1-5 10:6-10 10:11	10:1-13
	I Lirë nga Idhujtaria	Zbatim: Flijime Sërish Idhuj	10:12-13	Festa Flijimesh: Asnjë Kompromis me Idhujtarinë
10:14-22	10:14-22	10:14-22	10:14-17 10:18-22	10:14-22
Beni Gjithçka për Lavdi të Perëndisë	Gjithçka për Lavdi të Perëndisë	Parime: Liria dhe Përgjegjësia Jonë për të Tjerët		Ushqim i Sakrifikuar ndaj Idhujve: Zgjidhje Praktike
10:23-11:1	10:23-11:1	10:23-30 10:31-11:1	10:23-24 10:25-26 10:27-29a 10:29b-30 10:31-11:1	10:23-11:1

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 10:1-11:1**

- A. Kapitujt 8 deri në 10 lidhen në mënyrë integrale në përpjekjet e tyre për të sjellë ekuilibër në diskutimin e lirisë së krishterë përkundrejt përgjegjësisë së krishterë në dashuri. Pali nuk përqëndrohet në rregulla të



vështira dhe të shpejta, por në prioritetet të marrëdhënieve ndërpersonale që forcojnë besimtarët dhe i tërheqin jobesimtarët tek Jezusi.

- B. Diskutimi i Palit për Darkën e Zotit, që fillon tek 1 Kor. 10:14 dhe vazhdon përgjatë 1 Kor. 10:22, është një parashtrim i diskutimit më të plotë tek 1 Kor. 11:17-34.
- C. Pali ndoshta adreson besimtarët “e dobët” tek 1 Kor. 10:14-22 dhe besimtarët “e fortë” tek 1 Kor. 10:23-33. Nëse kjo nuk është struktura, atëherë lind pyetja se si këta dy paragrafë nuk e kundërshtojnë njëri tjetrin: 1 Kor. 10:14-22, mos hani ushqim të flijuar; 1 Kor. 10:23-33, hani nëse nuk është me dyshim. Ndoshta i pari i referohet një ushqimi publik tek një tempull pagan dhe i dyti i referohet një ushqimi privat në shtëpi.
- D. Libri *Handbook on Paul's First Letter to the Corinthians* [Udhëzues mbi Letrën e Parë të Palit ndaj Korintasve] i United Bible Societies [Shoqërive të Bashkuara Biblike] nga Ellingworth dhe Hatton ka një skicim interesant të 1 Kor. 10:1-13.
- “Struktura e përgjithshme vijon si më poshtë:
- a. Hyrja – vargu 1a.
  - b. Aspekte pozitive.
    - i. Katër shembuj pozitivë nga Dhjata e Vjetër – vargjet 1b-4a – shembulli i fundit i zgjeruar në vargun 4b.
    - ii. Përfundime të nxjerra nga shembujt pozitivë – vargu 5.
    - iii. Zbatime ndaj lexuesve – vargu 6a.
  - c. Aspekte negative.
    - i. Pesë shembuj negativë të Dhjatës së Vjetër – vargjet 6b-10.
    - ii. Zbatim ndaj lexuesve – vargjet 11-13.

Fjala **të gjithë** përsëritet pesë herë në vargjet 1-4, duke i dhënë një theks të madh faktit që i gjithë populli i Izraelit kishte mbrojtjen dhe bekimet e Perëndisë përgjatë eksodit dhe viteve në vazhdim të endjes në shkretëtirë. **Të gjithë** del në kontrast me **pjesën më të madhe të tyre** në vargun 5 dhe me **disa prej tyre**, të cilët përsëriten katër herë në vargjet 7-10” (fq. 214).

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 10:1-5

<sup>1</sup> Sepse, o vëllezër, unë nuk dua që ju të mos e dini se gjithë etërit tanë ishin nën renë, dhe të gjithë shkuan nëpër det, <sup>2</sup> dhe të gjithë u pagëzuan për Moisinë në re dhe në det, <sup>3</sup> të gjithë hëngrën të njëjtën ushqim frymëror, <sup>4</sup> dhe të gjithë pinë të njëjtën pije frymërore, sepse pinin prej shkëmbi frymëror që i ndiqte; edhe ky shkëmb ishte Krishti. <sup>5</sup> Por Perëndia nuk pëlqeu shumicën prej tyre; sepse ranë të vdekur në shkretëtirë.

**10:1 “Sepse, o vëllezër, unë nuk dua që ju të mos e dini”** Kjo frazë është një teknikë letrare e përdorur shpesh nga Pali për të prezantuar një konkluzion (shih Rom. 1:13; 11:25; 1 Kor. 10:1; 12:1; 2 Kor. 1:8; 1 Thes. 4:13).

☐ **“etërit tanë”** Kjo reflekton (1) një element hebrejsh besimtarë në kishë ose (2) jobesimtarët e Dhjatës së Re që janë përfshirë në pemën natyrale të ullirit, Izraelin (shih Rom. 10; Gal. 6:16), tani janë një në Krishtin (shih Efe. 2:11-3:13).

☐ **“gjithë... të gjithë”** Termi përfshirës (dmth., *pantes*) përdoret dy herë tek 1 Kor. 10:1 dhe një herë tek 1 Kor. 10:2,3 dhe 4. Është një mënyrë për të theksuar unitetin e të gjithë izraelitëve në përjetimin e hirit dhe gjykimit të Perëndisë, të quajtur Periudha e Endjes në Shkretëtirë (dmth., Numrat).

☐ **“renë”** Kjo i referohet simbolit unik të pranisë së YHWH. Quhej nga rabinët reja *shekinah* e lavdisë (shih Eksod. 13:21-22, 14:19). Fjala në hebraisht *shekinah* do të thotë “të banosh me”. YHWH ishte me popullin e Tij

përgjatë kësaj periudhe gjykimi në mënyra të tilla intime dhe përkujdesëse sa që rabinët filluan ta quanin këtë periudhën e “muajit të mjaltit” midis YHWH dhe Izraelit.

■ **“të gjithë shkuan nëpër det”** Ky është një aludim ndaj ndarjes së Detit të Kuq (fjalë për fjalë “kallam” ose “ferra”) nga YHWH. Sot studiuesit janë të pasigurtë se cilës pjesë të ujërave i referohet kjo. I njëjti term *yam suph* përdoret në Dhjatën e Vjetër për t’iu referuar (1) Gjirit të Aqaba (shih Eksod. 21:4; Ligji i Përt. 2:1; 1 Mbr. 9:26; Jer. 49:21) ose (2) Oqeani Indian. Dukshëm i referohet ujërave misterioze të jugut. Është interesante që “ujërat” nuk thuhet se janë krijuar nga Perëndia tek Zanafilla 1. Shpesh mitet mesopotamiane të krijimit flasin për ujërat (dmth., të kripura dhe të ëmbla) si perëndi që dëshironin shkatërrimin njerëzor. YHWH çliron popullin e Tij nga kaosi dhe mposhtja e ujërave.

## TEMË E VEÇANTË: DETI I KUQ (SPECIAL TOPIC: THE RED SEA)

### I. Emri

A. Fjalë për fjalë emri është *Yam Suph*.

1. “Deti i Kallamëve” ose “Deti i Ferrave” (rrënja egjiptiane).
2. “Deti në fund (të tokës)” (rrënja semitike).

B. Kjo mund t’i referohet

1. Ujit të kripur, 1 Mbret. 9:26 (Gjiri i Aqaba); Jona 2:5 (Deti Mesdhe)
2. Ujit të ëmbël, Eksod. 2:3; Isa. 19:6

C. Septuaginti është përkthimi i parë që e quan atë “Deti i Kuq”. Ndoshta këta përkthyes po e lidhnin atë me detin e Edomit (i kuq). Ky përcaktim u përjetësua nga përkthimi latin Vulgate dhe më vonë nga përkthimi në anglisht i Mbretit Xhejms.

### II. Vendndodhja

A. Ka disa trupa ujërash që i referohen me këtë emër.

1. Trupi i ngushtë i ujërave midis Egjiptit dhe gadishullit Sinai rreth 190 milje i gjatë (Gjiri i Suezit)
2. Trupi i ujit midis gadishullit të Sinait dhe Arabisë rreth 112 milje i gjatë (Gjiri i Aqabas)

B. Ai mund të lidhej me zonën e cekët moçalore në pjesën verilindore të lumit të Nilit pranë Tanis, Zoan, Avaris, Rameses, që është në bregun jugor të liqenit Menzaleh (rajoni moçalor).

C. Ai mund të jetë duke u përdorur metaforikisht për ujërat misterioze në jug, shpesh përdorur për detin në fund (të tokës). Kjo do të thotë se mund t’i referohet:

1. Detit modern të Kuq (Gjiri i Suezit ose Gjiri i Aqabas, shih 1 Mbret. 9:26)
2. Oqeanit Indian (shih Herodotus 1.180)
3. Gjirit Persik (shih Josephus)

### III. Suph (sufiti) tek Numrat 33

A. Tek Num. 33:8, trupi i ujërave që u nda në mënyrë të mrekullueshme quhet *suph* (BDB 693 I, “kallamë” ose “ferra”).

B. Tek Num. 33:10,11, thuhet se Izraelitët u vendosën pranë *yam suph* (deti i kallamëve / ferrave).

C. Ka dy trupa të ndryshëm ujërash.

1. I pari nuk është Deti i Kuq (Gjiri i Suezit)
2. I dyti ndoshta është Deti i Kuq (Gjiri i Suezit)

D. Termi *suph* përdoret në Dhjatën e Vjetër në tre mënyra.

1. Trupi i ujërave i ndarë nga YHWH për të lejuar Izraelitët të kalonin, por ku u mbytën ushtarët egjiptianë
2. Zgjatimi veriperëndimor i Detit të Kuq (Gjiri i Suezit)
3. Zgjatimi verilindor i Detit të Kuq (Gjiri i Aqabas)

E. *Yam suph* ndoshta nuk do të thotë “deti i kallamëve” sepse

1. Nuk kishte / ka asnjë kallam (papyrus) në Detin e Kuq (ujë i kripur)
2. Etimologjia e supozuar egjiptiane i referohet një toke dhe jo një liqeni

F. *Suph* mund të vijë nga rrënja semitike “fund” (BDB 692) dhe t’i referohet ujërave misteriozë të panjohur të jugut (shih artikullin e Bernard F. Batts, "Red Sea or Reed Sea? What Yam Suph Really Means" [Det i Kuq apo Det i Kallamëve? Çfarë do të thotë vërtetë Yam Suph] tek *Approaches to the Bible* [Përfaqse ndaj Biblës], vol. 1, fq. 291-304).

**10:2 “u pagëzuan për Moisinë”** Dorëshkrimet greke variojnë midis formës pasive (dmth., MSS  $\alpha$ , A, C, D) dhe formës së mesme (dmth., MS B). Mua më duket sikur forma e mesme është kontekstualisht e përshtatshme për të theksuar vendimin e vullnetshëm të izraelitëve për të ndjekur Moisiun dhe faktin historik të pagëzimit prozelit hebraik që ishte i vetë administruar. Kjo është një frazë e pazakontë, e gjendur vetëm këtu në Dhjatën e Re. Ajo nënkupton një paralelizëm midis përgjegjësisë dhe privilegjit të besëlidhjes mozaike dhe besëlidhjes sonë të re në Krishtin; të dyja janë nga Perëndia dhe në disa mënyra janë të ngjashme. Këtu pagëzimi zakonisht është një simbol për dikë që ndjek.

Gjendet një traditë rabinike që kthehet pas tek Hillel (shih b Ker 9a; bYeb 46a) e cila lidh pagëzimin prozelit me ndodhinë e Detit të Kuq. Shih Richard N. Longenecker, *Biblical Exegesis in the Apostolic Period* [Eksegeza Biblike në Periudhën Apostolike], fq. 102-103.

**10:3 “ushqim frymëror”** Kjo i referohet si manës (shih Eksod. 16) ashtu edhe shkurtave (shih Eksod. 16:13; Num. 11:31-32), të cilët ishin ushqime të siguruara në mënyrë mbinatyrore nga Perëndia përgjatë periudhës së endjes në shkretëtirë.

**10:4 “të njëjtën pije frymërore”** Kjo i referohet sigurimit të mrekullueshëm të ujit (Eksod. 17:6; Num. 20:8 e në vazhdim).

☐ **“pinin prej shkëmbi frymëror”** Shkëmb është një titull për YHWH në Dhjatën e Vjetër i cili thekson fuqinë dhe përjetësinë e Tij (shih Ligji i Përt. 32:4,15; Ps. 18:2; 19:14). Ai gjithashtu përdoret për Mbretërinë Mesianike si një forcë shkatërruese (shih Dan. 2:45).

☐ **“që i ndiqte”** Këto duken se i referohen një legjende rabinike të bazuar tek Eksod. 17:6 dhe Num. 20:11 e në vazhdim, që shkëmbi ndiqte izraelitët dhe ai ishte Mesia. Kjo traditë përmendet specifikisht në Kuran.

☐ **“edhe ky shkëmb ishte Krishti”** Kjo është një tipologji rabinike (personifikimi i shkëmbit mund të ketë ardhur nga Num. 21:17 ose Ligji i Përt. 32:4,15,18,30, shih Targum Onkelos mbi Numrat 21). Perëndia siguroi ujë jetë-dhënës përgjatë periudhës së endjes në shkretëtirë. Pali sheh një analogji ndërmjet sigurimit të Perëndisë atëherë dhe sigurimit jetë-dhënës të Perëndisë tani. Teologjia e Palit shihte Krishtin si para-eksisutes dhe agjent të Atit të jetës dhe bekimit. Jezusi ka qënë gjithnjë sigurimi i plotë dhe bekimi më i madh i Perëndisë At.

**10:5 “Por”** Kjo është fjala greke *alla*, e cila tregon një kontrast të fuqishëm. Shih Njohuri Kontekstuale, pika D.

☐ **“Perëndia nuk pëlqeu shumicën prej tyre”** Ky është një nën-pohim që zë rob vëmendjen: të gjithë përveç dyve të atij brezi vdiqën. Vetëm ata që ishin nën moshën 22 vjeçare (dmth., ende jo të vjetër mjaftueshëm për të qënë pjesë e ushtrisë) dhe Jozueu dhe Kalebi (dmth., dy spiunët që sollën një raport pozitiv besimi) hynë në tokën e premtuar (shih Juda 1:5).

☐ **“ranë të vdekur në shkretëtirë”** Kjo fjalë nënkupton se kockat e tyre u shpërndanë përgjatë rrugëtimit në shkretëtirë (shih Num. 14:16). Ata ishin populli i zgjedhur i Perëndisë, por Ai gjykoji mosbesimin e tyre. Këta besimtarë të Dhjatës së Vjetër e panë sigurimin e mrekullueshëm të Perëndisë. Ata e dinin vullnetin e Tij përgjatë drejtuesve të tyre të dhënë nga Perëndia (dmth., Moisiu, Aroni dhe Miriami), dhe megjithatë ata prapëseprapë vepruan në mosbesimin dhe rebelimin e tyre (shih Hebrenjtë 3-4).

Pali sapo ka komentuar mbi përpjekjet e tij të fuqishme në vetë-kontroll (shih 1 Kor. 9:24-27). Në kapitullin 11 ai po aludon ndaj atyre që u përpoqën të ndanin njohurinë teologjike nga stili i perëndishëm i të jetuarit (dmth., Gnostikët dhe intelektualët e tjerë). Edhe vaktet e zakonshme të shoqërizimit (dmth., festa *agape*) nuk mund të

hahen nga besimtarë të paperëndishëm (shih 1 Kor. 11:27-32). Vdekja fizike mund të jetë një gjykim i përkohshëm hyjnor i vuajtur nga besimtarët e pabindur.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 10:6-13**

**<sup>6</sup>Dhe këto u bënë si shembuj për ne, që ne të mos dëshirojmë gjëra të liga, ashtu si dëshiruan ata, <sup>7</sup>dhe që të mos bëheni idhujtarë si disa nga ata, sikurse është shkruar: “Populli u ul që të hajë dhe të pijë, dhe u ngrit për të luajtur.” <sup>8</sup>Dhe të mos kurvërojmë, ashtu si kurvëruan disa nga ata edhe ranë të vdekur në një ditë njëzet e tre mijë. <sup>9</sup>Dhe të mos e tundojmë Krishtin, ashtu si e tunduan disa nga ata dhe u vranë nga gjarpërinjtë. <sup>10</sup>Dhe mos u ankoni, ashtu si u ankuan disa nga ata, dhe u vranë nga shkatërruesi. <sup>11</sup>Dhe të gjitha këto gjëra u ndodhën atyre si shëmbull, dhe janë shkruar për paralajmërimin tonë, për ne që jemi në mbarim të epokës. <sup>12</sup>Prandaj ai që mendon se qëndron më këmbë, le të shohë se mos bjerë. <sup>13</sup>Asnjë tundim nuk ju ka gjetur juve, përveç se tundimi njerëzor; por Perëndia është besnik dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballoni.**

**10:6 “Tani<sup>25</sup>”** Versionet NRSV, TEV dhe JB gjithashtu bëjnë një ndarje të paragrafit në këtë pikë për të treguar kalimin nga analogjitë historike tek zbatimi i tashëm.

▣ **“këto u bënë si shembuj për ne”** Termi grek *tupoi*, “shembuj”, (në njëjës *tupos*) ka një fushë semantike të gjerë. Ai ishte shenja e lënë nga një goditje. Kjo mund t’i referohet rënies fizike (shih Mat. 24:49; 27:30) ose një metafore për të (shih 1 Kor. 8:12).

Ai u përdor për gjurmën e lënë nga goditja e një çekiçi (shih Gjoni 20:25). Kjo gjurmë mund t’i referohej imazhit fizik – një idhulli (shih Veprat e Apo. 7:43) ose një imazhi të printuar (shih Veprat e Apo. 23:25; Rom. 6:17). Nga kjo ajo u bë një simbol (shih Veprat e Apo. 7:44; Fil. 3:17; 1 Thes. 1:7; 2 Thes. 3:5; 1 Tim. 4:12; Heb. 8:5; 1 Pjet. 5:3).

Paralelizimet më të mira ndaj përdorimit të këtij termi në këtë tekst (dmth., “tipi” 1 Kor. 10:6) janë 1 Kor. 10:11 dhe Rom. 5:14, ku ai i referohet (1) një tipi të nënkuptuar; (2) një pale figurative; or (3) një shembulli simbolik. Vargjet 6 dhe 11 i kujtojnë besimtarët e Dhjatës së Re se Dhajta e Vjetër ka lidhje frymore për ta (shih Rom. 4:23-24; 15:4; 1 Kor. 9:10; 10:6,11). Zbulesat e Perëndisë janë të përjetshme dhe parimet janë relevante.

▣ **“që ne të mos dëshirojmë gjëra të liga, ashtu si dëshiruan ata”** Vini re se Pali po krahason popullin e besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër me popullin e besëlidhjes së Dhjatës së Re. Ligësia është një problem i përsëritur. Ai mund të vjedhë njerëzit nga jeta e përjetshme, nga marrëdhënia intime me Perëndinë. Ligësia korrupton çdo nivel të ekzistencës njerëzore. Shpëtimi nuk na liron nga shtrëngimi (shih Romakëve 7; Efe. 6:10-19). Kisha korintase ishte në rrezik në zona si të ortodoksisë dhe të ortopraksisë! Perëndishmëria, dhe jo informacioni, është qëllimi!

Termi “dëshirojmë” (i përdorur dy herë) reflekton fjalën e përbërë të fuqishme greke *epithumeō*, e cila përbëhet nga parashtesa “mbi” dhe “të nxitosh”. Ai i referohet një ndjenje apo emocioni të fuqishëm që të pushton dhe kontrollon mendjen dhe zemrën e një personi. Ai mund të përdoret në një kuptim pozitiv si tek Fil. 1:23, por zakonisht përdoret në një kuptim negativ (shih 2 Tim. 2:22). Pali mund të jetë duke reflektuar dëshirën e fortë dhe mosbindjen e izraelitëve të regjistruar tek Num. 11:31-35, për shkak se ai aludon ndaj Num. 25:9 tek 1 Kor. 10:8 dhe Num. 16:4-5; 17:5,10 tek 1 Kor. 10:10.

**10:7 “të mos bëheni idhujtarë”** Kjo është një formë urdhërore e mesme e tashme (deponente) me një pjesore mohuese, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që është tashmë në proces. Ky citim nga Dhajta e Vjetër i referohet orgjisë idhujtare të Eksodit 32.

Praktika e saktë idhujtare së cilës i referohet Pali në Korint është e pasigurtë. Në një mënyrë besimtarët rrezikonin të ofendonin Perëndinë. Nga kapitulli 7 dhe situata historike në Korint mund të kenë qënë praktikatat pagane seksuale të adhurimit ose nga kapitulli 8 mund të kenë qënë flijimet pagane idhujtare.

▣ **“Populli u ul që të hajë dhe të pijë, dhe u ngrit për të luajtur.”** Ky është një aludim ndaj Aronit që bëri vëçin e artë tek Eksodi 32 dhe bijve të Izraelit që festonin përpara tij dhe kryenin vepra seksuale (shih Eksod. 32:6,19).

<sup>25</sup> Versioni në shqip është “Dhe” (shënim i përkthyesit).

Aspekti seksual i termit “kërcej” shihet në të njëjtën fjalë në hebraisht të përdorur tek Zan. 26:8 për Isakun ndërsa bënte dashuri me Rebekën.

**10:8 “Dhe të mos kurvërojmë”** Kjo tregon rrethanat pagane të Korintit dhe gjithashtu tendencën e paganëve, edhe të paganëve të shpenguar, për të qënë pre e imoralitetit në emër të fesë.

■ **“ranë të vdekur në një ditë njëzet e tre mijë”** Kjo është një referencë ndaj Num. 25:1-9. Ka një mospërputhje të dukshme midis kësaj dhe tekstit në hebraisht të Num. 25:9, i cili ka njëzetë e katër mijë. Ky nuk duket të jetë një gabim kopjimi. Kjo është një mospërputhje në të gjithë dorëshkrimet greke. Ai mund të jetë një gabim kujtese nga ana e Palit. Kjo nuk do të thotë të nënkuptosh një mungesë frymëzimi ose besueshmërie, por bota antike nuk ishte aq preçize në përdorimin e tyre të numrave sikurse njerëzit perëndimorë modernë.

Në librin *Encyclopedia of Bible Difficulties* [Enciklopedia e Vështirësive të Biblës] të Archer, fq. 141, 401, ai pranon se pasazhi i Dhjatës së Vjetër të cilit i referohet Pali nuk është Num. 25:1-9, por Eksodi 32. Ai nxjerr një konkluzion të mirë teksa tek 10:7 citon nga Eksod. 32:4 dhe tek Eksodi 32:35 përmend që Zoti godet njerëzit me sa duket edhe përtej 3,000 të 1 Kor. 10:28. Kjo është sigurisht një mundësi kontekstuale e zbatueshme.

**10:9 “Dhe të mos e tundojmë Zotin”<sup>26</sup>** Ky është termi *peirazō* me parashtesën *ek*, e cila e intensifikon atë (shih Mate. 4:7; Luka 4:12; 10:25). Shih Temën e Veçantë: Termit në Greqisht për Vënie në Provë tek 1 Kor. 3:13. Kisha korintase po sillet në një mënyrë të ngjashme me izraelitët në shkretëtirë (shih Num. 21:5-6). Perëndia përdor gjykimin e përkohshëm për të korrigjuar popullin e Tij.

Termi “Zot” (shih NASB, TEV, NJB dhe NIV) gjendet në dorëshkrimet antike greke  $\alpha$ , B, C, P dhe në përkthimin armen. Ai i përshtatet më mirë aludimit të Dhjatës së Vjetër, duke iu referuar YHWH tek Numrat 21.

Termi “Krisht” (shih NKJV, NRSV) gjendet në dorëshkrimet P<sup>46</sup>, D, F, G dhe në përkthimet Vulgate dhe Peshitta. Ai i përshtatet më mirë dëgjuesve të drejtëpërdrejtë të Palit.

Ndërsa UBS<sup>4</sup> favorizon “Krisht” me një shkallëzim “B” (dmth., pothuajse të sigurtë), një argument i fortë për “Zot” bëhet nga Bart D. Ehrman tek *The Orthodox Corruption of Scripture* [Korruptimi Ortodoks i Shkrimeve], fq. 89-90. Shih TEMË E VEÇANTË: TERMAT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE (Special Topic: Greek Terms for "Testing" and Their Connotations) tek 1 Kor. 3:13.

■ **“u vranë nga gjarpërinjtë”** Kjo është një referencë ndaj Num. 21. Shih TEMË E VEÇANTË: SHKATËRRIMI (APOLLUMI) [Special Topic: Apollumi] tek 1 Kor. 8:11.

**10:10 “Dhe mos u ankoni, ashtu si u ankuan disa nga ata”** Fraza e parë është një formë urdhërore aktive e tashme me një pjesë mohore, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim në proces. Kjo i referohet Num. 16:41-50, ndaj të cilës referohet tek Num. 17:5,10. Kisha korintase po ankohej ashtu sikurse bënte Izraeli dikur.

■ **“shkatërruesi”** Kjo aludon ndaj plagës tek Num. 16:49. Ishte një mënyrë teologjike për të treguar se vdekja ishte në duart e YHWH (shih Eksod. 12:23,29; 2 Sam. 24:16; 1 Kro. 21:15; Heb. 11:28). Nuk ka asnjë “korrës të zymtë”! Nuk ka asnjë shans apo fat! Është Zoti, Zoti i Izraelit, Ati i Zotit Jezus Krisht. Ai dhe vetëm ai ka nën kontroll jetën dhe vdekjen!

**10:11 “atyre”** Kjo i referohet popullit në Dhjatën e Vjetër i cili vdiq në duart e shkatërruesit.

■ **“shëmbull”** Shih shënimin tek 1 Kor. 10:6. Shih TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJET E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT (SPECIAL TOPIC: PAUL'S VIEWS OF THE MOSAIC LAW) tek 1 Kor. 9:9.

■ **“jemi në mbarim të epokës”** Kjo është një formë treguese aktive e përkryer. Ajo është një metaforë për epokën e re të profetizuar (frazë e ngjashme tek Heb. 9:26). Besimtarët në Mbretërinë e Perëndisë, të inaguruar në ardhjen e parë të Jezusit, për t’u konsumuar me Ardhjen e Tij të Dytë. Ne jetojmë në tensionin e “ka ardhur tashmë por ende jo”!

Shih TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA E ARDHSHME (SPECIAL TOPIC: THIS AGE AND THE AGE TO COME) tek 1 Kor. 1:20.

<sup>26</sup> Versioni në shqip është: “Krishtin” (shënim i përkthyesit).

**10:12** “ai që mendon se qëndron më këmbë, le të shohë se mos bjerë” Vetë-siguria dhe krenaria arrogante e grupeve të përçara korintase ishin një problem madhor, sikurse është i njëjti qëndrim sot (shih Rom. 11:20; 2 Pjet. 3:17). Perëndia ka gjykuar dhe do të gjykojë njerëzit e Tij (shih Jer. 25:29; 1 Pjet. 4:17). Vetë-mashtrimi është një mallkim i njerëzve fetarë! Ata që janë në Krishtin duhet të vazhdojnë të bëjnë kujdes (shih 1 Kor. 9:24-27)!

**10:13** “tundim” Kjo fjalë përdoret tre herë në këtë varg dhe do të thotë të tundosh me një kuptim drejt shkatërrimit (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13). Ka tre burime tundimi në Dhjatën e Re:

1. Natyra mëkatore e njerëzimit të rënë
2. I ligu personal (dmth., Satani dhe demonët)
3. Sistemi botëror i rënë (shih Efe. 2:1-3; Jakobi 4:1,4,7)

**NASB** “por siç është e zakonit për njeriun”  
**NKJV** “përveç asaj që është e zakonit për njeriun”  
**NRSV** “që nuk është i zakonit për këdo”  
**TEV** “lloji që normalisht iu vjen njerëzve”  
**NJB** “asnjë... që nuk është më shumë nga ç’mund të mbajë një qenie njerëzore”

Njerëz të tjerë janë përballur me tundim të ngjashëm sikurse besimtarët korintas. Jezusi gjithashtu kishte përjetuar dhe tejkaluar të gjithë tundimin që është i zakonit për qeniet njerëzore (shih Heb. 4:15).

▣ **“Perëndia është besnik”** Ky është një pohim kaq thelbësor përshkrues! Besimi biblik qëndron mbi karakterin e Perëndisë. Shpresa jonë është karakteri i Tij i hirshëm, premtimet e Tij të sigurta dhe veprimet e Tij shpenguese. Ky aspekt i karakterit të Perëndisë pohohet fillimisht tek Ligji i Përt. 7:9, që është një përforcim i Ligjit të Përt. 5:9-10. Drejtësia e Perëndisë lëviz përmes kohës në tre dhe katër breza, por dashamirësia e Tij (dmth., dashuria e tij besnike e besëlidhjes, *hesed*) zgjat në njëmijë breza. Po i njëjti pohim vazhdohet tek Isa. 49:7. Kjo është një temë kryesore tek letrat korintase (shih 1 Kor. 1:9; 10:13; 2 Kor. 1:18, ashtu sikurse tek 1 Thes. 5:24 dhe 2 Thes. 3:3). Besimtarët duhet t’i besojnë besnikërisë së Perëndisë; duhet t’i besojnë besueshmërisë së Perëndisë. Ky është thelbi i besimit biblik!

**NASB** “por me tundimin do t’ju japë dhe rrugë dalje, që ju të mund ta përballonit”  
**NKJV** “por me tundimin do të bëjë gjithashtu një rrugëdalje, që ju të mund ta duroni”  
**NRSV** “por me testimin ai gjithashtu do të sigurojë një rrugë largimi që ju të mund ta përballonit”  
**TEV** “në kohën kur ju sfidoheni, ai do t’ju japë forcë ta përballonit dhe do t’ju sigurojë një rrugë dalje”  
**NJB** “me çdo tundim, ai gjithashtu do të prodhojë një rrugë dalje duke siguruar që ju të kaloni”

Kjo fjalë greke përdoret si një mënyrë për t’u larguar për një njësi ushtarake të zënë në kurth. Besimtarët nuk përballen vetëm me tundimet!

Problemi në këtë tekst është se si bëhet lidhja e “sigurojë një rrugëdalje” me “që ju të mund ta përballonit”. A iu jepet disave një rrugëdalje dhe të tjerët duhet ta përballojnë apo është rrugëdalja e Perëndisë një mënyrë për të përballuar? A ndalon sprovimi apo besimtarët veprojnë gjatë sprovimit me besim? Edhe pse kjo paqartësi nuk mund të sqarohet, lajmi i mirë është se Perëndia është me ne në problemet (shih Psa. 23:4). Perëndia nuk do të na lërë dhe nuk do të na braktisë. Mekanizmi i saktë i fitores nuk zbulohet qartazi, por fitorja është e sigurtë!

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 10:14-22

<sup>14</sup> Prandaj, të dashurit e mi, largohuni nga idhujtaria. <sup>15</sup> Po ju flas si të mënçur, gjykojeni ju atë që them: <sup>16</sup> kupa e bekimit, që ne bekojmë, a nuk është vallë pjesëmarrje në gjakun e Krishtit? Buka që ne thyejmë, a nuk është vallë pjesëmarrje në trupin e Krishtit? <sup>17</sup> Sepse ne të shumtë, jemi një bukë, një trup, sepse të gjithë marrim pjesë në të vetmen bukë. <sup>18</sup> Shikoni Izraelin sipas mishit: ata që hanë flijimet a nuk janë pjesëmarrës të altarit? <sup>19</sup> Çfarë them, pra? Se idhulli është diçka? Apo se ajo që u është flijuar idhujve është diçka? <sup>20</sup> Jo, por them se gjërat që flijojnë johebrenjtë, ua flijojnë demonëve dhe jo Perëndisë; tani

**unë nuk dua që ju të keni pjesë me demonët.<sup>21</sup> Ju nuk mund të pini kupën e Zotit dhe kupën e demonëve; ju nuk mund të merrni pjesë në tryezën e Zotit dhe në tryezën e demonëve.<sup>22</sup> A duam ne të provokojmë Zotin deri në xhelozë? A jemi ne më të fortë se ai?**

**10:14 “Prandaj”** Pali po përmbyll diskutimin e mëparshëm dhe po lëviz drejt një konkluzioni.

NASB, NKJV “të dashurit e mi”  
NRSV, TEV, NJB “miqtë e mi të dashur”

Letrat korintase të Palit (dhe letra galatase) janë fjalët e tij më të ashpra ndaj kishave. Prandaj, ai dëshiron që t’i rikujtojë atyre se sa të çmuar ata janë për të edhe pse ai po ju flet kaq ashpër atyre (shih 1 Kor. 4:14; 10:14; 15:58; 2 Kor. 7:1; 12:19).

Ky term u përdor nga Perëndia At i Jezusit (shih Mate. 3:17; 12:18; 17:5). Pali, Pjetri, Juda dhe Gjoni, në letrat e tyre, përdorin këtë mbiemër për të përcaktuar ndjekësit e Jezusit. Ata janë të dashur për shkak të marrëdhënies së tyre me Krishtin; të dashur nga Perëndia, nga Krishti dhe nga shkrimtarët e letrave të Dhjatës së Re.

■ **“largohuni nga idhujtaria”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Vini re “idhujtari” ka një shuar. Perëndia siguron një rrugë, por besimtarët duhet të zgjedhin të përfitojnë prej saj (shih 1 Kor. 6:18). Një mënyrë për të përballuar tundimin është që të largohesh nga prania e tij. Besimtarët nuk duhet ta vendosin veten e tyre në një zonë të tundimit.

“Idhujtaria” në Dhjatën e Vjetër ishte imazhi dhe adhurimi i perëndive pagane. Në kohën tonë, ajo është çdo gjë që zëvendëson Perëndinë në strukturën tonë të prioriteteve (shih 1 Kor. 10:7,14). Sikurse Jezusi tha, aty ku është thesari yt, aty do të jetë zemra jote (shih Mate. 6:21). Modernët zbulojnë prioritetet e tyre me anë të kohës, parave dhe përmes jetës. Feja zakonisht është shpesh një shtojcë e rëndësishme, por jo prioriteti thelbësor. Besimi i vërtetë nuk merret me teprinë, por me thelbin e jetës. Libri i parë i Gjonit mbyllet me “ruani veten tuaj nga idhujt” (shih 1 Gjonit 5:21).

**10:15** Kjo tregon përjashtjen e Palit ndaj drejtimit. Ai ishte një Apostull i Krishtit, por ai i paralajmëron këta besimtarë krenarë për të gjykuar fjalët e tij për veten e tyre (shih 1 Kor. 14:39-40). Sigurisht është e mundur që Pali të jetë duke u treguar sarkastik. Ai përdor po të njëjtën fjalë (dmth., i mënçur) tek 1 Kor. 4:10 dhe 2 Kor. 11:19 në një kuptim sarkastik.

**10:16** Ky varg ndërtohet si dy pyetje retorike (edhe pse TEV e përkthen atë si pohime treguese).

■ **“kupa e bekimit”** Kjo ndoshta i referohet kupës së tretë në shërbimin e Pashkës hebraike. Ajo ishte ajo që Jezusi përdori për të inaguruar Darkën e Zotit. Termi “bekim” është *eulogia* nga folja *eulogeō*, që do të thotë “të adhurosh”, “të përlevdosh”, “të bekosh” ose “të përfitosh”. Shih shënimin tek 2 Kor. 9:5. Nga kjo rrënjë greke marrim termin eulogji. Kur Jezusi ushtroi këtë urdhër ai mori si kupën edhe bukën dhe falenderoi Perëndinë. Termi grek për falenderim është *eucharistia*, fjalë nga e cila marrim termin Eukarist. Të dy këta terma grekë përdoren në një mënyrë sinonime tek 1 Kor. 14:16. Është interesante, por jo teologjikisht e rëndësishme, që rregulli normal i kupës dhe bukës (shih 1 Kor. 11:24-27) këtu është i anasjelltë. Nuk është rregulli çështja, por marrëdhënia me Krishtin në vaktin e Tij të përbashkët në krahasim me marrëdhënien me zotët paganë në vaktet e tyre kolektive.

**TEMË E VEÇANTË: RENDI I SHËRBESËS SË PASHKËS NË JUDAIZMIN E SHEKULLIT TË PARË [SPECIAL TOPIC: PASSOVER (ORDER OF SERVICE)]**

- A. Lutja
- B. Kupa e verës
- C. I zoti i shtëpisë lan duart dhe ua kalon legenin të gjithëve
- D. Ngjyerja e bukës në një salcë me bimë të hidhura
- E. Qengji dhe vakti kryesor

- F. Lutja dhe ngjyerja e dytë e bukës në salcën me bimë të hidhura
- G. Kupa e dytë e verës me një kohë “pyetje-përgjigje” për fëmijët (shih Eks. 12:26-27)
- H. Këndimi i Psalmeve “Halel” 113-114 dhe lutja
- I. Kryesuesi i ceremonisë ngjyen nga një kafshatë për secilin pjesëmarrës pasi lan duart
- J. Të gjithë hanë derisa ngopen; e përfundojnë me një copë mishi nga qengji
- K. Kupa e tretë e verës pas larjes së duarve
- L. Këndimi i Psalmeve “Halel” 115-118
- M. Kupa e katërt e verës, që nënkuptonte ardhjen e Mbretërisë

Shumë besojnë se inaugurimi i Darkës së Zotit ndodhi në pikën “K”.

▣ **“pjesëmarrje”** Kjo është fjala greke *koinonia*, e cila do të thotë “pjesëmarrje e përbashkët me”. Kjo është origjina e fjalës “komunion / kungim”, e përdorur për vaktin simbolik eukaristik, i cili thekson marrëdhënie tani, por një marrëdhënie më intime në të ardhmen. Shih Temën e Veçantë: *Koinonia* (Special Topic: *Koinonia*) tek 1 Kor. 1:9.

▣ **“në gjakun e Krishtit”** Ky është një theks mbi vdekjen e Krishtit dhe kontekstin e tij sakrifikues të Dhjatës së Vjetër (shih Levitiku 1-7). Gjaku simbolizonte jetën (shih Lev. 17:11,14).

▣ **“Buka që ne thyejmë”** Ky është burimi i frazës që ne përdorim për Darkën e Zotit “thyerja e bukës” (shih Veprat e Apo. 2:42). Ky ishte një simbol që Jezusi zgjodhi për të përfaqësuar Besëlidhjen e Re në trupin e Tij të thyer në kryq. Ai qëllimisht nuk zgjodhi Qengjin e Pashkës, i cili ishte një simbol i përjetesës së besëlidhjes së vjetër (shih Eksod. 12).

▣ **“pjesëmarrje në trupin e Krishtit”** Simboli i “trupit të Krishtit” është i dyfishtë: (1) trupi i Tij fizik u flijua për mëkatën njerëzore dhe (2) ndjekësit e Tij u bënë trupi i Tij frymor, kisha (e cila gjithashtu ka dy aspekte tek 1 Korintasve: [a] kisha lokale dhe [b] kisha universale).

**10:17** Ky është një theks mbi unitetin e Krishtit dhe kishës së Tij të shprehur në simbolizmin e Darkës së Zotit (dmth., një bukë). I njëjti unitet i trupit të Krishtit është tek 1 Kor. 12:12-13 në lidhje me dhuntitë frymore.

**10:18 “kombin e Izraelit”<sup>27</sup>** Kjo është fjalë për fjalë “Izraelin sipas mishit” (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26). Kjo është një mënyrë tjetër simbolike (dmth., aludim historik) për të treguar unitetin e atyre që marrin pjesë në Darkën e Zotit.

**10:19 “Çfarë them, pra?”** Shkrimet e Palit janë disa nga tekstet më të thjeshta biblike për t’u interpretuar për shkak se ai e zhvillon mendimin e tij në mënyrë logjike. Shenjat logjike si për shëmbull kjo frazë lejojnë interpretuesit modernë të skicojnë mendimet e Palit në nivel paragrafi, që është kyç për interpretimin e librave të tij.

Pali zhvillon mendimin e tij përmes këtij konteksti me një seri pyetjesh retorike (shih NASB, 1 Kor. 10:16 (dy); 1 Kor. 10:18 (një); 1 Kor. 10:19 (dy ose tre); 1 Kor. 10:22 (dy); 1 Kor. 10:29 (një); 1 Kor. 10:30 (një)).

▣ **“Se idhulli është diçka?”** Si një shëmbull i mënyrës se si skribët antikë joqëllimisht ndryshonin tekstet që ata po kopjonin, kjo frazë është lënë aksidentalisht jashtë në dorëshkrimet shumë të hershme antike greke (dmth., P<sup>46</sup>, s\*, A dhe C). Për një diskutim të mëtejshëm të Kriticizmit Tekstual shih Shtojcën Dy.

**10:20 “flijojnë demonëve”** Pali, duke u kthyer tek Dhjata e Vjetër, kuptoi idhujtarinë si të lidhur, jo me realitetin e imazheve, por me realitetin e forcave frymore në krijimin fizik (shih Lev. 16:8; 12:7; Ligji i Përt. 32:17; Psa. 96:5; 106:37; Isa. 65:11; Zbu. 9:20; 16:14). Pas gjithë veprimtarisë njerëzore është realiteti frymor (shih Ligji i Përt. 32:8 [LXX]; Daniel 10; Efe. 6:10-18). Edhe pse nuk thuhet kurrë specifikisht se engjëjt e rënë të Dhjatës së Vjetër janë demonët në Dhjatën e Re, Pali iu referohet këtyre forcave frymore të rëna me terma të tjerë tek Rom.

<sup>27</sup> Versioni në shqip është: “Izraelin sipas mishit” (shënim i përkthyesit).



### TEMË E VEÇANTË: ENGJËJ DHE DEMONË (SPECIAL TOPIC: ANGELS AND DEMONS)

- A. Popujt e lashtë ishin animistë. Ata u vishnin personalitet njerëzor forcave të natyrës, kafshëve dhe objekteve natyrore. Jeta shpjegohej përmes ndërveprimit të këtyre qenieve shpirtërore me njerëzimin.
- B. Ky personifikim u shndërrua në politeizëm (shumë perëndi). Zakonisht, demonët (*genii*) ishin perëndi më të ulëta ose gjysmëperëndi (të mirë ose të këqinj) që ndikonin në jetën e njeriut si individ.
1. Mesopotami, kaos dhe konflikt
  2. Egjipt, rend dhe funksion
  3. Kanaan, shih W. F. Albright, *Archaeology and the Religion of Israel* [Arkeologjia dhe feja e Izraelit], botimi i pestë, fq. 67-92
- C. Dhjata e Vjetër nuk flet shumë (dhe as zhvillon) për temën e perëndive më të ulëta, engjëjve, ose demonëve, ndoshta për shkak të monoteizmit të saj të rreptë (shih Temë e Veçantë: Monoteizëm / Special Topic: Monotheism, shih Eksod. 8:10; 9:14; 15:11; Ligji i Përt. 4:35,39; 6:4; 33:26; Psa. 35:10; 71:19; 86:8; Isa. 46:9; Jer. 10:6-7; Mik. 7:18). Gjithsesi, ajo përmend perënditë e rreme të kombeve pagane (*Shedim*, shih Ligji i Përt. 32:17; Psa. 106:37), madje jep dhe emra për disa prej tyre.
1. *Se'im* (satirët ose demonët leshatakë, BDB 972 III, KB 1341 III, shih Lev. 17:7; 2 Kro. 11:15; Isa. 13:21; 34:14)
  2. *Lilith* (demon femër, ose joshës të natës, BDB 539, KB 528, shih Isa. 34:14)
  3. *Mavet* (fjalë hebraisht për vdekjen, që përdorej për perëndinë kanaanite të nënbotës, *Mot*, BDB 560, KB560, shih Isa. 28:15, 18; Jer. 9:21; dhe ndoshta Ligji i Përt. 28:22)
  4. *Resheph* (fatkeqësi, zjarr ose breshër, BDB 958, KB 958, shih Ligji i Përt. 32:24; Psa. 78:48; Hab. 3:5)
  5. *Dever* (murtajë, BDB 184, shih Psa. 91:5-6; Hab. 3:5)
  6. *Az'azel* (emri i pasigurtë, por, ndoshta, demon shkretëtire ose emër vendi, shih Lev. 16:8, 10, 26) (Këta shembuj janë marrë nga *Encyclopaedia Judaica*, vëll. 5, fq. 1523.)
- Gjithsesi nuk ka dualizëm apo pavarësi engjëjlore nga YHWH në Dhjatën e Vjetër. Satani është shërbëtor i YHWH-së (shih Jobi 1-2; Zakaria 3), jo një armik i pavarur, që e drejton vetë veten (shih A. B. Davidson, *A Theology of the Old Testament* [Teologji e Dhiatës së Vjetër], fq. 300-306).
- D. Judaizmi u zhvillua gjatë robërisë babilonase (586-538 para Krishtit). Teologjikisht, u ndikua nga dualizmi i personifikuar persian i zoroastrianizmit, me një perëndi të mirë e të lartë, të quajtur *Mazda* ose *Ormazd*, dhe një kundërshtar të lig, të quajtur *Ahriman*. Kjo lejoi brenda judaizmit të pasrobërisë dualizmin e personifikuar mes YHWH-së e engjëjve të Tij dhe Satanit e engjëjve (ose demonëve) të tij.
- Teologjia e ligësisë së personifikuar në judaizëm shpjegohet dhe dokumentohet më së miri nga Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah* [Jeta dhe koha e Jezus Mesisë], vëll. 2, shtojca XIII (fq. 749-863) dhe XVI (fq. 770-776). Judaizmi e personifikonte ligësinë në tre mënyra.
1. Satani, ose *Sammael*
  2. Synimi i lig (*yetzer hara*) brenda njerëzimit.
  3. Engjëlli i Vdekjes
- Edersheim i karakterizon këta si
1. Akuzuesi;
  2. Tunduesi;
  3. Ndëshkuesi (vëll. 2, fq. 756).
- Ka një dallim të madh teologjik mes judaizmit pas robërisë dhe prezantimit e shpjegimit që i

bën Dhjata e Re ligësisë.

- E. Dhjata e Re, veçanërisht në ungjijtë, pohon ekzistencën dhe kundërshtimin e qenieve të këqija shpirtërore ndaj njerëzimit dhe YHWH-së (në judaizëm, Satani ishte armik i njerëzimit, por jo i Perëndisë). Ata i kundërvihen vullnetit, sundimit dhe mbretërisë së Perëndisë.

Jezusi i kundërshtoi dhe i dëboi nga njerëzit këto qenie demoniake, të quajtura edhe (1) frymë të papastra (shih Luka 4:36; 6:18), ose (2) frymë të liga (shih Luka 7:21; 8:2). Jezusi bëri qartazi dallimin mes sëmundjes (fizike dhe mendore) dhe pushtimit demoniak. Ai e demonstroi fuqinë dhe njohurinë e vet shpirtërore duke dalluar dhe dëbuar këto frymë të liga. Shpesh, ata e njihnin dhe përpiqeshin t'i drejtoheshin Atij, por Jezusi ua hidhte poshtë dëshminë e tyre, kërkonte që të heshtnin dhe i dëbonte. Dëbimet janë shenjë e disfatës së mbretërisë së Satanit.

Ka një mungesë të habitshme informacioni në letrat apostolike të Dhjatës së Re për këtë temë. Dëbimi i demonëve nuk renditet kurrë si dhunti shpirtërore, dhe as nuk na jepet një metodologji apo procedurë për brezat e ardhshëm të predikuesve ose besimtarëve.

- F. Ligësia është reale; ligësia është personale; ligësia është e pranishme. As origjina, as synimi i saj nuk na zbulohen. Bibla pohon realitetin e saj dhe kundërshton me forcë ndikimin e saj. Nuk ka dualizëm përfundimtar në të. Perëndia ka plotësisht situatën nën kontroll; ligësia mposhtet, gjykohet dhe do të shfaroset nga njerëzimi.
- G. Populli i Perëndisë duhet ta kundërshtojë ligësinë (shih Jakobi 4;7). Ata nuk mund të kontrollohen prej saj (shih 1 Gjonit 5:18), por mund të tundohen dhe kjo mund t'u dëmtojë dëshminë dhe ndikimin (shih Efe. 6:10-18). Ligësia është pjesë e zbuluar e pikëpamjes së të krishterit. Të krishterët e sotëm nuk kanë të drejtën të ripërcaktojnë ligësinë (çmitologjizimi i Rudolf Bultmann), të çpersonalizojnë ligësinë (strukturat shoqërore të Paul Tillich), apo të përpiqen ta shpjegojnë plotësisht me terma psikologjikë (Zigmund Frojd). Ndikimi i ligësisë është i gjerë, por ajo është mposhtur. Besimtarët duhet të ecin në fitoren e Krishtit!

▣ **“të keni pjesë me demonët”** Ndiqni analogjinë e Palit. Të krishterët janë një me trupin e Krishtit (dmth., kishën) sepse ata janë një me flijimin e Tij (dmth., trupi i Tij i kryqëzuar në Kalvar) sepse ata ndajnë në bukën e Darkës së Zotit që simbolizonte trupin e Tij të thyer. Prandaj, paganët që ndajnë në ngrënien e mishit të flijuar një idhulli jo-ekzistent marrin pjesë në idhujtari frymore të lidhur me demonët pas feve botërore. Ndërsa besimtarët kanë pjesë në ndodhitë historike të jetës së Jezusit me anë të ritualeve (dmth., Romakëve 6), po kështu edhe jobesimtarët kanë pjesë me demonët.

**10:21** Kjo frazë i referohet flijimeve pagane dhe ritualeve në tempujt paganë të Korintit. Një besimtar nuk mund të pranojë ekskluzivitetin e Krishtërit (dmth., një dhe vetëm një Perëndi i vërtetë dhe Jezusi Mesia i Tij) dhe prapëseprapë të marrë pjesë frymërisht në adhurimin pagan. Nëse ata e bëjnë, është idhujtari frymore!

**10:22 “të provokojmë Zotin deri në xheloz”** Kjo duket se është një aludim ndaj Ligji i Përt. 4:25; 32:16,21; Psa. 78:58; ose Isa. 65:3. Termi Zot tek 1 Kor. 10:21 dukshëm i referohet Jezusit, por tek 1 Kor. 10:22 tek YHWH. Ky lloj transferimi është një nga mënyrat që autorët e Dhjatës së Re pranojnë hyjësinë e Jezusit të Nazaretit.

Termi “xheloz” është një fjalë e fuqishme dashurie. Dikush është xheloz vetëm për dikë që ai do. YHWH është emocionalisht i përfshirë me popullin e Tij, i cili reflekton karakterin e Tij dhe përçon emrin e Tij në botë. Idhujtaria shkatërron këtë marrëdhënie dhe qëllimin ungjiltar.

▣ **“Ne nuk jemi më të fortë se Ai, apo jo?”<sup>28</sup>** Forma gramatikore pret “jo” si përgjigje. Kjo terminologji nënkupton se i referohet dy grupeve të ndryshme të krishterësh: vëllai i dobët tek 1 Kor. 10:14-21 dhe vëllai më i fortë tek 1 Kor. 10:23-33. Vargu 22 tregon vështirësinë e përpjekjes për t'u marrë me mendjen e këtyre dy grupeve të besimtarëve (shih Rom. 14:1-15:13). Pali po përpiket të ecë në një litar të lartë teologjik midis dy filozofive / pikëpamjeve të krishtera (dmth., liria nga dhe skllavëria ndaj përjetesave të shkuara).

<sup>28</sup> Versioni në shqip është: “A jemi ne më të fortë se ai?” (shënim i përkthyesit).

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 10:23-30

<sup>23</sup> Gjithçka më lejohet, por jo gjithçka është dobishme; gjithçka më lejohet, por jo çdo gjë ndërton.

<sup>24</sup> Askush të mos kërkojë interesin e vet, por atë të tjetrit. <sup>25</sup> Hani çdo gjë që shitet te kasapi, pa bërë pyetje për shkak të ndërgjegjes, <sup>26</sup> sepse “toka është e Zotit dhe gjithçka që ajo përmban.” <sup>27</sup> Dhe në qoftë se ndonjë jobesimtar ju fton dhe ju doni të shkoni, hani çdo gjë që t’u vihet përpara, pa bërë pyetje për shkak të ndërgjegjes. <sup>28</sup> Por në qoftë se dikush ju thotë: “Kjo është nga flijim idhujsh,” mos hani, për atë që ju paralajmëroi dhe për shkak të ndërgjegjes, sepse “toka është e Zotit dhe gjithçka që ajo përmban.” <sup>29</sup> Dhe them ndërgjegje, por jo tënden, por të tjetrit. Sepse përse të gjykohet liria ime nga ndërgjegja e një tjetri? <sup>30</sup> Në qoftë se unë marr pjesë me falenderim, pse të shahem për atë gjë, për të cilin falenderoj?

**10:23** Ky është një rikthim tek tema e nisur në kapitullin 6:12 mbi mënyrën se si duhet ekuilibruar liria dhe përgjegjshmëria e krishterë (shih Rom. 14:19). Vargjet 23-33 i drejtohen vëllait më të fortë.

▣ **“Gjithçka më lejohet”** Kjo frazë përsëritet dy herë. Disa përkthime e vendosin këtë frazë në thonjëza (shih NRSV, TEV, NJB) për shkak se mendojnë se ishte një slogan i një prej grupeve të përcara në Korint ose një proverbë kulturore. Kjo është pikëpamja e emancipuar e të krishterit “të fortë” (shih 1 Kor. 6:12; 10:26; Rom. 14:14,20).

### TEMË E VEÇANTË: LIRIA E KRISHTERË PËRKUNDREJT PËRGJEGJËSISË SË KRISHTERË (SPECIAL TOPIC: CHRISTIAN FREEDOM VS. CHRISTIAN RESPONSIBILITY)

- A. Romakëve 14:1-15:13 përpiket të ekuilibrojë paradoksin e lirisë dhe përgjegjesisë së krishterë. Njësia letrare nis nga Rom. 14:1-15:13.
- B. Problemi i cili u përshkallëzua në këtë kapitull ishte ndoshta tensioni midis besimtarëve johebrenj dhe hebrenj në kishën e Romës. Përpara konvertimit, hebrenjtë prireshin të ishin legalistë dhe paganët prireshin të ishin të shturur. Kujtoni, kjo i drejtohet ndjekësve të sinqertë të Jezusit. Ky kapitull nuk iu drejtohet besimtarëve mishorë. Qëllimi më i lartë iu vendoset të dy grupeve. Gjendet një rrezik në ekstremet në të dy anët. Ky diskutim nuk është një liçencë për legalizmin që kapet pas çdo gjëje apo për lirinë valëvitëse.
- C. Besimtarët duhet të bëjnë kujdes që të mos e bëjnë teologjinë apo etikën e tyre standartin për të gjithë besimtarët e tjerë (shih 2 Kor. 10:12). Besimtarët duhet të ecin në dritën që ata kanë por duhet të kuptojnë se teologjia e tyre nuk është automatikisht teologjia e Perëndisë. Besimtarët ende ndikohen nga mëkati. Ne duhet të inkurajojmë, nxisim dhe mësojmë njëri-tjetrin nga Shkrimet, arsyeja dhe përjetesa, por gjithmonë në dashuri. Sa më shumë që dikush di, aq më shumë ai / ajo nuk di (shih 1 Kor. 13:12)!
- D. Qëndrimi dhe motivet e dikujt përpara Perëndisë janë çelësi i vërtetë për vlerësimin e veprimeve të një vëllai / motre të krishterë. Të krishterët do të qëndrojnë përpara Krishtit për t’u gjykuar mbi mënyrën se si ata trajtojnë njëri-tjetrin (shih Veprat e Apo. 15:10,12 dhe 2 Kor. 5:10).
- E. Martin Luteri tha: “Një njeri i krishterë është më i liri zot i të gjithëve, subjekt ndaj askujt; një njeri i krishterë është shërbëtori më i madh i të gjithëve, subjekt ndaj të gjithëve.” E vërteta biblike shpesh prezantohet në një paradoks të mbushur me tension (shih Temën e Veçantë: Paradoks në Shkrime).
- F. Kjo temë e vështirë por thelbësore trajtohet në të gjithë njësinë letrare të Romakëve 14:1-15:13 dhe gjithashtu tek 1 Korintasve 8-10 dhe Kolosianëve 2:8-23.
- G. Megjithatë, duhet të theksohet se pluralizmi mes besimtarëve të sinqertë nuk është diçka e keqe. Çdo besimtar ka pika të forta dhe të dobëta. Secili duhet të ecë në dritën që ai / ajo ka, gjithmonë i hapur ndaj Frymës dhe Biblës për më shumë dritë. Në këtë periudhë të shikimit përmes një xhami të turbullt (1 Kor. 13:8-13) duhet të ecim në dashuri (Veprat e Apo. 15:15), dhe paqe (Veprat e Apo. 15:17-19) për ndërtim të përbashkët. Dallimet tona si besimtarë janë dera e hapur e Perëndisë për besimtarë të ndryshëm që të gjejnë faljen dhe restaurimin në Krishtin. Pluralizmi i krishterë, brenda kufijve biblikë, është diçka e mirë për ungjillizim!

H. Titujt “më i fortë” dhe “më i dobët” që Pali iu jep këtyre grupeve i paragjykon ata për ne. Ky sigurisht nuk ishte qëllimi i Palit. Të dy grupet ishin besimtarë të singertë. Ne nuk duhet të përpiqemi të formojmë të krishterë të tjerë sipas vetes sonë! Ne e pranojmë njëri-tjetrin në Krishtin!

I. I gjithë argumenti mund të skicohet si më poshtë

1. Pranoni njëri-tjetrin sepse Perëndia na pranon ne në Krishtin (Rom. 15:14:1,3; 15:7)
2. Mos e gjykoni njëri-tjetrin për shkak se Krishti është Mjeshtri dhe Gjykuesi ynë i vetëm (Rom. 14:3-12)
3. Dashuria është më e rëndësishme se liria personale (shih Rom. 14:13-23)
4. Ndiqni shembullin e Krishtit dhe lerini poshtë liritë tuaja për ndërtimin dhe të mirën e të tjerëve (shih Rom. 15:1-13)

■ **“por jo çdo gjë ndërton”** Sprova praktike, frymore është: “A e ndërton trupin (dmth., komunitetin besimtar)?” (shih 1 Kor. 6:12; 14:3-4,26; 2 Kor. 12:19; Rom. 14:19; 15:2). Ky duhet të jetë testi në gjithçka që besimtarët bëjnë ose thonë. Liria e dikujt në Krishtin nuk duhet të lëndojë dikë tjetër për të cilin Krishti vdiq (shih Rom. 14:15).

Një fjalë personale, kjo nuk nënkupton se jeta frymore duhet të pluskojë në nivelin më të ulët të besimtarit më të dobët, por se besimtarët e pjekur nuk duhet të valëvisin lirinë e tyre në kurriz të vëllezërve besimtarë. Disa besimtarë janë dogmatikë, legalistë si farisenjtë. Unë nuk duhet t’iu nënshtrohem rregullave të tyre, por unë duhet t’i dua ata, duhet të lutem për ta, t’i pranoj ata plotësisht dhe jo t’i turpëroj ata në publik apo të valëvis lirinë time. Unë jam i përgjegjshëm frymërisht për vëllezërit e mi besimtarë! Shih Temën e Veçantë: Ndërtoj (SPECIAL TOPIC: EDIFY) tek 1 Kor. 8:1.

**10:24 “Askush të mos kërkojë të mirën<sup>29</sup> e vet, por atë të tjetrit”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Krishtërimi i pjekur e vendos mirëqënien e të tjerëve në parafront (shih 1 Kor. 10:33; 12:7; 13:5; Rom. 14:7; 15:2; Fil. 2:1-5,21).

**10:25, 27** Ky është zëri i besimit të emancipuar. Por besimi “i fortë” publik shpie në besim “të dobët” (shih 1 Kor. 10:28-29).

**10:25 “ndërgjegjes”** Nuk ka një term të ngjashëm në Dhjatën e Vjetër me termin grek “ndërgjegje” përveç termit hebraik “gji” që nënkupton një njohuri të vetvetes dhe motiveve të saj. Fillimisht termi grek të cilit i referohet lidhet me pesë shqisat. Ai u përdor për shqisat e brendshëm (shih Rom. 2:15). Pali e përdor këtë term dy herë në sfidat e tij tek Veprat e Apostujve (dmth., 23:1 and 24:16). Ai i referohet shqisës së tij që ai, në dijeninë e tij, nuk kishte thyer ndonjë nga detyrat fetare ndaj Perëndisë (shih 1 Kor. 4:4).

Ndërgjegja është i kuptuari që zhvillohet tek qëllimet dhe veprimet e besimtarëve të bazuara në (1) një pikëpamje biblike; (2) Frymën që banon; dhe (3) një njohuri të stilit të jetesës të bazuar në fjalën e Perëndisë. Një ndërgjegje e krishterë mundësohet nga pranimi personal i ungjillit. Shih shënimin më të plotë tek 1 Kor. 8:7.

**10:26 “sepse ‘toka është e Zotit dhe gjithçka që ajo përmban.’”** Ky është një pohim i mirësisë së gjithçkaje të krijuar (shih 1 Kor. 6:12; 10:26; Rom. 14:14,20), e marrë nga një kombinim i Psa. 24:1 dhe 50:12, i cili u përdor nga hebrenjtë e Dhjatës së Vjetër si një bekim në vakte.

Textus Receptus përsërit 1 Kor. 10:26 në fund të 1 Kor. 10:28. Ky nuk është origjinali. Ai mungon në dorëshkrimet greke  $\alpha$ , A, B, C, D, F, G, H\* dhe P, dhe gjithashtu nuk përfshihet tek përkthimet Vulgate, Syriac apo Coptic.

**10:27** Ky varg është thelbësor në dallimin midis pjesëmarrjes në festat publike idhujtare përkundërt socializimit ditor të zakonit me jobesimtarët. Pali nuk ka rregulla të vështira dhe të shpejta. Ai prioritetizojë marrëdhëniet

<sup>29</sup> Versioni në shqip është: “interesin” (shënim i përkthyesit).

personale (dmth., ungjillizimin dhe dishepullizimin). Njerëzit janë prioritet. Njerëzit janë të përjetshëm. Njerëzit janë qëllimi i vdekjes së Krishtit, jo ushqimi! Vargjet 29-33 na tregojnë përmbledhjen e Palit mbi këtë çështje.

**10:27, 30 “në qoftë se”** Të dy këto forma janë fjali kushtore të rendit të parë, të cilat supozohen të jenë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

**10:28 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila do të thotë veprim i mundshëm.

▣ **“mos hani”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme me një nyjë mohuese e cila zakonisht do të thotë të ndalosh së ngrëni atë. Nëse i krishteri informohet se ai / ajo nuk duhet ta hajë për vetë faktin se çështja do të diskutohet tregon praninë e besimit të dobët apo një besimi që po kërkon (shih 1 Kor. 10:29).

**10:29**

**NASB** “pse gjykohet liria ime nga ndërgjegja e dikujt tjetri”  
**NKJV** “përse të gjykohet liria ime nga ndërgjegja e një tjetri”  
**NRSV** “pse duhet të jetë liria ime subjekt i gjykimit të ndërgjegjes së dikujt tjetri”  
**TEV** “pse duhet të kufizohet liria ime për të vepruar nga ndërgjegja e një personi tjetër”  
**NJB** “pse duhet të sundohet liria ime nga ndërgjegja e dikujt tjetër”

NRSV e thekson këtë si të ishin fjalët e Palit. TEV e përkthen këtë si ato të ishin një pyetje tjetër e bërë nga një kundërshtar i supozuar. Kjo është teknika letrare e quajtur diatribe (shih 1 Kor. 6:12,13).

Kjo është pyetja thelbësore që ju duhet t’i përgjigjeni për veten tuaj. Secili nga ne, nën drejtimin e Frymës së Shenjtë, duhet të përcaktojë kufijtë e vetë-kufizimit tonë për të tjerët, nga dashuria dhe respekti për Krishtin.

**TEMË E VEÇANTË: A DUHET TA GJYKOJNË TË KRISHTERËT NJËRI-TJETRIN? [SPECIAL TOPIC: JUDGING (SHOULD CHRISTIANS JUDGE ONE ANOTHER?)]**

- A. Tek 1 Korintasve 5:12 Pali dhe kisha duhet të merren me anëtarët (v. 12 pret një “po” si përgjigje), por besimtarët duhet të lejojnë Perëndinë të merret me jo-besimtarët. Besimtarët nuk duhet ta gjykojnë njëri-tjetrin (shih Mat. 7:1-5,15-20; Rom. 14:1-15:13), por
1. Ne duhet të analizojmë frytet e njëri-tjetrit për pozita drejtimi (shih 1 Kor. 6:1-3; Mateu 7)
  2. Ne duhet të ushtrojmë disiplinë kishë kur reputacioni i kishës vihet në rrezik

Kjo është shpesh një vijë e hollë! Pali duke nënkuptuar po pohon se njeriu që mëkaton i 1 Korintasve 5 duhet të vendoset në hapësirën e gjykimit të Perëndisë (dmth., jashtë kishës).

Është e çuditshme se si ky kontekst lidhet me shoqëritë moderne ku besimtarët dhe jo-besimtarët kanë mundësinë që me anë të votimit të rregullojnë normat sociale. A duhen besimtarët të marrin pjesë fuqishëm në procesin politik? Ky kontekst është i kufizuar tek gjykimi i lidhur me disiplinën e kishës dhe jo demokracinë perëndimore, moderne. Besimtarët janë qytetarë të dy botëve me detyrime dhe privilegje në secilën! Fryma e Perëndisë, vullneti i Perëndisë dhe libri i Perëndisë na ndihmojnë ne si besimtarë të gjejmë shtegun tonë në këtë botë të rënë, por jobsimtarët shfrytëzohen dhe manipulohen nga mëkati, vetvetja dhe Satani. Ata kanë nevojë për dëshminë dhe dhembshurinë tonë, jo për vetë-drejhtësinë tonë gjykuese. Ata nuk janë të aftë të kuptojnë motivet, qëllimet dhe veprimet tona.

Problemi i kur dhe si duhet “të gjykojnë” të krishterët njëri-tjetrin ka bërë që disa dorëshkrime greke ta ndryshojnë këtë tekst.

1. Dorëshkrimi papirus i hershëm P<sup>46</sup> (rreth vitit 200 pas Krishtit) ashtu sikurse përkthimi Baharik Koptik (shekulli i 3-të) dhe përkthimi Siriak Peshitta (shekulli i 5-të) thjesht e heqin formën negative dhe e përkthejnë fjalinë si urdhërore: “Gjykoni ata që janë brenda [kishës]” (shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke], fq. 551).
2. Përkthimi Sahidik Koptik (shekulli i 3-të) vendos formën negative në fjalinë pararendëse: “Sepse ç’punë kam unë me gjykimin e atyre që janë jashtë dhe jo me ata që janë brenda? Gjykoni ata që janë brenda” (Metzger, fq. 51).

3. Teksti UBS<sup>4</sup> as nuk e pranon mundësinë e këtyre varianteve si origjinale.

B. Kjo çështje duhet trajtuar në dy mënyra.

1. Besimtarët paralajmërohen që të mos gjykojnë njëri-tjetrin (shih Mat. 7:1-5; Luka 6:37, 42; Rom. 2:1-11; Jak. 4:11-12)

2. Besimtarët nxiten që të vlerësojnë drejtuesit (shih Mat. 7:6, 15-16; 1 Kor. 14:29; 1 Thes. 5:21; 1 Tim. 3:1-13; dhe 1 Gjonit 4:1-6)

Na nevojiten disa kritere për vlerësimin e drejtë.

1. vlerësimi duhet kryer me qëllim afirmimim (shih 1 Gjonit 4:1 – “sprova” që synon aprovimin)

2. vlerësimi duhet kryer me përlësi dhe butësi (shih Gal. 6:1)

3. vlerësimi nuk duhet të përqendrohet në çështje preferencash personale (shih Rom. 14:1-23; 1 Kor. 8:1-13; 10:23-33)

4. vlerësimi duhet të identifikojë ata drejtues që nuk “preken nga kritikata” brenda kishës, apo nga komuniteti (shih 1 Timoteut 3).

**10:30** Kjo i referohet një vakti për të cilin besimtari ka falenderuar dhe ka ngrënë. Pyetja këtu përgatit terrenin për parimin universal se si të ushtrojmë të drejtat tona të krishtera, të cilat vazhdojnë tek 1 Kor. 10:31.

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 10:31-33**

<sup>31</sup> Pra, nëse hani, nëse pini, nëse bëni ndonjë gjë tjetër, të gjitha t’i bëni për lavdinë e Perëndisë. <sup>32</sup> Mos u bëni shkak skandali as për Judenj, as për Grekë, as për kishën e Perëndisë; <sup>33</sup> sikurse edhe unë vetë përpiqem t’u pëlqej të gjithëve në çdo gjë, nuk kërkoj përfitimin tim, por të të shumtëve, që të shpëtohen. <sup>11:1</sup> Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues i Krishtit.

**10:31 “të gjitha t’i bëni për lavdinë e Perëndisë”** Ky është parimi universal i zbatueshëm në çdo zonë të jetës së besimtarit (shih Efe. 6:7; Kol. 3:17,23; 1 Pjet. 4:11). Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA [SPECIAL TOPIC: GLORY (DOXA)] tek 1 Kor. 2:7.

**10:32 “Mos u bëni shkak skandali as për Judenj, as për Grekë, as për kishën e Perëndisë”** Kjo duket se i referohet tre gupeve. Dy grupet e para lidhen me ungjillizimin; grupi i fundit lidhet me marrëdhënien në kishë. Termi “kishë” dukshëm po përdoret në një kuptim universal si tek Mate. 16:18. Termi i përdorur në Dhjatën e Re në

1. një kuptim lokal (pjesa më e madhe e rasteve)
2. një kuptim rajonal (shih Veprat e Apo. 9:31; Gal. 1:2)
3. një kuptim universal (shih Fil. 3:6; Heb. 12:23)
4. një kuptim kozmik i të gjithë shenjtorëve të të gjitha kohërave të gjallë dhe të vdekur (Efe. 1:22; 5:23,24,25,27,29,32; Kol. 1:18,24)

▣ **“kishë”** Shih Temën e Veçantë: Kisha tek 1 Kor. 1:2.

**10:33 “sikurse edhe unë vetë përpiqem t’u pëlqej të gjithëve në çdo gjë... që të shpëtohen”** Ungjillizimi, jo të drejtat e personit, është prioriteti i besimtarëve të pjekur (shih 1 Kor. 9:19-22).

▣ **“të shumtëve”** Në përkthimet tona kjo fjalë mund të kuptohet si një pjesë e madhe e të gjithë grupit. Megjithatë, në mendimin hebraik ajo është thjesht një variacion letrar i “të gjithëve”. Ky paralelizëm mund të shihet tek

1. Isaia 53:11, “shumë veta”  
Isaia 53:12, “shumë vetave”  
Isaia 53:6, “ne të gjithëve”
2. Romakëve 5:18, “të gjithë njerëzit... të gjithë njerëzit”  
Romakëve 5:19, “të shumtët... të shumtët”

3. Tek 1 Korintasve 10:17, “ne të shumtit” (këtu Pali po përdor termin “shumtë” për t’iu referuar të gjithë grupit të besimtarëve)

▣ **“që të shpëtohen”** Ky është qëllimi i predikimit të ungjillit dhe jetesës së Krishterë (shih 1 Kor. 9:19-22). Premtimi i Perëndisë tek Zan. 3:15; 12:3 tani është plotësuar. Marrëdhënia e thyer (dmth., pamja e prishur e Perëndisë tek njerëzimi) është restauruar përmes Krishtit. “Kushdo që dëshiron” mund të vijë (shih Ezek. 18:23,32; Gjoni 1:12; 3:16; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9).

**11:1** Ky vag duket se shkon me kapitullin 10 dhe jo 11. Qëllimet dhe veprimet ungjillore të Palit paralelizojnë jetën dhe mësimet e Jezusit. Sikurse Pali e imitonte Atë, besimtarët në Korint duhet të fokusohen mbi (1) të mirën e trupit (kishës) dhe (2) shpetimin e botës jobesimtare.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A ishin të humbur frymërisht izraelitët që vdiqën në shkretëtirë?
2. Cili është qëllimi kryesor i Darkës së Zotit?
3. Si duhet ekuilibruar liria e krishterë dhe përgjegjësia e krishterë?
4. Cili duhet të jetë qëllimi kryesor i lirisë sonë?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 11

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
		Probleme në Jetën e Bashkësisë (11:2-14:40)		Etikë në Adhurimin Publik (11:2-14:40)
Të Mbuluarit e Kokës në Adhurim	Mbulimi i Kokës	Përshtatshmëria në Veshje në Adhurimin Publik	Mbulimi i Kokës në Adhurim	Sjellja e Grave në Shërbesa
11:2-16	11:2-16	11:2-16	11:2-12  11:13-16	11:2-6 11:7-12 11:13-15 11:16
Abuzime në Darkën e Zotit	Sjellja gjatë Darkës së Zotit	Udhëzime përballë Abuzimeve në Darkën e Zotit	Darka e Zotit	Darka e Zotit
11:17-22	11:17-22	11:17-22	11:17-22	11:17-22
Institucioni i Darkës së Zotit	Institucioni i Darkës së Zotit			
11:23-26	11:23-26	11:23-26	11:23-26	11:23-27
Pjesëmarrja e Padenjë në Darkë	Hetoni Vetën tuaj			
11:27-34	11:27-34	11:27-34	11:27-32  11:33-34	11:28-32 11:33-34

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 11:2-34**

- A. Kapitujt 11 deri në 14 merren me çështjet e adhurimit të përbashkët / kolektiv. Ato formojnë një njësi letrare të bashkuar.
  - a. Veshja dhe veprimet e grave dhe burrave (1 Kor. 11:2-16)



- b. Vështrimi mbi Darkën e Zotit (1 Kor. 11:17-34)
  - c. Ushtrimi i dhuntive frymërore (1 Kor. 12-14)
- B. Kur them “adhurim i përbashkët” ka dy rrethana të mundshme.
- a. Mbledhje të rregullta në grupe të vogla në shtëpi, disa në lagje të pasura, disa në lagje etnike, disa në lagje skllëvërish
  - b. Periodikisht (hapësira e saktë kohore është e pasigurtë) këto kisha-shtëpi të vogla mblidheshin për një event adhurimi në të gjithë qytetin (dmth., dreka *agapë* me festën e Eukaristit)
  - c. Nëse ka një set protokollesh të ndryshëm për kishat-shtëpi përkundrejt eventit të mbledhur është e pasigurtë
- C. Ka pasur mënyra të ndryshme për ta kuptuar 1 Kor. 11:2-16.
- a. Ky kontekst kryesisht trajton etikën e përshtatshme (shih 1 Kor. 11:13) në adhurimin e përbashkët, jo me marrëdhënien midis burrave dhe grave (shih 1 Kor. 11:11-12).
  - b. Ky kontekst trajton lirinë e re në Krishtin të cilën burrat dhe gratë romake në kishën e Korintit po e përdornin për të shfaqur statusin e tyre social (burrat) dhe pavarësinë nga tradita dhe kultura (gratë).
  - c. Ky kontekst trajton marrëdhënien e krijimit midis bashkëshortëve dhe bashkëshorteve (shih Efe. 5:22-31; 1 Tim. 2:9-15). Marrëdhënia e duhur bazohet tek Zanafilla 2-3, e cila tregon prioritetin e burrave për shkak të krijimit original të Adamit dhe rebelimit të parë të Evës.
  - d. Diskutimi i Palit për mbulimin e kryeve nuk kufizohet tek gratë, por iu drejtohet edhe burrave. Si zakonisht, në Korint problemi është nga dy drejtime. Si një shenjë e statusit të tyre social elitë, disa burra po mbulonin kokat e tyre kur ata drejtonin në adhurim e përbashkët ashtu siç kishin bërë në paganizëm. Si një shenjë e emancipimit të tyre social, gratë po hiqnin vellt e tyre të martesës kur ato drejtonin në adhurimet e përbashkëta (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin], fq. 121-141). Ky tekst i përshtatet në mënyrë të veçantë Korintit romak. Në jetën hebraike dhe greke, gratë normalisht nuk i mbulonin kryet e tyre. Duket se ky kontekst i paqartë është i hapur për interpretime të shumta. Këto interpretime thonë më shumë për anësinë e interpretuesit se sa për qëllimin e Palit. Një tekst i cili ka qënë dhe mund të kuptohet në kaq shumë mënyra nga besimtarë të sinqertë duhet që sigurisht të mos përdoret në një mënyrë përcaktuese dhe dogmatike për të kufizuar apo mbrojtur vendin dhe funksionin e grave në kishë apo marrëdhëniet midis burrave dhe grave në të gjitha epokat dhe kulturat. Më mahnit se disa besimtarë e zvogëlojnë diskutimin e kapitullit 11 të mbulimit të kryeve për burrat dhe gratë në një çështje kulturore (edhe pse Pali i referohet Zanafillës 1-3), ndërkohë në të njëjtën kohë, duke kërkuar kufijtë e Palit mbi gratë në kishë si një parim për të gjitha epokat. Kjo mungesë qëndrueshmërie ka shkaktuar kaq shumë problematika në interpretim. Diskutimi më i mirë i shkurtër i kësaj çështjeje të komplikuar dhe emocionale është *How to Read the Bible for All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj] nga Fee dhe Stuart, fq. 61-77 ose *Gospel and Spirit* [Ungjilli dhe Fryma], nga Gordon Fee.
- D. Ky kapitull na ndihmon të shohim se disa simbole teologjike dhe privilegje duhet të kufizohen ose zgjerohen në marrëdhënie me kulturën në të cilën i krishteri i pjekur e gjen veten. Një libër që më ka ndihmuar mua në këtë sferë është nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj], fq. 71-89.
- E. Ky është shkrimi më i hershëm i Darkës së Zotit / Eukaristit / Kungimit.
- F. Qëllimi i Darkës së Zotit
- a. Uniteti dhe marrëdhënia e kishës
  - b. Shprehja e pranisë së Jezusit
  - c. Shprehja e sakrificës historike të Jezusit
  - d. Shprehja e marrëdhënies sonë ndaj Perëndisë përmes Krishtit
  - e. Një veprim i shpalljes së eventit të shkuar dhe ardhjes së pritur të Krishtit
  - f. Një veprim serioz adhurimi

Nga 1 Kor. 10:16-17 është e sigurtë që Pali e shihte këtë eksperiencë si më shumë se sa thjesht simbolik apo përkujtim (shih 1 Kor. 11:24-25). Megjithatë, ky koncept nuk zhvillohet. Ndoshta Gjoni 6:41-71 (edhe pse asgjë në kontekstin e menjëhershëm nuk lidhet me Darkën e Zotit) është një aspekt i këtij uniteti frymor. Krishtërimi është së pari një marrëdhënie personale besimi me Perëndinë Triun.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 11:2-16

<sup>2</sup>Dhe unë po ju lavdëroj, vëllezër, që më kujtoni në të gjitha gjërat dhe i zbatoni porositë ashtu siç ua kam transmetuar. <sup>3</sup>Por dua që të dini se kreu i çdo njeriu është Krishti, edhe kreu i gruas është burri; edhe kreu i Krishtit është Perëndia. <sup>4</sup>Çdo burrë, kur lutet ose profetizon *kokëmbuluar*, turpëron kryet e tij. <sup>5</sup>Edhe çdo grua, që lutet ose profetizon *kokëzbuluar*, turpëron kryet e saj, sepse është njëlloj sikur të ishte e rruar. <sup>6</sup>Sepse në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le t'ia presin flokët; por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kryet. <sup>7</sup>Sepse burri nuk duhet të mbulojë kryet, sepse është shëmbëllimi dhe lavdia e Perëndisë, kurse gruaja është lavdia e burrit, <sup>8</sup>sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri, <sup>9</sup>edhe sepse burri nuk u krijua për gruan, por gruaja për burrin. <sup>10</sup>Prandaj gruaja, për shkak të engjëjve, duhet të ketë një *shenjë* pushteti mbi kryet. <sup>11</sup>Gjithsesi në Zotin as burri s'është pa gruan, as gruaja pa burrin, <sup>12</sup>sepse sikurse gruaja vjen nga burri, ashtu edhe burri *lind* nëpërmjet gruas, dhe çdo gjë vjen nga Perëndia. <sup>13</sup>Gjykoni ndër veten tuaj. A i ka hije gruas t'i lutet Perëndisë *pa u mbuluar*? <sup>14</sup>Po vetë natyra, a nuk ju mëson se, në qoftë se një burrë i mban flokët të gjata, kjo është çnderim për të? <sup>15</sup>Por në qoftë se gruaja i ka flokët të gjata, kjo është lavdi për të, sepse flokët i janë dhënë asaj për mbulesë. <sup>16</sup>Por në qoftë se ndokush mendon të kundërshtojë, ne s'kemi zakon të tillë, as kishat e Perëndisë.

11:2 Nën dritën e kapitujve të mëparshëm, dikush mund të vrasë mendjen nëse ky varg është ironi apo sarkazëm. Kjo kishë nuk po kujtonte fjalët e Palit dhe nuk po ndiqte mësimet e tij (shih 1 Kor. 11:17,22). Ka mundësi që kjo të jetë një tjetër pyetje për të cilën kisha i shkroi Palit.

NASB	“mbahuni fort tek traditat”
NKJV	“ruani traditat”
NRSV	“mbani traditat”
TEV	“ndiqni mësimet”
NJB	“duke mbajtur traditata” <sup>30</sup>

Kjo është një formë treguese aktive e tashme. Besimtarët duhet të vazhdojnë të mbahen tek të vërtetat që Pali predikon (shih 2 Thes. 2:15). Ky është ekulibri i besëlidhjes në zgjedhje.

Termi “tradita” (*pardosis*) përdoret në disa kuptime:

1. Tek 1 Kor. 11:2,23; 15:3 për të vërtetat e ungjillit
2. Tek Mat. 15:6; 23:1 e në vazhdim; Mark 7:8; Gal. 1:14 për traditat hebraike
3. Tek Kol. 2:6-8 për spekulimet gnostike
4. Katolikët romakë (Ortodoksët lindorë dhe rusë) e përdorin këtë varg si një pjesëz të shkëptur biblike për të mbështetur idenë se Shkrimet dhe traditat kishtarë janë në autoritet të barabartë
5. Në këtë kontekst i referohet së vërtetës apostolike, ose e folur ose e shkruar (shih 2 Thes. 3:6)

■ **“traditat”** shumë nga informacioni për Jezusin kalohej gojarisht nga individ në individ deri sa u shkruajt rreth 30 deri në 60 vjet pas vdekjes së Tij.

■ **“ashtu siç ua kam transmetuar”** Gjendet një lojë fjalësh midis “traditat” (*paradoseis*) dhe “transmetuar” (*paredōka*), të cilat janë të dyja forma të *paradidōmi*. Pali nuk ishte filluesi, por thjesht një lidhje në zinxhirin e zbulesës. Termi “tradita” u përdor për të vërtetat e krishtera që u kaluan nga një person në një tjetër (shih 1 Kor. 11:23; 15:3).

Pali mori informacion mbi ungjillin nga disa burime.

<sup>30</sup> Versioni në shqip është: “i zbatoni porositë”. (shënim i përkthyesit)

1. Predikimi i Stefanit (shih Veprat e Apo. 7)
2. Të krishterët që persekutoi ai (shih Veprat e Apo. 8:1-3; 9:1-2; 22:4,19)
3. Ananais (shih Veprat e Apo. 9:10-18)
4. Koha e tij në Arabi me Krishtin (shih Gal. 1:11-17)
5. Koha e tij në Jeruzalem me Pjetrin dhe Jakobin (shih Gal. 1:18-19)
6. Barnaba (shih Veprat e Apo. 9:20-27; 11:25-26)

**11:3 “kreu i çdo njeriu është Krishti”** Në komentarin e tij *1 and 2 Corinthians* [Letra e Parë dhe e Dytë drejtuar Korintasve], fq. 103, F. F. Bruce pranon se në këtë kontekst *kephalē* ndjek fjalën hebraike *rosh* në kuptimin e origjinës ose burimit. Ky kuptim i fjalës *kephalē* nuk dokumentohet në leksikonët grekë nga:

1. Bauer, Arndt, Gingrich, Danker
2. Moulton, Milligan
3. Louw, Nida
4. Moulton

Kjo tregon se si konteksti (dmth., 1 Kor. 11) përcakton përkufizimin, jo një fjalor. Në këtë kontekst “burimi” ose “origjina” i përshtatet më së miri 1 Kor. 11:3 në lidhje me Zan. 1:26-27; 2:18 (shih Kaiser, Davids, Bruce, dhe Brauch, *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës], fq. 599-602).

Jezusi ishte agjenti i Atit në krijim (shih Gjoni 1:3,10; 1 Kor. 8:6; Kol. 1:16; Heb. 1:2). Njerëzit, meshkuj dhe femra, u krijuan nga Ai, në shëmbëllimin e Tij. Megjithatë, Biri i nënshtrohet Atit (shih 1 Kor. 3:23; 11:2; 15:28). Ky nënshttrim i përshtatshëm zgjerohet tek burrat dhe gratë. Ata janë të dy të krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27), por ka një rregull, në fillim burri, dhe më pas gruaja (shih Zan. 2:18) i lidhur me funksionin (të paktën në sistemin patriarkal), por jo në pabarazi! Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: KOKA (KEPHALĒ) [SPECIAL TOPIC: HEAD (KEPHALĒ)]**

Ka pasur diskutim të gjatë teologjik mbi kuptimin e “kokës” (*kephalē*). Termi mund të kuptohet si

1. Ekuivalenti i tij në Dhjatën e Vjetër është *rosh* (BDB 910, KB 1164), që mund të ketë kuptim
  - a. Kokë
  - b. Drejtues
  - c. Fillimi ose origjina (shih Pro. 8:23; Pred. 3:11; Isa. 41:4)
  - d. Shuma totale

(Shih *Dictionary of Old Testament Theology and Exegesis* [Fjalori i Teologjisë dhe Eksegezës së Dhjatës së Vjetër], vol. 3, fq. 1015-1020)

2. Tek LXX *rosh* përkthehet nga fjala greke
  - a. *archē* (fillimi, shih Ps. 137:6)
  - b. *prōtotokos* (i pari, shih 1 Kro. 5:12)
  - c. *kephalē* (koka)
    - 1) Koka e një njeriu
    - 2) Koka e një kafshe
    - 3) Maja e një mali
    - 4) Maja e një kulle (shih Mat. 21:42)
3. Në Dhjatën e Re *kephalē*
  - a. Koka e një njeriu (shih 1 Kor. 11:4,5,7)
  - b. Koka e një kafshe
  - c. Shprehje për një person në tërësi
  - d. Fillimi ose origjina (shih 1 Kor. 11:3)
  - e. Shuma (shih Rom. 13:9)
  - f. Drejtuesi
    - 1) Jezusi është kreu mbi të gjithë sunduesit dhe autoritetin, shih Kol. 2:10
    - 2) Jezusi është kreu i kishës (shih Efe. 4:15; 5:23; Kol. 1:18; 2:19)
  - g. Bashkëshorti (shih Efe. 5:23)

(Shih *Dictionary of New Testament Theology* [Fjalori i Teologjisë së Dhjatës së Re], vol. 2, fq.

▣ **“kreu i gruas është burri”** Termat “burri” dhe “gruaja” mund të kuptohen si bashkëshorti dhe bashkëshortja (shih NRSV, TEV). Në këtë kontekst ky nuk është vetëm teksti i qëllimtë, por rendi i krijimit i reflektuar tek Zanafilla 2.

▣ **“edhe kreu i Krishtit është Perëndia”** Kjo është një e vërtetë e përsëritur tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 3:23; 11:3; 15:28). Rendi brenda trinisë nuk ka të bëjë aspak me pabarazinë, por është një ndarje e funksionit. Kjo e vërtetë gjithashtu mund të nënkuptohet nga diskutimi i mashkullit dhe femrës. Ndërsjellshmëria ishte patjetër modeli përpara rënies tek Zanafilla 3. Kjo ndërsjellshmëri rivendoset tek marrëdhënia e restauruar e besimtarëve me Atin përmes Birit (dmth., Jezusi ka restauruar shëmbëllimin tek besimtarët si meshkuj ashtu edhe femra).

#### 11:4

NASB	<b>“Çdo burrë që ka diçka mbi kokën e tij ndërkohë që lutet... turpëron kryet e tij”</b>
NKJV	<b>“Çdo burrë që është duke u lutur ose duke profetizuar, duke e pasur kokën e tij të mbuluar, çnderon kryet e tij”</b>
NRSV	<b>“Cilido burrë i cili lutet ose profetizon me diçka në kokë, turpëron kryet e tij”</b>
TEV	<b>“Kështu, një burrë që lutet ose shpall mesazhin e Perëndisë gjatë adhurimit publik me kokën e tij të mbuluar, turpëron Krishtin”</b>
NJB	<b>“Cilido burrë që të lutet ose të profetizojë me kokën e tij të mbuluar, tregon mungesë respekti ndaj kryeve të tij”</b>

Kjo është një lojë fjale me fjalën “krye”. Përdorimi i dytë i fjalës “krye” i referohet Krishtit (shih TEV). Pali po ndeshet me një kulturë romake, format dhe simbolet e së cilës ishin krejtësisht të kundërta me kulturën hebraike (dmth., burrat mbulonin kryet e tyre). Çështja e vërtetë nuk është se cili mbulon kokën e kujt, por simboli i (1) origjinës ose (2) nënshtrimit, të cilat janë të dyja teologjikisht të rëndësishme. Është sugjeruar që në situatën historike në Korint:

1. Drejtuesit social, politikë dhe financiarë udhëhiqnin adhurimin me një kokë të mbuluar për të dalluar veten e tyre nga njerëzit e zakonshëm
2. Hebrenjtë në sinagogën në Korint i kishin gratë e tyre të mbuluara me një vel dhe hebrenjtë besimtar prisnin të njëjtën gjë në kishë

Gjendet një tension teologjik midis këtij vargu, i cili duket se pranon gratë në role drejtimi në adhurimin në publik me mbulimin që ishte i pranueshëm nga ana sociale në krahasim me 14:34-35, ku grave (ose të paktën “bashkëshorteve”, 1 Kor. 11:35) iu ndalohej të flasin në kishë.

Disa grupe e shkëpusin kapitullin 11, ndërsa të tjerë përdorin kapitullin 14. Duhet pranuar se çelësi për këtë pasazh janë rrethanat kulturore të shekullit të parë në Korint, por cili aspekt specifik nuk është e qartë për ne sot. Kisha e shekullit të parë njihte drejtimin e grave në Dhjatën e Vjetër dhe ishte e ndërgjegjshme për përdorimin e grave nga Pali gjatë shërbesës së tij (shih Romakëve 16). Në Korint dhe kulturën romake e kuptonin çështjen në atë mënyrë që ne nuk e kuptojmë sot. Dogmatizmi është i papërshtatshëm!

Një libër i kohëve të fundit: *“After Paul Left Corinth: The Influence of Secular Ethics and Social Change”* [Pasi Pali la Korintin: Ndikimi i Normave të Etikës së Botës dhe Ndryshimi Social], nga Bruce W. Winter, fq. 121-141, ofron disa njohuri shumë të dobishme nga letërsia dhe arti romak. Ky dhe artikuj të tjetër (dmth., E. Fantham, *“The ‘New Woman’: Representation and Reality,”* [‘Gruaja e Re’: Përfaqësimi dhe Realiteti] tek *Women in the Classical World*, [Gra në Botën Klasike] kapitulli 10, dhe P. W. J. Gill, *“The Importance of Roman Portraiture for Head Coverings in 1 Corinthians 11:2-16,”* [Rëndësia e Portretizimit Romak për Mbulimin e Kokës tek 1 Korintasve 11:2-16] TynB 41.2 (1990): fq. 245-260 dhe *“In Search of the Social Elite in the Corinthian Church,”* [Në Kërkim të Elitës Sociale tek Kisha e Korintit] TynB 44.2 (1993): fq. 323-337), iu tregojnë interpretuesve modernë se si Korinti i shekullit të parë ishte romak në kulturë, dhe jo grek.

Me këto njohuri të reja të dokumentuara nga shekulli i parë i Korintit romak, është e mundur që të fillojmë të shohim çështjet kulturore me të cilat Pali ndeshet në këtë libër.

1. Pali nuk po i drejtohet as kulturës hebraike dhe as kulturës greke aspak në këtë kontekst.
2. Pali po i drejtohet dy grupeve me status social elitë.

- a. Meshkujt besimtarë të pasur, të elitës sociale, po mburreshin me pozitat e tyre duke mbuluar kryet e tyre ndërkohë që ishin duke drejtuar adhurim publik, sikurse ishte zakon për këtë klasë sociale, ndërkohë që drejtonin adhurim fetar greko-romak civil. Ata po mburreshin me veten e tyre.
  - b. Gratë e pasura elitë po hiqnin vëllot e tyre, të cilat priteshin nga ana kulturore për t'i mbajtur, dhe e bënë këtë në mënyrë që të valëvisnin barazinë e tyre, jo vetëm në Krishtin, por gjithashtu si një pohim social, sikurse po bënë gratë e tjera romake të asaj periudhe.
3. Qytetarët e Korintit romakë, të cilët ishin kuriozë për besimin dhe praktikën e adhurimit të krishterë, dërgonin një "lajmëtar" (dmth., engjëjt e 1 Kor. 11:10 mund t'iu referohen shërbëtorëve ose përfaqësuesve të dërguar për llogari të zotërinjve) për të parë si ishte mbledhja.

Ky informacion historik / kulturor / social nxjerr kuptim nga një tekst mjaft i vështirë dhe i diskutuar. Ai gjithashtu i përshtatet teksteve të tjera të letrës së parë të Korintasve, i cili dukshëm reflekton një rrethanë unike të shekullit të parë në Korint!

TEMË E VEÇANTË: GRATË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: WOMEN IN THE BIBLE), shih 1 Korintasve 7:4

**11:5 "Por<sup>31</sup> çdo grua, që lutet ose profetizon kokëzbuluar, turpëron kryet e saj"** Kjo nënkupton në mënyrë të fuqishme se me kryet e saj të mbuluar, ajo mund të jetë duke u lutur ose duke profetizuar në mbledhjet publike. Termi "duke profetizuar" në këtë libër do të thotë "të ndash ungjillin" ose "të predikosh publikisht" (shih 1 Kor. 14:39). Vargjet 4 dhe 5 janë paralelizma të lidhur me atë që burrrat dhe gratë bëjnë ndërkohë që marrin pjesë në adhurimin në grup. Shih TEMËN E VEÇANTË: PROFECIA NË DHJATËN Ë RE (SPECIAL TOPIC: NEW TESTAMENT PROPHECY) tek 1 Kor. 14:1.

▣ **"turpëron kryet e saj"** Korinti ishte një koloni romake dhe reflektonte kulturën romake. Gratë romake martoheshin në fillim të adoleshencës së tyre. Veli ishte një aspekt kulturor i shërbesës martesore. Ai pritej që të mbahej jashtë shtëpisë nga gratë romake. Mungesa e velit do të shihej si

1. Një grua e turpëruar
2. Një prostitutë
3. Një partnere dominuese lezbike
4. Një grua "e re" (dmth., një lëvizje sociale e barazizë dhe lirisë aktive në mes të shoqërisë romake të shekullit të parë)

Një grua që tregonte veten e saj në këtë mënyrë duhet ta ketë turpëruar në mënyrë publike bashkëshortin e saj dhe duhet të ketë dhënë përshtypjen e gabuar për kishën tek vizitorët dhe tek komuniteti. Krishti i bën të lirë meshkujt dhe femrat, por secili prej tyre ka një detyrim për të kufizuar lirinë për çështjen e Krishtit. Meshkujt dhe femra, bashkëshorte dhe bashkëshortë të cilët janë besimtarë, janë të thirrur për të jetuar për shëndetin dhe rritjen e Mbretërisë! Kjo është tema e 1 Korintasve 8-10 dhe që vazhdohet në kapitullin 11.

▣ **"sepse është njëllor sikur të ishte e rruar"** Kjo është një pjesore pasive e përkryer. Ka disa mundësi për ta kuptuar këtë frazë.

1. Ajo i referohet veshjes së zakonshme të prostitutave lokale.
2. Është një veprim kulturor i një gruaje kurorëshkelëse për ta turpëruar në publik.
3. Ajo tregonte se gratë e turpëruara ishin karakteristike në botën mesdhetare për ndjekësit e "Feve Misterioze"
4. Ajo i referohet veprimit të papritur kulturor të grave të krishtera që prisnin flokët e tyre shumë shkurt për të treguar lirinë e tyre të re (dmth., një trend kulturor në Romën e shekullit të parë dhe kolonive të tyre)

Në shumë komentare pika e parë theksohet. Pranohet që kjo mund t'iu referohet prostitutave të tempullit të Dianës. Megjithatë, ky tempull në Akropolis u shkatërrua nga një tërmet 150 vjet përpara kohës së Palit dhe nuk ka asnjë provë historike se ende funksiononte. Gjithashtu, nuk ka asnjë provë që prostitutat në Greqi rruanin kokat e tyre. Pyetja kyç është: "Cila është tema së cilës po i drejtohet Pali?"

1. Veshja dhe veprimet e përshtatshme kulturore të pritura në adhurim
2. Abuzimi i lirive personale
3. Marrëdhënia e përshtatshme midis
  - a. Grave dhe burrave

<sup>31</sup> Versioni në shqip është: "Edhe" (shënim i përkthyesit).

- b. Bashkëshortëve dhe bashkëshorteve
- c. Engjëjve dhe grave (1 Kor. 11:10)
- d. Kulturës dhe grave (1 Kor. 11:13)

Unë kam arritur të kuptoj se pika 1 është mundësia më e mirë, që i drejtohet si bashkëshortëve dhe bashkëshorteve që nuk ishin të drejtuar nga liria e tyre e re në Krishtin, por nga refuzimi i tyre i paepur për të lënë mënjanë privilegjet e tyre kulturore dhe për të punuar drejt unitetit dhe rritjes së kishës.

**11:6 “në qoftë se... në qoftë se”** Gjenden dy fraza kushtore të rendit të parë në këtë varg, të cilat nënkuptohen të jenë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Kishte gra të krishtera në kishë të cilat refuzonin të mbulonin kryet e tyre, por gjithësesi dëshironin të ishin aktive në adhurimin në grup. Ishte diçka e papranueshme nga ana sociale. Besimtarët duhet të kufizojnë liritë e tyre të reja në Krishtin për

1. Ata në kishë që janë më të dobët (shih Rom. 14:1-15:13)
2. Pritshmërinë kulturore të shoqërisë të cilën kisha po përpiqet të ungjillizojë dhe përfshijë

<b>NASB</b>	<b>“nuk mbulon kokën e saj”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“nuk mbulohej”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“nuk do vendos vel mbi veten”</b>
<b>TEV</b>	<b>“nuk mbulon kokën e saj”</b>
<b>NJB</b>	<b>“shkon pa një vel”</b>

Të dhënat historike mbi përdorimin e mbulimit të fytyrës (dmth., të velit) ose mbulimit të kokës gjeri në gjatësinë e shpatullave nga njerëzit mesdhetarë antikë janë shumë ndihmuese. Unë kam dokumentuar provën e fundit tek shënimet e 1 Kor. 11:4. Gratë romake që ishin të martuara, jo vejusha dhe jo prostitute, priteshin nga kultura që të mbanin një vel në publik si një shenjë që ato ishin të martuara. Kishte shumë pak gra beqare në botën antike mesdhetare.

Në kulturën hebraike, veli i fytyrës përdorej si një shenjë e

1. Lebrës, Lev. 13:45
2. Zisë për dikë të vdekur, Ezek. 24:17,22
3. Turpit, Mikea 3:7
4. Martesës, Zan. 24:65
5. Prostitutumit, Zan. 38:14-15

Megjithatë, kujtoni se Pali nuk po i referohet një kulture hebraike aspak sepse në atë kulturë burrat mbulojnë kryet e tyre gjatë adhurimit.

■ **“le t’ia presin flokët”** Kjo është një formë urdhërore aoriste e mesme. Kjo nuk duhet të merret fjalë për fjalë. Pali nuk po mbron një turpërim publik të grave të krishtera, por ai po pranon pasojat kulturore për sjellje të papërshtatshme!

■ **“le të mbulojë kryet”** Kjo është një formë urdhërore e mesme e tashme. Gratë e krishtera për hir të Krishtit konformonin me kulturën e pritshme në mënyrë që të arrinin njerëzit për shpëtimin dhe pjesëmarrjen në kishë. Format do të ndryshojnë nga kultura në kulturë dhe nga epoka në epokë! Qëllimi qëndron i njëjtë (shih Mat. 28:18-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

**11:7 “ai është shëmbëllimi dhe lavdia e Perëndisë”** Kjo i referohet Zan. 1:26-27, e megjithatë në kontekst të këtij vargu Zan. 1:26, fjala “burrë” është e përgjithshme. Teologjikisht është e pasigurtë se cilës “shëmbëllimi dhe ngjasie” saktësisht i referohet Zan. 1:26-27. Pjesa më e madhe e studiuesve do t’i lidhnin ato me personalitetin, vetë-ndërgjegjësimin, perspektivën morale, aftësinë për të zgjedhur, aftësinë për t’u lidhur me të tjerët. Gjendet dukshëm një ndërsjellje midis burrave dhe grave si tek Zan. 1:26-27 dhe tek 2:18. Problemi vjen tek Zan. 3:16! Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA [SPECIAL TOPIC: GLORY (DOXA)] tek 1 Korintasve 2:7.

<b>11:8</b>	
<b>NASB</b>	<b>“Sepse burri nuk vjen nga gruaja, por gruaja nga burri”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“Sepse burri nuk është nga gruaja, por gruaja nga burri”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“në fakt, burri nuk u krijua nga gruaja, por gruaja nga burri”</b>

TEV  
NJB

“sepse burri nuk u krijua nga gruaja, por gruaja nga burri”  
“sepse burri nuk erdhi nga gruaja; jo, gruaja erdhi nga burri”

Termi “erdhi” nuk është në tekstin grek. Është vetëm parashtesa *ek* (dmth., nga), siç është tek 1 Kor. 11:12. Pali po pranon radhën e krijimit tek 1 Kor. 11:7 dhe 9 nga Zanafilla 2 (dmth., Adami i pari, pastaj Eva). Megjithatë, tek 1 Kor. 11:8-9,11, Pali pranon varësinë e tyre të ndërsjelltë (e cila aludohet tek Zan. 1:27 dhe 2:18).

**11:9 “burri nuk u krijua për gruan”** Ne duhet të kujtojmë se pohimi i Palit tek Gal. 3:28 mbi lirinë e grave nuk e minimizon dallimin e krijuar midis dy seksëve, të paktën në këtë epokë. Liria e plotë e burrave dhe grave në Krishtin nuk do të thotë automatikisht të heqësh të gjitha pritishtëritë kulturore / tradicionale të roleve. Besimtarët (burrat dhe gratë) nuk duhet të valëvisin liritë personale, të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e kishës në mes të kulturës jobesimtare. Besimtarët e pjekur e kufizojnë lirinë e tyre në Krishtin për hir të Mbretërisë së Tij. Besimtarët kanë një përgjegjësi të përbashkët ndaj (1) trupit të Krishtit dhe (2) komunitetit jobesimtar!

**11:10 “Prandaj gruaja, për shkak të engjëjve, duhet të ketë një shenjë pushteti mbi kryet”** Ky tekst, sikurse të gjithë të tjerët në këtë kontekst, mund të kuptohet në disa mënyra. Çështja kyçe është se çfarë përfaqëson “pushteti” (dmth., *exousia*)?

Së pari, duhet të vihet re se *exousia* shpesh lidhet me *dunamis*. Otto Betz ka një artikull interesant mbi *exousia* tek *New International Dictionary of New Testament Theology* [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re], vol. 2, fq. 606-611. Më poshtë gjenden pesë shembuj.

“Është karakteristikë e Dhjatës së Re që si *exousia* ashtu edhe *dunamis* të lidhen me veprën e Krishtit, rregulli i ri si pasojë e strukturave fuqi dhe besimtarëve të fuqizuar” (fq. 609).

“*Exousia* e besimtarëve. Pushteti i një besimtari të krishterë gjendet në sundimin e Krishtit dhe në çarmatimin e të gjitha fuqive. Ai nënkupton si liri ashtu edhe shërbim” (fq. 611).

“Ai është i lirë të bëjë çdo gjë (1 Kor. 6:12; 10:23 *exestin*); ky është një pohim, i cili u bë fillimisht nga entuziastët sektarë në Korint, i marrë më pas nga Pali i cili pranoi se është e saktë” (fq. 611)

“Megjithatë, në praktikë, kjo liri e pakufizuar teorikisht sundohet nga konsiderata e asaj që është ndihmëse për të krishterët e tjerë individual dhe për kongregacionin në tërësi nën dritën e faktit që shpengimi i plotë ende nuk ka ardhur (1 Kor. 6:12; 10:23)” (fq. 611).

“‘Gjithçka më lejohet [*exestin*],’ por jo gjithçka është dobishme; ‘gjithçka më lejohet [*exestin*],’ por jo çdo gjë ndërton. Askush të mos kërkojë interesin e vet, por atë të tjetrit. (1 Kor. 10:23 e në vazhdim). Citimet brenda këtyre thonjzave (‘) janë ndoshta sloganet e libertalëve në Korint. Pali i përball ato duke pranuar të vërtetën e tyre, por duke treguar se nuk është e vërteta e plotë” (fq. 611)

Pali përdor këto dy terma shpesh në letrat e tij drejtuar kishës në Korint.

1. *exousia*, 1 Kor. 7:37; 9:4,5,6,12 (dy herë),18; 11:10; 2 Kor. 13:10

2. *dunamis*, 1 Kor. 1:18; 2:4,5; 4:19,20; 5:4; 15:24,43; 2 Kor. 4:7; 6:7; 8:3 (dy herë); 12:9; 13:4 (dy herë)

Të drejtat dhe fuqia ishin çështjet kryesore si për legalistët ashtu edhe për liberalët. Pali përpiqet të ecë në një vijë të hollë midis dy ekstremeve. Në këtë kontekst gratë e krishtera inkurajohen për të pranuar rendin e krijimit të dhënë nga Perëndia (dmth., Krishti-burri-gruaja) për qëllimin e përparimit të Mbretërisë. Pali pranon ndërsjelljen origjinale (shih Zan. 1:26-27; 2:18) tek vargjet 11-12. Është shumë e rrezikshme teologjikisht të

1. izolosh një varg në këtë kontekst

2. zbatosh një kornizë sistematike denominacionale mbi çështjen e marrëdhënies së burrave dhe grave / bashkëshortëve dhe bashkëshorteve të shekullit të parë në çdo kulturë në çdo shekull

3. të humbasësh ekuilibrin e Palit midis lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së përbashkët të besëlidhjes së krishterë

Ku e gjetën gratë e krishtera lirinë për të marrë pjesë si drejtuese në adhurimin e përbashkët (dmth., kisha-shtëpi)? Me siguri jo nga një sinagogë. Ishte një trend kulturor nga shoqëria romake e shekullit të parë? Kjo është patjetër e sigurtë dhe sipas mendimit tim ndihmon të shpjegohen shumë aspekte të këtij kapitulli. Megjithatë, gjithashtu është e mundur që fuqia e ungjillit, restaurimi i “shëmbëllimit fillestar të Perëndisë” të humbur tek

rënia, të jetë burimi. Gjendet një liri e re shokuese në të gjitha zonat e jetës dhe shoqërisë njerëzore. Por kjo liri mund të kthehet në një leje për abuzim personal. Është një zgjatim i papërshtatshëm i asaj së cilës Pali po i drejtohet.

Libri *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve] e F. F. Bruce më ka ndimuar mua vërtet për të menduar për shumë nga çështjet kundërshtuese të lidhura me traditat e kishës moderne të krishterimit perëndimor. Si një studiues i Biblës, unë gjithmonë kam menduar se mbulimi i grave kishte për qëllim të tregonte dhuntinë e Perëndisë (ose bashkë-barazinë e Zan. 1:26, 27), jo autoritetin e bashkëshortit të saj. Megjithatë, unë nuk do të mund ta gjeja këtë interpretim mes burimeve biblike që unë përdor, prandaj, e kisha të vështirë ta vendosja në komentare apo të predikoja / mësoja rreth saj. Ende e mbaj mend gëzimin dhe lirinë që ndjeva kur F. F. Bruce mendonte të njëjtën gjë (shih *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve], fq. 95). Unë mendoj se të gjithë besimtarët janë shërbëtorë të Krishtit të thirrur, me kohë të plotë dhe plot dhunti!

■ **“për shkak të engjëjve”** Gjenden tre linja interpretimi të këtij pasazhi që lidhet me engjëjt.

1. Që referenca është ndaj engjëjve si përfaqësues të Perëndisë që janë të pranishëm në shërbesat tona të adhurimit si vrojtues, 1 Kor. 4:9; 1 Tim. 5:21; Ps. 138:1; dhe gjithashtu Dorëshkrimet e Detit të Vdekur
2. Që këta janë engjëj të këqij me dëshira seksuale të ngjashme me ato të engjëjve tek Zan. 6:2; 2 Pjet. 2:4; dhe Juda 6; engjëjt përmenden shpesh tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 4:9; 6:3; 11:10; 13:1)
3. Përkthimi i *angelous* si “lajmëtarë” në vend të “engjëj”

Termet për lajmëtar dhe engjëll janë të njëjtat si në hebraisht (dmth., *malak*) edhe në greqisht (dmth., *angelos*). Kjo teori bazohet në zakonet shoqërore të shekullit të parë (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali La Korintin], fq. 133-138). Një person me status nuk do të vizitonte një kishë shtëpi pa dërguar dikë që të kontrollonte fillimisht takimin. Kjo ka më shumë kuptim se sa të përipiqesh të lidhësh 1 Kor. 11:10 me engjëj epshorë apo engjëj të shqetësuar për gjendjen e tyre (shih Ps. 138:1) në adhurimet e përbashkëta.

**11:11-12 “në Zotin as burri s’është pa gruan, as gruaja pa burrin”** Këto vargje theksojnë ndërsjelljen midis burrave dhe grave (shih Zan. 1:26-27; 2:18; Gal. 3:26-29). Kjo liri (dmth., rikthimi në modelin fillestar të krijimit tek Zan. 1:26-27) duhet të shprehet në mënyra të përshtatshme brenda kulturës së rënë të dikujt. Nuk ka asnjë dyshim në pohimin e Palit të shpengimit të plotë të Jezusit që ndryshon statusin e çdo besimtari! Ne të gjithë jemi një në Krishtin. Qëllimi ynë tani është të ndihmojmë të afërmit tanë dhe qytetarët e rënë që të gjejnë po këtë shpengim. Gjenden ende çështje sociale në çdo kulturë. Për shkak se besimtarët munden, nuk do të thotë se ata duhet të bëjnë diçka!

Përdorimi i fjalës “nga” (dmth., *ek*, fjalë për fjalë “prej”) në këtë kontekst (dy herë) duket se përforcon përdorimin e “kryet” si “origjinë”. Gruaja është prej burrit; burri është prej Perëndisë. Historia e Zanafillës gjithashtu jep bazën për “krye” si rendi i duhur i krijimit. Si liria dhe nënshtrimi në Krishtin (shih Efe. 5:21) janë të përshtatshme kur e mira e kishës është qëllimi përfundimtar.

**11:13-15** Pali përdor po të njëjtën përjasje tek 1 Kor. 10:15 ku mund të ishte sarkastike, i bazuar në këtë përdorim të “burra të mençur” (shih 1 Kor. 4:10; 2 Kor. 11:10), por këtu nuk duket sarkastik por më shumë në kuptimin e “një mendimi kulturor”. Pali përdor etiketën korintase / greko-romake / të shekullit të parë.

1. Gratë e martuara duhet të mbulohen në publik ose në veprime adhurimi (1 Kor. 11:13).
2. Djemtë e rinj në Korint i mbanin flokët e tyre të gjata gjatë kalimit të tyre në burra (dmth., në moshën 10 vjeçare). Të mbaje flokët e gjatë ishte një shenjë kulturore e feminitetit ose homoseksualitetit (1 Kor. 11:14).
3. Gratë me flokë më të shkurtër identifikoheshin ose si
  - a. Një grua që ishte turpëruar në mënyrë publike
  - b. Një prostitutë (1 Kor. 11:15).

Këto nuk janë njohuri frymërore dhe as njohuri biblike (dmth., ato nuk përshtaten me zakonet hebraike), por janë njohuri kulturore.

**11:13 “veten tuaj”** Kjo është e theksuar.

**11:14-15 “në qoftë se... në qoftë se”** Këto janë të dyja fjali kushtore të rendit të tretë, të cilat flasin për veprim të mundshëm.



Përkthime të ndryshme në anglisht i pikësojnë këto vargje si pyetje (dmth., NRSV, NJB); pohime (dmth., NASB, TEV); ose si një pyetje dhe një pohim (dmth., NKJV). Pjesëza që e përcakton një pyetje tek 1 Kor. 11:14 tregon se është një pyetje që pret një “po” si përgjigje.

**11:16 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë e cila nënkuptohet të jetë e vërtetë nga pikëpamja e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Kishte të krishterë kundërshtues në kishën në Korint.

**NASB** “njëri ka prirje të jetë kundërshtues”  
**NKJV** “ndokush duket të jetë kundërshtues”  
**NRSV** “ndokush është i prirur të jetë kundërshtues”  
**TEV** “ndokush dëshiron të diskutojë për këtë”  
**NJB** “ndokush dëshiron të jetë kundërshtues”

Folja është një formë treguese aktive e tashme, e cila nënkupton veprim të vazhdueshëm. Kjo kundërshti është një qëndrim i vazhdueshëm për ta. Ata e dëshironin shumë grindjen dhe diskutimin!

Termi “kundërshtues” është një përbërje e *philos* (dmth., dashuri) dhe *veikos* (dmth., zënkë). Ai përdoret për apostujt në Darkën e Fundit tek Luka 22:24.

☐ **“ne s’kemi zakon të tillë, as kishat e Perëndisë”** (shih 1 Kor. 11:4:17). Pali nuk po i u jep atyre diçka të veçantë (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:16; 14:33). Kjo kishë po përlëvdohej në urtësinë dhe lirinë e saj. Ata mendonin se kishin të drejtën të jetonin ndryshe nga kishat e tjera të krishtera. Pali shpall se nuk është kështu!

☐ **“kishat”** Shih Temën e Veçantë: Kisha (*eklesia*) tek 1 Kor. 1:2.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 11:17-22

<sup>17</sup> Por, duke porositur këtë, unë nuk ju lavdëroj, se ju mblidheni, jo për më të mirën, po për më të keqen. <sup>18</sup> Para së gjithash, sepse dëgjoj se kur bashkoheni në asamble ka midis jush përçarje, dhe pjesërisht e besoj. <sup>19</sup> Sepse duhet të ketë midis jush edhe grupime, që të njihen në mes tuaj ata që janë të sprovuar. <sup>20</sup> Kur mblidheni bashkë, pra, në një vend, kjo që bëni nuk është për të ngrënë darkën e Zotit, <sup>21</sup> sepse, në të ngrënë, gjithësecili merr darkën e vet më përpara; dhe njëri ka uri dhe tjetri është i dehur. <sup>22</sup> A nuk keni, pra, shtëpi për të ngrënë e për të pirë? Apo përbuzni kishën e Perëndisë dhe turpëroni ata që s’kanë asgjë? Çfarë t’ju them juve? T’ju lavdëroj? Për këtë nuk ju lëvdoj.

**11:17** Pali po fillon një temën të re, por qëndrimet krenare të disa besimtarëve të krishterë janë ende fokusi. Tema ndryshon, por problemi thelbësor nuk ndryshon.

1. Elitizmi i tyre
2. Theksi i tyre mbi lirinë personale
3. Supozimi i tyre i urtësisë

Të gjitha temat e adresuara nga Pali (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 16:1), të cilat iu dërguan atij me letra, vërtiten rreth të njëjtave çështje.

Edhe festat e tyre kolektive të dashurisë (shih Juda 1:12) ktheheshin në festa “më shumë për mua”! E drejta, aftësia dhe statusi i zinin vendin dashurisë, shërbimit dhe shëndetit të Trupit.

☐ **“unë nuk ju lavdëroj”** Pali i ka mbrojtur ata tek 1 Kor. 11:2, por në këtë pikë ai mundet vetëm t’i qortojë ata.

☐ **“se ju mblidheni”** Ky është termi i përbërë grek *sunerchomai*. Pali është shumë i dhënë pas fjalëve të përbëra *sun*. Parashtesa në thelb do të thotë “së bashku me”. Ky term shpreh të njëjtën ide si sinagoga, e cila i referohet mbledhjeve të përbashkëta të besimtarëve. Kapitujt 11-14 trajtojnë adhurimin e përbashkët (shih 1 Kor.

11:17,18,20,33,34; 14:23,26).

Unë vras mendjen se si funksiononte kjo “mbledhje së bashku”. Dukshëm kishte kisha-shtëpi të ndryshme në Korint, ndoshta burimi i disa prej grupeve të përçara. A nënkupton Pali këtu se të gjitha kishat-shtëpi takoheshin së bashku për Darkën e Zotit?

**11:18 “Para së gjithash”** Kjo frazë mund të kuptohet në dy mënyra.

1. E rëndësisë së parë (NKJV)
2. E para nga dy ose më shumë çështje, megjithatë, nuk përmendet një “e dytë” në kontekst
3. E njëjta strukturë gramatikore gjendet tek Rom. 1:8

▣ **“ka midis jush përçarje”** Këto përçarje përmenden së pari tek 1 Kor. 1:10-17 dhe 3:3-4, por prania e tyre supozohet përgjatë librit. Në këtë kontekst përçarja nuk është mbi drejtuesin, por karakterizohet nga faktorë socio-ekonomikë. Kjo mund të përkufizojë grupet e përçara si përfaqësues të klasave shoqërore ashtu edhe të thekseve teologjike.

### 11:19

**NASB, NKJV** “Sepse duhet të ketë midis jush edhe grupime”

**NRSV** “Në fakt, duhet të ketë midis jush grupime”

**TEV** “(Nuk ka dyshim që duhet të ketë përçarje midis jush”

**NJB** “duhet të ketë grupe të ndryshme midis jush”

Termi është “grupim” (1 Kor. 11:19, dmth., *hairesis*), nga i cili marrim fjalën herezi. Etimologjia bazë e saj është “të zgjedhësh” ose “të përzgjedhësh”, por me domethënien e tregimit të një favoriti të veçantë, të zgjedhësh dikë dhe të refuzosh zgjedhjet e tjera (shih Veprat e Apo. 24:14; 1 Kor. 11:19; Gal. 5:20). Ai mund të përdoret për të përshkruar (1) një person që beson në mësimet e rreme (shih Titit 3:10) ose (2) vetë mësimin e rremë (shih 2 Pjet. 2:1).

Gjendet një term tjetër i përdorur tek 1 Kor. 11:18, “përçarje” (dmth., *schisma*), nga i cili ne marrim fjalën skizmë – përçarje. Etimologjia bazë e saj është “të ndash” (shih Mat. 27:51). Ai përdoret për përçarjen e grupeve mbi një çështje (shih Gjoni 7:43; 9:16; 10:19; Veprat e Apo. 14:4; 23:7; 1 Kor. 1:10; 11:18).

Pali përmend një qëllim teologjik (dmth., *hina*) dhe nevojën (dmth., *dei*) për praninë e këtyre grupeve të ndryshme. Ata ishin të nevojshëm që drejtuesit e tyre të vërtetë frymorë të zbuloheshin qartazi. Drejtuesit e pjekur bëhen të dukshëm në kohë krize.

Mundësia tjetër është që disa grupe dhe drejtuesit e tyre do të tregojnë me veprimet e tyre se nuk janë aspak të krishterë (shih 1 Gjoni 2:19; Mark 4:16-19).

▣ **“ata që janë të sprovuar”** Shih Temën e Veçantë: TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVE” tek 1 Kor. 3:13.

**11:20 “nuk është për të ngrënë darkën e Zotit”** Këto grupime të elitës sociale të privileguara po silleshin në mënyra tërësisht të huaja ndaj precedentëve komunitarë dhe vetë-dhënës të darkës së fundit të Jezusit me dishepujt e Tij. Vargjet që pasojnë e qartësojnë pikën e tij (shih 1 Kor. 11:22).

▣ **“darkën e Zotit”** Kjo është e vetmja shfaqje e kësaj fraze në Dhjatën e Re. Ky është ndoshta një shembull tjetër i sarkazmës. Asgjë rreth qëndrimeve dhe veprimeve të tyre nuk krahasohet me qëndrimet dhe veprimet e Jezusit në dhënien e Vetes së Tij për njerëzimin mëkatar!

Ky takim adhurimi ka disa emra

1. Darka e Zotit
2. “tavolina e Zotit” (1 Kor. 10:21)
3. “thyerja e bukës” (Veprat e Apo. 2:42; 20:7; 1 Kor. 10:16; 11:24 [shih Luka 24:30])
4. Falenderimi (dmth., *eucharist*) ose bekimi (dmth., *eulogia*, Mat. 26:26-27; 1 Kor. 10:16; 11:24)

**11:21 “gjithësecili merr darkën e vet më përpara”** Kisha e hershme kombinonte Darkën e Zotit dhe një vakt bashkësie të quajtur “Agape” (shih 2 Pjet. 2:13; Juda 12, dhe ndoshta Veprat e Apo. 20:7).

Është e mundur të kuptosh këtë frazë në mënyra të ndryshme.

1. Të pasurit / edukuarit / ndikuesit / të lindur në familje të larta vinin herët dhe hanin vaktin e tyre shpejt në mënyrë që kur të vinin të varfërit, të mos kishte asgjë, ose pothuajse asgjë, të mbetur për të ngrënë.
2. Çdo person duhej të sillte ushqimin e tij. Besimtarët elitë hanin vaktet e tyre shpejt në prani të të varfërve, ose anëtarëve skllëvër të kishës, të cilët sillnin pak ose aspak.

Problemi ishte egoizmi dhe grykësia të bazuara në dallimet sociale dhe jo dashuria vetë-dhënëse, ashtu siç mësuan dhe pararendën qartazi veprimet e Jezusit. Kisha korintase nuk besonte se ata ishin një në Krishtin. Kishte dikotomi radikale midis

1. Kanë dhe nuk kanë – nga ana sociale
2. Të pasurve dhe të varfërve
3. Burrave dhe grave
4. Të lirëve dhe skllëvërve
5. Romakëve dhe gjithë të tjerëve
6. Elitës frymërore dhe besimtarit të zakonitë

Këto dallime adresohen qartazi tek 1 Kor. 11:21 dhe 22.

▣ **“njëri ka uri dhe tjetri është i dehur”** Nëse kjo ishte shkaktuar nga dallimet shoqërore romake apo nga egoizmi, qartazi tregohet një situatë e papranueshme. Qëllimi i vaktit të kujtimit dhe marrëdhënies së përbashkët ishte harruar. Kjo ishte një çështje serioze (shih 1 Kor. 11:23). Ky varg nuk mund të përdoret për të mbrojtur një mungesë të plotë të këtyre gjërave. Është e dukshme se vera ishte pjesë e kësaj përvoje. Është abuzimi ai që dënohet.

### **TEMË E VEÇANTË: QËNDRIMET BIBLIKE NDAJ ALKOOLIT DHE ALKOOLIZMIT (SPECIAL TOPIC: BIBLICAL ATTITUDES TOWARD ALCOHOL AND ALCOHOLISM)**

#### **I. Termat biblikë**

##### **A. Dhjata e Vjetër**

1. *Yayin* – ky është term i përgjithshëm për verën (BDB 406, KB 409), që përdoret 141 herë. Etimologjia e tij është e paqartë pasi nuk vjen nga një rrënjë hebraisht. Gjithmonë ka kuptimin “lëng fryti i fermentuar”, zakonisht nga rrushi. Disa pasazhe tipike janë Zan. 9:21; Eks. 29:40; Num. 15:5, 10.
2. *Tirosh* – Kjo është “verë e re” (BDB 440, KB 1727). Për shkak të kushteve klimatike të Lindjes së Afërt, fermentimi fillonte që gjashtë orë pas nxjerrjes së lëngut. Ky term i referohet verës në procesin e fermentimit. Për disa pasazhe tipike, shih Ligji i Përt. 12:17; 18:4; Isa. 62:8-9; Os. 4:11.
3. *Asis* – Qartazi, këtu bëhet fjalë për pije alkoolike (“verë e ëmbël”, BDB 779, KB 860, p.sh., Joeli 1:5; Isa. 49:26).
4. *Sekar* – ky term do të thotë “pije e fortë” (BDB 1016, KB 1500). Rrënja hebraisht përdoret në termin “i dehur” ose “pijanec”. Atij i shtohet diçka për ta bërë më dehës. Është fjalë paralele me *yayin* (shih Fja. 20:1; 31:6; Isa. 28:7).

##### **B. Dhjata e Re**

1. *Oinos* – fjala greqisht që është e barasvlershme me *yayin*
2. *Neos oinos* (verë e re) – fjala greqisht e barasvlershme me *tirosh* (shih Marku 2:22).
3. *Gleukos vinos* (verë e ëmbël, *asis*) – verë në fazat e para të fermentimit (shih Veprat 2:13).

#### **II. Përdorimi biblik**

##### **A. Dhjata e Vjetër**

1. Vera është dhuratë nga Perëndia (Zan. 27:28; Psa. 104:14-15; Pred. 9:7; Os. 2:8-9; Joeli 2:19, 24; Amosi 9:13; Zak. 10:7).
2. Vera është pjesë e ofrimit flijues (Eks. 29:40; Lev. 23:13; Num. 15:7, 10; 28:14; Ligji i Përt. 14:26; Gjyq. 9:13).
3. Vera përdoret si ilaç (2 Sam. 16:2; Fja. 31:6-7).
4. Vera mund të jetë problem i vërtetë (Noeu – Zan. 9:21; Loti – Zan. 19:33, 35; Samsoni – Gjyq. 16; Nabali – 1 Sam. 25:36; Uriahu – 2 Sam. 11:13; Amoni – 2 Sam. 13:28; Elahu – 1 Mbret. 16:9; Benhadadi – 1 Mbret. 20:12; Sundimtarët –

- Amosi 6:6; dhe Zonjat – Amosi 4).
- 5.Me verën mund të abuzohet (Fja. 20:1; 23:29-35; 31:4-5; Isa. 5:11, 22; 19:14; 28:7-8; Osea 4:11).
- 6.Vera iu ndalohej grupeve të caktuara (priftërinjve në detyrë, Lev. 10:9; Ezek. 44:21; nazaritëve, Num. 6; dhe sundimtarëve, Fja. 31:4-5; Isa. 56:11-12; Osea 7:5).
- 7.Vera përdoret në kontekstin eskatologjik (Amosi 9:13; Joeli 3:18; Zak. 9:17).
- B. Periudha ndërdhjatore
- 1.Vera, me masë, është shumë e dobishme (Predikuesi 31:27-30).
- 2.Rabinët thonë: “Vera është ilaçi më i shkëlqyer; aty ku vera mungon, atëherë nevojiten ilaçet” (BB 58b).
- C. Dhjata e Re
- 1.Jezusi shndërroi një sasi të madhe uji në verë (Gjoni 2:1-11).
- 2.Jezusi piu verë (Mat. 11:18-19; Luka 7:33-34; 22:17 e më tej).
- 3.Pjetri u akuzua për dehje me “verë të re” në ditën e Rrëshajave (Veprat e Apo. 2:13).
- 4.Vera mund të përdoret si ilaç (Marku 15:23; Luka 10:34; 1 Tim. 5:23).
- 5.Drejtimesit nuk duhet të jenë abuzues me verë. Kjo nuk do të thotë se duhet të mos pinë fare alkool (2 Tim. 3:3, 8; Titi 1:7; 2:3; 1 Pje. 4:3).
- 6.Vera përdoret në kontekste eskatologjike (Mateu 22:1 e më tej; Zbu. 19:9).
- 7.Dehja shihet me sy të keq (Mat. 24:49; Luka 12:45; 21:34; 1 Kor. 5:11-13; 6:10; Gal. 5:21; 1 Pje. 4:3; Rom. 13:13-14).

### III. Mësime teologjike

- A. Tensioni dialektik
- 1.Vera është dhuratë nga Perëndia.
- 2.Dehja përbën problem të madh.
- 3.Në disa kultura, besimtarët duhet t’i kufizojnë liritë e tyre për hir të ungjillit (Mat. 15:1-20; Marku 7:1-23; 1 Korintasve 8-10; Romakëve 14).
- B. Prirja për t’i kaluar caqet e dhëna
- 1.Perëndia është burimi i të gjitha gjërave të mira.
- a. Ushqimi – Marku 7:19; Luka 11:44; 1 Kor. 10:25-26
- b. Të gjitha gjërat e pastra – Rom. 14:14, 20; 1 Tim. 4:4
- c. Të gjitha gjërat e lejueshme – 1 Kor. 6:12; 10:23
- d. Të gjitha gjërat e pastra – Titit 1:15
- 2.Njerëzimi i rënë ka abuzuar me të gjitha dhuratat e Perëndisë duke i çuar përtej kufijve të caktuar nga Perëndia.
- C. Abuzimi është faji ynë, jo i gjërave. Nuk ka asgjë të keqe në krijimin fizik (shih pikën B 1. më lartë).

### IV. Kultura dhe fermentimi judaik në shekullin e parë

- A. Fermentimi fillon shumë herët, rreth 6 orë pasi është shtypur rrushi.
- B. Tradita judaike thotë se, kur në sipërfaqe shfaqet një shkumë e lehtë (shenjë e fermentimit), ajo duhet t’i nënshtrohet të dhjetave të verës (Maaseroth 1:7). Quhet “verë e re” ose “verë e ëmbël”.
- C. Fermentimi i parë i fortë përfundonte pas një jave.
- D. Fermentimi dytësor kërkonte rreth 40 ditë. Në këtë fazë, konsiderohej “verë e vjetruar” dhe mund të ofrohej në altar (Edhujoth, 6:1).
- E. Vera që kishte pushuar mbi llumin e vet (vera e vjetër) konsiderohej e mirë, por duhej kulluar mirë përpara përdorimi.
- F. Vera konsiderohej e vjetruar sa duhet zakonisht pas një viti fermentimi. Tre vite ishte periudha më e gjatë kohore që vera mund të magazinohet e sigurt. Ajo quhej “verë e vjetër” dhe duhej holluar me ujë.

G. Vetëm në 100 vitet e fundit është arritur të vonohet periudha e fermentimit, për shkak të mjedisit steril dhe kimikateve të shtuara. Bota e lashtë nuk e ndalonte dot procesin e natyrshëm të fermentimit.

V. Pohime përmyllëse

- A. Sigurohu që përvoja, teologjia dhe interpretimi yt biblik të mos nënvlerësojë Jezusin dhe kulturën judaike/të krishterë të shekullit të parë! Është e qartë se ata nuk ishin njerëz që s'pinin fare alkool.
- B. Nuk po mbroj përdorimin shoqëror të alkoolit. Megjithatë, shumë vetë e kanë ekzagjeruar pozicionin e Biblës për këtë temë dhe, tani, pretendojnë drejtësi më të lartë për shkak të anshmërisë së tyre kulturore / denominacionale.
- C. Për mendimin tim, Romakëve 14 dhe 1 Korintasve 8-10 na sigurojnë mësim dhe udhëzime të bazuara në dashurinë dhe respektin për bashkëbesimtarët dhe për përhapjen e ungjillit në kulturën tonë, dhe jo liri vetjake apo kritika plot gjykim. Nëse Bibla është i vetmi burim për besimin dhe praktikën, atëherë, ndoshta të gjithë ne duhet ta mendojmë nga e para këtë çështje.
- D. Nëse themi se mospirja absolute e alkoolit është vullneti i Perëndisë, çfarë po themi për Jezusin, si dhe për ato kultura që përdorin rregullisht verë (p.sh., Evropa, Izraeli, Argjentina)?

☐ **“A nuk keni, pra, shtëpi për të ngrënë e për të pirë”** Disa legalistë dhe liberalë janë përpjekur për të përdorur këtë tekst të nxjerrë nga konteksti për të mos ngrënë në kishë. Historia dhe konteksti janë gjithmonë thelbësore në interpretimin e letërsisë antike. Duke cituar pjesë të vogla nga Shkrimet mund ta bëjmë Biblën / Perëndinë të thotë pothuajse çdo gjë! Sikurse ka thënë Gordon Fee: “Një libër që mund të thotë çdo gjë, nuk do të thotë asgjë!” Gjendet një seri pyetjesh retorike të cilat zbulojnë emocionin me të cilin Pali po shkruan. Ai është i shokuar nga veprimet e disa prej kishave (shih Jakobi 2:6).

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 11:23-26**

<sup>23</sup> Sepse unë mora nga Zoti atë që ju transmetova edhe juve; se Zoti Jezus, në atë natë që po tradhetohej, mori bukën <sup>24</sup> dhe, si falënderoi, e theu dhe tha: “Merrni, hani; ky është trupi im që është thyer për ju; bëni këtë në përkujtimin tim.” <sup>25</sup> Gjithashtu, pas darkës, Ai mori edhe kupën, duke thënë: “Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim; bëni këtë sa herë që të pini, në përkujtimin Tim.” <sup>26</sup> Sepse sa herë të hani nga kjo bukë ose të pini nga kjo kupë, ju shpallni vdekjen e Zotit, derisa ai të vijë.

**11:23 “Sepse unë mora nga Zoti atë që ju transmetova edhe juve”** Pali nuk ishte i pranishëm në Darkën e Zotit. Ai deklaroi tek Gal. 1:11-17 se ka marrë zbuluesë drejtpërsëdrejti nga Jezusi dhe tek Gal. 1:18-19, se nuk e ka marrë nga apostujt e tjerë apo nga drejtuesit e Jeruzalemit. Megjithatë, fjalët e tij këtu reflektojnë një njohuri të traditave të Ungjijve Sinoptikë.

☐ **“mori bukën”** Është e rëndësishme që Jezusi nuk përdori qengjin e Pashkës si një simbol. Ishte tepër i lidhur me Besëlidhjen e Vjetër (shih Eksod. 12). Buka u bë simboli i ri i unitetit (10:16-17).

**11:24 “dhe, Ai si falënderoi, Ai e theu dhe tha”** Kjo i drejtohet një veprimi specifik historik (dmth., vakti i Pashkës në dhomën e sipërme natën përpara se Jezusi të tradhetohej). Shumë të krishterë e quajnë ceremoninë *Eucharist*, që është forma greke e fjalës “të falenderosh” (dmth., *eucharisteō*, shih Mat. 26:27; Mark 14:22; Luke 22:19).

NASB “Ky është trupi im, i cili është për ju”

NKJV “Merrni, hani; ky është trupi im që është thyer për ju”

NRSV “Ky është trupi im, që është për ju”

## TEV, NJB “Ky është trupi im, i cili është për ju”

Kjo është dukshëm metaforike. Kanibalizmi do të ishte një horror për këdo hebre. Jezusi po përdor bukën e thyer si një simbol të trupit të Tij të thyer në Kalvar. Sikurse buka jep ushqim fizik dhe jetë për ata që e hanë atë, kështu edhe veprimet e Jezusit japin jetë frymërore ndaj atyre që e pranojnë atë.

Ka pasur shumë debat teologjik mbi kuptimin e fjalëve të Jezusit. Shumë nga diskutimet bazohen mbi (1) natyrën e ngjarjes dhe (2) mënyrën se si Perëndia siguron hir. Ata që e shohin këtë si një sakrament varen thellësisht mbi Gjonin 6, i cili në këtë kontekst, nuk ka aspak të bëjë me Darkën e Zotit.

Ka disa variante dorëshkrimesh greke mbi këtë frazë.

1. Textus Receptus shton: “merrni, hani”. Kjo gjendet në variantet greke MSS C<sup>3</sup>, K, L, dhe P. Nuk është origjinali.
2. Frazja e shkurtër e Palit “për ju” (shih MSS P<sup>46</sup>,  $\kappa^*$ , A, B, C<sup>\*</sup>) është zgjeruar nga skribët e hershëm në disa mënyra:
  - a) “thyer për ju” (shih MSS  $\kappa^2$ , C<sup>3</sup>, D<sup>2</sup>, F, G)
  - b) “derdhur për ju” (shih MS D<sup>\*</sup>)
  - c) “dhënë për ju” (shih Luka 22:19)

UBS<sup>4</sup> e vlerëson tekstin më të shkurtër (tek *huper humōn*) si “A” (i sigurtë).

**11:24-25 “bëni këtë në përkujtimin Tim”** Kjo është ose një formë treguese aktive e tashme ose urdhërore aktive e tashme. Forma urdhërore i përshtatet më mirë kontekstit. Ky vakt simbolik duhet të përsëritet rregullisht deri sa Jezusi të kthehet.

Është interesante që në regjistrimin e Darkës së Zotit tek Ungjijt e Mateut dhe të Markut fraza “bëjeni këtë në përkujtimin Tim” nuk përfshihet. Megjithatë, ajo nuk shfaqet tek Luka 22:19 dhe 1 Kor. 11:24-25. Është shumë befasuese që një ndodhi dukshëm e rëndësishme në jetën e Jezusit, e cila duhej të përsëritej, regjistrohet me kaq shumë varietet tek ungjijt dhe shkrimet e Palit.

Dhjata e Re nuk e specifikon se sa shpesh duhet të bëhet kjo. Disa grupe besimtarësh nuk e bëjnë kurrë (dmth., Quakers), të tjerë e bëjnë çdo javë. Ato grupe të krishterësh që kanë një pikëpamje sakramentale të Darkës dukshëm e bëjnë atë një ndodhi të përsëritur (dmth., çdo javë) dhe kryesore. Besimtarët e hershëm palestinezë mund ta kenë bërë atë një herë në vit në lidhje me Pashkën (dmth., Ebionitët, shih Origen dhe Epiphanius). Ata të krishterë të cilët janë të shqetësuar për përsëritjen e ritualeve dhe humbjen e ndikimit dhe rëndësisë së tyre dhe nuk e shohin atë si një kanal hiri, zakonisht e bëjnë Darkën më rrallë (dmth., Baptistët Jugorë – një herë në tremujor).

**11:25 “Kjo kupë është besëlidhja e re”** Kjo besëlidhje e re përmendet specifikisht tek Jer. 31:31-34 (përkthyer tek Ezek. 36:22-38). Termi grek për besëlidhje fillimisht do të thoshte “një testament” ose “testamenti i fundit”, por kuptimi këtu reflekton përdorimin e Septuagint-it për termin si “besëlidhje”. Koncepti i “një besëlidhje e re” duhet të ketë qënë shokuese për hebrejtë. Ata po besonin në vazhdimësinë e besëlidhjes së Moisiut. Jeremia duhej t’ju rikujtonte atyre se besëlidhjet e YHWH ishin kushtore mbi një përgjigje me besim dhe pendesë.

## TEMË E VEÇANTË: BESËLIDHJA (SPECIAL TOPIC: COVENANT)

Fjala e Dhjatës së Vjetër, *berith* (BDB 136, KB 157), “besëlidhje”, s’përcaktohet dot lehtë. Nuk ekziston asnjë FOLJE që i përkon këtij emri në hebraisht. Çdo përpjekje për t’i dhënë një përcaktim etimologjik ka dalë jobindëse. Ndoshta gjetja më e mirë është “të presësh” (BDB 144), duke përcaktuar sakrifikimin e kafshëve që shoqëronte besëlidhjet (shih Zan. 15:10,17). Gjithsesi, rëndësia e qartë qendrore e këtij koncepti i ka detyruar studiuesit të shqyrtojnë përdorimin e kësaj fjale në përpjekje për t’i përcaktuar kuptimin funksional.

Besëlidhja është mjete me të cilin Perëndia i vetëm dhe i vërtetë përcakton marrëdhënien e Tij me krijesat njerëzore (shih Temën e Veçantë: Monoteizëm / Special Topic: Monotheism). Koncepti i besëlidhjes, traktatit, ose marrëveshjes, është thelbësor për të kuptuar zbuluesën biblike. Tensioni mes sovranitetit të Perëndisë dhe vullnetit të lirë njerëzor shihet qartë në konceptin e besëlidhjes. Disa besëlidhje bazohen kryekëput në karakterin dhe veprimet e Perëndisë

1. Vetë krijimi (shih Zan. 1-2)
2. Ruajtja e Noeut dhe premtimi për të (shih Zan. 6-9)
3. Thirrja e Abrahamit (shih Zan. 12)
4. Besëlidhja me Abrahamin (shih Zan. 15)

Sidoqoftë, nga vetë natyra, besëlidhja kërkon një përgjigje

1. Me anë të besimit, Adami duhet t’i bindet Perëndisë dhe të mos hajë nga pema në mes të Edenit
2. Me anë të besimit, Noeu duhet të ndërtojë një barkë të stërmadhe larg nga uji dhe të mbledhë kafshët
3. Me anë të besimit, Abrahami duhet të lërë familjen, të ndjekë Perëndinë dhe të besojë në brezat e ardhshëm
4. Me anë të besimit, Moisiu i nxori izraelitët nga Egjipti deri në malin Sinai dhe mori udhëzime të qarta për jetën fetare dhe shoqërore, bashkë me premtimet e bekimit dhe mallkimit (shih Levitiku 26; Ligji i Përtërirë 27-28)

I njëjti tension, që bën fjalë për marrëdhënien e Perëndisë me njerëzimin, përfshihet edhe në konceptin e “besëlidhjes së re” (shih Jer. 31:31-34; Heb. 7:22; 8:6,8,13; 9:15; 12:24). Ky tension mund të shihet qartë kur krahason Ezek. 18:31 me Ezek. 36:27-37 (veprimi i YHWH). A bazohet kjo besëlidhje në veprimet e hirshme të Perëndisë, apo në reagimin e detyrueshëm njerëzor? Kjo është çështja kyçe në Besëlidhjen e Vjetër dhe atë të Re. Synimet e të dyjave janë të njëjta:

1. ripërtëritja e bashkësisë me YHWH-në të humbur në Zanafilla 3;
2. formimi i njerëzve të drejtë që pasqyrojnë karakterin e Perëndisë.

Besëlidhja e re e Jer. 31:31-34 e zgjidh tensionin duke larguar veprimin njerëzor si mjet për të arritur pranimin nga Perëndia. Ligji i Perëndisë bëhet dëshirë e brendshme, jo kod i jashtëm ligji. Synimi për formimin e një populli të perëndishëm dhe të drejtë mbetet i njëjti, por metodologjia ndryshon. Njerëzimi i rënë e ka provuar veten të paaftë për të qenë pasqyrimi i përsosur i shëmbëllimit të Perëndisë. Problemi s’ ishte te besëlidhja e Perëndisë, por te mëkati dhe dobësia e njeriut (shih Zanafilla 3; Romakëve 7; Galatasve 3).

I njëjti tension mes besëlidhjeve të pakushtëzuara dhe atyre të kushtëzuara në Dhjatën e Vjetër mbetet edhe në Dhjatën e Re. Shpëtimi është kryekëput falas për shkak të veprës së përfunduar te Jezu Krishtit, por kërkon pendim dhe besim (si në fillim, ashtu dhe në vijimësi, shih Temën e Veçantë: Besim në Dhjatën e Re / Special Topic: Believe in the NT). Jezusi e quan marrëdhënien e Tij të re me besimtarët “një besëlidhje e re” (shih Mat. 26:28; Mark 14:24; Luka 22:20; 1 Kor. 11:25). Bëhet fjalë, si për një deklaratë ligjore, ashtu dhe për një thirrje për të qenë si Krishti (shih Mat. 5:48; Rom. 8:29-30; 2 Kor. 3:18; 7:1; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 4:13; 1 Thes. 3:13; 4:3,7; 5:23; 1 Pjet. 1:15), një shpallje e pranimin nga Perëndia (Romakëve 4), por edhe një urdhër për shenjtëri (Mat. 5:48)! Besimtarët nuk shpëtohen nga veprat e tyre, por gjithsesi shpëtohen për të treguar bindje (shih Efe. 2:8-10, 2 Kor. 3:5-6). Jeta e perëndishme bëhet prova e shpëtimit, jo mjete i tij (dmth., Jakobi dhe 1 Gjonit). Sidoqoftë, jeta e përjetshme ka disa tipare të vrojtueshme! Ky tension shihet qartë në paralajmërimet në Dhjatën e Re (shih Temën e Veçantë: Femohimi / Special Topic: Apostasy).

■ **“në gjakun tim”** Kjo i referohet konceptit hebraik të vdekjes sakrifikuese të Jezusit (shih 2 Kor. 5:21). Gjaku është një shprehje hebraike e Dhjatës së Vjetër që i referohet një sakrifice të dhënë Perëndisë (shih Lev. 17:11,14; Ligji i Përt. 12:23). Besëlidhja e parë u vulos me gjak të derdhur (shih Eksod. 24:8).

**11:26**

**NASB, NKJV, NRSV** “Sepse sa herë të hani ... pini”  
**TEV** “Që çdo herë që të hani... pini”  
**NJB** “Kurdoherë që hani... pini”

Vini re se nuk ka momente specifike që jepen këtu, ose në ndonjë vend tjetër, në Dhjatën e Re. Tek Veprat e Apostujve fraza karakteristike për të përshkruar Darkën e Zotit, “buka e thyer” përdoret për (1) një përjetesë ditore (2:42,46) ose (2) adhurimi i së dielës (20:7,11). Megjithatë, fraza gjithashtu përdoret për të treguar një vakt të rregullt (27:34-35).

■ **“ju shpallni vdekjen e Zotit”** Kjo qartazi tregon aspektin sakrifikues të vdekjes së Krishtit. Darka e Zotit është një vështrim mbrapa tek vdekja e Krishtit.

■ **“derisa Ai të vijë”** Darka e Zotit është një shikim para tek Ardhja e Dytë (shih 1 Kor. 1:7; 4:5; 11:26; Mark 14:25).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 11:27-32**

<sup>27</sup> Prandaj ai që ha nga kjo bukë ose pi nga kjo kupë e Zotit padenjësisht, do të jetë fajtor i trupit dhe i gjakut të Zotit. <sup>28</sup> Por secili të shqyrtojë vetveten dhe kështu të hajë nga buka e të pijë nga kupa, <sup>29</sup> sepse ai që ha dhe pi padenjësisht, ha dhe pi një dënim për veten e tij, sepse nuk e dallon trupin e Zotit. <sup>30</sup> Për këtë arsye ka në mes jush shumë të dobët e të sëmurë, dhe shumë vdesin. <sup>31</sup> Sepse, po të shqyrtonim veten tonë, nuk do të gjykohehim. <sup>32</sup> Por kur gjykohehi, ndreqemi nga Zoti, që të mos dënohehi bashkë me botën.

**11:27**

**NASB, NKJV, NRSV** “ai që ha nga buka ose pi nga kupa e Zotit”  
**KJV** “ai që ha nga kjo bukë ose pi nga kjo kupë e Zotit”  
**TEV** “që nëse njëri nga ju ha nga buka e Zotit ose pi nga kupa e tij”  
**NJB** “prandaj kushdo që ha bukën pi kupën e Zotit”

“Dhe” nuk është në tekstin original të 1 Kor. 11:27, por është tek 1 Kor. 11:28 dhe 29. “Ose” është në tekstin grek. Përkthyesit e King James Version kishin frikë se katolikët romakë e kuptonin si vendi ku prifti pinte verën dhe laikët hanin bukën, dhe e kanë përkthyer gabim qëllimisht këtë varg! NKJV e ka korrigjuar këtë përkthim të gabuar të qëllimtë (shih Bart Ehrman, *The Orthodox Corruption of Scripture* [Korrumpimi Ortodoks i Shkrimeve], fq. 154).

**NASB, NKJV, NRSV** “në një mënyrë të padenjë”  
**TEV** “në një mënyrë që e çnderon atë”  
**NJB** “padenjësisht”

Konteksti nënkupton se kjo i referohet unitetit të shkëputur të kishës të shkaktuar nga arroganca dhe krenaria e grupeve të përçara, por disa e kanë kuptuar sikur kjo i referohet mandatit për një qëndrim frymor të përshtatshëm kur bëhet Darka e Zotit (shih Heb. 10:29).

**11:28 “Por secili të shqyrtojë vetveten”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Termi “shqyrtojë” ka nënkuptimin e “të testosh me një prirje drejt aprovimit”. Shih TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” (Special Topic: Greek Terms for "Testing") tek 1 Kor. 3:13. Në një kuptim, të gjithë të krishterët janë të padenjë për shkak se ata të gjithë kanë mëkatuar dhe vazhdojnë të mëkatojnë. Në këtë kontekst i referohet specifikisht mungesës së unitetit dhe frymërave përçarëse të disa kishave në Korint (shih 2 Kor. 13:5).



<b>11:29</b>	
<b>NASB</b>	“nëse ai nuk e gjykon trupin siç duhet”
<b>NKJV</b>	“nuk e dallon trupin e Zotit”
<b>NRSV</b>	“duke mos e dalluar trupin”
<b>TEV</b>	“nëse ju nuk e dalloni kuptimin e trupit të Zotit”
<b>NJB</b>	“duke mos dalluar trupin”

“Trupi i Tij” nuk duket se i referohet (1) trupit fizik të Jezusit dhe as (2) pjesëmarrësve, por Kishës si një grup (shih 1 Kor. 10:17; 12:12-13,27). Mungesa e unitetit është problem. Një frymë superioriteti ose dallim klasash e shkatërron marrëdhënien.

▣ “**gjykon**<sup>32</sup>” Shih shënimin tek 1 Kor. 4:7 dhe Temën e Veçantë tek 1 Kor. 10:29.

**11:30** Pali po pranon në gjuhë të thjeshtë se besimtarët që thyejnë unitetin e kishës mund të vuajnë pasoja të përkohshme fizike, madje edhe vdekje (shih 1 Kor. 3:17). Kjo lidhet drejtpërsëdrejti me një mungesë respekti për trupin e Krishtit, kishën, popullin e Perëndisë (shih Veprat e Apo. 5; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

**11:31 “po”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të dytë, e cila quhet “në kundërshtim me faktin”. Ajo duhet të përkthehet “nëse ne do të na duhej të gjykonim veten tonë drejt, të cilën ne nuk e kemi bërë, atëherë ne nuk duhet të gjykohe mi, që në fakt gjykohe mi”. Shih shënimin tek 1 Kor. 4:7.

**11:32 “ndreqemi nga Zoti”** Është e vështirë të kuptosh se kur të krishterët po vuajnë për shkak se

1. ata jetojnë në një botë të rënë
2. ata po korrin nga pasojat e veprimeve të tyre mëkatore
3. ata po sprovohen nga Zoti për pjekuri frymërore (shih Heb. 5:8)

Perëndia sprovon dhe disiplinon (shih Heb. 12:5-11). Është një provë e dashurisë së Tij dhe statusin tonë familjar.

▣ “**që të mos dënohe mi bashkë me botën**” Gjykimi i përkohshëm i besimtarëve që janë duke lënduar kishën e Perëndisë mund të jetë një veprim dashurie duke i kursyer ata nga një gjykim më i ashpër i lidhur me shkatërrimin e kishës (shih 1 Kor. 3:10-17).

Më pëlqen një citim nga George Ladd tek *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re].

“Bota gjithashtu ka fenë e saj që i mban njerëzit të prangosur nga asketicizmi dhe legalizmi që mund të kenë dukjen e urtësisë dhe të promovojnë një lloj devocioni dhe vetë-disipline, por përfundimisht ajo dështon të sigurojë një zgjidhje për dilemën morale me të cilën njeriu përballet (Kol. 2:20 e në vazhdim). E parë me këtë këndvështrim, bota qëndron nën gjykimin e Perëndisë (1 Kor. 11:32) dhe është në nevojë të një pajtimi (2 Kor. 5:19; Rom. 11:15)” (fq. 399).

#### **VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 11:33-34**

<sup>33</sup> Prandaj, o vëllezërit e mi, kur mblidheni për të ngrënë, pritni njeri tjetrin. <sup>34</sup> Dhe në qoftë se dikush ka uri, le të hajë në shtëpi, që të mos mblidheni për dënim. Dhe gjërat e tjera, kur të vij, do t’i rregulloj.

**11:33 “kur mblidheni për të ngrënë, pritni njeri tjetrin”** Kjo i referohet 1 Kor. 11:21. Ata po silleshin si individë egoistë, jo si një familje, një trup. Ata po silleshin pikërisht në mënyrën e kundërt nga veprimi vetë-sakrifikues i dashurisë së Jezusit.

**11:34 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet se është e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

▣ “**le të hajë në shtëpi**” Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Nëse besimtarët janë aq të uritur sa sillen në mënyrë agresive dhe egoiste në Darkën e Zotit, atëherë ata duhet të kënaqin urinë e tyre përpara se ata të bashkohen në një vakt bashkësie.

<sup>32</sup> Versioni në shqip është “dallon” (shënim i përkthyesit).

<b>NASB</b>	<b>“Çështjet që mbeten do t’i rregulloj kur të vij”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“Dhe gjërat e tjera, do t’i rregulloj kur të vij”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“Për gjërat e tjera do t’ju jap udhëzime kur të vij”</b>
<b>TEV</b>	<b>“Ndërsa për gjërat e tjera, do t’i qartësoj ato kur të vij”</b>
<b>NJB</b>	<b>“Çështjet e tjera do t’i rregulloj kur të vij”</b>

Vini re se Perëndia nuk e ka parë të përshtatshme për të kaluar më tej të gjitha përshkrimet e detajuara që Pali i dha kësaj kishë. Është e pasigurtë nëse kjo lidhet vetëm me Darkën e Zotit apo edhe me çështje të tjera. Struktura e 1 Korintasve (duke iu përgjigjur shumë pyetjeve që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën) nënkupton se lidhet. Thelbi i Darkës së Zotit nuk gjendet në një libër leturgjie, por në një marrëdhënie me Jezus Krishtin. Detajet e ritualeve fetare nuk janë aq të rëndësishme sa një zemër e mirë ndaj Perëndisë, e cila ecën në një dashuri për kishën.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A duhet që të krishterët modernë të duplikojnë të gjitha ritualet dhe format e kishës së Dhjatës së Re?
2. Çfarë thotë 11:2-16 për pjesëmarrjen femërore në role drejtimi në adhurimin publik?
3. Kujt i korrespondon vëli sot?
4. Shpjego problemin e grave të pambuluara dhe burrave të mbuluar në kulturën romake të shekullit të parë.
5. Cili është qëllimi kryesor i Palit në diskutimin e Darkës së Zotit në kapitullin 11?
6. Si e shpjegoni 1 Kor. 11:30?

# 1 KORINTASVE 12

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Sjellja gjatë Adhurimit Publik (11:2-14:40)
Dhunitë Frymërore	Dhunitë Frymërore: Uniteti në Diversitet	Varieteti i Dhuntive Frymërore	Dhunti nga Fryma e Shenjtë	Dhunti Frymërore
12:1-3	12:1-11	12:1-3	12:1 12:2-3	12:1-3 Varieteti dhe Uniteti i Dhuntive
12:4-11		12:4-11	12:4-11	12:4-11
Një Trup me Shumë Anëtarë	Uniteti dhe Diversiteti në Një Trup	Trupi Kërkon një Varietet Anëtarësh	Një Trup Shumë Pjesë	Analogjia e Trupit
12:12-31a	12:12-31	12:12-13 12:14-26	12:12-13 12:14-20 12:21-26	12:12-17 12:18-21 12:22-26
		12:27-31	12:27-31a 12:31b	12:27-30

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 12:1-31

- A. Kapitujt 11-14 formojnë një njësi letrare e cila trajton adhurimin e përbashkët. Kishte shumë probleme në kishat shtëpi korintase. Pali adreson shumë nga këto çështje, për të cilat dukshëm kisha i kishte shkruar atij (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12). Çështjet e lidhura me adhurimin në grup ishin:
  - a. Si të luteshe dhe të profetizojë
    - i. Burrat e zbuluar
    - ii. Gratë e mbuluara

- b. Krenaria dhe abuzimi të lidhura me dhuntitë frymërore
- c. Si të implementosh dhunti në adhurim
  - i. Folësit dhe interpretuesit në gjuhë të tjera
  - ii. Këngëtarë
  - iii. Profetë

B. Ka tre teste të lidhura me dhuntitë frymërore.

- a. Kapitulli 12 – a motivojnë ato një unitet të qendëruar tek Krishti?
- b. Kapitulli 13 – a motivojnë ato dashuri?
- c. Kapitulli 14 – a e ndërtojnë ato trupin?

C. Gjenden disa lista dhuntish frymërore në Dhjatën e Re (shih Rom. 12; 1 Kor. 12-14; Efe. 4:11; dhe 1 Pjet. 4:10-11). Listat nuk janë të njëjta, dhe as rendi i dhuntive nuk është i njëjti. Ato janë pjesë përfaqësuese, jo lista përfundimtare. Disa nga dhuntitë funksionojnë në adhurimin e përbashkët, por të tjera fokusohen në mbledhje jashtë adhurimit kolektiv.

Theksi që Pali vendos mbi dhuntitë frymërore është befasues, por ai thotë pak për mënyrën se si gjendet apo identifikon dhuntinë e tij / saj. Unë jam hezitues për të konfirmuar shumë nga “sprovat frymërore” që janë zhvilluar në kohën tonë. Ato testojnë vetëm për dhunti të listuara në Dhjatën e Re. Shumë nga dhuntitë e listuara nuk janë të përkufizuara qartë (dmth., dhuntitë e drejtimit tek Efe. 4:11). Udhezuesi më i dobishëm që kam gjetur në këtë çështje është liberthi IVP i titulluar *Affirming the Will of God* [Konfirmimi i Vullnetit të Perëndisë] nga Paul Little. E njëjta urtësi e krishterë që na ndihmon të gjejmë vullnetin e Perëndisë gjithashtu na ndihmon të identifikojmë dhuntinë tonë të frytshme për shërbesë.

- a. Lutu specifikisht
- b. Pyeti të krishterët e pjekur që të njohin se cilat forca ata shohin në ty
- c. Shiko për mundësi të hapura për të provuar në zona të ndryshme
- d. Ndiq dëshirat e zemres tënde

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:1-3

<sup>1</sup> Edhe për sa u përket *dhuntive* frymërore, o vëllezër, nuk dua të jeni të paditur. <sup>2</sup> Ju e dini se, kur ishit paganë, *tërhiqeshit* pas idhujve të pagojë, nën shtytje të çastit. <sup>3</sup> Prandaj ju bëj të ditur se askush që flet në Frymën e Shenjtë nuk thotë: “Mallkuar qoftë Jezusi!”; edhe asnjë nuk mund të thotë: “Jezusi është Zot,” veç se në Frymën e Shenjtë.

**12:1 “Tani<sup>33</sup> për sa u përket”** Kjo është një frazë e përsëritur tek 1 Korintasve që tregon se Pali po iu përgjigjet pyetjeve specifike nga kisha (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12).

NASB, NKJV	“ <i>dhuntive</i> frymërore”
NRSV (shënim)	“personave frymërorë”
TEV	“ <i>dhuntive</i> nga Fryma e Shenjtë”
NJB	“ <i>dhuntive</i> të Frymës”

Termi grek është forma gjinore e shumësit të *pneuma*. Kjo mund t’i referohet personave, dhuntive ose spiritualiteteve (dmth., çështjeve frymërore, shih 1 Kor. 14:1).

<sup>33</sup> Versioni në shqip është: “Edhe” (shënim i përkthyesit).

## TEMË E VEÇANTË: FRYMË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: SPIRIT IN THE BIBLE)

- I. Dhjata e Vjetër (*ruah*, BDB 924, KB 1197; shih TEMË E VEÇANTË: FRYMË, ERË, SHPIRT [Dhjata e Vjetër] (Special Topic: Breath, Wind, Spirit [OT]))
- A. Veprimet e Perëndisë monoteist (dmth., Fryma, përdorur rreth 90 herë në Dhjatën e Vjetër)
    - 1. Pozitive, Zanafilla 1:2
    - 2. Negative, 1 Sam. 16:14-16,23; 1 Kgs. 22:21-22; Isa. 29:10
  - B. Forca e jetës së dhënë nga Perëndia tek njerëzimi (dmth., fryma e Perëndisë, shih Zan. 2:7)
  - C. Septuaginti e përkthen *ruah* me *pneuma* (e përdorur rreth 100 herë tek LXX)
  - D. Shkrimet e mëvonshme rabinike, apokaliptike dhe dorëshkrimet e Detit të Vdekur, të ndikuara nga Zoroastrianizmi, *pneuma* përdoret për engjëjt dhe demonët
- II. Termat grekë
- A. *pneō*, të frysh
  - B. *pnoē*, erë, frymë
  - C. *pneuma*, shpirt, frymë
  - D. *pneumatikos*, që i takon frymës
  - E. *pneumatikōs*, frymërisht
- III. Sfondi filozofik grek (*pneuma*)
- A. Aristoteli përdori termin si forcë e jetës që zhvillohet nga lindja deri në vetë-disiplinim.
  - B. Stoikët e përdorën termin si sinonim ndaj *psuchē*, (shpirti) madje dhe *nous* (mendja) në kuptimin e pesë shqisave fizike dhe intelektit njerëzor.
  - C. Në mendimin grek, termi u bë ekuivalenti i veprimit hyjnor (dmth., hyjësi, magjike, okult, profeci etj.)
- IV. Dhjata e Re (*pneuma*; shih TEMË E VEÇANTË: FRYMA NË DHJATËN E RE (Special Topic: Spirit in the NT))
- A. Prania, fuqia dhe pajisja e veçantë nga Perëndia
  - B. Fryma lidhet me veprimtarinë e Perëndisë në kishë (kryesisht tek Gjoni)
    - 1. profecia
    - 2. mrekullitë
    - 3. guxim për të shpallur ungjillin
    - 4. urtësi (dmth., ungjilli)
    - 5. gëzim
    - 6. sjell epokën e re
    - 7. konvertim (dmth., bindës dhe banues)
    - 8. ngjashmëria me Krishtin
    - 9. dhuntitë e veçanta të shërbesës
    - 10. lutet për besimtarët
- Fryma zgjon dëshirën njerëzore për marrëdhënie me Perëndinë, gjë për të cilën u krijuan. Kjo marrëdhënie është e mundur për shkak të personit dhe veprës së Jezusit, Mesias së Perëndisë (shih TEMË E VEÇANTË: MESIA [Special Topic: Messiah]). Zgjimi i ri frymor çon në jetesë, shërbim dhe besim si i Krishtit.
- C. Ai mund të kuptohet më mirë si një vazhdimësi frymërore me Frymën e Shenjtë në fund, dhe njerëzimin si një krijesë fizike të këtij planeti, por gjithashtu si një krijesë frymërore në shëmbëlltërinë e Perëndisë, nga ana tjetër.
  - D. Pali është autori i Dhjatës së Re i cili zhvillon një teologji të Frymës / frymës.
    - 1. Pali përdor Frymën në kontrast ndaj mishit (dmth., natyra mëkatore)
    - 2. Pali përdor frymën në kontrast ndaj fizikes
    - 3. Pali përdor Frymën / frymën në kontrast ndaj mendimit, njohurisë dhe qenies njerëzore
  - E. Disa shembuj nga 1 Korintasve
    - 1. Fryma e Shenjtë, 1 Kor. 12:3
    - 2. Fuqia dhe urtësia e Perëndisë e përçuar përmes Frymës së Shenjtë, 1 Kor. 2:4-5

### 3. Veprimet e Perëndisë tek besimtari

- a. Mendësia e re, 1 Kor. 2:12; 14:14,32
- b. Tempulli i ri, 1 Kor. 3:16; 6:19-20
- c. Jeta e re (dmth., moraliteti), 1 Kor. 6:9-11
- d. Jeta e re e simbolizuar në pagëzim, 1 Kor. 12:13
- e. Një me Perëndinë (dmth., konvertimi), 1 Kor. 6:17
- f. Urtësia e Perëndisë, jo urtësia e botës, 1 Kor. 2:12-15; 14:14,32,37
- g. Dhuntitë frymërore të çdo besimtari për shërbesë, 1 Korintasve 12 dhe 14

4. Frymorja në kontrast ndaj fizikes, 1 Kor. 9:11; 10:3; 15:44

5. Bota frymërore në kontrast ndaj botës fizike, 1 Kor. 2:11; 5:5; 7:34; 15:45; 16:18

6. Një mënyrë për t'iu referuar një jete të brendshme / frymërore njerëzore në dallim nga trupi fizik, 1 Kor. 7:34

- F. Njerëzit jetojnë në dy botë nga krijimi (dmth., fizike dhe frymërore). Njerëzimi ra nga intimiteti me Perëndinë (Zanafilla 3). Përmes jetës, mësimeve, vdekjes, ringjalljes dhe rikthimit të premtuar të Krishtit, Fryma i bind njerëzit e rënë për të ushtruar besim tek ungjijt (dmth., Gjoni 6:44,65), pikë në të cilën ata restaurohen në marrëdhënie me Perëndinë. Fryma është pjesa personale e Trinisë e cila karakterizohet nga Epoka e Re e drejtësisë. Fryma është agjenti i Perëndisë At dhe Avokati i Birit në këtë “epokë” (shih TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA [Special Topic: Jesus and the Spirit]). Një problem ekziston për shkak se epoka e re ka ndodhur në kohë, ndërkohë që epoka e vjetër e rebelimit mëkatar ekziston ende. Fryma transformon të vjetrën në të re, edhe pse ekzistojnë ende të dyja.

▣ **“vëllezër”** Pali shpesh përdor “vëllezër” për të sinjalizuar një ndryshim të temës. Vargu i parë ka tre shënjes kontekstuale të një ndryshimi të temës: (1) tani për sa i përket; (2) vëllezër; dhe (3) nuk dua të jeni të paditur. Kapitujt 11-14 trajtojnë aspekte të ndryshme të adhurimit të përbashkët.

Mesazhet që Pali i dërgoi Korintit ishin kaq të vështira sa ai shpesh përdor “vëllezër” për t’i kujtuar ata për unitetin e tyre në familjen e Perëndisë (shih 1 Kor. 1:10,11,26; 2:1; 3:1; 4:6; 6:5,8; 7:24,29; 5:12; 9:5; 10:1; 11:2,33; 12:1; 14:6,20,26,39; 15:1,6,50,58; 16:11,12,15,20; 2 Kor. 1:8; 8:1,23; 9:3,5; 11:9; 13:11).

▣ **“nuk dua të jeni të paditur”** Kjo është një frazë e përsëritur tek shkrimet e Palit (shih Rom. 1:13; 11:25; 1 Kor. 10:1; 11:3; 12:1; 2 Kor. 1:8; 1 Thes. 4:13). Ishte një nga mënyrat e tij për të prezantuar një temë të re të rëndësishme.

**12:2 “ishit paganë”** Kjo është një formë treguese e papërkryer. Këta besimtarë ishin dikur paganë, por tani ata duhet të hedhin këtë mendësi dhe këtë veprimtari të lidhur. Kisha në Korint ndikohej thellësisht nga (1) praktikatat pagane të adhurimit dhe (2) kultura romake. Të dyja po ngjyroshin ungjillin në mënyra të papërshtatshme.

NASB	“ju drejtoheshit në rrugën e gabuar”
NKJV	“tërhiqeshit pas... megjithatë, ju drejtoheshit”
NRSV	“ju tërhiqeshit dhe drejtoheshit në rrugë të gabuar”
TEV	“ju drejtoheshit në rrugën e gabuar në shumë mënyra”
NJB	“ju tërhiqeshit në mënyrë të pazezistueshme”

Kjo frazë ka dy folje të lidhura nga rrënja e “të drejtosh”. E para është një formë treguese pasive perifrastike e papërkryer dhe e dyta është një pjesore pasive e tashme: “ju u drejtuat dhe vazhdoni të drejtoheni.”

Termi i dytë gjithashtu intensifikohet nga parashtesa *apo*, e cila nënkupton të drejtosh si një të burgosur (shih Mark 14:44; 15:16). Këta paganë të dikurshëm kishin qënë vazhdimisht të kontrolluar nga frymëra demonike në praktikatat e tyre të adhurimit (shih 1 Kor. 10:20) përpara konvertimit të tyre.

▣ **“pas idhujve të pagojë”** Kjo i referohet perëndive që nuk mund të flisnin apo ndihmonin (shih Isa. 46:5-7; Jer. 10:5; Hab. 2:18-19) në kundërshti ndaj Frymës së Shenjtë.

**12:3 “askush që flet në Frymën e Shenjtë”** Kjo është një shprehje hebraike për frymëzimin (shih 1 Sam. 10:10; 19:23-24). Kjo i rikujton besimtarët që jo çdokush që pretendon se flet për Perëndinë, e bën vërtetë këtë gjë. Çdo besimtar duhet të vlerësojë ata që pretendojnë se flasin mesazhin e Perëndisë (shih 1 Kor. 12:10; Ligji i Përt. 18:20-22; Mat. 7; 1 Gjoni 4:1-3).

**NASB** “Jezusi është i mallkuar”  
**NKJV** “e quan Jezusin të mallkuar”  
**NRSV** “Mallkuar qoftë Jezusi”  
**TEV, NJB** “një mallkim mbi Jezusin”

Ky është një pohim shokues. Pse dikush (përveç hebrejve tradicionalë) që pretendon se flet për Perëndinë do ta thoshte një gjë të tillë? Vetë termi (dmth., *anathema*) kishte një sfond të Dhjatës së Vjetër (dmth., hebraisht, *herem*). Ai lidhet me konceptin e Luftës së Shenjtë, ku një qytet i përkushtohet Perëndisë, dhe prandaj, bëhej i shenjtë. Kjo do të thoshte që çdo gjë në të që merrte frymë, njerëz apo kafshë, duhej të vdiste (shih Joz. 6:17; 7:12).

Teoritë se si përdorej ky term në Korint janë

1. Që ai ka një rrethanë hebraike që lidhet me betimet e sinagogës (shih Veprat e Apo. 26:11, dmth., më pas formulat e mallkimit rabinik u përdorën për të hequr të krishterët nga sinagoga). Për të qëndruar anëtar, një personi i duhej të refuzonte ose të mallkonte Jezusin e Nazaretit.
2. Që ai ka një rrethanë romake që lidhet me adhurimin e perandorit ku vetëm Çezari do të quhej “Zot”.
3. Që ai ka një rrethanë adhurimi pagan ku mallkimet thirreshin mbi njerëzit nga përdorimi i emrit të një perëndie. Ky term më pas mund të përkthehej: “Jezusi mallkoftë \_\_\_\_\_” (shih 1 Kor. 16:22).
4. Që dikush lidhte frazën me konceptin teologjik të Jezusit që mbante mallkimin e Dhjatës së Vjetër për ne (shih Ligji i Përt. 21:23; Gal. 3:13).
5. Studimet e fundit nga Korinti (shih shënimin nr. 1 fq. 164 tek *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin] e Bruce Winter) që dokumenton mbi pllaka mallkimi të gjetura në akropolin antik në Korint. Studiuesit biblikë kanë supozuar se duhet të ketë një lidhje midis foljes “është” në frazën “Jezusi është i mallkuar”, por kjo provë arkeologjike qartazi tregon se këto mallkime të periudhës së shekullit të parë romak nga Korinti iu mungon folja (sikurse ndodh me disa nga mallkimet tek LXX nga Ligji i Përt. 22:15-20), siç është tek 1 Kor. 12:3. Ka më tej provë arkeologjike se të krishterët e shekullit të parë në Korintin romak përdornin formula mallkimi në mallkime varrimi (dmth., në periudhën Bizantine), të gjendura mbi varre të krishtera (J. H. Kent, *The Inscriptions* [Mbishkrimet], 1926-50. Princeton: American School of Classical Studies, 1966, vol. 8:3, numër 644).

Disa segmente të kishës po i riktheheshin mallkimeve pagane në emër të Jezusit kundër anëtarëve të tjerë në kishë. Jo vetëm që problemi është metoda, por gjithashtu motivi plot urrejtje. Ky është një tjetër shembull i tensionit brenda kësaj kishë. Pali dëshiron që ata ta ndërtojnë kishën, ta ngrenë kishën. Ata dëshironin të mallkonin pjesë të kishës!

▣ **“Jezusi është Zot”** Ky ishte rrëfimi i besimit i kishës së hershme (shih si Rom. 10:9-13 ashtu edhe Veprat e Apo. 2:21 të citojnë Joelin 2:33; gjithashtu vër re Fil. 2:11). Ishte një mënyrë për të pranuar hyjësinë e Jezusit dhe që ai është Mesia.

▣ **“veç se në Frymën e Shenjtë”** Detyra e Frymës së Shenjtë është që të bindë botën për mëkat dhe t’i tërheqë njerëzit tek Krishti (shih Gjoni 16:8-14). Asnjë njeri i rënë nuk mund të kthehet tek Perëndia ose Krishti i pandihmuar (shih Gjoni 6:44,65). Ky është misteri i një Perëndie Sovran i cili e do të gjithë njerëzimin e krijuar në shëmbëllimin e Tij dhe megjithatë mandati i besëlidhjes së Tij është që ata duhet të përgjigjen (dhe të vazhdojnë të përgjigjen) në pendesë, besim, bindje, shërbesë dhe qëndrueshmëri!

## TEMË E VEÇANTË: MALLKIMI (ANATHEMA) [SPECIAL TOPIC: CURSE (ANATHEMA)]

### I. Dhjata e Vjetër

Në hebraisht përdoren një sërë fjalësh me kuptimin “mallkim”. *Herem* (BDB 356, Kb 353) përdorej për diçka që i jepej Perëndisë (shih LXX e përkthen si *anathema*, BAGD 54, Lev. 27:28). Zakonisht, kjo kërkonte që objekti në fjalë të shkatërrohej pasi ishte tepër i shenjtë për përdorim nga njerëzit (shih Ligji i Përt. 7:26; Joz. 6:17-18; 17:12). Ishte një term që përdorej në konceptin e “luftës së shenjtë”. Perëndia i tha Jozueut të shkatërronte kanaanejtë. Jeriko ishte mundësia e parë, pra “fryti i parë” i këtij shkatërrimi/pastrimi.

### II. Dhjata e Re

Në Dhjatën e Re, *anathema* dhe format që rrjedhin prej saj përdoren në disa kuptime të ndryshme:

- A. Si dhuratë ose ofertë për Perëndinë (shih Luka 21:5)
- B. Si betim vdekjeje (shih Veprat e Apostujve 23:14)
- C. Për të mallkuar dhe për t’u betuar (shih Marku 14:71)
- D. Një formulë mallkimi që lidhej me Jezusin (shih 1 Kor. 12:3)
- E. Kur jep dikë ose diçka për gjykim ose për shkatërrim nga Perëndia (shih Rom. 9:3; 1 Kor. 16:22; Gal. 1:8-9)

## VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:4-11

<sup>4</sup> Ka larmi dhuntish, por i njëjti Frymë. <sup>5</sup> Ka edhe larmi shërbimesh, por i njëjti Zot. <sup>6</sup> Dhe ka larmi veprimtarish por është i njëjti Perëndi i cili i bën të gjitha gjërat në të gjithë *personat*. <sup>7</sup> Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët. <sup>8</sup> Dikujt, pra, i jepet, me anë të Frymës, fjalë diturie; një tjetri, sipas të po atij Frymë, fjalë njohurie; <sup>9</sup> një tjetri besim, nga po ai Frymë; një tjetri dhuntitë e shërimeve, nëpërmjet po atij Frymë; një tjetri pushtet për të kryer veprime të fuqishme; një tjetri profeci; një tjetri të dallojë frymërat; <sup>10</sup> një tjetri *larmi* gjuhësh; një tjetri interpretimi i gjuhëve. <sup>11</sup> Dhe të gjitha këto i bën i njëjti dhe i vetmi Frymë, duke i ndarë gjithsecilit dhunti veç e veç ashtu si do vetë.

### 12:4-6

NASB, NRSV “varietete”

NKJV “larmi”

TEV “lloje të ndryshme”

NJB “të ndryshme”

Ky term do të thotë (1) të shpërndash ose (2) larmi (shih 1 Kor. 12:4,5,6). Gjendet një paralelizëm i dukshëm letrar midis 1 Kor. 12:4,5, dhe 6, i cili bashkon veprën e të tre personave të Trinisë (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10).

**12:4-6 “Frymë... Zot... Perëndi”** Vini re veprimin e Trinisë i cili thekson unitetin në mes të larmishmërisë, jo uniformitetin. Kisha është një grup prej individësh me dhunti. Ne kemi nevojë për njëri-tjetrin! Secili është i rëndësishëm. Secili është i pajisur me dhunti për shërbesë. Termi “Trini” nuk është një term biblik, por koncepti është i tillë. Shih Temën e Veçantë: Trinia tek 1 Kor. 2:10.

**12:4 “dhuntish”** Kjo është një fjalë e ndryshme nga fjala e përdorur tek 1 Kor. 12:1. Ky është termi grek *charisma*. Kjo është nga termi rrënjë “*chairō*”, i cili do të thotë të gëzosh ose të jesh i mbushur me gëzim (shih 1 Kor. 7:30; 13:6; 2 Kor. 2:3; 6:10; 7:7,9,16 dhe përbërjen me *sun* tek 1 Kor. 12:26 dhe 13:6). Nga ky koncept zhvillohen disa koncepte.

1. *chara* – gëzim, të gëzosh
2. *charis* – dhuratë bujare (shih 1 Kor. 16:3; 2 Kor. 8:4,6)
  - a. hir (shih 1 Kor. 1:4; 15:10)



- b. falenderim (shih 1 Kor. 15:57)
- 3. *charizomai*
  - a. jep bujarisht
  - b. fal (shih 2 Kor. 2:7-10; 12:13)
  - c. fshij një detyrim
- 4. *charisma* – një dhuratë falas (shih Rom. 5:15,16; 6:23; 2 Kor. 1:11) ose një zbukurim i dhënë hyjesisht (shih 1 Kor. 12:4,9,28,30,31)

Perëndia i ka dhënë dhunti kishës së Tij falas. Dhuntitë janë për të ndërtuar dhe për të rritur trupin e Krishtit. Në të vërtetë ato janë vepra e Krishtit e ndarë midis ndjekësve të Tij. Besimtarët duhet të bashkojnë dhuntitë e tyre me dashuri dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që kisha të mund të fitojë dhe të dishepullizojë një botë të humbur (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

**12:5 “shërbimesh”** Ky është termi grek *diakonos*. Ai ka disa përdorime në Dhjatën e Re.

- 1. *diakonos*
  - a. një shërbëtor (shih Mat. 20:28; 22:13; 23:11; Gjoni 2:5)
  - b. një predikues (shih 1 Kor. 3:5; 2 Kor. 3:6; 6:4; 11:15[dy herë],23)
- 2. *diakoneō*
  - a. të shërbesh (shih 1 Pjet. 4:11)
  - b. dhjak (shih Rom. 16:1; 1 Tim. 3:8,10,13; gjithashtu vër re Fil. 1:1)
  - c. administrator (shih Veprat e Apo. 6:2; 2 Kor. 3:3; 8:19,20)
- 3. *diakonia*
  - a. ndihmë e përqëndruar (shih Veprat e Apo. 6:1; 2 Kor. 8:4; 9:1,12,13)
  - b. shërbesë për ungjillin (shih 1 Kor. 12:5; 16:15; 2 Kor. 4:1; 5:8; 6:3; 11:8)
  - c. një zbulës nga Perëndia (shih 2 Kor. 3:7,8,9)

Ideja kyçe është të shërbesh dhe të ndihmosh të tjerët në nevojë (dmth., frymërisht ose fizikisht). Perëndia pajis kishën e Tij për të shërbyer – për t’i shërbyer vetvetes dhe për t’i shërbyer një bote të humbur dhe në nevojë.

## 12:6

NASB	“efekte... vepra”
NKJV	“veprimtari... gjërat”
NRSV	“veprimtari... aktivizon”
TEV	“aftësitë... aftësi”
NJB	“veprimtari... vepër”

Kjo është një lojë me termin *energēs* nga i cili marrim fjalën energji. Kuptimi thelbësor i saj është të përmbushësh një detyrë në mënyrë të efektshme. Kjo fjali ka një emër dhe një pjesore që i përshtatet (forma aktive e tashme). Pali e përdorte këtë term shpesh në letrat e tij korintase.

- 1. *energēs, energiea, energeō, energēma*, 1 Kor. 4:12; 9:6; 12:6,10,11; 16:9,10; 2 Kor. 1:6; 4:12
- 2. *ergon* dhe *sunergeō*, 1 Kor. 3:13,14,15; 9:1; 15:58; 16:10; 2 Kor. 6:1; 9:8; 11:15

Vepra e Perëndisë është vepër efektive. Ajo e përmbush qëllimin e saj. Besimtarët janë thirrur për shërbesë aktive, por energjia dhe frytshmëria vjen nga Perëndia.

## 12:7

NASB	“Por secilit i jepet shfaqja e Frymës për të mirën e përbashkët”
NKJV	“Por shfaqja e Frymës i jepet kujtdo për dobinë e të gjithëve”
NRSV	“Secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët”
TEV	“Prania e Frymës shfaqet në disa mënyra në secilin person për dobinë e të gjithëve”
NJB	“Shfaqja e veçantë e Frymës që i jepet secilit është për t’u përdorur për të mirën e përbashkët”

E vërteta është shumë e rëndësishme për jetën dhe shërbesën e kishës.

- 1. Çdo besimtar ka një dhunti hiri të dhënë falas nga Fryma për shërbesën në shpëtim.
  - a. Çdo besimtar është i rëndësishëm.
  - b. Çdo besimtar ka dhunti.

c. Çdo besimtar është një shërbenjës.

2. Qëllimi i dhuntisë së Perëndisë nuk është lartësimi i individit, por shëndeti dhe rritja e të gjithë trupit. Ne kemi nevojë për njëri-tjetrin!

Kjo e vërtetë nevojitet në mënyrë të dëshpëruar nga besimtarët e përçarë, arrogantë dhe vetë-besues në Korint (dhe në çdo epokë). “Dobia e përbashkët” apo “përfitimi” (*sumpheron*, shih 1 Kor. 6:12; 7:35; 10:33; 2 Kor. 8:10) është për trupin dhe jo për individin. Besimtarët duhet të marrin përgjegjësi personale për të mbajtur unitetin e Frymës në lidhje me paqen (shih Efe. 4:2-3). Kjo është rrënjësisht kaq ndryshe nga individualizmi perëndimor.

**TEMË E VEÇANTË: KRISHTERIMI ËSHTË KOLEKTIV (SPECIAL TOPIC: CHRISTIANITY IS CORPORATE)**

- A. Metaforat e Palit dhe Pjetrit në shumës për popullin e Perëndisë
1. trupi (shih 1 Kor. 12:12-20)
  2. fusha (shih 1 Kor. 3:9)
  3. ndërtesa (shih 1 Pje. 2:4-5)
- B. Termi “shenjtor” është gjithmonë në SHUMËS (përveç Fil. 4:21; por edhe aty është në sensin kolektiv)
- C. Theksi që Martin Luteri dhe Reformacioni vinin te “priftëria e besimtarit” (pra, aftësia e shpirtit) është supozim biblik. Në të vërtetë, Bibla flet për “priftërinë e besimtarëve” (shih Eks. 19:6; 1 Pje. 2:5, 9; Zbu. 1:6).
- D. Secili besimtar ka dhunti për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7)
- E. Vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin mund të jetë i frytshëm populli i Perëndisë. Shërbesa është kolektive (shih Efe. 4:11-12).

**12:8**

**NASB, NKJV** “fjalë diturie... fjalë njohurie”

**NRSV** “e folur dituri... e folur njohurie”

**TEV** “një mesazh i mbushur me dituri... një mesazh i mbushur me njohuri”

**NJB** “dhurata e së folurës që shpreh urtësi... dhurata e së folurës që shpreh njohuri”

Këto janë dy terma të ndryshëm grekë, “urtësi” (dmth., *sophia*) dhe “njohuri” (dmth., *gnōsis*). Ato reflektojnë dallimin hebraik midis “urtësi” dhe “njohuri”. E para është praktike dhe e dyta, më akademike. E para lidhet me jetesën e jetës së Krishterë dhe e dyta me një shpjegim të përshtatshëm të doktrinës së krishterë.

**12:9 “besim”** Kjo nuk i referohet besimit të shpëtimit si Marku 1:15; Gjoni 1:12, për shkak se dhuntitë iu jepën vetëm besimtarëve, por i referohet mrekullisë së besimit që vepron, e cila bëhet e qartë nga 1 Kor. 13:2 (shih Mat. 17:20; 21:21).

■ **“shërimeve”** Ky term (*iaomai*) është shumës (shih 2 Kor. 12:7-9,28,30), i cili fjalë për fjalë është “dhunti të kurimit”. Të shëroshe është një dhunti nga Fryma në këtë konteskt dhe një shërbesë e “pleqve” tek Jakobi 5:14. Shërimi fizik ishte / është një provë e dashurisë dhe përkujdesit të Perëndisë dhe një shenjë e shërimit frymor (dmth., falja e mëkateve, shpëtimi). Për hebrenjtë kishte një lidhje midis mëkatit dhe sëmundjes, drejtësisë dhe shëndetit (shih Ligji i Përtërirë 27-28). Megjithatë, Jobi dhe Psalmi 73 e sqarojnë çështjen, ashtu sikurse bën Gjoni 9. Misteri është se pse disa shërohen dhe disa jo. Besimi i një personi nuk mund të jetë përbërësi kryesor, por është vullneti i Perëndisë. Kurrë nuk varet nga sa shumë besim ushtrojmë ne, por nga objekti i besimit tonë (besimi sa një kokërr sinapi lëviz malet, shih Mat. 17:20).

Lavdi Perëndisë për shërimin, shëruesit dhe kishat përkujdesëse!

**12:10 “veprime të fuqishme”** Kjo duket se paralelizohet tek 1 Kor. 12:9a (dmth., besimi që bën mrekulli). Duke qënë se kjo është një listë, ato nuk mund të jenë plotësisht anonime. Dallimi i plotë është i pasigurtë.

■ **“profeci”** Ka të paktën dy mënyra për ta kuptuar këtë term: (1) në letrat korintase kjo i referohet ungjillit ndarës ose shpallës (shih 1 Kor. 14:1), (2) libri i Veprave të Apostujve përmend profetët (shih 1 Kor. 11:27-28; 13:1; 15:32; 21:10, edhe profeteshat, 21:9).

Problemi me këtë term është se si dhuntia e profecisë e Dhjatës së Re lidhet me profetët e Dhjatës së Vjetër? Në Dhjatën e Vjetër profetët janë shkrimtarët e Shkrimeve. Në Dhjatën e Re kjo detyrë i është dhënë dymbëdhjetë apostujve fillestarë dhe ndihmësve të tyre. Termi “apostull” merret si një dhuratë e vazhdueshme (shih Efe. 4:11), por me një detyrë të ndryshuar pas vdekjes së të dymbëdhjetëve, dhe po kështu edhe të profetëve. Frymëzimi ka mbaruar, nuk ka më shkrim të frymëzuar (shih Juda 1:20). Detyra kryesore e profetëve të Dhjatës së Re është të shpallin ungjillin, por gjithashtu edhe një detyrë tjetër, ndoshta se si të zbatojnë të vërtetat e Dhjatës së Re në situata dhe nevoja aktuale. Shih TEMËN E VEÇANTË: PROFECIA NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NEW TESTAMENT PROPHECY) tek 1 Kor. 14:1.

## TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHJATËN E VJETËR (SPECIAL TOPIC: OLD TESTAMENT PROPHECY)

### I. HYRJE

#### A. Të dhëna hyrëse

1. Komuniteti i besimtarëve nuk bie dakord sesi të interpretojë profecinë. Të vërteta të tjera janë përcaktuar si pozicion ortodoks me kalimin e shekujve, por jo kjo.

2. Profecia e Dhjatës së Vjetër ka një sërë fazash të mirëpërcaktuara

#### a. paramonarkikë

1) individë të quajtur profetë

a) Abrahami – Zan. 20:7

b) Moisiu – Num. 12:6-8; Ligji i Përt. 18:15; 34:10

c) Aaroni – Eks. 7:1 (zëdhënës i Moisiut)

d) Miriami – Eks. 15:20

e) Medadi dhe Eldadi – Num. 11:24-30

f) Debora – Gjyq. 4:4

g) pa emër – Gjyq. 6:7-10

h) Samueli – 1 Sam. 3:20

2) përmendje të profetëve si grup – Ligji i Përt. 13:1-5; 18:20-22

3) grupe ose shkolla profetike – 1 Sam. 10:5-13; 19:20; 1 Mbret. 20:35, 41; 22:6, 1013; 2 Mbret. 2:3, 7; 4:1, 38; 5:22; 6:1, etj.

4) Mesia quhet profet – Ligji i Përt. 18:15-18

#### b. monarkikë, por pa shkrime (ata i drejtohen mbretit):

1) Gadi – 1 Sam. 22:5; 2 Sam. 24:11; 1 Kro. 29:29

2) Natani – 2 Sam. 7:2; 12:25; 1 Mbret. 1:22

3) Ahijahu – 1 Mbret. 11:29

4) Jehu – 1 Mbret. 16:1, 7, 12

5) Pa emër – 1 Mbret. 18:4, 13; 20:13, 22

6) Elija – 1 Mbret. 18 – 2 Mbret. 2

7) Milkajahu – 1 Mbret. 22

8) Elizeu – 2 Mbret. 2:8, 13

#### c. profetët shkrues klasikë (ata i drejtohen jo vetëm mbretit, por edhe kombit): Isaia-Malakia (përveç Danielit)

### B. Termat biblikë

1. *Ro’eh* = “shikues” (BDB 906, KB 1157), 1 Sam. 9:9. Vetë kjo referencë tregon kalimin për te termi *nabi*. *Ro’eh* vjen nga termi i përgjithshëm “shoh”. Ky person kuptonte udhët dhe planet e Perëndisë dhe konsultohet për të vërtetuar vullnetin e Perëndisë për ndonjë çështje.

2. *Hozeh* = “shikues” (BDB 302, KB 3011), 2 Sam. 24:11. Në thelb, është sinonim me *Ro’eh*. Vjen nga një term më i rrallë, “shikoj”. Forma pjesore përdoret më shpesh për

t'iu referuar profetëve (pra, "kundroj").

3. *Nabi* = "profet" (BDB 611, KB 661), e afrishme me FOLJEN akadiane *Nabu* = "thërras" dhe arabisht *Naba'a* = "shpall". Ky është termi më i zakonshëm në Dhjatën e Vjetër për të përcaktuar profetin. Përdoret mbi 300 herë. Etimologjia e saktë është e paqartë, por, për momentin, "thërras" duket alternativa më e mirë. Ndoshta, kuptimi më i mirë i saj vjen nga përshkrimi që i bën YHWH marrëdhënies së Moisiut me faraonin përmes Aaronit (shih Eks. 4:10-16; 7:1; Ligji i Përt. 5:5). Profeti është dikush që i flet popullit në emër të Perëndisë (Amosi 3:8; Jer. 1:7, 17; Ezek. 3:4).
4. Të tre këta terma përdoren për ofiqin e profetit te 1 Kro. 29:29; Samueli – *Ro'eh*; Natani – *Nabi* dhe Gadi – *Hozeh*.
5. Frazja, '*isha ha-'elohim*, "Njeriu i Perëndisë", është një përcaktim më i gjerë i zëdhënësit të Perëndisë. Përdoret rreth 76 herë në Dhjatën e Vjetër në kuptimin "profet".
6. Termi "profet" e ka origjinën nga greqishtja. Vjen nga: (1) *pro* – "më parë" ose "për" dhe (2) *phemi* = "flas".

## II. PËRCAKTIMI I PROFECISË

- A. Termi "profeci" kishte një fushë më të gjerë semantike në hebraisht sesa në greqisht. Librat historikë, nga Jozueu deri te Mbretërve (përveç Ruthit), etiketoheshin nga judenjtë si "profetët e hershëm". Si Abrahami (Zan. 20:7; Psa. 105:5), ashtu dhe Moisiu (Ligji i Përt. 18:18), përcaktohen si profetë (edhe Miriami, Eks. 15:20). Si rrjedhojë, kujdes nga ndonjë përcaktim i supozuar perëndimor!
- B. "Profetizmi mund të përcaktohet me të drejtë si ai botëkuptim i historisë që e pranon kuptimin vetëm në kuadër të preokupimi, synimit dhe pjesëmarrjes hyjnore", *Interpreter's Dictionary of the Bible*, vëll. 3, f. 896.
- C. "Profeti s'është, as filozof, as teolog sistematik, por ndërmjetës besëlidhjeje, i cili i përçon fjalën e Perëndisë popullit të vet me qëllim që t'u formësojë të ardhmen duke u reformuar të tashmen", "Profetët dhe Profecia", *Encyclopedia Judaica*, vëll. 13, f. 1152.

## III. QËLLIMI I PROFECISË

- A. Profecia është një mënyrë sesi Perëndia i flet popullit të vet, duke u siguruar udhëheqje në kontekstin e tanishëm dhe shpresë për kontrollin e tij në jetën e tyre dhe në ngjarjet botërore. Mesazhi i profetëve, në thelb, ishte kolektiv. Synonte të qortonte, nxiste, ngjallte besim dhe pendim, dhe të informonte popullin e Perëndisë për Perëndinë dhe për planet e tij. Profecitë i bëjnë thirrje popullit të Perëndisë për besnikëri ndaj besëlidhjeve të Perëndisë. Kësaj i duhet shtuar se, shpesh, profecia përdoret për të zbuluar qartë zgjedhjen e një zëdhënësi nga Perëndia (Ligji i Përt. 13:1-3; 18:20-22). Në fund fare, ky zëdhënës i referohej Mesisë.
- B. Shpesh, profeti merrte një krizë historike ose teologjike të ditës dhe e projektonte në një kontekst eskatologjik. Kjo pikëpamjeje "fund-bote" e historisë është unike për Izraelin dhe për konceptin e tij për zgjedhjen hyjnore dhe premtimet e besëlidhjes.
- C. Ofiqi i profetit duket se drejtpeshon (Jer. 18:18) dhe uzurpon ofiqin e Kryepriftit si mënyrë për të njohur vullnetin e Perëndisë. Urimi dhe Thumimi shndërrohen në mesazh verbal nga zëdhënësi i Perëndisë. Po kështu, ofiqi i profetit duket se reshti në Izrael pas Malakisë. Ai shfaqet vetëm 400 vjet më vonë me Gjon Pagëzorin. Është e paqartë se si lidhet dhuntia e "profecisë" në Dhjatën e Re me Dhjatën e Vjetër. Profetët e Dhjatës së Re (Veprat 11:27-28; 13:1; 15:32; 1 Kor. 12:10,28-29; 14:29,32,37; Efe. 4:11) nuk janë zbulues të ndonjë zbuluese ose Shkrimi të ri, por janë folës dhe parathënës të vullnetit të Perëndisë në situata besëlidhjeje.
- D. Profecia nuk ka vetëm, ose kryesisht, natyrë parashikuese. Parashikimi është një mënyrë për të vërtetuar këtë ofiqin dhe mesazhin e profetit, por duhet vërejtur se "më pak se 2% e profecive në Dhjatën e Vjetër janë mesianike. Më pak se 5% e tyre përshkruajnë në mënyrë

të veçantë epokën e Besëlidhjes së Re. Më pak se 1% e kësaj profecie bën fjalë për ngjarje të ardhshme”. (Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 166)

- E. Profetët përfaqësojnë Perëndinë para popullit, ndërsa priftërinjtë përfaqësojnë popullin para Perëndisë. Ky është një pohim i përgjithshëm. Ka dhe përjashtime si Habakuku, i cili i drejton pyetje Perëndisë.
- F. Një arsye pse është e vështirë të kuptojmë profetët është se nuk dimë sesi strukturoheshin librat e tyre. Ata nuk janë kronologjikë. Duket se janë tematikë, por jo gjithmonë ashtu siç e presim. Shpesh, nuk ka asnjë kontekst të qartë historik, as kornizë kohore, as ndarje të qartë mes profecive. Këta libra janë të vështirë
  - 1. të përfundohen me një lexim të vetëm;
  - 2. të përvijohen sipas temave; dhe
  - 3. të sigurohesh për të vërtetën qendrore ose synimin autorial në secilën profeci.

#### IV. KARAKTERISTIKAT E PROFECISË

- A. Në Dhjatën e Vjetër, duket se ka një zhvillim të konceptit “profet” dhe “profeci”. Në Izraelin e hershëm, u zhvillua një bashkësi profetësh, e kryesuar nga një drejtues i fortë karizmatik si Elija ose Elizeu. Nganjëherë, fraza “bij të profetëve” përdorej për të përcaktuar këtë grup (2 Mbret. 2). Profetët karakterizoheshin nga forma ekstaze (1 Sam. 10:10-13; 19:18-24).
- B. Megjithatë, nga kjo periudhë u kalua shpejt te profetët si individë. Kishte nga ata profetë (të vërtetë e të rremë) që identifikoheshin me mbretin dhe jetonin në pallatin mbretëror (Gadi, Natani). Po kështu, kishte nga ata që ishin të pavarur, nganjëherë tërësisht të palidhur me statukuo-në e shoqërisë izraelite (Amosi). Kishte edhe profetë edhe profetesha (2 Mbret. 22:14).
- C. Shpesh, profeti ishte zbulues i së ardhmes, e kushtëzuar nga reagimi i atypëratyshëm i njeriut. Shpesh, detyra e profetit ishte shpallja e planit të përbotshëm të Perëndisë për krijimin e vet, gjë që nuk ndikohej nga reagimi njerëzor. Ky plan i përbotshëm eskatologjik është unik ndër profetët e Lindjes së Afërt në lashtësi. Parashikimi dhe besnikëria ndaj besëlidhjes janë dy pika kyçe të mesazheve profetike (shih Fee dhe Stuart, f. 150). Kjo nënkupton se profetët kanë, pikësepari, fokus kolektiv. Zakonisht, por jo gjithmonë, ata i drejtohen kombit.
- D. Shumica e materialit profetik prezantohej gojarisht. Më vonë, kombinohej me anë të tematikave, kronologjisë, ose modeleve të tjera të letërsisë në Lindjen e Afërt, të cilat s’i kemi më. Për shkak se ishte gojor, ky material s’është aq i strukturuar sa proza e shkruar. Kjo i bën librat të vështirë për t’u lexuar nga fillimi në fund dhe të vështirë për t’u kuptuar pa një kontekst të veçantë historik.
- E. Profetët përdorin një sërë modelesh për të përçuar mesazhet e tyre.
  - 1. Skena e gjyqit – Perëndia e çon popullin e vet në gjyq, shpesh bëhet fjalë për një rast divorci, ku Yahweh refuzon gruan e vet (Izraelin) për tradhtinë e saj (Osea 4: Mikea 6).
  - 2. Këngë vajtimi për funeral – metri i veçantë i këtij lloji mesazhi dhe fjala e tij karakteristike, “mjerë”, e veçon si formë më vete (Isaia 5; Habakuku 2).
  - 3. Shpallja e bekimit të besëlidhjes – theksohet natyra e kushtëzuar e Besëlidhjes dhe jepen pasojat, pozitive dhe negative, për të ardhmen (Ligji i Përt. 27-28).

#### V. UDHËZIME TË DOBISHME PËR TË INTERPRETUAR PROFECINË

- A. Gjej synimin e profetit fillestar (redaktorit) duke vërejtur kontekstin historik dhe kontekstin letrar të secilës pjesë të profecisë. Zakonisht, ajo ka lidhje, në ndonjëfarë mënyre, me thyerjen e besëlidhjes së Moisiut nga ana e Izraelit.
- B. Lexo dhe interpreto gjithë profecinë, jo thjesht një pjesë të saj; përvijojta përmbajtjen. Shiko sesi lidhet ajo me profecitë rreth vetes. Përpiku të përvijosh gjithë librin.
- C. Supozo një interpretim të fjalëpërfjalshëm të pasazhit derisa diçka në tekst të të dëftojë një përdorim të figurshëm; pastaj, vëre gjuhën e figurshme në prozë.

- D. Analizo veprimin simbolik në dritën e kontekstit historik dhe pasazheve paralele. Mos harro se kjo letërsi e Lindjes së Afërt në lashtësi nuk është letërsi moderne, apo perëndimore.
- E. Trajtoji parashikimet me kujdes.
  - 1. A vlej në vetëm për kohën e autorit?
  - 2. A përmbushen më vonë në historinë e Izraelit?
  - 3. A janë ngjarje që ende s'kanë ndodhur?
  - 4. A kanë një përmbushje bashkëkohore dhe një përmbushje të ardhme?
  - 5. Lejo që përgjigjet e tua të drejtohen nga autorët e Biblës, jo nga autorët e sotëm.
- F. Preokupime të veçanta
  - 1. A cilësohet parashikimi nga ndonjë reagim i kushtëzuar?
  - 2. A është e qartë se kujt i drejtohet profecia (dhe pse)?
  - 3. A ka mundësi, nga ana biblike dhe/ose historike, për një përmbushje të shumëfishtë?
  - 4. Autorët e Dhjatës së Re, nën frymëzim, ishin në gjendje të shihnin Mesinë në shumë pasazhe të Dhjatës së Vjetër që nuk janë të dukshme për ne. Duket se ata përdornin tipologjinë ose lojën e fjalëve. Meqë ne s'jemi të frymëzuar, më mirë t'ua lemë atyre këtë qasje.

## VI. LIBRA TË DOBISHËM

- A. *A Guide to Biblical Prophecy* (Udhëzues për profecinë biblike), nga Carl E. Amending and W. Ward Basque
- B. *How to Read the Bible for All Its Worth* (Si të lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka), nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart
- C. *My Servants the Prophets* (Shërbëtorët e mi, profetët, nga Edëard J. Young
- D. *Plowshares and Pruning Hooks: Rethinking the Language of Biblical Prophecy and Apocalyptic* (Plugje dhe krasitëse: të rimendojmë terminologjinë e profecisë biblike dhe apokaliptikës), nga D. Brent Sandy
- E. *New International Dictionary of Old Testament Theology and Exegesis* (Fjalori i ri ndërkombëtar i teologjisë dhe eksegezës së Dhiatës së Vjetër), vëll. 4, f. 1067-1078
- F. *The Language and Imagery of the Bible* (Gjuha dhe Pamjet e Bilës) nga G. B. Caird

NASB	“dallimi i frymërave”
NKJV	“të dalluarit e frymërave”
NRSV	“dallimi i frymërave”
TEV	“aftësia për të daluar midis dhuntive që vijnë nga Fryma dhe atyre që nuk vijnë prej Tij”
NJB	“fuqia për të dalluar frymërat”

Ka tre burime të dhuntive njerëzore: (1) nga natyra (dmth., talente natyrore); (2) nga Fryma; dhe (3) nga djalli. Dhuntia është aftësia për të dalluar midis këtyre burimeve (shih 1 Tim. 4:1; 1 John 4:1-3).

■ **“larmi gjuhësh”** Ky është termi grek për “gjuhë” (dmth., *glōssa*). Ai përdorej në Dhjatën e Vjetër si një sinonim për “kombin”. Në greqisht ai përdorej për të folur gjuhën e një kombi. Kjo nënkuptonte që kishte konotacione të një gjuhe të njohur njerëzore. Megjithatë, nevoja për një interpretues, e cila gjithashtu është një dhunti frymërore, në vend të një përkthyesi, përgjatë diskutimit të plotë të Palit në kapitullin 14, të çon të mendosh se kjo ishte një e folur ekstatike në Korint.

Saktësisht se si “gjuhët” në Korint lidhen me gjuhët në Pentakost e regjistruar tek Veprat e Apostujve është e pasigurtë. Mrekullia tek Veprat e Apostujve 2 është e veshit (shih 1 Kor. 2:6,8,11), jo me gjuhën. Eksperiencat e gjuhëve tek Veprat e Apostujve komunikonin ungjillin drejtpërsëdrejti tek hebrenjtë e diasporës që ishin të pranishëm. Ajo gjithashtu funksionoi si një mënyrë për të dalluar praninë, fuqinë dhe vullnetin e Perëndisë për të përfshirë grupe të tjera, si Samaritanin (shih Veprat e Apo. 8) dhe Korneliusin, një oficer i ushtrisë romake (shih Veprat e Apo. 10). Gjuhët tek Veprat e Apostujve ishin një shenjë ndaj hebrenjve besimtarë që Perëndia kishte

hapur dyert që johebrenjtë të përfshiheshin (shih 1 Kor. 15:8). Vini re se nuk ka asnjë nevojë për një interpretues tek Veprat e Apostujve!

Gjuhët në Korint janë të ngjashme me të folurën ekstatike të feve greke (dmth., Delphi). Gjuhët korintase dukshëm po keqpërdorshin ose mbi-përlëvdoheshin (shih 1 Kor. 13:1 and 14:1-33).

Gjuhët janë një mënyrë se si një besimtar individual ka marrëdhënie intime me Perëndinë, por pa e kuptuar. Ajo është një dhunti e vlefshme (shih 1 Kor. 14:39), por nuk është për të gjithë besimtarët (shih 1 Kor. 12:29-30, e cila ka një seri pyetjesh që presin një “jo” si përgjigje). Ajo nuk është një dhunti që vërteton se dikush është i shpëtuar ose që tregon se është një person frymor. Gjuhët plus interpretimi ishin një mënyrë tjetër për të komunikuar ungjillin dhe rëndësinë e tij.

■ **“interpretimi i gjuhëve”** Korinti ishte një qytet kozmopolitan, romak në kulturë, grek në gjeografi. Vendndodhja e qytetit e kombinuar me rrezikn e anijeve rreth kepit të Greqisë në dimër e bënin atë një kryqëzim tregtar të perandorisë së lindjes dhe perandorisë së perëndimit. Çdo kombësi do të kishte qenë në Korint, por gjuhët kishin nevojë për një dhunti frymërore për të komunikuar mesazhin e tyre për kishën, jo vetëm një përkthyes. Gjuhët në Korint nuk ishin një gjuhë e njohur.

**12:11** Ky varg thekson të vërtetën që Fryma i jep çdo besimtar një dhunti shërbese (shih 1 Kor. 12:7,18). Gjithashtu, cila dhunti i jepet, është zgjedhje e Frymës dhe jo e besimtarit. Nuk ka një hierarki dhuntish. Të gjitha dhuntitë janë për t’i shërbyer trupit të Krishtit, kishës (shih 1 Kor. 12:7). Ato nuk janë etiketa meritash, por peshqirë shërtorësh.

TEMË E VEÇANTË: PERSONALITETI I FRYMËS (SPECIAL TOPIC: THE PERSONHOOD OF THE SPIRIT) tek 1 Korintasve 2:10

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:12-13

<sup>12</sup> Sepse ashtu si trupi është një, por ka shumë gjymtyrë, dhe të gjitha gjymtyrët e të njëjtit trup, megjithse janë shumë, formojnë një trup të vetëm, kështu është edhe Krishti. <sup>13</sup> Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në të njëjtin trup, qofshin Hebrenjtë apo Grekët, qofshin sklllevërit a të liruarit, dhe të gjithë e kemi jemi ujitur në të njëjtin Frymë.

**12:12** Kjo nis një paragraf të ri që përdoret për marrëdhëniet brenda trupit të njeriut si një metaforë për kishën (shih Efe. 4:4,16). Ai thekson unitetin në mes të diversitetit. Fokusi nuk është në ndonjë nga pjesët, por në funksionimin e të gjithës; jo individi, por familja.

Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re kanë një theks të përbashkët (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 12:7). Kjo nuk do të thotë të zhvlerësosh faktin që njerëzit bëhen të krishterë mbi bazë individuale, por që pasi dikush bëhet i krishter, fokusi është gjithmonë shëndeti, uniteti dhe mirëqenia e të gjithës!

**12:13 “në një Frymë”** Kjo parashtesë (*en*) mund të ketë kuptimin “në”, “me” ose “me anë të”. Kini kujdes në përdorimin e parashtesave të gjuhës koine greke për të bërë pohime doktrinale. Kjo është e paralelizuar me Efe. 2:18; 4:4.

Fryma është mjeti me anë të të cilit Perëndia i bind njerëzit për mëkat, i tërheq ata tek Krishti, i pagëzon ata në Krishtin dhe formon Krishtin në ta (shih Gjoni 16:8-14). Kjo është epoka e Frymës. Veprimtaria e Tij është shenja që epoka e re e drejtësisë ka ardhur. Dhuntia është Fryma dhe Fryma jep dhuntitë që reflektojnë detyrën e zbulimit të Krishtit, të tërhequrit të të humburve tek Krishti dhe formimin e ngjashmërisë me Krishtin tek besimtarët.

■ **“jemi pagëzuar të vetëm në të njëjtin trup”** Pagëzimi me ujë është një metaforë e një përjetese të mëparshme frymërore që ndodhi në konvertim (shih Efe. 4:5). Në mënyra të ndryshme, Efe. 4:4-6 e paralelizon këtë pasazh. Ky pagëzim i referohet shpëtimit fillestar, i cili i përfshin besimtarët në trupin e Krishtit, kishën. Faza bashkëkohore e përdorur shpesh “pagëzimi në Frymën e Shenjtë” është ngatërruese sepse biblikisht ajo i referohet besimit të një personi tek Krishti si shpëtimtar, por ajo përdoret sot për një përjetesë fuqizuese, të pjekur, të mëvonshme në jetët e besimtarëve. Unë nuk mohoj realitetin e kësaj eksperience të mëvonshme, por unë preferoj termin “eksperiencë me Zotin”. Teksa lexoj biografitë e të krishterëve të mëdhenj, del në pah një model: (1) t’i besosh Krishtit; (2) të përpiqesh t’i shërbesh Atij; (3) të dështosh të prodhosh fryt që zgjat; (4) acarimi me

përpjekjet personale; (5) t'i nënshtrohesh nevojës për Perëndinë që të bëjë punën e Tij; (6) të fuqizohesh për shërbesë; dhe (7) e gjithë lavdia Perëndisë, jo enës njerëzore.

☐ **“qofshin Hebrejtë apo Grekët, qofshin skllëvërit a të liruarit”** Nuk ka më dallime njerëzore bote apo barriera midis atyre që i besojnë Krishtit (shih Joel 2:28 cituar nga Pjetri tek Veprat e Apo. 2:14-36; Gal. 3:27-28; Kol. 3:11). Kjo e vërtetë sigurisht pranon barazinë e të gjithë njerëzve besimtarë. Megjithatë, ajo jo domosdoshmërisht heq të gjitha dallimet. Të gjithë besimtarët janë shërbëtorë të thirrur dhe të pajisur me dhunti, por një i krishterë mund të vazhdojë të jetë një skllav.

Kjo barazi do të kishte qënë shokuese për shoqërinë romake në Korint, ku burri ishte autoriteti supreme mbi (1) gruan e tij; (2) fëmijët e tij; (3) skllëvërit në shtëpinë e tij. Kishte një hierarki të fortë sociale. Teologjia radikale e Palit, e bazuar në mësimet dhe veprimet e Jezusit, ishte një ndryshim paradigm drastik dhe një botëkuptim i ri shokues i cili duhej të jetohej në marrëdhënie me kishën (shih Efe. 5:18-6:9). Specifikisht në këtë aspekt kisha në Korint ishte devijuese.

☐ **“të gjithë u krijuam për të pirë nga një frymë<sup>34</sup>”** Ky term u përdor për ujin vaditës. Ai fjalë për fjalë do të thotë “i njomur”. Kjo u interpretua si t'i referohej Darkës së Zotit nga Agustini, Luteri dhe Kalvini, por për shkak të Gjonit 7:37-39 ai mund t'i referohet Frymës. Është një metaforë e unitetit dhe bashkësisë së sjellë nga një agent, Fryma.

Të dy format “pagëzuar” dhe “bërë të pijmë” janë forma treguese pasive aoriste, të cilat nënkuptojnë një veprë të përfunduar në kohën e shkuar. Koha dhe paralelizmi tregojnë se ato nuk i referohen pagëzimit të krishterë me ujë dhe Darkës së Zotit, por një ndodhie të përmbushur në të shkuarën (dmth., konvertimit nga Fryma, dmth., në formë pasive, ose nga Krishti (shih Mat. 3:11; Luka 3:16; Veprat e Apo. 1:5, ose nga Ati, shih Veprat e Apo. 2:33).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:14-18

<sup>14</sup> Sepse edhe trupi nuk është një gjymtyrë e vetme, por shumë. <sup>15</sup> Sikur të thoshte këmba: “Mbasi nuk jam dorë, unë nuk jam pjesë e trupit,” mos për këtë nuk është pjesë e trupit? <sup>16</sup> Dhe sikur veshi të thoshte: “Mbasi nuk jam sy, unë nuk jam pjesë e trupit,” mos për këtë nuk është pjesë e trupit? <sup>17</sup> Po të ishte gjithë trupi sy, ku do të ishte dëgjimi? Po të ishte gjithë dëgjim, ku do të ishte të nuhaturit? <sup>18</sup> Por Perëndia ka vënë çdo gjymtyrë të trupit si ka dashur.

**12:14-26** Pali përdor trupin fizik si një analogji për të treguar marrëdhënien e ndërsjelltë midis pjesëve individuale të trupit të nevojshme për funksionimin e të tërit. Çdo pjesë individuale është e nevojshme për shëndetin dhe efektshmërinë e të gjithit.

**12:14** Kjo është e vërteta e përmbledhur e përsëritur disa herë në këtë kapitull (shih 1 Kor. 12:12,13,14,20,25,27).

**12:15-16 “Sikur... sikur”** Këto janë të dyja fjali kushtore të rendit të tretë, të cilat përcaktojnë veprim të mundshëm. Këto vargje tregojnë tensionin që ekziston midis jo vetëm grupimeve, por edhe mbi-vlerësimit të tyre të dhuntive të caktuara frymërore. Të gjitha dhuntitë janë nga Perëndia dhe Ai zgjedh cilën për secilin besimtar (shih 1 Kor. 12:11,18).

**12:17,19 “Po të... Po të”** Këto janë fjali kushtore të rendit të dytë të paplota (dmth., nuk ka folje tek 1 Kor. 12:17 dhe nuk ka fjali përmbyllëse në të tre ato). Pjesa e parë është e rreme (dmth., trupi i tërë nuk është një sy, 1 Kor. 12:17; trupi i tërë nuk është një vesh, v.17; dhe trupi i tërë nuk është një anëtar, 1 Kor. 12:19, shih A. T. Robertson, *A Grammar of the Greek New Testament In Light of Historical Research* [Një Gramatikë e Dhjatës së Re Greke nën Dritën e Kërkimeve Historike], fq. 1015,1023 dhe *Short Grammar of the Greek New Testament* [Gramatikë e Shkurtër e Dhjatës së Re Greke], fq. 166).

**12:18 “Perëndia ka vënë”** Kjo është një formë treguese aoriste e mesme, e cila nënkupton një veprim të plotë dhe personal. Tek 1 Kor. 12:11 Fryma thuhet se shpërndan dhuntitë. Ky është një identifikim i dukshëm i Frymës si hyjnore! Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:11.

<sup>34</sup> Versioni në shqip është: “të gjithë e kemi jemi ujtur në të njëjtin Frymë” (shënim i përkthyesit).



▣ “Perëndia ka vënë anëtarët, secilin prej tyre, në trup, ashtu siç Ai ka dashur<sup>35</sup>” Referenca është ndaj krijimit por analogjia është ndaj dhuntive frymërore (shih 1 Kor. 12:27). Ne nuk zgjedhim; Perëndia vendos.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:19-25**

<sup>19</sup> Po të ishin të gjitha gjymtyrët një gjymtyrë e vetme, ku do të ishte trupi? <sup>20</sup> Kështu, pra, janë shumë gjymtyrë, por një trup i vetëm. <sup>21</sup> Dhe syri nuk mund t’i thotë dorës: “Unë nuk kam nevojë për ty”; dhe po ashtu koka nuk mund t’u thotë këmbëve: “Unë nuk kam nevojë për ju.” <sup>22</sup> Madje, gjymtyrët e trupit që duken se janë më të dobëta, janë shumë më të nevojshme se të tjerat; <sup>23</sup> dhe ato që ne i konsiderojmë më pak të nderuara, pikërisht ata rrethojmë me më shumë nderim; dhe të pahijshmet tona kanë më tepër hijë. <sup>24</sup> Por gjymtyrët tona të hijshme nuk kanë nevojë. Por Perëndia e ndërtoi trupin duke i dhënë më tepër nder asaj pjesë që e kishte mangut, <sup>25</sup> që të mos kishte përçarje në trup, por të gjitha gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën.

**12:22-24 “më të dobëta... më pak të nderuara... të pahijshmet... asaj pjesë që e kishte mangut”** Kjo mund t’i referohet atyre pjesëve të trupit njerëzor që mbulohen me rroba. Ky diskutim zbulon se disa nga dhuntitë më pak të dukshme, më pak të dëshirueshme nga ana kulturore, më pak “të shfaqshme” ishin gjithësesi të nevojshme për një trup të shëndetshëm dhe të lumtur. Perëndia / Fryma i dha dhuntitë, të gjitha dhuntitë e nevojshme, të gjitha dhuntitë kanë nder. Shih TEMË E VEÇANTË: DOBËSIA (SPECIAL TOPIC: WEAKNESS) tek 2 Kor. 12:9.

▣ “më tepër nder” Ky term është si tek 1 Kor. 12:23 dhe tek 24. Shih Temën e Veçantë 2 Kor. 2:7.

**12:25** Ky varg shpreh pikën kryesore të Palit (dmth., një fjali e nënrenditur *hina*, një fjali e nënrenditur qëllimor). Kisha duhet të jetë një, jo e ndarë. Besimtarët duhet të kujdesen për njëri-tjetrin (shih 1 Kor. 12:7), jo të bëjnë gjërat e tyre!

Foljet janë në formë lidhore, gjë e cila prezanton një kontigjencë. Kjo është ajo që ata duhet të bëjnë, por ka dyshim rreth asaj që ata në të vërtetë bëjnë.

Termi “kujdes” zakonisht do të thotë ankth ose shqetësim (shih Mat. 6:25,27; 10:19; 13:22; 2 Kor. 11:28; Fil. 4:6). Ai gjithashtu mund të shprehë shqetësim të qënësishëm, sikurse në këtë tekst dhe tek 7:32,33,34 dhe Fil. 2:20.

▣ “përçarje” Ky është termi grek *schisma*, nga i cili ne marrim termin skizëm ose skizmatik. Pali i ka përmendur këto “përçarje” më parë (shih 1 Kor. 1:10; 11:18). Ato janë problemi thelbësor në Korint. Ndarjet lidheshin me (1) drejtues të caktuar; (2) thekse teologjike të caktuara; (3) qëndrim social romak; (4) lartësimin e dhuntive të caktuara; ose (5) mbetje e një mendësie pagane.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:26**

<sup>26</sup> Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të.

**12:26 “nëse... po të”** Këto janë fjali kushtore të rendit të parë (*eite* me formë treguese të tashme, shih 2 Kor. 1:6; pa asnjë folje, shih Rom. 12:6-8; 1 Kor. 3:22; 8:5; 14:27; 2 Kor. 5:10) e cila shpreh dëshirën e Palit për mënyrën se si besimtarët duhet të trajtojnë njëri-tjetrit (shih Rom. 12:15).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:27-31a**

<sup>27</sup> Dhe ju jeni trupi i Krishti dhe gjymtyrët e tij, veç e veç. <sup>28</sup> Dhe Perëndia i vuri disa në kishë, së pari apostuj, së dyti profetë, së treti mësues; pastaj vepra të fuqishme; pastaj dhuntitë e shërimit, të ndihmës e të qeverisjes dhe të *larmive* të gjuhëve. <sup>29</sup> A janë vallë të gjithë apostuj? Janë të gjithë profetë? Janë të gjithë mësues? <sup>30</sup> A kanë të gjithë dhuntinë e veprave të fuqishme? A kanë të gjithë dhuntitë e shërimeve?

<sup>35</sup> Versioni në shqip është: “Perëndia ka vënë çdo gjymtyrë të trupit si ka dashur” (shënim i përkthyesit).

**A flasin të gjithë gjuhë të ndryshme? A interpretojnë të gjithë? <sup>31</sup> Por kërkoni me zemër të zjarhtë dhuntitë më të mira.**

**12:28 “Perëndia i vuri”** Kjo është një formë aoriste e mesme. Kjo është teologjikisht paralele me 1 Kor. 12:18.

▣ **“kishë”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

▣ **“apostuj”** Termi grek është nga një nga foljet greke “të dërgosh”. Ai përdorej nga rabinët për dikë që sjell një përfaqësues zyrtar të dikujt tjetër. Në Ungjillin e Gjonit ai merr nënkuptimin e Jezus Mesias i cili u dërgua nga Perëndia. I Dërguari dërgon ndjekësit e Tij (shih Gjoni 20:21). Shih Temën e Veçantë: Dërgoj (Special Topic: Send) tek 1 Kor. 4:9.

Fillimisht kjo i referohet të Dymbëdhjetëve, por më vonë ai u përdor për të tjerët: (1) Barnaba (shih Veprat e Apo. 14:4,14); (2) Androniku dhe Junia (shih Rom. 16:7); (3) Apolloni (shih 1 Kor. 4:9); (4) Jakobi, gjysmë vëllai i Jezusit (shih Gal. 1:19); (5) Epafroditi (shih Fil. 2:25; (6 & 7) Silasi dhe Timoteu (shih 1 Thes. 2:6). Dhuntia e përmendur tek Efe. 4:11 është një dhunti e vazhdueshme.

▣ **“profetë”** Shih Temën e Veçantë: Profecia në Dhjatën e Re (Special Topics: NT Prophecy) tek 1 Kor. 14:1 dhe Profecia në Dhjatën e Vjetër (OT Prophecy) tek 1 Kor. 12:10.

▣ **“mësues”** Kjo dhunti përmendet tek Veprat e Apo. 13:1 në kombinim me profecinë, por tek Efesianëve 4:11, ajo lidhet me pastorët. Tek 2 Tim. 1:11 Pali thotë se ai është një predikues, apostull dhe një mësues. Këtu duket se qëndron i pavarur sikurse është tek Rom. 12:7. Gjithashtu diskutohet veçmas tek Jakobi 3:1 e në vazhdim. Kjo nënkupton se këto dhunti drejtimi mund të kombinohen në mënyra të ndryshme në besimtarë të ndryshëm për të përmbushur nevojën e kishës në atë kohë ose në atë zonë. Secili nga këta drejtues me dhunti shpallte ungjillin, por me thekse të ndryshme.

▣ **“mrekulli”<sup>36</sup>** Vini re tek 1 Kor. 12:9 dhe 10 kjo dhunti përmendet dy herë, por këtu një herë. Mrekullitë janë një mënyrë për të konfirmuar ungjillin. Ato janë të njohura në Ungjijt dhe tek Veprat e Apostujve dhe përmenden tek letrat apostolike. Ato janë ende të zakonshme në zonat ku ungjilli është i ri.

▣ **“shërimet”** Kjo dhunti funksionon si për të zbuluar dashurinë e Perëndisë ashtu edhe për të konfirmuar ungjillin. Pyetja nuk është nëse Perëndia ende shëron, por pse disa shërohen dhe disa jo? Jakobi 5:13-18 jep udhëzime të tjera rreth mënyrës se si duhet trajtuar kjo në një kishë lokale. Tek Jakobi është një shërbesë e pleqve të kishës, jo një dhunti frymërore.

**NASB, NKJV “ndihmës”**  
**NRSV “forma të ndihmës”**  
**TEV “fuqi për të... ndihmuar të tjerët”**  
**NJB “veprime ndihmëse”**

Ky term përdoret për “veprime ndihmëse”. Ai është një term i përgjithshëm dhe mund t’i referohet një shërbese të rregullt dhjakësh (shih Fil. 1:1 dhe M. R. Vincent, *Word Studies* [Studime Fjalësh], vol. 2, fq. 793).

**NASB, NKJV “qeverisjes”**  
**NRSV “forma të drejtimit”**  
**TEV “ata të cilëve iu jepet fuqi... t’i drejtojnë ata”**  
**NJB “dhuntitë e ... qeverisjes”**

Ky term u përdor fillimisht për një pilot anijeje (shih Veprat e Apo. 27:11; Zbu. 18:17). Ai u përdor në mënyrë metaforike për drejtuesit e kishës që funksionojnë si udhëzues. Kjo është aftësia për të drejtuar të tjerët që të përmbushin detyra frymërore.

<sup>36</sup> Versioni në shqip është: “vepra të fuqishme” (shënim i përkthyesit).

A. T. Robertson, *Word Pictures In Greek New Testament* [Pamje Fjalësh në Dhjatën e Re Greke], vol. 4, thotë se “ndihmës” i referohet veprës së dhjakëve teksa ndihmojnë të varfërit dhe të sëmurët dhe “qeverisjes” i referohet veprës së peshkopëve / pleqve / pastorëve, fq. 173-174.

▣ **“të larmive të gjuhëve”** Shih 1 Kor. 12:10.

**12:29-30** Kjo seri pyetjesh fillon me një pjesëz mohuese (dmth., *mē*), e cila përcakton se pyetjet presin një “jo” si përgjigje. Ky është një pasazh i rëndësishëm në kundërshtimin e pohimit të tepërt teologjik se “gjuhët e tjera” janë një dhunti për çdo besimtar, një lloj shenje konfirmuese e shpëtimit dhe / ose një shenjë e veçantë e stadi të vërtetë frymor. Ajo është një dhunti e vlefshme, por jo për këdo. Ekstremi tjetër është të refuzosh “gjuhët e tjera” si një mënyrë për të hedhur pas epokën apostolike. Ky është gjithashtu një pohim i tepërt teologjik (shih 1 Kor. 14:39).

E gjithë pika e këtij kapitulli është se është një trup, por shumë pjesë. As edhe një pjesë (dmth., dhuntia) nuk është e shquar.

### 12:31a

**NASB, NIV** “Por kërkonte me zemër të zjarrtë dhuntitë më të mëdha”  
**NKJV** “Por kërkonte me zemër të zjarrtë dhuntitë më të mira”  
**NRSV** “por kërkonte me zell për dhuntitë më të mëdha”  
**TEV** “Vendosni zemrat tuaja, më pas, mbi dhuntitë më të rëndësishme”  
**NJB** “Vendosni mendjet tuaja mbi dhuntitë më të larta”

Kjo është ose (1) një formë treguese aktive e tashme (dmth., një pohim ose një fakt) ose (2) një formë urdhërore aktive e tashme (dmth., një urdhërim i vazhdueshëm). W. Randolph Tate, *Biblical Interpretation* [Interpretim Biblik], preferon formën treguese: “ju jeni duke kërkuar me zell dhuntitë më të mira” si një tjetër nga komentet sarkastike të Palit (fq. 22).

Pjesa e dytë e këtij vargu duhet të shkojë me kapitullin 13. Dhuntitë më të mëdha do t’i referoheshin (1) besimit, shpresës dhe dashurisë tek 1 Kor. 13:13, ku dashuria është më e madhja ose (2) dhuntive që ngrenë të gjithë trupin, 1 Kor. 14:1 e në vazhdim, të cilat do të ishin predikimi dhe mësimi (shih 1 Kor. 12:28).

Ky mohim duket se i referohet kishës si e tërë, jo individit. Fokusimi mbi individin është një predispozitë e zakonshme perëndimore. Fokus i këtij kapitulli është marrëdhënia e përbashkët. Kisha duhet t’i kërkojë Frymës më shumë nga dhuntitë e Tij (dmth., besimtarët) që shpallin ungjillin dhe që ndërtojnë trupin.

## PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse kishte një problem të tillë me dhuntitë frymërore në Korint?
2. Kur duhet të marrë një besimtar dhuntinë e tij / saj frymërore? A ka secili një dhunti? A mundet që dikush të ketë më shumë se sa një dhunti frymërore? A mund të zgjedhë një person dhuntinë e tij / saj?
3. Cili është qëllimi i dhuntive frymërore?

## DISA UDHËZIME PRAKTIKE PËR MËNYRËN SE SI BESIMTARËT MUND TË NJOHIN DHUNTITË E TYRE

1. Kërkojini Perëndisë t’ju tregojë specifikisht.
2. Kërkojini besimtarëve të tjerë që të njohin se cila mendojnë se mund të jetë dhuntia juaj.
3. Zbuloni dëshirat tuaja natyrore.
4. Lëvizni në drejtimin e dritës më të mirë që ju keni dhe dëshirës suaj.

5. Përpiquni dhe kërkoni për kënaqësi personale dhe fryte frymërore.

Këto janë marrë nga një libërth i mrekullueshëm nga Paul Little, *Affirming the Will of God* [Të Konfirmosh Vullnetin e Perëndisë], e publikuar nga IVP. Ai jep urtësi të krishterë, jo Shkrime, mbi mënyrën se si të njohësh vullnetin e Perëndisë, i cili është analog ndaj mënyrës se si të njohësh dhuntitë frymërore.

Megjithatë, besimtarët kanë nevojë të kujtojnë se listat e dhuntive nuk janë të njëjta. Të mund të emërtosh dhuntinë tonë nuk është aq e rëndësishme sa të dallosh që ne kemi një dhunti. Besimtarët, të gjithë besimtarët, thirren dhe pajisen me dhunti për shërbesë (shih Efe. 4:11-12).

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 13

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Sjellja gjatë Adhurimit Publik (11:2-14:40)
Dashuria	Dhuntia më e Madhe	Dashuria, Dhuntia më e Madhe dhe Rruga	Dashuria	Rendi i Rëndësisë në Dhuntitë Frymërore dhe Dashuria
12:31b-13:3				12:31b-13:3
	13:1-13	13:1-13	13:1-13	
13:4-7		13:4-7	13:4-7	13:4-7
13:8-13		13:8-13	13:8-10 13:11-12 13:13	13:8-12 13:13

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 13:1-13**

- A. Ky kapitull formon një pjesë integrale të diskutimit të Palit për dhuntitë frymërore. “Kapitulli i dashurisë” është i vendosur drejt në mes të konfliktit mbi dhuntitë frymërore.
- B. Kisha në Korint ishte përpjekur të lartësonte disa nga dhuntitë. Pali konfirmon të gjitha dhuntitë dhe vendos kufijtë për funksionin e tyre dhe qëllimin e tyre në adhurimin e përbashkët në kapitujt 12-14.
- C. Sprova e dytë e madhe e dhuntive frymërore (shih Njohuri Kontekstuale, kapitulli 12, B) është: “A po ushtrohen ato në dashuri?”

#### **SKICIMI BAZË**

- A. Nevoja e dashurisë si motivi për të ushtruar dhuntitë frymërore (1 Kor. 13:1-3).
- B. Karakteri i dashurisë shprehet në marrëdhëniet me njerëzit (1 Kor. 13:4-7).
- C. Lartësia e dashurisë si karakteristikë e familjes së Perëndisë (1 Kor. 13:8-13).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 12:31b-13:3**

<sup>12:31</sup> dhe unë do t'ju tregoj një udhë shumë më të lartë. <sup>13:1</sup> Po të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve, dhe të mos kisha dashuri, do të bëhesha si një bronz që kumbon ose si cimbali që tingëllon. <sup>2</sup> Edhe sikur të kisha *dhuntinë* e profecisë, edhe të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën dhe të kisha gjithë besimin sa të luaja nga vendi malet, por të mos kisha dashuri, nuk jam asgjë. <sup>3</sup> Edhe sikur të ndaja gjithë pasuritë e mia për të ushqyer të varfërit dhe ta jepja trupin tim që të digjej, e të mos kisha dashuri, nuk do të më vlente asgjë!

**12:31b “një udhë shumë më të lartë”** Termi “shkëlqyer” / “lartë” është një term grek i përbërë nga *huper* (dmth., mbi ose përtej) dhe *ballō* (dmth., të hedhësh). Është metaforike për atë që shkon përtej. Pali e vendos këtë metaforë shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 1:8; 3:10; 4:7; 9:14; 11:23; 12:7). Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA *HUPER* (Special Topic: Paul's Use of Huper Compounds) tek 1 Kor. 2:1.

Termi “rruga” është një metaforë e Dhjatës së Vjetër për stil jetese të perëndishëm (shih Ligji i Përt. 5:32-33; 31:29; Ps. 27:11; Isa. 35:8). Besimi i Dhjatës së Vjetër, sikurse besimi i Dhjatës së Re, nuk ishte thjesht një kredo e saktë (ortodoksi), por një jetë bindjeje (ortopraksi). Titulli i kishës së hershme ishte “Rruga” (shih Veprat e Apo. 9:2; 19:9,23; 24:14,22). Më e mira e Perëndisë është një jetë dashurie që vetë-jepet, e modeluar nga Vetë Ai dhe Biri i Tij.

**13:1 “Po të”** Kjo është një seri fjalish kushtore të rendit të tretë, të cilat nënkuptojnë veprim të mundshëm, tek 1 Kor. 13:1, 2, dhe 3 (dy herë).

**NASB, NKJV “të flisja gjuhët e njerëzve dhe të engjëjve”**

**NRSV “të flisja me gjuhë të vdekatarëve dhe engjëjve”**

**TEV “të isha i aftë të flisja gjuhët e qenieve njerëzore dhe madje të engjëjve”**

**NJB “sikur të komandoja gjuhët edhe njerëzore edhe engjëjlore”**

Kjo është dukshëm një referencë ndaj dhuntisë së gjuhëve të përmendur tek 1 Kor. 12:10,28-29, një dhunti të cilën kisha korintase e lartësonte dhe Pali e kishte (shih 1 Kor. 14:1,5,6,18-19).

Duke qënë se mendoj se “gjuhët” tek Veprat e Apostujve ishin të ndryshme nga “gjuhët” në Korint, kjo referencë e dyfishtë më bën të mendoj nëse Pali ndoshta gjithashtu i kuptonte gjuhët që të ishin gjuhë njerëzore (dmth., Pentakosti) dhe një e folur ekstatike (dmth., gjuha e qiellit). Me siguri, ai konfirmon se vetëm një aftësi e plotë linguistike është e papërshtatshme përveçse nëse fuqizohet nga dashuria” krishtërimi është më shumë se sa një mesazh; ai është një person, një person vetë-dhënës, i dashur, i bindur – Jezusi.

☐ **“dashuri”** Ky është termi grek *agapē*. Ajo ishte një nga disa prej fjalëve për “dashuri” në greqishten klasike, por përdorej jo shpesh (dmth., forma emërore). Kisha e hershme duket se kishte zgjedhur këtë term dhe e përdori atë me një konotacion të ri të krishter (dmth., dashuria vetë-dhënëse e Perëndisë dhe Krishtit, shih 1 Gjoni 4:10) për shkak të përdorimit të saj tek Septuaginti (p.sh., Zan. 22:2) dhe judaizmi rabinik. Në Dhjatën e Vjetër dashuria e besëlidhjes e Perëndisë dhe besnikëria ndaj premtimeve dhe besëlidhjeve të Tij gjithmonë ishte shprehur nga *hesed*. Në shumë mënyra *agapē* shpreh këtë koncept të “dashurisë së besëlidhjes” duke e paralelizuar atë me “Mbretërinë e Perëndisë”. Ajo bëhet termi i Dhjatës së Re për karakterin e Perëndisë, i cili dëshiron që ndjekësit e tij ta imitojnë (shih 1 Gjoni 4:7-21).

Vetëm një shënim për marrëdhënien e *agapē* me *philos*. Në disa kontekste duket se ka një dallim (shih Gjoni 21:15-19). Megjithatë, në gjuhën koine greke ato janë sinonime të rregullta (shih Gjoni 3:35 dhe 5:20).

**TEMË E VEÇANTË: DASHAMIRËSI (HESED) [SPECIAL TOPIC: LOVINGKINDNESS (HESED)]**

Ky term (BDB 338 I, KB 336 II) ka një fushë të gjerë semantike.

**A. I përdorur në lidhje me qeniet njerëzore**

1. mirësi ndaj njerëzve të tjerë (shih 1 Sam. 20:14; 2 Sam. 16:17; 2 Kro. 24:22; Job 6:14; Psa. 141:5; Fjalët e Urta 19:22; 20:6)
2. mirësi ndaj të varfërve dhe nevojtarëve (p.sh., Mikea 6:8)
3. mirëdashje e Izraelit ndaj YHWH (shih Jer. 2:2; Os. 6:4,6)
4. bukuria e përkohshme e një luleje të egër (shih Isa. 40:6)

**B. I përdorur në lidhje me Perëndinë**

**1. dashuri dhe besnikëri besëlidhjeje**

- i. “në shpengim nga armiqtë dhe vështirësitë” (p.sh., Zan. 19:19; 39:21; Eksod. 15:13; Psa. 31:16; 32:10; 33:18,22; 36:7,10; 42:8; 44:26; 66:20; 85:7; 90:14; 94:18; 107:8,15,21,31; 109:21-22; 143:8,12; Jer. 31:3; Esdra 7:28; 9:9)
- ii. “në ruajtjen e jetës nga vdekja” (p.sh., Job 10:12; Ps. 6:4-5; 86:13)
- iii. “në ringjalljen e jetës shpirtërore” (p.sh., Psa. 119:41,76,88,124,149,159)
- iv. “në shpengimin nga mëkati” (shih Psa. 25:7; 51:1; 130:7-8)
- v. “në zbatimin e besëlidhjeve” (p.sh., Ligji i Përt. 7:9,12; 2 Kro. 6:14; Neh. 1:5; 9:32; Dan. 9:4; Mik. 7:20)

2. përshkruan një cilësi hyjnore (p.sh., Eksod. 34:6; Ps. 86:15; 103:8; Neh. 9:17; Joel 2:13; Jona 4:2; Mikea 7:20)

**3. mirësia e Perëndisë**

- a. “e pasur” (p.sh., Num. 14:18; Neh. 9:17; Ps. 86:5; 103:8; 145:8; Joel 2:13; Jer. 4:2)
- b. “e madhe në shtrirje” (p.sh., Eks. 20:6; Ligji i Përt. 5:10; 7:9)
- c. “e përjetshme” (p.sh., 1 Kro. 16:34, 41; 2 Kro. 5:13; 7:3, 6; 20:21; Esdra 3:11; Ps. 100:5; 106:1; 107:1; 118:1,2,3,4,29; 136:1-26; 138:8; Jer. 33:11)
- d. si një fortesë (p.sh., Ps. 59:17)
- e. e lidhur me fuqinë e Perëndisë (p.sh., Ps. 62:11c-12a)

4. vepra dashamirësie (p.sh., 2 Kro. 6:42; Psa. 89:2; Isa. 55:3; 63:7; Vaj. 3:22)

Kjo fjalë përkthehet në shumë mënyra në përkthimet në anglisht. Unë mendoj se përkufizimi përmbledhës më i mirë do të ishte “besnikëria e besëlidhjes së Perëndisë pa asnjë kushtëzim”. Kjo është paralele ndaj termit “dua” në Dhjatën e Re (*agapaō*). Perëndia është besnik dhe i dashur për shkak të asaj që Ai është!

**NASB, NRSV** “një gong i zhurmshëm ose një cimbal që tingëllon”

**NKJV** “si një bronx që kumbon ose si një cimbal që tingëllon”

**TEV** “jo më shumë se një gong i zhurmshëm ose një zile që tingëllon”

**NJB** “një gong që zhurmon ose një cimbal që kërcet”

Historikisht në botën romake të shëkullit të parë kjo përdorej nga kultet e Dionisit dhe të Cibeles në adhurim për të tërhequr hyjësitë e tyre. Në kontekstin e shpërdorimit korintas ai mund të nënkuptojë metaforikisht “një fanfarë të borive” (shih Mat. 6:2), e cila tërhiqte vëmendjen për tek folësi sikurse bënin burrat duke mbuluar flokët e tyre në adhurimin e përbashkët apo gratë duke zbuluar flokët e tyre të shkurtër në adhurimin e përbashkët (shih 1 Kor. 11:4-5).

Qyteti i Korintit ishte i njohur në botën antike për punimet e tij të bronzit. Përdorimi i këtij materiali ishte për “rritje të rezonancës” në teatër (shih *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalori i Palit dhe Letrave të Tij], fq. 172).

Paralelizmi i Palit tregon intensitetin e ndjenjave të tij mbi veprimtarinë frymërore pa dashuri.

1. “unë jam bërë një gong i zhurmshëm” (koha e përkryer), 1 Kor. 13:1
2. “unë jam asgjë” (koha e tashme), 1 Kor. 13:2

3. “nuk më vlen asgjë” (koha e tashme), 1 Kor. 13:3

**13:2 “dhuntinë e profecisë”** Në këtë libër, ky term kuptohet më mirë si “ndarja e mesazhit të ungjillit” (shih 1 Kor. 11:4,5; 14:39). Tre termat e parë të 1 Kor. 13:2 lidhen me dhuntitë e urtësisë dhe njohurisë (shih 1 Kor. 12:8). Kishte një problem në këtë aspekt sikurse tregojnë pohimet negative të Palit të 1 Kor. 1:17,19,20,21,22,24; 2:1,4,5,6,13; 3:19. Profecia pa dashuri, sikurse urtësia dhe njohuria pa dashuri, nuk është e pëlqyeshme nga Perëndia. Dhuntitë frymërore mund të përdoren në mënyra të papërshtatshme. Për konceptin “profeci” në Dhjatën e Vjetër shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 12:10 dhe Profeci e Dhjatës së Re tek 1 Kor. 14:1.

▣ **“të dija të gjitha misteret dhe mbarë shkencën”** Pali e përdor këtë tek 1 Kor. 4:1 për të vërtetat e ungjillit dhe tek 1 Kor. 15:51 për të vërteta specifike mbi ringjalljen e trupit. Në këtë kontekst, kjo frazë duket se i referohet njohurisë në çdo formë të saj, të cilën besimtarët në Korint po e vlerësonin dhe kërkonin. Edhe njohuria e përkryer pa dashuri nuk i pëlqen Perëndisë. Shih TEMË E VEÇANTË: MISTERI (SPECIAL TOPIC: MYSTERY) tek 1 Kor. 2:1.

▣ **“gjithë besimin”** Kjo i referohet besimit që bën mrekulli (shih 1 Kor. 12:9,28; Mat. 17:20; 21:21), por vini re tek Mat. 7:21-23 se fuqia mrekulli-bërëse pa dashuri nuk i pëlqen Perëndisë dhe as nuk e njeh Perëndinë. Për konceptin e “besimit” në Dhjatën e Vjetër shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9 dhe Dhjata e Re tek 1 Kor. 2:4.

**13:3**

NASB	“të jepja të gjitha pasuritë e mia”
Nkjv	“të ndaja të gjithë të mirat e mia”
NRSV	“të jepja tek të tjerët gjithçka që kam”
TEV	“të mund të jepja tek të tjerët gjithçka që kam”
NJB	“të duhej të jepja... gjithçka që kam në pronësi”

Kjo nënkupton të japësh gjithçka që ke, personalisht, çdo pjesë (shih Gjoni 13:26,27,30). Ky mund të jetë një aludim ndaj diskutimit të Jezusit me sunduesin e ri të pasur (Mat. 19:16-29; Mark 10:17-30; Luka 18:18-30).

NASB, NKJV	“për të ushqyer të varfërit”
NRSV	- nuk është –
TEV	- nuk është –
NJB	“tek të varfërit”

Kjo frazë nuk është në tekstin grek, por nënkuptohet në veprimin e kësaj foljeje.

NASB, NKJV, TEV, NJB	“trupin tim që të digjej”
NRSV	“trupin tim që unë të mburrem”

Ka dy mundësi dorëshkrimi: “digjej” (dmth., *kauthēsomai*) dhe “lavdi” (dmth., *kauchēsōmai*) të dy ja gjenden tek dorëshkrimet e hershme greke dhe tek etëritë e hershëm të kishës. Faza, “që unë të përlevdoj”, ka mbështetjen më të fortë të dorëshkrimit (dmth., MSS P<sup>46</sup>, א, dhe B), por UBS<sup>4</sup> nuk bën një dallim midis tyre. Ai është gjithashtu një term i përdorur shpesh nga Pali (shih 2 Kor. 8:24; Fil. 2:16; 1 Thes. 2:19; 2 Thes. 1:4).

Martirizimi duke u djegur ishte i panjohur në kishën e hershme, por u bë gjithnjë e më i zakonitë në persekutimet e mëvonshme (dmth., Nero dhe Domitiani). Prandaj, një person mund të kuptojë se si një skrib i mëvontë mund ta ketë ndryshuar “përlevdoj” në “digjej”.

Për një diskutim të plotë të varianteve tekstuale shih Bruce M. Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentari Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke], fq. 563-564. Për mendimin e kundërt shih *The Expositor's Bible Commentary* [Komentari Biblik i Studiuesit], fq. 270 shënimi.



## VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 13:4-7

<sup>4</sup> Dashuria është e durueshme; plot mirësi; dashuria nuk ka smirë, nuk vë në dukje, nuk krekoset, <sup>5</sup> nuk sillet në mënyrë të pahijshme, nuk kërkon të sajat, nuk pezmatohet, nuk dyshon për keq; <sup>6</sup> nuk gëzohet për padrejtësinë, por gëzohet me të vërtetën, <sup>7</sup> i duron të gjitha, i beson të gjitha, i shpreson të gjitha, i mban çdo gjë.

**13:4-7** Kjo mund të ketë qënë një himn ose poezi mbi dashurinë, e shkruar ose e cituar nga Pali. Të gjitha këto përshkrime të dashurisë janë aktive. Dashuria është një veprim, jo thjesht një emocion. Të gjitha këto përshkruajnë shërbesën e Jezusit (zbulesa e plotë dhe tërësore e YHWH) ndërsa ai u mor me njerëzit e papërkryer. Dashuria është një person!

**13:4 “e durueshme”** Kjo folje (forma treguese aktive e tashme) ka konotacionin e durimit me njerëzit (shih Fjalët e Urta 19:11; 1 Thes. 5:14; Jakobi 5:7,8; 2 Pjet. 3:9) të cilët sillen në mënyrë të padrejtë ndaj nesh, pa hakmarrje. Kjo është një nga frytet e Frymës (shih Gal. 5:22). Ajo është një karakteristikë e Perëndisë (shih Rom. 2:4; 9:22; 1 Tim. 1:16; 1 Pet. 3:20). Ajo (emri) duhet të karakterizojë besimtarët e epokës së re, të banuar nga Fryma e Perëndisë (shih 2 Kor. 6:6; Kol. 1:11).

☐ **“mirësi”** Kjo folje gjendet jo vetëm këtu dhe është gjithashtu një term i përqëndruar tek njerëzit. Ajo nënkupton “të jesh i mirë me të gjithë”. Pjetri gjithashtu përdor të njëjtin term për Jezusin tek 1 Pjet. 2:3. Ajo është gjithashtu një nga frytet e Frymës tek Gal. 5:22.

☐ **“nuk ka smirë”** Kjo përshkruan një dëshirë të madhe, fjalë për fjalë “të ziesh”. Dashuria nuk dëshiron për vetveten pasuritë e njerëzve apo kontroll mbi njerëzit.

☐ **“nuk vë në dukje”** Ky term i rrallë i referohet një personi që shihet nga të tjerët si mburravec ose llafazan. Ai shpesh lidhet me krenarinë intelektuale ose retorike ose me mburrjen në letërsinë greke.

☐ **“nuk krekoset”** Ky term i referohet atyre që mbivlerësojnë dhe mburren me vetveten. Ai përdoret shpesh tek 1 Korintasve (1 Kor. 4:6,18,19; 5:2; 8:1) dhe këtu. Ai vërtet reflekton karakterin e kësaj kishe. Shih shënimin tek 1 Kor. 4:6.

**13:5 “sillet në mënyrë të pahijshme”** Ky nuk është një term i thjeshtë për t’u përkufizuar. Ai përdoret tek 1 Kor. 7:36 në një kuptim më pozitiv. Këtu nënkuptimi i saj është negativ. Termi përdoret në papirusët egjiptianë duke nënkuptuar një mallkim ose një bërje betimi të lidhur me një veprim të dhunshëm apo të papërshtatshëm (shih 1 Kor. 12:3). Ai nënkupton sjellje të pahijshme në vend të sjelljes së hirshme.

☐ **“nuk kërkon të sajat”** Kjo është një e vërtetë e përsëritur shpesh (shih 1 Kor. 8:9; 10:24,33; Rom. 14:16; Fil. 2:3). Kjo mund të lidhet teologjikisht me Efe. 5:21, për të qënë të nënshtruar ndaj njëri-tjetrit nga respekti për Krishtin.

☐ **“nuk pezmatohet”** Ky term është fjalë për fjalë “të mprehësh”. Ai përdoret metaforikisht për të “trazuar”. Ai mund të jetë pozitiv si tek Veprat e Apo. 17:16 ose negativ, sikurse këtu. Përkthimi Phillips përmban “nuk preket”, e përdorur në kuptimin e “jo lehtësisht e acarueshme apo e zemërueshme”. Ky emër përdoret nga Pali dhe Barnaba në grindjen me Gjon Markun (shih Veprat e Apo. 15:39).

Nasb	“nuk merr parasysh të këqijat e vuajtura”
Nkjv	“nuk mendon për keq”
Nrsv	“apo e ofenduar”
Tev	“nuk mban mend të këqijat”
Njb	“nuk ruan kundërshtimet”

Ky është një term kontabiliteti për mbajtjen e faturave të papaguara (shih 2 Kor. 3:5; 12:6). Ai i referohet dikujt që mban një frymë hakmarrëse. Një shembull mund të jetë Veprat e Apo. 15:36-41 dhe 2 Tim. 4:11 mbi Gjon Markun.

Ka mundësi që ky të jetë një aludim ndaj përkthimit të Septuagint-it të Zak. 8:17 “askush të mos kurdisë në zemër të vet ndonjë të keqe kundër të afërmit të vet”. Megjithatë, duke qënë se frazat rrethuese nuk janë aludime ndaj Dhjatës së Vjetër, ulet mundësia që ky të jetë një aludim.

**13:6** Ky është një pohim si negativ ashtu edhe pozitiv i së vërtetës. Në këtë kontekst ai mund t’i referohet thashethemeve brenda komunitetit të krishter. Është e pazakontë që termi “padrejtësi” të vihet në kontrast me “e vërtetë”. Ndoshta “padrejtësi” është e kundërta e “jetesës së drejtë” dhe e vërtetë i referohet mesazhit të ungjillit.

▣ **“me të vërtetën”** Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 13:8.

**13:7 “i duron të gjitha”** Termi “të gjitha” (dmth., *panta*) ndeshet katër herë në këtë varg për efekt theksimi. Dashuria është përfshirëse. “Të gjitha” përdoret në kuptimin “të gjitha kohërat” (dmth., të katër *foljet* janë në kohën e tashme) dhe “të gjitha rastet”.

Termi “duron” është nga fjala greke për “çati” (shih Mat. 8:8). Ajo është metaforike për (1) mbulimin (shih 1 Pjet. 4:8, term i ndryshëm, por i njëjti koncept) ose (2) durimin (shih 1 Kor. 12:9; 1 Thes. 3:1,5). Përkthimi Moffat ka “i ngadaltë për t’u shfaqur”.

▣ **“i beson të gjitha”** Në këtë kontekst, kjo nënkupton “shikon më të mirën tek të tjerët” ose “i jep një vëllai të krishter përfitimin e dyshimit”. Ajo gjithmonë mban besimin (shih Gal. 5:22).

▣ **“i shpreson të gjitha”** Në këtë kontekst, dashuria mban shpresën e një vëllai besimtar për zhvillimin e tij në besim. Ajo nuk dëshpërohet.

▣ **“i mban çdo gjë”** Ky është një term i fuqishëm për tundimin dhe sprovimin e vazhdueshëm (shih Mat. 10:22; 24:13; Heb. 10:32; Jakobi 1:12). Këtu ajo flet për qëndrueshmërinë e vullnetshme dhe të vazhdueshme. Kjo frazë thekson se nuk duhet të ketë hakmarrje apo refuzim personal, por një qëndrueshmëri të vazhdueshme, sidomos me njerëzit.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 13:8-13

<sup>8</sup> Dashuria nuk ligshohet kurrë; por profecitë shfuqizohen, gjuhët pushojnë dhe njohuria do të shfuqizohet, <sup>9</sup> sepse ne njohim pjesërisht dhe profetizojmë pjesërisht. <sup>10</sup> Por, kur të vijë përsosmëria, atëherë ajo që është e pjesshme do të shfuqizohet. <sup>11</sup> Kur isha fëmijë, flisja si fëmijë, mendoja si fëmijë, arsyetoja si fëmijë; kur u bëra burrë, i flaka gjërat fëminore. <sup>12</sup> Tani në fakt, ne shohim si në pasqyrë, në mënyrë të errët, por atëherë do të shohim faqe për faqe; tashti njoh pjesërisht, kurse atëherë do të njoh thellë ashtu sikurse njihem. <sup>13</sup> Tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria; por më e madhja nga këto është dashuria.

**13:8** Disa përkthime fillojnë me një paragraf të ri tek 1 Kor. 13:8. Diskutimi i Palit mbi dashurinë e krishterë po ndryshon dhe po zhvillohet disi në një drejtim tjetër (dmth., cilësitë dhe veprimtaritë e kësaj epoke përkundrejtë konsumimit të epokës së re, e cila është inauguruar).

▣ **“Dashuria nuk ligshohet kurrë”** Ky term ka dy përdorime të lidhura metaforikisht: (1) ai përdorej për një aktor që i cicërohej nga jashtë skene ose (2) përdorej për një lule së cilës i binin petalet për shkak të kushteve të papërshtatshme klimaterike (shih Jakobi 1:11; 1 Pjet. 1:24). Dashuria e Perëndisë nuk heq dorë kurrë!

Nasb “nëse janë... nëse janë... nëse është”

Nkjb “nëse... nëse... nëse”

Nrsv “për sa i përket... për sa i përket... për sa i përket”

Tev “janë... janë... është”

Njb “nëse janë... nëse... nëse”

Forma gramatikore *eite* (tre fjalitë kushtore të rendit të parë) nënkupton se ka dhunti frymërore.

■ **“profecitë shfuqizohen, gjuhët pushojnë dhe njohuria do të shfuqizohet”** Vini re strukturën paralele. Këto ishin dhunti frymërore që kisha korintase po i lartësonte (shih 1 Kor. 13:1-3). Ky varg shpesh është përdorur për të zhvlerësuar gjuhët e tjera për shkak të një folje ndryshe dhe formës së përdorur. Megjithatë, konteksti është konfirmimi që të gjitha dhuntitë frymërore do të ndalojnë, por dashuria nuk do të ndalojë kurrë. Nuk ka asnjë theks në këtë kontekst mbi elementin kohë të njërës dhunti ndaj tjetrës. Dhuntitë frymërore janë një pjesë të kohës, jo në përjetësi. Dashuria është e përjetshme!

Ky term për “shfuqizohet” është tek 1 Kor. 13:8,10, dhe 11. Shih TEMË E VEÇANTË: KATARGEË (Special Topic: Katargeë) tek 1 Kor. 1:28.

**13:9** Kjo nis një seri vargjesh që theksojnë natyrën pjesore dhe paplotshmërinë e dhuntive frymërore. Kjo pjesshmëria është për shkak të dobësisë, natyrës së rënë dhe fundësisë njerëzore, jo për shkak të një mungese të lidhjes me dhuntitë nga Perëndia.

**13:10 “kur të vijë përsosmëria”** Ky term (dmth., *teleios*) do të thotë “pjekuri, plotësi” ose “plotësisht i pajisur për një detyrë të caktuar” (shih 1 Kor. 2:6; 13:10; 14:20). Pyetja gjithnjë ka qënë: “Kujt i referohet ajo?”:

1. Disa kanë mbrojtur mendimin se i referohet Dhjatës së Re. Asgjë në këtë kontekst nuk tregon drejt kësaj. Kjo është vetëm një teori e përdorur për të pretenduar se dhuntitë frymërore kanë mbaruar në kohërat pas-apostolike.
2. Disa kanë mbrojtur mendimin se i referohet pjekurisë frymërore për shkak të 1 Kor. 13:11 (dmth., fëmi dhe më pas i rritur) ose përdorimi i duhur i dhuntive frymërore.
3. Disa kanë mbrojtur mendimin se i referohet Ardhjes së Dytë të Krishtit dhe konsumimit të Epokës së Re të drejtësisë për shkak të 1 Kor. 13:12 (dmth., “shohim faqe për faqe”).
4. Për mua duket që është një kombinim i pikave numër 2 dhe 3.

Përdorimet dhe ngjyrimet e ndryshme të *teleios* mund të shihen në përdorimin e tij në librin e Hebrenjve. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: FUND OSE PLOTË [SPECIAL TOPIC: END OR FULL (TELOS)] tek 1 Korintasve 2:6

**13:11 “i flaka gjërat”** Ky është termi grek *katargeō*, të cilin Pali e përdor shumë shpesh. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:28. Në këtë kontekst Pali shpall se

1. profecitë do të përfundojnë, 1 Kor. 13:8 (forma treguese e ardhme pasive)
2. njohuria do të përfundojë, 1 Kor. 13:8 (forma treguese e ardhme pasive)
3. çdo dhunti do të përfundojë, 1 Kor. 13:10 (forma treguese e ardhme pasive)
4. foshnjëria frymërore do të përfundojë, 1 Kor. 13:11 (forma treguese e ardhme aktive)

**13:12 “pasqyrë”** Korinti ishte i famshëm për pasqyrat e tij të lëmuara prej metali. Ato ishin më të mirat e mundshme në atë kohë, por ato reflektonin një shëmbëllim të shtrembëruar. Njerëzit, edhe njerëzit e shpenguar, janë të penguar nga (1) natyra mëkatore; (2) fundshmëria; (3) perspektiva e limituar; (4) ndërjegjja dhe botëkuptimi të ndikuara nga kultura; (5) koha si një sekuencë kronologjike; dhe (6) gjuha njerëzore për të shpjeguar dhe përshkruar një botë frymërore.

Vini re paralelizmin

1. 1 Kor. 13:9, njohim pjesërisht, profetizojmë pjesërisht përkundrejt kur të vijë përsosmëria
2. 1 Kor. 13:11, një fëmi përkundrejt një i rritur
3. 1 Kor. 13:12, një pasqyrë korintase përkundrejt faqe për faqe dhe njoh pjesërisht përkundrejt njëhem plotësisht

Këto duket se reflektojnë një realitet të tashëm përkundrejt një realiteti të ardhshëm, prandaj, Ardhja e Dytë, e cila konsumon Epokën e Re, është fokusi.

■ **“në mënyrë të errët”** Kjo është fjalë për fjalë “një gjëegjëzë” (shih NJB). Rabinët besonin se Perëndia i fliste Moisiut në gjëegjëza (shih Num. 12:6,8).

▣ **“faqe për faqe”** Kjo është një metaforë për një marrëdhënie intime (dmth., e krahasueshme me Num. 12:8). Në Dhjatën e Vjetër të shihje YHWH do të thoshte të vdisje (shih Zan. 32:30; Eksod. 33:20; Gjoni 1:18). Në epokën e re kjo do të jetë normale (shih Mat. 5:8; 2 Kor. 5:7; 1 Gjoni 3:2; Zbu. 22:4).

▣ **“njoh pjesërisht... do të njoh thellë... sikurse njihem”** Kjo është dukshëm një lojë me konotacionin e termave hebraikë dhe grekë “njoh”. Në Dhjatën e Vjetër ajo i referohej, jo fakteve mendore (dmth., koncepti grek), por një marrëdhënieje personale (shih Zan. 4:1 dhe Jer. 1:5).

Në këtë varg gjithashtu ka një lojë me fjalën greke për “njoh” (dmth., *ginōskō*). Përdorimi i parë është termi bazë. Përdorimi i dytë dhe i tretë janë termi i përbërë (dmth., *epiginōskō*) që nënkupton njohuri përvoje, të plotë. Besimtarët do të njohin Perëndinë në epokën e re ashtu siç Ai na ka njohur ne (shih 1 Kor. 8:3; Gal. 4:9). “Besëlidhja e re” karakterizohet nga populli i Perëndisë që e njeh Atë (shih Jer. 31:31-34). Nuk do të ketë nevojë për predikues / mesues!

Koncepti teologjik i “njohjes” lidhet me konceptin e zgjedhjes. Misteri i mënyrës se si zgjedhja (dmth., zgjedhja e Perëndisë) lidhet me përgjigjen ndaj besëlidhjes (dmth., zgjedhja njerëzore) është i pasigurtë. Duke ndjekur logjikën e këtyre vargjeve të Dhjatës së Vjetër: Ps. 1:6; Jer. 1:5; Amos 3:2 dhe këtyre vargjeve të Dhjatës së Re: Rom. 8:29; 11:2; 1 Kor. 8:3; 13:13; Gal. 4:9, besimtarët njihen nga Perëndia përpara kohës, në kohë dhe përtej kohës. Megjithatë, besimtarët, e njohin Perëndinë në faza të ngjashme drejtësimin, shenjtërimin, përlëvdimin. Ne e njohim Atë në kohë dhe përmes Dhjatës së Vjetër, Jezusit dhe ungjijve; përmes kohës me anë të rritjes sonë në ngjashmëri me Krishtin përmes Frymës; dhe përtej kohës ne do ta njohim Atë faqe për faqe, në intimitet marrëdhënieje me njohuri të përkryer të Epokës së Re të drejtësisë.

**13:13 “shpresa”** Ky term grek nuk ka paqartësinë apo pasigurinë e termit siç e njohim ne. Ai është siguria e plotë që premtimet e Perëndisë do të bëhen realitet në kohën e Tij.

**TEMË E VEÇANTË: SHPRESA (ELPIS, TEK PALI) [SPECIAL TOPIC: HOPE (ELPIS, IN PAUL)]**

Pali e përdori shpesh këtë term në disa kuptime të ndryshme, por të lidhura me njëra-tjetrën. Shpesh, ky koncept lidhet me përbushjen e besimit të besimtarit (p.sh., 1 Tim. 1:1). Mund të shprehet si lavdi, jetë e përjetshme, shpëtim përfundimtar, Ardhja e Dytë, etj. Përbushja është e sigurtë, por elementi kohor është në të ardhmen dhe i panjohur. Shpesh, shpresa shoqërohet me “besimin” dhe “dashurinë” (1 Kor. 13:13; 1 Thes. 1:3; 2 Thes. 2:16). Një listë e pjesshme e përdorimit të kësaj fjale nga Pali është më poshtë:

1. Ardhja e Dytë (Gal. 5:5; Efe. 1:18; 4:4; Titit 2:13)
2. Jezusi është shpresa jonë (1 Tim. 1:1); (Perëndia është shpresa jonë, 1 Tim. 5:5; 1 Pje. 3:5)
3. Besimtari do të dalë para Perëndisë, Kol. 1:22-23; 1 Thes. 2:19
4. Shpresa ruhet në qiell, Kol. 1:5
5. Beso në ungjillin, Kol. 1:23; 1 Thes. 2:19
6. Shpëtimi përfundimtar, Kol. 1:5; 1 Thes. 4:13; 5:8
7. Lavdia e Perëndisë, Rom. 5:2; 2 Kor. 3:12; Kol. 1:27
8. Shpëtimi i johebrenjve me anë të Krishtit, Kol. 1:27
9. Siguria e shpëtimit, 1 Thes. 5:8
10. Jeta e përjetshme, Titit 1:2; 3:7
11. Rezultatet e pjekurisë së krishterë, Rom. 5:2-5
12. Shpengimi i gjithë krijimit, Rom. 8:20-22
13. Përbushja e birësimit, Rom. 8:23-25
14. Titull i Perëndisë, Rom. 15:13
15. Dëshira e Palit për besimtarët, 2 Kor. 1:7
16. Dhjata e Vjetër si udhërrëfyes për besimtarët e Dhjatës së Re, Rom. 15:4

▣ **“Tani, pra, këto tri gjëra mbeten: besimi, shpresa dhe dashuria”** Folja është në njëjës (shih Gal. 5:22). Pali shpesh përdor këtë triadë (shih Rom. 5:2-5; Gal. 5:5-6; Efe. 1:15-18; Kol. 1:4-5; 1 Thes. 1:3; 5:8; Hebrenjve) dhe po kështu bëjnë edhe shkrimtarët tjerë të Dhjatës së Re (shih Heb. 6:10-12; 1 Pjet. 1:21-22).

▣ **“por më e madhja nga këto është dashuria”** Është më e madhja për shkak se këto të tjerat do të mbarojnë në konsumimin e epokës së re. Besimi do të kthehet në shikim dhe shpresa do të ketë pasur përmbushjen e saj, por dashuria mbetet për shkak të karakterit thelbësor të Perëndisë (shih Gjoni 3:16; 1 Gjoni 4:8,16).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Jepni idenë qendrore të këtij kapitulli me fjalët tuaja, në një fjali.
2. Pse Pali përfshiu një kapitull mbi dashurinë midis diskutimit të tij të dhuntive frymërore?
3. Përkufizoni dashurinë *agapē* me fjalët tuaja.
4. Pse janë bërë vargjet 1 Kor. 13:8-13 një fushëbetejë mbi dhuntitë frymërore në kohërat tona?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](http://www.biblelessons.org)

# 1 KORINTASVE 14

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Sjellja gjatë Adhurimit Publik (11:2-14:40)
Gjuhët dhe Profecia	Profecia dhe Gjuhët	Mes Dhuntive, Profecia i Tejkalon Gjuhët	Më Shumë rreth Dhuntive nga Fryma	Dhuntitë Frymërore: Perspektiva dhe Rëndësia e Tyre në Komunitet
14:1-5	14:1-5 Gjuhët duhet të Interpretohen	14:1-5	14:1-4 14:5-6	14:1-5
14:6-19	14:6-19	14:6-12 14:13-19	14:7-12 14:13-17 14:18-19	14:6-12 14:13-19
	Gjuhët një Shenjë ndaj Jobsimtarëve			
14:20-25	14:20-25	14:20-25	14:20-22 14:23-25	14:20-25
Të Gjitha Gjërat të Bëhen në Rregull	Rregull në Takimet e Kishës		Rregull në Kishë	Rregullimi i Dhuntive Frymërore
14:26-33a	14:26-40	14:26-33a	14:26-33a	14:26-33a
14:33b-36		14:33b-36	14:33b-35 14:36-38	14:33b-36 14:36-38
14:37-40		14:37-40	14:39-40	14:39-40

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih "[Bible Interpretation Seminar](#)") [Seminari Biblik i Interpretimit]

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE MBI 1 KORINTASVE 14:1-40**

- A. Kjo vazhdon udhëzimet e Palit për adhurimin e bashkuar të nisur në kapitullin 11. Kisha në Korint po adhuronte në disa mënyra të papërshtatshme, jo standarte në disa aspekte.
- B. Kriteri kryesor për vlerësimin e praktikave të adhurimit është: “A e ndërton kjo të gjithë kishën?”  
Adhurimi i përbashkët ka dy fokuse:  
a. Nevojat për të humburit që janë të pranishëm  
b. Nevojat për besimtarët që janë të pranishëm  
Kjo ndjek Urdhërimin e Madh të Jezusit (shih Mat. 28:19-20). *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës] thotë:  
“Parimi operativ i Palit për jetën dhe adhurimin në kongregacion është konstant. Çfarëdo qoftë ajo që e pengon lëvizjen e ungjillit, shkakton konfuzion dhe jo rritje, ofendon në vend që të inkurajojë apo forcojë, ndërton veten në kurriz të të tjerëve – e gjithë kjo është në kundërshtim me qëllimin e Perëndisë. Dhe për sa kohë që gratë në Korint dhe kudo tjetër në kishat e reja përdornin dhuntitë e tyre në kundërshtim ndaj qëllimit të Perëndisë, urdhëri për të heshtur është një fjalë e përshtatshme dhe me autoritet. Parimi i cili i nënvendoset urdhërit vlen si për burrat ashtu edhe për gratë në të gjitha kishat” (fq. 616).
- C. Tani çështja e vazhdueshme e pjesëmarrjes së grave në adhurimin e përbashkët. Nëse lexoni pesë komentare do të gjeni pesë pikëpamje të ndryshme. Problemi duket se është që ne të gjithë vijmë në këtë kapitull me plane personale, denominacionale, hermeneutike dhe të bazuara në eksperiencë! Asnjë nga ne nuk është neutral. Ne marrim Biblën seriozisht, por në Bibël, edhe Pali flet me dy zëra (shih 1 Kor. 11:5 përkundrejt 14:34).  
Disa komentatorë edhe përpiqen të heqin vargjet 1 Kor. 14:34-35 si shtesa nga skribët (MSS D, F, G i vendosin këto vargje pas 1 Kor. 14:40) ose t’i drejtojnë ato ndaj Palit që citon një slogan të mësuesve të rremë. Sidoqoftë, këto përjasje e bëjnë kapitullin të thotë ekzaktësisht të kundërtën e asaj që duket se po thotë.
- D. Fjalët e Palit tek 1 Kor. 14:34-35 i përshtaten zakonet hebraik dhe kulturës greko-romake. Megjithatë, në shumë mënyra të rëndësishme shërbesa e Palit është kundër zakoneve hebraike dhe kulturës greko-romake.
- E. Bota mesdhetare e shekullit të parë ishte një shoqëri e bazuar mbi skllavërinë dhe dominimin mashkullor. Për Jezusin ose Palin që kishin ndryshuar secilin nga këto institucione sociale duhet të ketë ndikuar negativisht në rritjen e kishës, madje dhe në mbijetesën e saj. Si Jezusi ashtu edhe Pali konfirmojnë dinjitetin dhe vlerën e të gjithë njerëzve. Ungjilli me kalimin e kohës do të shkatërrojë të dy aspektet e shpërdorimit. Është e sigurtë të themi që ata i flisnin njerëzve të kohës së tyre me fuqi të frymëzuar dhe se fjalët e tyre tregonin tek një ditë e ardhshme dinjiteti dhe barazie.
- F. Gratë ose drejtuesit e skllavërve në kishën e hershme duhet të kenë ndikuar negativisht tek ungjillizimi. E njëjta gjë është e vërtetë sot, por nga ana e kundërt. Në shoqërinë tonë gratë e artikuluar me dhunti për shërbesë do të arrijnë një aspekt të shoqërsisë sonë më frytshëm se sa të tjerë. Kjo nuk do të thotë të dëshirosh një klergji me shumicë femërore, por të kuptosh se të gjithë besimtarët janë shërbëtorë të ungjillit të thirrur dhe të pajisur me dhunti; të gjithë besimtarët! Unë nuk po mbroj gratë për ndonjë detyrë të veçantë shërbesë, por po konfirmoj me forcë shërbesën për të gjithë besimtarët (shih Efe. 4:12).

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:1-5

<sup>1</sup> Kërkoni dashurinë dhe lypni me zemër të zjarrtë *dhuntitë* frymërore, por sidomos që të mund të profetizoni, <sup>2</sup> sepse ai që flet një gjuhë tjetër nuk u flet njerëzve, por Perëndisë; sepse askush nuk e kupton, por ai në frymë flet mistere. <sup>3</sup> Kurse ai që profetizon, u flet njerëzve për ndërtim, për nxitje e përdëllim. <sup>4</sup> Ai që flet një gjuhë tjetër ndërton veten e tij, por ai që profetizon, ndërton kishën. <sup>5</sup> Unë dua që të gjithë ju të flisnit gjuhëra, por më tepër të profetizonit, sepse ai që profetizon është më i madh nga ai që flet gjuhëra, veçse në interpretoftë, që të marrë ndërtim kisha.

**14:1 “Kërkoni dashurinë”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme (shih Rom. 14:19; 1 Thes. 5:15; 1 Tim. 6:11; 2 Tim. 2:22). Ajo tregon një lidhje kontekstuale me kapitullin 13. Dashuria është karakteristikë e Perëndisë dhe popullit të Tij (shih Gal. 5:22; 1 Gjoni 4:7-21). Kujtoni që kapitujt 11-14 janë një njësi letrare mbi problemet e lidhura me adhurimin e përbashkët në Korint.

<b>Nasb</b>	<b>“dëshironi me sinqeritet dhuntitë frymërore”</b>
<b>Nkjv</b>	<b>“dëshironi dhuntitë frymërore”</b>
<b>Nrsv</b>	<b>“lypni me zemër të zjarrtë dhuntitë frymërore”</b>
<b>Tev</b>	<b>“vendosni zemrat tuaja mbi dhuntitë frymërore”</b>
<b>Njb</b>	<b>“jini të etur, gjithashtu, për dhuntitë frymërore”</b>

Kjo është një tjetër formë urdhërore aktive e tashme nga rrënja “të zjesh” (shih 1 Kor. 12:31). Kjo tregon lidhjen kontekstuale me kapitullin 12. Në një kuptim kapitulli 13 hyn në këtë kontekst. Kujtoni se kapitujt 12-14 janë një pjesë e bashkuar mbi përdorimin e përshtatshëm të dhuntive frymërore.

Termi “frymërore” është i njëjti i përdorur tek 1 Kor. 12:1 (shih 1 Kor. 2:13,15; 3:1; 9:11; 10:3,4; 14:37; 15:44,46). Ai mund të lidhet me dhuntitë, njerëzit, gjërat, etj. Konteksti përcakton ngjyrimin.

▣ **“por sidomos që të mund të profetizoni”** Termi “profeci” përdoret tek 1 Korintasve në një kuptim të specializuar. Ai nuk i referohet veprimtarisë profetike të profetëve të Dhjatës së Vjetër (dmth., Shkrimet e shkruara), por një komunikimi të qartë të ungjillit qoftë në predikimet publike ose në dëshmitë private. Duhet të dëshirohet nga të gjithë besimtarët (shih 1 Kor. 14:39), por ajo është gjithashtu një dhunti frymërore (shih 1 Kor. 12:10,28-29). Të gjithë besimtarët marrin pjesë në një nivel në të gjitha dhuntitë e Frymës, por njëri ose tjetri energjizohet dhe fuqizohet nga Fryma brenda besimtarëve individual për frytshmëri të veçantë. Ky diversitet kërkon një frymë bashkëpunuese dhe të dashur mes besimtarëve. Ne jemi thirrur për unitet, jo uniformitet, për ungjillin. Ne jemi të frytshëm vetëm së bashku! Ne kemi nevojë të dëshpëruar për besimtarët e tjerë. Kisha është një komunitet shërbetarësh të thirrur, të pajisur me dhunti, me kohë të plotë. Ne jemi të pajisur me dhunti për shpërndarjen e ungjillit dhe shëndetin dhe plotësinë e kishës.

Kjo dhunti krahasohet me gjuhët me kriterin e “a e ndërton ajo kishën në tërësi?” Kjo dotë thotë në këtë kontekst “të shpallësh ungjillin”, që më pas është një bekim për kishën në tërësi, ashtu edhe për vizitorët. Të folurit në gjuhë të tjera është vetëm një bekim për besimtarin individual deri sa ajo interpretohet për të gjithë kishën. Ky term nuk duhet kuptuar në kuptimin e tij të Dhjatës së Vjetër të zbulësës së frymëzuar (shih TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHJATËN E VJETËR [SPECIAL TOPIC: OLD TESTAMENT PROPHECY] tek 1 Kor. 12:10).

#### **TEMË E VEÇANTË: PROFECIA NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: NEW TESTAMENT PROPHECY)**

- I. Nuk është e njëjta gjë si profecia e Dhjatës së Vjetër (BDB 611, KB 661; shih Temën e Veçantë: Profeci [Dhjata e Vjetër] / Special Topic: Prophecy [OT]), e cila ka ngjyrimin rabinik të marrjes dhe regjistrimit të zbulësave të frymëzuara nga YHWH (shih Veprat e Apo. 3:18, 21; Rom. 16:26). Vetëm profetët mund të shkruanin Shkrimin.
  - A. Moisiu quhej profet (shih Ligji i Përt. 18:15-21).
  - B. Librat historikë (Jozue-Mbretërve [përveç Ruthit]) quheshin “profetët e hershëm” (shih Veprat e Apo. 3:24).
  - C. Profetët zënë vendin e Kryepriftit si burim informacioni nga Perëndia (shih Isaia-Malakia)
  - D. Ndarja e dytë e kanonit hebraik është “Profetët” (shih Mat. 5:17; 22:40; Luka 16:16; 24:25, 27; Rom. 3:21).
- II. Në Dhjatën e Re, ky koncept përdoret në një sërë mënyrash të ndryshme.
  - A. për t’iu referuar profetëve të Dhjatës së Vjetër dhe mesazhit të tyre të frymëzuar (shih Mat. 2:23; 5:12; 11:13; 13:14; Rom. 1:2)
  - B. për t’iu referuar një mesazhi për një individ të caktuar, jo për një grup kolektiv (dmth.,



- profetët e Dhjatës së Vjetër i flisnin kryesisht Izraelit)
- C. për t'iu referuar, si Gjon Pagëzorit (shih Mat. 11:9; 14:5; 21:26; Luka 1:76), ashtu dhe Jezusit, si shpallës të Mbretërisë së Perëndisë (shih Mat. 13:57; 21:11, 46; Luka 4:24; 7:16; 13:33; 24:19). Po kështu, Jezusi shpalli se ishte më i lartë edhe se profetët (Mat. 11:9; 12:41; Luka 7:26).
- D. profetë të tjerë në Dhjatën e Re
1. në jetën e hershme të Jezusit, sikurse regjistruar në ungjillin sipas Lukës (dmth., kujtimet e Marisë)
    1. Elizabeta (shih Luka 1:41-42)
    2. Zakaria (shih Luka 1:67-79)
    3. Simeoni (shih Luka 2:25-35)
    4. Ana (shih Luka 2:36)
  2. parashikime ironike (shih Kajafa, Gjoni 11:51)
- E. për t'iu referuar dikujt që shpall ungjillin (përfshirë tek lista e dhuntive shpallëse te 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
- F. për t'iu referuar një dhuntie të vazhdueshme në kishë (shih Mat. 23:34; Veprat 13:1; 15:32; Rom. 12:6; 1 Kor. 12:10,28-29; 13:2; Efe. 4:11). Nganjëherë, mund t'u referohet grave (shih Luka 2:36; Veprat 2:17; 21:9; 1 Kor. 11:4-5).
- G. për t'iu referuar librit apokaliptik të Zbulesës (shih Zbu. 1:3; 22:7, 10, 18, 19)

### III. Profetët e Dhjatës së Re

- A. Ata nuk japin zbulesë të frymëzuar në të njëjtin kuptim si profetët e Dhjatës së Vjetër (pra, Shkrimi). Ky pohim është i mundshëm për shkak të përdorimit të frazës “besim” (pra, kuptimi i një ungjilli të plotësuar) në Veprat e Apo. 6:7; 13:8; 14:22; Gal. 1:23; 3:23; 6:10; Fil. 1:27; Juda 3, 20).

Ky koncept është i qartë nga fraza e plotë e përdorur në Juda 3, “besimi që iu dorëzua një herë e përgjithmonë shenjtoreve”. Besimi “një herë e përgjithmonë” u referohet të vërtetave, doktrinave, koncepteve, mësimëve të botëkuptimit të krishterë. Ky theksim i dhënë një herë e përgjithmonë është baza biblike pse frymëzimin e kufizojmë teologjikisht vetëm për shkrimet e Dhjatës së Re, pa lejuar që shkrimet e mëvonshme ose të tjera të konsiderohen zbulesë (shih Temën e Veçantë: Frymëzim / Special Topic: Inspiration). Ka shumë zona të paqarta, të pasigurta dhe gri në Dhjatën e Re (shih Temën e Veçantë: Letërsi Lindore [paradokse biblike] / Special Topic: Eastern Literature [biblical paradoxes]), por besimtarët pohojnë me besim se gjithçka që “nevojitet” për besimin dhe praktikën është përfshirë me qartësi të mjaftueshme në Dhjatën e Re. Ky koncept është përvijuar në atë që quhet “trekëndëshi i zbulesës”

1. Perëndia e ka zbuluar veten në historinë kohë-hapësirë (ZBULESA)
  2. Ai ka zgjedhur disa shkrimtarë njerëzorë për të dokumentuar dhe shpjeguar veprat e Tij (FRYMËZIMI)
  3. Ai ka dhënë Frymën e Vet për të hapur mendjen dhe zemrën e njerëzve që të kuptojnë këto shkrime, jo në mënyrë absolute, por aq sa mjafton për shpëtim dhe për një jetë të krishterë të efektshme (PËRNDRITJE). Ideja e kësaj është se frymëzimi vlen vetëm për shkruarit e Shkrimit. Nuk ka shkrime, vegime apo zbulesa të mëtejshme të autoritetshme. Kanoni është mbyllur. Ne kemi gjithë të vërtetën që na nevojitet për t'iu përgjigjur si duhet Perëndisë. Kjo e vërtetë mund të shihet më së miri në përkimin e shkrimtarëve biblikë, në dallim nga mosmarrëveshjet e besimtarëve të sinqertë e të perëndishëm. Asnjë shkrimtar ose folës i sotëm nuk ka nivelin e udhëheqjes hyjnore që kishin shkrimtarët e Shkrimit.
- B. Në disa mënyra, profetët e Dhjatës së Re janë të ngjashëm me profetët e Dhjatës së Vjetër.
1. parashikimi i ngjarjeve të ardhshme (p.sh., Pali, Veprat e Apo. 27:22; Agabi, Veprat 11:27-28; 21:10-11; profetë të tjerë pa emër, Veprat e Apo. 20:23)
  2. shpallje gjykimi (shih Pali, Veprat e Apo. 13:11; 28:25-28)

3. akte simbolike që portretizojnë në mënyrë të gjallë një ngjarje të caktuar (shih Agabin, Veprat e Apo. 21:11)

- C. Nganjëherë, i shpallin të vërtetat e ungjillit në mënyra parashikuese (shih Veprat e Apo. 11:27-28; 20:23; 21:10-1), por ky nuk është fokusi parësor. Profetizimi te 1 Korintasve, në thelb, është komunikimi i ungjillit (shih 14:24, 39).
- D. Ata janë mjeti bashkëkohor i Frymës për zbuluesën e zbatimeve bashkëkohore dhe praktike të së vërtetës së Perëndisë në çdo situatë të re, kulturë, apo periudhë kohore (shih 1 Kor. 14:3).
- E. Ata ishin aktivë në kishat e hershme paliane (shih 1 Kor. 11:4-5; 12:28,29; 13:2,8,9; 14:1,3,4,5,6,22,24,29,31,32,37,39; Efe. 2:20; 3:5; 4:11; 1 Thes. 5:20) dhe përmenden në *Didache* [Didake] (shkruar në fund të shekullit të parë ose në shekullin e dytë, data është e paqartë) dhe në montanizmin e shekujve të dytë e të tretë në Afrikën perëndimore.

#### IV. A kanë reshtur dhuntitë e Dhjatës së Re?

- A. Është e vështirë t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Në qartësimin e kësaj çështjeje na ndihmon përcaktimi i synimit të dhuntive. A synohen dhuntitë që të mbështesin predikimin fillestar të ungjillit, apo përbëjnë mënyra të vazhdueshme sesi kisha i shërben vetes dhe botës së humbur?
- B. A duhet të shqyrtojmë historinë e kishës për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, apo vetëm Dhjatës së Re? Në Dhjatën e Re nuk na tregohet se dhuntitë shpirtërore ishin të përkohshme. Ata që përpiqen të përdorin 1 Kor. 13:8-13 për të trajtuar këtë çështje abuzojnë me synimin autorial të pasazhit, i cili pohon se gjithçka, përveç dashurisë, do të kalojë.
- C. Tundohejm të them se, meqë autoriteti ynë është Dhjata e Re, jo historia e kishës, besimtarët duhet të pohojnë se dhuntitë vazhdojnë. Megjithatë, besoj se kultura ndikon në interpretim. Disa tekste shumë të qarta nuk janë më të zbatueshme (p.sh., puthja e shenjtë, veshja e mbulesës së kokës nga gratë, takimi i kishave nëpër shtëpi, etj). Nëse kultura ndikon në pasazhet, atëherë pse të mos bëjë të njëjtën gjë dhe historia e kishës?
- D. Kjo është thjesht një pyetje që nuk mund të marrë përgjigje përfundimtare. Disa besimtarë përkrahin "pushimin", ndërsa disa të tjerë "mospushimin". Në këtë fushë, si dhe në shumë çështje interpretuese, çelësi është zemra e besimtarit. Dhjata e Re është e vagullt dhe kulturore. Vështirësia është se duhet të jemi në gjendje të përcaktojmë se cilat pasazhe preken nga kultura/historia dhe cilat janë për gjithë kohën dhe për gjithë kulturat (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth* [Si të Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e saj], f. 14-19 dhe 69-77). Pikërisht këtu janë kyçe diskutimet për lirinë dhe përgjegjësinë, që gjenden në Rom. 14:1-15:13 dhe 1 Kor. 8-10. Mënyra sesi i përgjigjemi kësaj pyetjeje është e rëndësishme në dy mënyra.
  - 1. Secili besimtar duhet të ecë me besim në dritën e asaj që ka. Perëndia na shqyrton zemrën dhe motivet.
  - 2. Secili besimtar duhet të lejojë besimtarët e tjerë që të ecin sipas kuptimit të besimit të tyre. Duhet të ekzistojë tolerancë brenda caqeve biblike. Perëndia dëshiron që ta duam njëri-tjetrin njësoj si ai.
- E. Për të përmbledhur çështjen, krishterimi është jetë besimi dhe dashurie, jo teologji e përsosur. Marrëdhënia me të, e cila ndikon në marrëdhënien tonë me të tjerët, është më e rëndësishme se informacioni absolut, apo përsosmëria e kredove tona.

14:2

NASB, NKJV, NRSV, NJB

KJV

TEV

“një gjuhë”

“një gjuhë të panjohur”

“në gjuhë të huaja”

Kjo është fjala greke *glōssa*, e cila përdoret metaforikisht për t'iu referuar një pjese të veçantë të gjuhës apo dialektit njerëzor. Përvoja e “gjuhëve” në Pentakost dukshëm i referohej një gjuhe njerëzore të njohur (shih Veprat e Apo. 2:6-10). Mrekullia duket të jetë tek veshi (dmth., “ata po i dëgjonin ata duke folur në gjuhën e tyre”). I njëjti fenomen ka ndodhur disa herë tek Veprat e Apo. Për qëllimin e sigurimit të besimtarëve hebrej që Perëndia ka pranuar një grup tjetër popujsh (dmth., samaritanët, njerëzit ushtarakë romakë, johebrenjtë).

Megjithatë, “gjuhët” e 1 Korintasve duket se është më tepër në linjë me të folurën ekstatike të orakujve grekë si Delphi, ku një grua hynte në ekstazë dhe një person tjetër interpretonte atë që ajo thoshte. Korinti ishte një qytet kozmopolitan. Njerëzit nga gjithë bota e njohur ishin në Korint, e megjithatë teksti e përcakton “interpretimin e gjuhëve” si një dhunti frymërore (shih 1 Kor. 12:10,30; 14:26), jo thjesht një person që rastësisht flet një gjuhë të huaj.

▣ **“nuk u flet njerëzve, por Perëndisë”** Gjuhët korintase janë një bisedë private midis Perëndisë dhe një besimtari (shih 1 Kor. 14:24). Gjuhët nuk janë në vetvete një mjet komunikimi, por një marrëdhënie intime me Perëndinë. Vetëm nëse ato interpretohen, e kuptojnë folësi dhe dëgjuesit.

▣ **“sepse askush nuk e kupton”** Gjuhët në Korint duken se janë të tinguj të panjohur, të artikuluar. Në Delphi një person i veçantë (zakonisht një grua) do të fliste në tinguj të paartikuluar, më pas një person tjetër do t'i interpretonte këto për personat që ishin të pranishëm. Kjo procedurë duket se është paralele me përjetesën e “gjuhëve” në Korint. Nuk ka “interpretues” në Veprën e Apostujve!

**14:3 “ndërtim”** Kjo është prova e tretë e përdorur për të vlerësuar dhuntitë frymërore (shih njohuri kontekstuale në kapitullin 12, C). A e ndërtojnë ato kishën? Kjo temë përsëritet sërish e sërish në këtë kapitull, 1 Kor. 14:3,4,5,12,17,26. Kjo është arsyeja pse “profecia”, e kuptuar si ndarja e ungjillit, duhet të dëshirohet më shumë se “gjuhët”. Profecia shpall ungjillin tek të gjithë që janë të pranishëm, ndërsa gjuhët bekojnë vetëm folësin, përveçse kur ato interpretohen. Nëse interpretohen, gjuhët dhe interpretimi i tyre vlen për të njëjtin qëllim si shpallja e ungjillit (dmth., profetizimi). Shih TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ (SPECIAL TOPIC: EDIFY) tek 1 Kor. 8:1.

▣ **“për nxitje e përdëllim”** Qëllimi i shpalljes së ungjillit nuk është vetëm për ungjillizim, por gjithashtu për inkurajimin e kishës (dmth., ndërtimi, nxitja dhe ngushëllimi).

**14:4 “Ai që flet një gjuhë tjetër ndërton veten e tij”** Gjuhët korintase pa interpretim janë dhunti të orientuara tek individi.

▣ **“kishën”** Ky është termi *eklesia* pa asnjë njëjë që i referohet të gjithë trupit të besimtarëve. Dëshira e Palit është që të gjithë besimtarët, jo vetëm disa të zgjedhur, të jenë të bekuar në adhurimin e përbashkët. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

**14:5 “Unë dua që të gjithë ju të flisnit gjuhëra”** Krahasoni vargun 12:30 dhe kujtoni që kjo frazë është një fjali e ndërvarur ndaj asaj që pason. Pali nuk i zhvlerëson gjuhët, por (1) konfirmon marrëdhënien e tyre të përshtatshme me dhuntitë e tjera frymërore dhe (2) vendos disa udhëzime praktike. Korintasit dukshëm po kërkonin këtë dhunti për lavdi personale dhe egoiste dhe për prestigj.

▣ **“ai që profetizon është më i madh”** Ky është një vlerësim i bazuar mbi kriterin e Palit se gjuhët janë me më pak vlerë në ndërtimin e kishës së mbledhur. Por kujtoni se e folura në gjuhë është një dhunti e vlefshme e Frymës (shih 1 Kor. 14:18,39)!

▣ **“veçse në interpretoftë”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e nisur me *ei* në vend të *ean*. A është e mundur që një person të ketë si dhuntinë e gjuhëve ashtu edhe të interpretimit? Është e dukshme nga tekste të tjera që drejtuesit e krishterë kishin më shumë se sa një dhunti frymërore (shih Veprat e Apo. 13:1; 2 Tim. 1:11). Megjithatë, nëse do të ishte e mundur që i njëjti person të fliste në gjuhë dhe më pas të interpretonte, pse do të kishte nevojë për një interpretues? Si dallon ky kombinim nga profecia? Ndoshta është e mundur që një besimtar të ketë të dy dhuntitë të cilat përdoren në kohëra të ndryshme, por nuk është e zakonitë (shih 1 Kor. 14:13). Më

shumë e ngjashme është që Pali është duke përdorur një teknikë letrare për të nënvijëzuar nevojën për komunikim të kuptueshëm në adhurimin e mbledhur.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:6-12**

**<sup>6</sup>Dhe tani, o vëllezër, po të vija e t'ju flisja në gjuhë, ç'dobi do të kishit, po të mos ju flisja me anë të zbulësës, a me njohuri, a me profeci, a me mësim? <sup>7</sup>Edhe gjërat që nuk kanë shpirt dhe nxjerrin zë, fyelli ose qestja, po të mos japin zë të dallueshëm, si do të njihet të rënit e fyellit ose e qestes? <sup>8</sup>Sepse, po të japë buria një tingull të panjohur, kush do të përgatitet për betejë? <sup>9</sup>Kështu edhe ju, në qoftë se me gjuhën tuaj nuk flisni fjalë të kuptueshme, si do të kuptohet çfarë u tha? Sepse do të flisnit në erë. <sup>10</sup>Ka nuk e di se sa lloje zërash në botë, dhe asnjë prej tyre nuk është pa kuptim. <sup>11</sup>Pra, në qoftë se unë nuk e marr vesh kuptimin e zërit, do të jem si një i huaj për atë që flet, dhe ai që flet do të jetë një i huaj për mua. <sup>12</sup>Kështu edhe ju, mbasi doni fort të keni dhunti *frymërore*, kërkoni që t'i keni të bollshme për ndërtimin e kishës.**

**14:6 “po të”** Ka katër fjali kushtore të rendit të tretë tek paragrafi, 1 Kor. 14:6-12, i cili nënkupton veprim të mundshëm (shih 1 Kor. 14:6,7,8,11). Të dy vargjet, si 1 Kor. 14:6 ashtu edhe 7 janë pyetje që presin “jo” si përgjigje (ashtu sikurse 1 Kor. 14:9).

▣ **“me anë të zbulësës, a me njohuri, a me profeci”** Këta terma duket se reflektojnë dhunti të ndryshme, por dallimet mes tyre janë të pasigurta. Ndoshta duke qënë se disa drejtues me dhunti përmenden tek Efe. 4:11 secili duke shpallur ungjillin, por edhe këtu me thekse të ndryshme. Perëndia zbulon të vërtetat e tij në mënyra të ndryshme, por me përmbajtje të njëjtë. Shumë dhunti, një ungjill; shumë besimtarë, një qëllim (dmth., ndërtimi i kishës dhe rritja e kishës, shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

**14:7-8** Pali përdor instrumente muzikore për të nxjerrë konkluzionin e tij, fyej dhe qeste tek 1 Kor. 14:7 dhe një bori ushtarake tek 1 Kor. 14:8. Instrumentet muzikore përdoren për qëllime të ndryshme (dmth., për të bërë muzikë ose për të dhënë sinjal). Nëse instrumentet nxjerrin tingullin e gabuar, shkaktohet konfuzion. Zëri njerëzor ka për qëllim të komunikojë informacion tek njerëzit e tjerë. Nëse ai bën tinguj që nuk kanë asnjë rëndësi ndaj njerëzve të tjerë, ai dështon në qëllimin e tij (shih 1 Kor. 14:9).

**14:10** Kjo është një fjali e rrallë e rendit të katërt. Këto vargje nuk mund të përdoren për të provuar se gjuhët e tjera janë një gjuhë e njohur. Pali përdor një term tjetër (dmth., *phōnē jo glōssa*) në të dy vargjet 1 Kor. 14:10 dhe 11. Ky është një ilustrim i vështirësisë në të kuptuarit e një gjuhe të folur në mënyrë të papërshtatshme ose një gjuhe të huaj. Gjuha njerëzore ka për qëllim të jetë e kuptueshme.

**14:11**

**NASB, NJB, NKJV, NRSV** “barbar”  
**TEV** “i huaj”

Kjo është një fjalë onomatopoetike (dmth., *barbaros*) për tingujt e huaj të gjuhëve të tjera ndaj grekëve dhe romakëve, sidomos grupet fisnore të veriut të Perandorisë Romake. Grekët dhe romakët thoshin se këto gjuhë fisnore tingëllonin si “bar, bar” për ta. Prandaj, ka ardhur dhe termi “barbar”.

**14:12 “mbasi doni fort të keni dhunti frymërore”** Pali nuk kritikon zellin e tyre (shih 1 Kor. 14:1), por përpiket që ta kanalizojë atë për ndërtimin e të gjithë kishës (shih 1 Kor. 12:7).

**NASB, NKJV, NRSV, NIV** “dhunti frymërore”  
**RSV** “shfaqje të Frymës”  
**TEV** “dhuntitë e Frymës”  
**NJB** “fuqi frymërore”

Kjo është e njëjta fjalë greke si tek 1 Kor. 12:1 (dmth., *pneumatikōn*), por shumësi në rasën gjinore e *pneuma* (shih TEMË E VEÇANTË: FRYMË NË BIBËL (SPECIAL TOPIC: SPIRIT IN THE BIBLE) tek 1 Kor. 12:1), që do të thotë “frymëmarrje”, “erë”, “frymë”. Kjo formë gjendet gjithashtu tek 1 Kor. 12:10, ku ajo i referohet një

dhuntie të veçantë (dmth., frymërat dalluese, shih 1 Gjoni 4:1). Në kontekst duket se i referohet dhuntive të ndryshme frymërore të dhëna nga Fryma (shih 1 Kor. 12:11) për të mirën e përbashkët të trupit (shih 1 Kor. 12:7).

▣ **“kërkoni që t’i keni të bollshme për ndërtimin e kishës”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme në shumës. Qëllimi i dhuntive frymërore nuk është lartësimi dhe lavdia e një individi, por shëndeti dhe rritja e trupit të Krishtit, kishës.

Për “bollëk” shih Temën e Veçanë tek 2 Kor. 2:7.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:13-19

<sup>13</sup> Prandaj ai që flet një gjuhë tjetër, le të lutet që të mund ta interpretojë, <sup>14</sup> sepse, në qoftë se unë lutem në një gjuhë tjetër, fryma im lutet, por mendja ime është e pafrytshme. <sup>15</sup> Po atëherë? Do të lutem me frymën, por do ta bëj edhe me mendjen; do të këndoj me frymën, por do të këndoj edhe me mendjen. <sup>16</sup> Me fjalë të tjera, në qoftë se ti e lavdëron Perëndinë me frymën, ai që zë vendin e profanët, si do të thotë "amen" për falënderimin tënd, kur nuk merr vesh ç’po thua? <sup>17</sup> Sepse ti edhe mund të falënderosh mirë, por tjetri nuk ndërtohet. <sup>18</sup> Unë e falënderoj Perëndinë time, sepse flas më shumë në gjuhë se ju të gjithë. <sup>19</sup> Por në asamble parapëlqej të them pesë fjalë me mënçurinë time për mësimin e të tjerëve se dhjetë mijë fjalë në gjuhë tjetër.

**14:13** Në kontekst kjo nënkupton se komunikimi i ungjillit tek të gjithë është i preferueshëm ndaj ekstazës personale (shih 1 Kor. 14:15). A nënkupton ky varg se besimtarët marrin një dhunti në shpëtim (shih 1 Kor. 12:11), por më vonë mund të kërkojnë për një tjetër? Kjo pyetje duhet të qëndrojë pa përgjigje. Është e sigurtë që disa kanë disa dhunti (shih Veprat e Apo. 13:1; 1 Tim. 2:7; 2 Tim. 1:11).

**14:14 “në qoftë se”** Kjo është një tjetër fjali kushtore e rendit të tretë, sikurse 1 Kor. 14:6,7,8,11,23,24,28, dhe 29.

▣ **“fryma im lutet”** Kjo i referohet frymës njerëzore. Ajo ishte një metaforë letrare për personin.

▣ **“mendja ime është e pafrytshme”** Pali po luante me dashurinë e korintasve për urtësi. Ai gjithashtu po rikonfirmon se vetëm gjuhët nuk komunikojnë, as ndaj folësit.

#### 14:15

NASB “Cila është rrjedhoja atëherë”  
NKJV “Cili është rezultati atëherë”  
NRSV, TEV “Çfarë duhet të bëj unë atëherë”  
NJB “Po atëherë”

Kjo është një shprehje (shih 1 Kor. 14:26; Veprat e Apo. 21:22). Pali dëshiron të nxjerrë konkluzione ndaj diskutimit të tij.

▣ **“do të këndoj me frymën”** A nënkupton kjo një dhunti tjetër frymërore (shih 1 Kor. 14:26; Kol. 3:16; Efe. 5:19)?

**14:16 “në qoftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të tretë, sikurse 1 Kor. 14:6,7,8,11 dhe 14.

NASB “ai që mbush vendin e atyre pa dhunti”  
NKJV “ai që zë vendin e të painformuarve”  
NRSV “si mundet dikush në vendin e një të jashtëmi”  
TEV “si munden njerëzit e zakonit të marrin pjesë në takim”  
NJB “personi i profanë”

Ky term përdoret për dikë që ishte i pa informuar ose i patrajnuar në një zonë të caktuar, prandaj, ishte një person jo profesional ose amator (shih Veprat e Apo. 4:13; 2 Kor. 11:6). Përdorimi këtu dhe tek 1 Kor. 14:23-24 mund të ketë një nga dy kuptimet e mëposhtme të mundshme.

1. Një vizitor i rregullt i takimeve të krishtera ndërkohë që tek 1 Kor. 14:23 ndoshta një vizitor për herë të parë.

2. Ndoshta një i krishter i ri, por pa dhunti të gjuhëve apo të interpretimit

Fraza “vendin e” i referohet ose (1) vizitorëve ose ndoshta të krishterëve të rinj që kishin caktuar vende ku mund të dëgjonin më qartë ose (2) një shprehje për dikë që është i pa informuar.

▣ **“do të thotë ‘amen’”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

Sigurisht është e mundur që termi më sipër të jetë i lidhur me një besimtar pa dhunti (shih F. F. Bruce, *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve], fq. 98). Nëse kjo është e vërtetë, atëherë Pali dëshironte që besimtarët të “kontrollonin” ose të “gjykonin” mbi fjalët profetike të folura në adhurimet e përbashkëta (shih 1 Kor. 2:12,15; 14:29,37; 1 Thes. 5:20-21; gjithashtu vini re 1 Gjoni 4:1). Asnjë nuk mund të thoshte “amen” përveçse nëse

1. Ata kuptonin se çfarë po thuhej

2. Ata kishin një mënyrë (dmth., Fryma) për të vlerësuar atë që po thuhej

## **TEMË E VEÇANTË: AMEN (SPECIAL TOPIC: AMEN)**

### **I. DHJATA E VJETËR**

A. Termi “Amen” vjen nga një fjalë hebraike që do të thotë

1. “e vërtetë” (*emeth*, BDB 49)

2. “vërtetësi” (*emun, emunah*, BDB 53)

3. “besim” ose “besnikëri”

4. “besim te dikush” (*dmn*, BDB 52)

B. Etimologjia e saj vjen nga qëndrimi fizik i qëndrueshëm i dikujt. E kundërta do të ishte një njeri që është i paqëndrueshëm, që rrëshqet (shih Psalmi 40:2; 73:18; Jeremia 23:12), ose që pengohet (shih Psa. 73:2). Nga ky përdorim i fjalëpërfjalshëm u zhvillua zgjerimi metaforik i kuptimit “besnik, i besueshëm, i besës dhe me integritet” (shih Hab. 2:4).

C. Përdorimet e veçanta (shih TEMË E VEÇANTË: BESOJ, ZË BESË, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHJATËN E VJETËR / Special Topic: Special Topic: Believe, Trust, Faith, and Faithfulness in the OT)

1. Shtyllë, 2 Mbret. 18:16 (1 Tim. 3:15)

2. Siguri, Eks. 17:12

3. Palëvizshmëri, Eks. 17:12

4. Qëndrueshmëri, Isa. 33:6

5. I vërtetë, 1 Mbret. 10:6; 17:24; 22:16; Fja. 12:22

6. I patundur, 2 Kro. 20:20; Isa. 7:9

7. I besueshëm (Torahu), Psa. 119:43, 142, 151, 160

D. Në Dhjatën e Vjetër përdoren dhe ty fjalë të tjera hebraisht për besimin veprues.

1. *bathakh* (BDB, 105), besim

2. *yra* (BDB 431), frikë, respekt, adhurim (shih Zan. 22:12)

E. Nga kuptimi i besimit ose besueshmërisë u zhvillua dhe një përdorim liturgjik që u përdor për të mbështetur një pohim besnik ose të vërtetë të një tjetri (shih Num. 5:22; Ligji i Përt. 27:15-26; 1 Mbret. 1:36; 1 Kro. 16:36; Neh. 5:13; 8:6; Ps. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48; Jer. 11:5; 28:6).

F. Çelësi teologjik për këtë term nuk është besnikëria e njerëzimit, por ajo e YHWH-së (shih Eks. 34:6; Ligji i Përt. 32:4; Psa. 108:4; 115:1; 117:2; 138:2). Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është besnikëria besnike dhe e mëshirshme e YHWH-së ndaj besëlidhjes dhe premtimit e Tij. Ata që njohin YHWH-në duhet të jenë si ai (shih Hab. 2:4). Bibla është historia që dokumenton ripërtëritjen që i bën Perëndia shëmbëllimit të vet (shih Zan. 1:26-27) në njerëzimin. Shpëtimi i rikthen njerëzimit aftësinë për të patur bashkësi të ngushtë me

Perëndinë. Kjo është arsyeja pse jemi krijuar.

## II. DHJATA E RE

- A. Përdorimi i fjalës “amen” si pohim përmbyllës liturgjik i besueshmërisë së një pohimi të caktuar është i zakonshëm në Dhjatën e Re (shih 1 Kor. 14:16; 2 Kor. 1:20; Zbu. 1:7; 5:14; 7:12).
- B. Përdorimi i këtij termi në përmbyllje të lutjeve është i zakonshëm në Dhjatën e Re (shih Rom. 1:25; 9:5; 11:36; 16:27; Gal. 1:5; 6:18; Efe. 3:21; Fil. 4:20; 2 Thes. 3:18; 1 Tim. 1:17; 6:16; 2 Tim. 4:18).
- C. Jezusi është i vetmi që përdori këtë term (i dyfishuar te Gjoni 25 herë, dmth., Gjoni 1:51; 3:3,5,11; etj.) për të prezantuar pohime të rëndësishme (shih Luka 4:24; 12:37; 18:17, 29; 21:32; 23:43)
- D. Përdoret si titull për Jezusin te Zbu. 3:14 (gjithashtu vini re 2 Kor. 1:20, ndoshta, titull i YHWH-së nga Isa. 65:16).
- E. Koncepti i besueshmërisë, besimit, besnikërisë, ose besimit në dikë shprehet me termin greqisht *pistos* ose *pistis*, që në anglisht përkthehet “besim te dikush”, “besim në dikë”, “besoj” (shih TEMË E VEÇANTË: BESOJ, ZË BESË OSE BESIM / Special Topic: Faith, Believe, or Trust).

**14:16,17 “si për falënderimin tënd”** Kjo frazë mund t’i referohet Darkës së Zotit, e cila quhej *Eucharist* nga termi grek “falendero”. Megjithatë, vargu 17, nënkupton se i referohet lutjes.

▣ **“tjetri”** Shih shënimin tek 1 Kor. 6:1.

**14:18 “Unë e falënderoj Perëndinë time, sepse flas më shumë në gjuhë se ju të gjithë”** Pali e dinte se për çfarë po fliste. Ky varg, i kombinuar me 1 Kor. 14:39, duhet t’i bëjë të krishterët modernë të mendojnë dy herë përpara se të kritikojnë konceptin e gjuhëve të tjera në ditët tona. Kjo gjithashtu duhet t’i bëjë ata që e theksojnë atë, të mendohen dy herë. Pali pranon atë por gjithashtu nuk e mbivlerëson atë. Është interesante se si ky kapitull kalon nga njëjësi, 1 Kor. 14:2,4,9,13,14,19,26,17, në shumës, 1 Kor. 14:5,6,18, 22,23,39.

Tensioni në këtë kishë ishte (1) midis klasave shoqërore dhe (2) midis dhuntive individuale dhe ndërtimit të përbashkët. Në kishë individët gjithnjë i shërbejnë kolektivit (shih 1 Kor. 12:7)!

Ky është një tjetër shembull i përpjekjes së Palit për t’u identifikuar, të paktën në një farë mase, me besimtarët e mbi-zellshëm në Korint. Ndërsa ai konfirmonte njohurinë, por theksonte dashurinë, tani ai konfirmon gjuhët e tjera, por thekson ndërtimin.

**14:19 “Por në asamble parapëlqej të them pesë fjalë me mëncurinë time ... se dhjetë mijë fjalë në gjuhë tjetër”** Njësia letrare e kapitujve 11-14 trajton adhurimin publik dhe të përbashkët (shih 1 Kor. 14:23,28,34). Në këtë rrethanë, adhurimi personal në gjuhë është më pak i dëshirueshëm për shkak se askush tjetër nuk mësohet dhe si rrjedhojë nuk konvertohet (shih 1 Kor. 14:24-25) apo ndërtohet (“në mënyrë që unë të mund të udhëzoj të tjerët gjithashtu”, shih 1 Kor. 14:3,4,5,12,1,19,26).

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:20-25

<sup>20</sup> Vëllezër, mos u bëni kalamaj nga mendja, por bëhuni foshnje për të ligën, dhe burra të pjekur nga mendja. <sup>21</sup> Në ligj është shkruar: “Unë do t’i flas këtij populli në gjuhë të huaja dhe me buzë të tjera, por as kështu nuk do të më dëgjojnë,” thotë Zoti. <sup>22</sup> Prandaj gjuhët janë një shenjë jo për ata që besojnë, por për jobesimtarë, kurse profecia nuk është për jobesimtarë, po për besimtarë. <sup>23</sup> Pra, në qoftë se, kur gjithë kisha është mbledhur në një vend, të gjithë flasin gjuhëra dhe hyjnë profanë ose jobesimtarë, a nuk do të thonë se ju kanë dalë mendtë? <sup>24</sup> Por, në qoftë se profetizojnë të gjithë dhe hyn një jobesimtar ose një profan, ai bindet nga të gjithë dhe gjykohet nga të gjithë. <sup>25</sup> Dhe kështu të fshehtat e zemrës së tij zbulohen; edhe kështu, duke rënë me faqe përmbys, do të adhurojë Perëndinë, duke deklaruar se Perëndia është me të vërtetë midis jush.

**14:20 “mos u bëni kalamaj”** Kjo është një formë urdhërore e tashme me një nyjë mohuese, e cila zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim që është në proces e sipër. Ata ishin duke u sjellë si fëmijë në këtë aspekt (shih Efe. 4:14), edhe pse mendonin se po tregoheshin shumë frymorë dhe të mençur!

▣ **“nga mendja”** Kjo është nga fjala greke për diafragmën ose mesin. Në antikitet, kjo, dhe jo truri, mendohej se ishte qendra filozofike e intelektit.

▣ **“por bëhuni foshnje për të ligën”** Në disa aspekte, besimtarët duhet të jenë të painformuar (shih Mat. 10:16; Rom. 16:19). Një nga mbrojtësit më të mëdhenj nga e liga është injoranca ose naiviteti.

▣ **“bëhuni ... të pjekur”** Pali përdor këtë term (dmth., *teleios*) për të përshkruar besimtarin që e kupton dhe e jeton plotësisht ungjillin (shih 1 Kor. 2:6; 13:10; 14:20; Efe. 4:13; Fil. 3:15; Kol. 1:28). Të gjithë besimtarët fillojnë si foshnje të krishtera dhe duhet të rriten. Gjenden nivele të të kuptuarit dhe të të jetuarit të perëndishëm. Megjithatë, ky term nuk nënkupton mungesën e mëkatit, por një plotësi frymërore dhe pajisje për shërbesë.

**14:21-22** Kjo është një pjesë citimi nga Isa. 28:11-12. Ai lidhet me sundimin asirian të Izraelit. Vargu 22 lidhet me këtë citim dhe **jo** me të gjithë kontekstin. Kjo fjali është saktësisht e kundërta e gjithçkaje tjetër që Pali thotë në këtë kontekst. Ai duhet të lidhet vetëm me citimin e Dhjatës së Vjetër. Pali po përdor “shenja” në dy mënyra: gjykim dhe hir.

**14:21 “Në ligj”** Zakonisht në një kontekst hebraik, kjo do t’i referohej shkrimeve të Moisiut (dmth., Zanafilla – Ligji i Përtërirë), por jo gjithmonë. Tek Gjoni 10:34; 12:34; dhe 15:25, kjo frazë i referohet një citimi nga Psalmet, ashtu sikurse tek Rom. 3:9. E njëjta frazë përdoret tek 1 Kor. 14:34, por është e pasigurtë se cilëve tekste i referohet përveçse ndoshta Zanafilla 3.

Walter Kaiser, tek *Toward An Exegetical Theology* [Drejt një Teologjie Eksegjetike], fq. 110, bën një koment interesant se vargjet 34 dhe 35 janë një citim nga letra që Pali mori nga kisha korintase. Zakonisht përgjigjet e Palit ndaj pyetjeve të tyre të shkruara nisin me frazën “tani për sa i përket” (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1), por jo gjithmonë (dmth., citimi i dukshëm nga letrat i gjendur tek 1 Kor. 6:12 and 10:23). Nëse kjo është e vërtetë, atëherë “Ligji gjithashtu thotë” mund t’i referohet Ps. 68:11, të cilit i aludohet pa e cituar tek 1 Kor. 14:36! Psalmi 68:11 konfirmon shpalljen e lajmit të mirë në adhurimin e përbashkët nga gratë. Gordon Fee, në komentarin e tij mbi 1 Korintasve (*New International Commentary* [Komentari i Ri Ndërkombëtar]) gjithashtu konfirmon se Pali nuk shkroi 1 Kor. 14:34-35 (fq. 699-708).

**14:23 “në goftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të tretë (shih 1 Kor. 14:6,7,8,11, dhe 14).

▣ **“gjithë kisha është mbledhur në një vend”** Konteksti letrar i kapitujve 11-14 trajton udhëzimet për adhurimin e përbashkët.

Zakonisht këto kisha të hershme (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2) takoheshin në shtëpi private (dmth., kisha shtëpi). Shpesh në një qytet në përmasat e Korintit kishte disa shtëpi të përfshira. Kjo mund të jetë një nga arsyet për zhvillimin e grupimeve brenda kishës. Fjalët e Palit nënkuptojnë një takim grupi më të madh ndoshta për të festuar festën e dashurisë (shih 1 Kor. 11:17-34) dhe Darkën e Zotit. Sa shpesh apo ku takoheshin ata është e pasigurtë. Nga ky varg është e dukshme se lejoheshin të ftuarit, gjë që tregon se nuk ishte një takim sekret apo i mbyllur.

NASB	“ju jeni të çmendur”
NKJV, NRSV	“ju kanë dalë mendtë”
TEV	“ju jeni të gjithë të çmendur”
NJB	“ju jeni të gjithë të tërbuar”

Ky term (dmth., *mainomai*) përdoret tek Veprat e Apostujve 12:15 dhe 26:24-25. Tek Gjoni 10:20 ai përdoret për të përshkruar posedimin nga demonët. Ky term nuk nënkupton çmenduri, por posedimin nga një frymë. Në kulturën greke kjo do të ishte parë si një stad frymëror i privilegjuar, por nuk është kështu në krishtërim.



**14:24 “në qoftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të tretë (shih 1 Kor. 14:6,7,8,11,14,23,24,28,29).

NASB	“bindet... thirret për llogari”
NKJV	“bindet... gjykohet”
NRSV	“riprovohet... thirret për llogari”
TEV	“binden për mëkatit e tyre... gjykohen”
NJB	“e gjen veten të sprovuar... gjykohet”

Profecia sjell të kuptuar dhe bindje; gjuhët e tjera sjellin konfuzion tek jobesimtarët që janë për vizitë apo tek besimtarët e rinj.

▣ **“të gjithë... të gjithë... të gjithë”** Kjo nuk nënkupton që çdo besimtar fliste në çdo shërbesë adhurimi, por se gjithçka që bëhej në shërbesën e adhurimit i shtohet bindjes frymërore që vizitorët dhe ndoshta besimtarët e rinj përjetonin. Fjala “të gjithë” sigurisht përfshin edhe gratë besimtare të pranishme.

**14:25 “të fshehtat e zemrës së tij zbulohen”** Kjo mund t’i referohet të vërtetës që

1. Perëndia njih mendimet e njerëzve dhe sjell bindje me Frymën e Tij (shih 1 Kor. 24)
2. Rrëfimi publik i mëkatit ishte pjesë e adhurimit të shekullit të parë (shih Mat. 3:6; Mark 1:5; Veprat e Apo. 19:18; dhe Jakobi 5:16)

#### **TEMË E VEÇANTË: ZEMRA (DHJATA E RE) [SPECIAL TOPIC: THE HEART (NT)]**

Fjala greke *kardia* përdoret në Septuagintë dhe në Dhjatën e Re për të pasqyruar fjalën hebraisht *lēb* (BDB 523, KB 513). Ajo përdoret në disa mënyra (shih Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *A Greek-English Lexicon* [Leksik greqisht-anglisht], fq. 403-404).

1. qendra e jetës fizike, një metaforë për individin (shih Veprat e Apo. 14:17; 2 Kor. 3:2-3; Jakobi 5:5)
2. qendra e jetës shpirtërore (pra, morale)
  - a. Perëndia njih zemrën (shih Luka 16:15; Rom. 8:27; 1 Kor. 14:25; 1 Thes. 2:4; Zbu. 2:23)
  - b. përdoret për jetën shpirtërore të njerëzimit (shih Mat. 15:18-19; 18:35; Rom. 6:17; 1 Tim. 1:5; 2 Tim. 2:22; 1 Pjet. 1:22)
3. qendra e jetës mendore (pra, intelekti, shih Mat. 13:15; 24:48; Veprat 7:23; 16:14; 28:27; Rom. 1:21; 10:6; 16:18; 2 Kor. 4:6; Efe. 1:18; 4:18; Jakobi 1:26; 2 Pjet. 1:19; Zbu. 18:7; zemra është sinonime me mendjen te 2 Kor. 3:14-15 dhe Fil. 4:7)
4. qendra e vullnetit (shih Veprat 5:4; 11:23; 1 Kor. 4:5; 7:37; 2 Kor. 9:7)
5. qendra e ndjenjave (shih Mat. 5:28; Veprat e Apo. 2:26,37; 7:54; 21:13; Rom. 1:24; 2 Kor. 2:4; 7:3; Efe. 6:22; Fil. 1:7)
6. vendi unik i veprimtarisë së Frymës (shih Rom. 5:5; 2 Kor. 1:22; Gal. 4:6 [pra, Krishti në zemrat tona, Efe. 3:17])
7. Zemra është mënyrë metaforike për të nënkuptuar gjithë njeriun (shih Mat. 22:37, që citon Ligji i Përt. 6:5). Mendimet, qëllimet dhe veprimet që i atribuohen zemrës zbulojnë llojin e individit.  
Dhjata e Vjetër ka disa përdorime goditëse të këtyre termave
  - a. Zan. 6:6; 8:21, “Perëndia u trishtua në zemër”, shih dhe Osea 11:8-9
  - b. Ligji i Përt. 4:29; 6:5, 10:12, “me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt”
  - c. Ligji i Përt. 10:16, Jer. 9:26, “zemër e parrethprerë” dhe Rom. 2:29
  - d. Ezek. 18:31-32, “një zemër të re”
  - e. Ezek. 36:26, “një zemër të re” në dallim nga “një zemër guri” (shih Ezek. 11:19; Zak. 7:12)

## VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:26-33

<sup>26</sup> Ç' duhet bërë, pra, o vëllezër? Kur të mblidheni, secili nga ju ka një psalm, një mësim, fjalim në gjuhë tjetër, zbulesë, interpretim, çdo gjë le të bëhet për ndërtim. <sup>27</sup> Nëse ndonjë flet në gjuhë tjetër, le të bëhet kjo nga dy a më të shumtën tre vetë dhe njeri pas tjetrit, dhe një le të interpretojë. <sup>28</sup> Por nëse nuk ka interpretues, le të heshtë në kishë dhe le të flasë me veten e tij dhe me Perëndinë. <sup>29</sup> Le të flasin dy a tre profetë, dhe të tjerët të gjykojnë. <sup>30</sup> Por nëse ka një zbulesë ndonjë tjetër që rri ulur, le të heshtë i pari. <sup>31</sup> Sepse të gjithë, njeri pas tjetrit, mund të profetizojnë, që të mësojnë të gjithë dhe të inkurajohen të gjithë. <sup>32</sup> Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve, <sup>33</sup> sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi si në të gjitha kishat e shenjtorëve.

**14:26-33** Kjo na jep një njohuri të vërtetë në shërbesën e adhurimit dinamike dhe të pastrukturuar të kishës së hershme. Dukshëm nuk kishte, ende, një klergji profesionale. Kushdo mundej dhe fliste lirshëm. Problemet ngriheshin në dy zona.

1. Kishte konfuzion për shkak se një numër i madh njerëzish donin të flisnin
2. Ata po ndërprisnin njëri-tjetrin

Pali po përpiqet të strukturojë shërbesën e adhurimit të përbashkët në mënyrë të tillë që të mos kufizojë lirinë e Frymës, por të theksojë qëllimin e takimit, i cili është shpëtimi i të pashpëtuarve dhe pjekuria e të shpëtuarve (shih Mat. 28:19-20). Kjo nuk është strukturë për hir të strukturës (shih 1 Kor. 14:32)! Pali nuk po kërkon një rrethanë adhurimi të kontrolluar!

**14:26** “Cili është *rezultati*<sup>37</sup>” Shih shënimin tek vargu 15.

▣ “**çdo gjë le të bëhet për ndërtim**” Ky është mandati i përsëritur (dmth., forma urdhërore e tashme pasive [deponente]). Qëllimi i dhuntive frymërore nuk është lartësimi i një individi, por rritja (si në numër ashtu edhe në pjekuri) e kishës. Për ta thënë në një mënyrë tjetër “A arrin ky veprim apo strukturë qëllimin e Urdhërimit të Madh të Jezusit” (shih Mat. 28:19-20)?

**14:27** “Nëse” Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Pali nuk po konfirmon veprimet e tyre, por po i vë në dukje veprimet e tyre.

**14:28** “nëse” Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë. Pali dëshiron që adhurimi i përbashkët të japë informacion frymëror për të gjithë të pranishmit. Gjuhët e tjera janë të pranueshme nëse ato interpretohen. Adhurimi i përbashkët nuk është koha dhe vendi për përjetesa dhe devocion personal që të dominojë qëllimin e kolektives.

▣ “**nëse nuk ka interpretues, le të heshtë në kishë**” Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Gjuhët e tjera dhe profecitë janë të kontrollueshme nga personi që e ka dhuntinë (shih 1 Kor. 14:30). Ndërtimi i trupit të Krishtit dhe ungjillizimi, dhe jo liria personale, janë çelësi për adhurimin në publik.

**14:29** Profetët nuk kanë liri të pakufijshme (dmth., në tematikë, kohë apo përmbajtje) për të folur. Ata duhet të vlerësohen nga besimtarët e tjerë që kanë dhuntitë (shih 1 Kor. 14:30 dhe 12:10; 1 Gjoni 4:1-3). Kujtoni se demonët ishin të pranishëm kur Jezusi foli si në sinagogë ashtu edhe në predikimet në ambient të hapur.

▣ “**të gjykojnë**” Shih shënimin tek 1 Kor. 4:7 dhe Temën e Veçantë tek 1 Kor. 10:29.

**14:30** “nëse” Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të tretë (shih shih 1 Kor. 6,7,8,11,23,24,28,29).

▣ “**le të heshtë i pari**” Kjo është paralele me 1 Kor. 14:28 (dmth., formë urdhërore aktive e tashme). Kjo nënkupton se një folës mund të ndërpritet nga një besimtar tjetër dhe se folësi aktual duhet të dëgjojë folësin e ri përpara se të përgjigjet apo të shtojë ndaj zbulesës. Këto shërbesa të hershme ishin shumë dinamike dhe të improvizuara. Kjo i bën thirrje disa personaliteteve po aq fuqishëm sa një rregull strikt i bën thirrje personaliteteve të tjera!

<sup>37</sup> Versioni në shqip është: “Ç’ duhet bërë” (shënim i përkthyesit).

Tani pyetja është “a ishte kjo struktura standarte në të gjitha kishat e Palit apo një aspekt unik i kishës korintase? A e marrim në këtë diskutim si një provë të Dhjatës së Re për mënyrën se si duhet të strukturohen të gjitha shërbesat apo thjesht një shembull i mënyrës se si duhen trajtuar problemet në këtë aspekt?”

**14:31 “Sepse të gjithë, njeri pas tjetrit, mund të profetizojnë”** Sa drejtpërsëdrejti duhet marrë kjo frazë? A po konfirmon Pali një strukturë apo një mundësi të pakufizuar për këdo dhe për të gjithë besimtarët për të folur në shërbesën e njëjtë të adhurimit? A nuk kishte kufizim kohe në shërbesat e hershme të asamblesë? Ky është një shembull i një pohimi letrar, jo një pohimi për t’u marrë fjalë për fjalë. Në kontekst, Pali po kufizon lirinë e tyre, nuk po e zgjeron lirinë e tyre!

Megjithatë, termi “të gjithë” sigurisht nënkupton se si gratë ashtu edhe burrat mund të profetizojnë (shih 1 Kor. 11:5). Të gjithë besimtarët, meshkuj dhe femra, janë të pajisur me dhunti për të mirën e përbashkët (shih 1 Kor. 12:7; 14:26). Kjo shton një nevojë tjetër për të sqaruar 1 Kor. 14:34!

▣ **“që të mësojnë të gjithë dhe të inkurajohen të gjithë”** Kjo fjali qëllimore (dmth., *hina*) pohon shqetësimin kryesor të Palit, jo që të gjithë të jenë të aftë të flasin, por që të gjithë të ndërtohen, të inkurajohen dhe të maturohen! Kjo është tema e përsëritur e këtij kapitulli.

#### 14:32

**NASB, NKJV, NRSV “Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve”**

**TEV “dhuntia e shpalljes së mesazhit të Perëndisë duhet të jetë nën kontrollin e folësit”**

**NJB “fryma profetike duhet të jetë nën kontrollin e profetit”**

Këto mundësi përkthimi tregojnë dy mënyra të ndryshme se si mund të kuptohet kjo frazë.

1. Ata që shpallin mesazhin e Perëndisë i nënshtrohen (dmth., forma treguese pasive e tashme) të tjerëve që shpallin mesazhin e Perëndisë (dmth., profetët kontrollojnë profetët, 1 Kor. 14:29).
2. Ai që shpall mesazhin e Perëndisë ka kontroll personal (dmth., forma treguese e mesme e tashme) mbi kur dhe çfarë të thotë (shih 1 Kor. 14:30).

Termi “frymë” përdoret në të njëjtën mënyrë sikurse 1 Kor. 14:2,14,15 (dy herë), 16. Ajo është një mënyrë idiomatike për t’iu referuar personit të një individi (shih 1 Kor. 2:11; 5:3-4; 7:34; 16:18). Shih shënimet mbi “nënshtrimin” tek 1 Kor. 16:16 dhe Temën e Veçantë tek 2 Kor. 9:13.

#### 14:33

**NASB “sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi”**

**NKJV “sepse Perëndia nuk është autori i konfuzionit por i paqes”**

**NRSV, NJB “sepse Perëndia nuk është një Perëndi i çrregullimit por i paqes”**

**TEV “sepse Perëndia nuk dëshiron që ne të jemi në çrregullim por në harmoni dhe paqe”**

Kjo nuk i referohet krijimit. Ky nuk është rregulli përkundrejt kaosit, por luftërave të grupimeve ose egoizëmit të tyre përkundrejt paqes. Kjo nuk është të zvogëlosh karakterin dinamik të adhurimit të shekullit të parë (shih 1 Kor. 14:39-40), por qëndrimin xheloz dhe egoist të disa prej folësve me dhunti (shih 2 Kor. 6:5; 12:20; Jakobi 3:16). Si stili ynë i adhurimit ashtu edhe qëndrimi ynë reflektojnë ndaj Perëndisë të cilin shpallim se adhurojmë (shih 1 Kor. 11:17-34).

▣ **“si në të gjitha kishat e shenjtorëve”** Është e pasigurtë nëse kjo frazë shkon me 1 Kor. 14:33a (NASB, NKJV) apo me 1 Kor. 14:34 (NRSV, TEV, NJB). Për shkak se frazë “në kisha” përsërit 1 Kor. 14:33b është e mundur që 33b të formojë një shënim përmbyllës ashtu siç bën tek 1 Kor. 4:17 dhe 7:17. Kjo frazë pohon qartazi ndaj të gjitha kishave shtëpi në Korint se ato nuk janë të veçanta, superiore apo të pajisura në mënyrë unike me dhunti (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:16; 14:33,36; 16:1). Shih TEMËN E VEÇANTË: SHENJTORË (SPECIAL TOPIC: SAINTS) tek 1 Kor. 1:2.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:34-36

<sup>34</sup> Gratë tuaja të heshtin në kishë, sepse nuk u lejohet të flasin, por duhet të nënshtrohen, sikurse thotë edhe ligji. <sup>35</sup> Dhe në qoftë se duan të mësojnë ndonjë gjë, le të pyesin burrat e tyre në shtëpi, sepse është e

**14:34 “Gratë tuaja të heshtin në kishë”** Ky varg është bërë një çështje kryesore teologjike në segmente të caktuara të kishës moderne. Trendi modern perëndimor social dhe kulturor ndaj të drejtave të individëve dhe barazizë e ka bërë Dhjatën e Re, dhe sidomos Palin, të duket gjykues dhe negativ mbi këtë çështje. Në kohën e Palit teologjia e tij e lidhur me gratë ishte pozitivisht radikale (shih Efe. 5:22-23). Pali dukshëm punonte me shumë gra, sikurse tregon lista e tij e bashkëpunëtorëve tek Romakëve 16. Gjithashtu, shih Temën e Veçantë: Gratë në Bibël (Special Topic: Women in the Bible) tek 1 Kor. 7:5. Edhe në këtë kontekst, Pali pohon ekuilibrin 1 Kor. 11:5 përkundrejt 14:34. Në një farë mënyre, 1 Kor. 14:34-35 lidhet në mënyrë unike me Korintin dhe shekullin e parë. Teoritë janë legjione (shih Temën e Veçantë më poshtë)! Mënyra se si ajo lidhet me kohën tonë është problematike. Dogmatizmi dhe nxjerrja e tekstit nga konteksti janë të papërshtatshme. Dëshmitari biblik nuk është uniform ose monolitik mbi këtë çështje. Pali kufizon disa grupe në rrethanat e adhurimit korintas, “të heshtin”, 1 Kor. 14:28,30,34. Kishte një problem në adhurimin e përbashkët në Korint. Gratë e krishtera ishin një pjesë e atij problemi. Liria e tyre e re në Krishtin (ose të qënurit pjesë e një lëvizjeje sociale romake për liritë e grave) po shkaktonte probleme kulturore, teologjike dhe ungjillore. Në kohën tonë e kundërta mund të jetë e vërtetë. Gratë drejtuese me dhunti do të ndihmojnë kishën e shekullit të njëzetë e një-të të arrijë botën me ungjillin. Kjo nuk ndikon mbi rregullin e dhënë nga Perëndia për krijimin, por tregon prioritetin e ungjillizimit (shih 1 Kor. 9:22). Kjo çështje nuk është një çështje ungjilli apo doktrine.

**TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI NGA PALI I GRAVE NË SHËRBESË (SPECIAL TOPIC: PAUL'S USE OF WOMEN IN MINISTRY)**

Vini re të gjitha gratë tek Romakëve 16 që ishin bashkëpunëtoresh me Palin në ungjill (shih Fil. 4:3):

Feba (dhjake) tek Rom. 16:1  
Prishila tek Rom. 16:3  
Maria tek Rom. 16:6  
Junia (ose Junias — nëse ishte burrë) tek Rom. 16:7  
Trifena dhe Trifoza tek Rom. 16:12  
Persida tek Rom. 16:12  
“nënës së tij” tek Rom. 16:13  
Julia (ndoshta apostull) tek Rom. 16:15  
dhe “motrës së tij” tek Rom. 16:15

Kini kujdes nga dogmatizmi në aspektin e grave në shërbesë. Të gjithë besimtarët pajisen me dhunti (shih 1 Kor. 12:7,11); të gjithë besimtarët janë shërbëtorë me kohë të plotë (shih Efe. 4:12). Në këtë listë, ne kemi një grua dhjake, Feba, dhe ndoshta një grua apostull, Junia (shih Joel 2:28; Veprat e Apo. 2:16-21). Është e vështirë të dish se si të trajtosh këtë çështje biblikisht për shkak të pohimeve në dukje paradoksikale të Palit sikurse tek 1 Kor. 11:4-5 krahasuar me 14:34.

**TEMË E VEÇANTË: TEORI TË LIDHURA ME “GRATË TË HESHTIN” (SPECIAL TOPIC: THEORIES RELATED TO “WOMEN KEEP SILENT”)**

- I. Ky nuk është një pohim nga Pali, por një shtesë e mëvonshme (shih Gordon Fee, *New International Commentary* [Komentari i Ri Ndërkombëtar], “I Corinthians” [1 Korintasve], fq. 699-708) zakonisht i bazuar mbi disa dorëshkrime greke (dmth., MSS D, F, G; një MS nga Vulgate; Ati kishtar latin Ambrosiaster, pas vitit 384 pas lindjes së Krishtit) i cili vendosi 1 Kor. 14:33-34 pas v. 40.
- II. Pali po citon letrën nga kisha, e cila pohon pikëpamje të rreme të grupimeve. Pali po e citon atë që

ta mohojë atë. Megjithatë, ky diskutim i zgjatur (dmth., 1 Kor.14:33-35 ose 36) nuk i përshtatet “sloganeve” të mëparshme të Palit. Ai nuk është një pohim i thjeshtë i modifikuar nga Pali, por një argument i mbështetur.

- III. Pali po i referohet një grupi problematik grash që janë duke ndërprerë shërbesën e adhurimit me gjuhë të tjera, profetizim ose pyetje. Tepria e tyre në lirinë e re në Krishtin po shkaktonte vështirësi kulturore në ungjillizim dhe adhurim.
- IV. Pali po i kufizon gratë, jo në profetizimin në publik, por në vlerësimin e mesazheve të profetëve të tjerë (dmth., profetëve meshkuj), duke nënkuptuar në këtë mënyrë një autoritet mbi to (James Hurley, *Men and Women in Biblical Perspective* [Burrat dhe Gratë në Perspektivë Biblike], fq. 185-194 dhe Wayne Grudem, *The Gift of Prophecy in I Corinthians* [Dhunia e Profecisë tek 1 Korintasve], fq. 239-255).
- V. Pali po trajton situata të ndryshme tek 1 Kor. 11:5 dhe 14:34.
- A. Njëra është në një kishë shtëpi (dmth., 11:5) dhe tjetra është në kishën kolektive (dmth., 14:34)
- B. 11:5 i drejtohet grave beqare dhe 14:34 grave të martuara
- C. Disa gra ishin të padisiplinuara dhe tepër të shprehura
- Llojshmëria dhe numri i interpretimeve tregojnë pasigurinë e interpretesve modernë të lidhur me praktikatat e adhurimit të Korintit (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin]) dhe për këtë çështje, grigjat e krishtera të shekullit të parë. A ishte problemi
1. Lokal (dmth., vetëm në Korint),
  2. Kultura romake e shekullit të parë,
  3. Abuzimi me dhuntitë,
  4. Përpjekja e grave për të dominuar,
  5. Përpjekja për të imponuar një strukturë hebraike,
  6. Pikëpamje të rreme të një grupimi në Korint?

NASB	“duhet të nënshtrohen”
NKJV	“ato duhet të jenë të nënshtuara”
NRSV	“duhet të jenë vartëse”
TEV	“nuk duhet të jenë në ngarkim”
NJB	“pjesa e tyre është një pjesë e ndërvarur”

Kjo është një formë urdhërore pasive e tashme. “Nënshttrim” ishte një term ushtarak që përshkruante radhën e urdhërave. Ai përdoret për Jezusin (shih Luka 2:51 ndaj prindërve të Tij tokësorë dhe 1 Kor. 15:28 ndaj Atit të Tij Qiellor) dhe është një e vërtetë universale për kishën (shih Efe. 5:21).

#### **TEMË E VEÇANTË: NËNSHTRIMI (HUPOTASSŌ) [SPECIAL TOPIC: SUBMISSION (HUPOTASSŌ)]**

Septuaginta e përdor këtë term për të përkthyer dhjetë fjalë të ndryshme hebraike. Kuptimi i tij kryesor në Dhjatën e Vjetër ishte “të urdhërosh” ose “e drejta e komandës.” Kjo merret në Septuagintë (LXX).

1. Perëndia urdhëron (shih Lev. 10:1; Jona 2:1; 4:6-8)
2. Moisiu urdhëron (shih Eks. 36:6; Ligji i Përt. 27:1)
3. mbretërit urdhërojnë (shih II Kron. 31:13)

Në Dhjatën e Re ky kuptim vazhdon si në Veprat e Apo. 10:48, ku urdhëron një apostull. Megjithatë, në Dhjatën e Re ka zhvillohen nuanca të reja kuptimore.

1. del në pah një aspekt vullnetar (shpesh në DIATEZËN JOVEPRORE)
2. ky veprim vetë-kufizues mund të shihet në nënshtrimin e Jezusit
  - a. ndaj Atit (shih 1 Kor. 15:25)
  - b. ndaj prindërve të Tij tokësorë (shih Luka 2:51)
3. besimtarët u nënshtrohen aspekteve të kulturës në mënyrë që ungjilli të mos ndikohet për keq
  - a. besimtarëve të tjerë (shih Efe. 5:21)
  - b. bashkëshortet besimtare (shih Kol. 3:18; Efe. 5:22-24; Titit 2:5; I Pjet. 3:1)
  - c. besimtarët ndaj qeverive pagane (shih Rom. 13:1-7; I Pjet. 2:13)

Besimtarët veprojnë nga motive dashurie, për Perëndinë, për Krishtin, për Mbretërinë, për të mirën e të tjerëve.

Ashtu si me *agapaō* (dua) kisha e mbushi këtë term me kuptim të ri bazuar në nevojat e Mbretërisë dhe në nevojat e të tjerëve. Ky term merr një fisnikëri të re vetëmohimi, jo bazuar në një urdhër, por në një marrëdhënie të re me një Perëndi vetë-dhënës dhe Mesian e Tij. Besimtarët binden dhe nënshtrohen për të mirën e të tërës dhe për bekimin e familjes së Perëndisë.

▣ **“sikurse thotë edhe ligji”** A po i referohet Pali një teksti specifik apo një parimi të përgjithshëm? Nuk ka asnjë tekst në Dhjatën e Vjetër ku thuhet kjo. Ka mundësi që nën dritën e 1 Kor. 11:8-9 që Zan. 2:20-24 të jetë teksti referues (shih 1 Tim. 2:13). Disa mendojnë se rezultati i rënies dhe se Zan. 3:16 është vargu referues. Gjithashtu, është e mundur nga ana tekstuale që “nënshtrimi” të lidhet me përdorimin e fjalës tek 1 Kor. 14:32, ku duhet t’i referohet nënshtrimit ndaj profetëve të tjerë (shih *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës], fq. 616).

Gjendet një rrjedhshmëri në shkrimet e Palit në përdorimin e këtij termi “ligj”. Më shpesh ai i referohet ligjit të Moisiut, besëlidhjes së vjetër, por ndonjëherë i referohet konceptit të ligjit në përgjithësi. Nëse kjo është e vërtetë këtu atëherë i referohet parimeve të përgjithshme të kësaj kulture patriarkale të llojit “burrat të parët”. Nëse gratë lejoheshin të kishin detyra në ngarkim, edhe në dukje, do ta kishte dëmtuar çështjen e Krishtit në botën greko-romake të shekullit të parë. Në këtë mënyrë është e ngjashme me mënyrën se si Dhjata e Re trajton çështjen e skllavërisë. Shih shënimin tek 1 Kor. 14:21 për një të kuptuar ndryshe të kësaj fraze.

**14:35** Ky varg tregon se termi “grua” tek 1 Kor. 14:34 i referohet “bashkëshorteve”. A nënkupton kjo se një grua beqare mund të flasë? E njëjta paqartësi ekziston tek kapitulli 11:5.

Ky varg lidhet me 1 Tim. 2:11-12 dhe Titit 2:5. A është një çështje teologjike apo kulturore tek 1 Tim. 2:13-14? A është ajo e lidhur me një rrethanë unike historike apo është një e vërtetë universale për të gjitha kulturat, të gjitha epokat? (shih *How to Read the Bible For All Its Worth* [Si të Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj] nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, fq. 15,63,72,74).

▣ **“në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Bashkëshortet e krishtera po bënin pyetje gjatë adhurimit kolektiv në Korint. Takimet e kishës ndërpriteshin nga këngëtarët, folësit në gjuhë të tjera, interpretuesit e gjuhëve të tjera dhe profetët. Tanimë bashkëshortet kurioze ose bashkëshortet që donin të valëvisnin lirinë e tyre gjithashtu po përfshiheshin aktivisht në kaosin e shkaktuar!

▣ **“le të pyesin burrat”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Këtyre grave iu thuhet se kë të pyesin dhe kur ta pyesin dhe pse! Veprimet e tyre po ndikonin mbi frytshmërinë e adhurimit të përbashkët. Ju lutem, lexoni shënimin mbi të kuptuarit e Walter C. Kaiser të 1 Kor. 14:34-36 at 1 Kor. 14:21, paragrafi dy.

**14:36** Kjo ishte një pyetje sarkastike për të shokuar kishën korintase krenare në realitetin frymor dhe vendin e tyre në mes të grigjave të tjera. Forma gramatikore e dy pyetjeve tek 1 Kor. 14:36 pret një “jo” si përgjigje.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:37-38

<sup>37</sup> Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror, le të njohë se ato që po ju shkruaj janë

**14:37-38** Pali po konfirmon se ata që kanë dhunti të vërteta frymërore duhet të dallojnë të tjerët që flasin dhe kanë dhunti nga Perëndia (shih 1 Kor. 14:32; Matt. 11:15; 13:9,15,16,43). Përshkrimi i Palit i kuptimit të tij të drejtimit shprehet tek 1 Kor. 7:40 dhe 14:38. Pali dallon dhuntinë e tij apostolike dhe autoritetin e saj për të folur për Krishtin. Apostullati i tij po vihej në pikëpyetje dhe po sfidohej nga disa në Korint.

Vargu 38 nënkupton një mallkim hyjnor (forma treguese pasive e tashme) mbi ata që refuzojnë autoritetin apostolik (shih Wayne Grudem, *The Gift of Prophecy in 1 Corinthians* [Dhuntia e Profecisë tek 1 Korintasve], fq. 52 shënimi nr. 104).

▣ **“Në qoftë se... nëse”** Këto të dyja janë fjali kushtore të rendit të parë, që janë të supozuara se janë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Disa në Korint “mendojnë” se janë “frymërore” (dmth., *pneumatikos*, shih 1 Kor. 12:1), por veprimet e tyre dhe marrëdhënia e tyre ndaj autoritetit apostolik (dmth., autoriteti i Palit) tregojnë se ata në të vërtetë nuk janë. Nëse ata nuk e njohin dhe nuk i nënshtrohen autoritetit të Palit atëherë ata nuk duhet të njihen si drejtues frymërore.

**14:38**

<b>NASB</b>	“ai nuk njihet”
<b>NKJV</b>	“le të jetë i paditur”
<b>NRSV</b>	“ai nuk duhet njohur”
<b>TEV</b>	“mos i kushtoni vëmendje atij”
<b>NJB</b>	“ai person nuk njihet vetë”

Gjendet një variacion në kohën e foljes tek dorëshkrimet greke, midis formës treguese pasive të tashme (MSS  $\alpha^*$ , A<sup>\*</sup>) dhe formës urdhërore aktive të tashme (MSS P<sup>46</sup>,  $\kappa^2$ , A<sup>c</sup>, B, D<sup>2</sup>). Forma treguese pasive nënkupton “i shpërfillur ose i panjohur nga Perëndia”. Forma urdhërore komandon besimtarët në Korint që të refuzojnë personin që refuzon autoritetin e Palit ose ndoshta autoritetin e Palit në avokatin dhe përfaqësuesin e tij, Timoteun. Version UBS<sup>4</sup> i jep formës treguese një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë).

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 14:39-40**

**<sup>39</sup> Prandaj, o vëllezër të mi, kërkoni me zemër të zjarrtë të profetizoni dhe mos ndaloni të flasin në gjuhëra. <sup>40</sup> Por të gjitha të bëhen sikur ka hije dhe me rregullsi.**

**14:39 “kërkoni me zemër të zjarrtë”** Ky është termi i Palit për dëshirë të fortë (shih 1 Kor. 12:31; 14:1). TEV ka “vendosni në zemrat tuaja”. Për Palin në këtë rrethanë kulturore dëshira është e drejtuar tek shpallja / ndarja e ungjillit për të mirën e besimtarit dhe jobesimtarit. Krahasojeni këtë me Num. 29:11.

Duket se pohimi hapës i Palit tek 1 Kor. 14:1 është gjithashtu pohimi i tij përmbyllës tek 1 Kor. 14:39. Termi grek *ōste*, i ndjekur nga një formë urdhërore, mund të jetë një mënyrë për të nisur përmbledhjet apostolike (shih 1 Kor. 10:12; 11:33; 14:39; 15:58; Fil. 2:12; 1 Thes. 4:18).

▣ **“mos ndaloni të flasin në gjuhëra”** Ky është ekuilibri i nevojshëm ndaj probelmeve në Korint dhe sot. Ne priremi të reagojmë më shumë nga ç’ duhet në qëndrimet tona mbi çështjet frymërore. Shtegu i së vërtetës ka një hendek gabimi në të dy anët (dmth., të gjithë flasin në gjuhë të tjera përkundrejt askush nuk flet në gjuhë të tjera)!

<b>NASB</b>	“në mënyrën e duhur dhe me rregull”
<b>NKJV, NRSV</b>	“sikur ka hije dhe me rregullsi”
<b>TEV</b>	“në mënyrë të përshtatshme dhe me rregull”
<b>NJB</b>	“në formë të përshtatshme dhe me rregull”

Termi i parë vjen nga kombinimi i ndajfoljes “mirë” (*eu*) dhe emrit “mënyrë” ose “formë” (shih Rom. 13:13; 1 Thes. 4:12).

Termi i dytë do të thotë “të rregullosh në një mënyrë të përshtatshme, të japësh rregull” (shih Kol. 2:5). Kjo frazë paralelizon 1 Kor. 14:33. Ajo nuk ka të bëjë me një rregull të paravendosur (dmth., një plan kontrollues), por me qëllimin e shërbesës së adhurimit kolektiv, i cili është ungjillizimi dhe dishepullizimi (shih Mat. 28:19-20). Ky është pohimi përmbyllës i Palit mbi temën e adhurimit të përbashkët, i cili filloi në kapitullin 11.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Cilët janë tre kriteret për gjykimin e dhuntive frymërore?
  - a.
  - b.
  - c.
2. Pse gjuhët e tjera nënvlerësohen në këtë kapitull ndaj profecisë? A janë gjuhët e tjera një dhunti frymërore inferior?
3. Si lidhet mendja me gjuhët e tjera?
4. Cili është problemi me vargun 22?
5. A duhet të përdoret kisha në Korint si një udhëzues për të gjitha kishat?
6. A duhet të heshtin gratë në kishë? Shpjegoni përgjigjen tuaj duke krahasuar 11:5 and 14:34.



# 1 KORINTASVE 15

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ringjallja e Krishtit 15:1-11	Krishti i Ringjallur, Realiteti i Besimit 15:1-11	Ungjilli i Vdekjes dhe Ringjalljes së Krishtit 15:1-11	Ringjallja e Krishtit 15:1-2 15:3-7 15:8-11	Fakti i Ringjalljes 15:1-8
Ringjallja e të Vdekurve 15:12-19	Krishti i Ringjallur, Shpresa Jonë 15:12-19	Rëndësia e Ringjalljes për Ne 15:12-19	Ringjallja Jonë 15:12-19	15:12-19
15:20-28	Armiku i Fundit i Shkatërruar Efektet e Mohimit të Ringjalljes 15:20-28	15:20-28	15:20-28	15:20-28
15:29-34	15:29-34	15:29-34	15:29-32 15:33-34	15:29-34
Trupi i Ringjallur 15:35-41	Një Trup i Lavdishëm 15:35-49	Natyra e Ringjalljes 15:35-41	Trupi i Ringjalljes 15:35-38 15:39 15:40-41	Mënyra e Ringjalljes 15:35-38 15:39-44a
15:42-49		15:42-49	15:42-49	15:44b-49
15:50-58	Fitorja Jonë Përfundimtare 15:50-58	15:50-57 15:58	15:50 15:51-57 15:58	15:50-53 Një Himn i Përmbylljes së Triumfit 15:54-57 15:58

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

## NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Është e dukshme nga konteksti se Pali po reagon ndaj një herezie të mundshme lokale që mohon ringjalljen e të vdekurve (gjë me të cilën shumica e hebrenjve do të kishin rënë dakord). Disa teori janë hedhur mbi origjinën e mundshme:
- Idetë e Gnostikëve fillestarë (shih Fjalorthin) të cilët theksojnë dualizmin midis frymës (dmth., Perëndisë që është i mirë) dhe materies (dmth., gjërat materiale të cilat janë të këqija)
  - Ata që pranojnë se ringjallja ka ndodhur tanimë (shih 2 Tim. 2:17-18).
- B. Ky është pasazhi përcaktues në Dhjatën e Re mbi ringjalljen e Krishtit dhe ringjalljen e besimtarëve. Duhet të mbajmë mend se ky pasazh është shkruar ndoshta përpara se të shkruheshin Ungjijt.
- C. Vini re theksin pastoral të Palit në mënyrën se si përfundon ky kapitull doktrinal, 1 Kor. 15:58. Ky është i ngjashëm me 1 Thes. 4:18. Pali gjithmonë e sjell poshtë doktrinën në jetesën dhe shërbesën e përditshme. E vërteta informon stilin e jetesës!
- D. Na ndihmon të shohim strukturën e përgjithshme të këtij kapitulli të gjatë. Dr. David King, një koleg tek Universiteti Baptist i Teksasit Lindor, ka një skicim të mirë nga shënimet e tij të leksionit:
- IV. “Të rrisësh të krishterë të pjekur kërkon një të kuptuar të besimit në ringjallje (1 Kor. 15:158).
- Hyrja: (1 Kor. 15:1-11)
    - Vetë ungjilli bazohet fort mbi ringjalljen e Jezusit (1 Kor. 15:1-8).
      - Faktet bazë të ungjillit (*Kerygma*) lidhen me vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e Jezusit (1 Kor. 15:3-4).
      - Shfaqjet pas-ringjalljes të Jezusit provojnë përtej çdo dyshimi se Jezusi u ringjall prej së vdekurish (1 Kor. 15:5-7).
      - Pali lartëson hirin e Perëndisë i cili e lejoi atë të jetë mes dëshmitarëve të ringjalljes së Jezusit (1 Kor. 15:8-11).
    - Baza e doktrinës së ringjalljes sonë është ringjallja e Jezusit (1 Kor. 15:12-34).
      - Disa thonë se Ai nuk u ringjall prej së vdekurish. Cilat janë implikimet e kësaj (1 Kor. 15:12-19)?
        - Predikimi ynë është i pavlerë (1 Kor. 15:12-14).
        - Besimi juaj është i kotë (1 Kor. 15:14 & 17).
        - Ne jemi dëshmitarë të rremë të së vërtetës së Perëndisë (1 Kor. 15:15).
        - Ju jeni ende në mëkatet tuaja (1 Kor. 15:17).
        - Ata besimtarë që kanë vdekur janë të humbur përgjithmonë (1 Kor. 15:18).
        - Të gjithë besimtarët janë për t’u mëshiruar (1 Kor. 15:19).
      - Por Krishti ka qënë (dhe ende është) Ringjallur! Cilat janë implikimet e kësaj (1 Kor. 15:20-34)?
        - Ai është i pari-fryt i një të korre që po vjen (1 Kor. 15:20).
        - Krishti, njeriu, e mundi vdekjen që hyri në botë nga njeriu i parë, Adami (1 Kor. 15:21-22, shih Rom. 5:12-21).
        - Ringjallja ndahet në dy pjesë: ringjallja e Krishtit dhe ringjallja e të tjerëve (1 Kor. 15:23).
        - Vdekja do të mundet nga ringjallja dhe të gjithë do t’i nënshtrohen Perëndisë, krijuesit të gjithçkaje (1 Kor. 15:24-28).
        - Besimtarët pagëzohen në besim duke besuar në ringjallje si frymore ashtu edhe fizike (1 Kor. 15:29).
        - Ne përballemi me të gjitha llojet e rrezikut pa frikë, sepse nëse vdesim, ne do të jetojmë sërish dhe do të gjykohe mi, sipas veprave tona (e nënkuptuar) kështu që duhet të jemi të kujdesshëm se si jetojmë (1 Kor. 15:30-34).
    - Doktrina e ringjalljes së besimtarëve është e arsyeshme. Pali iu përgjigjet disa prej pyetjeve të tyre (1 Kor. 15:35-57).

- a. Si ringjallen të vdekurit? Përgjigje: Me fuqinë e Perëndisë, ashtu sikurse Perëndia rrit bimët nga farërat (1 Kor. 15:35-38).
- b. Çfarë lloj trupi kanë ata? Përgjigje: Një lloj ndryshe trupi të përshtatshëm për llojin e jetës që ne do të jetojmë në përjetësi (1 Kor. 15:39-41).
- 1) Perëndia ka krijuar lloje të ndryshme trupash për jetën në këtë botë (1 Kor. 15:39-41).
  - 2) Trupi i ringjallur është një trup i ri (1 Kor. 15:42-44).  
I paprishshëm dhe jo i prishshëm,  
I lavdishëm dhe jo i turpëruar,  
I fuqishëm dhe jo i dobët  
Frymëror dhe jo kafshëror (ose fizik)
  - 3) Natyra e trupit të ringjalljes sqarohet nga kontrasti me trupin natyror i cili e çon Palin tek kontrasti midis Adamit dhe Krishtit (1 Kor. 15:45-49, shih Rom. 5:12-21).
- c. Kur do të ndodhë kjo? Përgjigje: Kur Jezusi të vijë sërish (1 Kor. 15:50-57).
- 1) Një ndryshim nevojitet për të gjithë (1 Kor. 15:50).
  - 2) Ne do të ndryshohemi të gjithë menjëherë (1 Kor. 15:51-52, shih 1 Thes. 4:14-17).
  - 3) Do të ndodhë kur boria e Perëndisë të bjerë (1 Kor. 15:52-shih 1 Thes. 4:16).
  - 4) Kur ndryshimi të ketë ndodhur fitorja e plotë mbi vdekjen do të jetë e jona në Jezus Krishtin (1 Kor. 15:53-57).
4. Përmbyllja: Rezultati i besimit në këtë doktrinë është qëndrueshmëria në shërbesë për shkak se ne e dimë se shërbesa jonë nuk është më kot (1 Kor. 15:58).”

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:1-2

<sup>1</sup> Tani, o vëllezër, po ju deklaroj ungjillin që ju kam shpallur dhe që ju e keni marrë dhe mbi të cilin ju qëndroni, <sup>2</sup> dhe me anë të të cilit ju jeni shpëtuar, nëse do ta mbani fjalën që ju kanë predikuar, veç nëse besuat kot.

15:1

NASB	“Tani po ju bëj të ditur”
NKJV	“Për më tepër, po ju deklaroj”
NRSV	“Tani do t’ju rikujtoja”
TEV	“Dhe tani dua që t’ju rikujtoj”
NJB	“Unë dua t’ju bëj të qartë”

Pali e ka strukturuar letrën e tij rreth disa pyetjeve që kisha në Korint i kishte dërguar atij (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1) me frazën “tani për sa i përket” (dmth., *peri de*). Kapitulli 15 fillon me *de*. A është e mundur që ky diskutim mbi ringjalljen të mos ishte një pyetje që kisha kishte bërë, por një situatë për të cilën Pali ishte i ndërgjegjshëm dhe dëshironte t’i drejtohej?

Kjo është një formë treguese aktive e tashme e *gnōrizō*, që do të thotë të bësh të njohur, të zbulosh ose të deklarojsh. Megjithatë, Pali nuk po jepte informacion të ri (shih 1 Kor. 12:3), por një përmbledhje doktrinale duke organizuar ungjillin që ai më parë iu kishte predikuar atyre.

### TEMË E VEÇANTË: KERIGMA E KISHËS SË HERSHME (SPECIAL TOPIC: THE KERYGMA OF THE EARLY CHURCH)

Ka shumë mendime për krishterimin. Koha jonë është kohë e pluralizmit fetar, njësoj si në shekullin e parë. Personalisht, unë i përfshij dhe i pranoj të gjitha grupet që pretendojnë se e njohin dhe besojnë në Jezus Krishtin. Të gjithë kemi mosmarrëveshjet tona për gjëra të ndryshme, por, në thelb, krishterimi ka të bëjë

vetëm me Jezusin. Sidoqoftë, ka grupe që pretendojnë se janë të krishtera, por në fakt janë thjesht kopje “false”, ose “të vonët në fushën e betejës”. Si t’i dalloj sektet nga e vërteta? Po, ja ka dy mënyra:

- A. Një libër i dobishëm për të mësuar çfarë besojnë grupet moderne të kulteve (nga vetë librat e tyre) është *The Kingdom of the Cults* [Kultet e Mbretërisë], nga Walter Martin.
- B. Predikimet e kishës së hershme, veçanërisht ato të apostujve Pjetër dhe Pal në librin e Veprave të Apostujve, na japin skicën bazë të mënyrës sesi autorët e frymëzuar të shekullit të parë ua paraqesnin krishterimin grupeve të ndryshme. Kjo “shpallje”, ose ky “predikim” i hershëm (Veprat e Apostujve përbën një përmbledhje të tij) njihet me fjalën greke *kerygma*. Më poshtë janë të vërtetat bazë të ungjillit për Jezusin në Veprat e Apostujve:
  - 1.përmbush shumë profeci nga Dhjata e Vjetër – Veprat e Apostujve 2:17-21,30-31,34; 3:18-19,24; 10:43; 13:17-23,27; 33:33-37,40-41; 26: 6-7,22-23
  - 2.i dërguar nga YHWH sipas premtimit – Veprat e Apostujve 2:23; 3:26
  - 3.kreu mrekulli për ta vërtetuar mesazhin e vet dhe për të zbuluar mëshirën e Perëndisë – Veprat e Apostujve 2:22; 3:16; 10:38
  - 4.u dorëzua dhe u mohua – Veprat e Apostujve 3:13-14; 4:11
  - 5.u kryqëzua – Veprat e Apostujve 2:23; 3:14-15; 4:10; 10:39; 13:28; 26:23
  - 6.u ringjall – Veprat e Apostujve 2:24,31-32; 3:15,26; 4:10; 10:40; 13:30; 17:31; 26:23
  - 7.u lartësua në të djathtë të Perëndisë – Veprat e Apostujve 2:33-36; 3:13, 21
  - 8.do të kthehet sërish – Veprat e Apostujve 3:20-21
  - 9.i caktuar Gjykatës – Veprat e Apostujve 10:42; 17:31
  10. dërgoi Frymën e Shenjtë – Veprat e Apostujve 2:17-18, 33, 38-39; 10:44-47
  11. Shpëtimtar i gjithë atyre që besojnë – Veprat e Apostujve 13:38-39
  12. Askush tjetër s’është Shpëtimtar – Veprat e Apostujve 4:12; 10:34-36

Ja disa mënyra si të reagojmë ndaj këtyre shtyllave apostolike të së vërtetës:

- 1.Pendohu – Veprat e Apostujve 2:38; 3:19; 17:30; 26:20
- 2.Beso – Veprat e Apostujve 2:21; 10:43; 13:38-39
- 3.Pagëzohu – Veprat e Apostujve 2:38; 10:47-48
- 4.Merr Frymën – Veprat e Apostujve 2:38; 10:47
- 5.Të gjithë mund të vijnë – Veprat e Apostujve 2:39; 3:25; 26:23

Kjo skemë shërbeu si shpallja thelbësore e kishës së hershme, ndonëse autorë të ndryshëm të Dhjatës së Re mund ta lënë pa përmendur një pjesë, ose të thekojnë disa pjesë të tjera në shkrimet e tyre. Gjithë ungjilli i Markut ndjek me kujdes aspektin pjetrin të *kerygma*. Nga tradita, Marku shihet si strukturues i predikimeve të Pjetrit, të bëra në Romë, në formën e një ungjilli me shkrim. Si Mateu ashtu dhe Luka ndjekin strukturën bazë të Markut.

▣ **“vëllezër”** Pali shpesh përdor këtë fjalë për të përcaktuar një aspekt të ri të temës së tij ose një ndryshim të temës, ashtu sikurse bën këtu (shih 1 Kor. 1:10; 2:1; 3:1; 4:6; 8:12; 10:1; 11:33; 12:1; 14:6,20,26; 15:1,58; 16:12,15).

▣ **“ungjillin”** Pali paralelizon konceptin e “ungjillit” me “fjalën që ju predikova” (1 Kor. 15:2). Në mendimin hebraik kishte një fuqi ndaj fjalës hyjnore (p.sh., Zan. 1:3,6,9,11,14,20,24; Ps. 33:6,9; Isa. 55:11; Gjoni 1:1). Kjo më pas është një metaforë për përmbajtjen e predikimit të Palit, jo vetëm një mënyrë për t’iu referuar vokalizimit. Ky varg përmban një lidhës kallëzor, fjalë për fjalë “ungjillin që unë ju ungjillizova juve”. Këto janë komentet e mia mbi “ungjillin” nga komentari im, *Gospel According to Peter* [Ungjilli Sipas Pjetrit], Vëll. 2 (shih online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org))

“Duke qënë Marku ndoshta Ungjilli i parë i shkruar, ky është përdorimi i parë i termit *euangelion* (shih Mark 1:14,15; 8:35; 10:29; 13:10; 14:9) nga një shkrimtar i Ungjillit (përdorimi i Palit tek Gal. 2:2 dhe 1 Thes. 2:9 do të kishte qënë kronologjikisht më përpara). Fjalë për fjalë është “fjala e mirë” ose “mesazhi i mirë”. Kjo

dukshëm reflekton Isa. 61:1 dhe ndoshta Isa. 40:9 dhe 52:7. Forma e saj gramatikore mund të kuptohet si (1) mesazhi i dhënë nga Jezusi ose (2) mesazhi mbi Jezusin. Opsioni numër 2 është ndoshta kuptimi që kishte për qëllim autori. Megjithatë *Dictionary of Jesus and the Gospels* [Fjalori i Jezusit dhe Ungjijve], i publikuar nga IVP thotë “Forma gjinore (‘e’) është ndoshta edhe subjektive edhe objektive: Jezusi shpall ungjillin dhe ai [ungjilli] shpall historinë e tij” (fq. 285). *Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik i Xheromë] thotë “Përdorimi i Markut i fjalës ‘ungjill’ është i ngjashëm me atë të Palit ku mund të nënkuptojë ose një veprim shpalljeje ose përmbajtjen e asaj që shpallet.”

■ **“që ju e keni marrë”** Ky term përdoret nga hebrenjtë për “kalimin e traditave” (shih 1 Kor. 15:3; 11:23; 15:3; Mark 7:4; Fil. 4:9; 1 Thes. 4:10; 2 Thes. 3:6). Pali po tejçonte atë që ai kishte marrë (dmth., ungjillin, shih 1 Kor. 15:3) nga Krishti (shih Gal. 1:12,16; Veprat e Apo. 9:1-22; 22:3-16; 26:7-18). Përpara se Pali të ishte Apostull ndaj johebrenjve, ai vetë ishte një marrës i ungjillit. Kjo është një formë treguese aktive aoriste. Edhe pse Jezusi vdiq për të gjithë mëkatin njerëzor, është e dukshme nga ky pasazh dhe nga të tjerë (shih Gjoni 1:12; 3:16; Rom. 10:9-13) që çdo person duhet ta marrë personalisht ofertën falas të shpëtimit të Perëndisë (shih 1 Kor. 15:11). Ungjilli përfshin (1) mirëpritjen e një personi; (2) besimin e të vërtetave për atë person dhe (3) jetesën e një jete që imiton atë person.

■ **“mbi të cilin ju qëndroni”** Kjo është një formë treguese aktive e tashme, e cila përcakton veprim të përmbushur në kohën e shkuar dhe që është bërë një gjendje e përhershme. Ajo flet për nevojën e qëndrueshmërisë (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:21).

#### **TEMË E VEÇANTË: QËNDROJ (*HISTËMI*) [SPECIAL TOPIC: STAND (*HISTËMI*)]**

Ky term i zakonshëm përdoret në disa kuptime teologjike në Dhjatën e Re

1. përforcoj/konsolidoj
  - a. Ligjin e Dhjatës së Vjetër, Rom. 3:31
  - b. Drejtësinë e dikujt, Rom. 10:3
  - c. Besëlidhjen e Re, Heb. 10:9
  - d. Një porosi, II Kor. 13:1
  - e. Të vërtetën e Perëndisë, II Tim. 2:19
2. rezistoj shpirtërisht
  - a. ndaj djallit, Efe. 6:11
  - b. në ditën e gjykimit, Zbu. 6:17
3. rezistoj duke qëndruar i patundur
  - a. metaforë ushtarake, Efe. 6:14
  - b. metaforë civile, Rom. 14:4
4. një pozicion në të vërtetën, Gjoni 8:44
5. një pozicion në hir
  - a. Rom. 5:2
  - b. I Kor. 15:1
  - c. I Pjet. 5:12
6. një pozicion në besim
  - a. Rom. 11:20
  - b. I Kor. 7:37
  - c. I Kor. 15:1
  - d. II Kor. 1:24
7. një pozicion arrogance, I Kor. 10:12

Ky term shpreh edhe hirin dhe mëshirën të bazuar në besëlidhjen e një Perëndie sovran, edhe faktin që besimtarët duhet t’i përgjigjen atij (hirit) dhe të mbahen pas tij me anë të besimit! Të dyja janë të vërteta biblike. Ato duhet të mbahen së bashku! Shih Temën e Veçantë: Besëlidhja / Special Topic: Covenant dhe Temën e Veçantë: Paradoks në Shkrime / Special Topic: Paradox in Scripture

**15:2 “ju jeni shpëtuar”** Kjo është forma treguese pasive e tashme, “të jesh i shpëtuar (shih 1 Kor. 1:18; 2 Kor. 2:15; 1 Pet. 3:21; 4:18). Shpëtimi është një proces drejt ngjashmërisë me Krishtin.

Shih TEMË E VEÇANTË: KOHË FOLJESH NË GREQISHT TË PËRDORURA PËR SHPËTIMIN [SPECIAL TOPIC: SALVATION (GREEK VERB TENSES)] tek 1 Kor. 3:15

▣ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila nënkupton se ata do të “mbaheshin fort” tek e vërteta e ungjillit, që ai iu predikoi atyre, por kjo shton një shënim të kontigjencës me një “*ei*” të dytë (dmth., vetëm nëse). Kjo duket se është paralele me Shëmbëlltoren e Jezusit të Tokës (shih Mat. 13) dhe diskutimit të Gjonit tek 1 Gjonit 2:19 të atyre që ishin në marrëdhënie por u larguan.

Kishte nga ato grupime në Korint, të cilët me veprimet, qëndrimet dhe teologjinë e tyre tregonin se ata kurrë nuk kishin qënë besimtarë! Ata refuzuan (1) ungjillin e Palit; (2) autoritetin apostololik të Palit dhe (3) e shkruanë ungjillin në kulturën romake, gjatë të cilit kultura u bë dominuese! Krishtërimi kulturor është gjithmonë i dobët dhe ndonjëherë aspak i krishterë!

Megjithatë, ju lutem, vini re se kontekstualisht Pali po pranon sigurinë që ai ka se besimtarët korintas janë besimtarë të vërtetë.

- a. Koha aoriste, 1 Kor. 15:1, “keni marrë”
- b. Koha e përkryer, 1 Kor. 15:1, “qëndroni”
- c. Fjalja kushtore e rendit të parë, 1 Kor. 15:2, “nëse do ta mbani”

▣ **“veç nëse besuat kot”** “Nëse ju do ta mbani... kot.” Fjala “kot” (*eikē*) do të thotë “për asnjë qëllim” (shih Gal. 3:4; 4:11). Është e dukshme nga Mat. 13:1-9,18-23, dhe Gjoni 8:31-59 që shpalljet e rreme janë një realitet i jetës fetare (shih TEMËN E VEÇANTË: FEMOHIMI (APHISTËMI) [SPECIAL TOPIC: APOSTASY (APHISTËMI)] tek 1 Kor. 6:9). Kjo frazë formon pjesën e katërt në një seri e cila përshkruan elementët e nevojshëm të jetës së krishterë: pranimi, pozicioni, progresi dhe vazhdimësia. Shpëtimi është një proces i cili përfshin pendesën, besimin, bindjen (si fillimisht ashtu edhe në vazhdimësi), sikurse dhe qëndrueshmërinë. Shih TEMË E VEÇANTË: NEVOJA PËR QËNDRESË / Special Topic: The Need to Persevere tek 1 Kor. 1:21.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:3-11

<sup>3</sup> Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve, <sup>4</sup> se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve, <sup>5</sup> edhe se iu shfaq Kefës dhe pastaj të dymbëdhjetëve. <sup>6</sup> Pastaj iu shfaq një herë të vetme më shumë se pesëqind vëllezërve, prej të cilëve më të shumtët rrojnë edhe sot, kurse disa kanë rënë në gjumë. <sup>7</sup> Më pas iu shfaq Jakobit dhe pastaj të gjithë apostujve. <sup>8</sup> Më së fundi m’u shfaq edhe mua, si në dështimit. <sup>9</sup> Sepse unë jam më i vogli i apostujve dhe as nuk jam i denjë të quhem apostull, sepse e kam përndjekur kishën e Perëndisë. <sup>10</sup> Por me hirin e Perëndisë jam ai që jam; dhe hiri i tij ndaj meje nuk qe i kotë, madje jam munduar më shumë se gjithë të tjerët, jo unë, por hiri i Perëndisë që është me mua. <sup>11</sup> Pra, si unë, ashtu edhe ata kështu predikojmë dhe ju kështu besuat.

**15:3 “ju kam transmetuar”** Kjo i referohet (1) dëshmisë së krishterë që Pali mori (dmth., nga Stefani, Veprat e Apo. 7; nga Anania, Veprat e Apo. 9:10-18; dhe nga të krishterët e persekutuar, Veprat e Apo. 9:1-2; 1 Kor. 15:9) ose (2) zbulesa e drejtpërdrejtë nga Zoti (shih 1 Kor. 11:23; Acts 9:1-22; 22:3-16; 26:9-18; Gal. 1:12). Pali transmetoi të vërtetat e ungjillit që ai kishte marrë. Pali nuk ishte një inovator, por një dëshmitar besnik i cili zbatoi të vërtetat e ungjillit në situata të reja johebraike.

▣ **“para së gjithash”** Kjo është e vetmja përmbledhje apostolike e ungjillit. Përmbledhjet tona moderne të ungjillit, sikurse Rruga Romake (dmth., 3:23; 5:8; 6:23; 10:9-13), janë përzgjedhje moderne të marra nga shkrime më të mëdha të frymëzuara. Pali dëshiron t’iu rikujtojë atyre thelbin e ungjillit (shih TEMËN E VEÇANTË: *KERYGMA* / Special Topic: The *Kerygma* tek 1 Kor. 15:1).

Përmbledhja e Palit e ungjillit:

1. Krishti vdiq për mëkatet tona
2. Krishti vërtet vdiq dhe u varros

3. Krishti u ringjall prej së vdekurish
4. Ne i dimë këto të vërteta për shkak se Ai iu shfaq shumë njerëzve gjatë shumë ditëve

▣ **“Krishti vdiq për mëkatet tona”** Termi “Krishti” është përkthimi grek i termit hebraik Mesia, i cili do të thoshte një i vajosur. Ky term, pa format e zakonshme “Jezus Krishti” ose “Zoti Jezus Krisht” ose “Krishti Jezus” tregon origjinën primitive të traditës së Palit, ku Jezusi pohoet si Mesia hebraik, I premtuari (shih TEMË E VEÇANTË: MESIA / SPECIAL TOPIC: MESSIAH tek 1 Kor. 1:23). Me gjithë mundësinë, Pali e mori këtë nga Anania dhe nga besimtarët e tjerë në Damask pas konvertimit të tij.

Kjo është një formë treguese aoriste aktive. “Jezusi pagoi një detyrim për të cilin Ai nuk detyrohej dhe ne kishim një detyrim që nuk mund ta paguanim” (shih Gal. 3:13; 1 Gjoni 4:10).

Parashtesa “për” (*hyper*) do të thoshte “për llogari të”; ajo shpesh përdorej në mënyrë sinonime me parashtesa të tjera greke, *anti*, që do të thoshte “në vend të”. Kjo ishte një referencë ndaj shpagimit zëvendësues dhe të dërguar (shih Isa. 53; Mark 10:45).

Vdekja e Krishtit ishte një temë e përsëritur në shkrimet e Palit. Ai përdori disa terma dhe fraza të ndryshme për t’iu referuar vdekjes zëvendësuese të Jezusit:

1. Gjaku (shih 1 Kor. 11:25,27; Rom. 3:25; 5:9; Efe. 1:7; 2:13; Kol. 1:20)
2. Dha Vetën e Tij (shih Efe. 5:2,25)
3. Çlirroi (shih Rom. 4:25; 8:32)
4. Sakrificë (shih 1 Kor. 5:7)
5. Vdiq (shih Rom. 5:6; 8:34; 14:9,15; 1 Kor. 8:11; 15:3; 2 Kor. 5:15; Gal. 5:21; 1 Thes. 4:14; 5:10)
6. Kryqi (shih 1 Kor. 1:17-18; Gal. 5:11; 6:12-14; Efe. 2:16; Fil. 2:8; Kol. 1:20; 2:14)
7. Kryqëzimi (shih 1 Kor. 1:23; 2:2; 2 Kor. 13:4; Gal. 3:1)

▣ **“sipas Shkrimeve”** Kjo i referohet Dhjatës së Vjetër sepse aspak nga Dhjata e Re nuk ishte shkruar në këtë kohë, përveçse ndoshta Galatasve dhe Thesalonikasve. Përdorimi i kësaj fraze tek 1 Kor. 15:3-4 pohon pjesën profetike (shih Luke 24:27) dhe planin shpengues të paracaktuar të Perëndisë (shih Veprat e Apo. 2:23; 3:18; 4:28; 13:29, shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:21).

Megjithatë, është e mundur që Shkrimet këtu t’i referohet njërit prej Ungjijve (ose fjalëve të Jezusit që qarkullonin të ndara nga Ungjijt sinoptikë të mëvonshëm). Është e pasigurtë koha në të cilën ata u shkruan, dhe kur ata po qarkullonin midis kishave të hershme. Nëse fraza i referohet një regjistrimi të Ungjillit, atëherë “në ditën e tretë” mund t’i referohet Jezusit që u ringjall të dielën, ditën e parë të javës dhe sipas llogaritjeve hebraike, tre ditë.

**15:4 “u varros”** Ai vërtetë vdiq!

▣ **“të tretën ditë”** Nuk ka asnjë vërtetim të qartë të Dhjatës së Vjetër ndaj “të tretën ditë”. Megjithatë, ishte pjesë e *kerygma* (shih Mark 10:34; Luka 24:46; Veprat e Apo. 10:40, shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:1). Disa e shohin si referencë ndaj Jonës 1:17 ose Ps. 16:10, megjithatë, komenti i Jezusit (shih Mat. 12:40) duket se e lidh atë me përjetimin e Jonës brenda peshkut të madh.

▣ **“u ringjall”** Kjo është një formë treguese pasive e përkryer, e përdorur kaq shpesh në këtë kapitull (shih 1 Kor. 15:4,12,13,14,16,17,20). Kjo kohë folje greke flet për statusin e vazhdueshëm të Krishtit si “i Ringjalluri” dhe forma pasive tregon për veprimet e Perëndisë At në ringjalljen e Tij prej së vdekurish. Kjo vërteton aprovimin e Atit të jetës, mësimëve dhe vdekjes sakrificuese të Jezusit. Dhjata e Re shpesh i atribuon veprat shpenguese të tre personave të Perëndisë:

1. Perëndia At e ringjalli Jezusin (shih Veprat e Apo. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10)
2. Perëndia Bir e ringjalli Vetveten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë e ringjalli Jezusin (shih Rom. 8:11).

## TEMË E VEÇANTË: RINGJALLJA (SPECIAL TOPIC: THE RESURRECTION)

Në Bibël, kthimi nga vdekja ka tre kuptime:

- A. Ata që nuk vdiqën, por shkuan te Perëndia (pra, Eunuku, shih Zan. 5:24; Elia, shih 2 Mbre. 2:11), që quhet “u mor lart”.
- B. Nga fuqia e Perëndisë, disa kthehen nga pragu i vdekjes dhe shërohen fizikisht. Ky quhet “reanimacion”. Në të ardhmen, këta njerëz do të vdesin.
- C. Ka patur vetëm një ringjallje (pra, Jezusi). Ai vdiq, por u ringjall nga vdekja (pra, *hades* hadesi) dhe iu dha një trup i ri, i përgatitur për jetën e përjetshme me Perëndinë. Ai është fryti i parë i të vdekurve (shih 1 Kor. 15:20, 23; “i parëlinduri i të vdekurve”, shih Kol. 1:15, 17). Për shkak të Tij, besimtarët do të ringjallen në Ardhjen e Dytë (shih Psa. 49:15; 73:24; Isa. 26:19; Dan. 12:2; Mat. 22:31-32; Marku 12:26-27; Gjoni 5:25,28-29; 6:39-40,44,54; Rom. 8:11; 1 Kor. 15; 1 Thes. 4:13-18; 1 Gjonit 3:2).

Prova për ringjalljen:

- A. Pesëdhjetë (50) ditë më vonë, në ditën e Rrëshajëve, ringjallja u bë pika qendrore e predikimit të Pjetrit (shih Veprat e Apo. 2). Mijëra vetë që jetonin në atë zonë, ku ndodhi kjo gjë, besuan!
- B. Jetët e dishepujve ndryshuan rrënjësisht, nga dekurajimi (nuk e prisnin ringjalljen e Jezusit) te guximi, madje dhe martirizimi.
- C. Pali rendit shumë besimtarët në 1 Kor. 15:5-8, përfshi dhe veten (shih Veprat e Apo. 9).

Vlera e ringjalljes:

- A. Tregon se Jezusi është vërtetë Ai që tha (shih Mat. 12:38-40; parashikimi i vdekjes dhe ringjalljes së tij)
- B. Perëndia miratoi jetën, mësimet dhe vdekjen zëvendësuese të Jezusit! (shih Rom. 4:25)
- C. Na tregon premtimin për gjithë të krishterët (pra, trupin e ringjalljes, shih 1 Kor. 15)

Thënie të Jezusit se do të ringjallej nga vdekja:

- A. Mat. 12:38-40; 16:21; 17:9,22, 23; 20:18-19; 26:32; 27:63
- B. Marku 8:31; 9:1-10,31; 14:28,58
- C. Luka 9:22-27
- D. Gjoni 2:19-22; 12:34; kapitujt 14-16

Pjetri dhe Pali pohojnë se Psalmi 16 bën fjalë për Jezus Mesinë

- A. Pjetri, Veprat e Apo. 2:24-32
- B. Pali, Veprat e Apo. 13:32-37

Për studim të mëtejshëm:

- A. *Evidence that Demands a Verdict*, nga Josh McDowell
- B. *Who Moved the Stone?* Nga Frank Morrison
- C. *The Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible*, “Resurrection”, “Resurrection of Jesus Christ”

**15:5 “iu shfaq”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: SHFAQJET E JEZUSIT PAS RINGJALLJES (SPECIAL TOPIC: JESUS' POST RESURRECTION APPEARANCES)**

Jezusi iu shfaq shumë njerëzve për t’u vërtetuar ringjalljen e Tij.

1. grave te varri, Mat. 28:9
2. njëmbëdhjetë dishepujve në mbledhjen e caktuar në Galile, Mat. 28:16
3. Simonit, Luka 24:34
4. dy burrave në rrugën për në Emaus, Luka 24:15
5. dishepujve në dhomën e sipërme, Luka 24:36



6. Maria Magdalenës, Gjoni 20:15
7. dhjetë dishepujve, Gjoni 20:20
8. njëmbëdhjetë dishepujve në dhomën e sipërme, Gjoni 20:26
9. shtatë dishepujve në Detin e Galilesë, Gjoni 21:1
10. Kefës (Pjetrit), 1 Kor. 15:5
11. Të dymbëdhjetëve (apostujve), 1 Kor. 15:5
12. 500 vëllezërve, 1 Kor. 15:6, e kombinuar me Mat. 28:16-17
13. Jakobit (familjes së Tij tokësore), 1 Kor. 15:7
14. të gjithë apostujve, 1 Kor. 15:7
15. Palit, 1 Kor. 15:8 (Veprat e Apo. 9)

Qartazi, disa prej këtyre rasteve bëjnë fjalë për të njëjtën shfaqje. Jezusi donte që ta dinin me siguri se ishte gjallë!

▣ **“Kefës”** Pali zakonisht e thërret atë me këtë emër në letrat e tij ndaj korintasve (shih 1 Kor. 1:12; 3:22; 9:5; 15:50), por tek Galatasit ai e thërret atë si Kefa (shih 1 Kor. 2:9) ashtu edhe Pjetër (shih 1 Kor. 1:18; 2:7,8,11,14). Pali kurrë nuk e thërret atë Simon.

Është e mahnitshme se personi i parë (pas grave tek varri) të cilit i shfaqet Krishti i ringjallur është po ai person që e pati mohuar Atë tri herë, po ai që dha predikimin e parë të kishës në Rrëshaja. Jezusi e dallon atë duke i vendosur një theks të veçantë tek Marku 16:7, ku apostujve iu tha që të takoheshin me Jezusin në Galile. Kjo me siguri tregon dashurinë, mirëkuptimin, faljen dhe fuqitë restauruese të Krishtit. Një pjesë e madhe e Gjonit 21 përshkruan restaurimin e Pjetrit në drejtim.

▣ **“të dymbëdhjetëve”** Familja perëndimore e dorëshkrimeve greke (dmth., MS D [Codex Bezae]), sikurse Vulgate, kanë “njëmbëdhjetë”. Termi “të dymbëdhjetët” u përdor si një term teknik për grup apostolik. Pali kurrë nuk e përdor këtë fjalë në ndonjë nga shkrimet e tij të tjera. Disa mendojnë se kjo nënkupton se 1 Kor. 15:3-7 mund të ketë qenë një përmbledhje katekizmale e kishës së hershme.

#### **TEMË E VEÇANTË: NUMRI DYMBËDHJETË (SPECIAL TOPIC: THE NUMBER TWELVE)**

Dymbëdhjeta ka qenë gjithmonë numër simbolik organizimi (shih Temën e Veçantë: Numra Simbolikë në Shkrime / Special Topic: Symbolic Numbers in Scripture).

##### A. Jashtë Biblës

1. dymbëdhjetë shenjat e Zodiakut
2. dymbëdhjetë muajt e vitit

##### B. Në Dhjatën e Vjetër (BDB 1040, plus 797)

1. bijtë e Jakobit (fiset judaike)
2. reflektohet në
  - a. dymbëdhjetë shtyllat e altarit, te Eks. 24:4
  - b. dymbëdhjetë gurët e çmuar në gjoksoren e kryepriftit (që nënkupton dymbëdhjetë fiset) në Eks. 28:21
  - c. dymbëdhjetë çyrekët e bukës në vendin e shenjtë të tabernakullit, Lev. 24:5
  - d. dymbëdhjetë spiunët e dërguar në Kanaan, në Num. 13 (një nga secili fis)
  - e. dymbëdhjetë shufrat (flamujt fisnorë) në rebelimin e Korës, Num. 17:2
  - f. dymbëdhjetë gurët e Jozueut, Joz. 4:3, 9, 20
  - g. dymbëdhjetë ndarjet administrative në administrimin e Solomonit, 1 Mbret. 4:7
  - h. dymbëdhjetë gurët e altarit të Elias për YHWH-në, 1 Mbret. 18:31

##### C. Në Dhjatën e Re

1. dymbëdhjetë apostujt e zgjedhur
2. dymbëdhjetë shportat me bukë (një për secilin apostull) në Mat. 14:20

3. dymbëdhjetë frone, ku do të ulen dishepujt e Dhjatës së Re (që i referohet 12 fiseve të Izraelit), në Mat. 19:28
4. dymbëdhjetë legjionet me engjëj për të shpëtuar Jezusin, Mat. 26:53
5. simbolizmi i Zbulesës
  - a. 24 pleqtë në 24 frone, 4:4
  - b. 144,000 (12x12,000), në 7:4; 14:1, 3
  - c. dymbëdhjetë yje në kurorën e gruas, 12:1
  - d. dymbëdhjetë porta, dymbëdhjetë engjëj që reflektojnë dymbëdhjetë fiset në 21:12
  - e. dymbëdhjetë gurët e themelit të Jerusalemit të ri dhe, mbi ta, emrat e dymbëdhjetë apostujve, 21:14
  - f. dymbëdhjetë mijë stade, te 21:16 (madhësia e qytetit të ri, Jerusalemit të Ri)
  - g. muri është 144 kubitë, te 21:17
  - h. dymbëdhjetë portat me perla, te 21:21
  - i. pemët në Jerusalemin e ri me dymbëdhjetë lloje frutash (një për çdo muaj), 22:2

**15:6 “Ai iu shfaq më shumë se pesëqind vëllezërve”** Kjo mund t’i referohet Mat. 28:16-20, sidomos 1 Kor. 15:17, i cili tregon se Urdhërimi i Madh iu dha të gjithë kishës, jo vetëm disa drejtuesve. Theksi i Palit tek 1 Kor. 15:6 është realiteti historik i ringjalljes. Nëse dikush nuk besonte, kishte një numër shumë të lartë dëshmitarësh okularë për të dëshmuar.

▣ **“deri tani”<sup>38</sup>** Jezusi u kryqëzua në mes të viteve 30-të dhe letra e parë e Korintasve u shkruajt në mes të viteve 50-të, kështuqë në këtë hapësirë kohore prej njëzetë vitesh shumë nga ata që ishin prekur personalisht nga fjalët dhe veprat e Jezusit ishin ende gjallë dhe duke dëshmuar!

▣ **“kanë rënë në gjumë”** Pali vijon me përdorimin e Jezusit (shih Mat. 27:52; Gjoni 11:11,13) dhe përdorimin e Dhjatës së Vjetër (shih Dan. 12:2) për gjumin si eufemizëm për vdekjen.

**15:7 “Jakobit”** Kjo i referohet vëllait të Zotit i cili nuk besonte tek Ai deri pas ringjalljes (shih Mark 3:21; Gjoni 7:5). E gjithë familja e tij ishte e pranishme në Dhomën e Epërme (shih Veprat e Apo. 1:14). Ky Jakob identifikohet si gjysmë-vëllai i Zotit (shih Mat. 13:55; Mark 6:3), në mënyrë që ta dallonin atë nga Jakobi apostulli, pjesë e rrethit të brendshëm, i cili u vra shumë herët (shih Veprat e Apostujve 12). Për disa breza, Kisha në Jeruzalem kishte një lidhje fizike të Jezusit si drejtues i saj. Disa pasazhe biblike (shih Veprat e Apo. 12:17; 15:13; 21:18; 1 Kor. 15:7; dhe Jakobi 1:1) tregojnë se Jakobi ishte një drejtues mjaft i rëndësishëm në Kishën në Jeruzalem. Pali ishte i vetmi që përmend shfaqjen e tij. Kjo tregon se sa shumë detaje janë hequr në Dhjatën e Re për mësimet dhe veprat e Jezusit. Ne kemi gjithçka që na nevojitet për t’i besuar Atij dhe për ta ndjekur Atë, por jo mjaftueshëm për një histori të plotë të jetës së Tij.

#### **TEMË E VEÇANTË: JAKOBI, GJYSMË-VËLLAI I JEZUSIT (SPECIAL TOPIC: JAMES, THE HALF-BROTHER OF JESUS)**

- A. Ai quhej “Jakobi i Drejti” dhe më pas me pseudonimin “gjunjët e devesë” sepse ai lutej vazhdimisht në gjunjë (nga Hegesippus, cituar nga Eusebiusin *Hist. Eccl.* 2.23-24; 4-18).
- B. Jakobi nuk ishte një besimtar deri pas ringjalljes (shih Mark 3:21; Gjoni 7:5). Jezusi iu shfaq atij personalisht pas ringjalljes (shih 1 Kor. 15:7).
- C. Ai ishte i pranishëm në dhomën e epërme me dishepujt (shih Veprat e Apo. 1:14) dhe ndoshta ishte gjithashtu atje kur Fryma erdhi në Rrëshaja.
- D. Ai ishte i martuar (shih 1 Kor. 9:5).
- E. Pali i referohet atij si një shtyllë e kishës së Jeruzalemit (ndoshta një apostull shih Gal. 1:19; shih

<sup>38</sup> Versioni në shqip është “edhe sot”. (shënim i përkthyesit)

Temën e Veçantë: Dërgoj [*apostellō*] / Special Topic: Send [*apostellō*] por nuk ishte një nga të Dymbëdhjetët (shih Gal. 2:9; Veprat e Apo. 12:17; 15:13 e në vazhdim; 21:18).

- F. Në *Antiquities of the Jews [Antikitete të Hebrenjve]*, 20.9.1, Josephus tha se ai u vra me gurë në vitin 62 pas lindjes së Krishtit sipas urdhrave të Saducenjve të Sanhedrinit, ndërkohë që një tjetër traditë (shkrimtarët e shekullit të dytë, Klementi i Aleksandrisë ose Hegesippus) thotë se atë e hodhën nga muri i Tempullit.
- G. Për shumë breza pas vdekjes së Jezusit, një i afërm i Jezusit u caktua drejtues i kishës në Jeruzalem.
- H. Ai ishte autori i librit të Dhjatës së Re “Jakobi” dhe vëllai i autorit të librit të Dhjatës së Re “Juda” (shih Juda v.1).

▣ **“të gjithë apostujve”** Duke qënë se të Dymbëdhjetët përmenden tek 1 Kor. 15:5, kjo duket se i referohet një përdorimi më të gjerë të termit. Jakobi duket se është një “apostull” në të njëjtin kuptim sikurse Barnaba (shih Veprat e Apo. 14:4, 14); Androniku dhe Junias (ose Junia, shih Rom. 16:7); Apolli (shih 2 Kor. 4:9); Epafroditi (Fil. 2:25); ose Silvanasi dhe Timoteu (shih 1 Thes. 2:6; Veprat e Apo. 18:5).

Është e mundur që të argumentohet se Kefa përmendet veçmas nga të Dymbëdhjetët, kështuqë “të gjithë Apostujve” mund t’i referohet gjithashtu të Dymbëdhjetëve.

### 15:8

NASB, NRSV **“si dikujt që u lind jo në kohën e duhur”**

NKJV **“si dikujt të lindur si në dështim”**

TEV **“edhe pse unë jam si dikush lindja e të cilit nuk ishte normale”**

NJB **“si të isha një fëmijë i lindur në mënyrë anormale”**

Këto përkthime në anglisht tregojnë kuptimin e gjerë të këtij termi të rrallë. Ai përdoret vetëm tre herë në Septuagintë (shih Num. 12:12; Job 3:16; dhe Pred. 6:3) për një dështim. Termi nënkupton një lindje të hershme, jo në kohë. Megjithatë, në këtë kontekst, Pali duket se po përshkruan shtimin e tij të vontë tek grupi apostolik (dmth., konvertimi në rrugën për në Damask, shih Veprat e Apostujve 9).

Është sigurisht e mundur që kjo ishte një nga vërejtjet poshtëruese të një ose më shumë grupimeve në Korint të cilët refuzonin autoritetin e Palit (dmth., ai nuk ishte një apostull i zakonit). Pali pranon hirin e Krishtit teksa iu shfaq atij në mes të persekutimit që ai i bënte Kishës (shih 1 Kor. 15:10; Gal. 1:23). Megjithatë, ai është prapësepse në listën e zgjedhur të atyre të cilëve Krishti iu shfaq pas ringjalljes së Tij. Pali mund edhe të jetë duke pranuar se ai është i vetmi ndaj të cilit iu shfaq (shih Gal. 1:15-16) Krishti i përlëvdur (dmth., i lartësuar). Gjithashtu, është e mundur që termi të kishte një kuptim të dytë të “përbindësh”, i cili do t’i referohej sulmeve të vazhdueshme dhe vicioze të Palit ndaj besimtarëve të pafajshëm (dmth., Veprat e Apo. 9:1-2, shih Jerome Biblical Commentary [Komentari Biblik i Xherom], fq. 273). Pali mund ta ketë sajuar vetë këtë fjalë duke qënë se ajo përshkruante teprinë e tij në traditën hebraike përpara konvertimit të tij.

**15:9 “më i vogli i apostujve”** Pali ishte kaq i përlurur nga hiri i Perëndisë edhe në mes të persekutimit të tij ndaj kishës së Jezusit. Ai shpesh përdor fraza si kjo për të përshkruar vetveten (shih 2 Kor. 12:11; Efe. 3:8; 1 Tim. 1:15).

▣ **“sepse e kam përndjekur kishën e Perëndisë”** (shih Veprat e Apo. 9:1,13,21; Veprat e Apo. 22:4,19; Veprat e Apo. 26:10-11; Gal. 1:13,23; Fil. 3:6; 1 Tim. 1:13).

**15:10 “me hirin e Perëndisë jam ai që jam”** “Hiri” vendoset për theks (shih Rom. 12:3; Efe. 2:89). Të gjithë besimtarët janë ata të cilët ata janë me anë të hirit të Perëndisë, por vini re ekuilibrin e nevojshëm mbi veprimin e qëllimshëm njerëzor (shih Fil. 2:12-13).

▣ **“nuk qe i kotë”** Kjo është një fjalë tjetër nga ajo e përdorur tek 1 Kor. 15:2. Në fakt, Pali përdor tre terma të ndryshëm të përkthyer “kot” ose “bosh” në këtë kapitull.

1. *eikē*, 1 Kor. 15:2

2. *kenos*, 1 Kor. 15:10,14,48; 2 Kor. 6:1
3. *mataios*, 1 Kor. 15:17; 1 Kor. 3:20

**Ajo që Pali dëshiron të thotë është se hiri i Perëndisë u vërtetua që ishte i frytshëm në shërbesën e Palit, për të cilën vetë kisha korintase ishte një provë dhe rezultat.**

▣ **“madje jam munduar më shumë se gjithë të tjerët”** Konteksti dikton se kjo i referohet apostujve të tjerë. Pali krahason veten e tij me apostujt e tjerë tek Galatasit për shkak se autoriteti i tij apostolik po vihej në diskutim. Ka mundësi që një ose më shumë nga grupimet po bënte të njëjtën gjë në Korint. Pali nuk kishte pasur zënkë me të Dymbëdhjetët. Ai thjesht pranon qartazi thirrjen dhe autoritetin e tij!

**Shih Temën e Veçantë mbi “edhe më tepër” tek 2 Kor. 2:7.**

▣ **“jo unë, por hiri i Perëndisë që është me mua”** Gjendet një ekuilibër në teologjinë e Palit midis thirrjes, dhuntisë dhe shërbesës të lidhur me sovranitetin e Perëndisë. Gjithmonë ka një ekuilibër mbi bazën e besëlidhjes midis këtyre dy pikëpamjeve të frytshmerisë së dikujt. Pali pranon se ai punoi më fortë se sa apostujtë e tjerë, por ai gjithashtu e dinte se Perëndia ishte burimi, jo ai vetë. Po i njëjti ekuilibër shihet midis Gjonit 15:5 dhe Fil. 4:13, ose Fil. 2:12-13.

**15:11** Pali pranon fuqishëm se ungjilli që ai mori dhe predikoi është po i njëjti që predikonin apostujt fillestarë. Vetë fakti që ai e bën këtë shpallje tregon se çfarë kundërshtie po haste ai në Korint. Disa po e mohonin autoritetin e tij apostolik dhe, madje ndoshta, përmbajtjen e ungjillit në fjalët e tij.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:12-19**

<sup>12</sup> Por, në qoftë se predikohet se Krishti u ringjall prej së vdekurish, si atëherë disa nga ju thonë se nuk ka ringjallje të të vdekurve? <sup>13</sup> Në qoftë se nuk ka ringjallje të të vdekurve, as Krishti nuk u ringjall. <sup>14</sup> Por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, predikimi ynë është i kotë dhe i kotë është edhe besimi juaj. <sup>15</sup> Atëherë edhe ne do të ishim dëshmitarë të rremë të Perëndisë, sepse dëshmuam për Perëndinë, se ai ringjalli Krishtin, të cilin ai nuk e paska ringjallur, po të jetë se me të vërtetë të vdekurit nuk ringjallen. <sup>16</sup> Në qoftë se të vdekurit nuk ringjallen, as Krishti nuk është ringjallur; <sup>17</sup> por në qoftë se Krishti nuk është ringjallur, i kotë është besimi juaj; ju jeni ende në mëkatet tuaja, <sup>18</sup> edhe ata që fjetën në Krishtin janë të humbur. <sup>19</sup> Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve.

**15:12 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila nënkupton se Krishti po predikohej (shih 1 Kor. 15:11).

▣ **“si atëherë disa nga ju thonë se nuk ka ringjallje të të vdekurve”** Burimi i këtij mohimi të ringjalljes ndoshta e kishte origjinën në filozofinë greke (dmth., gnosticizmi, shih fjalorthin), sipas të cilit mendohej se trupi fizik ishte burimi i së keqes. Tekstualisht është e pasigurtë nëse ata po mohonin ringjalljen e Krishtit apo ringjalljen e të gjithë besimtarëve. Ky nuk ishte një problem unik në kishën e hershme (shih 2 Tim. 2:18).

**15:13 “Në qoftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të parë. Ajo shpesh quhet nga gramatikët një kusht “i thjeshtë” ose “llogjik” (shih 1 Kor. 15:13,14,15,16,17,19). Dukshëm në këtë varg Pali po e përdor atë për të lartësuar argumentin e tij letrar dhe jo për të pranuar se Krishti nuk është ringjallur! Por llogjika në këto vargje pasuese është e fuqishme. Nëse Krishti nuk është ringjallur atëherë:

1. nuk ka asnjë ringjallje, 1 Kor. 15:13,16
2. predikimi ynë është i kotë, 1 Kor. 15:14
3. besimi juaj është i kotë, 1 Kor. 15:14
4. ata janë dëshmitarë të rremë, 1 Kor. 15:15
5. besimi juaj është i pavlerë, v 17
6. ju jeni ende në mëkatet tuaja, 1 Kor. 15:17
7. ata që kanë vdekur kanë ikur tashmë, 1 Kor. 15:18
8. ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve, 1 Kor. 15:19

Kjo çështje teologjike e ringjalljes së Krishtit nuk është aspak një çështje e vogël! Ose Ai është i gjallë ose krishtërimi është një gënjeshtër! Kjo është një doktrinë vendimtare!

**15:14,17 “kotë... i pavlerë”** Këto dy terma të ndryshëm nënkuptojnë bosh dhe pafrytshmëri. Pa ringjalljen, pretendimet e mesazhit të ungjillit nuk kanë asnjë efekt!

**15:19 “Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Pali po nxjerr konkluzionin se nëse Krishti nuk u ringjall, ne kemi shpresë vetëm (formë aktive perifrastike e përkryer) në këtë jetë për shkak se nuk ka një jetë të përtejme – nëse Krishti nuk është ringjallur!

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:20-28

<sup>20</sup> Por tashti Krishti u ringjall prej së vdekurish, dhe është fryti i parë i atyre që kanë fjetur. <sup>21</sup> Sepse, ashtu si *erdhi* vdekja me anë të një njeriu, kështu *erdhi* dhe ringjallja e të vdekurve me anë të një njeriu. <sup>22</sup> Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallën në Krishtin, <sup>23</sup> por secili sipas radhës së vet: Krishti, fryti i parë, pastaj ata që janë të Krishtit, në ardhjen e tij. <sup>24</sup> Pastaj do të vijë fundi, kur Ai t’ia dorëzojë mbretërinë Perëndisë Atë, pasi të ketë asgjësuar çfarëdo sundimi, çdo pushtet e fuqi. <sup>25</sup> Sepse duhet që Ai të mbretërojë, derisa t’i vërë të gjithë armiqtë e Tij nën këmbët e Veta. <sup>26</sup> Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja. <sup>27</sup> Sepse Perëndia i vuri të gjitha nën këmbët e Tij. Por, kur thotë se çdo gjë i është nënshtruar, është e qartë se përjashtohet Ai që ia ka nënshtruar çdo gjë. <sup>28</sup> Dhe kur t’i ketë nënshtruar të gjitha, atëherë Biri vetë do t’i nënshtrohet Atij që i nënshtroi të gjitha, që Perëndia të jetë gjithçka në të gjithë.

**15:20 “Por”** Çfarë kontrasti i rëndësishëm!

▣ **“Krishti u ringjall”** Ky kapitull shpesh është quajtur “Kapitulli i Ringjalljes”. Ringjallja si e Krishtit ashtu edhe e ndjekësve të Tij është një temë e përsëritur. Siguria dhe rezultatet afatgjatë të kësaj mund të shihen në foljen *egeirō*, që do të thotë të zgjosh, të ngresh:

- v. 12, forma treguese pasive e përkryer
- v. 13, forma treguese pasive e përkryer
- v. 14, forma treguese pasive e përkryer
- v. 15, forma treguese aoriste aktive (dy herë)
- v. 16, forma treguese pasive e përkryer
- v. 16, forma treguese pasive e përkryer
- v. 17, forma treguese pasive e përkryer
- v. 20, forma treguese pasive e përkryer
- v. 32, forma treguese pasive e përkryer
- v. 35, forma treguese pasive e përkryer
- v. 42, forma treguese pasive e përkryer
- v. 43, forma treguese pasive e përkryer
- v. 44, forma treguese pasive e përkryer
- v. 52, forma treguese pasive e ardhme

Vini re formën pasive të vazhdueshme. Perëndia Triun i ringjall të vdekurit. Koha e përkryer flet për ringjalljen e Jezusit në të shkuarën, e cila bëhet një gjendje aktuale. Besimtarët ndajnë realitetin e ringjalljes së Tij dhe me anë të besimit, sigurinë e ringjalljes së tyre!

▣ **“fryti i parë”** Ky ritual vjetor sakrifikimi i Dhjatës së Vjetër diskutohet tek Lev. 23:10 e në vazhdim. Frytet e para në Dhjatën e Vjetër ishin duajt e pjekur të të korrave të elbit të valvitura përpara Zotit në Tempull në ditën pas Shabatit të Lartë të Shenjtë të Javës së Pashkës, e cila do të ishte e Diela e Ringjalljes. Ata jepeshin për të treguar pronësinë e Perëndisë mbi të gjithë të mbjellat. Ky është një lloj i Dhjatës së Vjetër për premtimin e ringjalljes së të gjithë ndjekësve të Krishtit! Pali e përdor sërish këtë term tek 1 Kor. 16:15 për të përshkruar besimtarët e parë në Akai. Ai gjithashtu e përdor tek Rom. 8:23 për të përshkruar besimtarët që kanë marrë Frymën, por që presin me ankth për ringjalljen. Jezusi është i pari që u ringjall (shih Kol. 1:18), por në kohën e

caktuar të gjithë ndjekësit e Tij do të përjetojnë të njëjtën gjë. Në një kuptim frymëror ne të gjithë kemi jetën e ringjalljes (shih Efe. 2:5-6).

### TEMË E VEÇANTË: I PARËLINDURI (SPECIAL TOPIC: FIRSTBORN)

Kjo fjalë “i parëlinduri” (*prōtotokos*) përdoret në Bibël në disa kuptime të dallueshme.

1. Sfondi i saj i Dhjatës së Vjetër i referohet
  - a. i parëlinduri i përket YHWH (BDB 114, KB 131, shih Eksod. 13:2,12; 22:29; 34:19; Num. 3:13)
  - b. përparësisë së djalit të parëlindur të familjes (shih Ligji i Përt. 21:17; Ps. 89:27; Luka 2:7; Rom. 8:29; Heb. 11:28)
2. Përdorimi i saj te Kol. 1:15 flet për Jezusin si të parin e krijimit që është një aludim i mundshëm nga Dhjata e Vjetër te Fjalët e Urta 8:22-31, ose agjenti i krijimit i Perëndisë (shih Gjoni 1:3; I Kor. 8:6; Kol. 1:15-16; Heb. 1:2)
3. Përdorimi i tij te Kol. 1:15,18; I Kor. 15:20,23; Zbu. 1:5 i referohet Jezusit si i parëlinduri nga të vdekurit
4. Ai është një titull i Dhjatës së Vjetër i përdorur për Mesian (shih Ps. 89:27; Heb. 1:6; 12:23). Është një titull që kombinon disa aspekte të parësisë dhe pozicionit qendror të Jezusit.

**15:21-22** Kjo është një tipologji Adami-Krishti që do të ndiqet tek 1 Kor. 15:45-48 (shih Rom. 5:12-21; Fil. 2:6-11). Në Adamin i gjithë krijimi u prek nga mëkati (dmth., vdekja). Në Krishtin, i gjithë krijimi ka mundësinë të preket nga hiri.

Këto vargje të paqarta, së bashku me Rom. 5:18-19, kanë bërë që disa teologë të pranojnë një shpëtim eventual për të gjithë krijimin. Të tjerë e kanë parë atë si t’i referohej ringjalljes si të të shpëtuarve ashtu edhe të të humburve (shih Dan. 12:2). Në Adamin të gjithë vdesin; në Jezusin të gjithë do të ringjallen (dmth., disa për t’u shpërblyer, disa për t’u gjykuar). Mua më duket e qartë që shkrimet e Palit, të marra në kontekst, kërkojnë një përgjigje besimi të penduar për t’u shpëtuar!

**15:23-25** Disa teologë pranojnë se këto vargje konfirmojnë një koncept para-mijëvjeçar të eskatologjisë. Megjithatë, ky tekst nuk është një diskutim i mijëvjeçarit, por i ringjalljes. Vdekja u mund në varrin bosh, jo një sundim i ardhshëm i përkohshëm. Ne duhet të tregohemi të kujdesshëm me planet tona teologjike që përpiqen të shpien interpretimin e një konteksti. Pali kurrë nuk e diskuton një mijëvjeçar, edhe në diskutimin e tij të rrëmbimit (shih 1 Thes. 4:13-18) dhe as të Antikrishtit (shih 2 Thesalonikasve 2). As Jezusi nuk diskutoi kurrë një mijëvjeçar, as në diskutimet e Tij eskatologjike (shih Mat. 24; Mark 13; Luka 21). Ka disa libra të mirë që japin një përmbledhje të secilit pozicion aktual mijëvjeçari dhe që lejojnë të shohësh pikat e forta dhe të dobëta të secilit pozicion tjetër.

1. Robert G. Clouse (rishikuar), *The Meaning of the Millennium, Four Views* [Kuptimi i Mijëvjeçarit, Katër Pikëpamje]
2. C. Marvin Pate (rishikuar), *Four Views on the Book of Revelation* [Katër Pikëpamjet e Librit të Zbulesës]
3. Darrell L. Boch (rishikuar), *Three Views on the Millennium and Beyond* [Tre Pikëpamjet mbi Mijëvjeçarin dhe Më Tej]

Shih komentet e mia tek Zbulesa, kapitulli 20, online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org)

**15:23 “ardhjen e Tij”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

### TEMË E VEÇANTË: TERMA TË DHJATËS SË RE PËR KTHIMIN E KRISHTIT (SPECIAL TOPIC: NT TERMS FOR CHRIST'S RETURN)

Theksimi eskatologjik i një dite të veçantë në të ardhmen, kur njerëzit do të takojnë Jezusin (si Shpëtimtar dhe Gjykatës), përmendet me disa përcaktime.

1. “dita e Zotit tonë Jezu Krisht” (shih 1 Kor. 1:8)
2. “dita e Zotit” (shih 1 Kor. 5:5; 1 Thes. 5:2; 2 Thes. 2:2)
3. “dita e Zotit Jezus” (shih 2 Kor. 1:14, dorëshkrimi MS & ka “... Zoti Jezus” në 1 Kor. 5:5)
4. “dita e Jezu Krishtit” (shih Fil. 1:6)
5. “dita e Krishtit” (shih Fil. 1:10; 2:16)
6. “dita e Tij (Birit të Njeriut)” (shih Luka 17:24)
7. “dita kur do të zbulohet Biri i Njeriut” (shih Luka 17:30)
8. “zbulesa e Zotit tonë Jezu Krisht” (shih 1 Kor. 1:7)
9. “kur Zoti Jezus të zbulohet nga qielli” (shih 2 Thes. 1:7)
10. “në prani të Zotit Jezus, në ardhjen e tij” (shih 1 Thes. 2:19)

Ka të paktën katër mënyra sesi autorët e Dhjatës së Re i referohen kthimit të Jezusit.

1. *epiphaneia*, që nënkupton shkëlqimin vezullues që lidhet teologjikisht (ndonëse jo etimologjikisht) me “lavdinë”. Në 2 Tim. 1:10; Titit 2:11 dhe 3:4 i referohet ardhjes së parë të Jezusit (pra, mishërimit), si dhe Ardhjes së Tij të Dytë. Përdoret dhe në 2 Thes. 2:8, që përfshin të tria fjalët kryesore për Ardhjen e Dytë: 1 Tim. 6:14; 2 Tim. 4:1, 8; Titit 2:13.
2. *parousia*, që do të thotë “prani” dhe, në fillim, bënte fjalë për vizitën e mbretit. Është termi i përdorur më gjerësisht (shih Mat. 24:3,27,37,39; 1 Kor. 15:23; 1 Thes. 2:19; 3:13; 4:15; 5:23; 2 Thes. 2:1,8; Jakobi 5:7,8; 2 Pje. 1:16; 3:4,12; 1 Gjonit 2:28).
3. *apokalupsis* (ose *apocalypsis*), që do të thotë “heqje veli me qëllim zbuluese”. Është emri i librit të fundit të Dhjatës së Re (shih Luka 17:30; 1 Kor. 1:7; 2 Thes. 1:7; 1 Pje. 1:7; 4:13).
4. *phaneroō*, që do të thotë “nxjerr në dritë”, ose “zbuloj, shfaq qartazi”. Ky term përdoret shpesh në Dhjatën e Re për shumë aspekte të zbulësës së Perëndisë. Ashtu si *epiphaneia*, edhe kjo fjalë mund t’i referohet ardhjes së parë të Krishtit (shih 1 Pje. 1:20; 1 Gjonit 1:2; 3:5, 8; 4:9), ose edhe ardhjes së dytë të Tij (shih Mat. 24:30; Kol. 3:4; 1 Pje. 5:4; 1 Gjonit 2:28; 3:2).
5. Fjala shumë e përdorur për “ardhjen”, *erchomai*, përdoret ndonjëherë edhe për kthimin e Krishtit (shih Mat. 16:27-28; 23:39; 24:30; 25:31; Veprat e Apo. 1:10-11; 1 Kor. 11:26; Zbu. 1:7, 8).
6. Përdoret edhe me frazën “dita e Zotit” (shih 1 Thes. 5:2), që është titull i Dhjatës së Vjetër për ditën e bekimit (ringjalljes) dhe gjykimit të Perëndisë.

Dhjata e Re në tërësi u shkrua brenda botëkuptimit të Dhjatës së Vjetër, që pohonte

- a. një epokë e tanishme, e ligë dhe rebele
- b. një epokë e re e ardhshme drejtësie
- c. një epokë që do të vijë me anë të Frymës nëpërmjet veprës së Mesisë (të Vajosurit).

Supozimi teologjik i zbulësës përparuese është i nevojshëm për shkak se autorët e Dhjatës së Re e modifikojnë disi pritshmërinë e Izraelit. Në vend të një ardhjeje ushtarake dhe nacionaliste (izraelite) të Mesisë, ka dy ardhje. Ardhja e parë është mishërimi i hyjnisë në ngjizjen dhe lindjen e Jezusit të Nazaretit. Ai erdhi si “shërbëtor i përvuajtur” jo ushtarak, jo gjyqësor, i Isa. 53; po kështu, ai erdhi si kalorësi i përlulur mbi kërrin e një gomari (jo një kali luftime apo mushke mbretërore) i Zak. 9:9. Ardhja e parë inauguroi Epokën e Re Mesianike, mbretërinë e Perëndisë në tokë (shih Temën e Veçantë: Mbretëria e Perëndisë / Special Topic: The Kingdom of God). Në një kuptim, mbretëria është këtu, por, sigurisht, në një kuptim tjetër, është ende larg. Pikërisht ky tension midis dy ardhjeve të Mesisë (shih Temën e Veçantë: Mesia / Special Topic: Messiah), në njëfarë kuptimi, është mbivendosja e dy epokave judaike (shih Temën e Veçantë: Kjo Epokë dhe Epoka që do të Vijnë / Special Topic: This Age and the Age to Come) që ishin të paparë, ose të paktën të paqarta, në Dhjatën e Vjetër. Në të vërtetë, kjo ardhje e dyfishtë thekson përkushtimin e YHWH-së për të shpenguar gjithë njerëzimin (shih Zan. 3:15; 12:3; Eks. 19:5 dhe predikimin e profetëve, veçanërisht Isaisë dhe Jonës).

Kisha nuk po pret përmbushjen e profecisë së Dhjatës së Vjetër, sepse shumica e profecive kanë të bëjnë me ardhjen e parë (shih *How to Read the Bible For All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj], fq. 165-166). Ajo që presin besimtarët është ardhja e lavdishme e të ringjallurit Mbret mbi Mbretë

dhe Zot mbi Zotër, përmbushja e pritur historike e epokës së re të drejtësisë në tokë, ashtu si dhe në qiell (shih Mat. 6:10). Prezantimet e Dhjatës së Vjetër nuk ishin të pasakta, por të paplota (shih Temën e Veçantë: Pse Duken kaq të Ndryshme Premtimet e Besëlidhjes së Dhjatës së Vjetër nga Premtimet e Besëlidhjes së Dhjatës së Re? / Special Topic: Why Do OT Covenant Promises Seem So Different from NT Covenant Promises?). Ai do të vijë sërish, ashtu siç parathënë profetët me fuqinë dhe autoritetin e YHWH-së.

Ardhja e Dytë nuk është term biblik, por ky koncept është botëkuptimi dhe korniza e gjithë Dhjatës së Re. Perëndia do ta vërë gjithçka në vendin e vet. Bashkësia mes Perëndisë dhe njerëzimit të krijuar në shëmbëllimin e tij do të ripërtërihet. Ligësia do të gjykohej dhe shfaroset. Synimet e Perëndisë nuk do të dhe nuk mund të dështojnë!

Kisha e hershme adhuronte si në ditën e Shabatit ashtu edhe në ditën e parë të javës (dmth., e diela, dita e ringjalljes). Sinagoga i drejtohej lëvizjes së krishterë në rritje duke kërkuar që anëtarët e saj të refuzonin Jezusin si Mesia (dmth., Tetëmbëdhjetë Bekimet). Në këtë pikë (dmth., në vitin 70 pas lindjes së Krishtit) të krishterët takoheshin vetëm ditën e dielë.

**15:24 “mbretërinë”** Është e habitshme se sa shpesh ky koncept përdoret për Jezusin në Ungjijt Sinoptikë. Ai është subjekti i predikimit të Tij të parë dhe predikimit të fundit sikurse i nxjtes së pjesës më të madhe të shëmbëlltyrave. Është e habitshme që përdoret vetëm dy herë në Ungjillin e Gjonit. Është sundimi i Perëndisë në besimin e zemrave të njerëzve tani që një ditë do të konsumohet mbi të gjithë tokën (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 4:20).

Ai përdoret nga Jezusi për praninë aktuale të mbretërisë së Perëndisë në dhe përmes pranisë dhe mësimave të Tij personale (shih Mat. 3:2; 4:17; 10:7; 11:12; 12:28; Mark 1:15; Luka 9:9,11; 11:20; 21:31-32). Megjithatë, ai gjithashtu lidhet me një konsumim të ardhshëm të lavdishëm në rikthimin e Tij (shih Mat. 6:10; 16:28; 26:64). Ky është tensioni eskatologjik i “tashmë i pranishëm / por ende jo” që gjendet tek Ungjijt!

Referenca specifike ndaj “mbretërisë” është relativisht e rrallë në shkrimet e Palit.

Romakëve - 14:17

1 Korintasve - 4:20; 6:9; 15:24,50

Galatasve - 5:21

Efesianëve - 5:5

Kolosianëve - 1:13; 4:11

1 Thesalonikasve - 2:12

2 Thesalonikasve - 4:1,18

▣ **“pasi të ketë asgjësuar çfarëdo sundimi, çdo pushtet e fuqi”** Kjo i referohet fuqive engjëjlore (*eons* në mendimin gnostik) në këtë epokë të tashme të ligë (shih Rom. 8:38; Efe. 1:21; 3:10; 6:12; Kol. 1:16; 2:10,15). Ky anulim dukshëm ndodh

1. teologjikisht në kryq dhe në ringjallje
2. në kohë në rikthimin e Krishtit

Nëse kjo është e vërtetë, atëherë 1 Thes. 4:13-18 është forma paralele më e afërt në shkrimet e Palit. Vini re se pas rrëmbimit, besimtarët janë përgjithmonë me Zotin (shih 1 Thes. 4:17), që është mbretëria e përjetshme e Atit (shih Dan. 7:13-14).

Për “sundim” shih Temën e Veçantë më poshtë.

### **TEMË E VEÇANTË: ARCHĒ (SPECIAL TOPIC: ARCHĒ)**

Termi grek *archē* do të thotë “fillimi” ose “origjina” e diçkaje.

1. fillimi i rendit të krijuar (shih Gjoni 1:1; Heb. 1:10)
2. fillimi i ungjillit (shih Marku 1:1; Fil. 4:15; 2 Thes. 2:13; Heb. 2:3; 1 Gjonit 1:1)



3. dëshmitarët e parë okularë (shih Luka 1:2)
4. shenjat e fillimit (mrekullitë, shih Gjoni 2:11)
5. parimet fillestare (shih Heb. 5:12)
6. siguria fillestare, bazuar në të vërtetat e ungjillit (shih Heb. 3:14)
7. fillimi (Kol. 1:18; Zbu. 3:14)

Më vonë, u përdor për “sundimin”, ose “autoritetin”

1. për zyrtarët qeveritarë njerëzorë
  - a. Luka 12:11
  - b. Luka 20:20
  - c. Romakëve 13:3; Titi 3:1
2. për autoritetet engjëjlore
  - a. Romakëve 8:38
  - b. 1 Kor. 15:24
  - c. Efe. 1:21; 3:10; 6:12
  - d. Kol. 1:16; 2:10, 15
  - e. Juda 1:6

Këta mësues të rremë të librit të Judës përçmojnë çdo autoritet, tokësor dhe qiellor qoftë. Ata janë njerëz të shturur antinomianë. Vendosin veten dhe dëshirat e tyre përpara Perëndisë, engjëjve, autoriteteve civile dhe drejtuesve të kishave.

Për “autoritet” shih Temën e Veçantë më poshtë.

### **TEMË E VEÇANTË: AUTORITETI (*EXOUSIA*) [SPECIAL TOPIC: AUTHORITY (*EXOUSIA*)]**

- I. Përdorimi i Lukës – Është interesante të vëzhgosh përdorimin nga Luka të *exousia* (autoritet, fuqi/pushtet, ose e drejtë ligjore).
  1. Tek Luka 4:6 Satani thotë se mund t’i japë Jezusit autoritet/pushtet.
  2. Tel Luka 4:32,36 hebrenjtë u habitën se si Jezusi mësonte duke përdorur autoritetin e Tij personal.
  3. Tek Luka 9:1 Ai u dha pushtetin dhe autoritetin e Tij Apostujve të Tij.
  4. Tek Luka 10:19 Ai u dha autoritetin e Tij shtatëdhjetë misionarëve.
  5. Tek Luka 20:2,8 bëhet pyetja qendrore e autoritetit të Jezusit.
  6. Tek Luka 22:53 të keqes i është lejuar autoriteti për ta dënuar dhe vvarë Jezusin.

Megjithëse jo te Luka, hyrja e Mateut e Porosisë së Madhe (Mat. 28:18), “Mua më është dhënë i gjithë autoriteti në qiell dhe në tokë,” është një deklaratë e mrekullshme e autoritetit të Jezusit.

Jezusi pohoi se Ai kishte autoritet për shkak të

1. fjalëve që i foli Perëndia në
  - a. pagëzimin e Tij (Luka 3:21-22)
  - b. shpërfytyrimin e Tij (Luka 9:35)
2. profecia e përmbushur e Dhjatës së Vjetër
  - c. fisi i Judës (shih Zan. 49:10)
  - d. familja e Jeseut (shih II Samuel7)
  - e. lindur në Betlehem (shih Mikea 5:2)
  - f. lindur gjatë perandorisë së katërt (Romës) të Danielit 2
  - g. ndihmoi të varfrit, të verbrit, nevojtarët (Isaia)
3. Dëbimi i demonëve nga Ai zbuloi fuqinë dhe autoritetin e Tij mbi Satanin dhe mbretërinë e Tij.

4. Fakti që Ai ringjalli shumë nga vdekja tregoi fuqinë e Tij mbi jetën fizike dhe vdekjen.
5. Të gjitha mrekullitë e Tij zbulojnë fuqinë dhe autoritetin e Tij mbi të përkohshmen, hapësinoren dhe fiziken.
  - h. natyra
  - i. ushqyerjet
  - j. shërimet
  - k. të kuptuarit e mendimeve
  - l. kapja e peshqve

## II. Përdorimi i Palit i “autoritetit” të lidhur me gratë e krishtera

Çështja e autoritetit gjithashtu diskutohet tek 1 Korintasve 11 në lidhje me mbulimin e kokës së një gruaje. Më poshtë janë shënimet e mia nga ky pasazh.

### **11:10 “Prandaj gruaja, për shkak të engjëjve, duhet të ketë një shenjë pushteti mbi kryet”**

Përdorimi i autoritetit tek 1 Korintasve mund të kuptohet në disa mënyra. Çështja kyçe (në këtë konteskt) është se çfarë përfaqëson “autoriteti” (*exousia*).

Së pari, duhet të vihet re se *exousia* shpesh lidhet me *dunamis* (fuqi). Otto Betz ka një artikull interesant mbi *exousia* tek *New International Dictionary of New Testament Theology* [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re], vol. 2, fq. 606-611. Më poshtë gjenden pesë shembuj.

“Është karakteristikë e Dhjatës së Re që si *exousia* ashtu edhe *dunamis* të lidhen me veprën e Krishtit, rregulli i ri si pasojë e strukturave fuqi dhe besimtarëve të fuqizuar” (fq. 609).

“*Exousia* e besimtarëve. Pushteti i një besimtari të krishterë gjendet në sundimin e Krishtit dhe në çarmatimin e të gjitha fuqive. Ai nënkupton si liri ashtu edhe shërbim” (fq. 611).

“Ai është i lirë të bëjë çdo gjë (1 Kor. 6:12; 10:23 *exestin*); ky është një pohim, i cili u bë fillimisht nga entuziastët sektarë në Korint, i marrë më pas nga Pali i cili pranoi se është e saktë” (fq. 611)

“Megjithatë, në praktikë, kjo liri e pakufizuar teorikisht sundohet nga konsiderata e asaj që është ndihmëse për të krishterët e tjerë individualë dhe për kongregacionin në tërësi nën dritën e faktit që shpengimi i plotë ende nuk ka ardhur (1 Kor. 6:12; 10:23)” (fq. 611).

“Gjithçka më lejohet [*exestin*],’ por jo gjithçka është dobishme; ‘gjithçka më lejohet [*exestin*],’ por jo çdo gjë ndërton. Askush të mos kërkojë interesin e vet, por atë të tjetrit. (1 Kor. 10:23 e në vazhdim). Citimet brenda këtyre thonjzave (‘’) janë ndoshta sloganet e liberalëve në Korint. Pali i përball ato duke pranuar të vërtetën e tyre, por duke treguar se nuk është e vërteta e plotë” (fq. 611)

Pali përdor këto dy terma shpesh në letrat e tij drejtuar kishës në Korint.

3. *exousia*, 1 Kor. 7:37; 9:4,5,6,12 (dy herë),18; 11:10; 2 Kor. 13:10
4. *dunamis*, 1 Kor. 1:18; 2:4,5; 4:19,20; 5:4; 15:24,43; 2 Kor. 4:7; 6:7; 8:3 (dy herë); 12:9; 13:4 (dy herë)

Të drejtat dhe fuqia ishin çështjet kryesore si për legalistët ashtu edhe për liberalët. Pali përpiqet të ecë në një vijë të hollë midis dy ekstremeve. Në këtë kontekst gratë e krishtera inkurajohen për të pranuar rendin e krijimit të dhënë nga Perëndia (dmth., Krishti-burri-grauja) për qëllimin e përparimit të Mbretërisë. Pali pranon ndërsjelljen origjinale (shih Zan. 1:26-27; 2:18) tek vargjet 1 Kor. 11-12. Është shumë e rrezikshme teologjikisht të

4. izolosh një varg në këtë kontekst
5. zbatosh një kornizë sistematike denominacionale mbi çështjen e marrëdhënies së burrave dhe grave / bashkëshortëve dhe bashkëshorteve të shekullit të parë në çdo kulturë në çdo shekull
6. të humbasësh ekuilibrin e Palit midis lirisë së krishterë dhe përgjegjësisë së përbashkët të

besëlidhjes së krishterë

Ku e gjetën gratë e krishtera lirinë për të marrë pjesë si drejtuese në adhurimin e përbashkët (dmth., kisha-shtëpi)? Me siguri jo nga një sinagogë. Ishte një trend kulturor nga shoqëria romake e shekullit të parë? Kjo është patjetër e mundur dhe sipas mendimit tim ndihmon të shpjegohen shumë aspekte të këtij kapitulli. Megjithatë, gjithashtu është e mundur që fuqia e ungjillit, restaurimi i “shëmbëllimit fillestar të Perëndisë” të humbur tek rënia, të jetë burimi. Gjendet një liri e re shokuese në të gjitha zonat e jetës dhe shoqërisë njerëzore. Por kjo liri mund të kthehet në një leje për abuzim personal. Është një zgjatim i papërshtatshëm i asaj së cilës Pali po i drejtohet.

Libri *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve] e F. F. Bruce më ka ndimuar mua vërtet për të menduar për shumë nga çështjet kundërshtuese të lidhura me traditat e kishës moderne të krishtërimit perëndimor. Si një studiues i Biblës, unë gjithmonë kam menduar se mbulimi i grave kishte për qëllim të tregonte dhuntinë e Perëndisë (ose bashkë-barazinë e Zan. 1:26, 27), jo autoritetin e bashkëshortit të saj. Megjithatë, unë nuk do të mund ta gjeja këtë interpretim mes burimeve biblike që unë përdor, prandaj, e kisha të vështirë ta vendosja në komentare apo të predikoj / mësoja rreth saj. Ende e mbaj mend gëzimin dhe lirinë që ndjeva kur F. F. Bruce mendonte të njëjtën gjë (shih *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve], fq. 95). Unë mendoj se të gjithë besimtarët janë shërbëtorë të Krishtit të thirrur, me kohë të plotë dhe plot dhunti (shih Efe. 4:11-12)!

Ky kontekst mund t'i referohet *eons* gnostikë. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: NIVELE ENGJËLLORE NË SHKRIMET E PALIT (SPECIAL TOPIC: ANGELIC LEVELS IN PAUL'S WRITINGS)**

Rabinët mendonin se engjëjt ishin xhelozë për dashurinë dhe vëmendjen e Perëndisë (dmth., dhënia e ligjeve të Tij tek Mali Sinai) ndaj njerëzimit të rënë, dhe prandaj, ata i kundërshtonin ata. Mësuesit e rremë gnostikë pohonin se shpëtimi ishte i mundur vetëm nëpërmjet fjalëkalimeve të fshehta përmes sferave engjëjlore armiqësore (shih Kolosianëve dhe Efesianëve) të cilat të përçonin tek perëndia i mirë dhe i lartë.

George Eldon Ladd ka një përmbledhje të mirë të termave të përdorur nga Pali për engjëjt në librin e tij *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re]:

“Pali i referohet jo vetëm engjëjve të mirë dhe të këqij, Satanit dhe demonëve; ai përdor një grup tjetër fjalës për të përshkruar rendin e frymërave engjëjlore. Terminologjia është si më poshtë:

'Sundim' [*archē*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21; Kol. 2:10

'Sundimtarë' [*archai*; RSV, “principata”], Efe. 3:10; 6:12; Kol. 1:16; 2:15; Rom. 8:38

'Autoritet' [*exousia*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21; Kol. 2:10

'Autoritete' [*exousiai*; RSV, “autoritete”], Efe. 1:21

'Fuqi' [*dynamis*], I Kor. 15:24; Efe. 1:21

'Fuqitë' [*dynameis*], Rom. 8:38

'Fronet' [*thronoi*], Kol. 1:16

'Zotërim' [*kyriotēs*; RSV, “sundim”], Efe. 1:21

'Zotërime' [*kyriotētes*], Kol. 1:16

'Sunduesit e botës së kësaj errësire,' Efe. 6:12

'Mbajtësit frymorë të së ligës në vendet qiellore,' Efe. 6:12

'Autoriteti i errësirës,' Kol. 1:13

'Çdo emër që emërtohet,' Efe. 1:21

'Qeniet qiellore, tokësore dhe nën-tokësore,' Fil. 2:10" (fq. 401).

**15:25 “Ai t’i vërë të gjithë armiqtë e Tij nën këmbët e Veta”** Kjo është një shprehje e Dhjatës së Vjetër për fitore të plotë (shih Ps. 8:6; 110:1). Në Dhjatën e Vjetër armiqtë ishin kombet pagane përreth besimtarëve, por në Dhjatën e Re ata janë fuqitë engjëjllore, frymërore që kundërshtojnë Perëndinë dhe Krishtin e Tij. Këto fuqi të liga ndikojnë mbi njerëzimin që të mos besojë dhe të rebelohet. Jezusi i ka mposhtur plotësisht këto fuqi me anë të kryqit dhe të ringjalljes së Tij. Ringjallja përfundimtare e të gjithë besimtarëve do të shënojë konsumimin e kësaj fitoreje!

Gjenden dy libra interesantë që përpiqen të përkufizojnë saktësisht se çfarë i referohen këto “fuqi”.

1. Hendricus Berkhof, *Christ and the Powers* [Krishti dhe Fuqitë]
2. Oscar Cullmann, *Christ and Time* [Krishti dhe Koha]

**15:26 “Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja”** Kjo do të thotë “të bëhet asgjë dhe bosh”. Vdekja është mposhtur (shih 2 Tim. 1:10; Zbu. 21:4). Vdekja nuk ishte vullneti i Perëndisë për njerëzimin, por rezultati i rënies (dmth., Zanafilla 3). Mallkimi do të hiqet (shih Zbu. 21:3) sepse tani është i mposhtur.

Për termin “shfuqizoj” tek 1 Kor. 15:24 dhe 26 shih Temën e Veçantë: *Katargeō* (Special Topic: *Katargeō*) tek 1 Kor. 1:28.

**15:27-28** Përemrat e mëparshëm janë të paqartë. Dukshëm kjo i referohet një marrëdhënieje të brendshme brenda Perëndisë Trium (shih 1 Kor. 3:23; 11:3). Krishti, Biri, është i nënshtuar (por jo i pabarabartë, shih Kol. 3:11) ndaj Atit në funksionin e Tij shpengues brenda kohës (shih Rom. 11:33-36).

**15:27** Ky është një citim nga Ps. 8:6 me një aludim të shtuar ndaj Ps. 110:1. Për “nënshttrim” shih shënimin tek 1 Kor. 16:16 dhe Temën e Veçantë tek 2 Kor. 9:13.

**15:28 “kur t’i ketë nënshtuar të gjitha”** Kur ndodh kjo? Kjo është pyetja! Gjenden dukshëm tregues kohorë përgjatë këtij paragrafi.

1. Pas kësaj (*epeita*), 1 Kor. 15:23
2. Më pas (*eita*), 1 Kor. 15:24
3. Kur (*hotav*, dy herë), 1 Kor. 15:24
4. Deri (*achri*), 1 Kor. 15:25
5. Kur (*hostan*), 1 Kor. 15:27
6. Kur (*hostan*), 1 Kor. 15:28

A i referohet kjo

1. Vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit
2. Ngjitjes në qiell të Jezusit
3. Rikthimit / rrëmbimit të Jezusit
4. Disa aspekteve të mijëvjeçarit

Gjendet dukshëm një sekuencë kohore, por Pali është shumë i paqartë për këdo interpretues që ta shpallë këtë gjë me siguri. Shpesh supozimet tona dhe teologjitë tona sistematike i japin këtij pasazhi formën që ne dëshirojmë!

## VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:29-34

<sup>29</sup> Përndryshe çfarë do të bëjnë ata që pagëzohen për të vdekurit? Në qoftë se me të vërtetë të vdekurit nuk ringjallen, përse ata edhe pagëzohen për të vdekurit? <sup>30</sup> Përse jemi edhe ne në rrezik në çdo orë? <sup>31</sup> Përditë unë po vdes për shkak të mburrjes për ju, që kam në Krishtin Jezu, Zotin tonë. <sup>32</sup> Nëse u ndesha në Efes si njeri kundër bishave, ç'dobi kam? Në qoftë se të vdekurit nuk ringjallen, le të hamë e të pimë, sepse nesër do të vdesim. <sup>33</sup> Mos u gënjeni; shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira. <sup>34</sup> Zgjuhoni për drejtësinë dhe mos mëkatoni, sepse disa nga ju nuk e njohin Perëndinë; për turpin tuaj po ua them.

**15:29** Ky varg ka shkaktuar probleme të mëdha në interpretim. Ne nuk kemi pasazhe paralele në Shkrime. Ne nuk kemi asnjë referencë tjetër për këtë praktikë në kishën e hershme, edhe pse gjenden prova historike mbi diçka të ngjashme që është praktikuar mes heretikëve të shekullit të dytë dhe të tretë. Ne duhet të pranojmë se ne thjesht nuk e dimë saktësisht biblikisht se kujt i referohet kjo. Disa teori janë:

1. Të krishterë të rinj që pagëzoheshin për të zënë vendin e të krishterëve të vdekur
  2. Të konvertuar të rinj që pagëzoheshin për shkak të respektit të tyre për një të dashur të vdekur
  3. Persona në katekizëm që kishin vdekur përpara se të pagëzoheshin, pagëzoheshin të përfaqësuar nga të krishterë të gjallë
  4. Të konvertuar të rinj që pagëzoheshin mbi varret e të krishterëve të mëdhenj
- Hermeneutikisht nevojiten disa supozime për t'u zbatuar ndaj interpretimit të këtij vargu.

1. Në thelb ajo është një seri shembujsh / ilustrimesh e realitetit të ringjalljes
2. Një person nuk mund të ndërtojë teologji / doktrinë mbi ilustrime.
3. Duke qënë se nuk ka asnjë ide për referencën e saktë historike, ky tekst nuk duhet të theksohet apo zbatohet dhe sigurisht jo të kthehet në një doktrinë (dmth., Mormonizmi)
4. Është madje edhe kontekstualisht e pasigurtë nëse Pali po pranon këtë praktikë apo thjesht po bën një aludim ndaj saj (shih TEV, NJB)

▣ **“Në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë e përdorur për të bërë një kundërshebull të fuqishëm. Teksti grek ka fjalën *holōs* (në fakt) në këtë fjali të nënrenditur. Shih shënimin tek 1 Kor. 5:1.

### 15:31

Nasb, nkjv      “unë pranoj”  
Nrsv            “është e sigurtë”  
Tev              “unë ju shpall këtë”  
Njb              “unë betohem”

Kjo nuk është në versionin në greqisht<sup>39</sup>, por në kontekst fraza pasuese mund të jetë një formulë betimi. Pali i përdor formulat e betimit mjaft shpesh për të vërtetuar të vërtetën e pohimeve të tij (shih Rom. 9:1; 2 Kor. 1:18,23; 11:10-11,31).

▣ **“për shkak të mburrjes për ju, që kam në Krishtin”** Pali po pranon se vepra e tij në Korint është provë e punës së tij për Krishtin. Puna e tij ia ka vlejtur (shih 2 Kor. 3:1-2; 7:4; 9:2-3). Kishat e Palit ishin një provë e apostullatit dhe frytshmërisë së tij.

▣ **“Përditë unë po vdes”** Kjo frazë vendoset në fillim të fjalisë për efekt theksimi (shih 2 Kor. 5:14-15; Gal. 2:20; 1 Gjoni 3:16). Vargjet 30-32 i referohen vështirësive që Pali hasi gjatë shërbesës ndaj Krishtit (shih 2 Kor. 1:8-10, 4:8-12; 6:3-10; 11:23-27). Ai e dinte që ia vlente për shkak se ai kishte parë personalisht Krishtin e përlëvdur në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:1-22; 22:3-16; 26:9-18). Teologjia e Palit ishte e informuar nga përvoja personale dhe zbulesa personale (shih Veprat e Apo. 9:1-22; Gal. 1:11-12) dhe Dhjata e Vjetër (trajnimi i tij rabinik).

**15:32 “Nëse”** Pali përdor dy fjali kushtore të rendit të parë për të nxjerrë konkluzionin. Nëse nuk ka ringjallje dhe as shpërblim të krishterë, pse atëherë ishte i gatshëm Pali për të vuajtur përditë për ungjillin?

<sup>39</sup> Kjo frazë mungon edhe në tekstin në shqip. (shënim i përkthyesit)

▣ **“u ndesha në Efes si njeri kundër bishave”** Pali nuk e përmend këtë përjetesë në litaninë e tij të vuajtjeve tek 2 Kor. 11:23-27, dhe për shkak se Pali ishte një qytetar romak, ai nuk duhej të ishte detyruar për të luftuar me bishat e egra. Kjo duhet të jetë një metaforë për situatën e vështirë frymërore që Pali ndeshi në Efes (shih 1 Kor. 1:8-10). Disa e marrin këtë tekst në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pohojnë për një burgim në Efes.

▣ **“ç’dobi kam”** Veprat e Palit për Krishtin nuk janë me efekt frymëror nëse nuk ka ringjallje, as të Krishtit dhe si rrjedhojë nuk ka as ringjallje për Palin. Ai punon për ungjillin, por nëse ungjilli nuk është i vërtetë, nuk ka asnjë shpërblim (dmth., asnjë shpëtim, asnjë ringjallje, asnjë jetë të përjetshme, asnjë marrëdhënie me Perëndinë, asnjë ribashkim me të dashurit që janë në qiell, shih 1 Kor. 15:12-19).

▣ **“le të hamë e të pimë, sepse nesër do të vdesim”** Kjo ishte motoja e Epikureanëve. Ajo është gjithashtu një citim nga Isa. 22:13 (shih Isa. 56:12; Luka 12:19). Kjo është e ngjashme me thënien aktuale: “Në jetë kalon vetëm një herë, kështuqë merr të gjithë shijen që mundesh!” Por, po sikur të ketë një ringjallje? Po sikur ne të qëndrojmë përpara një Perëndie të Shenjtë për të dhënë llogari për dhuratën e jetës (shih Dan. 12:2)?!

**15:33 “Mos u gënjeni”** Kjo është një formë urdhërore pasive mohore e tashme. Kisha në Korint po drejtohej në mënyrën e gabuar nga teologjia e rreme (shih 1 Kor. 6:9).

▣ **“shoqëritë e këqija prishin zakonet e mira”** Ky duket se është një citim nga profeti grek Menander's *Thais*, duke e lidhur me një prostitutë. Disa grupime në Korint ishin krenarë të (1) trashëgimisë së tyre greko-romake ose (2) lirisë së tyre seksuale. Pali i intensifikon qëndrimet e tyre duke cituar nga vetë filozofët e tyre (shih 1 Kor. 15:32 dhe 33). Pali u rrit në Tarsus, që ishte mjaft i njohur për shkollat e saja të filozofisë greke (shih Veprat e Apo. 17:28 dhe Titi 1:12). Ai u mësua në mënyrë unike në judaizmin rabinik dhe në mendimin grek laik.

▣ **“prish / korruptoj” Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:42.**

**15:34**

<b>NASB</b>	“bëhuni të kthjellët”
<b>NKJV</b>	“zgjohuni për drejtësinë”
<b>NRSV</b>	“ejani në një mendje esëll dhe të drejtë”
<b>TEV</b>	“rikthehuni tek shqisat tuaja të drejta”
<b>NJB</b>	“zgjohuni nga mpirja juaj siç duhet”

Kjo është një formë urdhërore aktive aoriste. Ajo duket se nënkupton: “kthehuni tek të kuptuarit tuaj moral një herë e përgjithmonë”.

▣ **“mos mëkatoni”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme me një pjesëz mohore e cila zakonisht do të thotë të ndalosh një veprim në proces. Është e dukshme se ata që mohuan ringjalljen gjithashtu po jetonin jetë të paperëndishme. Pali përdori imoralitetin e tyre si një mënyrë për të treguar vlefshmërinë e rreme të pohimit të tyre teologjik (pra, që nuk ka ringjallje).

▣ **“nuk e njohin Perëndinë”** Në anglisht ky është termi “agnostic”. Kjo është një vërejtje e hollë sarkastike për ata që e çmonin aq lart njohurinë. Teologjia dhe veprimet e tyre qartazi tregonin se ata nuk kishin njohuri të vërtetë!

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:35-41**

<sup>35</sup> Por do të thotë ndonjë: “Si ringjallen të vdekurit, edhe me ç’trup do të vijnë?.” <sup>36</sup> O i pamend! Atë që ti mbjell, nuk ngjallet, nëse nuk vdes përpara. <sup>37</sup> Dhe atë që mbjell, ti nuk mbjell trupin që do të bëhet, por një kokërr të zhveshur, ndoshta nga grurë ose ndonjë farë tjetër. <sup>38</sup> Po Perëndia i jep trup si të dojë, secilës farë trupin e vet. <sup>39</sup> Jo çdo mish është i njëjti mish; por tjetër është mishi i njerëzve, tjetër mishi i bagëtive, tjetër i peshqve dhe tjetër i shpendëve. <sup>40</sup> Dhe ka trupa qiellorë dhe trupa tokësorë; por tjetër është lavdia e trupave qiellorë e tjetër e atyreve të tokës. <sup>41</sup> Tjetër është lavdia e diellit dhe tjetër lavdia e hënës dhe tjetër lavdia e yjeve; sepse ndryshon në lavdi ylli nga ylli.

**15:35 “do të thotë ndonjë”** Ky është përdorimi i Palit i një teknike letrare të quajtur diatribe. Kjo formë pyetje / përgjigje gjithashtu shihet në Dhjatën e Vjetër tek Malakia dhe në Dhjatën e Re tek Romakëve dhe letra e I e Gjonit. Subjekti i veprës letrare tejçohet nga një dialog midis autorit dhe një kundërshtuesi të supozuar. Këtu argumenti lëvizet më tej në një temë disi ndryshe. Së pari, disa nga grupimet mohonin ringjalljen e Krishti dhe si rrjedhojë, ringjalljen e të gjithë besimtarëve. Tani Pali iu drejtohet atyre që vinin në pyetje formën e trupit të ringjallur.

▣ **“me ç’lloj trupi<sup>40</sup> do të vijnë”** Një burim i konfliktit lidhur me një trup të ringjallur vjen nga pikëpamja negative e trupit fizik në disa nga shkollat e filozofisë greke. Grekët shpesh e shihnin materien si të ligë (dmth., gnosticizmi) dhe madje edhe më keq, trupin fizik si shtëpinë-burg të shkëndijës ose shpirtit hyjnor të përjetshëm brenda të gjithë njerëzve. Ky sfond kulturor / filozofik vinte në konflikt të drejtpërdrejtë me sfondin hebraik të Palit (dmth., fariseik) të pranimit të një pas-jete fizike, trupore.

**15:35-41** Pali përdor një seri ilustrimesh që tregojnë vazhdimësinë, e megjithatë ndryshimin, midis trupit fizik dhe trupit frymëror.

1. Farë përkundrejt bimës së pjekur, 1 Kor. 15:37
2. Mish njerëzor përkundrejt mishit kafshëror, 1 Kor. 15:39
3. Trupi qiellor përkundrejt trupave tokësorë, v 40
4. Dritave të natës përkundrejt dritës së Diellit, 1 Kor. 15:41

**15:36 “O i pamend”** Njerëzit që shpallin se e njohin Perëndinë, por mendojnë ose sillen në mënyra të papërshtatshme shpesh karakterizohen si të pamendë! Komentet sarkastike të Palit, aq të shpeshta në letrën e I dhe II drejtuar korintasve, e zbulojnë këtë lloj njeriu. Ata ishin aq të sigurtë se kishin njohuri saqë ata nuk mund të shihnin dhe as të dallonin njohurinë e vërtetë!

#### **TEMË E VEÇANTË: I PAMEND (SPECIAL TOPIC: FOOLISH)**

Ky qëndrim / person shprehet nga disa terma të Dhjatës së Vjetër.

1. “Budalla” (BDB 17, KB 21) – shih Job 5:2,3; Ps. 107:17; Fj. Urta 1:7 (dhe shumë të tjera); Isa. 19:11; 35:8; Jer. 4:22; Ose. 9:7
2. “Mendjeshkurtër / Me besim tek vetvetja” (BDB 493, KB 489) – shih Ps. 49:10; 92:6; 94:8; Fj. Urta. 1:22,32 (dhe shumë të tjera); Pred. 2:14-16; 5:1,3,4 (dhe shumë të tjera)
3. “Njeri bosh” (BDB 614, KB 663) – shih Ligji i Përt. 32:6,21; 2 Sam. 3:33; 13:13; Job 2:10; 30:8; Ps. 14:1; 39:8; 53:1; 74:18,22; Fj. Urta. 17:7,21; 30:22; Jer. 17:11
4. “I pamend” (BDB 698, KB 754) – shih Zan. 31:28; 1 Sam. 13:13; 2 Sam. 15:31; 24:10; 1 Kro. 21:8; 2 Kro. 16:9; Pred. 2:19; 10:3,14; Isa. 44:25; Jer. 5:21

Jezusi përdori tre fjalë për të përshkruar njerëzit e pamendë.

1. *aphrōn*, Luka 11:40; 12:20
2. *anoētos*, Luka 24:25
3. *mōros*, Mat. 5:22; 23:17,19

Pohimi më i fortë i Jezusit në lidhje me përdorimin e këtij karakterizimi të një personi nga dikush tjetër është tek Mat. 5:22, ku *mōros reflekton fjalën në gjuhën aramaike raca, që do të thotë i paafte për jetën. Ky seksion nuk po trajton se çfarë titujsh të veçantë mund apo nuk mund të quhet një person tjetër, por me qëndrimin e besimtarit të supozuar ndaj të tjerëve, sidomos ndaj vëllezërve në besëlidhje.*

*Termi grek, mōros, i përkthyer “i pamend”, kishte për qëllim të reflektonte termin në gjuhën aramaike raca. Megjithatë, loja e fjalës e Jezusit nuk ishte ndaj fjalës greke mōros, por kryesisht ndaj fjalës hebraike mōreh, BDB 598, që do të thoshte “rebel ndaj Perëndisë” (shih Num. 20:10; Ligji i Përt. 21:18,20; shih F. F. Bruce, Answers to Questions [Përgjigje ndaj Pyetjeve], fq. 42). Jezusi i quajti farisenjtë me vetë*

<sup>40</sup> Versioni në shqip është “ç’trup”. (shënim i përkthyesit)

këtë term tek Mat. 23:17. Jo vetëm veprimet tona, por edhe motivet, qëndrimet dhe qëllimet tona përcaktojnë mëkatën përkundrejt mikut tonë njerëzor. Vrasje, sipas Perëndisë, mund të jetë edhe një mendim! Urrejtja e vëllait apo motrës sonë qartazi tregon se ne nuk e njohim Perëndinë (shih 1 Gjoni. 2:9-11; 3:15, dhe 4:20). Duke folur nga ana sociale, një mendim plot urrejtje është më mirë se sa një vdekje, por kujtoni se ky seksion i Shkrimeve ka për qëllim të shkatërrojë gjithë vetë-drejtësinë dhe krenarinë në mirësinë e vetë njeriut.

Pali ndjek Dhjatën e Vjetër dhe Jezusin në përdorimin e disa termave për të përshkruar njerëzit budallenj.

1. *aphrōn*, 1 Kor. 15:36; 2 Kor. 11:16,19; 12:6,11
2. *mōros*, 1 Kor. 3:18; 4:10 dhe një formë e lidhur tek Rom. 1:22

Njerëzit që shpallin se e njohin Perëndinë, por mendojnë ose sillen në mënyra të papërshtatshme shpesh karakterizohen si të pamendë! Komentet sarkastike të Palit, aq të shpeshta në letrën e I dhe II drejtuar korintasve, e zbulojnë këtë lloj njeriu. Ata ishin aq të sigurtë se kishin njohuri saqë ata nuk mund të shihnin dhe as të dallonin njohurinë e vërtetë!

**15:37 “Atë që ti mbjell, nuk ngjallet, nëse nuk vdes përpara”** Pali sërish po ndjek fjalët e Jezusit (shih Gjoni 12:24). Ky është përdorimi i gjuhës fenomenologjike (dmth., mënyra se si gjërat shfaqen ndaj pesë shqisave). Kjo nuk ka për qëllim të jetë një pohim shkencor, por një metaforë bujqësore e jetës së re nga farërat e forta, dukshëm të vdekura.

Termi “nëse nuk” përcakton një fjali kushtore të rendit të tretë, e cila do të thotë veprim i mundshëm.

▣ **“ndoshta”** Kjo është një fjali kushtore e paplotë e rendit të katërt (shih 1 Kor. 14:10). Pali po pranon mundësinë e llojeve të ndryshme të kokrrave të farëve.

**15:39-40 “tjetër... tjetër”** E para, e përdorur katër herë tek 1 Kor. 15:39 dhe tre herë tek 1 Kor. 15:41, është *allos* dhe “tjetër” më tej përdoret tre herë tek 1 Kor. 15:40 dhe është *heteros*. Dallimi midis këtyre të dyjave ishte i dukshëm në gjuhën klasike greke, por pothuajse i zhdukur në gjuhën koine greke. Në këtë kontekst, dallimi duket se qëndron:

1. *allos*, një tjetër i të njëjtit lloj (shih 1 Kor. 15:39,41)
2. *heteros*, një tjetër i një lloji tjetër (shih 1 Kor. 15:40)

**15:40,41,43 “lavdi”** Shih TEMËN E VEÇANTË: LAVDI (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:42-49

<sup>42</sup> Kështu do të jetë edhe ringjallja e të vdekurve; trupi mbillet në prishje dhe ringjallet në paprishje. <sup>43</sup> Mbillet në çnderim dhe ringjallet në lavdi; mbillet i dobët dhe ringjallet në fuqi. <sup>44</sup> Mbillet trup natyror dhe ringjallet trup frymëror. Ka trup natyror, ka edhe trup frymëror. <sup>45</sup> Kështu edhe është shkruar: “Njeriu i parë, Adami, u bë shpirt i gjallë; por Adami i fundit është Frymë që jep jetë. <sup>46</sup> Por frymërori nuk është më parë, por përpara është natyrori, pastaj frymërori. <sup>47</sup> Njeriu i parë i bërë prej dheu, është tokësor; njeriu i dytë është Zoti nga qielli. <sup>48</sup> Siç është tokësori ashtu janë dhe tokësorët; dhe siç është qiellori, të tillë do të jenë edhe qiellorët. <sup>49</sup> Dhe sikurse mbartëm shëmbëllimin e tokësorit, do të mbartim edhe shëmbëllimin e qiellorit.

**15:42-49** Bibla nuk zbulon në mënyrë specifike apo tërësore gjërat që lidhen me jetën e përtejme. Ndoshta për shkak se ne nuk i kuptojmë dot ato në gjendjen tonë të rënë, të përkohshme, tokësore. Ky paragraf diskuton trupin e ringjallur duke e krahasuar atë me trupin tokësor. Megjithatë, nuk është preçiz. Gjithçka që mund të thuhet është se trupat tanë të rinj do të jenë të përgatitur në mënyrë të përkryer për jetën, bashkësinë, adhurimin dhe shërbesën



për Perëndinë tonë në një epokë të re. Nën dritën e gjithë kësaj, forma e saktë është e pavend (shih Fil. 3:21; 1 Gjoni 3:2).

15:42

NASB, NRSV, NJB “prishje... paprishje”  
NKJV “e korruptueshme... e pakorruptueshme”  
TEV “e vdekshme... e pavdekshme”

Shpesh ky term përdoret në të njëjtin kontekst sikurse e kundërta e saj mohore (shih Rom. 1:23; 1 Kor. 9:25; 15:50,53). Vini re kontrastet paralele midis trupave tanë fizikë tokësorë dhe trupave tanë qiellorë të përjetshëm.

1. Prishje përkundrejt paprishje, 1 Kor. 15:42,50
2. Çnderim përkundrejt lavdi, 1 Kor. 15:43
3. I dobët përkundrejt në fuqi, 1 Kor. 15:43
4. Trup natyror përkundrejt trup frymëror, 1 Kor. 15:44
5. Adami i parë përkundrejt Adami i fundit, 1 Kor. 15:45
6. Shëmbëllimi i tokësorit përkundrejt shëmbëllimi i qiellorit, 1 Kor. 15:49

**TEMË E VEÇANTË: SHKATËRROJ, SHKRETOJ, KORRUPTOJ (PHTHEIRŌ) [SPECIAL TOPIC: DESTROY, RUIN, CORRUPT (PHTHEIRŌ)]**

Kuptimi themelor i këtij temi *phtheirō* është shkatërroj, shkrettoj, korruptoj ose prish. Ai mund të përdoret për

1. shkatërrimin financiar (II Kor. 7:2 ndoshta)
2. shkatërrimin fizik (shih I Kor. 3:17a)
3. korrupsionin moral (shih Rom. 1:23; 8:21; I Kor. 15:33,42,50; Gal. 6:8; Zbu. 19:2)
4. joshjen seksuale (shih II Kor. 11:3)
5. shkatërrimin e përjetshëm (shih II Pjet. 2:12,19)
6. traditat në zhdukje të njerëzve (shih Kol. 2:22)

Shpesh ky term përdoret në të njëjtin kontekst si i kundërta i tij (shih Rom. 1:23; I Kor. 9:25; 15:50,53). Vini re kontrastet paralele midis trupave tanë tokësore fizikë dhe trupave tanë qiellorë të përjetshëm.

1. i prishshëm përkundrejt i paprishshëm, I Kor. 15:42,50
2. çnderim përkundrejt lavdi, I Kor. 15:43
3. dobësi përkundrejt fuqi, I Kor. 15:43
4. trup natyror përkundrejt trup frymëror, I Kor. 15:44
5. Adami i parë përkundrejt Adami i fundit, I Kor. 15:45
6. imazhi i tokësorit përkundrejt imazhi i qiellorit, I Kor. 15:49

15:43 “dobësi<sup>41</sup>” Shih TEMËN E VEÇANTË: DOBËSI (SPECIAL TOPIC: WEAKNESS tek 2 Kor. 12:9.)

15:44 “nëse<sup>42</sup>” *Handbook on Paul's First Letter to the Corinthians* [Udhëzuesi mbi Letrën e Parë dhe Letrën e Dytë të Palit drejtuar Korintasve] i United Bible Societies thotë se kjo nuk është një fjali kushtore e rendit të parë, por një pohim fakti (shih fq. 361). Megjithatë, A. T. Robertson tek *Word Pictures in the New Testament* [Fjalë në Pamje në Dhjatën e Re] pranon se është një fjali kushtore e rendit të parë (shih fq. 197). Gramatika nuk është një shkencë.

15:45 “Njeriu i parë, Adami” Ky është një citim nga Zan. 2:7. Përmendja nga Jezusi e Adamit (shih Mat. 19:4; Mark 10:6; Luka 3:38) përcakton historikun e tij. Jezusi supozoi korruptimin e një çifti fillestar të quajtur Adam dhe Eva. Përdorimi i Palit i tipologjisë Adam-Krisht, si këtu ashtu edhe tek Rom. 5:17-21, kërkon një krijim të veçantë të Adamit dhe Evës. Ky mund të jetë një krijim i mëvonshëm (shih komentarin tim mbi Zanafillën 1-11

<sup>41</sup> Versioni në shqip është “i dobët”. (shënim i përkthyesit)

<sup>42</sup> Kjo fjalë mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

[online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org)], ku unë vërtetoj një tokë të vjetër, por një krijim relativisht të hershëm të Edenit), por mua më duket se duhet të jetë një krijim i veçantë.

▣ **“Adami i fundit u bë<sup>43</sup> Frymë që jep jetë”** Kjo duhet t’i referohet ringjalljes së Jezusit. Ajo nuk ka për qëllim të mohojë një aspekt fizik të shfaqjeve pas-ringjalljes të Jezusit, por një kontrast ndaj Adamit të parë, veprimet e të cilit shkaktuan vdekje, me Adamin e fundit, veprimet e të cilit shkaktuan jetë, jetë të përjetshme, jetë ringjalljeje! Ky është një shembull i tipologjisë Adam-Krisht (shih Rom. 5:12-21; 1 Kor. 15:21-22,45-49; Fil. 2:6-8).

▣ **“frymë që jep jetë”** Ky është një shembull i mirë i vështirësisë në disa kontekste të dallimit nëse “frymë” duhet të jetë me “f” të vogël<sup>44</sup> (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:3; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11). Bibla e përdor termin *pneuma* në disa vargje të ndryshme. Shih Temën e Veçantë: Pneuma / Special Topic: Pneuma tek 1 Kor. 12:1.

**15: 46** Ky nuk është një pohim ontologjik, por një pohim i përkohshëm i lidhur me Adamin e parë dhe Adamin e dytë (shih 1 Kor. 15:47). Jeta njerëzore fizike paraprin jetën frymërore!

**15:47 “njeriu i dytë është nga qielli<sup>45</sup>”** Ka disa shtime ndaj kësaj fraze në dorëshkrimet greke. Pjesa më e madhe e tyre përpiqen të theksojnë se Jezusi është në natyrën njerëzore si Adami, por më shumë se sa njerëzor. Bart D. Ehrman në *The Orthodox Corruption of Scripture* [Korruptimi Ortodoks i Shkrimeve], fq. 94-95, mendon se këto ndryshime ishin si rezultat i kundërshtimeve doktrinale brenda kishës gjatë periudhës kur këto dorëshkrime po kopjoheshin. Ai sugjeron se shtimet ishin sqarime të qëllimta teologjike nga ana e skribëve besimtarë.

**15:49 “Dhe sikurse mbartëm shëmbëllimin e tokësorit”** Ky tekst shfaqet në dorëshkrimet e hershme greke P<sup>46</sup>, x, A, C, D (dmth., forma lidhore aoriste aktive). Konteskti duket se kërkon tekstin e dorëshkrimit të hershëm aleksandrian B, i cili ishte: “Ne do të mbajmë...” (dmth., forma treguese aktive e ardhme). Të dy këto fjalë në gjuhën greke shqiptoheshin në mënyrë të ngjashme. Dorëshkrimet e hershme greke shpesh kopjoheshin në një kohë nga një person që lexonte tekstin me zë të lartë dhe disa burra që bënin kopjet e shkruara. Teologjikisht forma treguese e ardhme është ajo që preferohet. Foljet e tjera në kontekst janë në kohën e ardhme. Ky është një kontekst përshkrues, jo këshillues (dmth., nxitje për veprim).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:50-57

<sup>50</sup> Edhe këtë po ju them, o vëllezër, se mishi dhe gjaku nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë, as prishja nuk mund të trashëgojë paprishjen. <sup>51</sup> Ja, unë po ju them një të fshehtë: të gjithë nuk do të vdesim, por të gjithë do të shndërrohemi në një moment, <sup>52</sup> sa hap e mbyll sytë, në tingullin e burisë së fundit; sepse do të bjerë buria, të vdekurit do të ringjallen të paprishshëm dhe ne do të shndërrohemi, <sup>53</sup> sepse ky trup që priset duhet të veshë mosprishjen dhe ky i vdeksëm të veshë pavdekësinë. <sup>54</sup> Edhe ky trup që priset, kur të veshë mosprishjen, edhe ky i vdeksëm kur të veshë pavdekësinë, atëherë do të realizohet fjala që është shkruar: “Vdekja u përpi në fitore.” <sup>55</sup> O vdekje, ku është gjëmba jote? O ferr, ku është fitorja jote? <sup>56</sup> Edhe gjëmba e vdekjes është mëkati; dhe fuqia e mëkatis është ligji. <sup>57</sup> Por ta falënderojmë Perëndinë që na jep fitoren me anë të Zotit tonë Jezu Krisht.

**15:50 “mishi dhe gjaku”** Kjo është një metaforë për njerëzimin (shih Mat. 16:17; Gal. 1:16; Efe. 6:12; Heb. 2:14).

▣ **“trashëgojnë”** Kjo është një fjali metafore që përshkruan marrëdhënien tonë të përhershme me Perëndinë. Në Dhjatën e Vjetër Levitet nuk merrnin asnjë trashëgimi toke të madhe (vetëm 48 qytete levitike), prandaj ata thuhej se kishin YHWH si trashëgiminë e tyre. Dhjata e Re e transferon këtë (ashtu sikurse bën për shumë aktivitete priftërore) tek të gjithë besimtarët. Shih TEMËN E VEÇANTË: TRASHËGIMIA E BESIMTARËVE (SPECIAL TOPIC: BELIEVERS' INHERITANCE) tek 1 Kor. 6:9.

<sup>43</sup> Versioni në shqip është “është”. (shënim i përkthyesit)

<sup>44</sup> Version në shqip është me “F” të madhe. (shënim i përkthyesit)

<sup>45</sup> Versioni në shqip është “njeriu i dytë është Zoti nga qielli”. (shënim i përkthyesit)

▣ **“mbretërinë e Perëndisë”** Shih shënimin tek 1 Kor. 15:24.

**15:51 “të fshehtë / mister”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: MISTERI / SPECIAL TOPIC: MYSTERY tek 1 Korintasve 2:1

Perëndia ka një qëllim të unifikuar për shpengimin e njerëzimit që edhe e paraprinte rënien (Zanafilla 3). Grimca të këtij plani zbulohen në Dhjatën e Vjetër (Zanafilla 3:15; 12:3; Eksodi 19:5-6; dhe pasazhet universale tek profetët). Megjithatë, ky plan përfshirës nuk ishte i qartë (1 Kor. 2:6-8). Me ardhjen e Jezusit dhe të Frymës, ai fillon të bëhet më i qartë. Pali e përdor termin “mister / e fshehtë” për të përshkruar këtë plan plotësisht shpengues, i cili dikur ishte i fshehur, por tani është plotësisht i zbuluar (1 Kor. 4:1; Efe. 6:19; Kol. 4:3; 1 Tim. 1:9). Megjithatë, ai e përdori atë në disa kuptime të ndryshme.

1. Një fortësim pjesor i Izraelit për të lejuar johebrenjtë që të përfshihen. Kjo hyrje e johebrenjve do të veprojë si mekanizëm (xheloz) për hebrenjtë që të pranojnë Jezusin si Mesia i profecisë (Rom. 11:25-32).
2. Ungjilli iu bë i ditur kombeve, të gjithëve atyre që mund të përfshihen në Krishtin dhe përmes Krishtit (Rom. 16:25-27; Kol. 2:2).
3. Besimtarët do të kenë trupa të rinj në Ardhjen e Dytë (1 Kor. 15:5-57; 1 Thes. 4:13-18).
4. Përmbledhja e të gjitha gjërave në Krishtin (Efe. 1:8-11).
5. Johebrenjtë dhe hebrenjtë janë bashkë-trashëgimtarë (Efe. 2:11-3:13).
6. Intimiteti i marrëdhënies midis Krishtit dhe kishës përshkruhet në terma martesorë (Efe. 5:22-33).
7. Johebrenjtë të përfshirë në popullin e besëlidhjes dhe të banuar nga Fryma e Krishtit që të mund të prodhojnë pjekuri të ngjashme me Krishtin, që do të thotë, shëmbëllimin e restauruar të Perëndisë në njerëzimin e rënë (Zan. 1:26-27; 5:1; Kol. 1:26-28).
8. Antikrishti i kohëve të fundit (2 Thes. 2:1-11).
9. Një përmbledhje e misterit e kishës së hershme gjendet tek 1 Tim. 3:16.

▣ **“të gjithë nuk do të vdesim, por të gjithë do të shndërrohemi”** Kjo duket se vërteton se do të ketë të krishterë të gjallë në Ardhjen e Dytë (shih 1 Thes. 4:13-18). Gjumi është një eufemizëm biblik për vdekjen.

A pret Pali që të jetë i gjallë në Ardhjen e Dytë apo është kjo një formë editoriale “ne” (gjallë në rikthimin e Jezusit, 1 Kor. 15:51-52; 1 Thes. 4:15,17 apo i ringjallur në rikthimin e Jezusit, 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; 5:1-10)? Sikurse të gjithë autorët e Dhjatës së Re dhe Jezusi, ai duket se ka pritur një rikthim të menjëhershëm të Krishtit të perlëvduar. Por vetëm Ati e dinte kohën (shih Mat. 24:36; Mark 13:32; Veprat e Apo. 1:7). Besimtarët duhet të jetojnë çdo ditë nën dritën e shpresës së Ardhjes së Dytë, por të planifikojnë dhe të trajnohen për veprimtarinë e mbretërisë si të ishte e vonuar.

TEMË E VEÇANTË: RIKTHIMI NË ÇDO MOMENT I JEZUSIT PËRKUNDREJT “AKOMA JO” / SPECIAL TOPIC: THE ANY-MOMENT RETURN OF JESUS VERSUS THE NOT YET tek 1 Korintasve 6:14

**15:52 “në një moment”** Ne marrim termin “atom” nga termi grek, që do të thoshte “i pandashëm”.

▣ **“sa hap e mbyll sytë”** Kjo përdoret për vezullimin e një ylli ose një lëvizje të shpejtë të krahëve të një mushkonje. Nënkuptimi i këtyre dy termave është se rikthimi i Jezusit do të ndodhë shumë shpejt sapo të fillojë. Nuk do të ketë kohë për lutje të minutës së fundit.

▣ **“në tingullin e borisë së fundit”** Kjo ishte një mënyrë e Dhjatës së Vjetër për të shpallur ndodhitë e kohëve të fundit me anë të *shophar* (dmth., briri i majtë i dashit, shih Isa. 27:13; Zak. 9:13; Mat. 24:31; 1 Thes. 4:16). Është sigurisht e mundur që boria të ishte një metaforë për zërin e Perëndisë (shih Eksod. 19:16,19; 20:18; Zbu. 1:10), gjithashtu e përdorur për zërat e profetëve (shih Isa. 58:1; Heb. 12:19).

## TEMË E VEÇANTË: BRIRË TË PËRDORUR NGA IZRAELI (SPECIAL TOPIC: HORNS USED BY ISRAEL)

Gjenden katër fjalë në hebraisht të lidhura me boritë / trumpetat:

1. “briri i dashit” (BDB 901, KB 1144) – i përdorur si një instrument frymor, shih Joz. 6:5. Po e njëjta fjalë përdoret për dashin e kapur nga brirët e tij me të cilin Abrahami zëvendësoi Isakun tek Zan. 22:13.
2. “trumpetë / bori” (BDB 1051) – nga termi asirian për delen e egër (ibex). Kjo është boria që u përdor tek Eksod. 19:16,19 tek mali Sinai / Horeb.

Pikat 1 dhe 2 janë paralelizma ndaj Joz. 6:5. Ai përdorej për të komunikuar

- a. Kohë adhurimi (shih Lev. 25:9)
- b. Kohë për të luftuar (dmth., Jeriko ishte për të dyja, shih Joz. 6:4; Gjyq. 3:27; 6:34; 1 Sam. 13:3; Jer. 4:5; Ose. 5:8)
- c. Kohë për vajosjen e një mbreti të ri, 1 Mbret. 1:34,39
- d. Rënë nga Perëndia, Zak. 9:14

3. “briri i dashit” (BDB 385, KB 398) – nga fjala feniciane për dash (shih Joz. 6:4,6,8,13). Ajo gjithashtu përfaqëson Vitin e Jubileut (shih Lev. 25:13,28,40,50,52,54; 7:17,18,23,24).

Të tërë këta tre terma të parë duken se përdoren në mënyrë të ndërsjelltë pa asnjë dallim të nënkuptuar.

Mishnah (RH 3.2) lejonte brirë kafshësh nga dele, dhi apo antilopë, por jo nga një lopë.

4. “trumpeta” (BDB 348, KB 344) – ndoshta nga folja “të zgjasësh”, duke nënkuptuar një kockë të drejtë (jo të harkuar sikurse në brirët e kafshëve). Këto bëheshin prej argjendi (sipas formës së Egjiptit). Ato përdoren:
  - a. Me rite adhurimi (shih Num. 10:2,8,10; Esdra 3:10; Neh. 12:35,41)
  - b. Për qëllime ushtarake (shih Num. 10:9; 31:6; Osea 5:8)
  - c. Për qëllime mbretërore (shih 2 Mbret. 11:14)

Një nga këta brirë metali përshkruhet në *Arch of Titus in Rome* [Harku i Titit në Romë]; gjithashtu *Josephus* [Josefi] i përshkruan ata tek *Antiq.* 3.12.6.

**15:54** Kjo është një referencë ndaj Isa. 25:8, ndaj të cilit aludohet tek Mat. 5:11; 1 Pjet. 4:14; Zbu. 7:17; 21:4. Vargjet 54 dhe 55 janë dukshëm mënyra e Palit për të tallur armikun e fundit të madh të njerëzimit – vdekjen, e cila është mposhtur plotësisht në ringjalljen e Krishtit prej së vdekurish dhe ndjekësit e Tij janë liruar nga ndëshkimi i mëkatit dhe presin me siguri ringjalljen e vetvetes.

**15:55** Kjo është një referencë ndaj Osea 13:14, e cila përmbys rendin duke cituar nga Septuaginta. Pjesa më e madhe e citimeve nga Dhjata e Vjetër në Dhjatën e Re janë nga përkthimet greke të Dhjatës së Vjetër. Ajo ishte Bibla e kishës së shekullit të parë.

**15:56** Në këtë varg Pali po pranon marrëdhënien e thyer të njerëzimit me Perëndinë të shkaktuar nga mëkati (shih Zanafilla 3; Romakëve 2-3). Ky rebelim ka shkaktuar që ne të ndihemi të larguar nga Vetë Ai që na krijoi për Vetën e Tij.

Mëkati hyri në botë përmes një veprimi të vullnetshëm mosbindjeje. Termi “ligj” nuk i referohet ligjit të Moisiut, por ndalimeve të Perëndisë në përgjithësi. Ne jemi të korrptuar, por Perëndia ka zgjedhur të restaurojë marrëdhënien përmes Krishtit. Atë që mëkati e shkatërroi, Krishti e restauron (dmth., marrëdhënia e përhershme me Perëndinë; shëmbëllimi i prishur është riparuar).

**15:57** “**ta falënderojmë Perëndinë**” Kjo më rikujton për thirrjen e Palit tek Rom. 6:17 dhe 7:25. Ajo kumton metaforën e madhe të Palit për marshimin triumfator romak tek 2 Kor. 2:14, sikurse shpërthimin e tij të mirënjohjes tek 2 Kor. 9:15. Shih Temën e Veçantë: Lavdërimi, Lutja dhe Falenderimi i Palit / Special Topic: Paul's Praise, Prayer, and Thanksgiving tek 2 Kor. 2:14.

■ **“fitoren me anë të Zotit tonë Jezu Krisht”** E gjithë fitorja frymërore vjen përmes Krishtit dhe vetëm Krishtit! Ajo ka ardhur tashmë! Besimtarët jetojnë në dritën e fitores së plotë dhe tërësore të Krishtit!

## VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 15:58

**<sup>58</sup> Prandaj, o vëllezërit e mi të dashur, qëndroni të fortë e të patundur, duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin.**

**15:58** Pali përmbyll këtë diskutim teologjik të jashtëzakonshëm të ringjalljes me një inkurajim praktik pastoral për nevojën e vazhdueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në jetët tona të përditshme të krishtera. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme! Gjendet një formë urdhërore e tashme e ndjekur nga dy forma pjesore të përdorura si forma urdhërore. Do t'ia vlejë gjithçka kur ne të shohim Atë dhe të mirëpritemi në Mbretërinë e përjetshme!

▣ “**duke tepruar**” Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

### **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Listoni katër aspektet e jetës së krishterë të gjendur tek 1 Kor. 15:1 dhe 2.
2. Listoni parimet kryesore të ungjillit të gjendura tek 1 Kor. 15:3 dhe 4.
3. Pse e konsideroi Pali vetveten të ishte më i vogli i apostuje?
4. Cila ishte baza e anëtarëve të kishës në Korint që mohonin ringjalljen?
5. Çfarë është tipologjia Adam-Krisht?
6. Çfarë do të thotë të pagëzosh të vdekurit?
7. A do të jenë trupat tanë të ringjalljes në formë njerëzore?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# 1 KORINTASVE 16

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Kontributi për Shenjtorët	Të Mbledhurit për Shenjtorët	Mesazhe Përfundimtare	Ofrimi për Besimtarët në Nevojë	Rekomandime, Përsëndetje
16:1-4	16:1-4	16:1-4	16:1-4	16:1-4
Plane për Udhëtim	Plane Personale		Planet e Palit	
16:5-9	16:5-12	16:5-9	16:5-7 16:8-9	16:5-9
16:10-11		16:10-11	16:10-11	16:10-12
16:12		16:12	16:12	
Kërkesë dhe Përsëndetje të Fundit	Nxitje të Fundit		Fjalë Përfundimtare	
16:13-14	16:13-18	16:13-14	16:13-14	16:13-14
16:15-18		16:15-18	16:15-16 16:17-18	16:15-18
	Përsëndetje dhe një Lamtumirë Solemne			
16:19-20	16:19-24	16:19-20	16:19-20a 16:20b	16:19-20
16:21-24		16:21-24	16:21 16:22a 16:23 16:24	16:21 16:22 16:23 16:24

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### HYRJE

- A. Kapitulli 15 është një argument teologjik tejet i zhvilluar i cili trajton realitetin e ringjalljes ndërkohë që kapitulli 16 lidhet me krishtërimin praktik të përditshëm. Pali nuk ka asnjë problem që të lëvizë midis së vërtetës dhe jetës. Ato duhet të mbahen së bashku. Ky lloj ndryshimi i menjëhershëm nga një temë në një tjetër karakterizon shkrimet e Palit.

B. Skicim i shkurtër:

- a. 1 Kor. 16:1-4, të mbledhurit për judenjtë e varfër
- b. 1 Kor. 16:5-9, plane të mundshme për të udhëtuar për në Korint
- c. 1 Kor. 16:10-12, punëtorë të tjerë të krishterë
- d. 1 Kor. 16:13-18, këshillime të fundit
- e. 1 Kor. 16:19-24, përshëndetje përmbyllëse

C. Marrëdhënia e Palit me Akuilën dhe Prishilën:

- a. Ata ishin tendë-bërës hebrej (ose punues lëkure) në Romë. Dekreti i Klaudius-it i viteve 49-50 pas lindjes së Krishtit, i cili ndalonte të gjitha praktikat hebraike të adhurimit (i cili në këtë periudhë përfshinte veprimtaritë e kishës), i detyroi ata të lëvizin.
- b. Ata takuan Palin në Korint, Veprat e Apo. 18:2.
- c. Ata më vonë lëvizën për në Efes dhe filluan një kishë shtëpi, 1 Kor. 16:19.
- d. Ata u rikthyen në Romë pasi Klaudius-i vdiq në vitin 54 pas lindjes së Krishtit dhe dekreti u shfuqizua, Rom. 16:6.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:1-4

<sup>1</sup> Sa për të mbledhurit e ndihmave për shenjtorët, bëni edhe ju ashtu si i urdhërova kishat e Galatisë. <sup>2</sup> Të parën ditë të çdo jave, secili nga ju le të vërë mënjanë aq sa mundet sipas të ardhurave të tij, që, kur të vij, të mos bëhen atëherë mbledhje ndihmash. <sup>3</sup> Edhe, kur të vij, ata që ju do të miratoni, unë do t'i dërgoj me letra, që të çojnë në Jeruzalem dhuratën tuaj bujare. <sup>4</sup> Dhe po të jetë e udhës që të shkoj vetë, ata do të shkojnë me mua.

**16:1 “Tani sa për”** “*Peri de*” është një frazë greke e cila nis përgjigjet e Palit ndaj pyetjeve të cilat kisha korintase i kishte dërguar Palit (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12).

▣ **“të mbledhurit”** *Logia* është një term i cili është gjendur në papirusët grekë në Egjipt si një dhuratë parash për një qëllim fetar, por jo e lidhur me një taksë të rregullt (Moulton, Milligan, *The Vocabulary of the Greek Testament* [Fjalori i Dhjatës Greke], fq. 377). Pali së pari përmend këtë shqetësim për të varfërit në Jude në një bisedë me Jakobin, Pjetrin, Gjonin dhe Barnabën tek Gal. 2:10; 6:10. Ky ofrim specifik u nis nga kisha në Antioki ku Pali dhe Barnaba shërbyen, Veprat e Apo. 11:27-30. Ky ofrim përmendet në disa libra të Dhjatës së Re (shih Rom. 15:26; 2 Kor. 8-9; 1 Kor. 16:1). Ishte një përpjekje për të vulosur marrëdhënien midis kishës mëmë hebraike dhe kishave johebraike.

Pali e quan këtë kontribut të një-hershëm me emra të ndryshëm.

1. Oferta për të varfërit (dhuratat e bamirësisë), Veprat e Apo. 24:17
2. Bashkësi, Rom. 15:26,27; 2 Kor. 8:4; 9:13
3. Një vënie në borxh, Rom. 15:27
4. Shërbesa, Rom. 15:27; 2 Kor. 9:12

▣ **“për shenjtorët”** “Shenjtorët” (*hagioi*) është nga termi i Dhjatës së Vjetër “i shenjtë” (*kadosh*) që do të thoshte “vënë mënjanë për shërbesën e Perëndisë” (shih 1 Kor. 1:2; 2 Kor. 1:1; Rom. 1:1; Efe. 1:1; Fil. 1:1; Kol. 1:2). Është gjithmonë në shumës në Dhjatën e Re përveçse një herë tek Filipianët (4:21), por edhe atje, përdoret në mënyrë kolektive. Të shpëtohesh do të thotë të jesh pjesë e bashkësisë së besëlidhjes së besimit, familjes së besimtarëve.

Populli i Perëndisë është i shenjtë për shkak të drejtësisë të ngaruar nga Jezusi (shih Romakëve 4; 2 Kor. 5:21). Është vullneti i Perëndisë që ata të jetojnë jetë të shenjta (shih 1 Kor. 1:4; 4:1; 5:27; Kol. 1:22; 3:12). Besimtarët deklarohen si të shenjtë (shenjtërim pozicional) ashtu edhe thirren për një stil jetese shenjtërie (shenjtërim progresiv). Drejtësimi dhe shenjtërimi duhet të mbahen fort së bashku! Shih Temën e Veçantë: Shenjtorë / Special Topic: Saints tek 1 Kor. 1:2 dhe Temën e Veçantë: Shenjtërim / Special Topic: Sanctification tek 1 Kor. 1:2.

▣ **“si i urdhërova kishat e Galatisë”** Pali nuk po e trajtonte ndryshe kishën në Korint. Kishte një procedurë standarte (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:34; 14:33; Titit 1:5) në këtë ofrim. Ne nuk e dimë se si ua komunikoi Pali këtë kishave galatase. Në fakt, ne nuk jemi të sigurtë se cilave kisha iu referohet ky term. Disa mendojnë se kjo i referohet provincës romake ndërkohë që të tjerë mendojnë se është një grup gjuhësor apo etnik.

▣ **“kishat”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

**16:2 “Të parën ditë të çdo jave”** Ky model adhurimi u vendos nga dukjet e hershme pas-ringjalljes të Jezusit në natën e së dielës (shih Gjoni 20:19,20). Ajo u bë një ditë e rregullt adhurimi për kishën që mbliidhej (shih Veprat e Apo. 20:7; Zbu. 1:10). E diela ishte dita e parë e punës e javës deri në periudhën Kostandiniane (Perandor i Perandorisë Romake në periudhën 306-337 pas lindjes së Krishtit). Të krishterët takoheshin përpara punës të dielave për adhurim, predikim dhe Darkën e Zotit.

Drejtimesit hebrenj u riorganizuan pas rënies së Jeruzalemit në vitin 70 pas lindjes së Krishtit dhe inauguruan disa reforma. Një prej tyre ishte një betim i cili mallkonte dhe refuzonte Jezus Mesian. Besimtarët e hershëm takoheshin me sinagogën në ditën e Shabatit dhe me kishën të dielën. Megjithatë, ky betim detyroi një ndarje dhe besimtarët e bënë të dielën ditën e tyre të caktuar të adhurimit.

▣ **“secili nga ju le të vërë mënjanë dhe të kursejë”<sup>46</sup>** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme e ndjekur nga një pjesore aktive e tashme e përdorur si një formë urdhërore. Ky tekst duket se nënkupton se kur të vinte fillimi i javës, secili individ duhet të vinte mënjanë një ofertë në një vend të sigurtë në shtëpi, që më vonë do të çohet në kishë. Megjithatë, fakti që ishte ditën e dielë nënkupton se ata depozitonin fonde të mbledhura çdo ditë në shërbesat javore të adhurimit (shih Justin Martyr, *Apology* [Apologji] 1.67-68). Vini re se ky varg i shkurtër i kombinuar me 2 Korintasve 8 dhe 9 na jep udhëzimet bazë të Dhjatës së Re për dhënien: (1) rregullisht; (2) si prioritet; (3) në mënyrë vullnetare; (4) plot gëzim dhe (5) në mënyrë proporcionale.

Është befasuese që autorët e Dhjatës së Re nuk diskutojnë dhënien e rregullt të krishterë. Fjalët inkurajuese të Palit dhe procedura për dhuratën një-herë të kishave johebraike ndaj kishës mëmë në Jeruzalem janë të vetmet udhëzime të lidhura me këtë temë. Të krishterët kuptuan se ata nuk kishin asgjë dhe ishin kujdestarë të të gjithë burimeve të tyre. Kjo e kuptuar zëvendësoi konceptin e Dhjatës së Vjetër të “dhënies së të dhjetës”. Është sigurisht e vërtetë që mund të dallohen prioritetet e një personi nga mënyra se si ai shpenzon dhe nga kalendari i tij! E dhëna e krishterë është një çështje e një zemre që derdhet, jo një makinë llogaritëse!

#### **TEMË E VEÇANTË: TË JAPËSH TË DHJETËN (SPECIAL TOPIC: TITHING)**

Dhjata e Re ka pak referenca ndaj dhënies së të dhjetës. Unë nuk besoj se Dhjata e Re e mëson dhënien e së dhjetës për shkak se e gjithë kjo rrethanë është kundër “tërheqjes” së legalizmit dhe vetë-drejtësisë hebraike (dmth., Mat. 23:13-36). Unë besoj se udhëzimet e Dhjatës së Re për të dhënë rregullisht (nëse ka ndonjë) gjenden tek 2 Korintasve 8 dhe 9 (dmth., duke iu referuar dhuratës së një-hershme të kishave johebraike ndaj të varfërve të Kishës Mëme në Jeruzalem), të cilat shkojnë shumë përtej dhënies së një të dhjetës! Nëse një hebreu që kishte vetëm informacionin e Dhjatës së Vjetër urdhërohej të jepte dhjetë deri në tridhjetë përqind (gjenden dy, ndoshta tre, të dhjeta të kërkuara në Dhjatën e Vjetër; shih Temën e Veçantë: Dhënia e të Dhjetës sipas Ligjit Mozaik / Special Topic: Tithes in the Mosaic Legislation), atëherë të krishterët duhet të japin shumë përtej dhe madje as të mos e diskutojnë dhënien e së dhjetës!

Besimtarët e Dhjatës së Re duhet të tregohen të kujdesshëm për të mos e kthyer krishtërimin në një kod të ri ligjor të orientuar drejt performancës (Talmud i krishterë). Dëshira e tyre për të kënaqur Perëndinë i bën ata që të përpiqen të gjejnë udhëzime për çdo zonë të jetës. Megjithatë, teologjikisht është e rrezikshme të tërheqësh rregulla të besëlidhjes së vjetër të cilat nuk rikonfirmohen në Dhjatën e Re (dmth., Këshilli i Jeruzalemit për Veprat e Apostujve 15) dhe t’i bësh ato kritere dogmatike, sidomos kur ato deklarohen (nga predikues modernë) që shkaktojnë fatkeqësi ose premtime të begatisë (shih Malakia 3).

Më poshtë është një citim i mirë nga Frank Stagg, *New Testament Theology*, fq. 292-293.

<sup>46</sup> “dhe të kursejë” mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)



“Dhjata e Re nuk e prezanton as edhe një herë dhënien e së dhjetës në hirin e të dhënit. Të dhjetat përmenden vetëm tre herë në Dhjatën e Re:

1. Në censorimin e farisenjve për lënien pas dore të drejtësisë, mëshirës dhe besimit ndërkohë që japin kujdes tepër të përpiktë ndaj dhënies së të dhjetës madje edhe të prodhimeve të kopështit (Mat. 23:23; Luka 11:42)
2. Në ekspozimin e fariseut krenar që “lutej me vete”, duke u mburur që ai agjëronte dy herë në javë dhe jepte të dhjetën e gjithçkaje që kishte (Luka 18:12)
3. Në diskutimin për superioritetin e Melkizedekut, dhe si rrjedhojë e Krishtit, ndaj Levit (Heb. 7:6-9).

“Është e qartë që Jezusi aprovonte dhënien e së dhjetës si pjesë e sistemit të Tempullit, thjesht si parim dhe praktikë që ai mbështeste praktikave të përgjithshme të Tempullit dhe të sinagogave. Por nuk ka asnjë tregues që ai impononte ndonjë pjesë të praktikave të Tempullit mbi ndjekësit e tij. Dhëniet e së dhjetave ishin kryesisht prodhime, të cilat më parë konsumoheshin në vendin e shenjtë nga personi që po jepte të dhjetën dhe më pas nga priftërinjtë. Dhënia e së dhjetës sikurse vendosur në Dhjatën e Vjetër mund të bëhej vetëm në një sistem fetar të ndërtuar rreth një sistemi sakrifikimi të kafshëve.”

“Shumë të krishterëve iu duket e dhjeta se ishte një plan i drejtë dhe i realizueshëm për të dhënë. Për sa kohë që nuk bëhet një sistem detyrues ose legalistik, ai mund të vërtetohet se është një plan i gëzueshëm. Megjithatë, një person nuk mund të deklarojë plot vlefshmëri se dhënia e së dhjetës mësohet në Dhjatën e Re. Ajo dallohet si e duhur për praktikave hebraike (Mat. 23:23; Luka 11:42), por nuk imponohet mbi të krishterët. Në fakt, tani është e pamundur që hebrenjtë ose të krishterët të japin të dhjetën në kuptimin e Dhjatës së Vjetër. Të japësh të dhjetën reflekton vetëm pak praktikën rituale antike që i përket sistemit sakrifikues të hebrenjve.”

Stagg përmbledh si më poshtë.

“Ndërkohë që shumë mund të jetë thënë për zbatimin e së dhjetës vullnetarisht si një standard për dhënien pa e imponuar atë ngurtësisht mbi të tjerët si një kërkesë e krishterë, është e qartë se marrja e një praktike të tillë nuk përbën zbatim të praktikës së Dhjatës së Vjetër. Maksimumi po bëhet diçka që vetëm paksa është analoge me praktikën e dhënies së të dhjetës në Dhjatën e Vjetër, që ishte një taksë për të mbështetur Tempullin dhe sistemin priftëror, një sistem social dhe fetar që nuk ekziston më. Dhëniet e së dhjetës ishin të detyruara në judaizëm si një taksë deri në shkatërrimin e Tempullit në vitin 70 pas lindjes së Krishtit, por si rrjedhojë e kësaj nuk janë detyruese për të krishterët.

“Ky nuk është një zhvlerësim i dhënies së të dhjetës, por për të qartësuar marrëdhënien e saj me Dhjatën e Re. Ky është një argument për të mohuar se Dhjata e Re mbështet motivin detyrues, legalistik, përfitues dhe natyrën e ujdisë që aq shpesh karakterizon thirrjet për dhënien e së dhjetës sot. Si një sistem vullnetar, dhënia e së dhjetës ofron shumë; por ajo duhet të bëhet me hir nëse do të jetë e krishterë. Të mbrosh se ‘ajo funksionon’ është vetëm një mënyrë për të marrë teste pragmatike të botës. Shumë gjëra që ‘funksionojnë’ nuk janë të krishtera. Dhënia e së dhjetës, nëse duhet të jetë në përputhje me teologjinë e Dhjatës së Re, duhet të rrënjoset në hirin dhe dashurinë e Perëndisë.”

**NASB, NKJV** “sipas begatisë që ai ka”  
**NRSV** “çfarëdo që keni shtesë”  
**TEV** “në proporcion me atë që keni fituar”  
**NJB** “sa mund të kurseni”

Kjo është fjalë për fjalë “çfarëdo nëse ai mund ketë begati” (A. T. Robertson, *Word Pictures In the New Testament* [Fjalë në Pamje në Dhjatën e Re], thotë: “është e pasigurtë se çfarë forme gramatikore është *eudō tai*, lidhore pasive e tashme, treguese pasive e përkryer apo madje lidhore pasive e përkryer” fq. 200). Kjo ishte një shprehje greke me të cilën i urohej dikujt një udhëtim i gëzueshëm dhe me sukses (për qëllime tregtare). Pali po e përdor atë si një parim të dhënies së krishterë (dmth., sipas mundësisë suaj, shih 2 Kor. 8:3,11).

■ **“që, kur të vij, të mos bëhen atëherë mbledhje ndihmash”** Pali gjithmonë ishte i kujdesshëm për mënyrën e duhur të trajtuarit të parasë. Ndoshta ai (1) kishte parë probleme të zhvilloheshin në këtë aspekt ose (2) ishte akuzuar personalisht në lidhje me këtë temë. Ai nuk merrte para nga kishat me të cilat punonte aktualisht dhe gjithashtu kur kjo dhuratë çohet në Jeruzalem ai dëshironte që përfaqësues të kishave të ndryshme ta shoqëronin atë. Ai madje nuk ishte as i sigurtë që do të shkonte vetë (shih 1 Kor. 16:4).

**16:3 “ata që ju do të miratoni, unë do t’i dërgoj me letra, që të çojnë në Jeruzalem dhuratën tuaj”** Ky varg është një përzjerje interesante e autoritetit apostolik dhe autoritetit të grigjës. Është debatuar se kush i shkroi letrat e rekomandimit, Pali apo kisha (shih Veprat e Apo. 18:27). Të dyja janë gramatikisht të mundura. Versionet King James Version dhe RSV supozojnë se ishte kisha ndërkohë që versionet Williams NT, TEV, NIV, NJB dhe REB supozojnë se ishte Pali. Pali dëshiron që kisha të zgjedhë përfaqësues që të shoqërojnë ofertën në mënyrë që ai të mos akuzohet për motive të gabuara, sikurse është akuzuar aq shpesh nga kjo kishë (shih 1 Kor. 9:3-18). Pali shpesh shkroi letra rekomandimi për bashkë-punëtorët e tij (shih Rom. 16:1; 2 Kor. 3:1; ;8:18-24; dhe shembuj të tjerë, Veprat e Apo. 9:2; 22:5; 3 Gjoni). Pali e përdor këtë koncept në mënyrë metaforike tek 2 Kor. 3:1 në kuptimin që kishat e tij funksionuese ishin letra e tij e rekomandimit. Dukshëm, apostulli Gjon gjithashtu zbatoi këtë lloj letrë (shih 3 Gjoni 9). Në një farë kuptimi, kjo ishte metoda me anë të së cilës kishat e hershme konfirmonin shërbenjësit e tyre të ungjillit të cilët ishin në udhëtim.

**16:4 “po të”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila do të thoshte veprim i mundshëm.

NASB	“më përshtatet që të shkoj”
NKJV	“përshtatet që të shkoj”
NRSV	“duket e këshillueshme”
TEV	“duket e vlefshme”
NJB	“ia vlen që unë të shkoj”

Kjo duket se lidhet me (1) përmasat e ofertës; (2) personi që nisi ofertën e shoqëron atë ose (3) Pali dëshiron që kjo kishë, e cila kishte kaq shumë probleme me autoritetin e tij, të dallonte rolin e tij të duhur dhe besueshmërinë e tij.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:5-9

<sup>5</sup> Edhe unë do të vij te ju, pasi të kem kaluar nëpër Maqedoni. <sup>6</sup> Dhe ndoshta do të rri te ju, ose edhe të dimërojmë, që ju të më përcillni kudo që të shkojmë. <sup>7</sup> Sepse kësaj here nuk dua t’ju shoh vetëm kalimthi, por shpresoj të rri pak kohë pranë jush, në dashtë Zotit. <sup>8</sup> Dhe unë do të rri në Efes deri për Rrëshajët, <sup>9</sup> sepse m’u hap një derë e madhe dhe e efektshme, dhe kundërshtarë ka shumë.

**16:5-9** Pali po shkruante nga Efesi në udhëtimin e tij të tretë misionar. Ai më vonë u sulmua nga një grup brenda kishës në Korint për shkak të këtyre planeve të udhëtimit “të paqëndrueshme” (shih 2 Kor. 1:15 e në vazhdim). Ai së pari do të merrte rrugën e detit për në Korint dhe më pas do të kalonte përmes Maqedonisë, por duke qënë se ai dëshironte të qëndronte më gjatë, ai vendosi të shkojë nga rruga tokësore përmes Maqedonisë fillimisht dhe më pas në Korint. Ai qëndroi gjatë dimrit atje (shih Veprat e Apo. 20:2,3). Disa në kishë përdornin pavendosmërinë e Palit në planet e tij të udhëtimit për të sulmuar teologjinë e tij (dmth., ungjillin).

**16:6 “që ju të më përcillni kudo që të shkojmë”** Folja *propempō* përdoret si një term teknik për të furnizuar nevojat e udhëtimit të shërbetarëve në lëvizje të Perëndisë (shih 1 Kor. 16:11, “përcilleni”, shih Veprat e Apo. 15:3; Rom. 15:24; 2 Kor. 1:16; Titit 3:13; 3 Gjoni 6).

**16:7 “në dashtë Zotit”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila do të thotë veprim i mundshëm. Kjo nuk ishte një frazë e rëndomtë me të krishterët e Dhjatës së Re. Ata besonin se hapat e tyre drejtoheshin si me porosi nga Zoti (shih Veprat e Apo. 18:21; 1 Kor. 4:19; Jakobi 4:14; Heb. 6:3).

**16:8 “Rrëshajët”** Ky term zakonisht do të thotë “i pesëdhjetë”. Ai i referohet festivalit të të korrave të grurit (dmth., Festës së Javës, shih Num. 28:26) të hebrenjve që ndodhte 50 ditë pas ditës së dytë të Festës së Bukës pa

Maja (dmth., *Nisan* 16). Në këtë kontekst duket se përdoret si një metodë për të datuar planet e udhëtimit të Palit dhe jo për të siguruar që Pali ende po zbaton këto ditë feste hebraike.

**16:9**

**NASB** “sepse një derë e gjerë për *shërbesë* të frytshme më është hapur”  
**NKJV** “sepse m’u hap një derë e madhe dhe e efektshme”  
**NRSV** “sepse një derë e gjerë për punë të frytshme më është hapur”  
**TEV** “Gjendet një mundësi e vërtetë këtu për punë të madhe dhe të vlefshme”  
**NJB** “një derë shumë premtuese po qëndron e hapur ndaj meje”

Kjo është një formë treguese aktive e përkryer. Përdorimi i termit “derë” si një metaforë për mundësinë është i zakonit në Dhjatën e Re (shih Veprat e Apo. 14:27; 2 Kor. 2:12; Kol. 4:3; Zbu. 3:8).

#### TEMË E VEÇANTË: “DERA” NË DHJATËN E RE (SPECIAL TOPIC: “DOOR” IN THE NT)

Dhjata e Re përdor “derë” në disa kuptime.

1. Të drejtpërdrejtë
  - a. Të shtëpive, Mat. 6:6; Mark 1:33; 2:2; 11:7, dhoma e epërme, Gjoni 20:19,26
  - b. Të tempullit, Veprat e Apo. 3:2; 21:30
  - c. Të një burgu, Veprat e Apo. 5:19,23; 12:6; 16:26-27
  - d. Të një varri, Mat. 27:60; 28:2; Mark 15:46; 16:3
  - e. Të një vathe, Gjoni 10:1,2
  - f. Të një oborri, Gjoni 18:16; Veprat e Apo. 12:13
2. Metaforik
  - a. Afërsi e kohës, Mat. 24:33; Mark 13:29; Veprat e Apo. 5:9; Jakobi 5:9
  - b. Kufizimi i hyrjes për në besimin e vërtetë, Mat. 7:13-14; Luka 13:24; Zbu. 3:20
  - c. Mundësia e ruajtjes së besimit të humbur, Mat. 25:10; Luka 13:25; Zbu. 3:7
  - d. Mundësia e ruajtjes së besimit, Veprat e Apo. 14:27; Zbu. 3:7
  - e. Mundësia e shërbesës, 1 Kor. 16:9; 2 Kor.2:12; Kol. 4:3; Zbu. 3:8
  - f. Zbulesa, Zbu. 4:1; 19:11
3. Titull për Jezusin, Gjoni 10:7,9

▣ **“kundërshtarë ka shumë”** Mundësitë e Perëndisë shpesh shoqërohen me kundërshti. Për rrethanën specifike historike lexoni Veprat e Apo. 19:19-20; 20:19,23.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:10-11

<sup>10</sup> Tani, nëse vjen Timoteu, kujdesuni që të rrijë me ju pa druajtje, sepse ai punon për veprën e Zotit ashtu si unë. <sup>11</sup> Pra, asnjë të mos e përçmojë, por përcillen në paqe që të vijë tek unë, sepse e pres bashkë me vëllezërit.

**16:10 “nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, që do të thotë veprim i mundshëm. Duket se Pali tashmë e kishte dërguar Timoteun dhe Erastin (shih Veprat e Apo. 19:22), dhe ndoshta Titin (shih 2 Kor. 2:13; 7:6,7) për në Korint me anë të rrugës tokësore. Ai po dërgonte letrën e tij nëpërmjet detit dhe ajo do të arrinte më shpejt.

▣ **“kujdesuni që të rrijë me ju pa druajtje”** Pali e vendos këtë në formën e një urdhërimi (dmth., urdhërore aktive e tashme). Ai e dinte personalisht se sa e ashpër mund të ishte kisha. Ai nuk dëshironte që ky ndihmës i ri të fyej për shkak të (1) moshës së tij; (2) personalitetit të tij apo (3) zemërimit të tyre ndaj Palit (shih 1 Kor. 16:11).

**16:11**

**NASB, NKJV, NRSV** “asnjë të mos e përçmojë”

**TEV** “asnjë nuk duhet ta shohë me përçmim”  
**NJB** “asnjë nuk duhet ta nënvlerësojë atë”

Kjo është një formë lidhore aktive aoriste, e cila fjalë për fjalë do të thotë “ta bësh asgjë” (shih 1 Kor. 1:28; 1 Tim. 4:12; Titit 2:15).

▣ **“me vëllezërit”** Ne nuk jemi të sigurtë se cilët përfshinte kjo. Ndoshta është Erasti (shih Veprat e Apo. 19:22, dhe Titit, 2 Kor. 2:13; 7:6-7), por kush tjetër, nëse ishte dhe dikush tjetër, është e pasigurtë.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:12**

<sup>12</sup> Sa për vëllanë Apol, iu luta shumë që të vijë tek ju bashkë me vëllezërit, por ai s’desi kurrsesi të vinte tani; por do të vijë kur ta ketë volinë.

**16:12 “Sa për”** Kjo është një tjetër përgjigje ndaj një pyetjeje të bërë nga kisha korintase (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12).

▣ **“Apol”** Ky ishte një predikues tejet i shkolluar dhe elokuent nga Aleksandria, Egjipti. Ai ishte në Korint më parë (shih 18:24-19:1), por ai refuzoi të kthehej (shih 1 Kor. 16:12).

▣ **“dhe nuk ishte aspak dëshira e tij të vinte tani”<sup>47</sup>** Teksti mund të interpretohet në dy mënyra: (1) nuk ishte vullneti i Apolit të vinte ose (2) nuk ishte vullneti i Perëndisë që ai të vinte. Nga ky varg duket se Apoli e kishte lënë Efesin midis kohës që Pali foli me të dhe kohës në të cilën është shkruar kjo letër.

**VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:13-14**

<sup>13</sup> Rrini zgjuar, qëndroni të palëkundshëm në besim, silluni si burrat, jini të fortë. <sup>14</sup> Dhe çdo gjë që bëni, ta bëni me dashuri!

**16:13-14** Kjo është një seri prej pesë formash urdhëruese të tashme. Ato janë shumë të ngjashme me paralajmërimet praktike të 1 Kor. 15:58. Katër të parat janë në vetën e tretë shumës dhe kanë një sfond ushtarak. E fundit është në vetën e dytë njëjës dhe duket se i drejtohet kishës kolektive.

**16:13**  
**NASB** “Rrini të vëmendshëm”  
**NKJV** “shihni”  
**NRSV** “mbani vëmendje”  
**TEV** “jini të vëmendshëm”  
**NJB** “rrini zgjuar”

Kjo është një formë urdhëruese aktive e tashme. Kuptimi i saj bazë është të zgjosh, e përdorur në kuptimin e “kini kujdes” (shih Mat. 24:42; 25:13; 26:38,40,48; Mark 13:35,37; 14:34,37,38). Pali po i paralajmëron ata që të qëndrojnë të vëmendshëm dhe të rrinë zgjuar ndaj ndonjë fryme grupimi, herezie, papërmbytje dhe krenarie!

**NASB, TEV** “qëndroni të palëkundshëm në besim”  
**NKJV** “qëndroni të fortë në besim”  
**NRSV** “qëndroni fort në besimin tuaj”  
**NJB** “qëndroni të palëkundshëm në besim”

Kjo është një tjetër formë urdhëruese aktive e tashme. Ajo është termi ushtarak për mbajtjen e pozicionit nga dikush. “Në besim” i referohet së vërtetës së krishterë ose doktrinës së krishterë (shih Juda 1:3, 20).  
Shih TEMË E VEÇANTË: QËNDROJ (*HISTËMI*) / SPECIAL TOPIC: STAND (*HISTËMI*) tek 1 Kor. 15:1.

<sup>47</sup> Versioni në shqip është: “por ai s’desi kurrsesi të vinte tani”. (shënim i përkthyesit)

■ **“silluni si burrat”** Kjo është një formë urdhërore aktive e mesme (deponente). Ky është i vetmi rast i përdorimit të termit në Dhjatën e Re. Është forma foljore e termit *anēr*, i cili do të thoshte një burrë i pjekur ose një bashkëshort. Ajo shfaqet tek LXX tek Joz. 1:6. Nuk është një formë gjinore (dmth., që t’i referohet vetëm meshkujve), por inkurajon të gjithë kishën që të sillet në mënyrë të përshtatshme si besimtarë të pjekur dhe guximtarë.

■ **“jini të fortë”** Kjo është një formë urdhërore pasive e tashme.

### TEMË E VEÇANTË: JINI TË FORTË (SPECIAL TOPIC: BE MADE STRONG)

Ky term (*krataioō*) në formën pasive përdoret disa herë në Dhjatën e Re për kuptime të ndryshme.

1. Zhvillimi natyror i Jezusit si një qenie njerëzore, Luka 1:80; 2:40
2. Besimtarët e forcuar nga Fryma e Shenjtë, Efe. 3:16
3. Besimtarët të jenë të fortë ose të patundur në besimin e tyre në përballje me shtrëngimet e brëndshme në kishën korintase, 1 Kor. 16:13

**16:14 “Dhe çdo gjë që bëni, ta bëni me dashuri”** Vini re “çdo gjë” vendoset përballë në tekstin grek për ta theksuar atë. Në një situatë fetare dhe kulturore aq dinamike, e shumëllojshme dhe problematike sa Korinti, dashuria është thelbësore. Kjo është një tjetër formë urdhërore e mesme e tashme (deponente). Ortodoksia dhe ortopraksia pa dashurinë nuk janë vullneti apo mënyra e Perëndisë (shih 1 Kor. 14:1)! Është e vështirë të kuptosh se mjeti (për të krishterët) është po aq thelbësor sa edhe qëllimi.

### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:15-18

<sup>15</sup> Tani, o vëllezër (ju e njihni familjen e Stefanas që është fryti i parë i Akaisë dhe që i janë kushtuar shërbesës së shenjtoreve), <sup>16</sup> ju bëj thirrje që t’u nënshtroheni edhe ju atyreve dhe kujt do që punon dhe mundohet në punën tonë të përbashkët. <sup>17</sup> Edhe gëzohem për ardhjen e Stefanas, të Fortunatit dhe të Akaikut, sepse ata e plotësuan mungesën tuaj, <sup>18</sup> sepse e freskuan frymën tim dhe tuajin; prandaj nderoni njerëz të tillë.

**16:15 “ju bëj thirrje”<sup>48</sup>** Kjo shkon me 1 Kor. 16:16. Pali ka përfshirë një mendim në kllapa mbi shtëpinë e Stefanasit.

■ **“o vëllezër”** NRSV ka “vëllezër dhe motra”, që është edhe qëllimi i Palit për t’iu adresuar të gjithë kishës. Pali e përdor këtë fjalë në letrat e tij për të nisur një temë të re ose një zhvillim të ri në prezantimin e tij.

■ **“familjen e Stefanas”** Këta të konvertuar të hershëm (dmth., frytet e para) ishin dukshëm drejtues në kishën lokale. Pali përmend edhe besimtar të tjerë të hershëm tek Veprat e Apo. 17:34. Koncepti i “familjes” që konvertohej njëhershmi kur kreu i familjes konvertohet (shih Korneliusi, Veprat e Apo. 11:14-17; Lidia, Veprat e Apo. 16:14-15; i burgosuri filipian, Veprat e Apo. 16:31-33) është shpesh i vështirë për ungjilltarët të cilët theksojnë konvertimet individuale. Megjithatë, kultura është thelbësore në të kuptuarit jo vetëm se si besimi familjar funksionon, por gjithashtu edhe besimi fisnor. Perëndia nuk është i kufizuar ndaj individualizmit modern perëndimor apo i impresionuar së tepërmi prej tij! Kjo është kaq e dhimbshme për të menduarit dhe dogmatizmin tonë parokial!

Koncepti i konvertimeve “familjare” përdoret nga denominacionet për të konfirmuar pagëzimin e foshnjeve. Zakonisht ritet e rrethprerjes së Izraelit gjithashtu përfshijnë fëmijët tetë-ditësh në familjen e Izraelit. Ndoshta biblikisht fillimi duhet të shihet nga fundi. Besimi i vërtetë rritet, pendohet, beson, bindet dhe qëndron. Besimi i vërtetë shihet nga frytet e tij, jo vetëm nga ritet e tij që e nisin atë (shih 1 Kor. 16:16b dhe Jakobi dhe 1 Gjoni).

<sup>48</sup> Në versionin në shqip kjo pjesë gjendet tek vargu 16. (shënim i përkthyesit)

■ **“që i janë kushtuar shërbesës”** Kjo është një frazë shumë interesante. Termi “përkushtuar” është *tassō*, që zakonisht do të thotë “caktoj”. Besimi, besimi i vërtetë, e sheh qëllimin e tij në shërbesë! Të kuptosh ungjillin kërkon një gatishmëri për të dhënë veten tonë në shërbesë për të tjerët ashtu siç Jezusi dha Vetveten për ne (shih 1 Gjonit 3:16). Ky është një zhvillim normal i besimit, por jo përjashtimor. Sikurse grupimet (dmth., elita korintase) kërkonte vetë-interesin, vetë-promovimin, vetë-drejtimin, besimi i vërtetë kërkon dashurinë (shih 1 Kor. 14:4; 16:14). Besimtarët shpëtohen dhe pajisen me dhunti për Urdhërimin e Madh (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8) dhe të mirën e përbashkët të trupit të Krishtit, kishën (shih 1 Kor. 12:7). Stefanasi dhe familja e tij vendosën që të përdorin burimet e tyre për mbretërinë. Nëse Stefanasi ishte një anëtar i pasur i klasës së elitës sociale atëherë veprimet e tij modelonin mesimet e Palit. Ai u bë modeli për anëtarët e tjerë të pasur elitë të kishës (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin], fq. 184-205). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 4:1.

■ **“shërbesës”** Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

■ **“shenjtorëve”** Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË / SPECIAL TOPIC: SAINTS tek 1 Kor. 1:2.

**16:16 “që t’u nënshtroheni edhe ju atyreve”** Kjo është një formë lidhore pasive e tashme. “Nënshttrim” (*hupotassō*) është një term ushtarak për të lidhur vetveten nën urdhërin e një komande. Në letrat e Palit ndaj Korintasve ajo përdoret për

1. Frymërat e profetëve në nënshttrim ndaj profetëve, 1 Kor. 14:32
2. Të gjitha gjërat nënshtrohet Jezusit, 1 Kor. 15:27
3. Jezusi i nënshtrohet Atit, 1 Kor. 15:28
4. Besimtarët nënshtrohet drejtuesve të perëndishëm, 1 Kor. 16:16

Mund të gjendet një lojë fjalësh midis drejtuesve “që i janë kushtuar shërbesës” (nga *tassō*) dhe “besimtarëve që nënshtrojnë vetveten (*hupo* plus *tassō*) ndaj drejtuesve të perëndishëm” (shih 2 Kor. 9:12-13). Shih TEMË E VEÇANTË: NËNSHTRIMI / Special Topic: Submission tek 2 Kor. 9:13.

Kjo kishë kishte probleme në zonën e trajtimit dhe respektit të duhur të drejtuesve të saj të vërtetë (shih 1 Kor. 16:18; 1 Thes. 5:12; Heb. 13:17). Letra e Klementit të Romës, e shkruar ndaj po së njëjtës kishë 40 vjet më vonë, tregon se ata ende kishin të njëjtin problem.

**16:17 “Stefanas, të Fortunatit dhe të Akaikut”** Disa kanë pohuar se dy emrat e fundit, për të cilët nuk lexojmë asgjë tjetër në Dhjatën e Re, ishin anëtarë të familjes së Stefanasit. Disa pohojnë se ata ishin të tre skllevër, por kjo nuk mund të provohet. Ata duket se kanë sjellë letrën nga kisha Korintase te Pali. Pali kishte marrë disa informacione mbi kishën nga njerëzit e Kloes. Klementi i Romës i shkroi Korintit rreth 40 vjet më vonë dhe ai përmend një presbiter të quajtur Fortunati.

■ **“ata e plotësuan mungesën tuaj”** Kjo frazë tingëllon negativisht në anglisht, por nuk ka këtë qëllim. Raportimi i tyre solli lajme tek Pali nga kisha të cilën ai e donte, madje me gjithë problemet e tyre (shih 1 Kor. 16:24). Ata funksiononin si përfaqësues të kishave tek Pali. Saktësisht se çfarë bënin ata për Palin me praninë e tyre, përveçse i sillnin atij gëzim (shih 1 Kor. 16:18), është e pasigurtë.

**16:18 “frymën tim dhe tuajin”** Është e dukshme nga konteksti se Pali po përdor “frymë” si një mënyrë për t’iu referuar vetvetes (shih 1 Kor. 2:11; 5:4; 2 Kor. 2:13; 7:13; Rom. 1:9; 8:16; Fil. 4:23).

NASB, NKJV	“nderoni njerëz të tillë”
NRSV	“jepini nderim personave të tillë”
TEV	“burra si këta meritojnë të dallohen”
NJB	“ju duhet të vlerësoni njerëz si ata”

Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme e “*ginōskō*” në kuptimin e dallimit (shih 2 Kor. 3:2) ose për të njohur dhe për të pranuar (shih 1 Kor. 8:3).

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:19-20

<sup>19</sup> Kishat e Azisë ju përshëndesin; Akuila dhe Prishila, bashkë me kishën që është në shtëpi të tyre, ju përshëndesin shumë në Zotin. <sup>20</sup> Të gjithë vëllezërit ju përshëndesin; përshëndetni njëri-tjetrin me një puthje të shenjtë.

**16:19 “Kishat e Azisë”** Kjo i referohet provincës romake të shekullit të parë të një të tretës perëndimore të shtetit modern të Turqisë.

■ **“Akuila dhe Prishila”** Akuila ishte një tendë-bërës hebre (ose punues lëkure), sikurse Pali. Të gjithë hebrenjve, edhe rabinëve, ju mësohej një zanat në mënyrë që ata të mos merrnin para për mësimdhënien e tyre.

Bashkëshortja e Akuilës, Prishila ose Priska, listohet katër herë nga gjashtë që ata përmenden (shih Veprat e Apo. 18:2,18,26; Rom. 16:3; 1 Kor. 16:19; 2 Tim. 4:19). Shumë kanë vënë re se emri i saj ishte një emër fisnik romak (*gens Prisca*). Që kur ajo përmendet herën e parë, që nuk është e zakonit për hebrenjtë, shumë kanë parë në ta një histori madhështore dashurie të një gruaje të pasur romake dhe një tendbërësi hebraik në lëvizje!

Textus Receptus ka Prishila, i cili është emri i saj tek Veprat e Apo. 18:2,18,26. Ai gjithashtu shfaqet tek Rom. 16:3 dhe këtu. Kjo ndjek dorëshkrimet greke A, C, D, F, G, K, L, përkthimet siriake, dhe pjesën më të madhe të dorëshkrimeve të mëvonshme me shkronja të vogla. Megjithatë, Pali e quan atë Priska, që gjendet tek dorëshkrimet P<sup>46</sup>, x, B, M dhe përkthimet Vulgate dhe Coptic. Shih Bruce Metzger, *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke], fq. 570.

■ **“kishën që është në shtëpi të tyre”** Kisha e hershme nuk kishte ndërtesa. Ata takoheshin në shtëpitë e tyre. Kjo ishte për shkak të

1. Mungesës së parave
2. Nevojës për fshehtësi, duke qënë se krishtërimi u bë fe e paligjshme në Perandorinë Romake që herët
3. Nevojës për shfaqje të legalitetit duke qënë se kishat e hershme organizoheshin si shoqëri sociale romake

Koncepti i kishës shtëpi fillon tek Veprat e Apo. 2:46; 5:4. Ai vazhdohet dhe zhvillohet tek Romakëve 16:5,23, Kol. 4:15; Filemon 2.

■ **“Të gjithë vëllezërit ju përshëndesin”** Kjo dukshëm i referohet të gjithë kishës, jo vetëm meshkujve.

**16:20 “përshëndetni njëri-tjetrin me një puthje të shenjtë”** Kjo formë e përshëndetjes publike (puthja në një rën ose të dyja faqet) dhe shenja e marrëdhënies mund të shihen në Dhjatën e Vjetër tek Eksod. 4:27. Ai mund të shihet në Ungjijt tek Marku 14:45. U bë e standartizuar në kishën e hershme (shih Rom.16:16; 2 Kor. 13:12; 1 Thes. 5:26; 1 Pjet. 5:14), që të ndiqte modelin e sinagogës. Burrat puthnin burrat dhe gratë puthnin gratë. U abuzua nga disa të krishterë dhe u keqkuptua nga jobesimtarët dhe më pas u hoq nga kisha e hershme. Megjithatë, ajo ende vazhdon në raste të veçanta në kishat lindore. Ekuivalenti modern perëndimor do të ishte një shtrëngim duarsh ose përqafim i ngrohtë.

#### VERSIONI SHQIP: 1 KORINTASVE 16:21-24

<sup>21</sup> Të fala me shëndet me dorën time, të Palit. <sup>22</sup> Nëse ndokush nuk e do Zotin Jezu Krisht, qoftë mallkuar! Maranatha. <sup>23</sup> Hiri i Zotit Jezu Krisht qoftë me ju. <sup>24</sup> Dashuria ime qoftë me ju të gjithë në Krishtin Jezu. Amen.

**16:21 “Të fala me shëndet me dorën time, të Palit”** Kjo ishte praktika e zakonit e Palit pasi diktonte korrespondencën e tij. Ishte një mënyrë për t'u siguruar për origjinalitetin e saj (shih Gal. 6:11; 2 Thes. 2:2; 3:17; Kol. 4:18; Filemon 19).

**16:22 “Nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Dukshëm disa në kishën korintase nuk e donin Zotin”

■ **“nuk e do”** Kjo është fjala greke “*phileō*”. Pali nuk e përdor këtë term për dashuri shumë shpesh (shih Titit 3:15). Për shkak të kësaj, shumë kanë supozuar se ai po citon një himn ose formulë liturgjike. Është e njëjta rrënjë sikurse “puthje” (*philēma*). “*Phileō*” në gjuhën koine greke u bë sinonim me “*agapaō*” (shih Gjoni 5:20; 16:27), por ka raste kur ende mund të ketë një dallim kontekstual (shih Gjoni 21:15-17).

■ **“mallkuar”** *“Anathema”* është një fjalë greke e cila reflekton termin hebraik *“herem”* ose diçka e kushtuar Perëndisë, e cila më pas bëhet e shenjtë dhe duhet shkatërruar (p.sh., Jeriko tek Joz. 6:17-19). Ai u përdor në kuptimin e një mallkimi hyjnor (shih Veprat e Apo. 22:12,14; Rom. 9:31; 1 Kor. 12:3; 16:22; Gal. 1:8-9). Ky pohim i fuqishëm mund të reflektojë praninë e mësuesve të rremë në Korint (shih 1 Kor. 12:3). Është e mundur që ai reflekton një praktikë të tashme në Korint. Shih shënimin mbi termin tek 1 Kor. 12:3.

■ **“Maranatha”** Jezusi dhe apostujt e hershëm flisnin gjuhën aramaike (jo hebraisht). U bë gjuha e zakonit që nga Perandoria Persiane. Gjenden disa fjalë / fraza në gjuhën aramaike të regjistruara në Dhjatën e Re.

1. *talitha kum* - Mark 5:41
2. *ephphatha* - Mark 7:34
3. *abba* - Mark 14:36; Rom. 8:15
4. *maranatha* - 1 Kor. 16:22.

Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: MARANATHA (SPECIAL TOPIC: MARANATHA)**

Kjo është një frazë në gjuhën aramaike e cila reflekton një konfirmim liturgjik teologjik të një kishe të hershme palestineze për (1) hyjësinë e Jezusit (Psalm 110) ose (2) Ardhjen e Dytë të Jezusit (Veprat e Apo. 3:19-21). Kuptimi i saj varet nga mënyra se si ndahet fjala:

1. *“Zoti ynë, eja”* (dmth., *marana-tha*) është kuptimi i një fraze të ngjashme urdhëruese tek Zbu. 22:20. Prandaj pjesa më e madhe e përkthimeve supozojnë kuptimin tek 1 Kor. 16:22. Nëse është kështu, atëherë do të ishte një lutje për rikthimin e Jezusit.
2. *“Zoti ynë ka ardhur”* (dmth., *maran-atha*), *do të ishte forma e PËRKRYER në gjuhën aramaike. Ky është përkthimi që Chrysostom (vitet 345-407 pas lindjes së Krishtit) preferonte, i cili flet për mishërimin e Jezusit.*
3. *“Zoti ynë po vjen”* i referohet një forme TË PËRKRYER PROFETIKE, e cila përdoret nga shumë për të supozuar një motiv për shërbesën e krishterë. Ardhja e Dytë gjithmonë ka qënë një inkurajim për besimtarët në çdo epokë.
4. Didache (i shkruar në fund të shekullit të parë ose të dytë) 10:6, përdor po të njëjtën frazë në kontekstin e Darkës së Zotit ku prania aktuale dhe ardhja e pritur eskatologjike e Jezusit, theksohen të dyja në lutje.

**16:23 “Hiri i Zotit Jezu Krisht”** Hapi i parë në interpretimin e Biblës është të vendosësh fjalët origjinale. Një burim ndihmues për këtë është *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke] të United Bible Societies, nga Bruce M. Metzger. Në mënyrë që të tregoj se sa ndihmues mund të jetë, me lejoni të citoj paragrafin mbi këtë varg.

“Textus Receptus, duke ndjekur  $\kappa^c$  A C D F G K L M pjesa më e madhe e dorëshkrimeve me shkronja të vogla, duke përfshirë 6 424<sup>c</sup> 920 1739, it<sup>d,g,r</sup> syr<sup>p,h</sup> cop<sup>8a,bo</sup> arm eth, lexohet Ἰησοῦ Χριστοῦ. Leximi më i shkurtër Ἰησοῦ, i cili mbështetet nga  $\kappa^*$  B 2 33 35 226 356 442 823 1611 1908 2002 vg goth *al*, duhet të preferohet. Duke parë praninë e leximit më të gjatë në bekimet e tjera Pauline (Rom. 16.24; 2 Kor. 13.13; Gal. 6.18; Fil. 4.23; I Thes. 5.28; 2 Thes. 3.18; Filem. 25), sikurse prirjen natyrore të skribëve për të zgjeruar emrat e shenjtë, është për t’u vënë re se cilido dëshmitar duhet t’i ketë qëndruar presioneve të tilla” (fq. 570).

**16:24 “Dashuria ime qoftë me ju të gjithë”** Kjo është një nga shprehjet e rralla të dashurisë personale të Palit. Vini re se ai shpreh dashuri ndaj të gjithëve në një kishë që kishte qënë aq e grupuar dhe plot urrejtje.

■ **“Amen”** Shih shënimin tek 1 Kor. 14:16.



## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Listoni pyetjet që kisha e Korintit i kishte shkruar Pali.
2. Cilat ishin burimet e ndryshme të informacionit për Palin rreth kushteve aktuale në kishën korintase?
3. Listoni udhëzimet për dhënien në Dhjatën e Re.
4. Pse ishte kaq i interesuar Pali në kontributin ndaj kishës në Jeruzalem?
5. Pse Pali vazhdonte të ruante ditët e festive hebraike pasi ai u shpëtua?
6. Si pajtohet vargu 16:15 me Veprat e Apo. 17:34?
7. Kush ishin Akuila dhe Priska?
8. Pse Pali përdor një frazë në gjuhën aramaike në një letër ndaj një kisha greke?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

# HYRJA TEK LETRA E DYTË DREJTUAR KORINTASVE

## POHIME HYRËSE

- A. Ky libër, më shumë se çdo letër tjetër e Palit, na tregon zemrën dhe mendjen e Apostullit për johebrenjtë. Është më e afërta që kemi ndaj autobiografisë së tij frymërore / pastorale.
- B. Ky libër mund të jetë vepra retorike më e arrirë e Palit. Raymond E. Brown tek *An Introduction to the New Testament* [Një Hyrje në Dhjatën e Re], thotë: “mund të jetë një nga shkrimet më bindëse oratorike të të gjitha shkrimeve të Palit”, fq. 541. Megjithatë, kjo u bë për të refuzuar sofistët të cilët kishin ardhur në Korint dhe kishin sulmuar metodat e të folurit në publik të Palit sikurse dhe ungjillin e tij (dmth., sulmi i tij ndaj urtësisë tek 1 Korintasve 1-4).

### TEMË E VEÇANTË: SOFISTËT (SPECIAL TOPIC: SOPHISTS)

Fjala greke *sophia* do të thotë urtësi. Termi i lidhur me të *sophistēs* mori kuptimin e dikujt “me aftësi” ose “i edukuar në retorikë”. Ajo zakonisht përcaktonte një folës publik, shpesh në lëvizje, i cili vinte në një qytet dhe përpiqej të niste një shkollë për të trajnuar fëmijët e klasës elitë. Kjo e folur në publik (dmth., trajnim retorik) është ajo që i bënte prindërit t’i kërkonin ata për mësim apo shkollim privat për fëmijët e tyre.

Kishte një konkurrencë të madhe midis këtyre “burrave të mençur” të lidhur me reputacionet dhe aftësitë e tyre për të tërhequr studentët. Kishte madje një sërë rregullash për mundësitë e tyre fillestare të të folurit. Një nga këto grup procedurash ishte një kohë për filozofin që të listonte kualifikimet dhe pikat e tij të forta.

Problemet e Palit në Korint duken se lidhen me

1. Grupimet në kishë, ku secili pretendonte se ndiqte një mësues të caktuar (1 Korintasve 1-4)
2. Mësuesit e rremë hebraikë të trajnuar helenistikë nga Jeruzalemi (2 Korintasve 10-13)

Refuzimi i Palit i “urtësisë” tek 1 Korintasve 1-4 shpjegon rrethanat për sulmin e tij nga ata që përlëvdoheshin në trajnimin e tyre filozofik dhe retorik dhe gjykonin të gjithë të tjerët nën dritën e këtyre kritereve. Është surprizuese që mësuesit hebraikë do të përlëvdoheshin në kategoritë filozofike, por një precedent vendoset në Judaizëm nga Filo i Aleksandrisë dhe ndoshta edhe trajnimi dhe eksperiencia e Apollit të Aleksandrisë.

Pali nuk ishte një folës publik i rafinuar. Ai sulmohej për këtë. Ai hakmerret duke shkruar në formë të rafinuar, ekuilibruar, retorike të strukturuar mjaft mirë tek 2 Korintasve 10-13. Ai përdor termat e tyre, format e tyre dhe ekspozon qëndrimet e tyre të papërshtatshme dhe arrogancën e tyre. Shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali mes Sofistëve].

- C. Ky libër është një kombinim i çuditshëm, sikurse vetë Pali, i pikave të larta dhe të ulëta frymërore, të emocioneve që rrjedhin të lira duke kaluar nga zemërimi deri tek gëzimi i madh.
- D. Ky libër është vërtet një letër dhe si një letër është vetëm gjysma e një bisede. Shumë nga ngjarjet e mëparshme dhe rrethanat llogjike pas përgjigjeve të Palit janë humbur. Ky është një shembull i mirë i së vërtetës që letrat e Dhjatës së Re ishin shkruar fillimisht si një korrespondencë ndaj nevojave specifike, jo si dizertacione teologjike të pavarura.
- E. Ky libër është lënë pas dore nga shkollat dhe në predikime. Gjenden më pak komentare mbi letrën e dytë të korintasve se çdo libër tjetër i Dhjatës së Re. Kjo është për të ardhur keq sepse është burimi i diskutimit më përcaktues të Palit mbi vuajtjen në jetën e krishterë.

- F. Për pastorët, ky libër ofron udhëzime të vlefshme mbi mënyrën se si të trajtojnë problemet me kishat lokale. Pali na jep të gjithëve një shembull për t'u ndjekur në mes të sulmeve dhe keqkuptimeve personale.

## AUTORI

- A. Edhe në mes të të gjithë mohimeve shkollore moderne të autorësisë tradicionale të librave biblik, për këtë libër nuk është mohuar kurrë që autori të jetë Pali.
- B. Është kaq autobiografik dhe aq e vështirë të kuptosh disa nga frazat e tij sa mundësia e dikujt që përpiqet të imitojë Palin duke shkruar një libër si ky është tejet e pamundur. Vështirësia dhe specifika e letrës flasin për origjinalitetin e saj. Është e vërtetë që shumë nga studiuesit e Dhjatës së Re mendojnë se letra e dytë e Korintasve është një letër e përbërë që kombinon disa letra të ndara të Palit në një të vetme. Unë i qëndroj njëjesisë së saj për shkak se
1. Nuk ka asnjë informatë të copëzimit në ndonjë nga dorëshkrimet antike greke
    - a. Asnjë variacion të njësive letrare
    - b. Asnjë dorëshkrim i cili nuk përmban të trembëdhjetë kapitujt
  2. Edhe pse 2 Korintasve 13 ishte dukshëm i panjohur për Klementin e Romës në vitin 96 pas lindjes së Krishtit, ai citohet nga Polycarp në vitin 105 pas lindjes së Krishtit.
  3. Libri kuptohet si një njësi. Duket se ka tema të caktuara të cilat tregojnë unitetin e tij, siç është “vuajtja”.
  4. Prova e brendshme është tepër e kufizuar për të mbrojtur një copëzim rrënjësor të 2 Korintasve.
- C. Pali pohohet se është autori tek 2 Kor. 1:1 dhe 10:1.

## DATA

- A. Data e 2 Korintasve është në mënyrë të pandashme e lidhur me 1 Korintasve dhe librin e Veprave të Apostujve.
- B. Veprat e Apostujve 18:1-18 dhe 20:2-3 lidhet me qëndrimin e Palit në Korint, por gjithashtu duket se ka pasur të paktën edhe një udhëtim tjetër të paregjistruar (2 Korintasve 2:1; ku një vizitë përmendet tek 2 Kor. 12:14; 13:1-2).
- C. Pyetja kryesore është marrëdhënia kohore midis vizitave të Palit dhe letrave të tij ndaj Korintit.
- D. Problemi i vërtetë me datimin e ndodhive të lidhura me Korintin është se ne nuk kemi asnjë provë të jashtme apo informacion midis Veprave të Apo. 18:1-18 dhe Veprave të Apo. 20:2-3, përveç provave të brendshme të paqarta të vetë letrave korintase.
- E. Kontaktet e Palit me kishën korintase – një rikonstruksion i propozuar.

<b>DATA</b>	<b>VIZITA</b>	<b>LETRA</b>
Viti 50-52 pas Krishtit, Udhëtimi i Dytë Misionar i Palit	a. Gjatë Udhëtimit të tij të Dytë Misionar, Pali qëndroi në Korint për 18 muaj (shih Veprat e Apo. 18:1-11)	
Viti 52 pas Krishtit, Gallio ishte prokonsull nga viti 51 pas Krishtit (shih Veprat e Apo. 18:12-17)		a. 1 Kor. 5:9-11 duket se i referohet një letre mbi situatën imorale në kishë. Kjo letër është e panjohur, vetëm nëse: (1) sikurse disa supozojnë, se 2 Kor. 6:14-7:1 është pjesë e saj ose (2) se 2 Kor. 2:3,4,9 janë forma aoriste të letrës dhe i

Viti 56 pas Krishtit (pranverë)

b. Pali dëgjon për problemet në kishë ndërkohë që ai është në Efes nga dy burime: (1) njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11 dhe (2) Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17. Ata me sa duket sollën një letër nga kishat e shtëpive korintase që përmbante pyetje

Viti 56 pas Krishtit (dimër) ose viti 57 pas Krishtit (dimër)

c. Pali bëri një vizitë urgjente dhe të dhimbshme në Korint (të paregjistruar tek Veprat e Apostujve, shih 2 Kor. 2:1). Ajo nuk rezultoi e suksesshme, por ai u betua se do të rikthehej.

d. Pali planifikonte të takonte Titin në Troas, por Titi nuk kishte ardhur, kështu që Pali shkoi në Maqedoni (shih 2 Kor. 13; 7:5,13), ndoshta Filipi (shih MSS B<sup>c</sup>, K, L, P).

Viti 57-58 pas Krishtit (dimër)

e. Vizita e fundit e Palit për në Korint e regjistruar duket se ka referencë tek Veprat e Apo. 20:2-3. Edhe pse ajo nuk e përmend Korintin me emër, ajo e nënkupton atë. Ai qëndroi atje gjatë muajve të dimrit.

referohet 2 Korintasve.

b. Pali iu përgjigjet këtyre pyetjeve (shih 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,2) duke shkruar letrën e parë drejtuar Korintasve. Timoteu (shih 1 Kor. 4:17) merr përgjigjen nga Efesi (shih 1 Kor. 16:8) tek Korinti. Timoteu nuk mund t'i zgjidhte problemet në kishë.

c. Pali shkroi një letër të ashpër (shih 2 Kor. 2:3-4:9; 7:8-12) ndaj kishave të shtëpive korintase, letër e cila u dorëzua nga Titi (shih 2 Kor. 2:13; 7:13-15). Kjo letër është e panjohur, vetëm nëse, sikurse disa supozojnë, një pjesë e saj është tek 2 Kor. 10-13.

d. Ai gjeti Titin dhe dëgjoji që kisha i ishte përgjigjur drejtimit të tij dhe ai më pas shkroi 2 Korintasve me shumë falenderim (shih 7:11-16). Kjo letër u dorëzua nga Titi.

e. Ndryshimi në qëndrim nga kapitujt 1-9 dhe 10-13 shpjegohet nga disa studiues si më shumë si një lajm i keq (ndoshta rivitalizimi i kundërshtarëve të vjetër dhe shtimi i kundërshtarëve të rinj) nga kishat e shtëpive korintase pasi kapitujt 1-9 ishin shkruar (F. F. Bruce).

## SA LETRA I SHKROI PALI KISHËS NË KORINT

- A. Vetëm dy, letrën e I dhe II drejtuar Korintasve
- B. Tre, dhe një letër është humbur
- C. Katër, dhe dy letra kanë humbur
- D. Disa studiues modernë gjejnë pjesë të dy letrave të humbura në 2 Korintasve
  - 6. Një letër e mëparshme (1 Kor. 5:9) tek 2 Kor. 6:14-17:1
  - 7. Një letër e ashpër (2 Kor. 2:3-4,9; 7:8-12) tek 2 Kor. 10-13
- E. Pesë, ku 2 Kor. 10-13 janë letra e pestë, e dërguar pas raportimit të Titit të lidhur me lajme të tjera të këqija
- F. Unë i qëndroj teorisë C (shih gjithashtu H. C. Thiessen, *Introduction to the New Testament* [Hyrje në Dhjatën e Re], fq. 209)
  - 5. Letra e mëparshme, e humbur (1 Kor. 5:9)
  - 6. 1 Korintasve
  - 7. Letër e ashpër, e humbur (2 Kor. 2:1-11; 7:8-12)
  - 8. 2 Korintasve

## ARMIQTË E PALIT NË KORINT

- A. Tek 2 Korintasve problemi duket se është me disa grupime që sundojnë në shtëpi kisha të ndryshme (jo domosdoshmërisht të njëjtat grupime si tek 1 Korintasve, por ndoshta po).
  - a. Një grup besimtarësh që mbështetin kulturën dhe zakonet tradicionale romake
  - b. Një grup besimtarësh që mbështetin trajnimin retorik tradicional grek
  - c. Një grup besimtarësh që mbështetin kulturën dhe zakonet tradicionale hebraike
  - d. Një grup besimtarësh nga shtresat shoqërore të pafuqishme dhe pa të drejtë vote
- B. Mbërritja e ngatërrestarëve hebraikë nga Palestina shkaktoi kundërshti të shtuar (shih 2 Korintasve 10-13). Ata janë të ndryshëm nga judazierët e Galatianëve dhe hebrejntë / grekët legalistë të Kolosianëve. Ata ishin ndoshta mësues karizmatikë, të trajnuar nga ana retorike, të ngjashëm me Apollin.
- C. Më poshtë janë disa nga akuzat e ngritura kundër Palit ndaj të cilave ai u përgjigj
  - a. Pali ishte i paqëndrueshëm (dmth., planet e tij të udhëtimit ndryshonin, shih 2 Kor. 1:15 e në vazhdim).
  - b. Pali ishte një shkrimtar i fuqishëm, por i dobët në të folurën personale (shih 2 Kor. 10:10).
  - c. Pali nuk ishte një orator i rafinuar (shih 2 Kor. 10:10; 11:6).
  - d. Pali nuk pranonte para (shih 2 Kor. 11:7 e në vazhdim; 12:13 e në vazhdim).
  - e. Pali nuk ishte një apostull i vërtetë (shih 2 Kor. 11:5,13; 12:4).
  - f. Pali nuk ishte një hebre fetar (shih 2 Kor. 11:21 e në vazhdim).
  - g. Pali nuk pati zbulesë të drejtëpërdrejtë dhe vegime frymërore të drejtëpërdrejtë sikurse patën ata (shih 2 Kor. 12:1 e në vazhdim).

## RASTI DHE QËLLIMI I II KORINTASVE

- A. Mirënjohje për përgjigjen pozitive të kishës ndaj drejtimit të Palit (shih 2 Kor. 2:12,13; 7:11-16)
- B. Përgatitja për vizitën e tretë të Palit (shih 10:1-11). Vizita e tij e dytë ishte dukshëm e dhimbshme dhe pa sukses. Toni i ndryshuar emocional i kapitujve 10-13 është i dukshëm. Disa kanë pranuar se është si rezultat i disa letrave të Palit ndaj kishës në Korint që janë kombinuar në letrën e dytë të Korintasve. Gjithashtu është e mundur që Pali i shkroi ato pasi ai kishte dëgjuar për një thyerje të kundërshtimit brenda bashkësisë korintase. Është një shtesë emocionale.

C. Refuzimi i mësuesve të rremë hebraikë në lëvizje (shih 2 Kor. 10-12) të cilët i kishin refuzuar Palit:

1. Personin
2. Motivet
3. Autoritetin
4. Stilin e të folurit
5. Mesazhin e ungjillit

## NJËSI LETRARE TË MUNDSHME

A. Skicimi i këtij libri është ekstremisht e vështirë për shkak të:

1. Ndryshimeve të tonalitetit
2. Varietetit të temave
3. Shprehjeve të zgjatura në kllapa (2 Kor. 2:14-7:1 ose 7:4)
4. Njohurive tona të kufizuara mbi situatën lokale

B. Megjithatë, gjenden tre ndarje të dukshme kryesore të temave:

1. Pali i përgjigjet mesazhit të Titit dhe e lidh me planet e tij të udhëtimit, kapitujt 1-7 (gjendet një shprehje kryesore në kllapa që trajton shërbesën apostolike të Palit, 2 Kor. 2:14-7:1 ose 7:4)
2. Inkurajimi i Palit për përmbushjen e kontributit për kishën në Jeruzalem, kapitujt 8-9
3. Mbrojtja e Palit për drejtimin e tij, kapitujt 10-13

### **CIKLI NJË I LEXIMIT (nga “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik])**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh. Shprehni me fjalët tuaja tematikën qendrore të të gjithë librit.

1. Tematika e gjithë librit
2. Lloji i letërsisë (zhanri)

### **CIKLI DY I LEXIMIT (nga “[A Guide to Good Bible Reading](#)” [Një Udhëheqës për Lexim të Mirë Biblik])**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Prandaj lexoni të gjithë librin biblik përnjëherësh për një herë të dytë. Skiconi subjektet kryesore dhe shprehni secilin subjekt në një fjali të vetme.

1. Subjekti i njësisë së parë letrare
2. Subjekti i njësisë së dytë letrare
3. Subjekti i njësisë së tretë letrare
4. Subjekti i njësisë së katërt letrare
5. Etj.

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#).

# 2 KORINTASVE 1

## NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Përshëndetje	Përshëndetje	Përshëndetje dhe Falenderim	Përshëndetje	Adresim dhe Përshëndetje
1:1-2	1:1-2	1:1a 1:1b 1:2	1:1a 1:1b 1:2	1:1-2
Falenderimi i Palit pas Vuajtjeve	Ngushëllim në Vuajtje		Pali Falenderon Perëndinë	Falenderim
1:3-7	1:3-7	1:3-7	1:3-7	1:3-7
	Të Çliruar nga Vuajtjet			
1:8-11	1:8-11	1:8-11	1:8-11	1:8-11
Shtyrja e Vizitës së Palit	Sinqeriteti i Palit	Marrëdhënie të Kohëve të Fundit me Kishën (1:12-2:13)	Ndryshimi në Planet e Palit (1:12-2:4)	Pse Pali Ndryshoi Planet e Tij (1:12-2:11)
1:12-14	1:12-14	1:12-14	1:12-14	1:12-14
	Ruajtja e Kishës			
1:15-22	1:15-24	1:15-22	1:15-22	1:15-22
1:23-2:4		1:23-2:4	1:23-2:4	1:23-2:4

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimor udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. 2 Korintasve u shkruajt rreth gjashtë deri në tetëmbëdhjetë muaj pas 1 Korintasve, duke pasuar vizitën e Palit në Maqedoni me Titin, i cili raportoi përgjigjen e kishës ndaj uverturës së Palit (shih 2 Kor. 2:12-13; 7:11-16).
- B. Kjo është një letër personale mjaft e ndjerë. Gjendja emocionale e Palit madje mund të vihet re në gramatikën (dmth., mungesa e lidhëzave dhe fjalitë e paplota).
- C. Pali po sulmohej në mënyrë vicioze nga një minorancë brenda kishës. Ky grup i vogël duket se është si nga kongregacioni lokal në Korint ashtu edhe nga një grup hebraik në lëvizje. Akuzat e tyre ishin:
  1. Pali kishte qëllime jo të ndershme, 2 Kor. 1:12

2. Pali ishte i paqëndrueshëm, 2 Kor. 1:15 e në vazhdim
3. Pali ishte i dobët, 2 Kor. 10:10
4. Pali ishte fizikisht i shëmtuar, 2 Kor. 10:10
5. Pali nuk ishte një orator i mirë, 2 Kor. 10:10; 11:16
6. Pali predikonte për para 2 Kor. 11:7 e në vazhdim; 12:13 e në vazhdim
7. Pali nuk ishte një apostull i vërtetë, 2 Kor. 11:5,13; 12:4
8. Pali nuk ishte një hebre tradicional, 2 Kor. 11:21 e në vazhdim
9. Ata kishin pasur zbulësë të drejtpërdrejtë, ndërsa Pali jo, 2 Kor. 12:1 e në vazhdim.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 KORINTASVE 1:1a

<sup>1</sup>Pali, apostull i Jezus Krishtit nëpërmjet vullnetit të Perëndisë, dhe vëllai Timote,

**1:1a “Pali”** Sauli i Tarsit së pari thirret Pal tek Veprat e Apo. 13:9. Është e mundur që pjesa më e madhe e hebrenjve të “diasporës” kishin një emër hebraik dhe një emër grek. Nëse është kështu, atëherë prindërit e Saulit i dhanë atij këtë emër, por pse, më pas, shfaqet papritur “Pal” tek Veprat e Apostujve 13? Ndoshta (1) të tjerë filluan ta thërrisnin atë me emrin e tij ose (2) ai filloi t’i referohet vetvetes me termin “i vogël” ose “më i vogli”. Emir grek *Paulos* do të thoshte “i vogël”. Disa teori kanë avancuar mbi origjinën e emrit të tij grek.

1. Statura e tij fizike, tradita e shekullit të dytë që Pali ishte i shkurtër, i shëndoshë, pa flokë, me këmbë të harkuara, me vetulla të trasha dhe sy shpërthyes është ndoshta një burim i emrit, i derivuar nga një libër jo-kanonik nga Thesalonika të quajtur *Paul and Thekla* [Pali dhe Thekla]
2. Pasazhet ku Pali e quan vetveten “më i vogli nga shenjtorët” për shkak se ai persekutonte kishën sikurse tek Veprat e Apo. 9:1-2 (shih 1 Kor. 15:9; Efe. 3:8; 1 Tim. 1:15). Disa e kanë parë këtë “vogëlsi” si origjina e titullit të vetë-zgjedhur. Megjithatë, në një libër si Galatasit, ku ai theksonte pavarësinë dhe barazinë e tij me të Dymbëdhjetët e Jeruzalemit, ky arsyetim është disi më pak i mundshëm (shih 2 Kor. 11:5; 12:11; 15:10).

▣ **“një<sup>49</sup> apostull”** Kjo është fjala e zakonit greke për “dërgoj” (dmth., *apostellō*). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 4:9. Ky term ka disa përdorime teologjike.

1. Rabinët e përdornin atë si një i thirrur dhe i dërguar si një përfaqësues zyrtar i dikujt tjetër, diçka e ngjashme me fjalën tonë “ambasador” (shih 2 Kor. 5:20).
2. Ungjijt shpesh përdorin këtë term për Jezusin që u dërgua nga Ati (shih Mat. 10:40; 15:24; Mark 9:37; Luka 9:48). Tek Gjoni termi merr mbi vete tone Mesianike (shih Gjoni 4:34; 5:24,30,36,37,38; 6:29,38,39,40,57; 7:29; 8:42; 10:36; 11:42; 17:3,8,18,21,23,25; 20:21). Përdoret për Jezusin që dërgoi besimtarët (shih Gjoni 17:18; 20:21).
3. Dhjata e Re e përdori për dishepujt.
  - a. Të Dymbëdhjetët e parë që ishin një rreth i brendshëm dishepujsh (shih Luka 6:13; Veprat e Apo. 1:21-22)
  - b. Një grup i veçantë ndihmësish dhe bashkëpunëtorësh apostolikë
    - 1) Barnaba (shih Veprat e Apo. 14:4,14)
    - 2) Androniku dhe Junias (KJV, Junia, shih Rom. 16:7)
    - 3) Apolli (shih 1 Kor. 4:6-9)
    - 4) Jakobi, vëllai i Zotit (shih Gal. 1:19)
    - 5) Silvani dhe Timoteu (shih 1 Thes. 2:6)
    - 6) Ndoshta Titi (shih 2 Kor. 8:23)
    - 7) Ndoshta Epafroditi (shih Fil. 2:25)
  - c. Një dhuratë e vazhdueshme në kishë (shih 1 Kor. 12:28-29; Efe. 4:11)
4. Pali përdor emrin si një titull për veten e tij në pjesën më të madhe të letrave të tij si një mënyrë për të pranuar thirrjen dhe autoritetin e tij të dhënë nga Perëndia si përfaqësues i Krishtit (shih Rom. 1:1; 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Gal. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1; 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; Titi 1:1).

<sup>49</sup> Kjo një mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)



▣ **“Krishtit”** Ky është ekuivalenti grek i termit hebraik *messiah* (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:23), i cili do të thoshte “i vajosuri”. Ai nënkupton “dikush i thirrur dhe i pajisur nga Perëndia për një detyrë të caktuar.” Në Dhjatën e Vjetër tre grupe drejtuesish vajoseshin: priftërinjtë, mbretërit dhe profetët. Jezusi i përmbush të tre këto detyra të vajosura (shih Heb. 1:2-3).

▣ **“Jezu”** Emri hebraik do të thoshte “YHWH shpëton” ose “YHWH sjell shpëtim”. Ky emër iu zbulua prindërve të tij nga një engjëll (shih Mat. 1:21). “Jezu” derivohet nga fjala hebraike për shpëtim, *hosea*, me prapashtesë ndaj emrit të Perëndisë për besëlidhjen, YHWH. Është i njëjti sikurse emir hebraik Joshua. Dorëshkrimet greke ndahen për sa i përket rendit të këtyre termave.

1. Jezus Krisht, A, D, G, K, L (Peshitta, KJV, NKJV)
2. Krishti Jezus, P<sup>46</sup>, α, B, M, P (NASB, NRSV, TEV, NJB, NIV)

**Nuk duket të ketë asnjë rëndësi teologjike rendi. Shih TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY) tek 1 Kor. 2:8.**

▣ **“nëpërmjet vullnetit të Perëndisë”** Po e njëjta frazë hyrëse përdoret tek 1 Kor. 1:1; 2 Kor. 1:1; Efe. 1:1; Kol. 1:1 dhe 2 Tim. 1:1. Pali ishte i bindur se Perëndia e kishte zgjedhur atë të ishte një apostull. Kjo ndjesi e veçantë thirrjeje filloi në konvertimin e tij në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:1-22; 23:3-16; 26:9-18). Pali shpesh e pohoi autoritetin dhe thirrjen e tij të dhënë nga Perëndia për të konfirmuar shkrimet e tij si të dhëna vetëm nga Perëndia (dmth., të frymëzuara, shih 2 Tim. 3:16; 1 Kor. 2:9-13; 1 Thes. 2:13).

▣ **“vëllai ynë”<sup>50</sup> Timote** Tek 1 Kor. 1:1 “Sosteni” përmendet; këtu përmendet Timoteu, ndoshta si bashkëpunëtor, bashkëautor ose skrib. Gjithashtu është e mundur që Pali përmend Timoteun për shkak se kjo kishë nuk i përgjigjej atij kur ai iu dorëzoi atyre letrën e parë të Palit ndaj korintasve.

#### **TEMË E VEÇANTË: TIMOTEU (SPECIAL TOPIC: TIMOTHY)**

- A. Emri i tij do të thotë “dikush që nderon Perëndinë.”
- B. Ai ishte biri i një nëne hebraike dhe një babai grek dhe jetonte në Listra (shih Veprat e Apo. 16:1). Përkthimi latin i komentarit të Origenit mbi Rom. 16:21 thotë se Timoteu ishte një qytetar i Derbes. Kjo është e mundur nga Veprat e Apo. 20:4.
- C. Ai u mësua në besimin hebraik (ose besimin e krishter) nga nëna dhe gjyshja e tij (shih 2 Tim. 1:5; 3:14-15).
- D. Ai dukshëm i besoi Krishtit gjatë udhëtimit të parë misionar të Palit (shih Veprat e Apo. 14:6-7).
- E. Atij iu kërkua që t’i bashkohej skuadrës misionare të Palit dhe Silës në udhëtimin e tyre të dytë (shih Veprat e Apo. 16:1-5), dukshëm për të marrë detyrat e Gjon Markut. Ai u konfirmua me profeci (shih 1 Tim. 1:18; 4:14).
- F. Ai u rrethpre nga Pali në mënyrë që të punonte si me hebrenjtë ashtu edhe me grekët (shih Veprat e Apo. 16:3).
- G. Ai ishte një shoqërues i përkushtuar i Palit dhe u bë delegati i tij apostolik. Ai përmendet me emër më shumë se çdo ndihmës tjetër i Palit (17 herë në 10 letra, shih Rom. 16:21; 1 Kor. 4:17; 16:10; Fil. 1:1; 2:19,22; Kol. 1:5; 1 Tim. 1:2; 2 Tim. 1:2; Titit 1:4).
- H. Pali e quan atë me përzemërsi “biri im i vërtetë në besim” (shih 1 Tim. 1:2); “biri im i dashur” (shih 2 Tim. 1:2); “biri im i vërtetë në besimin e përbashkët” (shih Titit 1:4). Gjithashtu, vini re “biri im i dashur dhe besnik në Zotin” tek 1 Kor. 4:17.
- I. Ai ishte qartazi në Romë kur Pali u lirua nga burgu dhe e shoqëroi atë në udhëtimin e tij të katërt misionar (shih Kol. 1:1; Filemon 1:1).
- J. Ai quhet një “apostull” tek 1 Thes. 2:6 në kuptimin e një dhurate frymërore të vazhdueshme për kishat (shih Efe. 4:11).
- K. Dy nga tre Letrat Pastorale i drejtohen atij.
- L. Ai përmendet së fundmi tek Heb. 13:23 (por kronologjikisht tek 2 Tim. 1:2).

<sup>50</sup> Ky përmemër mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

## VERSIONI SHQIP: 2 KORINTASVE 1:1b

<sup>1</sup>kishës së Perëndisë që është në Korint, bashkë me gjithë shenjtorët që janë në gjithë Akainë:

**1:1b “kishës”** Ky është termi grek *ekklesia* (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2). Ajo përbëhet nga dy fjalë, “nga” dhe “thirrur”, prandaj, termi nënkupton ata që janë të thirrur hyjesisht. Kisha e hershme e mori këtë fjalë nga përdorimi laik (shih Veprat e Apo. 19:32,39,41) dhe për shkak të përdorimit të Septuagintës ky term u përdor për “kongregacion” të Izraelit (shih Num. 16:3; 20:4). Ata e përdorën këtë term për vetveten si një vazhdimësi e popullit të Perëndisë në Dhjatën e Vjetër. Ata ishin Izraeli i ri (shih Rom. 2:28-29; Gal. 6:16; 1 Pjet. 2:5,9; Zbu. 1:6), përmbushja e misionit mbarëbotëror të Perëndisë (shih Zan. 3:15; 12:3; Eksod. 19:5:6).

■ **“së Perëndisë që është në Korint”** Kjo frazë shpreh dy kuptime të ndryshme rreth “kishës”.

1. Ajo është trupi lokal i besimtarëve të rilindur, të pagëzuar. Pjesa më e madhe e vendeve në Dhjatën e Re ku përdoret fjala *ekklesia* reflekton këtë kuptim lokal.
2. Gjithashtu, është shprehia universale e trupit të Krishtit. Kjo shihet tek Mat. 16:18 (dmth., përdorimi i parë nga përdorimet e rralla të këtij termi nga Jezusi, shih Mat. 18:17 [dy herë]); Veprat e Apo. 9:31 përdor njëjtesin “kishë” për të gjitha kongregacionet lokale në Jude, Galile dhe Samari; dhe së fundmi, përdorimi i termit tek Efesianëve, e cila është një letër ciklike e Azisë së Vogël (shih 2 Kor. 1:22; 3:10,21; 5:23-32).

Është një trup i madh i Krishtit i përbërë nga të gjithë besimtarët (disa tanimë të vdekur, disa gjallë) dhe gjenden shprehje lokale të atij trupi universal.

■ **“bashkë me gjithë shenjtorët që janë në gjithë Akainë”** Kjo përshëndetje tregon se letra ishte për një audiencë më të madhe se sa një kishë (sikurse u bënë të gjitha letrat e Palit). Ajo mund të ketë funksionuar si një letër ciklike ndaj të gjithë rajonit sikurse bënë letrat drejtuar Galatasve dhe Efesianëve. Megjithatë, ajo ekskluzivisht fokusohet mbi problemet në Korint.

■ **“shenjtorët”** Kjo do të thotë se ata janë deklaruar të shenjtë me anë të veprës së Jezusit dhe përmes punës së Frymës (shih 2 Kor. 6:11). Folja (*hagiazō*) lidhet me fjalën “i shenjtë” (*hagios*) dhe “shenjtorë” (dmth., “të shenjtë”, *hagioi*). Ajo flet për ndarjen tonë për shërbesë ndaj Perëndisë. Këtu i referohet pozicionit tonë në Të sikurse tek 2 Kor. 1:3, por në vende të tjera në Dhjatën e Re besimtarët duhet që të synojnë fort drejt “shenjtërisë”. Është një pozicion që duhet të mbahet. Pali inkurajon këtë kishë të grupuar dhe krenare duke i thirrur ata “shenjtorë”, pavarësisht dështimeve dhe mëkateve të tyre! Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË / SPECIAL TOPIC: SAINTS tek 1 Kor. 1:2

## VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:2

<sup>2</sup>Paçi hir dhe paqe nga Perëndia, Ati ynë, dhe nga Zoti Jezu Krisht.

**1:2 “Paçi hir dhe paqe nga Perëndia”** Hapja tradicionale helenistike e letrave ishte “përshëndetje” (shih Veprat e Apo. 23:26; Jakobi 1:1), jo “hir”. Pali bën një lojë fjalësh nga “*chairein*” tek “*charis*,” të cilat e bënë atë veçanërisht të krishterë (shih 1 Thes. 1:1; Gal. 1:3). Disa pohojnë se “paqe” reflekton termin hebraik “*shalom*” (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:3). Është e mundur që Pali ta njihte këtë kombinim të termave nga bekimi Aronik i Num. 6:24-26. Pjesa më e madhe e letrave helenistike dhe letrave të Dhjatës së Re fillojnë me një lutje falenderimi, por për shkak të problemeve midis Palit dhe kësaj grigje, lutja hapëse e falenderimit i drejtohet Perëndisë (shih 2 Kor. 1:3-7).

■ **“nga Perëndia, Ati ynë”** Kjo e vendos theksin mbi marrëdhëniet intime ndërpersonale familjare (shih Mat. 6:9). Në Dhjatën e Vjetër Perëndia është ati i Izraelit (shih Isa. 64:8; Ose. 1-3;11). Për shkak se Perëndia është personal, metaforat më të mira për të përshkruar marrëdhënien e Tij me anëtarët e tjerë të Trinisë dhe popullit të Tij janë termat hebraik familjarë. Ndërsa Ati lidhet me Jezusin në një mënyrë analoge, Ai lidhet me besimtarët. Shih TEMË E VEÇANTË: ATËRRORITETI I PERËNDISË / SPECIAL TOPIC: FATHERHOOD OF GOD tek 1 Kor. 1:3.

Si “hir” ashtu edhe “paqe” vijnë nga Ati dhe nga Biri. Ati dhe Jezusi lidhen gramatikisht si një njësi (dmth., një parashtesë, por dy objekte). Kjo është mënyrë e zakonit për autorët e Dhjatës së Re që të pohojnë hyjësinë e Jezusit (shih 1 Thes. 1:1; 3:11; 2 Thes. 1:2,12; 2:16).

■ **“dhe nga Zoti Jezu Krisht”** Këta terma janë pjesë e titullit më të plotë “Zoti Jezu Krisht” (shih 2 Kor. 1:2,3,7,8,9,10). Këta tri (shih 2 Kor. 1:2,3,7,8,9,10) kanë të gjithë rëndësi individuale.

1. “Krisht” është përkthimi grek i fjalës në hebraisht *Messiah* (dmth., i Vajosuri). Ai pohon se titulli i Jezusit në Dhjatën e Vjetër si i Premtuari i YHWH i dërguar për të vendosur epokën e re të drejtësisë.
2. “Jezus” është emri i dhënë foshnjës në Betlehem nga engjëlli (shih Mat. 1:21). Ai përbëhet nga dy emra hebraikë: “YHWH”, emri i besëlidhjes për hyjësinë dhe “shpëtim” (dmth., *hosea*). Është i njëjti emër hebraik sikurse Joshua. Kur përdoret vetëm ai shpesh identifikon njeriun, Jezusin e Nazaretit, birin e Marisë (p.sh., Mat. 1:16, 25; 2:1; 3:13,15,16).
3. “Zot” (përdorur tek 2 Kor. 1:1 tek KJV) është përkthimi për termin hebraik *adon*, i cili do të thoshte “pronar, bashkëshort, mjeshtër ose zot”. Hebrenjtë kishin frikë të shqiptonin emrin e shenjtë YHWH se mos ata e përdornin atë kot dhe thyenin një nga Dhjetë Urdhërimet. Kurdo ata lexonin Shkrimet, ata përdornin *Adon* për të zëvendësuar YHWH. Kjo është arsyeja pse përkthimet tona përdorin të gjitha shkronjat e mëdha për YHWH në Dhjatën e Vjetër. Duke e transferuar këtë titull (*kurios* në greqisht) tek Jezusi, autorët e Dhjatës së Re pohojnë hyjësinë dhe barazinë e Tij me Atin.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:3-7

<sup>3</sup> Bekuar qoftë Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, Ati i të mëshirëve dhe Perëndia e çdo ngushëllimi, <sup>4</sup> i cili na ngushëllon në çdo shtrëngim tonin, që, nëpërmjet ngushëllimit me të cilin ne jemi ngushëlluar nga Perëndia, të mund të ngushëllojmë ata që janë në çfarëdo shtrëngimi. <sup>5</sup> Sepse, ashtu si ndër ne teprojnë vuajtjet e Krishtit, po ashtu, nëpërmjet Jezus Krishtit, tepron edhe ngushëllimi ynë. <sup>6</sup> Dhe, nëse jemi të pikëlluar, kjo ndodh për ngushëllimin dhe shpëtimin tuaj; nëse jemi të ngushëlluar, kjo ndodh për ngushëllimin dhe shpëtimin tuaj, që veprojnë në mënyrë të efektshme që të duroni të njëjtat vuajtje që heqim edhe neve. <sup>7</sup> Edhe shpresa jonë për ju është e patundur, duke ditur se ashtu siç jeni pjesëmarrës në mundime, kështu do të jeni pjesëmarrës edhe në ngushëllim.

**1:3 “Bekuar”** Ne marrim fjalën “eulogji” nga kjo fjalë greke. Ky term (duke ndjekur Septuagintën) gjithmonë përdoret për njerëzit që bekojnë Perëndinë (shih Luka 1:68). Tek Marku 14:61 është një perifrëzim për emrin e Perëndisë (dmth., “i Bekuari”). Pali përdor termin për Atin tek Rom. 1:25; 9:5; 2 Kor. 1:3; 11:31; dhe Efe. 1:3.

■ **“Perëndia”** Kjo lutje adhurimi, 2 Kor. 1:3-11, përshkruan Perëndinë në tre mënyra.

1. Ai është Ati i Jezusit
2. Ai është Ati i të gjitha mëshirave
3. Ai është Perëndia i të gjithë ngushëllimit

Forma e zakonit e letrës në greqisht ishte një lutje falenderimi për marrësit e letrës, por në këtë letër lutja e falenderimit i drejtohej Perëndisë.

YHWH si Ati i *Yeshua* (dmth., Jezus në hebraisht), njihet vetëm me anë të zbulësës. Asnjë argument nga nevoja apo dizenjimi filozofik nuk mund ta jepte këtë teologji marrëdhënieje. Bëni kujdes nga “provat” për Perëndinë të cilat bazohen në logjikë dhe jo mbi Shkrime, por ato ndihmojnë shumë njerëz të cilët refuzojnë të pranojnë Shkrimet si të vërteta. Shih Elton Trueblood, *The Logic of Belief* [Logjika e Besimit].

■ **“Ati i të mëshirëve”** Gjenden tri terma grekë të cilët lidhen me “mëshirë” ose “dhembshuri”.

1. *eleos*, zakonisht duke iu referuar ndjenjave të mëshirës ose përkushtimit (shih 2 Kor. 4:1; Rom. 9:15, i cili është një citim nga Eksod. 33:19)
2. *splanchna*, i cili i referohet vendndodhjes së supozuar fizike të dhembshurisë ose mëshirës në rropullitë më të ulëta (shih Fil. 2:1; Kol. 3:12)
3. *oiktirmos*, të ndjesh ose të shprehësh një sens mëshire ose dhembshurie për kushtet e dikujt tjetër (shih 2 Kor. 1:3,4-6; Rom. 12:1)

Ky term karakterizon veprimet dhe ndjenjat e Perëndisë ndaj njerëzimit të rënë. Kjo është shpresa jonë e madhe – mëshira dhe hiri i pandryshueshëm i Perëndisë.

Dhjata e Re shpesh përdor “At” plus një pjesëz gjinore për të përshkruar hyjësinë.

1. Ati i mëshirave (shih 2 Kor. 1:3)
2. Ati i lavdisë Efe. 1:17 (shih Veprat e Apo. 7:2; 1 Kor. 2:8)
3. Ati i të gjithëve (shih Efe. 4:6)
4. Ati i shpirtrave (shih Heb. 12:9; Zbu. 22:6)
5. Ati i dritave (shih Jakobi 1:17)
6. Sërish e sërish në shkrimet e Palit, “Ati i Zotit tonë Jezus Krisht”

**1:4-11 “ngushëllimi”** Ky term, *paraklēsis*, në format e tij të ndryshme, përdoret dhjetë herë tek 2 Kor. 1:3-11. Është termi kyç përgjatë të gjithë pasazhit dhe gjithashtu tek kapitujt 1-9, ku ai përdoret njëzetë e pesë herë. Kjo fjalë do të thotë: “të thërrasësh përgjatë”. Ai përdoret shpesh në një kuptim gjyqësor për një avokat të cilit i jepej ndihmë, ngushëllim apo udhëzim ligjor.

Në këtë kontekst përdoret në kuptimin e inkurajimit dhe të ngushëllimit. Një term i lidhur, *paraklētos*, përdoret për Frymën e Shenjtë tek Gjoni 14:16,26; 15:26; 16:7; dhe për Jezusin tek 1 Gjonit 2:1. Në këtë kontekst ai përdoret për Atin.

Forma foljore *parakaleō* përdoret në disa kuptime.

1. Septuaginta
  - a. nxis, Ligji i Përt. 3:28
  - b. qetësoj, Zan. 24:67; 37:35; Ps. 119:50 (në një kuptim Mesianik; Isa. 40:1; 49:13; 51:3; 61:2)
  - c. kam dhembshuri, Ligji i Përt. 32:36; Gjyq. 2:18; Ps. 135:14
  - d. ngushëlloj, Isa. 35:4
  - e. thërras, Eksod. 15:13
2. shkrimet e Palit ndaj Korintit
  - a. nxis, 1 Kor. 1:10; 4:16; 14:30-31; 16:15-16; 2 Kor. 2:8; 5:20; 6:1; 8:4,6; 10:1
  - b. qetësoj, gëzoj, 2 Kor. 1:4,6; 2:7; 7:6,7,13; 13:11
  - c. kam dhembshuri, ngushëllim, 1 Kor. 4:13
  - d. lutem, përgjërohem, kërkoj, 1 Kor. 16:12; 2 Kor. 9:5; 12:18

**1:4 “të mund të ngushëllojmë ata që janë në çfarëdo shtrëngimi”** Ka dy arsye të pohuara në këtë kontekst pse vuajnë të krishterët: (1) që ata të mund të ngushëllojnë të tjerët, 2 Kor. 1:4 dhe (2) për të na ruajtur ne që të mos mbahemi tek vetvetja, 2 Kor. 1:9. Besimtarët jetojnë në një botë të rënë. Gjëra të këqija ndodhin; disa janë statistike, disa janë për shkak të ligësisë personale, por të gjitha mund të përdoren (jo të dërgohen, por lejohen) nga Perëndia për pjekurinë dhe shërbesën tonë (shih Rom. 8:28-29). Shih John W. Wenham, *The Goodness of God* [Mirësia e Perëndisë].

Termi, vuajtje (dmth., *thlipsis*), etimologjikisht do të thoshte “të shtrydhësh ose të shtypësh” (dmth., sikurse rrushi që shtypet ose gruri që bluhet për t’u bërë miell), por u përdor në mënyrë figurative për trauma (shih 2 Kor. 4:8; 7:5) fizike (shih 2 Kor. 1:6) ose emocionale (shih 2 Kor. 2:4; 11:28).

Thjesht një koment i shkurtër personal. Është kaq e vështirë në këtë libër që të njohësh se kujt i referohet Pali me përemrat shumë: “ne”, “neve” dhe “tonë”. Ato mund t’i referohen (1) vetëm vetes së tij; (2) atij dhe skuadrës së tij të misionit; (3) atij dhe apostujve të tjerë; ose (4) të gjithë besimtarëve. Vetëm konteskti mund të përcaktojë dhe ndonjëherë është e paqartë.

#### **TEMË E VEÇANTË: MUNDIMI (THLIPSIS) [SPECIAL TOPIC: TRIBULATION (THLIPSIS)]**

Duhet të ketë një dallim teologjik midis mënyrës si e përdor Pali këtë term (*thlipsis*) dhe si e përdor Gjoni.

- A. Përdorimi i Palit (i cili reflekton përdorimin nga Gjoni)
  1. probleme, vuajtje, të këqija që gjenden në një botë të rënë
    - a. Mat. 13:21
    - b. Rom. 5:3
    - c. I Kor. 7:28

- d. II Kor. 7:4
  - e. Efe. 3:13
  - 2. probleme, vuajtje, të këqija të shkaktuara nga jobesimtarët
    - a. Rom. 5:3; 8:35; 12:12
    - b. II Kor. 1:4,8; 6:4; 7:4; 8:2,13
    - c. Efe. 3:13
    - d. Fil. 4:14
    - e. I Thes. 1:6
    - f. II Thes. 1:4
  - 3. probleme, vuajtje, të këqija të kohës së fundit
    - a. Mat. 24:21,29
    - b. Marku 13:19,24
    - c. II Thes. 1:6-9
- B. Përdorimi nga Gjoni**
1. Gjoni bën një dallim specifik midis *thlipsis* dhe *orgē* apo *thumos* (zemërimi) të Zbulesa. *Thlipsis* është ajo që jobesimtarët u bëjnë besimtarëve dhe *orgē* dhe *thumos* është ajo që Perëndia u bën jobesimtarëve.
    - a. *thlipsis* – Zbu. 1:9; 2:9-10,22; 7:14
    - b. *orgē* – Zbu. 6:16-17; 11:18; 16:19; 19:15
    - c. *thumos* – Zbu. 12:12; 14:8,10,19; 15:2,7; 16:1; 18:3
  2. Gjoni gjithashtu e përdor këtë term në Ungjillin e tij për të reflektuar problemet që ndeshin besimtarët në çdo epokë – Gjoni 16:33.

**1:5 “ndër ne teprojnë vuajtjet e Krishtit”** Termi grek *pathēma* përdoret këtu për vuajtjet e Krishtit (shih Luka 22:15) dhe tek 2 Kor. 1:6 dhe 7 për vuajtjet e besimtarëve. Pali përdor një fjalë tjetër për vuajtjet / shtrëngimet e skuadrës së misionit (*thlipsis*) tek 2 Kor. 1:4.

Pali përmend besimtarët si bashkë-vuajtës me Krishtin disa herë (shih 2 Kor. 4:10-11; Rom. 8:17; Fil. 3:10; Kol. 1:24). Ndërsa ne ndajmë në vdekjen dhe ringjalljen e Tij, po kështu, ne ndajmë në vuajtjet dhe persekutimin e Tij. Koncepti i vuajtjes së krishterë trajtohet shpesh (shih Veprat e Apo. 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; Gal. 6:17; Fil. 1:29; 3:10; Kol. 1:24; 1 Thes. 3:3-4; 2 Tim. 3:12; Heb. 13:13; Jakobi 1:1-4; 1 Pjet. 2:19-23; 3:14; 4:12-19). Kjo është norma për të gjithë të krishterët. Kjo temë duket se është një temë e unifikuar e letrës së dytë drejtuar Korintasve. Mjaftueshmëria e Krishtit është gjithashtu me tepri dhe mëse e mjaftueshme! Po, besimtarët do të vuajnë në një botë të rënë për shkak se janë të krishterë, por Perëndia ynë do të furnizojë çdo nevojë tonën, fizikisht, emocionalisht dhe frymërisht përmes Krishtit. Vdekja dhe ringjallja e Krishtit nuk janë vetëm për qiellin, por gjithashtu për ne tani!

▣ **“tepron”** Stili letrar i Palit tek 2 Korintasve mund të ilustrimet me anë të përdorimit të tij të “tepri”.

1. *perissos*, mbi dhe përtej (shih 2 Kor. 2:7; 9:1)
2. *perissoterōs*, më shumë me tepri (shih 2 Kor. 2:4; 7:13)
3. *perisseuō*, mbi dhe përtej (shih 2 Kor. 1:5; 3:9; 4:15; 8:2; 9:8)
4. *perisseauma*, më shumë se mjaftueshëm (shih 2 Kor. 8:13,14)
5. *perisseia*, supertepri (shih 2 Kor. 8:2; 10:15)

Kur vjen çështja tek çfarë ka bërë Perëndia për besimtarët, gjithmonë është “super me tepri”, “ekstravagante”, “më shumë dhe përtej”! Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 2:7.

**1:6 “nëse... nëse”** Këto janë dy fjalitë e para kushtore të rendit të parë. Në këtë botë të rënë, drejtuesit e krishterë do të vuajnë, por kjo siguron një pasuri me ndihmë dhe shpëtim për ata që dëgjojnë. Vuajtja ka një qëllim hyjnor (shih 2 Kor. 1:7).

▣ **“kjo ndodh për ngushëllimin dhe shpëtimin tuaj”** Për shkak se ngushëllimi lidhet me shpëtimin, duket se kjo ndjek kuptimin e Dhjatës së Vjetër për termin, *sosō*, që do të thotë çlirim fizik (shih Mat. 9:22; Mark 6:56; Jakobi 5:20).

Ka disa variante dorëshkrimi grek të lidhur me 2 Kor. 1:6-7. Arsyjeja më e dukshme është se fjala “ngushëllim” (*paraklēseōs*) tek 2 Kor. 1:6a ngatërrohet me po të njëjtën formë tek 6b, të cilën teksti ndërhyrës e ka lënë jashtë. Me heqjen, fjalë të tjera janë shtuar nga skribët për ta bërë tekstin të kuptueshëm.

■ **“duron i vuajtje”** Në Septuagintë ky term u përdor për shpresën ose pritshmërinë (shih Jer. 14:8; 17:13; 50:7). Në shkrimet e Palit, ajo nënkupton një “qëndrueshmëri aktive, të qëndrueshme, vullnetare”, që prodhohet vetëm nga vuajtjet e shkaktuara nga ungjilli: duke u besuar, duke u jetuar dhe duke u shpallur. Ka një lidhje në shkrimet e Palit midis “shpresës” (shih 2 Kor. 1:7) dhe “qëndrueshmërisë së durueshme” (shih Rom. 5:3-5; 8:25; 15:4-5; dhe 1 Thes. 1:3; 1 Tim. 6:11).

**1:7** Ndërsa besimtarët ndajnë persekutimet, ashtu sikurse bëri Jezusi, ata gjithashtu ndajnë ngushëllimin e Perëndisë, sikurse bëri Jezusi.

Shpresa e Palit për ta ishte:

NASB	“fortësisht e themeluar”
NKJV	“e qëndrueshme”
NRSV	“e patutundur”
TEV	“kurrë e tundur”
NJB	“e sigurtë”

Ky është i njëjti term (*bebaios*) i përdorur tek 1 Kor. 1:8 dhe 2 Kor. 1:21.

#### TEMË E VEÇANTË: GARANCI (SPECIAL TOPIC: GUARANTEE)

Ky është termi grek *bebaios*, i cili ka tre nuanca kuptimore.

1. ajo që është e sigurt, e padyshimtë, apo mbi të cilën mund të mbështetesh (shih Rom. 4:16; II Kor. 1:7; Heb. 2:20; 3:6,14; 6:19; II Pjet. 1:10,19)
2. procesi me anë të të cilit tregohet apo vërtetohet besueshmëria e diçkaje (shih Rom. 15:8; Heb. 2:2; shih Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament* [Leksikoni Greko-Anglez i Dhjatës së Re], Vol. 1, fq. 340,377,670).
3. në papiruse u bë një term teknik për një garanci ligjore (shih Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek New Testament* [Fjalori i Dhjatës së Re Greke], fq. 107-8).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:8-11

<sup>8</sup> Sepse nuk duam, o vëllezër, që të mos dini për vështirësinë që *na* ngjau në Azi, që u rënduam përtej fuqive tona, aq sa u dëshpëruam edhe për jetën vetë. <sup>9</sup> Për më tepër ne e kishim në veten tonë vendimin e vdekjes, që të mos besonim në veten tonë, por në Perëndinë që ringjall të vdekurit, <sup>10</sup> i cili na ka çliruar dhe na çliron nga një vdekje kaq e madhe, dhe tek i cili ne shpresojmë se do të *na* çlirojë edhe më, <sup>11</sup> me ndihmën tuaj me anë të lutjeve për ne, që shumë njerëz të falënderojnë për dhuntinë e hirit që do të na jepet me anë të *lutjeve* të shumë njerëzve.

**1:8 “nuk duam, o vëllezër, që të mos dini”** Pali e përdor shpesh këtë frazë për të nisur një informacion të ri ose një konkluzion të ri (shih Rom. 1:13; 11:25; 1 Kor. 10:1; 12:1; 2 Kor. 1:8; 1 Thes. 4:13).

■ **“për vështirësinë që *na* ngjau në Azi, që u rënduam përtej fuqive”** Është e pasigurtë saktësisht se kujt i refereohet Pali me këtë frazë të ndjerë.

1. Trazira e shkaktuar nga Demetrius tek Veprat e Apo. 19:23-41
2. “përleshja me bishat e egra në Efes” të 1 Kor. 15:32
3. Një burgosje, ndoshta me dënim me vdekje (shih 2 Kor. 1:9-10)
4. Disa lloj sëmundjesh fizike

Cilado qoftë, ishte eksperiencia e Palit për jetë ose vdekje (shih 2 Kor. 1:8-10) dhe duksëm kisha në Korint kishte dëgjuar për të sepse Pali nuk ndjen nevojën për ta identifikuar atë.

Për “tepri” (*hyperbolē*) shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER (Special Topic: Paul's Use of Huper Compounds) tek 1 Kor. 2:1.

**1:9 “ne e kishim në veten tonë vendimin e vdekjes”** Ky është një pohim i çuditshëm. Së pari, fjala “vendim” përdoret vetëm këtu në të gjithë shkrimin grek, vetëm më vonë ka kuptimin “vendim vdekjeje” (shih Josephus, *Antiquities* [Antikitete] 14:10:6). Pali nuk duket se i referohet një vendimi ligjor, por një ndjesie personale të vdekjes së tij të pashmangshme. Kjo e detyroi atë dhe shoqëruesit e tij që të hidhnin plotësisht vetveten në ndihmën, dhembshurinë dhe fuqinë e Perëndisë.

Folja është në formën treguese perfekte aktive. Disa e kanë parë këtë si një mënyrë për t’iu referuar një sëmundjeje që Pali dhe shoqëruesit e tij të misionit ndeshën, e cila kishte rezultate të vazhdueshme. Megjithatë, ajo mund të interpretohet si një formë aorsite, sikurse forma tek 2 Kor. 2:13.

E gjithë kjo shtohet për ta bërë këtë frazë mjaft të paqartë me shumë interpretime të ndryshme. Edhe pse rrethanat e sakta fizike janë të pasigurta, kuptimi frymëror i Palit është i qartë – vuajtja ndihmon besimtarët të besojnë më plotësisht dhe tërësisht tek Perëndia, tek Krishti!

▣ **“që të mos besonim në veten tonë”** Sikurse 2 Kor. 1:4 shpreh, qëllimi i parë i vuajtjes së krishterë, ky varg shpreh qëllimin e dytë. Po e njëjta e vërtetë mund të shihet tek “gjëmbi në mish” i Palit (shih 2 Kor. 12:7-9). Në hapësirën frymërore, dobësia njerëzore e shoqëruar me besim çliron fuqinë e Perëndisë.

▣ **“Perëndinë që ringjall të vdekurit”** A po mendon Pali për

1. Shembuj të Dhjatës së Vjetër të njerëzve që Perëndia risolli në jetë fizike (shih 1 Mbret. 17:17-22; 2 Mbret. 4:32-37)
2. Pohime teologjike të Dhjatës së Vjetër (shih Ligji i Përt. 32:39; 1 Sam. 2:6; 2 Mbret. 5:7)
3. Diskutimi i tij i ringjalljes tek 1 Korintasve 15

**1:10 “tek i cili ne kemi vendosur shpresën tonë”<sup>51</sup>** Përemri i referohet Perëndisë At (shih 2 Kor. 1:9; 1 Tim. 4:10). Çfarë titulli i mrekullueshëm përshkruet për Perëndinë. Pali shpesh bashkon titujt e fuqishëm, të mrekullueshëm dhe përshkruet për Perëndinë (Shih listën e plotë tek 2 Kor. 1:3), si për shembull

1. “Ati i mëshirave” (shih 2 Kor. 1:3)
2. “Ati i gjithë ngushëllimit” (shih 2 Kor. 1:3)
3. “Atij që mundet” (shih Rom. 16:25; Efe. 3:20)

Folja është në formën treguese aktive të përkryer, e cila nënkupton një veprim të përmbushur në të shkuarën me rezultate që vazhdojnë (shih 1 Kor. 15:19; 1 Tim. 5:5; 6:17).

▣ **“çliruar”** Ky term përdoret tri herë tek 2 Kor. 1:10. Kjo ndjek kuptimin e Dhjatës së Vjetër për çlirim fizik, social, emocional dhe frymëror. Pali përdori këtë term disa herë (shih Rom. 7:24; 11:26; 15:31; 2 Kor. 1:10; Kol. 1:13; 1 Thes. 1:10; 2 Thes. 3:2; 2 Tim. 3:11; 4:17-18). Ai vërtet mendoi se do të vdiste në Efes (shih 2 Kor. 1:8-10).

NASB	“një rrezik kaq i madh vdekjeje”
NKJV	“nga një vdekje kaq e madhe”
NRSV	“nga një rrezik i tillë vdekjeprurës”
TEV	“nga rreziqe kaq të tmerrshme vdekjeje”
NJB	“nga një vdekje e tillë”

Gjendet një variacion i dorëshkrimit grek midis njëjësit “një vdekje kaq e madhe” (dmth., MSS  $\alpha$ , A, B, C, D, F, G) dhe shumës (dmth., MS P<sup>46</sup> dhe përkthimit Siriak, sikurse tekstit grek të përdorur nga Origen, Basil, Chrysostom, Theodoret, Jerome dhe Augustine). Shumësi (shih TEV) është më pak e zakonit dhe më antike. Ky shumës mund të shihet në listën e problemeve që Pali ndeshi së brëndshmi dhe së jashtmi tek 2 Kor. 4:812; 6:3-10; 11:23-29. UBS<sup>4</sup> i jep formës shumës një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë).

<sup>51</sup> Version në shqip është: “tek i cili ne shpresojmë”. (shënim i përkthyesit)

1:11

NASB	“duke u bashkuar në ndihmën për ne përmes lutjeve tuaja”
NKJV	“me ndihmën tuaj me anë të lutjeve për ne”
NRSV	“bashkohuni në ndihmën për ne me anë të lutjeve tuaja”
TEV	“na ndihmoni nëpërmjet lutjeve tuaja për ne”
NJB	“lutjet tuaja për ne do të kontribuojnë për këtë”

Disa studiues e besojnë këtë ndërtim gramatikor (Murry J. Harris tek *The Expositor's Bible Commentary* [Komentari Biblik i Studiuesit], vëll. 10, fq. 322) përdoret në një kuptim kushtëzues (*The Anchor Bible* [Bibla Spirancë], vëll. 32A, fq. 115). Nëse besimtarët nuk luten, në një mënyrë Perëndia Sovran ka zgjedhur të mos veprojë (shih Jakobi 4:2). Kjo tregon përfitimet e lutjes ndërmjetësuese (shih Efe. 6:18-20). Pali ndjeu se lutjet e të krishterëve të lidhura me hirin e Perëndisë e shpëtuan atë nga vdekja dhe ai vazhdoi ta mbronte dhe ta çlironte atë. Çlirimi i Palit nga Perëndia do të njihej dhe përlëvdohej nga shumë që do të bekoheshin nga shërbesat e vazhdueshme të Palit.

■ “njerëz” Kjo është fjalë për fjalë “fytyrë” (dmth., *prosōpon*) Pali e përdor këtë term shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 2:10; 3:7 [dy herë], 13,18; 4:6; 5:12; 8:24; 10:1,7; 11:20). Ai mund të jetë një aludim i Dhjatës së Vjetër ndaj qëndrimit fizik standart të lutjes hebraike me kokën e ngritur, i cili i përputhet saktësisht këtij konteksti.

Pali e përdor këtë term në disa kuptime tek 2 Korintasve:

1. Për njerëz, 2 Kor. 1:11; 2:10; 4:6
2. Për fytyrën e një personi, 2 Kor. 3:7 (dy herë), 2 Kor. 13,18; 10:1,7; 11:20
3. Metaforë për përpara në kuptimin e “përballë” (pra, pozicion, jo kohë), 2 Kor. 8:24
4. Metaforë për pamjen e jashtme (shih NRSV), 2 Kor. 5:12

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:12-14

<sup>12</sup> Mburrja jonë, në fakt, është kjo: dëshmimi i ndërgjegjes sonë se ne jemi sjellë me thjeshtësinë dhe sinqeritetin e Perëndisë në botë dhe sidomos përpara jush, jo me dituri mishi, por me hirin e Perëndisë.

<sup>13</sup> Sepse ne nuk ju shkruajmë të tjera gjëra, përveç atyre që ju mund të lexoni dhe të kuptoni; dhe unë shpresoj se do t'i kuptoni deri në fund; <sup>14</sup> sikurse i keni kuptuar tanimë deri diku, se ne jemi mburrja juaj, sikurse edhe ju do të jeni mburrja jonë, në ditën e Jezus Krishtit.

1:12 “Mburrja jonë” Këta terma grekë *kauchaomai*, *kauchēma* dhe *kauchēsis* përdoren rreth tridhjetë e pesë herë nga Pali dhe vetëm dy herë në pjesën tjetër të Dhjatës së Re (të dyja tek Jakobi). Përdorimi i tyre dominues është tek 1 dhe 2 Korintasve.

Gjenden dy të vërteta kryesore të lidhura me mburrjen:

1. Asnjë mish nuk do të përlëvdohet / mburret përpara Perëndisë (shih 1 Kor. 1:29; Efe. 2:9)
2. Besimtarët duhet të përlëvdohen në Zotin (shih 1 Kor. 1:31; 2 Kor. 10:17, që janë aludime ndaj Jer. 9:23-24)

Prandaj, ka një mburrje / përlëvdim të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm (dmth., krenaria).

1. I përshtatshëm
  - a. Në shpresë të lavdisë (shih Rom. 4:2)
  - b. Në Perëndinë përmes Zotit Jezus (shih Rom. 5:11)
  - c. Në kryqin e Zotit Jezus Krisht (dmth., tema kryesore e Palit, shih 1 Kor. 1:17-18; Gal. 6:14)
  - d. Pali mburret në
    - 1) Shërbesën e tij pa kompesim (shih 1 Kor. 9:15,16; 2 Kor. 10:12)
    - 2) Autoritetin e tij nga Krishti (shih 2 Kor. 10:8,12)
    - 3) Mburrjen e tij jo me veprën e njerëzve të tjerë (sikurse bënin disa në Korint, shih 2 Kor. 10:15)
    - 4) Trashëgiminë e tij racore (sikurse bënin të tjerë në Korint, shih 2 Kor. 11:17; 12:1,5,6)
    - 5) Kishat e tij
      - a) Korint (shih 2 Kor. 7:4,14; 8:24; 9:2; 11:10)
      - b) Thesalonika (shih 2 Thes. 1:4)



- 6) Siguria e tij në ngushëllimin dhe çlirimin e Perëndisë (shih 2 Kor. 1:12)
2. I papërshtatshëm

- a. Në lidhje me trashëgiminë hebraike (shih Rom. 2:17,23; 3:27; Gal. 6:13)
- b. Disa në kishën korintase mburreshin në
  - 1) Në njerëzit (shih 1 Kor. 3:21)
  - 2) Në urtësi (shih 1 Kor. 4:7)
  - 3) Në liri (shih 1 Kor. 5:6)
- c. Mësues të rremë që përpiqeshin të mburreshin në kishën në Korint (shih 2 Kor. 11:12)

■ **“dëshmimi i ndërgjegjes sonë”** Pali përdor termin “ndërgjegje” shpesh në letrat korintase (shih 1 Kor. 4:4; 8:7,10,12; 10:25,27,28,29; 2 Kor. 1:12; 4:2; 5:11). Ai i referohet ndjesisë së brëndshme morale të asaj që është e përshtatshme apo e papërshtatshme (shih Veprat e Apo. 23:1; Rom. 2:15). Ndërgjegja mund të ndikohet nga jetët tona të shkuara, nga zgjedhjet tona të gabuara ose nga Fryma e Perëndisë. Ajo nuk është një udhëheqës i pagabueshëm (shih 1 Kor. 4:4; 8:7; 1 Tim. 4:2), por ajo përcakton kufijtë e besimit individual (shih 1 Tim. 1:5,19). Prandaj, të dhunosh ndërgjegjen tonë, edhe nëse ajo është në gabim apo e dobët, është një problem kryesor besimi.

Ndërgjegja e besimtarit ka nevojë të jetë shumë e më shumë e formuar nga Fjala e Perëndisë dhe Fryma e Perëndisë (shih 1 Tim. 3:9). Perëndia do t’i gjykojë besimtarët në dritën që ata kanë, por të gjithë besimtarët duhet që të jenë progresivisht të hapur ndaj Biblës dhe Frymës për më shumë dritë dhe në mënyrë që të vazhdojnë të rriten në njohurinë e Zotit Jezus Krisht. Në këtë kontekst, gjykimi i kohëve të fundit është në pikëpamje (shih 2 Kor. 1:13-14). Perëndia do t’i gjykojë njerëzit në dritën e të kuptuarit të tyre, ndërgjegjes së tyre (shih Rom. 2:15-16; 9:1; 13:5).

Arsyet dhe veprimet e Palit u kritikuan ashpërsisht nga një minoritet mësuesish të rremë në Korint (shih kapitujt 10-13). Duket se kishte dy grupe: (1) një grup lokal kundërshtuesisht dhe (2) një grup hebre palestinez të mësuesve të rremë në lëvizje.

■ **“shenjtërinë”<sup>52</sup>** Disa dorëshkrime greke kanë “shenjtëri” (dmth., P<sup>46</sup>, s\*, A, B, C, K, P, dhe përkthimet koptike NASB, NIV dhe NJB). Të tjerë kanë “thjeshtësinë” (dmth., s<sup>2</sup>, D, F, G, dhe përkthimet Vulgate, Peshitta, NKJV, NRSV dhe TEV). Bruce Metzger tek *A Textual Commentary on the Greek New Testament* [Një Komentar Tekstual mbi Dhjatën e Re Greke], komenton se komiteti përkthyes për UBS<sup>3</sup> preferonte “thjeshtësinë” (*haplotēti*), por i dha asaj një vlerësim “D”, që do të thotë një shkallë shumë e lartë dyshimi (fq. 575). Megjithatë, botimi UBS<sup>4</sup> i jep një vlerësim “B”, që do të thotë pothuajse i sigurtë (fq. 612). Kjo e rriti sigurinë që vjen nga fakti që Pali përdor termin “thjeshtësi” tek 2 Kor. 11:3 (dhe i njëjti term përkthehet “liri” tek 2 Kor. 8:2; 9:11,13), por kurrë në shkrimet e tij nuk përdor *hagiotēti*.

■ **“sinqeritetin”** Ky term kishte dy kuptime, “zemërgjerë” ose “i sinqertë”. Ishte një metaforë e lidhur me shikimin. Në Dhjatën e Vjetër syri përdorej si një metaforë për qëllime në dy mënyra (1) syri i keq (koprac, BDB 949, shih Ligji i Përt. 15:9-10) dhe (2) syri i mirë (zemërgjerë, BDB 373 III, shih Fjalët e Urta 22:9). Jezusi ndoqi këtë përdorim (shih Matt. 6:22-23; 20:15). Pali e përdori këtë term në dy kuptime.

1. “thjeshtësi, sinqeritet, pastërti” (dmth., asnjë plan i fshehur apo pretendime të rreme, shih 2 Kor. 1:12; 11:3; Efe. 6:5; Kol. 3:22)
2. “liri” (shih Rom. 12:8; 2 Kor. 8:2; 9:11,13)

■ **“jo me dituri mishi”** Pali diskuton diturinë e botës gjerësisht tek 1 Korintasve (shih 1 Kor. 1:1831; 2:1-16; dhe 3:18-23 dhe në mënyrë sarkastike tek 2 Kor. 4:10; 6:5 dhe ndoshta 10:15). Pali përdor fraza të ngjashme për t’iu referuar urtësisë njerëzore tek 1 Kor. 1:17; 2:4,13-14. Në këtë paragraf ai bën një lojë me urtësinë e botës përkundërjet hirit të jetesës në botë. Prova e Palit e drejtimit të tij nuk është vetëm logjik dhe retorik, por një jetesë e perëndishme dhe një ndërgjegje e pastër përpara Perëndisë. Pali shpall se iu ka shkruar atyre në terma të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshëm. Nëse ata janë aq të ditur, ata duhet t’i kishin kuptuar shpejt dhe pa mundim fjalët e tij, motivet dhe nënkuptimet e stilit të jetesës së tij, por ata nuk e bënë.

Pali përdor këtë term “mishi” në disa kuptime. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

<sup>52</sup> Versioni në shqip është: “thjeshtësinë”. (shënim i përkthyesit)

**1:13-14** Këto vargje janë në një strukturë paralele dhe duket se i referohen letrave të mëparshme të Palit ndaj Korintit (cilës është e pasigurtë). Ai iu shkroi që të kuptohej. Megjithatë, qëndrimet dhe stilet e jetesës së tyre tregojnë se ata kuptuan vetëm pjesërisht.

A do të thotë termi *telous* në këtë konteskt “i plotë” (TEV, NJB, NIV) apo “fund” (NASB, NKJV, NRSV)? Të dyja kanë kuptim. Nëse është “i plotë” (dmth., plotësisht përkundrejt pjesërisht), ai do të lidhet me pjesën e parë të 2 Kor. 1:14. Nëse është “fund” do të ishte paralele me “ditën e Zotit tonë Jezus Krisht” në fund të 2 Kor. 1:14.

■ **“ne jemi mburrja juaj, sikurse edhe ju do të jeni mburrja jonë”** Kisha në Korint është një konfirmim i frytshmërisë apostolike të Palit. Pali dëshiron që fjalët e tyre, motivet dhe veprimet e tyre të jenë një burim krenarie dhe mburrjeje të përshtatshme kur Zoti të rikthehet për të gjykuar (dmth., “dita e Zotit tonë Jezus”, shih 1 Kor. 1:8; 5:5; Fil. 1:6,10; 2:16; 1 Thes. 5:2; 2 Thes 2:2).

**1:14 “në ditën e Zotit tonë Jezus”<sup>53</sup>** Fraza “në ditën” është një shprehje e Dhjatës së Vjetër. Shih shënimin tim nga komentari mbi Amos 2:16.

### TEMË E VEÇANTË: ATË DITË (SPECIAL TOPIC: THAT DAY)

Kjo frazë, “atë ditë”, ose “në atë ditë”, është mënyra sesi profetët e shekullit të tetë para Krishtit flisnin për vizitimin (praninë) e Perëndisë, si për gjykim, ashtu dhe për rimëkëmbje.

Osea		Amosi		Mikea	
<u>Positive</u>	<u>negative</u>	<u>positive</u>	<u>negative</u>	<u>positive</u>	<u>negative</u>
1:11	1:5		1:14(2)		2:4
	2:3		2:16		3:6
2:15			3:14	4:6	
2:16	4:5		5:18 (2)		5:10
2:18	5:9		5:20		7:4
2:21	6:2		6:3	7:11(2)	
	7:5		8:3	7:12	
	9:5	9:11	8:9 (2)		
	10:14		8:10		
			8:13		

Ky model është tipik për profetët. Perëndia do të veprojë kundër mëkatit në kohën e duhur, por Ai gjithashtu ofron një ditë pendimi dhe faljeje për ata që janë të gatshëm të ndryshojnë zemrën dhe veprimet (dmth., të marrin një zemër të re, një mendje të re dhe një frymë të re, shih Ezek. 36:22-27)! Synimi i shpengimit dhe rimëkëmbjes së Perëndisë do të përmbushet! Ai do të ketë një popull që pasqyron karakterin e Tij. Synimi i krijimit (bashkësia mes Perëndisë dhe njerëzimit) do të përmbushet!

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:15-22

<sup>15</sup> Dhe me këtë siguri unë doja të vija te ju më përpara që të kishit një vepër të mirë të dytë, <sup>16</sup> dhe, nga ju të shkoja në Maqedoni, dhe përsëri nga Maqedonia të vija te ju dhe ju të më përcillnit në Jude. <sup>17</sup> Kur mora këtë vendim, vallë mos kam vepruar me mendjehhtësi? Apo ato që unë vendos, i vendos sipas mishit, që të jetë tek unë po, po dhe jo, jo? <sup>18</sup> Por Perëndia është besnik; fjala jonë ndaj jush nuk ka qenë po dhe jo. <sup>19</sup> Sepse Biri i Perëndisë, Jezu Krisht, që u predikua ndër ju nga ne, pra, nga unë, nga Silvani dhe nga

<sup>53</sup> Versioni në shqip është: “në ditën e Jezu Krishtit”. (shënim i përkthyesit)

**Timoteu, nuk ka qenë "po" dhe "jo," por ka qenë "po" në Atë.** <sup>20</sup> Sepse të gjitha premtimet e Perëndisë janë në Atë "po" dhe në Atë "amen", për lavdi të Perëndisë nëpërmjet nesh. <sup>21</sup> Edhe Ai që na themelon neve bashkë me ju në Krishtin dhe na vajosi është Perëndia, <sup>22</sup> i cili edhe na vulosi dhe *na dha kaparin e Frymës në zemrat tona.*

**1:15 "me këtë siguri"** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 3:4.

▣ **"unë doja të vija te ju më përpara"** "Unë doja" është një kohë e papërkryer e cila përcakton veprime të përsëritura, këtu mendime, në të shkuarën. Tek 1 Kor. 16:2-8, Pali iu tha atyre për planet e tij të propozuara të udhëtimit. Për shkak të veprimeve të tyre, ai më vonë ndryshoi mendimin e tij sepse ai nuk dëshironte që të vinte në gjykim, por në gëzim! Minoriteti folës e akuzoi atë për paqëndrueshmëri, jo vetëm në planet e tij të udhëtimit, por edhe në ungjillin e tij (shih 2 Kor. 1:18-20).

**NASB** "që ju të mund të merrnit dy herë një bekim"  
**NKJV** "që të mund të kishit një vepër të mirë të dytë"  
**NRSV** "që ju të mund të kishit një favor të dyfishtë"  
**TEV** "në mënyrë që ju të mund të bekoheshit dy herë"  
**NJB** "që ju të mund të përfitonit në mënyrë të dyfishtë"

Këtu gjendet një variant dorëshkrimi grek. Disa dorëshkrime kanë *charin*, që vjen nga *charis*, që do të thotë përfitim ose favor (pra,  $\kappa^*$ , A, C, D, F, G, dhe përkthimet siriake dhe armeniane). Dorëshkrime të tjera kanë *charan*, që vjen nga *chara*, që do të thotë gëzim, hare ose të gëzosh (pra,  $\kappa^2$ , B, L, P). Teksti grek UBS<sup>4</sup> i jep *charin* një vlerësim "B" (pothuajse i sigurtë). Në kontekst (dmth., 2 Kor. 1:16) ajo i referohet ardhjes së Palit dy herë në Korint dhe mundësisë që ata kishin për të siguruar nevojat e tij ndërkohë që ai udhëtonte (shih Gordon D. Fee, *To What End Exegesis?* [Çfarë e Përfundoi Eksegjezën?], fq. 99-104).

**1:16 "dhe ju të më përcillnit në Jude"** Pali nuk do të merrte para nga kisha korintase ndërkohë që iu shërbente atyre. Ai kishte frikë se do të sulmohej mbi këtë çështje. Sikurse rezultoi, ai u sulmua pse nuk mori para prej tyre. Kjo frazë nënkupton se ai do ta linte këtë kishë të siguronte për nevojat e tij të udhëtimit misionar (shih 1 Kor. 16:6; Rom. 15:24). Kjo mund të ketë qenë një mënyrë për të sprovuar besnikërinë e tyre ndaj tij dhe ungjillit dhe për t'i bërë të heshtin kritikët e tij.

**1:17 "i vendos sipas mishit"** Kjo frazë mund të reflektojë kritikët e Palit (shih 2 Kor. 10:2-3; 11:18) ose Palin që kërkon vullnetin e Perëndisë në gjithçka që ai bën, përfshirë udhëtimet e tij (shih 1 Kor. 4:19; 16:7; Veprat e Apo. 18:21; Rom. 1:10; 15:32).

Fakti se opsioni i dytë i përshtatet këtij konteksti më mirë mund të shihet nga 2 Kor. 1:18a. Besnikëria e Perëndisë është tema e përsëritur në shkrimet e Palit (shih 1 Kor. 1:9; 10:13; 1 Thes. 5:24; 2 Thes. 3:3).

Për "mish" shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**1:18 "Perëndia është besnik"** Besnik vendoset në fillim për theks. Në shkrimet e Palit ky bëhet një titull përshkrues për Perëndinë (shih 1 Kor. 1:9; 10:13; 1 Thes. 5:24; 2 Thes. 3:3). Në Dhjatën e Vjetër, besim zakonisht kuptohet si besnikëri. Kjo është karaktersitka thelbësore e Perëndisë (shih Ligji i Përt. 7:9; Isa. 49:7). Karakteri i Tij i hirshëm dhe besnik është i pandryshueshëm (shih Mal. 3:6). Shpresa e njerëzimit nuk është në performancën apo përkushtimin njerëzor, por në karakterin dhe premtimet e Perëndisë (shih 2 Kor. 1:12,15,20)!

**1:19 "Biri i Perëndisë, Jezu Krisht"** Pali nuk përdor frazën "Biri i Perëndisë" shpesh (shih Rom. 1:4; këtu dhe tek Gal. 2:20). Megjithatë, koncepti dhe fraza e lidhur me të është shumë e zakonitë. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9.

▣ **"Silvani"** Silas, ose Silvani, ishte njeriu që Pali zgjodhi që ta shoqëronte në udhëtimin e tij të dytë misionar pasi Barnaba dhe Gjon Marku u rikthyen në Qipro.

1. Ai përmendet për herë të parë në Bibël tek Veprat e Apo. 15:22 ku ai quhet një njeri kyç mes vëllezërve të Kishës Jeruzalem.

2. Ai ishte gjithashtu një profet (shih Veprat e Apo. 15:32).
3. Ai ishte një qytetar romak si Pali (shih Veprat e Apo. 16:37).
4. Ai dhe Juda Barsaba u dërguan në Antiok nga Kisha Jeruzalem për të inspektuar situatën (shih Veprat e Apo. 15:22,30-35).
5. Pali e përmend atë tek 2 Kor. 1:19 si një bashkë-predikues të ungjillit.
6. Më vonë ai identifikohet me Pjetrin në shkrimin e 1 Pjetrit (shih 1 Pjet. 5:12).
7. Si Pali dhe Pjetri e quajnë atë Silvani ndërkohë që Luka e quan atë Silas (forma aramaike e Saul). Është e mundur që Silas ishte emri i tij hebraik dhe Silvani ishte emri i tij latin (shih F. F. Bruce, *Paul: Apostle of the Heart Set Free* [Pali: Apostulli me Zemrën e Çliruar], fq. 213)

**1:19-20 “por është<sup>54</sup> po në Të”** Vargjet 19 dhe 20 janë të mbushura teologjikisht! Pali po konfirmon se skuadra e misionit (ai vetë, Silvani dhe Timoteu) predikonin Jezusin si premtimi përmbushës i Perëndisë si Biri i Perëndisë dhe si shpresa e vetme e njerëzimit për ata si kulmi i zbulesës së Dhjatës së Vjetër! Predikimi i tyre nuk ishte i shpëlarë, por i caktuar (shih 2 Kor. 1:18). Jezusi është “po”-ja e Atit për çdo premtim, çdo nevojë, çdo shpresë (dmth., forma treguese aktive e përkryer e *ginomai*). Duke konfirmuar Jezusin, ata i jepnin lavdi sigurimit të Atit. E gjithë kisha e Korintit kishte njohuri për (1) Perëndinë, (2) Birin e Tij, (3) premtimet e Tij (shih Rom. 9:4) dhe (4) sigurimit të Tij të hirshëm përmes skuadrës së misionit të Palit. Nëse ata fillonin të dyshonin motivet dhe mesazhin e Palit, ata humbisnin sigurinë në ungjill!

**1:20 “Amen”** Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 14:16c.

▣ **“lavdi”** Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) [SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*)] tek 1 Kor. 2:7.

**1:21-22** Këtu është një strukturë e përcaktuar ndaj këtyre dy vargjeve që përshkruan se çfarë Perëndia (dmth., “Ai që”) ka bërë për të pajisur dhe konfirmuar skuadrën misionare.

1. Perëndia na themelon, 2 Kor. 1:21 (shih 1 Kor. 1:8). Kjo është një formë pjesore aktive e tashme e cila tregon drejt një veprimi të vazhdueshëm. Ajo do të thotë të konfirmosh, të themelosh, të bësh të vazhdueshme dhe të palëkundur (shih 2 Kor. 1:7; Rom. 4:16). Ky term përdoret në papirusë për të përcaktuar një garanci ligjore (shih Moulton dhe Milligan, fq. 107).
2. Perëndia na vajosi, 2 Kor. 1:21 (shih 1 Gjoni 2:20,27). Kjo është një formë pjesore aktive aoriste. Koha e foljes tregon drejt një veprimi të përfunduar, të njëhershëm. Vetë termi reflekton një koncept të Dhjatës së Vjetër të Perëndisë që zgjedh dhe pajis për shërbesë drejtues të caktuar të Izraelit
  - a. profetë, shih 1 Mbret. 19:16 dhe ndoshta paralelizëm i 1 Kro. 16:22; Ps. 105:15
  - b. priftërinj, shih Eksod. 40:15; Lev. 4:3; Ps. 105:15
  - c. mbretër, shih 1 Sam. 9:16; Ps. 2:2; 18:50; 20:6; Hab. 3:13
 Është termi që në greqisht përkthehet “Krisht” kur i referohet Mesias (dmth., i Vajosuri). Besimtarët gjithashtu zgjidhen dhe pajisen nga Perëndia për t’iu shërbyer qëllimeve të mbretërisë së Tij.
3. Perëndia na vulos ne, 2 Kor. 1:22 (shih Gjoni 3:33; 6:27; Rom. 4:11; 15:28; 1 Kor. 9:2; Efe. 1:13; 4:30; 2 Tim. 2:19; Zbu. 7:3-8). Kjo është një formë pjesore aoriste e mesme e cila do të thotë të caktosh diçka ose dikë si pasuri e dikujt, ose si të pastër, ose ta çlirosh në siguri. Besimtarët i përkasin Perëndisë!
4. Perëndia na dha ne Frymën në zemrat tona si kapar, 2 Kor. 1:22 (shih 2 Kor. 5:5; Rom. 8:9-16,23,26-27; Efe. 1:13-14).

Termi “dhënë” është një tjetër formë pjesore aoriste aktive, duke nënkuptuar një veprim të përfunduar. Perëndia ka siguruar plotësisht për fëmijët e Tij.

1. Themelon (koha e tashme)
2. Vajosur (koha aoriste)
3. Vulosur (koha aoriste)
4. Dhënë Fryma (koha aoriste)

Të gjitha këto sigurime lidhen me sigurinë e Palit tek 2 Kor. 1:15,19-20. Siguria e Palit ishte në veprimet dhe sigurimet e Atit dhe të Birit dhe të Frymës.

<sup>54</sup> Versioni në shqip është: “ka qenë”. (shënim i përkthyesit)

■ **“Krishtin... Perëndia... Frymës”** Vini re se Trinia është aktive në sigurinë tonë (shih Temën e Veçantë që vijon). Megjithëse termi “Trini” nuk shfaqet në Bibël, koncepti është i përsëritur (shih 1 Kor. 12:4-6; 2 Kor. 13:14). Krishtërimi është një besim monoteistik (shih Ligji i Përt. 6:4). Megjithatë, nëse Jezusi është hyjnor dhe Fryma e Shenjtë është një person ne kemi tre persona të një thelbi hyjnor. Një unitet trium! Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10.

### **TEMË E VEÇANTË: SIGURIA E SHPËTIMIT (SPECIAL TOPIC: ASSURANCE)**

- A. A mund ta dinë të krishterët se janë të shpëtuar (shih 1 Gjonit 5:13)? 1 Gjonit ka tre prova ose dëshmi.
1. Doktrimore (besimi) (shih 1 Gjonit 1,5,10; 2:18-25; 4:1-6,14-16; 5:11-12)
  2. Të stilit të jetesës (bindja) (shih 1 Gjonit 2-3; 2:3-6; 3:1-10; 5:18)
  3. Shoqërore (dashuria) (1 Gjonit 2-3; 2:7-11; 3:11-18; 4:7-12, 16-21)
- B. Siguria e shpëtimit është bërë çështje denominacionale
1. John Calvin [Gjon Kalvini] e bazonte sigurinë e shpëtimit në zgjedhjen e Perëndisë. Ai thoshte se nuk mund të jemi kurrë të sigurt në këtë jetë.
  2. John Wesley [Gjon Uezli] e bazonte sigurinë në përjetimin fetar. Ai besonte se ne kemi aftësinë të jetojmë pa kryer mëkate të njohura.
  3. Katolikët romakë dhe denominacioni “Kisha e Krishtit” e bazojnë sigurinë e shpëtimit në kishën e autoritetshme. Grupi të cilit i përket njeriu është çelësi për të patur siguri shpëtimi.
  4. Shumica e ungjillorëve e bazojnë sigurinë në premtimet e Biblës, që lidhet me frytin e Frymës (shih Gal. 5:22-23) në jetën e besimtarit (pra, ngjashmërinë e përditshme me Krishtin).
- C. Siguria parësore e njerëzimit të rënë lidhet me karakterin e Perëndisë trium
1. dashuria e Perëndisë Atë
    - a. Gjoni 3:16; 10:28-29
    - b. Romakëve 8:31-39
    - c. Efesianëve 2:5, 8-9
    - d. Filipianëve 1:6
    - e. 1 Pjetrit 1:3-5
    - f. Gjoni 4:7-21
  2. veprimet e Perëndisë Bir
    - a. vdekja për hirin tonë
      - 1) Veprat e Apo. 2:23
      - 2) Romakëve 5:6-11
      - 3) 2 Korintasve 5:21
      - 4) 1 Gjonit 2:2; 4:9-10
    - b. lutja kryepriftërore (Gjoni 17:12)
    - c. ndërmjetësimi i vazhdueshëm
      - 1) Romakëve 8:34
      - 2) Hebrenjve 7:25
      - 3) 1 Gjonit 2:1
  3. shërbesa e Perëndisë Frymë
    - a. thirrja (Gjoni 6:44, 65)
    - b. vulosja
      - 1) 2 Korintasve 1:22; 5:5
      - 2) Efesianëve 1:13-14; 4:3
    - c. dhënia e sigurisë
      - 1) Romakëve 8:16-17
      - 2) 1 Gjonit 5:7-13
- D. Por njerëzit duhet t’i përgjigjen ofertës së besëlidhjes së Perëndisë (qoftë në fillim, ashtu dhe në vazhdimësi)
1. besimtarët duhet t’i kthejnë shpinën mëkatit (pendimi) dhe të kthehen te Perëndia përmes

- Jezusit (besimi)
- a. Marku 1:15
  - b. Veprat e Apo. 3:16, 19; 20:21
2. besimtarët duhet të marrin ofertën e Perëndisë në Krishtin (shih Temën e Veçantë: Ç’do të thotë “pranoj”, “besoj”, “rrëfej”, “i bëj thirrje”? [Special Topic: What Does It Mean to "receive," "believe," "confess/profess," "call upon"?])
    - a. Gjoni 1:12; 3:16
    - b. Romakëve 5:1 (dhe, në mënyrë të ngjashme, 10:9-13)
    - c. Efesianëve 2:5, 8-9
  3. besimtarët duhet të vazhdojnë në besim (shih Temën e Veçantë: Qëndrueshmëri [Special Topic: Perseverance])
    - a. Marku 13:13
    - b. 1 Korintasve 15:2
    - c. Galatasve 6:9
    - d. Hebrenjve 3:14
    - e. 2 Pjetrit 1:10
    - f. Juda 20-21
    - g. Zbulesa 2:2-3, 7, 10, 17, 19, 25-26; 3:5, 10, 11, 21
- E. Siguria e shpëtimit është e vështirë sepse
1. shpesh, besimtarët kërkojnë disa përjetime që nuk premtohen në Bibël
  2. shpesh, besimtarët nuk e kuptojnë plotësisht ungjillin
  3. shpesh, besimtarët vazhdojnë të mëkatojnë me dashje (shih 1 Kor. 3:10-15; 9:27; 1 Tim. 1:19-20; 2 Tim. 4:10; 2 Pje. 1:8-11)
  4. disa lloje personaliteti (pra, perfeksionistët) nuk mund ta pranojnë dot kurrë pranimin dhe dashurinë e pakushtëzuar të Perëndisë
  5. në Bibël ka shembuj rrëfimesh të rreme besimi (shih Mat. 13:3-23; 7:21-23; Marku 4:14-20; 2 Pje. 2:19-20; 1 Gjonit 2:18-19; shih Temën e Veçantë: Femohimi [Special Topic: Apostasy])

Shih Temën e Veçantë: Siguria e krishterë (Special Topic: Christian Assurance), për një përvijim të ndryshëm të kësaj doktrine.

1:22 “na vulosi” Shih TEMË E VEÇANTË: VULA (SPECIAL TOPIC: SEAL) tek 1 Kor. 9:2.

■ “zemrat tona” Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 14:25.

■ “si një kapar” Kjo flet si për premtimin e pagesës së plotë në të ardhmen dhe pagesës së pjesëshme tani. PAGESA e Perëndisë ishte jeta e Birit të Tij dhe prania e plotë e Frymës së Tij (shih Efe. 1:3-14). Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 5:5.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 1:23-24

<sup>23</sup> Dhe unë e thërras Perëndinë për dëshmitar mbi jetën time që, për t’ju kursyer, nuk kam ardhur ende në Korint. <sup>24</sup> Jo se kemi pushtet mbi besimin tuaj, por jemi bashkëpunëtorët e gëzimit tuaj, sepse për shkak të besimit ju qëndroni të patundur.

1:23

NASB

NKJV

NRSV

TEV

NJB

“Por unë thërras Perëndinë si dëshmitar për shpirtin tim”

“Dhe unë thërras Perëndinë si dëshmitar përkundrejt shpirtit tim”

“Por unë thërras Perëndinë si dëshmitar përkundrejt meje”

“unë thërras Perëndinë si dëshmitarin tim – ai e njeh zemrën time”

“Me anë të jetës sime unë thërras Perëndinë të jetë dëshmitari im”

Ky është një betim i vërtetësisë. Pali shpesh përdor betime për të konfirmuar fjalët e tij (shih 2 Kor. 11:11,31; Rom. 1:9; Gal. 1:20; Fil. 1:8; 1 Thes. 2:5).

▣ **“për t’ju kursyer”** Ndryshimi i planeve të udhëtimit të Palit nuk ishte një shembull i paqëndrueshmërisë së tij, por i dashurisë së tij. Ai zgjodhi të mos kthehet në një atmosferë ku mundësia e tij e vetme ishte gjykimi dhe grindja. Mësuesit e rremë kishin kundërshtuar motivet dhe veprimet e tij. Pali i vuri gjërat drejt!

▣ **“nuk kam ardhur ende në Korint”** Ka shumë debat mbi numrin e vizitave që Pali bëri nga Efesi në Korint dhe numrin e letrave që ai i shkroi kishës në Korint. Për më shumë informacion shih hyrjen tek 2 Korintasve, pika D.

**1:24 “Jo se kemi pushtet mbi besimin tuaj”** Këtu ne shohim ekuilibrin midis Palit si një apostull autoritativ, 1:1, dhe lirisë së kësaj grigje lokale. Besimi biblik, besimi i besëlidhjes, fillon dhe zhvillohet përmes zgjedhjeve të vullnetshme të cilat kanë për qëllim të prodhojnë gëzim, qëndrueshmëri dhe pjekuri.

▣ **“sepse për shkak të besimit ju qëndroni të patundur”** Pali e përmend këtë koncept tek 1 Kor. 15:1 (shih Rom. 5:2; 11:20). Kjo mund të ketë një sfond të Dhjatës së Vjetër (shih Ps. 76:7; 130:3; Nah. 1:6; Mal. 3:2; shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9). Ajo flet për besimin e sigurtë në praninë e Perëndisë. Në dritën e problemeve në Korint, ky është një pohim shokues. Kisha korintase të paktën nuk ndikohej nga mbërritja e mësuesve të rremë sa kishin bërë kishat galatase. Disa nga kishat shtëpi ishin të forta dhe të pastra (dmth., koha e përkryer: “ju keni qënë dhe vazhdoni të qëndroni fort”). Shih Temën e Veçantë: Qëndroj (*Histēmi*) [Special Topic: Stand (*Histēmi*)] tek 1 Kor. 15:1.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Nëse Pali po i shkruan një problemi lokal në Korint, pse u lexua letra përgjatë Akaisë? (2 Kor. 1:1)
2. Cilat janë dy përfitimet e vuajtjes të përmendura tek 2 Kor. 1:4 dhe 9?
3. Çfarë vuajtjesh kaloi Pali në Azi që pothuajse e vranë atë? (v.8-10)
4. Pse u sulmua Pali për ndryshimin në planet e tij të udhëtimit? (1 Kor. 16:1-8 përkundrejt 2 Kor. 1:12-20)
5. Pse besojmë ne në një Trini?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

## 2 KORINTASVE 2

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shtyrja e Vizitës së Palit (1:12-2:4)	Ruajtja e Kishës 1:15-2:2	Marrëdhënie të Fundit me Kishën (1:12-2:13)	Ndryshimi në Planet e Palit (1:12-2:4)	Pse Pali Ndryshoi Planet e Tij (1:12-2:11)
1:23-2:4 Falja e Fajtorit	Falja e Fajtorit 2:3-11	1:23-2:4	1:23-2:4 Falja e Fajtorit	
2:5-11		2:5-11	2:5-11	2:5-11
Ankthi dhe Lehtësimi i Palit	Triumf në Krishtin		Ankthi i Palit në Troas	Nga Troas në Maqedoni – Apostullati: Rëndësia e Tij
2:12-13	2:12-13	2:12-13 Shërbesa Jonë (2:14-3:6)	2:12-13 Fitore Përmes Krishtit	(2:12-4:6)
2:14-17	2:14-17	2:14-17	2:14-17	2:12-3:3

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### HYRJE

- A. Ka shumë diskutim mes komentatorëve se sa vizita i bëri dhe sa letra i shkroi Pali kësaj kishe. Ky kapitull është thelbi i këtij diskutimi sepse duket se i referohet një letre të mëparshme dhe një vizite të dhimbshme. Ka shumë paqartësi si në tekstin ashtu edhe në njohurinë tonë të jetës së Palit. Dogmatizmi është i papërshtatshëm.
- B. Një sferë tjetër diskutimi e përfshirë në këtë kapitull është nëse fajtori i përmendur tek 2 Kor. 2:5 dhe 6 është
  - a. Sinonim me njeriun fajtor për incest tek 1 Korintasve 5
  - b. Një drejtues të një nga grupimeve ose kishave shtëpi të përmendura tek 1 Korintasve 1-4
  - c. Një kryetar i mësuesve të rremë nga Jeruzalemi i cili e konfrontoi Palin personalisht gjatë kësaj vizite të dhimbshme, 2 Korintasve 10-13.



- C. Ndarja e kapitullit është dukshëm e papërshtatshme. Kapitulli 2 lidhet në mënyrë integrale me diskutimin e planeve të udhëtimit të Palit të përmendur tek 2 Kor. 1:15 e në vazhdim.
- D. Gjendet një devijim i madh nga tema ose kllapa në fillim tek 2 Kor. 2:14. Pali nuk rikthehet tek diskutimet e tij në lidhje me mbledhjen me Titin në Maqedoni deri tek 2 Kor. 7:5. Unë falenderoj Perëndinë për këtë devijim për shkak se na tregon zemrën e Palit dhe dashurinë e tij të madhe për Jezus Krishtin!

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 2:1-4

<sup>1</sup>Por unë kisha vendosur në veten time të mos vij përsëri te ju me hidhërim. <sup>2</sup>Sepse, në qoftë se unë ju hidhëroj, kush do të më gëzojë mua, në mos ai vetë që u hidhërua prej meje? <sup>3</sup>Dhe ju shkrova në këtë mënyrë që, kur të vij, të mos kem trishtim nga ata që duhet të më gëzonin, duke pasur besim në ju të gjithë, se gëzimi im është i të gjithë juve. <sup>4</sup>Ju shkrova, në fakt, me shumë lot dhe me pikëllim të madh dhe ankth në zemër, jo që të hidhëroheni, por që të njihni dashurinë shumë të madhe që kam për ju.

2:1

NASB, NKJV

“Por”

NRSV, TEV, NIV, REB

“Kështu”

NJB

“atëherë”

RSV

“Sepse”

Gjendet një variant dorëshkrimi grek midis “sepse” (dmth., *gar*, shih P<sup>46</sup> dhe B) dhe “por” (dmth., *de*, shih 8, A, C, D, F, G). UBS<sup>4</sup> i jep “sepse” një vlerësim “C”, duke treguar se ata nuk mund të vendosin. Shpesh lidhësat janë thelbësorë në interpretim, por në këtë rast kuptimi i fjalisë e përkufizon çështjen.

NASB

“unë vendosa këtë për veten time”

NKJV

“unë kisha vendosur në veten time”

NRSV, TEV, NJB

“vendosa”

Kjo duket se nënkupton se Pali nuk kishte njohuri të veçanta nga Fryma rreth kësaj çështjeje. Ai përmend disa herë se si Fryma drejtoi planet e tij të udhëtimit (shih Veprat e Apo. 16:9-10; 18:21; Rom. 1:10; 15:32; 1 Kor. 4:19), por këtë herë ai nuk ka asnjë udhëzim specifik dhe vendos të mos vijë.

■ **“të mos vij përsëri te ju me hidhërim”** Pali përmend një vizitë të tretë në Korint tek 2 Kor. 12:14; 13:1. Libri i Veprave të Apostujve nuk e regjistron këtë vizitë të dytë të dhimbshme. Qëndrimi i tij fillestar në Korint regjistrohet tek Veprat e Apo. 18:1-11. Shih tek Hyrja, Data, Pika E. “vizitë” C. Ndoshta kjo ndodhi midis shkrimit të letrës së parë dhe të dytë të Korintasve.

**2:2 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Vizita e dytë e Palit e kishte trishtuar kishën. Mua më pëlqen përkthimi NJB për këtë varg: “sepse nëse ju shkaktoj mërzë po i shkaktoj mërzë burimit tim të vetëm të mundshëm të gëzimit.” Pali nuk i pëlqente aspekti konfrontues i përgjegjësisë së tij apostolike.

**2:3 “ju shkrova në këtë mënyrë”** Gjenden disa teori që përpiqen të shpjegojnë këto vargje.

1. Disa e quajnë këtë një formë aoriste letrash, që do të thotë se do t’i referohej 2 Korintasve (shih NJB)
2. Disa besojnë se i referohet 1 Korintasve
3. Të tjere besojnë se i referohet letrës së mëparshme të humbur të përmendur tek 1 Kor. 5:9
4. Të tjerë mendojnë se kjo i referohet një letre të ashpër të humbur, ndoshta e ruajtur pjesërisht tek 2 Korintasve 10-13

**2:4** Ky varg aq qartazi zbulon zemrën e Palit dhe dhimbjen emocionale që ndjente ai për çfarë ndodhi gjatë vizitës së tij të dhimbshme. Megjithatë, ai flet të vërtetën, ashtu e dhimbshme siç ishte. Si një doktor i mirë mjekësor, Pali e dinte se ndonjëherë dhimbja ishte e nevojshme për shërim afatgjatë.

Pali përdor këto dy folje në formë lidhore në këtë fjali për shkak se ndonjëherë njerëzit nuk i përgjigjen mirë korrigjimit. Perëndia krijoi të gjithë njerëzit me vullnet të lirë, gjë që është diçka si e çmuar ashtu edhe e rrezikshme. Ajo përmban potencialin e gëzimit dhe restaurimit ose hidhërimit dhe vazhdimin të rebelimit.

**NASB** “veçanërisht”  
**NKJV, NRSV** “me tepri”  
**NJB** “sa shumë”

Ky varg gjithashtu përfshin një nga termat karakteristike të Palit të cilin ai e përdor aq shpesh tek letrat e tij korintase (dmth., *perissoterōs*). Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:5 ose Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

#### **VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 2:5-11**

<sup>5</sup> Edhe në qoftë se dikush ka shkaktuar trishtim, s’më ka hidhëruar vetëm mua, por deri diku, pa e tepruar, ju të gjithë. <sup>6</sup> Mjaft është për atë njeri ndëshkimi që iu bë nga shumica, <sup>7</sup> por tani, përkundrazi, ju duhet më tepër ta falni atë dhe ta ngushlloni, që ai njeri të mos gëlltitet nga trishtimi i tepërt. <sup>8</sup> Prandaj ju lutem t’i shfaqni dashuri, <sup>9</sup> sepse ju shkrova edhe për këtë, që të njoh provën tuaj, nëse jeni të dëgjueshëm në çdo gjë. <sup>10</sup> Por atij që ju do t’i falni diçka, e fal edhe unë, sepse edhe unë, nëse kam falur gjë, kujtdo që t’ia kem falur, e bëra për ju përpara Krishtit, <sup>11</sup> që të mos na mposhtë Satanai, sepse ne i dimë qëllimet e tij.

**2:5** Ky varg është shumë i vështirë për t’u përkthyer! Unë besoj se kuptimi i përkthimeve RSV dhe Phillips janë ndoshta më të mirët: “por nëse dikush ka shkaktuar dhimbje, ai nuk ma ka shkaktuar atë mua, por në një farë mase (jo për ta vendosur shumë rëndë) jua ka shkaktuar ju të gjithëve.” Nuk ka asnjë kundrinor të përmendur në këtë fjali, prandaj, disa e lidhin atë me (1) të gjithë kishën (shih NKJV, NJB, RSV, Phillips, NIV, NEB) ose (2) personin që bën fajin (shih KNOX translation).

Kush është ky “ai” që shkakton problem? Ka pasur disa sugjerime.

1. I referohet 1 Kor. 5:9 dhe njeriut që u martua me bashkëshorten e babait të tij
2. I referohet kryetarit të një nga grupimeve ose kishave shtëpi
3. I referohet folësit të grupit të “drejtuesve” të supozuar nga Palestina të cilët e konfrontuan Palin në rikthimin e tij në Korint dhe dukshëm kisha nuk e mbrojti Palin ashtu siç duhej të kishte bërë.

▣ **“në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Dikush ka shkaktuar dhimbje, si ndaj Palit ashtu edhe ndaj të gjithë kishës (forma treguese aktive e përkryer) dhe rrethanat mbeteshin.

**2:6 “ndëshkimi që iu bë nga shumica”** Vendimi nuk ishte unanim. Pali, edhe kur sulmohej, kujdesej për sulmuesin (shih 2 Kor. 2:7) dhe rrethanat frymërore që mund të shkaktojnë kundërshtia dhe konfrontimi (shih 2 Kor. 2:11).

Përmendja e “shumica” tregon se si Pali e shihte qeverisjen e kishës. Ai ndjente vetveten të thirrur apostull ndaj johebrenjve, por kjo nuk hoqi aspektin e përgjegjësisë për të drejtuar grigjën. Pali mban një ekuilibër të shkëlqyer në letrat e tij midis urdhërimeve autoritative (dmth., Galatasve dhe 1 Korintasve 5) dhe nevojës për drejtim lokal. Dhjata e Re ka tre forma të qeverisjes: apostolike (dmth., episkopale); drejtuesit lokalë (dmth., presbiterian) dhe kongregacionale (dmth., çdo besimtar). Veprat e Apostujve 15 i përfshin të tre nivelet në procesin kishtar. Nuk është një çështje se cila është biblike; të gjitha ato janë. Është një çështje e besimtarëve të perëndishëm që drejtojnë brenda udhëzimeve biblike, dhe jo planeve personale!

**2:7 “përkundrazi, ju duhet më tepër ta falni atë dhe ta ngushlloni”** Këto janë të dyja forma infinitive aoriste. Disiplina e kishës nuk është kurrë hakmarrëse, por gjithmonë shpenguese (shih Gal. 6:1). Mëkati duhet të ekspozohet, por gjithashtu edhe të mbulohet (dmth., i falur nga Perëndia, i falur nga kisha) pasi ai ekspozohet. Për “ngushëllim” shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

**NASB** “mund të mbingarkohet nga trishtimi i tepërt”

NKJV	“të mos gëlltitet nga trishtimi i tepërt”
NRSV	“të mos mbingarkohet nga trishtimi i tepërt”
TEV	“nga të trishtuarit aq i madh sa të dorëzohet plotësisht”
NJB	“mund të mbingarkohet nga masa e madhe e shqetësimit të tij”

Fraza e parë është fjalë për fjalë “se mos një person i tillë gëlltiet nga trishtimi i tepërt”. Shih Temën e Veçantë më poshtë.

Termi i dytë, *katapinō*, gjithashtu është një metaforë intensive. Ajo është fjalë për fjalë “të gulposësh poshtë”. Ajo përdoret në kuptimin pozitiv tek 2 Kor. 5:4 (dmth., jetë e përjetuar). Në mënyrë negative ajo mund të nënkuptojë të shkatërrosh (shih 1 Kor. 15:54; 2 Kor. 2:7; Heb. 11:29; 1 Pjet. 5:8).

Eksperienca personale dhe trajnimi teologjik i Palit e bënë atë akutisht të vetëdijshëm të thellësive të mëkatit dhe lartësive të hirit dhe mëshirës së Perëndisë. Zgjedhja e fjalëve që ai bën zbulojnë thellësinë e ndjenjave të tij.

#### TEMË E VEÇANTË: TEPROJ (*PERISEUŌ*) [SPECIAL TOPIC: ABOUND (*PERISEUŌ*)]

Pali e përdor këtë term shpesh. Ai përcakton atë që rrjedh me tepri (dmth., në një kuptim pozitiv).

1. E vërteta e Perëndisë teproi për lavdinë e Tij, Rom. 3:7
2. Dhurata falas e hirit e atij një njeriu, Jezus Krishtit, teproi, Rom. 5:15
3. Besimtarët teprojnë në shpresë, Rom. 15:13
4. Besimtarët nuk e fitojnë miratimin e Perëndisë duke ngrënë ose mos ngrënë disa ushqime, I Kor. 8:8 (shih Mark 7:15,17-23)
5. Besimtarët teprojnë në ndërtimin e kishës, I Kor. 14:12
6. Besimtarët teprojnë në punën e Zotit, I Kor. 15:58
7. Besimtarët marrin pjesë me bollëk në vuajtjen e Krishtit dhe me bollëk në ngushëllimin e Krishtit, II Kor. 1:5
8. Shërbesa e drejtësisë tepron në lavdi, II Kor. 3:9
9. Falenderimi i besimtarëve duhet të teprojë për lavdinë e Perëndisë, II Kor. 4:15
10. Bollëku i gëzimit të besimtarëve, II Kor. 8:2
11. Besimtarët teprojnë në çdo gjë (besim, fjalë, njohuri, zell dhe dashuri), gjithashtu në dhuratën për kishën e Jerusalemit, II Kor. 8:7
12. I gjithë hiri tepron për besimtarët, II Kor. 9:8
13. Falenderimi me tepri i besimtarëve ndaj Perëndisë, II Kor. 9:12
14. Pasuritë e hirit të Perëndisë janë derdhur me tepri mbi besimtarët, Efe. 1:8
15. Dashuria e besimtarëve të mund të teprojë gjithnjë edhe më shumë, Fil. 1:9
16. Siguria e besimtarëve në Palin tepron në Krishtin, Fil. 1:26
17. Pasja me tepri, Fil. 4:12,18
18. Besimtarët teprojnë me mirënjohje, Kol. 2:7
19. Besimtarët të rriten dhe të teprojnë në dashuri për njëri-tjetrin, I Thes. 3:12
20. Teproni në jetesë të perëndishme, I Thes. 4:1
21. Teproni në dashuri për besimtarët e tjerë, I Thes. 4:10

Të kuptuarit e Palit të hirit të Perëndisë në Krishtin ishte “me tepri,” dhe po ashtu është edhe nevojja që besimtarët të ecin në këtë hir dhe dashuri “me tepri” në jetën e tyre të përditshme!

**2:8 “ju lutem t’i shfaqni dashuri”** Kjo i referohet rikthimit në pozitën e mëparshme ose veprimit ligjor nga një votim zyrtar (shih përdorimin e termit tek Gal. 3:15) të kishës përmes motivit të dashurisë. Është e mundur që ajo është metaforike e realitetit të diçkaje (shih Louw and Nida, p. 668).

**2:9 “ju shkrova”** Shih shënimin tek 2 Kor. 2:3.

▣ **“provën”** Kjo i referohet një prove të monedhave metalike për t’u siguruar për pastërtinë e tyre. Ajo duket se ka një ngjyrim në Dhjatën e Re për “të testuar me një synim drejt aprovimit”. Shih Temën e Veçantë mbi “Sprovimin” tek 1 Kor. 3:13.

▣ **“nëse jeni të dëgjueshëm në çdo gjë”** Kjo ishte një sprovë e besnikërisë së tyre ndaj autoritetit të Palit. Kjo ishte çështja (shih 2 Kor. 7:15; 10:6).

Gjendet një variant i dorëshkrimit grek i lidhur me “nëse.” Disa MSS kanë

1. *ei - s*, C, D, F, G
2. *η - A*, B
3. hequr - P<sup>46</sup>

Duket se P<sup>46</sup>, edhe pse shumë i vjetër, u bë me nxitim dhe shpesh heq fjalë ose fraza. Për sa i përket opsioneve të tjera, ata shqiptoheshin njësoj. Shumë nga dorëshkrimet e hershme greke u kopjuan nga një person që lexonte një tekst dhe disa të tjerë që e shkruanin atë. Prandaj, variantet si ky të lidhur me tingujt, janë të zakonitë. Versioni UBS<sup>4</sup> i jep opsionit numër 1 një shkallëzim “A” (i sigurtë).

**2:10 “falni”** Ky term, *charizomai* (shih 2 Kor. 2:7,10; 12:13) vjen nga fjala rrënjë *chairō*, që do të thotë të gëzosh, të jesh i gëzuar. Në këtë kontekst ajo do të thotë të falësh ose të heqësh hirshëm (shih 2 Kor. 2:7,10 [tri herë]).

Pali i kërkon shumicës që të falë tek 2 Kor. 2:7 (forma infinitive aoriste e mesme); tek 2 Kor. 2:10 ai përsërit kërkesën e vazhdueshme (forma treguese e tashme e mesme); tek 2 Kor. 2:10 ai i siguron ata për faljen e tij (dmth., përemri vetor *egō*) të hirshme dhe të vazhdueshme ndaj fajtorit (dy forma treguese të mesme të përkryera).

▣ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Pali përsërit faljen e tij personale të fajtorit.

▣ **“për ju përpara Krishtit”** Kjo është mënyra e Palit për të vërtetuar se restaurimi i fajtorit do ta forcojë kishën. Ai vetë është në gjendje ta bëjë për shkak të dashurisë së tij për Krishtin.

## 2:11

NASB	“që Satani të mos përfitojë nga ne në asnjë mënyrë”
NKJV	“që të mos përfitojë nga ne Satani”
NRSV	“që të mos mposhemi nga Satani”
TEV	“në mënyrë që të pengojmë Satanin nga marrja e dorës së fortë”
NJB	“që të shmangim mposhtjen nga Satani”

Ky varg konfirmon forcën personale të së ligut në botën tonë për të penguar planin e Perëndisë. Pali e thërret atë me disa tituj tek 2 Korintasve.

1. Satan tek 2 Kor. 2:11; 11:14; 12:7
2. “zoti i kësaj epoke (bote)” tek 2 Kor. 4:4
3. “Belial” tek 2 Kor. 6:15
4. “gjarpri” tek 2 Kor. 11:3

“Ne” mund t’i referohej vetë Palit, ose Palit dhe kishës korintase. Është interesante të dimë se Satani tundon si me anë të tërheqjes tek e liga ashtu edhe me anë të shtrëmbërimit të së mirës. Një qëndrim i papërshtatshëm, mosfalës, i zemëruar apo krenar nga ana e kishës mund t’i hapë derën Satanit për të shpëputur marrëdhënien. Shih TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON / SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL tek 1 Kor. 7:5.

▣ **“sepse ne nuk jemi injorantë për qëllimet e tij”<sup>55</sup>** I ligu përpiqet të ndikojë jetët tona (shih Efe. 4:14; 6:10-18). Shpesh besimtarët janë injorantë (dmth., *agnōō*) të qëllimeve të tij.

### TEMË E VEÇANTË: PLANE (TEK PALI) [SPECIAL TOPIC: SCHEMES (IN PAUL)]

Kjo është fjala greke *noēma*. Ajo përdoret nga Pali pesë herë tek 2 Korintasve dhe vetëm një herë tjetër

<sup>55</sup> Versioni në shqip është: “sepse ne i dimë qëllimet e tij”. (shënim i përkthyesit)

tek Fil. 4:7. Ajo vjen nga rrënja *nous* që do të thotë “mendje” ose “mendime”. Pali e zhvillon këtë në dy mënyra.

A. Mendim i lig ose shkatërrues

1. Qëllime të Satanit 2 Kor. 2:11
2. Mendje të ngurtësuar dhe të mbuluara në mosbesim, 2 Kor. 3:14
3. Mendje të verbuara nga Satani (perëndia i kësaj bote), 2 Kor. 4:4
4. Mendje të mashtruara nga Satani (sikurse Eva) dhe të drejtuara në rrugën e gabuar, 2 Kor. 11:3

B. Mënyrë e perëndishme e të menduarit

1. Duke ia nënshruar çdo mendim bindjes ndaj Krishtit, 2 Kor. 10:5
2. Paqja e Perëndisë e cila tejkalon çdo të kuptuar (dmth., *nous*) do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja (dmth., *noemata*)

I menduari njerëzor dhe aftësitë gjuhësore njerëzore janë pjesë e shëmbëllimit të Perëndisë (shih Temën e Veçantë: E Folura Njerëzore / Special Topic: Human Speech). Këto dhurata të mrekullueshme mund të përdoren për mirë ose për keq. Besimtarët duhet të ruajnë mendimet dhe fjalët e tyre. Mendja jonë mund të zihet në kurth, mund të verbohët dhe manipulohet nga Satani (shih Temën e Veçantë: Satani / Special Topic: Satan dhe Temën e Veçantë: Lufta Frymërore / Special Topic: Spiritual Warfare). Mendjet tona gjithashtu mund të fuqizohen në mënyrë të mrekullueshme nga Perëndia për lavdinë e Tij dhe për Mbretërinë e Tij. Ne jemi kujdestarë të mendimeve, planeve dhe qëllimeve tona!

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 2:12-13**

<sup>12</sup> Dhe, kur arrita në Troas për ungjillin e Krishtit edhe m'u hap një derë në Zotin, <sup>13</sup> nuk gjeta prehje në frymën time, sepse nuk gjeta aty Titin, vëllanë tim; prandaj, si u përshëndeta me ta, shkova në Maqedoni.

**2:12 “kur arrita në Troas”** Kjo ndjek itinerarin e 1 Kor. 16:5 (shih Veprat e Apo. 16:8-11). Pali dukshëm po sulmohej nga disa në Korint për shkak të mosrealizimit të planeve të tij të udhëtimit. Pali përpiqet të shpjegojë pse.

■ **“edhe m'u hap një derë në Zotin”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer që nënkupton se Perëndia hapi këtë mundësi për ungjillin dhe se ajo vazhdon të qëndrojë e hapur! “Derë e hapur” është një metaforë e famshme e Palit (shih 1 Kor. 16:9; Kol. 4:3; dhe gjithashtu Veprat e Apo. 14:27 dhe Zbu. 3:8). Kjo frazë thekson fuqinë efektive të Perëndisë përmes shërbesës shpenguese të përmbushur të Mesias dhe nxitjes së Frymës së Tij për ungjillizim dhe dishepullizim të krishterë (shih Mat. 28:19-20 dhe Veprat e Apo. 15:3-4,12; 21:19). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 16:9.

**2:13 “nuk gjeta prehje në frymën time”** Ky është përdorimi i “frymë” si sinonim me një person ose njeri (shih 2 Kor. 7:13; 1 Kor. 16:18). Pali ishte vazhdimisht i shqetësuar (forma treguese aktive e përkryer) për Korintin (shih 2 Kor. 7:5). Imagjinata e Palit u lëshua; bëni kujdes për tuajën. Ai la një derë të hapur në Troas për shkak të shqetësimit dhe frikës së tij për kishën e Korintit. Pali e donte këtë kishë të përçarë dhe krenare!

■ **“sepse nuk gjeta aty Titin”** Pali e kishte dërguar më parë Timoteun në Korint, por ai dukshëm nuk ishte pritur mirë nga kisha dhe prandaj Pali kishte dërguar Titin me një letër të ashpër (shih 2 Kor. 2:3-4). Pali nuk kishte marrë vesh për të në kohën e pritshme dhe ishte shqetësuar shumë. Titi përmendet disa herë tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 2:13; 7:6,13,14; 8:6,16,23; 12:18).

**TEMË E VEÇANTË: TITI (SPECIAL TOPIC: TITUS)**

- A. Titi ishte një nga bashkëpunëtorët më të besuar të Palit. Kjo provohet nga fakti që Pali e dërgoi atë

tek pikat problematike të Korintit dhe Kretës.

- B. Ai ishte një johebre i plotë (Timoteu ishte vetëm gjysmë grek), i konvertuar nën predikimin e Palit. Pali refuzoi ta rrethpriste atë (shih Galatasve 2).
- C. Ai përmendet shpesh në letrat e Palit (shih 2 Kor. 2:13; 7:6-15; 8:6-24; 12:18; Gal. 2:1-3; 2 Tim. 4:10) dhe është shumë befasuese që Luka nuk e përmend atë tek Veprat e Apostujve. Disa komentarë japin teorinë që
  - 1. Ai mund të ketë qënë një i afërm i Lukës (ndoshta vëlla) dhe përfshirja e emrit të tij do të ishte parë si një veprim i papërshtatshëm i Lukës nga ana kulturore ose
  - 2. Titi është burimi kryesor i Lukës për informacion rreth jetës dhe shërbesës së Palit dhe prandaj, sikurse Luka, nuk përmendet me emër
- D. Ai shoqëronte Palin dhe Barnabën tek Këshilli i rëndësishëm i Jeruzalemit, i regjistruar tek Veprat e Apostujve 15.
- E. Libri i Titit përqëndrohet mbi këshillën që Pali i jep Titit për veprën e tij në Kretë. Titi po sillet si përfaqësues zyrtar i Palit.
- F. Informacioni i fundit në Dhjatën e Re rreth Titit është që ai u dërgua për të punuar në Dalmaci (shih 2 Tim. 4:10).

■ “shkova në Maqedoni” Gjendet një parantezë në mendimet e Palit deri tek 2 Kor. 7:5. Është një devijim nga tema për t’i dhënë lavdi Perëndisë për Krishtin! Devijimi është aq i bukur dhe ndihmës sa që falenderojmë Perëndinë për të. Shumë nga citimet më të paharrueshme të Palit vijnë nga ky devijim.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 2:14-17

<sup>14</sup>Por, faleminderit Perëndisë, që na bën të ngadhnjejmë gjithnjë në Krishtin dhe shfaq kudo nëpërmjet nesh erën e këndshme të njohurisë së vet. <sup>15</sup>Sepse ne jemi për Perëndinë era e këndshme e Krishtit ndër ata që shpëtohen dhe ndër ata që humbasin; <sup>16</sup>për këta një erë vdekjeje në vdekje, po për ata erë jete në jetë. Dhe kush është i zoti për këto? <sup>17</sup>Ne në fakt nuk falsifikojmë fjalën e Perëndisë, si shumë të tjerë, por flasim me sinqeritet si nga ana e Perëndisë, përpara Perëndisë në Krishtin.

2:14 “faleminderit Perëndisë” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### TEMË E VEÇANTË: LAVDËRIMI, LUTJA DHE FALENDERIMI I PALIT NDAJ PERËNDISË (SPECIAL TOPIC: PAUL'S PRAISE, PRAYER, AND THANKSGIVING TO GOD)

Pali ishte një njeri i lavdërimit. Ai e njihte Dhiatën e Vjetër. Secila nga katër ndarjet (dmth., librat) e Psalmeve përfundon me doksologji (shih Ps. 41:13; 72:19; 89:52; 106:48). Njerëzit që e njohin Perëndinë e lavdërojnë dhe lartësojnë Atë shpesh.

- 1. Paragrafët e hyrjes në letrat e tij
  - a. bekimet apo përshëndetjet e hyrjes (shih Rom. 1:7; I Kor. 1:3; II Kor. 1:2)
  - b. bekimet e hyrjes (*eulogētos*, shih II Kor. 1:3-4; Efe. 1:3-14)
- 2. shpërthime të shkurtra lavdërimi
  - a. Rom. 1:25; 9:5
  - b. II Kor. 11:31
- 3. doksologji (të karakterizuara nga përdorimi i [1] *doxa* {dmth., lavdi} dhe [2] “në përjetësi/përjetë”)
  - a. Rom. 11:36; 16:25-27
  - b. Efe. 3:20-21
  - c. Fil. 4:20
  - d. I Tim. 1:17
  - e. II Tim. 4:18
- 4. falenderime (dmth., *eucharisteō*)
  - a. hyrje të letrave (shih Rom. 1:8; I Kor. 1:4; II Kor. 1:11; Efe. 1:16; Fil. 1:3; Kol. 1:3,12; I

Thes. 1:2; II Thes. 1:3; Filemon v. 4; I Tim. 1:12; II Tim. 1:3)

- b. thirrje për falenderim (shih Efe. 5:4,20; Fil. 4:6; Kol. 3:15,17; 4:2; I Thes. 5:18)
- 5. shpërthime të shkurtra falenderimi
  - a. Rom. 6:17; 7:25
  - b. I Kor. 15:57
  - c. II Kor. 2:14; 8:16; 9:15
  - d. I Thes. 2:13
  - e. II Thes. 2:13
- 6. bekime të mbylljes
  - a. Rom. 16:20,24
  - b. I Kor. 16:23-24
  - c. II Kor. 13:14
  - d. Gal. 6:18
  - e. Efe. 6:24

Pali e njihte Perëndinë Triun teologjikisht dhe nga përvoja. Në shkrimet e tij ai e fillon me lutje dhe me lavdërim. Në mes të prezantimeve të tij ai shpërthen në lavdërim dhe falenderim. Në mbyllje të letrave të tij, ai gjithmonë kujtohet të lutet, të lavdërojë dhe të falenderojë Perëndinë. Shkrimet e Palit janë plot me lutje, lavdërime dhe falenderime. Ai e njihte Perëndinë, e njihte veten dhe e njihte ungjillin.

■ **“gjithnjë”** Perëndia gjithmonë na drejton ne (1) përmes Krishtit; (2) në fitoren e Krishtit dhe (3) për qëllim të dëshmisë (dmth., “manifestohet përmes nesh”, forma pjesore aktive e tashme, shih 2 Kor. 2:15-16).

**NASB, NKJV “që gjithnjë na drejton në triumf në Krishtin”**

**NRSV “që në Krishtin gjithmonë na drejton në proçesion triumfator”**

**TEV “të udhëhequr nga Perëndia si të burgosur në proçesionin fitimtar të Krishtit”**

**NJB “i cili gjithmonë na bën pjesë në Krishtin në proçesionin e tij triumfator”**

Kjo frazë i referohet praktikave ushtarake romake të marshimit triumfator për komandantët legjionarë fitimtar përmes rrugëve të Romës, që do ta theksonte Krishtin si fitimtar (forma pjesore është në njëjës). Ai i ka shkatërruar të gjitha fuqitë kundërshtarë (shih Kol. 2:15, folja shfaqet vetëm në këto dy fraza në Dhjatën e Re). Besimtarët që e ndjekin Atë, jo si të burgosur (TEV, NEB dhe REB e përkthejnë këtë shprehimisht si “të burgosur”, por kjo është kundër fitores së dukshme të kontesktit, vetëm nëse Pali po i referohet vuajtjeve dhe poshtërimeve të tij si një ungjilltar të krahasuara me të burgosurit në një paradë romake), por si bashkë-ushtarë! Ne jemi fitimtarë për shkak të Tij dhe përmes Tij! Fitorja jonë është marrë tashmë, por ne duhet të zgjedhim ta kërkojmë atë dhe të ecim në të çdo ditë!

■ **“ne”** Përmerat shumë tek 2 Kor. 2:14-17 i referohen (1) apostujve; (2) Palit dhe skuadrës së tij të misionit ose (3) të gjithë besimtarëve që shpërndajnë ungjillin. Për mua, opsioni numër 2 është fokusi, por opsioni numër 3 është ajo që nënkuptohet. Ungjilltarët janë fitimtarë, por duhet të paguhet një çmim (shih 2 Kor. 4:7-12; 6:3-10; 11:23-30).

■ **“shfaq”** Pali e përdor këtë fjalë aq shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 2:14; 3:3; 4:10,11; 5:10,11[dy herë]; 7:12; 11:6). Termi do të thotë të tregosh qartazi ose të bësh të njohur. Dëshira më e madhe e Palit ishte që të zbulonte Perëndinë plotësisht, publikisht dhe qartazi duke zbuluar personin dhe veprën e Krishtit (dmth., ungjillin).

■ **“kudo... të njohurisë së vet”** Kisha korintase ishte krenare për trashëgiminë e saj intelektuale. Pali ishte krenar për njohurinë e tij të Perëndisë përmes Krishtit. Njohuria nuk është për lavdi personale, por për ungjillizim. Ashtu sikurse ne jemi “gjithmonë” (dmth., *pantote*) të udhëhequr në triumf në Krishtin, po kështu nga ne pritët që të zbulojmë qartazi (dmth., të manifestojmë) mesazhin e Krishtit “kudo” (dmth., *panti*). Ungjilli universal i Krishtit duhet të ndahet me anë të ndjekësve të Tij fitimtarë në çdo vend (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

Pali e përdor shpesh këtë frazë të vogël “kudo” (shih 1 Kor. 1:2; 1 Thes. 1:8; 1 Tim. 2:8). Unë vras mendjen nëse ky nuk është një aludim ndaj Mal. 1:11, i cili profetizon një adhurim mbarëbotëror të Mesias së Perëndisë?

**2:15 “Sepse ne jemi për Perëndinë era e këndshme e Krishtit”** Kjo frazë ka dy sfone të mundshme.

1. Në Dhjatën e Vjetër tymi nga flijimi dhe aroma ngjiteshin tek Perëndia dhe pranoheshin si një aromë e ëmbël (shih Zan. 8:21; Eksod. 29:18,25; tek LXX tek Lev. 1:9,13,17; 2:2; gjithashtu i përdorur në mënyrë metaforike nga Pali tek Fil. 4:18)
2. Në shekullin e parë aroma digjej përgjatë shtegut të paradës ushtarake romake për në Romë

Shpërndarja e ungjillit është flijimi i lavdërimit i pranuar nga YHWH. Besimtarët pranohen në Krishtin me qëllim arritjen e ngjashmërisë me Krishtin dhe ndarjen e ungjillit të Tij.

▣ **“ata që shpëtohen dhe ndër ata që humbasin”** Dallimi duket se janë ata që po humbasin dhe ata që po humbasin nën një veprim të vazhdueshëm të vullnetit të tyre (forma pjesore aktive e tashme), dhe ata që shpëtohen dhe janë duke u shpëtuar me anë të vullnetit të Perëndisë përmes Krishtit (forma pjesore pasive e tashme). Për rëndësinë teologjike të “ata që po shpëtohen”, shih TEMË E VEÇANTË: KOHË FOLJESH NË GREQISHT TË PËRDORURA PËR SHPËTIMIN / SPECIAL TOPIC: SALVATION (GREEK VERB TENSES) tek 1 Kor. 3:15.

Për konceptin e “humbas” shih diskutimin e plotë teologjik tek 1 Kor. 1:18, që është paralele me këtë tekst.

**2:16 “Dhe kush është i zoti për këto”** Predikimi i ungjillit e ndan njerëzimin përjetësisht. Nga 2 Kor. 3:5-6 ne kuptojmë se Perëndia pajis fëmijët e Tij për këtë përgjegjësi të mrekullueshme të dëshmimit. Jeta e çdo besimtarit është një aromë ndaj Perëndisë, aromë ndaj së cilës të tjerët reagojnë, ose duke besuar ndaj Krishtit ose duke e refuzuar Krishtin. Është e rëndësishme se si jetojmë; të tjerët po na shohin (shih 2 Kor. 2:16; 3:2,3). Ndërsa lexoj këtë varg mendoj se sa herë dhe në sa vende kam pasur privilegjin të ndaj ungjillin. Një njeri nuk e di kurrë se kush është i pranishëm ose çfarë po kalojnë të tjerët! Disa nga predikimet e mia janë të mira dhe disa të tjera janë dështime të vërteta! Si mundet një shpallës t’i bëjë ballë presionit që dëgjuesit e tij kanë një zgjedhje të përjetshme për të bërë të bazuar në atë që dëgjojnë nga folësi njerëzor? Ai nuk ia del dot. Detyra është e Frymës, jo e shpallësit! Ne duhet të jemi besnikë ndaj të folurit të ungjillit por përgjegjësia jonë frymore ka kufij! Është ungjilli i Perëndisë! Është bota e Tij! Asnjë nuk mund të shpëtohet pa prekjen e Frymës (shih Gjoni 6:44,65). Logjika apo elokuenca njerëzore nuk janë faktori thelbësor!

**2:17 “ne nuk jemi si shumë të tjerë”<sup>56</sup>** Pali po i referohet (1) mësuesve shëtitës në botën greko-romake të cilët udhëtonin nga një vend në tjetrin për të mësuar dhe (2) filozofëve që krahasoheshin me mësuesit e rremë që vinin nga Palestina (sikurse ata tek Gal. 1:6-9) dhe sulmonin Palin, ungjillin e tij dhe apostullatin e tij (shih 2 Kor. 4:2). Gjendet një variant i lidhur me “shumë” (MSS ⋈, A, B, C, K, P). Të tjerë variante të MSS (P<sup>46</sup>, D, F, G, L) kanë “pjesën tjetër” (NKJV, shënimi NRSV). Bruce Metzger, *A Textual Commentary of the Greek New Testament* [Një Komentari Tekstual i Dhjatës së Re Greke], fq. 577, thotë se mundësia e dytë është një term “ofendues” të cilin Pali nuk do ta kishte përdorur në këtë kontekst. UBS<sup>4</sup> i jep opsionit të parë një shkallëzim “B” (pothuajse i sigurtë).

▣ **“falsifikojmë fjalën e Perëndisë”** Ky është një term nga industria e verës. Ai përdorej në dy mënyra:

1. Ta hollosh verën në masë të tillë që të nxjerrësh më shumë para (dmth., përziej)
2. Të reklamosh produktin për përfitime (dmth., reklamues)

Pali nuk e ndryshoi mesazhin e tij (ungjillin) për audiencën të ndryshme (dmth., grekët, hebrenjtë), por ai e përshtati përjasjen e tij (shih predikimet e Palit tek Veprat e Apostujve dhe pohimin e tij tek 1 Kor. 9:19-23).

▣ **“por flasim me sinqeritet”** Ky term vjen nga një rrënjë “të jesh i papërzierë” (shih 2 Kor. 1:12). Kjo do të ishte e kundërta e “i pavlerë”. Kjo fjalë e rrallë për sinqeritetin është ndoshta një term i përbërë nga “rreze dielli” dhe “gjykim”. Ajo përcjell konceptin e qëllimeve të pafshehura dhe të pastra (shih 1 Kor. 5:8; 2 Kor. 1:12; 2:17; Fil. 1:10; 2 Pjet. 3:1). Vini re paralelizmin midis “por flasim me sinqeritet” dhe “por si nga Perëndia”.

<sup>56</sup> Version në shqip është: “Ne në fakt nuk falsifikojmë fjalën e Perëndisë, si shumë të tjerë”. (shënim i përkthyesit)



▣ **“fjalën e Perëndisë... nga ana e Perëndisë... përpara Perëndisë”** Pali konfirmon se mesazhi i tij i ungjillit është mesazhi i Perëndisë dhe se mesazhi është Krishti! Pali falenderon Perëndinë (shih 2 Kor. 2:14) për:

1. Triumfin tonë në Krishtin (shih 2 Kor. 2:14)
2. Shpalljen tonë të një njohurie të Tij kudo (shih 2 Kor. 2:14)
3. Mesazhi ynë për Të prodhon jetë ose vdekje (shih 2 Kor. 2:15-16)
4. Mesazhi ynë i papërzierë është nga Perëndia, përpara Perëndisë, rreth Krishtit dhe në Krishtin (shih 2 Kor. 2:17)

▣ **“ne flasim në Krishtin përpara Perëndisë”** Po kjo frazë përsëritet 2 Kor. 12:19. Kjo duket se është një mënyrë shprehimore e të konfirmuarit të besueshmërisë dhe vërtetësisë së ungjillit.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse Pali i diskuton kaq shumë planet e tij të udhëtimit?
2. Sa letra i shkroi Pali kishës korintase?
3. Shpjegoni sfondin e triumfit tek 2 Kor. 2:14.
4. Si i bëhet ballë presionit frymëror të përfshirë tek 2 Kor. 2:15-16 kur ne e dimë se ndarja e ungjillit mund të nënkuptojë diferencën midis qiellit dhe ferrit?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

## 2 KORINTASVE 3

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërbestarë të Besëlidhjes së Re	Letra e Krishtit	Shërbesa Jonë (2:14-3:6)	Shërbëtorë të Besëlidhjes së Re	Nga Troas në Maqedoni – Apostullati: Rëndësia e Tij (2:12-4:6)
3:1-3	3:1-3 Fryma, Jo Shkronja	3:1-3	3:1-3	3:1-3
3:4-6	3:4-6 Lavdia e Besëlidhjes së Re	3:4-6 Shërbesa e Besëlidhjes së Re	3:4-6	3:4-11
3:7-11	3:7-18	3:7-11	3:7-11	
3:12-18		3:12-18	3:12-18	3:12-18

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Theksi i këtij kapitulli është shumë i ngjashëm me theksin e Librit të Hebrenjve. Është një krahasim midis Besëlidhjes së Vjetër dhe Besëlidhjes së Re. Si bëhen të drejtë me Perëndinë njerëzit mëkatarë.
  - a. Performanca e Ligjit të Moisiut
  - b. Besimi në veprën pajtuese të Perëndisë në Krishtin?

Ky krahasim përdoret nga Pali për të mbrojtur ungjillin e tij dhe veten e tij përkundrejt mësuesve të rremë të orientuar ndaj hebraizmit të cilët kishin mbërritur në Korint.
- B. Përdorimi i këtij kapitulli i termit “frymë” është tejet i paqartë. Ka pasur shumë diskutim mbi 2 Kor. 3:6,8,17 dhe 18. A po e lidhin ata me “Frymën e Shenjtë” apo konceptin “frymëror”? Duket se gjendet një rrjedhshmëri e qëllimtë midis këtyre të dyjave. Epoka e re është epoka e Frymës (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38), i cili inauguron një marrëdhënie frymërore me Perëndinë përkundrejt një marrëdhënieje legaliste, të bazuar mbi performancë.
- C. Përdorimi i Palit i termit “ligj” (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 9:9)
  - a. Ligj = zemërim; Rom. 3:20; 4:15; Gal. 3:10-13; Kol. 2:14
  - b. Ligj = mirë frymërisht; Rom. 7:14
  - c. Kontrasti midis Rom. 1:5; 2:13; Gal. 3:12; dhe Rom. 3:2 ose 8:7; 2 Kor. 3:6; Gal. 3:21

- d. Pali përdor Abrahamin dhe Moisiun si dy simbole tipologjike të marrëdhënies midis “besimit” dhe “ligjit”  
Ligji është i mirë. Ai është nga Perëndia. Ai i shërbente, dhe vazhdon t’i shërbejë, një qëllimi hyjnor (shih Rom. 7:7,12,14,22,25). Ai nuk mund të sjellë paqe apo shpëtim. James Stewart në librin e tij *A Man in Christ* [Një Njeri në Krishtin], tregon të menduarit dhe shkrimin paradoksisht të Palit:  
“Normalisht pritet, që një person i cili ka vendosur të ndërtojë një sistem mendimi dhe doktrine, të rregullojë në mënyrë sa më të ngurtë të mundshme kuptimet e termave që ai përdor. Pritet që ai të synojë tek precizioni në frazologjinë e ideve të tij kryesore. Do të prisnim që një fjalë, e përdorur një herë nga shkrimtari në një kuptim të caktuar, do të mbante atë kuptim përgjatë gjithë materialit. Por të presësh këtë nga Pali do të thotë të zhgënjehesh. Shumë nga frazologjia e tij është e rrjedhshme, jo e ngurtë... ‘Ligji është i shenjtë’, shkruan ai, ‘unë kënaqem në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm’ (Rom. 7:12-13) por është qartazi një aspekt tjetër i *nomos* që e bën atë diku tjetër të thotë: ‘Krishti na ka shpënguar nga mallkimi i mëkatit’ (shih Gal. 3:13)” (fq. 26).

D. Pali përdor tre metafora kryesore në këtë kapitull:

- a. Letrat, 2 Kor. 3:1-3
  - i. Letrat e rekomandimit, 2 Kor. 3:1
  - ii. Ata janë letrat, 2 Kor. 3:2
  - iii. Pllakat e Dhjatës së Vjetër, 2 Kor. 3:3
- b. Besëlidhja e Vjetër dhe e Re, 2 Kor. 3:6-11
  - i. E shkruar përkundrejt frymërore, 2 Kor. 3:3,6
  - ii. Vret përkundrejt jep jetë, 2 Kor. 3:6
- c. Veli, 2 Kor. 3:7, 12-16
  - i. Moisiu, 2 Kor. 3:7, 12-16
  - ii. Hebrenjtë e kohës së Palit, 2 Kor. 3:14
  - iii. Besimtarët, 2 Kor. 3:14-16

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 3:1-3

<sup>1</sup> A fillojmë përsëri të rekomandojmë veten tonë? Apo mos kemi nevojë, si disa, për letra rekomandimi për ju ose për rekomandime nga ana juaj? <sup>2</sup> Ju jeni letra jonë, e shkruar në zemrat tona, e njohur dhe e lexuar nga të gjithë njerëzit, <sup>3</sup> duke qenë manifestuar se jeni një letër e Krishtit, e hartuar me anë të shërbesës sonë, dhe e shkruar jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë, dhe jo mbi rrasa guri, por mbi rrasa të një zemre mishi.

**3:1** Forma gramatikore e të dyja pyetjeve tek 2 Kor. 3:1 pret një “jo” si përgjigje. Është e vështirë të dish nëse Pali po tregohet sarkastik apo zemër-thyer.

☐ **“të rekomandojmë”** Kjo është një fjalë e përbërë nga “të vendosësh” dhe “bashkë”, që përdoret në mënyrë metaforike për të demonstruar, vendosur së bashku apo rekomanduar.

1. Për të demonstruar (shih Rom. 3:5; 5:8; 2 Kor. 7:11; Gal. 2:18)
2. Për të qëndruar (shih Kol. 1:17)
3. Për të rekomanduar (shih Rom. 16:1; 2 Kor. 3:1; 4:2; 5:12; 6:4; 10:12,18; 12:11)

☐ **“si disa”** Pali e përdor këtë term shpesh tek 2 Korintasve për shkak të konfliktit me mësuesit e rremë agresivë nga Palestina të cilët u përpoqën të ngrinin veten e tyre duke e krahasuar vetveten me Palin dhe sfondin e tij dhe ungjillin e tij (shih 2 Kor. 3:2; 2:17; 10:2). Ai gjithashtu përdor të njëjtën shprehje në një kuptim negativ tek 1 Korintasve për t’u lidhur me veprimet dhe besimet e disa anëtarëve të kishës (shih 2 Kor. 4:18; 15:12).

▣ **“letra rekomandimi”** Kisha e hershme zbatonte procedurën e letrave të rekomandimit për t’u siguruar për ortodoksinë dhe besueshmërinë e shërbestarëve në lëvizje (shih Veprat e Apo. 18:27; Rom. 16:1; 1 Kor. 16:3,1518; Fil. 2:29-30; 3 Gjoni 1:12).

**3:2 “Ju jeni letra jonë, e shkruar në zemrat tona”** Pali po konfirmon se ai nuk ka nevojë për një letër për të rekomanduar vetveten tek kjo kishë (ose nga kjo kishë), për shkak se ai është themeluesi i saj frymëror sikurse Krishti është shpëtimtari dhe Zoti i saj. Ata ishin letra e tij prej mishi dhe gjaku (shih 2 Kor. 3:3).

Fraza “shkruar në zemrat tona” është në formën pjesore pasive të përkryer. Pali e donte këtë kishë. Ata ishin përherë në zemrën dhe mendjen e tij. Forma pasive nënkupton se Perëndia / Krishti / Fryma është agjenti (shih 2 Kor. 3:3), i cili prodhon dashurinë e Palit.

Shih TEMË E VEÇANTË: ZEMRA / SPECIAL TOPIC: THE HEART tek 1 Kor. 14:25.

▣ **“e njohur dhe e lexuar”** Gjendet një lojë tingulli midis këtyre dy fjalëve greke (dmth., *ginōskomenē* dhe *anaginōskomenē*, shih 2 Kor. 1:13). Të dyja janë forma pjesore pasive të tashme.

▣ **“nga të gjithë njerëzit”** Ky është rasti ku termi “të gjithë” përdoret por jo me kuptimin përfshirës (shih Rom. 11:26). Kjo është dukshëm një hiperbolë, aq e zakonitë në letërsinë hebraike (shih Mat. 5:29-30,38-42; 6:24; 7:3-5; 23:23-24).

**3:3 “duke qenë manifestuar”** Shih shënimin tek 2 Kor. 2:14.

▣ **“jeni një letër e Krishtit”** Qëllimi i besimtarëve është të zbulojnë qartazi Krishtin me motivet e tyre, fjalët dhe veprimet e tyre. Mënyra se si jetojmë reflekton reputacionin e Tij!

▣ **“me anë të shërbesës sonë”** Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

▣ **“Frymën e Perëndisë së gjallë”** Terminologjia që i referohet Perëndisë Triun është shumë fluide. Frymës shpesh i referohet si Fryma e Jezusit (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11). Këtu i njëjti lloj rrjedhshmërie drejtohet tek Ati. Titulli “Perëndi i gjallë” është një lojë ndaj YHWH, i cili vjen nga folja hebraike “të jesh” (shih Eksod. 3:14). Titulli përshkruar është i zakonitë për Atin në Dhjatën e Re (shih Mat. 16:16; 26:63; Veprat e Apo. 14:15; Rom. 9:26; 2 Kor. 6:16; 1 Thes. 1:9; 1 Tim. 3:15; 4:10; Heb. 3:12; 9:14; 10:31; 12:22; Zbu. 7:2). Në Dhjatën e Vjetër idhujt paganë ishin pa jetë. Ata nuk mund të përgjigjeshin ose ishin të vdekur një pjesë të vitit (dmth., dimrin) duke ndjekur ciklet e pjellorisë së natyrës. YHWH ishte i vetmi Perëndi i gjallë vërtet, gjithmonë i gjallë!

▣ **“jo mbi rrasa guri, por mbi rrasa të një zemre mishi”** Kjo duket se lidhet me dhënien e ligjit tek Eksod. 31:18 dhe me premtimin e një Besëlidhjeje të Re (shih Jer. 31:31-34 dhe Ezek. 36:22-38). Ky është një kontrast i qartë midis Besëlidhjes së Vjetër si një ligj i jashtëm përkundrejt Besëlidhjes së Re si e brendshme (dmth., zemra e re, mendja e re dhe fryma e re, shih Ezek. 11:19; 36:26).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 3:4-6

<sup>4</sup> Dhe këtë besim ne e kemi në Perëndinë me anë të Krishtit; <sup>5</sup> jo se jemi të aftë prej vetiu të kuptojmë ndonjë gjë sikur vjen nga vetja jonë, por aftësia jonë vjen nga Perëndia, <sup>6</sup> i cili na bëri të aftë të jemi shërbëtorë të besëlidhjes së re, jo të shkronjës, por të Frymës, sepse shkronja vret, por Fryma jep jetë.

▣ **“besim”** Ky është një tjetër term i Palit i përdorur më së shumti tek 2 Korintasve. Ai vjen nga e njëjta rrënjë greke sikurse siguri, besoj, kam besim (dmth., *peithō* dhe *pistis, pisteuō*). Ajo në thelb do të thotë të besosh, të kesh siguri ose të varesh.

1. Konteksti pozitiv:

- a. Planet e udhëtimit të Palit, 2 Kor. 1:15
- b. Siguria e Palit në Perëndinë përmes Krishtit, 2 Kor. 3:4
- c. Siguria e Palit në Titin, 2 Kor. 8:22

- d. Siguria e Palit në Krishtin, Efe. 3:12
- 2. Konteksti negativ:
  - a. Pali dëshiron të jetë i butë me ta, 2 Kor. 10:2
  - b. Krahasimi ngurrues i Palit i kredencialeve të tij me mësuesit e rremë, Fil. 3:4

**3:5 “jo se jemi të aftë prej vetiu”** Termi grek *hikanos* është i zakonit në Dhjatën e Re dhe përdoret në dy kuptime.

1. Si një numër i madh diçkaje (shih 2 Kor. 11:30), edhe i kohës
  2. I përshtatshëm, i duhur (shih 2 Kor. 2:6), kompetent, i kualifikuar, i aftë ose i mjaftueshëm
- Kuptimi i dytë përdoret këtu. Pali shpreh kuptimin e tij të pavlefshëmrisë duke përdorur këtë term tek 1 Kor. 15:9. Ai gjithashtu pranon se shërbëtarët e ungjillit nuk janë në vetvete të denjë tek 2 Kor. 2:16 dhe 3:5. Megjithatë, edhe ndërkohë që ne jemi të papërshtatshëm në vetvete, Perëndia na ka thirrur dhe na ka fuqizuar si përfaqësues të Tij (shih 2 Kor. 3:6; 2 Tim. 2:2). Ne jemi të përshtatshëm në Të (shih Kol. 1:12).

▣ **“të konsiderojmë”<sup>57</sup>** Ky është termi *logizomai*, i cili përdoret tridhjetë e katër herë nga Pali, por më pak se shtatë herë në pjesën tjetër të Dhjatës së Re (shih 2 Kor. 3:5; 5:19; 10:2,7; 11:5; 12:6). Ai reflekton prezantimin logjik të Palit të së vërtetave dhe më pas shërben si inkurajim për të menduar qartazi përmes çështjeve.

Termi është një fjalë thelbësore teologjike për shkak të:

1. Përdorimit të saj në Septuagintë për të vërtetën e personalizuar (shih *New International Dictionary of NT Theology* [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re], vëll. 3, fq. 823)
2. Përdorimit të saj tek Zan. 15:6, të cilin Pali e përdor për të justifikuar drejtësinë e Dhjatës së Vjetër të bazuar mbi një dhuratë falas të Perëndisë përmes besimit (shih Rom. 4:3)
3. Ai mund të ketë qënë një term teknik i përdorur nga sofistët në prezantimet e tyre retorike (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali mes Sofistëve])

Besimtarët modernë duhet të konsiderojnë me kujdes se çfarë besojnë rreth besimit dhe pse. Aftësitë tona mendore dhe verbale janë pjesë e shëmbëllimit të Perëndisë tek njerëzimi. Ne duhet ta adhurojmë Perëndinë me mendjet tona (shih LXX Ligji i Për. 6:5; Mat. 22:37). Ne kemi nevojë të japim një dëshmi të shpresës që është në ne (shih 1 Pjet. 3:15). Ne duhet të mendojmë përmes parimeve të besimit tonë për qëndrueshmërinë tonë dhe për ungjillizimin. Shih videon “Why I Trust the NT” [Pse Unë i Besoj Dhjatës së Re] online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org), kliko mbi “Biblical Interpretation Sermons” [Predikime Interpretimi Biblik] dhe më pas mbi Video Seminar, Dallas, TX, 2009 dhe në të djathtë të ekranit tek mësimi 3.

**3:6 “shërbëtorë të besëlidhjes së re”** Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / Special Topic: Servant Leadership tek 1 Kor. 4:1.

▣ **“jo të shkronjës, por të Frymës”** Gjendet një seri krahasimesh.

1. E shkruar përkundrejt frymërore, 2 Kor. 3:3 dhe 6
2. Shkronjë përkundrejtë Frymë, 2 Kor. 3:6
3. Shërbesa e vjetër përkundrejt shërbesës frymërore, 2 Kor. 3:7
4. Shërbesa e lidhur me ndëshkimin përkundrejt shërbesës së lidhur me qëndrimin e duhur, 2 Kor. 3:9
5. Ajo që ka kaluar përkundrejt asaj që është e përjetshme, 2 Kor. 3:11
6. Veli qëndron i pangritur përkundrejt veli është hequr, 2 Kor. 3:14

Pali po vë në kontrast besëlidhjen e re me atë të vjetër, por në të vërtetë ai po krahason besimin e zemrës (shih Rom. 2:29; 7:6) me besimin e kokës (dmth., legalizmi, performancë njerëzore, vetë-drejtësia).

▣ **“shkronja vret”** Kjo duket se lidhet me qëllimin kryesor të ligjit të Moisiut. Ai nuk u dha për të dhënë jetë, por për të theksuar dhe për të zbuluar natyrën mëkatore në ne (shih Rom. 7:9-11; Gal. 3:10). Ligji sjell ndëshkim (shih Rom. 5:13), zemërim (shih Rom. 4:15), dhe vdekje (shih Rom. 7:19; 2 Kor. 3:6). Shih *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], fq. 495-510 e George E. Ladd. Vendi i ligjit shihet gjithashtu qartazi tek Rom. 3:20; 5:20; 10:4; Gal. 3:24-25. Marrëdhënia midis besimtarit të Dhjatës së Re dhe ligjit të Dhjatës së Vjetër ka qënë një çështje tejet konfunduese. Mua më duket, bazuar mbi të gjitha pasazhet e Dhjatës së Re, se i krishteri nuk është nën ligjin e Dhjatës së Vjetër (shih Rom. 6:14; Gal. 5:18). Kjo jo për shkak se ligji i Dhjatës së

<sup>57</sup> Versioni në shqip është: “të kuptojmë”. (shënim i përkthyesit)

Vjetër ka kaluar, por për shkak se i krishteri i Dhjatës së Re përmbush ligjin e Dhjatës së Vjetër në marrëdhëniet e dashurisë së Perëndisë me ne e parë kjo në dashurinë e besimtarëve për të tjerët (shih Rom. 13:8-10; Gal. 5:14). Qëllimi i ligjit është që ta sjellë njerëzimin e rënë tek Krishti, në mënyrë të tillë që t'i shpengojë ata. Megjithatë, thjesht sepse ligji i Dhjatës së Vjetër nuk është një mjet shpëtimi nuk do të thotë se nuk është vullneti i Perëndisë për njerëzimin në shoqëri (shih Mat. 5:17; Rom. 8:4). Shih TEMË E VEÇANTË: PIKËPAMJA E PALIT PËR LIGJIN E MOISIUT / SPECIAL TOPIC: PAUL'S VIEWS OF THE MOSAIC LAW tek 1 Kor. 9:9.

▣ **“Fryma jep jetë”** Ky kontekst nuk na siguron një metodë hermeneutike! Ky paragraf nuk lidhet me metodën historiko-gramatikore të hermeneutikës biblike përkundrejt metodës alegorike. Ai lidhet kryesisht me dallimin midis qëllimit të Dhjatës së Vjetër dhe qëllimit të Dhjatës së Re. Edhe më shumë në këtë pikë, roli i një besimi të ndjerë me zemër në burimet e Perëndisë (shih Gjoni 6:63) përkundrejt besimit në burimet njerëzore (dmth., njohuria, veprat, qëndrimi racor). Çelësi është dashuria e Perëndisë, vepra e Krishtit dhe aftësi të Frymës. Vini re se të dyja format, si vrasja e letrës ashtu edhe dhënia jetë e Frymës, janë forma treguese aktive të tashme.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 3:7-11

**<sup>7</sup> Dhe, në qoftë se shërbimi i vdekjes, që ishte gdhendur me shkronja mbi gurë, që i lavdishëm aq sa bijtë e Izraelit nuk mund të vështronim me sy fytyrën e Moisiut, për shkak të lavdisë së pamjes së tij, që duhet të anulohet, <sup>8</sup> sa më i lavdishëm do të jetë shërbimi i Frymës? <sup>9</sup> Sepse, nëse shërbimi i dënimit që rrethuar me lavdi, shumë më tepër do të teprojë në lavdi shërbimi i drejtësisë. <sup>10</sup> Sepse ç'ka është lavdëruar nuk është lavdëruar nga kjo pikëpamje, për shkak të asaj lavdie që e kapërcen çdo masë. <sup>11</sup> Sepse, në qoftë se ajo që duhet të anulohet u rrethua me lavdi, ajo që mbetet do të jetë shumë më e lavdishme.**

**3:7 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet se është e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

▣ **“shërbimi i vdekjes, që ishte gdhendur me shkronja mbi gurë”** Qëllimi i ligjit ishte të tregonte natyrën mëkatore (shih Gal. 3:24). Ky seksion, 2 Kor. 3:7-18, është një *Midrash* rabinik mbi Eksod. 34:23-35. Gjendet një përdorim i trefishtë i metaforës së “velit”: (1) Moisiu; (2) hebrenjtë bashkëkohorë; (3) besimtarët. Besëlidhja e vjetër është shkruar me gishtin e Perëndisë mbi pllakat e gurit mbi Malin Sinai (shih Eksodi 19-20). Besëlidhja e re, gjithashtu e shkruar nga Perëndia, është në zemrat e ndjekësve besnikë (shih Jer. 31:31-34; Ezek. 36:22-38). E para karakterizohet nga bindja ndaj një kodi të jashtëm, por e dyta, bindje ndaj një marrëdhënieje të brendshme.

▣ **“erdhi me lavdi”<sup>58</sup>** Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

▣ **“nuk mund të vështronim me sy fytyrën e Moisiut, për shkak të lavdisë së pamjes së tij, që duhet të anulohet”** Kjo lidhet me Eksod. 34:30-35. Ka pasur shumë diskutim mbi këtë pasazh. Disa mendojnë se Moisiu e mbuloi fytyrën e tij që të mos i lejonte izraelitët të shihnin lavdinë që venitej (shih 2 Kor. 3:7,13). Megjithatë, të tjerë mendojnë se Moisiu e mbuloi fytyrën e tij për shkak se izraelitët nuk mund ta përballonin lavdinë e Perëndisë për shkak të mëkateve të tyre.

**3:8** Ky varg vendos në kontrast shërbesën e Moisiut, i cili reflektonte lavdinë e Perëndisë me shërbesën e Frymës i cili ndan lavdinë e Atit.

**3:9 “nëse”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të parë, e cila supozohet se është e vërtetë nga pikëpamja e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

▣ **“shërbimi i dënimit”** Çfarë mënyre negative e fortë dhe shokuese për të përshkruar Besëlidhjen e Vjetër.

<sup>58</sup> Versioni në shqip është: “që i lavdishëm”. (shënim i përkthyesit)

▣ **“shërbimi i drejtësisë”** Dhjata e Vjetër prodhoi ndëshkim për pjesën më të madhe të bijve të Abrahamit. Dhjata e Re prodhon drejtësi për të gjithë fëmijët e Adamit vetëm nëse ata do të besojnë në veprën e përfunduar të Perëndisë në Krishtin dhe në nxitjen e Frymës. Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA / Special Topic: Righteousness tek 1 Kor. 1:30.

▣ **“teprojë”** Kjo është një formë treguese aktive e tashme e *perisseuō*, e cila thekson natyrën e saj të vazhdueshme. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:5 dhe Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

### 3:10

NASB	“Sepse në të vërtetë çfarë kishte lavdi, në këtë rast nuk ka lavdi për shkak të lavdisë që e kapërcen atë”
NKJV	“Sepse edhe ajo që është bërë e lavdishme nuk kishte lavdi në këtë aspekt për shkak të lavdisë që shkëlqen”
NRSV	“Në të vërtetë, ajo që dikur kishte lavdi e ka humbur lavdinë e vet për shkak të lavdisë më të madhe”
TEV	“Ne mund të themi se për shkak të lavdisë tejet më të shkëlqyeshme tani lavdia që ishte kaq e shkëlqyeshme në të shkuarën është larguar”
NJB	“Në të vërtetë, ajo që dikur konsiderohej e lavdishme e ka humbur të gjithë pretendimin për lavdi, duke u vënë në kontrast me lavdinë që e tejkalon atë”

Dhjata e Vjetër karakterizohet si “kishte lavdi” (forma treguese pasive e përkryer). Lavdia ishte sigurisht nga Perëndia dhe reflektonte Perëndinë. Megjithatë, zbulesa më e plotë është në Krishtin, lavdia e Dhjatës së Re (forma pjesore pasive e përkryer). Ky krahasim i besëlidhjeve të YHWH gjithashtu zhvillohet në librin e Hebrenjve. Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7. Përemri i shquar “në” (emërore, neutrale, njëjës) përdoret si një vend mbajtëse gramatikore për “besëlidhjen e vjetër” (pjesa më e madhe e përkthimeve në anglisht kanë “atë”). Ajo karakterizohet në këtë kontekst nga

1. “shkruar mbi rrasa guri”, 2 Kor. 3:3,7
2. “shkronja”, 2 Kor. 3:6
3. “shërbimi i vdekjes”, 2 Kor. 3:7
4. “shërbimi i dënimit”, 2 Kor. 3:9

▣ **“kapërcen”** Ky është një term i intensifikuar nga “mbi” ose “përtej” dhe “të hedhësh”. Pali e përdor atë këtu dhe tek 2 Kor. 9:14 (dmth., “hiri kapërcyes i Perëndisë”). Ai gjithashtu përdor si *perisseuō* dhe *hyperballō* tek 2 Kor. 11:23, ku ai krahason përvojën dhe shërbesën e tij me kredencialet e mësuesve të rremë. Pali flet me ndjenja të intensifikuara dhe fjalor hiperbolik! Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul's Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

**3:11 “në qoftë se”** Kjo është një fjali tjetër kushtore e rendit të parë.

▣ **“ajo që venitet”<sup>59</sup>** Ky është termi *katargeō*, i cili përdoret aq shpesh nga Pali në letrat e tij korintase (shih 1 Kor. 1:28; 2:6; 6:13; 13:8,10,11; 15:24,26; 2 Kor. 3:7,11,13,14). Për Temën e Veçantë shih 1 Kor. 1:28.

▣ **“ajo që mbetet është në lavdi”<sup>60</sup>** Kontrasti nuk është midis asaj që është nga Perëndia ose që ka lavdinë e Perëndisë, por ajo që ka lavdi më të madhe dhe lavdinë që qëndron. Përgjigja është Besëlidhja e Re në Krishtin, Epoka e Re e Frymës dhe plani i paracaktuar i përjetshëm i shpengimit tanimë i plotë (shih Veprat e Apo. 2:22-24; 3:18-21; 4:28; 13:29-41).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 3:12-18

<sup>12</sup> Duke pasur, pra, një shpresë të tillë, flasim me shumë guxim, <sup>13</sup> dhe jo si Moisiu, i cili vinte një vel mbi fytyrën e vet, që bijtë e Izraelit të mos vështronin me sy fundin e asaj që duhej të anullohej. <sup>14</sup> Por mendjet e tyre u errën; sepse, në leximin e besëlidhjes së vjetër, po ky vel mbetet pa u hequr, sepse veli anullohet në

<sup>59</sup> Versioni në shqip është: “ajo që duhet të anullohej”. (shënim i përkthyesit)

<sup>60</sup> Versioni në shqip është: “do të jetë shumë më e lavdishme”. (shënim i përkthyesit)

**Krishtin.** <sup>15</sup> Por deri më sot, kur lexohet Moisiu, një vel mbetet mbi zemrat e tyre. <sup>16</sup> Por kur Izraeli të kthehet te Zoti, veli do të hiqet. <sup>17</sup> Sepse Zoti është Fryma, dhe atje ku është Fryma e Zotit, atje është liria. <sup>18</sup> Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shëmbëllim nga lavdia në lavdi, posi prej Frymës së Zotit.

**3:12 “Duke pasur, pra, një shpresë të tillë”** Kjo duket se lidhet me lavdinë eskatologjike (shih 2 Kor. 3:11). Shih TEMË E VEÇANTË: SHPRESA / SPECIAL TOPIC: HOPE tek 1 Kor. 13:13.

▣ “flasim me shumë guxim” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: GUXIM (PARRHËSIA) [SPECIAL TOPIC: BOLDNESS (PARRHËSIA)]**

Kjo fjalë greke përbëhet nga “të gjithë” (pan) dhe “ligjëratë” (rhēsis). Kjo liri ose guxim ligjërata, shpesh, kishte ngjyrimin e guximit në mes të kundërshtisë ose refuzimit (shih Gjoni 7:13; 1 Thes. 2:2).

Në shkrimet e Gjonit (e përdorur 13 herë), shpesh, ajo nënkupton një shpallje publike (shih Gjoni 18:20, si dhe në shkrimet e Palit, Kol. 2:15). Sidoqoftë, nganjëherë do të thotë thjesht “qartazi” (shih Gjoni 10:24; 11:14; 16:25, 29).

Në Veprat, apostujt flasin mesazhin për Jezusin në të njëjtën mënyrë (me guxim) si, foli dhe Jezusi për Atin dhe për planet e premtimet e Tij (shih Veprat e Apo. 2:29; 4:13,29,31; 9:27-28; 13:46; 14:3; 18:26; 19:8; 26:26; 28:31). Po kështu, Pali kërkoi lutje që të predikonte me guxim ungjillin (shih Efe. 6:19; 1 Thes. 2:2) dhe të jetonte ungjillin (shih Fil. 1:20).

Shpresa eskatologjike e Palit në Krishtin i dha atij guximin dhe sigurinë që të predikonte ungjillin në këtë epokë të tanishme të ligë (shih 2 Kor. 3:11-12). Po kështu, ai kishte sigurinë se ndjekësit e Jezusit do të vepronin në të njëjtën mënyrë (shih 2 Kor. 7:4).

Ky term ka dhe një aspekt tjetër. Letra e Hebrenjve e përdorur në kuptimin unik të guximit të besimtarit në Krishtin për t’iu afruar Perëndisë dhe për të folur me Të (shih Heb. 3:6; 4:16; 10:19, 35). Besimtarët janë plotësisht të pranuar dhe të mirëpritur në marrëdhënie të ngushtë me Atin përmes Birit (shih 2 Kor. 5:21)!

Në Dhjatën e Re përdoret në një sërë mënyrash.

1. bindje, guxim, ose siguri në lidhje me
  - a. njerëzit (shih Veprat e Apo. 2:29; 4:13, 31; 2 Kor. 3:12; Efe. 6:19)
  - b. Perëndinë (shih 1 Gjonit 2:28; 3:21; 4:12; 5:14; Heb. 3:6; 4:16; 10:19)
2. të flasësh hapur, qartazi, dhe jo me dy kuptime (shih Marku 8:32; Gjoni 7:4, 13; 10:24; 11:14; 16:25; Veprat e Apo. 28:31)
3. të flasësh botërisht (shih Gjoni 7:26; 11:54; 18:20)
4. forma e lidhur me të (*parrhēsiazomai*) përdoret për predikimin me guxim në mes të situatave të vështira (shih Veprat e Apo. 18:26; 19:8; Efe. 6:20; 1 Thes. 2:2)

**3:13** Ky varg i referohet vargut 7, i cili është një aludim ndaj Eksod. 34:29-35. Në Dhjatën e Vjetër arsyeja pse Moisiu mbante një vel ishte frika e asaj që mund t’iu shkaktonte izraelitëve fytyra e tij ndriçuese (shih Eksod. 34:30). Pali interpreton arsyen në mënyrë që të theksojë zhvlerësimin e tij të Besëlidhjes së Vjetër. Sikurse fytyra e Moisiut venitet, po kështu bën edhe besëlidhja e Moisiut!

Pali bën disa krahasime midis besëlidhjes së Moisiut dhe besëlidhjes së Jezusit.

1. Zoti i Eksodit = Fryma e Jezusit
2. Vetëm Moisiu mund t’i afrohej në mënyrë intime Perëndisë përkundrejt faktit që të gjithë besimtarët në Krishtin mund t’i afrohen Perëndisë
3. Lavdia e Moisiut u venit përkundrejt lavdisë së Jezusit që nuk venitet kurrë
4. Ndjekësit e Moisiut nuk mund ta shihnin Krishtin në Dhjatën e Vjetër përkundrejt ndekjesve të Jezusit që përmes Frymës mund të interpretojnë siç duhen Dhjatën e Vjetër nën dritën e Krishtit
5. Moisiu solli skllavëri të performancës përkundrejt Krishtit që sjell liri të hirit
6. Letra e ligjit të Moisiut sjell vdekje përkundrejt Frymës të Besëlidhjes së Re që sjell jetë, jetë të përjetshme, jetë me tepri



7. Besëlidhja e Moisiut nuk ishte e aftë të prodhonte njerëz të drejtë përkundrejt besëlidhjes së Jezusit që prodhon njerëz të drejtë (si në mënyrë objektive në drejtësim dhe subjektive në shenjtërim)

**3:14 “Por mendjet e tyre u ngurtësuan”<sup>61</sup>** Kjo është një formë treguese aoriste pasive. Termi grek vjen nga ideja e “lëkurës së trashë” ose “të bërë kallo” (shih Marku 6:52; 8:17; Rom. 11:7,25). Verbëria frymërore ka si një origjinë frymërore (dmth., [1] Perëndia me anë të formës pasive, shih Isa. 6:9-10; 29:10; Gjoni 12:40; Rom. 9:18 dhe [2] Satani, shih 2 Kor. 4:4) dhe origjinë njerëzore (shih Gjoni 3:19-20). Për një diskutim të misterit teologjik të ngurtësimit të Izraelit lexo Rom. 9-11 dhe *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës] nga Inter Varsity Press, fq. 619-621.

Folja “mbetet” tek 2 Kor. 3:15 mund të jetë ose në formën pasive të tashme (dmth., opsioni 1) ose të mesme të tashme (dmth., opsioni 2).

Shih TEMA E VEÇANTË: PLANE (NË PALIN) / SPECIAL TOPIC: SCHEMES (IN PAUL) tek 2 Kor. 2:11.

▣ **“po ky vel mbetet pa u hequr”** Moisiu përdori një vel të vërtetë; ky term tani përdoret për të përshkruar verbërinë e brendshme të judaizmit bashkëkohor. Hebrenjtë po ecnin / po ecin në gjykimin e Isa. 6:9-10 dhe 29:10. Kjo gjithashtu lidhet me hebrenjtë e kohës sonë të cilët refuzojnë të pranojnë Jezusin si Mesia (shih 2 Kor. 3:15).

▣ **“sepse veli anulohet në Krishtin”** Vetëm hiri i Perëndisë mund të heqë verbërinë e traditës, vetë-drejtësimin dhe mëkatit. Njerëzit fetarë janë pre e verbërisë frymërore sikurse njerëzit jo-fetarë. Shpresa e vetme e njerëzimit të rënë është

1. Mëshira e pandryshueshme e Atit
2. Pajtimi i plotë dhe i përfunduar i Birit
3. Nxitja / vepra universale e Frymës

Shpëtimi është një dhunti frymërore dhe jo një çështje familjare, tradite, intelekti, performance apo preference! Ajo që Pali mund të jetë duke konfirmuar në këtë kontekst është aftësia e besimtarit përmes Frymës që të shohë jetën, mësimet dhe veprën e Jezusit në Dhjatën e Vjetër. Vetë Jezusi hapi mendjet e dy burrave në rrugën për në Emaus (shih Luka 24:13-35, sidomos 2 Kor. 3:25-27).

NASB, TEV “hiqet”  
NKJV “largohet”  
NRSV “vihet mënjanë”  
NJB “mbarohet”

Shih TEMA E VEÇANTË: KATARGEË / Special Topic: Katargeë tek 1 Kor. 1:28.

**3:15 “zemra”** Shih TEMA E VEÇANTË: ZEMRA / SPECIAL TOPIC: THE HEART tek 1 Kor. 14:25.

**3:16 “por çdo herë që një person kthehet tek Zoti, veli hiqet”<sup>62</sup>** Ky mund të jetë një citim nga Eksod. 34:34. Nëse është kështu, ai lidhet me veprimet e Moisiut kur i afrohej Perëndisë. Ai gjithashtu duket se është një thirrje dhe ftesë universale për këdo dhe cilindo që të kthehet tek Zoti. Termi “kthehet” në hebraisht (*shub*) i referohet pendesës. Termi, “Zoti” këtu mund t’i referohej kontekstualisht ose YHWH ose Jezusit. Paqartësia është ndoshta e qëllimtë. Vini re theksin mbi zgjedhjen e vullnetshme njerëzore dhe veprimin hyjnor (dmth., besëlidhjen).

**3:17 “Sepse Zoti është Fryma”** Shërbesa e Jezusit dhe e Frymës janë të lidhura në mënyrë të pandashme (shih 2 Kor. 3:17-18). Shërbesa e Frymës është që të madhërojë Jezusin (shih Gjoni 16:8-14).

Në kontekst është e mundur që Pali nuk po komenton mbi lidhjen midis Jezusit dhe Frymës, por po përkufizon fjalën “Zot” (*kurios*) tek 2 Kor. 3:16, i cili në kontekstin e Eksod. 34:34, i referohet YHWH (shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 1:1), por Pali po e përdor atë në kuptimin e përkthimit REB, “Tani Zoti për të cilin flet ky pasazh është Fryma”. Nëse kjo është e saktë atëherë i gjithë seksioni nuk i referohet Jezusit me termin “Zot”, por

<sup>61</sup> Versioni në shqip është: “u errën”. (shënim i përkthyesit)

<sup>62</sup> Versioni në shqip është: “Por kur Izraeli të kthehet te Zoti, veli do të hiqet”. (shënim i përkthyesit)

Frymës (shih Zan. 1:2 gjithashtu vini re Gordon D. Fee, *To What End Exegesis* [Çfarë i Dha Fund Eksegezës], fq. 218-239). Ky atëherë do të ishte i vetmi vend ku Pali përdor *Kurios* për Frymën. Ai është një kontrast midis kodit të ligjit të Dhjatës së Vjetër dhe ungjillit, i cili asokohe ishte i pashkruar (dmth., i shkruar përkundrajt i jetuar).

### TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA (SPECIAL TOPIC: JESUS AND THE SPIRIT)

Ekziston një rrjedhshmëri mes veprës së Frymës dhe asaj të Birit. G. Campbell Morgan tha se emri më i mirë për Frymën është “Jezusi tjetër” (sidoqoftë, ata janë persona të veçantë e të përjetshëm). Më poshtë vijon skica e krahasimit të veprës dhe titujve të Frymës dhe të Birit.

1. Fryma quhet “Fryma e Jezusit”, ose me shprehje të ngjashme (shih Rom. 8:9; 2 Kor. 3:17; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11).
2. Të dy thirren me të njëjtat fjalë
  - a. “e vërteta”
    - 1) Jezusi (Gjoni 14:6)
    - 2) Fryma (Gjoni 14:17; 16:13)
  - b. “avokati”
    - 1) Jezusi (1 Gjonit 2:1)
    - 2) Fryma (Gjoni 14:16, 26; 15:26; 16:7)
  - c. “I Shenjtë”
    - 1) Jezusi (Marku 1:24; Luka 1:35; Veprat e Apo. 3:14; 4:27, 30)
    - 2) Fryma (Luka 1:35)
3. Të dy banojnë brenda besimtarëve
  - a. Jezusi (Mat. 28:20; Gjoni 14:20,23; 15:4-5; Rom. 8:10; 2 Kor. 13:5; Gal. 2:20; Efe. 3:17; Kol. 1:27)
  - b. Fryma (Gjoni 14:16-17; Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14)
  - c. Ati (Gjoni 14:23; 2 Kor. 6:16)
4. Detyra e Frymës është të dëshmojë për Jezusin (shih Gjoni 15:29; 16:13-15)

■ **“atje është liria”** Kjo i referohet lirisë nga verbëria frymërore, vetë-drejtësia dhe legalizmi i shkaktuar nga një marrëdhënie personale besimi me Jezus Krishtin (shih Gjoni 8:32,36; Rom. 14: 1 Kor. 8; 10:23 e në vazhdim; Gal. 5:1,13).

Një nga komentatorët e mi të preferuar, F. F. Bruce, në librin e tij, *Paul: Apostle of the Heart Set Free* [Pali: Apostulli me Zemër të Çliruar], thotë:

“Pali sigurisht e njihte dashurinë e Krishtit që ishte fuqia gjithë-tërheqëse në jetë. Atje ku dashuria është fuqia tërheqëse, nuk ka asnjë ndjesi të sforcimit apo konfliktit apo skllavërisë për të bërë atë që është e duhur: burri ose gruaja që tërhiqet nga dashuria e Jezusit dhe fuqizohet nga Fryma e tij bën vullnetin e Perëndisë nga zemra. Sepse (sikurse Pali mund të thoshte nga eksperiencia) ‘atje ku është Fryma e Zotit, atje zemra lirohet’” (fq.21).

**3:18 “fytirëzbuluar”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer që nënkupton një zbulim të përhershëm prej velit. Gjithashtu vini re formën përfshirëse “ne të gjithë” që i referohet besimtarëve në kishën konfuze dhe të grupuar korintase.

■ **“duke soditur lavdinë e Zotit si në pasqyrë”** Ungjilli ka zbuluar plotësisht si YHWH ashtu edhe Jezusin e Nazaretit (shih 2 Kor. 4:6). Ndërsa ne përgjigjemi në pendesë dhe besim, zbulesa na ndryshon në shëmbëllimin e Tij. E njëjta metaforë gjendet tek 2 Kor. 4:4. Këta të krishterë korintas e kishin parë qartazi Perëndinë në Krishtin përmes ungjillit.

Termi “duke soditur” është një term i rrallë. *Greek-English Lexicon of the New Testament and Other Early Christian Literature* [Leksikoni Greko-Anglez i Dhjatës së Re dhe Literaturave të Tjera të Hershme të Krishtera] nga Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker liston përdorimet e mundshme të bazuara në formën e përdorur (fq. 424).

1. Aktive, prodhon një reflektim
2. Pasive, ajo që shihet në një pasqyrë

### 3. E mesme, duke parë vetveten në një pasqyrë

▣ **“transformohemi”** Kjo është një formë treguese pasive e tashme. Të gjitha format foljore në këtë kontekst janë në formë pasive, duke nënkuptuar veprimtarinë e Perëndisë për llogarinë tonë, duke transformuar besimtarët në ngjashmërinë me Krishtin (shih Rom. 12:2). Po e njëjta folje përdoret për Shpërfytyrimin (shih Mat. 17:2; Mark 9:2). Ne marrim fjalën metamorfozë nga ky term grek.

▣ **“në të njëjtën shëmbëllim”** Jezusi është shëmbëllimi i Perëndisë (shih 2 Kor. 4:4; Gjoni 1:14-18; 14:9; Kol. 1:15; Heb. 1:3). Njerëzit u krijuan në shëmbëllimin e Perëndisë (shih Zan. 1:26-27). Besimtarët janë në shëmbëllimin e Krishtit (shih Rom. 8:29-30). Ngjashmëria me Krishtin është qëllimi kryesor i Perëndisë për të gjithë besimtarët (shih Gal. 4:19; Efe. 1:4).

▣ **“nga lavdia në lavdi”** Gjenden etapa në planin e Perëndisë për restaurim dhe rinovim. Besimtarët janë në një proces (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:15) që shpie në ngjashmëri me Krishtin (shih 1 Gjoni 3:2). Shih Tema e Veçantë: Lavdi / Special Topic: Glory tek 1 Kor. 2:7.

▣ **“Zotit, Frymës”<sup>63</sup>** Disa përkthime të mundshme:

1. King James, “madje si me anë të Frymës së Zotit”
2. Vulgate, “madje si nga Zoti (që është) Fryma”
3. Westcott dhe Hort, “madje si nga Fryma sovrane”
4. Nga konteksti i 2 Kor. 3:16-17, “madje si nga Zoti që është Fryma” (shih TEV, NJB dhe NIV)

Është e vështirë në disa kontekste të dish nëse *pneuma* (dmth., fryma) duhet të jetë

1. Me “F” të vogël duke iu referuar frymës njerëzore (shih KJV të 2 Kor. 3:6,8; Rom. 7:6; 1 Kor. 15:45)
2. Me “F” të madhe, duke iu referuar Frymës së Shenjtë, personit të tretë të Trinitës së përjetshme (shih 2 Kor. 3:3; Rom. 8:9; Gal. 4:6; 1 Pjet. 1:11)

## PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Përshkruani dallimin midis Besëlidhjes së Vjetër dhe Besëlidhjes së Re?
2. Pse thuhet se Dhjata e Vjetër është vdekje? A do të thotë kjo se Dhjata e Vjetër është e ligë?
3. Cila është marrëdhënia midis Dhjatës së Vjetër dhe Dhjatës së Re?
4. A flet ky pasazh për Frymën e Shenjtë apo për realitetin frymëror?
5. Çfarë përpiqet t’i komunikojë metafora e “velit” të krishterëve të kohëve moderne?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](http://www.biblelessons.org)

---

<sup>63</sup> Versioni në shqip është: “Frymës së Zotit”. (shënim i përkthyesit)

## 2 KORINTASVE 4

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Thesar në Enë Tokësore	Drita e Ungjillit të Krishtit	Thesar i Vërtetë, Shërbenjës të Vdekshëm	Thesar Frymëror në Enë Balte	Nga Troas në Maqedoni – Apostullati: Rëndësia e Tij (2:12-4:6)
4:1-6	4:1-6 Të Mposhtur por të Papushtuar	4:1-6	4:1-6	4:1-6 Vështirësitë dhe Shpresat e Apostullatit (4:7-5:10)
4:7-15	4:7-15	4:7-12	4:7-12	4:7-12
Duke Jetuar me Anë të Besimit	Të Shohësh të Padukshmen	4:13-15	4:13-15	4:13-15
(4:16-5:5)	4:16-18	4:16-18	Duke Jetuar me Anë të Besimit (4:16-5:5)	4:16-18

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### SKICIM I SHKURTËR KONTEKSTUAL

- A. Prezantimi i mesazhit, 2 Kor. 4:2
- B. Kundërshtia ndaj mesazhit, 2 Kor. 4:3-4a
- C. Mesazhi i mbuluar, 2 Kor. 4:4b-6
- D. Paradoksi i mesazhit, 2 Kor. 4:7-13
- E. Rezultatet e mesazhit, 2 Kor. 4:14-1

#### STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

## VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 4:1-6

<sup>1</sup>Prandaj, duke pasur këtë shërbim për mëshirën që na është bërë, ne nuk na lëshon zemra. <sup>2</sup>Ne kemi hequr dorë plotësisht nga gjërat e turpshme që bëhen në fshehtësi, duke mos ecur me dinakëri, duke mos falsifikuar aspak fjalën e Perëndisë, por duke shfaqur të vërtetën, ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu përpara Perëndisë. <sup>3</sup>Dhe, në qoftë se ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel, ai është i mbuluar për ata që humbin, <sup>4</sup>të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata. <sup>5</sup>Sepse ne nuk predikojmë, pra, veten tonë, por Jezu Krishtin, Zotin, dhe jemi shërbëtorët tuaj për hir të Jezu Krishtit, <sup>6</sup>sepse Perëndia që tha: “Le të ndriçojë drita në errësirë,” është i njëjti që shkëlqeu në zemrat tona për t’na ndriçuar në njohurinë e lavdisë së Perëndisë, në fytyrën e Jezu Krishtit.

**4:1 “ne”** Është e dukshme që Pali po përdor përemrin pronor shumë për t’iu referuar vetvetes, ashtu sikurse ai bën përgjatë këtij kapitulli.

▣ **“duke pasur këtë shërbim”** Pali po i referohet “shërbesës së Frymës” (shih 2 Kor. 3:8), gjithashtu e quajtur “shërbesa e drejtësisë” (shih 2 Kor. 3:9). Pali përdor këtë fjalë për shërbesën, *diakonia*, aq shpesh tek 2 Korintasve.

1. *diakonō*, 2 Kor. 3:3; 8:19,20
2. *diakonia*, 2 Kor. 3:7,8,9; 4:1; 5:18; 6:3; 8:4; 9:1,12,13; 11:8
3. *diakonos*, 2 Kor. 3:6; 6:4; 11:15,23

Të krishterët shpëtohen për të shërbyer (shih Efe. 2:10). Krishtërimi nuk është një fokus i llojit “çfarë ka në këtë mes për mua” por më shumë e fokusit “çfarë mund të bëj unë për të tjerët për shkak të asaj që Krishti ka bërë për mua” (shih Gal. 2:20). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

▣ **“për mëshirën që na është bërë”** Mëshira e Perëndisë për Saulin, i cili ishte një anti-i-krishterë aq i patundur dhe militant (shih 1 Tim. 1:13,16), në rrugën për në Damask (forma treguese aoriste pasive) e inkurajoi atë për të vazhduar për të predikuar Lajmin e Mirë në ballë të kundërshtisë.

Pali shkruante në greqisht, por mendonte në hebraisht. Termi grek *eleeō* (dmth., mëshirë, keqardhje, dhembshuri) përdoret në Septuagintë për të përkthyer termin hebraik *hesed* (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 13:1), e cila lidhet me besnikërinë e besëlidhjes. YHWH është besnik ndaj premtimeve të Tij të besëlidhjes, edhe atëherë kur njerëzimi nuk është! Konvertimi dramatik i Palit qartazi zbulon dhembshurinë e Perëndisë. Ai vepron në mëshirë ndaj hebrenjve (shih Rom. 9:15,16,18,23-24; 11:30) dhe ndaj johebrenjve (shih Rom. 11:32) për qëllimin e vetë besëlidhjes së Tij, që është restaurimi i shëmbëllimit të Tij në njerëzimin përmes veprës së Krishtit dhe shërbesës së Frymës. Besnikëria e Perëndisë ndaj besëlidhjes së Tij dhe karakteri i Tij i pandryshuar i mëshirës janë shpresa e vetme e njerëzimit.

▣ **“ne nuk na lëshon zemra”** Kjo është forma treguese aktive e tashme. Kjo duhet të kuptohet nën dritën e shërbesës së përgjithshme të Palit dhe këtij konteksti të veçantë (shih 2 Kor. 4:16). Pali u ndje disa herë që të hiqte dorë (shih Veprat e Apo. 18:9-10; 23:11; 27:24; 2 Tim. 4:17). Në këtë kontekst të veçantë, në përballje me sprovat dhe probleme fizike me kishën në Korint, Pali kishte sigurinë se Perëndia i mëshirshëm i besëlidhjes ishte atje dhe kishte gjithçka nën kontroll (shih 2 Kor. 3:12). Detyra ishte tepër e rëndësishme që ai të lejonte t’i lëshohej zemra (shih Mat. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8).

**4:2 “Ne kemi hequr dorë”** Kjo është një formë treguese aoriste e mesme. Gjendet një seri gjërash që Pali personalisht refuzoi të përdorë në shërbesën e tij.

1. Asnjë mjet i fshehtë
2. Asnjë metodë e turpshme
3. Asnjë dredhi
4. Asnjë lojë me apo ndryshim i mesazhit të Perëndisë

Secila nga këto metoda reflekton fajet apo veprimet e mësuesve të rremë.

NASB **“gjërat e fshehura për shkak të turpit”**

<b>NKJV</b>	<b>“gjërat e fshehura të turpit”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“gjërat e turpshme që fshihen”</b>
<b>TEV</b>	<b>“veprat e turpshme dhe të fshehta”</b>
<b>NJB</b>	<b>“fshehtësia e turpshme”</b>

Pali përdor këtë frazë të ngjashme për të përshkruar skllavërinë ndaj mëkatit tek Rom. 6:21 dhe mëkatet e njerëzimit të cilat do të zbulohen tek 1 Kor. 4:5 (gjithashtu shih 1 Kor. 14:25). Në këtë kontekst fraza duket se përshkruan metodologjinë e mësuesve të rremë shëtitës.

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“duke mos ecur me dinakëri”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“ne refuzojmë të bëjmë dredhi”</b>
<b>TEV</b>	<b>“ne nuk veprojmë me mashtrim”</b>
<b>NJB</b>	<b>“nuk është mënyra jonë që të jemi të pandershëm”</b>

Kjo është forma pjesore aktive e tashme. Pali përdor termin “dinak” (dmth., “të gjithë” plus “vepra”) disa herë në letrat e tij ndaj Korintit (shih 1 Kor. 3:19; 2 Kor. 4:2; 11:3; 12:16). Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm për metodat tona ashtu sikurse edhe për qëllimet tona. Sepse në krishtërim mjetet përcaktojnë qëllimin. Po e njëjta fjalë përdoret nga Pali

1. Në një citim nga Jobi 5:13 duke iu referuar njohurisë njerëzore (shih 1 Kor. 3:19)
2. Për Satanin që tundoi Evën (shih 2 Kor. 11:3)
3. Për dredhitë e Satanit dhe të mësuesve të rremë (shih Efe. 4:14)
4. Këtu për metodat e mësuesve të rremë

<b>Nasb</b>	<b>“ose duke falsifikuar fjalën e Perëndisë”</b>
<b>Nkjb</b>	<b>“as duke e trajtuar fjalën e Perëndisë me mashtrim”</b>
<b>Nrsv</b>	<b>“për të falsifikuar fjalën e Perëndisë”</b>
<b>Tev</b>	<b>“ne as nuk falsifikojmë fjalën e Perëndisë”</b>
<b>Njb</b>	<b>“apo për të falsifikuar fjalën e Perëndisë”</b>

Ky term dhe format e lidhura me të kanë kuptimin

1. Holluar (shih 2 Kor. 2:17)
2. Zënë në kurth me karrem (shih Mat. 26:4; Mark 14:1)
3. Mashtruar (shih 2 Kor. 11:13; Rom. 3:13)

Ai i referohet një mesazhi që ndryshon i bazuar mbi ndjeshmëritë e dëgjuesit ose përpjekjen për të mashtruar dëgjuesit (shih 1 Kor. 1:23).

<b>NASB</b>	<b>“me anë të manifestimit të së vërtetës”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“me manifestimin e së vërtetës”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“nga pohimi i hapur i së vërtetës”</b>
<b>TEV</b>	<b>“nën dritën e plotë të së vërtetës”</b>
<b>NJB</b>	<b>“duke treguar të vërtetën haptazi”</b>

Për “manifestim” shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 2:14. Termi “vërtetë” ka nyjën dhe i referohet ungjillit të Krishtit, Besëlidhjes së Re. Mësuesit e rremë vepronin në mënyra të turpshme, mënyra të fshehta, por Pali predikonte të vërtetën e plotë haptazi. Shih TEMA E VEÇANTË: “E VËRTETA” NË SHKRIMET E PALIT / SPECIAL TOPIC: "TRUTH" IN PAUL'S WRITINGS tek 2 Kor. 13:8.

■ **“ne ia rekomandojmë veten tonë ndërgjegjes së çdo njeriu përpara Perëndisë”** Pali po i referohet dashurisë së tij vetë-kufizuese për të tjerët (shih 1 Kor. 9:19-23). Kjo nuk flet për kompromisin, por për vetë-kufizim të vullnetshëm të lirisë për shkak të varësive kulturore ose preferenceve personale të të tjerëve. Qëllimi i tij ishte ungjillizimi, jo liria personale (shih Rom. 14:1-15:13; 1 Kor. 8; 10:23 e në vazhdim).

Pali përdor po këto terma tek 2 Kor. 5:11-21, ku gjithashtu theksohet ungjilli dhe pjesa jonë në shpalljen e tij. Shih shënimin e plotë mbi “rekomandoj” tek 2 Kor. 3:1. Shih shënimin e plotë mbi “ndërgjegje” tek 1 Kor. 8:7 dhe 10:25.

■ **“përpara Perëndisë”** Kjo duket se është një shprehje frazore paralele me “Perëndia është dëshmitari im”. Tekste të tjera të Palit gjithashtu e përdorin këtë frazë në një mënyrë të ngjashme (shih Gal. 1:20; 1 Tim. 5:21; 6:13; 2 Tim. 2:14; 4:1), gjithashtu vini re formulën e betimit të Palit tek 2 Kor. 1:23; 11:31; dhe 1 Thes. 2:5,10.

**4:3 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë. Disa njerëz thjesht nuk e kuptojnë (shih Mateu 13).

■ **“ungjilli ynë është ende i mbuluar me vel”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer perifrastike e “mbuluar me vel” (shih 2 Kor. 3:14,16). Është e dukshme ndaj Palit se kur ai predikonte ungjillin disa njerëz absolutisht nuk mund t’i përgjigjeshin atij. Ndërsa hebrenjtë “ngurtësohen” (shih 2 Kor. 3:14; dhe Isa. 6:9-10), dëgjuesit në çdo epokë gjithashtu “verbohen” (shih 2 Kor. 4:4). Ky është misteri i paracaktimit përkundrejt vullnetit të lirë, paradoksi i ungjillit (shih Gjoni 1:12; 3:16 përkundrejt 6:44,65).

■ **“ata që humbin”** Pali po vazhdon analogjinë e tij të ungjillit si një aromë e jetës dhe e vdekjes (shih 2 Kor. 2:15; 1 Kor. 1:18-19; 8:11; 10:9-10; 15:18). Shpallja e ungjillit është diçka serioze, për disa jetë, por për disa vdekje.

Për konceptin e “humbasin” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 8:11 dhe një diskutim tek 1 Kor. 1:18.

**4:4 “perëndia i kësaj bote”<sup>64</sup>** Personaliteti i ligë thirret me disa emra nga Pali.

1. Satani (shih Rom. 16:20; 1 Kor. 5:5; 7:5; 2 Kor. 2:11; 11:14; 12:7; 1 Thes. 2:18; 2 Thes. 2:9; 1 Tim. 1:20; 5:15)
2. Djalli (shih Efe. 4:27; 6:11-12; 1 Tim. 3:6,7; 2 Tim. 2:26; forma shumës e përdorur për demonik, 1 Kor. 10:20-21; 1 Tim. 4:1)
3. “princi i fuqive të ajërit” (shih Efe. 2:2)
4. “perëndia i kësaj epoke / bote” (Gjoni e quan atë “sunduesi i kësaj epoke/ bote”, Gjoni 12:31; 14:30; 16:11)
5. “tunduesi” (shih 1 Thes. 3:5)
6. “i ligu” (shih 2 Thes. 3:3, ky titull është i zakonitë në shkrimet e Mateut dhe të Gjontit)
7. “një engjëll i dritës” (shih 2 Kor. 11:14)

Ky varg ka shkaktuar shumë shqetësim ndaj etërve të hershëm të kishës për shkak se ai duket se i fryn zjarrit të mësuesve të rremë gnostikë dhe arianë. Prandaj, fatkeqësisht, ata (Ireneasi, Tertuliani, Origeni, Chrysostom [Krisostomi], Ambrose, Theodoret, dhe Augustine [Agustini]) ndryshuan formën në greqisht të këtij teksti në: “në të cilët Perëndia ka verbuar mendjet e jobesimtarëve të kësaj bote”. Tani Satanit dukshëm i referohet si princi dhe fuqia e kësaj bote (shih Gjoni 12:31; 14:30; Efe. 2:2). Këta Etër të hershëm të Kishës nuk po reagonin ndaj konceptit të një force personale ligësie, por ndaj konceptit teologjik të Demiurge gnostike dhe pikëpamies së arianëve të një Krishti më-pak-se-hyjnor. Shih TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON / SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL tek 1 Kor. 7:5.

■ **“të kësaj bote”** Ky është gjithashtu termi grek për “epokë” (dmth., *aiōnos*). Kjo duket se i referohet pikëpamjes hebraike të dy epokave: epoka aktuale e ligë e dominuar nga mëkati dhe epoka që do të vijë, e vendosur dhe e dominuar nga Mesia (shih Mat. 28:20; Efe. 2:2). Për diskutimin e plotë të dy epokave shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:20. Termat “kjo botë” (*kosmos houtos*) dhe “kjo epokë” (*aiōn houtos*) përdoren duke zëvendësuar njëra-tjetrën (shih *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re] nga George E. Ladd, fq. 223).

■ **“ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë”** Kjo është një formë treguese aktive arosite. Termi përdoret për verbërinë frymërore tek Mat. 15:14; 23:16; 1 Gjoni 2:11 dhe koncepti është tek Gjoni 9. Po i njëjti term përdoret në një citim nga Septuaginta i Isa. 6:10 tek Gjoni 12:40. Është një term mjaft i rrallë në shkrimet e Palit (shih Rom. 2:19 dhe këtu), por i zakonitë në Ungjijtë.

Tek pasazhi i Isaias (dmth., 6:9-10) është gjykimi i Perëndisë që verboi sytë frymërorë të izraelitëve për shkak të mosbesimit të tyre të vazhdueshëm. Po e njëjta e vërtetë shprehet tek Rom. 1:21, ku forma pasive nënkupton Perëndinë (shih Rom. 11:8-10, duke cituar Isa. 29:10 dhe Ps. 69:22-23). Është e vështirë të balancosh

<sup>64</sup> Versioni në shqip është: “perëndia i këtij shekulli”. (shënim i përkthyesit)

1. Mosbesimin njerëzor
2. Ngurtësimin hyjnor
3. Verbërimin satanik

Besimi është një dhuratë dhe një përgjigje e nevojshme! Paradoksi i besëlidhjes është misteri i paracaktimit dhe vullnetit të lirë. Ne duhet ta lejojmë Perëndinë të jetë Perëndia dhe të kërkojmë llogaridhënie njerëzore. Shih **TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK / SPECIAL TOPIC: ELECTION/PREDESTINATION AND THE NEED FOR A THEOLOGICAL BALANCE** tek 2 Kor. 8:16-17.

A mund ta imagjinoni fuqinë që i ligu duhet të ketë që ai është i aftë të verbojë sytë e njerëzve ndaj bukurisë tërheqëse të ungjillit (shih Mat. 13:19) dhe nxitjes së Frymës së Shenjtë për t'iu përgjigjur atij (shih Gjoni 6:44, 65)? Pali përdor disa metafora për të përshkruar mosbesimin: (1) zemra të ngurtësuar; (2) mendje të verbuara; (3) ndërgjegje të dobëta dhe (4) sy të verbuar. Gjendet një konflikt frymëror i vazhdueshëm (shih Efe. 6:10-19).

<b>NASB</b>	<b>“që ata të mos mund të shohin dritën e ungjillit të lavdisë së Krishtit”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“që drita e ungjillit e lavdisë së Krishtit... të mos ndriçojë tek ata”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“për t’i penguar ata nga të parët e dritës së ungjillit të lavdisë së Krishtit”</b>
<b>TEV</b>	<b>“Ai i pengon ata që të mos shohin dritën që ndriçon mbi ta, dritën që vjen nga Lajmi i Mirë për lavdinë e Krishtit”</b>
<b>NJB</b>	<b>“që ata të mos mund të shohin dritën ndriçuese të ungjillit të lavdisë së Krishtit”</b>

Nëse do të vini re në këtë kontekst, gjenden disa fjalë që lidhen me dritën. Kjo i referohet

1. Jezusit, shpesh i quajtur “drita” (shih Gjoni 1:4,9; 3:19; 8:12)
2. Ndoshta përjetesës së Palit në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9)
3. Ndoshta një aludim ndaj lavdisë *Shekinah* të Perëndisë nga Eksodi (të përmendur tek 2 Kor. 4:6; 3:7)

Të mos shohësh Krishtin në Shkrimet do të thotë të humbasësh shpëtimin. Dhjata e Re shpall lavdinë e Krishtit, ungjillit. Dhjata e Vjetër përmbushet dhe plotësohet në Të. Ai është themeli i nevojshëm, guri i qoshes, guri i vendosur dhe guri i lartë. Të mos shohësh Atë do të thotë të fundosësh besimin.

▣ **“që është shëmbëllimi i Perëndisë”** Të shohësh Jezusin do të thotë të shohësh Atin (shih Gjoni 1:18; 14:8,9; Kol. 1:15; Heb. 1:3). Dhjata e Re konfirmon se Jezusi u mishërua për t’i shërbyer tre qëllimeve.

1. Për të zbuluar plotësisht Atin
2. Për të pajtuar për mëkatin
3. Për t’iu dhënë besimtarëve një shembull që duhet të ndjekin

**4:5 “ne nuk predikojmë, pra, veten tonë”** Të përpiqesh të interpretosh letrën e Palit është si të dëgjosh vetëm gjysmën e një bisede telefonike. Ne supozojmë nga pohimet e Palit gjërat që mund t’i kenë shkaktuar ato. Nga vargu 3:1, këtu dhe kapitujt 10-13, është e dukshme se Pali kishte ndeshur nga ata në Korint që e sulmuan atë personalisht dhe ungjillin e tij. Pali po konfirmon me forcë që Jezusi është Zot dhe shërbesën e tij (shih 1 Kor. 3:5-9). Ai vetëm mbron vetveten (dmth., “ne vetë” është e theksuar) ose madhështon kredencialet e tij (shih kapitullin 12) në mënyrë që të mbrojë vlefshmërinë e ungjillit të tij. Për një diskutim interesant mbi limitet e autoritetit apostolik shih *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re] nga George Ladd, fq. 382.

▣ **“Jezu Krishtin, Zotin”** Kjo frazë ishte shpallja e kishës së hershme të besimit në pagëzim (shih Rom. 10:9-13; 1 Kor. 12:3; Fil. 2:9-11). Të tre termat kryesorë të përdorur në Dhjatën e Re për të përshkruar të Premtuarin, Shërbëtorin Vuajtës, përdoren në këtë frazë.

1. Krisht – Ky është ekuivalenti grek i termit hebraik *messiah*, që do të thoshte “një i vajosur”. Ai nënkupton “një i thirrur dhe i pajisur nga Perëndia për një detyrë specifike.” Në Dhjatën e Vjetër tre grupe drejtuesish vajoseshin: priftërinjtë, mbretërit dhe profetët. Jezusi i përmbush të tre këto detyra të vajosura (shih Heb. 1:2-3).
2. Jezus – Ky emër hebraik do të thoshte “YHWH shpëton” ose “YHWH sjell shpëtim”. Ai iu zbulua prindërve të tij nga një engjëll (shih Mat. 1:21). “Jezus” rrjedh nga fjala hebraike për shpëtim, *hosea*, me parashtesën për emrin e besëlidhjes për Perëndinë, “YHWH”. Është i njëjti si emri hebraik Joshua.



3. Zot – Termi “zot” (*kurios*) mund të përdoret në një kuptim të përgjithshëm ose në një kuptim specifik teologjik. Ai mund të ketë kuptimin “zotëri”, “zot”, “mjeshër”, “pronar”, “bashkëshort”, ose “njeriu-Perëndi i plotë”. Përdorimi i Dhjatës së Vjetër i këtij termi (*adon*) vinte nga hezitimi i hebrenjve për të shqiptuar emrin e besëlidhjes për Perëndinë, YHWH (shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 1:1), që vinte nga folja hebraike “të jesh” (shih Eksod. 3:14). Ata kishin frikë se mos thyenin urdhërimin që thoshte: “Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd, kot” (shih Eksod. 20:7; Ligji i Përt. 5:11). Ata mendonin se nëse nuk e shqiptonin emrin, nuk mund ta përdornin atë kot. Kështuqë, ata e zëvendësuan me emrin hebraik, *Adonai*, i cili kishte një kuptim të ngjashëm me fjalën greke, *Kurios* (Zot). Autorët e Dhjatës së Re përdornin këtë term për të përshkruar hyjësinë e plotë të Krishtit.

Gjenden fraza të ndryshme rrëfimore të përdorura për Jezusin.

1. Jezusi është Mesia / Krishti – Veprat e Apo. 5:42; 9:22; 17:3; 18:5,28; 1 Kor. 1:23
  2. Jezusi është Biri i Perëndisë – Veprat e Apo. 9:20; Rom. 1:3-4; Heb. 4:14
  3. Jezusi është Zot – Veprat e Apo. 2:36; 10:36; 11:20; Rom. 10:9; 2 Kor. 4:5; Fil. 2:11; Kol. 2:6
- Në një kuptim këto përmbledhin të kuptuarit e kishës së hershme për Jezusin e Nazaretit.

**4:6 “sepse Perëndia që tha: ‘Le të ndriçojë drita në errësirë,’”** Ky është një aludim ndaj Zan. 1:3 dhe një aludim personal ndaj eksperiencës së Palit në rrugën e Damaskut (shih Veprat e Apo. 9:1-22; 22:3-16; 26:9-18). Për Pjetrin i njëjti lloj eksperience zbuluese që përfshinte Jezusin dhe dritën (dmth., lavdia) ndodhi në Malin e Shpërfytyrimit (shih 2 Pjet. 1:19).

▣ **“zemrat”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 14:25.

▣ **“lavdisë së Perëndisë”** Kjo duket se lidhet me renë e lavdisë *Shekinah* që simbolizonte praninë e YHWH në librin e Eksodit (shih 2 Kor. 3:17). Ky simbol i pranisë së Perëndisë u transferua në Arkën e Besëlidhjes pas kalimit të Lumit Jordan për në Tokën e Premtuar. YHWH njihet plotësisht, jo si një objekt fizik i dukshëm, por në Jezusin, hyjësinë e mishëruar. Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

▣ **“në fytyrën e Jezu Krishtit”** Ky është krahasimi i vazhdueshëm midis velit të Moisiut (shih 2 Kor. 3:13) dhe reflektimi i përkryer i Jezu Krishtit (shih Heb. 1:3). Besimtarët kanë parë lavdiën e Krishtit tek ungjilli (shih 2 Kor. 3:18).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 4:7-12

<sup>7</sup> Dhe ne e kemi këtë thesar në enë prej balte që epërsia pashoqe e kësaj fuqie të jetë nga Perëndia dhe jo nga ne. <sup>8</sup> Ne jemi të shtrënguar në çdo mënyrë, por nuk jemi të ngushtuar deri në fund; jemi ndërduash por jo të dëshpëruar; <sup>9</sup> jemi të përndjekur por jo të braktisur; të rrëzuar, por jo të shkatërruar; <sup>10</sup> kurdo ne e mbajmë në trupin tonë vdekjen e Zotit Jezus, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në trupin tonë. <sup>11</sup> Ne që jetojmë, jemi vazhdimisht të dorëzuar në vdekje për Jezusin, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në mishin tonë të vdekshëm. <sup>12</sup> Dhe kështu tek ne vepron vdekja, ndërsa në ju jeta.

**4:7 “Por<sup>65</sup> ne e kemi këtë thesar”** Kjo i referohet Frymës banuese të Perëndisë që madhështon, zbulon dhe formon personin e Krishtit në jetët tona (shih Gjoni 16:8-14; Rom. 8:9; Kol. 1:27; 2 Pjet. 1:3-4).

▣ **“në enë prej balte”** Ky është një theks mbi trupin njerëzor (shih 2 Kor. 4:10,16; 5:1 e në vazhdim; Zan. 2:7; 3:19; 18:27). I gjithi ky kontekst është një formë dialektike midis kushteve fizike tokësore të Palit dhe fuqisë së jashtëzakonshme frymërore të ungjillit dhe Frymës së Shenjtë që banon në jetën e tij.

▣ **“epërsia pashoqe”** *Huperbolë*, shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / SPECIAL TOPIC: PAUL'S USE OF HUPER COMPOUNDS tek 1 Kor. 2:1.

**4:8-11 “Ne jemi të shtrënguar në çdo mënyrë, por nuk jemi të ngushtuar deri në fund”** Vargjet 8-10 përmbajnë një seri të nëntë formave pjesore (më së shumti pasive) të tashme të cilat janë lojëra fjalësh me fjalë në

<sup>65</sup> Versioni në shqip është: “Dhe”. (shënim i përkthyesit)

gjuhën greke koine që përshkruajnë shërbesën e vështirë të Palit. Tetë format e para pjesore janë në çifte kontrastesh. E para përshkruan eksperiencën e shërbesës së Palit dhe e dyta kufizon pasojat. Shembujt e kësaj loje fjalësh janë: (1) “humbje por jo humbje absolute” dhe (2) “të rrëzuar por jo të shkatërruar”. Ky seksion mund të krahasohet me 2 Kor. 1:6; 6:4-10; 11:23-28.

**4:9 “shkatërruar”** Për konceptin “shkatërruar” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 8:11 dhe diskutimin tek 1 Kor. 1:18.

**4:10 “kurdo ne e mbajmë në trupin tonë vdekjen e Zotit Jezus”** Kjo i referohet paradoksit të të qënies tonë drejtë në lidhje me Perëndinë, por të ekspozuar ndaj problemeve fizike për shkak të një bote të rënë. Ne kemi jetën e përrjetshme, por ne po vdesim fizikisht (shih 2 Kor. 1:8). Sikurse Jezusi u refuzua dhe u persekutua (shih Gjoni 15:20), po kështu ndodh edhe për besimtarët (shih 1 Kor. 15:31; Gal. 2:20; Fil. 3:10; Kol. 1:24; 1 Pjet. 4:12-19).

▣ **“që edhe jeta e Jezusit”** Kjo i referohet (1) Krishtit të ringjallur, i cili ishte shpresa e Palit ose (2) besnikërisë së Jezusit nën persekutim. Pali dëshironte të shfaqte besnikërinë e Jezusit (shih 2 Kor. 4:11) dhe të merrte pjesë në ringjalljen e ndjekësve të Tij (shih 2 Kor. 4:14; 1 Kor. 15).

▣ **“të shfaqet në trupin tonë”** Kjo është një formë lidhore aoriste pasive. Lexoni Gal. 6:17, varg i cili dukshëm i referohet plagëve fizike të Palit në shërbesën ndaj Jezusit. Ndërsa ena jonë tokësore thytet, thesari brenda saj bëhet gjithnjë e më i dukshëm (shih 2 Kor. 12:9-10).

Pali përdor termin grek sarx (dmth., mish) në disa kuptime.

1. Trupi njerëzor (“trupi” i 2 Kor. 4:10 paralel me “mish” i 2 Kor. 4:11; gjithashtu 2 Kor. 7:5; 10:3; 12:7)
2. Personi njerëzor (shih 2 Kor. 5:16; 11:18)
3. Njeriu trashëgues (dmth., at - bir, shih Rom. 1:3; 4:1)
4. Njerëzimi i tërë (shih 1 Kor. 1:26,29)
5. Mëkati njerëzor (shih Rom. 7:5,18; 8:3,4,5,8,9,12,13; 2 Kor. 7:1; 10:2)

**4:11 “Ne që jetojmë, jemi vazhdimisht të dorëzuar në vdekje për Jezusin”** Njohuria teologjike në këtë varg mund të shihet tek 1 Kor. 4:9, ku apostujt janë në ekspozitë si për engjëjt dhe për njerëzit. Besimtarët gjithashtu janë në ekspozitë ndaj një bote të humbur dhe ndaj botës engjëjlore (shih Efe. 2:7; 3:10).

Termi “vazhdimisht” (shih 2 Kor. 6:10) është paralel me termin “gjithnjë” tek 2 Kor. 4:10. Thirrja për shërbesë është një thirrje për tek vdekja e qëllimtare e përditshme ndaj vetvetes (shih 2 Kor. 5:14-15; Rom. 6:7; 1 Kor. 15:31; Gal. 2:20; Fil. 3:8,10; 1 Gjoni 3:16). Ky qëndrim është e anasjellta e rënies së njerëzimit tek Zanafilla 3. Ajo është një provë e ngjashmërisë me Krishtin, që është restaurimi i shëmbëllimit të Perëndisë në njerëzimin.

Termi “të dorëzuar tek” (*paranididōmi*) u përdor nga Juda teksa dorëzonte Jezusin tek autoritetet (shih Mat. 20:18-19; Mark. 10:33). Ai përdoret nga Jezusi në një kuptim profetik për të përshkruar ndjekësit e Tij tek Mat. 10:17; 24:9; Mark 13:11-12.

Fraza “për Jezusin” duhet të kuptohet si shkakësi. Rëndesat e shërbesës sonë nuk janë për përfitim të Krishtit, por ato janë tonat për shkak se ne e ndjekim Atë. Sikurse ata persekutuan Atë, ata do të na persekutojnë neve.

Megjithatë, gjithashtu është e vërtetë se gjërat që ne vuajmë si ndjekës të Krishtit janë pikërisht gjërat që mund të na ndihmojnë të rritemi gjithnjë e më shumë në ngjashmëri me Të.

Identifikimi i Palit me vdekjen e Jezusit funksionon teologjikisht në disa nivele.

1. Teologjia sakramentale (shih Rom. 6:3-5; Kol. 2:12; 3:1,3-5)
2. Doktrina e kishës (shih 1 Thes. 4:14-15)
3. Eksperienca personale (shih 2 Kor. 4:10-11; Gal. 2:20; Fil. 3:10)

▣ **“mishin tonë të vdekshëm”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**4:12 “Dhe kështu tek ne vepron vdekja, ndërsa në ju jeta”** Kjo është një formë treguese e mesme e tashme (deponente) e cila personifikon vdekjen. Kjo i referohet persekutimit fizik të Palit dhe skuadrës së tij të misionit (shih 2 Kor. 4:16) dhe jetës frymërore në ata të cilëve ai u predikon ungjillin.

Në serinë e *The Anchor Bible* [Bibla Spirancë] mbi 2 Korintasve Victor Furnish beson se është në formë pasive (fq. 257) për shkak se forma dominon 2 Kor. 4:10-11, ku kryefjala e kuptuar është fuqia e Perëndisë (shih 2 Kor.

4:7). Kjo do të nënkuptonte se Perëndia përdor sprovat dhe persekutimet si një mënyrë për të prodhuar ngjashmëri me Krishtin tek ndjekësit e Tij. Jetët e drejtuesve iu japin fuqi mesazheve të tyre (shih 2 Kor. 1:3-11; 2 Tim. 2:9-10).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 4:13-15

<sup>13</sup> Por, duke pasur të njëjtën frymë besimi, sikurse është shkruar: “Unë besova, prandaj fola,” edhe ne besojmë, prandaj edhe flasim, <sup>14</sup> duke ditur se ai që ringjalli Zotin Jezus, do të na ringjallë edhe ne nëpërmjet Jezusit dhe do të na paraqesë bashkë me ju. <sup>15</sup> Sepse të gjitha këto gjëra janë për ju, që hiri, duke arritur me anë të shumë personave, të prodhojë falenderim me tepri për lavdi të Zotit.

**4:13 “duke pasur të njëjtën frymë besimi”** E rëndësishmja këtu është se i njëjti besim që bëri një person të drejtë me Perëndinë në Dhjatën e Vjetër (dmth., shkruesi i Psalmi 116) është besimi që e bën një person të drejtë me Perëndinë në Dhjatën e Re (dmth., Abrahami tek Zan. 15:6, cituar nga Pali tek Rom. 4:3,9,22).

Pali po përdor termin “frymë” në kuptimin e vetvetes së një personi. Ai shpesh përdor “frymë” si një mënyrë për t’iu referuar cilësive të brendshme të një njeriu (shih shënimin tek 2 Kor. 4:21). Kjo nuk lidhet me frazën e ngjashme të gjendur tek 1 Kor. 12:9, e cila i referohet Frymës që pajis besimtarët me besim. Kjo i referohet besimit si të Abrahamit (shih Zan. 15:6). Është interesante se si tek *Word Studies in the New Testament* [Studime Fjalësh në Dhjatën e Re], vëll. 2, M. R. Vincent thotë: “jo specifiku Fryma e Shenjtë dhe as nga ana tjetër, një dispozitë ose aftësia njerëzore, por një përzjerje e të dyjave; besimi është një dhunti e Frymës së Perëndisë” (fq. 82).

Në *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], Robert Girdlestone ka një diskutim interesant mbi përdorimet e termit “frymë” në Dhjatën e Re (fq. 61-63).

1. Frymëra të liga
2. Fryma njerëzore
3. Fryma e Shenjtë
4. Gjërat që Fryma prodhon në dhe përmes frymërave njerëzore
  - a. ‘jo një frymë skllavërie përkundrejt një frymë birërie’ – Rom. 8:15
  - b. ‘një frymë zemërbutësie’ – 1 Kor. 4:21
  - c. ‘një frymë besimi’ – 2 Kor. 4:13
  - d. ‘një frymë urtësie dhe zbulose në njohurinë e Tij’ – Efe. 1:17
  - e. ‘jo një frymë frike përkundrejt fuqie, dashurie dhe disipline’ – 2 Tim. 1:7
  - f. ‘fryma e gabimit’ përkundrejt ‘fryma e së vërtetës’ – 1 Gjoni 4:6”

■ **“sikurse është shkruar”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer, e cila përdoret nga autorët e Dhjatës së Vjetër për t’iu referuar dhënies dhe lidhjes së Shkrimeve (shih Mat. 5:17-19).

■ **“Unë besova, prandaj fola”** Ky është një citim nga Septuaginta e Psalmi 116:10, e cila flet për shpëtimin e Perëndisë të një shenjtori.

**4:14 “se ai që ringjalli Zotin Jezus”** Kjo frazë është një mundësi e shkëlqyer për të treguar se Dhjata e Re shpesh i atribuon veprat e shpengimit të tre personave të Perëndisë Tre në Një.

1. Perëndia At e ringjalli Jezusin (shih Veprat e Apo. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10)
2. Perëndia Bir e ringjalli Vetveten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë e ringjalli Jezusin (shih Rom. 8:11)

Gjenden disa variante të lidhura me frazën, “Zoti Jezus”.

1. “Zoti Jezus” – MSS x, C, D, F, G
2. “Zoti Jezus Krisht” – MS 436
3. “Zoti Jezus prej së vdekurish” – MSS 104, 459
4. “Jezus” – MSS P<sup>46</sup>, B

UBS<sup>4</sup> i jep opsionit të parë një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë), por Bruce Metzger preferon opsionin e katërt (sikurse edhe Bibla NET). Sikurse me shumë variante, cili ishte origjinali nuk ndikon mbi kuptimin e përgjithshëm të pasazhit.

▣ **“do të na ringjallë... do të na paraqesë”** Këto janë të dyja forma treguese aktive të ardhshme. Besimtarët do të ringjallen prej së vdekurish (*syn* me Jezusin) dhe do të paraqiten tek Ati (*syn* me të gjithë besimtarët). Të kuptuarit e Palit si koha e Ardhjes së Dytë është e paqartë. Në disa tekste duket se ai pret që të jetë gjallë tek *parousia* (shih 1 Thes. 4:15,17; 1 Kor. 15:51-52; dhe Fil. 3:20; 4:5), por në tekste të tjera duket se identifikon vetveten me ata besimtarë që kanë vdekur (shih 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; 5:1-10). Vetëm Ati e di kohën e Ardhjes së Dytë (shih Mat. 24:36; Mark 13:32; Veprat e Apo. 1:7). Ardhja e Dytë është shpresa e çdo brezi besimtarësh, por realiteti i vetëm një brezi. Besimtarët duhet të jetojnë në gatishmëri, gati për të qënë aktivë në shërbesën e Krishtit.

**4:15** Zemra e Palit ishte të ndihmonte mëkatarët të vinin në besim në Krishtin dhe të gjenin paqen dhe gëzimin e vërtetë dhe t’i jepnin lavdi Perëndisë (shih 2 Kor. 1:11 dhe NASB, NRSV, TEV, NJB). NKJV i referohet pak më drejtpërdrejt “shumicës”. Kjo mund t’i referohet mbështetësve të Palit në kishën korintase. Ai do të ishte e kundërta e “disa” (shih 2 Kor. 3:1; 10:12; 1 Kor. 4:18; 6:11; 8:7; 10:7,8,9,10; 15:6,12,34,35). Vargu 15 është dukshëm një përmbledhje doksologjike.

▣ **“lavdi të Zotit”** Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 4:16-18**

**<sup>16</sup> Prandaj nuk na lëshon zemra; por, edhe pse njeriu ynë i jashtëm shkon në shkatërrim, ai i brendshëm përtërihet nga dita në ditë. <sup>17</sup> Sepse trishtimi ynë i lehtë që është vetëm për një moment, prodhon për ne, një peshë të pamasë e të pashoqe të amshueshme lavdie; <sup>18</sup> ndërsa ne nuk i drejtojmë sytë ndaj gjërave që duken, por ndaj gjërave që nuk shihen, sepse gjërat që duken janë për një kohë, kurse ato që nuk shihen janë të përjetshme.**

**4:16 “Prandaj nuk na lëshon zemra”** Kjo është tema e përsëritur në shkrimet e Palit (shih 2 Kor. 4:1; Gal. 6:9; Efe. 3:13; 2 Thes. 3:13). Rrethanat janë, në të vërtetë, për forcimin e qëndrueshmërisë dhe frytshmërisë sonë frymërore.

▣ **“por, edhe pse njeriu ynë i jashtëm shkon në shkatërrim, ai i brendshëm përtërihet nga dita në ditë”** Këto janë të dyja forma treguese pasive të tashme, të cilat përcaktojnë veprim të vazhdueshëm. Forma pasive është e vështirë të përkthehet dhe të kuptohet në këtë kontekst. Pjesa më e madhe e përkthimeve në anglisht i përkthejnë ato në formë aktive, por ato gjithashtu mund të përcaktojnë veprim hyjnor në përdorimin e problemeve dhe persekutimeve fizike si një mënyrë për të forcuar dhe pjekur ndjekësit e Jezusit (shih Mat. 5:10-12; Gjoni 15:18-21; 16:1-2; 17:14; Veprat e Apo. 14:22; Rom. 5:3-4; 8:17; 2 Kor. 4:16-18; Fil. 1:29; 3:11; 1 Thes. 3:3; 2 Tim. 3:12; Heb. 5:8; Jakobi 1:2-4; 1 Pjet. 4:12-19). Tek Efe. 3:16 dhe 4:24 gjendet një krahasim i njeriut të vjetër dhe njeriut të ri, por kontrasti këtu është midis një trupi fizik të jashtëm dhe natyrës sonë të brendshme frymërore.

▣ **“përtërihet”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

**TEMË E VEÇANTË: PËRTËRIJ (*ANAKAINŌSIS*) [SPECIAL TOPIC: RENEW (*ANAKAINŌSIS*)]**

Ky term grek në format e tij të larmishme (*anakainoō*, *anakainizō*) ka dy kuptime bazë.

1. “të shkaktosh diçka që të bëhet e re dhe e ndryshme (dmth., më e mirë)” – Rom. 12:2; Kol. 3:10
2. “të shkaktosh një ndryshim ndaj një gjendjeje të preferueshme të mëparshme” – II Kor. 4:16; Heb. 6:4-6 (marrë nga *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greko-Anglez], Louw dhe Nida vol. 1, fq. 157, 594)

Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek Testament* [Fjalori i Dhjatws Greke], thotë që ky term (dmth., *anakainōsis*) nuk mund të gjendet në literaturën greke përpara Palit. Pali mund ta ketë krijuar këtë term vetë (fq. 34).

Frank Stagg, *New Testament Theology* [Teologjia e Dhjatws sw Re], ka një koment interesant. “Rigjenerimi dhe ripërtëritja i përkasin vetëm Perëndisë. *Anakainōsis*, fjala për “ripërtëritje,” është një emër veprimi, dhe përdoret në Dhjatën e Re, bashkë me forma foljore, për të përshkruar një ripërtëritje të vazhdueshme, si te Romakëve 12:2, ‘transformohuni sipas ripërtëritjes së mendjes suaj’ dhe 2 Korintasve 4:16, ‘Njeriu ynë i brendshëm ripërtërihet nga dita në ditë.’ Kolosianëve 3:10 e përshkruan ‘njeriun e ri’ si ‘atij që përtërihet në njohurinë e plotë sipas imazhit të atij që e krijoi.’ Kështu ‘njeriu i ri,’ ‘risia e jetës,’ ‘rigjenerimi,’ apo ‘ripërtëritja,’ sido që të thuhet, e ka zanafillën te një veprim fillestar dhe një veprim i vazhdueshëm i Perëndisë si dhënësi dhe mbajtësi i jetës së përjetshme” (fq. 118).

▣ **“nga dita në ditë”** Pali përdor përsëritjen shprehimore hebraike (shih Zan. 39:10; Ester 3:4; Psa. 68:19) tek 2 Kor. 4:16, “dita ditës”, dhe një përsëritje të ngjashme hebraike tek 2 Kor. 4:17, “të pamasë e të pashoqe” (dmth., *huperbolën eis huperbolën*). Mbani mend se, autorët e Dhjatës së Re (përveç Lukës) janë mendimtarë hebrenj / aramaikë që shkruajnë në gjuhën koine greke. Gjenden shumë shprehje dhe ndërtime gramatikore hebraike, sikurse aludime dhe citime të shumëta ndaj dhe nga Dhjata e Vjetër në Dhjatën e Re.

**4:17-18** Vargu 17 është shumë i ngjashëm me Rom. 8:18, ndërkohë që 2 Kor. 4:18 është i ngjashëm me Rom. 8:24. Pali shkroi letrën e Romakëve nga Korinti! Ai ka qënë duke menduar për thirrjen e tij dhe problemet e lidhura me të. Në të vërtetë, nuk kishte asnjë krahasim midis vështirësisë së lehtë të përkohshme dhe lavdisë së përjetshme! Kjo është pikëpamja biblike që mban popullin e Perëndisë në këtë botë të rënë. Ai është me ne, për ne dhe do të na sjellë në praninë e Tij personale për të qëndruar aty përgjithmonë!

**4:17 “prodhon”** Po e njëjta folje përdoret tek Rom. 5:3-4 dhe Jakobi 1:2-4, të cilat gjithashtu flasin për përfitimet e vuajtjes dhe persekutimit.

▣ **“një peshë lavdie”** Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDI (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

▣ **“të pamasë e të pashoqe të amshueshme”** *Huperbolë*. Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul's Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

## PYETJE DISKUTIMI

Ky është një koment studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si flet 2 Kor. 4:1 për metodat e mësuesve të rremë?
2. Ku e justifikonin etërit e kishës së hershme ndryshimin e tekstit grek të 2 Kor. 4:4 për të zgjidhur problemin e kohëve të tyre?
3. Çfarë do të thotë që Satani është “perëndia” i kësaj bote?
4. Pse Pali po tërheq vëmendjen tek problemet e tij fizike përkundrajt fuqive të tij frymërore?

## 2 KORINTASVE 5

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Të Jetosh Sipas Besimit (4:16-5:10) 4:16-5:5	Siguria e Ringjalljes  5:1-8	Siguria në Përballje me Vdekjen  5:1-5	Të Jetosh Sipas Besimit (4:16-5:10)	Vështirësia dhe Shpresat e Apostullatit (4:7-5:10)  5:1-5
5:6-10	Froni i Gjykimit i Krishtit	5:6-10	5:6-10	5:6-10
Shërbesa e Pajtimit  5:11-15	5:9-11  Pajtuar me Perëndinë 5:12-21	Mbrojtje e Mëtejshme e Shërbesës së Tij të Pajtimit  5:11-15 (5:11-6:13)	Miqësia me Perëndinë përmes Krishtit  5:11-15 (5:11-6:13)	Apostullati në Veprim  5:11-15
5:16-6:10		5:16-6:10	5:16-6:19 5:20-6:3	5:16-6:19 5:20-6:10

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Pali diskuton vdekjen e tij tek 2 Kor. 5:1-10.
  - a. Ai përdor dy metafora.
    - i. Një çadër tokësore përkundrajt një ndërtesë të përhershme, të bërë nga Perëndia
    - ii. I veshur përkundrajt i zhveshur (dmth., lakuriq)
  - b. Është shumë e vështirë të ndjekësh mendimet paraardhëse të Palit. A po flet ai për
    - i. Të qenit tonë të veshur në Krishtin në pagëzim (shih 2 Kor. 5:2-4)
    - ii. Banimin e Frymës që në shpëtim (shih 2 Kor. 5:5)
    - iii. Marrja jonë e një trupi të ri frymëror në rikthimin e Krishtit (shih vargjet 3 dhe 10)
  - c. Paralelizimet më të mira të Palit për të interpretuar këtë tekst gjenden tek Rom. 8:18-25,26-30 (dmth., rënkimi) dhe 1 Kor. 15:53-54 (dmth., “i gëlltitur”).
  - d. Në një farë mënyre ky tekst duhet të lidhet me diskutimin e Palit të vuajtjes tek kapitujt 4 dhe 6. Jeta e perëndishme dhe me besnikëri në mes të rrethanave të vështira është një temë e përsëritur.

- B. Pali jep një konfirmim thelbësor teologjik tek 2 Kor. 5:6 dhe 8. Më parë besimtarët dhe jobesimtarët mendoheshin se shkonin në *Hades* në vdekje për të pritur gjykimin (shih TEMË E VEÇANTË: KU JANË TË VDEKURIT / SPECIAL TOPIC: Where Are the Dead? tek 2 Kor. 5:6). Judaizmi rabinik madje pranonte një ndarje midis këtij vendi mbajtjeje të të vdekurve (dmth., *Sheoli* i Dhjatës së Vjetër) midis të drejtëve dhe të këqijve. Pali konfirmon se në ringjalljen e Jezusit Ai mori të drejtët me Vete në qiell. Tani besimtarët nuk shkojnë në *hades*, por janë me Zotin. Nëse kjo nënkupton një marrëdhënie të plotë apo një marrëdhënie të pjesshme është e pasigurtë. Bibla nuk na zbulon informacion të detajuar mbi jetën e përtejme.
- C. Pali bën një tjetër pohim befasues tek 2 Kor. 5:10. Dukshëm të gjithë besimtarët dhe jobesimtarët do të qëndrojnë përpara Krishtit si Gjykatës. A është kjo paralele me gjykimin e deles dhe të dhisë tek Mateu 25 ose me Gjykimin e Madh të Fronit të Bardhë të Zbulesës 20? Nëse besimtarëve iu janë falur të gjitha mëkatet përmes Krishtit, për çfarë do të gjykohej ata? Përsëri, këto pyetje specifike nuk mund të marrin përgjigje biblikisht. Supozimi logjik është se ata janë përgjegjës për
- Mesazhin e ungjillit
  - Dhuntitë e tyre frymërore
  - Përdorimin që iu kanë bërë burimeve fizike
  - Gatishmërinë e tyre për shërbesë
- Por, ky është vetëm supozim i bazuar mbi përmbajtjen e 2 Kor. 5:11-21.
- D. Diskutimi i Palit i përgjegjësisë frymërore tek 2 Kor. 5:11-21 dukshëm reflekton mësimet / veprimet egoiste dhe ndoshta imorale të mësuesve të rremë.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 5:1-5

<sup>1</sup> Ne e dimë në fakt se, në qoftë se kjo çadër, vendbanimi ynë tokësor, priset, ne kemi një godinë nga Perëndia, një banesë të përjetshme, në qiej, që nuk është bërë nga dorë njeriu. <sup>2</sup> Sepse në këtë çadër ne psherëtimë duke dëshëruar fort të vishemi me banesën tonë qiellore, <sup>3</sup> nëse do të gjindemi të veshur e jo të zhveshur. <sup>4</sup> Sepse ne që jemi në këtë çadër psherëtimë duke qenë të rënduar, dhe për këtë arsye nuk duam, pra, të na zhveshin, por të na veshin, që ç'është e vdekshme të përpihet nga jeta. <sup>5</sup> Dhe ai që na ka formuar pikërisht për këtë është Perëndia, i cili na dha edhe kaparin e Frymës.

**5:1 “Ne e dimë”** Është e vështirë në këtë libër të dimë pararendësin e përemrave shumë të Palit. Ndonjëherë ai i referohet (1) vetvetes; (2) skuadrës së tij të misionit ose (3) të gjithë besimtarëve. Vetëm konteksti duhet të përcaktojë se cila nënkuptohet. Këtu unë supozoj se është opsioni numër 3.

☐ **“në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë e cila do të thotë veprim i mundshëm. Vdekja e Palit ishte e sigurtë vetëm nëse fillimisht do të ndodhte Ardha e Dytë. Ai kishte menduar se do të vdiste në Azi (shih 2 Kor. 1:8-10). Jeta e tij si apostull nuk kishte qënë e lehtë apo pa dhimbje (shih 2 Kor. 4:7-12; 6:3-10; 11:24-28). Pali thjesht nuk e dinte kohën apo rrethanat e vdekjes së tij. Ai mund të ketë menduar apo shpresuar se do të ishte gjallë kur Krishti të rikthehej (shih 1 Kor. 15:51-52; Fil. 3:20; 1 Thes. 4:15,17). Megjithatë, në pasazhe të tjera ai pret që të ringjallet prej së vdekurish (shih 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14. Për një diskutim të mirë shih *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve] të F. F. Bruce, fq. 200-201). Shpresa e të qenit gjallë në rikthimin e Krishtit është shpresa e çdo brezi besimtarësh por realiteti i vetëm një brezi të persekutuar.

☐ **“çadër”** Kjo është një nga disa metafora biblike për brishtësinë e trupit njerëzor (dmth., bar, enë). Pali e dinte se trupi i tij po prishej. Ai ishte përprjekur që të riparonte shumë çadra të vjetra!

NASB, TEV “priset”  
 NKJV, NRSV “shkatërrohet”  
 NJB “paloset”

Kjo është një formë lidhore aoriste pasive. Pali e dinte se jeta dhe vdekja ishin në dorën e Perëndisë (dmth., në formën pasive). Ai e dinte se do të vdiste, por ai nuk e dinte kur apo si (dmth., mënyra lidhore).

Ky term është një fushë e gjerë semantike. Në Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re *kataluma* përdoret për një vend banimi dhe *kataluō* për një vend ku jetoje ose vendoseshë ose pushoje. Megjithatë, ajo gjithashtu përdoret për shkatërrimin apo shfuqizimin e diçkaje (që është një zgjerim metaforik i *luō*, dmth., i lirë, shih Mat. 24:2). Tek Isa. 38:12 ai përdoret për të ulur një çadër. Ky duket se është paralelizmi më i mirë që Pali përdor këtu.

▣ **“ne kemi një godinë nga Perëndia”** Kjo është një ndërtesë e përhershme (shih Gjoni 14:2-3; Heb. 11:10) krahasuar me një çadër të lëvizshme e të përkohshme (shih Heb. 11:9). Kjo është në kohën e tashme. Pali po pohon një të vërtetë profetike si të ishte një realitet i tashëm.

▣ **“një banesë... nuk është bërë nga dorë njeriu”** Trupat tanë të rinj do të jenë frymërorë (shih 1 Kor. 15:35-49), si i Jezusit (shih Mark 14:58; 1 Gjoni 3:2).

▣ **“të përjetshme, në qiell”** Kjo i referohet vendit të banimit të Perëndisë. Termi “qiell” është shumë për shkak se rabinët debatonin mbi çështjen se sa “qiell” kishte. Tek Zanafilla 1 termi qiell i referohet atmosferës mbi tokë. Kështu rabinët përdornin njohurinë e tyre të numerologjisë biblike për të konfirmuar një qiell të tretë ose një qiell të shtatë si vendi ku Perëndia banonte. Shih Tema e Veçantë: Qiej / Special Topic: Heavens tek 2 Kor. 12:2. Qielli nuk është lart ose jashtë. Ai ndoshta është një dimension tjetër pa kohë dhe hapësirë. Jezusi ishte i aftë pas ringjalljes që të shfaqej dhe të zhdukej, dhe po ashtu që të lëvizte nga një vend në një tjetër. Pasi kuptohet përmasa e universit fizik, mahnitja e realitetit frymëror është tronditëse.

**5:2 “në këtë”** Kjo është në gjininë asnjëanëse, që i referohet “shtëpisë / banesës” tek 2 Kor. 5:1.

▣ **“psherëtimë”** Kjo fjalë është një formë treguese aktive e tashme, besimtarët vazhdojnë të psherëtimë ose të rënkojnë thellësisht për rregullin e ri të Perëndisë dhe trupat tanë të rinj frymërorë (shih Rom. 8:18-27; krijimi psherëtimin / rënkon, 2 Kor. 5:22; besimtarët psherëtimë, 2 Kor. 5:23; dhe Fryma psherëtimin, 2 Kor. 5:26).

▣ **“duke dëshëruar”** Ky është një term i fortë për dëshirë (shih 2 Kor. 9:14). Forma emërore është tek 2 Kor. 7:7 and 11. Pali ishte një njeri me ndjenja të forta.

**5:3-4 “të na veshin / të veshur”** Pali shpesh përdor veshjen si një metaforë për jetën frymërore. Rroba së cilës i referohet këtu ishte tunika e jashtme ose e sipërme (*ependutēs*, shih Gjoni 21:7). Ai përdori veshjen si një metaforë për zgjedhjet e një personi për stilin e jetesës. Besimtarët inkurajohen të heqin jetën e vjetër dhe ta vendosin atë mënjani si një rrobë (shih 2 Kor. 3:8,9; Efe. 4:22,25,31; Jakobi 1:21; 1 Pjet. 2:1). Ata duhet të veshin Krishtin (shih 2 Kor. 3:10,12,14; Efe. 4:24; Rom. 13:14; Gal. 3:27). Këta besimtarë dikur kontrolloheshin dhe zotëroheshin nga dëshirat e tyre të liga, por tani, përmes Krishtit, ata mund të largohen prej tyre (shih Romakëve 5-6). Kjo terminologji e veshjes së Krishtit mund të ketë qenë e lidhur me rregullin e pagëzimit në kishën e hershme, ku të konvertuarit e rinj vishnin rroba të pastra dhe të bardha pas pagëzimit. Pali nuk dëshironte të përjetonte një gjendje të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes, por dëshironte të merrte pjesë në ndodhitë e lidhura me Ardhjen e Dytë (shih 1 Thes. 4:15-17), një prej tyre ishte trupi i ri frymëror.

Koncepti teologjik i gjendjes së patrupëzuar nuk pohohet specifikisht në Shkrime, por është vetëm një nënkuptim ngurrues për shkak se koncepti u përdor në filozofinë greke si një gjendje e përhershme e ngjizur nga një trupëzim fizik superior. Në *Word Pictures in the New Testament* [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re] A. T. Robertson thotë: “Pali nuk dëshironte të jetë thjesht një frymë e patrupëzuar më veshjen e tij frymërore” (vëll. 4, fq. 228). Më poshtë është një shënim i shkurtër nga komentari im, vëll. 7, 1 Thes. 4:16 (shih [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org)).

“Dhe të vdekurit në Krishtin do të ringjallen të parët’ Kjo frazë shkakton konfuzion se ku shkojnë të vdekurit midis vdekjes së tyre dhe ditës së ringjalljes. Kjo frazë nënkupton se ata do të qëndrojnë në varr (shih Mat. 27:52-53).”

Megjithatë, 2 Kor. 5:8 nënkupton se ata janë me Zotin. Zgjidhja mund të jetë në kërkimin e një gjendjeje të patrupëzuar. Trupi fizik qëndron në varr, forca e jetës shkon që të jetë me Zotin. Ka shumë pyetje pa përgjigje këtu. Bibla nuk na jep një pasazh të qartë mësimi mbi këtë temë.



Pjesa më e madhe e përkthimeve e përkthejnë atë sikur shenjtorët janë me Perëndinë / Jezusin dhe rikthehen me Të (shih NASB). Një tjetër pikëpamje gjendet tek TEV: “Ata që kanë vdekur duke besuar në Krishtin do të ringjallen në jetë të parët.”

**5:3** Vargu tre është ndoshta një kllapë. Është e vështirë të dish saktësisht se kujt po i referohet Pali për shkak se

1. Teksti përziën metaforat
2. Pasiguria se si “i zhveshur” lidhet me “vishni”
3. Marrëdhënia kontesktuale ndaj dhimbjes (vdekjes) apostolike apo kundërshtisë ndaj saj (mësimet e rreme)
4. Gjendet gjithashtu problemi i shtuar i një varianti tekstual. Prova më e mirë tekstuale gjendet pas *eadusameno* (“zhvesh”, dmth. MSS P<sup>46</sup>,  $\alpha$ , B, C, D<sup>2</sup>), por termi shumë i ngjashëm *ekdusameno* (“vesh”, dmth., MS D\*) ka shumë më tepër kuptim në këtë kontekst. Nëse një person zgjedh me anë të kriterit të kritikizmit tekstual
  - a. Dorëshkrimet më të vjetra greke janë më të mira
  - b. Teksti më i pazakontë është ndoshta origjinaliAtëherë Pali ka shkruar një tautologji (dmth., “zhvishni... të zhveshur”). UBS<sup>4</sup> nuk është në gjendje të vendosë (vlerësim “C”), por vendos “vishni” në tekst. Net Bible [Bibla Net] gjithashtu preferon opsionin e dytë, “vishni”.

▣ **“të zhveshur”** Kjo fjalë përdoret aq shpesh në letërsinë greke për gjendjen e preferuar të patrupëzuar në vdekje (shih Vincent, *Word Studies* [Studime Fjalësh], vëll. 2, fq. 822; Frank Stagg, *New Testament Theology* [Teologjia e Dhjatës së Re], fq.322-324; George E. Ladd, *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], fq. 552-554). Grekët e dëshironin shumë këtë çlirim fillestar nga trupi fizik, megjithatë, krishtërimi sikurse judaizmi, konfirmon se ne gjithmonë do të kemi një shfaqje trupërore (si besimtarët ashtu edhe jobesimtarët, shih Dan. 12:1-2; Mat. 25:46; Gjoni 5:28-29). Ndoshta Pali sërish po refuzon mësimet e rreme (dmth., gnosticizmin fillestar).

**5:4** Ky varg i shkurtër dhe misterioz duhet të interpretohet nën dritën e Rom. 8:18-25,26-30 (dmth., “psherëtim”) dhe 1 Kor. 15:53-54 (dmth., “e vdekshme”, “të përpihet”). Duket të jetë një ripohim i vargut 2.

**5:5 “përgatitur”<sup>66</sup>** (shih 2 Kor. 4:17; 5:5; 7:10,11; 9:11; 12:12). Jetët tona nuk kontrollohen nga fati apo shansi, por nga Perëndia. Edhe sprovat tona mund të jenë një mjet për pjekuri dhe besim më të madh (shih Rom. 8:28-30; Heb. 5:8).

Dhënia e Frymës është

1. Shenja që Epoka e Re po agon
2. Provë e shëptimit personal
3. Mjeti i shërbesës
4. Mjeti i pjekurisë
5. Siguria e qiellit

**NASB, NJB** “kaparin”  
**NKJV, NRSV, TEV** “garancinë”

Ky koncept i një kapari ka një precedent në Dhjatën e Vjetër (mbani mend, shkrimtarët e Dhjatës së Re janë mendimtarë hebrenj që shkruajnë në gjuhën koine greke).

1. Një premtim për të paguar një detyrim (shih Zan. 38:17,18,20; Ligji i Përt. 24:10-13)
2. Një premtim për mbështetje të sigurtuar (shih 1 Sam. 17:18)
3. Një premtim personal (shih 2 Mbret. 18:23; Isa. 36:8)

Ky term grek i referohet një “parapagimi” ose kaparosjeje (shih 2 Kor. 1:22; 5:5). Në gjuhën moderne greke ai përdoret për një unazë fejeje, e cila është premtimi i një martese që do të vijë. Fryma është premtimi i përmbushur i një epoke të re të drejtësisë. Kjo është pjesa e tensionit midis “tashmë” dhe “ende jo” në Dhjatën e Re, i cili përbën mbivendosjen e dy epokave hebraike për shkak të dy ardhjeve të Krishtit (shih diskutimin e shkëlqyer tek

<sup>66</sup> Versioni në shqip është: “formuar”. (shënim i përkthyesit)

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 5:6-10**

<sup>6</sup>Ne, pra, kemi gjithnjë siguri besimi dhe e dimë se gjersa banojmë në trup, jemi larg Zotit, <sup>7</sup>sepse ecim nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet vizionit. <sup>8</sup>Por jemi të sigurt dhe na parapëlqen më tepër ta lëmë trupin dhe të shkojmë e të banojmë bashkë me Zotin. <sup>9</sup>Prandaj edhe përpiqemi t'i pëlqejmë Atij, qoftë duke banuar në trup, qoftë duke e lënë atë. <sup>10</sup>Sepse ne të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit, që secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen.

5:6

NASB “guxim të mirë”

NKJV, NRSV “siguri”

TEV “plot me guxim”

NJB “plot me siguri”

Ky term përdoret disa herë tek 2 Korintasve në dy kuptime.

1. Siguri, mbushur me ngazëllim (shih 2 Kor. 5:6,8; 7:16)
2. Guxim (shih 2 Kor. 10:1,2)

Siguria jonë e vazhdueshme (dmth., forma pjesore aktive e tashme) në Krishtin na jep ne guxim në lutje dhe në shërbesë.

▣ **“banojmë... larg”** Gjendet një lojë fjalësh midis këtyre dy termave të lidhur (gjithashtu tek 2 Kor. 5:8, 9).

1. *endēmountes*, të jesh në shtëpi (forma pjesore aktive e tashme)
2. *ekdēmoumen*, ne jemi larg nga shtëpia (forma treguese aktive e tashme)

Kur ti e di që je në Të, ti je gjithmonë në shtëpi me Të, edhe pse ndërkohë që jemi në tokë, jetojmë me anë të besimit (shih v.7).

**TEMË E VEÇANTË: TË VDEKURIT, KU JANË ATA? (SHEOL/HADES, GEHENNA, TARTARUS) [SPECIAL TOPIC: THE DEAD, WHERE ARE THEY? (SHEOL/HADES, GEHENNA, TARTARUS)]**

I. Dhjata e Vjetër

A. Të gjithë njerëzit shkojnë në *Sheol* (nuk ka asnjë rrënjë lidhjeje dhe etimologjia është e paqartë, BDB 982, KB 1368), që nënkupton vendin ku jetojnë të vdekurit ose varrin, kryesisht në letërsinë e urtësisë dhe në librin e Isaisë. Në Dhjatën e Vjetër, kjo ishte një ekzistencë e errët, e vetëdijshme, por pa gëzim (shih Jobi 10:21-22; 38:17).

B. Karakteri i *Sheolit*

1. shoqërohet me gjykimin (zjarrin) e Perëndisë, Ligji i Përt. 32:22
2. një burg me porta, Jobi 38:17; Psa. 9:13; 107:18
3. tokë / realitet pa kthim, Jobi 7:9 (titull akadian për vdekjen)
4. tokë / sferë e errët, Jobi 10:21-22; 17:13; 18:18
5. vend heshtjeje, Psa. 28:1; 31:17; 94:17; 115:17; Isa. 47:5
6. shoqërohet me ndëshkimin edhe përpara Ditës së Gjykimit, Psa. 18:4-5
7. shoqërohet me *abaddon*-in (shkatërrimin, shih Temë e Veçantë: *Abaddon ... Apollyon / Special Topic: Abaddon ... Apollyon*), ku është i pranishëm dhe Perëndia, Jobi 26:6; Psa. 139:8; Amosi 9:2
8. shoqërohet me “Gropën” (varrin), Psa. 16:10; 88:3-4; Isa. 14:15; Ezek. 31:15-17
9. të ligjtë zbresin të gjallë në *Sheol*, Num. 16:30, 33; Jobi 7:9; Psa. 55:15
10. shpesh, personifikohet si kafshë me gojë të madhe, Num. 16:30; Fjalët e Urta 1:12; Isa. 5:14; Hab. 2:5

11. njerëzit aty thirren *Refa'im* (pra, shpirtat e të vdekurve), Jobi 26:5; Fjalët e Urta 2:18; 21:16; 26:14; Isa. 14:9-11
12. megjithatë, YHWH është i pranishëm edhe aty, Jobi 26:6; Psa. 139:8; Fjalët e Urta 15:11

## II. Dhjata e Re

- A. Fjala hebraisht *Sheol* përkthehet në greqisht si *Hades* (bota e padukshme)
- B. Karakterizimi i Hadesit (shumë i ngjashëm me *Sheol*)
  1. i referohet vdekjes, Mat. 16:18
  2. lidhet me vdekjen, Zbu. 1:18; 6:8; 20:13-14
  3. shpesh nënkupton vendin e ndëshkimit të përhershëm (*Gehenna*), Mat. 11:23 (citim i Dhjatës së Vjetër); Luka 10:15; 16:23-24
  4. shpesh nënkupton varrin, Luka 16:23
- C. Ndoshta i ndarë (rabinët)
  1. pjesa e të drejtëve quhet *Paradise* [Parajsë] (në fakt, ky është një tjetër emër i qiellit, shih 2 Kor. 12:4; Zbu. 2:7), Luka 23:43
  2. pjesa e të ligjve quhet *Tartarus* [Tartar], 2 Pjetrit 2:4, ku është vendi që mbahen engjëjt e këqij (shih Zan. 6; 1 Enokut). Shoqërohet me "Humnerën", Luka 8:31; Rom. 10:7; Zbu. 9:1-2, 11; 11:7; 17:18; 20:1, 3
- D. *Gehenna*
  1. Reflekton frazën e Dhjatës së Vjetër, "lugina e bijve të Hinomit" (në jug të Jeruzalemit). Ishte vendi ku perëndia fenikas i zjarrit, *Moleku* (BDB 574, KB 591), adhurohej me flijime foshnjash (shih 2 Mbret. 16:3; 21:6; 2 Kro. 28:3; 33:6), gjë që ndalohej nga Lev. 18:21; 20:2-5.
  2. Jeremia e ndryshoi, nga vend adhurimi pagan, në një vend të ndëshkimit të YHWH-së (shih Jer. 7:32; 19:6-7). Kështu, ky u bë vendi i gjykimit të flaktë e të përjetshëm në 1 Enokut 90:26-27 dhe Sib. 1:103.
  3. Judenjtë e kohës së Jezusit ndienin kaq shumë neveri prej pjesëmarrjes së paraardhësve të tyre në adhurimin pagan me flijime foshnjash, sa që këtë zonë e shndërruan në vendgrumbullimi plehrash për Jeruzalemin. Shumë prej metaforave të Jezusit për gjykimin e përjetshëm vinin nga ky vendgrumbullim (zjarri, tymi, krimbat, era e qelbur, shih Marku 9:44, 46). Termi *Gehenna* përdoret vetëm nga Jezusi (përveçse te Jakobi 3:6).
  4. Përdorimi i *Gehenna*-s nga Jezusi
    - a. zjarr, Mat. 5:22; 18:9; Marku 9:43
    - b. i përhershëm, Marku 9:48 (Mat. 25:46)
    - c. vend shkatërrimi (i trupit dhe shpirtit), Mat. 10:28
    - d. paralel me *Sheolin*, Mat. 5:29-30; 18:9
    - e. karakterizon të ligjtë si "bij të ferrit", Mat. 23:15
    - f. rezultat i dënimit të gjyqit hyjnor, Mat. 23:33; Luka 12:5
    - g. koncepti i *Gehenna*-s është paralel me vdekjen e dytë (shih Zbu. 2:11; 20:6, 14), ose me liqenin e zjarrtë (shih Mat. 13:42, 50; Zbu. 19:20; 20:10, 14-15; 21:8). Ka gjasa që liqeni i zjarrtë të bëhet vendbanimi i përhershëm i njerëzve (nga *Sheoli*) dhe i engjëjve të ligj (nga *Tartari*, 2 Pjet. 2:4; Juda v. 6, ose humnera, shih Luka 8:31; Zbu. 9:1-11; 20:1, 3).
    - h. nuk u krijua për njerëzit, por për Satanin dhe për engjëjt e tij, Mat. 25:41
- E. Ka gjasa që, për shkak të mbivendosjes së *Sheolit* me *Hadesin* dhe *Gehenna*-n,
  1. në fillim, të gjithë njerëzit shkonin në *Sheol/Hades*
  2. përvoja e tyre atje (e mirë/e keqe) përkeqësohet pas Ditës së Gjykimit, por vendi i të ligjve mbetet i njëjtë (ja pse KJV e përktheu fjalën *hades* (varr) si *gehanna* (ferr))
  3. I vetmi pasazh në Dhjatën e Re që përmend torturën përpara Gjykimit është shëmbëlltura e Lukës 16:19-31 (Lazari dhe i Pasuri). *Sheoli* përshkruhet edhe si vend ndëshkimi tani (shih Ligji i Përt. 32:22; Psa. 18:1-5). Megjithatë, s'mund të krijojmë një doktrinë në bazë

të një shëmbëlltyre.

III. Gjendja e ndërmjetme midis vdekjes dhe ringjalljes

- A. Dhjata e Re nuk mëson “pavdekshmërinë e shpirtit”, që është një prej disa pikëpamjeve të lashta për jetën pas vdekjes.
1. shpirti njerëzor ekziston përpara jetës së vet fizike
  2. shpirti njerëzor është i përjetshëm përpara dhe pas vdekjes fizike
  3. shpesh, trupi fizik shihet si një burg, ndërsa vdekja si çlirim për t’u kthyer në gjendjen paraekzistuese
- B. Dhjata e Re aludon për një gjendje të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes
1. Jezusi flet për ndarjen e shpirtit dhe trupit, Mat. 10:28
  2. Abrahami mund të ketë një trup tani, Marku 12:26-27; Luka 16:23
  3. Moisiu dhe Elija kanë një trup fizik në çastin e shndërrimit në mal, Matu 17
  4. Pali pohon se, në Ardhjen e Dytë, shpirtat me Krishtin do të marrin të parët trupa të rinj, 1 Thes. 4:13-18
  5. Pali pohon se besimtarët do të marrin trupa të rinj shpirtërorë në Ditën e Ringjalljes, 1 Kor. 15:23, 52
  6. Pali pohon se besimtarët nuk shkojnë në *Hades*, por, pas vdekjes, janë me Jezusin, 2 Kor. 5:6, 8; Fil. 1:23. Jezusi mposhti vdekjen dhe i mori të drejtët në qiell me Të (1 Pjet. 3:18-22).

IV. Qielli

- A. Kjo fjalë përdoret në tre kuptime në Bibël.
1. atmosfera mbi tokë, Zan. 1:1, 8; Isa. 42:5; 45:18
  2. qiejt me yje, Zan. 1:14; Ligji i Përt. 10:14; Psa. 148:4; Heb. 4:14; 7:26
  3. vendi i fronit të Perëndisë, Ligji i Përt. 10:14; 1 Mbret. 8:27; Psa. 148:4; Efe. 4:10; Heb. 9:24 (qielli i tretë, 2 Kor. 12:2)
- B. Bibla nuk na zbulon shumë gjëra për jetën pas vdekjes, ndoshta për shkak se njerëzit e rënë nuk kanë kapacitetin që të kuptojnë (shih 1 Kor. 2:9).
- C. Qielli është edhe vend (shih Gjoni 14:2-3), edhe person (shih 2 Kor. 5:6 8). Qielli mund të jetë Kopshti i ripërtërirë i Edenit (Zanafilla 1-2; Zbulesa 21-22). Toka do të pastrohet dhe rimëkëmbët (shih Veprat e Apo. 3:21; Rom. 8:21; 2 Pjet. 3:10). Shëmbëllimi i Perëndisë (Zan. 1:26-27) ripërtërihet në Krishtin. Tani, bashkësia e ngushtë e Kopshtit të Edenit bëhet sërish e mundshme.
- Gjithsesi, kjo mund të jetë metaforike (qielli si qytet i stërmadh në formë kubi, i Zbu. 21:9-27), dhe jo e fjalëpërfjalshme. 1 Korintasve 15 përshkruan dallimin mes trupit fizik dhe trupit frymëror si dallimi mes farës dhe bimës së rritur. Sërish, 1 Kor. 2:9 (citim i Isa. 64:4 dhe 65:17) është një shpresë dhe premtim madhështor! Unë e di se, kur të shohim Atë, do të jemi si Ai (shih 1 Gjonit 3:2).

V. Burime të dobishme

- A. William Hendriksen, *The Bible on the Life Hereafter* [Bibla për Jetën pas Vdekjes]  
B. Maurice Rawlings, *Beyond Death's Door* [Përtej Derës së Vdekjes]

**5:7 “sepse ecim nëpërmjet besimit dhe jo nëpërmjet vizionit”** Kjo është një temë e përsëritur e Dhjatës së Re (shih 2 Kor. 4:18; Heb. 11:1,10,27; 1 Pjet. 1:8). “Ecim” është një metaforë biblike për stilin e jetesës. Besimtarët jetojnë në sferën fizike, por me anë të besimit kuptojnë dhe besojnë në realitetin e padukshëm.

**5:8** Ky është një varg aq i mrekullueshëm për të krishterët. Ai konfirmon se ne do të jemi me Zotin në një farë kuptimi në vdekje. Kjo refuzon konceptin e gjumit të shpirtit. Edhe pse marrëdhënia jonë me besimtarët e tjerë është e pasigurtë në këtë fazë dhe marrëdhënia jonë me Perëndinë nuk është gjithçka që do të jetë pasi të marrim trupat tanë të rinj në Ditën e Ringjalljes, siguria e madhe është se ne do të jemi me Të! Kjo e vërtetë nuk mësohet

qartazi diku tjetër në Bibël përveçse ndoshta tek Fil. 1:21-23, gjë që e bën këtë një varg shumë të rëndësishëm! Nën dritën e kësaj të vërtete, Pali dhe të gjithë besimtarët mund të përballen me çfarëdo dhe çdo lloj rrethane në jetë.

**5:9 “edhe përpiqemi t’i pëlqejmë Atij”** Kjo është ambicja dhe motivimi për besimtarët (shih Efe. 5:8-10; Kol. 1:10).

Termi “t’i pëlqejmë” është gjendur në disa mbishkrime, edhe përpara kohës së Palit. Ai ishte një slogan i besnikërisë dhe besueshmërisë në gjendjen kulturore helenisitike të shekullit të parë (shih Moulton dhe Milligan, *The Vocabulary of the Greek Testament* [Fjalori i Dhjatës së Re Greke], fq. 259). Pali ishte një studiues mjaft i mirë i mendimit si grek ashtu edhe hebraik.

**5:10 “të gjithë duhet të dalim para gjyqit të Krishtit”** Konteksti i menjëhershëm iu shkruhet besimtarëve; edhe besimtarët do të qëndrojnë përpara Perëndisë (shih Rom. 14:10; 1 Kor. 3:10-17). Dukshëm, ne do të gjykohe mi / shpërblehemi për qëllimet tona, për gatishmërinë tonë dhe përdorimin e dhuntive frymërore. Mëkati dhe mëkatet janë trajtuar plotësisht në vdekjen zëvendësuese të Krishtit, por dishepullizimi është një çështje prezente!

Për konceptin e Jezusit si Gjyqtar, këtu është një shënim i shkurtër nga komentari im mbi Gjonin 3:17 (shihe online tek [www.freebiblecommentary.org](http://www.freebiblecommentary.org)).

“Gjenden disa pasazhe tek Gjoni të cilat konfirmojnë se Jezusi erdhi si Shpëtimtar, jo si Gjykatës (shih Gjoni 3:17-21; 8:15; 12:47). Megjithatë, gjenden pasazhe të tjera tek Gjoni të cilat pranojnë se Jezusi erdhi për të gjykuar, do të gjykojë (shih Gjoni 5:22-23,27; 9:39; dhe në pjesë të tjera të Dhjatës së Re, Veprat e Apo. 10:42; 17:31; 2 Tim. 4:1; 1 Pjet. 4:5).

Disa komente teologjike janë sipas radhës: (1) Perëndia i dha veprën e gjykimit Jezusit, ashtu sikurse Ai kreu veprën e krijimit dhe të shpengimit, si një shenjë nderimi (shih Gjoni 5:23); (2) Jezusi nuk erdhi herën e parë për të gjykuar, por për të shpëtuar (shih Gjoni 3:17), por kur njerëzit refuzojnë Atë, ata gjykojnë vetveten; (3) Jezusi do të rikthehet si Mbreti i Mbretërve dhe Gjykatës (shih Gjoni 9:39).

Këto pohime në dukje kundërshtuese janë të ngjashme me pohimet mbi Gjon Pagëzorin a ishte apo jo Elia.”

■ **“në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen”** Është një parim universal që njerëzit janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe do të japin llogari tek Perëndia (shih Job 34:11; Fjalët e Urta 24:12; Pred. 12:14; Jer. 17:10; 32:19; Mat. 16:27; 25:31-46; Rom. 2:6; 14:12; 1 Kor. 3:8; Gal. 6:7-10; 2 Tim. 4:14; 1 Pjet. 1:17; Zbu. 2:23; 20:12; 22:12). Edhe besimtarët do të japin llogari për jetët e tyre dhe shërbesën ndaj Krishtit (dmth., “libri i kujtimeve”). Besimtarët nuk shpëtohen me anë të veprave por shpëtohen për vepra (shih Efe. 2:8-10; Jakobi dhe 1 Gjoni). Shih TEMË E VEÇANTË: LIRIA E KRISHTERË PËRKUNDREJT PËRGJEGJËSISË SË KRISHTERË / SPECIAL TOPIC: CHRISTIAN FREEDOM VS. CHRISTIAN RESPONSIBILITY tek 1 Kor. 10:23.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 5:11-15

<sup>11</sup> Duke e njohur frikën e Zotit, ne bindim njerëzit dhe jemi njohur nga Perëndia; dhe unë shpresoj se edhe në ndërgjegjet tuaja të jemi njohur. <sup>12</sup> Sepse ne nuk e rekomandojmë përsëri veten ndaj jush, por ju japim rastin të krenoheni për ne, që të keni çfarë t’u përgjigjeni atyre që krenohen me dukjen dhe jo me zemër. <sup>13</sup> Sepse, nëse nuk jemi në vete, jemi për Perëndinë, dhe në qoftë se jemi me mend në kokë, jemi për ju. <sup>14</sup> Sepse dashuria e Krishtit na shtrëngon, sepse kemi arritur në konkluzionin se, në qoftë se një ka vdekur për të gjithë, të gjithë, pra, kanë vdekur; <sup>15</sup> dhe se ai ka vdekur për të gjithë, me qëllim që ata të cilët jetojnë, të mos jetojnë që sot e tutje për veten e tyre, po për atë që vdiq dhe u ringjall për ta.

**5:11 “frikën e Zotit”** Kjo frazë lidhet me fronin e gjykimit të Krishtit të përmendur tek 2 Kor. 5:10. Gjendet një respekt dhe madhështi (shih Veprat e Apo. 5:11; 9:31) që i takon Gjykatësit të Universit (shih Heb. 10:31; 12:29; Juda 22-23)! Besimtarët motivohen për të jetuar jetë të perëndishme dhe për të ndarë ungjillin duke e ditur që secili do të japë llogari tek Perëndia.

Titulli “Zot” mund t’i referohet YHWH ose Jezusit. Frazja “frika e Zotit” është e zakonitë në Septuagintë, duke iu referuar YHWH. Megjithatë, ajo është gjithashtu një titull i zakonitë i Dhjatës së Re për Jezusin. Gjykimi i përket YHWH, por Ai ia ka kaluar atë Birit të Tij të mishëruar.

☐ **“ne bindim njerëzit”** Në kontekst kjo mund t’i referohej disa grupeve specifike të njerëzve.

1. Besimtarëve (shih 2 Kor. 5:10)
2. Mësuesve të rremë (shih 2 Kor. 5:12)
3. Besimtarëve të dobët (shih 2 Kor. 5:11-12)

Shërbesa e Palit përmbushi Urdhërimin e Madh si në ungjillizim (shih Mat. 28:19) ashtu edhe në dishepullizim (shih Mat. 28:20).

☐ **“jemi njohur nga Perëndia”** Kjo është një formë treguese pasive e përkryer. Pali me guxim konfirmon se Perëndia plotësisht dhe tërësisht njeh motivet dhe qëllimet e tij (shih 2 Kor. 4:2). Shih shënimin tek 2 Kor. 2:14.

☐ **“se edhe në ndërgjegjet tuaja të jemi njohur”** Kjo është një formë paskajore pasive e përkryer. Pali po i rikthehet një mendimi të mëparshëm të shprehur tek 2 Kor. 4:2. Shërbesa e tij me ta kishte qënë plotësisht e hapur dhe e sinqertë. Pali dëshironte që kjo kishë të kuptonte qëllimet dhe veprimet e tij të shërbesës po aq qartazi sa i njihte Perëndia.

☐ **“ndërgjegjet”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:12.

**5:12 “rekomandojmë veten”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 3:1.

☐ **“që të keni çfarë t’u përgjigjeni atyre që krenohen me dukjen dhe jo me zemër”** Qëllimet dhe metodat e shërbesës janë thelbësore! Dukshëm Pali po i krahason ato të tijat me ato të drejtuesve të tjerë në kishën korintase (shih 2 Kor. 4:2, gjithashtu vini re 1 Kor. 3:10-15). Disa drejtues bënin gjithçka për dukje dhe pa thelb në vetvete.

☐ **“krenoheni... krenohen”** Këto janë të dyja forma të termit *kauchēma*. Gjendet një formë e përshtatshme krenimi (dmth., kisha është krenare për Palin) dhe një krenari e papërshtatshme (dmth., krenimi i mësuesve të rremë). Shih TEMË E VEÇANTË: MBURRJA / SPECIAL TOPIC: BOASTING tek 1 Kor. 5:6.

☐ **“dukjen”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:11.

**5:13 “nëse... në qoftë se”** Këto janë të dyja fjali kushtore të rendit të parë, të cilat supozohen të jenë të vërteta nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

NASB, NKJV, NRSV **“përveç vetes sonë”**  
TEV **“nuk jemi aspak në vete”**  
NJB **“të paarsyeshëm”**

Ky është termi grek “qëndroj” (*histēmi*, shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:1) me parashtesën “nga” (*ek*). Ai mund të përdoret për

1. mahnitje (shih Mat. 12:23; Mark 5:42)
2. frikë (shih Mark 16:8; Luka 5:26)
3. ekstazë (shih Veprat e Apo. 10:10; 11:5; 22:17)
4. humbje të të kuptuarit ose tërbim (shih Mark 3:21; 2 Kor. 5:13)

Është e vështirë të dish saktësisht se kujt po i referohet Pali. Shumë komentatorë e lidhin me 11:1,16; 12:11.

Megjithatë, një fjalë tjetër përdoret: “i marrë”. Në këta kapituj Pali krahason përvojën e tij frymërore dhe kualifikimet e tij me mësuesit e rremë karizmatikë. Ndoshta ky është një koment që këta mësues të rremë kishin bërë duke iu referuar Palit.

☐ **“jemi me mend në kokë, jemi për ju”** Pali sigurisht ka momentet e tij të ekstazës frymërore (shih Veprat e Apo. 9; 1 Kor. 14:5,18; 2 Kor. 12), por ai jetonte për shërbesën dhe prezantonte ungjillin me qartësi dhe thellësi, në një linjë me pritshmëritë kulturore të grupit ndaj të cilit po shërbente (shih 1 Kor. 9:19-23).

**5:14 “Sepse dashuria e Krishtit”** Gramatikisht kjo është ose “dashuria e Krishtit për ne” (dmth., forma gjinore subjektive) ose “dashuria jonë për Krishtin” (dmth., forma gjinore objektive). Në këtë kontekst, opsioni i parë është më i miri.

<b>NASB</b>	<b>“kontrollon”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“shtrëngon”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“nxit”</b>
<b>TEV</b>	<b>“sundon”</b>
<b>NJB</b>	<b>“pushton”</b>

Ky term do të thotë “të mbash fort bashkë”. Dashuria shtrëngon mundësitë dhe veprimet tona. Nayra e ungjillit kërkon veprimin e duhur; në këtë rast vdekje ndaj ambicjeve dhe stilit egoist të jetesës.

▣ **“një ka vdekur për të gjithë”** Dashuria universale e Perëndisë shihet në Krishtin ndërsa Ai vdiq për hebrenjtë dhe johebrenjtë (shih Efe. 2:11-3:13). Të gjithë njerëzit mund të shpëtohen në Krishtin (shih 2 Kor. 5:19; Gjoni 3:16-18; 4:42; Rom. 5:18; 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9; 1 Gjoni 2:2; 4:14). Vargjet 14-15 janë në një marrëdhënie paralele. Pajtimi i dërguar me Krishtin (shih Isaia 53) theksohet tri herë. Po e njëjta e vërtetë shprehet tek Rom. 5:12-21. Kjo shpesh quhet tipologjia Adam / Krisht (shih 1 Korintasve 15).

▣ **“të gjithë, pra, kanë vdekur”** Teologjikisht besimtarët bashkohen me vdekjen e Krishtit në pagëzimin e tyre. Vdekja e Tij na jep falje dhe jetë të përjetshme (shih Romakëve 6). Ndërsa ne identifikohemi në vdekjen e Tij, ne gjithashtu duhet të identifikohemi në jetën e Tij sakrifikuere për të tjerët (shih 1 Gjoni 3:16). Jetesa egoiste e qëndëruar tek vetja është e papërshtatshme për besimtarët e blerë me gjak (shih 2 Kor. 5:15).

Tek *Synonyms of the Old Testament* [Sinonime të Dhjatës së Vjetër], Robert B. Girdlestone ka një diskutim të mirë të këtij ngjyrimi të ri të “vdekjes” së besimtarëve.

“Zoti ynë i tha dishepujve të Tij (Mat. 16. 28): ‘Disa nga ata që janë të pranishëm këtu nuk do të vdesin pa e parë më parë Birin e Njeriut duke ardhur në mbretërinë e vet.’ Fjalët jepen në një formë tjetër nga shën Marku (9:1), ‘Midis jush që jeni këtu ka disa që nuk do ta shijojnë vdekjen para se të shohin të vijë me fuqi mbretëria e Perëndisë.’ Shih gjithashtu Luka 9:27.

Qëllimi i këtij pasazhi ishte të përgatiste mendjet e dishepujve për të vërtetën e madhe që vdekja, e cila kishte qënë deri atëherë terrori i botës, e kishte humbur *shijen* ose *gjëmbën* e saj në rastin e atyre që e bashkonin vetveten me Zotin me anë të besimit. Vetë Krishti duhej të vdiste, Ai duhej të vuante dhimbjet e vdekjes, shpirti i Tij duhej të trishtohej tmerrësisht shumë deri në vdekje, dhe duhej të çlironte ata që përmes frikës së vdekjes kishin qënë gjithë jetën e tyre në skllavëri. Prandaj, Ai solli një pikëpamje të re të jetës dhe vdekjes, duke iu thënë dishepujve të Tij se ai që do ta shpëtonte jetën e tij duke mohuar Zotin, do ta humbiste atë, ndërsa ai që ishte i gatshëm ta humbiste jetën e tij për hir të Zotit, ai do ta shpëtonte atë. Në Ditën e Madhe Zoti do të ishte i turpëruar nga i pari, por do të rrëfente të dytin.

Hyrja në një jetë të re e cila ndodh përmes besimit në Krishtin përfshin vdekjen në një kuptim tjetër. Ajo është heqja e natyrës njerëzore nga metodat dhe parimet e saj të vjetra të egzistencës – me fjalë të tjera, është vdekje ndaj mëkatit. Ashtu sikurse në shpërbërjen fizike trupi ndalon së ndjeri, zemra ndalon së rëni, duart nuk punojnë më dhe këmbët nuk ecin më, po kështu në këtë vdekje mistike trupi dhe të gjitha pjesët e tij nuk janë më shërbëtorë të mëkatit; i njëjti hendek ose humnerë duhet të bëhet midis të krishterit dhe mëkatit sikurse është midis një njeriu të vdekur dhe botës së jashtme në të cilën ai dikur jetonte dhe lëvizte dhe kishte qenien e tij. Kjo vdekje lidhet me kryqëzimin e Krishtit, i cili ‘vdiq për mëkat’. Besimtari pagëzohet në vdekjen e Krishtit, ai vdes me Krishtin, bëhet i konformueshëm ndaj vdekjes së Tij, kryqëzohet me Krishtin (Rom. 6:5; 2 Kor. 5:14; Gal. 2:19,20; Kol. 2:20, 3:3)” (fq.285, 286).

**5:15** Vargu 15 paralelizon dhe përkufizon 2 Kor. 5:14. Kjo është një e vërtetë kaq e rëndësishme. Shpëtimi është falas, por jeta në ngjashmëri me Krishtin kushton gjithçka që jemi dhe kemi (shih Gal. 2:20)!

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“u ngrit sërish”</b>
<b>NRSV, TEV, NJB</b>	<b>“u ringjall”</b>

Kjo është një formë pjesore aoriste pasive me një agjent të pashprehur. Dhjata e Re shpesh i atribuon veprat e shpengimit të tre personave të Perëndisë Tre në Një.

1. Perëndia At e ringjalli Jezusin (shih Veprat e Apo. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 6:4,9; 8:11; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10)
2. Perëndia Bir ringjalli Vetveten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18)
3. Perëndia Frymë ringjalli Jezusin (shih Rom. 8:11)

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 5:16-19

<sup>16</sup>Prandaj tash e tutje ne nuk njohim më askënd sipas mishit; po, edhe sikur ta kemi njohur Krishtin sipas mishit, nuk e njohim më *ashtu*. <sup>17</sup>Prandaj nëse dikush është në Krishtin, ai është një krijesë e re; gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja. <sup>18</sup>Edhe të gjitha gjërat janë nga Perëndia që na pajtoi me Vetën përmes Jezu Krishtit dhe na dha shërbimin e pajtimit, <sup>19</sup>sepse Perëndia e ka pajtuar botën me Vetën në Krishtin, duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre dhe vuri ndër ne fjalën e paqartimit.

**5:16 “Prandaj tash e tutje”** Jeta dhe vdekja e Krishtit inauguruan një epokë të re. Çdo gjë është ndryshe nën dritën e Tij (shih Gal. 3:28; Kol. 3:11).

NASB	“ne nuk njohim askënd sipas mishit”
NKJV	“ne nuk konsiderojmë askënd sipas mishit”
NRSV	“ne nuk konsiderojmë askënd nga pikëpamja njerëzore”
TEV	“ne nuk gjykojmë më”
NJB	“ne nuk do të konsiderojmë askënd me standarte njerëzore”

Ky mund të reflektojë 1 Sam. 16:7; Isa. 11:3; Gjoni 7:24; 8:15. Jezusi ka ndryshuar çdo zonë të vlerësimit. Standartet njerëzore tanimë janë një mjet i papërshtatshëm gjykimi (shih Rom. 3:22; 1 Kor. 12:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11). Njohja e Krishtit na ndryshon ne (shih 2 Kor. 5:17).

Kjo mund të reflektojë se disa brenda kishës korintase ishin përpjekur të vlerësonin Palin, ungjillin e tij dhe shërbesën e tij (shih kapitujt 4, 11 dhe 12).

Ajo që kjo nuk nënkupton është se Pali konsideronte Jezusin historik si të parëndësishëm apo edhe të kontrastuar me Krishtin e përlëvdur. Pali përmend shpesh jetën tokësore të Jezusit, mësimet e Tij dhe veprat e tij shpenguese (dmth., kryqi, ringjallja). Pali po i referohet vlerësimit njerëzor (dmth., të njohësh sipas mishit). Shpengimi i lejon besimtarët të shohin të gjithë jetën dhe historinë nën një dritë të re të qendëruar tek Krishti. Historia njerëzore e kthen shpëtimin në histori. Njeriu Jezus bëhet Mesia, i Premtuari. Jeta dhe mësimet e Tij bëhen Shkrime të frymëzuara. Historia e Izraelit duhet të ri-interpretohet nën dritën e Tij!

Për termin “mish” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**5:17 “nëse”** Kjo është një tjetër fjali kushtore e rendit të parë sikurse ato tek 2 Kor. 5:13 dhe 16.

☐ **“në Krishtin”** Kjo është një nga metaforat e preferuara të Palit për të përshkruar të krishterët. Ajo flet për pozicionin tonë në Krishtin.

NASB	“krijesë e re”
NKJV, NRSV, NJB, NIV	“krijim i ri”
TEV	“qenie e re”

Pali gjithashtu personifikon krijimin tek Rom. 8:18-25. Ai karakterizon krijimin e ri të Perëndisë, epokën e re, epokën e Frymës tek 2 Kor. 5:17 dhe Gal. 6:15. Besimtarët duhet të jetojnë si qytetarë të epokës së re (shih Rom. 6:4).

#### TEMË E VEÇANTË: KTISIS (SPECIAL TOPIC: KTISIS)

Kjo fjalë, *ktisis*, përdoret në një larmi kuptimesh në Dhjatën e Re. Leksiku i Louw dhe Nida rendit



mundësitë e mëposhtme:

1. krijimi (vepra e krijimit, shih Marku 13:19; Rom. 1:20-22; Efe. 3:9)
2. krijesa (ajo që krijohet e gjallë, shih Marku 10:6; Rom. 1:25; 8:39; Kol. 1:15;23)
3. universi (gjithçka që u krijua, shih Marku 13:19; Rom. 8:20; Heb. 9:11)
4. institucioni (shih 1 Pje. 2:13 [#42.39]) 5.
5. autoriteti (shih 1 Pje. 2:13, [#37.47])

Pali gjithashtu e personifikon krijimin në Rom. 8:18-25. Ai e karakterizon krijimin e ri të Perëndisë si epokë të re, epoka e Frymës tek 2 Kor 5:17 dhe Gal. 6:15. Besimtarët duhet të jetojnë si qytetarë të epokës së re (shih Rom. 6:4).

■ **“gjërat e vjetra kanë shkuar; ja, të gjitha gjërat u bënë të reja”** Vini re shkëmbimin e qëllimtë të kohëve të foljeve.

1. “gjërat e vjetra kanë shkuar” Kjo është një kohë aoriste në mënyrën treguese shpesh duke iu referuar një veprimi të përfunduar në kohën e shkuar. Kjo i referohet konvertimit.
2. “gjëra të reja kanë ardhur<sup>67</sup>” Kjo është një kohë e përkryer e cila i referohet një veprimi të përmbytur në të shkuarën me rezultate që qëndrojnë. Kjo i referohet dishepullizimit.

Gjendet një variant dorëshkrimi grek i cili reflekton “të gjitha gjërat” në fjalinë e nënrenditur të fundit (dmth., MS D<sup>2</sup>). Ky lloj shtese sqaruese është i zakonit për skribët e mëvonshëm. Dorëshkrimet më të vjetra greke (dmth., MSS P<sup>46</sup>, x, B, C, D\*, F, G) përfundojnë me *kaina*. UBS<sup>4</sup> i jep këtij leximi një vlerësim “A” (i sigurtë).

Ky koncept i “të reja” është pjesë e terminologjisë së Dhjatës së Vjetër për *eschaton*. Profetët e Dhjatës së Vjetër flisnin për këtë epokë të re.

1. “gjërat e reja” (shih Isa. 42:9; 43:19; Jer. 31:22)
2. “besëlidhja e re” (shih Jer. 31:31-34)
3. “zemra e re, fryma e re” (Ezek. 11:19; 18:31; 36:26)
4. “emër i ri” (shih Isa. 62:2; 56:5; 65:15)
5. “këngë e re” (shih Ps. 96:1; Isa. 42:10)
6. “qiej të rinj dhe tokë e re” (shih Isa. 65:17; 66:22)

Kjo risi eskatologjike kishte ardhur në Jezusin, por gjërat e vjetra ishin ende të pranishme. E reja nuk është konsumuar plotësisht. Mbivendosja e “dy epokave” hebraike (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:20) nga dy ardhjet e Jezusit nuk u parapa nga profetët e Dhjatës së Vjetër edhe pse ata e përshkruan Mesian në terma të shërbëtorit të ulët sikurse në terma mbretërorë fitimtarë.

**5:18 “Tani<sup>68</sup> të gjitha gjërat janë nga Perëndia”** Është dashuria e Perëndisë që dërgoi Birin në botë (shih Gjoni 3:16). Shpëtimi është plotësisht nga Perëndia (shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 8:16-17, shih Gjoni 6:44,65; Efe. 1:4; 2:8-9), por besimtarët duhet t’i përgjigjen dhe të vazhdojnë t’i përgjigjen besëlidhjes së re në pendesë, besim, bindje dhe qëndrueshmëri.

■ **“pajtoi”** Kjo është një e vërtetë thelbësore teologjike. Fjala në thelb do të thotë të shkëmbesh ose të ndërrosh dhe si rrjedhojë të sjellësh bashkë atë që është ndarë. Njerëzit rebelë janë risjellë në marrëdhënie me Perëndinë përmes Krishtit. Perëndia shkëmbeu drejtësinë e Krishtit (shih 2 Kor. 5:21) për mëkatën e tyre. Krishti vdiq në vendin tonë (shih 2 Kor. 5:14,21).

Ky kontekst (dmth., 2 Kor. 5:16-21) dhe Rom. 5:10-11 janë pasazhe përcaktuese mbi këtë term teologjik.

Mëkatarët tanimë janë miq, madje familjarë, me të Shenjtin. Restaurimi i marrëdhënies së dëmtuar tek Rënia (shih Zanafilla 3) është plotësuar në Krishtin.

Një diskutim i “pajtimit” si një koncept teologjik gjendet tek *New Testament Theology* [Teologjia e Dhjatës së Re] e Frank Stagg, fq. 102-104, 142.

■ **“na dha shërbimin e pajtimit”** Teologjikisht kjo është paralele me 2 Kor. 5:14-15. Jezusi u bë pajtimi i besimtarëve, tani ata duhet të bëhen mjeti i ndarjes së ungjillit të pajtimit me të tjerët. Besimtarët ndajnë në

<sup>67</sup> Versioni në shqip është: “të gjitha gjërat u bënë të reja”. (shënim i përkthyesit)

<sup>68</sup> Versioni në shqip është: “Edhe”. (shënim i përkthyesit)

vdekjen e Jezusit dhe ne ndajmë në shërbesën e Tij (shih 2 Kor. 5:19). Qëllimi është shërbesa e ngjashme me atë të Krishtit (shih 1 Gjoni. 3:16). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

**5:19 “Perëndia ishte në Krishtin<sup>69</sup>”** Kjo është çështja kryesore e krishtëritimit. A ishte Perëndia (dmth., Perëndia, YHWH i Dhjatës së Vjetër) në Jezusin e Nazaretit, duke pajtuar botën me Vetveten (shih Gal. 1:3-4)? Nëse po, krishtërimi është i vërtetë; nëse jo, ai është i rremë. A ishte Jezusi vërtet plotësia e Perëndisë (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:15-16; Fil. 2:6-11; Heb. 1:2-3)? A është Ai vërtet e vetmja mënyrë e pajtimit dhe faljes (shih Gjoni 14:6)? Nëse po, atëherë ungjilli është informacioni më i rëndësishëm që njerëzit do të dëgjojnë ndonjëherë! Ne duhet të themi të vërtetën; ne duhet të predikojmë ungjillin; ne duhet të lartësojmë Krishtin; ne duhet të ofrojmë një shpëtim falas tek një botë e humbur.

▣ **“botën”** Perëndia e do botën (shih Gjoni 3:16). Bota mund të shpëtohet (shih 1 Tim. 2:4; 2 Pjet. 3:9). Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I KOSMOS (BOTË) NGA PALI / Special Topic: Paul's Use of Kosmos tek 1 Kor. 3:21b-22.

▣ **“duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre”** Kjo mund të reflektojë Ps. 32:2, i cili citohet tek Rom. 4:68. Përpara Ligjit, mëkati nuk ishte i ngarkuar tek individët (shih Rom. 4:15; 5:13-14; Veprat e Apo. 17:30). Por ky tekst ka një të vërtetë edhe më të madhe. Përballë rebelimit të njohur njerëzor gjendet falja në Krishtin. Gjaku i Jezusit pastron nga të gjitha mëkatet! Mëkati nuk është më barrierë midis Perëndisë dhe njerëzimit, por tani është

1. Mosbesimi
2. Refuzimi i besimit në Krishtin
3. Mungesa e dëshirës për t’iu përgjigjur ofertës së Perëndisë

▣ **“mos numëruar”** Ky është termi *logizomai*, i cili përdoret tridhjetë e katër herë nga Pali, por në dy kuptime plotësisht të ndryshme. I pari mund të shihet tek 2 Kor. 3:5, “kuptoj”. Shih shënimin e plotë atje. I dyti është “numëroj”. Ky kuptim shihet qartazi tek Rom. 4:3,4,5,6,8,9,10,11,22,23,24, dhe Gal. 3:6. Ky përdorim teologjik nënkupton depozitimin e diçkaje në llogarinë bankare të dikujt tjetër. Perëndia numëron drejtësinë e Jezusit për llogarinë tonë (shih 2 Kor. 5:21). Gjithashtu Perëndia nuk numëron mëkatin tonë për llogarinë tonë. Çfarë Perëndie i mahnitshëm! Çfarë Shpëtimtari efektiv!

▣ **“vuri ndër ne fjalën e paqtimit”** Një botë e humbur nuk është në pragun e një Perëndie të pafuqishëm dhe pa dashuri, por është në pragun e një kishë të plogësht dhe të pashqetësuar. Ne kemi mesazhin; ne kemi çelësat e Mbretërisë (shih Mat. 16:19; Zbu. 1:18; 3:7). Ne kemi Frymën e Shenjtë që banon në ne (shih Rom. 8:9,11; 1 Kor. 3:16; 6:19; 2 Tim. 1:14). Ne kemi urdhërat marshues të Jezusit (shih Mat. 28:18-20). Çfarë do të bëjmë ne?

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 5:20-21

**<sup>20</sup> Ne, pra, bëhemi lajmëtarë për Krishtin, sikurse Perëndia të këshillonte nëpërmjet nesh; dhe ne ju këshillojmë juve për hir të Krishtit: Paqtohuni me Perëndinë! <sup>21</sup> Sepse Ai bëri të jetë mëkat për ne Ai që nuk njihnte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në Të.**

**5:20 “ne jemi ambasadorë për Krishtin<sup>70</sup>”** Kujt i referohet “ne” dhe “ju” në këtë varg? A po i flet Pali kishës? Nëse po, “ne” është Pali dhe skuadra e tij misionare dhe “ju” janë besimtarët në Korint. Këta njerëz nuk kishin nevojë të shpëtoheshin, por ata kishin nevojë të riktheheshin në unitet. Vini re se Pali nuk thotë se besimtarët duhet të jenë ambasadorë, por se ata janë ambasadorë. Kjo është e ngjashme me pohimet e Jezusit tek Mat. 5:13-16. Besimtarët janë kripë dhe dritë. Pyetja është çfarë lloj kripe dhe drite. Kjo është pyetja këtu. Besimtarët janë përfaqësues të Krishtit, por çfarë lloj ambasadorësh janë ata: të përcarë, heretikë, mosdashës etj.?

▣ **“këshillojmë”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

<sup>69</sup> Versioni në shqip është: “Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin”. (shënim i përkthyesit)

<sup>70</sup> Versioni në shqip është: “Ne, pra, bëhemi lajmëtarë për Krishtin”. (shënim i përkthyesit)

■ **“Paqtohuni me Perëndinë”** Kjo është një formë urdhërore pasive e tashme. A është ky një urdhërim ndaj njerëzve të humbur apo ndaj njerëzve të shpëtuar? Konteksti më i madh po kërkon një stil jetese të përshtatshëm nga ana e besimtarëve. Jezusi na shpëtoi nga mëkati dhe lufta; ne shpëtohemi për të shërbyer! Ne jemi thirrur në shërbesë në ngjashmëri me Krishtin, jo plane personale.

Ky kontekst ka një mesazh ndaj botës së humbur dhe në nevojë – Krishti vdiq për ju (drejtësi pozicionale). Ky kontekst ka një mesazh për kishën e përçarë dhe mosdashëse – Krishti vdiq për ju (drejtësi progresive).

Forma pasive mund të përkthehet “lejojeni Perëndinë t’ju pajtojë me Vetveten”; “lejojeni veten tuaj të pajtohet” (shih *The Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik Xherom], fq. 281); ose “lejojeni Perëndinë t’ju kthejë nga armiq në miq të tij” (shih TEV). Besimtarët shpallin të vërtetën, Fryma bind të humburit, Biri siguron mjetin dhe Ati përmbush vullnetin e Tij përmes përgjigjes së besëlidhjes.

**5:21** Ky tekst ka disa të vërteta të mëdha.

1. Perëndia dërgoi Jezusin të vdesë për ne (shih Gjoni 3:16). Jezusi erdhi të vdiste për ne (shih Mark 10:45).
2. Jezusi nuk njihte asnjë mëkat (shih Gjoni 8:46; Heb. 4:15; 7:26; 1 Pjet. 1:19; 2:22; 1 Gjoni 3:5).
3. Qëllimi është drejtësia personale, shërbesa në ngjashmëri me Krishtin (shih Rom. 8:28-29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pjet. 1:15). Megjithatë, gjendet një shënim kontigjence (mënyra lidhore). Të gjithë besimtarët nuk e kuptojnë tërësisht qëllimin e plotë të Perëndisë tek shpëtimi. Është një thirrje për shërbesë, një thirrje për vetë-mohim, një thirrje për shenjtëri. Krishtërimi vetëm fillon kur një person i beson Krishtit. Besimi është vetëm hapi i parë i një udhëtimi të gjatë.

<b>NASB</b>	<b>“të jetë mëkat për llogarinë tonë”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“të jetë mëkat për ne”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“të jetë mëkat”</b>
<b>TEV</b>	<b>“të ndajë mëkatin tonë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“një fitimtar për mëkatin”</b>

Si e bëri Perëndia Jezusin të ishte mëkat? Ky mund të jetë një aludim i Dhjatës së Vjetër ndaj një ofrimi mëkati (shih Isaia 53; Rom. 8:3). Perëndia ofroi Jezusin si qengji i pamëkatë (shih Gjoni 1:29,36).

Unë mendoj se fjalët e Jezusit nga kryqi: “Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?” (shih Mark 15:34), që është një citim nga Psalmi 22, reflekton realitetin frymëror të Atit që largohet nga Biri (dmth., i simbolizuar nga errësira, shih Mark 15:33), ndërsa Ai mori mëkatin e botës. Kjo është teologjikisht paralele me Gal. 3:13, “u bë mallkim për ne”!

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A mëson ky kapitull një periudhë të patrupëzuar midis vdekjes dhe ringjalljes?
2. A nënkupton 2 Kor. 5:10 se besimtarët gjithashtu do të gjykohen? Nëse po, për çfarë?
3. Rendisni dy motivet e Palit për ungjillizim (2 Kor. 5:11,14).
4. Shpjegoni pse vargjet 14-15 janë thelbësore për një të kuptuar të përshtatshëm të jetës së krishterë.

## 2 KORINTASVE 6:1-7:1

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Shërbesa e Pajtimit  (5:11-6:13) 5:11-6:10	Shenja të Shërbesës  6:1-10 Jini të Shenjtë	Mbrojtje e Mëtejshme e Shërbesës së Tij të Pajtimit  (5:11-6:13)	Miqësia me Perëndinë përmes Krishtit  6:3-10	Apostullati në Veprim  (5:11-6:10)  Një Paralajmërim
6:11-13 Tempulli i Perëndisë së Gjallë	6:11-7:1	6:11-13 Një Kllapë mbi Marrëdhënien me Jobsimtarët	6:11-13 Paralajmërim Kundër Ndikimeve Pagane	6:11-13
6:14-7:1		6:14-7:1	6:14-7:1	6:14-7:1

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE**

- A. Vargu 1 i këtij kapitulli është thelbësor për interpretimin e të gjithë kapitullit. Konteksti përfshin besimtaërt e kishës në Korint dhe prandaj, nuk përfshin të larguarit (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 6:9), por dështimi për të jetuar jetën e krishterë në mënyrë efektive.
- B. Duke filluar në vargun 4 gjendet një seri parashtesash.
  - a. *en* me dhanore, tetëmbëdhjetë herë, 2 Kor. 6:4-7
  - b. *dia* me gjinore, tri herë, 2 Kor. 6:7-8
  - c. *hōs* me pjesore të kohës së tashme, shtatë herë, 2 Kor. 6:9-10  
Kjo duket se përfshin një përshkrim të shërbesës së Palit që përfshin problemet dhe presionet, si të brendshme ashtu edhe të jashtme, sikurse dhe hiri i pakrahasueshëm i Perëndisë.
- C. Paradokset përmbyllëse të 2 Kor. 6:8-10 duket se përshkruajnë jetën e Palit, si nga pikëpamja e kritikëve dhe nga pikëpamja e Perëndisë.
- D. Seksioni 6:14-7:1 duket se është jashtë kontekstit. Vargu 7:2 merr terminologjinë dhe diskutimin e 2 Kor. 6:13. Ky seksion është shumë hebraik në natyrë. Ai është një paralajmërim përkundërt identifikimit të

dikujt shumë ngushtë me kulturën pagane. Paralajmërimet janë nga një rrethanë e Dhjatës së Vjetër (dmth., hebrejtë përkundrejt johebrejve ose populli i Perëndisë përkundrejt idhujtarëve). Megjithatë, Pali po e përdor atë në një mënyrë të ngjashme me 1 Kor. 10:14-33, ku ai diskuton pjesëmarrjen e krishterë në adhurimin pagan.

Veçimi i dukshëm i këtij paragrafi ka shkaktuar teori që mendojnë se 2 Korintasve është një letër e përbërë nga disa letra që Pali i dërgoi Korintit.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 6:1-10

<sup>1</sup> Dhe, duke qenë bashkëpunëtorë të Tij, ju këshillojmë të mos e pranoni më kot hirin e Perëndisë, <sup>2</sup> sepse Ai thotë: “Në kohë të pëlqyer unë të dëgjova dhe në ditë shpëtimit të ndihmova.” Ja, pra, koha e pëlqyer, ja, pra, dita e shpëtimit. <sup>3</sup> Ne nuk japim asnjë shkas për skandal në asnjë gjë, që të mos shahet shërbesa jonë; <sup>4</sup> por në çdo gjë e rekomandojmë veten tonë si shërbëtorë të Perëndisë në shumë vuajtje, në shtrëngime, në nevoja, në ngushtica, <sup>5</sup> në rrahje, në burgosje, në kryengritje, në mundime, në të pafjetura, në agjërime, <sup>6</sup> me pastërti, me njohuri, me durim, me mirësi, me Frymën e Shenjtë, me dashuri jo të shtirur, <sup>7</sup> me fjalën e së vërtetës, me fuqinë e Perëndisë, me armët e drejtësisë në të djathtë dhe në të majtë, <sup>8</sup> në lavdi dhe në çnderim, me emër të mirë dhe me emër të keq; <sup>9</sup> si gënjeshtarë, por të vërtetë; si të panjohur, por të njohur; si njerëz që vdesin, por ja, jetojmë; si të ndëshkuar, por jo të vrrarë; <sup>10</sup> si të brengosur, por gjithmonë të gëzuar; si të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur; si njerëz që s’kanë kurrgjë, por kanë gjithçka.

**6:1 “duke punuar së bashku me Të<sup>71</sup>”** Kjo është një formë pjesore aktive e tashme. Nuk ka një kryefjalë të konstatuar, por konteksti nënkupton “me Perëndinë” (shih 2 Kor. 5:20; 1 Kor. 3:9). Pali përdor po këtë term për të përshkruar bashkëpunëtorët e tij në ungjill (shih 2 Kor. 1:24; 8:23; 1 Kor. 16:16; Rom. 16:3,9,21), por këtu konteksti nënkupton fortësisht Perëndinë. Çfarë mendimi i mahnitshëm që besimtarët janë bashkëpunëtorë për Perëndinë (shih 1 Kor. 3:5-9).

▣ **“ne gjithashtu ju nxisim<sup>72</sup>”** Pali përdori të njëjtën folje tek 2 Kor. 5:20. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

▣ **“të mos e pranoni më kot hirin e Perëndisë”** Forma paskajore është aoriste, e cila i referohet besimtarëve korintas që pranojnë Krishtin. Por “më kot” i referohet qëllimit të shpëtimit, i cili është frytshmëria për Mbretërinë, jo thjesht shpëtimit personal. Pali shpesh përdor këtë term për të shprehur këtë shërbesë të pritshme të Mbretërisë (shih 1 Kor. 15:10,14,58; Gal. 2:2; Fil. 2:16; 2 Thes. 2:1; 3:5). Ky koncept është paralel me përdorimin e Palit të “ecjes” tek Efesianëve (shih Efe. 4:1,17; 5:2,15).

**6:2 “Ai thotë”** Pali po citon një pasazh të Dhjatës së Vjetër të lidhur me Izraelin, por nga përdorimi i kësaj forme treguese aktive të tashme (dmth., thotë), ai tregon se premtimi është i lidhur me të gjitha kohët dhe të gjithë njerëzit. Pali përdor këtë citim si një thirrje të drejtpërdrejtë nga Perëndia ndaj kishës korintase. Shkrimi është aktual dhe i përshtatshëm!

▣ **“Në kohë të pëlqyer”** Ky është një citim nga Septuaginta e Isa. 49:8 (dmth., një nga poemat / këngët e Shërbëtorit), të cilat trajtojnë Perëndinë që mirëpret dhe pajis (1) Mesian dhe (2) një komunitet mesianik. Gjendet shpesh një tension tek Isaia 40-53 midis kolektives (dmth., kombi i Izraelit) dhe Mbretit ideal izraelit (dmth., Mesia).

▣ **“koha e pëlqyer... dita e shpëtimit”** E para është një citim nga Septuaginta e Isa. 49:8, ku përdoret *dektos*, por Pali përdor një formë më të intensifikuar (dmth., *eurosdektos*, shih Rom. 15:16) kur ai zbaton këtë profeci në

<sup>71</sup> Versioni në shqip është: “duke qenë bashkëpunëtorë të Tij”. (shënim i përkthyesit)

<sup>72</sup> Versioni në shqip është: “ju këshillojmë”. (shënim i përkthyesit)

situatën korintase (shih 2 Kor. 6:2b). Mesia ka ardhur dhe tani ftesa për të qënë plotësisht të pranuar nga Perëndia ka ardhur tek ata. Ata duhet të kapin momentin. Ata duhet të jenë komuniteti mesianik eskatologjik. Dita e shpëtimit të dikujt është një ndodhi e mrekullueshme dhe madhështore, por ajo shpesh shoqërohet me persekutim dhe vështirësi (shih 2 Kor. 6:4-10).

**NASB, NKJV** “Vër re”  
**NRSV** “shiko”  
**TEV** “Dëgjo”  
**NJB** “epo”

Kjo është pjesëza greke *idou*, e cila shërben për të tërhequr vëmendjen tek një pohim i vërtetë. Pali e përdor atë shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 5:17; 6:2,9; 7:11; 12:14).

■ **“ja, pra, dita e shpëtimit”** Kjo fjali e fundit tek 2 Kor. 6:2 është komenti i Palit mbi citimin nga Isaia. Kjo mund t’i referohet edhe një ftese të individit për t’iu përgjigjur ungjillit, edhe jetës së shërbesës ndaj mbretërisë mesianike.

**6:3 “Ne nuk japim asnjë shkas për skandal në asnjë gjë”** Kjo është një formë mohuese e dyfishtë e fuqishme në greqisht. Pali ishte i vendosur, si në jetën e tij personale dhe në shërbesën e tij, që të mos vendoste ndonjë barrierë midis vetvetes dhe dëgjuesve të ungjillit (shih 1 Kor. 9:19-23). Ai po përdor jetën e tij për të arritur dy gjëra: (1) për t’iu dhënë atyre një model që ta ndjekin në shërbesën e tyre dhe (2) për t’iu kundërpërgjigjur akuzave të mësuesve të rremë (shih 2 Kor. 11:12).

I vetmi “gur pengese” ishte Vetë Krishti (shih 1 Kor. 1:18-25). Ungjilli u refuzua nga

1. Hebrenjtë për shkak të një Mesie vuajtës
2. Johebrenjtë për shkak të një trupi të ringjallur
3. Mësuesve të rremë korintas për shkak të mungesës së aftësive prezantuese retorike të Palit

Për shkak të verbimit të Satanit (shih 2 Kor. 4:4) dhe tensionit të vetë mesazhit të ungjillit, Pali nuk dëshironte të bënte ndonjë gjë që mund të shkaktonte që njerëzit të refuzonin predikimin e tij (shih 1 Kor. 9:19-23,24-27).

**NASB** “në mënyrë që shërbesa të mos diskreditohej”  
**NKJV** “që të mos shahet shërbesa jonë”  
**NRSV** “në mënyrë që të mos gjendet asnjë faj me shërbesën tonë”  
**TEV** “Ne nuk duam që ndokush të gjejë faj në punën tonë”  
**NJB** “në mënyrë që asnjë faj të mos i ngjitet veprës sonë të shërbesës”

Termi “jonë” (shih NKJV, NRSV, TEV, NJB) nuk është në tekstin grek, i cili thjesht ka njëjën e shquar, “shërbesa”. Ky varg lidhet teologjikisht me 1 Tim. 3:2-10, i cili konfirmon se shërbetarët nuk duhet të kenë asnjë rast për kritikizëm. Besimtarët jetojnë dhe shërbejnë për përparimin e Mbretërisë Mesianike, jo për arritje personale apo plane personale (shih 1 Kor. 9:12). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

**6:4-7** Kjo është një seri termash të paraqitur nga parashtesa greke *en*. Ajo përsëritet tetëmbëdhjetë herë për theksim. Gjenden disa lista në shkrimet e Palit të problemeve që ai hasi (shih 1 Kor. 4:9-13; 2 Kor. 7:5; 11:23-29). Ai i përmend ato për të motivuar besnikët dhe për të zhvlerësuar pretendimet e mësuesve të rremë. Shih TEMË E VEÇANTË: VESET DHE VIRTYTET NË DHJATËN E RE / Special Topic: NT Vices and Virtues tek 1 Kor. 5:9.

#### FRAZA GREKE ME EN

	NASB	NKJV	NRSV	TEV	NJB
v. 4, <i>hupomonē</i>	shumë qëndrueshmëri	shumë durim	qëndrueshmëri e madhe	durim i qëndrueshëm	këmbëngulje e vendosur

v. 4, <i>thliphis</i>	vuajtje	sfida	vuajtje	sprova	vështirësi
v. 4, <i>anagkē</i>	vështirësi	nevoja	vështirësi	vështirësi	vështirësi
v. 4, <i>stenochōria</i>	pikëllime	pikëllime	ngushtica	vështirësi	pikëllime
v. 5, <i>plēgē</i>	rrahje	rrahje me rrip	rrahje	rrahur	rrahje me kamzhik
v. 5, <i>phulakē</i>	burgosje	burgosje	burgosje	burgosur	dërguar në burg
v. 5, <i>akatastasia</i>	turbullira	turbullira	kryengritje	grumbulluar	grumbulluar
v. 5, <i>kopos</i>	mundime	mundime	mundime	mbingarkuar	munduar
v. 5, <i>agrupnia</i>	pafjetura	pafjetura	netë pa gjumë	pa gjumë	i pagjumë
v. 5, <i>nēsteia</i>	Uri	agjërimë	uri	pa ushqim	vdekje urie
v. 6, <i>hagnotēs</i>	pastërti	pastërti	pastërti	pastërti	pastërti
v. 6, <i>gnōsis</i>	njohuri	njohuri	njohuri	njohuri	njohuri
v. 6, <i>makrothumia</i>	durim	vuajtje e gjatë	durim	durim	durim
v. 6, <i>chrēstotēs</i>	mirësi	mirësi	mirësi	mirësi	mirësi
v. 6, <i>pneumati hagiō</i>	Fryma e Shenjtë	Fryma e Shenjtë	shenjtëria e Frymës	Fryma e Shenjtë	Fryma e Shenjtë
v. 7, <i>logō aletheias</i>	fjalën e së vërtetës	fjalën e së vërtetës	e folur e vërtetë	mesazhi i së vërtetës	fjalën e së vërtetës
v. 7, <i>dunamei theou</i>	fuqinë e Perëndisë	fuqinë e Perëndisë	fuqinë e Perëndisë	fuqinë e Perëndisë	fuqinë e Perëndisë

**6:4 “por në çdo gjë e rekomandojmë veten tonë si shërbëtorë të Perëndisë”** Kjo është çështja. Kjo i referohet frazës “më kot” tek 2 Kor. 6:1. Pali konfirmon prioritetin e shërbesës së Mbretërisë. Të gjithë besimtarët janë shërbëtarë (shih Efe. 4:12) të pajisur me dhunti (shih 1 Kor. 12:7,11). Ungjilli ka një fokus si individual (dmth., shpëtimi personal) ashtu edhe një fokus kolektiv (dmth., shpallja e ungjillit dhe shërbesa e ungjillit, shih 1 Kor. 12:7). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / Special Topic: Servant Leadership tek 1 Kor. 4:1.

**6:6 “me pastërti”** Kjo i referohet ose (1) kuptimit rrënjësor të këtij termi, të pasurit e një qëllimi ose (2) stilit moral dhe etik të jetesës së Palit.

▣ **“me durim”** Ky term përdoret shpesh për t’iu referuar durimit me njerëzit, megjithatë ai gjithashtu u përdor në Dhjatën e Re për t’iu referuar karakterit të Perëndisë (shih Rom. 2:4; 9:22; 2 Pet. 3:9,15).

▣ **“me mirësi”** Ky term përkthehet shpesh “një ëmbëlsi e frymës”. Ajo përbën qëndrimin kur dikush do të preferonte të lëndohej vet se sa të lëndonte të tjerët, të bënte të tjerët të ndihen të mirëpritur se sa të ndihej vet i mirëpritur.

■ **“me Frymën e Shenjtë”** New English Bible [Bibla e Re në Anglisht] e përkthen këtë si “dhunti të Frymës së Shenjtë”. *Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik Xherom] ka “në një frymë të shenjtë” (fq. 282). Arsyeya pse ata ndryshojnë përkthimin është se është e pazakontë për Palin që t’i referohet personit të Frymës së Shenjtë në mes të një serie fjalësh përshtues. Unë jam dakord që kjo i referohet frymës personale të shenjtërisë së Palit të prodhuar nga Fryma e Shenjtë, por nuk duhet të jemi dogmatikë me këtë për shkak të Rom. 9:1; 14:17; 15:16; 1 Kor. 12:3; 1 Thes. 1:5.

■ **“me dashuri jo të shtirur”** Po e njëjta frazë përdoret tek Rom. 12:9. Pali përdor të njëjtin mbiemër për të përshtuar besimin tek 1 Timoteu 1:5 dhe 2 Tim. 1:5. Pjetri përdor të njëjtin mbiemër me një sinonim të *agapē*, *philadelphia* tek 1 Pet. 1:22.

**6:7 “me fjalën e së vërtetës”** Duhet të mbajmë mend se sfondi hebraik ndaj këtij termi nuk është “e vërtetë përkundrejtë e rremë” por “besnikëri dhe besueshmëri”, sikurse në marrëdhëniet ndërpersonale (shih 1 Gjoni 8:32; 14:6). Shih TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” NË SHKRIMET E PALIT / SPECIAL TOPIC: “TRUTH” IN PAUL’S WRITINGS tek 2 Kor. 13:8.

### FRAZA GREKE TË PARAQITURA ME *DIA*

	NASB	NKJV	NRSV	TEV	NJB	NIV
v. 7, <i>hoplōntēs dikaiosunēs</i>	armët e drejtësisë	armatura e drejtësisë	armët e drejtësisë	drejtësia si arma jonë	armët e drejtësisë	armët e drejtësisë
v. 8, <i>dozēs kai atimias</i>	lavdi dhe çnderim	nderim dhe çnderim	nderim dhe çnderim	nderuar dhe çnderuar	kohëra nderi dhe turpi	lavdi dhe çnderim
v. 8, <i>dusphēmias kai euphēmias</i>	me emër të mirë dhe me emër të keq	me emër të mirë dhe me emër të keq	të fyer dhe të përlevduar	me reputacion të keq dhe reputacion të mirë	në faj dhe në lavdërim	me emër të mirë dhe me emër të keq

■ **“me armët e drejtësisë në të djathtë dhe në të majtë”** Kjo i referohet furnizimeve të Perëndisë për luftën tonë frymërore në tokë (shih 2 Kor. 2:11; Rom. 6:13; Efe. 2:2; 4:14,27; 6:10-18; 1 Pjet. 5:8). Është e mundur që dora e djathtë t’i referohet armëve sulmuese dhe dora e majtë t’i referohet armëve mbrojtëse. Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA / SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS tek 1 Kor. 1:30.

**6:8 “çnderim”** Ky term përdoret për një rezident që humbet të drejtat e qytetarisë.

### FRAZA GREKE TË PARAQITURA ME *HŌS*

	NASB	NKJV	NRSV	TEV	NJB
v. 8, <i>planoi kai alētheis</i>	si mashtrues, por të vërtetë	si mashtrues, por të vërtetë	si mashtrues, por të vërtetë	si gënjeshtarë, por të vërtetë	marrë për mashtrues, por të vërtetë
v. 9, <i>agnooumenoi kai epigninōskomenoi</i>	si të panjohur, por të njohur	si të panjohur, por të njohur	si të panjohur, por të njohur	si të panjohur, por të njohur nga të gjithë	si të panjohur, por të pranuar



v. 9, <i>apothnēskontes kai idou zōmen</i>	si njerëz që vdesin, por ja, jetojmë	si njerëz që vdesin, por jetojmë	si njerëz që vdesin, por jemi të gjallë	si të vdekur por ne jetojmë	si njerëz që vdesin, por jemi të gjallë
v. 9, <i>paideuomenoi kai mē thanatoumenoi</i>	si të ndëshkuar, por jo të vrarë	si të ndëshkuar, por jo të vrarë	si të ndëshkuar, por jo të vrarë	edhe pse të ndëshkuar, ne nuk jemi të vrarë	të fshikulluar por jo të ekzekutuar
v. 10, <i>lupoumenoi aei de chairontes</i>	si të brengosur, por gjithmonë të gëzuar	si të brengosur, por gjithmonë të gëzuar	si të brengosur, por gjithmonë të gëzuar	edhe pse të trishtuar, ne jemi gjithmonë të lumtur	në dhimbje por gjithmonë plot gëzim
v. 10, <i>ptōchoi pollous de ploutizontes</i>	si të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur	si të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur	si të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur	ne dukemi të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur	të varfër, por shumë veta i bëjmë të pasur
v. 10, <i>mēden echontes kai panta katechontes</i>	si njerëz që s'kanë kurrgjë, por kanë gjithçka	si njerëz që s'kanë kurrgjë, por kanë gjithçka	si njerëz që s'kanë kurrgjë, por kanë gjithçka	ne dukemi sikur nuk kemi asgjë, por në fakt kemi gjithçka	duke mos pasur asgjë, por duke pasur në pronësi gjithçka

**6:8-9 “por ja... por”** Teksti grek ka *kai*, i cili zakonisht do të thotë “dhe”, por në disa tekste ai mund nënkuptojë “por ja” (shih Gjoni 20:29). Mbani mend se konteksti, dhe jo një leksikon, përcakton kuptimin.

**6:10 “të brengosur, por gjithmonë të gëzuar”** (shih Rom. 5:3-5; Fil. 2:17-18; 3:1; 4:4; 1 Thes. 5:16)

▣ **“por kanë gjithçka”** Kjo seri paradoksesh duket se vë në kontrast perspektivën botërore dhe perspektivën e Perëndisë. Besimtarët janë trashëgimtarë të të gjitha gjërave përmes Krishtit (shih Rom. 8:17,32; 1 Kor. 3:21).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 6:11-13

<sup>11</sup> Goja jonë u hap për ju, o Korintas, zemra jonë u bë e gjërë. <sup>12</sup> Ju nuk jeni ngushtë në ne, por ju jeni të ngushtë në zemrat tuaj. <sup>13</sup> Por në shkëmbim po ju flas si fëmijve, bëhuni të gjërë edhe ju.

**6:11** Dy foljet janë të dyja në kohën e përkryer. Pali ka ndarë të vërtetën e plotë dhe tërësore të ungjillit dhe nënkuptimet e saj me besimtarët korintas duke qënë plotësisht i hapur dhe me sinqeritet të plotë.

▣ **“o Korintas”** Ky është i vetmi nga tri vende në shkrimet e Palit ku ai personalisht i drejtohet në veçanti kishës së cilës po i shkruan (shih Gal. 3:1; Fil. 4:15). Të gjithë këta pasazhe tregojnë intensitetin e zemrës së apostullit.

#### 6:12

NASB	“Ju nuk jeni të ngushtuar nga ne”
NKJV	“Ju nuk jeni të kufizuar nga ne”
NRSV	“Nuk ka asnjë kufizim”
TEV	“Nuk jemi ne që kemi mbyllur zemrat tona ndaj jush”
NJB	“Çfarëdo shtrëngimi që të ndjeni nuk është nga ana jonë”

Forma emërore e kësaj foljeje përdoret tek 2 Kor. 6:4 dhe 12:10 (shih Rom. 2:9; 8:35). Ai i referohet drejtpërdrejt diçkaje ose dikujt të mbledhur bashkë në një vend të ngushtë, dhe prandaj është bërë i imët. Ai përdoret metaforikisht për “ngushtica”, “imët” ose “pikëllim” (shih 2 Kor. 4:8; 6:12).

NASB, NKJV, NRSV “sëmundje”  
 TEV “ngushtë në zemrat tuaja”  
 NJB “pikëllim”

Kjo është një metaforë e Dhjatës së Vjetër nga “zorë”. Njerëzit në antikitet mendonin se organet e brendshme të ulëta ose organet kryesore (dmth., zemra, mëlçia, mushkритë) ishin vendi i emocioneve (shih Septuaginta Fjalët e Urta 12:10; 26:22; Jer. 28:13,51; II Macc. 9:5-6; IV Macc. 10:8; Baruch 2:17). Pali e përdor këtë metaforë shpesh (shih 2 Kor. 6:12; 7:15; Fil. 1:8; 2:1; Kol. 3:12; Filemoni 1:7,12,20).

6:13

NASB “Tani si në një shkëmbim”  
 NKJV “Tani në shkëmbim për të njëjtën gjë”  
 NRSV “Në kthim”  
 NJB “Në një shkëmbim të drejtë”

Në këtë frazë fjala kryesore është *antimisthia*, e cila është termi *misthos* (dmth., kompensim i bazuar mbi atë që një person meriton, shih 1 Kor. 3:8,14; 9:17-18; 1 Tim. 5:18) plus parashtesa *anti*. Kjo formë gjendet vetëm këtu dhe tek Rom. 1:27.

Ky term mund të përdoret në një kuptim pozitiv ose negativ; konteksti duhet ta përcaktojë. Tek Rom. 1:27; është negativ, por këtu duket se përdoret pozitivisht në kuptimin e Gal. 4:12.

▣ “fëmijve” Pali, sikurse Gjoni, iu drejtohet atyre që janë konvertuar prej tij si fëmijë (shih 1 Kor. 4:14,17; Gal. 4:19; 1 Tim. 1:2,18; 2 Tim. 1:2; 2:1; Tit 1:4; Filemoni 1:10).

▣ “bëhuni të gjërë edhe ju” Ndërsa Pali zgjeron zemrën e tij që t’i përfshijë ata, sado të përçarë dhe kundërshtues që kanë qënë, ai me sinqeritet dëshiron që ata t’ia kthejnë në mënyrë reciproke. Kjo është një formë urdhërore aoriste pasive. Vini re idenë pasive që ata nuk mund ta bëjnë vetë, por ata duhet të lejojnë Perëndinë që ta bëjë.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 6:14-18

<sup>14</sup> Mos hyni në një zgjedhë bashkë me të pabesët, sepse ç’lidhje ka drejtësia me paudhësinë? Dhe çfarë afrie ka drita me terrin? <sup>15</sup> Dhe ç’harmonie ka Krishti me Belialin? Ose ç’pjesë ka besimtari me jobesimtarin? <sup>16</sup> Dhe çfarë marrëveshje ka tempulli i Perëndisë me idhujt? Sepse ju jeni tempulli i Perëndisë së gjallë, sikurse tha Perëndia: “Unë do të banoj në mes tyre, dhe do të ec ndër ta; do të jem Perëndia i tyre dhe ata do të jenë populli im.” <sup>17</sup> Prandaj “dilni nga mesi i tyre dhe ndahuni prej tyre, thotë Zoti, dhe mos prekni asgjë të ndyrë, dhe unë do t’ju pranoj, <sup>18</sup> dhe do të jem si një Atë për ju, dhe ju do të jeni për mua si bijtë e bijat, thotë Zoti i Plotfuqishëm.”

6:14

NASB “Mos u lidhni bashkë me jobesimtarët”  
 NKJV “Mos hyni në një zgjedhë të pabarabartë bashkë me jobesimtarët”  
 NRSV “Mos jini të keqpërputhur me jobesimtarët”  
 TEV “Mos u përpiqni të punoni së bashku si të barabartë me jobesimtarët”  
 NJB “Mos hyni në një takëm në një skuadër të barabartë me jobesimtarët”

Pali shpesh përdor citime bujqësore të Dhjatës së Vjetër për të ilustruar të vërteta të krishtera (shih 1 Kor. 9:9; 1 Tim. 5:18), për të reflektuar Ligjin e Përt. 22:10. Kjo është një formë urdhërore e tashme me një pjesëz mohuese, e cila nënkupton se “ata po formonin” këto marrëdhënie ndërpersonale të papërshtatshme, intime me jobesimtarët. Termi grek është një përbërje e “zgjedhë” (*zugeō*) dhe “një tjetër i një lloji tjetër” (*heteros*, dmth., lloje të ndryshme kafshësh). Ky varg është nxjerrë nga konteksti në lidhje me besimtarët që martohen me jobesimtarët. Megjithatë, ky tekst nuk duket se trajton specifikisht martesën, edhe pse kjo sigurisht përfshihet në këtë pohim më të gjërë. Besimtarët duhet që t’i kufizojnë marrëdhëniet e tyre më intime dhe personale me vëllezër besimtarë. Kjo na ndihmon të luftojmë tërheqjen e kulturës së rënë për të na çuar larg nga Krishti. Besimi në Jezusin dhe Fryma

që banon në ne ka shkaktuar një copëtim të ashpër dhe të thellë brenda familjeve, bizneseve, hobeve, argëtimeve dhe madje kishave.

Duhet marrë parasysh pasazhe si 1 Kor. 5:9-13; 7:12-16; 10:27 që të nxjerrin ekuilibrin teologjik të kësaj të vërtete. Ne duhet të mbajmë mend ligësinë e kulturës pagane të shekullit të parë. Ky nuk është një konfirmim i jetesës prej murgu, por një përpjekje për të reduktuar marrëdhënien personale intime me sistemin botëror të rënë (shih 1 Gjonit 2:15-17).

▣ **“ç’lidhje ka drejtësia me paudhësinë”** E njëjta e vërtetë përsëritet në letrën ciklike të Efesianëve (shih 2 Kor. 5:7,11). Kontrasti i Palit i drejtësisë me paudhësinë tregon qartazi se në këtë kontekst drejtësia nuk i referohet drejtësisë së numëruar (shih Romakëve 4; Galatasve 3), por jetesës së drejtë (shih Mat. 6:1). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA / SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS tek 1 Kor. 1:30.

▣ **“afrie”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9.

## 6:15

NASB, NKJV **“Belial”**

NRSV, NJB **“Beliar”**

TEV **“Djali”**

Ky është një term hebraik (dmth., *beli* dhe *ya'al*, shih BDB 116) etimologjia e të cilit është disi në dyshim. Beliar është një variant gërmëzimi nga disa shkrime hebraike. Sfondet e mundshme janë:

1. Pavlefshmëri (dmth., një përshkrim i njerëzve të këqij, shih Ligji i Përt. 13:13; 2 Sam. 23:6; 1 Mbret. 21:10,13)
2. Paudhësi (shih 2 Sam. 22:5)
3. Vendi nga ku nuk ka kthim prapa (dmth., *Sheol*, shih Ps. 18:4)
4. Një tjetër term për Satanin (shih Nahum 1:15; Jubilees 1:20; 15:33; dhe dorëshkrimet e mbledhura të Detit të Vdekur [p.sh., IQS 1:18,24; 2:5,19])

**6:16 “Dhe çfarë marrëveshje ka tempulli i Perëndisë me idhujt”** Ky varg duhet të krahasohet me 1 Kor. 3:16, ku kisha lokale quhet tempulli i Perëndisë. Tek 1 Kor. 3:16 nuk ka asnjë nyjë me “tempull” (dmth., *naos*, vetë vendi qëndror i faltores). Përemri “ju” është shumë, ndërsa “tempull” është njëjës, prandaj në këtë kontekst “tempull” duhet t’i referohet të gjithë kishës në Korint (shih Efe. 2:21-22).

Fokusi i besimit hebraik zhvillohet në rritja dhe liturgjinë e tempullit (shih Jeremia 7) në vend të një besimi personal në YHWH. Nuk ka të bëjë me ku apo kur apo si adhurojmë, por **kush** është në marrëdhënie me ne, Perëndia. Jezusi pa trupin e Tij si tempulli i Perëndisë (shih Gjonit 2:21). Jezusi është më i madh se sa tempulli i Dhjatës së Vjetër (shih Mat. 12:6). Veprimtaria e Perëndisë ka lëvizur nga një ndërtesë e shenjtë në një trup të shenjtëruar të besimtarëve (dmth., të shpenguar, të shenjtë).

Idhujt dhe besimtarët diskutohen plotësisht tek 1 Kor. 8 dhe 10:14-22. Këto duhet të jenë përjashtuese ndaj njëra-tjetrës! Jo të gjitha rrugët të shpien në qiell!

▣ **“Perëndisë së gjallë”** Emri i besëlidhjes për Perëndinë e Dhjatës së Vjetër ishte YHWH (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:8), i cili ishte një formë e foljes “të jesh”. Autorët e Dhjatës së Vjetër shpesh përdornin mbiemrin “i gjallë” për të reflektuar Perëndinë që ka ekzistuar gjithnjë, Perëndinë e vetëm që ekziston. Aludimet e Dhjatës së Vjetër tek 2 Kor. 6:16-18 përmbajnë terminologji të besëlidhjes: “Unë do të jem Perëndia i tyre dhe ata do të jenë populli Im” (shih Ezek. 37:27).

Fraza “ec ndër ta” duket se vjen nga Lev. 26:12. Tekstet e Dhjatës së Vjetër tek 2 Kor. 6:16 reflektojnë epokën e re kur YHWH do të banojë në mes të popullit të Tij sikurse kishte për qëllim tek Zanafilla 2 dhe ndodhi përkohësisht dhe pjesërisht gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë, por do të realizohet plotësisht në qiejt e rinj dhe në tokën e re (shih Zbulesa 21-22).

▣ **“tha Perëndia”** Ky është një kombinim i lëshuar i Lev. 26:11-12 dhe Ezek. 37:27 nga Septuaginta. Në këtë kontekst Pali po zbaton këto premtime që janë bërë fillimisht ndaj Izraelit të besëlidhjes tani ndaj kishës që është Izraeli frymëror (shih Rom. 9:6; Gal. 6:16).

**6:17 “dilni... ndahuni”** Këto janë të dyja forma urdhërore aoriste. Këto janë aludime ndaj Isa. 52:11 në Septuagintë. Populli i Perëndisë duhet ta veçojë vetveten nga mëkatarët dhe jobesimtarët se mos ata kapen në gjykimin e tyre (shih Rev. 18:4).

Shpesh sot e dëgjoj këtë varg të cituar në lidhje me cilin denominacion i përket një person. Më lejoni të citoj F. F. Bruce në *Answers to Questions* [Përgjigje ndaj Pyetjeve]: “Përdorimi i këtyre fjalëve për të justifikuar ndarjen ekleziastike midis të krishterëve tregon një dështim grotesk për t’i lexuar ato në kontekstin e tyre” (fq. 103).

▣ **“mos prekni asgjë të ndyrë”** Kjo është një formë urdhërore e tashme e mesme. Besimtarët nuk duhet të marrin pjesë në veprimet mëkatore të kulturave të tyre respektive. Si të shpenguar ne duhet të shfaqim dhe të shpallim zemrën e re dhe mendjen e re të popullit të Perëndisë. Çdo gjë ka ndryshuar në Të!

**6:18** Ky varg reflekton të vërtetën e shumë profetëve, por më plotësisht, të Oseas (ose ndoshta 2 Sam. 7:14). Krishtërimi është një çështje familjare.

▣ **“Zoti i Plotfuqishëm”** Kjo reflekton termin e Dhjatës së Vjetër për Perëndinë, YHWH (shih Eksod. 3:14), dhe *El Shaddai* (shih Eksod. 6:3). Në Septuagintë ajo përkthen frazën “Zot i Ushtrive”. Shih TEMË E VEÇANTË: EMRAT E PERËNDISË / SPECIAL TOPIC: NAMES FOR DEITY tek 1 Kor. 2:8.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 7:1

**<sup>1</sup> Duke i pasur këto premtime, o të dashur, le ta pastrojmë veten nga çdo ndotje e mishit dhe e frymës dhe ta përfundojmë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë.**

**7:1 “Duke i pasur këto premtime”** Kjo është një formë pjesore aktive e tashme. Pali citoi fjalët profetike të Dhjatës së Vjetër nga Perëndia sikur ato të zbatoheshin aktualisht tek Korintasit (shih 2 Kor. 6:2). Dhjata e Vjetër gjithashtu citohet tek 2 Kor. 6:16-18, duke treguar dëshirën e vazhdueshme të YHWH për të pasur një popull i cili reflekton karakterin e Tij. Pali po përpiket t’i motivojë besimtarët korintas që të jetojnë jetë të perëndishme, të veçuara. Ata kanë përjetuar “hirin” (shih 2 Kor. 6:1), tani ata duhet të jetojnë në të. Ky varg është një thirrje për shenjtëri të ngjashme me Krishtin (shih Efe. 1:4; 2:10).

▣ **“o të dashur”** Kjo frazë përdoret tek Mat. 3:17 dhe 17:5 si një titull për Jezusin. Pali përdor po këtë term për të përshkruar ndjekësit e Jezusit (shih 2 Kor. 12:19; 1 Kor. 10:14; 15:58; Rom. 12:19; Fil. 2:12; 4:1). Ky term flet për dashurinë e vendosur të Perëndisë, dashurinë besnike ndaj besëlidhjes (hebraisht, *hesed*; greqisht, *agapē*) me ne në Krishtin, por këtu ajo flet për dashurinë e Palit për këtë kishë të grupuar, arrogante, të përçarë.

▣ **“le ta pastrojmë veten”** Kjo është një formë lidhore aoriste aktive. Koha aoriste është mënyra se si gjuha greke koine konfirmon një veprim. Ajo mund të ketë disa nënkuptime të ndryshme (shih D. A. Carson, *Exegetical Fallacies* [Mangësitë Eksegetike], botimi i dytë, fq. 68-73). Këtu ajo është një thirrje për veprim vendimtar (dmth., forma lidhore nxitëse e përdorur në një formë urdhërore). Mënyra lidhore jep një element kontigjence. Besimtarët duhet të bashkëpunojnë me Perëndinë në shpëtim dhe më pas të bashkëpunojnë në pjekuri.

▣ **“e mishit dhe e frymës”** Kjo flet për të gjithë qenien tonë njerëzore. Shumë njerëz e kanë kundërshtuar që ky varg të jetë origjinal për shkak të përdorimit teknik të Palit të këtyre dy termave në kontekste të tjera. Megjithatë, 2 Kor. 7:5, kur lidhet me 2 Kor. 2:13 (i cili është fillimi dhe fundi i kllapës së zgjeruar të Palit), përdor këtu dy terma në mënyrë sinonime. Pali përdor të njëjtët terma në kuptime të ndryshme (lexoni *A Man in Christ* [Një Njeri në Krishtin] nga James S. Stewart, Harper dhe Row).

▣ **“përfundojmë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë”** Kjo është një formë pjesore aktive e tashme. Është teologjikisht e vërtetë se kur ne shpëtohem, ne jemi menjëherë si të drejtësuar ashtu edhe të shenjtëruar (shih 1 Kor. 1:30, gjithashtu shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTËRIA/SHENJTËRIMI NË DHIATËN E RE / SPECIAL TOPIC: NEW TESTAMENT HOLINESS/SANCTIFICATION tek 1 Kor. 1:2). Kjo flet për pozitën tonë në Krishtin. Megjithatë, ne duhet të jetojmë nën dritën e pozitës tonë. Prandaj, ne jemi të nxitur për të përmbushur thirrjen tonë me shenjtërim progresiv apo ngjashmëri me Krishtin (shih Rom. 8:28-29; Efe. 4:1). Ky është një luftim i vazhdueshëm (shih Romakëve 7). Ndërsa shpëtimi është si një dhuratë e lirë ashtu edhe një

përkushtim i shtrenjtë, po kështu, është edhe shenjtërimi. I njëjti koncept është i vërtetë për besimtarët që janë të thirrur shenjtorë (forma treguese) dhe më pas thirren të jenë të shenjtë (forma urdhërore). Unë nuk besoj në mundësinë e mungesës së mëkatit në këtë jetë, por besoj në përshtatshmërinë e besimtarëve që mëkatojnë gjithnjë e më pak! Ky është tensioni teologjik dhe praktik i shkaktuar nga besimtarët që janë në Mbretëri, por Mbretërinë që nuk konsumohet (shih Fee, Stewart, *How to Read the Bible For All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj], fq. 131-134).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. A na mëson 2 Kor. 6:1 se ne mund ta humbasim shpëtimin tonë?
2. Si mundet të jetojë një i krishterë në mënyrë të tillë që të mos vendosë ndonjë gur pengese përpara të tjerëve?
3. Pse ishte jeta e Palit aq e vështirë?
4. Çfarë do të thotë “ndahuni”?
5. A është shpëtimi plotësisht falas apo na kushton ai gjithçka?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

## 2 KORINTASVE 7:2-16

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
				Një Paralajmërim (6:11-7:4)
Gëzimi i Palit ndaj Pendesës së Kishës 7:2-4	Përgjigja e Korintasve 7:2-12	Gëzimi i Palit 7:2-4	Gëzimi i Palit 7:2-4	7:2-4 Pali në Maqedoni: Atij i Bashkohet Titi
7:5-13a		7:5-13a	7:5-7 7:8-11 7:12-13a	7:5-7 7:8-13a
7:13b-16	Gëzimi i Titit 7:13-16	7:13b-16	7:13b-16	7:13b-16

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 7:2-4

<sup>2</sup> Na pranoni; ne nuk i kemi bërë padrejtësi askujt, nuk kemi korruptuar askënd, nuk ia hodhëm askujt.

<sup>3</sup> Këtë nuk e them për dënim, sepse që më parë ju thashë se jeni në zemrat tona për të vdekur bashkë dhe për të jetuar bashkë. <sup>4</sup> Jam shumë i hapur me ju dhe kam me se të mburrem për ju; jam plot me ngushullim dhe jam jashtë mase i gëzuar në gjithë shtrëngimin tonë.

**7:2 “Bëni vend për ne në zemrat tuaja”<sup>73</sup>** Ky paragraf vazhdon mendimin e 2 Kor. 6:13. Ai është një formë urdhërore aoriste aktive, një urdhërim vendimtar, por me një theks të vazhdueshëm. Pali e përmend po këtë ide tek 2 Kor. 6:13. Ai përdor një antonim 2 Kor. 6:12 (dmth., shtrëngim). Pali dëshiron që ata ta hapin veten e tyre ndaj tij ashtu sikurse ai e hap veten e tij ndaj tyre.

Termi “zemër” tek 2 Kor. 6:11 është një mënyrë për t’iu referuar vetes së tij. Pali bën të njëjtën gjë me “mish” tek 2 Kor. 7:5 dhe “frymë” tek 2 Kor. 7:13b. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 7:5.

<sup>73</sup> Versioni në shqip është: “Na pranoni”. (shënim i përkthyesit)

☐ “ne nuk i kemi bërë padrejtësi askujt, nuk kemi korruptuar askënd, nuk ia hodhëm askujt” Këto janë të gjitha forma treguese aktive aoriste. “Askujt” përsëritet dhe vendoset në çdo frazë për theksim. Këto lidhen me veprimet e mësuesve të rremë ose me akuzat e bëra nga kritikët e Palit kundrejt tij dhe shërbesës së tij (shih 2 Kor. 12:17-18).

☐ “korruptuar” Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:42.

**7:13 “për të vdekur bashkë dhe për të jetuar bashkë”** Forma greke ka: “unë do të vdisja me ju ose do të vazhdoja të jetoja me ju”. Folja e parë është një formë paskajore aoriste e tashme dhe e dyta është një formë paskajore aktive e tashme. Kjo mund t’i referohet 6:1. Pali dëshiron një kishë të pjekur dhe që funksionon në Korint. Nëse ata ndjekin drejtimin e tij dhe autoritetin e tij ata do të japin fryt, por nëse nuk e bëjnë, ata do të ekzistojnë më kot. Gjithashtu është e mundur që kjo të jetë një shprehje kulturore e përkushtimit deri në fund.

**7:4 “siguri”<sup>74</sup>** Shih TEMË E VEÇANTË: GUXIM (PARRËSIA) / Special Topic: Parrhësia tek 2 Kor. 3:12.

☐ “mburrem” Shih studimin e plotë të fjalëve tek 1 Kor. 5:6 dhe Temën e Veçantë tek 2 Kor. 1:12.

☐ “jam plot me ngushëllim dhe jam jashtë mase i gëzuar” Kjo duket se i referohet raportit të Titit tek 2 Kor. 7:6-13a. Pali ishte shumë i ndjeshëm ndaj statusit frymëror të kishave të tij (shih Gal. 4:19). Termi dërrmues (dmth., *hyperperisseuomai*, shih Rom. 5:20) është një formë e intensifikuar e *perisseuō*. Ky term dhe format e tij të lidhura përdoren shpesh nga Pali në letrat e tij ndaj Korintit. See TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul's Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

1. *perissos* / *perissoteros*
  - a. jashtëzakonisht (shih 1 Kor. 12:23,24; 15:10)
  - b. tepri (shih 2 Kor. 2:7; 10:8)
  - c. i tepërt (shih 2 Kor. 9:1)
2. *perissoterōs*, më shumë me tepri (shih 2 Kor. 1:12; 2:4; 7:13,15; 11:23; 12:15)
3. *perisseuō*
  - a. të teprosh (shih 2 Kor. 1:5; 3:9; 9:8,12)
  - b. të pajisësh me tepri me dhunti (shih 1 Kor. 14:12; 2 Kor. 8:7)
  - c. të teprosh në performancë (shih 1 Kor. 15:58)
  - d. tepri në ushqim (shih 1 Kor. 8:8)
  - e. të shkaktosh që të teprojë (shih 2 Kor. 4:14; 9:8)
4. *perisseuma*, supertepri (shih 2 Kor. 8:13,14)
5. *perisseia*, supertepri (shih 2 Kor. 8:2; 10:15)

☐ “në gjithë shtrëngimin tonë” Shih TEMË E VEÇANTË: MUNDIMI / SPECIAL TOPIC: TRIBULATION tek 2 Kor. 1:4.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 7:5-13a

<sup>5</sup> Sepse, kur erdhëm në Maqedoni, mishi ynë nuk pati fare prehje, por u shtrënguam në të gjitha mënyrat: jashtë betejë, përbrenda frikë. <sup>6</sup> Por Perëndia, që ngushëllon të pikëlluarit, na ngushëlloi me ardhjen e Titit, <sup>7</sup> dhe jo vetëm me ardhjen e tij, por edhe me ngushëllimin që ai pati prej jush; ai na tregoi dëshirën tuaj të madhe, lotët tuaj, zellin tuaj për mua, kaq sa u gëzova më tepër, <sup>8</sup> sepse, ndonëse edhe ju kam trishtuar me letrën time, nuk më vjen keq, ndonëse më pati ardhur keq, *sepse* shoh se ajo letër, edhe pse për pak kohë, ju trishtoi. <sup>9</sup> Tani po gëzohem, jo sepse u trishtuat, por sepse u trishtuat për pendim, sepse u trishtuat sipas Perëndisë, që të mos ju bëhet juve ndonjë dëm nga ne. <sup>10</sup> Trishtimi sipas Perëndisë në fakt, sjell pendim për shpëtim, për të cilin njeriut nuk i vjen keq, por trishtimi i botës shkakton vdekje. <sup>11</sup> Në fakt, ja sa kujdes shkaktoi te ju pikëllimi sipas Perëndisë, madje sa fjalë për të kërkuar ndjesë, sa zemëratë, sa druajtje, sa dëshirë të zjarrtë, sa zell, sa kënaqësi! Me çdo mënyrë ju e treguat se jeni të pastër në këtë çështje. <sup>12</sup> Edhe pse ju shkrova, nuk e bëra as për atë që e bëri padrejtësinë, as për atë që e pësoi,

<sup>74</sup> Versioni në shqip është: “ngushëllim”. (shënim i përkthyesit)

**7:5 “Sepse, kur erdhëm në Maqedoni”** Pali i rikthehet vlerësimit të lidhur me raportin e Titit të cilin e nisi tek 2 Kor. 2:13. Gjendet një devijim i mrekullueshëm nga tema i bërë nga Pali midis 2:13 dhe 7:5, ku ai diskuton gëzimet dhe trishtimet e shërbesës apostolike.

▣ **“mishi ynë nuk pati fare prehje”** Pali ishte i tejet i shqetësuar për kishën e tij (shih 2 Kor. 2:12-13, të dyja në forma treguese aktive të përkryera). Mua më ndihmon në mes të shqetësimeve dhe dyshimeve të mia të di se apostulli i madh ndaj johebrenjve ishte aq i rrënuar nga dyshimet e tij në lidhje me rezultatet e qëndrueshme të shërbesës së tij (shih 2 Kor. 6:1).

Pali përdor termin “mish” si një sinonim për vetveten (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26). Ai bën të njëjtën gjë në lidhje me frymën tek 2 Kor. 7:13b (shih paralelizmin tek 2 Kor. 2:13, “prehje në frymën time”), duke iu referuar Titit. Dhjata e Re nuk e mbështet një pikëpamje trinome të njerëzimit. Njerëzimi është një unitet (shih Zan. 2:7). Pali e shpreh këtë unitet shumëdimensional në disa mënyra.

▣ **“por u shtrënguar në të gjitha mënyrat”** Kjo është forma pjesore pasive e tashme. Ky varg është një përmbledhje e shkurtër e problemeve që Pali përmend tek 2 Kor. 1:4-10; 4:7-12; dhe 6:3-10.

▣ **“jashtë betejë, përbrenda frikë”** Që nga koha e Chrysostom, kjo frazë është interpretuar duke iu referuar problemeve mes jobesimtarëve dhe besimtarëve (shih 2 Kor. 11:28). Pali shqetësohej nga planet e Satanit (shih 2 Kor. 11:3; 1 Kor. 7:5)

**7:6 “Por Perëndia, që ngushëllon të pikëlluarit, na ngushëlloi”** Çfarë titulli i mrekullueshëm për Perëndinë – “Ai që vazhdimisht ngushëllon” (forma pjesore aktive e tashme). Shih shënimin e plotë mbi ngushëllimin tek 2 Kor. 1:4-11.

**7:7** Lutjet dhe letrat e Palit kishin qënë efektive. Pjesa më e madhe në kishë ishte përgjigjur në mënyrën e duhur ndaj autoritetit të tij apostolik dhe prezantimit të ungjillit. Ata kishin refuzuar mësuesit imoralë dhe heretikë (shih 2 Kor. 7:8-13a).

#### 7:8

Nasb	“Sepse edhe pse ju shkaktova trishtim”
Nkjv, nrsv	“sepse, ndonëse edhe ju kam trishtuar”
Tev	“sepse edhe nëse... ju kam bërë të trishtuar”
Njb	“kështu tani, edhe pse ju kam stresuar”

Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë.

▣ **“me letrën time”** Kjo duket se i referohet letrës së tretë të Palit ndaj Korintit e cila quhet nga studiuesit “letra e ashpër” (shih 2 Kor. 2:3.4.9). Kjo është një nga dy letrat e humbura, vetëm nëse kapitujt 10-13 janë fragmente të saj.

▣ **“trishtuat... pendim... ndjesë”** Gjenden tri terma shumë të rëndësishëm grekë të përdorur në këtë pasazh për të përshkruar pikëllimin dhe pendesën. Termi i parë (dmth., *lupeō*) është termi i përgjithshëm për “trishtim” ose “pikëllim”. Ai është një term teologjikisht neutral i gjendur dy herë tek 2 Kor. 7:8; tri herë tek 2 Kor. 7:9; dy herë tek 2 Kor. 7:10; dhe një herë tek 2 Kor. 7:11 (shih 2 Kor. 2:2,4,5; 6:10)

Termi pendim (dmth., *metamelomai*), i gjendur dy herë tek 2 Kor. 7:8 dhe i mohuar tek 2 Kor. 7:10, është një term që do të thotë “pas kujdesit”. Kjo duket se nënkupton trishtim mbi pasojat e veprimeve të së shkuarës. Për shembull: (1) ata që nuk u penduan vërtet tek shëmbëlltyra e Jezusit, Mat. 21:29,32; (2) Juda, Heb. 12:16-17; dhe (3) Esau, Mat. 27:3.

Termi i fundit (dmth., *metanoëia*), i gjendur tek 2 Kor. 7:9 dhe 10, është ekstremisht i vështirë teologjikisht. Fjalë për fjalë do të thotë “pas mendjes”. Ai nuk përfshin vetëm një ndryshim në qëndrim, por një ndryshim të veprimit



(shih Mark 1:15; Veprat e Apo. 3:16; 20:21). Shembuj të këtij lloji pendese mund të gjenden tek Mbreti David dhe Apostulli Pjetër.

Pali po i referohet letrës së tij “të dhimbshme”, të cilën ai ia kishte shkruar kishës në Korint. Ai plotësisht dhe vërtetësisht shprehu veten e tij, por ishte i shqetësuar se mos letra kishte shkaktuar trishtim dërrmues në vend që të sillte një pendesë të shëndetshme, që do të rezultonte në një marrëdhënie të ripërtërirë. Ata e kishin detyruar Palin të sillej si një kirurg frymëror në vend të një ati frymëror. Pali iu drejtua veprimeve dhe qëndrimeve të papërshtatshme dhe priste plotësisht që ata të përgjigjeshin siç duhej. Por, sikurse një at disiplinon fëmijët e tij në trishtim, Pali shkroi në trishtim dhe i trembej më së keqes, se ata nuk do të përgjigjeshin në pendesë të vërtetë dhe se marrëdhënia nuk do të ripërtërihej dhe vepra e tij atje do të ishte e kotë (shih 2 Kor. 6:1).

### **TEMË E VEÇANTË: PENDIMI NË DHJATËN E VJETËR [SPECIAL TOPIC: REPENTANCE (OT)]**

Ky koncept është thelbësor, por i vështirë për t’u përcaktuar. Shumica prej nesh e kanë një përcaktim, që vjen nga denominacioni ynë i caktuar. Megjithatë, zakonisht disa fjalëve hebraisht (ose greqisht) u imponohet një përcaktim “i caktuar” teologjik, ndonëse ato nuk e nënkuptojnë në mënyrë të veçantë këtë lloji përcaktimi. Duhet të mos harrojmë se autorët e Dhjatën e Re (me përjashtim të Lukës) ishin autorë hebrej që përdornin fjalë të greqishtes koine; prandaj, vendi nga duhet t’ia nisim janë vetë fjalët hebraisht, të cilat janë veçanërisht dy.

1. *nakhm* (BDB 636, KB 688)

2. *shuv* (BDB 996, KB 1427)

E para, *nakhm*, që në fillim mund të ketë patur kuptimin “marr frymë thellë”, përdoret në disa kuptime.

- a. “pushim” ose “rehat” (p.sh., Zan 5:29; 24:67; 27:42; 37:35; 38:12; 50:21; shpesh përdoret në emra, shih 2 Mbre. 15:14; 1 Kro. 4:19; Neh. 1:1; 7:7; Nahumi 1:1)
- b. “vajtoi” (p.sh. Zan. 6:6, 7)
- c. “ndryshim mendjeje” (p.sh., Eks. 13:17; 32:12, 14; Num. 23:19; Jobi 42:5-6)
- d. “dhembshuri” (p.sh., Ligji i Përt. 32:36)

Vini re se të gjitha këto përfshijnë ndjenja të forta! Thelbi është ky: ndjenja të forta që çojnë në veprim. Ky ndryshim veprimi, shpesh, drejtohet te personat e tjerë, por edhe te Perëndia. Pikërisht ky ndryshim qëndrimi dhe veprimi drejt Perëndisë e mbush këtë fjalë me rëndësi të madhe teologjike. Por, këtu, duhet patur kujdes. Perëndia thuhet se “pendohet” (shih Zan. 6:6, 7; Eks. 32:14; Gjq. 2:18; 1 Sam. 15:11, 35; Psa. 106:45), por kjo nuk vjen nga keqardhja e tij për ndonjë mëkat apo gabim, por përbën një mënyrë letrare për të treguar dhembshurinë dhe përkujdesjen e Perëndisë (shih Num. 23:19; 1 Sam. 15:29; Psa. 110:4; Jer. 4:27-28; Ezek. 24:14). Ndëshkimi i duhur për mëkatin dhe rebelimin falet nëse mëkatari ia kthen vërtet shpinën mëkatit dhe drejtohet te Perëndia. Kjo nënkupton riorientim të jetës.

Fjala e dytë, *shub*, do të thotë “kthehem” (i kthej shpinën, kthehem pas, kthehem drejt). FOLJA *shub* (BDB 996, KB 1427) në thelb do të thotë “kthehem pas” ose “kthehem”. Mund të përdoret në këto kuptime:

1. i kthej shpinën Perëndisë (Num. 14:43; Joz. 22:16,18,23,29; Gjq. 2:19; 8:33; 1 Sam. 15:11; 1 Mbre. 9:6; Jer. 3:19; 8:4).
2. kthehem te Perëndia (1 Mbre. 8:33,48; 2 Kro. 7:14; 15:4; 30:9; Psa. 51:13; 116:7; Isa. 6:10; 10:21,22; 31:6; Jer. 3:7,12,14,22; 4:1; 5:3; Ose. 3:5; 5:4; 6:1; 7:10,16; 11:5; 14:1,2; Amosi 4:6,8,11; vini re veçanërisht Jeremia 7 dhe Amosi 4)
3. Kur YHWH i thotë fillimisht Isaisë se Juda nuk do të/mund të pendohet (shih Isa. 6:10), por jo për herë të parë në këtë libër, ai u bën thirrje që të kthehen tek ai.

Më shumë sesa ndjenjë, pendimi është qëndrim ndaj Perëndisë. Është riorientim i jetës nga vetja njerëzore drejt Tij. Nënkupton gatishmërinë për të ndryshuar dhe për t’u ndryshuar. Nuk nënkupton ndalimin e plotë të mëkatit, por ndalimin e përditshëm nga rebelimi i vetëdijshëm! Pendimi përbën përmbyshjen e rrjedhojave egoiste të Rënies së Zanafillës 3. Tregon se shëmbëllimi dhe ngjasimi i Perëndisë

(Zan. 1:26-27), ndonëse i dëmtuar, tani rikthehet! Bashkësia e njerëzve të rënë me Perëndinë bëhet sërish e mundshme.

Në Dhjatën e Vjetër, pendim do të thotë kryesisht “ndryshim veprimi”, ndërsa në Dhjatën e Re nënkupton kryesisht “ndryshimin e mendjes” (shih Tema e Veçantë: Pendimi [Dhjata e Re]). Të dyja këto janë të domosdoshme për të patur pendimin e vërtetë biblik. Po kështu, duhet të kuptojmë se pendimi është, edhe akt fillestar, por edhe proces i vazhdueshëm. Veprimi fillestar mund të shihet te Marku 1:15; Veprat e Apo. 3:16 dhe 19; 20:21, ndërsa procesi i vazhduar mund të shihet te 1 Gjonit 1:9; Zbulesa 2 dhe 3. Pendimi nuk është fakultativ (shih Luka 13:3,5)!

Nëse është e vërtetë se dy kërkesat e besëlidhjes janë “pendimi” dhe “besimi” (p.sh., Mat. 3:2; 4:17; Marku 1:4,15; 2:17; Luke 3:3,8; 5:32; 13:3,5; 15:7; 17:3), atëherë *nakham* bën fjalë për ndjenjat e forta që shkaktohen kur njeriu pranon mëkatin dhe i kthen shpinën, ndërsa *shub* bën fjalë për kthimin nga mëkati dhe, pastaj, për kthimin drejt Perëndisë (një shembull i këtyre dy veprimeve shpirtërore është Amosi 4:6-11, “ju nuk u kthyet tek unë” [pesë herë] dhe Amosi 5:4, 6, 14, “më kërkoni... kërkoni Zotin... kërkoni të mirën dhe jo të keqen”).

Shembulli i parë madhështor i fuqisë së pendimit është mëkati i Davidit me Batshebën (shih 2 Sam. 12; Psa. 32, 51). Ndonëse kjo pati pasoja të mëvonshme për Davidin, familjen e tij dhe Izraelin, Davidi vetë u rikthye në bashkësi me Perëndinë! Edhe Manasi i lig mund të pendohet dhe të marrë falje (shih 2 Kro. 33:12-13).

Të dyja këto fjalë përdoren në mënyrë paralele te Psa. 90:13. Njeriu duhet ta pranojë mëkatin dhe t’i kthejë shpinën në mënyrë personale dhe të qëllimshme; duhet të ketë dhe dëshirën për të kërkuar Perëndinë dhe drejtësinë e Tij (shih Isa. 1:16-20). Pendimi ka një aspekt njohës, një aspekt personal dhe një aspekt moral. Të tri janë të domosdoshëm për të filluar një marrëdhënie të re me Perëndinë dhe për ta ushqyer këtë marrëdhënie të re. Ndjenja e thellë e penësës kthehet në një përkushtim të vazhdueshëm ndaj Perëndisë dhe për Perëndinë!

## 7:9

NASB	“sepse ju u trishtuat sipas <i>vullnetit të Perëndisë</i> ”
NKJV	“sepse ju u bëtë të trishtë në një mënyrë të perëndishme”
NRSV	“sepse ju ndjetë trishtim të perëndishëm”
TEV	“ai trishtim u përdor nga Perëndia”
NJB	“stresimi juaj ishte i llojit që Perëndia miraton”

Fjalë për fjalë kjo është “sepse u trishtuat sipas Perëndisë”. Ju mund të dalloni pikëpamjet e ndryshme teologjike në përkthime të ndryshme. A e përdor Perëndia trishtimin, dhimbjen, dhe madje edhe ligësinë, për qëllimet e Tij? Disa do të citonin Rom. 8:28 dhe do të thonin “po”. Të tjerë do të citonin Jakobin 1:13,17 dhe do të thonin “jo”. Pali rendit problemet dhe vuajtjet me të cilat ai u përball si një apostull. Ai rendit burimin e tyre tek Efe. 2:2-3 si Satani, sistemi botëror i rënë dhe natyra e rënë adamike e njerëzimit. Perëndia është i gatshëm të falë, të punojë me dhe t’i mirëpresë njerëzit mëkatarë. Ai përdor ligësinë për qëllimet e Tij, por nuk është personalisht i përfshirë në të. Vuajtja dhe problemet shpesh prodhojnë një efekt pozitiv. Në këtë kontekst ajo prodhon pendim (shih 2 Kor. 7:9-11).

▣ “që të mos ju bëhet juve ndonjë dëm nga ne” Kjo është një formë lidhore aoriste pasive. Vini re se gjendet një element kontigjence. Pali dëshironte të ishte një bekim për këtë kishë dhe jo një pengesë në ndonjë mënyrë. Megjithatë, kisha duhet ta pranojë Palin dhe shërbesën e tij.

**7:10 “sjell pendim për shpëtim”** Pendesa është një nga elementët e nevojshëm të shpëtimit. Pendesa u përmend si kërkesë nga Gjon Pagëzori (shih Mat. 3:2), Jezusi (shih Mat. 4:17), Pjetri (shih Veprat e Apo. 2:38), dhe Pali (shih Veprat e Apo. 26:20). Pendimi është kthimi nga mëkati dhe besimi është kthimi tek Krishti; të dyja janë të

domosdoshme (shih Mark 1:15; Veprat e Apo. 3:16,19; 20:21). Unë kam ardhur në pikën që besoj se ka disa kërkesa normative për një shpëtim të pjekur: pendim, besim, pagëzim, bindje, shërbesë dhe qëndrueshmëri. Krishtërimi është një marrëdhënie stili jetese, jo një grup rrathësh nëpër të cilët duhet kërcyer, sepse jeta e përjetshme ka disa karakteristika të dukshme!

Tensioni i besëlidhjes midis një Perëndie Sovran dhe një përgjigjeje njerëzore të kërkuar gjithashtu mund të shihet në këtë sferë të teologjisë për shkak se Veprat e Apo. 11:18 konfirmon se Perëndia e jep pendimin. Shpëtimi mund të shihet biblikisht si i gjithi nga Perëndia dhe megjithatë ai kërkon një përgjigje njerëzore. Ky është paradoksi i një shpëtimi falas dhe një jete të krishterë që kushton gjithçka.

Koncepti i Dhjatës së Re i shpëtimit përshkruhet si një veprim fillestar besimi i ndjekur nga një marrëdhënie besimi në rritje dhe që do të kulmojë në ardhjen e Krishtit. Ky tekst duket se nënkupton një konsumim të ardhshëm. Shih TEMË E VEÇANTË: KOHË FOLJESH NË GREQISHT TË PËRDORURA PËR SHPËTIMIN / Special Topic: Greek Verb Tenses for Salvation tek 1 Kor. 3:15.

■ **“por trishtimi i botës shkakton vdekje”** Kjo fjali ka tri fjalë kyçe që duhet të kuptohen në kontekstin e tyre në Dhjatën e Re.

1. “Trishtimi”. Ky varg përmban të tri fjalët greke për trishtim, pendim, pendesë. Në këtë frazë trishtimi është *lupeō*, që do të thotë pikëllim. Njerëzve iu vjen keq për veprimet e tyre të shkuara, por për arsye egoiste.
2. “Botës”. Kjo është një referencë ndaj shoqërisë njerëzore të organizuar dhe që funksionon e ndarë nga Perëndia. Ky është njerëzimi i rënë!
3. “Vdekje”. Përdorimi i këtij termi është ndoshta paqartësi e qëllimtë. Ai i referohet vdekjes frymërore (shih Zanafilla 3) dhe vdekjes fizike (shih Zanafilla 5).

**7:11** Trishtimi i perëndishëm (dmth., *lupeō*) prodhon rezultate frymërore (dmth., pendesë të vërtetë, *metanoē* dhe frytet e saj). Rezultatet e perëndishme renditen tek vargu 11.

■ **“çfarë hakmarrje ndaj së keqes”<sup>75</sup>** Termi fjalë për fjalë është “hakmarrje”, por ajo përdoret në kuptimin e dhënies së drejtësisë. Ka pasur disa ndryshime në mendim mes studiuesve se kujt saktësisht i referohet ky varg. Disa pohojnë se (1) i referohet 1 Kor. 5:5, ndërkohë që të tjerë besojnë se (2) i referohet grupimeve apo mësuesve të rremë (shih 2 Kor. 7:12).

**7:12** Vargu 12 duket se është një shprehje hebraike krahasimi, jo një pohim mohues (shih *The Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik Xherom], fq. 283).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 7:13b-16

<sup>13b</sup> për shkak të ngushëllimit tuaj dhe u gëzuam aq më tepër për gëzimin e Titit, sepse fryma e tij u shlodh nga ju të gjithë. <sup>14</sup> Prandaj, në qoftë se u mburra për ndonjë gjë tek ai për ju, nuk u turpërova por, ashtu si ju kemi treguar të gjitha gjërat me vërtetësi, kështu edhe mburrja jonë te Titi doli e vërtetë. <sup>15</sup> Dhe ai ka një dashuri të madhe për ju, kur kujton bindjen e ju të gjithëve dhe si e pritët atë me frikë dhe me të dridhura. <sup>16</sup> Gëzohem, pra, që në çdo gjë mund të besoj në ju.

**7:13b “u gëzuam aq më tepër për gëzimin e Titit, sepse fryma e tij u shlodh nga ju të gjithë”** Kisha e trajtoi Titin mirë (dmth., ai u rifreskua / shlodh, forma treguese pasive e përkryer). Dukshëm Pali ishte i shqetësuar për këtë për shkak të trajtimit që kishte marrë Timoteu më parë.

Vini re se Pali po përdor “frymë” si një sinonim për personin e Titit, jo thjesht një aspekt (dmth., trupi, shpirti, fryma, shih *Elwell's Evangelical Dictionary of Theology* [Fjalori Ungjillor i Teologjisë i Elwell], fq. 676-680). Shih shënimin e plotë mbi “frymë” tek 2 Kor. 4:13.

Për “shumë më tepër” shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

**7:14 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga pikëpamja e autorit ose për qëllimet e tij letrare. Pali i ishte mburrur Titit për kishën korintase.

<sup>75</sup> Versioni në shqip është: “sa kënaqësi”. (shënim i përkthyesit)

▣ “**mburra**” Shih TEMË E VEÇANTË: MBURRJA / Special Topic: Boasting tek 1 Kor. 5:6.

▣ “**me vërtetësi**” Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 13:8.

**7:15 “dashuri”** Kjo është fjalë për fjalë termi grek, *splagchna*. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 6:12.

▣ “**të madhe**” Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

▣ “**kur kujton bindjen e ju të gjithëve**” Kjo është një formë pjesore e mesme e tashme (dmth., Moulton tek *Analytical Greek Lexicon Revised* [Leksikoni Grek Analitik i Rishikuar], fq. 24) ose një formë pjesore pasive e tashme (dmth., Friberg tek *Analytical Greek New Testament* [Dhjata e Re Greke Analitike], fq. 562). Mënyra se si kisha trajton shërbëtorët e Perëndisë tregon diçka rreth tyre (shih 1 Kor. 16:16; 1 Thes. 5:12; Heb. 13:17).

**7:16** Ky pohim përmbyll këtë njësi letrare (shih 2 Kor. 2:14-7:16) me një shënim të sigurisë së besimit.

▣ “**besoj**” Shih shënimin tek 2 Kor. 5:6.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse ishte raportimi i Titit aq i rëndësishëm për Palin?
2. Përkufizoni tri fjalët e ndryshme për “trishtim” të gjendura tek vargjet 8-11 dhe lidhni rëndësinë e tyre teologjike.

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

## 2 KORINTASVE 8

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Të Japësh Lirshëm	Të Shkëlqesh në Dhënie	Mbledhja për Lehtësimin e Kishës Jeruzalem (8:1-9:15)	E Dhëna e Krishterë	Pse Korintasit Duhet të Jenë Zemërgjerë
8:1-7	8:1-7 Krishti Modeli Ynë	8:1-7	8:1-7	8:1-15
8:8-15	8:8-15	8:8-15	8:8-9 8:10-12 8:13-15	
Titi dhe Shoqëruesit e Tij	Mbledhje për Shenjtorët Judenj		Titi dhe Shoqëruesit e Tij	Delegatët e Rekomanduar tek Korintasit
8:16-24	8:16-24	8:16-24	8:16-19 8:20-21 8:22-24	8:16-9:5

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Kapitujt 8 dhe 9 formojnë një njësi letrare të lidhur me pjesën korintase në kontributin e kishave johebraike për të varfërit e kishës në Jeruzalem (shih 1 Kor. 16:1-3).
- B. Sfondi lidhur me dhuratën e Palit ndaj kishës Jeruzalem
  - a. Tek Veprat e Apo. 11:27-30 kisha në Antioki nisi programin e lehtësimit të punës për Jeruzalemin. Ishte një mënyrë për të bashkuar kishat hebraike dhe johebraike.
  - b. Tek Gal. 2:10 dhe 6:10 Pali nisi një theks të ngjashëm në veprën e tij të hershme të misionit.
  - c. Tek 1 Kor. 16:1-4 tregohet se ky kontribut kishte nisur tashmë në Korint.
  - d. Tek Rom. 15:26 përmenden kontributet si të Maqedonisë dhe të Akaisë.
- C. Argumenti i përgjithshëm i Palit në lidhje me dhënien e krishterë
  - a. Shembulli i të tjerëve (maqedonasve) 2 Kor. 8:1-5
  - b. Dhënia është një aspekt i rritjes frymërore, 2 Kor. 8:7-8

- c. Shembulli i Krishtit, 2 Kor. 8:9; 9:15
- d. Vetë nisja e tyre, 2 Kor. 8:6,10
- e. Inkurajimi për të vendosur dëshirat në veprim, 2 Kor. 8:10
- f. Motivi, dhe jo shuma, është thelbësore, 2 Kor. 8:12
- g. Të japësh në mënyrë të barabartë, 2 Kor. 8:14

- D. Udhëzime të Dhjatës së Re për të dhënët e krishterë bazuar në modelin e kishave të Maqedonisë
- a. Plot gëzim dhe sinqeritet, edhe në mes të varfërisë, 2 Kor. 8:2; 9:7
  - b. Dha në maksimumin e mundësive, 2 Kor. 8:3
  - c. Dha në mënyrë sakrifikuese përtej aftësisë, 2 Kor. 8:3,12
  - d. Dha falas, 2 Kor. 8:3; 9:7
  - e. Dha me sinqeritet, 2 Kor. 8:4
  - f. Dha më shumë se sa para, 2 Kor. 8:5

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 8:1-6

<sup>1</sup> Tani, o vëllezër, ju bëjmë të ditur hirin e Perëndisë, që u është dhënë kishave të Maqedonisë, <sup>2</sup> se, në mes të shumë sprovave pikëllimi, mbushullia e gëzimit të tyre dhe varfëria e tyre e thellë e treguan në pasuritë e dorëgjërësinë e tyre. <sup>3</sup> Sepse unë dëshmoj se *ata kanë dhënë* me dëshirë dhe sipas mundësisë së tyre, madje edhe përtej mundësisë së tyre, <sup>4</sup> dhe na u lutën, pa na u ndarë, ta pranojmë dhuratën dhe pjesëmarrjen në ofertën për shenjtoret. <sup>5</sup> Dhe jo vetëm vepruan ashtu si shpresonim, po dhanë veten më përpara te Perëndia dhe pastaj te ne sipas vullnetit të Perëndisë. <sup>6</sup> Kështu ne e këshilluam Titin që, ashtu si e nisi këtë vepër të hirit midis jush, ashtu ta përfundojë.

**8:1 “hirin e Perëndisë”** Kjo fjalë “hir” (*charis*) përdoret më shumë se dhjetë herë në kapitujt 8 dhe 9. Ajo përdoret në kuptimin e

1. Dashuria e pamerituar e Perëndisë në Krishtin, 2 Kor. 8:1,9; 9:8,14
2. Favor / privilegj, 2 Kor. 8:4
3. Ofrimi për Jeruzalemin, 2 Kor. 8:1,6,7,19
4. Falenderime, 2 Kor. 8:16; 9:15

Vini re se hiri kuptohet si t’i referohet dashurisë së pamerituar të Perëndisë në Krishtin ose si një mënyrë për t’iu referuar kontributit nga kishat johebraike të Palit ndaj kishës mëmë në Jeruzalem. Termi grek ka një fushë të gjerë semantike.

▣ **“kishave të Maqedonisë”** Kjo i referohej Filipisë, Thesalonikës dhe Bereas (shih Veprat e Apo. 16-17). Kishte një ndjesi kulturore të konkurrencës midis Akaisë dhe Maqedonisë. Shih TEMË E VEÇANTË: KISHA (*EKKLESIA*) / Special Topic: Church tek 1 Kor. 1:2.

**8:2 “se, në mes të shumë sprovave pikëllimi”** Ne shohim pak nga ky persekutim nga Veprat e Apo. 17:1-15 dhe 1 Thes. 1:6; 2:14. Gjenden dy fjalë greke që përkthehen “sprovë”, “test” ose “tundim” (këtu “sprovë”). Njëra i referohet një testi me pikëpamje drejt shkatërrimit, ndërsa tjetra i referohet një testi me një pikëpamje drejt aprovimit (shih 2 Kor. 8:2,8,22; 9:13). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13.

Për “pikëllim” shih TEMË E VEÇANTË: MUNDIMI / SPECIAL TOPIC: TRIBULATION tek 2 Kor. 1:4.

▣ **“mbushullia e gëzimit të tyre”** Është kaq befasuese që kjo frazë shfaqet midis “në mes të shumë sprovave pikëllimi” dhe “varfëria e tyre e thellë”. Ky gëzim në mes të rrethanave të vështira është një karakteristikë e besimtarit (shih Mat. 5:10-12; Rom. 5:3; Jakobi 1:2). Gëzimi është një fryt i Frymës (shih Gal. 5:22) dhe nuk ka lidhje me rrethanat!

Për përdorimin e përsëritur të Palit të “tepri” apo “derdhet” shih shënimin tek 2 Kor. 1:5.

▣ **“varfëria e tyre e thellë e treguan në pasuritë e dorëgjërësinë e tyre”** Termi “varfëri” (dmth., *ptōchos*) është një term shumë i fortë grek i përdorur për (1) varfërinë ekstreme në Septuagintë tek Ligji i Përt. 8:9; Gjyq. 6:6;

14:15 (2) Iypësit (shih 2 Kor. 6:10; Rom. 15:26; Zbu. 2:9; 3:17). Ata nuk jepnin nga tepria. Ata i besonin Perëndisë se do të siguronte për nevojat e tyre (shih Mark 12:42; Luka 21:2). Në këtë kontekst “varfëria e tyre e thellë” duket se lidhet me persekutimin që iu bëhej atyre për ungjillin (shih 2 Kor. 8:13-18).

■ **“lirisë”<sup>76</sup>** Kuptimi rrënjësor i këtij termi është “një-mendësia”, që mund të nënkuptojë “i pastër” ose “i sinqertë” (shih Septuagintën 2 Sam. 15:11; 1 Kro. 29:17). Por, ai përdoret në Dhjatën e Re (dmth., termi vetëm në shkrimet e Palit) në kuptimin e “lirisë” ose “zemërgjerësisë” (shih 2 Kor. 9:11,13). *Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik Xherom] (fq. 284) mendon se fjala reflekton kuptimin hebraik që do të thotë “perfeksion” ose “integritet” dhe prandaj, i referohet pastërtisë së qëllimeve. Qëllimi për dhënien tonë është kyç (shih 2 Kor. 8:12). Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:12.

**8:3** Pali e kishte parë drejtpërdrejt varfërinë e tyre.

<b>NASB</b>	<b>“ata dhanë me dëshirën e tyre”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“ata ishin lirshëm të gatshëm”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“ata dhanë në mënyrë vullnetare”</b>
<b>TEV</b>	<b>“nga vullneti i tyre i lirë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“ishte sipas dëshirës së tyre”</b>

Ky term është nga *autos* dhe *haireomai*, që do të thotë “zgjedhje vetiake”. Ai përdoret si tek 2 Kor. 8:3 ashtu edhe tek 17. Termi rrënjësor ka ngjyrimin e shtuar të të zgjedhurit me gëzim ose dashuri (shih Mat. 12:18, që është një citim nga Kënga e Shërbëtorit e Isa. 42:1-3). Ai përdoret tek (1) II Maccabees 6:19 dhe III Maccabees 6:6; 7:10 dhe (2) papirusët në gjuhën koine nga Egjipti të dikujt që vepronte sipas vullnetit të tij të lirë.

*A Handbook on Paul's Second Letter to the Corinthians* [Një Udhëzues mbi Letrën e Dytë të Palit ndaj Korintasve] nga Roger L. Omanson dhe John Ellington tregon se si përkthimet në anglisht ndryshojnë nga ana gramatikore mbi cilën fjali të nënrenditur i bashkangjisin kësaj fraze.

“Këto fjalë mund të konsiderohen si një pjesë e fjalisë që paraprin, se maqedonasit jepnin nga vullneti i tyre i lirë (kështu tek RSV, NRSV, NJB, SPCL), ose ndaj fjalisë që vijon në vargun 4, që thotë se, sipas vullnetit të tyre të lirë ata lypnin për të marrë pjesë në mbledhje (kështu tek TEV, NIV, REB, NJB, TNT, FRCL). Interpretimi i dytë ndjek pikëzimin e UBS *Greek New Testament* [Dhjata e Re Greke] dhe ka më shumë mundësi të jetë i sakti” (fq. 142).

**8:4 “pa na u ndarë”** Shih shënimin e plotë mbi këtë frazë tek 2 Kor. 1:4-11.

■ **“ta pranojmë dhuratën dhe pjesëmarrjen”** Për “favor / dhuratë” shih shënimin tek 2 Kor. 8:1. Termi “pjesëmarrje” (dmth., *koinōnia*) përdoret shpesh nga Pali në letrat e tij korintase në disa kuptime, por që kanë lidhje me njëri-tjetrin. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9.

1. Marrëdhënie personale, intime, të afërta (termi i lidhur *koinōneō* shpesh përdoret për nisjen në fe misterioze)
  - a. Me Birin, 1 Kor. 1:9
  - b. Me Frymën, 2 Kor. 13:14
  - c. Jo me të keqen, 2 Kor. 6:14
  - d. Titë dhe Pali në shërbesë, 2 Kor. 8:23
2. Zemërgjërësi (termi i lidhur *koinōnikos* do të thotë të ndash lirshëm të mirat që ke), 2 Kor. 9:13
3. Pjesëmarrje në diçka
  - a. 1 Kor. 10:16 (dmth., gjaku i Krishtit)
  - b. 2 Kor. 8:4 (dmth., në kontribut për shenjtorët e varfër në Jeruzalem)
  - c. 2 Kor. 1:7 (dmth., në vuajtje)

Gjendet një lojë e dukshme fjalësh midis pjesëmarrje (*koinōnia*) dhe mbështetje (ose shërbesë, *diakonia*). Kjo fjalë për shërbesë përdoret kaq shpesh tek 2 Korintasve.

1. *diakonos* (shërbëtor), 2 Kor. 3:6; 6:4; 11:15,23
2. *diakoneō* (të shërbesh), 2 Kor. 3:3; 8:19,20

<sup>76</sup> Versioni në shqip është: “mundësisë”. (shënim i përkthyesit)

3. *diakonia* (shërbesë), 2 Kor. 3:7,8,9; 4:1; 5:18; 6:3; 8:4; 9:1,12,13; 11:8  
Krishtërimi është shërbim. Ne shpëtohem për të shërbyer!

▣ “në mbështetje<sup>77</sup> për” Shih shënimin tek 1 Kor. 16:1.

▣ “shenjtorët” Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË / SPECIAL TOPIC: SAINTS tek 1 Kor. 1:2.

**8:5 “po dhanë veten më përpara te Perëndia dhe pastaj te ne sipas vullnetit të Perëndisë”** Kujdesi përfshin gjithçka që ne jemi dhe kemi. Nëse ju jepni veten tuaj tek Zoti atëherë nuk mbetet asgjë tjetër për të dhënë! Kujdesi i krishterë është një termometër i pjekurisë sonë frymërore. Besimtarët janë pronarë të asgjëje dhe kujdestarë të Perëndisë në çdo gjë. Kjo e vërtetë është ndonjëherë më e lehtë për njerëzit e varfër që të kuptohet dhe që të binden se sa për njerëzit e pasur.

**8:6 “Titin”** Në *Paul: Apostle of the Heart Set Free* [Pali: Apostulli me Zemrën e Çliruar], F. F. Bruce komenton mbi teorinë se kapitujt 10-13 janë një segment i një letre të mëparshme, “por kjo duket e pamundur nga vargu 12:18, i cili duket se qartazi i referohet sërish vargjeve 8:6,16-19” (fq. 274 shënim 51).

▣ “këtë vepër të hirit” Kjo i referohet kontributit nga kishat johebraike të Palit ndaj të varfërve në kishën mëmë në Jeruzalem (shih 1 Kor. 16:1-4; Rom. 15:26). Në *Jesus and the Rise of Early Christianity* [Jezusi dhe Ngritja e Krishtërimin të Hershëm], Paul Barnett bën një argument mbi varietetin e termave që Pali përdori për të përshkruar këtë ofrim dashurie për besimtarët e varfër në Jeruzalem.

“Thirrja karakterizohet nga fjalori i vet: ‘kontributi për shenjtorët’ (1 Kor. 16:1); ‘dhurata’ (1 Kor. 16:3); ‘hiri’ (2 Kor. 8:6, 7, 9; 9:14); ‘shërbesa’ (2 Kor. 9:12; shih Rom. 15:27) dhe ‘marrëdhënia’ (2 Kor. 8:4; 9:13; Rom 15:26)” (fq. 344).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 8:7-15

<sup>7</sup> Por sikurse ju jeni të pasur në çdo gjë, në besim, në fjalë e në dituri, në çdo kujdes dhe në dashurinë tuaj ndaj nesh, përpiquni të pasuroni edhe në këtë vepër të hirit. <sup>8</sup> Këtë nuk e them si urdhër, por që me anë të kujdesit të të tjerëve të vë në sprovë sinqeritetin e dashurisë suaj. <sup>9</sup> Sepse ju e njihni hirin e Zotit tonë Jezu Krisht, i cili, duke qenë i pasur, u bë i varfër për ju, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së Tij. <sup>10</sup> Lidhur me këtë po ju jap një këshillë, sepse kjo është e dobishme për ju, që vjet filluat jo vetëm ta bëni, por edhe ta dëshironi. <sup>11</sup> Tani përfundojeni edhe bërjen që, ashtu si *qe* dëshira për të dëshiruar, kështu të jetë edhe për ta përfunduar sipas mundësive që keni. <sup>12</sup> Sepse, në qoftë se ekziston gatishmëria për të dhënë, ai është i mirëpritur sipas asaj që ka dhe jo sipas asaj që nuk ka. <sup>13</sup> Por jo që ju të shtrëngoheni që të lehtësohen të tjerët, <sup>14</sup> por të ndiqet vetëm një kriter barazimi; që tani mbushullia juaj të plotësojë nevojat e tyre, kështu që edhe mbushullia e tyre të plotësojë nevojat tuaja, që të ketë barazi, <sup>15</sup> sikurse është shkruar: “Ai që *mblodhi* shumë, nuk mori më shumë dhe ai që *mblodhi* pak, nuk mori më pak.”

**8:7 “Por sikurse ju jeni të pasur në çdo gjë”** Vini re se lista (dmth., besimi, e folura, njohuria, sinqeriteti, dashuria) nuk lidhen me pasuritë materiale. Ne nuk japim për të marrë më shumë gjëra për veten tonë. Ne teprojmë në Të (shih 1 Kor. 1:5). Ai siguron gjithçka që kemi nevojë (shih 2 Kor. 9:8).

▣ “teproni<sup>78</sup>” Ky term përdoret dy herë në këtë varg. I pari është në formën treguese aktive të tashme, ata po tepronin në bekimet e ungjillit. I dyti është në formën lidhore aktive të tashme, që shton një shënim pasigurie. Sikurse ata kishin tepruar në përfitimet e Besëlidhjes së Re, ata duhet të teprojnë në përgjegjësi. Ndhima e tyre për të varfërit në kishën në Jeruzalem është një nga këto “vepra të hirshme”.

NASB “në dashurinë që ne frymëzuar në ju”

NKJV, TEV “në dashurinë tuaj për ne”

NRSV “në dashurinë tonë për ju”

<sup>77</sup> Kjo pjesë mungon tek versioni në shqip. (shënim i përkthyesit)

<sup>78</sup> Versioni në shqip është: “pasuroni”. (shënim i përkthyesit)



## NJB “dhe dashuria për ne gjithashtu”

Këto përkthime zbulojnë variantin në greqisht.

1. “në dashurinë tonë për ju” (NRSV) nga MSS P<sup>46</sup>, B
2. “në dashurinë tuaj ndaj nesh” (NKJV, TEV, NIV) nga MSS א, C, D, F, G
3. NASB ndjek opsionin numër 1, por e ndryshon paksa fokusin, “dashuria që ne frymëzuar në ju”
4. UBS<sup>4</sup> vendos opsionin numër 1 në tekst, por i jep atij një vlerësim “C”.

I njëjti konfuzion përemrash shihet tek variantet në greqisht tek 2 Kor. 8:9.

**8:8 “Këtë nuk e them si urdhër”** Urdhërat janë të papërshtatshëm dhe jo të frytshëm në zonën e kujdesit të krishterë. Qëllimet e duhura janë thelbësore në këtë sferë të jetës së krishterë.

TEMË E VEÇANTË: TË JAPËSH TË DHJETËN (SPECIAL TOPIC: TITHING) tek 1 Korintasve 16:2.

NASB	“për të provuar përmes sinqeritetit të të tjerëve, sinqeritetin e dashurisë suaj gjithashtu”
NKJV	“por unë po vë në sprovë sinqeritetin e dashurisë suaj me anë të kujdesit të të tjerëve”
NRSV	“por unë po vë në sprovë pastërtinë e dashurisë suaj përkundrejt sinqeritetit të të tjerëve”
TEV	“por duke treguar se sa të etur janë të tjerët për të ndihmuar, unë po përpiqem të gjej se sa e vërtetë është vetë dashuria juaj”
NJB	“por duke testuar pastërtinë e dashurisë suaj kundrejt kujdesit të tjerëve”

Pali po sfidon kishat akaike që të ndjekin udhëheqjen e kishave maqedonase (shih 2 Kor. 8:1-5) përmes vizitës së Titit (shih 2 Kor. 8:6,16-24).

☐ “vë në sprovë” Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13.

**8:9 “hirin”** Shih shënimin tek 2 Kor. 8:1.

☐ “e Zotit tonë Jezu Krisht” Shih shënimin tek 2 Kor. 1:2.

☐ “i cili, duke qenë i pasur” Kjo i referohet lavdisë para-ekzistuese të Jezus Krishtit (shih Gjoni 1:1; 8:56-59; 16:28; 17:5,24; 2 Kor. 8:9; Fil. 2:6-7; Kol. 1:17; Heb. 1:3; 10:5-8; 1 Gjoni 1:1).

☐ “u bë i varfër për ju” Ky është një theks i mishërimit të *Logos* paraekzistues në grazhdin në Betlehem. Ai u lind tek një vajzë fshati, e re, virgjëreshë, në jetën e një marangozi fshati, por Ai ishte Perëndia në formën njerëzore (shih George Ladd, *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], fq. 241-242).

☐ “që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së Tij” Pali po përdor mishërimin e Jezusit në dy mënura.

1. Ai erdhi të vdesë në vendin tonë për mëkatet tona (shih Mark 10:45).
2. Ai erdhi të na japë një shembull që të ndjekim (shih 1 Gjoni 3:16).

Ky mendim i mrekullueshëm është paralel me 9:15. Kjo kishë mendonte se ata ishin tashmë të pasur (shih 1 Kor. 4:8). Tani përkufizimi i vërtetë i pasurisë është qartazi pasuri frymërore dhe e orientuar drejt shërbesës, nuk është vetë-kërkuese apo intelektuale, apo materialiste.

**8:10 “unë ju jap opinionin tim<sup>79</sup>”** Edhe pse Pali konfirmon se ky është opinionin i tij, për shkak të komenteve të tij tek 1 Kor. 7:25,40 ky është një pohim autoritativ (dmth., i frymëzuar).

☐ “që vjet filluat” 2 Korintasve u shkrua midis gjashtë dhe tetëmbëdhjetë muaj pas 1 Korintasve (shih 2 Kor. 16:1-4).

<sup>79</sup> Versioni në shqip është: “po ju jap një këshillë”. (shënim i përkthyesit)

**8:11 “Tani përfundojeni edhe bërjen”** Kjo është një formë urdhërore aoriste aktive. Ata ishin një nga kishat e para që fillimisht dëshironin të ndihmonin të varfërit në Jeruzalem. Tani ka ardhur koha ta bëjnë këtë gjë (shih TEV).

NASB, NKJV “gatishmëri”  
NRSV “etje”  
TEV “jini po aq të etur”  
NJB “entuziazëm”

Kjo është fjala në greqisht *prothumia*, që gjithashtu përdoret tek 2 Kor. 8:12 dhe 2 Kor. 8:19 ashtu sikurse tek 9:2. Kuptimi i saj bazë është “gatishmëri, menjëhershëm” (shih Veprat e Apo. 17:11).

▣ **“për ta përfunduar sipas mundësive që keni”** Vini re se Pali i rikthehet kësaj teme sërish. Është kaq befasuese për mua që Pali nuk diskuton kurrë dhënien e rregullt të krishterë. Komentet e tij të vetme në lidhje me “dhënien” lidhen me këtë dhuratë një herë për kishën në Jeruzalem. Ai pranon se një punëtor është i denjë për punësimin e tij dhe se kishat duhet të ndihmojnë misionarët që udhëtojnë, por nuk jep udhëzime të mëtejshme. Besimtarët e Besëlidhjes së Re duhet të jenë të kujdesshëm që të mos nxjerrin konkluzione të Dhjatës së Vjetër duke nxjerr vargjet nga konteksti i Dhjatës së Re (shih *Hard Sayings of the Bible* [Thënie të Vështira të Biblës], fq. 539 shënimi #1). Nëse ne pranojmë se dhënia e të dhjetës është vullneti i Perëndisë, çfarë mund t’i ndalojë të tjerët që të kërkojnë adhurimin sakrifikues apo të Shabatit? Jezusi e përmendi dhënien e të dhjetës kur fliste me një legalist hebre (shih Mat. 23:23; Luka 11:42), por kjo nuk mund të pretendohet të jetë e vetmja provë në Dhjatën e Re që ky rit i Dhjatës së Vjetër është gjithmonë i vlefshëm (shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 8:8). Nuk po përpiqem që të ul atë që besimtarët duhet të japin, por të theksoj udhëzimet e Palit tek 2 Korintasve 8-9 si i vetmi informacion i Dhjatës së Re (gjithashtu shih 1 Kor. 16:2). Besimtarët nuk duhet të jenë të kënaqur kurrë me një standard të Dhjatës së Vjetër! Lexoni sërish Palin (shih Frank Stagg, *New Testament Theology* [Teologjia e Dhjatës së Re], fq. 285-293).

**8:12 “në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Pali supozon se ata ishin gati dhe të gatshëm të jepnin.

▣ **“ai është i mirëpritur sipas asaj që ka dhe jo sipas asaj që nuk ka”** Çelësi për kujdesin e krishterë është qëndrimi dhe motivi ynë, jo shuma apo përqindja (shih Mark 12:41-44).

**8:13-14** Fjala kyçe në këto dy vargje është “barazimi” dhe koncepti kyç është reciprociteti. Familja e Perëndisë duhet të ndihmojë njëri-tjetrin në nevojë (shih Efe. 4:28). Kisha Jeruzalem ka përhapur lajmin e mirë të Krishtit (shih Rom. 15:27). Kishat johebraike mund të ndihmojnë që të sigurojnë për besimtarët e varfër në Jeruzalem. Disa mund të jenë të varfër për shkak të besimit të tyre në Krishtin.

▣ **“shtrëngoheni”** Shih TEMË E VEÇANTË: MUNDIMI / Special Topic: Tribulation tek 2 Kor. 1:4.

**8:15 “sikurse është shkruar”** Kjo formë treguese pasive e përkryer (shprehje hebraike) përdoret për të treguar një citim të Dhjatës së Vjetër. Ajo nënkupton frymëzimin hyjnor dhe lidhjen e përjetshme të Shkrimeve. Teksti i cituar lidhet me mrekullinë e mbledhjes së përditshme të manës ku çdo Izraelit kishte mjaftueshëm (shih Eksod. 16:17,18). Perëndia do të sigurojë nevojat e besimtarëve ndërkohë që ata e kërkojnë dhe i binden Atij (shih Mat. 6:19-34).

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 8:16-24**

<sup>16</sup> Le ta falënderojmë Perëndinë, që i shtiu në zemër Titit po atë kujdes për ju, <sup>17</sup> sepse ai jo vetëm që e pranoi këshillën tonë, por u nis për të ardhur te ju, me dëshirën e tij dhe me shumë zell. <sup>18</sup> Edhe bashkë me të dërguam edhe vëllanë, lëvdimi i të cilit për predikimin e ungjillit *u përhap* në të gjitha kishat, <sup>19</sup> dhe jo vetëm *kaq*, por ai u zgjodh nga kishat që të jetë shoku ynë në udhëtim me këtë dhuratë që ne administrojmë për lavdinë e Zotit Vetë, *për të treguar gatishmërinë e zemrës suaj*, <sup>20</sup> duke shmangur qortimin e ndonjërit në këtë dhuratë bujare që administrohet prej nesh, <sup>21</sup> sepse kujdesemi të veprojmë

mirë jo vetëm përpara Zotit, por edhe përpara njerëzve.<sup>22</sup> Edhe ne dërguam bashkë me ta vëllanë tonë, të cilin e kemi vënë në sprovë shumë herë në shumë gjëra dhe doli i zellshëm, por tani është edhe më i zellshëm për shkak të besimit të madh që ka ndaj jush.<sup>23</sup> Sa për Titin, ai është bashkëpunëtori im dhe shok i veprës midis jush; sa për vëllezërit, ata janë apostuj të kishave, lavdi e Krishtit.<sup>24</sup> U tregoni atyre provën e dashurisë suaj dhe pse mburremi me ju edhe përpara kishave.

**8:16-17** “Le ta falënderojmë Perëndinë, që i shtiu në zemër Titit po atë kujdes për ju” Vini re të kuptuarit e Palit për mënyrën si pajis (shih Efe. 4:12) dhe motivon Perëndia për shërbesë. Po i njëjti i kuptuar i drejtimit Sovran të Perëndisë në çështjet e njerëzimit shihet gjithashtu tek Zbu. 17:17. Ky është misteri i sovranitetit hyjnor dhe vullnetit të lirë njerëzor.

TEMË E VEÇANTË: ZGJEDHJA/PARACAKTIMI DHE NEVOJA PËR NJË DREJTPESHIM TEOLOGJIK / SPECIAL TOPIC: ELECTION/PREDESTINATION AND THE NEED FOR A THEOLOGICAL BALANCE tek 1 Korintasve 1:24.

**8:16-24** Vargjet 16-24 duken se janë një letër rekomandimi për Titin. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 3:1. Një skicim i shkurtër biografik i Titit vijon më poshtë.

1. Titi ishte një nga bashkëpunëtorët më të besuar të Palit. Kjo provohet nga fakti që Pali e dërgoi atë tek pikat problematike të Korintit dhe Kretës.
2. Ai ishte një johebre i plotë (Timoteu ishte vetëm gjysmë grek), i konvertuar nën predikimin e Palit. Pali refuzoi ta rrethriste atë (shih Gal. 2).
3. Ai përmendet shpesh në letrat e Palit (shih 2 Kor. 2:13; 7:6-15; 8:6-24; 12:18; Gal. 2:1-3; 2 Tim. 4:10) dhe është shumë befasuese që Luka nuk e përmend atë tek Veprat e Apostujve. Disa komentarë japin teorinë që (1) Ai mund të ketë qënë një i afërm i Lukës (ndoshta vëlla) dhe përfshirja e emrit të tij do të ishte parë si një veprim i papërshtatshëm i Lukës nga ana kulturore ose (2) Titi është burimi kryesor i Lukës për informacion rreth jetës dhe shërbesës së Palit dhe prandaj, sikurse Luka, nuk përmendet me emër.
4. Ai shoqëronte Palin dhe Barnabën tek Këshilli i rëndësishëm i Jeruzalemit, i regjistruar tek Veprat e Apostujve 15.
5. Libri i Titit përqëndrohet mbi këshillën që Pali i jep Titit për veprën e tij në Kretë. Titi po sillet si përfaqësues zyrtar i Palit.
6. Informacioni i fundit në Dhjatën e Re rreth Titit është që ai u dërgua për të punuar në Dalmaci (shih 2 Tim. 4:10).

**8:16** “zemër” Pali e përdor shpesh këtë term tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 1:22; 3:2-3,15; 4:6; 5:12; 6:11; 7:3; 8:16; 9:7). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 14:25.

**8:18** “Edhe bashkë me të dërguam edhe vëllanë, lëvdimi i të cilit për predikimin e ungjillit u përhap në të gjitha kishat” Tradita kishtarë ka pranuar se ky mund të jetë bashkëpunëtori i Palit, Luka. Luka nuk përfshihet në listën e shoqëruesve të udhëtimit të Palit të regjistruar tek Veprat e Apo. 20:4, por seksioni “ne”, i cili nënkupton praninë e Lukës dhe fillon tek Veprat e Apo. 20:5-6, shfaqet në këtë pikë në kontekst (shih Origen i regjistruar tek *Hist. Eccl.* 6:25:6 e Eusebius-it; A. T. Robertson, *Word Pictures in the New Testament* [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re], fq. 245).

F. F. Bruce, *Paul: Apostle of the Heart Set Free* [Pali: Apostulli me Zemrën e Çliruar], komenton mbi Lukën dhe Titin se janë vëllezër.

“Një shpjegim i heshtjes së Lukës mbi se kush ishte një zëvendës i besuar i Palit është se Titi ishte vëllai i Lukës, shih W. M. Ramsay, *St. Paul the Traveller and the Roman Citizen* [Shën Pali Udhëtari dhe Qytetari Romak] (Londër, 1895), fq. 390; *Luke the Physician and Other Studies* [Luka Doktorit dhe Studime të Tjera] (Londër, 1908), fq. 17 f.; A. Souter, 'A Suggested Relationship between Titus and Luke' [Një Marrëdhënie e Sugjeruar midis Titit dhe Lukës], *Expository Times* [Kohët Përshkruese] 18 (1906-7), fq. 285, dhe 'The Relationship between Titus and Luke' [Marrëdhënia midis Titit dhe Lukës], nga i njëjti burim, fq. 335 f. Por nëse kjo marrëdhënie ruhet, atëherë mundësia që Luka është ‘vëllai’ i vargut 2 Korintasve 8:18 f. (shih fq. 320) përjashtohet: qëllimi i Palit në dërgimin e këtij ‘vëllai’ së bashku me

Titin ishte se ai duhej të ishte një garantues i pavarur i ndershmërisë së administrimit të fondit të tyre të ngushëllimit, dhe ky qëllim do të kishte qënë acarues nëse kritikëvë do t'ju jepej mundësia që të tërhiqnin vëmendjen ndaj një lidhjeje gjaku midis atyre të dyve. Asgjë nuk mund të kishte qënë më e mirë llogaritur për të nxitur ato dyshime që ekzistonin tashmë” (fq. 339 shënimi numër 5).

M. R. Vincent tek *Word Studies* [Studime Fjalësh] përmend një teori tjetër.

“Personi të cilit i referohet është identifikuar ndryshe nga vëllai i Titit, Barnaba, Marku, Luka dhe Epeneti, të përmendur tek Rom. 16:5. Referenca ndaj Epenetit është bërë mbi bazë të një loje të supozuar me fjalën *adhuroj, epainos*; duke qënë se Epenet do të thotë i denjë për adhurim; dhe paralelizmi citohet në rastin e Onesimus-it i *përfitueshëm* për të cilin Pali thotë se do të jetë paskëtaj i *dobishëm*, Filem. v.11” (fq. 830).

**8:19 “por ai u zgjodh nga kishat”** Folja është *cheirotoneō*, e cila përbëhet nga “dorë” dhe “zgjas”. Ajo fillimisht i referohej një votimi me anë të ngritjes së dorës. Ajo nuk mund të ketë këtë kuptim tek Veprat e Apo. 14:23, por e nënkupton atë këtu tek 2 Kor. 8:19.

Këtu është një shembull tjetër i qeverisjes së grigjës të lidhur me disa kongregacione të ndryshme. Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 16:3.

NASB	“të udhëtojë me ne në veprën e hirshme”
NRSV	“të udhëtojë me ne me këtë dhuratë”
NKJV	“të udhëtojë me ne ndërkohë që ne administrojmë këtë ndërmarrje bujare”
TEV	“të udhëtojë me ne ndërkohë që ne kryejmë këtë shërbesë dashurie”
NJB	“të jetë shoku ynë në udhëtim në këtë vepër të bujarisë”

Pali ishte gjithnjë syhapur për akuzat e keqpërdorimit të parave nga ana e tij (shih 2 Kor. 8:20; 11:9,12). Prandaj, ai dëshironte që të merrte disa përfaqësues nga kisha të ndryshme me vete për t’iu dhënë kontributin nga kishat johebraike ndaj kishës mëmë në Jeruzalem.

▣ **“për lavdinë e Zotit Vetë, për të treguar gatishmërinë e zemrës sonë”<sup>80</sup>** Kjo dhuratë monetare ka disa qëllime. Dy përmenden këtu.

1. Për të përlëvduar Zotin
2. Për të treguar gatishmërinë e kishave johebraike për të ndihmuar kishën mëmë në Palestinë.

Me shumë mundësi e ndihmonte Palin të tregonte përkushtimin dhe besnikërinë e tij ndaj besimtarëve hebrej të kishës universale. Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7.

Ky është një variant dorëshkrimi në greqisht i lidhur me “Vetë”. Ky përemër reciprok shfaqet në dy forma,

1. *auto* - MSS  $\alpha$ , D<sup>1</sup>
2. *autēn* - MS P
3. hequr tek shkrimi me të vogla MSS B, C, D\*, F, G dhe L (NJB)

UBS<sup>4</sup> i jep opsionit të parë një vlerësim “C” që do të thotë se komiteti tekstual nuk mund të vendosë.

**8:20 “duke shmangur”** Faza “duke bërë kujdes” (dmth., “duke shmangur”, një formë pjesore e mesme e tashme e përdorur vetëm këtu dhe tek 2 Thes. 3:6) ishte një metaforë detare për kujdesin shtesë në mbarëvajtjen e udhëtimit gjatë afrimit tek një dok (shih Moulton dhe Milligan, fq. 587 nga *Homer*).

NASB	“qortim”
NKJV, NRSV	“fajësim”
TEV	“trazoj ankesa”
NJB	“të jem në gjenjdje të bëj akuza”

Ky është termi në greqisht *mōmos*, i cili në thelb do të thotë të fajësosh, të poshtërosh, të turpërosh, të dëmtosh (shih 2 Pjet. 2:13). Folja këtu (dmth., forma lidhore [deponente] aoriste e mesme) nënkupton “të gjeshe faj”, “të çensurosh” ose “të fajësosh” (shih 2 Kor. 6:3; 8:20).

<sup>80</sup> Versioni në shqip është: “suaj”. (shënim i përkthyesit)

**NASB, NRSV, TEV** “këtë dhuratë bujare”  
**NKJV** “këtë dhuratë dorëgjere”  
**NJB** “këtë shumë të madhe”

Ky nuk është termi i zakonshëm për dhuratë. Ai përdoret në Septuagintë për të rriturit e pjekur (shih 2 Sam. 15:18; 1 Mbret. 1:9) dhe për drejtuesit (shih 2 Sam. 15:18; 2 Mbret. 10:6,11; Isa. 34:7). Nga letërsia greke ai përdoret për drithin e pjekur ose diçka të trashë. Ai gjendet vetëm këtu në Dhjatën e Re.

**8:21 “sepse kujdesemi për atë që është nderuese<sup>81</sup>”** Ky duket se është një citim nga Fjalët e Urta 3:4 në Septuagintë. Besimtarët kanë nevojë të jenë mbi dyshimin në çdo gjë (shih Mat. 10:16; Rom. 12:17; 1 Thes. 5:22).

Termi “nderuese” (NASB) ose “e drejtë” (NKJV, NIV) është termi në greqisht, *kalos*, që ka një varietet ngjyrimesh.

1. E bukur
2. E mirë
3. E dobishme
4. E shkëlqyeshme
5. E drejtë
6. Nderuese
7. E dalluar
8. Shkëlqim moral
9. E denjë
10. E virtytshme
11. E hijshme

▣ **“përpara Zotit”** Kjo i referohet qëllimeve të dikujt dhe njohurisë që ka nga Shkrimet. Nëse 2 Kor. 8:21 është nga Fjalët e Urta 3:4, atëherë Zotit i referohet YHWH.

▣ **“por edhe përpara njerëzve”** Kjo i referohet dëshmisë sonë (shih Rom. 14:18; Fil. 2:15; 4:8; 1 Tim. 3:7; 1 Pjet. 2:12).

**8:22 “ne dërguam bashkë me ta vëllanë tonë”** Ky duket se është një shoqërues i dytë i panjohur për të përmbushur kërkesën e Dhjatës së Vjetër për dy dëshmitarë (shih Ligji i Përt. 17:6; 19:15). Kjo do të thotë se Pali po i referohet në këtë kontekst tri njerëzve.

1. Titit
2. Vëllait të 2 Kor. 8:18
3. Vëllait të 2 Kor. 8:22

▣ **“e kemi vënë në sprovë shumë herë”** Ky term *dokimazō* gjithashtu shfaqet tek 2 Kor. 8:8 dhe në një formë tjetër të fjalës tek 2 Kor. 8:2. Shih TEMË E VEÇANTË: FJALËT GREQISHT PËR “VËNIEN NË PROVË” DHE NGJYRIMET E TYRE KUPTIMORE / Special Topic: Greek Terms for "Testing" and Their Connotations tek 1 Kor. 3:13.

▣ **“besimit të madh që ka ndaj jush”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 3:4.

**8:23**

**NASB, NKJV, NRSV** “ata janë lajmëtarë të kishave”  
**TEV** “ata përfaqësojnë kishat”  
**NJB** “ata janë të dërguar të kishave”

Kjo është fjala *apostolos*<sup>82</sup>, që do të thoshte “lajmëtar” ose “agjent”. Për shkak të përdorimit unik të termave tek Ungjilli i Gjonit që i referohen Jezusit si “I Dërguari” dhe dërgimit të Tij të ndjekësve të Tij, termi mori një

<sup>81</sup> Versioni në shqip është: “të veprojmë mirë”. (shënim i përkthyesit)

kuptim të specializuar të përfaqësimit zyrtar (dmth., apostull). Këtu ai përdoret në kuptimin e tij të zakonshëm të atyre (dmth., Titit dhe dy vëllezërve që nuk iu përmendet emri) të dërguar për të përfaqësuar kishat në udhëtimin për në Jeruzalem me ofrimin. Shih TEMË E VEÇANTË: DËRGOJ [APOSTELLË] / Special Topic: Send tek 1 Kor. 4:9.

▣ **“lavdi e Krishtit”** Kjo duhet t’i referohet 2 Kor. 8:19. Shih TEMË E VEÇANTË: LAVDIA (*DOXA*) / SPECIAL TOPIC: GLORY (*DOXA*) tek 1 Kor. 2:7. Ka mundësi që kjo frazë t’i referohet kishave që dërgonin ofrimin.

**8:24** Pyetja eksegjetike është se kujt i referohet “ata”?

1. Mund t’i referohet të varfërve në kishën në Jeruzalem. Kisha korintase e tregoi dashurinë e saj me dhuratën e saj për kishën mëmë. Bujaria e tyre iu tregoi kishave të tjera johebraike se ata ishin duke bashkëpunuar me Palin dhe duke ndjekur udhëheqjen e Palit.
2. Mund t’i referohet vetë kishave të tjera. Opsioni më i mirë nga ana kontekstuale dhe gramatikore është opsioni numër 2.

▣ **“haptazi”<sup>83</sup> përpara** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:11.

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si dallon dhënia në Dhjatën e Re nga dhënia në Dhjatën e Vjetër?
2. A është dhënia e së dhjetës një e vërtetë universale apo kulturore? Pse ose pse jo?
3. Si grumbullohet dhënia juaj në dallim me atë të maqedonasve?
4. Shpjegoni dallimin midis dhënies dhe kujdesit.
5. Kush është vëllai i përmendur tek 2 Kor. 8:18?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

---

<sup>82</sup> Versioni në shqip është: “apostuj”. (shënim i përkthyesit)

<sup>83</sup> Kjo fjalë nuk është në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

## 2 KORINTASVE 9

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Ofrimi për Shenjtorët	Administrimi i Dhuratave	Mbledhja për Lehtësimin e Kishës Jeruzalem  (8:1-9:15)	Ndihmë për Besimtarët në Nevojë	Të Dërguarit e Rekomanduar tek Korintasit (8:1-9:5)
9:1-5	9:1-5	9:1-5	9:1-5	Bekim që Pritet nga e Mbledhura
9:6-15	Dhënësi i Gëzuar 9:6-15	9:6-15	9:6-15	9:6-9 9:10-15

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih “[Bible Interpretation Seminar](#)” [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentuar studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Duhet të mbajmë mend se kapitujt 8 dhe 9 formojnë një njësi letrare. Gjithashtu deri në një farë mase ata janë paralel. Ndoshta Pali ka kombinuar dy predikime mbi dhënien e krishterë.
- B. Këta dy kapituj të marrë së bashku, sipas mendimit tim, janë diskutimi përcaktues i Dhjatës së Re mbi kujdestarinë.

#### STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

##### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 9:1-5

<sup>1</sup> Sa për shërbesën në dobi të shenjtorëve, është e tepërt t’ju shkruaj, <sup>2</sup> sepse e njoh gatishmërinë e zemrave tuaja, për të cilën unë mburrem për ju te Maqedonasit, se Akaia është gati që vjet; dhe zelli juaj nxitë shumë të tjerë. <sup>3</sup> Unë i dërgova këta vëllezër, që mburrja jonë për ju të mos dalë e kotë për këtë gjë dhe me qëllim, sikurse thoja, të jeni gati, <sup>4</sup> sepse, po të vinin me mua disa Maqedonas dhe të mos ju gjenin gati, ne (të mos them ju), do të dilnim të turpëruar për besimin dhe mburrjen tonë. <sup>5</sup> Prandaj m’u duk e nevojshme t’i këshilloj vëllezërit të vijnë te ju më përpara, që të bëjnë gati më parë ofertën që kishit premtuar më parë, kështu që ajo të jetë gati si dhuratë bujarie dhe jo kopracie.

**9:1 “është e tepërt”** Ky është termi *perissos*. Ai përdoret këtu në kuptimin e përtej dhe mbi. Ajo dhe format që lidhen me të përdoren shpesh tek 2 Korintasve. Pali shpesh përdor gjuhë emocionale ose “mbi majën”. Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:7.

▣ **“t’ju shkruaj”** Është e pazakontë për Palin që ta thotë këtë kur ai sapo iu ka shkruar atyre mbi këtë temë (dmth., e mbledhura nga kishat e tij johebraike për kishën mëmë në Jeruzalem, shih kapitulli 8). Këta dy kapituj janë paralel në parimet frymërore të lidhura me kujdestarinë e krishterë. Ndoshta ata janë dy predikime të kombinuara ose pjesë të dy katekizmave.

▣ **“shërbesën”** Ky term (*diakonia*) shpesh përdoret për kujdestarinë e krishterë (shih Veprat e Apo. 6:1; 11:29; Rom. 15:31; 2 Kor. 8:4; 9:1,12,13). Këtu ajo i referohet të qenit shërbenjës. Marrëdhënia e besimtarëve ndaj një Perëndie të hirshëm dhe një Mesie që jep veten e tij kërkon një jetë shërbesë ndaj të tjerëve (shih Gjoni 17:18; 20:21; 1 Gjoni 3:16). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

▣ **“shenjtorëve”** Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË / Special Topic: Saints at 1 Kor. 1:2.

**9:2 “e njoh gatishmërinë e zemrave tuaja”** Pali ka bërë aludim ndaj kësaj tek 2 Kor. 8:8-12,20.

▣ **“për të cilën unë mburrem për ju te Maqedonasit”** Kjo është një formë treguese e mesme e tashme. Pali vazhdon të mburret për akaikët. Tek 2 Kor. 8:1-5, Pali ka përdorur maqedonasit për të inkurajuar korintasit; tani në kapitullin 9, Pali pohon se ai ka përdorur akaikët për të inkurajuar maqedonasit.

▣ **“mburrem”** Shih TEMË E VEÇANTË: MBURRJA / Special Topic: Boasting tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“Akaia”** Kjo ishte provinca romake përgjatë bregut jugor të Greqisë. Kjo është në kundërshti me 2 Kor. 1:1, ku letra është shkruar për të gjithë popullin e Perëndisë në Akai. Kjo tregon se letra u shkrua në disa kisha të zonës ose se kisha në Korint, i cili ishte kryeqyteti i provincës, kishte një ndikim të gjerë gjeografik.

▣ **“është gati që vjet”** Duket se gjendet një kundërshtim ndaj kapitullit 8. Megjithatë, korintasit dëshironin të fillonin ofrimin një vit më përpara, por ata nuk e kishin përfunduar atë kurrë. Problemi i vërtetë është përkthimi (format e zgjedhuara janë të njëjta) i foljes.

1. Nëse është në mënyrën treguese të mesme të përkryer, ajo duhet të përkthehet “kanë bërë përgatitje”

2. Nëse është në mënyrën treguese pasive të përkryer, ajo duhet të përkthehet “është përgatitur”

Unë mendoj se duhet të jetë forma e mesme e përkryer për shkak të kontekstit dhe formës pjesore me të cilën përshtatet tek 2 Kor. 9:3 (dmth., e mesme e përkryer).

▣ **“zelli juaj nxiti shumë të tjerë”** Folja në këtë fjali mund të përdoret në një kuptim negativ (shih Septuagintën e Ligjit të Përt. 20:21; Kol. 3:21) ose një kuptim pozitiv (shih 2 Kor. 9:2).

**9:3 “të jeni gati”** Kjo është një formë lidhore pasive e përkryer. Koha dhe forma përputhen me 2 Kor. 9:2, por mënyra lidhore tregon se gjendet një element kujdesi i bazuar në vullnetin e besimtarëve në Korint në lidhje me ofrimin (fjalë për fjalë, “këtë çështje”).

**9:4 “po të vinin me mua disa Maqedonas”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm. Këta përfaqësues përmenden tek 2 Kor. 8:19-24. Tek Veprat e Apo. 20:4, ku përmenden përfaqësuesit në Jeruzalem me këtë ofrim, asnjë nuk listohet nga Korinti. Disa kanë pranuar se ndoshta ishte Titi përfaqësuesi i tyre, i cili shkoi atje më parë, por ai nuk përmendet asnjëherë tek Veprat e Apostujve.

▣ Gjenden tri folje në mënyrën lidhore aoriste tek 2 Kor. 9:4 të cilat prezantojnë një element pasigurie të bazuar në veprimet e kishave akaike.

NASB “ne – të mos flasim për ju –”  
NKJV “ne (të mos përmendim ju!)”



**NRSV**  
**NJB**

**“ne... të mos themi gjë për ju –”**  
**“ne – për të mos thënë gjë për veten tuaj –”**

Problemi i cili përkthehet në këto mënyra të ndryshme lidhet me përemrin dhe se si duhet të lidhet me foljen paraardhëse (“do të dilnim të turpëruar”, *kataischunthōmen*, forma lidhore pasive aoriste, shumës). UBS<sup>4</sup> tregon tre mundësitë.

1. “*lego*” (forma lidhore aktive e tashme, njëjës) - MSS P<sup>46</sup>, C\*, D, F, G
2. “*legōmen*” - (forma lidhore aktive e tashme, shumës) - MSS  $\kappa$ , B, C<sup>2</sup>
3. Hequr – MS K

UBS<sup>4</sup> i jep opsionit numër 1 një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë). Pali përdor vetën e parë njëjës tek 2 Kor. 9:1, 2, 3 dhe 5 (Metzger, fq. 582).

**NASB** “me këtë besim”  
**NKJV** “me këtë mburrje plot besim”  
**NRSV** “në këtë që po ndërmerrni”  
**TEV** “që ndihemi kaq të sigurtë për ju”  
**NJB** “me sigurinë tonë në ju”

Pse duhej të kishin turp korintasit dhe Pali? Termi *hupostasis* (dmth., sipas NASB “besim / siguri”), sipas Bauer, Arndt, Gingrich dhe Danker, *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greqisht-Anglisht], nuk mund të përkthehet “besim”, por duhet të jetë “gjendje shpirtërore” ose ndoshta “i kuptuar” i ofrimit për të varfërit në Jeruzalem (shih NRSV) (fq. 847 numri 2 dhe numri 3). Pali ishte i shqetësuar për ofrimin, jo për mburrjen e tij. Kjo i përshtatet përdorimit të fjalës tek Heb. 1:3. Megjithatë, kur e krahason përdorimin e po të njëjtit term tek 2 Kor. 11:17, “mburrje me siguri”, atëherë kuptohet pse NASB e përkthen në këtë mënyrë këtë varg. Fjala “mburrje” (NKJV) mungon në pjesën më të madhe të dorëshkrimeve të hershme në greqisht (MSS P<sup>46</sup>,  $\kappa$ \*, B, C, D\*, F, G). Ajo gjendet tek MSS  $\kappa$ <sup>2</sup>, D<sup>1</sup>. UBS<sup>4</sup> i jep heqjes së saj një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë).

**9:5** Gjenden tri fjalë në këtë varg të cilat fillojnë me *pro* (dmth., përpara).

1. Pali dërgon përfaqësuesit e kishës paraprakisht (*proerchomai*, shih Veprat e Apo. 20:5,13)
2. Pali dëshironte që ata të përgatiteshin paraprakisht (*prokatartizō*, shih Veprat e Apo. 3:18,24; 7:52)
3. Pali dëshironte që ata të përmbushnin premtimin e tyre paraprak (*proepēngellomai*, shih Rom. 1:2)

▣ **“dhuratë bujarie”** Kjo është *eulogia* (dmth., fjalë për fjalë “fjalë e mirë”). Ky term gjithashtu përdoret tek 2 Kor. 9:6 në kuptimin e “bollëkut”.

Ky term ka një fushë të gjerë semantike. Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greqisht-Anglisht], listojnë gjashtë kuptime (vëll. 2, fq. 108).

1. lavdërim (shih Jakobi 3:9)
2. fjalë të ëmbla (shih Rom. 16:18)
3. bekim (shih 1 Kor. 10:16; Jakobi 3:10)
4. përfitim (shih Rom. 15:29)
5. dhuratë (shih 2 Kor. 9:5)
6. shumë e madhe (shih 2 Kor. 9:6)

Opsioni numër 3 ndjek Septuagintën (shih Mbre. 1:15).

**Nasb** “si një dhuratë bollëku dhe jo e ndikuar nga zilia”  
**Nkjv** “si një çështje bujarie dhe jo si një detyrim zilie”  
**Nrsv** “si një dhuratë e vullnetshme dhe jo si një zhytje”  
**TeV** “ju jepni sepse dëshironi, jo sepse duhet ta bëni”  
**Njb** “si një dhuratë e vërtetë dhe jo si një imponim”

Fjalë për fjalë “kjo si një bekim dhe jo si një kopraci”. I gjithë diskutimi i Palit mbi dhënien në këtë njësi letrare (dmth., 2 Kor. 8-9) është shkruar me takt dhe në mënyrë positive, por kjo frazë tregon se gjendej një element kundërshtie në kishë. Pali dëshironte që kisha në Korint të ndihej pjesë e bashkësisë më të madhe të kishave të tij dhe të ishte pjesë e kësaj shërbese dashamirëse kolektive. Megjithatë, ai e dinte, se disa do ta shfrytëzonin këtë

mundësi për ta akuzuar atë se po bëhej imponues në lidhje me këtë kontribut. Prandaj, për të ndaluar çdo kritikë të mundshme, ai tha: “Bëjeni përpara se unë të mbërrij aty!”

*Jerome Biblical Commentary* [Komentari Biblik Xherom] thotë se emri shpesh i përkthyer “kopraci” duhet të përkthehet, në këtë kontekst, “dhuratë e dhënë pa dëshirë” (fq. 285).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 9:6-15

<sup>6</sup> Dhe ju *them* këtë: Ai që mbjell me kursim, do të korrë po me kursim; dhe ai që mbjell dorëhapur edhe do të korrë dorëhapur. <sup>7</sup> Secili le të veprojë ashtu si ka vendosur në zemrën, as me keqardhje as nga shtrëngimi, sepse Perëndia do një dhurues të gëzuar. <sup>8</sup> Dhe Perëndia mund të bëjë që gjithë hiri të teprojë për ju, aq sa mbasi të kenë gjithnjë mjaft në çdo gjë, t’ju tepërojë për çfarëdo pune të mirë, <sup>9</sup> sikurse është shkruar: “Ai ndau, u ka dhënë të varfërve, drejtësia e tij mbetet në përjetësi.” <sup>10</sup> Edhe ai që i jep farën mbjellësit dhe bukë për të ngrënë, ju dhëntë dhe e shumoftë farën tuaj, dhe i bëftë të rriten frytet e drejtësisë suaj; <sup>11</sup> dhe atëherë do të pasuroheni për të qenë dorëdhënë, duke i sjellë nëpërmjet nesh falënderim Perëndisë. <sup>12</sup> Sepse kryerja e kësaj shërbese të shenjtë jo vetëm përmbush nevojat e shenjtorëve, por sjell edhe një mbushulli falënderimesh ndaj Perëndisë, <sup>13</sup> sepse për shkak të përvojës nga kjo shërbesë, ata e përlëvdojnë Perëndinë për bindjen ndaj ungjillit të Krishtit që ju rrëfeni dhe për bujarinë me të cilën merrni pjesë me ta dhe me të gjithë. <sup>14</sup> Dhe me lutjet e tyre për ju ju shfaqin një dashuri të veçantë për hirin e shkëlqyer të Perëndisë përmbi ju. <sup>15</sup> Le të falënderojmë Perëndinë për dhuratën e Tij të patregueshme.

▣ **“Ai që mbjell me kursim, do të korrë po me kursim”** Ky duket se është një aludim ndaj Fjalëve të Urta 11:24-25 (shih Fjalët e Urta 19:17; 22:9). Ajo reflekton mësimin e Jezusit mbi dhënien (shih Mat. 7:2; Mark 4:24; Luka 6:38). Metafora bujqësore e mbjelljes përdoret shpesh në Bibël; ndonjëherë në një kuptim eskatologjik, gjykues (shih Gal. 6:7), por gjithashtu si një mënyrë për t’iu referuar veprimeve të mbinatyrshe si ringjallja (shih 1 Kor. 15:35-37). Në këtë kontekst, ajo flet për një farë që prodhon shumë farëra si një mënyrë për t’iu referuar bollëkut. Por fara e parë duhet të hidhet (dmth., të mbillet)!

**9:7 “Secili le të veprojë ashtu si ka vendosur në zemrën”** Kjo është një formë treguese e mesme e përkryer. Ky është një nga parimet kyçe në dhënien frymërore. Ajo renditet së bashku me 8:12 në udhëzimet kryesore që iu jepen besimtarëve dhënës në lidhje me kujdesin.

▣ **“zemrën”** Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 14:25.

▣ **“as me keqardhje as nga shtrëngimi”** Dhënia frymërore duhet të jetë e vullnetshme dhe me qëllimin e duhur (shih 2 Kor. 8:12). Unë personalisht tmerrohem kur dëgjoj të predikohet dhënia e të dhjetës sipas Dhjatës së Vjetër (zakonisht nga Malakia ose Levitiku) si (1) një mandat për pasurinë personale ose (2) një rrezik ndaj shëndetit apo mirëqënies fizike. Shih TEMË E VEÇANTË: TË JAPËSH TË DHJETËN / SPECIAL TOPIC: TITHING tek 2 Kor. 8:8.

▣ **“Perëndia do një dhurues të gëzuar”** Kjo duket se është nga Fjalët e Urta 22:8 në Septuagintë. Pohimi nuk shfaqet tek MT. Ne marrim termin në anglisht “hilarious” (i gëzueshëm), nga kjo rrënjë fjale në greqisht. I njëjti term përdoret në lidhje me mëshirën tek Rom. 12:8. Në papirusët e gjuhës koine greke (dmth., tekste magjike) termi *hilaros* (i gëzuar) është sinonim me *hileōs* (mëshirë). Për shkak të kësaj Moulton dhe Milligan, tek *The Vocabulary of the Greek New Testament* [Fjalori i Dhjatës së Re në Greqisht], mendojnë se përdoret në kuptimin i hirshëm (fq. 303).

**9:8 “Perëndia mund”** Kjo është një dëshmi e fuqishme e karakterit të Perëndisë dhe një titull i mrekullueshëm (dmth., “Atij që është në gjendje”, shih Rom. 16:25; Efe. 3:20; Juda 24). Besimtarët besojnë, duan dhe i shërbejnë një Perëndie që vepron!

▣ **“të bëjë që gjithë hiri të teprojë për ju”** Kjo frazë nuk i referohet dhënies së korintasve, por i referohet natyrës bazë të Perëndisë, që është hiri. Për shkak të natyrës së Perëndisë dhe dhuratës së Perëndisë (dmth., Jezusit), besimtarët duhet gjithashtu të japin. Besimtarët reflektojnë karakteristikat e familjes së Perëndisë.

▣ **“të keni gjithnjë mjaft në çdo gjë”** Vini re formën përfshirëse “të gjithë / çdo gjë” (dmth., *pas*).

1. Gjithë hiri (*pasan*)
2. Gjithnjë (*pantote*)
3. Mjaft (*pasan*)
4. Në çdo gjë (*panti*)
5. Çfarëdo pune të mirë (*pan*)

Dhënia e krishterë ndikon të gjithë jetën! Perëndia siguron për të gjitha nevojat (shih Mat. 6:19-34).

Termi “mjaftueshmëri / mjaft” vjen nga dy terma në greqisht, “vetë” dhe “kënaqshmëri” (shih 1 Tim. 6:6-10; Fil. 4:11-12,19; Heb. 13:15). A. T. Robertson tek *Word Pictures In The New Testament* [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re], vëll. 4, fq. 248 dhe M. R. Vincent tek *Word Studies* [Studime Fjalësh], fq. 831, të dy pretendojnë se Pali ishte i mësuar me mendimin dhe termat stoikë. Por ai i ripërkufizon ata nën dritën e ungjillit. Shih Bruce Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali mes Sofistëve].

▣ **“t’ju tepërojë për çfarëdo pune të mirë”** Perëndia do t’ju japë atyre që ndajnë burimet e tyre me Të, më shumë burime. Megjithatë, kjo tepri nuk është për përdorimin personal të individit, por për kauzat e Krishtit (shih Efe. 4:28). Dhënësi i krishterë bëhet një kanal i furnizimit të Perëndisë për nevojat e të tjerëve. Kjo është e vërteta që humbet aq shpesh në mësimin tonë mbi kujdesin e krishterë. Po, bekimet e besëlidhjes dhe tepria do të ndodhin, por ato janë për t’u përçarur më tej për Mbretërinë, jo për t’u mbajtur! Besimtarët shpëtohen për të shërbyer dhe bekohen për të dhënë!

**9:9 “sikurse është shkruar”** Ky është një citim nga Ps. 112:9 nga Septuaginta (dmth., 111:9). Ky citim përfshin një nga përdorimet e rralla të termit “drejtësi” (shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:30) që i referohet veprimeve njerëzore (shih Mat. 6:1). Në judaizëm ajo i referohej praktikës javore të dhënies së lëmoshës nga hebrejtë për të varfërit e sinagogës (shih Ps. 112:1-6). Zakonisht në Dhjatën e Re, drejtësia është një dhuratë nga Perëndia në Krishtin e ndarë nga veprimi apo merita njerëzore.

#### **TEMË E VEÇANTË: LËMOSHA (SPECIAL TOPIC: ALMSGIVING)**

##### **I. Termi në vetvete**

- A. Ky term u zhvillua brenda judaizmit.
- B. Bën fjalë për të ndihmuar të varfërit dhe/ose nevojtarët.
- C. Në shqip, fjala “lëmoshë” vjen nga një deformim i fjalës greke *eleēmosunē*.

##### **II. Koncepti në Dhjatën e Vjetër**

- A. Koncepti i ndihmës së të varfërve shprehet herët në Torah
  1. konteksti tipik, Ligji i Përt. 15:7-11
  2. “mbledhja e kallinjve”; një pjesë e të korrave iu lihej të varfërve (Lev. 19:9; 22:23; Ligji i Përt. 24:20)
  3. “viti i shabatit”, që u lejonte të varfërve të hanin prodhimet e vitit të shtatë, kur toka nuk punohej (Eks. 23:10-11; Lev. 25:2-7).
- B. Ky koncept u zhvillua më tej në literaturën e urtësisë (shembuj të përzgjedhur)
  1. Jobi 5:8-16; 29:12-17 (të ligjtë përshkruhet në 24:1-12)
  2. Psalmet, 11:7 3. Fjalët e Urta 11:4; 14:21, 31; 16:6; 21:3,13

##### **III. Zhvillimi në judaizëm**

- A. Vëllimi i parë i Mishnës flet për mënyrën si duhen trajtuar të varfërit, nevojtarët dhe levitët lokalë.
- B. Citime të përzgjedhura
  1. Predikuesi (i njohur edhe si Urtësia e Ben Sirakut) 3:30: “ashtu si uji shuan zjarrin e tërbuar, kështu dhe lëmosha shlyen mëkatën” (NRSV)
  2. Tobiti 4:6-11: “sepse ata që veprojnë në përputhje me të vërtetën do të begatohen në

çdo gjë që bëjnë. Gjithë atyre që kryejnë drejtësinë<sup>7</sup> jepu lëmoshë nga pasuria jote, dhe mos lejo që syri yt ta shohë me keqardhje dhuratën kur e jep. Mos e kthe kokën nga ana tjetër para të varfrit, dhe as Perëndia nuk do ta kthejë kurrë fytyrën nga ana tjetër para teje.<sup>8</sup> Nëse ke shumë pasuri, jepe dhuratën në përpjesëtim me to; nëse ke pak, mos ki frikë të japësh sipas asaj pak që ke.<sup>9</sup> Kështu, ke për të grumbulluar një thesar të madh për vete ditën e nevojës.<sup>10</sup> Sepse lëmosha të çliron nga vdekja dhe të mbron që të mos kridhesh në Errësi.<sup>11</sup> Me të vërtetë, për gjithë ata që e japin, lëmosha është ofertë e shkëlqyer në prani të Shumë të Lartit”. (NRSV)

3. Tobiti 12:8-9: “<sup>8</sup>Lutja dhe agjërimi janë të mira, por më e mirë se të dyja është lëmosha me drejtësi. Pak me drejtësi është më mirë se pasuria me keqberje. Më mirë të japësh lëmoshë sesa të grumbullosh flori.<sup>9</sup> Sepse lëmosha të shpëton nga vdekja dhe të pastron nga çdo mëkat. Ata që japin lëmoshë do të shijojnë një jetë të plotë”. (NRSV)

C. Citimi i fundit nga Tobiti 12:8-9 tregon zhvillimin e problemit. Veprimet/meritat njerëzore shiheshin si mekanizëm për të siguruar falje dhe begati.

Ky koncept zhvillohet më tej në Septuagintë, ku fjala greke “lëmoshë” (*eleēmosunē*) bëhet sinonim i “drejtësisë” (*dikaïosunē*). Të dyja përdoren për të përkthyer ndonjëherë fjalën hebraisht “drejtësi” (BDB 842, dashuria dhe besnikëria e besëlidhjes së Perëndisë, shih Ligji i Përt. 6:25; 24:13; Isa. 1:27; 28:17; 59:16; Dan. 4:27).

D. Veprimet e mëshirshme njerëzore u bënë synim në vetvete për të arritur begati personale gjatë jetës dhe shpëtimit pas vdekjes. Kjo vepër (dhe jo motivi pas këtij veprimi) mori vlerë të madhe teologjike. Perëndia sheh zemrën, pastaj gjykon veprimin e dorës. Ky ishte mësimi i rabinëve, por, në njëfarë mënyre, humbi dhe u shndërrua në veprim individual vetëdrejtësie (shih Mikea 6:8).

#### IV. Reagimi i Dhjatës së Re

A. Kjo fjalë gjendet në

1. Mat. 6:1-4
2. Luka 11:41; 12:33
3. Veprat e Apo. 3:2-3, 10; 10:2, 4, 31; 24:17

B. Jezusi trajton konceptin tradicional të drejtësisë si (shih 2 Klementit 16:4)

1. Lëmoshë
2. Agjërim
3. Lutje

C. Në Predikimin në Mal (shih Mat. 5-7), Jezusi i jep një riorientim rrënjësor pikëpamjes tradicionale për drejtësinë (pra, besimit në veprimet njerëzore). “Besëlidhja e re” e Jer. 31:31-34 bëhet standardi i ri për të patur marrëdhënien e drejtë me Perëndinë (shih Rom. 3:19-31). Perëndia të jep zemër, mendje dhe shpirt të ri. Fokusi i Jezusit është te arritjet hyjnore, jo arritje njerëzore (shih Ezek. 36:26-27).

▣ “në përjetësi” Shih Temën e Veçantë më poshtë.

TEMË E VEÇANTË: ‘OLAM (PËRJETË) / SPECIAL TOPIC: FOREVER (‘OLAM) tek 1 Korintasve 2:7.

**9:10** Pjesa e parë e këtij vargu duket se është një citim nga Isa. 55:10, dhe pjesa e dytë duket se citohet nga Osea 10:12. Këto vargje pohojnë

1. Pronësinë e Perëndisë mbi gjithçka dhe furnizimin e Perëndisë me gjithçka
2. Kujdestarinë e besimtarëve

Perëndia është burimi, por besimtarët marrin një bekim kur ata ndajnë.

Pronësia e Perëndisë komunikohet përmes fjalës në greqisht “furnizime” (dmth., *chorēgeō*), që vjen në anglisht si “chorus” (kor).

Ky term në gjuhën koine greke u përdor për një mirëbërës që furnizon me bollëk për një kor lokal. Shpesh besimtarët modernë ia atribuojnë pasurinë e tyre krijueshmërisë së tyre, punës etike, njohurisë së akumuluar apo

përpjekjeve të tyre. Megjithatë, një pikëpamje biblike ia atribuon të gjitha burimet Perëndisë. Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / Special Topic: Servant Leadership tek 1 Kor. 4:1.

**NASB, NRSV** “e rritë të korrën e drejtësisë suaj”  
**NKJV** “i bëftë të rriten frytet e drejtësisë suaj”  
**TEV** “prodhofte një të korrë të pasur nga bujaria juaj”  
**NJB** “bëftë të korrën e drejtësisë suaj më të madhe”

Tek 2 Kor. 8:5 termi “hir” përdoret në disa kuptime të ndryshme, po kështu, edhe drejtësia. Misteri teologjik është se si besimtarët marrin një bekim apo shpërblim për gjërat që Perëndia jep dhe frymëzon? Ky është misteri i një Perëndie Sovran dhe përgjigjen e kërkuar ndaj besëlidhjes! Besimtarët japin për shkak

1. Se Perëndia jep
2. Të shembullit të Jezusit
3. Të nevojës njerëzore
4. Të një pikëpamjeje të re
5. Të Frymës që banon brenda tyre

Të japësh është rezultati natyror i shpëtimit. Një i krishterë koprac është në kundërshti me parimet!

**9:11 “do të pasuroheni në çdo gjë<sup>84</sup>”** Kjo është forma pjesore pasive e tashme e *ploutizō* me “në çdo gjë” e vendosur për theksim. Nga vargjet 8:7-9, është e dukshme se kjo nuk i referohet vetëm bekimeve materiale, por gjithashtu bekimeve frymërore (shih 2 Kor. 6:10; 1 Kor. 1:5).

■ **“gjithë lirinë”** Vini re edhe dy pjesëza *pas* përfshirëse (shih 2 Kor. 9:8). Ky term në greqisht gjithashtu mund të nënkuptojë një-mendësi (dmth., sinqeritet, pastërti) dhe origjinalitet (shih 2 Kor. 8:2; 9:11,13). Shih shënimin tek 2 Kor. 1:12.

■ **“duke i sjellë nëpërmjet nesh falënderim Perëndisë”** Theksi i këtij seksioni përmyllës të kapitullit 9 është që Perëndia të marrë lavdinë nga dhënia e besimtarëve (shih 2 Kor. 9:11-13). Kjo më kujton vargun nga Mat. 5:16, ku thotë: “që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej”. Qëllimi kryesor i Palit në lidhjen e kishës mëmë në Jeruzalem me kishat e tij johebraike ishte që të mund të zhvillohej një atmosferë dashurie dhe vlerësimi (shih 2 Kor. 9:14).

**9:12 “shërbese”** Ky është termi grek *leitourgia* (i përbërë nga publik dhe vepër) nga i cili marrim termin “liturgji”.

Fillimisht ai i referohej dikujt që bënte shërbesë në publik me shpenzimet e veta. Në këtë kuptim ajo është e ngjashme me *chorēgeō* nga 2 Kor. 9:10.

■ **“përmbush plotësisht<sup>85</sup> nevojat e shenjtorëve”** Ky është termi në greqisht *prosanaplēroō*, (forma treguese aktive e tashme perifrastike), e cila është *pros plus anaplēroō*, që do të thotë të mbushësh ose të plotësosh (shih 1 Kor. 14:16; 16:17). Pali përdor shumë forma foljore të intensifikuara me *pros* (shih 2 Kor. 9:5), megjithatë, kuptimi i saktë rrjedhues është i pasigurtë. Pali përdor të njëjtën formë të intensifikuar tek 2 Kor. 11:9. Termi “nevoja” është fjalë për fjalë “gjërat që mungojnë” (shih 1 Kor. 16:17; 2 Kor. 8:8,13,14; 11:8). Besimtarët e varfër në Jeruzalem kishin nevoja të vërteta që këto kisha johebraike mund të përmbushnin. Për “shenjtorë” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

■ **“një mbushulli falënderimesh ndaj Perëndisë”** Njerëzit në nevojë në Jeruzalem dhe gjithë besimtarët në Palestinë po falënderonin Perëndinë për shqetësimin dhe ndihmën sakrifikuese të kishave johebraike (shih 2 Kor. 9:13).

<sup>84</sup> Versioni në shqip është: “për të qenë dorëdhënë”. (shënim i përkthyesit)

<sup>85</sup> Kjo fjalë mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

**9:13 “provës”<sup>86</sup>** Kjo është fjala për “test” (dmth., *dokimē*) përdorur tek 2 Kor. 2:9; 8:2; 13:3. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13.

■ **“kjo shërbesë”** Kjo i referohet kontributit të kishave johebraike të Palit ndaj kishës mëmë në Jeruzalem. Kjo është e njëjta fjalë e përdorur tek 2 Kor. 9:1.

#### **TEMË E VEÇANTË: RRËFIMI (SPECIAL TOPIC: CONFESSION)**

- A. Ka dy forma të së njëjtës rrënjë greqisht që përdoren për “rrëfimin e fajit” ose “rrëfimin e besimit”, *homologeō/exomologō*. Kjo fjalë e përbërë vjen nga *homo*, “e njëjtë”; dhe *legō*, “flas”; ose *ex*, “prej”. Kuptimi bazë është “them të njëjtën gjë, bie dakord me” dikë. PARAFJALA greke, *ex*, shtohet për të nënkuptuar një shpallje publike.
- B. Përkthimet e fjalëve në këtë grup janë:
1. lavdëroj
  2. bie dakord
  3. shpall (Mat. 7:23)
  4. rrëfej besimin
  5. rrëfej fajin (Heb. 4:14; 10:23)
- C. Ky grup fjalësh kishte dy përdorime në dukje të kundërta:
1. Lavdëroj (Perëndinë)
  2. Pranoj mëkatin
- Këto mund të jenë zhvilluar nga fakti se njerëzimi e kupton shenjtërinë e Perëndisë dhe mëkatin e vet. Të pranosh njërën të vërtetë, do të thotë t’i pranosh të dyja.
- D. Përdorimet e këtij grupi fjalësh në Dhjatën e Re janë:
1. premtoj (Mat. 14:7; Veprat e Apo. 7:17)
  2. bie dakord për diçka (Gjoni 1:20; Luka 22:6; Veprat e Apo. 24:14; Heb. 11:13)
  3. lavdëroj (Mat. 11:25; Luka 10:21; Rom. 14:11; 15:9; Heb. 13:15)
  4. pranoj
    - a. një person (Mat. 10:32; Luka 12:8; Gjoni 9:22; 12:42; Rom. 10:9; Fil. 2:11; 1 Gjonit 2:23; Zbu. 3:5)
    - b. një të vërtetë (shih Veprat e Apo. 23:8; 1 Gjonit 4:2)
  5. bëj shpallje publike të diçkaje (kuptimi ligjor u shndërrua në pranim fetar; shih Veprat e Apo. 24:14; 1 Tim. 6:13)
    - a. pa pranim faji (shih 1 Tim. 6:12; Heb. 10:23)
    - b. me pranim faji (shih Mat. 3:6; Veprat e Apo. 19:18; Heb. 4:14; Jakobi 5:16; 1 Gjonit 1:9)

**NASB, NKJV, NRSV, NJB** “bindjen”  
**TEV** “besnikërinë”

Kjo është fjalë për fjalë termi “nënshtrim” (dmth., *hupotagē*, shih Gal. 2:5; 1 Tim. 2:11; 3:4), por përdoret në kuptimin e bindjes për shkak se kundrinori është “ungjilli”, jo një person.

TEMË E VEÇANTË: NËNSHTRIMI / SPECIAL TOPIC: SUBMISSION (HUPOTASSŌ) tek 1 Korintasve 14:34.

■ **“për bindjen ndaj ungjillit të Krishtit që ju rrëfeni”** Rrëfim do të thotë “të biesh dakord me” (shih 1 Tim. 6:12-13; 1 Gjonit 1:9). Në këtë kontekst rrëfimi i tyre metaforik është kontributi i tyre i lirë, i cili konfirmonte

<sup>86</sup> Versioni në shqip është: “përvojës”. (shënim i përkthyesit)

marrëdhënien e tyre me kishat e tjera johebraike dhe me Krishtin. Jeta e përjetshme ka karakteristika të vëzhgueshme!

■ **“pjesëmarrjen”<sup>87</sup>** Ky është termi *koinōnia* (shih Rom. 15:26), që do të thotë “pjesëmarrje e përbashkët me”. Këtu ai i referohet parave të dhëna për të varfërit në kishën në Jeruzalem (shih shënimin tek 1 Kor. 16:1). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9.

■ **“dhe me të gjithë”** Kjo është një frazë e vështirë për t’u interpretuar. Ajo duhet t’i referohet në një farë mënyre ndikimit korintas në inkurajimin e kishave të tjera johebraike për të marrë pjesë në ofrim (shih 2 Kor. 9:2).

**9:14** Ky varg i referohet atyre që morën ofrimin (dmth., të varfërve të kishës Jeruzalem dhe të gjithë anëtarëve të tyre). Pali dëshironte që këta dy krahe të kishës së hershme të ishin të bashkuar në mënyrë të pandashme.

■ **“që tejkalon”<sup>88</sup>** *Huperballō*. Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul’s Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

**9:15 “Le të falënderojmë Perëndinë për dhuratën e tij të patregueshme”** Disa e marrin këtë kontekst si t’i referohej dhuratës monetare të korintasve, por për shkak se

1. sakrificat e madhe e Jezusit përmendet tek 2 Kor. 8:9
2. ungjilli i Krishtit përmendet tek 2 Kor. 9:1,

ajo i referohet me shumë mundësi shërbesës së Jezusit të Nazaretit, Mesias. James D. G. Dunn, *Unity and Diversity in the New Testament* [Uniteti dhe Diversiteti në Dhjatën e Re] (fq. 184) përmend se “dhurata e Perëndisë” tek Veprat e Apostujve i referohet Frymës së Shenjtë (dmth., epokës së re, shih Veprat e Apo. 2:38; 8:20; 10:45; 11:17).

Shërbesa e Birit që jep veten (shih 2 Kor. 8:9) kishte për qëllim të

1. frymëzonte këta besimtarë që të falënderonin (dmth., *eucharistia*, 2 Kor. 9:11,12; *charis*, 2 Kor. 9:13) Perëndinë
2. t’i nxiste ata të ndanin burimet e tyre financiare me besimtarët në nevojë

**NASB, NKJV, NRSV “të papërshkrueshme”**

**TEV “të paçmueshme”**

**NJB “të patregueshme”**

Ky është termi *ekdiēgeomai*, që do të thotë të shpjegosh plotësisht ose të përmendësh të gjithë detajet, plus forma alfa privative, e cila e mohon atë. Në disa mënyra, dashuria e Perëndisë është tepër e mrekullueshme që njerëzit të kuptojnë të gjitha aspektet e saj (shih Ligji i Përt. 30:11; Job 11:7; Ps. 139:6; Fjalët e Urta 30:18; Isa. 55:8-9; Rom. 11:33).

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Skiconi me fjalët tuaja parimet e kujdesit të përmendura në kapitujt 8 dhe 9.
2. Përkufizoni me fjalët tuaja se çfarë do të thotë në jetën tuaj citimi nga 2 Kor. 9:6 dhe 2 Kor. 9:10.

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

<sup>87</sup> Versioni në shqip është: “merrni pjesë me ta”. (shënim i përkthyesit)

<sup>88</sup> Versioni në shqip është: “të veçantë”. (shënim i përkthyesit)

## 2 KORINTASVE 10

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Pali Mbron Shërbesën e Tij 10:1-6	Lufta Frymërore 10:1-6 Realiteti i Autoritetit të Palit	Një Thirrje për Apostullat të Vërtetë 10:1-6	Pali Mbron Shërbesën e Tij 10:1-6	Përgjigja e Palit ndaj Akuzave të Dobësisë 10:1-11
10:7-11	10:7-11 Kufijtë e Autoritetit të Palit	10:7-11	10:7-11	Përgjigja e Tij ndaj Akuzave të Ambicjes 10:12-18
10:12-18	10:12-18	10:12-18	10:12-16 10:17-18	10:12-18

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### NJOHURI KONTEKSTUALE

- A. Kapitujt 10 deri në 13 formojnë një njësi letrare ku Pali mbron vetveten përkundrejt akuzave të mësuesve të rremë. Mësuesit e rremë e kishin bërë vetë Palin thelbin e argumentit. Prandaj, duke ngurruar, ai mbron veten mbi baza njerëzore, duke përdorur fjalët e tyre dhe stilin e tyre retorik. Qëllimi i tij përfundimtar ishte të mbronte ungjillin.
- B. Disa shembuj të akuzave të bëra ndaj Palit.
  - a. Ai ishte i përunjur kur përballej personalisht, por i guximshëm në letrat e tij, 2 Kor. 10:1,9,11.
  - b. Ai po sillej duke u bazuar mbi motivet më të ulta njerëzore, 2 Kor. 10:2.
  - c. Dukja e tij e personale nuk ishte e kënaqshme dhe retorika e tij ishte e varfër, 2 Kor. 10:2,10
  - d. Ai predikonte thjesht për para, 2 Kor. 11:8,12; 12:16
- C. Armiqtë e Palit
  - a. Duket se janë tre grupe të përfshira.
    - i. Një kontigjent korintas vendas (grupimet e 1 Korintasve 1-4)
    - ii. Një kontigjent hebraik nga Palestina (i ngjashëm me judaizerët, 2 Kor. 10-13).
    - iii. Ndoshta një hibrid i të dy grupeve
  - b. Nga 1 Korintasve duket se janë grupet që e sulmojnë atë për dhe nga pozita opozitare
    - i. Një grup legalist (asketicizmi)



## ii.Një grup antinomian (liberalët)

- D. Për shkak se Pali përmend disa letra që ai mund t'i ketë shkruar kishës në Korint, të cilat dukshëm nuk janë ruajtur, ka pasur shumë spekulim studiuesish mbi 2 Korintasve se është një përbërje e këtyre letrave të humbura. Është sigurisht e vërtetë që përdorimi i Palit i formës aoriste epistolare në referencë ndaj letrave të tij të ndryshme ka shkaktuar konfuzion sikurse edhe njësitë dukshëm të ndryshme letrare të cilat e përbëjnë 2 Korintasve, letër e cila shpesh duket se nuk përmban një rregull kronologjik dhe racional.

Është sigurisht e mundur që shkëputjet të jenë shkaktuar nga Pali që shkruante këtë letër përgjatë një periudhe kohe dhe se informacioni vazhdonte të arrinte pasi ai kishte shkruar një njësi letrare. Letra fillon me një konfirmim pozitiv, por më pas kthehet negative.

Personalisht, mundësia që disa nga letrat e Palit të kenë humbur nuk më shqetëson (ndoshta ato përmbanin informacion që Fryma nuk dëshironte që të bëheshin Shkrime), por natyra e përbërë e propozuar e 2 Korintasve, e cila nuk ka provë në traditën e dorëshkrimit grek ose në traditën e kishës, por është thjesht spekulimi i studiuesve modernë perëndimorë ajo që më shqetëson! Ne nuk duhet t'i sforcojmë mendimtarët dhe shkrimtarët antikë lindorë në kategoritë letrare moderne perëndimore.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 10:1-6

<sup>1</sup> Personalisht unë, Pali, po ju këshilloj me anë të zemërbutësisë dhe të mirësisë së Krishtit; unë, që kur ndodhem vetë midis jush jam i përunjur, ndërsa kur jam larg jush tregohem i guximshëm ndaj jush. <sup>2</sup> Ju lutem, që, kur të vij te ju, të mos jem i detyruar të veproj me guxim me atë siguri, me të cilin mendoj të guxoj kundër disave, që na konsiderojnë sikur ecim sipas mishit. <sup>3</sup> Sepse, edhe pse ecim në mish, nuk luftojmë sipas mishit, <sup>4</sup> sepse armët e luftës sonë nuk janë prej mishi, por të fuqishme në Perëndinë për të shkatërruar fortesat, <sup>5</sup> që të hedhim poshtë mendimet dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë dhe t'ia nënshtrijmë çdo mendim dëgjuesës së Krishtit, <sup>6</sup> dhe jemi gati të ndëshkojmë çdo mosbindje, kur të bëhet e përkryer bindja juaj.

**10:1 “Personalisht unë, Pali, po ju këshilloj”** Pali nuk përdor formën “ne” të kapitujve të mëparshëm për shkak se ai po e mbron veten personalisht përpara akuzave të mësuesve të rremë. Pali përdori *autos* dhe *ego* (shih 2 Kor. 12:13; Rom. 7:25; 9:3; 15:24; dhe tek Gal. 5:2 *egō* dhe *Paulos*) për të theksuar se kjo ishte lutja e tij personale. Për “këshilloj / nxis”, shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:4-11.

▣ **“me anë të zemërbutësisë dhe të mirësisë së Krishtit”** Pali përdori qëndrimin dhe metodologjitë e duhura edhe me këta mësues të rremë (shih Mat. 11:29). Zemërbutësia nuk shihej si një virtut nga mendimtarët grekë (dmth., Sokrati, Aristoteli, Stoikët). Kjo reflekton një nga kritikata e tyre ndaj Palit. M. R. Vincent në *Word Studies* [Studime Fjalësh], vëll. 2, pranon se në Septuagintë “zemërbutësi” (*praus*, 2 Kor. 10:1), “zemërbutë” (*tapeinos*, 2 Kor. 10:1), dhe “i varfër” (*penēs*, v 9:9) përdoren për të përkthyer të njëjtën fjalë në hebraisht. Ato vënë në kontrast i pasur dhe i fuqishëm ndaj i ulët dhe i shtypur (fq. 832).

▣ **“kur ndodhem vetë midis jush jam i përunjur, ndërsa kur jam larg jush tregohem i guximshëm ndaj jush”** Ky vlerësim mund t'i referohet letrës së ashpër të Palit që ishte humbur (shih 2 Kor. 1:9-11). Vini re lojën e tij ndaj konceptit të “zemërbutësisë”. Ai e quan Krishtin zemërbutë (dmth., *praus* i përdorur për Mesian tek Mat. 21:5 dhe për besimtarët tek Mat. 5:5; 1 Pjet. 3:4,15). Në këtë frazë ai përdor sinonimin *tapeinos* (shih Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greqisht-Englisht], vëll. 1, fq. 748), i cili gjithashtu përdoret për Jezusin (shih Mat. 11:29) dhe për Palin (shih 2 Kor. 11:7; 12:21).

▣ **“i guximshëm”** Shih shënimin tek 2 Kor. 5:6.

**10:2 “Ju lutem”** Ky është termi në greqisht *deomai*, i cili do të thotë të kërkosh me urgjencë ose të lutesh. Ai është sinonim me termin (dmth., *parakaleō*, shih Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greqisht-

Anglisht], vëll. 1, fq. 408) që Pali përdori tek 2 Kor. 10:1 (shih 2 Kor. 2:8; 5:20; 6:1; 8:6; 9:5; 12:8,18; 13:11). Ai po lutet me urgjencë me këta besimtarë që të rivlerësojnë atë që ata kanë dëgjuar nga mësuesit e rremë.

▣ **“që, kur të vij te ju”** Pali nuk dëshironte të rikthehej në Korint deri sa gjërat të kishin ndryshuar. Ai nuk dëshironte që të ishte i guximshëm, por i butë.

▣ **“të mos jem i detyruar të veproj me guxim me atë siguri, me të cilin mendoj të guxoj kundër disave”** Kjo është një lojë me fjalën në greqisht për “mish”. Mësuesit e rremë po e akuzonin Palin se po sillej duke u bazuar mbi qëllimet më të ulëta njerëzore (dmth., në mish). Ndërkohë që Pali pranon se ai është në mish (dmth., trupi fizik, 2 Kor. 10:3), ai fuqishëm pranon se ai nuk po sillet mbi bazë qëllimesh mishore (shih 2 Kor. 1:17; 2:17; 4:3; 7:2; 10:3-4).

Për “siguri” shih shënimin tek 2 Kor. 3:4.

▣ **“mendoj... konsiderojnë”** Kjo është një lojë me fjalën në greqisht *logizomai*. Pali përdor foljen (forma treguese aktive e mesme [deponente]) për të përshkruar mendimet e tij dhe formën pjesore (forma [deponente] e mesme e tashme) për të përshkruar akuzat e rreme të mësuesve të rremë. Ky mundet madje të ketë qënë një term teknik nga Sofistët (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në Mes të Sofistëve]). Shih shënimin e plotë të termit tek 2 Kor. 3:5.

▣ **“ecim”** Kjo është një shprehje në hebraisht për sjelljen e një stili jetese (p.sh., Efe. 4:1,17; 5:2,1).

▣ **“sipas mishit”** Ata po e gjykonin Palin nën dritën e normave të tyre të shoqërisë (shih 1 Kor. 9:8; 15:32; Rom. 3:5; Gal. 1:11; 3:15). Besimtarët kanë një standard të ndryshëm – fjalën e zbuluar të Perëndisë: (1) Dhjata e Vjetër; (2) Krishti; dhe (3) Dhjata e Re. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

**10:3-6** Pali përdor një seri metaforash ushtarake për të përshkruar luftën e përditshme midis të krishterit dhe ligësisë frymërore (shih Rom. 7; 8:3-11). Kjo ligësi frymërore përkufizohet tek 2 Kor. 10:5 si logjikë, urtësi dhe argumentim njerëzor përkundrejt ungjillit (shih Efe. 6:10-18).

**10:3 “në mish”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

▣ **“luftojmë”** Ky është *strateuō*, nga i cili ne marrim termin strategji. Ai përdorej për një ushtar (shih 1 Kor. 9:7; 2 Tim. 2:4) ose metaforikisht për një luftë frymërore (shih këtu dhe tek 1 Tim. 1:18). Gjendet një konflikt i vazhdueshëm në botën frymërore.

**10:4-5** Gjendet një seri gjërash të përmendura tek 2 Kor. 10:4-5 të cilat Pali i sulmon.

1. Shkatërrimi i fortesave (*ochurōma*)
2. Shkatërrimi i mendimeve (*logizomai*)
3. Shkatërrimi i çdo lartësie (*huphōma*)
4. Nënshtrimi i çdo mendimi (*noēma*)

Këto gjëra ndoshta i referohen retorikës së sofistëve, të cilën Pali e kishte zhvlerësuar tek 1 Kor. 1-4 (shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në Mes të Sofistëve], fq. 180-202).

**10:4 “armët e luftës sonë”** Pali ka aluduar ndaj kësaj lufte frymërore më parë tek 2 Kor. 6:7. Libri i Romakëve u shkrua nga Korinti rreth së njëjtës kohë. Ai gjithashtu përmend këtë luftë tek Rom. 6:13 dhe 13:12. Pali përdor 1 Pjet. 4:1, ku ai inkurajon besimtarët që të armatosin vetveten në luftërat e tyre me mishin.

Një burim i mirë në këtë aspekt është libri *Three Crucial Questions About Spiritual Warfare* [Tri Pyetje Thelbësore mbi Luftën Frymërore] nga Clinton E. Arnold, i publikuar nga Baker.

▣ **“për të shkatërruar fortesat”** Ky mund të jetë një aludim ndaj Fjalëve të Urta 21:22 (konteksti më i madh tek 2 Kor. 10:13-31). Ka pasur shumë diskutim mes komentatorëve mbi kuptimin e kësaj fraze, por është e dukshme se 2 Kor. 10:5 është një përshkrim se cilave fortesa frymërore po i referohet Pali. Duket se ai po i drejtohet teologjisë së rreme të mësuesve të rremë.

<b>10:5</b>	
<b>NASB</b>	“të shkatërrojmë spekulimet”
<b>NKJV</b>	“të hedhim poshtë mendimet”
<b>NRSV</b>	“të shkatërrojmë argumentet”
<b>TEV</b>	“të tërheqim poshtë”
<b>NJB</b>	“janë idetë që ne thyejmë”

Shih shënimin tek 2 Kor. 3:5.

<b>NASB</b>	“dhe çdo gjë e lartë”
<b>NKJV</b>	“dhe çdo lartësi”
<b>NRSV</b>	“dhe çdo pengesë krenare”
<b>TEV</b>	“çdo pengesë krenare”
<b>NJB</b>	“çdo nocion mendjemadhësie”

Kjo është fjala për “lartësi” e përdorur në kuptimin e mendimit krenar njerëzor. Kjo reflekton mbi-theksimin e mësuesve të rremë ndaj

1. Njohurisë dhe arsyetimit njerëzor (shih 1 Kor. 1:18-25; Kol. 2:8)
2. Legalizmi (shih Kol. 2:16-23)

▣ **“t’ia nënshtrojmë çdo mendim dëgjësës së Krishtit”** Folja është një përbërje e “kursej” dhe “zë rob në betejë”. Mësuesit e rremë po zinin rob mendimin dhe mendjet e besimtarëve korintas. Pali dëshiron që ne të “ripërtërijmë mendjet tona” (shih Rom. 12:2; Efe. 4:23); mbrojmë mendjet tona (shih Fil. 4:7). Shpëtimi është falas, por jeta e krishterë karakterizohet nga bindja, shërbesa, adhurimi dhe qëndrueshmëria. Këto janë përgjegjësitë e besëlidhjes. Gjendet një konflikt i vazhdueshëm!

Pali përdor fjalën “mendim” (*noëma*) shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 2:11; 3:14; 4:4; 11:3), por vetëm një herë tjetër, tek Fil. 4:7. Mbi-theksimi korintas ndaj njohurisë mund të ketë qënë arsyeja për përdorimin e tij të përsëritur të këtij termi. Tek *The Analytical Greek Lexicon Revised* [Leksikoni Greqisht Analitik i Rishikuar], Harold K. Moulton, rendit disa ngjyime (fq. 280).

1. Mendja, të kuptuarit, intelekti – 2 Kor. 3:14; 4:4
2. Zemra, shpirti, dhembshuritë, ndjenjat, gatishmëria – 2 Kor. 11:3
3. Një koncept i mendjes, mendimit, qëllimit, pajisjes – 2 Kor. 2:11; 10:5

**10:6** Pali i paralajmëron mësuesit e rremë dhe ndjekësit e tyre se dita e tyre e vlerësimit po vjen. Ata e akuzonin atë se ishte i dobët, por ata thjesht keqkuptonin durimin e tij ndaj tyre (1) për hir të Krishtit dhe (2) për shëndetin e përbashkët të kishës. Pali po e paralajmëron këtë kishë që të trajtojë problemet e saja përpara se ai të mbërrijë ose përndryshe ai do të merret me to (shih 1 Kor. 5:3-5).

#### **VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 10:7-11**

<sup>7</sup> A i shihni gjërat sipas pamjes së jashtme? Në qoftë se dikush është i bindur në veten e tij se është i Krishtit, le ta mendojë këtë përsëri nga vetja e tij: sikurse ai është i Krishtit, ashtu edhe ne jemi të Krishtit. <sup>8</sup> Edhe, nëse unë do ta mburrja veten më tepër për autoritetin tonë, që Zoti na dha për ndërtimin tuaj dhe jo për shkatërrimin tuaj, nuk do të turpërohesha. <sup>9</sup> Nuk dua të dukem se po kërkoj t’ju tremb me letrat e mia. <sup>10</sup> Sepse dikush thotë: “Letrat e tij janë të ashpra dhe të fuqishme, kurse paraqitja e tij trupore është e dobët, dhe fjala e tij ka pak peshë.” <sup>11</sup> Le ta dijë, pra, ai njeri, se ashtu si jemi në fjalë, me anë të letrave kur jemi larg, të tillë do të jemi edhe me vepra, kur të jemi të pranishëm.

**10:7 “Ju po i shihni<sup>89</sup>”** Në gjuhën greke forma e zgjedhur mund të jetë një formë urdhërore (shih NRSV, NJB) ose treguese (shih NASB, TEV, NIV). Versionet NKJV dhe ASV e përkthejnë atë si një pyetje. Kisha në Korint po analizonte dhe kritikonte mbi një nivel mishi / bote / fizik në vend të një fokusi tek ungjilli.

<sup>89</sup> Versioni në shqip është në formë pyetjeje: “A i shihni...?” (shënim i përkthyesit)

▣ **“Në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Kishte disa kisha në Korint që mashtronin vetveten (shih 1 Kor. 14:37) për sa i përket kushteve dhe gjendjes së tyre frymërore (dmth., “është e sigurtë”, forma treguese aktive e përkryer).

▣ **“veten e tij”** Pali përdor këtë term, *eautou*, dy herë në këtë varg. Këta mësues të rremë kishin mashtruar vetveten. Kjo është gjëndja frymërore më e vështirë me të cilën të arsyetosh apo tek e cila të kesh ndikim.

▣ **“sikurse ai është i Krishtit, ashtu edhe ne jemi të Krishtit”** Mësuesit e rremë po pretendonin autoritetin dhe gjendjen e tyre frymërore, por po mohonin atë të Palit.

**10:8 “nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm (shih 2 Kor. 11:1-12:13).

▣ **“mburrja”** Ky term (dmth., *kauchaomai* dhe format e tij) përdoret aq shpesh nga Pali në letrat e tij ndaj korintasve.

1. *kauchaomai* (lavdi, mburrje, shih 1 Kor. 1:29,31; 3:21; 4:7; 13:3; 2 Kor. 5:12; 7:14; 9:2; 10:8,13,15,16,17; 11:12,16,18,30; 12:1,5,6,9)
2. *kauchēma* (shih 1 Kor. 5:6; 9:15,16; 2 Kor. 1:14; 5:12; 9:3)
3. *kauchēsis* (shih 1 Kor. 15:31; 2 Kor. 1:12; 7:4,14; 8:24; 11:10,17)

Shih shënimin e plotë në përdorimin e fjalës tek 2 Kor. 1:12 dhe Temën e Veçantë tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“për autoritetin tonë, që Zoti na dha”** Kjo i referohet përvojës së Palit në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:15,16; Rom. 1:5; Gal. 2:9).

▣ **“për ndërtimin tuaj dhe jo për shkatërrimin tuaj”** Pali e përsërit këtë frazë tek 2 Kor. 13:10. Kjo është e ngjashme me thirrjen e Isaia (shih Isaia 6) dhe Jeremias (shih Jeremia 1), përveçse ata u thirrën për t’i bërë të dyja! Pali përdor të njëjtën folje (dmth., *kathairesis*), të cilën ai e përdori tek 2 Kor. 10:4 (dy herë) për shkatërrimin e fortesave të arsytimit njerëzor. Pali është thirrur të shkatërrojë disa gjëra dhe ide, por jo vetë kishën. Ai është thirrur ta mbrojë dhe ruajë kishën (shih 2 Kor. 10:9). Shih TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ / SPECIAL TOPIC: EDIFY tek 1 Kor. 8:1.

▣ **“nuk do të turpërohesh”** Pali do ta mbrojë vetveten për shkak se mësuesit e rremë e kishin gjykuar atë. Ai mbron vetveten për të mbrojtur (1) autoritetin që i ishte dhënë dhe (2) ungjillin që ai predikonte. Kjo mund të reflektojë premtimet e Perëndisë në Dhjatën e Vjetër (shih Rom. 9:33 dhe 10:11, duke cituar Isa. 28:16), ku ata që besojnë tek Perëndia nuk do të turpërohen apo zhgënjehen. Pali e dinte se tek Kush besonte! Edhe nëse Pali ishte mburrur së tepërmi (shih NRSV, TEV) në thirrjen e tij dhe caktimin e tij, ajo ishte ende e vërtetë dhe Perëndia do ta mbronte atë! Ata që refuzojnë autoritetin e Palit janë të dënuar (shih 1 Kor. 14:37-38).

**10:9** Letrat e Palit kishin për qëllim të nxisnin pendesën e tyre dhe jo të sillnin dënim (shih 2 Kor. 7:5-13a). Por për mësuesit e rremë ndryshonte çështja (shih 2 Kor. 10:8,11; 13:10).

**10:10 “Sepse ata thonë”<sup>90</sup>** “Ata thonë” ndjek versionet MSS B, Vulgate latin dhe Peshitta (përkthimi siriak i shekullit të pestë). Pjesa më e madhe e dorëshkrimeve të tjera në greqisht kanë “ai / dikush”, që mund t’i referohet një drejtuesi pasues të mësuesve rremë (shih 2 Kor. 10:7,11; 11:4).

▣ **“paraqitja e tij trupore është e dobët”** Një traditë e shekullit të dytë e përshkrimi të pamjes fizike të Palit vjen nga Thesalonika në një pjesë të një libri të titulluar *Paul and Thekla* [Pali dhe Thekla]. Ajo thotë se Pali ishte i shkurtër, pa flokë, me këmbë të harkuara, kishte vetulla të trasha dhe sy të dalë. Pali nuk ishte një burrë tërheqës nga ana fizike (shih Gal. 4:14). Disa nga këto karakteristika mund të lidhen me gjëmbin e tij në mish (shih 2 Kor. 12:7), që mendoj se ishin probleme me sytë, ndoshta lidhur me verbimin e tij në “rrugën për në Damask”.

<sup>90</sup> Versioni në shqip është: “Sepse dikush thotë”. (shënim i përkthyesit)

Ka mundësi që kjo frazë, sikurse fraza pasardhëse, t'i referohen aftësive folëse në publik të Palit, të cilat ishin një çështje madhore kënaqësie (shih 1 Kor. 1:17). Kjo frazë shpesh përdorej për “prani në skenë” (shih Bruce W. Winter, *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali la Korintin], fq. 35).

■ **“dhe fjala e tij ka pak peshë”** Kjo është një formë pjesore pasive e përkryer. Ky është një term i fuqishëm në greqisht (shih 1 Kor. 1:28; 6:4; 16:11; Rom. 14:3,10). Pali nuk ishte një folës i spikatur (dmth., sipas stilit retorik grek, shih 1 Kor. 1:17; 2 Kor. 11:6). Apolli ishte predikuesi nga Aleksandria, elokuent dhe i trajnuar në retorikë. Megjithatë, Pali pretendon se edhe pse i paaftë në stilin retorik (shih 2 Kor. 11:6), mesazhi dhe autoriteti i tij ishin nga Krishti.

**10:11** Mësuesi(t) e rremë e kishin akuzuar Palin se kishte shkruar letra të forta, por kishte një paraqitje personale të dobët. Pali konfirmon forcën me të cilën ata konfirmonin letrat e tij dhe se ishte e njëjtë me forcën e paraqitjes së tij personale nëse do t'i duhej të vinte personalisht dhe t'i vinte gjërat siç duhej!

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 10:12-18

<sup>12</sup> Sepse nuk guxojmë të renditemi ose të krahasohemi me ata që e rekomandojnë veten e vet; por ata, duke matur veten e tyre dhe duke u krahasuar me veten e tyre, nuk kanë mend. <sup>13</sup> Por ne nuk do të mburremi jashtë masës, po sipas masës së rregullës që caqet i caktoi Perëndia, sa të arrijmë deri te ju, <sup>14</sup> Sepse ne nuk po shtrihemi përtej caqeve, sikurse nuk arritëm deri te ju, sepse ne arritëm më të vërtetë deri te ju me anë të predikimit të ungjillit të Krishtit. <sup>15</sup> Dhe ne nuk mburremi përtej masës për punët e tjetrit, por kemi shpresë se, duke u rritur besimi juaj, ne do të kemi një konsideratë më të madhe ndër ju, sipas cakt tonë, <sup>16</sup> sa që përhapim ungjillin edhe përtej vendeve tuaj, pa u mburrur me ato që janë bërë në këtë lëmë nga të tjerë. <sup>17</sup> Ai që lëvdohet, le të lëvdohet në Zotin, <sup>18</sup> sepse nuk miratohet ai që e rekomandon veten e tij, po ai të cilin e rekomandon Zoti.

**10:12 “por ata, duke matur veten e tyre dhe duke u krahasuar me veten e tyre”** Pali ka aluduar ndaj lavdërimeve njerëzore tek 2 Kor. 3:1 (shih 2 Kor. 10:18); tani ai e zgjeron këtë tek krahasimet njerëzore. Dukshëm këta mësues të rremë po krahasonin vetveten me Palin në një mënyrë të tillë si për të theksuar pozitën e tyre dhe për të zhvlerësuar të tjetren.

Pali e dinte nga studimi i tij i Dhjatës së Vjetër (shih 1 Sam. 16:7; Fjalët e Urta 21:2) se sa e pafrytshme ishte kjo. Ai ndoshta ishte gjithashtu i njohur me mësimet e Jezusit mbi njerëzit që justifikojnë vetveten (shih Luka 10:29; 16:15; 18:9,14).

Gjendet një shënim sarkazme në këtë varg ashtu sikurse është tek 2 Kor. 10:1. Pali përdori këtë formë letrare shpesh tek 1 Korintasit.

Gjendet një lojë e dukshme fjalësh midis dy formave paskajore aoriste aktive.

1. *egkrinai* (en dhe *krinō*), të gjykosh si t'i përkasin të njëjtës kategori
2. *sugkrinai* (sun dhe *krinō*), të gjykosh duke krahasuar

Në kodeksin Bezae (shkrime me shkronja të vogla MS të shekullit të pestë) gjendet një frazë që lihet jashtë në fund të 2 Kor. 10:12 dhe në fillim të 2 Kor. 10:13. Duket se syri i një skribi ka lëvizur nga “ou” tek 2 Kor. 10:12 në “ouk” tek 2 Kor. 10:13 dhe i ka lënë jashtë fjalët ndërhyrëse (“nuk kuptojnë. Por ne nuk do të”). Shih shtojcën e dytë mbi Kritikën e Tekstit. UBS<sup>4</sup> i jep përfshirjes së fjalës një vlerësim “B” (pothuajse i sigurtë).

■ **“nuk kanë mend”** Ky është një pohim mjaft tronditës.

1. Tek filozofët grekë do të zhvlerësonte pretendimin e tyre për njohuri frymërore superiore
2. Tek mendimtarët hebraikë do të ishte një aludim ndaj kafshëve.

**10:13** Pali po aludon ndaj thirrjes dhe mandatit të tij hyjnor (dmth., përjetesës së tij në “rugën për në Damask”, shih Veprat e Apo. 9; 22:3-16; 26:9-18) për të qënë një apostull ndaj johebrenjve. Ai nuk po krahasonte dhe nuk po lëvdohej, por po pohonte thirrjen e Perëndisë.

Thirrja e Perëndisë mbi të si një përfaqësues i veçantë tek johebrenjtë madje përfshinte edhe kishën në Korint (shih 2 Kor. 10:14-15).

■ **“caqet i caktoi Perëndia”** NASB Study Bible [Studimi Biblik NASB] (fq. 1701) ka një koment të mirë mbi këtë frazë.

**10:13** *caqet i caktoi Perëndia*. Pamja që Pali ka në mendje mund të jetë ajo e një konkursi atletik në të cilën korsitë janë të shenjuara për vrapues të ndryshëm. Në atë rast ‘caqe / sferë’ duhet të përkthehet ‘korsi’ (gjithashtu tek 2 Kor. 10:15-16). Në përzierjen e tyre në Korint, apostujt e rremë kishin kaluar në korsinë e Palit, që ishte korsia që Perëndia kishte shenjuar dhe që e kishte sjellë atë tek korintasit si apostulli i tyre i singertë. Ai nuk ka asnjë qëllim që të pushtojë territorin e caktuar për të tjerët dhe të pretendojë se vepra e tyre është e tija, sikurse po bënin këta mësues të rremë. Të tjerë e kuptojnë fjalën greke si pyetje për t’iu referuar një sferë autoriteti të caktuar.”

**10:14** **“Sepse ne nuk po shtrihemi përtej caqeve”** Kjo është një tjetër fjalë e përbërë *“huper”*, *huperekeinō*. Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul’s Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

■ **“sepse ne arritëm të parët<sup>91</sup> deri te ju me anë të predikimit të ungjillit të Krishtit”** Pali ishte themeluesi i kishës korintase, e megjithatë mësuesit e rremë po përpiqeshin të merrnin meritat (shih 2 Kor. 10:18b).

**10:15** **“ne nuk mburremi përtej masës për punët e tjetrit”** Mësuesit e rremë po merrnin merita për kishën korintase, të cilën Pali e themeloi.

**10:16** **“që përhapim ungjillin edhe përtej vendeve tuaj”** Kjo duket se i referohet dëshirës së Palit për të shkuar në Romë dhe / ose Spanjë (shih Veprat e Apo. 19:21; Rom. 15:22 e në vazhdim). Ai dëshironte të themelonte kisha për ta ndihmuar atë si me kontributin për Jeruzalemin dhe t’i mundësonin atij të udhëtonte për në mesdheun perëndimor dhe të themelonte edhe më shumë kisha.

Për “përtej”, kjo është një tjetër fjalë e përbërë *“huper”*, (*huperekeinē*), shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / Special Topic: Paul’s Use of Huper Compounds tek 1 Kor. 2:1.

**10:17** **“Ai që lëvdohet, le të lëvdohet në Zotin”** Ky është një citim nga Septuaginta e Jer. 9:23-24. Ai gjithashtu citohet tek 1 Kor. 1:31. E gjithë mburrja njerëzore është marrëzi. Shih TEMË E VEÇANTË: MBURRJA / Special Topic: Boasting tek 2 Kor. 1:12.

**10:18** Pyetja kryesore është se cilin grupim, mësues apo teologji miraton Jezusi (shih 1 Kor. 4:1-5).

## PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Shpjegoni shkëputjen e dukshme midis kapitujve 9 dhe 10.
2. Cilat ishin disa nga akuzat e mësuesve të rremë ndaj Palit?
3. Pse Pali përdor terma ushtarakë për të përshkruar luftën e tij kundër mësuesve të rremë?
4. A ishin mësuesit e rremë të krishterë të singertë që thjesht po bënin gabim mbi çështje të vogla të teologjisë apo ishin ata drejtues kultesh që po përpiqeshin të keqdrejtonin njerëzit nga e vërteta e Ungjillit?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

<sup>91</sup> Kjo fjalë mungon në versionin në shqip, por është: “më të vërtetë”. (shënim i përkthyesit)

## 2 KORINTASVE 11

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Pali dhe Apostujt e Rremë	Shqetësim për Besnikërinë e Tyre	Përgjigja e Palit ndaj Kundërshtarëve	Pali dhe Apostujt e Rremë	Pali Shpall Lavdërimet e Tij (11:1-12:18)
11:1-6	11:1-4 Pali dhe Apostujt e Rremë 11:5-15	11:1-6	11:1-4  11:5-6	11:1-6
11:7-11		11:7-11	11:7-11	11:7-15
11:12-15		11:12-15	11:12-15	
Vuajtja e Palit si Apostull	Mburrje Ngurruese		Vuajtja e Palit si Apostull	
11:16-29	11:16-21 Vuajtja për Krishtin  11:22-33	11:16-21a  11:21b-29	11:16-21a  11:21b-29	11:16-21a  11:21b-29
11:30-33		11:30-33	11:30-33	11:30-33

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

#### **NJOHURI KONTEKSTUALE**

- A. 2 Korintasve 10-13 formojnë një njësi letrare. Në këtë seksion që është kaq i ndryshëm nga kapitujt e tjerë të 2 Korintasve, Pali e mbron vetveten ndaj sulmeve të mësuesve të rremë. Ata e kishin bërë vetë Palin objektin e talljes në përpjekjet e tyre për të diskretitur ungjillin e tij.
- B. Pali iu përgjigjet akuzave të kritikëve të tij në kapitujt 2 Kor. 11:4,8,12-15,18-20.
- C. Pali përdor ironinë dhe sarkazmën për të shkundur kujtesën e të krishterëve korintas në lidhje me shërbesën e tij (shih 2 Kor. 11:5, 7, 19, 20, 21).

#### **STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE**

## VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:1-6

<sup>1</sup> Oh, sa do të dëshiroja që ju të duronit pak marrëzi me mua! Po në fakt, ju më duroni. <sup>2</sup> Jam xheloz për ju me xhelozinë e Perëndisë, sepse ju fejova me një burrë, që t'ju nxjerr para Krishtit si virgjëreshë të dliërë. <sup>3</sup> Por druaj se, ashtu si gjarpëri e gënjeu Evën me dinakërinë e tij, kështu edhe mendja juaj të mos priset duke u shmangur nga thjeshtësia ndaj Krishtit. <sup>4</sup> Sepse, po të vinte dikush dhe t'ju predikonte një Jezus tjetër, që ne nuk e kemi predikuar, ose, po të merrnit një frymë tjetër që nuk e keni marrë, ose një ungjill tjetër që nuk e keni pranuar, do ta duronit fort mirë. <sup>5</sup> Unë mendoj se nuk kam qenë aspak më poshtë nga apostujt më të shquar. <sup>6</sup> Dhe, megjithëse jam i thjeshtë në të folur, nuk jam i tillë në dituri; madje me të gjitha mënyrat dhe në të gjitha gjërat jua kemi treguar.

**11:1 “sa do të dëshiroja që ju të duronit ... me mua”** Kjo është një formë treguese e mesme e papërkryer. Forma e mesme i përputhet hyrjes personale theksuese në kapitullin 10. Koha e përkryer mund të nënkuptojë (1) veprim të përsëritur në të shkuarën ose (2) fillimin e një veprimi. Opsioni i dytë i përshtatet më mirë kontekstit. Shih shënimin e plotë mbi “duroj” tek 2 Kor. 11:4.

▣ **“pak marrëzi”** Pali ka pohuar më parë se krahasimi fizik është marrëzi, por mësuesit e rremë e kishin përdorur atë si objektin e talljes. Prandaj, ai përdor stilin retorik të Sofistëve (dmth., mburrjen) kundër tyre (dmth., një parodi sarkastike). Ai duhej ta mbronte vetveten përpara kësaj kishe për të mirën e tyre. Ai ndihej i marrë teksa i duhej ta bënte këtë sikurse e konfirmojnë dhe vargjet 17 dhe 21.

▣ **“ju më duroni”** Kjo është ose një formë treguese e mesme e tashme (NASB, NKJV, NJB) ose një formë urdhëruese e mesme e tashme (NRSV, TEV). Gjenden tri arsye të përmendura tek 2 Kor. 11:2, 4, 5 se përse ata duhet të dëgjojnë. Secila nga këto arsye paraqitet me fjalën “për”, “sepse” ose “që”<sup>92</sup> (*gar*).

**11:2 “ju fejova me një burrë, që t'ju nxjerr para Krishtit”** Pali, si themelues i kësaj kishe, po sillet si një prind që i fejon ata tek Krishti (shih Efe. 5:22-33; Zbu. 19:9; 21:2,9; 22:17). Ideja e Dhjatës së Vjetër për Perëndinë si bashkëshort gjendet tek Isa. 54:5; 62:5; dhe Osea 1-3; 11:1-4.

▣ **“që t'ju nxjerr para Krishtit si virgjëreshë të dliërë”** Kjo është terminologjia e Dhjatës së Vjetër për një ceremoni martesore. Pali e përsërit po këtë temë tek Efe. 5:25-27. Pali në mënyrë të tërthortë po qorton të krishterët korintas që i dëgjojnë mësuesit e rremë shëtitës. Në një farë kuptimi ata që i mbështesnin ata ishin bërë frymërisht jobesnikë (dmth., tradhëti frymërore sipas Dhjatës së Vjetër).

**11:3 “ashtu si gjarpëri e gënjeu Evën me dinakërinë e tij”** Kjo i referohet tundimit të gjendur tek Zanafilla 3 (shih 1 Tim. 2:14). Kujtoni se gjarpëri e drejtoi Evën larg nga YHWH me hapa të vegjël që çonin në pavarësi vetë-konfirmuese!

Termi gënjeu (*exapataō*) përdoret vetëm nga Pali në Dhjatën e Re (shih Rom. 7:11; 16:18; 1 Kor. 3:18; 2 Kor. 11:3; 2 Thes. 2:3; 1 Tim. 2:14). Forma e intensifikuar, *apataō*, përdoret në Septuagintën e Zan. 3:13 për Evën. Pali e përdor atë tek Efe. 5:6 dhe 1 Tim. 2:14 (dy herë). Mashtrimi vjen si nga brenda ashtu edhe së jashtmi. Besimtarët duhet të jenë vazhdimisht vigjilentë.

Termi dinakëri (*panourgia*) është një fjalë e përbërë nga “gjithë” (*pan*) dhe “vepër” (*ergon*). Pali e ka përdorur atë dy herë përpara letrave të tij korintase (shih 1 Kor. 3:19; 2 Kor. 4:2). Pali e kuptonte luftën frymërore me të cilën duhej të përballëshin besimtarët (shih Efe. 4:14). Ai i pohon qartazi rezultatet e ligësisë mbi njerëzimin tek Romakëve 1-3 dhe mbi besimtarët tek Romakëve 7; Efe. 6:10-19. Teologjia e Palit fillon me rebelimin engjëllor dhe njerëzor. Shih TEMË E VEÇANTË: PLANE (TEK PALI) / SPECIAL TOPIC: SCHEMES tek 2 Kor. 2:11.

▣ **“kështu edhe mendja juaj të mos priset”** Folja *phtheirō* është një formë lidhore aoriste pasive. Në një aludim të mëtejshëm ndaj Zanafillës 3, Pali e përdor këtë term disa herë për “shkatërroj” ose “prish” në kuptimin moral (shih 2 Kor. 7:2; 11:3; 1 Kor. 3:17; 15:33; Efe. 4:22). Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:42. Besimtarët mund të mashtrohen, manipulohen dhe mposhten nga i ligu!

▣ **“nga thjeshtësia”** Shih shënimin tek 2 Kor. 1:12.

<sup>92</sup> Në anglisht janë të trija me fjalën “for”. (shënim i përkthyesit)



▣ **“dhe pastërtia”<sup>93</sup>** Gjendet një variant dorëshkrimi grek i cili shton “dhe pastërtia”. Ai gjendet tek MSS P<sup>46</sup>, s\*, B dhe G (shih NASB, NRSV, TEV, NIV). Ai mungon tek dorëshkrimet MSS s<sup>c</sup>, D<sup>c</sup>, H, K dhe P (shih NKJV, NJB, REB). Dorëshkrimi MS D\* nuk ka shtesë tjetër, por termat janë në rendin e anasjelltë. Studiuesit tekstualë ndahen për sa i përket mendimit se cili është origjinali. Përfshirja e “pastërti” rinis tek 2 Kor. 11:2 dhe përfshihet në disa dorëshkrime antike mjaft të mira dhe gjeografikisht të ndryshme.

NASB	<b>“nga përkushtimi ndaj Krishtit”</b>
NKJV	<b>“që është në Krishtin”</b>
NRSV, TEV, NJB, NIV	<b>“përkushtimit ndaj Krishtin”</b>

Parashtesa në rasën rrjedhore, *apo*, paraqet tre objekte.

1. Nga thjeshtësia
2. Nga pastërtia
3. Nga “ndaj Krishtit”

Cilës i referohet vargu 2 Kor. 11:3? Disa përkthime në anglisht japin “përkushtim”, por mund t’i referohej “në Krishtin”, që është fraza e famshme e Palit për besimin personal në Krishtin.

**11:4 “po të vinte dikush”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga perspektiva e autorit ose për qëllimet e tij letrare. “Dikush” duket se i referohet mësuesit të rremë kryesor ndaj të cilit aludohet tek 2 Kor. 10:7,10.

▣ **“një Jezus tjetër, që ne nuk e kemi predikuar”** Këta mësues të rremë nuk kishin mosmarrëveshje mbi disa çështje periferike, të vogla, por mbi personin dhe veprën e Jezus Krishtit (shih 1 Kor. 3:11). Është e dukshme kur mbliidhen të gjitha provat së bashku se këta mësues të rremë ishin një përzierje e të dy grupeve, judaizerëve si në librin e Galatasve dhe helenistëve (dmth., sofistët). Këta surrogatë nga Jeruzalemi kishin hequr theksin e rrethëprerjes, ndoshta për shkak të gjetjeve të Këshillit të Jeruzalemit tek Veprat e Apostujve 15, por ata vazhduan legalizmin e tyre hebraik në një farë mënyre duke e kombinuar atë ose duke e rafinuar atë me mendimin helenistik (dmth., sofistët).

Ka mundësi që Pali po përdor akuzat e mësuesve të rremë ndaj tij. Ata mund ta kenë akuzuar atë se kishte “predikuar një ungjill tjetër”.

Ne që besojmë se Bibla është fjala e frymëzuar e Perëndisë kemi disa pyetje për t’iu përgjigjur.

1. A e lexojmë ne Dhjatën e Re përmes syve të Dhjatës së Vjetër apo ka Dhjata e Re një epërsi interpretative?
2. A janë fjalët e Palit (apo të kujtdo autori të Dhjatës së Re) po aq të frymëzuara sa fjalët e Jezusit?
3. A lejon prania e “pak” diversiteti mes autorëve të Dhjatës së Re që interpretuesit modernë të kenë pak “hapësirë për të luajtur” me disa çështje? A lejojmë ne të njëjtën gjë mes interpretuesve të kishës së hershme (dmth., Etërit Grek dhe Latin të kishës; më pas drejtuesit e kishës [Agustini, Aquinas, Luteri, Kalvini, etj.]?) Ose për ta thënë ndryshe, si e kuptojmë (përkufizojmë, kufizojmë) ortodoksinë?

▣ **“po të merrnit një frymë tjetër që nuk e keni marrë”** Disa e shohin këtë si një referencë ndaj Frymës së Shenjtë (shih Gal. 4:6; TEV), por duket më e preferueshme ta lidhësh këtë ose me (1) “frymën e frikës dhe të skllavërisë” (shih Rom. 8:15; 2 Tim. 1:7) ose (2) “frymën e paqes dhe të gëzimit” (shih Rom. 14:17). Për një shënim më të plotë mbi “frymë” shih 1 Kor. 2:11.

Termi “tjetër” është *heteros*, që do të thotë i një lloji tjetër. Pali po vë në kontrast mesazhet e mësuesve të rremë me mesazhin e tij (shih Gal. 1:6). Ka shumë ngjashmëri midis problemeve të përmendura tek Gal.1:6-9 dhe këtu.

▣ **“marrë... pranuar”** Foljet në greqisht *lambanō* dhe *dechomai* janë sinonime. Kuptimet bazë të të dyjave janë që të rrokësh diçka. Dy shënimet tek *Greek-English Lexicon* [Leksikoni Greqisht-Anglisht] i Louw dhe Nida janë të dobishme.

1. “të marrësh ose të pranosh një objekt apo përfitim për të cilin iniciativa qëndron tek dhënësi, por fokusi i vëmendjes së transferimit të jetë tek marrësi” (fq. 572).

<sup>93</sup> Kjo pjesë mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

2. Shënimi 31, “Mund të gjendet një dallim i hollë në kuptimin midis *dechomai* dhe *lambanō* ku e dyta nënkupton një pjesëmarrje më aktive nga ana e atij që merr dhuratën, por kjo nuk mund të përcaktohet nga kontekstet ekzistuese” (fq. 572).

Për mua si një i krishterë ungjillor, këta terma janë thelbësorë për një përgjigje të duhur ndaj ungjillit (shih Gjoni 1:12). Premtimet e Perëndisë, veprat e Krishtit dhe nxitjet e Frymës duhet të marrin një përgjigje nga njerëzit që është si fillestare ashtu edhe e vazhdueshme. Kjo formon bazën e konceptit të besëlidhjes (dmth., Perëndia inicicion, por njerëzit duhet të përgjigjen).

*Lambanō* është e përsëritur në këtë kontekst (shih 2 Kor. 11:4,8,20,24; 12:16).

<b>NASB</b>	<b>“ju e duroni këtë shumë bukur”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“do ta duroni fort mirë”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“ju i nënshtroheni asaj mjaft me gatishmëri”</b>
<b>TEV</b>	<b>“ju toleroni me gëzim”</b>
<b>NJB</b>	<b>“dhe ju e duroni atë me tepër gatishmëri”</b>

Kjo është ose një formë urdhërore e mesme e tashme ose një formë treguese e mesme e tashme. Kjo është sarkazëm e hidhur e drejtuar tek gatishmëria e të krishterëve korintas për të dëgjuar këta mësues të rremë. Pali e përdor këtë term, *anechomai*, disa herë në këtë kapitull (shih 2 Kor. 11:1,4,10,20). Tek 2 Kor. 11:1 ai përdoret në kuptimin e “qëndroj” (shih 1 Kor. 4:12), por tek 2 Kor. 11:4,19,20 ai përdoret në mënyrë sarkastike në kuptimin e “toleroj”.

**11:5 “Unë mendoj se”** Në këtë njësi letrare Pali përdor këtë folje shpesh *logizomai* (shih 2 Kor. 10:2,7,11; 11:5; 12:6). Ajo mund të ketë qënë një fjalë kapëse ose një term i përdorur shpesh i mësuesve të rremë sofistë.

☐ **“nuk kam qenë aspak më poshtë”** Folja në këtë frazë është në formën paskajore aktive të përkryer. Në asnjë kohë, të shkuar apo të tashme, Pali nuk mendon për vetveten si më pak se këta përfaqësues të supozuar autoritativë nga Jeruzalemi (shih 2 Kor. 12:11). Kjo pikëpamje diskutohet gjithashtu tek Gal. 1:11-2:14, ku Pali mbron apostullatin e tij.

<b>NASB, NKJV</b>	<b>“ndaj apostujve më të shquar”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“ndaj këtyre super-apostujve”</b>
<b>TEV</b>	<b>“ndaj këtyre apostujve tuaj ashtu-quajtur shumë të veçantë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“ndaj super-apostujve”</b>

Ky përshkrim sarkastik është një kombinim i dy termave grekë, *huper* (dmth., mbi dhe përtej) dhe *lian* (dmth., i madh ose shumë). Kjo frazë përshkruese është e rrallë dhe Pali e përdor atë vetëm këtu dhe tek 2 Kor. 12:11. Vargu 5 është i lidhur nga ana kontekstuale dhe gramatikore me 2 Kor. 11:4, i cili dukshëm i referohet mësuesve të rremë (shih 2 Kor. 11:13-15). Pali po përdor termin “apostuj” në mënyrë sarkastike në dy kuptimet e tij: (1) të Dymbëdhjetët dhe (2) lajmëtarë të dërguar nga kishat (shih 2 Kor. 11:13). Dukshëm, këta mësues të rremë kishin disa lidhje me kishën në Jeruzalem (2 Kor. 11:22 nxjerr si konkluzion se ata pretendonin një sfond hebraik; 12:1 tregon se ata pretendonin përvoja karizmatike).

☐ **“më të shquar”** (*huperlian*) Shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / SPECIAL TOPIC: PAUL'S USE OF HUPER COMPOUNDS tek 1 Kor. 2:1.

**11:6 “Dhe, megjithëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Pali pranonte përpara tyre se retorika greke nuk ishte një nga pikat e tij të forta. Forca e tij ishte përmbajtja e frymëzuar e mesazheve të tij.

☐ **“i paaftë<sup>94</sup> në të folur”** Ky term përdoret në kuptimin e “i patrajnuar” ose “amator” (shih Veprat e Apo. 4:13, ku ai përdoret për Pjetrin dhe Gjonin ose 1 Korintasve 14, ku ai përdoret për ata që janë të pamësuar në dhuntitë frymërore). Duket se lidhet me rrëfimin e Palit se ai nuk ishte i aftë në retorikë (shih 2 Kor. 10:10; 1 Kor. 1:17).

<sup>94</sup> Versioni në shqip është: “i thjeshtë”. (shënim i përkthyesit)

Ky koment, dukshëm nga mësuesit e rremë, tregon se ata nderonin të folurën retorike. Kjo nënkupton një sfond helenistik (dmth., sofistët). Shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali në mes të Sofistëve].

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:7-11**

<sup>7</sup> Mos vallë bëra mëkat duke e ulur veten time që të lartoheni ju, sepse ju kam predikuar falas ungjillin e Perëndisë? <sup>8</sup> Unë shfrytëzova kishat e tjera, duke marrë një rrogë që t'ju shërbej juve. <sup>9</sup> Dhe, kur isha midis jush dhe isha nevojtar, nuk iu bëra barrë askujt; sepse nevojat e mia i plotësuan vëllezërit që erdhën nga Maqedonia; dhe në çdo gjë u ruajta që të mos ju bëhem barrë ju, edhe për të ardhmen do të ruhem. <sup>10</sup> Duke qenë se e vërteta e Krishtit është në mua, kjo mburrje, përsa më përket mua, nuk do të më ndalohet në vendet e Akaisë. <sup>11</sup> Pse? Ndoshta sepse nuk ju dua? Perëndia e di.

**11:7 “Mos vallë bëra mëkat duke e ulur veten time që të lartoheni ju”** Vargu 7 është një pyetje që pret një “jo” si përgjigje. Ky është një shembull tjetër i sarkazmës së Palit të lidhur me kundërshtinë e vazhdueshme ndaj tij për mospranimin e shpërblimit monetar nga kisha korintase (shih 1 Kor. 9:3-18).

Fjala “mëkat” (*hamartia*) përdoret në një kuptim jo-moral për “a bëra një gabim” ose “keqgjykim”. Mbani mend, konteksti, konteksti, konteksti – përcakton kuptimin e fjalëve. Bëni kujdes nga përkufizimet e paracaktuara teologjike të fjalëve që lexoni në çdo ndodhi!

☐ **“ungjillin e Perëndisë”** Vini re se ungjilli i Krishtit (shih 2 Kor. 2:12; 9:13; 10:14) është gjithashtu ungjilli i Perëndisë!

**11:8 “Unë shfrytëzova kishat e tjera”** Grekët dhe romakët ishin mësuar të paguanin mësuesit e tyre në lëvizje, por Pali e dinte se kjo do të ishte burim për kritikizëm nga mësuesit e rremë dhe ai refuzoi të pranojë ndihmë monetare nga kjo kishë (ose nga ndonjë kishë tjetër ndërkohë që ai punonte mes tyre, shih 1 Thes. 2:5-9; 2 Thes. 3:7-9). Pali pranoi ndihmë si nga Filipia dhe nga Thesalonika pasi ai ishte larguar prej tyre (shih Fil. 4:15-18 dhe ndoshta 1 Thes. 3:6). Dukshëm, kjo i lëndonte ndjenjat e kësaj kishë (shih 2 Kor. 11:11; 12:13,14; 1 Kor. 9:12,15,18).

☐ **“kishat”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

☐ **“që t'ju shërbej juve”** Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

**11:10 “Duke qenë se e vërteta e Krishtit është në mua”** Kjo është një formë shprehimore për të konfirmuar vërtetësinë ose sensin e frymëzimit të Palit (shih Rom. 9:1). Shih TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” NË SHKRIMET E PALIT / SPECIAL TOPIC: “TRUTH” IN PAUL'S WRITINGS tek 2 Kor. 13:8.

☐ **“kjo mburrje, përsa më përket mua, nuk do të më ndalohet në vendet e Akaisë”** Ky është një term grek i fortë i cili përdoret në Septuagintë për ngritjen e shtratit të një lumi. Pali refuzoi të merrte para nga kisha korintase dhe me sa duket ai e bëri këtë të ditur publikisht dhe shpesh. Për “mburrje” shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:12.

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:12-15**

<sup>12</sup> Por atë që bëj, do ta bëj përsëri, që t'u pres çdo shkas atyre që duan shkas, që ata të gjenden si edhe ne, në atë gjë, për të cilën mburren. <sup>13</sup> Të tillë apostuj të rremë, janë punëtorë hileqarë, që shndërrohen në apostuj të Krishtit. <sup>14</sup> Dhe nuk është për t'u çuditur, sepse Satanai vet shndërrohet në engjell drite. <sup>15</sup> Nuk është, pra, gjë e madhe, nëse edhe punëtorët e tij shndërrohen në punëtorë (marrin trajtën e punëtorëve) të drejtësisë, fundi i të cilëve do të jetë sipas veprave të tyre.

**11:12** Pali i njihte kundërshtarët e vet. Ai u përpoq që të hiqte çdo mundësi për sulmet e tyre. Ai kufizoi lirinë dhe të drejtat e veta për të mbrojtur dhe për të zgjeruar ungjillin (shih Rom. 14:1-15:13).

**11:13 “Të tillë apostuj të rremë”** Këta drejtues fetarë nga jashtë qytetit, ndoshta nga Jeruzalemi, pretendonin autoritet. Pali i quan ata pseudo-apostuj dhe pseudo-vëllezër (shih 2 Kor. 11:26).

▣ **“punëtorë hileqarë”** Kjo fjalë është nga emri që do të thoshte “karrem peshkimi”. Ata u përpoqën të kapin besimtarët korintas për qëllimet e tyre dhe për të përçuar më tej reputacionin e tyre.

▣ **“që shndërrohen në apostuj të Krishtit”** Këta nuk ishin të krishterë të singertë të ngatërruar. Ata ishin njerëz të humbur frymërisht (shih 2 Kor. 11:14) që përpiqeshin të përçanin kishën e Perëndisë (shih 1 Kor. 3:10-15). Ata ishin ujqër të veshur si dele (shih Mateu 7; Veprat e Apo. 20:29; 2 Pjet. 2:1-22; Juda 1:3-16). Termi “maskohen”<sup>95</sup> (dmth., *metaschematizō*) përdoret tek 2 Kor. 11:13,14,15. Ai flet për ndryshimin e formës së jashtme të diçkaje apo dikujt (shih Fil. 3:21). Këta (dmth., mësuesit e rremë dhe Satani) duken ashtu siç nuk janë!

**11:14 “sepse Satanai vet shndërrohet në engjell drite”** Kjo është një e vërtetë e qartë, por nuk pohohet në këtë mënyrë në asnjë vend tjetër në Bibël. Kjo mund të jetë nga traditat rabinike rreth Zanafillës 3 (shih DSS cave 1, *Manual of Discipline* [Manuali i Disiplinës] 3:20,24). Mashtrimi kryesor i Satanit është i maskuar si e vërtetë (shih Zan. 3). Ligësia gjithmonë përpiqet të imitojë ose falsifikojë të mirën. Mësuesit e rremë gjithmonë vijnë nga brenda kishës (shih 2 Pjet. 2; 1 Gjoni 2:18-19). Shih TEMË E VEÇANTË: LIGËSIA SI PERSON / SPECIAL TOPIC: PERSONAL EVIL tek 1 Kor. 7:5.

**11:15 “nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë. Kishte mësues të rremë të frymëzuar nga Satani brenda kishës në Korint. Ata janë me ne edhe sot!

▣ **“punëtorë të drejtësisë”** Pali nuk e përdor shpesh “drejtësinë” në kuptimin që ai e përdor këtu. Këtu ajo ka ngjyrimin e “mirësisë” ose “të qënies së drejtë” (shih Mat. 6:1), por jo në kuptimin teologjik të drejtësisë me anë të besimit (shih Romakëve 4). Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTËSIA / SPECIAL TOPIC: RIGHTEOUSNESS tek 1 Kor. 1:30. Shih TEMË E VEÇANTË: DREJTIM SHËRBYES / SPECIAL TOPIC: SERVANT LEADERSHIP tek 1 Kor. 4:1.

▣ **“fundi i të cilëve do të jetë sipas veprave të tyre”** Ky duket se është një aludim ndaj Fjalëve të Urta 24:12. Ajo është gjithashtu e vërteta bazë e Biblës. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 5:10.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:16-21a

<sup>16</sup> Po e them përsëri: Askush të mos mendojë se jam i marrë; në mos, më pranoni edhe si të marrë, që edhe unë të mburrem pakëz. <sup>17</sup> Atë që po them në mburrjen e guximit tim, nuk po e them sipas Zotit, por në marrëzi. <sup>18</sup> Duke qenë se shumë vetë mburren sipas mishit, edhe unë do të mburrem. <sup>19</sup> Sepse ju që jeni të ditur, i duroni lehtë të marrët. <sup>20</sup> Sepse tashmë ju duroni, nëse dikush ju robëron, nëse dikush ju gllabëron, nëse dikush ju grabit, nëse dikush krenohet, nëse dikush ju godet në fytyrë. <sup>21a</sup> Flas për turpin tim, sikurse ne të ishim të dobët;

**11:16 “Askush të mos mendojë se jam i marrë... që edhe unë të mburrem pakëz”** Pali nuk ishte rehat me mburrjen personale (shih 2 Kor. 11:1,17). Mësuesit e rremë e kishin detyruar atë që të përdorte metodat e tyre (dmth., stili i kapitujve 10-13 reflekton karakteristikat e formave retorike helenistike).

Për “i pamend” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:36. Për “mburrje” shih TEMË E VEÇANTË: MBURRJA / SPECIAL TOPIC: BOASTING tek 1 Kor. 5:6.

▣ **“nëse”<sup>96</sup>** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë jo e plotë (dmth., pa folje). Këta besimtarë korintas u befaskan nga letra e Palit.

**11:17** Pali aludoi ndaj jetës dhe qëndrimit të Jezusit tek 2 Kor. 10:1 (dmth., me anë të butësisë dhe mirësisë së Krishtit), por kur bëhej fjalë për mburrjen apo krahasimin njerëzor, Pali duhet të pranojë se nuk ka asnjë precedent në Jezusin.

<sup>95</sup> Versioni në shqip është: “shndërrohen”. (shënim i përkthyesit)

<sup>96</sup> Versioni në shqip është: “në mos”. (shënim i përkthyesit)

**11:18 “Duke qenë se shumë vetë mburren sipas mishit, edhe unë do të mburrem”** Ky është fokusi kryesor i kapitujve 10-13. Mësuesit e rremë e kishin sulmuar Palin dhe ungjillin e tij duke e krahasuar trashëgiminë e tij dhe talentet e tij frymërore me të tyre (shih 2 Kor. 11:8). Pali ishte i shqetësuar që kisha i kishte dëgjuar ata dhe ishte ndikuar nga argumentet e tyre. Prandaj, ai vendosi që të ulej në nivelin e tyre me qëllim që të fitojë sërish këtë kishë në sigurinë e drejtimit të tij dhe ungjillit të tij.

**11:19-20** Kjo është një sarkazëm shumë e hidhur e drejtuar tek kisha korintase. Gjithçka për të cilën mësuesit e rremë e akuzonin Palin, ata e praktikonin dhe kisha iu përgjigjej atyre pozitivisht!

▣ **“toleroni / duroni”** Shih shënimin tek 2 Kor. 11:4.

**11:20 “nëse dikush ju robëron”** Kjo nis një seri prej pesë fjalish kushtore të rendit të parë. Kjo folje (dmth., *katadouloō*) përdoret vetëm këtu dhe tek Gal. 2:4 ku ajo i referohet judaizerëve. Judaizerët pohonin se një person duhej të bëhej plotësisht hebre përpara se të bëhej i krishterë. Se si lidheshin këta mësues të rremë me judaizerët është e pasigurtë. Rregullat apo ritualet e sakta të cilat mësuesit e rremë në Korint i vendosnin përpara si të nevojshme për shpëtim gjithashtu janë të pasigurta.

▣ **“nëse dikush ju gllabëron”** Pali e përdor këtë folje vetëm dy herë, këtu dhe tek Gal. 5:15, varg i cili gjithashtu përshkruan kishën në një konflikt me mësuesit e rremë.

NASB, NRSV, TEV “përfiton nga ju”  
NKJV “merr nga ju”  
NJB “ju mban nën urdhrat e veta”

Kjo është folja e zakonitë *lambanō*, por me një zgjerim metaforik të kuptimit të drejtpërdrejtë të “mbaj”. Këtu ajo manipulohet për përdorim personal.

NASB, NKJV “lartëson vetveten”  
NRSV “ngre veten lart”  
TEV “ju ul poshtë”  
NJB “e vendos vetveten mbi ju”

Pali përdor po të njëjtin term tek 2 Kor. 10:5 për të përshkruar arrogancën e argumenteve dhe spekulimeve të mësuesve të rremë. Ky term është thjesht fjala “të lartësoj” (shih 1 Tim. 2:8). Por tek 1 Korintasve ajo ka një ngjyrim negativ të krenarisë dhe arrogancës njerëzore.

▣ **“ju godet në fytyrë”** Fjalët e Palit kullojnë në sarkazëm (shih 2 Kor. 11:21). Ai u tregua aq i butë dhe i mirë me ta (shih 2 Kor. 10:1), por ata e refuzuan atë; mësuesit e rremë ishin kaq egoistë dhe manipulues, por ata i donin ata.

**11:21 “për turpin tim”** Kjo është fjalë për fjalë “sipas çnderimit”. Pali ndihej se butësia dhe mirësia e tij ishin keqkuptuar dhe keqpërdorur nga mësuesit e rremë. Ky mund të jetë një tjetër shembull i sarkazmës.

▣ **“të dobët”** Shih TEMË E VEÇANTË: DOBËSIA / SPECIAL TOPIC: WEAKNESS tek 2 Kor. 12:9.

**VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:21b-29**

<sup>21b</sup> megjithatë në çdo gjë që dikush guxon, po flas si i marrë, marr guxim edhe unë. <sup>22</sup> Janë ata Hebrej? Jam edhe unë! Janë ata Izraelitë? Jam edhe unë! Janë ata pasardhës të Abrahamit? Jam edhe unë. <sup>23</sup> Janë ata shërbëtorë të Krishtit? Po flas si i pamend, unë jam edhe më tepër si këta; në mundime më tepër, në goditje më tepër, në burgje më tepër dhe shpesh në rrezik për vdekje. <sup>24</sup> Nga Judenjtë mora pesë herë nga dyzetë *kamxhike* pa një. <sup>25</sup> Tri herë më rrahën me shkopinj, një herë më qëlluan me gurë, tri herë m'u mbyt anija në det, kalova një ditë e një natë në humnerë. <sup>26</sup> Në udhëtime të shpeshta në rreziqe lumenjsh, në

**rreziqe kusarësh, në rrezik nga ana e bashkëatdhetarëve, rreziqe nga ana johebrenjve, rreziqe në qytet, rreziqe në shkretëtirë, rreziqe në det, rreziqe midis vëllezërve të rremë,<sup>27</sup> në lodhje e në mundim, në netët pa gjumë, në uri e në etje, shpesh herë në agjërime, në të ftohtë dhe në të zhveshur.<sup>28</sup> Përveç këtyre gjërave të jashtme, ajo që më mundon çdo ditë është kujdesja për të gjitha kishat.<sup>29</sup> Kush është i dobët, që të mos jem edhe unë? Kush është skandalizuar dhe unë të mos përvëlohem?**

**11:21b** Pali është gati që të luftojë zjarrin me zjarr. Ata dëshironin të krahasonin kualifikimet, atëherë kështu le të bëhej!

**11:22 “Janë ata Hebrenj? Jam edhe unë”** Kjo është pyetja e parë nga katër pyetje retorike. “Hebrenjtë” nga ana shprehimore i referohej aftësisë për të folur gjuhën aramaike (shih Veprat e Apo. 6:1), por me nënkuptimin e hebrenjve të vërtetë raciale. Kjo është një tjetër provë që ky grup i mësuesve të rremë kishin një origjinë palestineze / judaike.

Forma “jam dhe unë” (dmth., *kagō*) përsëritet tri herë tek 2 Kor. 11:22.

▣ **“Janë ata Izraelitë? Jam edhe unë”** Dukshëm ata po mburreshin sepse ishin pjesë e popullit të besëlidhjes me Perëndinë sipas Dhjatës së Vjetër (shih Fil. 3:5; Gjoni 8:31-59).

**11:23 “Janë ata shërbëtorë të Krishtit?”** Pali nuk po pohon këtu se ata janë të krishterë. Ai thjesht po pohon, për hir të argumentit, se ai ka të njëjtat kualifikime frymërore për të cilat ata po mburren. Ata madje pretendonin se ishin superiorë frymërisht ndaj Palit.

▣ **“unë jam edhe më tepër”** Pali ka një seri krahasimesh me *en*.

1. në mundime më tepër, 2 Kor. 11:23
2. në burgje më tepër, 2 Kor. 11:23
3. në goditje më tepër, 2 Kor. 11:23
4. shpesh në rrezik për vdekje, 2 Kor. 11:23
  - a. mora pesë herë nga dyzetë kamxhike pa një, 2 Kor. 11:24
  - b. tri herë më rrahën me shkopinj, 2 Kor. 11:25
  - c. një herë më qëlluan me gurë, 2 Kor. 11:25
  - d. tri herë m’u mbyt anija në det, 2 Kor. 11:25

Disa prej këtyre regjistrohen tek Veprat e Apostujve, por jo të gjitha. Në të vërtetë, ne dimë aq pak nga kisha e shekullit të parë. Pali kishte paguar çmimin për të folur ungjillin!

**11:24 “Nga Judenjtë mora pesë herë nga dyzetë kamxhike pa një”** Kjo i referohet dënimit të ushtruar nga gjykatat e sinagogave (shih Ligji i Përt. 25:1-3). Goditjet me shumë mundësi jepeshin me një thupër (shih Eksod. 21:20; Fjalët e Urta 10:13; 19:29; 26:3) dhe bëheshin në publik. Ky lloj dënimi njihej dhe praktikohet në Asiri dhe në Egjipt. Ai praktikohet në Izrael (shih Isa. 50:6; Jer. 20:2; 37:15).

Rabinët më vonë e kodifikuan se duhej të ishte një më pak se sa dyzetë goditje (dmth., numri maksimal, shih Josephus, *Antiq.* 4:8:21,23). Ata specifikonin se sa goditje duhej të bëheshin në kurriz dhe sa përpara, sa në shpatullën e majtë dhe sa në të djathtën (shih *Maccoth* 3:10 e në vazhdim).

**11:25 “më rrahën me shkopinj”** Kjo i referohet një lloj dënimi romak gjyqësor (dmth., *verberatio*), ndoshta i bërë nga një gjykatë qyteti në publik (shih Veprat e Apo. 16:22-40; 1 Kor. 4:21).

▣ **“një herë më qëlluan me gurë”** Tek Veprat e Apo. 14:19 sulmuesit e tij mendonin se ai kishte vdekur! Ky mund të jetë incidenti.

▣ **“tri herë m’u mbyt anija në det”** Kjo tregon se sa e kufizuar është në të vërtetë historia e Veprave të Apostujve. Mbytja e anijes e Palit e regjistruar tek Veprat e Apostujve ka ndodhur pas kësaj pike në histori. Veprat e Apostujve nuk është një histori e kompletuar, por një regjistrim teologjik i lëvizjes së ungjillit nga Palestina në Romë, nga hebrenjtë tek johebrenjtë.

<b>11:26</b>	
<b>NASB</b>	<b>“unë kam qënë në udhëtime të shpeshta”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“në udhëtime shpesh”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“në udhëtime të shpeshta”</b>
<b>TEV</b>	<b>“në shumë udhëtime”</b>
<b>NJB</b>	<b>“vazhdimisht duke udhëtuar”</b>

Kjo nis një listë tjetër formash në rasën dhanore në shumës ose në një sistem me tetë rase sikurse i A. T. Robertson, kjo emërtohet si rasë vendore. Nuk ka asnjë folje, pjesore apo paskajore, tek 2 Kor. 11:26,27,28. Kjo përshkruan shërbesën e Palit për Krishtin.

1. rreziqe lumenjsh,
2. në rreziqe kusarësh,
3. në rrezik nga ana e bashkëatdhetarëve (duke qënë se ai ishte në Korint)
4. rreziqe nga ana johebrenjve,
5. rreziqe në qytet,
6. rreziqe në shkretëtirë,
7. rreziqe në det,
8. rreziqe midis vëllezërve të rremë (duke qënë se ai ishte në Korint)

**11:27 “unë kam qënë”<sup>97</sup>** Pali nis një tjetër listë duke përdorur rasën dhanore / vendore.

1. në lodhje,
2. në mundim,
3. në netët pa gjumë,
4. në uri,
5. në etje,
6. shpesh herë në agjërime (fjalë për fjalë “shpesh pa ushqim”),
7. në të ftohtë,
8. në të zhveshur (fjalë për fjalë “në ekspozim”)

Të gjithë ne që pretendojmë se jemi shërbëtorë të ungjillit duhet të heqim dorë nga të qarët!

**11:28** Një gjë tjetër që e shkaktonte dhimbjen e përditshme të Palit ishte shqetësimi psikologjik / frymëror për shëndetin dhe frytshmërinë e kishave – ndoshta kjo ishte dhimbja më e madhe nga të gjitha!

**11:29 “Kush është i dobët, që të mos jem edhe unë”** Vargu 29 ka dy pyetje retorike. Kur Pali sheh kishat dhe besimtarët teksa vuajnë, atij i dhemb dhe e bën atë të tërbohet me ata që kanë shkaktuar që të vegjëlit të pengohen (shih Mat. 18).

<b>NASB</b>	<b>“shqetësohem thellësisht”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“të digjem me indinjatë”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“indinjatë”</b>
<b>TEV</b>	<b>“të mbushem me shqetësim”</b>
<b>NJB</b>	<b>“të digjem në agoni”</b>

Pali e përdor këtë term, djeg, në një kuptim të specializuar në letrat e tij korintase. Nuk është një formë mohore apo shkatërruese (shih Efe. 6:16), por një metaforë për një dëshirë të thellë (shih 1 Kor. 7:9).

<b>NASB, TEV</b>	<b>“drejtohet në mëkat”</b>
<b>NKJV, NRSV</b>	<b>“skandalizohet”</b>
<b>NJB</b>	<b>“bëhet të rrëzohet”</b>

<sup>97</sup> Kjo pjesë mungon në versionin në shqip. (shënim i përkthyesit)

Ky është termi grek *skandalon*, që fjalë për fjalë i referohej një kurthi me karrem (shih Rom. 11:9). Ai përdoret në kuptimin e dështimit moral (këtu dhe tek 1 Kor. 8:13) ose ndoshta për t'u joshur nga mësuesit e rremë të “super-apostujve” (shih 1 Kor. 1:23; Gal. 5:11).

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 11:30-33

<sup>30</sup> Në qoftë se duhet të mburrem, unë do të mburrem me ato që kanë të bëjnë me dobësinë time. <sup>31</sup> Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht, që është i bekuar përjetë, e di se unë nuk gënjej. <sup>32</sup> Në Damask, qeveritari i mbretit Areta e ruante qytetin e Damaskasve për të më zënë, <sup>33</sup> por nga një dritare më ulën përgjatë murit me një shportë, dhe shpëtova nga duart e tij.

**11:30 “Në qoftë se”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë.

▣ **“ato që kanë të bëjnë me dobësinë time”** Sprovat dhe kritikantët e Palit kanë bërë që ai të kuptojë se pikat e tij të forta ishin nga Perëndia dhe pikat e tij të dobëta ishin një mundësi që Perëndia të merrte lavdinë (shih 2 Kor. 12:1-10).

**11:31 “Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezu Krisht”** Ky varg është një tjetër betim. Pali përdor emrin e Perëndisë për të konfirmuar vërtetësinë e pohimeve të tij mjaft shpesh (shih Rom. 1:9; 2 Kor. 1:18; 11:10,11; Gal. 1:20; 1 Tim. 2:7).

▣ **“përjetë”** Kjo është fjalë për fjalë “në kohët” (shih Rom. 1:25; 9:5; 11:36; 16:27). E njëjta frazë, por në njëjës, gjendet tek 1 Kor. 8:13 dhe 2 Kor. 9:9. Shih TEMË E VEÇANTË: KJO EPOKË DHE EPOKA E ARDHSHEME / SPECIAL TOPIC: THIS AGE AND THE AGE TO COME tek 1 Kor. 1:20.

**11:32-33 “Në Damask, qeveritari i mbretit Areta”** Disa thonë se kjo është zhgënjyese, por ky ishte dukshëm momenti më turpërues (dmth., më i dobët) i jetës së Palit. Ai mund t'i referohet një akuze tjetër të mësuesve të rremë. Mbreti Areta (dmth., *Harethath*) ishte mbreti i perandorisë nabateane nga viti 9 para lindjes së Krishtit deri në vitin 40 pas lindjes së Krishtit. Ai ishte vjehri i Herod Antipas. Termi “Areta” është si termi “Faraon”, një titull për të gjithë mbretërit nabateanë që sunduan në Petra. Termi “etnark” i referohet përfaqësuesit zyrtar aretas në Damask. Ajo që rregjistrohet tek Veprat e Apo. 9:23-25 është disi ndryshe; ndoshta mësuesit e rremë e përdorën këtë incident për të sulmuar karakterin e Palit.

#### PYETJE DISKUTIMI

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse e mbron vetveten Pali kundrejt këtyre mësuesve të rremë?
2. A i referohet vargu 2 Kor. 11:3 rënies nga hiri apo joshjes për t'u larguar nga autoriteti apostolik?
3. Pse Pali nuk pranonte para nga kisha korintase?
4. Kush ishin këta apostuj të rremë?
5. Përshkruaj teologjinë e këtyre mësuesve të rremë.
6. Pse ishte jeta e Palit, me një trajtim kaq brutal, një shenjë e autoritetit të tij apostolik? (shih 1 Kor. 4:9-13; 2 Kor. 4:8-12; 6:4)



## 2 KORINTASVE 12

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Vegime dhe Zbulesa	Vegimi i Parajsës	Mburrije e Mëtejshme: Forca në Dobësi	Vegimi dhe Zbulesat e Palit	Pali Shpall Lavdërimet e Tij (11:1-12:18)
12:1-10	12:1-10	12:1-10	12:1-6 12:7-10	12:1-6 12:7-10
Shqetësimi i Palit Për Kishën Korintase	Shenja të Një Apostulli		Shqetësimi i Palit për Korintasit	
12:11-18	12:11-13 Dashuria për Kishën	12:11-13 Planet e Palit për të Vizituar Korintin Sërish (12:14-13:10)	12:11-13	12:11-13
	12:14-21	12:14-18 Një Thirrje për Vetë- Ekzaminim dhe Ndryshim (12:19-13:10)	12:14-15 12:16-18	12:14-15 12:16-18 Frikërat dhe Ankthet e Palit (12:19-13:10)
12:19-21		12:19-21	12:19-21	12:19-21

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### HYRJE

- A. Vegimi i veçantë i Palit dhe problemet e tij fizike trajtohen në të njëjtin kontekst, ndoshta të dyja ndodhën 14 vjet përpara Tarsusit (viti 42 ose 43 pas lindjes së Krishtit). Kjo nuk mund t’i referohet përvojës së tij të konvertimit e cila ndodhi rreth 20 vjet më parë, edhe pse mendoj se “gjëmbi” i tij ishin problemet me sytë, të cilat mund të kenë nisur nga takimi i tij me Jezusin në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9:22,26).
- B. Pali vazhdon sarkazmën e tij therëse tek 2 Kor. 12:11,13 dhe 15 sikurse bëri tek 2 Kor. 11:4-5,7,19-21. Unë besoj se kapitujt 10-13 janë shkruar në një stil retorik helenistik me qëllim që t’iu tregojnë mësuesve

të rremë hebrenj arrogantë të trajnuar në helenistikë se edhe ai, gjithashtu, e njihte dhe mund të përdorte stilin e tyre të preferuar letrar.

## STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 12:1-10

<sup>1</sup> Sigurisht nuk kam dobi nga të mburrurit; prandaj do t'ia filloj me vegimet dhe zbulesat e Zotit. <sup>2</sup> Unë njoh një njeri në Krishtin, i cili, para katërbëdhjetë vjetësh (a ishte në trup, a ishte jashtë trupit, nuk e di; Perëndia e di), u rrëmbye gjer në të tretin qiell. <sup>3</sup> Dhe e di se ai njeri (a me trupin ose pa trupin, nuk e di, Perëndia e di), <sup>4</sup> u rrëmbye në parajsë dhe dëgjoi fjalë të patregueshme, që nuk është e lejuar të thuhet nga njeri. <sup>5</sup> Për atë njeri unë do të krenohem, por nuk do të krenohem për veten time, veç se për dobësitë e mia. <sup>6</sup> Edhe sikur të doja të krenohesha, nuk do të isha i marrë, sepse do të flisja të vërtetën; por nuk e bëj këtë, se mos ndonjë më çmon më tepër nga ajo që më sheh, a më tepër nga ajo që dëgjon nga unë. <sup>7</sup> Dhe, që të mos më rritet mendja për shkak të jashtëzakonshmërisë së zbulesave, m'u dha një gjëmb në mish, një engjëll i Satanit, për të më rënë me grushta, që të mos mbahem me të madh. <sup>8</sup> Lidhur me këtë iu luta tri herë Zotit që ta largonte nga unë. <sup>9</sup> Por Ai më tha: "Hiri im të mjafton, sepse fuqia ime përsoset në dobësi." Prandaj me kënaqësi të madhe do të krenohem më tepër për dobësitë e mia, që fuqia e Krishtit të rrijë tek unë. <sup>10</sup> Prandaj unë kënaqem në dobësi, në fyerje, në nevoja, në përndjekje, në ngushtica për shkak të Krishtit, sepse, kur jam i dobët, atëherë jam i fortë.

**12:1** "Të mburrurit është i nevojshëm"<sup>98</sup> Termi në greqisht *dei* do të thotë "nevojë". Mësuesit e rremë po sulmoheshin nga Pali. Ai mbronte veten për të mbrojtur mesazhin e tij. Termi "mburrje", i përdorur aq shpesh në kapitujt 10-13 (shih 2 Kor. 10:8,13,15,16,17; 11:12,16,18,30; 12:1,5,6,9, shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:12 dhe Temën e Veçantë tek 1 Kor. 5:6), karakterizonte një stil retorik mjaft të përhapur në shekullin e parë. Pali iu tregoi mësuesve të rremë se ai mund të bënte të njëjtën lojë si ata.

Kjo fjali ishte ngatërruese për skribët antikë, të cilët e modifikuan atë në disa mënyra.

1. Disa shtuan "nëse" (MSS  $\kappa^2$ , H)
2. Disa e ndryshuan *dei* (duhet) në *de* (por), (MSS  $\kappa$  dhe D)
3. Forma tek UBS<sup>4</sup> mbështetet nga MSS P<sup>46</sup>, B, D<sup>2</sup>, F, G (vlerësimi "A")

Numrat 2 dhe 3 tregojnë se si tekstet e hershme origjinale në greqisht u modifikuan nga skribët që kishin qëllime të mira.

NASB	"edhe pse nuk është e dobishme"
NKJV	"pa dyshim nuk është e dobishme"
NRSV	"nuk fitohet asgjë prej saj"
TEV	"edhe pse ajo nuk sjell asnjë të mirë"
NJB	"jo se ajo bën ndonjë të mirë"

Nëse mburrja e Palit nuk sjell asnjë të mirë, atëherë pse ta bëjë? Ai e bën atë në sarkazëm për shkak të efektit të saj, duke përdorur po të njëjtët terma dhe metodologji sikurse mësuesit e rremë (dmth., besimtarët hebrenj të diasporës të trajnuar në retorikë, të cilët ishin të lidhur në një farë mënyre me kishën në Jeruzalem, të ngjashëm me judaizerët e galatasve dhe elementët fariseikë të ndeshur në Këshillin e Jeruzalemit të Veprave të Apostujve 15).

■ **"vegimet dhe zbulesat"** Ndoshta nuk ka asnjë dallim midis këtyre dy termave; të dy përshkruajnë një lloj zbulesë të drejtpërdrejtë (shih 1 Kor. 2:10; 11:23; Gal. 1:12; 2:2; Efe. 3:3). Mësuesit e rremë ndoshta po pretendonin një zbulesë të veçantë të drejtpërdrejtë. Termi "zbulesë" është *apocalypse*, që do të thotë "një heqje veli".

Mësuesit e rremë, atëherë dhe tani, karakterizohen nga

1. Shfrytëzim seksual
2. Shfrytëzim financiar
3. Një pretendim për një zbulesë të veçantë dhe unike

<sup>98</sup> Kjo frazë mungon tek versioni në shqip. (shënim i përkthyesit)

☐ **“e Zotit”** Ajo mund të jetë një formë gjinore subjektive, “një zbulesë nga Zoti” ose një formë gjinore objektive, “mbi Zotin”. Konteksti që vijon nënkupton “nga Zoti” (forma pasive, 2 Kor. 12:2,4,7).

**12:2 “Unë njoh një njeri”** Kjo është mënyra rabinike e të folurit për dikë. Pali duket se heziton madje edhe ta përmendë incidentin, por ai e bën këtë për shkak të dashurisë së tij për këtë kishë dhe pretendimeve të mësuesve të rremë për vegime frymërore.

☐ **“në Krishtin”** Ky ishte emërtimi i preferuar i Palit për një të krishter. Besimtarët identifikohen me jetën / vdekjen / ringjalljen e Tij (shih Romakëve 6). Qëllimi i besimtarit është që të jetë si Ai (shih Rom. 8:29; 2 Kor. 3:18; Gal. 4:19; Efe. 1:4; 1 Thes. 3:13; 4:3; 1 Pjet. 1:15).

George Ladd, në *A Theology of the New Testament* [Një Teologji e Dhjatës së Re], bën një pohim interesant se: “njeriu në Krishtin është gjithashtu në Frymë. Nëse e kundërta e ‘në Krishtin’ është të jesh në Adamin, e kundërta e ‘në Frymë’ është të jesh ‘në mish’.  
Jeta në Frymë do të thotë një jetë-ekzistence eskatologjike në epokën e re.” (fq. 483)

☐ **“para katërmbëdhjetë vjetësh”** Kjo ndoshta ishte gjatë shërbesës së hershme të parregjistruar të Palit në Tarsus, pak përpara se Barnaba të vinte për ta marrë që ta ndihmonte në Antioki (shih Veprat e Apo. 11:25-26). Vini re se vegimet e veçanta nuk ishin një ndodhi e përditshme e Palit, por ai pati disa prej tyre (shih Veprat e Apo. 9:4; 18:9; 23:11; 27:23).

☐ **“a ishte në trup, a ishte jashtë trupit, nuk e di”** Vetë Pali nuk ishte i sigurtë se çfarë ndodhi (faza përsëritet dy herë tek 2 Kor. 12:2 dhe 3). Ajo ishte ndoshta si përvoja e Ezekielit tek Ezekieli 8 ose si përvoja e Gjonit tek libri i Zbulesës (shih Zbu. 1:10; 4:2; 17:3; 21:10). Vini re se, ndryshe nga sikurse bëhej në filozofinë greke, në krishtërimin trupi nuk përjashtohet nga qielli.

☐ **“u rrëmbye”** Ky është i njëjti term i përdorur për (1) Filipin tek Veprat e Apo. 8:30; (2) “rrëmbimin” tek 1 Thes. 4:17; dhe (3) djali tek Zbu. 12:5. Kuptimi i saj bazë është që të zësh sikurse një mishngrënës zë prenë e tij. Pali u prek në mënyrë të papritur dhe të shpejtë në trup ose në mendje nga prania e Perëndisë (shih 2 Kor. 12:4).

☐ **“në të tretin qiell”** Shih Temën e Veçantë që vijon.

#### **TEMË E VEÇANTË: QIEJT DHE QIELLI I TRETË (SPECIAL TOPIC: THE HEAVENS AND THE THIRD HEAVEN)**

Në Dhjatën e Vjetër, termi “qiell” zakonisht është në SHUMËS (pra, *shamayim*, BDB 1029, KB 1559). Kjo fjalë hebraisht do të thotë “lartësi”. Perëndia banon në lartësi. Ky koncept pasqyron shenjtërinë dhe epërsinë e Perëndisë.

Në Zan. 1:1, SHUMËSI “qiejt dhe toka” është marrë në kuptimin se Perëndia krijoi (1) atmosferën mbi këtë planet, ose (2) si mënyrë referimi për gjithë realitetin (pra, shpirtëror dhe fizik). Nga ky kuptim bazë, pasazhe të tjera citoreshin sikur u referoheshin niveleve të qiellit: “qielli i qiejve” (shih Psa. 68:33), ose “qielli dhe qielli i qiejve” (shih Ligji i Përt. 10:14; 1 Mbre. 8:27; Neh. 9:6; Psa. 148:4). Rabinët hamendësonin se mund të kishte

1. dy qiej (p.sh., R. Judah; Hagigah 12b)
2. tre qiej (Test. Levi 2-3; Ngjitja e Isa. 6:-7; Midrash Tehillim për Psa. 114:1)
3. pesë qiej (III Barukut)
4. shtatë qiej (R. Simon b. Lakish; Ngjitja e Isa. 9:7)
5. dhjetë qiej (2 Enokut 20:3b; 22:1)

Të gjitha këto sinonin të tregonin veçimin e Perëndisë nga krijimi fizik dhe/ose epërsinë e Tij. Numri më i zakonshëm i qiejve në judaizmin rabinik ishte shtatë. A. Cohen, *Everyman’s Talmud* [Talmudi i Çdo Njeriu] (f. 30), thotë se kjo lidhej me sferat astronomike, por unë mendoj se i referohet shtatës si numri i

përsosur (pra, ditët e krijimit, ku shtata përfaqësonte pushimin e Perëndisë te Zan. 2:2).

Pali, në 2 Kor. 12:2, përmend qiellin “e tretë” (greqisht, *ouranos*) si mënyrë për të nënkuptuar praninë personale dhe madhështore të Perëndisë. Pali pati takim personal me Perëndinë!

**12:3-4** Këto vargje përshkruajnë më tej ndodhinë e pohuar tek 2 Kor. 12:2.

**12:4 “Parajsë”** Kjo është një fjalë e huazuar persiane për “kopështin e rrethuar me mur të një fisniku”. Fjala në greqisht përdoret në Septuagintë për “Kopështin e Edenit” (shih Zan. 2:8; 3:1; Ezek. 28:13; 31:18). Termi përdoret tek Luka 23:43 për pjesën e drejtë të Hades-it ose Sheol-it. Në librin ekstra-kanonik *The Secrets of Enoch* [Sekretet e Eunukut], or *II Enoch* [Eunuku II], kapitulli 8, ai përdoret për qiellin e tretë ose praninë e Perëndisë. Qielli i tretë dhe Parajsa janë të dyja mënyra për t’iu referuar pranisë së Perëndisë.

▣ **“dëgjoji fjalë të patregueshme, që nuk është e lejuar të thuhet nga njeri”** Kurioziteti i njerëzimit nuk duhet lehtësuar në të gjitha zonat e së vërtetës. Ashtu sikurse Llazari nuk foli për përvojën e tij në varr, as Pali nuk do ta bënte (dmth., ishte tepër e shenjtë), nuk mund ta bënte (dmth., nuk kishte fjalor njerëzor të përshtatshëm) për të ndarë këtë eksperiencë. Gjendet dukshëm një lojë fjalësh me “e patregueshme”: *arrētos*, “e folur” dhe *hrētos* ose ndoshta kjo ishte një shprehje teknike e misterit të riteve fetare të nismës. Ndoshta thjesht nuk ishte e përshtatshme nga ana e fjalorit njerëzor të shprehje atë që ai pa (shih 1 Kor. 2:9).

**12:5** Pali nuk po mburrej me arritjet personale (shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 1:12), por në zbuluesën e Perëndisë për Vetveten, përmes si përjetesave personale ashtu edhe së vërtetës së ungjillit. Janë papërshtatshmëritë e Palit ato që lejojnë që Perëndia të përlëvdohet në të (krahaso Gjoni 15:5 me Fil. 4:13).

▣ **“dobësitë”** Shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 12:9.

**12:6 “sikur”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, e cila nënkupton veprim të mundshëm.

▣ **“i marrë”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 15:36.

▣ **“se mos ndonjë më çmon më tepër nga ajo që më sheh, a më tepër nga ajo që dëgjon nga unë”** Kjo është e thelluar në sarkazëm. Këta mësues të rremë mburreshin me përvojat e shkuara dhe kualifikimet, të cilat korintasit vetëm sa i kishin dëgjuar. Pali thotë: “mos më cilësoni me ato që ju kam treguar ju, por me atë që kam bërë në mesin tuaj. Shihni veprat e mia!”

**12:7 “për shkak të jashtëzakonshmërisë së zbulësive”** Kjo frazë mund të lidhet në mënyrë gramatikore me “se mos ndonjë më çmon” nga 2 Kor. 12:6 ose “që të mos më rritet mendja” nga 2 Kor. 12:7. Nëse *dio* është në tekstin origjinal të 2 Kor. 12:7 (shih MSS  $\alpha$ , A, B, F, G) atëherë ai ndoshta shkon me 2 Kor. 12:6, por *dio* është përjashtuar në disa nga dorëshkrimet antike në greqisht (shih MSS P<sup>46</sup>, D, dhe përkthimet Vulgate, Armenian dhe Peshitta). UBS<sup>4</sup> i jep përfshirjes së saj një cilësim “C” (vështirësi për të vendosur).

Për “madhështinë e jashtëzakonshme” (*hyperbolē*) shih TEMË E VEÇANTË: PËRDORIMI I PALIT TË FJALËVE TË PËRBËRA HUPER / SPECIAL TOPIC: PAUL’S USE OF HUPER COMPOUNDS tek 1 Kor. 2:1.

▣ **“që të mos më rritet mendja”** E njëjta fjalë përdoret tek 2 Thes. 2:4 për të përshkruar mburrjen krenare të “Njeriut të Mëkatit” ose Antikrishtit. Pali sërish po vë në kontrast veten e tij me mësuesit e rremë. Ata mburreshin me anë të stilit të tyre retorik sofist (të cilin Pali po e imiton në kapitujt 10-13). Pali besonte se Perëndia (dmth., forma pasive “m’u dha”) i kishte dhënë këtë “gjëmb në mish” për një qëllim (dmth., fjalja e nënrenditur *hina*). Ky mund të jetë kuptimi i Rom. 8:28 (dmth., disa dorëshkrime në greqisht lexojnë “Perëndia mund të shkaktojë të gjitha gjërat”), por e mira është ngjashmëria me Krishtin e shprehur aq qartazi tek Rom. 8:29 (dmth., i konformuar me shëmbëlltyrën e Birit të Tij). Satani është një shërbëtor!

■ **“gjëmb në mish”** Termi “gjëmb” mund të nënkuptojë “piketë” (dmth., fjalë për fjalë “të piketohesh”). Në gjuhën klasike greke ajo përdoret në kuptimin e një pikete të mprehtë ndërkohë që në Septuagintë ajo përdoret për një gjëmb bime (shih Num. 33:55; Ezek. 28:24; Ose. 2:6). Disa teori në lidhje me gjëmbin në mish të Palit janë:

1. Etërit e kishës së hershme, Luteri dhe Kalvini, thonë se ishte një problem frymëror me natyrën e tij të rënë (dmth., “në mish”)
2. Chrysostom thotë se ishte një problem me persona (shih Num. 33:55; Gjyq. 2:3)
3. Disa thonë se ishte epilepsia
4. Sir William Ramsay thotë se ishte malarja
5. Unë mendoj se ishte ophthalmia, një problem i zakonshëm shikimi (krahaso Gal. 4:13-15 dhe 6:11) i përkeqësuar ose i shkaktuar nga verbimi në rrugën për në Damask (shih Veprat e Apo. 9, ndoshta një aludim i Dhjatës së Vjetër tek Joz. 23:13)

Për “mish” shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:26.

■ **“një lajmëtar”<sup>99</sup> i Satanit** Perëndia lejon dhe përdor të ligun (shih Job 2:6; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20). Termi “lajmëtar” duket se i referohet një agjenti djallëzor. Termi “lajmëtar” si në gjuhën hebraike ashtu edhe në gjuhën greke mund të përkthehet “engjell”. Nëse është kështu, ne shohim se besimtarët mund të lëndohen nga forcat djallëzore, por vëmë re se edhe kjo përdoret për qëllime të Perëndisë. Perëndia përdor ligësinë për qëllimet e Tij të drejta.

### **TEMË E VEÇANTË: SATANI (SPECIAL TOPIC: SATAN)**

Kjo është një temë shumë e vështirë për disa arsye.

1. Dhjata e Vjetër nuk na paraqet një kryearmik të së mirës, por një shërbëtor të YHWH (shih A. B. Davidson, *OT Theology* [Teologjia e Dhjatës së Vjetër], fq. 300-306), i cili i ofron njerëzimit një alternativë, si dhe e akuzon njerëzimin për padrejtësi. Ka vetëm një Perëndi (shih Temën e Veçantë: Monoteizmi / Special Topic: Monotheism), një fuqi dhe një shkak të vetëm në Dhjatën e Vjetër — YHWH (shih Isa. 45:7; Amosi 3:6).
2. Koncepti i kryearmikut personal të Perëndisë u zhvillua në literaturën ndërbiblike (jokanonike) nën ndikimin e feve dualiste perse (zoroastrianizmi). Nga ana e vet, kjo gjë ndikoi së tepërmi në judaizmin rabinik dhe në komunitetin esen (dmth., Pergamenat e Detit të Vdekur).
3. Dhjata e Re i zhvillon motivet e Dhjatës së Vjetër në kategori çuditërisht të thekta, por të përzgjedhura.

Nëse studimin e ligësisë e shohim nga pikëvështrimi i teologjisë biblike (ku secili libër, autor, ose gjini letrare studiohet dhe përvijohet veçmas), atëherë na zbulohen pikëpamje shumë të ndryshme për ligësinë.

Nga ana tjetër, nëse i qasemi studimit të ligësisë nga përqsja jobiblike ose jashtëbiblike e feve botërore ose feve lindore, atëherë një pjesë e mirë e zhvillimeve të Dhjata së Re paraprihen nga dualizmi persian dhe spiritizmi greko-romak.

Nëse dikush (si unë!) është i përkushtuar paraprakisht ndaj autoritetit hyjnor të Shkrimit, atëherë zhvillimi i Dhjata së Re duhet parë si zbulues dhe përshkallëzues. Të krishterët duhet të mos lejojnë që folklori judaik apo literatura perëndimore (Dantja, Milioni) të ndikojnë më tej në këtë koncept. Ka pa dyshim mister dhe paqartësi në këtë pjesë të zbuluesës. Perëndia ka zgjedhur që të mos na i zbulojë të gjitha aspektet e ligësisë, origjinën e saj (shih Temën e Veçantë: Luciferi / Special Topic: Lucifer), zhvillimin, apo synimin e saj, por na ka zbuluar disfatën e ligësisë!

Në Dhjatën e Vjetër, termi “satan” ose “akuzues” (BDB 966, KB 1317) mund të përdoret për tre grupe të ndryshme.

<sup>99</sup> Versioni në shqip është: “engjell”. (shënim i përkthyesit)

1. Akuzuesit njerëzorë (shih 1 Sam. 29:4; 2 Sam. 19:22; 1 Mbre. 11:14, 23, 25; Psa. 109:6)
2. Akuzuesit engjëj (shih Num. 22:22-23; Jobi 1-2; Zak. 3:1)
3. Akuzuesit demoniakë (shih 1 Kro. 21:1; 1 Mbre. 22:21; Zak. 13:2)

Vetëm më vonë, në periudhën midis dy Dhjatave, gjarpri i Zanafillës 3 identifikohet me Satanin (shih Book of Wisdom [Libri i Urtësisë] 2.23-24; 2 Enoch [Enoku] 31:3), dhe, më vonë, kjo shndërrohet në koncept rabinik (shih *Sot* 9b dhe *Sanh.* 29a). “Bijtë e Perëndisë” tek Zanafilla 6 bëhen engjëj tek 1 Enoku 54:6. E përmend këtë, jo për të thënë se ky libër është teologjikisht i saktë, por për të treguar zhvillimin e termit. Në Dhjatën e Re, këto veprimtari të Dhjatës së Vjetër i atribuohen ligësisë së personifikuar engjëjlore (shih 2 Kor. 11:3; Zbu. 12:9).

Origjina e ligësisë së personifikuar është e vështirë ose e pamundur (varet nga pikëpamja e secilit) për t’u përcaktuar nga Dhjata e Vjetër. Një arsye për këtë është monoteizmi i rreptë i Izraelit (shih Temën e Veçantë: Monoteizmi / Special Topic: Monotheism; si dhe vini re 1 Mbre. 22:20-22; Pred. 7:14; Isa. 45:7; Amosi 3:6). Çdo shkakësi (shih Isa. 45:7; Amosi 3:6) i atribuohet YHWH-së për të treguar natyrën unike dhe parësinë e tij (shih Isa. 43:11; 44:6, 8, 24; 45:5-6, 14, 18, 21, 22).

Burime të mundshme informacioni janë: (1) Jobi 1-2, ku Satani është një nga “bijtë e Perëndisë” (pra, engjëjt), ose (2) Isaia 14 dhe Ezekieli 28, ku mbretërit kryelartë të Lindjes së Afërt (Babilonia dhe Tiri) ndoshta përdoren për të ilustruar krenarinë e Satanit (shih 1 Tim. 3:6). Unë kam dyshimet e mia për këtë qasje. Ezekieli përdor metafora nga Kopshti i Edenit, jo vetëm për mbretin e Tirit si Satan (shih Ezek. 28:12-16), por edhe për mbretin e Egjiptit si Pema e Njohurisë së të Mirës dhe së Ligës (Ezek. 31). Megjithatë, Isaia 14, sidomos v. 12-14, duket se përshkruan një kryengritje engjëjlore për shkak të krenarisë. Nëse Perëndia ka dashur të na e zbulojë natyrën dhe origjinën e saktë të Satanit, e ka bërë në një mënyrë dhe vend shumë të tërthortë. Duhet t’i shmangemi prirjes së teologjisë sistematike, e cila merr pjesë të vogla dhe të paqarta nga Dhjatat, autorët, librat dhe gjinitë e ndryshme dhe i kombinon si të ishin pjesë të një pamje të vetme hyjnor.

Unë jam dakord me Alfred Edersheim (*The Life and Times of Jesus the Messiah* [Jeta dhe Kohët e Jezus Mesias], vëll. 2, shtojcat XIII [fq. 748-763]) dhe XVI [fq. 770-776]) se judaizmi rabinik është ndikuar së tepërmi nga dualizmi pers dhe nga hamendësimet perse për demonët. Rabinët nuk janë burim i saktë për të vërtetën në këtë pikë. Jezusi devijon rrënjësisht nga mësimet e Sinagogës në këtë fushë. Unë mendoj se koncepti i një armiku kryeengjëllor të YHWH-së u zhvillua nga dy perënditë e larta të dualizmit iranian, *Ahkiman* dhe *Ormaza*, dhe më tej u zhvilluan nga rabinët për t’u shndërruar në dualizmin biblik të YHWH-së dhe Satanit.

Pa dyshim, Dhjata e Re përmban zbulesë të përshkallëzuar në lidhje me personifikimin e ligësisë, por mësimet e saj nuk janë aq të detajuara sa ato të rabinëve. Një shembull i qartë i këtij dallimi është “lufta në qiell”. Rënia e Satanit është një domosdoshmëri logjike, por nuk na jepen hollësi (shih Temën e Veçantë: Rënia e Satanit dhe engjëjve të tij / Special Topic: The Fall of Satan and His Angels). Edhe shpjegimet që na jepen fshihen në gjuhën e gjinisë letrare apokaliptike (shih Zbu. 12:4, 7, 12-13). Ndonëse Satani është mposhtur në Jezusin dhe është dëbuar në tokë, ai ende funksionon si shërbëtor i YHWH-së (shih Mat. 4:1; Luka 22:31-32; 1 Kor. 5:5; 1 Tim. 1:20).

Duhet t’i vëmë fre kureshtjes në këtë pikë. Ekziston një forcë personale tundimi dhe ligësie, por gjithsesi ka vetëm një Perëndi dhe ne jemi përgjegjës për zgjedhjet që bëjmë. Ekziston një betejë shpirtërore, si përpara, ashtu dhe pas, shpëtimit. Fitorja mund të vijë dhe të qëndrojë vetëm në Perëndinë Triun dhe nëpërmjet Tij. Ligësia është mposhtur dhe do të asgjësohet (shih Zbu. 20:10)!

▣ **“për të më torturuar”<sup>100</sup>** Kjo është një formë lidhore aktive e tashme. Termi fjalë për fjalë do të thotë “t’i biesh me grushta”. Ky problem ishte i dhimbshëm dhe i vazhdueshëm.

▣ **“që të mos mbahem me të madh”** Kjo është një fjali e nënrenditur qëllimore (dmth., *hina*). Pretendimet frymërore të mësuesve të rremë theksonin egotizmin e tyre. Fjalët e Palit e përlulnin atë.

**12:8 “iu përgjërova”<sup>101</sup> Zotit** Kontekstualisht kjo mund t’i referohej (1) YHWH ose (2) Jezus (shih Gjoni 14:13-14). Pali normalisht i lutet Atit. Të krishterët mund t’i luten secilit prej Personave Hyjnor të Trinisë, edhe pse normalisht ne i lutemi Atit, në emër të Birit, përmes Frymës.

▣ **“këtë”** Është e mundur që “këtë” t’i referohet (1) kësaj situatë; (2) këtij persekutimi; (3) këtij lajmëtari të Satanit ose (4) kësaj sëmundjeje fizike.

▣ **“tri herë”** Lutja e Jezusit në Gjetsemani u përsërit tri herë (shih Mat. 26:42; Mark 14:39,41). Përsëritja e trefishtë tregon theksim. Kjo nuk ishte një mungesë besimi, por tregon se mund të lutemi për çdo gjë që na shqetëson sa shpesh që mendojmë se ka nevojë. Ky problem i dhimbshëm dhe i përsëritur i mësoi Palit një mësim të madh frymëror (shih 2 Kor. 12:9). Unë duhet të them në këtë pikë se kjo hedh dritë mbi mbi-theksimin në ditën tonë mbi besimin që shëron që është i kushtëzuar nga sasia e besimit të personit që ka nevojë për shërim. Dukshëm Pali kishte besim shumë të madh. Gjithashtu, mësimi i pavend që Perëndia dëshiron që çdo besimtar të jetë i shëruar dhe i çliruar nga çdo problem adresohet në këtë pasazh. Kërkesat si të Jezusit dhe të Palit nuk morën përgjigje në mënyrën që ata dëshironin. Perëndia përdor problemet dhe sëmundjen në jetët tona për qëllimet e Tij (shih Rom. 8:17; 2 Kor. 1:5,7; Fil. 3:10; 1 Pjet. 4:12-17). Nevojat tona janë mundësia e Perëndisë për të zbuluar Vetveten dhe vullnetin e Tij tek ne!

**12:9 “Ai më tha”** Kjo është në kohën e përkryer, formë shprehimore për “Ai përfundimisht më tha”.

▣ **“Hiri im të mjafton”** Karakteri dhe prania e Perëndisë është gjithçka për të cilën Pali ka nevojë. Unë mendoj se Pali mund të ketë qënë duke menduar për 1 Mbret. 8:27.

▣ **“fuqia ime përsoset”** Kjo është një formë pasive e përkryer. Fuqia e Perëndisë vepron me kritere të ndryshme nga ajo e njerëzimit. Perëndia merr lavdi kur ena njerëzore është e dobët dhe e paaftë për të përmbushur nevojat e saj. Fuqia e Perëndisë është në karakterin e Tij të pandryshueshëm! Kjo frazë mund t’i ketë kujtuar Palit 1 Kor. 2:5 ose 2 Kor. 4:7 dhe thjesht nuk lidhet me theksin e mësuesve të rremë mbi performancën apo meritën njerëzore.

▣ **“krenohem më tepër për dobësitë e mia”** Shih Temën e Veçantë më poshtë.

#### **TEMË E VEÇANTË: DOBËSIA (*ASTHENEŌ*) [SPECIAL TOPIC: WEAKNESS (*ASTHENEŌ*)]**

Mësuesit e rremë mburren me kredencialet dhe stilin e tyre retorik, por Pali e njeh vlerën e “dobësisë” (*astheneō*). Pali e përdor konceptin e dobësisë në disa mënyra të ndryshme.

1. Dobësia e Perëndisë është më e fortë se njerëzit, I Kor. 1:25
2. I dobët në botë, I Kor. 1:27
3. Dobësia dhe frika e Palit, I Kor. 2:3; 9:22; II Kor. 11:29,30; 12:5
4. Pali dhe skuadra e tij e misionit, I Kor. 4:10; II Kor. 11:21
5. Besimtari i dobët (shih Rom. 14:1-15:13), I Kor. 8:7,9,10,11,12; 9:22
6. Sëmundja fizike, I Kor. 11:30
7. Pjesët e trupit njerëzor, I Kor. 12:22
8. Trupi fizik, I Kor. 15:43
9. Gjendja fizike e Palit ose aftësia e tij në të folur, II Kor. 10:10

<sup>100</sup> Versioni në shqip është: “për të më rënë me grushta”. (shënim i përkthyesit)

<sup>101</sup> Versioni në shqip është: “luta”. (shënim i përkthyesit)

10. Dobësia e Palit e lartësoi forcën e Perëndisë, II Kor. 12:9,10; 13:4,9  
 11. Mesazhi i Krishtit përmes Palit, II Kor.13:3  
 12. Trupi fizik i Krishtit, II Kor. 13:4

☐ **“që fuqia e Krishtit të rrijë tek unë”** Vini re se është fuqia e Perëndisë! Është fuqia e Krishtit! Krishti është Perëndi!

NASB, NRSV **“të banojë në mua”**  
 NKJV, NJB **“të rrijë në mua”**  
 TEV **“të ndjej mbrojtjen ... mbi mua”**

Ky është termi grek *episkēnoō*, i cili është *epi* plus *skēnē* (tendë, shih 2 Kor. 5:1), prandaj, përdoret në mënyrë metaforike për mbuloj ose qëndroj. Kjo fjalë gjendet vetëm këtu në Dhjatën e Re. Po e njëjta rrënjë përdoret për lindjen e Jezusit nga një virgjëreshë (shih Luka 1:35) shpërfytyrimin e Jezusit (shih Mat. 17:5), dhe hijen e aspostujve që binte mbi njerëzit dhe shërimin që ata merrnin (shih Veprat e Apo. 5:15).

Pali e dinte se reja gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë (shih Eksod. 40:35) quhej nga rabinët “reja *shekinah* e lavdisë”. *Shekinah* do të thotë “të banosh përjetësisht”. Pali dëshironte praninë personale të Perëndisë, të zbuluar plotësisht dhe tërësisht dhe të trupëzuar në Krishtin, me të. Ky është qëllimi i krishtërimin, jo fuqi personale, prestigj personal, një njohuri apo përjetesë e veçantë (dmth., “të njoh Atë përmes dobësisë dhe vuajtjes”, shih Fil. 3:10).

**12:10 “Prandaj unë kënaqem në dobësi”** Pali e dinte nga përvoja personale (dmth., në rrugën për në Damask) se qëllimet e mira dhe përpjekjet personale nuk mjaftojnë. Ne kemi nevojë për hir (shih 2 Kor. 12:9), jo për fuqi. Asnjë qenie njerëzore nuk do të uzurpojë lavdinë e Perëndisë (shih 1 Kor. 1:29; Efe. 2:9). Hiri, fuqia dhe lavdia e Perëndisë theksohen në enë njerëzore të nënshtruara dhe të papërkryera.

☐ **“unë kënaqem në dobësi”** Në pjesën e mbetur të vargut, Pali na jep një përmbledhje të shkurtër të sfidave të shërbesës së tij, të cilat ai i ka përmendur më parë tek 2 Kor. 4:7-11; 6:3-10; 11:24-28. Pali e dinte plotësisht kuptimin e fjalëve të Jezusit tek Mat. 5:10-12!

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 12:11-13

<sup>11</sup> U bëra i marrë duke u mburrur; ju më shtrënguati, sepse u desh që ju të më rekomandoni, sepse nuk qeshë aspak më poshtë se apostujt e lartë, edhe pse unë nuk jam asgjë. <sup>12</sup> Shenjat e apostullit u vërtetuan ndër ju me durim të madh, me shenja e mrekulli dhe çudira. <sup>13</sup> Vallë nëse ju mbetët prapa, pra, nga kishat e tjera, përveç se në faktin se unë nuk u bëra barrë për ju? Falmani këtë gabim.

**12:11 “U bëra i marrë”** Kjo është në formën treguese aktive të përkryer. Disa grupime (dmth., 1 Korintasve 1-4) ose disa grupe të mësuesve të rremë në lëvizje (dmth., 2 Kor. 10-13) e kanë sulmuar Palin, drejtimin e tij, autoritetin e tij, stilin e tij të folurit dhe ungjillin. Prandaj, Pali duhej të mbrohej. Ai e bëri këtë në disa mënyra.

1. Duke krahasuar jetën e tij me të tyre
2. Duke përdorur stilin e tyre të retorikës, por me përlulësi
3. Duke përdorur sarkazmën për të nxjerrë konkluzionet e tij

Shih TEMË E VEÇANTË: I PAMEND (SPECIAL TOPIC: TERMS FOR FOOLISH PEOPLE) tek 1 Kor. 15:36.

☐ **“Unë”** Forma e theksuar “unë” (dmth., *egō*) përdoret tek 2 Kor. 12:11,13,15 dhe 16.

☐ **“rekomandoni”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 3:1.

☐ **“nuk qeshë aspak më poshtë se apostujt e lartë”** Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 11:5.



☐ **“nëse”<sup>102</sup>** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë e përdorur për qëllimet letrare për të nxjerrë konkluzionin e tij, por jo për të shprehur realitetin. Pali nuk ishte inferior ndaj tyre në asnjë mënyrë.

☐ **“unë nuk jam asgjë”** Pali e dinte dhe e kuptonte pozitën e tij vetëm në hir (shih 1 Kor. 15:9; Efe. 3:8; 1 Tim. 1:15). Ai gjithashtu e dinte pozitën e tij si një apostull i thirrur dhe i talentuar (shih Veprat e Apo. 8,22,26)!

**12:12 “me shenja e mrekulli dhe çudira”** Shërbesa e Palit ishte e provuar nga fuqia e Perëndisë (shih 1 Kor. 2:4; 4:20; Rom. 15:19). Megjithatë, nuk ishin thjesht mrekullitë, por qëndrimi i tij dhe veprimet e tij ndaj kësaj kishe ato që vërtetë se ai ishte nga Perëndia.

**12:13 “unë nuk u bëra barrë për ju”** Pali nuk do ta lejonte këtë kishë të grupuar që ta ndihmonte atë. Ai i lejoi kishat në Filipi (Fil. 4:15) dhe Thesalonikë (1 Thes. 3:6), por vetëm pasi ai ishte larguar nga qytetet e tyre. Kjo i lëndoi ndenjat e kishës në Korint (shih 2 Kor. 12:13a), por Pali nuk tundej nga akuzat e mësuesve të rremë (shih 2 Kor. 11:8-20). Megjithatë, Pali e mbështeti (në parim) ndihmën financiare të kishës për shërbenjësit (shih 1 Kor. 9:3-18).

☐ **“kishat”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:2.

☐ **“Falmani këtë gabim”** Kjo është një sarkazëm therëse.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 12:14-18

<sup>14</sup> Ja, kjo është e treta herë që jam gati të vij te ju, dhe nuk dua t’ju bëhem barrë, sepse s’kërkoj pasuritë tuaja, por juve; sepse bijtë nuk e kanë për detyrë të mbledhin për prindërit, por prindërit për bijtë. <sup>15</sup> Sa për veten time, unë do të shpenzoj me gëzim dhe do të shpenzohem për shpirtrat tuaja, megjithëse ju dua më fort dhe më doni më pak. <sup>16</sup> Ashtu qoftë! Unë nuk u bëra barrë për ju; megjithatë, duke qenë dinak ju zura me dredhi. <sup>17</sup> Mos përfitova vallë ndonjë gjë nga ju me anë të ndonjë që dërgova te ju? <sup>18</sup> Unë iu luta Titit dhe me të dërgova edhe këtë vëlla. Mos përfitoi gjë Titi nga ju? A nuk kemi ecur me të njëjtin frymë dhe në të njëjtat gjurmë?

#### 12:14

NASB, NRSV, NJB “këtu”  
NKJV “tani për”  
TEV -hequr-

Kjo është pjesëza greke theksuese *idou*, e përdorur aq shpesh në ungjijt, që zakonisht përkthehet “ja”. Ajo shërben për të tërhequr vëmendjen ndaj pohimit pasardhës. Pali e përdori atë rrallë (shih Rom. 9:23 [citim i Dhjatës së Vjetër]; 1 Kor. 15:51; 2 Kor. 5:17; 6:2 [citim i Dhjatës së Vjetër], 9; 7:11; 12:14; Gal. 1:20).

☐ **“kjo është e treta herë”** Libri i Veprave të Apostujve rregjistron dy vizita në Korint (shih Veprat e Apo. 18:1; 20:2-3; 2 Kor. 1:15; 13:1,2). Megjithatë, Veprat e Apostujve nuk është një histori e plotë apo e detajuar, por një dokument teologjik që tregon përhapjen e krishterimit nga grupe njerëzish në grupe të tjerë njerëzish, nga Palestina në Romë.

☐ **“nuk dua t’ju bëhem barrë”** Kjo i referohet kompesimit financiar (shih 2 Kor. 11:9; 12:13; 1 Kor. 9:12,18). Pali konfirmoi të drejtën e shërbenjëseve për të marrë shpërblim, por personalisht e refuzoi atë për shkak se (1) ai u sulmua rreth kësaj çështjeje nga mësuesit e rremë (shih 2 Kor. 12:14b) ose (2) për shkak se e shkuara e tij si një rabin e përjashtonte këtë.

☐ **“por ju”** Pali nuk dëshiron paratë e tyre, por besnikërinë dhe vullnetin e mirë të tyre.

☐ **“bijtë... prindërit”** Pali po përdor një analogji familjare. Ai e konsideron veten si babai i tyre frymëror (shih 1 Kor. 4:14-15; Gal. 4:19).

<sup>102</sup> Versioni në shqip është: “pse”. (shënim i përkthyesit)

**12:15 “shpenzoj”** Kjo fjalë në greqisht mund të kuptohet në dy mënyra: (1) fjalë për fjalë “të paguash para” (shih Veprat e Apo. 21:24) ose (2) në mënyrë figurative “të shpenzosh plotësisht” ose “të paguash çdo gjë dhe gjithçka” (shih Mark 5:26). Pali ishte gati të jepte të gjitha asetet e tij dhe / ose vetveten për kauzën e Krishtit në mes besimtarëve korintas.

Dukshëm Pali po përdor lojë fjalësh me paranë. Ai nuk donte që ata të shpenzonin para për të, por ai do të shpenzonte vetë për ta.

▣ **“për shpirtrat tuaja”** “Shpirtrat” (dmth., *psychē*) përdoret në kuptimin e personave në shkrimet e Palit siç është “fryma” (shih *pneuma*, shih Fil. 1:27).

Kjo nuk është një dikotomi ontologjike në njerëzimin, por një marrëdhënie e dyfishtë si ndaj këtij planeti dhe ndaj Perëndisë. Fjala në hebraisht *nephesh* (BDB 659) përdoret si për njerëzimin dhe për kafshët tek Zanafilla, ndërkohë që “frymë” (*ruah*, BDB 924) përdoret vetëm për njerëzimin. Kjo nuk është një nxerrje nga konteksti për natyrën e njerëzimit si një qenie me pjesë të trefishtë (trikotomi). Njerëzimi parësisht përfaqësohet në Bibël si një unitet (shih Zan. 2:7). Për një përmbledhje të mirë të teorive të njerëzimit si trikotomi, dikotomi apo një njësi, shih *Christian Theology* [Teologjia e Krishterë] (botimi i dytë) nga Millard J. Erickson fq. 538-557 dhe *Polarities of Man's Existence in Biblical Perspective* [Polaritete të Ekzistencës së Njeriut në Pikëpamje Biblike] nga Frank Stagg.

▣ **“nëse”<sup>103</sup>** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, e cila supozohet të jetë e vërtetë nga pikëpamja e autorit ose për qëllimet e tij letrare.

▣ **“më fort”** Ky grup termash i lidhur karakterizon stilin letrar emocional dhe ekstravagant të Palit tek 2 Korintasve. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 2:7.

▣ **“a duhet të më doni më pak”<sup>104</sup>** Sa më shumë ju jepte Pali atyre, aq më shumë ata e trajtonin atë me pak respekt dhe dashuri. Kjo ishte një situatë e patolerueshme.

**12:16 “megjithatë, duke qenë dinak ju zura me dredhi”** Kjo mund të lidhet me kontributin për kishën Jeruzalem tek kapitujt 8-9. Mësuesit e rremë ndoshta e akuzonin atë që dërgonte të tjerë për të mbledhur para për të (shih 2 Kor. 12:17-18).

Komenti i Palit këtu është një sarkazëm therëse!

**12:18 “Titit”** Është befasuese që Titi nuk përmendet asnjëherë tek libri i Veprave të Apostujve (ndoshta ai ishte vëllai i Lukës). Ai ishte një nga ndihmësit më të besuar dhe besnik të Palit. (shih Temën e Veçantë tek 2 Kor. 2:13). Dukshëm, Titi gjithashtu nuk mori ndonjë para nga kjo kishë, duke ndjekur shembullin e Palit.

▣ **“me të dërgova edhe këtë vëlla”** Ky është ndoshta i njëjti person sikurse tek 2 Kor. 8:18. Disa mendojnë se ishte Luka (dmth., Origeni). Marrja me vete e përfaqësuesve nga kishat ishte mënyra e Palit për të ç’armatosur akuzat e lidhura me këtë kontribut ndaj Kishës Jeruzalem.

▣ Vargjet 17 dhe 18 kanë një seri prej katër pyetjesh. Forma gramatikore e dy të parave pret një “jo” si përgjigje, ndërsa dy të fundit presin një “po” si përgjigje. Qëllimi i pyetjeve është të tregojë se as Pali dhe as Titi nuk kishin përfituar nga ata në ndonjë mënyrë, ashtu siç akuzonin disa.

▣ **“me të njëjtin frymë”** Kjo i referohet frymës njerëzore të shpenguar të Titit (dmth., rasa vendore), jo Frymës së Shenjtë (rasa instrumentale). Pali përdor “frymë” për t’iu referuar vetes së tij shpesh (shih 2 Kor. 2:13; 7:13; 1 Kor. 2:11; 5:4; 16:18; Rom. 1:9; 8:16; Fil. 4:23). Shih shënimin tek 2 Kor. 7:13b.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 12:19-21

**<sup>19</sup> A mendoni përsëri se ne kërkojmë të justifikohemi para jush? Ne flasim përpara Perëndisë, në Krishtin,**

<sup>103</sup> Versioni në shqip është: “megjithëse” dhe fjalia nuk është në formë pyetëse por pohore. (shënim i përkthyesit)

<sup>104</sup> Versioni në shqip është pohim: “më doni më pak”. (shënim i përkthyesit)

dhe të gjitha këto, o fort të dashur, janë për ndërtimin tuaj.<sup>20</sup> Sepse kam frikë se mos kur të vij nuk ju gjej sikundër kam dashur dhe se mos ju më gjeni sikundër nuk keni dashur juve se mos ka grindje, xhelozë, zemërim, shpërthime, përgojime, insinuata, kryelartësi, ose trazira midis jush;<sup>21</sup> se mos kur të vijë sërish, Perëndia im do të më përulë në mes tuaj dhe unë do të vajtoj për shumë nga ata që kanë mëkatuar më parë dhe nuk u penduan për fëlliqësinë, kurvërinë dhe shturjen që praktikuan.

**12:19** “Gjatë gjithë kësaj kohe<sup>105</sup>” Pali i referohet letrës së tij aktuale (dmth., 2 Korintasve).

☐ “ju keni menduar se ne jemi duke mbrojtur veten tek ju<sup>106</sup>” Ky është një shënim sarkastik. Pali e njihte mirë këtë kishë. Ata kishin një vlerësim të fryrë të vlerës dhe lirisë së tyre.

☐ “Ne flasim përpara Perëndisë” Pali përdor po këtë frazë tek 2 Kor. 2:17, ku ai bën një betim për vërtetësi përpara Perëndisë.

☐ “të gjitha këto janë për ndërtimin tuaj” Pali përmend autoritetin e tij duke përdorur këtë term tek 2 Kor. 10:8. Ai mbron veten e tij për të mbrojtur këtë kishë të keqduhëhequr. Veprimet e tij ishin për ta, jo për veten e tij. Shih TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ / SPECIAL TOPIC: EDIFY tek 1 Kor. 8:1.

☐ “fort të dashur” Pali i drejtohet kësaj kishë me çiltërsi, por dhe dashuri të madhe. Ky ishte një term përkëdhelie (shih 1 Kor. 10:14; 15:58; 2 Kor. 7:1; 12:19).

**12:20** Kjo reflekton saktë përshkrimin e 1 Korintasve për këtë kishë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj Palit.

☐ “grindje” Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 2:11. Ky term dhe termi tjetër janë në njëjs (shih MSS P<sup>46</sup>, ⲛ, A), por termat e tjerë në listë janë në shumës.

☐ “xheloz” Në këtë kontekst i referohet një grupi ose fryme përçarëse (shih 1 Kor. 3:3). Shih shënimin tek 2 Kor. 9:2.

☐ “shpërthime” Kjo i referohet një shpërthimi zemërimi (shih Gal. 5:20; Efe. 4:31; Kol. 3:8).

☐ “zemërim” Ky term (dmth., *eritheia*) fillimisht kishte kuptimin “të rrotullosh për punë”. Ajo u përdor për një arrogancë aristokratike kundër atyre që ju duhej të punonin për të fituar bukën e gojës. Ky qëndrim i përshtatet rivalitetit përçarës të 1 Korintasve, sidomos kapitullit 11. Ky term përdoret shpesh nga Pali (shih Rom. 2:8; Gal. 5:20; Fil. 1:17; 2:3; dhe gjithashtu shih përdorimin e Jakobit tek Jakobi 3:14,16).

☐ “insinuata” Kjo i referohet të folurit të lig për një person tjetër, për të shpifur ndaj tyre (shih Rom. 1:30; 2 Kor. 12:20; Jakobi 4:11; 1 Pjet. 2:1,12; 3:16). Kjo veprimtari përdoret për të përshkruar veprimtarinë e Satanit.

☐ “përgojime” Ky është termi “pëshpëris”, që mund t’i referohet një thashethemnaje prapa shpinës së dikujt.

☐ “kryelartësi” Fjala në greqisht *phusioō* fillimisht kishte kuptimin të frysh diçka (dmth., Robertson, *Word Pictures in the New Testament* [Pamje të Shprehura në Fjalë në Dhjatën e Re], fq. 105 dhe Vincent, *Word Studies* [Studime Fjalësh], fq. 766, nga *phusa* - kacak). Ajo u përdor më pas në letërsinë e krishterë (ndoshta e lidhur nga Pali) në mënyrë metaforike për krenarinë ose arrogancën. Ky ishte një problem frymëror kryesor për kishën në Korint. Pali përdori këtë fjalë tek 1 Kor. 4:6,18,19; 5:2; 8:1; 13:4; dhe në një listë mëkatesh tek 2 Kor. 12:20. Ajo përdoret vetëm jashtë letrave korintase në Dhjatën e Re tek Kol. 2:18, ku i referohet vizioneve gnostike të njohurisë së veçantë.

NASB “trazira”

<sup>105</sup> Kjo frazë mungon tek versioni në shqip. (shënim i përkthyesit)

<sup>106</sup> Versioni në shqip është në formë pyetjeje: “A mendoni përsëri se ne kerkojmë të justifikohemi para jush?” dhe jo pohimi. (shënim i përkthyesit)

**NKJV** “turbullime”  
**NRSV, TEV** “rrëmuje”  
**NJB** “rrëmuja”

Shih shënimin tek 1 Kor. 14:33. Kjo ishte një kishë e përçarë. Ky term gjithashtu përdoret tek Jakobi 3:16. Gjenden disa lista vesesh në shkrimet e Palit (shih Rom. 1:29-31; 1 Kor. 5:11; 6:9; Gal. 5:19-21; Efe. 4:31; 5:34; Kol. 3:5-9). Në shumë mënyra ato janë paralele me listat e veseve të stoikëve. Krishtërimi kërkon një përgjigje etike. Jeta e përjetshme ka karakteristika morale të dukshme.

**12:21** Pali ishte i shqetësuar se nëse kjo kishë nuk pendohej ai do të detyrohej të ushtronte autoritetin e tij apostolik kur të kthehej (shih 2 Kor. 13:2). Disa nga grupet (dmth., 1 Korintasve) dhe mësuesit e rremë (dmth., 2 Korintasve) ishin dukshëm duke jetuar jetë të paperëndishme për vetëkënaqësi.

**NASB, TEV, NJB** “poshtërojë”  
**NKJV, NRSV, NIV** “përlulë”

Pali e përdor këtë term rrënjësor në disa kuptime në letrat e tij korintase (marrë nga Harold K Moulton, *The Analytical Greek Lexicon Revised* [Leksikoni Analitik në Greqisht i Rishikuar], fq. 397.

1. *tapeinos*
  - a. në situatë të ulët, në depresion (2 Kor. 7:6)
  - b. të duash butësisht ose pa tepri (2 Kor. 10:1)
2. *tapeinoō*
  - a. (forma e mesme) të jetosh në kushte të përlulura (2 Kor. 11:7)
  - b. të përlulësh veten në lidhje me shpresat dhe pritshmëritë; të jesh i mërziur me zhgënjim (2 Kor. 12:21)

▣ **“vajtoj”** Shih shënimin tek 1 Kor. 5:2.

▣ **“ata që kanë mëkatuar më pare”** E gjithë kjo frazë përkthen një nyjë dhe një formë pjesore të përdorura vetëm këtu dhe tek 2 Kor. 13:2. Ajo është një formë pjesore aktive e përkryer e parashesës në greqisht *pro* (dmth., përpara) dhe *hamartanō* (dmth., të mëkatosh). Kuptimi i kombinuar është ata që kanë mëkatuar dhe vazhdojnë të mëkatojnë. Koncepti i “së shkuarës” nuk përfshihet, por është një shtesë e përkthyesve. Koha përfshihet vetëm në mënyrën treguese.

▣ **“penduan”** Ky varg dukshëm i referohet të krishterëve që vazhdojnë të mëkatojnë. Pendesa është thelbësore, jo vetëm fillimisht (shih Mark 1:15; Veprat e Apo. 2:38,41; 3:16,19; 20:21), por edhe në vazhdimësi (shih 1 Gjoni 1:9). Pendesa për një besimtar restauron marrëdhënien, jo shpëtimin! Pendesa është një qëndrim ndaj Perëndisë dhe vetes më shumë se sesa një tërësi veprimesh apo hapash frymërore të caktuara. Shih shënimin e plotë tek 2 Kor. 7:8-11.

▣ **“fëlliqësinë, kurvërinë dhe shthurjen”** Ne duhet të mbajmë mend se nga cila kulturë e paperëndishme dhe e pshore vinin këta besimtarë të rinj nga Korinti. Ata ishin rritur me tepri seksuale dhe mospërmbajtje në emër të zotëve. Megjithatë, vini re se ky varg gjithashtu përmend mënyrat me anë të të cilave të krishterët trajtojnë mëkatin në jetët e tyre – pendesa (shih 1 Gjoni 1:9; Ps. 19:12-14). Besimi dhe pendesa janë përjetesa frymërore si fillestare ashtu edhe të vazhdueshme në jetën e të krishterit.

Lista mund të reflektojë veprimet e mësuesve të rremë të cilët theksonin stilin retorik në greqisht, që mund të nënkuptojë se ata kishin qënë gjithashtu të ekspozuar ndaj gnosticizmit, i cili theksonte njohurinë, por zhvlerësonte standartet etike. Të gjithë këta terma listohen nga Pali në mëkatet e mishit tek Gal. 5:19. Drejtësimi nuk duhet / nuk mund të ndahet nga shenjtërimi!

## **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t'ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Pse e përmend Pali zbulesën e tij të veçantë dhe më pas nuk na e tregon atë?
2. Pse është dobësia një kyç që të bëhesh i përdorshëm?
3. A e përdor Perëndia ligësinë për të arritur qëllimin e Tij?
4. Pse ishte Pali aq i prekur nga marrja e parave nga kjo kishë? (shih 2 Kor. 12:20-21).

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](#)

## 2 KORINTASVE 13

### NDARJA E PARAGRAFËVE TË PËRKTHYESVE MODERNË

UBS <sup>4</sup>	NKJV	NRSV	TEV	NJB
Paralajmërimet dhe Përshëndetje Përfundimtare	Ardhja me Autoritet	Një Thirrje për Vetë-vlerësim dhe Ndryshim  (12:19-13:10)	Paralajmërimet dhe Përshëndetje Përfundimtare	Frikërat dhe Ankthet e Palit  (12:19-13:10)
13:1-4	13:1-6	13:1-4	13:1-4	13:1-4
13:5-10	Pali Preferon Johebrenjtë  13:7-10	13:5-10	13:5-10	13:5-10
13:11-12	Përshëndetje dhe Bekime  13:11-14	Përmbyllje  13:11-12	13:11  13:12a  13:12b	Përmbyllje  13:11  13:12
13:13		13:13	13:13	13:13

### CIKLI TRE I LEXIMIT (shih [“Bible Interpretation Seminar”](#) [Seminari Biblik i Interpretimit])

#### *DUKE NDJEKUR QËLLIMIN ORIGJINAL TË AUTORIT NË NIVEL PARAGRAFI*

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t'ia dorëzoni këtë një komentatori.

Lexoni kapitullin përnjëherësh. Identifikoni subjektet. Krahasoni ndarjen tuaj të temave me ato të pesë përkthimeve më sipër. Ndarja e tekstit në paragrafë nuk është frymëzuar por është kyç për të ndjekur qëllimin fillestar të autorit i cili është në zemër të interpretimit. Çdo paragraf ka një dhe vetëm një subjekt.

1. Paragrafi i parë
2. Paragrafi i dytë
3. Paragrafi i tretë
4. Etj.

### STUDIM I FJALËS DHE FRAZAVE

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 13:1-4

<sup>1</sup> Ja, kjo është e treta herë që po vij te ju. “Çdo gjë do të qëndrojë me gojën e dy a tre dëshmitarëve.” <sup>2</sup> E thashë edhe më parë, kur isha i pranishëm te ju për të dytën herë, dhe po e them tani që jam larg jush. Po u shkruaj atyre që kanë mëkatuar më përpara dhe të gjithë të tjerëve se, po të vij përsëri, nuk do të kursej *njeri*. <sup>3</sup> Sepse ju kërkoni provën e Krishtit që flet në mua; dhe ai s’është i dobët ndaj jush, por është i fuqishëm në ju. <sup>4</sup> Sepse, megjithëse Ai u kryqëzua në dobësinë e Tij, Ai po rron nëpërmjet fuqisë së Perëndisë, sepse edhe ne jemi të dobët në Të, por do të rrojmë me Të nëpërmjet fuqisë së Perëndisë ndaj nesh.

**13:1 “kjo është e treta herë që po vij te ju”** Kjo jep besueshmëri tekstuale ndaj teorisë së vizitës së dhimbshme të Palit në Korint midis shkrimit të letrës së I dhe II të Korintasve (shih 2 Kor. 12:14). Kjo vizitë nuk regjistrohet në librin e Veprave të Apostujve.

■ **“Çdo gjë”** Kjo fillon një citim nga Ligji i Përt. 19:15 (shih Num. 35:30; Ligji i Përt. 17:6; Mat. 18:16; 1 Tim. 5:19), i cili trajton procedurat e gjyqit. Kujt i referohet në këtë kapitull? Ka dy mundësi.

1. I referohet vlerësimit të kishës për Palin. Ai kishte qënë atje dy herë dhe kishte ndarë me ta. Ata ishin përgjegjës dhe do të mbanin përgjegjësi si dëgjues të së vërtetës.
2. I referohet disiplinës së kishës të lidhur me një grup brenda kishës.
  - a. Grupimet e përçara të 1 Kor. 1-4 (shih 2 Kor. 12:20)
  - b. Një grupi imoral (shih 2 Kor. 12:21)
  - c. “super apostujve” ose mësuesve të rremë me lidhje ndaj Jeruzalemit dhe Judaizmit (kapitujt 10-13, sidomos 11:13-15)

<b>NASB</b>	<b>“do të konfirmohet”</b>
<b>NKJV</b>	<b>“do të qëndrojë”</b>
<b>NRSV</b>	<b>“duhet të mbahet”</b>
<b>TEV</b>	<b>“duhet të qëndrojë”</b>
<b>NJB</b>	<b>“është e domosdoshme”</b>

Forma e kësaj foljeje është një formë treguese pasive e ardhshme (shih NKJV), por Barbara dhe Timothy Friberg në *Analytical Greek New Testament* [Analizë e Dhjatës së Re në Greqisht], fq. 573, thonë se ajo funksionon si një formë urdhërore pasive aoriste (shih NRSV, NJB). Shih TEMË E VEÇANTË: QËNDROJ (HISTËMI) / SPECIAL TOPIC: STAND (HISTËMI) tek 1 Kor. 15:1.

**13:2 “Po u shkruaj atyre që kanë mëkatuar më përpara dhe të gjithë të tjerëve”** Kjo duket se lidhet me dy grupe. I pari “që ka mëkatuar më përpara” (forma pjesore aktive e përkryer), duhet t’i referohet atyre besimtarëve në Korint që e dëgjuan Palin dy herë, por ende u rebeluan kundër drejtimit të tij. Ky duhet të ishte grupi i përçarë i 1 Korintasve 1-4 ose një grup imoral (shih 2 Kor. 12:20-21; 1 Korintasve 5).

Fraza “dhe të gjithë të tjerëve” duket se lidhet me ata që nuk ishin të pranishëm të dy herët, ndoshta apostujt e rremë nga Jeruzalemi dhe mbështetësit e tyre, të cilët janë fokusi i kapitujve 10-13. Megjithatë, të dy grupet / të gjithë grupet vendosen në vëmendjen që Pali dëshiron që ata të trajtojnë problemet, dhe nëse nuk e bëjnë, do ta bëjë ai!

▣ **“po të”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të tretë, por ajo përdoret në kuptimin e “kur” (shih Gjoni 16:7 dhe 1 Gjonit 3:2).

▣ **“nuk do të kursej njeri”** Pali përdor këtë term në një kuptim pozitiv tek 1 Kor. 7:23 dhe 2 Kor. 1:23, por në një kuptim gjykues si këtu ashtu edhe tek 2 Kor. 12:6 (shih 2 Kor. 10:11).

**13:3 “provën”** Ky koncept i testimi përsëritet në këtë kontekst. Gjendet një lojë fjalësh e vazhdueshme midis ngjyrimëve të dy termave në greqisht, *dokimazō* dhe *peirazō*.

1. v. 3, provë - *dokimē* (shih 2 Kor. 2:9; 8:2; 9:13; 13:3)
2. v. 5, test (provoj) - *peirazō* (shih 2 Kor. 13:5)
3. v. 5, analizoj - *dokimazō* (shih 2 Kor. 8:8,22; 13:5)
4. v. 5, nuk e kaloj provën - *adokimos*
5. v. 6, e kalojnë testin (të përjashtuar) - *adokimos*
6. v. 7, miratoj - *dokimos* (shih 2 Kor. 10:18)
7. v. 7, përjashtoj - *adokimos*

Për studimin e plotë të fjalës shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13.

▣ **“e Krishtit që flet në mua”** Disa në Korint po sfidonin autoritetin e Palit. Ata po vinin në “provë” Palin! Tek 2 Kor. 13:5 Pali do të vërë në “provë” ata! Prania e Krishtit tek Pali është konfirmuar (shih 2 Kor. 12:12).

▣ **“s’është i dobët”** Dobësia është mënyra e Perëndisë për të fituar sikurse ilustron në jetën e Jezusit (shih 2 Kor. 13:4) dhe në jetën e Palit (shih 2 Kor. 10:1,11; 12:9; 13:9). Asnjë genie njerëzore nuk do të përlëvdohet përpara Perëndisë për arritje frymërore që janë një rezultat i drejtpërdrejtë i Atij që Perëndia është dhe asaj që ne nuk jemi. Janë burimet e Perëndisë ato që arrijnë rezultate frymërore! Besimtarët duhet të lejojnë që fuqia e Tij të rrjedhë përmes nevojave dhe dobësisë së tyre. Shih TEMË E VEÇANTË: DOBËSIA / SPECIAL TOPIC: WEAKNESS tek 2 Kor. 12:9.

Vargjet 3-4 janë antiteza e përmbledhur e mësuesve të rremë arrogantë retorikë. Ata pretendonin një superioritet nga

1. prejardhja racore
2. përvoja personale karizmatike
3. trajnimi retorik superior sofistisk
4. krahasimet personale

▣ **“ndaj jush... në ju”** Kjo formë “ju” në shumës tregon se Pali po i referohet një përvoje të grigjës, jo një përvoje personale (shih 2 Kor. 13:5). Ndoshta përkthimi TEV, “mes jush”, arrin të kapë kuptimin.

**13:4 “u kryqëzua”** Pali përdor disa terma për të përshkruar vdekjen e Jezusit:

1. vdekja (shih Rom. 5:6 e në vazhdim; 8:34; 14:15; 1 Kor. 8:11; 15:3; 2 Kor. 5:15; Gal. 2:21; 1 Thes. 4:14; 5:10)
2. gjaku (shih Rom. 3:25; 5:9; Efe. 1:7; 2:13; Kol. 1:20)
3. kryqi (shih 1 Kor. 1:17-18; Gal. 5:11; 6:12,14; Efe. 2:16; Fil. 2:8; Kol. 1:20; 2:14)
4. kryqëzimi (shih 1 Kor. 1:23; 2:2; 2 Kor. 13:14; Gal. 3:1)

▣ **“Ai po rron nëpërmjet fuqisë së Perëndisë”** Janë fraza si këto që kanë shkaktuar kaq shumë polemika kristologjike në kishën e hershme. A nuk është Jezusi gjithashtu Perëndi? A jeton Jezusi njerëzor me anë të fuqisë së një hyjnie të ndarë (dmth., YHWH)? Nuk mund të ndërtohet një i kuptuar sistematik mbi një varg ose vargje të përzgjedhura, por duhet të përpiqemi të unifikojmë të gjitha konceptet teologjike në një tërësi të integruar. Shih TEMË E VEÇANTË: MONOTEIZMI / SPECIAL TOPIC: MONOTHEISM tek 1 Kor. 8:4.

Zakonisht terminologjia e këtij vargu përdoret për të konfirmuar se Perëndia At, si një vepër miratimi, e ringjalli Birin (shih Veprat e Apo. 2:24; 3:15; 4:10; 5:30; 10:40; 13:30,33,34,37; 17:31; Rom. 1:4; 6:4,9; 8:11; 10:9; 1 Kor. 6:14; 2 Kor. 4:14; Gal. 1:1; Efe. 1:20; Kol. 2:12; 1 Thes. 1:10). Megjithatë, gjenden tekste të tjera të frymëzuar që konfirmojnë se (1) Fryma e ka ringjallur Birin (shih Rom. 8:11) ose (2) Biri e ka ringjallur Vetveten (shih Gjoni 2:19-22; 10:17-18).

▣ **“edhe ne jemi të dobët në Të, por do të rrojmë me Të”** Të kuptuarit e Palit të krishtërit ishte një identifikim i besimtarëve në jetën, vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Ndërsa Ai jetoi një jetë të përlur, të butë dhe të keqkuptuar, po kështu do të bëjmë edhe ne; ndërsa Ai vdiq në shërbim ndaj të tjerëve, po kështu duhet të bëjmë edhe ne; ndërsa Ai u ringjall, po kështu jemi ringjallur ne (dmth., jeta e re tani) dhe do të ringjallemi (dmth., trupi i ringjalljes në Ardhjen e Dytë).

Kjo teologji identifikuese është aq e dukshme tek Romakëve 6. Pali shkroi letrën ndaj Romakëve ndërkohë që ai po merrej me Korintin. Të kuptuarit sistematik i Palit i krishtërit (dmth., Romakëve) u plotësua ndërkohë që ai po punonte me këtë kishë disfunktionale.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 13:5-10

<sup>5</sup> Analizoni veten tuaj a jeni në besim; provoni veten tuaj! A thua nuk e njihni vetveten se Jezu Krishti është në ju? Veç në qofshi të përjashtuar. <sup>6</sup> Por unë shpresoj se ju do ta njihni se ne nuk jemi të përjashtuar. <sup>7</sup> Edhe i lutem Perëndisë që të mos bëni ndonjë të keqe, jo që të dukemi të miratuar, por që ju të bëni atë që është e mirë edhe sikur ne të ishim të përjashtuar. <sup>8</sup> Ne në fakt nuk kemi asnjë forcë kundër së vërtetës, por *vetëm* pro së vërtetës. <sup>9</sup> Sepse ne gëzohemi kur jemi të dobët dhe ju jeni të fortë; dhe ne lutemi edhe për këtë: për përsosjen tuaj. <sup>10</sup> Prandaj i shkruaj këto gjëra, kur jam larg jush, që, kur të jem i pranishëm, të mos sillem me ashpërsi, sipas autoritetit që më ka dhënë Zoti për të ndërtuar e jo për të prishur.

**13:5 “Analizoni veten tuaj”** Kjo është një formë urdhërore aktive e tashme. Kjo është folja *peirazō*, që do të thotë “të testosh me një synim drejt shkatërrimit”. Shih shënimin e plotë tek 1 Kor. 3:13. Ata kishin testuar Palin; tani ata duhet të testonin vetveten!



☐ **“nëse”** Kjo është një fjali kushtore e rendit të parë, që supozohet të jetë e vërtetë. Pali nuk po vë në dyshim besimin e tyre, por po i sfidon ata që të zgjohen!

☐ **“besim”** Termi në greqisht “*bësim*” (*pistis*) përkthehet në anglisht nga tri terma: besim, besoj ose kam besim. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:4. Besimi përdoret në tri kuptime në Dhjatën e Re: (1) si pranim personal i Jezusit si Krishti i Perëndisë; (2) si të jetuarit besnik për Të; dhe (3) si një trup të vërtetash rreth Tij (shih 2 Kor. 13:3; Gal. 1:23; 3:23-25). Krishtërimi i pjekur i përfshin të tre kuptimet.

☐ **“provoni veten tuaj”** Pali e përsërit urdhërimin e tij (dmth., një formë tjetër urdhërore aktive e tashme), por përdor një term tjetër (dmth., *dokimazō*) për provim, që nënkupton të provosh me një synim drejt miratimit. Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 3:13.

☐ **“njihni”** Ky është termi në greqisht *epignōskō* (dmth., forma treguese aktive e tashme), e cila zakonisht përcakton njohuri të plotë të përvojës.

☐ **“Jezu Krishti është në ju”** Sikurse 2 Kor. 13:4 fokusohet mbi aspektin e përbashkët, kjo frazë (duke përdorur të njëjtën parashtesë dhe përemër në shumës) mund t’i referohet një aspekti më shumë individual. Krishti është sigurisht në mes të popullit të Tij, por Ai është gjithashtu në secilin nga njerëzit e Tij! Shërbesat e Jezusit dhe të Frymës gjithashtu lidhen aq ngushtësisht sa që Fryma quhet Fryma e Krishtit (shih Rom. 8:9; 1 Pjet. 1:11). Për Jezusin madje thuhet se banon brenda besimtarëve (shih Gjoni 14:23; Rom. 8:10; Kol. 1:27. Gjithashtu vini re Mat. 28:20). Shih TEMË E VEÇANTË: JEZUSI DHE FRYMA / SPECIAL TOPIC: JESUS AND THE SPIRIT tek 2 Kor. 3:17.

☐ **“Veç në mos e kalofshi provën”<sup>107</sup>** Kjo frazë është paralele me “nëse jeni në besim” tek 2 Kor. 13:5. Pali ka konfirmuar në disa mënyra (dmth., fjalia kushtore e rendit të parë tek 2 Kor. 13:5 dhe përdorimi i *dokimazō*) se ai beson se lexuesit e tij janë besimtarë, por jo të gjithë. Gjendet një kontigjent mësuesish të rremë të cilët nuk e njohin Krishtin [shih TEMË E VEÇANTË: FEMOHIMI (AFISTËMI) / SPECIAL TOPIC: APOSTASY (APHISTËMI) tek 1 Kor. 6:9]. Kjo fjali lidhet me ta.

Kjo fjali nuk lidhet me besimtarët mëkatarë për shkak se Pali iu drejtohet atyre tek 2 Kor. 12:20-21. Ata kanë nevojë të pendohen, por mësuesit e rremë kanë nevojë për Krishtin (shih Mateu 7).

Pali përdor po këtë term tek 1 Kor. 9:27 si arsyeja pse ai e kishte të vështirë që ta mbante veten nën kontrollin e Perëndisë. Pali nuk dëshironte të ishte i “pakualifikuar” apo i refuzuar. Besimtarët sfidohen që të kontrollojnë vetveten (shih Fil. 2:12).

**13:6** Pali po konfirmon se ai dhe besimtarët e tij e kanë kaluar provën (dmth., nuk janë të rremë, *adokimos*, shih 2 Kor. 13:7), sidomos në lidhje me kishën në Korint. Nëse ata kanë Krishtin që banon brenda tyre, atëherë shërbesa e Palit ishte e frytshme.

**13:7** Në një farë kuptimi, një kishë besimtare e fortë do të konfirmonte drejtimin e Palit dhe kredencialet e tij apostolike. Ai është më i shqetësuar që ata të bëjnë atë që është e drejtë dhe e përshtatshme për shkak të Perëndisë dhe të ungjillit, jo thjesht që t’ju tregojë kredencialet e Palit apo të konfirmojë drejtimin e tij (shih 2 Kor. 13:9).

☐ **“të miratuar... të përjashtuar”** Pali e vazhdon këtë lojë fjalësh me *dokimos* dhe *adokimos*.

**13:8** E vërteta në këtë kontekst i referohet ungjillit si një person (dmth., Jezus Mesias), si një mesazh (dmth., ungjilli mbi Jezusin) dhe si një stil jetese (dmth., synimi i jetës së Jezusit).

**TEMË E VEÇANTË: “E VËRTETA” NË SHKRIMET E PALIT (SPECIAL TOPIC: “TRUTH” IN PAUL'S WRITINGS)**

Përdorimi nga ana e Palit i këtij termi dhe i formave të lidhura me të vjen nga barazvlerësi i tij në

<sup>107</sup> Versioni në shqip është: “Veç në qofshi të përjashtuar”. (shënim i përkthyesit)

Dhjatën e Vjetër, *emet*, që do të thotë i besueshëm ose besnik (BDB 53, shih TEMË E VEÇANTË: BESOJ, ZË BESË, BESIM DHE BESNIKËRI NË DHJATËN E VJETËR / Special Topic: Believe, Trust, Faith, and Faithfulness in the OT). Në shkrimet hebreje të periudhës midis dy Dhjatave ajo përdoret për të vërtetën në kontrast me gënjeshtren. Ndoshta paraleli më i afërt do të ishin Rrotullat e Detit të Vdekur “Himnet e Falenderimit,” ku ajo përdoret për doktrinat e zbuluara. Anëtarët e Komunitetit Esen u bënë “dëshmitarë të së vërtetës.”

Pali e përdor këtë term si një mënyrë për t’iu referuar ungjillit të Jezu Krishtit.

1. Romakëve 1:18,25; 2:8,20; 3:7; 15:8
2. I Korintasve 13:6
3. II Korintasve 4:2; 6:7; 11:10; 13:8
4. Galatasve 2:5,14; 5:7
5. Efesianëve 1:13; 6:14
6. Kolosianëve 1:5,6
7. II Thesalonikasve 2:10,12,13
8. I Timoteut 2:4; 3:15; 4:3; 6:5
9. II Timoteut 2:15,18,25; 3:7,8; 4:4
10. Titit 1:1,14

Pali gjithashtu e përdor këtë term si një mënyrë për të shprehur faktin që po flet me saktësi.

1. Veprat e Apo. 26:25
2. Romakëve 9:1
3. II Korintasve 7:14; 12:6
4. Efesianëve 4:25
5. Filipianëve 1:18
6. I Timoteut 2:7

Ai gjithashtu e përdor atë për të përshkruar motivet dhe mënyrën e tij të jetesës te I Kor. 5:8 (gjithashtu për të gjithë të krishterët) në Efe. 4:24; 5:9; Fil. 4:8. Ai ndonjëherë e përdor atë për njerëzit.

1. Perëndia, Rom. 3:4 (shih Gjoni 3:33; 17:17)
2. Jezusi, Efe. 4:21 (në ngjashmëri me Gjoni 14:6)
3. Dëshmitarët apostolikë, Titit 1:13
4. Pali, II Kor. 6:8

Pali e përdor formën foljore (dmth., *alētheuō*) vetëm tek Gal. 4:16 dhe Efe. 4:15, ku ajo i referohet ungjillit. Për studim të mëtejshëm konsultoni Colin Brown (ed), *The New International Dictionary of New Testament Theology* [Fjalori i Ri Ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re], vëll. 3, faqet 784-902.

**13:9 “ne gëzohemi kur jemi të dobët dhe ju jeni të fortë”** Ky është paradoksi i Palit. Ai e di se fuqia frymërore çlirohet përmes dobësisë njerëzore (shih 2 Kor. 12:10; 13:4). Prandaj, ai dëshiron që të qëndrojë i dobët. Megjithatë, për kishën korintase që të ishte e fortë, edhe ajo gjithashtu, duhej të bëhej e dobët. Kjo është mënyra e kundërt nga se si njerëzit e vlerësojnë jetën. Mësuesit e rremë kanë konfirmuar fuqinë përmes arsimimit, prejardhjes, përvojës, por Pali konfirmon fuqinë përmes shembullit të Krishtit (shih 2 Kor. 13:4).

▣ **“për përsosjen tuaj”** Forma emërore e këtij termi gjendet vetëm këtu në Dhjatën e Re. Folja do të thotë “të lidhësh bashkë”. Pali përdor formën foljore tek 1 Kor. 1:10, gjë që i bën thirrje kishës korintase që t’i japë fund ndarjeve të tyre në grupime. Tani në fund të 2 Korintasve ai i rikthehet këtij urdhërimi (dmth., uniteti që do të rezultojë në jetë të përshtatshme frymërore).

Louw dhe Nida, *Greek-English Lexicon of the New Testament* [Leksikoni Greqisht-Anglisht i Dhjatës së Re], vëll. 1, p. 680, konfirmon se *artios* (dmth., i plotë, i përshtatshëm, i pajisur plotësisht për detyrën e caktuar), me të gjitha përbërjet e tij të ndryshme parashtesore (dmth., *epi* dhe *kata*), janë të gjitha sinonime (shih Luka 6:40; 2 Kor. 13:9,11; Efe. 4:12; 2 Tim. 3:17).

Pali dëshiron një kishë funksionale, të bashkuar dhe të dashur në Korint (shih 2 Kor. 13:11). Që kjo të ndodhë duhet të ketë falje, pajtim dhe disiplinë kishë (shih Gal. 6:1).

**13:10** Pali nuk dëshironte të bënte një vizitë tjetër të dhimbshme në Korint (shih 2 Kor. 2:3-4). Ai nuk dëshironte të vinte i mbështjellë në autoritetin e tij apostolik, por në dashuri prindërore. Megjithatë, përgjigja e kishës përcaktoi se si duhej të vepronte ai.

☐ **“sipas autoritetit që më ka dhënë Zoti”** Po e njëjta frazë shfaqet tek 2 Kor. 10:8. Ky autoritet apostolik, qoftë në prani personale apo prej së largmi (shih 1 Kor. 5:4), ka autoritetin e Krishtit (shih 2 Kor. 12:19; 13:3). Ky autoritet iu dha Palit në takimin në rrugën e Damaskut (shih Veprat e Apo. 9,22,26).

☐ **“për të ndërtuar”** Shih TEMË E VEÇANTË: NDËRTOJ / SPECIAL TOPIC: EDIFY at 1 Kor. 8:1.

#### VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 13:11-13

**<sup>11</sup> Më në fund, o vëllezër, gëzohuni, përsosuni, ngushëllohuni, jini të një mendje, jetoni në paqe; dhe Perëndia i dashurisë dhe i paqes do të jetë me ju. <sup>12</sup> Përsëndetni njeri tjetrin me një puthje të shenjtë, <sup>13</sup> të gjithë shenjtoret ju përshëndesin.**

**13:11 “Më në fund”** Fjalë për fjalë kjo është “për të tjerat” (shih Gal. 6:17). Kjo është një shprehje karakteristike e Palit për përmbyllje (shih Efe. 6:10; Fil. 3:1; 4:8; 2 Thes. 3:1). Ajo zakonisht shenjon një kalim tek një pikë mbylljeje.

☐ **“o vëllezër”** Çfarë mënyre e bukur dhe ngushëlluese për të mbyllur këtë letër të vështirë ndaj një kishë problematike. Ajo gjithashtu funksionon si një pjesë letrare për të sinjalizuar kalimin tek një temë e re.

☐ Gjendet një seri prej pesë formash urdhërore.

1. “gëzohuni” (forma urdhërore aktive e tashme). Pali e përdor shpesh këtë term tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 2:3; 6:10; 7:7,9,13,16; 13:9,11). Ky term mund të ketë kuptimin “mirëupafshim” (shih Fil. 3:1; 4:4), por kjo nuk përputhet me një seri formash urdhërore.
2. “përsosuni” (forma urdhërore pasive e tashme). Kjo flet për unitetin dhe shërbesën (shih v 9).
3. “ngushëllohuni” (forma urdhërore pasive e tashme). Pali e përdor këtë term shpesh tek 2 Korintasve (shih 2 Kor. 1:4,6; 2:7,8; 5:20; 6:1; 7:6,7,13; 8:6; 9:5; 10:1; 12:8,18; 13:11).
4. “jini të një mendje” (forma urdhërore aktive e tashme). Ky term në greqisht ka shumë ngjyime (shih Louw dhe Nida, vëll. 2, fq. 259), por në këtë kontekst ajo është paralele me “përsosuni”. Kjo i referohet unitetit për hir të ungjillit. Kjo nuk po konfirmon se besimtarët duhet të bien dakord mbi çdo çështje, por se kur ata nuk bien dakord duhet ta bëjnë me dashuri dhe se ungjilli gjithmonë duhet të ketë prioritet mbi opinionet apo preferencat personale!
5. “jetoni në paqe” (forma urdhërore aktive e tashme). Kjo sigurisht reflekton 1 Korintasve 1-4 dhe 2 Korintasve 10-13. Është e pasigurtë se si lidhen këto probleme, por të dyja shkaktojnë përçarje dhe grindje. Pali urdhëron paqe, jo kompromis, por në ngjashmëri me Krishtin. Perëndia i paqes (shih 2 Kor. 13:11) do të na ndihmojë ne në dobësinë tonë!

☐ **“Perëndia i dashurisë dhe i paqes”** Çfarë titulli i mrekullueshëm përshkruet për YHWH. YHWH shpesh lidhet me “paqen” (shih Rom. 15:33; 16:20; 1 Kor. 14:33; Fil. 4:9; 1 Thes. 5:23; Heb. 13:20). Ai thirret “Zoti i paqes” tek 2 Thes. 3:16. Dashuria dhe paqja përmenden të dyja tek Efe. 6:23. Besimtarët duhet të shpalosin këto karakteristika në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrit.

**13:12 “Përsëndetni”** Kjo mund të përkthehet “thojuni lamtumirë” (shih Veprat e Apo. 20:1; 21:6). Ajo përçon një qëndrim pranimit dhe bashkëpunimi. Qëndrimi i kundërt shprehet tek Mat. 5:47.

Vetëm një koment mbi numrat tek këto dy vargje të fundit. Disa përkthime në anglisht kombinojnë 2 Kor. 13:12-13 (TEV, NJB, RSV, NRSV), ndërsa të tjerë e ndajnë atë në dy vargje (KJV, NKJV, NASB, NIV).

■ **“puthje të shenjtë”** Ky zakon (dmth., midis anëtarëve të familjes dhe miqve) më pas u ndalua për shkak të keqkuptimit pagan (dmth., puthje erotike). Në kishën e hershme burrat puthnin burrat dhe gratë puthnin gratë (dmth., duke ndjekur zakonet e sinagogës, shih Rom. 16:16; 1 Kor. 16:20; 1 Thes. 5:26). Shih shënimin tek 1 Kor. 16:20.

Kjo është një formë urdhërore. A do të thotë kjo se të krishterët duhet ta përshëndesin njëri-tjetrin në një mënyrë të caktuar? Këtu është një shembull i mirë se si kultura dhe situatat e ardhshme duhet të ndikojnë në interpretim. Nuk është çështja tek forma e përshëndetjes, por tek qëndrimi. Besimtarët janë një familje.

**13:13 “të gjithë shenjtorët”** Kjo frazë nuk i referohet vetëm Palit dhe skuadrës së tij misionare, por “të gjithë shenjtorëve” (dmth., të gjitha kishat e tjera të Palit). Gjendej një tension midis Korintit dhe këtyre kishave të tjera. Ata e mbanin për superiore këtë kishë. Pali e adreson këtë çështje duke iu përmendur disa herë standartet që ai mësoi në të gjitha kishat (shih 1 Kor. 4:17; 7:17; 11:16,34; 14:33). Korinti duhet të jetë pjesë e familjes, jo një anëtar i privilegjuar elitë. Shih TEMË E VEÇANTË: SHENJTORË / SPECIAL TOPIC: SAINTS tek 1 Kor. 1:2. Në krizën e tyre aktuale, të gjitha grigjat e nisura nga Pali dërgojnë përshëndetjet e tyre, që nënkupton bashkësi, përkujdesje, bashkëpunim, lutje dhe pranim.

#### **VERSIONI SHQIP: 2 Korintasve 13:14**

**<sup>14</sup>Hiri i Zotit Jezu Krisht, dashuria e Perëndisë dhe bashkësia e Frymës së Shenjtë qofshin me ju të gjithë. Amen.**

**13:14** Pali gjithmonë mbyll letrat e tij me një lutje ose bekim, por kjo është e veçantë. Ajo kombinon tri aspektet e karakterit të Perëndisë me tri personat e Trinitës. Gjithashtu është e pazakontë që Jezusi përmendet i pari. Për shënimet e plota mbi Trinitën shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 2:10.

Tri aspektet e Perëndisë: hiri, dashuria dhe bashkësia, janë për “të gjithë” besimtarët në Korint. Kjo është një pjesë thelbësore e lutjes. Pali dëshiron të restaurojë unitetin në mes të besimtarëve por edhe të dallojë dhe të refuzojë besimtarët e rremë.

Pali përdori një skrib për të shkruar letrat e tij, por ndoshta ai mori penën për ta shkruar lutjen e fundit vetë ai (shih 2 Thes. 3:17). Pali e donte këtë kishë!

■ **“bashkësia e Frymës së Shenjtë”** Shih Temën e Veçantë tek 1 Kor. 1:9 dhe 12:11.

#### **PYETJE DISKUTIMI**

Ky është një komentari studimi udhëzues, i cili do të thotë se ju jeni përgjegjës për interpretimin tuaj të Biblës. Secili nga ne duhet të ecë në dritën që kemi. Ju, Bibla dhe Fryma e Shenjtë jeni prioritet në interpretim. Nuk duhet t’ia dorëzoni këtë një komentatori.

Këto pyetje diskutimi janë dhënë për t’ju ndihmuar të mendoni përmes çështjeve të mëdha të këtij seksioni të librit. Ato kanë për qëllim që të provokojnë mendime, dhe jo të jenë definitive.

1. Si e provojnë vetveten besimtarët?
2. Pse flet Pali kaq shpesh në kapitujt 11-13 mbi dobësinë e tij?
3. Si lidhet siguria me qëndrueshmërinë?
4. Si mundet që Perëndia të jetë një dhe tre në të njëjtën kohë?

Copyright © 2013 [Bible Lessons International](http://www.biblelessons.org)

# PËRCAKTIVE TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT

Grequishtja koine, shpesh e quajtur grequishtja heleniste, ishte gjuha e përbashkët e botës mesdhetare, duke filluar që nga pushtimi i Aleksandrit të Madh (336-323 para lindjes së Krishtit) dhe duke zgjatur rreth tetëqind vjet (300 para lindjes së Krishtit – 500 pas lindjes së Krishtit). Ajo nuk ishte thjesht greqishte klasike e thjeshtëzuar, por, në shumë mënyra, ishte një formë më e re e greqishtes, e cila u bë gjuha e dytë e Lindjes së mesme dhe botës mesdhetare në lashtësi.

Grequishtja e Dhjatës së Re ishte unike në shumë mënyra pasi përdoruesit e saj, përjashtoj Lukën dhe autorin e Hebrenjve, ndoshta përdornin aramaishten si gjuhë të parë. Si rrjedhojë, shkrimet e tyre u ndikuan nga idiomat dhe format strukturore të aramaishtes. Po kështu, ata lexonin dhe citonin Septuagintën (përkthimin greqisht të Dhjatës së Vjetër), e cila ishte shkruar gjithashtu në greqishten koine. Mirëpo edhe Septuaginta ishte shkruar nga studiues judenj, gjuha amëtare e të cilëve nuk ishte greqisht.

Kjo na shërben si kujtesë se nuk mund ta vendosim forcërisht Dhjatën e Re brenda një strukture të ngushtë gramatikore. Ajo është unike, por, megjithatë, ka shumë të përbashkëta me (1) Septuagintën; (2) shkrimet judaike si ato të Jozefit; dhe (3) papiruset e gjetura në Egjipt. Po atëherë, si duhet t'i qasemi analizës gramatikore të Dhjatës së Re?

Tiparet gramatikore të greqishtes koine dhe greqishtes koine të Dhjatës së Re janë të paqëndrueshme. Në shumë mënyra, bëhet fjalë për një periudhë thjeshtëzimi të gramatikës. Si udhërrëfyes kryesor do të kemi kontekstin. Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst më të gjerë, prandaj, struktura gramatikore mund të kuptohet vetëm në dritën e (1) stilit individual të autorit; dhe (2) kontekstit të veçantë. Asnjë përcaktim përfundimtar i formave dhe strukturave greke nuk është i mundshëm.

Grequishtja koine ishte kryesisht një gjuhë foljore. Shpesh, çelësi drejt interpretimit është lloji dhe forma e trajtave FOLJORE. Në shumicën e rasteve, FOLJA shfaqet e para, duke treguar epërsinë e saj. Në analizën e FOLJES greke, duhen vërejtur tre pjesë informacioni: (1) theksimi bazë i KOHËS, DIATEZËS dhe MËNYRËS (eptimi ose morfologjia); (2) kuptimi bazë i FOLJES (leksikografia); dhe (3) rrjedha e kontekstit (sintaksa).

## I. KOHA

- VII. Koha ose aspekti ka të bëjë me marrëdhënien e FOLJEVE me veprimin e përfunduar ose të papërfunduar. Shpesh, ai quhet “I KRYER”, ose “I PAKRYER”.
5. KOHËT E KRYERA përqendrohen te kryerja e një veprimi. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk jepet përveç faktit se diçka ka ndodhur! Nuk trajtohet fillimi, vazhdimi, apo kulmimi i veprimit.
  6. KOHËT E PAKRYERA përqendrohen tek procesi i vazhduar i një veprimi. Mund të përshkruhet në kuadër të veprimit linear, veprimit durativ, veprimit progresiv etj.
- VIII. Kohët mund të kategorizohen sipas mënyrës sesi autori sheh përparimin e veprimit
- a. Ndodhi = AORIST
  - b. Ndodhi, dhe rezultatet vazhdojnë = E KRYER
  - c. Po ndodhte në të kaluarën dhe rezultatet po vazhdonin, por jo tani = E KRYER E TEJSHKUAR
  - d. Po ndodh = E TASHME
  - e. Po ndodhte = E PAKRYER
  - f. Do të ndodhë = E ARDHME
- Një shembull konkret sesi ndihmojnë këto KOHË në interpretim do të ishte fjala “shpëtoj”. Ajo përdoret në disa kontekste të ndryshme për të treguar, si procesin, ashtu dhe kulmimin e tij:
1. AORISTI = “shpëtoi” (shih Rom. 8:24)
  2. E KRYER = “jemi shpëtuar dhe rezultati vazhdon” (shih Efe. 2:5, 8)
  3. E TASHME = “po shpëtohem” (shih 1 Kor. 1:18; 15:2)
  4. E ARDHME = “do të shpëtohem” (shih Rom. 5:9; 10: 9)
- IX. Kur përqendrohet te KOHËT E FOLJES, interpretuesi kërkon arsyen pse autori fillestar zgjodhi të shprehej në një KOHË të caktuar. Koha standarde, “pa zbukurime”, ishte AORISTI. Kjo ishte forma e

rregullt FOLJORE “e paspecificuar”, “e paklasifikuar”, ose “e pashënuar”. Ajo mund të përdoret në një larmi të madhe mënyrash, të cilat duhet t’i qartësojë konteksti. Kjo kohë thjesht pohon se diçka ka ndodhur. Aspekti i kohës së shkuar përdoret vetëm në MËNYRËN DËFTORE. Nëse përdoret një KOHË tjetër, po theksohej diçka më e veçantë. Por çfarë?

- a. KOHA E KRYER. Bën fjalë për një veprim të përfunduar, por me rezultate që vazhdojnë. Në disa mënyra, ky ishte një kombinim i KOHËS AORISTE me atë TË TASHME. Zakonisht, fokusi është te rezultatet e vazhdueshme, ose te plotësimi i një veprimi (shembull: Efe. 2:5 dhe 8: “ju jeni shpëtuar dhe po vazhdoni të shpëtoheni”).
- b. KOHA E KRYER E TEJSHKUAR. Kjo ishte si E KRYERA, përveçse këtu rezultatet e vazhduara kanë përfunduar. Për shembull: Gjoni 18:16, “Pjetri kishte qëndruar përjashta te porta”.
- c. KOHA E TASHME. Flet për një veprim të papërfunduar ose të pakryer. Zakonisht, fokusi është te vazhdimi i ngjarjes. Shembull: 1 Gjonit 3:6 dhe 9, “Kushdo që banon në të nuk vazhdon të mëkatojë”. “Kushdo që është lindur nga Perëndia nuk vazhdon të kryejë mëkat”.
- d. KOHA E PAKRYER. Në këtë kohë, marrëdhënia me KOHËN E TASHME është e ngjashme me marrëdhënien mes TË KRYERËS dhe TË KRYERËS SË TEJSHKUAR. E PAKRYERA flet për një veprim të paplotë që po ndodhte por që, tani, ka përfunduar, ose për fillimin e një veprimi në të shkuarën. Shembull: Mateu 3:5, “atëherë gjithë Jerusalemi po vazhdonte të shkonte tek ai”, ose, “atëherë, gjithë Jerusalemi filloi të shkonte tek ai”.
- e. KOHA E ARDHME. Bën fjalë për një veprim që, zakonisht, vendoset në një kornizë kohore në të ardhmen. Fokusohej te mundësia e një ndodhie, më shumë sesa te një ndodhi aktuale. Shpesh, flet për sigurinë e ngjarjes. Shembull: Mat. 5:4-9, “Të bekuar janë... Ata do të...”.

## II. DIATEZA

- A. DIATEZA përshkruan marrëdhënien mes veprimit të FOLJES dhe KRYEFJALËS së saj.
- B. DIATEZA VEPRORE ishte mënyra normale, e pritshme dhe e patheksuar për të pohuar se kryefjala po kryente veprimin e FOLJES.
- C. DIATEZA PËSORE do të thotë se kryefjala po merrte veprimin e FOLJES të kryer nga një veprues i jashtëm. Vepruesi i jashtëm që kryente veprimin tregohet në Dhjatën e Re greqisht me anë të këtyre PARAFJALËVE dhe rasave:
  1. Një veprues personal i drejtpërdrejtë, nga *hupo* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22; Veprat 22:30).
  2. Një veprues personal i ndërmjetëm, nga *dia* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22).
  3. Një veprues jopersonal, zakonisht nga *en* me RASËN MJETORE.
  4. Nganjëherë, një veprues personal ose jopersonal, vetëm me anë të RASËS MJETORE.
- D. DIATEZA MESORE tregon se kryefjala prodhon veprimin e FOLJES dhe, gjithashtu, është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e FOLJES. Shpesh, ajo quhet diateza e interesit të shtuar vetjak. Ky konstrukt theksonte në njëfarë mënyre kryefjalën e fjalisë ose periudhës. Ky konstrukt nuk gjendet në anglisht. Ka një mundësi të gjerë kuptimesh dhe përkthimesh në greqisht. Disa shembuj të kësaj forme janë:
  1. VETVETORE – veprimi i drejtpërdrejtë i kryefjalës mbi veten. Shembull: Mat. 27:5: “vari veten”.
  2. INTENSIVE – kryefjala e kryen veprimin për vete. Shembull: 2 Kor. 11:14: “vetë Satani e maskon veten si engjell drite”.
  3. E NDËRSJELLË – veprim i ndërsjellë i dy subjekteve. Shembull: Mat. 26:4: “ata këshillonin njëri-tjetrin”.

## III. MËNYRA (ose “MODALITETI”)

- A. Greqishtja koine ka katër MËNYRA. Ato tregojnë marrëdhënien e FOLJES me realitetin, të paktën në mendjen e autorit. MËNYRAT ndahen në dy kategori të përgjithshme: ajo që tregonte realitetin (DËFTORE) dhe ajo që tregonte mundësinë (LIDHORE, URDHËRORE dhe DËSHIRORE).
- B. MËNYRA DËFTORE ishte forma normale për të shprehur një veprim që kishte ndodhur ose që po ndodhte, të paktën në mendjen e autorit. Ishte e vetmja mënyrë greqisht që shprehte një kohë të përcaktuar, ndonëse edhe këtu ky aspekt ishte dytësor.
- C. MËNYRA LIDHORE shprehte veprim të ardhshëm të mundshëm. Diçka nuk kishte ndodhur ende, por kishte mundësi që të ndodhte. Kishte shumë të përbashkëta me DËFTOREN E ARDHME. Dallimi ishte

se LIDHORJA shpreh njëfarë mase dyshimi. Shpesh, në anglisht, shprehet me termat “mund të”, “do të”, “mund”.

- D. MËNYRA DËSHIRORE shprehte një dëshirë që ishte teorikisht e mundshme. Konsiderohej si një hap më larg realitetit nga LIDHORJA. DËSHIRORJA shprehte mundësi në disa kushte të caktuara. DËSHIRORJA është e rrallë në Dhjatën e Re. Përdorimi i saj më i shpeshtë është në frazën e famshme të Palit, “Kurrë mos qoftë!” (KJV, “Mos e dhëntë Zoti”), e përdorur pesëmbëdhjetë herë (shih Rom. 3:4, 6, 31; 6:2, 15; 7:7, 13; 9:14; 11:1, 11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Shembuj të tjerë gjenden te Luka 1:38; 20:16; Veprat 8:20; dhe 1 Thes. 3:11.
- E. MËNYRA URDHËRORE theksonte një urdhër që ishte i mundshëm, por theksin e vinte te synimi i folësit. Ajo theksonte vetëm një mundësi dëshirore dhe kushtëzohej nga zgjedhjet e tjetrit. URDHËROREJA përdorej në mënyrë të veçantë në lutjet dhe në kërkesat e vetës së tretë. Këto urdhra gjenden vetëm në KOHËN E TASHME dhe atë AORISTE në Dhjatën e Re.
- F. Disa gramatika kategorizojnë edhe PJESORET si një tjetër lloj MËNYRE. Ato janë shumë të zakonshme në Dhjatën e Re në greqisht, dhe zakonisht përcaktohen si MBIEMRA FOLJORË. Ato përkthehen në lidhje me FOLJEN kryesoren me të cilën kanë të bëjnë. Ekzistonte një larmi e madhe mundësish për përkthimin e PJESOREVE. Gjëja më e mirë është të konsultosh disa përkthime të Biblës në anglisht. *The Bible in Twenty Six Translations* (Bibla në 26 përkthime), e botuar nga Baker, është shumë e dobishme në këtë pikë.
- G. DËFTORJA AORISTE VEPRORE ishte mënyra normale, ose “e paklasifikuar”, për të shënuar një veprim. Çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte një domethënie të veçantë interpretuese që dëshironte të komunikonte autori fillestar.

IV. Për ata që nuk e njohin greqishten, ndihmat e mëposhtme studimore do t’u sigurojnë informacionet e nevojshme:

- A. Friberg, Barbara dhe Timothy. *Analytical Greek New Testament* (Dhjata e Re analitike në greqisht). Grand Rapids: Baker, 1988.
- B. Marshall, Alfred. *Interlinear Greek-English New Testament* (Dhjata e Re ndërlineare greqisht-anglisht). Grand Rapids: Zondervan, 1976.
- C. Mounce, William D. *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament* (Leksiku analitik i Dhjatës së Re në greqisht). Grand Rapids: Zondervan, 1993.
- D. Summers, Ray. *Essentials of New Testament Greek* (Elementet bazë të greqishtes së Dhjatës së Re). Nashville: Broadman, 1950.
- E. Kurse greqishteje koine me korrespondence, të akredituar nga ana akademike, janë të disponueshme përmes Institutit Biblik Moody në Çikago, Illinois

## V. EMRAT

- A. Nga ana sintaksore, EMRAT klasifikohen sipas RASËS. RASA ishte forma e eptuar e EMRIT, që tregonte marrëdhënien e tij me FOLJEN dhe me pjesë të tjera të fjalisë. Në greqishten koine, shumë prej funksioneve të RASËS tregoheshin nga PARAFJALËT. Meqë forma e RASËS ishte në gjendje të identifikonte një sërë marrëdhëniesh të ndryshme, u zhvilluan PARAFJALËT për t’u dhënë një ndarje më të qartë këtyre funksioneve të mundshme.
- B. RASAT greke kategorizoheshin në tetë mënyrat e mëposhtme:
  - 1. RASA EMËRORE përdorej për të emërtuar dhe, zakonisht, ishte KRYEFJALA e fjalisë ose periudhës. Po kështu, përdorej edhe për EMRAT KALLZUESORË dhe MBIEMRAT me FOLJET lidhëse “jam” ose “bëhem”.
  - 2. RASA GJINORE përdorej për përshkrim dhe, zakonisht, i caktonte një cilësi ose sasi fjalës me të cilën lidhej. I përgjigjej pyetjes, “Çfarë lloji?” Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “i/e [dikujt]”.
  - 3. RASA RRJEDHORE përdoret të njëjtën formë të eptuar si GJINORJA, por përdoret për të përshkruar ndarje. Zakonisht, shënonte ndarje nga një pikë në kohë, hapësirë, burim, origjinë ose shkallë. Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “nga/prej”.
  - 4. RASA DHANORE përdorej për të përshkruar interes vetjak. Mund të shënonte një aspekt pozitiv, ose negativ. Shpesh, ajo ishte KUNDRINORI I ZHDREJTË. Shpesh, në anglisht shprehet me PARAFJALËN “to”.

5. RASA VENDORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA, por përshkruante pozicionin ose vendndodhjen në hapësirë, kohë, ose kufij logjikë. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “në, mbi, mes, gjatë, me anë të, përbri”.
6. RASA MJETORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA dhe VENDORJA. Shprehte mjete ose shoqërime. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “nga” ose “me”.
7. RASA KALLËZORE përdorej për të përshkruar përfundimin e një veprimi. Shprehte kufizim. Kryesisht, përdorej për KUNDRINORIN E DREJTË. I përgjigjej pyetjes, “Sa larg?”, ose “Deri në çfarë mase?”
8. RASA THIRRORE përdorej për thirrjen e drejtpërdrejtë.

## VI. LIDHËZAT DHE LIDHËSET

- A. Greqishtja është gjuhë shumë preçize, për shkak se ka një numër shumë të madh fjalësh lidhëse. Ato lidhin mendimet (PERIUDHAT, FJALITË dhe PARAGRAFËT). Janë caq të zakonshme saqë, shpesh, mungesa (asindetit) e tyre ka rëndësi nga ana ekzegjetike. Në fakt, këto LIDHËZA dhe LIDHËSE tregojnë drejtimin e mendimit të autorit. Shpesh, kanë rol kyç në përcaktimin e saktë të asaj që po përpiqet të përçojë ai.
- B. Ja një listë me disa prej LIDHËZAVE dhe LIDHËSEVE, si dhe kuptimet e tyre (ky informacion është qëmtuar kryesisht nga libri i H. E. Dana dhe Julius K. Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament* [Gramatikë praktike e Dhjatës së Re greqisht]).
  1. Fjalët lidhëse kohore
    - a. *epei, epeidē, hopote, hōs, hote, hotan* (LIDH.) – “kur”
    - b. *heōs* – “ndërsa”
    - c. *hotan, epan* (LIDH.) – “kurdo”
    - d. *heōs, achri, mechri* (LIDH.) – “derisa”
    - e. *priv* (PASK.) – “përpara”
    - f. *hōs* – “që kur”, “kur”, “ndërsa”
  2. LIDHËZA logjike
    - a. Qëllim
      - (1) *hina* (LIDH.), *hopōs* (LIDH.), *hōs* – “me qëllim që”, “që”
      - (2) *hōste* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
      - (3) *pros* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) ose *eis* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
    - b. Rezultat
      - (1) *hōste* (PASKAJORE, kjo është më e përhapura) – “me qëllim që”, “kështu”
      - (2) *hina* (LIDH.) – “në mënyrë që”
      - (3) *ara* – “kështu”
    - c. Shkakore, ose arsye
      - (1) *gar* (shkak/efekt, ose arsye/përfundim) – “sepse,” “pasi”
      - (2) *dioti, hotiy* – “sepse”
      - (3) *epei, epeidē, hōs* – “meqë”
      - (4) *dia* (me kallëzore) dhe (me pask. nyjore) – “për shkak”
    - d. Rrjedhimore
      - (1) *ara, poinun, hōste* – “prandaj”
      - (2) *dio* (LIDHËZA më e fortë rrjedhimore) – “për shkak të kësaj”, “si rrjedhojë”, “prandaj”
      - (3) *oun* – “prandaj”, “kështu”, “atëherë”, “rrjedhimisht”
      - (4) *toinoun* – “në këtë mënyrë”
    - e. Kundërshtore, ose kontrast
      - (1) *alla* (KUNDËRSHTORE e fortë) – “por”, “përveç”
      - (2) *de* – “por”, “megjithatë”, “gjithsesi”, “nga ana tjetër”
      - (3) *kai* – “por”
      - (4) *mentoi, oun* – “sidoqoftë”
      - (5) *plēn* – “gjithsesi” (kryesisht te Luka)
      - (6) *oun* – “megjithatë”



- f. Krahاسim
    - (1) *hōs, kathōs* (prezanton FJALITË KRAHASUESE)
    - (2) *kata* (në fjalë të përbëra, *katho, kathoti, kathōsper, kathaper*)
    - (3) *hosos* (te Hebrenjve)
    - (4) *ē* – “sesa”
  - g. Vazhduese, ose seri
    - (1) *de* – “dhe”, “tani”
    - (2) *kai* – “dhe”
    - (3) *tei* – “dhe”
    - (4) *hina, oun* – “që”
    - (5) *oun* – “atëherë” (te Gjoni)
3. Përdorimet theksuese
- a. *alla* – “sigurisht”, “po”, “madje”
  - b. *ara* – “me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
  - c. *gar* – “por me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
  - d. *de* – “me të vërtetë”
  - e. *ean* – “madje”
  - f. *kai* – “madje”, “me të vërtetë”, “vërtet”
  - g. *mentoi* – “me të vërtetë”
  - h. *oun* – “vërtetë”, “patjetër”

## VII. PERIUDHA KUSHTORE

- A. PERIUDHA KUSHTORE është ajo që përmban një ose më tepër fjali të varura kushtore. Kjo strukturë gramatikore i vjen në ndihmë interpretimit për shkak se jep kushtet, arsyet, ose shkaqet pse ndodh ose pse nuk ndodh veprimi i FOLJES kryesore. Ka katër lloje PERIUDHASH KUSHTORE. Ato variojnë nga ajo që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit (ose për synimet e tij) tek ajo që është vetëm dëshirë.
- B. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË PARË shprehte veprim ose qenie që supozohej si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrimtarit (ose për synimet e tij), ndonëse shprehej me “nëse”. Në një sërë kontekstesh, mund të përkthehet “meqë” (shih Mat. 4:3; Rom. 8:31). Sidoqoftë, me këtë nuk nënkuptojmë se të gjitha KLASËT E PARË përputhen me realitetin. Shpesh, ato përdoren për të vërtetuar një argument ose për të theksuar një ide të gabuar (shih Mat. 12:27).
- C. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË DYTË shpesh quhet “kundër fakteve”. Ajo shpreh diçka që ishte e pavërtetë ndaj realitetit, në mënyrë që të argumentonte diçka. Shembuj: 1. “Po të ishte vërtet profet, dhe nuk është i tillë, do të dinte se kush dhe ç’karakter është kjo gruaja që po varet tek ai, por ja që nuk e di” (Luka 7:39) 2. “Po t’i kishit besuar vërtet Moisiut, por ju nuk i besoni, do të besonit edhe në mua, por ja që nuk po e bëni” (Gjoni 5:46) 3. “Po të përpiqesha ende që të kënaqja njerëzit, gjë që nuk po e bëj, nuk do të isha aspak skllav i Krishtit, por ja që jam i tillë” (Gal. 1:10).
- D. KLASI I TRETË bën fjalë për një veprim të mundshëm në të ardhmen. Shpesh, supozon probabilitetin e veprimit. Zakonisht, nënkupton kushtëzim nga rrethanat. Veprimi i FOLJES kryesore varet nga veprimi në fjalinë e varur që fillon me “nëse”. Shembuj nga 1 Gjoni: 1:6-10; 2:4, 6, 9, 15, 20, 21, 24, 29; 3:21; 4:20; 5:14, 16.
- E. KLASI I KATËRT është më i largëti për sa i përket mundësisë. Është i rrallë në Dhjatën e Re. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë PERIUDHË e plotë KUSHTORE E KLASIT TË KATËRT, ku të dyja pjesët e kushtit të përputhen me këtë përcaktim. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë hapëse është 1 Pje. 3:14. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë përmbyllëse është Veprat e Apo. 8:31.

## VIII. NDALIMET

- A. URDHËRORJA E TASHME me PJESËZËN MË shpesh (por jo ekskluzivisht) thekson ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër. Disa shembuj: “mos mblidhni më pasuri në tokë...” (Mat. 6:19); “mos u shqetësoni më për jetën tuaj...” (Mat. 6:25); “mos i ofroni më mëkatit gjymtyrët e trupit tuaj si mjete keqbërje...” (Rom. 6:13); “duhet të ndalni së fyeri Frymën e Shenjtë të Perëndisë...” (Efe. 4:30); dhe “ndalni së u dehuri me verë...” (5:18).

- B. LIDHORJA AORISTE me PJESËZËN MË ka këtë theks: “as mos fillo apo nis të bësh një veprim”. Disa shembuj: “As mos fillo të mendosh se...” (Mat. 5:17); “kurrë mos fillo të shqetësohesh...” (Mat. 6:31); “kurrë s’duhet të kesh turp...” (2 Tim. 1:8).
- C. MOHORJA E DYFISHTË me MËNYRËN LIDHORE përbën një mohim shumë të theksuar. “Kurrën e kurrës”, ose “në asnjë lloj rrethane”. Disa shembuj: “Ai nuk do të përjetojë kurrën e kurrës vdekje” (Gjoni 8:51); “Unë, kurrën e kurrës, nuk...” (1 Kor. 8:13).

#### IX. NYJA SHQUESE

- A. Në greqishten koine, NYJA SHQUESE kishte një përdorim të ngjashëm me nyjën shquese “the” në anglisht. Funkzioni bazë i saj ishte të shërbente si “dëftues”, si mënyrë për të tërhequr vëmendjen ndaj një fjale, emri, ose fraze. Përdorimi i saj ndryshon nga njëri autor në tjetrin në Dhjatën e Re. NYJA SHQUESE mund të funksionojë edhe si
1. mjet ballafaques, si PËREMËR dëftor;
  2. shenjë për t’iu referuar një teme ose personi të prezantuar më herët;
  3. mënyrë për të identifikuar KRYEFJALËN në fjali me një FOLJE lidhëse. Shembuj: “Perëndia është Frymë” (Gjoni 4:24); “Perëndia është dritë” (1 Gjonit 1:5); “Perëndia është dashuri” (4:8, 16).
- B. Greqishtja koine nuk kishte NYJË JOSHQUESE si në anglisht, “a” ose “an”. Mungesa e NYJËS SHQUESE mund të nënkuptonte
1. Një përqendrim te karakteristikat ose cilësitë e diçkaje
  2. Një fokus në kategorinë e diçkaje
- C. Autorët e Dhjatës së Re ndryshonin së tepërmi nga njëri-tjetri për mënyrën si e përdornin NYJËN.

#### X. MËNYRA PËR TË TREGUAR THEKSIMIN NË DHJATËN E RE GREQISHT

- A. Teknikat për të treguar theksimin ndryshojnë nga njëri autor në tjetrin në Dhjatën e Re. Shkrimtarët më të njëtrajtshëm dhe më formalë ishin Luka dhe autori i Hebrenjve.
- B. Më herët, pohuam se DËFTORJA AORISTE VEPRORË ishte standarde dhe e paklasifikuar për theksim, por çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte domethënie nga ana interpretuese. Me këtë nuk po themi se DËFTORJA AORISTE VEPRORË nuk përdorej shpesh në një kuptim gramatikor domethënës. (Shembull: Rom. 6:10 [dy herë]).
- C. Rendi i fjalëve në greqishten koine
1. Greqishtja koine ishte një gjuhë e eptuar që, në dallim nga anglishtja, nuk varej nga rendi i fjalëve. Si rrjedhojë, autori mund ta ndryshojë rendin e pritshëm dhe normal të fjalëve për të treguar
    - a. atë që autori donte t’i theksonte lexuesit
    - b. atë që autori mendonte se do të ishte e papritur për lexuesin
    - c. atë që autori e kishte shumë për zemër
  2. Rendi normal i fjalëve në greqisht është ende një çështje e pazgjidhur. Megjithatë, rendi i supozuar normal është ky:
    - a. për FOLJET lidhëse
      - (1) FOLJE
      - (2) KRYEFJALË
      - (3) PLOTËS
    - b. për FOLJET KALIMTARE
      - (1) FOLJE
      - (2) KRYEFJALË
      - (3) KUNDRINOR
      - (4) KUNDRINOR I ZHDREJTË
      - (5) FRAZË PARAFJALORE
    - c. për FRAZAT EMËRORE
      - (1) EMËR
      - (2) PËRCAKTOR
      - (3) FRAZË PARAFJALORE
  3. Rendi i fjalëve mund të jetë një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme ekzegjetike. Shembuj:

- a. “dorën e djathtë na dhanë mua dhe Barnabës për miqësi”. Fraza “dora e djathtë e miqësisë” ndahet dhe është vendosur në krye për të treguar domethënien e vet (Gal. 2:9).
- b. “me Krishtin” vendoset në fillim. Vdekja e tij ishte qendrore (Gal. 2:20).
- c. “ishite pjesë-pjesë dhe në shumë mënyra të ndryshme” (Heb. 1:1) vendoset në fillim. Kontrasti që po jepet është mënyra sesi Perëndia e zbuloi veten, jo fakti i zbulës.

D. Zakonisht, njëfarë shkalle theksimi tregohet nga

1. Përsëritja e PËREMËRIT që ishte tashmë i pranishëm në formën e eptuar të FOLJES. Shembull: “unë, vetë, do të jem patjetër me ju...” (Mat. 28:20).
  2. Mungesa e një LIDHËZE të pritshme, ose ndonjë tjetër mjeti lidhës mes fjalëve, frazave, fjalive, ose periudhave. Kjo gjë quhet asindet (“jo e lidhur”). Mjeti lidhës pritej, prandaj mungesa e tij tërhiqte vëmendje. Shembuj:
    - a. “Lum”-et në Mal, Mat. 5:3 e më tej (e theksoi listën)
    - b. Gjoni 14:1 (temë e re)
    - c. Romakëve 9:1 (pjesë e re)
    - d. 2 Kor. 12:20 (thekson listën)
  3. Përsëritja e fjalëve ose frazave të pranishme në një kontekst të dhënë. Shembuj: “për lëvdimin e lavdisë së tij” (Efe. 1:6, 12 & 14). Kjo frazë përdoret për të treguar veprën e secilit person të Trinisë.
  4. Përdorimi i një idiome ose loje fjalësh (tingujsh) mes termave
    - a. eufemizmat – zëvendësim fjalësh për disa tema tabu, si “gjumi” për vdekjen (Gjoni 11:11-14), ose “këmbët” për gjenitalet mashkullore (Ruthi 3:7-8; 1 Sam. 24:3).
    - b. perifrazimet – zëvendësim fjalësh për emrin e Perëndisë, si “Mbretëria e qiejve” (Mat. 3:21), ose “një zë nga qielli” (Mat. 3:17).
    - c. FIGURAT LETRARE
      - (1) ekzagjerime të pamundura (Mat. 3:9; 5:29-30; 19:24)
      - (2) pohime disi të tepruara (Mat. 3:5; Veprat e Apo. 2:36)
      - (3) personifikime (1 Kor. 15:55)
      - (4) ironi (Gal. 5:12)
      - (5) pasazhe poetike (Fil. 2:6-11)
      - (6) lojë tingujsh mes fjalëve
        - (a) “kisha”
          - i. “kisha” (Efe. 3:21)
          - ii. “thirrja” (Efe. 4:1, 4)
          - iii. “i thirrur” (Efe. 4:1, 4)
        - (b) “i lirë”
          - i. “grua e lirë” (Gal. 4:31)
          - ii. “liri” (Gal. 5:1)
          - iii. “i lirë” (Gal. 5:1)
    - d. gjuha idiomatike – terminologji që, zakonisht, është e veçantë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme:
      - (1) përdorimi figurativ i fjalës “ushqim” (Gjoni 4:31-34)
      - (2) përdorimi figurativ i fjalës “tempull” (Gjoni 2:19; Mat. 26:61)
      - (3) idioma hebraike për termin dhembshuri, “urrej” (Zan. 29:31; LiP. 21:15; Luka 14:36; Gjoni 12:25; Rom. 9:13)
      - (4) “Të gjithë” përkundër “shumë”-ve. Krahaso Isa. 53:6 (“të gjithë”) me 53:11 & 12 (“shumë”). Këta terma janë sinonimikë, siç e tregojnë dhe Rom. 5:18 dhe 19.
  5. Përdorimi i një fraze të plotë gjuhësore, në vend të një fjale të vetme. Shembull: “Zoti Jezu Krisht”.
  6. Përdorimi i veçantë i *autos*
    - a. kur ka NYJË (pozicioni atributiv), përkthehej “i njëjti”.
    - b. kur s’ka NYJË (pozicioni kallëzuesor), përkthehej si PËREMËR VETVETOR INTENSIV – “veten e tij”, “veten e saj”.
- E. Studiuesi i Biblës që nuk di greqisht mund ta identifikojë theksimin në mënyra të ndryshme:
1. Përdorimi i një leksiku analitik dhe i një teksti ndërlinear greqisht/anglisht.

2. Krahasimi i përkthimeve në gjuhën angleze, sidomos ato përkthime që kanë teori të ndryshme përkthimi. Shembull: krahasimi i një përkthimi “fjalë për fjalë” (KJV, NKJV, ASV, NASB, RSV, NRSV) me një përkthim të “ekuivalencës dinamike” (Williams, NIV, NEB, REB, JB, NJB, TEV). Ndhimë e dobishme këtu do të ishte *The Bible in Twenty-Six Translations*, përkthyer nga Baker.
3. Përdorimi i *The Emphasized Bible* (Bibla e theksuar), nga Joseph Bryant Rotherham (Kregel, 1994).
4. Përdorimi i një përkthimi shumë të fjalëpërfjalshëm
  - a. *The American Standard Version* i vitit 1901
  - b. *Young's Literal Translation of the Bible*, nga Robert Young (Guardian Press, 1976).

Studimi i gramatikës është i mërzitshëm, por i domosdoshëm për interpretimin e saktë. Këto përcaktime të shkurtra, komente dhe shembuj synojnë të inkurajojnë dhe të pajisin personat që nuk dinë greqisht që të përdorin shënimet gramatikore të dhëna në këtë vëllim. Pa dyshim, këto përcaktime janë të mbithjeshtëzuara. Ato nuk duhen përdorur në mënyrë dogmatike dhe të pandryshueshme, por si trampolina drejt të kuptuarit më të mirë të sintaksës së Dhjatës së Re. Shpresoj se këto përcaktime do t’u mundësojnë lexuesve edhe që të kuptojnë komentet e ndihmave të tjera studimore, si komentarët teknikë për Dhjatën e Re.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimin tonë ta verifikojmë në bazë të informacionit që gjendet në tekstin e Biblës. Gramatika është një nga pjesët më të dobishme të këtij informacioni; elementet e tjera përfshijnë sfondin historik, kontekstin letrar, përdorimin bashkëkohor të fjalëve, dhe pasazhet paralele.

# KRITIKA E TEKSTIT

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojmë shënimet tekstuale që gjenden në këtë komantar. Do të përdorim përvijimin e mëposhtëm:

- I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht
    - A. Dhjata e Vjetër
    - B. Dhjata e Re
  - II. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kritikës së ulët”, e quajtur edhe “kritika e tekstit”.
  - III. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm
- 

## I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

### A. Dhjata e Vjetër

1. Teksti Masoretik (MT) – teksti bashkëtingëllor hebraisht u përcaktua nga rabini Akiva më 100 pas lindjes së Krishtit. Pikat e zanoreve, thekset, shënimet anësore, pikësimi dhe pikat e aparatit filluan të shtoheshin në shekullin në shekullin e gjashtë pas lindjes së Krishtit dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas lindjes së Krishtit. Kjo u bë nga një familje studiuesish judenj të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që përdoren ata ishte e njëjta që përdoret në Mishnah, Talmud, Targumet, Peshita dhe Vulgatë.
2. Septuaginta (LXX) – Tradita thotë se Septuaginta u prodhua nga 70 studiues judenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë, me sponsorizimin e mbretit Ptoleme II (285-246 pas lindjes së Krishtit). Me gjasë, përkthimi u kërkua nga një udhëheqës jude që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristeas”. Shpesh, LXX bazohet në një traditë tekstuale hebraisht që ndryshon nga teksti i rabinit Akiva (MT).
3. Pergamenat e Detit të Vdekur (DSS) – Pergamenat e Detit të Vdekur u shkruan në periudhën romake para Krishtit (200 para lindjes së Krishtit deri më 70 pas lindjes së Krishtit) nga një sekt separatist i judenj të quajtur “esenë”. Dorëshkrimet hebraisht, të gjetura në vendndodhje të ndryshme përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraisht disi të ndryshme nga ajo e MT dhe LXX.
4. Disa shembuj të veçantë për mënyrën sesi krahasimi i këtyre teksteve ka ndihmuar interpretuesit që të kuptojnë Dhiatën e Vjetër
  - a. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
    - (1) LXX, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë do të mahniten me të”.
    - (2) MTT, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë u habitën me ty”.
    - (3) Në Isa. 52:15 konfirmohet dallimi përemëror i LXX
      - (a) LXX, “kështu dhe shumë kombe do të mrekullohen prej tij”
      - (b) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”
  - b. DSS kanë ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
    - (1) DSS, në Isa. 21:8: “atëherë vrojtuesi bërtiti, “Mbi një kullë roje po qëndroj”...”
    - (2) MT, në Isa. 21:8: “dhe unë bërtita, një luan! Zoti im, unë do të qëndroj gjithmonë në kullën e rojës ditën...”
  - c. Si LXX, ashtu dhe DSS, kanë ndihmuar për qartësimin e Isa. 53:11
    - (1) LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij, ai do të shohë dritë dhe do të kënaqet”
    - (2) MT, “ai do të shohë... e mundimit të shpirtit të tij, do të kënaqet”

### B. Dhjata e Re

1. Kanë mbijetuar mbi 5,300 dorëshkrime të gjithë Dhjatës së Re, ose të pjesëve të saj. Rreth 85 janë shkruar në papirus ndërsa 268 prej tyre janë shkruar vetëm me shkronja të mëdha (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas lindjes së Krishtit, u zhvillua një shkrim i lidhur (minuskul). Dorëshkrimet greqisht, në formë të shkruar, numërojnë rreth 2,700. Po kështu, kemi dhe rreth 2,100 kopje me lista pasazhesh biblike që përdoren në adhurim, të cilat i quajmë leksionarë.

2. Rreth 85 dorëshkrime greqisht, që përmbajnë pjesë të Dhjatës së Re të shkruara në papirus, gjenden në muze. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas lindjes së Krishtit, por shumica janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas lindjes së Krishtit. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban gjithë Dhjatën e Re. Thjesht fakti se ato janë kopjet më të lashta të Dhjatës së Re nuk do të thotë automatikisht se kanë më pak variante. Shumë prej tyre u kopjuan me shpejtësi për përdorim lokal. Nuk u ushtrua kujdes në këtë proces. Si rrjedhojë, ato përmbajnë shumë variante.
3. Kodiku Sinaitikus, i njohur me shkronjën hebraisht א (alef), ose (01), i gjetur në manastirin e shën Katerinës në malin Sinai nga Tischendorf. Daton nga shekulli i katërt pas lindjes së Krishtit dhe përmban, si LXX-në e Dhjatës së Vjetër, ashtu dhe Dhjatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
4. Kodiku Aleksandrinus, i njohur si “A”, ose (02), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili u gjet në Aleksandri të Egjiptit.
5. Kodiku Vatikanus, i njohur si “B”, ose (03), i gjetur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas lindjes së Krishtit. Përmban si LXX-në e Dhjatës së Vjetër, ashtu dhe Dhjatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
6. Kodiku Ephraemi, i njohur si “C”, ose (04), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili është shkatërruar pjesërisht.
7. Kodiku Bezae, i njohur si “D”, ose (05), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë ose të gjashtë. Është përfaqësuesi kryesor i atij që quhet “tekst perëndimor”. Përmban shumë shtesa dhe është dëshmitari kryesor në greqisht për përkthimin e King James Version.
8. Dorëshkrimet e Dhjatës së Re mund të grupohen në tre, ndoshta dhe katër, familje që ndajnë disa karakteristika.
  - a. Teksti aleksandrian nga Egjipti
    - (1) P<sup>75</sup>, P<sup>66</sup> (rreth 200 pas lindjes së Krishtit), që përmbajnë ungjijtë
    - (2) P<sup>46</sup> (rreth 225 pas lindjes së Krishtit), që përmban letrat e Palit
    - (3) P<sup>72</sup> (rreth 225-250 pas lindjes së Krishtit), që përmban Pjetrin dhe Judën
    - (4) Kodiku B, i quajtur Vatikanus (rreth 325 pas lindjes së Krishtit), që përfshin gjithë Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re
    - (5) Origeni citon nga ky lloj teksti
    - (6) Dorëshkrime të tjera që shfaqin këtë lloj teksti janë א, C, L, W, 33
  - b. Teksti perëndimor nga Afrika veriore
    - (1) Citime nga etërit e kishës në Afrikën veriore, Tertuliani, Qipriani dhe përkthimi i “Vjetër Latin”
    - (2) Citime nga Ireneu
    - (3) Citime nga Tatiani dhe përkthimi “i Vjetër Siriak”
    - (4) Kodiku D, “Beza”, ndjek këtë lloj teksti
  - c. Teksti bizantin i lindjes, nga Kostandinopoja
    - (1) Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 dorëshkrimeve
    - (2) Citohet nga etërit e kishës në Antioki të Sirisë, Kapadokianët, Gojarti dhe Theodreti
    - (3) Kodiku A, vetëm në ungjijtë
    - (4) Kodiku E (shekulli i tetë) për gjithë Dhjatën e Re
  - d. Lloji i katërt i mundshëm është ai “cezareas”, nga Palestina
    - (1) Kryesisht, shihet vetëm te Marku
    - (2) Disa dëshmitarë të tij janë P<sup>45</sup> dhe W

## II. Problemet dhe teoritë e “kritikës së ulët”, ose “kritikës së tekstit”.

### A. Si u shfaqën variantet

1. të paqëllimshëm ose aksidentalë (shumica dërrmuese e tyre)
  - a. shkarje syri në kopjimin me dorë, ku syri lexon rastin e dytë të dy fjalëve të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, lë pa shkruar të gjitha fjalët e ndërmjetme (homoioteleuton)
    - (1) shkarje syri, duke lënë pa shkruar një shkronjë, fjalë, ose frazë, që duhej shkruar dy herë (haplografi)
    - (2) shkarje mendjeje, duke përsëritur një frazë ose rresht të tekstit greqisht (ditografi)

- b. shkarje veshi, që ndodhte në kopjimin me diktim gojor, ku ndodh një keqshqiptim (itacizëm). Shpesh, keqshqiptimi nënkupton ose shqipton një fjalë tjetër greqisht, që tingëllon në mënyrë të ngjashme.
  - c. teksti më i hershëm greqisht nuk kishte ndarje në kapituj apo vargje, pak ose aspak pikëzim dhe asnjë ndarje mes fjalëve. Është e mundur që t'i ndash shkronjat në vende të ndryshme, duke formuar fjalë të ndryshme.
2. të qëllimshëm
- a. bëheshin ndryshime për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar
  - b. bëheshin ndryshime për të sjellë tekstin konform me tekste të tjera biblike (harmonizimi i paralelizmave)
  - c. bëheshin ndryshime duke kombinuar dy ose më tepër variante të ndryshme në një tekst të gjatë e të kombinuar (bashkëshkrirje)
  - d. bëheshin ndryshime për të korrigjuar ndonjë problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
  - e. disa informacione shtesë në lidhje me sfondin historik ose interpretimin e duhur të tekstit vendoseshin në anë të faqes nga njëri kopjues, ndërsa një kopjues i dytë i fuste në tekst (shih Gjoni 5:4)
- B. Parimet bazë të kritikës së tekstit (udhërrëfyes logjikë për përcaktimin e leximit origjinal të një teksti kur ekzistojnë forma variante)
1. Teksti më i vështirë, ose më i pazakontë nga ana gramatikore, ka gjasa të jetë origjinali
  2. Teksti më i shkurtër ka gjasa të jetë origjinali
  3. Tekstit më të vjetër i jepet më tepër peshë për shkak të afërsisë së tij historike me origjinalin, në rast se gjithçka tjetër është në ekuilibër
  4. MSS që janë të larmishme nga ana gjeografike zakonisht kanë leximin origjinal
  5. Duhet preferuar tekstet më të dobët nga ana doktrimore, sidomos ato që lidhen me diskutimet kryesore teologjike të periudhës së ndryshimeve në dorëshkrime, si Trinia në 1 Gjonit 5:7-8.
  6. Teksti që arrin të shpjegojë më mirë origjinën e varianteve të tjerë
  7. Dy citime që ndihmojnë për të treguar ekuilibrin për këto variante shqetësuese
    - a. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism* [Hyrje në Kritikëzmin Tekstual të Dhjatës së Re], f. 68: “Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet nga një tekst i debatueshëm; dhe studiuesi i Dhjatës së Re duhet të ketë kujdes që të mos dëshirojë që teksti i tij të jetë më ortodoks, ose më i fortë nga ana doktrimore, sesa vetë origjinali i frymëzuar”.
    - b. W. A. Criswell i tha Greg Garrisonit të The Birmingham News se ai (Criswell) nuk besonte se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut të sotëm nga shekuj përkthyesish”. Criswell tha: “unë jam besimtar i fortë në kritikën e tekstit. Si i tillë, unë mendoj se gjysma e fundit e kapitullit 16 të Markut është herezi: nuk është e frymëzuar, por thjesht e shpikur... Kur e krahason me dorëshkrimet më të lashta, nuk ekziston diçka e tillë si përmbyllja e librit të Markut. Dikush e shtoi...” Patriarku i atyre të SBC-së që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës pohoi gjithashtu se “ndërhyrja” është e dukshme edhe tek Gjoni 5, në rrëfimin e Jezusit te pellgu i Betezdës. Po kështu, ai diskuton për dy rrëfimet e ndryshme të vetëvrasjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat e Apo. 1): “Këtu kemi thjesht një pikëpamje të ndryshme të vetëvrasjes”, tha Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një shpjegim për këtë. Dhe dy rrëfimet e vetëvrasjes së Judës janë në Bibël”. Criswell shtoi: “Kritika e tekstit është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Nuk është kalimtare, nuk është e pacipë. Ajo është dinamike dhe qendrore...”

### III. Problemet në dorëshkrime (kritika e tekstit)

#### A. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

1. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual* (Kritika e Biblës: historike, letrare dhe tekstuale), nga R. H. Harrison
2. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption, and Restoration* (Teksti i Dhjatës së Re: transmetimi, shprishja dhe ndreqja e tij), nga Bruce M. Metzger

3. *Introduction to New Testament Textual Criticism* (Hyrje në kritikën e tekstit të Dhjatës së Re), nga J. H. Greenlee



# FJALORTH

**A priori.** Në thelb, ky është sinonim i termit “presupozim”. Nënkupton arsyetim mbi bazën e përcaktimeve, parimeve, ose pozicioneve të pranuar më parë, të cilat merren si të vërteta. Pra, nënkupton atë që pranohet pa shqyrtim ose analizë.

**Adopsionizmi.** Ishte një nga pikëpamjet e hershme për marrëdhënien e Jezusit me hyjninë. Në thelb, pohonte se Jezusi ishte njeri normal në të gjitha mënyrat dhe se u birësua në mënyrë të veçantë nga Perëndia në çastin e pagëzimit (shih Mat. 3:17; Marku 1:11), ose në ringjalljen e tij (Rom. 1:4). Jezusi bëri një jetë kaq shembullore sa që Perëndia, në një pikë të caktuar, (në pagëzim, ose në ringjallje) e adoptoi si “birin” e vet (shih Rom. 1:4; Fil. 2:9). Kjo ishte një pikëpamje pakice në kishën e hershme në shekullin e tetë. Në vend që Perëndia të bëhet njeri (Mishërimi), kjo pikëpamje e përmbys radhën dhe, tani, njeriu bëhet Perëndi!

Është e vështirë të verbalizosh se si Jezusi, Biri i Perëndisë, hyjësi para-ekzistuese, u shpërblye për një jetë shembullore. Nëse Ai tanimë ishte Perëndi, si mund të shpërblehej Ai? Nëse Ai kishte lavdi hyjnore paraekzistence, si mund të nderohej Ai më shumë? Edhe pse është e vështirë për ne për t’u kuptuar, Ati në një mënyrë e nderoi Jezusin në një kuptim të veçantë për përmbushjen e Tij të përkryer të vullnetit të Atit.

**Alegori.** Ky është një lloj interpretimi biblik që, së pari, u zhvillua brenda judaizmit aleksandrian. U popullarizua nga Filoja i Aleksandrisë. Thelbi bazë i alegorisë është dëshira për t’i dhënë Shkrimin peshë aktuale në sistemin filozofik ose kulturor të kohës duke anashkuar sfondin historik dhe/ose kontekstin letrar të Biblës. Ajo kërkon një kuptim të fshehur ose shpirtëror pas çdo teksti të Shkrimit. Duhet pranuar se Jezusi, tek Mateu 13, dhe Pali, tek Galatasve 4, përdorën alegori për të përçuar të vërtetën. Sidoqoftë, këtë e bënë në formë tipologjie, jo ngushtësisht alegorie.

**Aleksandrinus.** Ky dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë nga Aleksandria, në Egjipt, përfshin Dhjatën e Vjetër, Apokrifët dhe shumicën e Dhjatës së Re. Ai është një nga dëshmitarët tanë kryesorë për gjithë Dhjatën e Re në greqisht (me përjashtim të disa pjesëve të Mateut, Gjonit dhe 2 Korintasve). Kur ky dorëshkrim, që emërtohet me shkronjën “A”, përkon me dorëshkrimin e emërtuar “B” (Vatikanus) për ndonjë variant të caktuar teksti, konsiderohet si teksti origjinal nga shumica e studiuesve në shumicën e rasteve.

**Analogjia e Shkrimit.** Kjo frazë përdoret për të përshkruar pikëpamjen se gjithë Bibla është frymëzuar nga Perëndia dhe se, si rrjedhojë, nuk është kontradiktore, por plotësuese, në vetvete. Ky pohim parasupozues është baza për përdorimin e pasazheve paralele për të interpretuar pjesët biblike.

**Anësi.** Ky është një term që përdoret për të përshkruar një predispozitë të fortë kundrejt një objekti ose pikëpamjeje. Është një mendësi ku paanësia është e pamundur në lidhje me një objekt ose pikëpamje të caktuar. Anësia është një pozicion i paragjykuar.

**Antitetik.** Ky është një nga tre termat përshkrues që përdoren për të përcaktuar marrëdhënien mes rreshtave të poezisë hebraike. Ajo përshkruan ato rreshta poezie që janë të kundërt në kuptim me njëra-tjetrën (shih Prov. 10:1; 15:1).

**Antropomorfik.** Ky term do të thotë “të kesh karakteristika që shfaqen në qeniet njerëzore” dhe përdoret për të përshkruar terminologjinë tonë fetare në lidhje me Perëndinë. Ai vjen nga fjala greke “njerëzim”. Do të thotë se ne flasim për Perëndinë si të ishte njeri. Perëndia përshkruhet me fjalë fizike, sociologjike dhe psikologjike që lidhen me qeniet njerëzore (shih Zan. 3:8; 1 Mbret. 22:19-23). Sigurisht, kjo është thjesht analogji. Sidoqoftë, s’kemi ç’kategori ose fjalë të tjera të përdorim përveç atyre njerëzore. Si rrjedhojë, ndonëse e vërtetë, njohuria jonë për Perëndinë është e kufizuar.

**Apolog (Apologjetikë).** Kjo vjen nga rrënja e fjalës greke “mbrojtje ligjore”. Përbën një disiplinë të veçantë brenda teologjisë, e cila përpiqet të japë fakte dhe argumente racionale për besimin e krishterë.

**Arianizëm.** Ari ishte presbiter në kishën e Aleksandrisë, në Egjipt, në shekullin e tretë dhe në fillim të shekullit të katërt. Ai thoshte se Jezusi ishte paraekzistues, por jo hyjnor (jo i së njëjtës substance si Ati), ndoshta duke ndjekur Fjalët e Urta 8:22-31. Ai u sfidua nga peshkopi i Aleksandrisë, i cili (më 318 pas lindjes së Krishtit) nisi një polemikë që zgjati shumë vjet. Arianizmi u bë kredoja zyrtare e kishës lindore. Këshilli i Nikesë, më 325 pas lindjes së Krishtit, e dënoi Arin dhe pohoi barazinë e plotë të Birit me Atin si dhe natyrën e tij të plotë hyjnore.

**Aristoteli.** Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë, nxënës i Platonit dhe mësues i Aleksandrit të Madh. Edhe sot, ndikimi i tij depërton në shumë fusha të studimeve moderne. Kjo ndodh për shkak se ai theksonte njohurinë përmes vëzhgimit dhe klasifikimit. Ky është një nga parimet bazë të metodës shkencore.

**Autografet.** Ky është një emër që u jepet shkrimeve origjinale të Biblës. Të gjitha këto dorëshkrime origjinale, të shkruara me dorë, kanë humbur. Kanë mbetur vetëm kopjet e kopjeve. Ky është burimi i shumë varianteve tekstuale në dorëshkrimet hebraisht dhe greqisht dhe në versionet e lashta.

**Autori fillestar.** Me këtë, kuptojmë autorët/shkruesit realë të Shkrimit.

**Autoriteti biblik.** Ky term përdoret në një kuptim shumë të specializuar. Përcaktohet si përpjekja për të kuptuar atë që tha autori fillestar në kohën e vet dhe për ta zbatuar këtë të vërtetë në kohën tonë. Zakonisht, autoriteti Biblik përcaktohet si “konsiderimi i Biblës vetë si udhërrëfyesi ynë i vetëm me autoritet”. Sidoqoftë, në dritën e disa interpretimeve të papërshtatshme të kohës sonë, këtë koncept e kam kufizuar për të nënkuptuar interpretimin e Biblës sipas parimeve të metodës historiko-gramatikore.

**Beza.** Ky është një dorëshkrim greqisht dhe latinisht i shekullit të gjashtë pas lindjes së Krishtit. Emërtohet “D”. Përmban ungjijtë, Veprat dhe disa nga letrat e përgjithshme. Karakterizohet nga shumë shtesa shkruarish. Përbën bazën e “Textus Receptus”, tradita kryesore e dorëshkrimeve greqisht që qëndron pas King James Version.

**Deduktive.** Kjo metodë logjike ose arsyetimi kalon nga parimet e përgjithshme në zbatime të veçantë me anë të arsyes. Është e kundërta e arsyetimit induktiv, i cili reflekton metodën shkencore duke kaluar nga elementet e veçanta të vëzhguara në përfundime të përgjithshme (teori).

**Dialektike.** Kjo është metoda arsyetuese me anë të së cilës ajo që duket kontradiktore ose paradoksale mbahet e bashkuar brenda një tensioni, duke kërkuar një përgjigje të unifikuar që përfshin të dyja anët e paradoksit. Shumë doktrina biblike kanë çifte dialektike, paracaktimi-vullneti i lirë; siguria-qëndresa; besimi-veprat; vendimi-dishepullizimi; liria e krishterë-përgjegjësia e krishterë.

**Diaspora.** Ky është termi teknik që përdoret nga judenjtë e Palestinës për të përshkruar judenjtë e tjerë që jetonin jashtë kufijve gjeografikë të Tokës së Premtuar.

**Dorëshkrim.** Ky term ka të bëjë me kopjet e ndryshme të Dhjatës së Re në greqisht. Zakonisht, ato ndahen në lloje të ndryshme sipas (1) materialit ku janë shkruar (papyrus, lëkurë), ose (2) formës së vetë shkrimit (shkrim me shkronja të mëdha, ose me shkronja të lidhura kursive). Shkurtimi i saj është “MS” (njëjës), ose “MSS” (shumës).

**Dykuptimësia.** Kjo ka të bëjë me pasigurinë që rezulton në një dokument të shkruar kur ka dy ose më tepër kuptime të mundshme, ose kur përmenden dy ose më tepër gjëra në të njëjtën kohë. Ka gjasa që Gjoni të ketë përdorur dykuptimësinë e qëllimshme (fjalë më kuptim të dyfishtë).

**Eisegjezë.** Kjo është e kundërta e eksegjezës. Nëse eksegjeza është “nxjerrja jashtë” e synimit të autorit fillestar, ky term nënkupton “futjen” e një ideje ose mendimi të huaj në tekst.

**Eklektik.** Ky term përdoret në lidhje me kritikën e tekstit. Nënkupton praktikën e përzgjedhjes së varianteve nga dorëshkrime të ndryshme greqisht me qëllim që të arrijmë te një tekst që supozohet se është pranë

autografeve origjinalë. Ai refuzon pikëpamjen se një familje e caktuar dorëshkrimesh greqisht përmban tekstin origjinal.

**Eksegjezë.** Ky është një term teknik për praktikën e interpretimit të një pasazhi të caktuar. Do të thotë “të nxjerrësh jashtë” (nga teksti), që nënkupton se synimi ynë është të kuptojmë synimin e autorit fillestar në dritën e sfondit historik, kontekstit letrar, sintaksës dhe kuptimit të fjalëve në kohën që u shkruan.

**Ekuivalenca dinamike.** Kjo është një teori e përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiqet të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35, dhe në Hyrjen e Robert Bratcher për versionin TEV.

**Etimologji.** Ky është një aspekt i studimit të fjalëve që përpiqet të sigurojë kuptimin fillestar të fjalëve. Nga ky kuptim rrënjë, identifikohen më lehtë përdorimet e specializuara të fjalëve. Në interpretim, fokusin kryesor nuk e përbën etimologjia, por kuptimi dhe përdorimi i fjalëve në kohën e autorit.

**Fragmenti Muratorian.** Kjo është një listë e librave kanonikë të Dhjatës së Re. U shkrua në Romë përpara vitit 200 pas lindjes së Krishtit. Jep po ata njëzet e shtatë libra që kemi në Dhjatën e Re protestante. Kjo tregon qartazi se, praktikisht, kishat lokale në pjesë të ndryshme të perandorisë romake e kishin përcaktuar kanonin përpara këshillave të mëdhenj të kishës në shekullin e katërt.

**Frymëzim.** Ky është koncepti se Perëndia i ka folur njerëzimit duke udhëhequr autorët biblikë që të shënojnë saktë dhe qartë zbuluesën e tij. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbuluesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbuluesën e tij.

**Fushë semantike.** Ka të bëjë me gamën e plotë të kuptimeve që shoqërohen me një fjalë të caktuar. Në thelb, nënkupton ngjyrimet e ndryshme që ka një fjalë në kontekste të ndryshme.

**Gnosticizëm.** Shumica e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Sidoqoftë, idetë fillestare të tij ishin të pranishme në shekullin e parë (dhe më herët).

Disa parime të shprehura të gnosticizmit valentinian dhe kerintian në shekullin e dytë janë: (1) materia dhe shpirti janë të bashkëpërzjetshme (dualizmi ontologjik). Materia është e keqe, shpirti është i mirë. Perëndia, i cili është shpirt, nuk mund të merret drejtpërdrejt me modelimin e materies së ligë; (2) midis Perëndisë dhe materies ekzistojnë “rrezatime” (*eon*-et, ose nivelet engjëlllore). I fundmi dhe më i ulëti i tyre ishte YHWH i Dhjatës së Vjetër, i cili formoi universin (kozmos); (3) Jezusi ishte një rrezatim si YHWH, por i një shkalle më të lartë, më pranë Perëndisë së vërtetë. Disa e vendosnin në shkallën më të lartë, por gjithsesi, si më të ulët se Perëndia dhe sigurisht jo si Hyjni të mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të kishte trup njerëzor dhe të mbetej prapëseprapë hyjnor. Ai ishte një fantazmë shpirtërore (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6); dhe (4) shpëtimi sigurohej me anë të besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cilat njihet vetëm nga persona të veçantë. Nevojitej njohuri (fjalëkalimet) për të kaluar përmes sferave qiellore. Për të arritur te Perëndia nevojitej dhe legalizmi judaik.

Mësuesit e rremë gnostikë mbronin dy sisteme të kundërta etike: (1) për disa, stili i jetesës ishte plotësisht i palidhur me shpëtimin. Për ta, shpëtimi dhe jeta shpirtërore ishin të kyçura në njohuri sekrete (fjalëkalime) përmes sferave engjëlllore (*eons*); ose (2) për të tjerë, stili i jetesës ishte thelbësor për shpëtimin. Ata theksonin një stil jetese asketik si një provë e jetës së vërtetë shpirtërore.

**Gjini letrare.** Kjo ka të bëjë me format e veçanta që mund të marrë komunikimi njerëzor, si poezia ose narrativa historike. Secili lloj letërsie ka procedurat e veta të veçanta nga ana hermeneutike, përpos parimeve të përgjithshme që vlejné për çdo letërsi të shkruar.

**Gjinia (Zhanri).** Vjen nga një term francez (“zhanër”) që nënkupton llojet e ndryshme të letërsisë. Thelbi i këtij termi është ndarja e formave letrare në kategori që kanë karakteristika të përbashkëta: narrativa historike, poezia, fjalët e urta, apokaliptikja dhe legjislacioni.

**Gjuhë përshkrimi.** Kjo përdoret në lidhje me idiomat ku është shkruar Dhjata e Vjetër. I flet botës sonë në kuadër të mënyrës sesi na shfaqen gjërat ndaj pesë shqisave. Nuk është përshkrim shkencor, dhe as nuk synon të jetë i tillë.

**Hermeneutikë.** Ky është term teknik për parimet që i prijnë eksegjezës. Ajo është edhe një grup parimesh të veçanta, edhe art. Hermeneutika biblike, ose e shenjtë, zakonisht ndahet në dy kategori: parimet e përgjithshme dhe parimet e veçanta. Ato lidhen me llojet e ndryshme të literaturës që gjendet në Bibël. Secili lloj (gjini) i veçantë ka parimet e veta unike, por ndan edhe disa supozime dhe procedura të përbashkëta interpretimi.

**I fjalëpërfjalshëm.** Ky është një emër tjetër i metodës historike dhe me fokus tekstin, që erdhi nga Antiokia. Do të thotë se interpretimi përfshin kuptimin normal dhe të dukshëm të gjuhës njerëzore, ndonëse pranon gjithsesi dhe praninë e gjuhës së figurshme.

**Idiomë.** Kjo fjalë përdoret për frazat që gjenden në kultura të ndryshme, të cilat kanë kuptim të specializuar që nuk lidhet me kuptimin e zakonshëm të termave në vetvete. Disa shembuj të sotëm janë: “ishte tmerrësisht e shkëlqyer”, ose “ti më heq trurin”. Edhe Bibla përmban këto lloj frazash.

**Induktive.** Kjo është një metodë logjike ose arsyetuese që kalon nga elementet e veçanta te tërësia. Është metoda empirike e shkencës moderne. Në thelb, është qasja e Aristotelit.

**Judaizmi rabinik.** Kjo fazë e jetës së popullit jude filloi me robërinë babilonase (586-538 para lindjes së Krishtit). Me humbjen e ndikimit të priftërinjve dhe Tempullit, sinagogat lokale u bënë fokusi i jetës judaike. Këto qendra lokale të kulturës, bashkësisë, adhurimit dhe studimit biblik jude u bënë fokusi i jetës fetare të kombit. Në kohën e Jezusit, kjo “fe e skribëve” ishte paralele me atë të priftërinjve. Pas rënies së Jerusalemit më 70 pas Krishtit, forma skribale, e mbizotëruar nga farisenjtë, vuri nën kontroll drejtimin e jetës fetare judaike. Karakterizohet nga interpretimi praktik dhe legalist i Torahut, i cili shpjegohet nga tradita gojore (Talmudi).

**Kanon.** Ky është një term i përdorur për të përshkruar ato shkrime që besohet se janë frymëzuar në mënyrë unike. Përdoret për Shkrimet e Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re.

**Komentar.** Ky është një lloj i specializuar libri kërkimor. Ai jep një sfond të përgjithshëm për librin biblik. Pastaj, përpiqet të shpjegojë kuptimin e çdo pjese të librit. Disa komentare fokusohen te zbatimi, ndërsa të tjerë e trajtojnë tekstin në mënyrë më teknike. Këta libra janë të dobishëm, por duhen përdorur pasi të kesh përfunduar studimin paraprak personal. Interpretimet e komentuesit nuk duhen pranuar kurrë me symbyllur. Zakonisht, krahasimi i disa komentareve që japin pikëvështrime të ndryshme teologjike është diçka e dobishme.

**Kristocentrik.** Ky është një term që përdoret për të përshkruar natyrën dhe rolin qendror të Jezusit. Unë e përdor në lidhje me konceptin se Jezusi është Zoti i gjithë Biblës. Dhjata e Vjetër dëfton drejt tij dhe ai është përmbushja dhe synimi i saj (shih Mat. 5:17-48).

**Kritika e lartë.** Kjo është ajo procedurë e interpretimit biblik që fokusohet te sfondi historik dhe te struktura letrare e një libri të veçantë biblik.

**Kritika e ulët.** Shih “kritika e tekstit”.

**Kritikë e tekstit.** Ky është studimi i dorëshkrimeve të Biblës. Kritika e tekstit është e domosdoshme pasi nuk ekziston asnjë dorëshkrim origjinal dhe kopjet ndryshojnë nga njëra-tjetra. Ajo përpiket të shpjegojë variantet dhe të arrijë (sa më tepër të mundet) te fjalët origjinale të autografeve të Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re. Shpesh, quhet “kritika e ulët”.

**Legalizëm.** Ky qëndrim karakterizohet nga mbitheksimi i rregullave ose ritualeve. Prirjet të bazohet në zbatimet njerëzore të rregullave si mjet pranimit nga Perëndia. Prirjet të nënvlerësojë marrëdhënien dhe lartëson veprat, ndonëse këto janë të dyja aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së besëlidhjes mes Perëndisë së shenjtë dhe njerëzimit të mëkatshëm.

**Leksik analitik.** Ky është një lloj mjeti kërkimor që të lejon të identifikosh çdo formë greqisht në Dhjatën e Re. Leksiku është një përmbledhje, në rendin alfabeti greqisht, e formave dhe përcaktimeve bazë. Në kombinim me një përkthim ndërlinear, u mundëson besimtarëve që s’lexojnë dot greqisht që të analizojnë format gramatikore dhe sintaksore greqisht të Dhjatës së Re.

**Letërsia apokaliptike.** Kjo ishte në masën mbizotëruese (ndoshta, edhe në mënyrë unike) një gjini judaike. Ishte një lloj kriptik shkrimi që përdorej në kohë pushtimi dhe okupimi të judenjve nga fuqitë e huaja botërore. Supozimi i saj është se ngjarjet botërore janë krijuar dhe kontrollohen nga një Perëndi personal dhe shpengues, dhe se Izraeli ka rëndësi të veçantë për të dhe për përkujdesjen e tij. Kjo literaturë premtan fitoren përfundimtare përmes përpjekjes së veçantë të Perëndisë.

Ajo është tejet simbolike dhe imagjinare, me shumë terma kriptikë. Shpesh, të vërtetën e shpreh me ngjyra, numra, vegime, ëndrra, ndërmjetësime engjëjsh, fjalë të fshehta e të koduara dhe, shpesh, me një dualizëm të fortë mes mirësisë dhe ligësisë.

Disa shembuj të kësaj gjinie janë (1) në Dhjatën e Vjetër, Ezekieli (kapitujt 36-48), Danieli (7- 12), Zakaria, dhe (2) në Dhjatën e Re, Mateu 24, Marku 13; 2 Thesalonikasve 2; dhe Zbulesa.

**Letërsia e urtësisë.** Kjo ishte një gjini letërsie e përhapur në lindjen e afërt në lashtësi (si dhe në botën moderne). Në thelb, ishte përpjekje për të udhëzuar brezin e ri me udhëzime për jetë të suksesshme përmes poezisë, fjalëve të urta, ose eseve. I drejtohej më tepër individit sesa shoqërisë si kolektiv. Nuk përdorte aludime për historinë, por bazohej në përvojën dhe vëzhgimet nga jeta. Në Bibël, Jobi e deri te kënga e Këngëve merrnin si të sigurt praninë dhe adhurimin e YHWH, por ky botëkuptim fetar nuk është i shkoqur çdo herë, apo në çdo përjetim njerëzor.

Si gjini, ajo shprehte të vërtetën të përgjithshme. Sidoqoftë, kjo gjini nuk mund të përdoret në çdo situatë të veçantë. Këto janë pohime të përgjithshme që nuk zbatohen gjithmonë në çdo situatë individuale.

Këta njerëz të urtë guxuan të bënin pyetjet e vështira të jetës. Shpesh, ata i sfidonin pikëpamjet fetare tradicionale (Jobi dhe Predikuesi). Ata formojnë një ekuilibër dhe tension ndaj përgjigjeve të lehta për tragjeditë e jetës.

**Metonimia.** Kjo është një figurë letrare, ku emri i diçkaje përdoret për të paraqitur diçka tjetër që shoqërohet me të. Për shembull, “po zien çajniku” do të thotë “po zien uji në çajnik”.

**Ndërlineare.** Ky është një lloj mjeti kërkimor, i cili u lejon atyre që nuk njohin gjuhën biblike që të arrijnë të analizojnë kuptimin dhe strukturën e saj. Kjo metodë e vendos përkthimin në gjuhën tonë në nivelin “fjalë për fjalë”, poshtë gjuhës origjinale biblike. Ky mjet, i kombinuar me “leksikon analitik”, jep format dhe përcaktimet bazë të hebraishtes dhe greqishtes.

**Nestorianizëm.** Nestori ishte patriarku i Kostandinopojës në shekullin e pestë. Ishte edukuar në Antioki të Sirisë dhe pohonte se Jezusi kishte dy natyra, një plotësisht njerëzore dhe një plotësisht hyjnore. Kjo pikëpamje shmangej nga pikëpamja ortodokse e Aleksandrisë se Krishti ka një natyrë. Preokupimi kryesor i Nestorit ishte titulli “nëna e Perëndisë”, që i ishte dhënë Marisë. Nestori (dhe, rrjedhimisht, edukimi i tij antiokas) u kundërshtua nga Kirili i Aleksandrisë. Antiokia ishte qendra e qasjes historiko-gramatikore dhe tekstuale ndaj interpretimit biblik, ndërsa Aleksandria ishte qendra e shkollës së katërfishtë (alegorike) të interpretimit. Në fund, Nestorin e hoqën nga posti dhe e çuan në syrgjyn.

**Njësi letrare.** Ka të bëjë me ndarjet kryesore të mendimit në librat biblike. Mund të përbëhet nga disa vargje, paragrafë ose kapituj. Ajo përbën një njësi të vetëpërmbajtur me temë qendrore.

**Papirus.** Ky është një lloj materiali nga Egjipti mbi të cilin mund të shkruhej. Bëhej nga kallamet e lumit. Papirusi është materiali në të cilin janë shkruar kopjet më të hershme të Dhjatës së Re në greqisht.

**Paradoks.** Ka të bëjë me ato të vërteta që duket sikur janë kontradiktore, por janë të dyja të vërteta, ndonëse në tension me njëra-tjetrën. Ato e inkadrojnë të vërtetën duke e paraqitur nga anë të kundërta. Një pjesë e mirë e së vërtetës biblike paraqitet në formë dyshesh paradoksale (ose dialektike). Të vërtetat biblike nuk janë yje të izoluar, por janë yjësi që përbëhen nga formacione yjesh.

**Parafrazë.** Ky është emri i një teorie të përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përqipet të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35.

**Paragraf.** Kjo është njësi interpretuese bazë në prozë. Përmban një mendim qendror dhe zhvillimin e tij. Nëse qëndrojmë te mesazhi i tij kryesor, nuk do të përqendrohemi te pikat anësore, as nuk do të humbasim synimin e autorit fillestar.

**Pasazhet paralele.** Ato janë pjesë e konceptit se gjithë Bibla është e dhënë nga Perëndia dhe, si rrjedhojë, është interpretuesja më e mirë e vetes si dhe drejtpeshuesja e të vërtetave paradoksale. Kjo është e dobishme edhe kur përpiqemi të interpretojmë një pasazh të paqartë ose të dykuptimtë. Pasazhet paralele na ndihmojnë edhe që të gjejmë pasazhin më të qartë për një temë të dhënë, si dhe gjithë aspektet e tjera biblike të një teme të dhënë.

**Pergamenat e Detit të Vdekur.** I referohet një serie me tekste të lashta, të shkruara në hebraisht dhe aramaisht, që u gjetën pranë Detit të Vdekur më 1947. Ato ishin bibliotekat fetare të judaizmit sektar të shekullit të parë. Trysnia e pushtimit romak dhe luftërat zelote të viteve '60 i shtynë që t'i fshihnin pergamenat në qypa qeramike të mbyllur hermetikisht, duke i vendosur në shpella ose vrime. Ato na kanë ndihmuar të kuptojmë sfondin historik të Palestinës së shekullit të parë dhe kanë vërtetuar se Teksti Masoretik është shumë i saktë, të paktën që nga fundi i periudhës para Krishtit. Ato emërtohen me shkurtimin “DSS”.

**Përkues.** Ky është një lloj mjeti kërkimor për studimin e Biblës. Ai rendit çdo përdorim të çdo fjale në Dhjatën e Vjetër dhe atë të Re. Na ndihmon në një sërë mënyrash: (1) përcakton fjalën hebraisht ose greqisht që qëndron pas çdo fjale të caktuar në gjuhën tonë; (2) krahason pasazhet ku është përdorur e njëjta fjalë në greqisht ose hebraisht; (3) tregon se ku dy terma të ndryshëm hebraisht ose greqisht janë përkthyer me të njëjtën fjalë në gjuhën tonë; (4) tregon shpeshësinë e përdorimit të disa fjalëve në libra ose autorë të caktuar; (5) na ndihmon të gjejmë një pasazh të caktuar në Bibël (shih Walter Clark, *How to Use New Testament Greek Study Aids*, f. 54-55).

**Përndritja.** Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia i ka folur njerëzimit. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

**Përshkrimi simbolik i botës dhe botëkuptimi.** Këta terma janë shoqërues të njëri-tjetrit. Të dy janë koncepte filozofike të lidhur me krijimin. Termi “përshkrim simbolik i botës” lidhet me “si-në” e krijimit, ndërsa “botëkuptimi” lidhet me “Kush-in”. Këta terma gjejnë përdorim në interpretimin se Zanafilla 1-2 trajton kryesisht “Kush-in”, jo “si-në”, e krijimit.

**Platoni.** Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë. Filozofia e tij pati ndikim të jashtëzakonshëm në kishën e hershme përmes studiuesve nga Aleksandria e Egjiptit dhe, më vonë, nga Augustini. Platoni besonte se gjithçka në tokë ishte iluzion dhe thjesht kopje e një arketipi shpirtëror. Më vonë, teologët i barazuan “format/idetë” e Platonit me sferën shpirtërore.

**Presupozim.** Ka të bëjë me mënyrën e parakonceptuar si kuptojmë diçka. Shpesh, mendimet ose gjykimet tona për çështje të ndryshme i formojmë përpara se të shkojmë te vetë Bibla. Kjo predispozitë njihet edhe si anësi, si pozicion a priori, si supozim, ose si botëkuptim paraprak.

**Provincializëm.** Ka të bëjë me anësitë e rrënjësura në një sfond lokal teologjik/kulturor. Ai nuk e njeh natyrën ndërkulturore të së vërtetës biblike, apo zbatimin e saj.

**Septuagintë.** Ky është emri që iu dha përkthimit greqisht të Dhjatës së Vjetër hebraike. Tradita thotë se u shkrua në shtatëdhjetë ditë nga shtatëdhjetë studiues judenj për bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Data tradicionale është rreth 250 para lindjes së Krishtit (në të vërtetë, u deshën mbi njëqind vjet që të përfundonte). Ky përkthim është i rëndësishëm pasi (1) na jep një tekst të lashtë për ta krahasuar me tekstin hebraisht Masoretik; (2) na tregon gjendjen e interpretimit judaik në shekullin e tretë dhe të dytë para lindjes së Krishtit; (3) na jep botëkuptimin mesianik të judenjve përpara se të refuzonin Jezusin. Shkurtimi i tij është “LXX”.

**Sinaitikus.** Ky është një dorëshkrim greqisht i shekullit të katërt pas lindjes së Krishtit. U gjet nga studiuesi gjerman, Tischendorf, në manastirin e shën Katerinës në Xhebel Musa, vendi tradicional i malit Sinai. Ky dorëshkrim u emërtua me shkronjën e parë të alfabetit hebraik “alef” [א] .Përmban Dhjatën e Vjetër dhe atë të Re. Është një nga dorëshkrimet tona më të lashta uncialë.

**Sinonimik.** Ka të bëjë me terma që kanë kuptime të njëjta ose shumë të ngjashme (ndonëse, në realitet, dy fjalë nuk kanë kurrë mbivendosje të plotë semantike). Ato janë të lidhura kaq ngushtë sa që mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në fjali pa i humbur kuptimin. Ky term përdoret edhe për të përcaktuar një nga tri format e paralelizmit poetik hebre. Në këtë kuptim, u referohet dy rreshtave poetikë që shprehin të njëjtën të vërtetë (shih Psa. 103:3).

**Sintaksë.** Ky është një term greqisht që i referohet strukturës së fjalisë. Lidhet me mënyrat sesi bashkohen pjesët e fjalisë për të dhënë një mendim të plotë.

**Sintetik.** Ky është një nga tri termat që lidhet me llojet e poezisë hebraike. Ky term bën fjalë për ata rreshta poetikë që ndërtohen mbi njëri-tjetrin në mënyrë shtuese, nganjëherë, e quajtur “kulmore” (shih Psa. 19:7-9).

**Shkolla aleksandriane.** Kjo metodë e interpretimit biblik u zhvillua në Aleksandri të Egjiptit në shekullin e dytë pas Krishtit. Ajo përdor parimet interpretuese bazë të Filos, i cili ishte ndjekës i Platonit. Shpesh, ajo quhet metoda alegorike. Ajo mbizotëroi në kishë deri në kohën e Reformacionit. Përkrahësit më të aftë të saj ishin Origeni dhe Augustini. Shih Moises Silva, *Has The Church Misread The Bible?* (Academic, 1987).

**Shkolla antiokase.** Kjo metodë interpretimi biblik u zhvillua në Antioki të Sirisë në shekullin e tretë pas Krishtit si reagim ndaj metodës alegorike të Aleksandrisë në Egjipt. Thelbi bazë i saj ishte përqendrimi te kuptimi historik i Biblës. Ajo e interpretonte Biblën si letërsi normale dhe njerëzore. Kjo shkollë u përfshi në polemikën nëse Krishti kishte dy natyra (nestorianizmi) apo një natyrë (plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri). U shpall heretike nga kisha katolike e Romës dhe u zhvendos në Persi, por shkolla pati pak peshë. Më vonë, parimet e saj hermeneutike bazë u bënë parime interpretuese të reformatorëve klasikë të protestantizmit (Luteri dhe Kalvini).

**Shpirtërizim.** Ky term është sinonimik me alegorizimin, në kuptimin se përjashton kontekstin historik e letrar të pasazhit dhe interpreton në bazë të kriterëve të tjera.

**Talmudi.** Ky është titulli i kodifikimit të traditës gojore judaike. Judenjtë besojnë se Perëndia ia dha Moisiut në malin Sinai. Në të vërtetë, Talmudi duket se është urtësia kolektive e mësuesve judenj ndër vite. Ekzistojnë dy versione të ndryshme të shkruara të Talmudit: versioni babilonas dhe versioni më i shkurtër dhe i papërfunduar palestinas.

**Teksti Masoretik.** Kjo u referohet dorëshkrimeve hebraisht të Dhjatës së Vjetër në shekullin e nëntë, të prodhuara nga breza studiuesish judenj, të cilat përmbajnë pikësime zanoresh dhe të tjera shënime tekstuale. Ai përbën tekstin bazë për Dhjatën e Vjetër në gjuhën tonë. Teksti i tij është vërtetuar historikisht nga dorëshkrimet në hebraisht, sidomos Isaia, të njohura si Pergamenat e Detit të Vdekur. Shkurtohet si “MT”.

**Proof-texting ose “Teksti provë”.** Kjo është praktika e interpretimit të Shkrimit duke cituar një varg pa patur parasysh kontekstin e tij të atypëratyshëm apo kontekstin më të gjerë të njësisë së tij letrare. Kjo i largon vargjet nga synimi i autorit fillestar dhe, zakonisht, përfshin përpjekjen për të provuar një mendim personal duke pretenduar autoritet biblik.

**Tekstus Receptus.** Ky përcaktim u zhvillua në botimin e Dhjatës së Re greqisht prej Elzevirit më 1633 pas lindjes së Krishtit. Në thelb, kjo është një formë e Dhjatës së Re greqisht që u prodhua nga disa dorëshkrime të vona greqisht dhe versione latinisht të Erazmit (1510-1535), Stefanusit (1546-1599) dhe Elzevirit (1624-1678). Në *An Introduction to the Textual Criticism of the New Testament*, f. 27, A. T. Robertson thotë: “praktikisht, teksti bizantin është Textus Receptus”. Teksti bizantin është më pak i vlefshmi nga tre familjet e dorëshkrimeve të hershme greqisht (perëndimore, aleksandriane dhe bizantine). Ai përmban gabimet e akumuluar prej shekujsh të teksteve të kopjuara me dorë. Megjithatë, edhe A. T. Robertson thotë: “Textus Receptus ka ruajtur për ne një tekst, në thelb, të saktë” (f. 21). Kjo traditë e dorëshkrimeve greqisht (sidomos botimi i tretë i Erazmit i 1522) përbën bazën e përkthimit të King James Version më 1611.

**Teologji sistematike.** Kjo është një fazë interpretimi që përpiqet t’i lidhë të vërtetat e Biblës në mënyrë të unifikuar dhe logjike. Ajo përbën një paraqitje logjike, jo thjesht historike, të teologjisë së krishterë nëpërmjet kategorive (Perëndia, njeriu, mëkati, shpëtimi, etj.).

**Tipologjik.** Ky është një lloj i specializuar interpretimi. Zakonisht, nënkupton të vërtetën e Dhjatës së Re që gjendet në pasazhet e Dhjatës së Vjetër me anë të një simboli analogjik. Kjo kategori e hermeneutikës është element kryesor i metodës aleksandriane. Për shkak të abuzimit me këtë lloj interpretimi, duhet që përdorimin e tij t’ia rezervojmë vetëm shembujve të veçantë të regjistruar në Dhjatën e Re.

**Torah.** Ky është term hebraisht, që do të thotë “mësim”. U bë titulli zyrtar për shkrimet e Moisiut (Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë). Për judenjtë, është pjesa më e autoritetshme e kanonit hebre.

**Vatikanus.** Ky është dorëshkrimi greqisht i shekullit të katërt pas lindjes së Krishtit. U gjend në bibliotekën e Vatikanit. Në fillim, përmbante gjithë Dhjatën e Vjetër, Apokrifët dhe Dhjatën e Re. Sidoqoftë, disa pjesë humbën (Zanafilla, Psalmet, Hebrenjve, letrat pastorale, Filemoni dhe Zbulesa). Është dorëshkrim shumë i dobishëm për përcaktimin e fjalëve origjinale të autografeve. Është emërtuar me shkronjën e madhe “B”.

**Vulgata.** Ky është emri i përkthimit të Biblës në latinisht nga Jeronimi. Ai u bë përkthimi bazë, ose “i përbashkët”, i kishës katolike të Romës. U bë në vitet 380 pas lindjes së Krishtit.

**YHWH.** Ky është emri i Besëlidhjes i Perëndisë në Dhjatën e Vjetër. Përcaktohet tek Eksodi 3:14. Është forma KAUZATIVE e termit hebraisht “jam”. Judenjtë druheshin të shqiptonin emrin, që të mos e merrnin më kot; prandaj, e zëvendësonin me termin hebraisht Adonai, “zot”. Kështu u përkthye në anglisht ky emër besëlidhjeje.

**Zbulesa e natyrshme.** Kjo është një kategori e vetëzbulesës së Perëndisë ndaj njeriut. Ajo përfshin rendin e natyrshëm (Rom. 1:19-20) dhe ndërgjegjen morale (Rom. 2:14-15). Përmendet në Psa. 19:1-6 dhe Rom. 1-2. Duhet dalluar nga zbulesa e veçantë, e cila është vetëzbulesa e veçantë e Perëndisë në Biblën dhe, epërsisht, në Jezusin e Nazaretit.



Kjo kategori teologjike po ritheksohet nga lëvizja e “tokës së vjetër” ndër shkencëtarët e krishterë (p.sh., shkrimet e Hugh Ross). Ata e përdorin këtë kategori për të pohuar se gjithë e vërteta është e vërteta e Perëndisë. Natyra është derë e hapur për njohurinë rreth Perëndisë; është e ndryshme nga zbulesa e veçantë (Bibla). Ajo i jep shkencës moderne lirinë që të hulumtojë rendin natyror. Për mendimin tim, ajo përbën një mundësi të re të shkëlqyer për t’i dëshmuar botës së sotme shkencore në perëndim.

**Zbulesë.** Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia ka folur me njerëzimin. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

# SHPALLJE DOKTRINORE

S'është se dua t'ia di për shpalljet doktrimore apo kredot. Parapëlqej të pohoj vetë Biblën. Gjithsesi, e kuptoj se një shpallje besimi do t'u sigurojë atyre që s'më njohin një mënyrë për të vlerësuar këndvështrimin tim doktrinor. Në kohën tonë, të mbushur me kaq shumë gabime dhe mashtrime teologjike, ofroj shkurtimisht më poshtë përmbledhjen e teologjisë sime.

1. Bibla, si Dhjata e Vjetër ashtu dhe e Reja, është Fjala e frymëzuar, e pagabueshme, e autoritetshme dhe e përjetshme e Perëndisë. Ajo është vetëzbuluesja e Perëndisë, e shkruar nga njerëzit nën drejtimin e mbinatyrshëm hyjnor. Ajo është burimi ynë i vetëm i së vërtetës së qartë për Perëndinë dhe për synimet e Tij. Po kështu, ajo është burimi i vetëm i besimit dhe praktikës për kishën e Tij.
2. Ekziston vetëm një Perëndi i përjetshëm, krijues dhe shpengues. Ai është krijuesi i të gjitha gjërave, të dukshme dhe të padukshme. Ai e ka zbuluar Vetën si Perëndi i dashur dhe i dhembshur, ndonëse është edhe i paanshëm e i drejtë. Ai e ka zbuluar Vetën në tre persona të veçantë: Ati, Biri dhe Fryma; vërtet të veçantë por, megjithatë, të njëjtë për nga substanca.
3. Perëndia është aktivisht në kontroll të botës së Vet. Ekziston një plan i përjetshëm për krijimin e Tij, që është i pandryshueshëm, por edhe një plan i fokusuar tek individ, që lejon vullnetin e lirë njerëzor. Asgjë nuk ndodh pa njohurinë dhe lejen e Perëndisë, por, megjithatë, Ai lejon zgjedhje individuale ndër engjëjt dhe njerëzit. Jezusi është Njeriu i Zgjedhur i Atit dhe të gjithë janë potencialisht të zgjedhur në Të. Paranjohja e ngjarjeve nga ana e Perëndisë nuk i ul njerëzit në nivelin e një skenari të parashkruar dhe të paracaktuar. Të gjithë jemi përgjegjës për mendimet dhe veprat tona.
4. Njerëzimi, ndonëse i krijuar në shëmbëllimin e Perëndisë dhe i lirë nga mëkati, zgjodhi të ngrinte krye kundër Perëndisë. Ndonëse u tunduan nga një veprues i mbinatyrshëm, Adami dhe Eva ishin përgjegjës për egoizmin e tyre rebel. Kryengritja e tyre ka prekur njerëzimin dhe krijimin. Të gjithë kemi nevojë për mëshirën dhe hirin e Perëndisë, si për gjendjen tonë kolektive në Adamin, ashtu dhe për kryengritjen tonë të vullnetshme si individë.
5. Perëndia i ka siguruar njerëzimit të rënë një mënyrë faljeje dhe rimëkëmbjeje. Jezu Krishti, biri i pashoq i Perëndisë, u bë njeri, bëri një jetë të pamëkatë dhe, me anë të vdekjes së vet zëvendësuese, pagoi dënimin për mëkatin e njerëzimit. Ai është e vetmja rrugë për rimëkëmbjen dhe bashkësinë me Perëndinë. Nuk ka mënyrë tjetër shpëtimi përveçse përmes besimit në veprën e përfunduar të Tij.
6. Secili prej nesh duhet të pranohet personalisht ofertën e faljes së Perëndisë dhe rimëkëmbjes në Jezusin. Kjo arrihet me anë të besimit të vullnetshëm në premtimet e Perëndisë përmes Jezusit, duke i kthyer vullnetshëm shpinën mëkateve të njohura.
7. Të gjithë ne falemi dhe rimëkëmbemi plotësisht në bazë të besimit në Krishtin dhe pendimit nga mëkati. Sidoqoftë, provat për këtë marrëdhënie të re shihen në jetën e ndryshuar dhe në ndryshim e sipër të besimtarit. Synimi i Perëndisë për njerëzimin nuk është vetëm qielli dikur në të ardhmen, por ngjashmëria me Krishtin tani. Ata që janë vërtet të shpenguar, ndonëse mëkatojnë ndonjëherë, do të vazhdojnë me besim dhe pendim gjatë gjithë jetës.
8. Fryma e Shenjtë është "Jezusi tjetër". Ai është i pranishëm në botë për të drejtuar të humburit të Krishti dhe për të zhvilluar ngjashmërinë me Krishtin të shpëtuarit. Dhuntitë e Frymës jepen kur shpëtohem. Ato janë jeta dhe shërbesa e Jezusit, të ndara brenda trupit të Tij, kishës. Dhuntitë, të cilat në thelb janë qëndrimet dhe motivet e Jezusit, duhen motivuar me anë të frytit të Frymës. Fryma është po aq veprues në kohën tonë sa dhe në kohët biblike.
9. Ati e ka bërë Jezu Krishtin e ringjallur Gjykatës të të gjitha gjërave. Ai do të kthehet në tokë për të gjykuar gjithë njerëzimin. Ata që kanë besuar në Jezusin, emrat e të cilëve janë në librin e jetës së Qengjit, do të marrin trupa të përlëvdur dhe të përjetshëm kur të kthehet Ai. Ata do të jenë përjetësisht me të. Ndërsa ata që s'kanë pranuar t'i përgjigjen së vërtetës së Perëndisë do të ndahen përjetësisht nga gëzimet e bashkësisë me Perëndinë Triun. Ata do të dënohen së bashku me Djallin dhe engjëjt e tij.

Sigurisht, kjo nuk është as e plotë, as tërësore, por shpresoj se do t'ju japë sadopak ngjyrimin teologjik të zemrës sime. Mua më pëlqen shprehja:

"Në thelbësoret – unitet; në jothelbësoret – liri; në gjithçka – dashuri".